

*Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut*

BOTIMI I KATËRT

Titulli i librit: **Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut**. Botimi IV

Autor: LEDI BIANKU, ODETA KUMBARO

Arti Grafik: Dritan Lleshi

Shtypur në shtypshkronjën Tipografia Dollonja

International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-4432-4-3

---

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Promovimi i standardeve evropiane të të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe Kosovë”, zbatuar nga Qendra Europiane me mbështetjen e Mbretërisë së Holandës.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk shprehin qendrim zyrtar të Mbretërisë së Holandës dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ato janë të gjitha nën përgjegjësinë juridike dhe profesionale të autorit.

© **Qendra Europiane dhe Mberetëria e Holandës**

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, etj., pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

**Qendra Europiane**

Rr. “Vaso Pasha”  
P. 20, Ap. 57, 1001  
Tiranë, Shqipëri  
[www.euro-centre.eu](http://www.euro-centre.eu)

**Ambasada e Mbretërisë së Holandës**

Zyra e Shtetit të së Drejtës për Ballkanin  
Simina 29, 11000  
Beograd, Serbi

LEDI BIANKU  
ODETA KUMBARO

JURISPRUDENCA  
E GJYKATËS  
SË STRASBURGUT

- BOTIMI I KATËRT -



TIRANË, 2017



# Përmbajtja

---

PARATHËNIE.....	..vx
-----------------	------

## **NENI 1** Detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut

LOIZIDOU kundër TURQISË.....	2
BANKOVIĆ DHE TË TJERË kundër BELGIKËS DHE 16 SHTETEVE TË TJERA ANËTARE.....	8
ILAŞCU DHE TË TJERË kundër MOLDAVISË DHE RUSISË.....	12
BEHRAMI DHE BEHRAMI kundër FRANCËS DHE SARAMATI kundër FRANCËS, GJERMANISË DHE NORVEGJISË.....	18
BIJELIC kundër MALIT TË ZI DHE SERBISË.....	23
AL-SKEINI DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	27
JALOUUD kundër HOLANDËS.....	33
AZEMI kundër SERBISË.....	36

## **NENI 2** E drejta për jetën

### **I. NOCIONET BAZË**

#### *a) Mbrojtja e jetës me ligj*

MCCANN DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	42
MASTROMATTEO kundër ITALISË.....	49

#### *b) Detyrimet pozitive*

ÖNERYILDIZ kundër TURQISË.....	52
BUDAYEVA DHE TË TJERËT kundër RUSISË.....	57
BRANKO TOMAŠIĆ DHE TË TJERË kundër KROACISË.....	62
R.R. DHE TË TJERË kundër HUNGARISË.....	64

### **II. ASPEKTET MATERIALE**

#### *a) Dënimi me vdekje*

AL-SAADON DHE MUFDHI kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	67
---	----

#### *b) Përdorimi i forcës vdekjeprurëse*

NACHOVA DHE TË TJERË kundër BULLGARISË.....	73
GIULIANI DHE GAGGIO kundër ITALISË.....	79
ÇELNIKU kundër GREQISË.....	87

#### *c) Persoant nën kujdesin e autoriteteve*

PAUL & AUDREY EDWARDS kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	90
ANGUELOVA kundër BULLGARISË.....	95

#### *d) Dhuna në familje*

OPUZ kundër TURQISË.....	99
--------------------------	----

#### *e) Trajtimi mjekësor*

VO kundër FRANCËS.....	106
CALVELLI & CIGLIO kundër ITALISË.....	108

<i>f) Ndihma për vetëvrasje</i>	
PRETTY kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	113
<i>g) Kujdesi për të miturit</i>	
QENDRA PËR BURIME LIGJORE NË EMËR TË VALENTIN CAMPEANU kundër RUMANISË.....	119
NENCHEVA DHE TË TJERË kundër BULLGARISË.....	124
<i>h) Zhdukja e personave</i>	
VARNAVA DHE TË TJERË kundër TURQISË.....	130

## II. ASPEKTET PROCEDURALE TË SË DREJTËS PËR MBROJTJEN E JETËS

BAZORKINA kundër RUSISË.....	135
TANLI kundër TURQISË.....	139
SILIH kundër SLOVENISË.....	144
SHOQATA “21 DHJETOR 1989” DHE TË TJERË kundër RUMANISË.....	149
HUGH JORDAN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	155

## NENI 3 Ndalimi i torturës

### I. NOCIONET BAZË

<i>a) Ndalimi i akteve të torturës ose keqtrajtimit</i>	
IRLANDA kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	160
TOMASI kundër FRANCËS.....	164
SVINARENKO DHE SLYADNEV kundër RUSISË.....	168
<i>b) Detyrimet pozitive</i>	
O’KEEFFE kundër IRLANDËS.....	175

### II. ASPEKTET MATERIALE

<i>a) Tre nocionet themelore</i>	
<i>i. Tortura</i>	
KAÇIU DHE KOTORRI kundër SHQIPËRISË.....	179
EL MASRI kundër REPUBLIKËS ISH-JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË.....	185
<i>ii. Trajtimi çnjerëzor</i>	
REHBOCK kundër SLOVENISË.....	192
GÄFGEN kundër GJERMANISË.....	196
<i>iii. Trajtimi ose ndëshkimi degradues</i>	
VAN DER VEN kundër HOLANDËS DHE LORSÉ DHE TË TJERË kundër HOLANDËS.....	202
DULAŞ kundër TURQISË.....	206
<i>b) Situatat konkrete</i>	
KALASHNIKOV kundër RUSISË.....	209
RAMIREZ SANCHEZ kundër FRANCËS.....	213
TYRER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	217
DOUGOZ kundër GREQISË.....	220
PEERS kundër GREQISË.....	223
DYBEKU kundër SHQIPËRISË.....	225
ALEKSANYAN kundër RUSISË.....	231

SOERING kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	235
CRUZ VARAS DHE TË TJERË kundër SUEDISË.....	240
J.K. DHE TË TJERË kundër SUEDISË.....	245
PAPOSHVILI kundër BELGJIKËS .....	250

### III. ASPEKTET PROCEDURALE

HENAF kundër FRANCËS.....	255
PRICE kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	257
HILAL kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	260
M. DHE M. kundër KROACISË.....	263
JALOUD kundër HOLANDËS.....	268

### ENI 4 *Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar*

SILIADIN kundër FRANCËS .....	274
VAN DER MUSSELE kundër BELGJIKËS.....	278
CHOWDURY DHE TË TJERË kundër GREQISË.....	281

### ENI 5 *E drejta për liri dhe siguri*

#### I. PARIMET E PËRGJITHSHME

##### a) *Fusha e veprimit*

ENGEL DHE TË TJERË kundër HOLANDËS.....	288
---	-----

##### b) *Natyra e ndërhyrjes*

GILLAN DHE QUINTON kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	292
---	-----

#### II. LIGJSHMËRIA E NDALIMIT

GRORI kundër SHQIPËRISË.....	296
LAWLESS kundër IRLANDËS.....	301

#### III. HEQJA E AUTORIZUAR E LIRISË

D.G. kundër IRLANDËS.....	305
DE WILDE, OOMS & VERSYP kundër BELGJIKËS.....	309
MIHAILOVS kundër LETONISË.....	316
ČONKA kundër BELGJIKËS.....	319
LOULED MASSOUD kundër MALTËS.....	324
LAZOROVSKI kundër ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË.....	328
ASSENOV kundër BULLGARISË.....	331
MILOŠEVIĆ kundër SERBISË.....	336
BROGAN DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	338
SHANNON kundër LETONISË.....	343
CAMPBELL DHE FELL kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	346
MURRAY kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	351
GUSINSKIY kundër RUSISË.....	355
LAVENTS kundër LETONISË.....	358
YANKOV kundër BULLGARISË.....	363

**NENI 6** E drejta për një proces të rregullt**I. GARANCITË E PËRGJITHSHME PËR INDIVIDËT***a) E drejta për t'iu drejtuar një gjykatë*

KREUZ kundër POLONISË.....	370
MARINI kundër SHQIPËRISË.....	373
<i>i. Në fushën civile</i>	
GOLDER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	382
KUTIĆ kundër KROACISË.....	386
CRIŞAN kundër RUMANISË.....	388
<i>ii. Në fushën penale</i>	
ANAGNOSTOPOLOUS kundër GREQISË.....	390
MCELHINNEY kundër IRLANDËS, AL-ADSANI kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR DHE FOGARTY kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	393
A kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	401
CORDOVA kundër ITALISË.....	404
LAUKO kundër SLLOVAKISË.....	408
TRUHLI kundër KROACISË.....	413

*b) Kriteret institucionale**i. Pavarësia dhe paañësia*

DAUTI kundër SHQIPËRISË.....	414
DEVLIN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	417

*ii. Juridiksionet jogjyqësore*

COOPER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR DHE GREVIES kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	420
--	-----

*c) Kërkesat procedurale**i. Procedura e rregullt**i.i. Në civile*

PELLEGRINI kundër ITALISË.....	425
KLEYN DHE TË TJERË kundër HOLANDËS.....	429
PLATAKOU kundër GREQISË.....	432
C.G. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	434

*i.ii. Në penale*

PAPON kundër FRANCËS.....	436
OMAR OTHMAN (ABU QATADA) kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	439

*ii. Publiciteti i procedurës**ii.i. Në penale*

CRAXI kundër ITALISË (NR. 2).....	443
-----------------------------------	-----

*iii. Kohëzgjatja e procedurës**iii.i Në civile*

TIMOFEYEV kundër RUSISË.....	447
RAJAK kundër KROACISË.....	449

*iv. Ekzekutimi i vendimeve përfundimtare*

HORNSBY kundër GREQISË.....	450
QUFAJ CO. SH.P.K. kundër SHQIPËRISË.....	455



**II. GARANCITË E VEÇANTA PËR TË AKUZUARIT***a) Presumimi i pafajësisë*

ALLENET DE RIBEMONT kundër FRANCËS.....	461
HEANEY DHE MCGUINNESS kundër IRLANDËS DHE QUINN kundër IRLANDËS.....	465
LAMANNA kundër AUSTRISË.....	468

*b) E drejta e mbrojtjes*

GOTH kundër FRANCËS.....	469
TELFNER kundër AUSTRISË.....	471
VAUDELLE kundër FRANCËS.....	472

*c) Mbrojtësi i zgjedhur*

LANZ kundër AUSTRISË.....	474
ARTICO kundër ITALISË.....	476
GUTFREUND kundër FRANCËS.....	479
EZEH DHE CONNORS kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	481
BRENNAN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	485
KARATAS DHE SARI kundër FRANCËS.....	487
BALLIU kundër SHQIPËRISË.....	489

*d) Pyetja e dëshmitarëve*

DESTREHEM kundër FRANCËS.....	494
LUCA kundër ITALISË.....	496
SOLAKOV kundër ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË.....	499
RACHDAD kundër FRANCËS.....	502

**NENI 7 Nuk ka dënim pa ligj****I. NULLA POENA SINE LEGE 7 § 1***a) Dënim në përputhje me ligjin*

WELCH kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	506
S.W. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	508
VEEBER kundër ESTONISË (NR. 2).....	511

*b) Ndalimi i një dënimi më të rëndë*

ALIMUÇAJ kundër SHQIPËRISË.....	513
---------------------------------	-----

**II. NENI 7 § 2**

STRELETZ, KESSLER DHE KRENZ kundër GJERMANISË DHE K-H. W kundër GJERMANISË.....	516
---	-----

**NENI 8 E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare****I. E DREJTA PËR RESPEKTIMIN E JETËS PRIVATE***a) E drejta e intimitetit të jetës private*

X DHE Y kundër HOLANDËS.....	524
GLASS kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	527
WORWA kundër POLONISË.....	531
M.C. kundër BULLGARISË.....	533

<i>b) Të dhënat personale</i>	
S. DHE MARPER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	537
M.G. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	540
MIKULIĆ kundër KROACISË.....	543
ANTUNES ROCHA kundër PORTUGALISË.....	547
<i>c) Identiteti etnik</i>	
CHAPMAN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR, COSTER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR, BEARD kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR, LEE kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR DHE SMITH kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	550
SLIVENKO kundër LETONISË.....	554
<i>d) Mbikqyrje në hapësirat publike</i>	
PECK kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	558
<i>e) Integriteti fizik</i>	
K.H. DHE TË TJERË kundër SLOVAKISË.....	562
<i>f) Imazhi</i>	
VON HANNOVER kundër GJERMANISË.....	565
REKLOS DHE DAVOURLIS kundër GREQISË.....	569
<i>g) Identiteti seksual</i>	
DUDGEON kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	571
<i>h) E drejta e respektimit të banesës</i>	
HATTON DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	575
FADEYEVA kundër RUSISË.....	580
PIBERNIK kundër KROACISË.....	583
CONNORS kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	585
<i>i) Banesa dhe Sekreti Profesional</i>	
NIEMIETZ kundër GJERMANISË.....	589
COLAS EST DHE TË TJERË kundër FRANCËS.....	593
<i>j) Telefoni/ përgjimet</i>	
KLASS DHE TË TJERË kundër GJERMANISË.....	595
KRUSLIN kundër FRANCËS, DHE HUVIG kundër FRANCËS.....	599
P.G. DHE J.H. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	603

## II. JETA FAMILJARE

<i>a) Marrëdhëniet prindërore</i>	
MARCKX kundër BELGJIKËS.....	607
SAHIN kundër GJERMANISË, SOMMERFELD kundër GJERMANISË DHE HOFFMAN kundër GJERMANISË.....	611
HANSEN kundër TURQISË.....	615
T.P. DHE K.M. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	618
BAJRAMI kundër SHQIPËRISË.....	622
ZORICA JOVANOVIĆ kundër SERBISË.....	624

<i>b) Minorenët</i>	
K DHE T kundër FINLANDËS.....	627
PINI DHE BERTANI & MANERA DHE ATRIPALDI kundër RUMANISË.....	632
<i>c) Të huajt</i>	
BELDJOUDI kundër FRANCËS.....	635
BOULTIF kundër ZVICRËS.....	639
RADOVANOVIC kundër AUSTRISË.....	641

## **NENI 9** *Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë*

### **I. MANIFESTIMI I BESIMIT**

KOKKINAKIS kundër GREQISË.....	646
ŞAHIN kundër TURQISË.....	650

### **II. VENDET E KULTIT OSE TE BESIMIT**

MANOUSSAKIS DHE TË TJERË kundër GREQISË.....	654
--	-----

### **III. KISHAT DHE KOMUNITETET FETARE**

KISHA MITROPOLITE E BESARABISË DHE TË TJERË kundër MOLDAVISË.....	658
SERIF kundër GREQISË.....	661

## **NENI 10** *Liria e Shprehjes*

### **I. PARIMET E PËRGJITHSHME**

AXEL SPRINGER kundër GJERMANISË DHE VON HANNOVER (2) kundër GJERMANISË.....	666
---	-----

### **II. BOTIMET**

#### *a) Ndalimi i botimit*

HANDYSIDE kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	671
SHOQATA EKIN kundër FRANCËS.....	674
SUNDAY TIMES kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	679
COUDERC DHE HACHETTE FILIPACCHI ASSOCIÉS kundër FRANCËS.....	683

#### *b) Dënim penal*

LINGENS kundër AUSTRISË.....	687
JUPPALA kundër FINLANDËS.....	689

#### *c) E drejta e informimit*

GSELL kundër ZVICRËS.....	691
---------------------------	-----

#### *d) Sekuestrimi i materialeve të gazetarëve*

COLOMBANI DHE TË TJERË kundër FRANCËS.....	694
--	-----

### **III. FUNKSIONI PUBLIK/PUSHIMI NGA PUNA**

#### *a) Funkionarët*

AMIHALACHIOAIE MIHALACHIOAIE kundër MOLDAVISË.....	697
--	-----

#### *b) Të zgjedhurit*

CASTELLS kundër SPANJËS.....	699
RADIO FRANCE kundër FRANCËS.....	702

c) <i>Dënim i një avokati për shpifje ndaj gjyqtarëve</i>	
NIKULA kundër FINLANDËS.....	706

**IV. AUDIOVIZUALI**

OTTO - PREMINGER - INSTITUT kundër AUSTRISË.....	710
--	-----

**NENI 11** *Liria e tubimit dhe e organizimit*

**I. LIRIA E GREVËS**

SINDIKATA KOMBËTARE E PUNËTORËVE TË HEKURUDHAVE, DETAR DHE TË TRANSPORTIT kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	718
--	-----

**II. LIRIA E ORGANIZIMIT**

a) *Themelimi i shoqatave*

STANKOV DHE ORGANIZATA E BASHKUAR MAQEDONASE ILINDEN kundër BULLGARISË.....	722
APPLEBY DHE TË TJERËT kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	725
SIGURDUR A. SIGURJÓNSSON kundër ISLANDËS.....	728

**III. ROLI I SHOQATAVE**

a) *Përkatësia në shoqata*

MAESTRI kundër ITALISË.....	733
-----------------------------	-----

b) *Shpërbërja e shoqatave*

REFAH PARTISI DHE TË TJERË kundër TURQISË.....	736
--	-----

**NENI 13** *E drejta për ankim efektiv*

EGMEZ kundër QIPROS.....	740
--------------------------	-----

**NENI 14** *Ndalimi i diskriminimit*

SALGUEIRO DA SILVA MOUTA kundër PORTUGALISË.....	746
KUOA POIRREZ kundër FRANCËS.....	748
FABRIS kundër FRANCËS.....	750
X DHE TË TJERË kundër AUSTRISË.....	754

**NENI 18** *Kufiri i zbatueshmërisë së kufizimeve të të drejtave*

TYMOSHENKO kundër UKRAINËS.....	760
---------------------------------	-----

**PROTOKOLLI 1 NENI 1** *Mbrojtja e Pronës*

**I. NOCIONET KRYESORE**

SPORRONG DHE LÖNNROTH kundër SUEDISË.....	766
BOSPHORUS AIRËAYS kundër IRLANDËS.....	771
HUTTEN-CZAPSKA kundër POLONISË.....	775

*a) Kompensimi në nivel të brendshëm*

PIALOPOULOS DHE TË TJERË kundër GREQISË.....	779
VASILIU kundër RUMANISË, HODOŞ kundër RUMANISË DHE SURPACEANU kundër RUMANISË.....	780
WITTEK kundër GJERMANISË.....	783
JASIÛNIENË kundër LITUANISË.....	786
VASILESCU kundër RUMANISË.....	789

**PROTOKOLLI 1 NENI 2** *E drejta për arsimim*

ÇËSHTJA GJUHËSORE BELGE.....	794
------------------------------	-----

**PROTOKOLLI 1 NENI 3** *E drejta për zgjedhje të lira*

PODKOLZINA kundër LETONISË.....	802
ZDANOKA kundër LETONISË.....	804
AZIZ kundër QIPROS.....	807
SITAROPOULOS DHE GIAKOPOULOS kundër GREQISË.....	811
SEJDIC DHE FINCI kundër BOSNJE-HERCEGOVINËS.....	813
HIRST kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR.....	816
YUMAK DHE SADAK kundër TURQISË.....	820
PARTIA DEMOKRATIKE E BASHKUAR RUSE YABLOKO kundër RUSISË.....	823

**PROTOKOLLI 4 NENI 2** *Liria e Lëvizjes*

BAUMANN kundër FRANCËS.....	828
NAPIJALO kundër KROACISË.....	829
HIRSI JAMAA DHE TË TJERË kundër ITALISË.....	832
KHLAIFIA DHE TË TJERË kundër ITALISË.....	836

**NENI 34** *Kërkesa individuale*

DYBEKU kundër SHQIPËRISË.....	844
-------------------------------	-----

**NENI 35** *Kushtet e pranueshmërisë*

XHAVARA DHE PESËMBËDHJETË TË TJERË kundër ITALISË DHE SHQIPËRISË.....	852
NAUMOV kundër SHQIPËRISË.....	857
AZINAS kundër QIPROS.....	862

**NENI 37** *Çregjistrimi*

STOJANOVIĆ kundër SERBISË.....	868
--------------------------------	-----

**NENI 46** *Forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve*

VEREIN GEGEN TIERFABRIKEN SCHWEIZ (VGT) kundër ZVICRËS (NR. 2).....	872
---	-----

BIBLIOGRAFIA E PËRGJITHSHME.....	875
----------------------------------	-----



# Parathënie

I nderuar lexues,

Ky botim i katërt i librit “Jurisprudenca e Strasburgut” vjen 10 vjet pas botimit të fundit më 2007. Shumë gjëra kanë ndryshuar dhe janë zhvilluar që atëherë dhe ndër to pa dyshim shumë elementë, që kanë të bëjnë me këtë botim. Nga njëra anë ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme vetë jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut dhe nocione themelore të funksionimit të Konventës, duke nisur që nga juridiksioni, sipas nenit 1, e deri tek ndalimi i dënimit me vdekje në çdo rrethanë, sipas protokollit të fundit me dispozita materiale, atij 13 duke fituar dimensione të reja me ndikim të jashtëzakonshëm në jetën dhe të drejtat e individëve dhe në detyrimet korresponduese të 47 shteteve anëtare.

Nga ana tjetër kanë ndryshuar së tepërmi dhe në pjesën më të madhe pozitivisht, njohuritë e juristëve shqiptarë por edhe opinionin publik në Shqipëri në lidhje me jurisprudencën e Gjykatës. Qëllimi i këtij botimi është, ashtu si paraardhësit, të ndihmojë në kuptimin e atyre standardeve, që siç është theksuar edhe në botimin pararendës përbëjnë bazat e rendit publik evropian. Ky botim me anë të vendimeve konkrete dhe analizës së tyre synon t’i ofrojë gjyqtarëve, prokurorëve dhe të gjithë juristëve në Shqipëri një panoramë të përmbledhur të asaj, që sot pa frikë mund të konsiderohet si produkti jurisprudencial më masiv në nivel evropian, që udhëheq dhe kushtëzon veprimin e të gjithë juristëve në të gjitha shtetet anëtare.

Dilema kryesore në përgatitjen e këtij botimi ka qënë ajo se cilat vendime duhen zgjedhur. Megjithëse, përgatitja e tij ka praktikisht 10 vjet që ka filluar, ku çdo vendim të ri e klasifikonim në funksion të rëndësisë dhe mesazhit duke pasur për bazë botimin e tretë të librit në vitin 2007. Gjatë gjithë këtyre viteve kemi mbledhur materiale doktrinale dhe mbajtur shënime për debatet, që zhvilloheshin në lidhje me çdo vendim, përfshirë edhe kritikën. Ndaj në fund ishte tepër e vështirë për një numër të konsiderueshëm prej tyre që t’i linim jashtë botimit. Megjithatë, ishte e pamundur ndryshe. Pas një analize dhe diskutimesh të vazhdueshme mendojmë se kjo përmbledhje, që po ofrojmë jep një kuadër solid të zhvillimeve jurisprudenciale në Strasburg. Jemi të ndërgjegjshëm se kjo është vetëm një etapë dhe zhvillime të tjera do të vijojnë.

Duke u ndalur tek falenderimet, do ta fillonim me Ambasadën e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri dhe me të gjithë personelin e saj shumë bashkëpunues. Falenderimet nuk iu drejtohen thjesht sepse bënë të mundur këtë botim. Personeli i Ambasadës, duke filluar nga Ambasadorja Dewi van de Weerd, kishin kuptuar më së miri nevojën për një zbatim më të mirë të standardeve të

KEDNJ në Shqipëri dhe ishin tepër të hapur e bashkëpunues në gjetjen e formatit më të mirë për të drejtuar në këtë botim. Kjo nuk është lehtësisht e pranishme tek të gjithë donatorët. Mbështetja e tyre ishte vërtet për atë, që juristët shqiptarë e mendonin si më të mirë për punën e tyre. Zgjedhja e këtij formati si përmbledhje jurisprudenciale nuk është bërë thjesht sepse plotësonte formatet e shkuara, por sepse diskutimet e shumta gjatë viteve me gjyqtarë shqiptarë në të gjitha nivelet, prokurorë, studentë, avokatë dhe njerëz të ndryshëm na kishin shprehur nevojën për një përditësim të botimit të vitit 2007 por duke ruajtur atë format, si të thjeshtë, konkret dhe të zbatueshëm në punën e përditshme. Na duhet t'i falenderojmë edhe të gjithë ata kolegë dhe miq juristë, por edhe gazetarë e jo vetëm, interesat dhe shqetësimet profesionale të të cilëve na kanë ndihmuar për të përcjellë me këtë përmbledhje mesazhet, që menduam se reflektojnë më mirë shqetësimet e shoqërisë dhe të profesionistëve shqiptarë mbi problemet ligjore që trajtohen nga Konventa. Në fakt zgjedhja, që kemi bërë reflekton jo vetëm vendimet më të rëndësishme të Gjykatës gjatë historisë së saj, por në mënyrë të vetëdijshme janë shtuar edhe vendime me një rëndësi specifike për kontekstin shqiptar.

Nga ana tjetër ky botim do të kishte qenë thjesht i pamundur pa rolin e Qendrës Europiane. Puna intensive dhe e palodhur e Klara Kodrës, Lorena Goxhobellit dhe Ina Xhepës, për realizimin e një pjese të madhe të pëmbledhjeve, që përfshihen në botim ka qenë themelore për qëllimet e realizimit të tij. Na duhet gjithashtu të falenderojmë edhe të gjithë ata kolegë në Gjykatën e Strasburgut ose në organe të tjera të Këshillit të Evropës që me sugjerimet dhe komentet e tyre përgjatë viteve na kanë ndihmuar për përzgjedhjen e vendimeve dhe komentimin e tyre.

Një ndihmë e veçantë i duhet njohur gjithashtu Institutit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut, ose siç njihet ndryshe Instituti René Cassin dhe Presidenit të saj Jean-Paul Costa, ish President i Gjykatës së Strasburgut për mbështetjen dhe këshillat në përgatitjen e këtij botimi. Gjithashtu, nuk mund të lemë pa përmendur të gjithë ata kolegë dhe miq që kanë bashkëpunuar në përgatitjen e botimeve të mëparshme, pasi kontributi i tyre në një mënyrë ose në një tjetër ka ndihmuar edhe në përgatitjen e këtij botimi të katërt.

Shpresojmë që ky botim do të ndihmojë në jetësimin e këtyre standardeve mbi të drejtat e njeriut, që nga shumë autorë konsiderohen si më të përpunuarit edhe në nivel botëror.

Ledi Bianku  
 Odeta Kumbaro  
*Strasburg, nëntor 2017*



# NENI 1

**DETYRIMI PËR TË RESPEKTUAR  
TË DREJTAT E NJERIUT**

## LOIZIDOU kundër TURQISË

(kërkesa nr. 15318/89)

23 mars 1995

*ky vendim trajton çështjen e juridiksionit de facto të një shteti anëtar të Konventës edhe në lidhje me territore që nuk janë njohur formalisht si territore të atij shteti*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkesja është rritur në Kyrenia, në veri të Qipros, ku ajo kishte në pronësi disa troje. Më 1972 ajo u martua dhe shkoi për të banuar bashkë me të shoqin në Nikosia. Që më 1974 ajo pretendonte se ishte penguar që të shkonte në pronat e saj të lartpërmendura si rezultat i prezencës së forcave turke në Qipro.

2. Në 19 mars 1989, një grup grash greko-qipriote, i quajtur «Gratë drejt shtëpisë», organizuan një marshim me qëllimin e shpallur që më parë, të kapërcimit të vijës së zjarrit të forcave turke. Që nga Nikosia demonstruesit u drejtuan në fshatin Lymbia, ku një grup arriti që të kapërcejë postbllokun dhe vijën e forcave turke. Disa prej grave, përfshirë edhe znj. Loizidou, u arrestuan nga policë turko-qipriot. Më pas, në të njëjtën ditë, ato iu dorëzuan zyrtarëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (U.N.F.I.C.Y.P.) në Nikosia dhe u kaluan në zonën e Qipros greke.

3. Qeveria turke paraqiti, në formën e prapësimeve paraprake, *inter alia*, pretendimin që çështja dilte jashtë juridiksionit të Gjykatës për shkak se ajo kishte të bënte me fakte dhe ngjarje, të cilat kishin ndodhur përpara datës (22 janar 1990) së deklaratës së qeverisë turke për pranimin e juridiksionit të Gjykatës, sipas nenit 46 (pra, prapësim *ratione temporis*<sup>1</sup>) dhe nuk lidhej me çështje që kishin të bënin me territorin e marrë në konsideratë nga kjo deklaratë (prapësim *ratione loci*<sup>2</sup>). Kërkesa iu paraqit Komisionit më 22 korrik 1989 dhe u deklarua e pranueshme më 4 mars 1991.

4. Pasi u përpoq të arrinte një zgjidhje me pajtim, por pa sukses, Komisioni hartoi një raport më 8 korrik 1993 në të cilin ai parashtronte faktet dhe shprehte mendimin se nuk kishte pasur shkelje të: nenit 3 (me unanimitet); nenit 8 përsa i përket jetës private të kërkuases (njëmbëdhjetë vota pro, dy kundër); nenit 5 § 1

1 *Ratione temporis* - term me origjinë latine i përdorur gjerësisht sidomos nga e drejta ndërkombëtare dhe që do të thotë "kompetenca kohore"

2 *Ratione loci* - term me origjinë latine i përdorur gjerësisht sidomos nga e drejta ndërkombëtare dhe që do të thotë "kompetenca territoriale", "kompetenca vendore"

(nëntë vota pro, katër kundër); nenit 8 përsa i përket banesës së kërkueses (nëntë vota pro, katër kundër); dhe nenit 1, të Protokollit 1 (tetë vota pro, një kundër).

5. Çështja i ishte parashtruar Gjykatës nga ana e qeverisë së Republikës së Qipros në bazë të nenit 48 (b) të Konventës, përsa i përket ndërhyrjes së pretenduar në të drejtat e pronësisë së kërkueses (neni 1, i Protokollit 1 dhe neni 8 i Konventës).

## II. Vendimi i Gjykatës

### *A. Në lidhje me cilësinë për të dalë si palë paditëse të qeverisë kërkuese*

6. Sido që të jetë, njohja e një qeverie kërkuese nga ana e një qeverie të paditur nuk është kërkesë paraprake as në lidhje me fillimin e një çështjeje në bazë të nenit 24 të Konventës dhe as në lidhje me parashtrimin e çështjes Gjykatës në bazë të nenit 48. Në qoftë se do të ishte kështu, sistemi i garancisë kolektive, i cili është edhe element thelbësor i mekanizmit të Konventës, do të arrinte në praktikë deri në neutralizim duke u nisur nga loja e njohjes reciproke ndërmjet shteteve dhe qeverive të ndryshme.

### *B. Në lidhje me abuzimin e pretenduar në lidhje me procedurën*

7. Në masën që përjashtimi ishte drejtuar kundër qeverisë kërkuese, Gjykata vuri në dukje që ky i fundit i ishte drejtuar asaj për arsye, ndërmjet të tjerash, të shqetësimit për të drejtat e znj. Loizidou dhe të qytetarëve të tjerë që ndodheshin në të njëjtën situatë. Prandaj, Gjykata, në këtë rast nuk vërejtí ndonjë abuzim me procedurën.

### *C. Mbi rolin e qeverisë turke në çështje*

8. Gjykata çmoi se i përkiste një pale kontraktuese të Konventës që të cilësonte sipas mënyrës së vet statusin e saj në një çështje përpara vetë Gjykatës. Ajo vuri në dukje se çështja në fjalë merrte shkas nga një kërkesë e paraqitur në bazë të nenit 25 nga ana e znj. Loizidou kundër Turqisë si palë e lartë kontraktuese në Konventë dhe që asaj i ishte paraqitur nga një tjetër palë e lartë kontraktuese në bazë të nenit 48 (b).

### *D. Në lidhje me objektin e seancës gjyqësore*

9. Në kërkesën e saj paraqitur Gjykatës në bazë të nenit 48 (b) qeveria kërkuese e kufizonte objektin e kërkesës duke kërkuar marrjen e një vendimi vetëm në lidhje me pretendimet e ngritura në bazë të nenit 1, të Protokollit 1 dhe të nenit 8, për aq sa ato ishin deklaruar të pranueshme nga ana e Komisionit në lidhje me pengimin e kërkueses për të shkuar në pronat e veta. Prandaj, ishin vetëm këto pretendime që ishin për shqyrtim përpara Gjykatës.

### *E. Në lidhje me prapësimet e mungesës së kompetencës racione loci*

a) Në lidhje me pyetjen që ngrihej nëse faktet e denoncuar nga ana e kërkueses ishin të një natyre të tillë që ngrinin çështjen e juridiksionit të Turqisë në bazë të nenit 1 të Konventës.

10. Gjykata kujtoi në këtë kuadër që, në qoftë se neni 1 përcaktonte disa kufij fushës së veprimit të Konventës, nocioni i «juridiksionit» sipas kuptimit të kësaj dispozite nuk kufizohet aspak në territorin shtetëror të palëve të larta kontraktuese. Për shembull, sipas një jurisprudence të konsoliduar, ekstradimi ose dëbimi i një personi nga një shtet palë mund të ngrejë një problem në lidhje me nenin 3, pra, të përcaktojë përgjegjësinë e shtetit në fjalë në bazë të Konventës. Për më tepër, përgjegjësia e palëve kontraktuese mund të përfshihet për shkak të akteve që kanë si autorë organet e tyre dhe që i krijojnë pasojat e tyre në, ose edhe jashtë territorit të vetë palëve të larta kontraktuese. Duke mbajtur parasysh objektin dhe qëllimin e Konventës, përgjegjësia e një pale kontraktuese mund të përcaktohet gjithashtu kur, pas një veprimi ushtarak - të ligjshëm apo jo - ajo ushtron në praktikë kontrollin e saj në një zonë të vendosur jashtë territorit të saj shtetëror. Detyrimi për të siguruar në një zonë të tillë respektimin e të drejtave dhe të lirive të garantuara nga ana e Konventës rrjedh nga vetë fakti i këtij kontrolli, i cili ushtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, me anë të forcave të armatosura të shtetit në fjalë, ose me anë të një administrate vendore që varet prej tij.

*b) Në lidhje me vlefshmërinë e kufizimeve territoriale që përmbahen në deklaratat e bëra nga ana e Turqisë në lidhje me nenet 25 dhe 46 të Konventës.*

11. Gjykata vuri në dukje se nenet 25 dhe 46 janë dy dispozita thelbësore përse i përket efektivitetit të sistemit të Konventës për shkak se janë pikërisht ato që përcaktojnë përgjegjësinë e Komisionit dhe të Gjykatës, që të «sigurojnë respektimin e angazhimeve që palët e larta kontraktuese kanë marrë përsipër» në bazë të Konventës (neni 19), duke parashikuar kompetencën e tyre për të pranuar ankimet e bëra për shkak të shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe të lirive të shpallura në të. Kur ajo interpreton këto dispozita kyçe, duhet të mbajë parasysh nga ana e saj karakterin e veçantë të Konventës, si traktat që përmban garanci kolektive mbi të drejtat e njeriut dhe liritë e tij themelore. Ashtu siç e ka vënë në dukje edhe Gjykata në vendimin *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* të 18 janarit 1978:

*«Në ndryshim nga traktatet ndërkombëtare të një natyre klasike, Konventa e kapërcen kuadrin e reciprocitetit të thjeshtë ndërmjet shteteve kontraktuese. Përveç një rrjeti angazhimesh abstenuese me karakter dypalësh, ajo krijon edhe detyrime objektive, të cilat, siç shprehet edhe Preambula e saj, gëzojnë një "garanci kolektive".»*

12. Jurisprudenca e Gjykatës e ka theksuar qartë që Konventa është një instrument i gjallë dhe që duhet interpretuar nën dritën e kushteve të jetës aktuale. Një angazhim i tillë për Gjykatën, nuk kufizohet vetëm në dispozitat normative të Konventës, por është akoma edhe më i vlefshëm për ato dispozita, siç janë ato të neneve 25 dhe 46, të cilat rregullojnë funksionimin e mekanizmit të vënies në jetë të vetë Konventës. Prej këtej, rrjedh se këto dispozita nuk do të mund të interpretoheshin vetëm në përputhje me qëllimet e autorëve të tyre, ashtu siç kishin qenë shprehur këto qëllime këtu e dyzet vjet më parë.

13. Në vazhdim, objekti dhe qëllimi i Konventës, instrument i mbrojtjes së qenieve njerëzore, kërkojnë që dispozitat e saj të interpretohen dhe të gjejnë zbatim në një mënyrë të tillë që t'i plotësojë kërkesat e saj në një mënyrë konkrete dhe efektive.

14. Për të vlerësuar nëse palët kontraktuese mund të vinin kufizime përsa i përket pranimi të kompetencës së Komisionit dhe të Gjykatës në zbatim në nenit 25 dhe të nenit 46, Gjykata kërkoj se cili ishte kuptimi i zakonshëm që ajo duhet t'u jepte termave të këtyre dispozitave në kontekstin e tyre dhe nën dritën e objektit dhe qëllimit të tyre. Në lidhje me këtë Gjykata ftoi për referencë, në mënyrë të veçantë vendimin e 18 dhjetorit 1986 në çështjen *Johnston kundër Irlandës*, si dhe nenin 31 § 1 të Konventës së Vjenës të 23 majit 1969 mbi të drejtën e traktateve. Paralelisht me kontekstin, ajo mbajti parasysh «çdo praktikë të ndjekur në vazhdim në lidhje me zbatimin e traktatit, nga e cila është përcaktuar marrëveshja e palëve në lidhje me interpretimin e traktatit»<sup>3</sup>

15. Në qoftë se, siç pretendonte qeveria e paditur, këto dispozita do të lejonin kufizime territoriale ose kufizime në lidhje me përmbajtjen e pranimi, palët kontraktuese do të kishin qenë të lira që t'i nënshtroheshin regjimeve të ndryshme të vënies në jetë të detyrimeve që rrjedhin nga Konventa sipas shtrirjes së pranimi të tyre. Një sistem i tillë, i cili do t'u lejonte shteteve që ta përshtatnin pranimin e tyre sipas lojës së parashikimeve fakultative, do ta dobësonte rëndë rolin e Komisionit dhe të Gjykatës në ushtrimin e funksioneve të tyre, si dhe do të ulte efektivitetin e Konventës si instrument kushtetues i rendit publik evropian. Për më tepër, kur Konventa i autorizon shtetet që të kufizojnë pranimin e tyre në bazë të nenit 25, ajo e saktëson këtë gjë shprehimisht.<sup>4</sup>

16. Sipas Gjykatës, duke pasur parasysh edhe objektin dhe qëllimin e sistemit të Konventës të treguara më lart, pasojat për vënien në jetë të Konventës, si dhe realizimi i objektivave të saj kishin një rëndësi të tillë të madhe sa që do të duhej të parashikohej shprehimisht një kompetencë në këtë drejtim. Pra, as neni 25 dhe as neni 46 nuk e përmbajnë një dispozitë të tillë.

17. Ekzistenca e një parashikimi të tillë kufizues në lidhje me rezervat të bën të mendosh se shtetet nuk do ta kufizonin pranimin e parashikimeve fakultative për të nxjerrë, në fakt, nga kontrolli i organeve të Konventës, pjesë të të drejtës dhe të praktikës së tyre që janë nën «juridiksionin» e tyre. Pabarazia që do të mund të krijonte ndërmjet shteteve palë lejimi i pranimeve të kufizuara në një mënyrë të tillë do të ishte edhe më tepër në kundërshtim me qëllimin e Konventës të shprehur në preambulën e saj: realizimi i një bashkimi gjithnjë e më të ngushtë me anë të ruajtjes dhe zhvillimit të të drejtave të njeriut.

3 neni 31 § 3 b i Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve.

4 Në lidhje me këtë, Gjykata fton për referencë që të shihet në mënyrë të veçantë neni 6 § 2 i Protokollit nr. 4, si dhe neni 7 § 2 i Protokollit 7.

18. Konsideratat e mësipërme mbështesin fort në vetvete idenë që sistemi i Konventës nuk autorizon kufizime të tilla. Ky këndvështrim konfirmohet nga praktika e mëpasme e ndjekur nga ana e palëve kontraktuese në lidhje me këto dispozita.

19. Duhet marrë në konsideratë nga ana tjetër që neni 25 dhe neni 63 kishin objektiva dhe qëllime të ndryshme. Neni 63 kishte të bënte me vendimin e një pale kontraktuese për të marrë në mënyrë të plotë përgjegjësinë, *vis-à-vis* Konventës, për shkak të të gjitha akteve të pushtetit publik që vepronin në territorin në lidhje me të cilin ai siguronte marrëdhëniet ndërkombëtare. Neni 25, nga ana tjetër, kishte të bënte me pranimin nga një palë kontraktuese të kompetencës të Komisionit për të marrë dhe njohur kërkesa që lidheshin me akte të organeve që vepronin nën autoritetin e drejtpërdrejtë të kësaj pale kontraktuese. Për shkak të natyrës thellësisht të ndryshme të këtyre dispozitave, fakti që një shtet duhet të bënte një deklaratë të posaçme në bazë të nenit 63 § 4 me qëllim që të pranonte kompetencën e Komisionit për të njohur kërkesa të bëra në lidhje me territoret e tij, nuk duhet të ndikonte, nën dritën e argumenteve që sapo u trajtuan më lart, në vlefshmërinë e kufizimeve *ratione loci* që bënin pjesë në deklaratat që lidhen me nenet 25 dhe 46.

20. Duke pasur parasysh natyrën e Konventës, kuptimin normal të neneve 25 dhe 46 në përmbajtjen e tyre dhe në dritën e objektit dhe të qëllimit të tyre, si dhe, nga ana tjetër, praktikën e palëve kontraktuese, Gjykata arriti në përfundimin se kufizimet *ratione loci*, të cilat bënin pjesë në deklaratat e Turqisë, në lidhje me nenet 25 dhe 46, nuk ishin të vlefshme. Ngelej për t'u përcaktuar nëse, si rrjedhojë, vlefshmëria e vetë pranimeve si të tilla mund të rimerrej në konsideratë.

c) Në lidhje me vlefshmërinë e deklaratave të Turqisë të bëra në bazë të neneve 25 dhe 46

21. Në shqyrtimin e kësaj çështjeje, Gjykata duhet të mbante parasysh natyrën e veçantë të Konventës, si instrument i rendit publik europian për mbrojtjen e qenieve njerëzore, si dhe të misionit të saj, të përcaktuar në nenin 19, për të «siguruar respektimin e angazhimeve që palët e larta kontraktuese kanë marrë përsipër» në bazë të Konventës.

22. I përkiste, pra, Gjykatës, në ushtrimin e përgjegjësive që i ngarkonte neni 19, të merrte në shqyrtim këtë çështje duke iu referuar tekstit të deklaratave përkatëse, si dhe natyrës së veçantë të regjimit juridik të Konventës. Kjo e fundit, shkoi si preferencë, në drejtim të ndarjes së parashikimeve të kundërshtuara, sepse pikërisht në këtë mënyrë do të mund të garantoheshin të drejtat dhe liritë e parashikuara nga ana e Konventës në të gjitha fushat që bënin pjesë në juridiksionin e Turqisë, sipas kuptimit të nenit 1 të Konventës.

23. Gjykata mori në shqyrtim tekstin e deklaratave, si dhe formulimin terminologjik të kufizimeve, me qëllim që të shihte nëse kufizimet e kundërshtuara ishin veçmas nga instrumentet e pranimit apo nëse ato përbënin pjesë të tyre

integrale dhe të pandashme. Edhe duke i marrë tekstet e deklaratave në lidhje me nenet 25 dhe 46 si një të tërë, ajo çmoi se kufizimet e kundërshtuara do të mund të shkëputeshin nga pjesa tjetër e tekstit, duke e lënë të paprekur pranimin e parashikimeve fakultative.

#### *F. Mbi mungesën e kompetencës racione temporis*

24. Gjykata kujtoi se neni 46 i Konventës u njeh palëve kontraktuese mundësinë që të kufizojnë, ashtu siç bëri edhe Turqia me anë të deklaratës së saj të 22 janarit 1990, pranimin e juridiksionit në lidhje me fakte që ndodhin pas datës së depozitimit. Prej këtej rrjedh se juridiksioni i Gjykatës ishte i vlefshëm vetëm në lidhje me shkeljet e vazhdueshme të pretenduara ndaj së drejtës së pronësisë të kërkuases pas datës 22 janar 1990. Ndryshimi në kompetencën kohore të Komisionit dhe të Gjykatës për një ankesë të tillë ishte një pasojë e drejtpërdrejtë dhe e parashikueshme e dispozitave konventore të posaçme, të cilat parashikonin edhe njohjen e së drejtës të kërkesës individuale (neni 25) dhe atë të juridiksionit të Gjykatës (neni 46).

### III. Koment

25. Kjo çështje që i është paraqitur Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nga ana e qeverisë Qipriote në bazë të nenit 48 (b), ka të bëjë me posedimin e një pronësie në veri të Qipros. Përmbledhja që ju ofrohet i referohet vendimit të Gjykatës në lidhje me pretendimet paraprake të qeverisë turke për mungesën, të parë nga disa faktorë, të juridiksionit dhe për pasojë edhe të përgjegjësisë së saj në lidhje me shkeljet e pretenduara. Është në fakt ky vendimi që përbën interes në lidhje me jurisprudencën e Gjykatës dhe që përbën ende një çështje të hapur për Turqinë, e cila nuk e ka zbatuar ende këtë vendim, megjithë angazhimin e shprehur në këtë drejtim në dhjetor 2003 përpara Komitetit të Ministrave.

26. Vendimi përbën interes të jashtëzakonshëm në lidhje me përgjegjësinë juridiko-ndërkombëtare të shtetit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ishte shprehur ndërkohë në vendimin e saj të famshëm *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>5</sup> se përgjegjësia e shteteve anëtare në Konventë për shkelje të mundshme të saj shtrihet në lidhje edhe me akte që i prodhojnë pasojat edhe jashtë territorit të tyre të njohur ndërkombëtarisht. Gjithashtu, në këtë vendim, Gjykata e shtriu edhe më tej konceptin, duke pranuar se juridiksioni shtetëror që është një koncept që i tejkalon përmasat hapësinore të konceptit territor, duke prodhuar në këtë rast të njëjtat pasoja juridike përsa i përket përgjegjësisë së shtetit. Konkretisht, në këtë vendim, Gjykata pranoi se pavarësisht se territori i Qipros së Veriut nuk përfshihej në territorin e Republikës së Turqisë, prania e forcave ushtarake turke dhe e administratës turke ngarkonte me përgjegjësi pikërisht shtetin turk në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut në këtë pjesë të ishullit.

5 Vendim i 7 korrikut 1989.



## BANKOVIĆ DHE TË TJERË kundër BELGJIKËS DHE 16 SHTETEVE TË TJERA ANËTARE

(kërkesa nr. 52207/99)

19 dhjetor 2001

*kjo çështje lidhet me përgjegjësinë ekstraterritoriale të shteteve anëtare të NATO-s në kuadrin e Konventës, në lidhje me bombardimin e Radiotelevizionit të Serbisë gjatë luftës në Kosovë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkesa në fjalë iu paraqit gjykatës nga gjashtë shtetas jugosllavë, të cilët jetojnë në Beograd, në Republikën Federale të Jugosllavisë ('RFJ'). Vlastimir dhe Borka Banković, të lindur respektivisht më 1942 dhe 1945 iu drejtuan Gjykatës në emër të tyre dhe të vajzës së tyre të vdekur, Ksenija Banković. Živana Stojanović, e lindur më 1937, iu drejtua Gjykatës në emër të saj dhe të djalit të saj të vdekur, Nebojsa Stojanović. Mirjana Stoimenovski, aplikoi në emër të vet dhe të të birit të vdekur, Darko Stoimenovski. Dragana Joksimović, e lindur më 1956, aplikoi në emër të saj dhe në emër të burrit të saj të vdekur, Milan Joksimović. Dragan Suković, aplikoi në emër të vet.

2. Kjo çështje ka të bëjë me bombardimin nga ana e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut ('NATO') të selisë qendrore të Radiotelevizionit të Serbisë (Radio Televizija Srbije 'RTS') në kuadrin e fushatës së bombardimeve ajrore kundër RFJ-së gjatë konfliktit të Kosovës. Në orët e para të 23 prillit 1999, një prej godinave të RTS në rrugën Takovska u godit nga një raketë e lëshuar nga një avion i NATO-s. Dy nga katër katet e godinës u shembën dhe dhoma e kontrollit qendror u shkatërrua. Gjashtëmbëdhjetë persona gjetën vdekjen, përfshirë këtu Ksenija Banković, Nebojsa Stojanović, Darko Stoimenovski dhe Milan Joksimović dhe 16 të tjerë, ndër të cilët Dragan Suković u plagosën rëndë.

3. Kjo kërkesë u drejtua kundër 17 shteteve anëtare të NATO-s, të cilët janë gjithashtu edhe Palë Kontraktuese në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pra, kundër: Belgjikës, Republikës Çeke, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Islandës, Italisë, Luksemburgut, Holandës, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Spanjës, Turqisë dhe Mbretërisë së Bashkuar.

### II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesit ankoheshin se bombardimi i godinave qendrore të RTS nga ana e



NATO-s kishte shkelur nenin 2, nenin 10 dhe nenin 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

#### *A. Në lidhje me nenin 1*

5. Duke pasur parasysh që akti objekt i gjykimit ishte kryer, ose gjithsesi i kishte shfaqur pasojat e tij jashtë territorit të shteteve palë (“akt me karakter ekstraterritorial”), Gjykata vlerësoi se çështja kryesore që duhej marrë në shqyrtim ishte nëse kërkuesit dhe të afërmit e tyre të vdekur ishin, si pasojë e këtij akti me karakter ekstraterritorial, të përfshirë në juridiksionin e shteteve të paditura.

6. Në lidhje me ‘kuptimin e zakonshëm’ të termit ‘juridiksion’ në nenin 1 të Konventës, Gjykata ishte e mendimit se nga këndvështrimi i të drejtës ndërkombëtare publike, kompetenca juridiksionale e një shteti kishte kryesisht karakter territorial. Ndërkohë që e drejta ndërkombëtare nuk përjashtonte ushtrimin nga ana e shtetit të juridiksionit ekstra-territorial, kriteret bazë për një juridiksion të tillë (përfshirë këtu edhe rastet në të cilat ai ushtrohet si në lidhje me shtetësinë, flamurin, marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore, pasojat dhe mbrojtjen e këtyre, personalitetin pasiv dhe karakterin universal) ishin, si rregull i përgjithshëm, të përcaktuara dhe të kufizuara nga të drejtat sovrane territoriale të shteteve të tjera të interesuara në një çështje të caktuar. Gjykata ishte e mendimit se neni 1 i Konventës duhet vlerësuar sikur pasqyron pikërisht këtë nocion normalisht dhe kryesisht territorial të juridiksionit dhe se kriteret e tjera juridiksionit kishin karakter përjashtimor dhe kërkonin justifikime të posaçme në kuadrin e rrethanave të veçanta të çdo rasti konkret.

7. Gjykata vërejti se praktika e shteteve të ndryshme në zbatimin e Konventës që prej ratifikimit të saj linte të kuptohej një mungesë perceptimi nga ana e shteteve palë të përgjegjësisë ekstraterritoriale në raste të ngjashme me atë të rastit në fjalë. Megjithëse ka pasur disa misione ushtarake në të cilat shtetet palë kanë vepruar jashtë territorit të tyre që nga ratifikimi prej tyre i Konventës (ndër të tjera, në Gjirin Persik, në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në RFJ), asnjë shtet nuk ka treguar se besonte që veprimet e tij jashtëterritoriale përfshinin një ushtrim të juridiksionit në kuptimin e nenit 1, duke bërë derogim në bazë të nenit 15 (derogim në raste urgjence) të Konventës.

8. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se ajo kishte njohur ndërkaq vetëm në raste përjashtimore që aktet ekstraterritoriale përbënin një ushtrim juridiksioni, pikërisht kur shteti i paditur nëpërmjet një kontrolli efektiv të territorit përkatës dhe të banorëve të tij si rezultat i pushtimit ushtarak ose nëpërmjet pëlqimit, ftesës ose fitimit nga ana e qeverisë të atij territori, ushtron, në tërësi, ose pjesërisht pushtetet publike që normalisht ushtrohen nga ajo qeveri.

9. Duke pasur parasysh pretendimin e kërkuesve që detyrimi me karakter pozitiv në bazë të nenit 1 shtrihej deri në një masë të tillë sa të siguronte të

drejtat e parashikuara nga Konventa në një mënyrë proporcionale me nivelin e kontrollit të ushtruar në çdo lloj rrethane me karakter ekstraterritorial, Gjykata vlerësoi se kjo ishte njësoj sikur të argumentohej se çdokush që cenohej nga një akt që i ngarkohej një shteti palë, kudo në botë që mund të ishte kryer ky akt ose të ishin shfaqur pasojat e tij, të ishte brenda juridiksionit të këtij shteti për qëllimet e nenit 1.

10. Gjykata vlerësoi se neni 1 nuk ofronte ndonjë mbështetje në lidhje me sugjerimin e kërkuarve, sipas të cilit detyrimi me karakter pozitiv i mishëruar në nenin 1 për të siguruar “të drejtat dhe liritë e parashikuara në Seksionin I të kësaj Konvente” do të mund të ndahej dhe të përshtatej në përputhje me rrethanat e veçanta të aktit ekstraterritorial të marrë në shqyrtim. Parashtrimi i kërkuarve nuk shpjegoi zbatimin e termave “brenda juridiksionit të tyre” të parashikuar në nenin 1 dhe shkoi aq larg sa i bëri këto terma të pakuptimta dhe të tepërta. Në qoftë se hartuesit e Konventës do të kishin dëshiruar që ta shtrin juridiksionin në një masë të tillë sa pretendojnë kërkuarve, ata do të mund të kishin miratuar një tekst të njëjtë, ose të ngjashëm me atë të hartuar në të njëjtën kohë në kuadrin e Konventave të Gjenevës së vitit 1949.

11. Në lidhje me pretendimin se përjashtimi i kërkuarve nga juridiksioni i shteteve të paditura do të cenonte misionin e Konventës për një rend publik evropian dhe do të linte një boshllëk mjerran në sistemin e Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, detyrimi i Gjykatës ishte që të mbante parasysh karakterin e posaçëm të Konventës si një instrument kushtetues i rendit publik evropian për mbrojtjen e qenieve njerëzore dhe se roli i saj ishte që të siguronte respektimin e angazhimeve të marra përsipër nga palët kontraktore.

12. Konventa është një traktat shumëpalësh që vepron, në përputhje me nenin 56 të saj (zbatimi territorial) kryesisht në një kuadër rajonal dhe sidomos në hapësirën ligjore të shteteve palë në të. Republika Federale e Jugosllavisë, haptazi, nuk bën pjesë në këtë hapësirë ligjore. Konventa nuk ishte menduar dhe formuluar në një mënyrë të tillë që të gjente zbatim në të gjithë botën, qoftë edhe kur në lojë ishin qëndrimet e mbajtura nga ana e shteteve anëtare të saj.

13. Pra, Gjykata nuk u bind se kishte ndonjë lidhje juridiksionale ndërmjet personave që ishin viktimat ose të dëmtuar nga aktet e ankimuar dhe shteteve përgjegjëse. Për këtë arsye, ajo nuk ishte e mendimit se kërkuarve dhe të afërmit e tyre të vdekur mund të përfshiheshin në juridiksionin e shteteve përgjegjëse përse i përket akteve me karakter ekstraterritorial që ishin objekt gjykimi.

14. Për këto arsye, Gjykata arriti në përfundimin se veprimi i ankimuar i shteteve të paditura nuk çon në përgjegjësinë e tyre në kuadrin e Konventës dhe nuk ishte e nevojshme të vlerësoheshin çështjet e tjera të ngritura nga palët në lidhje me pranueshmërinë. Pra, kërkesa u konsiderua e papranueshme.

### III. Koment

15. Megjithëse kërkesa ishte bërë fillimisht më 1999, në këtë çështje u mor vendim në Strasburg nga ana e Gjykatës gjatë sulmit në Afganistan, që filloi pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 në New York. Do të ishte e pavlerë të hamendësohej duke imagjinuar qëndrimin që mund të kishte mbajtur Gjykata jashtë kuadrit historik të vjeshtës 2001, por është gjithashtu e qartë që ajo u shpreh hapur (në § 80 të vendimit) se “Konventa nuk ishte menduar dhe formuluar në një mënyrë të tillë që të gjejë zbatim në të gjithë botën, qoftë edhe kur në lojë ishin qëndrimet e mbajtura nga ana e shteteve anëtare të saj”.

16. RFJ nuk ishte palë e Konventës në kohën e bombardimeve të NATO-s. Gjykata sugjeroi që shtrirja ekstraterritoriale e Konventës (përveçse në raste dëbimi ose ekstradimi) kufizohet në territoret që normalisht mbulohen nga Konventa dhe në mbështetje të saj përmendi vendimet e saj të mëparshme në lidhje me çështjet *Loizidou kundër Turqisë*<sup>6</sup>, për rastin e Qipros së Veriut dhe Ilaşku dhe të tjerë kundër Moldavisë dhe Federatës Ruse<sup>7</sup>, vendimi mbi pranueshmërinë më 4 korrik 2001, për rastin e Transdnestrës, ku në të dyja rastet, të dy territoret e lartpërmendura përbëjnë ligjërisht pjesë të territorit të shteteve kontraktuese. Në mënyrë jo fort bindëse Gjykata iu shmang shpjegimit të përjasjes krejt të ndryshme që ajo mbajti në lidhje me veprimet e autoriteteve turke jashtë Evropës në çështjen *Öcalan kundër Turqisë*, vendimin mbi pranueshmërinë e të cilës ajo e dha më 14 dhjetor 2000<sup>8</sup> duke vënë në dukje se qeveria turke nuk e kishte ngritur çështjen e juridiksionit dhe, akoma më çuditërisht, duke thënë se nuk ishte marrë ende asnjë vendim mbi themelin e këtyre çështjeve<sup>9</sup>. Ajo haptazi hodhi poshtë atë çka ajo e quajti lidhja ‘shkak dhe pasojë’ të juridiksionit, sipas të cilit kushdo që cenohej nga një akt që i atribuohet një shteti palë në Konventë kudo ku mund të ishte kryer ky akt ose ku mund të shfaqte pasojat e veta, të ishte brenda juridiksionit të këtij shteti për qëllimet e nenit 1 të Konventës. Pasi e ndërtoi vendimin e saj mbi elementin e juridiksionit, Gjykata nuk i vlerësoi elementet e tjera të pranueshmërisë së çështjes, si për shembull përgjegjësinë e shteteve për veprime të marra bashkërisht në kuadrin e NATO-s, ekzistencën dhe shterimin e mjeteve të brendshme, apo kufizimet ligjore që mund të ishin vënë për shkak se veprimet ushtarake ishin kryer së bashku me shtete jo evropiane. Për këto arsye, vendimi e lë të hapur çështjen e përgjegjësisë së mundshme të shteteve palë për veprimtaritë e tyre në kuadrin e bashkësisë ndërkombëtare dhe forcave të paqes në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë. Gjykata vuri në dukje se ajo e kishte njohur juridiksionin<sup>10</sup> kur një shtet “nëpërmjet një kontrolli efektiv të territorit

6 Shih më lart në këtë botim më gjerësisht në lidhje me këtë çështje.

7 Shih në vijim në këtë botim informacion më të zgjeruar në lidhje me këtë çështje.

8 Vendimi i plotë edhe mbi themelin në lidhje me këtë çështje është trajtuar në këtë botim në kuadrin e nenit 2.

9 Problemi i juridiksionit është një kriter që ka të bëjë me fazën e pranueshmërisë dhe në qoftë se nuk pretendohet në këtë fazë nuk mund të pretendohet më vonë përpara Gjykatës.

10 Në vendimin e 10 majit 2001 në lidhje me çështjet *Loizidou kundër Turqisë* dhe *Qipro kundër Turqisë*.

përkatës dhe të popullsisë të tij, si rezultat i një pushtimi ushtarak ose nëpërmjet pëlqimit, ftesës ose fitimit nga ana e qeverisë të atij territori, ushtron në tërësi, ose pjesërisht pushtetet publike që normalisht ushtrohen nga ajo qeveri”.

## ILAŞCU DHE TË TJERË kundër MOLDAVISË DHE RUSISË

(kërkesa nr. 48787/99)

8 korrik 2004

*ky vendim i Dhomës së Madhe i rikthehet çështjes së përgjegjësisë së shtetit për një pjesë të territorit të tij, mbi të cilin ai nuk mund të ushtrojë kontroll de facto*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Ilie Ilaşcu, Alexandru Leşco, Andrei Ivanţoc dhe Tudor Petrov-Popa, ishin shtetas moldavë në kohën e bërjes së kërkesave në Strasburg dhe kanë lindur përkatësisht më 1952, 1955, 1961 dhe 1963. z. Ilaşcu ka marrë shtetësinë rumune më 2000 ndërsa z. Leşco dhe z. Ivanţoc më 2001. Kërkuesit, me përjashtim të z. Ilaşcu dhe z. Leşco, të cilët u lanë të lirë përkatësisht në maj 2001 dhe qershor 2004, aktualisht mbahen në “Republikën Moldave të Transdnestrrias” (tani e tutje RMT), një rajon i Moldavisë i cili ka shpallur pavarësinë më 1991.

2. Në kohën e ngjarjeve, z. Ilaşcu ishte lideri lokal i Frontit Popullor dhe përpiquej për bashkimin e Moldavisë me Rumaninë. Ai u zgjodh për dy herë radhazi anëtar i Parlamentit moldav dhe u caktua edhe anëtar i delegacionit moldav në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Në dhjetor 2000 ai u zgjodh anëtar i Senatit të Parlamentit Rumun, si dhe u caktua anëtar i delegacionit rumun në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

3. Midis datave 2 dhe 4 qershor 1992, kërkuesit u arrestuan në shtëpitë e tyre në Tiraspol nga një numër personash, disa prej të cilëve mbanin uniforma me shenjën e Armatës së XIV të ish Bashkimit Sovjetik. Ata u akuzuan se nën drejtimin e Frontit Popullor të Moldavisë dhe Rumanisë, kishin kryer veprimtari anti-sovjetike dhe veprimtari të kundraligjshme ndaj qeverisë legjitime të Shtetit të Transdnestrrias. Gjithashtu, ata u akuzuan për një sërë veprash të tjera penale, ndërmjet të cilave edhe dy vrasje. Më 9 dhjetor 1993 Gjykata e Lartë e RMT-së e dënoi z. Ilaşcu me vdekje dhe urdhëroi konfiskimin e pasurisë së tij. E njëjta gjykatë i dënoi kërkuesit e tjerë me burgim nga 12 deri në 15 vjet si dhe urdhëroi konfiskimin e pasurisë së tyre.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesit ankoheshin për shkelje të nenit 6 të Konventës me arsyetimin se gjykata, e cila i kishte dënuar ata nuk kishte juridiksion dhe se procedurat që kishin çuar në dënimin e tyre nuk kishin qenë të drejta. Gjithashtu, ata u ankuan në bazë të nenit 1, të Protokollit 1 për konfiskimin e pasurive të tyre dhe pretenduan se heqja e lirisë së tyre kishte qenë e paligjshme, duke përbërë shkelje të nenit 5. Për më tepër, z. Ilaşcu ankohej për shkelje të nenit 2 me arsyetimin se ai ishte dënuar me vdekje. Gjithashtu, të gjithë kërkuesit u ankuan për kushtet në të cilat ishin mbajtur në burg, duke iu referuar shprehimisht neneve 3 dhe 8 dhe në thelb nenit 34 të Konventës.

5. Ata parashtruan se për shkeljet e pretenduara prej tyre ishin përgjegjëse autoritetet moldave përderisa ato nuk kishin marrë të gjitha masat e duhura për t'i dhënë fund këtyre shkeljeve. Sipas pretendimeve të tyre përpara Gjykatës ishin bashkëpërgjegjëse edhe autoritetet e Federatës Ruse përderisa territori i Transdniestrias ishte nën kontrollin *de facto* të Ruisë, për shkak të pranisë së trupave dhe mjeteve ushtarake në këtë territor dhe për mbështetjen që ato iu jepnin separatistëve.

### A. Në lidhje me nenin 1

#### a) Përsa i përket Moldavisë

6. Gjykata vlerësoi se qeveria moldave, qeveria e vetme legjitime e Republikës së Moldavisë, në bazë të së drejtës ndërkombëtare nuk ushtronte autoritet në një pjesë të territorit të saj, konkretisht, mbi atë pjesë të territorit që ishte nën kontrollin efektiv të RMT-së. Megjithatë, edhe në mungesë të një kontrolli efektiv mbi rajonin e Transdniestrias, Moldavia kishte një detyrim pozitiv në bazë të nenit 1 të Konventës për të marrë të gjitha masat që mund të merrte nga ana e saj në bazë të së drejtës ndërkombëtare, për t'u siguruar kërkuesve të drejtat e garantuara nga Konventa.

7. Përsa i përket gjendjes së kërkuesve, Gjykata vuri në dukje se përpara ratifikimit të Konventës më 1997, por edhe pas kësaj date, autoritetet moldave kishin marrë një numër masash për të siguruar të drejtat e kërkuesve. Nga ana tjetër, nuk kishte ndonjë provë se pas lirimit të z. Ilaşcu në maj 2001 ishin marrë masa efektive për t'i dhënë fund vazhdimin të shkeljeve të të drejtave të kërkuesve të tjerë. Për këtë arsye Gjykata arriti në përfundimin se Moldavisë i lindte përgjegjësia ndërkombëtare për shkak të mosrespektimit të detyrimeve të saj pozitive në lidhje me aktet e ndodhura pas majit 2001.

#### b) Përsa i përket Ruisë

8. Autoritetet ruse kanë kontribuar ushtarakisht dhe politikisht për krijimin e një regjimi separatist në rajonin e Transdniestrias, i cili është pjesë e territorit të Republikës së Moldavisë. Ushtria ruse madje ishte ende e vendosur në territorin moldav duke shkelur angazhimin për t'u tërhequr plotësisht, gjë për të cilën

kishte marrë angazhim në takimet e nivelit të lartë të OSBE-së më 1999 dhe 2001. Në këto kushte, RMT-ja mbetej nën zotërimin efektiv, ose të paktën nën një ndikim përcaktues të Rusisë dhe në çdo rrethanë të zhvillimeve ndërkombëtare ajo kishte mbijetuar në sajë të mbështetjes ushtarake, ekonomike, financiare dhe politike që i kishte dhënë Rusia.

9. Në këto kushte, Gjykata vlerësoi se kishte pasur një lidhje të vazhdueshme dhe të pandërprerë të përgjegjësive së Rusisë në lidhje me fatin e kërkuësve, përderisa politika e saj në mbështetje të regjimit dhe bashkëpunimi me të kishte vazhduar përtej 5 majit 1998. Pas kësaj date, Rusia nuk kishte bërë asnjë përpjekje për t'i dhënë fund gjendjes së kërkuësve, në të cilën i kishin çuar forcat ruse dhe nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për të parandaluar shkeljet, për të cilat ankoheshin kërkuësit. Për këtë arsye kërkuësit ishin brenda “juridiksionit” të Rusisë dhe në lidhje me aktet e ankimuar rridhte edhe përgjegjësia ndërkombëtare e kësaj të fundit.

*c) Në lidhje me juridiksionin e Gjykatës*

10. Gjykata vuri në dukje se Konventa ka hyrë në fuqi për Moldavinë më 12 shtator 1997 dhe për Rusinë më 5 maj 1998. Ajo theksoi se Konventa gjente zbatim vetëm në lidhje me ngjarjet pas hyrjes së saj në fuqi në shtetin palë të interesuar. Për rjedhje, Gjykata nuk ka juridiksion për të marrë në shqyrtim ankesën në bazë të nenit 6 dhe ka juridiksion për të shqyrtuar ankesat në bazë të neneve 3, 5 dhe 8 vetëm për aq sa ato kishin të bënin me ngjarje të ndodhura pas datës në të cilën Konventa kishte hyrë në fuqi për Moldavinë dhe Rusi në. Së fundi, Gjykata vendosi se ka juridiksion për të marrë në shqyrtim ankesën e z. Ilaşcu në bazë të nenit 2 të Konventës.

**B. Në lidhje me nenin 2**

11. Gjykata vlerësoi se faktet për të cilat z. Ilaşcu ankohej (periudha e gjatë që ai kishte kaluar në të ashtuquajturin “korridorin e vdekjes”<sup>11</sup>) nuk kërkonin një shqyrtim më vete në bazë të nenit 2 të Konventës, përderisa këto mund të shqyrtoheshin në mënyrë më të përshtatshme në bazë të nenit 3 të saj.

**C. Në lidhje me nenin 3**

*a) Përsa i përket z. Ilaşcu*

12. Gjatë periudhës tepër të gjatë që ka kaluar në “korridorin e vdekjes” kërkuësi ka jetuar në një frikë të vazhdueshme se do ekzekutohej. Ankthi dhe vuajtjet janë rënduar nga fakti se vendimi për dënimin e tij nuk legjitimohej dhe as ligjërohej sipas qëllimeve të Konventës, përderisa Gjykata e Lartë e RMT ishte krijuar nga një subjekt që ishte i paligjshëm në bazë të së drejtës ndërkombëtare.

13. Përsa i përket kushteve në korridorin e vdekjes, Gjykata vuri në dukje se z.

11 Në lidhje me konceptin e “korridorit të vdekjes” shih vendimin e Gjykatës të 7 korrikut 1989 përfshirë në këtë botim, në lidhje me çështjen *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Seria A. Nr. 161, sidomos paragrafët 93-99 të vendimit.



Ilaşcu për tetë vite ishte mbajtur në një izolim tepër të rreptë: ai nuk kishte pasur kontakte me të burgosurit e tjerë, nuk merrte lajme nga jashtë, përderisa nuk lejohej të merrte ose dërgonte letra dhe nuk kishte të drejtë të takonte avokatin e tij, ose të priste vizita të rregullta nga familja e tij. Kushtet në qelinë ku ai mbahej ishin tepër të këqia; ai privohej nga ushqimi si masë ndëshkimore dhe shëndeti i tij përkeqësohej nga viti në vit. Në lidhje me këtë aspekt Gjykata iu referua raportit të Komitetit për Parandalimin e Torturës pas vizitës së tij në Transdnistria në vitin 2000, në të cilin ai e përshkruante izolimin në kushte të tilla dhe për një kohë kaq të gjatë si të pajustificueshëm.

14. Dënimi me vdekje i kërkuesit, i shoqëruar me kushtet në të cilat ai ishte mbajtur dhe me trajtimin nga i cili kishte vuajtur gjatë burgosjes së tij ishin tepër serioze dhe të egra dhe duhet të konsideroheshin si akte torture në kuptimin e nenit 3 të Konventës. Përderisa z. Ilaşcu ishte në burg në kohën kur Konventa hyri në fuqi në Rusi, kjo e fundit ishte përgjegjëse për kushtet e tij të burgimit, për trajtimin e tij atje dhe për vuajtjet e shkaktuara atij në burg. z. Ilaşcu u la i lirë në maj 2001 dhe vetëm duke filluar nga kjo datë lindte përgjegjësia e Moldavisë për mosrespektim të detyrimeve të saj pozitive. Për rrjedhojë kishte shkelje të nenit 3 nga ana e Ruisë, por jo nga ana e Moldavisë.

*b) Përsa i përket z. Ivançoc*

15. Marrë në tërësinë e tij dhe duke pasur parasysh seriozitetin, përsëritjen dhe qëllimin e tij, trajtimi i shkaktuar z. Ivançoc kishte shkaktuar dhimbje dhe vuajtje “të thella”, kishte qenë tepër i rëndë dhe i ashpër dhe përbënte akt, sipas kuptimit të nenit 3. Përderisa z. Ivançoc ishte në burg në kohën kur Konventa hyri në fuqi në Rusi, kjo e fundit ishte përgjegjëse për kushtet e tij të burgimit, për trajtimin e tij atje dhe për vuajtjet e shkaktuara atij në burg. Duke mbajtur parasysh përfundimin e saj se përgjegjësia e Moldavisë për mosrespektim të detyrimeve pozitive lindte duke filluar nga maji 2001, Gjykata arriti në përfundimin se kishte shkelje të nenit 3 nga ana e Ruisë dhe e Moldavisë.

*c) Përsa i përket z. Leşco dhe z. Petrov-Popa*

16. Marrë në tërësi dhe duke pasur parasysh karakterin tepër serioz të tij, mbajtja në burg e z. Leşco dhe z. Petrov-Popa mund të cilësohej si trajtim çnjerëzor dhe degradues sipas kuptimit të nenit 3. Pra ka pasur shkelje të nenit 3 nga ana e Ruisë dhe e Moldavisë.

**D. Në lidhje me nenin 5**

17. Gjykata vërejt se asnjë nga kërkuesit nuk ishte dënuar nga një “gjykatë” dhe se burgimi i tyre nuk mund të konsiderohej si “heqje lirie e ligjshme” e vendosur “në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj”. Në këto kushte, privimi i lirisë së kërkuesve nuk respektonte kriteret e parashikuara në paragrafin 1 (a), të nenit 5 të Konventës. Për rrjedhojë, kishte shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës deri në maj 2001 përsa i përket z. Ilaşcu dhe se ka pasur dhe vazhdonte të kishte shkelje të kësaj dispozite, përsa i përket kërkuesve të tjerë që ishin ende në burg.

18. Gjykata arriti në përfundimin se ky qëndrim që përbënte shkelje të nenit 5 në lidhje me të gjithë kërkuesit i ngarkohej Federatës Ruse. Duke mbajtur parasysh përfundimin e saj se përgjegjësia e Republikës së Moldavisë në kuadrin e detyrimeve të saj pozitive lindte vetëm duke filluar nga maji 2001, Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 5 nga Moldavia përsa i përket z. Ilaşcu, por kishte shkelje të kësaj dispozite nga Moldavia përsa i përket kërkuesve të tjerë.

#### *E. Në lidhje me nenin 8*

19. Duke qenë se të njëjtat ankesa i mori në shqyrtim në kuadrin e nenit 3, Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme që t'i shqyrtonte ato veçmas, nga këndvështrimi i nenit 8.

#### *F. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1*

20. Edhe duke supozuar se kishte juridiksion për të vendosur në lidhje me këtë aspekt të kërkesës, Gjykata theksoi se ajo nuk ishte i bazuar dhe prandaj arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të kësaj dispozite.

#### *G. Në lidhje me nenin 34*

21. Gjykata vuri në dukje se kërkuesit nuk kishin qenë në gjendje ta përdornin këtë nen nga vendi ku mbaheshin të izoluar dhe se kërkesa e tyre, e nënshkruar nga bashkëshortet e tyre, ishte dërguar në Strasburg nga i vetmi avokat që i kishte përfaqësuar ata në fillim të procedimit. Gjithashtu, Gjykata vuri re kërcënimet e bëra ndaj kërkuesve nga autoritetet e burgut në Transdnjestria dhe përkeqësimin e kushteve të tyre të burgut pas dërgimit të kërkesës në Strasburg. Akte të tilla përbënin një formë të ulët dhe të papranueshme trysnie, e cila kishte penguar ushtrimin nga ana e kërkuesve të së drejtës së tyre për kërkesë individuale. Pra, ka pasur shkelje të nenit 34 të Konventës nga ana e Rosisë.

22. Gjykata theksoi gjithashtu se pasi z. Ilaşcu ishte liruar ai kishte folur me autoritetet moldave në lidhje me mundësinë e lirimit të kërkuesve të tjerë dhe në këtë kuadër z. Voronin, Presidenti i Moldavisë, e kishte akuzuar publikisht z. Ilaşcu si shkakun e mbajtjes në burg të shokëve të tij, duke refuzuar që të tërhiqte kërkesën e tij të bërë në Gjykatën e Strasburgut kundër Moldavisë dhe Rosisë. Komente të tilla nga autoriteti më i lartë i një pale kontraktuese përbëjnë një trysni të drejtpërdrejtë që synon të pengojë ushtrimin e së drejtës për ankim individual duke përbërë në këtë mënyrë edhe shkelje të nenit 34 të Konventës.

#### *H. Në lidhje me nenin 41*

23. Në bazë të nenit 41 të Konventës Gjykata vendosi që Moldavia duhet t'i paguante z. Ivanţoc, z. Leşco dhe z. Petrov-Popa 60 000 euro shpërblim për dëm material dhe jomaterial dhe 3 000 euro secilit prej tyre për dëmin e ardhur si pasojë e shkeljes së nenit 34 dhe një shumë të përgjithshme prej 7 000 eurosh për shpenzime dhe pagesa, nga e cila duhen hequr 1 321.34 euro që i kishin marrë ndërkohë si ndihmë ligjore. Rusia duhet t'i paguante 180 000 euro z. Ilaşcu dhe 120 000 euro secilit prej kërkuesve të tjerë si shpërblim për dëm material dhe



jomaterial, 7 000 euro secilit prej tyre për dëmin e ardhur si pasojë e shkeljes së nenit 34 dhe një shumë të përgjithshme prej 14 000 euro për shpenzime dhe pagesa, nga e cila duhen hequr 2 642.66 euro që i kishin marrë ndërkohë si ndihmë ligjore.

24. Gjithashtu, Gjykata theksoi se Moldavia dhe Rusia duhet të merrnin të gjitha masat e nevojshme për t'i dhënë fund burgimit arbitrar të kërkuesve dhe të realizonin lirin e tyre të menjëhershëm.

### III. Koment

25. Fakti që ky vendim është më i gjati që Gjykata ka dhënë ndonjëherë pasqyron ndërlikim e çështjeve me të cilat ajo u mor gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje. Me interes të jashtëzakonshëm në këtë vendim është qëndrimi i Gjykatës në lidhje me vlerësimin e një territori i cili, nga njëra anë i përket një shteti, por është jashtë kontrollit të tij *de facto*, dhe nga ana tjetër, nuk i përket një shteti tjetër, por i nënshtrohet kontrollit të tij *de facto*.

26. Në lidhje me Moldavinë, shumica e Gjykatës (11 pro,6 kundër) vërejtë se kërkuesit ishin brenda juridiksionit të Moldavisë për disa prej ankesave të tyre. Në konceptin e së drejtës ndërkombëtare ishte qeveria moldave, qeveria legjitime e rajonit të Transdniestrias. Megjithëse ajo nuk kishte pasur kontroll efektiv mbi këtë territor qysh përpara se të ratifikonte Konventën, ajo kishte gjithsesi një detyrim pozitiv në bazë të nenit 1 të Konventës për marrjen e të gjitha masave për rivendosjen e kontrollit të tyre në rajon, si dhe për të respektuar të drejtat e personave që banonin në këtë rajon. Megjithëse kërkuesit ishin nën kontrollin *de facto* të RMT-së, kjo nuk i çlironte autoritetet moldave nga detyrimi i tyre pozitiv *vis-à-vis* kërkuesve. Dhe siç e pamë autoritetet moldave kishin dështuar në fakt në respektimin e këtyre detyrimeve.

27. Nga ana tjetër, përgjegjësia e Ruisë lindi për shkak se ajo ushtronte kontroll *de facto* mbi territorin e Transdniestrias, përderisa kishte vendosur atje trupa dhe pajisje ushtarake dhe përderisa mbështeste autoritetet që kishin kontroll *de facto* mbi atë territor. Aktet e ushtarëve rusë, përfshirë edhe transferimin e kërkuesve tek regjimi i RMT-së, si dhe bashkëpunimi i tyre me atë regjim, ngarkonin me përgjegjësi Federatën Ruse jo vetëm për veprimet e trupave të tyre, por edhe për veprimet e këtij regjimi që rridhnin si pasojë e tyre.

28. Ky vendim mund të ketë pasoja të rëndësishme për shtete të tjera palë në Konventë që nuk kanë kontroll efektiv në lidhje me pjesë të caktuara të territorit të tyre. Nga ana tjetër, ai ka rëndësi thelbësore edhe për shtete të tjera anëtare që kanë trupa ushtarake jashtë territorit të tyre për të mbështetur një regjim të caktuar mbi një territor që, sipas së drejtës ndërkombëtare, i përket formalisht territorit të një shteti tjetër.

29. Mendja të shkon natyrisht te shembulli më i qartë dhe më i afërt për ne që është Kosova. Nga njëra anë Serbia dhe Mali i Zi nuk kanë bërë ndonjë rezervë në lidhje me territorin e Kosovës dhe formalisht ai shtet duhet të jetë përgjegjës për të gjitha shkeljet e të drejtave të Konventës të bëra në territorin e Kosovës. Sigurisht që nuk do të përpiqeshim të bënim një paralelizëm të plotë midis gjendjes moldave në rastin në fjalë dhe asaj serbo-malazeze në rastet e mundshme kosovare<sup>12</sup>. Kjo për faktin se Moldavia gjendej përballë një situatë faktike të panjohur ndërkombëtarisht, kurse Serbia dhe Mali i Zi gjenden përballë një regjimi juridiko-ndërkombëtar të rregulluar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Nga ana tjetër, ky vendim i Gjykatës na çon në përfundimin se në raste të shkeljes së të drejtave të njeriut në Kosovë, përgjegjëse përpara organeve të Konventës do të ishin shtetet që në rajonin përkatës kosovar kanë trupa të armatosura dhe ushtrojnë një kontroll *de facto*. Kjo, natyrisht, vlen vetëm për ato shtete që janë palë në Konventë.

30. Gjithashtu, duhet mbajtur parasysh se përgjegjësia e Moldavisë dhe Rusisë ka lindur në lidhje me territorin e Transdnestrrias vetëm nga data e ratifikimeve të tyre respektive të Konventës. Asnjëri prej tyre nuk mund konsiderohej përgjegjës për ngjarje, veprime ose mosveprime që kanë ndodhur përpara ratifikimit.

## **BEHRAMI DHE BEHRAMI kundër FRANCËS DHE SARAMATI kundër FRANCËS, GJERMANISË DHE NORVEGJISË**

(kërkesat nr. 71412/01, 78166/01)

**31 maj 2007**

**Dhomë e Madhe  
Vendimi mbi pranueshmërinë**

*kompetenca e Gjykatës për të shqyrtuar në bazë të Konventës shkelje të të drejtave të njeriut kryer nga prania ndërkombëtare në Kosovë*

### **I. Faktet kryesore**

#### *i. Behrami dhe Behrami*

1. Kërkesat në këtë çështje janë Agim Behrami, i lindur në vitin 1962 dhe i biri, Bekir Behrami, i lindur në 1990. Të dy jetonin në komunën e Mitrovicës, Kosovë. Agim Behrami ankohej edhe në emër edhe të një prej djemve të tjerë të tij, Gadaf Behrami, i lindur në vitin 1988 dhe që tashmë ka vdekur. Më 11 mars 2000 Gadaf dhe Bekim Behrami ishin duke luajtur me disa djem të tjerë në zonën e Mitrovicës.

<sup>12</sup> Kërkesat e para janë bërë ndërkaq kundër forcave të KFOR-it në Kosovë për shkelje të të drejtave të Konventës.

Ata gjetën një numër të bomba thërrmuese të pashpërthyera, të cilat ishin hedhur gjatë bombardimeve të Jugosllavisë nga ana e NATO-s në vitin 1999, dhe filluan të luajnë me to. Një bombë shpërtheu dhe vrau Gadaf Behramin, ndërsa Bekim Behrami u plagos rëndë dhe iu nënshtrua operacioneve të shumta në sy.

2. Në kohën e ngjarjeve, Mitrovica ishte nën përgjegjësinë e një brigade shumëkombëshe të udhëhequr nga Franca. Kjo ishte një nga katër brigadat që përbënin forcën ndërkombëtare të sigurisë (KFOR) të pranishme në Kosovë, e mandatuara nga Rezoluta 1244 e qershorit të vitit 1999 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së (KSOKB). Administrata e Përkohshme e OKB-së për Kosovën (UNMIK) hetoi rastin dhe raportoi se ai përbënte "një vrasje të paqëllimshme të kryera nga pakujdesia". Më 22 maj 2000 Agim Behrami u informua se nuk do bëhej asnjë ndjekje penale, sepse bomba nuk shpërtheu gjatë bombardimeve të NATO-s dhe se ai kishte të drejtë të bënte një kallëzim penal brenda një afati prej tetë ditësh. Më 25 tetor 2001 Agim Behrami u ankua në Zyrën e Ankesave të Kosovës me pretendimin se Franca nuk kishte respektuar dispozitat e Rezolutës 1244, të cilat kishin të bënin me çminimin. Kërkesa e tij u refuzua me arsyetimin se pastrimi i minave kishte qenë përgjegjësi e OKB-së që më 5 korrik 1999.

### *ii. Saramati*

3. Kërkuesi në këtë çështje është Ruzhdi Saramati i cili ka lindur në vitin 1950 dhe jetonte në Kosovë. Në prill 2001, ai u arrestua nga policia e UNMIK-ut dhe më pas u dërgua në paraburgim. Më 23 maj 2001 prokurori e akuzoi kërkuesin për tentativë vrasjeje dhe me akuza të tjera. Kërkuesi e apeloj me sukses shtyrjen e masës së paraburgimit dhe u lirua. Më 13 korrik 2001, ai u arrestua nga dy oficerë të policisë së UNMIK-ut. Fillimisht, kërkuesi parashitroi se ishte një oficer gjerman i KFOR-it i cili dha gojarisht urdhrin e arrestit dhe e informoi atë se po e arrestonin me urdhër të Komandantit të KFOR-it, në atë kohë një oficer norvegjez. Më 14 korrik 2001, Komandanti i KFOR-it autorizoi paraburgimin e mëtejshëm të kërkuesit edhe për 30 ditë të tjera. Më 26 korrik 2001, dhe në përgjigje të një letre nga avokatët e kërkuesit që kundërshtonin ligshmërinë e ndalimit të tij, Këshilltari Ligjor i KFOR-it u shpreh se KFOR-i, në bazë të Rezolutës 1244, kishte autoritetin për ndalime dhe arrestime kur ishte e nevojshme "për të mbajtur një situatë të qetë dhe të sigurt" dhe për të mbrojtur trupat e KFOR-it. Më 11 gusht 2001 ndalimi i kërkuesit u zgjat përsëri.

4. Më 6 shtator 2001, rasti i kërkuesit kaloi në gjykatën e rrethit për gjykim. Gjatë çdo seance, që nga 17 shtatori 2001 deri më 23 janar 2002 avokatët e kërkuesit kërkuan lirimin e tij dhe gjykata u përgjigj se ndalimit të tij ishte përgjegjësi e KFOR-it. Më 3 tetor 2001 një gjeneral francez u bë Komandanti i KFOR-it. Më 23 janar 2002, kërkuesi u shpall fajtor për tentativë vrasjeje në bazë të dispozitave të Kodit Penal të Kosovës dhe të Kodit Penal të RFJ-së. Më 9 tetor 2002, Gjykata Supreme e Kosovës e prishi këtë vendim dhe e ridërgoi çështjen për rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Ai u lirua nga paraburgimi dhe pritej të rigjykohej.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Në çështjen Behrami, kërkuesit pretenduan se vdekja e Gadaf Behramit dhe plagët e Bekir Behramit ishin shkaktuar nga dështimi i trupave franceze të KFOR-it për të identifikuar dhe/ose neutralizuar bomba thërrmuese të pashpërthyer të cilat KFOR-i e dinte se ishin të pranishme në vendin përkatës. Ata u mbështetën në nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

6. Në çështjen Saramati, kërkuesi u ankua në bazë të nenit 5 dhe nenit 13 të Konventës, në lidhje me tij paraburgimin e tij nga KFOR-i. Ai më tej u ankua sipas nenit 6 § 1 se nuk ka pasur akses në gjykatë dhe, sipas nenit 1, se Franca, Gjermania dhe Norvegjia kishin dështuar të garantonin të drejtat e Konventës për personat që jetojnë në Kosovë.

7. Kërkesa në rastin e Behrami dhe Behrami kundër Francës u dorëzua në Gjykatë më 28 shtator 2000 dhe kërkesa në rastin Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë, më 28 shtator 2001. Më 13 qershor 2006 Dhoma e Gjykatës që i mori ato në shqyrtim hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe, në bazë të nenit 30 të Konventës.

### *i. Tërheqja e kërkesës në çështjen Saramatit kundër Gjermanisë*

8. z. Saramati kërkoi ta tërheqë ankimin e tij kundër Gjermanisë, pasi ai nuk ishte në gjendje të ofronte asnjë dëshmi objektive që ta mbështeste kërkesën e tij në pretendimin se një oficer gjerman i KFOR-it kishte qenë i përfshirë në arrestimin e tij. Gjykata vendosi ta çregjistrojë këtë kërkesë kundër Gjermanisë.

### *ii. Në lidhje me pranueshmërinë*

9. Gjykata vërejtë se kërkuesit në çështjen Behrami dhe Behrami u ankuan për mosveprimin e trupave të KFOR-it, ndërsa z. Saramati u ankua në lidhje me ndalimin e tij me urdhër dhe nga KFOR-i. Gjykata vlerësoi se pyetja e ngritur nga këto çështje ishte jo aq se sa Shtetet e interesuara ushtronin juridiksionin ekstraterritorial në Kosovë, por fakti nëse Gjykata Evropiane ishte apo jo kompetente për të shqyrtuar sipas Konventës kontributin e këtyre shteteve në qetësinë civile dhe sigurinë që ofronte duke ushtruar kontroll në Kosovë. Gjykata konsideroi se marrja e urdhërave të paraburgimit përfshihej në mandatin e sigurisë së KFOR-it dhe se mbikëqyrja e çminimit përfshihej në mandatin e UNMIK-ut. Në vijim, ajo vlerësoi nëse aktet e KFOR-it dhe mosveprimi i UNMIK-ut në rastet konkrete mund t'i atribuoheshin OKB-së. Gjykata vlerësoi se meqë KFOR-i po ushtronte kompetenca që i ishin njohur ligjërisht nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së dhe meqë UNMIK-u ishte një organ nën varësinë e OKB-së, i krijuar në bazë të Kreut VII të Kartës së saj, veprimet dhe mosveprimet e ankimuar, në parim, i "atribuohen" OKB-së, e cila kishte një personalitet juridik më vete nga ai i shteteve anëtare të saj dhe për më tepër nuk është palë kontraktore në Konventë.

10. Më tej, Gjykatatratjoi çështjennëse ajo ishte kompetente për të shqyrtuar aktet e Shteteve në fjalë të kryera në emër të OKB-së dhe, më në përgjithësi, marrëdhënien mes Konventës dhe OKB-së, kur kjo e fundit vepron në përputhje me Kreun VII të Kartës së saj. Objektivi kryesor i OKB-së është ruajtja e paqes dhe e sigurisë ndërkombëtare. Përderisa operacionet bazuara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit bazuar në Kreun VII të Kartës së OKB-së janë thelbësore për përmbushjen e misionit të OKB-së dhe meqë efektiviteti i tyre kushtëzohet nga mbështetja e shteteve anëtare, Konventa nuk mund të interpretohet në një mënyrë të tillë që t'ia nënshtrojë shqyrtimit të Gjykatës veprimet dhe mosveprimet e palëve Kontraktore të cilat bazohen në rezolutat e Këshillit të Sigurimit dhe kanë ndodhur në kuadrin e këtyre misionëve. Kjo do të ishte një ndërhyrje në përmbushjen e misionit kryesor të OKB-së në këtë fushë, duke përfshirë zbatimin efektiv operacioneve të saj. I njëjti arsyetim gjen zbatim për aktet e vullnetshme të Shteteve në fjalë si për shembull vota e anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB në favor të Rezolutës përkatëse në bazë të Kreut VII të Kartës së OKB-së dhe kontributin me trupa në misionet e sigurisë.

11. Në dritën e këtij përfundimi, Gjykata vendosi se nuk ishte e nevojshme për të shqyrtuar pretendimet e tjera të palëve në lidhje me pranueshmërinë e kërkesave, përfshirë edhe kompetencën e Gjykatës për të shqyrtuar ankesat kundër shteteve në lidhje me veprimet ose mosveprimet ekstraterritoriale dhe nëse kërkuessit kishin shteruar apo jo çdo mjete efektiv në dispozicion të tyre në kuptimin e nenit 35 § 1 të Konventës.

### III. Koment

12. Shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga prania ndërkombëtare në Kosovë dhe imuniteti i plotë nga pasojat ligjore në Kosovë që i ishin njohur UNMIK-ut dhe KFOR-it për veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë qenë objekt debatesh dhe kundërshtish të shumta në rajonin tonë të Ballkanit dhe në vijim janë shtrirë edhe më gjerë. Kjo, për faktin se personeli ushtarak dhe civil i vendeve anëtare të Konventës angazhuar në operacione, misione dhe programe në kuadrin e OKB-së ka qenë fillimisht i pranishëm në rajonin tonë për shkak të luftrave në Bosnjë<sup>13</sup> dhe në Kosovë. Çështja që po komentojmë është e para e një sërë rastesh që lidheshin me përgjegjësinë e shteteve që kontribuonin me trupa në kuadrin e këtyre misionëve të OKB-së në Ballkan dhe më gjerë. Për këtë arsye, duhet të jetë e qartë për lexuesin që kjo çështje është përfshirë në botim më shumë për të dhënë idenë e zhvillimeve përkatëse në të drejtën ndërkombëtare, sesa për të treguar parimin aktual të interpretimit të Konventës nën prizmin e përgjegjësisë së shteteve sipas nenit 1 të Konventës në raste të ngjashme.

13 Shih çështjen *Nënat e Serbencës kundër Holandës*.

Në fakt, kriteret e vendosura nga Gjykata në këtë çështje mund të thuhet se janë rishikuar dhe riformuluar nga Gjykata me vendime të mëvonshme<sup>14</sup>.

13. Gjithsesi, mund të thuhet se qasja që mbajti Gjykata në këtë çështje është interesante. Në vend që ta shqyrtonte rastin thjesht si problem të juridiksionit ekstraterritorial të shteteve (*ratione loci*), Gjykata e trajtoi atë si problem të juridiksionit të subjektit (pra *ratione personae*), duke u fokusuar në faktin se kush ishte përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e posaçme të kundërshtuara. Qeveritë e paditura, të mbështetura nga shtatë qeveri të tjera që ndërhyjnë si palë të treta, fillimisht i orientuan pretendimet e tyre në këtë çështje nën prizmin e *ratione loci*. Ndërkohë, Gjykata u orientua sipas një këndvështrimi tjetër, pra, që OKB-ja dhe jo shtetet anëtare mund të ishte përgjegjëse dhe natyrisht kjo mundësi interpretimi ju interesonte edhe qeverive të paditura. OKB-ja, e cila u pyet formalisht nga Gjykata për të dhënë mendimin e saj mbi pikëpamjen se kush ishte përgjegjës, pavarësisht se nuk ishte palë në këtë çështje, u shpreh qartë se as veprimet dhe as mosveprimet e kundërshtuara nuk i përkisnin OKB-së<sup>15</sup>. Megjithatë, Gjykata nuk e pranoi këtë analizë dhe nga ana e saj argumentoi se veprimet dhe mosveprimet në fjalë i atribuoheshin drejtpërdrejt OKB-së<sup>16</sup> dhe jo shteteve që kishin kontribuar me trupa dhe që ishin pala e paditur para Gjykatës.

14. Kjo qasje e Gjykatës në këtë çështje e la të hapur debatin tepër thelbësor dhe interesant edhe për të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, pikërisht atë të përkatësisë dhe të përgjegjësisë në lidhje me aktet e kryera në kuadër të operacioneve ushtarake ekstraterritoriale, në të cilat marrin pjesështete të cilat janë palë në Konventë (të cilat nuk mund t'i atribuohen OKB-së). Në këtë mënyrë, Gjykata e shtyu edhe për disa vite të tjera një përgjigje dhe sqarim të pritshëm, sidomos nga doktrina, në lidhje me këtë debat dhe me një zhvillim që do të qartësonte më tej një linjë jurisprudenciale të kritikuar si të mjegullt, nëse analizohen vendimet e deriatëhershme të Gjykatës në çështjet Bankoviç dhe të tjerë kundër Belgjikës dhe 16 shteteve të tjera<sup>17</sup>, Ilaşcu dhe të tjerë kundër Moldavisë dhe Ruisë<sup>18</sup> dhe Issa dhe të tjerë kundër Turqisë<sup>19</sup>.

14 Shih, sidomos, vendimet në çështjet *Al-Skeini kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Al-Jedda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Jaloud kundër Hollandës dhe Hassan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nga të cilat vetëm e dyta nuk është përfshirë në këtë botim.

15 Shih paragrafët 118 deri 120 të vendimit të Gjykatës. OKB-ja mbajti këtë qëndrim pavarësisht se ajo ka imunitet për veprimet dhe mosveprimet e personelit të saj në Kosovë, kështu që analiza e Gjykatës së Strasburgut në këtë rast nuk do të kishte asnjë pasojë konkrete ndaj saj.

16 Shih paragrafin 151 të vendimit.

17 Vendim papranueshmërie i Dhomës së Madhe, 19 dhjetor 2001, i përfshirë në këtë botim.

18 Vendim i Dhomës së Madhe, 8 korrik 2004, i përfshirë në këtë botim.

19 Vendim i Dhomës së Madhe, 16 nëntor 2005.



## BIJELIC kundër MALIT TË ZI DHE SERBISË

(kërkesa nr. 11890/05)

28 prill 2009

*kjo çështje ka të bëjë me vijueshmërinë e detyrimit të shteteve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut edhe në rast të shkëputjes nga një shtet që e ka ratifikuar më parë Konventën*

### I. Faktet Kryesore

1. Kërkuesja e parë, i dyti dhe i treti kanë lindur më 1950, 1973 dhe 1971 dhe aktualisht jetojnë në Beograd.
2. Kërkuesja e parë, burri i saj dhe dy kërkuesit e tjerë zotëronin një kontratë qiradhënieje për një apartament në Podgoricë në Mal të Zi, ku ata jetonin.
3. Në vitin 1989 kërkuesja e parë dhe burri i saj u divorcuan dhe të parës iu dha e drejta për kujdestari mbi dy kërkuesit e tjerë. Në 26 janar të vitit 1994, kërkuesja e parë mori të drejtën të vazhdonte kontratën e mbajtjes me qira të apartamentit të familjes. Në vazhdim, ish burri i saj (“i padituri në procedurat e brendshme”) u urdhërua që të linte apartamentin brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data kur vendimi u bë përfundimtar.
4. Duke patur parasysh se pala e paditur nuk iu bind urdhërit të gjykatës për të lënë apartamentin, në datën 31 maj të vitit 1994, kërkuesja e parë filloi një procedurë gjyqësore për ekzekutimin e urdhërit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Podgoricës.
5. Vendimi i vitit 1994 ka mbetur i pazbatuar edhe sot. Për shumë vite, përpjekjet e shumta për ta marrë apartamentin dështuan, kryesisht, sepse ish bashkëshorti i kërkueses së parë kërcënonte kërkuesit dhe policinë me përdorimin e forcës, përfshirë edhe një kërcënim se ai mund ta hidhte në erë të gjithë ndërtesën me anë të një mine me telekomandë. Në vitin 2007, policia vendase vlerësoi se zbrazja e godinës në fjalë ishte shumë e rrezikshëm për t’u ekzekutuar duke qenë se policët nuk kishin pajisje për t’u marrë me raste të tilla. Për pesëmbëdhjetë vite me radhë, kërkuesja e parë u ankua në një sërë organesh shtetërore për moszbatimin e vendimit të dhënë në favor të saj, por pa patur sukses.
6. Ndërkohë, kërkuesja e parë e bleu apartamentin në fjalë dhe u bë pronare e tij në vitin 1994. Një vit më vonë, ajo ua dhuroi atë fëmijëve të saj, përkatësisht kërkuesit të dytë dhe të tretë.

## II. Vendimi i Gjykatës

7. Kjo çështje i ka fillesat në një kërkesë kundër Shtetit Federativ të Serbisë dhe Malit të Zi të regjistruar në gjykatë në mars të vitit 2005. Kërkuesit u ankuan sidomos për mos-ekzekutimin e urdhrit përfundimtar për lirimin e apartamentit nga ish bashkëshorti i kërkueses së parë dhe për pamundësinë e tyre të vazhdueshme për të jetuar në apartamentin në fjalë.

### a. *Pajtueshmëria rationae personae*

8. Duke ndjekur deklaratën e pavarësisë të Malit të Zi në 6 qershor të vitit 2006, kërkuesit theksuan se ata do të donin që procedura të vazhdonte kundër Malit të Zi dhe Serbisë si dy shtete të pavarura. Çështja kryesore për të vendosur në lidhje me këtë kërkesë përpara Gjykatës është se cili prej shteteve, Serbia apo Mali i Zi duheshin shpallur përgjegjës për mosveprimin e vazhdueshëm të autoriteteve që nga 3 marsi 2004 (kur KEDNj-ja u ratifikua prej Shtetit Federal Serbi dhe Mal i Zi) dhe 5 qershorit të vitit 2006.

9. Duke pasur parasysh arsyetimet e paraqitura nga qeveritë serbe dhe malazeze, nga Komisioni i Venecias dhe nga një OJFvendase malazeze, si dhe kërkesat praktike të nenit 46 të Konventës dhe parimin që të drejtat themelore të mbrojtura nga traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut duhet t'u përkasin individëve që jetojnë në territorin e Shtetit palë në fjalë, si dhe duke mos anashkaluar zgjidhjen e tij në vazhdim, Gjykata konsideroi se si Konventa dhe Protokollit nr. 1 duhen interpretuar se kanë qenë në fuqi për edhe Malin e Zi që prej 3 marsit 2004 deri më 5 qershorit 2006, si dhe për çdo periudhë pas 5 qershorit 2006.

10. Së fundmi, duke pasur parasysh faktin se procedurat për zbatimin e vendimit për lirimin e apartamentit kanë qenë kompetencë vetëm e autoriteteve malazeze, Gjykata, pa paragjykuar themelin e çështjes i konsideroi pretendimet e kërkuesve kundër Malit të Zi si të pajtueshme *ratione personae* me dispozitat e Konventës dhe të Protokollit nr.1. Megjithatë, për të njëjtën arsye, Gjykata vendosi se pretendimet e tyre në lidhje me Serbinë nuk ishin të pajtueshme *ratione personae* në kuptimin e nenit 35 § 3, dhe për rrjedhojë u hodhën poshtë bazuar në nenin 35 § 4 të Konventës.

### b. *Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1*

11. Neni 1 i Protokollit 1 garanton, *inter alia* të drejtën e pronës, e cila përfshin të drejtën për të gëzuar pronën përkatëse lirisht, si dhe të drejtën për ta administruar atë. Në kuadrin e kësaj të drejte, detyrimet pozitive mund të kërkojnë që shteti të marrë masat përkatëse për të mbrojtur të drejtën e pronës, duke përfshirë këtu edhe përgjegjësinë e tij për të përdorur të gjitha mjetet ligjore të disponueshme për të zbatuar një vendim gjyqësor përfundimtar, pavarësisht nga fakti nëse ai është dhënë kundrejt një pale private.



12. Gjykata së pari vërejtë se pamundësia e kërkuesve për të larguar palën e paditur nga apartamenti në fjalë ka përbërë një ndërhyrje në të drejtat e tyre të pronësisë. Mos-zbatimi i vazhdueshëm hyn në kompetencat e Gjykatës *ratione temporis* për një periudhë prej thujse pesë vjetësh, po të mbahet parasysh ratifikimi i KEDNJ-së në mars të vitit 2004 nga Shteti Federativ Serbi Mali i Zi. Nga ana tjetër Gjykata mbajti parasysh edhe faktin që deri në momentin e ratifikimit kishin kaluar 10 vjet nda data kur vendimi ishte bërë përfundimtar. E fundit dhe më e rëndësishmja, policët vetë thanë se ata ishin të paaftë për të përmbushur detyrat e tyre sipas ligjit, çka edhe kishte shkaktuar vonesën në fjalë.

13. Pra, Gjykata vlerësoi se autoritetet malazeze kishin dështuar të përmbushin detyrimet sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit 1 për të zbatuar vendimin e 31 majit 1994 dhe gjeti një shkelje të kësaj të drejte.

#### *c. Në lidhje me nenin 6 § 1*

14. Duke pasur parasysh gjetjet e saj në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 dhe të faktit se është moszbatimi i vendimit përfundimtar në themel të pretendimeve të kërkuesit, Gjykata vërejtë se nuk ishte e domosdoshme që të shqyrtoheshin më vete pretendimet në lidhje me shkeljen ose jo të nenit 6 § 1.

#### *d. Në lidhje me nenin 8*

15. Pasi u shqyrtua çështja në veçanti edhe në këndvështrimin e faktit se kërkuesit kishin si qëllim shitjen e apartamentit në fjalë dhe ishin kthyer në banorë të përhershëm në Beograd, Gjykata vlerësoi se kjo pronë nuk mund të konsiderohej më si “shtëpia” e tyre për qëllim të zbatimit të nenit 8. Ankesa sipas këtij neni u hodh poshtë si e papajtueshme *ratione materiae* me Konventën.

#### *e. Në lidhje me nenin 41*

16. Gjykata u shpalli se u jep të drejtën kërkuesve të dëmshpërblehen me 4.500 euro për dëmet jopasurore të pësuarra prej tyre dhe 700 euro (përveç ndihmës ligjore të paguara tashmë prej Këshillit të Evropës) për kosto dhe shpenzime të tjera. Gjithashtu, Gjykata vendosi se nëse qeveria malazeze nuk arrin të sigurojë zbatimin e shpejtë të vendimit gjyqësor të vitit 1994, ajo duhet t’u paguajë të gjithë kërkuesve, së bashku, shumën prej 92.000 eurosh.

### **III. Koment**

17. Ky vendim, i pari kundër Malit të Zi, është i rëndësishëm sepse sqaron qëllimin e përkohshëm të detyrimeve të Serbisë dhe Malit të Zi sipas Konventës në vijim të shpërbërjes së shtetit federal dhe daljes së Malit të Zi si shtet më vete.

18. Aspekti i parë që rrjedh nga ky vendim i Gjykatës është ai që ka të bëjë me një parim të rëndësishëm të së drejtës ndërkombëtare, atë të suksedimit të shteteve

në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre ndërkombëtare<sup>20</sup> dhe sidomos kur këto kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Gjykata sqaron se Konventa konsiderohet se ka hyrë në fuqi në lidhje me Malin e Zi që nga data e ratifikimit të saj nga Shteti Federal Serbi dhe Mali i Zi, në mars 2004 e deri më sot, duke e mëvetësuar këtë përgjegjësi në lidhje me Malin e Zi nga data kur Mali i Zi shpalli pavarësinë nga shteti federal.

19. Gjithashtu, rasti në fjalë qartëson se megjithëse edhe Serbia mund të konsiderohej juridikisht e detyruar nga Konventa për faktet në fjalë deri në 5 qershor 2006, me shpalljen e pavarësisë nga Mali i Zi dhe duke pasur parasysh se procedurat për lirim të apartamentit ishin kompetencë vetëm e autoriteteve malazeze, vetëm ky i fundit konsiderohej përgjegjës për shkeljen në fjalë dhe jo Serbia. Kjo nënkupton se nëse i njëjti rast do të kishte ndodhur brenda territorit aktual serb, atëherë supozohet se vetëm Serbia do të ishte shteti përgjegjës. Ky rast paraqet interes të krahasohet me atë të përshkruar dhe të analizuar në vendimin Azemi kundër Serbisë, të përfshirë në këtë botim.

20. Përsa i përket shkeljeve të gjetura në lidhje me themelin e pretendimeve, mund të vihet në dukje fakti, se në një çështje që ka në themel mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të brendshëm, Gjykata nuk e analizon këtë rast, së pari, në bazë të nenit 6 § 1, në vijim të jurisprudencës *Hornsby kundër Greqisë*, të përfshirë në këtë botim, por e analizon nën këndvështrimin e nenit 1 të Protokollit 1 dhe pastaj arrin në përfundimin se nuk është e nevojshme që të analizohet edhe në kuadrin e nenit 6 § 1, pasi thelbi i problemit është i njëjti.

21. Në lidhje mesazhin që rrjedh nga ky vendim, mbetet të shpresohet që Mali i Zi, ashtu si edhe shtete të tjera me probleme të njëjta, ku përfshihet edhe Shqipëria, të garantojnë mos përsëritjen e rasteve kur një zaptues prone të guxojë të nëpërkëmbë legjislacionin ose vendimet përfundimtare të gjykatave, ose të mos realizojë në mënyrë të vazhdueshme marrjen e hapave të nevojshëm për të siguruar zbatimin e ligjit dhe të një vendimi gjyqësor që është forma më konkrete, përfundimtare dhe më e lartë e këtij zbatimi.

---

20 Shih për këtë qëllim Konventën e Vienës mbi suksesimin e shteteve në lidhje me traktatet ndërkombëtare, të 23 gushtit 1978.

## AL-SKEINI DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 55721/07)

7 korrik 2011

Dhomë e Madhe

*Gjykata saktëson nocionin e juridiksionit përtej territorit duke theksuar se Mbretëria e Bashkuar duhet të kishte hetuar vdekjen e gjashtë civilëve të vrarë në Irak në vitin 2003 në incidente ku ishin përfshirë ushtarë britanikë*

### I. Faktet kryesore

1. Pas rënies së regjimit Ba'ath në Irak më 1 maj të vitit 2003, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar dhe partnerët e tyre të koalicionit ishin fuqitë pushtuese dhe krijuan një organizëm qeverisës të përkohshëm, Autoritetin e Përkohshëm të Koalicionit (APK). Një nga kompetencat e ushtruara nga APK-ja, i cili u njoh edhe nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Rezolutën 1483 ishte garantimi i sigurisë në Irak. Pushtimi mori fund më 28 qershor të vitit 2004, kur autoriteti i plotë për të qeverisur Irakun, i kaloi Qeverisë së Përkohshme irakiane dhe APK-ja pushoi së ekzistuari. Gjatë periudhës së pushtimit, Britania e Madhe kishte komandën e provincës Al-Basrah, ku edhe të afërmit e kërkuesve vdiqën. Nga 1 maji 2003 e në vijim forcat britanike në Al-Basrah morën përgjegjësinë për ruajtjen e sigurisë dhe mbështetjen e administratës civile. Në detyrat e Britanisë së Madhe mbi ruajtjen e sigurisë përfshiheshin: patrullimi, arrestimi, operacionet antiterroriste, mbikëqyrja e demonstratave civile, mbrojtja e shërbimeve thelbësore dhe stacionet policore të infrastrukturës dhe të sigurisë.

2. Kërkuesit ishin të afërmit e gjashtë shtetasve irakianë të cilët kishin vdekur në Basra më 2003.

1) Mazin Jum'Aa Gatteh Al-Skeini ishte 23 vjeç kur ai u qëllua për vdekje në Basra, pak para mesnatës më 4 gusht 2003 nga një ushtar nën komandën e një patrulle britanike. Sipas deklaratës së të vëllait, më 4 gusht 2003, z. Al-Skeini kishte qenë në një ceremoni mortore në fshat. Në Irak është zakon që të qëllohet me armë në një ceremoni mortore. Ai pa ushtarët që qëlluan dhe vrarë vëllain e tij dhe një burrë tjetër, pa ndonjë arsye të dukshme, pasi të dy ishin të paarmatosur dhe rreth dhjetë metra nga ushtarët. Sipas variantit të ushtarëve britanikë, patrulla, duke u afruar në këmbë dhe në një natë shumë të errët, dëgjoi të shtëna armësh të rënda në Al-Majidiyah. Ata panë dy burra irakianë në një rrugë të fshatit, njëri prej të cilëve ishte rreth pesë metra nga rreshteri A, i cili drejtonte patrullën. Rreshteri A pa se ai ishte i armatosur dhe po i

drejtonte armën. Duke besuar se jeta e tij dhe e ushtarëve të tjerë të patrullës ishin në rrezik të menjëhershëm, rreshteri A hapi zjarr ndaj dy burrave pa paralajmërim. Komanda britanike vendosi se incidenti përfshihej në rregullat e përdorimit të forcës dhe se asnjë hetim i mëtejshëm nuk ishte i nevojshëm.

2) Muhammad Salim u qëllua dhe u plagos për vdekje më 6 nëntor 2003. Duke u bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve okularë, gruaja e tij, zj. Fattema Zabun Dahesh, deklaroi se më 5 nëntor 2003, z. Salim po vizitonte të kunatin në shtëpinë e tij në Basra, kur shtëpia u kontrollua nga ushtarët britanikë. Një nga ushtarët britanikë doli përballë me z. Salim në hollin e shtëpisë dhe me një të shtënë e qëlloi atë në stomak. Sipas variantit britanik të ngjarjes, patrulla kishte marrë informata se një grup njerëzish të armatosur rëndë ishte parë të hynte në shtëpi, prandaj ishte dhënë një urdhër për një operacion të shpejtë kontrolli dhe arrestimi. Meqë pasi trokitën patrullës nuk iu hap dera, ajo e shkallmoi derën. Rreshteri C dëgjoi të shtëna armësh automatike brenda shtëpisë. Dy burra të armatosur me armë të gjata vrapuan poshtë shkallëve në drejtim të tij dhe ai nuk pati kohë të jepte një paralajmërim me gojë. Rreshteri C besoi se jeta e tij ishte në rrezik të menjëhershëm. Ai qëlloi një herë drejt personit të parë, z. Salim dhe e goditi atë në stomak. U vendos që incidenti përfshihej në Rregullat e Përdorimit të Forcës dhe asnjë hetim i mëtejshëm nuk ishte i nevojshëm.

3) Hannan Mahaibas Sadde Shmailawi u qëllua dhe u plagos për vdekje më 10 nëntor 2003 në Institutin e Edukimit. Bashkëshorti i saj deklaroi se në atë datë, rreth orës 20.00, ai dhe familja e tij ishin ulur për të ngrënë darkë kur papritur shpërthyen të shtëna armësh automatike nga jashtë ndërtesës. Plumbat e goditën gruan e tij në kokë dhe këmbë dhe një nga fëmijët e tij në krah. Ata u dërguan në spital, ku fëmija i tij u shërua, ndërsa e shoqja vdiq. Sipas variantit britanik të incidentit, zj. Shmailawi u qëllua gjatë një shkëmbimi zjarri ndërmjet një patrullë britanike dhe disa personave të panjohur të armatosur. Kur zona u ndriçua nga fishekzjarrë parashutë, të paktën tre burra me armë të gjata u panë në terren të hapur, dy prej të cilëve po qëllonin drejt ushtarëve britanikë. U vendos që incidenti përfshihej në Rregullat e Përdorimit të Forcës dhe asnjë hetim i mëtejshëm nuk ishte i nevojshëm.

4) Waleed Sayay Muzban, 43 vjeç, u qëllua dhe u plagos për vdekje nga një ushtar britanik, natën e 24 gushtit 2003. Duke e bazuar dëshminë në rrëfimet e dëshmitarëve okularë, vëllai i tij tha se ai po drejtonte një mikrobus në rreth orës 20.30 të asaj date, i cili "u përfshi nën një breshëri plumbash", duke e lënë vëllanë e tij të plagosur për vdekje me goditje në gjoks dhe stomak. Ushtari S deklaroi se i kishte kërkuar z. Muzban, i cili ishte shoferi i mikrobusit të dyshimtë që t'i afrohej patrullës së tij ngadalë e të ndalonte. z. Murzan e goditi në gjoks me grusht dhe u përpoq t'ia rrëmbente armën përpara se të largohej me shpejtësi, duke dredhuar në drejtim të ushtarëve të patrullës. Mikrobusi ndaloi rreth 100 metra nga patrulla pasi ushtari S gjuajti në rrotat e tij. Kur u duk se shoferi po zgjatej për të marrë një armë, ushtari S besoi se shokët e tij do të qëlloheshin në atë çast dhe kështu që qëlloi disa herë. Shoferi doli jashtë dhe u urdhërua të shtrihej në tokë. Patrulla e kontrolloi mikrobusin nëse kishte njerëz të tjerë të armatosur, por ai ishte bosh. Shoferi kishte tre plagë plumbash

në shpinë dhe në ijë. Atij iu dha ndihma e parë dhe pastaj u dërgua në spital ushtarak çek, ku edhe vdiq. Pas një hetimi, oficeri komandues vendosi që incidenti përfshihej në Rregullat e Përdorimit të Forcës dhe kërkoi që hetimi të mbyllej. Pas kërkesës nga z. Muzban për shqyrtim gjyqësor, hetimi u rihap rreth nëntë muaj më vonë, si dhe u realizuan teste mjeko-ligjore. Prokurorët dëgjuan dëshmitë e ushtarëve, duke përfshirë edhe atë të ushtarit S. Pas një hetimi, një jurist i pavarur me përvojë këshilloi se nuk kishte asnjë perspektivë realiste që të provohej se ushtari S nuk kishte qëlluar për vetëmbrojtje. Dosja iu dërgua Prokurorit të Përgjithshëm, i cili vendosi të mos e ushtrojë juridiksionin e tij për të urdhëruar ndjekjen penale.

5) Ahmed Jabbar Kareem Ali vdiq më 8 maj 2003, në moshën 15 vjeç. Babai e kishte kërkuar, pasi nuk ishte kthyer në shtëpi natën vonë, siç pritej. Babait i thanë se i biri dhe tre të rinj të tjerë irakenë ishin arrestuar nga ushtarët britanikë që në mëngjes. Dyshohej se ata ishin rrahur dhe detyruAR të hynin në lumin Shatt Al-Arab. Djali i tij nuk mund të notonte dhe trupi i tij u gjet në ujë më 10 maj 2003. Pas një hetimi, katër ushtarë u gjykuan për vrasje nga një gjyq ushtarak. Tre ushtarë të tjerë të dyshuar për bashkëpunim ishin larguar pa njoftim. Prokuroria argumentoi se ushtarët kishin dyshuar se katër të rinjtë kishin kryer një grabitje dhe i kishin detyruan ata të futeshin në lumë për t'u "dhënë një mësim". Ushtarët u liruan kur dëshmitari kryesor i prokurorisë nuk ishte në gjendje që t'i identifikonte ushtarët. Në vijim të ankimit civil, të atit të djalit iu dha si dëmshpërblim një shumë prej 115 000 sterlinash nga Ministria e Mbrojtjes, si dhe iu paraqit një falje zyrtare nga ushtria britanike.

6) Baha Mousa ishte 26 vjeç kur vdiq në paraburgim, tre ditë pasi u arrestua nga ushtarët e Ushtrisë britanike më 14 shtator 2003. Babai i tij, koloneli Daoud Mousa shkoi për marrë atë nga puna në një hotel në Basra. Ai pa që djali i tij dhe gjashtë punonjës ishin arrestuar. Atij iu tha se ishte një hetim rutinë që do të përfundonte për nja dy orë. Në ditën e tretë pas arrestimit pjesëtarët e Policisë Ushtarake Mbretërore informuan kolonelin Mousa se djali i tij ishte vrarë në paraburgim. Atij iu kërkua të identifikonte trupin. Trupi Baha Mousa dhe fytyra ishin mbuluar me gjak dhe dëmtime; hunda i ishte thyer dhe një pjesë e lëkurës së fytyrës ishte shqyer. Një punonjës i hotelit, i cili ishte arrestuar gjithashtu në të njëjtën kohë, dëshmoi se të burgosurve irakenë u kishin mbuluar kokat me kapuçë, ishin detyruar të qëndronin në pozicione stresi, nuk iu jepej as ushqim as ujë dhe rriheshin. Gjithashtu, ai tregoi se Baha Mousa ishte çuar në një dhomë tjetër, nga ku dëgjohej se ulërinte dhe rënkonte. Një hetim që u hap në lidhje me vdekjen e Baha Mousa, gjeti se ai kishte 93 dëmtime të identifikueshme mbi trupin e tij dhe se kishte vdekur nga asfiksia. Kolonel Mousa nisi procedurat civile kundër Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat përfunduan në korrik 2008 me një pranim formal dhe publik të përgjegjësisë dhe pagimin e 575,000 sterlinave si kompensim. Më 14 maj 2008, Sekretari i Shtetit për Mbrojtjen njoftoi fillimin e një hetimi publik mbi vdekjen e Baha Mousa. Raporti u dorëzua në shtator të vitit 2011 dhe theksonte një injorancë të madhe në radhët e ushtrisë mbi trajtimin e të burgosurve të luftës, si dhe një mungesë doktrine të përshtatshme mbi teknikat e marrjes në pyetje.

3. Në mars të vitit 2004, Sekretari i Shtetit për Mbrojtjen vendosi që të mos kryheshin hetime të pavarura në lidhje me vdekjet, që të mos pranohej përgjegjësia në lidhje me vdekjet dhe të mos paguhej dëmshpërblim. Kërkuesit aplikuan për një shqyrtim gjyqësor. Në dhjetor 2004, Gjykata e Shkallës së Parë pranoi vetëm pretendimin e Kolonel Mousa dhe hodhi poshtë pretendimet e katër kërkuesve të tjerë, kurse pretendimi i kërkuesit të pestë u pezullua. Gjykata u shpreh se Shtetit i kërkohet normalisht ta zbatojë Konventën brenda territorit të saj. Ka pasur disa përjashtime ndaj këtij rregulli dhe fakti që Baha Mousa ishte vrarë në një bazë ushtarake britanike përbënte një përjashtim të tillë. Megjithatë, Mbretërisë së Bashkuar nuk i kërkohet ta zbatonte Konventën në lidhje me të afërmit të kërkuesve të tjerë. Gjykata konstatoi se kishte shkelje të detyrimit për të hetuar sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës në lidhje Baha Mousa për shkak se deri në korrik të vitit 2004, rreth 10 muaj pas vrasjes, rezultatet e hetimit ishin të panjohura dhe pa asnjë përfundim. Të gjitha apelimet në Gjykatën e Apelit u hodhën me pretendimin se vdekjet, përveç saj të Baha Mousa, nuk ishin brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar. Në qershor të vitit 2007, Dhoma e Lordëve<sup>21</sup> konstatoi se, me përjashtim të rastit të Baha Mousa, Mbretëria e Bashkuar nuk kishte juridiksion mbi vdekjet e viktimave. Sekretari i Shtetit e kishte pranuar tashmë se vdekja Baha Mousa ishte brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar sipas Konventës. Më 25 janar 2008 Ministria e Mbrojtjes botoi Raportin Aitken në lidhje me gjashtë raste të abuzimit të dyshuar të qëllimshëm dhe vrasjen e civilëve irakenë, duke përfshirë vdekjen e bijve të kërkuesve pestë dhe gjashtë.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesit pretenduan se të afërmit e tyre ishin brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar sipas nenit 1 të Konventës, kur ata u vranë si pasojë e akteve të forcave të armatosura britanike. Ata u ankuan sipas nenit 2 dhe, në rastin e kërkuesit të gjashtë nenit 3, në lidhje me dështimin për të kryer një hetim të plotë dhe të pavarur mbi rrethanat e çdo vdekjeje. Kërkesat u paraqitën në Gjykatë më 11 dhjetor 2007. Dhoma hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe, dhe më 9 qershor 2010 u mbajt një seancë publike.

### A. Në lidhje me nenin 1

5. Çështja kryesore ishte nëse Konventa gjente zbatim në lidhje me vrasjen e civilëve irakenë në Irak nga ushtarët britanikë gjatë periudhës maj dhe nëntor 2003 dhe nëse viktimat ishin brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar. Duke iu referuar jurisprudencës së saj të mëparshme, Gjykata vuri në dukje se aktet jashtë territorit hyjnë brenda juridiksionit të shtetit vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Një përjashtim i tillë sipas jurisprudencës së Gjykatës është ai kur një shtet palë i Konventës ushtron kompetenca publike në territorin e një shteti tjetër. Në rastin konkret, pas largimit nga pushteti të regjimit Ba'ath dhe

21 Që nga 1 tetori 2009, në përputhje me Pjesën 3 të Ligjit të vitit 2005 mbi Reformën Kushtetuese, është krijuar Gjykata Supreme e Mbretërisë së Bashkuar.



deri në pranimin e Qeverisë së Përkohshme të Irakut, Mbretëria e Bashkuar, së bashku me Shtetet e Bashkuara morën disa pushtete publike që normalisht ushtrohen nga një qeveri sovraane. Në veçanti, Mbretëria e Bashkuar mori autoritetin dhe përgjegjësinë për ruajtjen e sigurisë në Irakun Juglindor. Në këto rrethana të jashtëzakonshme, ekzistonte një lidhje juridiksionale midis Mbretërisë së Bashkuar dhe individëve të vrarë gjatë operacioneve të sigurisë të kryera nga ushtarët britanikë, gjatë periudhës nga maji 2003 deri në qershor 2004. Përderisa të afërmit e kërkuesve u vranë gjatë operacioneve për ruajtjen e sigurisë nga Mbretëria e Bashkuar gjatë kësaj periudhe, kjo e fundit duhet të kryente një hetim mbi vdekjen e tyre.

### *B. Në lidhje me nenin 2 (hetimi efektiv)*

6. Kërkuesit u ankuan se qeveria britanike nuk e kishte përmbushur detyrën e saj për të kryer një hetim efektiv mbi vdekjet e të afërmeve të tyre. Duke vënë në dukje se detyrimi për të mbrojtur jetën kërkon një hetim zyrtar efektiv kur individët janë vrarë si rezultat i përdorimit të forcës nga ana e agjentëve të shtetit, Gjykata pranoi problemet praktike që krijonte për autoritetet hetimore fakti që Mbretëria e Bashkuar ishte fuqi pushtuese në një rajon të huaj dhe armiqësor. Në këto rrethana, detyrimit procedural sipas nenit 2 duhet zbatuar në mënyrë realiste. Megjithatë, fakti që Mbretëria e Bashkuar ishte pushtuese nënkuptonte se, që një hetim në lidhje me aktet e kryera nga ushtarët britanikë të konsiderohej efektiv, ishte veçanërisht e rëndësishme që autoriteti hetimor të ishte, dhe të shihej se ishte, funksionalisht i pavarur nga zinxhiri i komandës ushtarake.

7. Nuk vihej në dyshim se në rastin e kërkuesve të parë, të dytë dhe të katërt, të afërmit e tyre u vranë nga ushtarë britanikë, identiteti i të cilëve ishte i njohur. Pyetja ishte nëse në çdo rast ushtarët kishin qëlluar në përputhje me rregullat për përdorimin e forcës. Në lidhje me kërkuesin e tretë, neni 2 kërkon një hetim për të përcaktuar rrethanat e vrasjes, duke përfshirë edhe nëse janë ndërmarrë hapat e duhura për të mbrojtur civilët në afërsi të vendit të ngjarjes. Në lidhje me djalin e kërkuesit të pestë, ishte e nevojshme të përcaktohej nëse ushtarët britanikë, siç pretendohet, e kishin rrahur djalin dhe nëse e kishin detyruar të futej në lumë. Në çdo rast, dëshmia e dëshmitarit okular ka qenë vendimtare. Prandaj ishte e domosdoshme që sa më shpejt që të jetë e mundur pas ngjarjes, dëshmitarët ushtarakë, dhe në veçanti autorët e dyshuar, të merreshin në pyetje nga një hetues ekspert dhe plotësisht i pavarur. Gjithashtu, duhej të ishte bërë çdo përpjekje për të identifikuar dëshmitarë okularë irakenë dhe për t'i bindur ata se nuk do ta vinin veten në rrezik për shkak të dëshmimeve dhe se këto do të trajtoheshin me seriozitet dhe do të veprohej pa vonesë. Ishte e qartë se hetimet në vrasjen e të afërmeve të kërkuesve të parë, të dytë dhe të tretë kishin dështuar të përmbushnin kërkesat e nenit 2, pasi procesi i hetimi mbeti tërësisht brenda zinxhirit të komandës ushtarake dhe ishte i kufizuar në marrjen e deklaratave nga ushtarët e përfshirë. Në lidhje me kërkuesit e tjerë, edhe pse ka pasur një hetim nga Dega e Hetimeve Speciale mbi vdekjen e vëllait të kërkuesit të katërt dhe të birin të kërkuesit të pestë, Gjykata nuk ka marrë parasysh se kjo ishte e

mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e nenit 2, për shkak se ajo nuk ishte e pavarur në funksionim nga zinxhiri komandues ushtarak. Nga ana tjetër, një hetim i plotë dhe publik thuajse po përfundonte në kohën e gjykimit të kësaj çështje në Strasburg, në lidhje me rrethanat e vdekjes së Baha Mousa. Nën dritën e këtij hetimi, kërkuesi i gjashtë nuk ishte më një viktimë e ndonjë shkelje të detyrimit procedural sipas nenit 2. Si përfundim, Gjykata gjeti shkelje të nenit 2 në lidhje me mungesën e një hetimi efektiv në vdekjen e të afërmeve të kërkuesve të parë, të dytë, të tretë, katërt dhe të pestë.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

8. Gjykata u shpreh se Britania e Madhe detyrohej t'u paguante secilit prej pesë kërkuesve nga 17 000 euro, në lidhje me dëmin jopasuror dhe 50 000 euro, të gjithëve së bashku, në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

### **III. Koment**

9. Ky vendim njihet ndërkaq si vendimi që përcakton se shtetet që janë palë të KEDNj-së janë përgjegjëse përpara Gjykatës së Strasburgut për veprimet e personelit të tyre ushtarak kur ata angazhohen në pushtimin, mënyrë të ligjshme apo jo, të vendeve të huaja, ose të territoreve të cilat janë *de jure* ose *de facto* jashtë territoreve të njohura të shteteve kontraktore. Viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut si ato në rastin e pushtimit të Irakut u konsideruan se ishin brenda juridiksionit të palës kontraktore, në këtë rast të Mbretërisë së Bashkuar.

10. Ky vendim, ashtu si vendimi *Al-Jedda kundër Mbretërisë së Bashkuar* i dhënë në të njëjtën ditë nga ana e Dhomës së Madhe dhe që kishte lidhje me paraburgimin e një civili iraken në një bazë ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar, rishikon përjasjen e mbajtur në vendimin e pranueshmërisë të datës 12.12.2001 në çështjen *Banković dhe të tjerët kundër 17 Shteteve të NATO-s*, dhe në vendimet e datës 2.5.2007, *Behrami dhe Behrami kundër Francës*, dhe *Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë*. Vendimi që po komentojmë hedh poshtë përfundimisht qëndrimin e mbajtur në çështjen *Banković* se juridiksioni kufizohet vetëm në "hapësirën juridike" të KEDNj-së, domethënë në territoret e shteteve, të cilat janë palë në Konventë. Megjithatë, vendimi i Dhomës së Madhe ka një tjetër element me zbatim më të përgjithshëm. Siç mund të shihet nga vendimi, Gjykata në çështjen *Al-Skeini* parashikon përfundimisht dhe me shumë hollësi se çfarë i kërkohet një shteti, në mënyrë që ai të plotësojë detyrimin për të kryer një hetim të shpejtë dhe të pavarur mbi vdekjet që kanë ndodhur (ose dyshohet se kanë ndodhur), si pasojë e veprimeve të agentëve të shtetit, të kryera madje edhe jashtë territorit shtetëror.

11. Në kohën që po bëhet komenti i këtij vendimi, parimi po iu nënshtrohet vlerësimeve sa juridike aq edhe politike.



## JALOUUD kundër HOLANDËS

(kërkesa nr. 47708/08)

20 nëntor 2014

### Dhoma e Madhe

*hetimi jo efektiv në lidhje me vrasjen e një shtetasi iraken nga ushtarët holandezë gjatë pushtimit të Irakut në vitin 2004 ishte brenda juridiksionit të Holandës*

#### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje ka të bëjë me vdekjen e Azhar Sabah Jaloud në një pikë kontrolli të automjeteve, e cila ishte nën drejtimin e ushtarëve holandezë dhe Trupave Irakiane të Mbrojtjes Civile (TIMC). Më 21 prill 2004, një makinë iu drejtua me shpejtësi pikës së kontrollit të automjeteve, duke goditur një prej fuçive të vendosura në mes të rrugës për të krijuar këtë pikë kontrolli. Automjeti u qëllua disa herë dhe shoferi ndaloi. Disa nga të shtënat vinin nga arma e togerit A, i cili komandonte ushtarët holandezë dhe të shtëna të tjera mund të jetë qëlluar nga ushtarë të TIMC. Azhar Sabah Jaloud, i cili ishte ulur në vendin e pasagjerit, ishte qëlluar në disa pjesë të trupit dhe pavarësisht nga përpjekjet e ushtarëve holandezë për t'i dhënë ndihmën e parë, ai u shpall i vdekur një orë më vonë.

2. Në lidhje me këtë ngjarje filloi një hetim nga Policia Ushtarake Mbretërore. Prokurori Publik Ushtarak i mbylli hetimet në qershor të vitit 2004 dhe vendosi të mos e ndjekë penalisht togerin A, duke arritur në përfundimin se Azhar Sabah Jaloud ishte qëlluar, mesa dukej, nga plumba irakenë. Megjithëse prokuroria pranoi se ishte qëlluar edhe nga togeri A, nuk kishte prova se ishte ai që kishte shkaktuar vdekjen e Azhar Sabah Jaloud. Prokuroria deklaroi që edhe në rast të kundërt, vrasja mund të justifikohet me supozimin se togeri A kishte vepruar në kushtet e vetëmbrojtjes. Gjykata e Apelit në Angli e la në fuqi vendimin e prokurorit për të mos e ndjekur penalisht togerin A. Ai arriti në përfundimin se togeri A kishte reaguar ndaj të shtënave të dala nga armët e kolegëve të tij nga ana tjetër e rrugës, duke menduar se ishin të shtëna armiqësore të bëra nga brenda makinës. Për këtë arsye, ai ka vepruar brenda udhëzimeve që kishte marrë dhe vendimi për të mos ndjekur atë penalisht ishte i arsyeshëm.

3. Përpara Gjykatës, kërkesa u soll nga z. Sabah Jaloud, që është babai i të ndjerit z. Azhar Sabah Jaloud.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesi u ankua në bazë të nenit 2, duke pretenduar se hetimi mbi rrethanat e vdekjes së djalit të tij nuk kishte qenë aq i pavarur dhe efektiv sa duhej. Qeveria holandeze ngriti një prapësim paraprak duke pretenduar se viktima nuk ishte brenda juridiksionit holandez për qëllimet e nenit 1. Më 9 korrik 2013, një Dhomë e Seksionit II të Gjykatës hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndërlikimin e elementeve faktike dhe juridike të kësaj çështjeje, Dhoma e Madhe vendosi të bashkojë prapësimet paraprake me themelin e çështjes dhe e deklaroi çështjen të pranueshme.

### A. Në lidhje me juridiksionin

5. Qeveria holandeze pretendoi se rrethanat e çështjes nuk përfshiheshin në juridiksionin e Holandës, sepse, së pari, Holanda nuk ka qenë një nga "fuqitë pushtuese" në Irak. Së dyti, theksoi ajo, ushtarët holandezë se nuk kishin ushtruar autoritet dhe kontroll përderisa pika e kontrollit ishte ngritur dhe drejtohej nga TIMC-i. Gjykata theksoi se një shtet nuk mund të çlirohet nga detyrimet e tij sipas nenit 2 duke thënë se ka ekzekutuar ose zbatuar një vendim ose urdhër të dhënë nga një autoritet i një shteti tjetër, që në rastin konkret ishte Mbretëria e Bashkuar<sup>22</sup>. Gjykata konstatoi se Holanda kishte "komandë të plotë" mbi personelin e saj ushtarak. Holanda kishte marrë përgjegjësinë për të garantuar sigurinë në atë zonë në ditën e ngjarjeve dhe TIMC-i ishte thjesht nën varësinë e saj. Në këto kushte, Gjykata konstatoi se Holanda kishte juridiksion dhe hodhi poshtë kundërshtimin paraprak të qeverisë së saj.

### B. Në lidhje me nenin 2

6. Në lidhje me elementin procedural të nenit 2, kërkuesi u ankua se Policia Ushtarake Mbretërore dhe prokurori publik ushtarak nuk kishin qenë të pavarur aq sa duhej, sepse ata ndanin kapononet e banimit me personelin ushtarak të ushtrisë holandeze. Gjykata konstatoi se ky fakt nuk kishte ndikuar në pavarësinë e xhandarmërisë Ushtarake Mbretërore.

7. Gjithashtu, kërkuesi pretendoi se hetimi nuk kishte qenë i përshtatshëm. Gjykata konstatoi se hetimet kishin qenë të papërshtatshme në një sërë çështjesh: autoritetet gjyqësore dhe paditësi nuk kishin pasur akses në dokumentet që përmbanin informacion të rëndësishëm në lidhje me rrethanat e rastit, si p.sh. në listën e emrave të personelit të TIMC-it që kishin qëlluar, informacione të cilat i kishte togeri A. Gjithashtu, nuk ishin marrë masat për të parandaluar togerin A që të mund të koordinohet me dëshmitarë të tjerë para se ai të merrej në pyetje. Në vijim, u vërejt se kushtet në të cilat ishte bërë autopsia ishin të papërshtatshme për qëllimet e hetimeve dhe provat materiale, të tilla si copëza plumbash, kishin humbur. Gjykata konstatoi se këto mangësi mund të ishin

22 Kjo sepse Rezoluta 1483 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së caktonte vetëm Shtetet e Bashkuara dhe Britaninë e Madhe si fuqi pushtuese. Shih gjithashtu vendimin *Al-Skeini kundër Britanisë së Madhe*, të përfshirë në këtë botim.

shmangur dhe vlerësoi se Holanda kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj procedurale sipas nenit 2 të Konventës. Për rrjedhojë ajo vendosi se ka pasur shkelje procedurale të këtij neni.

### C. Në lidhje me nenin 41

8. Gjykata i njohu të drejtën për dëmshpërblim kërkuesit në masën prej 25,000 eurosh për dëmet jomateriale, si dhe 1,372.06 euro për kostot dhe shpenzimet.

### III. Koment

9. Ky vendim i Dhomës së Madhe është i fundit i një serie të gjatë çështjesh në lidhje me përgjegjësinë e shteteve për veprimet dhe mosveprimet e personelit të tyre ushtarak të angazhuar në operacione jashtë territorit kombëtar. Rëndësia e Jaloud qëndron në arsyetimin e përdorur nga Gjykata për të gjetur se vdekjet kanë ndodhur brenda juridiksionit të Holandës. Gjykata konstatoi se fakti që Holanda nuk ishte një "fuqi pushtuese" sipas Konventës së Hagës nuk ishte përcaktues për qëllimet e pasjes së juridiksionit sipas nenit 1 të Konventës. Sipas Gjykatës nuk ishte përcaktues as fakti që trupat holandeze vepronin nën kontrollin e përgjithshëm operativ të Mbretërisë së Bashkuar, si fuqi pushtuese, që nga çasti që Holanda kishte pasur "komandën e plotë" mbi personelin e saj ushtarak.

10. Duke hedhur poshtë këto arsye në lidhje me pretendimin e mospasjes së juridiksionit, Gjykata vazhdoi në përcaktimin e kuptimit të bazës konceptuale të juridiksionit. Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës ka bërë të qartë se thjesht vrasja e dikujt nuk e sjell atë person brenda juridiksionit të shtetit të autoriteteve ose individëve që kanë kryer vrasjen. Në këtë rast nuk ka pasur civilë të arrestuar nga forcat ushtarake të shtetit të paditur, siç ka qenë rasti në çështje të mëparshme (*Al-skeini al Jedda*). Në fakt, kjo përbën risinë më të rëndësishme të vendimit. Gjykata vërejt se shteti i paditur e kishte ushtruar juridiksionin e saj me qëllim që "ushtronte autoritet dhe kontroll mbi personat që kalojnë nëpër pika kontrolli". Në këtë mënyrë, Gjykata pranoi një kriter të ri për njohjen e juridiksionit. Do të jetë interesante të shihet nëse Gjykata do ta zbatojë këtë kriter edhe për situata të tjera të ngjashme me kontrollet në postbllok, të tilla si kontrollet ekstraterritoriale kufitare<sup>23</sup>. Gjykata kishte vërejtur tashmë se çështje të juridiksionit mund të lindin si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve në det të hapur (shih *Medvedyev dhe të tjerët kundër Francë* dhe *Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë*).

23 Shih çështjen britanike në lidhje me një qytetar somalez që kërkonte të bashkohej me familjen në Britani, ku ky problem u shmang.

## AZEMI kundër SERBISË

(kërkesa nr. 11209/09)

5 nëntor 2013

*ky vendim papranueshmërie ka të bëjë me çështjen nëse tashmë Serbia është përgjegjëse sipas Konventës për moszbatimin e një vendimi gjyqësor të dhënë nga gjykatat kosovare*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, z. Ali Azemi, është shtetas i Kosovës, i cili ka lindur në vitin 1946 dhe jeton në Ferizaj, Kosovë. Në vitin 1990, kontratat e punës të kërkuesit dhe të disa prej kolegëve të tij me një ndërmarrje u ndërprejnë. Pas kësaj, ata iu drejtuan Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, por kërkesa e tyre nuk u shqyrtua asnjëherë. Në vitin 2002 Gjykata Komunale e Ferizajt vërejti se pushimi nga puna i kërkuesit dhe i kolegëve të tij kishte qenë i paligjshëm dhe urdhëroi kthimin e tyre në punë. Ajo urdhëroi punëdhënësin e tyre për t'u njohur atyre të gjitha të drejtat për periudhën 1990-2001. Përderisa asnjë ankim nuk u bëj ndaj këtij vendimi ai u kthye në përfundimtar në mars 2002. Megjithatë, ai nuk u zbatua. Ndërkohë, ndërmarrja punëdhënëse u privatizua sipas një procesi të organizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Akti final i privatizimit mban datën 21 nëntor 2007.

2. Në vitin 2010, Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendosi se ka pasur një shkelje të së drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë për shkak të moszbatimit të vendimit të Gjykatës Komunale. Ajo urdhëroi zbatimin e tij nga AKP-ja. Megjithatë vendimi nuk ishte zbatuar deri në ditën që Gjykata mori në shqyrtim çështjen.

### II. Vendimi i Gjykatës

3. Kërkuesi u ankua kundër Serbisë në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me mos-zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale. Megjithatë, që të mund të trajtonte pretendimet në bazë të nenit 6, Gjykata e vlerësoi të nevojshme që, së pari, të analizonte nëse faktet e ankimuaru ishin brenda juridiksionit të Serbisë sipas nenit 1 të Konventës.

#### A. Në lidhje me nenin 1

4. Gjykata mori në shqyrtim fillimisht periudhën midis viteve 1990 dhe 10 qershorit 1999, kur u miratua Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në atë kohë, Serbia nuk e kishte ratifikuar ende Konventën dhe ankesat në lidhje me këtë periudhë u konsideruan të papajtueshme *ratione temporis* pasi

Konventa ka hyrë në fuqi në lidhje me Serbinë vetëm më 3 mars 2004. Në lidhje me periudhën nga 10 qershori 1999 e tutje, Gjykata vuri në dukje se, në bazë të Rezolutës 1244, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ka marrë përsipër të gjitha pushtetet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në Kosovë. Për më tepër, nuk kishte asnjë provë që autoritetet serbe kishin ushtruar apo kishin pasur mundësi të ushtronin ndonjë kontroll mbi UNMIK-un. Në fakt, edhe vetë gjykatat serbe kishin konfirmuar se Serbia nuk kishte ushtruar ndonjë kontroll efektiv në Kosovë që nga viti 1999.

5. Pra, Gjykata vërejtë se Serbia nuk kishte pasur asnjë mundësi objektive që të siguronte respektimin e të drejtave të Konventës në Kosovë gjatë gjithë kësaj periudhe. Gjithashtu, ajo vuri re se në rastin konkret nuk mund të pretendoheshin detyrime pozitive nga ana e Serbisë që ajo të merrte masa të tjera të përshtatshme për zbatimin e vendimit. Nga ana tjetër, nëse supozohet se ankesat do të ishin ngritur kundër UNMIK-ut, që përbënte një administratë civile ndërkombëtare, Gjykata, duke përsëritur jurisprudencën e saj të qëndrueshme në lidhje me faktin se shkeljet e pretenduara të Konventës duhet të kryhen nga Shtetet kontraktuese ose t'u atribuohen atyre, i deklaroi ato të papranueshme.

6. Më tej, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe marrjes fund të "pavarësisë së mbikëqyrur", të deklaruar si të tillë më 10 shtator 2012, Gjykata konstatoi se ka pasur kufizime objektive që bënin që Serbia të mos mund të konsiderohej se mund të siguronte të drejtat dhe liritë themelore në Kosovë. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se Serbia nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për moszbatimin e vendimit të vitit 2002 të Gjykatës komunale në lidhje me rikthimin e zotit Azemi dhe të kolegëve të tij në punë. Si përfundim, kërkesa u shpall e papranueshme.

### III. Koment

7. Kjo çështje u deklarua e papranueshme për dy lidhje juridiksionale, ajo kohore (*ratione temporis*) dhe ajo territoriale (*ratione loci*). Por ky vendim papranueshmërie ka një rëndësi të konsiderueshme për dy arsye, së pari për lidhjen tepër interesante faktike dhe analitike të këtyre dy elementeve juridiksionale, dhe së dyti sepse vendimi konfirmon, nga ana e Strasburgut, që Serbia nuk ka asnjë juridiksion në Kosovë.

8. Është e rëndësishme të theksohet problemi në këtë çështje nuk ishte shkarkimi i paligjshëm i kërkuesit dhe kolegëve të tij në vitin 1990, kur Kosova ishte pjesë e ish-Jugosllavisë dhe sipas të drejtës ndërkombëtare mbi suksedimin e shteteve, Serbia, si suksesore e Jugosllavisë, duhet të ishte përgjegjëse. Problemi në fakt është dështimi për të zbatuar vendimin e Gjykatës Komunale të Ferizajt në vitin 2002, pasi UNMIK-u kishte marrë përgjegjësi mbi situatën në Kosovë. Në lidhje me këtë çast Gjykata e gjen zgjidhjen mbi bazën e juridiksionit kohor (*ratione temporis*). Pa u përfshirë në diskutimin nëse Serbia mund të kishte pasur apo jo,

*de jure* ose *de facto*, kontroll në Kosovë në vitin 2002, Gjykata preferoi zgjidhjen më të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë: Serbia nuk kishte qenë palë e Konventës në atë datë. Serbia, ashtu si çdo shtet tjetër anëtar mund të konsiderohen përgjegjëse vetëm për veprime ose mosveprime që kishin lindur pas anëtarësimit në Konventë, pra, pas vitit 2004. Në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve të dhëna përpara datës së aderimit, kjo përgjegjësi vazhdon edhe pas kësaj date, përderisa në këtë rast kemi të bëjmë me një shkelje të vazhdueshme. Në këtë pikë, analiza e Gjykatës orientohet menjëherë drejt *ratione loci* ose juridiksionit territorial dhe një orientim i tillë, ose kombinim i juridiksionit territorial me atë kohor që sapo përmendëm e bën çështjen, siç thamë, tepër interesante. Gjykata vërejt pa ndonjë vështirësi se Gjykata Kushtetuese kosovare kishte gjetur se përgjegjësia për zbatimin e vendimit të shkarkimit i takonte AKP-së dhe Gjykatës nuk i duket e arsyeshme që të mos pajtohej me këtë gjetje. Në këtë mënyrë, Gjykata, në njëfarë mase, njeh edhe juridiksionet kosovare, aktet e tyre juridike, si dhe konstatimet juridike që ato bëjnë.

9. Aspekti i dytë me rëndësi i këtij vendimi është se ai njeh si fakt shkëputjen e çdo lidhjeje juridike, madje edhe të përgjegjësisë ndërkombëtare, që do të thotë edhe nga pikëpamja e subjektit ndërkombëtar, midis Kosovës dhe Serbisë. Kjo sipas Gjykatës, shihet në këdvështrim efektiv që nga 10 qershori 1999 dhe më tej në këdvështrim formal, të paktën që nga 17 shkurti 2008. Çështja duhet kuptuar drejt, pra, pavarësisht se mund të duket se Gjykata nuk i dha të drejtë një shtetasi kosovar kundër Serbisë, ajo e bëri këtë mbi bazën e parimit se Serbia nuk ka asnjë juridiksion mbi Kosovën, një konstatim që konfirmon juridikisht statusin e Kosovës si jashtë juridiksionit të Serbisë, pra, si shtet i pavarur përderisa nuk mund të ishte as në juridiksionin e asnjë shteti tjetër. Natyrisht mbwshtetur kjo nw që opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe deklaratën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, e cila është njohur tashmë nga 114 shtete<sup>24</sup>. Ky vendim nuk do të thotë se Serbia nuk mund të jetë përgjegjëse për asnjë çështje që ka të bëjë me banorët e Kosovës pas vitit 1999. Kështu për shembull, dhënia e dokumenteve, llogaritja e kontributeve të akumuluarua të sigurimeve shoqërore ose pensioneve, të cilat vazhdojnë të rregullohen ose të vendosen nga Serbia, janë çështje për të cilat Serbia është përgjegjëse.

10. Ky rast përbën gjithashtu një evolucion, por edhe një dallim të rëndësishëm në raport me një jurisprudencë të mëparshme të Gjykatës në lidhje me juridiksionin sipas nenit 1 të Konventës. Është interesant që ky vendim të krahasohet dhe të dallohet sidomos me vendimet e marra në lidhje me Transdnistri<sup>25</sup>. Këto rastekishin gjithashtu të bënin me humbjen e kontrollit *de facto* e pjesëve të territorit të vetë shtetit. Megjithatë, ajo që është e dukshme në lidhje me këtë çështje, është shkëlqim i ndryshëm nga gjetjet në çështjen Ilaşcu dhe Catan se

24 Përditësuar në tetor 2017. faqja zyrtare Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, gjendet në <http://www.mfa-ks.net/?page=1,224> (Shënim i redaktorit)

25 Shih Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Ruisë dhe Catan dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Ruisë, vendim i 19 tetorit 2012.



mungesa e kontrollit të territorit nuk e çliron shtetin nga të gjitha detyrimet pozitive për të vijuar mesigurimin e mbrojtjes sipas Konventës brenda territorit.

11. Në Ilaşcu dhe Catan, Gjykata konstatoi se edhe pse Moldavia nuk ka ushtruar kontroll efektiv të Transdniestri, qeveria moldave ishte e vetmja qeveri legjitime e rajonit. Për këtë arsye, qeveria ka vazhduar për shkak një detyrim pozitiv të mbrojtje të drejtat e njohura nga Konventa, edhe pse ata nuk e mbajnë nën kontroll efektiv zonën. Kjo është në kontrast me këtë vendim në të cilin Gjykata ka përcaktuar se Serbia nuk kishte ushtruar asnjë kontroll mbi Kosovën pasi UNMIK-u kishte marrë tërë pushtetin ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor. Prandaj, Serbia nuk kanë një detyrim pozitiv në lidhje me Kosovën.

12. Ndërsa ky vendim reflekton saktë realitetin e marrëdhënieve juridiksionale, është gjithashtu për të ardhur keq për aplikuesit në lidhje me këtë vendim, pasi aplikuesit nuk kanë të drejta sipas Konventës, të drejta që garantohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

13. UNMIK-u nuk mund të konsiderohet përgjegjës sipas Konventës, pasi nuk është një shtet kontraktues, edhe pse "ligji i aplikueshëm" në Kosovë nga UNMIK-u ka përfshirë në mënyrë paradoksale gjithmonë Konventën (siç ishte në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Shtojcën 4, të Marrëveshjes së Dejtonit). Serbia nuk mund të konsiderohet përgjegjëse sot për vendimet gjyqësore në vitin 2002 në lidhje me pushimin nga puna të paarsyeshme të kryera nga një kompani në pronësi publike, në një kohë kur Kosova ishte ende brenda juridiksionit efektiv të Serbisë. Ankuesi ka në dispozicion rrugën e zgjidhjes ndërkombëtare dhe duhet të mbështetet në arsyetimin që AKP-ja vepron në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Rekursi ishte më parë në dispozicion të Panelit Këshillimor për të Drejtat e Njeriut të Kosovës, i cili përbëhet nga juristë të shquar ndërkombëtare dhe mund të vendosë mbi ankesat e paraqitura para marsit 2010 për institucionet e UNMIK-ut si rasti i AKP-së.





# NENI 2

E DREJTA PËR JETËN

## MCCANN DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa 18984/91)

27 shtator 1995

*një vendim themelor në lidhje me interpretimin e së drejtës së jetës dhe tërësisë së masave që duhet të marrin shtetet që aktet e tyre edhe të ligjshme të mos konsiderohen shkelje të së drejtës së jetës*

### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje lindi nga një kërkesë të paraqitur Komisionit më gusht 1991 nga tre shtetas irlandezë dhe britanikë, znj. Margaret McCann, z. Daniel Farrell dhe z. John Savage, të afërmit e të cilëve, respektivisht z. Daniel McCann, znj. Mairead Farrell dhe z. Sean Savage, ishin vrrarë më 6 mars 1988 nga disa anëtarë të një shërbimi ajror special (SAS), i cili është një regjiment i ushtrisë britanike.

2. Që në fillim të vitit 1988, autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar, të Spanjës si edhe ato të Gjibraltarit ishin informuar se organizata IRA po përgatiste një sulm terrorist në Gjibraltar. Më 4 mars 1988 ishte dhënë sinjali i dallimit të një njësie ushtarake aktive të IRA në Malaga të Spanjës. Më 5 mars, vlerësimi i të dhënave nga autoritetet britanike dhe ato të Gjibraltarit parashikonte se njësia ushtarake e IRA, tashmë e identifikuar, do të organizonte një sulm me anë të një bombe të vendosur në një makinë e cila do të mund të shpërthente me anë të një aparati të vendosur në largësi. Arrestimi i anëtarëve të njësisë ishte planifikuar pasi ata ta kishin sjellë makinën në Gjibraltar, gjë që do të përbënte provën për ta përdorur në një gjykim të ardhshëm ndaj tyre. Sidoqoftë, anëtarët e njësisë konsideroheshin nga autoritetet si terroristë të rrezikshëm, të cilët do të ishin me siguri të armatosur dhe në qoftë se do të ndaloheshin nga forcat e sigurisë, ata do të ishin të gatshëm të përdornin armët e tyre ose të shpërthenin bombën.

3. Sean Savage ishte parë në pasditen e 6 marsit 1988 duke parkuar një makinë në Gjibraltar. Më vonë ai ishte parë me Daniel McCann dhe Mairead Farrell, duke vëzhguar vendin ku makina qe parkuar. Pasi të tre u larguan nga makina, një ekspert bombash, pas një shqyrtimi të përciptë, deklaroi se për të makina mund të mbarte një bombë. Pas kësaj u vendos se të tre duhet të arrestoheshin. Ushtarët e SAS-it të veshur civilë po përgatiteshin për t'ia arritur qëllimit. Komisari i policisë së Gjibraltarit ia kaloi kontrollin e operacionit komandantit të njësisë.

4. McCann dhe Farrell u ndanë nga Savage. Ata ndiqeshin nga dy ushtarë. Kur McCann po shihte përreth, njëri nga ushtarët i drejtoi një pistoletë dhe i urdhëroi

të ndalonin. McCann lëvizi dorën e tij drejt trupit ndërsa Farrell kapi shpejt çantën e saj. Duke menduar se ata po aktivizonin bombën, ushtarët qëlluan derisa i vranë të dy të dyshuarit. Savage u ndoq nga dy ushtarë të tjerë. Me të dëgjuar të shtënat ai u kthye duke u gjendur përballë me ndjekësit e tij. Njëri prej tyre e urdhëroi të ndalojë dhe i drejtoi pistoletën. Savage zgjati dorën drejt ijës. Me frikën se ai po tentonte të kapte një telekomandë, ushtarët qëllojnë dhe e vrasin. Pas dëshmimeve të mjekëve, Farrell kishte marrë tetë plumba, McCann pesë dhe Savage gjashtëmbëdhjetë. Në trupin e tyre nuk u gjet asnjë mjet shpërthyes. Pas hetimit doli se makina e parkuar nga Savage nuk mbante mjete shpërthyes ose bombë. Megjithatë një makinë tjetër e zbuluar nga policia spanjolle në Marbella, përmbante një eksploziv të përbërë nga 64 kg semtex, të rrethuar nga dyqind fishekë me dy matës kohorë. Farrell e kishte marrë me qira këtë makinë me një emër të rremë.

5. Më 6 shtator 1988 Prokurori i Gjibraltarit nisi një hetim mbi vrasjet, në të cilin merrte pjesë edhe një juri e zgjedhur nga popullsia vendase. Provat u morën nga 79 dëshmitarë, përfshirë ushtarët, oficerët e policisë dhe personelin mbikëqyrës që kishte marrë pjesë në operacion si dhe patologët, mjekët ligjorë dhe ekspertë eksplozivash. Sipas disa deklaratave të lëshuara nga qeveria, disa të dhëna si identiteti, formimi, pajisja dhe aktivitetet e dëshmitarëve, anëtarë të ushtrisë dhe të shërbimeve të sigurimit, nuk u bënë publike. Më 30 shtator 1988 juria dha vendimin duke i konsideruar vrasjet si të ligjshme dhe legjitime. Të pakënaqur me këtë vendim, kërkuesit - znj. Margaret McCann, z. Daniel Farrell dhe z. John Savage, filluan më 1 mars 1990, përpara Gjykatës së Lartë të Drejtësisë së Irlandës së Veriut, disa veprime kundër Ministrisë së Mbrojtjes. Ministri i Punëve të Jashtme lëshoi disa deklarata duke përjashtuar çdo procedurë kundër Shtetit. Kërkuesit pretenduan më kot autorizimin e një kontrolli juridik mbi legjitimitetin e deklaratave. Veprimet e tyre u hoqën nga lista më 4 tetor 1991.

6. Në kërkesën e tyre drejtuar Komisionit, kërkuesit ankoreshin se vrasjet e Daniel McCann, Mairead Farrell dhe Sean Savage përbënin një shkelje të nenit 2 të Konventës, e cila mbron të drejtën e jetës. Kërkesa iu paraqit Komisionit më 14 gusht 1991. Ajo u deklarua e pranueshme më 3 shtator 1993. Pasi zgjidhja me pajtim dështoi, Komisioni, me njëmbëdhjetë vota kundër gjashtë, bëri një raport më 4 mars 1994, në të cilin ai përmbloodhi faktet e çështjes dhe shprehu opinionin e tij se neni 2 i Konventës nuk ishte shkelur. Komisioni ia kaloi çështjen Gjykatës më 20 maj 1994.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

7. Gjykata së pari rikujtoi se neni 2 tingëllon si një nga nenet më thelbësore të Konventës. Ajo nënvizoi se përjashtimi i nënvizuar në paragrafin 2 tregon se kjo dispozitë përfshin rastet kur vrasja ka ndodhur me qëllim, por ky nuk është objektivi i tij i vetëm. Teksti i nenit 2 i marrë si i tërë, tregon se paragrafi

2 nuk përcakton situatat në të cilat lejohet vrasja me qëllim, por përshkruan ato ku është e mundur "të përdorësh forcën", gjë që mund të çojë në vrasjen e tjetrit në mënyrë të paqëllimtë. Përdorimi i forcës duhet të jetë "i nevojshëm në mënyrë absolute" për të arritur një nga objektivat e cituara në pikat (a), (b) dhe (c). Gjykata vendosi se duhet t'ia nënshtronte heqjen e jetës një shqyrtimi tepër të kujdesshëm, në qoftë se një forcë vdekjeprurëse e qëllimshme qe përdorur, duke marrë në konsideratë jo vetëm veprimet e agjentëve të shtetit por edhe rrethanat, përfshirë këtu edhe çështje si planifikimi dhe kontrolli i veprimeve në shqyrtim<sup>26</sup>.

*A.i. Detyrimi për të mbrojtur jetën në nenin 2 § 1*

*a) Përqasja e ligjit kombëtar dhe të praktikave me nenin 2 paragrafi 1*

8. Gjykata nënvizoi se neni 2 i Kushtetutës së Gjibraltarit është i njëjtë me nenin 2 të Konventës me përjashtim të shkallës së justifikimit të përdorimit të forcës i cili çon në heqjen e jetës. Ushtrimi i forcës që "justifikohet në mënyrë të arsyeshme" i kundërvihet forcës "absolutisht të nevojshme". Ndërsa standardi i Konventës duket më i rreptë se standardi kombëtar, qeveria ishte e mendimit se duke marrë parasysh se në cilën mënyrë standardi interpretohej dhe aplikohet nga gjykatat kombëtare nuk kishte ndonjë ndryshim thelbësor ndërmjet dy koncepteve. Në këndvështrimin e Gjykatës, pavarësisht nga vlera e mendimit të qeverisë, ndryshimi midis dy standardeve nuk ishte aq i mjaftueshëm sa të vendoste për shkelje të nenit 2 §1.

*b) Karakteri i mjaftueshëm i procedurave si një mekanizëm shqyrtimi*

9. Gjykata vlerësoi se një ndalim i përgjithshëm i vrasjeve arbitrare nga agjentët e shtetit do të ishte në praktikë jo efikase, në qoftë se nuk do të kishte një procedurë për të rishqyrtuar ligjshmërinë e përdorimit të forcës vdekjeprurëse nga autoritetet e Shtetit. Detyrimi për të mbrojtur të drejtën e jetës kërkon zhvillimin e një hetimi zyrtar efikas kur individët janë vlarë si rezultat i përdorimit të forcës nga agjentët e shtetit. Megjithatë nuk ishte e nevojshme që Gjykata të vendoste për formën dhe kushtet e zhvillimit të këtij hetimi, përderisa në procedurat e hetimit kërkuesit ishin përfaqësuar ligjërisht nga avokatë dhe ishin dëgjuar shtatëdhjetë e nëntë dëshmitarë. Për më tepër, avokatët që vepronin në emër të kërkuesve kishin mundësi të pyesnin jo vetëm dëshmitarët e tyre por edhe ata të kundërshtarëve të tyre, si edhe ushtarakët e policët që morën pjesë në operacionin anti-terrorist dhe në fund të jepnin mendimin e tyre.

10. Pavarësisht nga këto fakte, Gjykata me një shqyrtim të paanshëm dhe të kujdesshëm të rrethanave të vrasjeve nuk vlerësoi se disa të meta të pretenduara në procedurë penguan në mënyrë thelbësore kryerjen tërësore të hetimit. Pra nuk ka pasur shkelje të nenit 2 §1 mbi këtë bazë.

26 Shih sidomos paragrafët 146-150 të vendimit.

*A.ii. Zbatimi i nenit 2 në ngjarje*

*a) Mendimi i përgjithshëm i vlerësimit të provave*

11. Gjykata nënvizoi se as qeveria as kërkuesit nuk kundërshtonin faktet e mbledhura nga Komisioni, megjithëse ato ndryshonin thelbësisht nga përfundimet në të cilat ato duhet të çonin në bazë të nenit 2. Komisioni u mor me vendosjen e fakteve në mënyrë të besueshme dhe të kujdesshme.

*b) Pretendimi i kërkuesve se vrasjet kishin qenë të paramenduara*

12. Gjykata vlerësoi se ajo kishte nevojë të kishte prova të bindshme përpara se të arrinte në përfundimin se kishte një plan për të vrarë të dyshuarit. Për të nuk ekzistonte një plan ekzekutimi i përgatitur nga një nivel i lartë në Ministrinë e Mbrojtjes ose nga qeveria, ose që ushtarët A, B, C dhe D ishin nxitur ose instruktuar nga oficerët për të filluar operacionin ose që ata të kenë vendosur sipas mendjes së tyre për të vrarë të dyshuarit, pa justifikuar përdorimin e forcës vdekjeprurëse dhe duke mos iu bindur instruksioneve të marra të arrestit. Nuk kishte asnjë provë se autoritetet i kishin inkurajuar ushtarët, duke i lënë të nënkuptonin vrasjen e të dyshuarve.

*c) Organizimi dhe planifikimi i operacionit*

*i. Vlerësime paraprake*

13. Gjykata vlerësoi se, për të shqyrtuar çështjen duke u bazuar mbi nenin 2, duhet pasur parasysh informimi i marrë nga autoritetet britanike, i cili i vinte këta përpara një dileme thelbësore. Nga njëra anë, atyre i kërkohet të mbronin jetën e njerëzve të Gjibraltarit, duke përfshirë edhe personelin ushtarak të tyre dhe nga ana tjetër, të bënin një përdorim sa më minimal të forcës vdekjeprurëse kundër të dyshuarve, nën dritën e detyrimit që rrjedh nga ligji i brendshëm dhe ai ndërkombëtar.

14. Disa faktorë të tjerë u morën gjithashtu në konsideratë. Në radhë të parë, autoritetet gjendeshin përballë një njësie të IRA-s të përbërë nga persona të cilët ishin të dënuar për vendosje lëndësh shpërthyesë si dhe një ekspert eksplozivash. IRA, e gjykuar për veprimet e saj në të kaluarën, kishte treguar një nënvlerësim të jetës njerëzore, përfshirë edhe atë të anëtarëve të saj. Së dyti, autoritetet ishin lajmëruar për operacionin terrorist dhe si rrjedhim kishin mundësi të organizonin reagimin e tyre dhe duke bashkëpunuar me autoritetet e Gjibraltarit të merrnin masa për të ndaluar shpërthimin dhe të arrestonin të dyshuarit. Sidoqoftë, në mënyrë të paevitueshme, autoritetet e sigurimit nuk mund të dinin të gjitha faktet e ngjarjes dhe ishin të detyruar të formulonin politikat e tyre duke u bazuar në hipoteza jo të plota.

*ii. Ndërrhyrja e ushtarëve*

15. Ushtarët që kryen vrasjet (A, B, C, dhe D) ishin informuar nga shefat e tyre se ekzistonte një makinë-bombë e cila mund të shpërthente nga njëri prej tre të dyshuarve me anë të një telekomande që secili prej tyre dispononte, se aparati mund të shpërthente vetëm duke shtypur një sustë dhe se ata mund të ishin

në gatishmëri për ta aktivizuar bombën sapo të ndaloheshin duke shkaktuar kështu humbje të mëdha jetësh dhe plagosje; ata mund të ishin të armatosur dhe gati për të qëlluar. Megjithatë u zbulua shpejt se të dyshuarit nuk mbanin armë, se ata nuk kishin telekomanda dhe se nuk kishte bombë në makinë.

16. Gjykata pranoi se, ushtarët besonin vërtet sipas të dhënave të marra se asgjësimi i të dyshuarve ishte i nevojshëm me qëllim për të ndaluar shpërthimin dhe si rrjedhim humbjet e jetëve. Veprimet që ata morën në përputhje me urdhrat e shefave ishin kuptuar prej tyre si të nevojshëm në mënyrë absolute me qëllim për të mbrojtur njerëz të pafajshëm. Ajo vlerësoi se përdorimi i forcës nga agjentët e shtetit në përputhje me njërin prej objektivave të nënvizuara në nenin 2 § 2, mund të justifikohet në bazë të kësaj dispozite në rastin kur veprimi udhëhiqet nga një besim i ndershmë i cili merret si i vlefshëm për shumë arsye të mira, po që shpejt kthehet në gabim. Duke pasur parasysh dilemën në të cilën ndodheshin autoritetet në këto rrethana, reagimet e ushtarëve nuk çonin në vetvete në një shkelje të nenit 2<sup>27</sup>.

### *iii. Kontrolli dhe organizimi i operacionit*

17. Së pari, Gjykata vuri re se autoritetet kishin pasur qëllimin për t'i arrestuar të dyshuarit në momentin e duhur. Organeve hetimore iu vunë në dispozicion disa prova që vërtetësonin procedurat e arrestit të praktikuar nga ushtarët përpara 6 marsit, si edhe për përpjekjet që ishin bërë për të gjetur një vend të duhur për të mbajtur të arrestuarit. Ajo pyeti përse tre të dyshuarit nuk u arrestuan në kufi menjëherë pas mbërritjes në Gjibraltar dhe përse nuk ishte vendosur që atyre t'u ndalohej hyrja në Gjibraltar meqenëse ata dyshoheshin për kryerjen e akteve terroriste. Duke pasur një paralajmërim të qëllimeve të terroristëve do të kishte qenë me siguri e mundur për autoritetet spanjolle t'i arrestonin ata. Shërbimet e sigurimit dhe autoritetet spanjolle kishin fotografitë e të dyshuarve, i njihnin emrat e tyre, pseudonimet dhe mund të kishin ditur se cilat pasaporta të kontrollonin.

18. Në vazhdim, Gjykata vlerësoi se autoritetet kishin bërë disa kontrole kyçe dhe kishin zbuluar, në veçanti, se terroristët nuk do të përdornin një makinë të bllokuar; se bomba do të shpërthente me anë të një pajisje e kontrolluar me radio; se shpërthimi do të bëhej duke shtypur një sustë; se ishte e mundur që ata mund të shpërthenin bombën në qoftë se do të ndaloheshin; se ata mund të ishin të armatosur dhe mund t'i përdornin armët. Në këtë çështje, të gjitha këto supozime të rëndësishme, përveç qëllimeve të terroristëve për të kryer një sulm, rezultuan si të gabuara.

19. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ishin lejuar supozime të tepërta. Për shembull, përderisa shpërthimi nuk pritej të ndodhte deri më 8 mars, kur ceremonia e ndryshimit të rojeve do të zhvillohej tre terroristët ishin në një

27 Shih paragrafët 195 - 201 të vendimit.

mision njohje. Për më tepër, u mendua si e pamundur që të dyshuarit të ishin duke përgatitur shpërthimin, meqenëse ata shëtisnin në zonën kufitare. Duke qenë se si rrjedhim do të vriteshin shumë civilë, kjo gjë do të shtonte rrezikun që sillte ndalimi i tyre. Gjithashtu duhet të ketë qenë e menduar si e pamundur që ata të kishin ndërtuar një transmetues me anë të të cilit do të shpërthenin menjëherë bombën e supozuar sapo të ndaloheshin. Për më tepër, edhe pse ishin bërë supozime të tepërta mbi teknologjinë e përdorur nga IRA, përshtkrimi i pajisjes shpërthyes si një “lloj suste” pa përcaktimin e dhënë nga ekspertët gjatë hetimit, e thjeshtëzonte shumë natyrën e këtyre pajisjeve. Ishte shqetësues fakti se supozimi se kishte një “makinë bombë të dyshuar”iu transmetua ushtarëve si një fakt përfundimtar se bomba ekzistonte.

20. Gjykata vlerësoi se në prani në hipotezave të shumta, raporti përfundimtar mbi ekzistencën e një bombe që mund të shpërthente duke shtypur një sustë, hipotezë e cila iu transmetua ushtarëve si e vërtetë, bënte të paevitueshëm ushtrimin e forcës. Sipas saj, dështimi për të parashikuar një gabim të mundshëm në hipotezat e parashtruara duhej të kombinohej me stërvitjen e ushtarëve të cilët qëllonin derisa të asgjësonin të dyshuarin. Ashtu si tregoi hetuesi gjatë hetimit, të katër ushtarët qëlluan për të vrarë të dyshuarit. Nga ana tjetër, autoritetet ishin të detyruar të respektonin të drejtën e jetës të të dyshuarve, dhe të tregoheshin sa më të kujdesëshëm në vlerësimin e informacioneve në dispozicion të tyre, përpara se t’ia transmetonin ushtarëve. Veprimet të ushtarëve i mungonte masa e kujdesit në përdorimin e armëve të zjarrit, e cila pritet të merret nga personeli që i përdor ato në një shoqëri demokratike, edhe kur bëhet fjalë për terroristë shumë të rrezikshëm. Ky dështim tregoi mungesën e një kujdesi të duhur në kontrollin dhe organizimin e arrestimit.

21. Pra, duke pasur parasysh vendimin për të mos ndaluar hyrjen e të dyshuarve në Gjibraltari, dështimin e autoriteteve për të lejuar gabimet e mundshme në lidhje me hipotezat e parashtruara, dhe përdorimin të menjëhershëm të forcës vdekjeprurëse, Gjykata nuk u bind se vrasja e tre terroristëve përbënte një përdorim force i cili ishte më se i nevojshëm për të mbrojtur personat nga dhuna e paligjshme sipas kuptimit të nenit 2 § 2(a) të Konventës. Pra ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës<sup>28</sup>.

### ***B. Në lidhje me nenin ish 50 (aktualisht neni 41)***

22. Gjykata nuk e vlerësoi të arsyeshme të jepte një shpërblim pasuror dhe jo-pasuror duke vlerësuar se tre terroristët e vrarë kishin pasur qëllim të shpërthenin një bombë në Gjibraltari. Si rrjedhim ajo hodhi poshtë kërkesën për dëmshpërblim. Gjykata i akordoi kërkuesve 38,700 sterlina, duke hequr shumën e paguar nga Këshilli i Evropës për ndihmën ligjore, sipas pagesave dhe shpenzimeve të nevojshme për procedurat e Strasburgut.

28 Shih sidomos paragrafët 202-214 të vendimit.



### III. Koment

23. Vendimi për shkelje të nenit 2 të Konventës në këtë çështje është arritur me një shumicë tepër të ngushtë në Dhomën e Madhe (10 kundër 9). Gjyqtarët e ngelur në pakicë, përfshirë edhe Kryetarin e atëhershëm të Gjykatës, Rolf Ryssdal, dolën me një mendim të përbashkët, në të cilin shpreheshin se nuk ishin dakord me qëndrimin e shumicës në lidhje me planifikimin dhe kontrollin e operacioneve antiterroriste në Gjibraltari. Nga ana tjetër, kritika të shumta i janë bërë këtij vendimi edhe nga qeveria dhe media britanike në atë kohë.

24. Vendimi përbën sigurisht një nga pikat më të spikatura të jurisprudencës së Gjykatës në lidhje me nenin 2 të Konventës. Një moment me vlerë në këtë vendim përbën fakti se Gjykata sqaroi se neni 2 § 2 i Konventës nuk duhet interpretuar në mënyrë të tillë që të justifikojë në vetvete vrasjen e personave. Ajo theksoi se ky paragraf justifikon akte të tilla, të cilat mund të çojnë edhe në marrjen e jetës së personit. Por që këto akte të konsiderohen të justifikueshme dhe të pajtueshme me Konventën hyn në lojë testi i “nevojës absolute” të këtyre akteve. Në këtë pikë Gjykata bën një dallim themelor të këtij nocioni me atë të “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” i cili parashikohet në paragrafët e dytë të neneve 8-11 të Konventës. Sipas saj, “nevoja absolute” në bazë të nenit 2 duhet interpretuar në një mënyrë shumë më strikte sesa nocioni i “nevojës në një shoqëri demokratike” i parashikuar në paragrafët 2 të neneve 8-11. Pikërisht për të vlerësuar karakterin “absolutisht të nevojshëm” të masave që çuan deri në vrasjen e komandos së IRA-s në këtë çështje, Gjykata iu referua në mënyrë tepër të kujdesshme jo vetëm nivelit të forcës vdekjeprurëse të përdorur, por të gjitha veprimet e ushtarëve britanikë e të informacioneve të dhëna në këtë drejtim dhe deri tek planifikimi dhe kontrolli i operacioneve antiterroriste në rastin në fjalë. Pikërisht në analizën në lidhje me këtë moment të fundit Gjykata u bind se kishte shkelje të nenit 2 dhe të parimit të “nevojës absolute”. Kjo formulë është përdorur në vijim nga Gjykata edhe në çështje të tjera që kanë pasur të bëjnë me marrjen e jetës nga autoritetet shtetërore<sup>29</sup>.

25. Gjykata në këtë çështje hodhi themelet e një parimi tjetër të rëndësishëm në lidhje me nenin 2. Ky parim ngrihet mbi bazën e një kombinimi të këtij neni me nenin 1 të Konventës, i cili kërkon që shtetet palë të marrin të gjitha masat për garantimin e të drejtave të parashikuara në Konventë. Ky detyrim, me karakter pozitiv për organet shtetërore kërkon edhe një hetim efektiv në lidhje me çdo rast të humbjes së jetës. Ky parim është bërë një kriter themelor në jurisprudencën e mëvonshme të Gjykatës dhe në konstatimin e shkeljeve të nenit 2 në disa raste në vijim<sup>30</sup>.

29 Shih sidomos vendimin e 10 prillit 2001 në lidhje me çështjen *Tanli kundër Turqisë* dhe vendimin e 23 majit 2001 në lidhje me çështjen *Denizci dhe të tjerë kundër Qipros*.

30 Vendimi i 9 tetorit 1997 në lidhje me çështjen *Andoncou dhe Constantinou kundër Qipros*.



## MASTROMATTEO kundër ITALISË

(kërkesa nr. 37703/97)

24 tetor 2002

### Dhomë e Madhe

*ky vendim sqaron natyrën dhe shtrirjen e detyrimit pozitiv të shtetit për të mbrojtur të drejtën e jetës*

#### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Raffaele Mastromatteo, ka lindur në vitin 1933 dhe jeton në Itali. Më 8 nëntor 1989 i biri i kërkuesit u vra nga tre persona, të cilët po tentonin t'i grabisnin makinën, në përpjekje për t'u larguar pasi grabitën një bankë. Dy nga këta tre persona kishin qenë në burg pas dënimeve penale të formës së prerë për vepra të dhunshme të përsëritura. Në kohën e ngjarjeve njëri nga këta dy persona, i cili edhe kishte qëlluar të shtënë fatale, ishte liruar përkohësisht nga burgu me leje, ndërsa tjetri ishte nën një regjim të heqjes së pjesshme të lirisë. Gjyqtarët përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve të tyre, u kishin dhënë leje për të dalë dhe miratuar regjimin e heqjes së pjesshme të lirisë sepse, sipas raporteve nga autoritetet e burgut mbi sjelljen e këtyre personave në burg, ata nuk përbënin rrezik për shoqërinë. Tre kriminelët më vonë u dënuan me dënime të gjata me burg.

2. Kërkuesi iu drejtua autoriteteve për të marrë kompensim në bazë të një ligji i cili parashikonte një gjë të tillë për viktimat e terrorizmit dhe krimin të organizuar, por kërkesa e tij u refuzua, së pari nga Ministri i Brendshëm dhe më pas nga Presidenti i Republikës.

3. Duke u bazuar në nenin 2 të Konventës, kërkuesi pretendoi se vendimet e gjyqtarëve përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve të cilët iu kishin dhënë leje për të dalë nga burgu vrasësve të djalit të tij, kishin çuar në vdekjen e tij. Ai më tej u ankua se ai nuk kishte marrë asnjë kompensim nga shteti.

#### II. Vendimi i Gjykatës

##### A. Në lidhje me nenin 2

*i. në lidhje me pretendimin se autoritetet nuk kishin përmbushur detyrimin për të mbrojtur jetën e djalit të kërkuesit*

4. Përsa i përket çështjes nëse, sistemi i masave alternative të dënimit me burg

bënte që të lindte përgjegjësia e Shtetit sipas nenit 2 të Konventës, Gjykata vuri re se një nga vrasësit ishte liruar me leje nga burgu. Gjykata pranon se një nga funksionet thelbësore të një dënimi me burg është që të mbrohet shoqëria, por ajo kujtoi gjithashtu qëllimin legjitim të një politike të ri-integrimit social të të dënuarve. Ajo vuri në dukje se legjislacioni italian parashikonte mundësinë që t'u jepej leje të burgosurve që kishin shërbyer një pjesë të dënimeve të tyre, pjesë që varet nga rëndësia e veprave penale për të cilat janë dënuar. Sipas këtij legjislacioni, të burgosurit duhet të tregojnë një dëshirë reale për të marrë pjesë në programin e ri-integrimit. Vlerësimi i rrezikut të këtyre të burgosurve për shoqërinë lihej në vlerësimin e gjyqtarit përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve, i cili për këtë qëllim konsultohet me autoritetet e burgut dhe, në rast nevojë edhe me policinë. Gjykata vlerëson se sistemi i miratuar në Itali ofron masa të mjaftueshme mbrojtëse për shoqërinë. Prandaj, nuk kishte elementë që të bënin të mendoje se sistemi i zbatueshëm i masave të ri-integrimit në Itali në atë kohë ishte problematik sipas nenit 2.

5. Në lidhje me problemin nëse miratimi dhe zbatimi i masave të dënimeve alternative përbën në vetvete një shkelje të detyrimit për kujdesin, të kërkuar nga neni 2 i Konventës, Gjykata theksoi se kërcënimi përkatës në rastin konkret ishte një kërcënim për jetën e anëtarëve të publikut në përgjithësi dhe jo të një ose më shumë individëve të caktuar. Në dhënien e masave alternative, gjyqtarët përgjegjës për ekzekutimin e dënimeve i kanë bazuar vendimet e tyre në raportet nga autoritetet e burgut të cilat jepnin përshtypje pozitive mbi sjelljen e dy të burgosurve. Gjykata konstaton se nuk del të ketë pasur asnjë element që t'i bënte autoritetet kombëtare të mendonin se lirimi i këtyre dy personave mund të përbënte një rrezik real dhe të menjëhershëm ndaj jetës. Nuk dilte as ndonjë element që t'i alarmonte autoritetet për nevojën për masa shtesë kundër tyre pasi ata ishin liruar. Për pasojë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 për sa i përket pretendimeve për mungesë veprimi të përshtatshëm nga ana e autoriteteve.

*ii. Në lidhje me pretendimin për shkelje të detyrimit procedural që rrjedh nga neni 2*

6. Përderisa vrasësit kishin qenë të burgosur nën kontrollin e autoriteteve në kohën e ngjarjeve, Gjykata vendosi se kishte një detyrim procedural për të përcaktuar rrethanat e vdekjes së djalit të kërkuesit. Si rezultat i hetimit, kriminelët u gjetën fajtorë për vrasjen, u dënuan me burg për një kohë të gjatë dhe u urdhëruan të kompensonin kërkuesin. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se Shteti kishte përmbushur detyrimin e tij në bazë të nenit 2 të Konventës për të garantuar një hetim penal.

7. Në lidhje me pyetjen nëse detyrimi procedural sipas nenit 2 kërkon një mjet sipas të cilit të mund të bëhet një padi kundër Shtetit, Gjykata vuri në dukje se pretendimi i kërkuesit për kompensim ishte hedhur poshtë, me arsyetimin se ligji në të cilin ai mbështetej nuk ishte i zbatueshëm në këtë rast. Megjithatë, ai kishte në dispozicion dy mjete juridike, një padi kundër Shtetit për dëm, dhe një

padi kundër gjyqtarëve përgjegjës për zbatimin e dënimeve. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se neni 2 i Konventës nuk u imponon Shteteve një detyrim që të japin dëmshpërblim në bazë të përgjegjësisë objektive. Fakti që, për të pasur përgjegjësi të gjyqtarëve duhet të vërtetohet një mashtrim ose një gabimi i rëndë, nuk e zhvesh nga substanca natyrën e mbrojtjes procedurale që ofron e drejta e brendshme. Për pasojë, Gjykata vlerësoi janë përmbushur kërkesat procedurale sipas nenit 2 të Konventës dhe se nuk ka pasur shkelje.

### III. Koment

8. Pas krijimit parimin e detyrimit pozitiv të shteteve për të mbrojtur jetën në rastin e *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, Gjykata ka shqyrtuar kërkesa të shumta në lidhje me pretendimet për përshtatshmërinë ose me dështimin në marrjen e hapave nga organet shtetërore për të mbrojtur jetën e personave brenda juridiksionit të tyre. Natyrisht që jeta është kushti thelbësor për shijuar të drejtat e tjera të parashikuara nga Konventa apo çdo akt tjetër, por nga ana tjetër, asnjë ligj nuk mund të garantojë jetën dikujt në mënyrë absolute. Ajo që duhet të mbrohet me ligj "*nuk është jeta, por e drejta për jetë*". Edhe kur bëhet fjalë për përfshirjen e autoriteteve shtetërore, duhet të jetë një lidhje bindëse shkakësore midis dy ngjarjeve, humbjes së jetës ose zbardhjes së rrethanave përkatëse dhe nxjerrjes së rolit të autoriteteve, në mënyrë që të lindë përgjegjësia e shtetit.

9. Në ndryshim nga çështja *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, ku kërkuesit pretendonin se policia kishte dështuar të merrte masa pozitive për të mbrojtur familjen nga kërcënimet dhe sulmet e përsëritura, në rastin konkret kërkuesi argumentoi se vdekja e djalit të tij ishte një pasojë e veprimeve të autoriteteve shtetërore, konkretisht, lirimi i përkohshëm nga burgu i kriminelëve të dhunshëm dhe dënimet alternative, me gjysmë liri. Gjykata në këtë rast, duke zbatuar testin e lidhjes shkakësore arriti në përfundimin se, autoritetet shtetërore nuk ishin në një pozitë të tillë kur morën vendimet për dënime alternative, që të parashikonin pasojat e këtyre veprimeve.

10. Dy vendimet, ai në çështjen *Osman* dhe ky në çështjen *Mastromateo* duhet të dallohen me kujdes nga njëri tjetri, pavarësisht se në asnjërin prej tyre nuk u gjet shkelje, edhe për një arsye tjetër. Ndërsa në *Osman* lidhja apo edhe konflikti mes autorit të vrasjes Paul Paget-Leëis dhe viktimave të aktit të tij, Ali Osman dhe Ahmet Osman, ishte shumë më e drejtpërdrejtë dhe iu ishte sjellë në dijeni autoriteteve<sup>31</sup>, në çështjen që po komentojmë *Mastromateo*, as nuk kishte një lidhje direkte mes autorëve të vrasjes dhe viktimës, djalit të kërkuesit, as nuk kishte ndonjë tregues në dispozicion të autoriteteve për një rrezik të mundshëm sado të largët, që i kanosej apo mund t'i kanosej djalit të kërkuesit nga të dënuarit e liruar me kusht nga autoritetet italiane. Në qoftë se

31 Atë që Lord Justice McCowan në vendimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me çështjen *Osman* e quajti "*lidhje të afërsisë*".

Gjykata do kishte gjetur shkelje në këtë çështje, kjo do të vendoste një barrë tepër të jashtëzakonshme ndaj autoriteteve të shteteve anëtare në lidhje me të gjithë sistemin e dënimeve alternative apo të lirimeve të parakohshme nga burgu, pasi praktikisht autoritetet do ngurronin të akordonin dënime alternative apo liri të përkohshme ose të parakohshme. Madje mesazhi mund të shkonte edhe më tej, duke ndikuar në politikat penale të shteteve anëtare dhe duke iu kërkuar autoriteteve që të japin gjithmonë dënime tepër të ashpra. Thënë kjo, sidoqoftë duhet theksuar se autoritetet ngelen përgjegjëse për të trajtuar me kujdes çdo rast lirimi të parakohshëm apo të përkohshëm si dhe çdo dënim penal për vepra të rënda, në përputhje me analiza të kujdesshme penalogjike, dhe me detyrimin në bazë të nenit 2 për të ndritur një aparat ligjor që i ndëshkon në mënyrë adekuate dhe proporcionale veprat penale.

## ÖNERYILDIZ kundër TURQISË

(kërkesa nr. 48939/99)

18 qershor 2002

*detyrimi pozitiv i shtetit për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe të pronësisë  
shkon deri aty sa për të parën, masat ndëshkimore duhet të jenë efektive  
ndërsa për të dytën, duhet të merren në kohë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Maşallah Öneriyıldız, është një shtetas turk, i lindur në vitin 1955. Në kohën e ngjarjeve ai dhe dymbëdhjetë anëtarë të familjes së tij jetonin në zonën periferike të Stambollit, që quhej Hekimbaşı Ümraniye.

2. Zona e Hekimbaşı përfshinte një numër ndërtesash të ndërtuara pa asnjë plan, në një truall që rrethonte një zonë të grumbullimit të plehrave, të përdorur së bashku nga katër këshilla zonale që prej vitit 1970 dhe që ishte nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Këshillit Bashkiak të Stambollit. Raporti i një eksperti i përgatitur në 7 maj 1991 me kërkesën e Gjykatës së Rrethit, tërhoqi vëmendjen e autoriteteve, ndërmjet të tjerave, në lidhje me faktin që asnjë masë nuk ishte marrë për të përkiste zonës në fjalë, për të parandaluar një shpërthim të mundshëm të gazit të metanit, i cili po çlirohej nga dekompozimi i plehrave. Raporti i la vend një sërë debatesh ndërmjet kryebashkiakëve të interesuar. Përpara se procedurat e filluara prej tyre të kishin përfunduar, më 28 prill 1993 ndodhi një shpërthim i gazit të metanit në qendrën e grumbullimit të plehrave dhe zjarri që përfshiu një grumbull plehrash dogji edhe njëmbëdhjetë shtëpi që gjendeshin pranë tij, përfshirë atë që i përkiste kërkuesit, i cili humbi edhe nëntë anëtarë të familjes së tij.

3. Në lidhje me këtë ngjarje filluan hetime administrative dhe penale, në vijim të të cilave kryetarët e bashkive të Ümraniye dhe të Stambollit u çuan përpara gjykatave, i pari sepse nuk kishte përmbushur detyrën e tij për të prishur barakat e kundërligjshme në zonën e lartpërmendur dhe i dyti sepse nuk kishte vepruar për ta bërë zonën e grumbullimit të plehrave të sigurt ose për të urdhëruar mbylljen e saj, duke mos mbajtur parasysh as përfundimet e raportit të ekspertizës së 7 majit 1991. Në 4 prill 1996 të dy kryetarët e lartpërmendur të bashkive u dënuan për “neglizhencë në ushtrimin e detyrave të tyre” dhe u dënuan me një gjobë prej 160,000 lirash turke dhe me një minimum prej tre muajsh burg, parashikuar nga neni 230 i Kodit Penal, dënime të cilët në vijim, iu konvertuan në gjobë. Gjykata turke urdhëroi gjithashtu një pezullim të ekzekutimit të këtyre gjobave.

4. Në vijim, kërkuesi paraqiti, në emrin e tij dhe të tre fëmijëve të tij të mbijetuar, një padi për dëme pranë Gjykatës Administrative të Stambollit kundër autoriteteve që ai konsideronte përgjegjëse për vdekjen e të afërmeve të tij dhe shkatërrimin e pronës së tij. Në një vendim të 30 nëntorit 1995, autoritetet u urdhëruan që t'i paguanin kërkuesit dhe fëmijëve të tij 100,000,000 Lira Turke për dëm jomaterial dhe 10 000 000 lira turke për dëm material (në kohën e ndodhjes së ngjarjeve përafërsisht 2 077 dhe 208 euro respektivisht), ku shuma e dytë kufizohej në dëmtimin e sendeve që gjendeshin shtëpinë e tij.

5. Kërkuesi ankohej, në bazë të nenit 2 të Konventës, që aksidenti i 28 prillit 1993, në të cilin vdiqën nëntë anëtarë të familjes së tij, kishte ardhur si pasojë e neglizhencës nga ana e autoriteteve përkatëse. Ai ankohej për mangësitë e procedurave administrative dhe penale të nisura në vijim. Ai ankohej gjithashtu, mbi bazën e nenit 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës), për humbjen e banesës së tij dhe të gjithë pasurisë së tij të luajtshme.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

#### i. Vdekja e të afërmeve të z. Öneriyıldız

6. Përsa i përket vënies në zbatim të masave parandaluese në zonën e grumbullimit të plehrave të lagjes Ümraniye dhe të lagjeve të tjera afër saj, Gjykata vuri në dukje se ekzistonin në fakt rregullime administrative që synonin mbrojtjen. Gjykata vlerësoi se raporti i ekspertëve i vitit 1991 kishte nxjerrë në pah sidomos një situatë të cilën autoritetet lokale duhet ta dinin dhe ta kishin nën kontroll, aq më tepër kur ishin nxjerrë edhe normat përkatëse në këtë drejtim. Gjykata konstatoi se, megjithëse autoritetet nacionale nuk e kishin nxitur kërkuesin që të ngrinte një banesë pranë zonës së grumbullimit të plehrave, ato as nuk kishin vepruar në drejtimin e kundërt.

7. Për këto arsye Gjykata ishte e mendimit se autoritetet administrative e kishin ditur ose duhet ta kishin ditur që banorët e disa zonave periferike ishin vënë

pranë një rreziku real dhe se ato kishin dështuar në ndreqjen e situatës e nuk kishin bërë gjithçka që pritej normalisht prej tyre për të mënjeluar rreziqet në fjalë. Për më tepër, ato kishin dështuar në detyrën e tyre për t'i vënë në dijeni banorët e këtyre zonave për rreziqet që i kërcënonin.

8. Gjykata gjeti pra, se ka pasur shkelje të nenit 2, pavarësisht se ankimet e kërkuesit mund të konsideroheshin se kishin pasur dëmshpërblim në shkallët e brendshme gjyqësore, nga zbatimi efektiv i një vendimi të drejtë gjyqësor.

*ii. Ndreqja e mundshme e situatës me anë të mjeteve ligjore*

9. Gjykata vuri në dukje se procedurat administrative dhe penale që kishin filluar ndaj personave përgjegjës për aksidentin kishin përfunduar respektivisht me një gjobë dhe me një dënim.

10. Duke mbajtur parasysh procedimin penal, Gjykata vuri në dukje se Gjykata Penale e Stambollit i kishte dënuar dy kryetarët e bashkive me gjobë – e pezulluar në vijim – prej 9.70 euro, për neglizhencë në ushtrimin e detyrave të tyre. Ajo theksoi se pretendimet e ngritura në ankesën e z. Öneriyıldız dhe vendimi i prokurorit kanë qenë bazuar në nocionin e vrasjes me neglizhencë. Sidoqoftë, pasi çështja iu kalua autoriteteve hetimore administrative, faktet nuk u vlerësuan më nga këndvështrimi i një shkeljeje të mundshme të së drejtës së jetës, gjë që sipas mendimit të Gjykatës, e ka dobësuar thelbin e hetimit të kryer deri në atë fazë në kuptimin që procesi ishte kufizuar në gjykimin e “neglizhencës” si të tillë. Për më tepër, shumica e pallogaritshme e gjobave të vëna ndaj të akuzuarve tregonte se gjykatat e brendshme nuk kishin qenë të ndërgjegjshme për shkallën e seriozitetit të ngjarjeve. Duke pasur parasysh pra mënyrën se si u drejtuan procedimet penale, nuk mund të thuhet se ato përbënin mjete të përshtatshme dhe efektive ankimi.

11. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për procedimin administrativ. Gjykata vuri në dukje se e drejta e z. Öneriyıldız për kompensim nuk ishte njohur për katër vjet, njëmbëdhjetë muaj e dhjetë ditë pas bërjes së kërkesës së tij të parë për kompensim, e cila ishte hedhur poshtë dhe se kompensimi që i ishte akorduar më së fundi, jo vetëm që ishte i një shume shumë të diskutueshme, por edhe nuk i ishte paguar ende.

12. Për këto arsye Gjykata mbajti qëndrimin se mjetet ankimore të përdorura në procedimet e brendshme nuk kishin qenë në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga detyrimi procedural në bazë në nenit 2 të Konventës.

### ***B. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1***

13. Megjithëse doli në pah që baraka e kërkuesit në truallin e lartpërmendur, ishte ndërtuar në shkelje të të gjitha normativave të planifikimit të ndërtimeve të qytetit, Gjykata vendosi se z. Öneriyıldız kishte qenë një pronar *de facto* i strukturës kryesore dhe të pjesëve përbërëse të barakës dhe të çdo sendi personal që ishte gjendur në të. Sipas mendimit të Gjykatës, ndërtimi i barakës dhe fakti që kërkuesi kishte



jetuar në të së bashku me familjen, përfaqësonte një interes thelbësor material i cili, duke qenë se ishte toleruar, si u tha më lart nga ana e autoriteteve, arrinte të përbënte një pasuri për qëllimet e nenit 1 § 1 të Protokollit 1 të Konventës.

14. Gjykata konstatoi se ushtrimi real dhe efektiv i të drejtës së parashikuar në nenin 1 të Protokollit 1 mund të kërkojë edhe masa mbrojtëse me karakter pozitiv. Ajo vendosi se seria e mosveprimeve nga ana e autoriteteve administrative, të cilat kishin dështuar në marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të parandaluar rrezikun e një shpërthimi, dhe shkatërrimi masiv që ndodhi në vijim, përbënin një cenim të hapur në të drejtën e kërkuarit për gëzimin e pasurive të tij, i cili mund të konceptohet si një “ndërrhyrje”. Përderisa këto mosveprime neglizhuese nga ana e autoriteteve ishin ndëshkuar nga e drejta administrative dhe penale turke, Gjykata vendosi se ndërhyrja e lartpërmendur kishte qenë haptas në kundërshtim me të drejtën e brendshme.

15. Duke pasur parasysh çështjen nëse, pretendimi i kërkuarit kishte gjetur një zgjidhje në bazë të së drejtës së brendshme, Gjykata vuri në dukje se atij i ishte akorduar një shumë e barabartë me 210 euro si kompensim për dëm material. Në marrjen e këtij vendimi gjykatat administrative nuk kishin vlerësuar siç duhej situatën reale në zonën përkatëse. Gjykata rimori përfundimin e saj të lartpërmendur mbi faktin që e drejta e kërkuarit për kompensim nuk ishte njohur brenda një periudhe të arsyeshme. Për këtë arsye ajo nuk mund të pranonte se pretendimet e kërkuarit për kompensimin e dëmeve materiale ishin vlerësuar me kujdes dhe shpejtësi me qëllimin që t'i akordohej atij kompensimi i duhur. Kjo, duke pasur parasysh që në këtë çështje nuk pati ndonjë njohje nga ana e gjykatave të faktit, të përgjegjësisë së autoriteteve administrative në lidhje me ankimin për humbjen e pasurive të tij. Së fundmi, Gjykata theksoi se autoritetet nuk i kishin bërë asnjë pagesë kërkuarit.

16. Për këto arsye Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet shtetërore turke nuk mund të thuhet se kishin njohur – dhe kompensuar në vijim – shkeljen e pretenduar dhe se pra ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

17. Gjykata i akordoi kërkuarit 154 000 euro për dëm material dhe jo-material dhe 10 000 euro për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore, duke i hequr kësaj shume 2 286.50 euro të dhëna ndërkaq si ndihmë nga ana e Këshillit të Evropës.

### **III. Koment**

18. Jurisprudenca e Gjykatës në lidhje me të drejtën për jetën është zhvilluar vetëm gjatë viteve të fundit. Çështja *McCann kundër Mbretërisë së Bashkuar*, e 27 shtatorit 1995, ishte e para çështje në të cilën u konstatua një shkelje e nenit 2. Ky vendim u vijua nga ato të dhëna në çështjet *LCB kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i 9 qershorit 1998, *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i 28 tetorit 1998, dhe



*Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i 3 prillit 2001, të cilat e bënë të qartë që edhe “thjesht neglizhenca” nga ana e autoriteteve publike, është e mjaftueshme për të çuar në shkelje të nenit 2 në qoftë se arrihet të përcaktohet ndonjë lidhje shkakësore midis kësaj neglizhence dhe vdekjeve që ndodhin. Autoritetet prapa janë të detyruara jo vetëm që të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të eliminuar burimet e dukshme të rrezikut për jetën por janë gjithashtu të detyruara të informojnë publikun për ekzistencën e këtyre rreziqeve.

19. Sidoqoftë Gjykata përsërit (në paragrafët 92 dhe 94 të vendimit) që, vdekja e shkaktuar nga neglizhenca, nuk kërkon domosdoshmërisht të njëjtat sanksione penale si një vrasje me qëllim<sup>32</sup>. Në çështjen *Calvelli* ajo nuk gjeti shkelje të nenit 2 për shkak se një mjek nuk ishte dënuar penalisht për neglizhencë në ushtrimin e profesionit të tij dhe të kujdesit ndaj një të sëmurit, e cila çoi pastaj në vdekjen e këtij të fundit. Në çështjen *Öneryıldız* shkalla e neglizhencës dhe numri i rreziqeve të konstatuara sipas Gjykatës kërkonin sanksione penale efektive që t'i përgjigjeshin rëndësisë së vdekjeve të ardhura si pasojë e neglizhencës në fjalë. Gjykata konstatoi se procedimet turke i ishin referuar vetëm “ushtrimit neglizhent të funksioneve zyrtare” dhe nuk i kishin kushtuar kujdes të mjaftueshëm vdekjeve që kishin ardhur si pasojë e kësaj neglizhence. Kjo dilte qartë në pah nga gjobat minimale që ishin vënë si dënim dhe nga mungesa e referimit në dispozitat e së drejtës penale në lidhje me vrasjen. Sipas mendimit të Gjykatës, as procedimi administrativ nuk ka qenë më i kënaqshëm.

20. Ky vendim përcakton gjithashtu një parim të rëndësishëm në lidhje me të drejtën e pronësisë. Gjykata njohu që banimi, edhe kur ndodh në shkelje të normativave të planifikimit të ndërtimeve, në qoftë se lejohet nga ana e autoriteteve merr karakterin e një pasurie të një lloji të tillë që përfiton mbrojtje nga ana e nenit 1 të Protokollit 1. Tre gjyqtarë ishin të një mendimi të kundërt në lidhje me këtë moment duke bërë që vendimi të merrej me një shumicë të vogël prej katër gjyqtarësh. Megjithatë në vendimin e saj të 30 nëntorit 2004 *Dhoma e Madhe e Gjykatës* mban të njëjtin qëndrim në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1 me një shumicë prej 15 kundër 2<sup>33</sup>. Në këto kushte, ky konceptim e ruan vlerën e tij të padiskutueshme për situatën shqiptare të ndërtimeve të paligjshme, të cilat, të lejueshme për një periudhë të caktuar kohe gjatë së cilës banohen ose shfrytëzohen, veshin karakterin e një objekti që përfiton mbrojtje nga ana e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës. Kjo tregon që përgjegjësia administrative e organeve shtetërore angazhohet në këto raste kryesisht për shkaqe mosveprimi dhe madje mosveprimi në kohë.

32 Shih çështjen *Calvelli dhe Ciglio kundër Italisë* të 17 janarit 2002, pararendëse në këtë botim.

33 Më 12 shtator 2002 Qeveria Turke duke u bazuar në nenin 43 të Konventës dhe në nenin 73 të Rregullores së Gjykatës kërkoi që kjo çështje t'i dërgohej për rishqyrtim Dhomës së Madhe. Një panel i kësaj Dhome e pranoi kërkesën më 6 nëntor 2002 dhe ia kaloi çështjen për shqyrtim Dhomës së Madhe e cila dha vendimin e lartpërmendur.

## BUDAYEVA DHE TË TJERËT kundër RUSISË

(kërkesat nr. 15339/02, 21166/02, 20058/02, 11673/02 dhe 15343/02)

20 mars 2008

*detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe të pronës në raste të fatkeqësive mjedisore*

### I. Faktet kryesore

1. Gjashtë kërkuesit janë shtetas rusë që kanë lindur ndërmjet viteve 1953 dhe 1961. Ata jetojnë në qytetin e Tyrnauz, i vendosur në rrethin malor të Republikës së Kabardino-Balkariya në Rusi. Rrëshqitje dheu janë regjistruar në zonë çdo vit që nga viti 1937, sidomos në verë.

2. Më 18 korrik të vitit 2000 një rrëshqitje dheu, balte dhe mbetjesh goditi qytetin e Tyrnauz dhe përmbysi një pjesë të zonës së banuar. Sipas kërkuesve nuk kishte asnjë paralajmërim paraprak dhe ata të gjithë mezi arritën të shpëtonin nga rrëshqitjet e dheut. Një nga kërkuesit, Fatima Atmurzayeva, dhe vajza e saj, ndërsa po përpiqeshin të shpëtonin, u përfshinë nga balta dhe mbeturinat duke u plagosur dhe pësuar dëmtime dhe djegie në trup. Pasi nisën rrëshqitjet e dheut, u dha alarmi nëpërmjet altoparlantëve në qytet, por kërkuesit pretenduan se nuk kishte forca shpëtimi apo ekipe të tjera emergjence në vendin e fatkeqësisë. Në mëngjesin e 19 korrikut 2000 niveli i baltës ra dhe, përderisa nuk kishte pengesa, barriera, njoftime ose polici apo ekipe emergjence që t'i ndalonin, disa banorë, ndërmjet tyre edhe kërkuesja Khalimat Budayeva dhe familja e saj, u kthyen në shtëpitë e tyre. Ata nuk ishin në dijeni të ndonjë urdhri për evakuim. Po atë ditë, më vonë, një rrëshqitje e dytë dhe më e fuqishme dheu dhe balte goditi qytetin.

3. Ms Budayeva dhe djali i saj i madh arritën të shpëtonin. Djali i saj më i vogël u shpëtua, por pësoi dëme të rënda cerebrale dhe në kurriz. Bashkëshorti i saj, Vladimir Budayev, që kishin mbetur prapa për të ndihmuar prindërit e kërkueses, u vra kur pallati në të cilën ai dhe familja e tij jetuan, u shemb. Qyteti më pas u godit nga një sërë rrëshqitjesh për një periudhë që zgjati deri më 25 korrik 2000. Tetë persona u deklaruan zyrtarisht të vdekur, por kërkuesit pretendonin se kishin humbur edhe 19 të tjerë. Të gjithë kërkuesit pretenduan se shtëpitë dhe pasuritë e tyre ishin shkatërruar dhe se kushtet e tyre të jetesës dhe të shëndetit ishin përkeqësuar nga kjo fatkeqësi.

4. Sipas Qeverisë, forca e jashtëzakonshme e rrëshqitjeve nuk mund të ishte parashikuar ose ndaluar. Pas valës së parë të baltës më 18 korrik 2000, autoritetet

urdhëruan një evakuim emergjent të qytetit Tyrnauz. Policia dhe zyrtarët lokalë lajmëruan në shtëpitë e banorëve dhe automjetet policore të pajisura me altoparlantë sillëshin nëpër qytet, duke u bërë thirrje banorëve të evakuohen. Ata banorë që u kthyen në shtëpitë e tyre e bënë këtë duke shkelur urdhrat e evakuimit. Qeveria pretendoi se ishin marrë të gjitha masat e nevojshme për të shpëtuar viktimat, për të strehuar banorët në vende të tjera dhe për tu dhënë atyre ndihma emergjente jetese.

5. Më 3 gusht 2000 Prokuroria e Qarkut Elbrus vendosi të fillojë një hetim penal në lidhje me këto ngjarje dhe mbi vdekjen e z. Budayev, e cila ishte konsideruar aksidentale.

6. Pas një vendimi në 12 gushtit 2000 të Qeverisë së Republikës së Kabardino-Balkariya, të gjithë kërkuesve iu ofrua strehim falas dhe një mbështetje financiare emergjent prej 13,200 rubla (rreth 530 euro në atë kohë). Kërkuesit bënë një padi civile për kompensim. Pretendimet e tyre u hodhën poshtë me arsyetimin se autoritetet kishin marrë të gjitha masat e arsyeshme për zbutur rrezikun e një rrëshqitje dheu. Kërkuesit nuk u pajtuan me këto përfundime. Ata akuzuan autoritetet për tre mangësi të mëdha në funksionimin e sistemit për mbrojtjen ndaj fatkeqësive natyrore në Tyrnauz: së pari, ata pohuan se autoritetet nuk arritën të ngrenë një infrastrukturë për mbrojtjen nga rrëshqitjet e dheut, sidomos të riparimit në një digë që mbante baltën e cila ishte dëmtuar në vitin 1999; së dyti, ata u ankuan për mungesën e një paralajmërimi publik; dhe së fundi ata u ankuan se nuk ishte bërë asnjë hetim për të vlerësuar efektivitetin e sjelljes së autoriteteve para dhe gjatë rrëshqitjeve të dheut. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, kërkuesit ofruan disa artikuj gazetash, deklarata dëshmitarësh dhe letra e dokumente zyrtare, të cilat vërtetonin se asnjë fond nuk ishte parashikuar në buxhetin e qarkut për riparimin e kërkuar pas rrëshqitjeve të dheut më 1999 dhe se autoritetet kishin marrë një numër të paralajmërimesh mbi rrezikun e afërt të një katastrofe nga Instituti Mountain, një agjenci shtetërore përgjegjëse për monitorimin e rreziqeve natyrore në zonat malore. Në paralajmërimet e tij, Instituti kishte rekomanduar që diga e dëmtuar të riparohet dhe që të ngriheshin pika vrojtimi për të lehtësuar evakuimin e popullatës në rast të një rrëshqitje dheu.

7. Duke u bazuar në nenet 2, 8, 13 dhe nenit 1 të Protokollit nr.1, kërkuesit pretendonin se, si rezultat i dështimit të autoriteteve ruse për të zbutur pasojat e rrëshqitjeve të dheut nga 18 deri në 25 korrik të vitit 2000, autoritetet kishin vënë jetën e kërkuesve në rrezik dhe ishin përgjegjës për vdekjen e z. Budayev dhe për shkatërrimin e shtëpive të tyre. Ata gjithashtu u ankuan sipas nenit 2 se autoritetet nuk arritën të kryejnë një hetim efektiv në lidhje me këtë fatkeqësi.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

*i. Për sa i përket mirëmbajtjes joadekuate të infrastrukturës së mbrojtjes nga rrëshqitjet e dheut dhe dështimit për të ngritur një sistem paralajmërimi*

8. Gjykata vuri në dukje se në vitin 1999 autoritetet kishin marrë një numër të paralajmërimesh të cilat duhet t'i kishin bërë ata të vetëdijshëm për rritjen e rreziqeve të një rrëshqitje dheu në shkallë të gjerë. Në rrethana të tilla, autoritetet duhet të kishin marrë masa praktike thelbësore për të garantuar sigurinë e popullatës lokale, të tilla si paralajmërimi i publikut dhe duke marrë hapa paraprakë për një evakuim emergjence. Megjithatë, kërkuesit vazhdimisht pretenduan dhe Qeveria konfirmoi se banorët nuk kishin marrë asnjë paralajmërim deri kur rrëshqitja e dheut kishte ndodhur faktikisht në qytet më 18 korrik 2000. Për më tepër, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nga ana e Institute Mountain, pikat e përkohshme të vrojtimit në male nuk ishin ngritur, duke e bërë të vështirë për autoritetet që të vlerësonin kohën, forcën apo kohëzgjatjen e rrëshqitjeve të dheut. Së fundi, qeveria nuk dha asnjë informacion në lidhje me zgjidhje të tjera që kishte parashikuar për të garantuar sigurinë e popullatës lokale, si për shembull një kuadër ligjor dhe administrativ, politika të planifikimit urban apo masa specifike të sigurisë. Parashtrirat e saj i referoheshin vetëm digës së mbrojtjes nga rrëshqitjet e dheut dhe kolektorit, i cili, siç ishte provuar ndërkaq, nuk ishte mirëmbajtur në mënyrë adekuate. Prandaj, autoritetet ruse kishin dështuar në detyrën e tyre për të krijuar një kuadër ligjor dhe administrativ me anë të të cilit të siguronin një mbrojtje parandaluese efektive ndaj një kërcënimi të të drejtës për jetën, në shkelje të nenit 2.

*ii. Lidhur me reagimin gjyqësor ndaj katastrofës*

9. Brenda një jave nga katastrofa prokuroria kishte vendosur të fillonte një hetim penal mbi rrethanat e vdekjes së Vladimir Budayev. Hetimi ishte kufizuar në shkaqet direkte të vdekjes së tij dhe nuk e kishte shqyrtuar çështjet e respektimit të masave të sigurisë apo përgjegjësinë e autoriteteve. Pretendimet e kërkuesve për dëmshpërblim ishin hedhur poshtë nga gjykatat ruse sepse nuk kishin arritur të provonin, sipas tyre, se në çfarë mase neglizhenca e autoriteteve kishte shkaktuar dëme përtej atyre që ishin pashmangshme në një fatkeqësi natyrore.

10. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se çështja e përgjegjësisë së Rusisë për aksidentin në Tyrnauz nuk ishte hetuar apo shqyrtuar asnjëherë si e tillë nga ndonjë autoritet gjyqësor ose administrativ, në shkelje të nenit 2.

### B. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

11. Palët ranë dakord se ishte e paqartë se deri në çfarë mase mirëmbajtja e duhur e infrastrukturës së mbrojtjes, ose sistemet e duhura paralajmëruese, mund të kishin zbutur forcën e jashtëzakonshme të rrëshqitjeve të dheut në rastin konkret. Dëmi i shkaktuar nga rrëshqitjet nuk mund t'i atribuohet pa

mëdyshje neglizhencës së autoriteteve. Për më tepër, detyrimi i një shteti për të mbrojtur pronën private nuk mund të shihet si sinonim me një detyrim për të kompensuar vlerën e plotë të tregut, të një prone të shkatërruar për shkaqe natyrore.

12. Mbi këtë bazë, Gjykata arriti në përfundimin se kompensimi për qëllime strehimi dhe kompensimi për orenditë shtëpiake për të cilat kërkuesit kishin të drejtë nuk kishte qenë haptazi në disproporcion me shtëpitë që kishin humbur. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur arsye asnjë shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.

### C. Në lidhje me nenin 13

13. Gjykata konstatoi se, nuk ka çështje më vete që ngrihen në bazë të nenit 13.

### D. Në lidhje me nenin 8

14. Gjykata vlerësoi se, nuk ishte e nevojshme që ankesat e kërkuesve të shqyrtoheshin edhe sipas nenit 8.

### E. Në lidhje me nenin 41

15. Gjykata iu akordoi kërkuesve për dëmin jopasuror 30 000 euro për Khalimat Budayeva, 15 000 euro për Fatima Atmurzayeva dhe 10 000 euro për secilin nga kërkuesit e tjerë.

## III. Koment

16. Në këtë çështje, Gjykata shqyrtoi përgjegjësinë e Shtetit për pasojat e katastrofave mjedisore. Gjykata e ka trajtuar edhe në raste të tjera këtë problem<sup>34</sup>. Dallimi në këtë rast, në krahasim me rastet *Oneryildiz* dhe *Fadeyeva*, është se fatkeqësia nuk ishte shkaktuar nga veprimtari njerëzore apo që lidheshin me veprimtari njerëzore. Megjithatë, Gjykata u shpreh se ka pasur një numër paralajmërimesh nga Instituti Mountain të cilat duhet t'i kishin alarmuar autoritetet për rreziqet e veçanta me të cilat përballej qyteti Tyrnauz, sidomos duke pasur parasysh se mbrojtja ekzistuese ndaj rrëshqitjeve të dheut ishte shkatërruar një vit më parë. Prandaj, autoritetet kishin dështuar në detyrimet e tyre pozitive për të mbrojtur të drejtën e jetës sipas Konventës. Testi që zbatohet edhe në këtë rast është ai që kemi analizuar në vendimin *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar* – pra a e dinin dhe a duhet ta dinin autoritetet rrezikun që i kanosej jetës së personave, edhe kur ky rrezik vinte si pasojë e katastrofave natyrore.

34 Në *Oneryildiz v. Turqisë*, vendim i Dhomës së Madhe të 30.11.2004 i përfshirë në këtë botim u gjet shkelje të nenit 2 sepse Qeveria turke nuk kishte ndërmarrë veprime për të mbrojtur individët nga një shpërthim i shkaktuar nga gazi metan në zonë ilegale të grumbullimit të mbeturinave, pranë së cilës kërkuesi kishte ndërtuar prej disa kohësh pa leje një barrakë për të banuar. Në *Fadeyeva v. Rusisë*, vendim i datës 9.06.2005, i përfshirë gjithashtu në këtë botim, Gjykata shqyrtoi të drejtën e kërkuesit për të respektuar për shtëpinë e saj, jetës private dhe familjare në bazë të nenit 8, si ajo jetoi në një zonë të përjashtimit vetëm jashtë një fabrikë çeliku e cila ishte prodhuar emisionet më të larta se kufiri ligjor.

Ky vendim e ngre në një nivel akoma më të lartë detyrimin e shteteve për detyrime pozitive në mbrojtjen e jetës. Mesazhi i tij është që në çdo situatë ku ekzistojnë të dhëna objektive që mund të ndodhin fatkeqsi natyrore që mund të çojnë në humbjen e jetës, autoriteteve iu lind detyrimi për marrjen e masave, ose në mungesë të tyre mund të lindë përgjegjësia në bazë të këtij neni<sup>35</sup>. Këto masa mund të përfshijnë si miratimin e një kuadri legjislativ dhe administrativ të caktuar<sup>36</sup>, ashtu edhe hapa konkretë, si vendosja e pikave të vrojtimit, miratimin dhe përgatitjen efektive të planeve emergjente të evakuimit, ose edhe mbajtjen parasysht të rekomandimeve të organeve të specializuara, siç ishte në këtë rast Instituti Mountain. Sidoqoftë duhet theksuar që vetëm në bazë të një analize konkrete të të gjithë këtyre elementëve, dhe jo të një analize abstrakte, Gjykata mund të arrijë, siç bëri në këtë rast, në konstatimin e ekzistencës së përgjegjësive së autoriteteve në një rast të caktuar. Vlen të theksohet se për Gjykatën, në analizën juridike të testit Osman në këtë rast, rëndësi të veçantë mori edhe karakteri i përsëritur i rrëshqitjeve të dheut në zonën përkatëse. Kjo sipas Gjykatës, duhet t'i kishte bërë autoritetet të ndërjegjeshme për rrezikun që kanosej nga një përsëritje krejt e mundshme e së njëjtës katastrofë. Ky është një mesazh tepër i rëndësishëm për realitetin shqiptar, ku disa zona, sidomos ajo e nën-Shkodrës, përmblyten periodikisht nga prurjet e lumejve në periudha reshjesh të shumta. Paralajmërimin natyra e ka dhënë disa vite me radhë. Vetëm masa adekuate dhe efektive mund ta shmangin përgjegjësinë e autoriteteve shqiptare në rast të një katastrofe të ardhshme.

17. Interesante është të vihet në dukje se, në këtë vendim, Gjykata bën një vlerësim të ndryshëm, në lidhje me të njëjtat fakte, kur bëhet fjalë për të drejtën e respektimit të pronës, sipas nenit 1 të Protokollit 1. Në këtë kuadër, Gjykata bën dallim ndërmjet fatkeqësive natyrore si këto të rastit që po analizojmë, dhe situatave të tilla si në Oneryildiz, ku kishim të bënim me trajtimin e mbeturinave, çështje që lidhen me zhvillimin industrial dhe planifikimit urban, dhe që planifikohen, zhvillohen dhe duhet të kontrollohen nën mbikëqyrjen e autoriteteve ose të subjekteve të autorizuar. Ky dallim mesa duket mjaftoi që Gjykata të vlerësonte se autoritetet ishin përgjegjëse për humbjen e pronës në atë rast dhe gjeti shkelje të nenit 1 të Protokollit 1. Konkluzioni ku mund të arrihet është se, për fatkeqësitë natyrore megjithatë, detyrimi për të mbrojtur

35 Ky vendim mund të krahasohet me vendimin *Brincat k. Maltës*, 24.07.2014, ku kërkuesit u ankuan se ishin sëmurur dhe një prej tyre edhe kishte vdekur si pasojë e ekspozimit ndaj asbestosit kur punonin në një kантиer riparimi anijesh që i përkiste shtetit. Në atë çështje Gjykata gjeti shkelje të nenit 2 në lidhje me punëtorin e vdekur dhe shkelje të nenit 8 në lidhje me të gjithë kërkuesit e tjerë, duke theksuar se natyra e detyrimeve pozitive sipas nenit 2 është e njëjtë me atë sipas nenit 8, dhe vetëm pasojat bënë ndryshimin. Kjo nuk përjashton që nëse kërkuesit vërtetojnë se sëmundja përbën një rrezik real për jetën, pavarësisht se kërkuesi nuk ka vdekur, përsëri të gjendet shkelje e nenit 2. Krahasim mund të bëhet gjithashtu me çështjen *Zavoloka v. Latvia*, 07.07.2009, ku vajza e kërkueses kishte vdekur si pasojë e një aksidenti rrugor për faj të një personi të tretë dhe ku autoritetet nuk kishin asnjë përgjegjësi. Prandaj Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 2 në atë rast. Megjithatë, Gjykata ka pranuar se Shtetet kanë për detyrë të mbrojnë jetën në garantimin e shërbimit e ndihmës së shpejtë, kur autoritetet informohen se jeta apo shëndeti i një personi është në rrezik edhe për shkak të një aksidenti (shih *Furdik k. Sllovakisë*, nr. 42994/05, 2.12.2008).

36 Shih paragrafin 129 të vendimit.



të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë, e cila nuk është absolute, nuk mund të shtrihet më tej se ajo që ishte e arsyeshme në ato rrethana. Duhet mbajtur gjithashtu parasysh që autoritetet morën masa për kompensimin monetar të arsyeshëm të kërkuesve si dhe u siguruan atyre strehim.

## BRANKO TOMAŠIĆ DHE TË TJERË kundër KROACISË

(kërkesa nr. 46598/06)

15 janar 2009

*ky vendim sqaron natyrën dhe shtrirjen e detyrimeve pozitive që kanë shtetet për të respektuar të drejtën e jetës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit janë Branko Tomašić, bashkëshortja e tij, Durđa Tomašić, dhe tre fëmijët e tyre. Ata janë shtetas kroatë të lindur respektivisht më 1956, 1963, 1985, 1995 dhe 2001 dhe jetojnë në Čakovec në Kroaci. Kërkuesit janë kushërinj të M.T. dhe fëmijës së saj, V.T., lindur në mars 2005, të cilët ishin vrarë në gusht 2006 nga M. M., babai i V.T.

2. M.T. dhe M.M. jetonin bashkë në shtëpinë e prindërve të M.T. deri në korrik 2005, kur M.M. u largua pas mosmarrëveshjeve me anëtarët e familjes. Në janar 2006 M.T. u ankua se M.M. e kërcënonte me vdekje. Më 15 mars 2006 gjykata e shkallës së parë vendosi se M.M. ishte fajtor për kërcënimet e vazhdueshme ndaj M.T. dhe për kërcënimet se do vriste veten dhe vajzën e tyre me një bombë. Ai u dënua me pesë muaj burg dhe si masë sigurie iu dha një trajtim i detyrueshëm psikiatrik gjatë burgimit dhe, nëse do të ishte e nevojshme, edhe në vijim. Më 28 prill 2006 Gjykata e Apelit e reduktoi trajtimin vetëm gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit të M.M.. Ky u lirua në korrik 2006. Më 15 gusht 2006 ai vrau M.T. dhe vajzën e tyre V.T., para se të kryente vetëvrasje.

3. Kërkuesit u ankuan në bazë të neneve 2 dhe 13, se autoritetet kroate kishin dështuar të merrnin masat e përshtatshme për të mbrojtur M.T. dhe V.T. dhe nuk kishin bërë hetime efektive për përgjegjësinë e Shtetit mbi vdekjen e tyre.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 2

4. Konstatimet e gjykatave të brendshme dhe konkluzionet e ekzaminimeve psikiatrike padyshim tregonin se autoritetet ishin në dijeni se kërcënimet e bëra ndaj M.T. dhe V.T. ishin serioze dhe se të gjitha masat e arsyeshme duhet të ishin marrë për t'i mbrojtur ato. Gjykata vërejtë se nuk kishte pasur asnjë kontroll të



banesës apo automjetit të M.M. gjatë fillimit të procedurës penale, pavarësisht nga fakti se ai kishte kërcënuar me përdorimin e një bombe. Për më tepër, dhe pse raporti psikiatrik i hartuar për qëllimin e procedurës penale theksonte nevojën e trajtimit psikiatrik të vazhdueshëm, Qeveria nuk vërtetonte dot se M.M. ishte trajtuar siç duhej. Në të vërtetë M.M. nuk kishte ndjekur një program individual gjatë mbajtjes së tij në burg edhe pse kjo parashikohej me ligj dhe ishte vendosur nga gjykata kroate. Për më tepër, M.M. nuk ishte ekzaminuar para lirimimit të tij për të vlerësuar nëse ai përbënte rrezik për M.T. dhe V.T.

5. Gjykata konkludoi se asnjë masë e përshtatshme nuk ishte marrë nga autoritetet vendase për të mbrojtur jetët e M.T. dhe V.T., në shkelje me nenin 2.

6. Gjykata vendosi se nuk ishte e nevojshme të ekzaminonte më vete ankesën e bazuar në nenin 2 për dështimin e shtetit në hetimin e përgjegjësive të agjentëve të tij për vdekjen e M.T. dhe V.T.

### **B. Në lidhje me nenin 13**

7. Gjykata tha se nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte ankimin e kërkuesve sipas nenit 13, pasi ajo e kishte identifikuar përgjegjësinë e Shtetit sipas nenit 2.

### **C. Në lidhje me neni 41**

8. Gjykata i akordoi kërkuesve 40 000 euro për dëmshpërblim moral dhe 1 300 për shpenzime të tjera.

## **III. Koment**

9. Ky vendim është përfshirë në botim me idenë për të hedhur dritë mbi zbatimin e testit të detyrimit pozitiv për mbrojtjen e së drejtës së jetës që Gjykata e përpunoi fillimisht në çështjen *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, të përfshirë në këtë botim, dhe me të cilin ky vendim duhet krahasuar<sup>37</sup>. Kujtojmë që testi Osman konsiston në këto dy elemente<sup>38</sup>: së pari duhet provuar se autoritetet e dinin ose duhet ta dinin në kohën e ekzistencës së një kërcënimi real dhe imediat ndaj jetës së një ose disa individëve të identifikuar nga aktet kriminale të një pale të tretë, ose elementi i lidhjes së afërsisë dhe, së dyti, nëse autoritetet nuk kishin marrë masa që ishin në kompetencë dhe brenda mundësive të tyre të cilat, sipas një gjykimi të arsyeshëm, pritej të merreshin për ta shmangur atë kërcënim.

10. Në ndryshim nga çështja Osman, dhe shumë më tepër nga Mastromateo, elementi i lidhjes së afërsisë ishte i qartë në këtë rast. Autoritetet ishin vënë në dijeni për kërcënimet e M.M. ndaj jetës M.T. dhe V.T. dhe kishin nisur procedurat penale dhe e kishin mbajtur atë në burg. Pra elementi i parë plotësohet qartë. Analiza vazhdon me elementin e dytë të testit Osman, pra a kishin marrë

37 Për një shkallë akoma më të largët të "lidhjes së afërsisë" mund të merret në krahasim edhe vendimi *Mastromateo k. Italisë*, gjithashtu i përfshirë në këtë botim.

38 Shih paragrafin 22 të komentit të çështjes *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*.

autoritetet të gjitha masat që ishin në kompetencë dhe brenda mundësive të tyre të cilat, sipas një gjykimi të arsyeshëm, pritej të merreshin për ta shmangur atë kërcënim për të cilin ishin në dijeni.

11. Kritika e Gjykatës sipas këtij elementi të detyrimit pozitiv të nenit 2 ishte se sistemi për të ndjekur personat e rrezikshëm që kërkonin një trajtim psikiatrik mungonte. Në veçanti, duke mos i dhënë trajtimin e duhur M.M. kur ai ishte në burg dhe duke mos i bërë asnjë vlerësim para lirit të tij për të parë rrezikun që ai paraqiste për M.T. dhe V.T., autoritetet kroate nuk kishin marrë masat që pritej të merreshin prej tyre. Opinioni paralel i gjyqtarit Nicolaou vë theksin edhe në elementin tjetër, që është pjesë përbërëse e testit Osman: konkretisht a kishin dështuar autoritetet kroate në sigurimin e një mbrojtje policore efektive të M.T. dhe V.T. kur M.M. u lirua. Sipas tij të gjitha elementët e mbrojtjes duhet të ekzistonin – trajtimi psikiatrik, vlerësimi psikiatrik dhe mbrojtja policore. Mund të them, edhe nga eksperiencia personale, se është tepër e vështirë të mos biesh dakord me urtësinë e gjyqtarit Nicolaou. Me mendimin e tij ai sugjeron që të gjitha masat e mundshme duhen provuar dhe marrë me qëllim mbrojtjen e jetës, kur autoritetet janë në dijeni për kërcënime konkrete.

## **R.R. DHE TË TJERË kundër HUNGARISË**

*(kërkesa nr. 19400/11)*

**4 dhjetor 2012**

*ky vendim ka të bëjë me detyrimet e shteteve për mbrojtjen e dëshmitarëve të cilëve iu kërcënohet jeta*

### **I. Faktet kryesore**

1. Kërkuesi i parë, z. R.R është shtetas serb, dhe banon në Hungari, ndërsa kërkuesja e dytë, znj. H.H është shtetase hungareze dhe bashkëjeton me kërkuesin e parë. Tre kërkuesit e tjerë janë fëmijët e tyre të mitur.

2. z. R.R kishte qenë pjesë aktive e trafikut të lëndëve narkotike dhe i fshihej mafies serbe dhe autoriteteve në Hungari duke përdorur një identitet të rremë. Ai kishte pranuar autorësinë për vepra të ndryshme penale dhe kishte rënë dakord të bashkëpunonte me autoritetet në hetimet e tyre. Bashkëpunimi i tij u dha mundësi prokurorëve të ngrinin akuza kundër anëtarëve të tjerë të mafias serbe. Pavarësisht kundërshtimeve nga ana e kërkuesit të parë, prokurorët hungarezë e bashkuan çështjen e tij me çështjet mbi akuzat kundër anëtarëve të tjerë të mafias serbe, për të cilët ai kishte dhënë informata. Si rezultat, z. R.R. iu kërkua të paraqitej në seancë gjyqësore publike duke zbuluar kështu identitetin e tij si bashkëpunëtor i drejtësisë.

3. Duke menduar se në këto rrethana, z. R.R dhe familja e tij mund të ishin pre e akteve hakmarrëse nga ana e mafias serbe, në gusht 2007 ata u regjistruan në Skemën e Mbrojtjes së Dëshmitarëve ('SMD'). SMD-ja përmbante një klauzolë sipas së cilës nëse z. R.R. nuk respektonte kushtet e SMD-së, të gjithë anëtarët e familjes humbisnin të drejtën e tyre për mbrojtje. Kërkuesit pretenduan se një nga fëmijët e tyre, i cili vuante nga autizmi i gradës së ulët, nuk i ishte ofruar kujdesi i duhur shëndetësor, dhe se dy kërkuesit e parë ishin nxitur që të ndaheshin. Pak kohë pas pranimit të tyre në SMD, familjes iu akordua një ndihmë financiare mujore. Kjo mbulonte qiranë e tyre, shkollimin e fëmijëve dhe pagesat për shërbimet. Kërkuesi i parë mbahej i burgosur në një burg të paidentifikuar, por familjes i mundësohej të udhëtonte për ta vizituar atë.

4. Gjatë gjyqimit të tij, kërkuesi i parë parashtrroi se, nëna e tij ishte kërcënuar në shtëpinë e saj në Serbi. Ai gjithashtu paraqiti shqetësimin se, mafia serbe kishte premtuar një "shpërblim në para" për vrasjen e tij, dhe se prindërit e tij ende vazhdonin të kërcënoheshin nga mafia serbe dhe nga autoriteteve serbe. Autoritetet hungareze vlerësuan se nuk kishte dëshmi të mjaftueshme që të provohej se ishte premtuar një "shpërblim në para" për vrasjen e kërkuesit. Kërkuesi i parë pohoi se kjo nuk ishte provuar për shkak të hetimeve të pamjaftueshme.

5. Në shkurt 2009, kërkuesi u gjet fajtor për trafikimin e lëndëve narkotike, armëmbajtje dhe për vepra të tjera penale, dhe u dënua me nëntë vjet burg. Disa prej personave që, sipas autoriteteve, përbënin një kërcënim për kërkuesit, u dënuan në të njëjtin proces gjyqësor. Më 28 shkurt 2012, kërkuesit të parë iu gjet në qeli një laptop dhe modem USB me internet, të cilët e lejonin atë të përdorte 'VOIP'<sup>39</sup>. Nuk u arrit të identifikoheshin personat me të cilët kërkuesi i parë kishte komunikuar por mund të konkludohej se ai mbante kontakte me qarqe kriminale. Për shkak të shkeljes së rëndë të marrëveshjes së tij me SMD, kërkuesi u përjashtua nga kjo skemë. Më 12 prill 2012, gjithë familja u përjashtua nga skema si një sanksion për këtë shkelje. Autoritetet e bënë të qartë se arsyeja e përjashtimit ishte shkelja e marrëveshjes dhe jo zhdukja e rrezikut.

6. Pas kësaj kërkuesit u vendosën nën një skemë tjetër mbrojtjeje, atë të 'mbrojtjes personale', e cila, për kërkuesin e parë, solli transferimin e tij në një burg të sigurisë së lartë, më vete nga të burgosurit e tjerë. Ai mbahej i burgosur në një qeli 6 m<sup>2</sup>, me dritare nga ku nuk mund të shihte jashtë dhe iu lejua të shëtiste një orë në ajër të hapur në ditë. Kërkuesja e dytë dhe fëmijët e saj u detyruan t'i ktheheshin shkollës dhe jetës së tyre nën emrat e tyre të vërtetë, dhe u pajisën me një numër telefoni emergjence. Vendndodhja e familjes mund të zbulohet letësisht nga çdokush.

39 VOIP (voice-over-internet-proxy)kupton një teknologji komunikimi nga PC në PC apo nga PC në telefon.

7. Kërkuesit pretendonin se heqja nga SMD i ekspozonte jetët e tyre ndaj rrezikut të hakmarrjes nga mafia serbe, çka binte në kundërshtim me nenet 2 dhe 5 të KEDNJ-së.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

8. Kërkuesit pretendonin se, vendimi i autoriteteve hungareze për t'i përjashtuar ata nga SMD binte në kundërshtim me të drejtën e tyre për jetë sipas nenit 2, pasi ata mund të ishin viktimë të hakmarrjes së mafias serbe. Gjykata u shpreh se, pozita e kërkuesit të parë nuk kishte ndryshuar materialisht, përveç transferimit të tij në një formë tjetër burgimi. Pra, pretendimi i kërkuesit të parë ishte haptazi i pabazuar.

9. Megjithatë, përse i përket kërkuesve të tjerë, Gjykata konstatoi se, pajisja e familjarëve me një numër urgjence nuk u ofronte atyre mbrojtje ose siguri të mjaftueshme. Gjykata më tej përsëriti se e drejta për jetën është formuluar në nenin 2 § 1 në mënyrë të tillë që t'i detyrojë shtetet të ndër marrin hapat e duhur për të mbrojtur jetën e personave që ndodhen në juridiksionin e tyre. Kështu, në situata të mirëpërcaktuara, ishte tërësisht normale që Shtetet të kishin detyrimin pozitiv për të ndërmarrë hapa parandaluese për të mbrojtur jetën e atyre që kërcënohen nga akte kriminale të personave të tjerë.

10. Më tej, Gjykata vërejti se, duke i vendosur fillimisht kërkuesit e tjerë në SMD, autoritetet kishin pranuar faktin se ekzistonte një rrezik real për jetën, mirëqënien fizike dhe lirinë e tyre personale. Pas përjashtimit të tyre nga SMD, identitetet e tyre të fshehta u zbuluan, dhe kështu Gjykata u shpreh se, nuk do të ishte e paarsyeshme të supozohej se kushdo që dëshironte të hakmerrej ndaj tyre, tashmë mund t'i gjente lehtësisht dhe ta çonte deri në fund hakmarrjen. Gjykata u shpreh se, në këto kushte, ekspozimi i kërkuesve të tjerë ndaj rrezikut për jetën nga hakmarrja e mundshme nga qarqet kriminale nuk plotësonte standardet e kërkuar nga neni 2 i KEDNJ.

### B. Në lidhje me nenet 5, 6 dhe 8

11. Gjykata i konstatoi se pretendimet e mëtejshme të kërkuesit të parë ishin haptazi të pabazuara, dhe në këtë mënyrë të papranueshme.

### C. Në lidhje me nenin 41

12. Gjykata u akordoi kërkuesit të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë së bashku shuma prej 10 000 eurosh në lidhje me dëmin jo material dhe 3 000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet para Gjykatës.

## III. Koment

13. Ditën e komunikimit të kësaj kërkese Qeverisë hungareze, Gjykata vendosi të zbatojë nenin 39 të Rregullores së Gjykatës, duke i kërkuar Qeverisë të merrte të

gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë personale të kërkuesve ndërkohë që Gjykata gjykonte rastin. Duke qenë se ky është një rast që përfshin një të drejtë absolute, siç është e drejta për jetën, Gjykatës i duhej të sigurohej, për sa mundej, se kërkuesit do vazhdonin të gëzonin mbrojtje gjatë gjithë procesit të shqyrtimit të kërkesës së tyre, dhe se kjo mbrojtje do të vazhdonte edhe pasi të konstatohej shkelje.

14. Në themel Gjykata shqyrtoi gjendjen e familjes së një individi i cili kishte bashkëpunuar me autoritetet dhe kishte dhënë informacione mbi aktivitetet e mafias, ndërkohë që ishte ndjekur edhe vetë penalisht për këto vepra. Kërkesa e tij u shpall e papranueshme nga Gjykata, me arsyetimin se ajo nuk vërente rreziqe të reja për jetën e atij vetë, pas përjashtimit të tij dhe të familjes nga SMD. R.R. vazhdonte të ishte i izoluar në burg. Kështu Gjykata e fokusoi diskutimin e saj mbi situatën e familjes së tij.

15. Gjykata në të vërtetë konstatoi shkelje të nenit 2 në lidhje me nënën dhe tre fëmijët e çiftit. Mesazhi që jep Gjykata është se një shkelje e kushteve të SMD nga kërkuesi i parë nuk duhet të cenojë jetën e kërkuesve të tjerë, për aq sa sipas Gjykatës por edhe vetë autoriteteve hungareze, kërcënimi ndaj tyre ishte ende i pranishëm. Interesante është të vihen në dukje masat specifike individuale që Gjykata i kërkoi Qeverisë sipas nenit 46 të Konventës, pikërisht marrjen e masave të përshtatshme për mbrojtjen e tyre, përfshirë edhe fshehjen si dhe sa duhej të identitetit të tyre, nëse do ishte e nevojshme, deri në kohën kur mund të vërtetohej se kërcënimi ishte zhdukur. Në rastin konkret, Gjykata konstatoi se, autoritetet shtetërore kishin dështuar për të mbrojtur nënën dhe tre fëmijët e saj duke i përjashtuar ata nga skema, d.m.th. ata kishin dështuar në respektimin e detyrimeve të tyre pozitive sipas nenit 2 të Konventës. Kur bëri këtë konstatim, Gjykata u mbështet pjesërisht në Rekomandimin Rec (2005) 9 të Komitetit të Ministrave, i cili përcakton udhëzime për shtetet kur hartojnë legjislacionet e tyre të brendshme dhe rishikojnë politikat dhe praktikat e tyre penale, Rekomandim i cili thekson rëndësinë e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe të njerëzve të tyre të afërm, e sidomos të familjes.

## **AL-SAADON DHE MUFDHI kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

*(kërkesa nr. 61498/08)*

**2 mars 2010**

*Me këtë vendim Gjykata jo vetëm konfirmon jurisprudencën e vet të hershme që transferimi i individëve drejt vendeve ku rrezikojnë t'i nënshtrohen trajtimeve në kundërshtim me nenin 3, do të përbënte shkelje të këtij neni, por, çka është më e rëndësishme, ajo thekson se dënimi me vdekje, tashmë, mund të konsiderohet i papajtueshëm me sistemin e Konventës*

## I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, z. Al-Saadoon dhe z. Mufdhi, ishin shtetas irakianë të lindur në vitin 1952 dhe 1950. Ata ishin myslimanë sunitë nga Iraku jugor dhe ish-zyrtarë të lartë të partisë Ba'ath. Në kohën e dhënies së vendimit nga Gjykata, ata mbaheshin të ndaluar në burg, në afërsi të Bagdadit.

2. Pas pushtimit të Irakut nga ana forcave të armatosura të koalicionit ndërkombëtar, më 20 mars 2003, kërkuesit u arrestuan nga forcat britanike dhe u mbajtën të burgosur në qendrat e kontrolluara prej tyre, si të dyshuar, ndër të tjera, për organizim të veprimtarive të dhunshme kundër forcave të koalicionit. Në tetor të vitit 2004, Policia Ushtarake Mbretërore e Mbretërisë së Bashkuar, konkludoi se kërkuesit kishin qenë të përfshirë në vdekjen e dy ushtarëve britanikë, duke u bërë pritë e më pas duke i vrarë në jug të Irakut më 23 mars 2003.

3. Në dhjetor të vitit 2005, autoritetet britanike vendosën t'ia përcjellin çështjen gjykatave penale të Irakut. Në maj të vitit 2006, kërkuesit u paraqitën para Gjykatës Penale të Basrës nën akuzat për vrasje dhe krime lufte. Gjykata Penale në Basra lëshoi urdhër arresti dhe autorizoi vazhdimin e mbajtjes së tyre në burg nga forcat ushtarake britanike në Basra. Më pas, Gjykata Penale në Basra vendosi se akuzat kundër kërkuesve, përbënin krime lufte dhe gjykimi i tyre ishte kompetencë e Tribunalit të Lartë të Irakut ("TLI"). Rasti iu transferua TLI-së i cili, më 27 dhjetor 2007, u kërkoi zyrtarisht forcave britanike transferimin e kërkuesve, kërkesë të cilën e përsëriti disa herë deri në maj të vitit 2008.

4. Më 12 qershor 2008, kërkuesit kërkuan rishqyrtim të çështjes në Angli, duke kundërshtuar, ndër të tjera, ligjshmërinë e transferimit të tyre. Rasti u gjykua nga Gjykata Angleze e Divizionit<sup>40</sup> e cila, më 19 dhjetor 2008, e deklaroi të ligjshëm transferimin e kundërshtuar. Gjykata vërejtë se, duke qenë se kërkuesit ishin mbajtur të burgosur në një strukturë ushtarake britanike, ata ishin brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar, siç parashikohej nga neni 1 i KEDNJ. Megjithatë, gjykata vendosi se sipas së drejtës ndërkombëtare publike, Mbretëria e Bashkuar ishte e detyruar të dorëzonte kërkuesit, përveç nëse kishte prova të qarta se Shteti pritës kishte për qëllim t'i keqtrajtonte në masën që përbënte krim kundër njerëzimit. Ajo nuk gjeti asnjë arsye thelbësore për të besuar se, nëse kërkuesit transferoheshin, ndaj tyre do zhvillohej një gjykim haptazi i padrejtë dhe se do të bëheshin objekt i torturave ose trajtimit çnjerëzor ose poshtërues. Edhe pse ekzistonte rreziku që kërkuesit të dënoheshin me vdekje pasi të dorëzoheshin tek autoritetet irakiane, dënimi me vdekje në vetvete nuk ishte i ndaluar nga e drejta ndërkombëtare.

40 Gjykata e Divizionit në Angli është një formacion gjyqësor me 2 ose 3 gjyqtarë që krijohet brenda Gjykatës së Lartë (the High Court) për të shqyrtuar çështje penale, ekstradime, çështje administrative ose familjare.



5. Kërkuesit apeluan në Gjykatën e Apelit por ajo u hodh poshtë më 30 dhjetor 2008. Gjykata e Apelit konstatoi se ekzistonte rreziku real që kërkuesit të ekzekutoheshin nëse transferoheshin. Megjithatë, ajo arriti në përfundimin se Britania e Madhe nuk po ushtronte juridiksionin e saj duke qenë se kërkuesit mbaheshin të ndaluar në territorin e Irakut dhe sipas urdhrave të gjykatave irakiane. Pra Konventa nuk zbatohet dhe Mbretëria e Bashkuar duhej të respektohte sovranitetin e Irakut dhe transferimin e kërkuesve. Menjëherë pas këtij vendimi, kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për urdhërimin e një mase të përkohshme, sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, për të ndaluar autoritetet britanike të kryenin transferimin. Gjykata urdhëroi një masë të përkohshme më 30 dhjetor 2008. Një ditë më pas Qeveria Britanike informoi Gjykatën se, kryesisht për shkak se mandati i OKB-së, i cili autorizonte forcat britanike të kryenin arrestime, ndalime dhe burgime në Irak, përfundonte më 31 dhjetor 2008, në mesnatë, ata nuk mund të zbatonin masën e përkohshme dhe i kishin transferuar kërkuesit në kujdestarinë e Irakut po atë ditë, më herët. Më 16 shkurt 2009, kërkuesit nuk u lejuan të apelonin në Dhomën e Lordëve.

6. Gjykimi i kërkuesve përpara TLI-së filloi në maj të vitit 2009 dhe përfundoi në shtator 2009. Ky tribunal vendosi rrëzimin e akuzave kundër tyre dhe lirin e tyre të menjëhershëm. Pas apelimit të prokurorit, Gjykata e Kasacionit e Irakut e ktheu çështjen për hetim të mëtejshëm nga autoritetet irakiane dhe për rigjykim. Kërkuesit vazhdonin të ishin të ndaluar në kohën e dhënies së vendimit nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

7. Kërkuesit u ankuan për transferimin e tyre tek autoritet irakiane. Ata u mbështetën në nenin 2, nenin 3, nenin 6 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit 13. Ata gjithashtu u ankuan për faktin se ishin transferuar tek autoritetet irakiane, pavarësisht urdhrat të Gjykatës sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, duke shkelur kështu nenet 13 dhe 34.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me juridiksionin

8. Më 30 korrik 2009, Gjykata mori vendim në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës në të cilën pretendohet se autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar kishin pasur kontroll të plotë dhe ekskluziv, së pari me anë të ushtrimit të forcës ushtarake dhe pastaj ligjërisht, mbi objektet e paraburgimit në të cilat ishin mbajtur kërkuesit. Gjykata vërejti se kërkuesit kishin qenë brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar deri në transferimin e tyre fizik tek autoritetet irakiane më 31 dhjetor 2008.

### B. Në lidhje me nenin 3

9. Gjykata theksoi se 60 vjet më parë, kur u hartua Konventa, dënimi me vdekje nuk konsiderohej se shkelte standardet ndërkombëtare. Megjithatë, kishte pasur një evolucion të mëvonshëm drejt heqjes së plotë të këtij dënimi, ligjërisht dhe në



praktikë, në të gjitha Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës. Kështu u miratuan dy Protokolle të Konventës, Protokollin nr. 6, i cili hoqi dënimin me vdekje në kohë lufte dhe Protokollin nr. 13 i cili e hoqi atë në të gjitha rrethanat. Mbretëria e Bashkuar i kishte ratifikuar të dy. Kështu, neni 2 i Konventës kishte ndryshuar duke ndaluar dënimin me vdekje në të gjitha rrethanat. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se dënimi me vdekje, që përfshinte shkatërrimin e qëllimshëm dhe me paramendim të një qenie njerëzore nga ana e autoriteteve shtetërore, duke i shkaktuar dhimbje fizike dhe vuajtje intensive psikologjike si rezultat i dijenisë se do ekzekutohej, mund të konsiderohej çnjerëzor dhe poshtërues dhe, si i tillë, binte në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

10. Gjykata pranoi gjetjet e gjykatave kombëtare, të cilat kishin vendosur pak para se të ndodhte transferimi, se kishte arsye serioze për të besuar se ekzistonte rreziku real që kërkuesit të dënoheshin me vdekje dhe të ekzekutoheshin. Më tej, ajo vërejti se autoritetet irakiane ende nuk kishin dhënë asnjë garanci që nuk do t'i ekzekutonin kërkuesit. Për më tepër, edhe pse ishte i pamundur parashikimi i rezultatit të hetimit dhe gjykimit të ri të urdhëruar nga gjykata irakiane, kishte ende arsye serioze për të besuar se kërkuesit rrezikonin realisht të dënoheshin me vdekje, nëse gjykoreshin nga një gjykatë irakiane.

11. Dënimi me vdekje kishte hyrë përsëri në fuqi në Irak në gusht të vitit 2004. Megjithatë, pa marrë ndonjë garanci nga autoritetet irakiane, autoritetet britanike, në dhjetor 2005, kishin vendosur referimin e çështjes së kërkuesve drejt gjykatave irakiane dhe në maj 2006 kishte filluar procesi në Gjykatën Penale në Basra. Gjykata konsideroi se të paktën që nga kjo datë, kërkuesit i ishin nënshtruar frikës për shkak të ekzekutimit, duke u shkaktuar vuajtjeve të konsiderueshme mendore, të cilat kishin vazhduar dhe duhet të ishin intensifikuar që nga data kur ata u transferuan fizikisht tek autoritetet irakiane.

12. Qeveria argumentoi se ata nuk kishin mundësi tjetër përveç se të respektonin sovranitetin e Irakut dhe të transferonin kërkuesit tek gjykatat e Irakut, kur iu kërkua, pasi ata ishin shtetas irakianë që mbaheshin të ndaluar në territorin e Irakut. Megjithatë, Gjykata nuk ishte e bindur se për të siguruar të drejtat e kërkuesve sipas Konventës duhej, në mënyrë të pashmangshme, të shkelej sovraniteti i Irakut. Nuk dukej se ishin bërë përpjekje reale për të negociuar me autoritetet e Irakut në mënyrë që të parandalohet rreziku i dënimit me vdekje. Në këto kushte, duke pasur parasysh mundësinë reale të dënimit me vdekje dhe të ekzekutimit të kërkuesve, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesin ishin trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese, në shkelje të nenit 3. Në këto kushte Gjykata vendosi se nuk kishte nevojë të vazhdonte edhe me shqyrtimin e ankesës sipas nenit 2 ose Protokollit 13 të Konventës.

### *C. Në lidhje me nenin 6*

13. Gjykata pranoi gjetjet e gjykatave kombëtare se, në datën e transferimit, nuk dihej nëse kërkuesit rrezikonin të gjykoreshin haptazi në mënyrë të padrejtë

nga TLI. Tani që gjyqi kishte përfunduar, ishte e qartë se nuk kishte prova para Gjykatës që hidhnin dyshime mbi këtë vlerësim. Si përfundim Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6.

#### ***D. Në lidhje me nenet 13 dhe 34***

14. Gjykata nuk u bind se Qeveria kishte ndërmarrë ndonjë hap ose i kishte ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm, për të vepruar në pajtim me urdhrin e Gjykatës sipas nenit 39 për të mos transferuar kërkuesit tek autoritetet irakiane. Mos respektimi i urdhrin të Gjykatës dhe transferimi i kërkuesve jashtë juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar i kishte ekspozuar ata ndaj rrezikut të rëndë dhe një dëmi të pariparueshëm dhe kishte zhveshur nga efektiviteti në mënyrë të pajustificueshme ankimin në Dhomën e Lordëve. Prandaj, Gjykata konstatoi shkelje të neneve 13 dhe 34 të Konventës.

#### ***E. Në lidhje me nenin 46***

15. Në kuadrin e masave të përgjithshme, Gjykata vendosi se, duke pasur parasysh se vuajtja e dy kërkuesve në burgjet irakiane vazhdon, autoritetet duhet të bëjnë çdo përpjekje për të marrë garanci nga autoritetet irakiane se dy kërkuesit nuk do t'i nënshtrohen dënimit me vdekje.

#### ***F. Në lidhje me nenin 41***

16. Gjykata u shpreh se konstatimi i shkeljes ishte shpërblim i drejtë i mjaftueshëm për dëmin jo material që kishin pësuar kërkuesit dhe u akordoi atyre në total 40 000 euro për kostot dhe shpenzimet.

### **III. Koment**

17. Së pari, vendimi në fjalë ka një rëndësi specifike sepse riafirmon jurisprudencën e mëparshme të Gjykatës në lidhje me juridiksioni për qëllimet e nenit 1 të KEDNJ-së. Gjykata, në këtë çështje me rrethana tepër specifike pohon se ka juridiksion sipas nenit 1 edhe kur një Shtet anëtar mban një person të ndaluar edhe kur ndalimi ndodh në territorin e një Shteti tjetër. Pasi përcaktohet juridiksioni, Shteti ka përgjegjësinë për garantimin e të drejtave të parashikuara në Konventë e individëve të prekur.

18. Së dyti, Gjykata diskutoi gjerësisht detyrimet e Mbretërisë së Bashkuar në bazë të nenit 2 dhe Protokolleve nr. 6 dhe nr. 13 (heqja e dënimit me vdekje), duke theksuar se ata duhet të interpretohen në mënyrë strikte. Ajo theksoi se nuk ishte e qartë nëse akuzat e reja ndaj kërkuesve mund të çonin në dënimin e tyre me vdekje, dhe zgjodhi që të vendosë për pretendimet e tyre në bazë të nenit 3 dhe jo në bazë të nenit 2 ose të Protokolleve. Gjithsesi ky qëndrim duhet kuptuar në vazhden e jurisprudencës të vazhdueshme të Gjykatës e cila që nga çështja *Soering k. Mbretërisë së Bashkuar* filloi të ecë drejt kësaj rruge, duke konsideruar se ankthi, për një kohë të gjatë, në pritje të dënimit me vdekje, përbën shkelje të nenit 3.

19. Në jurisprudencën e mëparshme, pikërisht në *Oçalan k. Turqisë*, i përfshirë në këtë botim, Gjykata ishte shprehur se vendosja e dënimit me vdekje, pas një gjykimi të padrejtë përbën shkelje të nenit 3. Në rastin konkret, Gjykata konstatoi se Mbretëria e Bashkuar nuk kishte marrë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që kërkuesit nuk do t'i nënshtroheshin dënimit me vdekje duke cenuar kështu të drejtat e tyre sipas nenit 3, për shkak të frikës dhe ankthit më të cilin ata do të përballeshin. Ndalimi absolut sipas nenit 3 kishte përparësi krahasuar me marrëveshjen ndërkombëtare ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Irakut. Është e rëndësishme të theksohet se ky vendim mund të interpretohet si një lexim i përditësuar i nenit 2 të Konventës në lidhje me dënimin me vdekje. Për këtë qëllim është me vlerë të citohet paragrafi 120 i vendimit të Gjykatës ku thuhet se "*është e qartë nga vendimi i Dhomës së Madhe në çështjen Oçalan se tashmë pranohej që neni 2 kishte ndryshuar duke hequr kështu përjashtimin që lejon dënimin me vdekje. Për më tepër, siç u tha më lart, qëndrimi kishte evoluar që atëherë. Të gjithë, përveç dy prej Shteteve Anëtare, tashmë e kanë nënshkruar Protokollin e nr. 13 dhe të gjithë, përveç tre prej Shteteve që e kanë nënshkruar, e kanë ratifikuar atë. Këto shifra, së bashku me praktikën e vazhdueshme të Shteteve në respektimin e ndalimit të dënimin me vdekje, janë tregues të rëndësishëm se neni 2 kishte ndryshuar në mënyrë të tillë që të ndalonte dënimin me vdekje në të gjitha rrethanat. Përkundrejt këtij sfondi, Gjykata nuk e konsideron formulimin e fjalisë së dytë të nenit 2 (1) si një pengesë për interpretimin e shprehjes "trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar" në nenin 3 se përfshinte edhe dënimin me vdekje (krahaso me *Soering, cituar më lart, para. 102-04*)". Gjykata pra, e sqaron përfundimisht qëndrimin e saj, duke u shprehur se tashmë edhe vetë mundësia e dënimit me vdekje përbën shkelje të nenit 3 të Konventës, megjithëse jo të nenit 2. Pavarësisht nga kjo zgjedhje metodologjike, duke pasur parasysh që Konventa duhet interpretuar në tërësinë e saj, mund të thuhet se tashmë dënimi me vdekje nuk mund të justifikohet më në bazë të Konventës, pavarësisht nga parashikimi i nenit 2 § 1 i saj.*

20. Gjithashtu, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 34, si pasojë e dështimit për të respektuar urdhrin e Gjykatës sipas nenit 39 të Rregullores për mos transferimin e kërkuesve tek autoritetet irakiane. Që në çështjen *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë*, Gjykata e ka bërë të qartë se Shtetet kanë detyrimin për të respektuar urdhrin sipas nenit 39 të Rregullores. Vetëm Gjykata Evropiane mund të tërheqë një urdhrë sipas nenit 39, pasi ishte dhënë. Gjyqtari britanik dha një mendim paralel në lidhje me konstatimin e një shkelje të nenit 3, por votoi kundra për sa i përket konstatimeve në bazë të nenit 34.

21. Interesant është edhe vlerësimi që i bëhet situatës në bazë të nenit 46 të Konventës në këtë çështje. Gjykata i kërkon autoriteteve britanike që të bëjnë çmos që të marrin garanci nga autoritetet irakiane që kërkuesit nuk do ekzekutohen. Që më 9 nëntor 2010 Kryetari i Komitetit të Drejtave të Njeriut i Parlamentit Britanik i kërkoi Ministrin të Mbrojtjes që ta vinte në dijeni mbi ekzekutimin e këtij vendimi të Gjykatës. Me një letër të 25 nëntorit 2010 Ministri Britanik i Mbrojtjes i përgjigjet kësaj letre, duke renditur të gjitha përpjekjet që autoritetet britanike po bënin për të marrë garanci se kërkuesit nuk do të ekzekutoheshin.

## NACHOVA DHE TË TJERË kundër BULLGARISË

(kërkesat nr. 43577/98 dhe 43579/98)

26 shkurt 2004

*ky vendim tepër i rëndësishëm dënon vrasjet për arsye raciale të dy romëve në Bullgari*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Anelia Kunchova Nachova, Aksiniya Hristova, Todorka Petrova Rangelova dhe Rangel Petkov Rangelov janë të gjithë shtetas bullgarë me origjinë rome. Ata kanë lindur përkatësisht më 1995, 1978, 1955 dhe 1954 dhe jetojnë në Bullgari.

2. Çështja ka të bëjë me vrasjen, më 19 korrik 1996, e të afërmeve të kërkuesve, Kuncho Angelov dhe Kiril Petkov, të dy nga 21 vjeç, nga një polic i cili po përpiqej t'i arrestonte.

3. z. Angelov dhe z. Petkov ishin rekrutuar të dy në një divizion të ushtrisë që merrej me ndërtimin e blloqeve të pallateve dhe me projekte të tjera në shërbim të komunitetit. Në fillim të vitit 1996 ata ishin arrestuar për largime të shumta pa leje nga reparti i tyre. Më 22 maj 1996 z. Angelov u dënua me nëntë muaj burg dhe z. Petkov me pesë muaj burg. Të dy ishin dënuar më parë edhe për vjedhje.

4. Më 15 korrik 1996 ata u larguan nga kantieri i ndërtimit ku po punonin dhe shkuan në shtëpinë e gjyshes së z. Angelov, në Lesura. Asnjëri prej tyre nuk kishte armë me vete.

5. Më 19 korrik 1996 komandanti i Rajonit të Policisë Ushtarake të Vratsas, Kolonel D., dërgoi katër oficerë të policisë ushtarake në komandën e Majorit G. që të arrestonin dy të ikurit. Të paktën dy prej oficerëve që u nisën me këtë detyrë, e njihnin të paktën njërin prej të ikurve. Koloneli D. i udhëzoi oficerët se “në përputhje me rregullat” ata duhet të mbanin gati revolverët dhe automatikët e tyre dhe të vishnin jelekë anti-plumb. Ai i informoi ata se z. Angelov dhe z. Petkov ishin “kriminelë aktivë” – një term që përdorej për të përshkruar persona të dënuar më parë ose ata që dyshoheshin për kryerjen e krimeve – dhe se ata ishin larguar nga izolimi. Oficerët e policisë ushtarake u instruktuan që të përdornin të gjitha mjetet që t'i arrestonin ata.

6. Kur policia arriti në shtëpinë e gjyshes së z. Angelov, dy të ikurit u përpoqën të largoheshin. Pas paralajmërimit se do t'i qëllonte në qoftë se nuk dorëzoheshin,

Majori G. qëllloi drejt të dyve. Ata u çuan në spitalin e Vrstas ku u deklaruan të vdekur.

7. Një dëshmitar okular pretendoi se për shkak të nipit të tij – një fëmijë i vogël – ishte gjendur në zonën ku kishin ndodhur të shtënat. Ai i kishte kërkuar Majorit G. leje për t’u afruar dhe larguar të nipin nga ajo zonë. Majori G i kishte drejtuar armën duke i thënë: “Ju dreq jevgjish!”.

8. Në të njëjtën ditë filloi hetimi penal në lidhje me vdekjen e këtyre dy personave. Raporti i autopsisë konstatoi se të dy djemtë kishin vdekur nga dëmtimet në pjesën e trungut të shkaktuara me armë automatike nga distanca, dhe drejtimi i të shtënave kishte qenë nga përpara-mbrapa për z. Petkov dhe nga mbrapa-përpara për z. Angelov. Hetimi arriti në përfundimin se Majori G. kishte respektuar Rregulloren e Policisë Ushtarake. Ai i kishte paralajmëruar disa herë të dy djemtë dhe kishte qëlluar paraprakisht në ajër. Ai i kishte qëlluar sepse ata nuk ishin dorëzuar, për shkak se kishte pasur mundësi që ata të largoheshin dhe se ishte përpjekur të shmangte dëmtime fatale. Në fakt askush tjetër nuk u dëmtua nga të shtënat. Kërkuesit u ankuan ndaj mbylljes së hetimit por pa sukses.

9. Kërkuesit pretenduan se të afërmit e tyre ishin privuar nga e drejta e jetës, në shkelje të nenit 2 të Konventës. Ata ankoheshin gjithashtu se autoritetet nuk kishin bërë një hetim efektiv të vdekjeve, duke shkelur nenin 2 dhe nenin 13 të Konventës.

10. Duke u mbështetur në nenin 14 të interpretuar së bashku me nenin 2, kërkuesit pretendonin gjithashtu se paragjykimi dhe qëndrimet armiqësore ndaj personave me origjinë romë kishin luajtur një rol vendimtar në ngjarjet që çuan deri në reagimin me armë dhe faktin që nuk u bë një hetim efektiv në lidhje me vrasjet.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

#### a. Privimi i jetës

11. Gjykata vuri në dukje se z. Angelov dhe z. Petkov kishin qenë duke vuajtur dënime të shkurtra për vepra penale jo të dhunshme, se ata ishin larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit pa përdorur dhunë, se asnjëri prej tyre nuk kishte qenë i armatosur dhe se në dosjet e tyre nuk kishte të dhëna për përdorim dhune prej tyre.

12. Përdorimi i armëve të zjarrit që mund të sillnin vdekjen pa dyshim që e ekspozon jetën e njeriut ndaj një rreziku për humbjen e saj, edhe kur ekzistojnë rregulla që parashikojnë uljen e rrezikut për këtë qëllim. Në këtë kuadër, Gjykata vlerësoi se në asnjë rast nuk ishte absolutisht e nevojshme që të përdreshin armë të tilla zjarri për të arrestuar një person të dyshuar për vepra jo të dhunshme

dhe që dihet që nuk përbën rrezik, edhe kur mospërdorimi i këtyre armëve mund të çojë në dështimin e arrestimit të personit në fjalë. Për pasojë, përdorimi i armëve të zjarrit në një situatë të tillë nuk mund të kishte qenë “absolutisht i nevojshëm” dhe për këtë qëllim ndalohej nga neni 2 i Konventës. Gjykata konstatoi gjithashtu se ishte përdorur forcë e tepërt e panevojshme, gjë e cila e rëndoi më tepër shkeljen e nenit 2.

13. Në lidhje me planifikimin dhe kontrollin e arrestimit, Gjykata vlerësoi se autoritetet bullgare nuk kishin respektuar detyrimin e tyre për të minimizuar rrezikun e humbjes së jetës, përderisa nuk ishin mbajtur parasysh natyra e shkeljes dhe fakti që dy djemtë nuk përbënin ndonjë rrezik. Po ashtu, rrethanat në të cilat duhet të ishin përdorur armët e zjarrit dhe fakti nëse këto duheshin përdorur apo jo, nuk iu nënshtruan ndonjë diskutimi – gjë që mesa dukej kishte ardhur për shkak të rregullave të paplota dhe mungesës së trajnimeve të përshtatshme. Për këtë arsye, Bullgaria ishte përgjegjëse për mungesën e planifikimit dhe të kontrollit të operacionit të arrestimit të dy të ikurve në një mënyrë që të ishte e pajtueshme me nenin 2.

*b. Efektiviteti i hetimit*

14. Gjykata vuri në dukje se autoritetet bullgare nuk ngritën asnjë akuzë ndaj oficerëve të policisë ushtarake sepse vlerësuan paraprakisht se rregullat e zbatueshme në lidhje me përdorimin e forcës ishin respektuar. Gjykata konstatoi se ky konkluzion ishte bazuar në konstatime të dyshimta të cilat, edhe në qoftë se pranoheshin, nuk mund të shiheshin si bazë për të arritur në përfundimin se forca e përdorur për arrestimin e dy djemve ishte “jo më shumë se ç’ishte absolutisht e nevojshme”. Kishte qenë gjithashtu e nevojshme që të hetohej planifikimi i operacionit dhe kontrolli i tij, përfshirë çështjen nëse oficerët kishin vepruar në një mënyrë të tillë që të kufizonin rrezikun e humbjes së jetës.

15. Në lidhje me mbledhjen dhe vlerësimin e provave, Gjykata vuri në dukje se ishin neglizhuar disa hapa fillestarë të rëndësishëm, të tillë si ruajtja e provave në vendin e ngjarjes dhe marrja e të gjitha shenjave të rëndësishme. Ishte gjithashtu tepër domethënës fakti se hetuesi dhe prokurorët nuk kishin komentuar në lidhje me një sërë faktesh të cilat dukej se nuk pajtoheshin me deklaratat e Majorit G. Autoritetet thjesht pranuan deklaratat e këtij të fundit pa dhënë ndonjë shpjegim të besueshëm.

16. Për këto arsye Gjykata konstatoi se hetimi u karakterizua nga një sërë mangësish serioze dhe të pashpjegueshme. Ai u mbyll me një vendim që përmbante papajtueshmëri dhe konkluzione që nuk mbështeteshin në një analizë të kujdesshme të fakteve. Si rezultat, vrasja e z. Angelov dhe e z. Petkov u konsiderua e ligjshme duke u mbështetur në argumente të dyshimtë. Oficerët e policisë të përfshirë si dhe eprorët e tyre nuk u ngarkuan me ndonjë akuzë penale dhe madje as me kritika, pavarësisht se kishte pasur arsye të mjaftueshme që të paktën njëri prej tyre të ndiqej penalisht.



17. Gjykata konstatoi se hetimi dhe përfundimet e arritura nga prokurorët karakterizoheshin nga mangësi dhe papajtueshmëri serioze të pashpjegueshme, madje edhe e gjithë përqasja e hetimit ishte e gabuar. Për këto arsye Gjykata u shpreh se ka pasur shkelje nga ana e Bullgarisë, lidhur me detyrimin e saj në bazë të nenit 2 § 1 të Konventës, sipas të cilit duhet të hetohen me efektivitet të gjitha rastet e privimit të jetës.

### **B. Në lidhje me nenin 13**

18. Gjykata vlerësoi se nuk kishte pse ngrihej ndonjë problem i veçantë në bazë të nenit 13.

### **C. Në lidhje me nenin 14**

*a. Mungesa e hetimit në lidhje me faktin nëse diskriminimi kishte ndikuar në të shtënat me armë zjarri.*

19. Gjykata vuri re se nuk ishin marrë në analizë disa fakte të cilat duhet t'i kishin alarmuar autoritetet dhe t'i kishin bërë ato të ishin veçanërisht vigjilente dhe të hetonin arsye të mundshme raciste. Nga organet e hetimit nuk iu kushtua aspak vëmendje faktit se Majori G. kishte qëlluar me automatik në një zonë të populluar - pikërisht në rrethinat rrome të qytetit të Lesurës – ndaj dy personave të paarmatosur dhe jo të dhunshëm që po largoheshin. Për më tepër, njëri prej viktimave ishte qëlluar në gjoks dhe jo në kurriz, gjë që të bën të mendosh se ai mund të ishte kthyer për t'u dorëzuar.

20. Për më tepër, pavarësisht nga informacioni se Majori G. njihte disa prej banorëve dhe zonën ku u qëllua me armë, nuk u bë asnjë përpjekje për të hetuar nëse armiqësia personale mund të kishte luajtur rol në këto ngjarje. Megjithëse nuk ishte kundërshtuar, organet hetimore nuk kishin mbajtur parasysh deklaratën e dëshmitarit sipas të cilit Majori G. kishte thirrur: “Ju drej jevgjish!”, ndërkohë që i kishte drejtuar automatikun pak pasi kishte qëlluar viktimat.

21. Gjykata vlerësoi se çdo provë në lidhje me abuzimet verbale nga personat e ngarkuar me zbatimin e ligjit gjatë një operacioni që përfshinte përdorimin e dhunës ndaj personave që i përkasin një pakice etnike ose ndonjë pakice tjetër ishte tepër e rëndësishme për të arritur në përfundimin nëse ishte ushtruar dhunë e paligjshme dhe e nxitur nga arsye raciale. Në rastet kur organet hetimore vihen në dijeni të provave të tilla, ato duhen verifikuar dhe në qoftë se konfirmohen, duhen ndërmarrë analiza të hollësishme të të gjitha fakteve me qëllim që të zbulohet ndonjë arsye e mundshme raciste. Por kjo nuk ishte bërë.

22. Për këtë arsye Gjykata konstatoi se autoritetet nuk kishin respektuar detyrën e tyre në bazë të nenit 14 të interpretuar së bashku me nenin 2, pra për marrjen e të gjitha hapave të mundshëm për të vendosur nëse qëndrimet diskriminuese mund të kishin ndikuar në zhvillimin e ngjarjeve.



*b. Në lidhje me faktin nëse diskriminimi kishte ndikuar në të shtënat me armë zjarri.*

23. Gjykata e vlerësoi si tepër të rëndësishëm faktin se ky nuk ishte rasti i parë kundër Bullgarisë në të cilin ajo kishte konstatuar se zyrtarë të ngarkuar me zbatimin e ligjit kishin ushtruar dhunë deri në vdekje ndaj romëve. Në vendimet e saj *Velikova* dhe *Anguelova*, Gjykata kishte vënë në dukje se ankesat për frymëzim racial të vrasjeve të dy romëve në dhomat e paraburgimit në dy situata të veçanta nga njëra tjetra ishin bazuar në “argumente seriozë”. Incidente të tjera për akte brutale të policisë ndaj romëve në Bullgari ishin bërë gjithashtu të ditura nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, organet e Kombeve të Bashkuara dhe nga organizata të tjera jo qeveritare. Rezultonte që disa prej këtyre raporteve nuk ishin kundërshtuar nga autoritetet bullgare. Madje duket se ato kishin pranuar nevojën për të marrë masa për të luftuar diskriminimin ndaj romëve.

25. Gjykata vlerësoi se qeveria bullgare duhet ta bindte atë, mbi bazën e provave shtesë ose të argumentimeve bindëse të fakteve, se ngjarjet objekt i ankesave nuk ishin rezultat i ndonjë sjelljeje diskriminuese të ndaluar nga ana e autoriteteve bullgare. Por qeveria bullgare nuk e bëri një gjë të tillë.

26. Si përfundim, duke pasur parasysh ndikimin e qëndrimeve të mundshme diskriminuese nga ana e Majorit G., mungesën e hetimit nga ana e autoriteteve dhe në veçanti të motiveve të mundshme raciste të cilat dukej qartë se duheshin hetuar, kontekstin e përgjithshëm dhe faktin që ky nuk ishte rasti i parë kundër Bullgarisë në të cilin romët ishin pretenduar viktima të dhunës raciale të ushtruar nga persona të veshur me pushtet publik, duke vënë re se asnjë shpjegim i kënaqshëm në lidhje me ngjarjet nuk u dha nga qeveria bullgare, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 14 të interpretuar së bashku me nenin 2 të Konventës.

#### ***D. Në lidhje me nenin 41***

27. Gjykata akordoi: bashkërisht znj. Nachova dhe znj. Hristova 25 000 euro për dëm material dhe jomaterial; bashkërisht znj. Rangelova dhe z. Rangelov 22 000 euro për dëm material dhe jomaterial; dhe, bashkërisht të gjithë kërkuesve 3 740 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

### **III. Koment**

28. Vendimi i Gjykatës në lidhje me nenin 2 në këtë çështje nuk ishte i papritur. Gjykata u shpreh se përdorimi i forcës vdekjeprurëse për të arrestuar dy djem të rinj që kishin ikur nga izolimi nuk ishte në raport të drejtë me qëllimin dhe nuk respektonte testin e “absolutisht i nevojshëm” të nenit 2 § 2. Gjykata konstatoi gjithashtu se hetimet nuk ishin kryer në mënyrë të përshtatshme dhe nuk respektonin garancitë procedurale të nenit 2 përderisa ato ishin fokusuar vetëm në respektimin e standardeve të së drejtës së brendshme dhe nuk e kishin analizuar testin e masës “absolutisht të nevojshme”.

29. Në këtë kuadër vendimi merr përmasa të jashtëzakonshme për të vënë në dukje një moment shumë me rëndësi sidomos në situatën shqiptare – pajtueshmëria e legjislacionit të brendshëm me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut përbën një kusht të nevojshëm por jo të mjaftueshëm për të shmangur mundësitë e konstatimit të shkeljeve nga Gjykata e Strasburgut. Nga ana tjetër, vendimi ta drejton vëmendjen nga puna e prokurorisë dhe policisë gjyqësore, të cilat duhet të përdorin në punën e tyre analiza dhe teknika të argumentimit juridik që jo domosdoshmërisht janë parashikuar në akte të brendshme ligjore ose nënligjore. Një mospërdorim i teknikave të tilla – si testi i “absolutisht i nevojshëm” -- nuk do t'i shmangte nga përgjegjësia profesionale. Kjo aq më tepër kur garancitë procedurale të nënkuptuara në nenin 2 të Konventës dalin edhe një herë si kriter për të vendosur nëse ka pasur apo jo shkelje të këtij neni. Rastet e gjakmarrjes në Shqipëri mund të përbënin një platformë më vete analize në këtë drejtim.

30. Risia më e madhe e vendimit konsiston gjithsesi në konstatimin e shkeljes së nenit 14 të interpretuar së bashku me nenin 2. Deri përpara këtij vendimi Gjykata ka hezituar në arritjen e përfundimit se racizmi kishte përbërë thelbin e disa shkeljeve të Konventës<sup>41</sup>. Në vendime të mëparshme<sup>42</sup> Gjykata kishte vënë në dukje “argumente seriozë që ishin parashtruar” në lidhje me elementët raciale të vrasjeve të romëve në dhomat e izolimit në rajone policie. Por në këtë çështje Gjykata u shpreh se “ndikimi i diskriminimit të mundshëm” nga ana e oficerit që kishte qëlluar ishte i tillë sa barra e provës për të vërtetuar të kundërtën i kalonte qeverisë, gjë që kjo nuk e kishte bërë. Në vijim, dhe këto janë gjithashtu dy risi themelore, Gjykata vendosi se mungesa e një hetimi efektiv në lidhje me vdekjet, se kishte pasur karakter diskriminues dhe se mungesa e një hetimi efektiv në lidhje me elementët raciste të vrasjeve përbënte gjithashtu shkelje të nenit 14 të interpretuar së bashku me nenin 2. Për këto arsye ky vendim ka vlera themelore për luftën ndaj racizmit në nivel Evropian. Ai gjithashtu shënon një prej zgjerimeve më domethënëse të interpretimit të nenit 14 të Konventës<sup>43</sup>.

41 Shih për shembull vendimin e 28 tetorit 1998 në lidhje me çështjen *Assenov kundër Bullgarisë*.

42 Në vendimet e 18 majit 2000 në lidhje me çështjen *Velikova kundër Bullgarisë* dhe të 13 qershorit 2002 në lidhje me çështjen *Anguelova kundër Bullgarisë*.

43 Të jetë ky zgjerim një hap që hidhet nën dritën e Protokollit 13 të Konventës, kjo ngelet për t'u diskutuar.

## GIULIANI DHE GAGGIO kundër ITALISË

(kërkesa nr. 23458/02)

24 mars 2011

### Dhomë e Madhe

*ky vendim ka të bëjë me vdekjen e një protestuesi gjatë protestave kundër G8 në Xhenova në korrik 2001 dhe me përgjegjësinë që mund t'iu lindë autoriteteve në lejimin, organizimin dhe reagimin ndaj protestave të tilla, sidomos kur këto bëhen të dhunshme*

#### I. Faktet kryesore

1. Faktet e kësaj çështje lidhen me përleshjet e dhunshme që ndodhën ndërmjet policisë dhe grupeve të demonstruesve gjatë Samitit të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive në kuadrin e Samitit të G8, të mbajtur në Xhenova 19 deri më 21 korrik të vitit 2001. Çështja e ka zanafillën në kërkesën e depozituar kundër Italisë nga tre shtetas italianë, z. G. Giuliani, znj. A. Gaggio dhe znj. E. Gaggio Giuliani. Kërkuesit janë përkatësisht babai, nëna dhe motra e Carlo Giuliani, një të riu që u vra me armë zjarri gjatë këtyre demonstratave.

2. Në mëngjesin e 20 korrikut 2001 disa grupe demonstruesish tepër agresivë, të maskuar me kapuçë dhe me maska të zeza (i ashtuquajturit Blloku i Zi), provokuan incidente të shumta dhe u përleshën me forcat e sigurisë. Në mënyrë të veçantë, rreth orës 17, në afërsi të Piazza Alimonda, një grup protestuesish detyruan një skuadër karabinierësh të tërhiqen duke lënë të izoluar dy xhipa të cilët kishin ardhur për të rivendosur rendin. Njëri nga xhipat mbeti i bllokuar dhe disa protestues filluan ta qëllonin me leva, me gurë dhe me objekte të tjera të rënda. Brenda këtij xhipi ishin tre karabinierë, F.C., D.R. dhe M.P. Ky i fundit, i plagosur, ishte i përkulur në anën e pasme të mjetit dhe mbrohej me një mburojë kundër sulmeve dhe, duke ju thirrur protestuesve që të largoheshin sepse përndryshe "do t'iu vriste", nxori një pistoletë Beretta 9 mm, e drejtoi armën në drejtim të një prej dritareve të prapme të thyera të xhipit, dhe mbas rreth dhjetë sekondash, qëlloi dy herë.

3. Njëra prej të shtënave qëllloi në fytyrë, nën syrin e tij të majtë, një prej demonstruesve, Carlo Giulianin, i cili ishte i maskuar me një kapuç dhe sapo kishte marrë dhe ngritur një bombol gazi bosh zjarri. Pas pak çastesh F.C. rindezi motorrin dhe xhipi, në përpjekje për t'iu larguar, shkeli dy herë mbi trupin Carlo Giuliani. Pak metra më tutje, marshalli A. hypi në xhip dhe mori drejtimin e mjetit pasi F.C., sipas raporteve, ishte në gjendje shoku. Në xhip

hypi edhe karabinieri R. Nga ana tjetër e sheshit forcat e policisë përpiqeshin të shpërndanin protestuesit. Në orën 17:27 u thirr një ambulancë dhe një mjek që mbërriti aty pak më vonë deklaroi vdekjen e Carlo Giuliani.

4. Në lidhje me këtë ngjarje u hap një dosje hetimore, dhe ndaj karabinierëve M.P. dhe F.C., filloi procedimi penal si të dyshuar për vrasje. Të gjithë personat e përfshirë në këtë ngjarje u morën në pyetje, u krye autopsia në trupin e Carlo Giuliani, dhe u kryen testet mjekësore dhe balistike si dhe u shqyrtuan të gjitha materialet audiovizuale në ish-in në dispozicion.

5. Në gusht të vitit 2001 u hap edhe një hetim parlamentar, i cili u mbyll me një raport që përmbante përfundime përgjithësisht pozitive në lidhje me organizimin e Samitit G8, pavarësisht nga konstatimi i mangësive të caktuara në koordinimin e operacioneve. Komisioni i ngarkuar me hetimin arriti gjithashtu në përfundimin se ishte e nevojshme të individualizoheshin dhe të ndëshkoheshin autorët e veprave penale dhe disiplinore.

6. Më 5 maj 2003, gjyqtari i hetimeve paraprake (tani e tutje G.I.P.)<sup>44</sup> të Xhenovës pranoi pushimin e procedurës penale në ngarkim të M.P. dhe F.C., duke iu referuar vrasjes në kufijtë e vetëmbrojtjes së ligjshme dhe "përdorimit legjitim të armëve gjatë manifestimeve" në lidhje me të parin, dhe duke përjashtuar çdo përgjegjësi penale për vdekjen e Carlo Giuliani, në lidhje me të dytin, pasi ishte e qartë që ky kishte vdekur nga të shtënat me armë zjarri dhe kalimi me xhip mbi trup kishin shkaktuar vetëm shembje dhe djegie. Apeli i kërkuësve kundër pushimit të çështjes penale nuk u pranua.

7. Kërkuësit iu drejtuan Gjykatës së Strasburgut, duke pretenduar shkelje nga autoritetet italiane të neneve 2, 3, 6, 13 dhe 38 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

8. Një Dhomë e Seksionit IV, me 25 gusht 2009, vendosi në këtë rast, nuk ka pasur shkelje të nenit 2 në lidhje me përdorimin e tepruar të forcës dhe detyrimin pozitiv të Shtetit për të mbrojtur jetën. Por Dhoma gjeti shkelje të kësaj dispozite nga autoritetet italiane në lidhje me detyrimet procedurale. Dhoma gjeti gjithashtu se nuk ka pasur një shkelje të nenit. 38 dhe nuk e gjeti të nevojshme të shqyrtuar kërkesën në bazë të neneve 3, 6 dhe 13. Të dy palët, edhe kërkuësit edhe Qeveria e apeluan vendimin në Dhomë të Madhe, apel që u pranua nga Paneli i Dhomës së Madhe në bazë të nenit 43 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 2

*i. Në lidhje me përdorimin e forcës nga karabinieri M.P.*

9. Kërkuësit pretendonin, së pari se, përdorimi i forcës, në rastin konkret nuk

44 GIP - Giudice per le Indagini Preliminari.

ishte "absolutisht i nevojshëm" për arritjen e objektivave të përcaktuar nga paragrafi 2 i Konventës. Gjykata, pasi shqyrtoi të gjitha fotot dhe videot në lidhje me ngjarjen, konstatoi se karabinieri M.P., duke u gjendur në prani të një grupi protestuesish veçanërisht të dhunshëm, reagoi duke qëlluar dy herë vetëm për të mbrojtur jetën dhe të integritetin e fizik të tij dhe të kolegëve të tij. Për më tepër, Gjykata, në bazë të provave në dispozicion të saj, përcaktoi se karabinieri qëlloi me pistoletë vetëm pasi kishte paralajmëruar protestuesit dhe pasi kishte parë që sulmi po vazhdonte vazhduar. Sipas Gjykatës ky është një qëndrim mëse legjitim, sidomos duke pasur parasysh se Carlo Giuliani, pavarësisht nga paralajmërimi, ngriti nga toka nën një bombol gazi.

10. Gjykata vuri re se trajektorja e plumbit që vrau Carlo Giuliani nuk është përcaktuar me saktësi. Sipas teorisë të mbështetur nga ekspertët të cilët kryen hetimet, pranuar nga GIP. i Xhenovës, por që kundërshtohet nga kërkuesit, plumbi u qëllua në drejtimin lart dhe fatkeqsisht kishte ndryshuar drejtim pas përplasjes me një nga gurët e hedhur nga protestuesit.

11. Gjithsesi, Gjykata thekson rëndësinë e kufizuar të këtij elementi, përderisa u provua se M. P. kishte qëlluar për të vetmin qëllim të mbrojtjes së jetës së tij dhe të kolegëve të tij që ndodheshin në xhip. Karabinierët brenda xhipit, në fakt gjendeshin në një situatë rreziku shumë të afërt dhe përdorimi i Beretës së tij, në atë moment, ishte e vetmja mënyrë për të mbrojtur veten. Fakti që për fat të keq e shtëna plagosi për vdekje një person nuk do të thotë se veprimi mbrojtës ishte i tepruar ose joproporcional. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte absolutisht i nevojshëm "për të garantuar mbrojtjen e çdo personi nga dhuna e paligjshme". Në këto rrethana dhe për këto arsye, Gjykata vlerësoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës nga ky këndvështrim. Gjykata vlerësoi në vijim se ishte e panevojshme të përcaktohej nëse përdorimi i forcës ishte i nevojshëm për të "shtypur, në përputhje me ligjin, një trazirë ose një kryengritje", në kuptimin e dispozitës së nenit 2.

*ii. në lidhje me ekzistencën e një kuadri të përshtatshëm legjislativ dhe rregullator*

12. Kërkuesit u ankuan gjithashtu se nuk kishte pasur një kuadër legjislativ, administrativ dhe rregullator të përshtatshëm për të mbrojtur jetën e demonstruesve. Gjykata vë re se GIP, kur vendosi të pushonte çështjen, i është referuar shprehimisht, si bazë ligjore për përdorimin e forcës nga M.P., neneve 52 dhe 53 të Kodit Penal Italian, të titulluara respektivisht "mbrojtje legjitime" dhe "përdorimi i ligjshëm i armëve". Gjykata thekson se, edhe pse formulimi i këtyre nuk është identik me atë të tekstit të nenit 2 të Konventës, ato pa dyshim i referohen parimeve bazë të kësaj dispozite, duke pasur parasysh këtu edhe interpretimin që iu kanë bërë gjykatat kombëtare. Për këtë arsye Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës edhe nga kjo pikëpamje.

13. Kërkuesit pretendojnë gjithashtu se forcat e rendit nuk duhet të ishin pajisur

me armë të vinin në rrezik jetën e njeriut. Në këtë drejtim, Gjykata kujton se vdekja e Carlo Giuliani ka ndodhur në kuadër të një sulmi të dhunshëm kundër karabinierëve dhe jo gjatë një operacioni të kontrollit dhe shpërndarjes së demonstruesve. Konventa, siç është interpretuar nga Gjykata, nuk përmban asnjë rregull i cili ndalon forcat e rendit që të përdorin armët e zjarrit për të përballuar situata të ngjashme. Përsa i përket pastaj argumentit të kërkuesve se policia kishte përdorur shkopinj gome, përdorimi i të cilave nuk parashikohej nga aktet në fuqi, Gjykata arriti në përfundimin se nuk dukej të kishte ndonjë lidhje mes këtij pretendimi dhe vdekjes së Carlo Giuliani. Për këto arsye Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 2 nga shteti italian, as në këtë këndvështrim.

*iii. Në lidhje me pretendimin për mangësi në organizimin e operacioneve nga forcat e rendit*

14. Kërkuesit pretenduan se ka pasur mangësi të thella në organizimin e operacioneve të kryera nga forcat e rendit dhe gabime të rënda veçanërisht në lidhje me kriteret e përzgjedhjes të forcave policore të pranishme gjatë ngjarjeve të G8, të reflektuar edhe në gjendjen psikologjike dhe fizike të karabinierit të ri M.P. si dhe në mungesën e përvojës së tij. Ata ngritën gjithashtu pretendimin se Carlo Giuliani, pas të shtënave, nuk ka marrë asnjë ndihmë.

15. Dhoma e Madhe vërejtë së pari se, incidenti në fjalë kishte ndodhur në një kontekst më të gjerë ngjarjesh relativisht më të qeta, dhe nuk ishte e parashikueshme që një sulm i tillë i dhunshëm të ndodhte në atë vend dhe në ato rrethana. Gjykata vuri re se shumë prej forcave të rendit në vendin e ngjarjes, duke përfshirë edhe M.P., kishin marrë trajnim të specializuar dhe nënvizon se, duke pasur parasysh numrin e madh të forcave të rendit të përfshira në operacion, të pranosh që duhet të ishin përdorur vetëm forca të specializuara për këto lloj situatash do të thotë që t'i vendosësh Shtetit një detyrim joproporcional dhe jorealit. Ky pretendim, sipas Gjykatës, mund të pranohet në rastet kur forcat e rendit përballen me një objektiv të caktuar, por jo në hipotezën kur këto forca përdoren për ruajtjen e rendit. Gjithashtu, Gjykata konstaton se gjendja psikologjike dhe fizike e M.P. nuk ishte i tillë sa që atij t'i kërkohej të dorëzonte armën e tij, si i vetmi mjet për mbrojtjen e sigurisë së tij fizike. Së fundi, asnjë element që iu vu në dispozicion Gjykatës nuk ishte në gjendje të provonte se Carlo Giuliani nuk kishte marrë ndihmën e duhur pas të shtënave ose që F.C. kishte kaluar me qëllim me xhip mbi trupin e tij. Dëmtimet që ai kishte pësuar në tru ishin aq serioze sa i kanë shkaktuar vdekjen brenda pak minutash. Për këto arsye, Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës përsa i përket organizimit të operacioneve të ruajtjes së rendit, në Piazza Alimonda në Xhenova gjatë G8.

*iv. Në lidhje me detyrimet procedurale sipas nenit 2*

16. Kërkuesit pretenduan së fundmi se shteti italian nuk ka përmbushur, në disa aspekte, detyrimet procedurale sipas nenit 2. Gjykata konstatoi se procesi hetimor ka qenë aq efektiv dhe i një natyre sa të mund të përcaktonte nëse



përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte i justifikuar në këtë rast dhe në qoftë se organizimi i forcave të rendit ishte në përputhje me detyrimin për të mbrojtur jetën e personave të pranishëm. Gjykata çmon se, edhe pse kërkuesit nuk kanë qenë në gjendje të dalin si palë civile në procesin penal<sup>45</sup>, legjislacioni italian u ka mundësuar atyre t'i mbronin interesat e tyre legjitime, për shembull me angazhimin e ekspertëve të cilët mundën të marrin pjesë në fazën hetimore dhe në disa teste balistike. Ata kishin gjithashtu mundësinë për të kundërshtuar vendimin e pushimit të hetimit, sipas nenit 410 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas Gjykatës fakti që kundërshtimi nuk ishte pranuar nuk përbën në vetvete shkelje të nenit 2, sidomos duke pasur parasysh që vendimi i GIP nuk duket të ketë qenë, sipas mendimit të Gjykatës, arbitrar.

17. Ajo shtoi se kërkuesit nuk kanë paraqitur prova të mjaftueshme në lidhje me pretendimin se se autopsia ka pasur mangësi dhe e konsiderojnë si të parëndësishme për vlerësimin e efektivitetit të hetimit, problemin e ciftës së plumbit që u gjet në kafkën e Carlo Giuliani. Për më tepër, përfundimi i autoriteteve italiane sipas të cilit shkaku i vdekjes ishte e shtëna nga M.P., nuk ishte kundërshtuar. Në lidhje me djegien e trupit të Carlo Giuliani, Gjykata vëren se ai ishte i autorizuar me kërkesë të vetë kërkuesve.

18. Së dyti, në lidhje me pavarësinë e hetimit, Gjykata vlerësoi se caktimi nga prokuroria i një eksperti nuk ishte i tillë në vetvete që të cenonte pavarësinë e hetimit, pasur parasysh detyrat që ai kreu, rolin e tij dhe faktin që ishte vetëm një ndër katër ekspertët e caktuar.

19. Së fundi, Gjykata konsideroi se pavarësia e personave të përfshirë në hetime ishte përtej çdo dyshimi dhe se gatishmëria e tyre për të hetuar ishte më se e qartë në sytë e saj, duke pasur parasysh që hetimi paraprak ka zgjatur një vit e katër muaj. Gjykata nga ana e saj nuk ishte e mendimit se autoritetet hetimore i kanë pranuar pa rezerva argumentet e karabinierëve të përfshirë në këtë ngjarje. Në këtë drejtim ajo konstatoi se ishin marrë në pyetje dëshmitarë të shumtë dhe ishin bërë një sërë analizash mjekësore dhe testesh balistike. Për këto arsye ajo arrin në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës as në aspektin procedural.

### **B. Në lidhje me nenin 3**

20. Gjykata e konsideron të panevojshme për të shqyrtuar veprimin në lidhje me nenin. 3.

### **C. Në lidhje me nenet 6 dhe 13**

21. Kërkuesit pretenduan se nuk kishte pasur në këtë rast hetime që respektonin kriteret e parashikuara nga nenet 6 dhe 13 të Konventës. Në lidhje me këto pretendime, Gjykata e vlerëson të përshtatshme ta shqyrtojë çështjen vetëm nën

45 Bëhet fjalë për pamundësinë e kërkuesve që të dilnin si palë civile që gjatë seancave paraprake, në përputhje me nenin 79 të Kodit të Procedurës Penale i cili e parashikon një mundësi të tillë. Megjithatë në këtë rast nuk ka pasur asnjë seancë paraprake.



nenin 13. Ajo arrin në përfundimin se, edhe pse kërkuesit nuk kishin qenë në gjendje që të dilnin si palë civile në procesin penal, ata kishin pasur mundësi të bënin padi civile me objekt shpërblimin e dëmeve që rridhnin nga vdekja e Carlo Giuliani. Ata kishin pasur pra në dispozicion, sipas Gjykatës, një zgjidhje efektive që iu krijonte mundësi të mbronin të drejtat e tyre. Për këtë arsye Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

#### *D. Në lidhje me nenin 38*

22. Kërkuesit pretenduan se autoritetet shtetërore nuk kanë bashkëpunuar si dhe sa duhej, përderisa u kanë dhënë kërkuesve informacione të rremë ose jo të plota, në kundërshtim me nenin 38. Gjykata vendosi se, megjithëse informacioni i dhënë nga Qeveria italiane ka pasur mangësi në disa pika, kjo nuk e pengoi Gjykatën për ta shqyrtuar çështjen. Prandaj ajo vendosi se nuk ka pasur një shkelje të Konventës në këtë këndvështrim.

### **III. Koment**

23. Ky vendim i Dhomës së Madhe, i arritur me një shumicë jo shumë të madhe votash, ndjek në njëfarë mënyre llogjikën dhe reflekton debatin e zhvilluar edhe në nivel Dhome<sup>46</sup>. Në lidhje me çështjet kryesore që u shtruan përpara Gjykatës për zgjidhje në këtë çështje shumicat ishin 13 kundër 4 vota, në lidhje me ligjshmërinë e përdorimit të forcës nga karabinieri M.P. dhe 10 me 7 në lidhje me aspektet e tjera të nenit 2 të Konventës.

24. Ky vendim shpalos një analizë thujse tërësore të veprimit të së drejtës së jetës sipas nenit 2 të Konventës në situatat e protestave masive të cilat mund të degjenerojnë në dhunë dhe që fatkeqsisht mund të çojnë edhe në viktima. Analiza e Dhomës së Madhe fokusohet, ashtu si edhe Dhoma, në tre elementët thelbësorë strukturorë të kësaj dispozite, të cilat, siç mund të shihen edhe nga përmbledhja më sipër, janë tre: së pari, përdorimi i forcës vdekjeprurëse, së dyti, detyrimet pozitive të autoriteteve në lidhje me masat legjislative dhe administrative në kuadër të këtij neni dhe, së treti, detyrimet me karakter procedural në lidhje me hetimin e rrethanave dhe gjatjen e përgjegjësive.

25. Në lidhje me elementin e parë, që ishte edhe pretendimi prioritar i kërkuesve, se përdorimi i forcës nga ana e karabinierëve nuk kishte qenë "absolutisht i nevojshëm" për ndjekjen e objektivave të shpallura nga neni 2 § 2, i Konventës. Në lidhje me këtë ankesë, Gjykata Evropiane rikujtoi se neni 2 i Konventës përfshin jo vetëm situatat e vrasjeve të qëllimshme, por edhe situatat

46 Në vendimin e saj të 25.8.2009 një Dhomë e Seksionit IV të Gjykatës arriti në përfundimin se nuk kishte pasur shkelje të aspektit material të nenit 2 (njëzëri), se nuk kishte pasur shkelje të detyrimeve pozitive nga ana e Italisë (5 vota kundër 2), dhe se kishte pasur shkelje të aspekteve procedurale të nenit 2 në lidhje me hetimin (4 kundër 3). Gjyqtarët Bratza, Sikuta, Casadevall, Garlicki dhe Zagrebelski paraqitën të gjithë mendime individuale në raport me vendimin e shumicës, duke u bërë kështu thujse i pashmangshëm dërgimi i çështjes në Dhomë të Madhe sipas nenit 43 të Konventës.

e "përdorimit legjitim të forcës", nga e cila edhe mund të shkaktohen vdekja e personave. Gjykata thekson se përdorimi i forcës, që të jetë legjitim, duhet të jetë "absolutisht i nevojshëm" për arritjen e një prej objektivave të parashikuar nga neni 2 § 2, a), b) dhe c). Përveç kësaj, Gjykata rikujton se forca e përdorur duhet të jetë në mënyrë rigoroze në proporcion me objektivat e lejuar nga neni 2. Në këtë drejtim, Gjykata u shpreh se përdorimi i forcës nga agjentët e shtetit, për të arritur objektivat e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 2 të Konventës, mund të justifikohet në përputhje me këtë dispozitë, vetëm nëse ai është i bazuar në mirëbesim dhe që konsiderohet, për arsye të mirëqëna, si i vlefshëm në kohën e ngjarjeve, edhe pse më vonë mund të rezultojë të jetë i gabuar. Për të arritur në përfundimin nëse përdorimi i forcës justifikohet në rastin konkret Gjykata analizoi me kujdes faktet e çështjes. Ajo iu referua jo vetëm konstatimeve të gjykatave italiane, por në mënyrë të pazakontë në një procedurë përpara Gjykatës së Strasburgut ajo organizoi një sesion ku të gjithë anëtarët e Dhomës së Madhe ndoqën një pjesë të konsiderueshme të filmimeve që ekzistonin në lidhje me ngjarjet në Piazza Alimonda, dhe sidomos filmimet mbi momentet kritike objekt i kësaj çështjeje. Ajo i kushtoi rëndësi faktit se protesta ishte tepër e dhunshme, se kolegëve të karabinierit M.P. dhe vetë atij, iu kanosej një rrezik i menjëhershëm për jetën, se ai kishte qëlluar vetëm pasi kishte paralajmëruar dhe se nuk kishte një mjet tjetër mbrojtjeje ndaj sulmit të dhunshëm që po i bëhej. Katër gjyqtarët e pakicës kundërshtuan faktin se M.P. kishte parë një rrezik të menjëhershëm që i kanosej pasi ai kishte thënë se qëlloi në ajër. Për këtë arsye ata menduan se të shtënat nuk ishin absolutisht të nevojshme. Megjithatë është e diskutueshme, për mendimin tim, nëse testi "absolutisht i nevojshëm" në rrethana të tilla si këto të çështjes në fjalë, kur M.P. po sulmohej nga një grup personash dhe ishte i shtrirë në Jeep, kërkon domosdoshmërisht identifikimin e pagabueshëm të personit që paraqet rrezikun më të drejtpërdrejtë. Ky test mund të kërkohej në një situatë ku balanca e forcave është krejt e ndryshme, si p.sh. ajo në çështjet *McCann k. Mbretërisë së Bashkuar*, *Alikaj k. Italisë* apo *Armani da Silva k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>47</sup>. Duhet pasur parasysh gjithashtu se për Gjykatën nuk u provua përtej dyshimit të arsyeshëm se plumbi e kishte goditur drejtpërdrejt Carlo Giulianin dhe nuk kishte ndryshuar trajektore pasi kishte goditur një gur në ajër.

26. Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm i këtij vendimi është ai që ka të bëjë me detyrimet pozitive që kanë shtetet në kuadrin e nenit 2, në mënyrë që të shmangin sa më tepër të jetë e mundur humbjen e jetës. Këtë koncept, në këtë çështje, Gjykata e analizoi në dy këndvështrime, siç mund të shihet edhe nga përmbledhja e bërë më sipër<sup>48</sup>. Së pari Gjykata analizoi kuadrin legjislativ, administrativ dhe rregullator mbi përdorimin e dhunës nga forcat e rendit, dhe së dyti, planifikimin, organizimin dhe administrimin e operacioneve policore në

47 Shih gjithashtu vendimet *Solomou* dhe të tjerëk. Turqisë, nr. 36832/97, § 63, 24.06.2008, *Avşar k. Turqisë*, nr. 25657/94, § 391, *Musayev dhe të tjerë k. Rusisë*, nr. 57941/00, 58699/00 dhe 60403/00, § 142, 26.06.2007.

48 Pikat a) (ii) dhe a) (iii) të përmbledhjes.

mënyrë të pajtueshme me këtë detyrim pozitiv sipas nenit 2. Dhoma e Madhe u nda 10 me 7 në analizën e këtyre dy aspekteve. Pakica insistoi se forcat e rendit nuk duhet të ishin pajisur domosdoshmërisht me armë zjarri dhe se M.P. kishte qenë i patrajnuar sa duhet për situata të tilla<sup>49</sup>. Megjithatë, shumica i kushtoi rëndësi faktit që nuk dukej të kishte mangësi legjislative apo rregullatore të tilla që të ishin shkaktare për vrasjen e Carlo Giulianit, se autoritetet kishin hedhur në terren forca të shumta të ruajtjes së rendit, faktit që organizimi nuk dukej të kishte qenë i mangët në raport me të gjitha situatat e ngjashme të samiteve që degjenerojnë në dhunë dhe se do të ishte një barrë e tepërt për autoritetet që të dislokonin forca speciale në ngjarje të tilla me një numër tepër të madh protestuesish të dhunshëm<sup>50</sup>.

Po aq e diskutueshme ishte në gjirin e Gjykatës edhe çështja e aspekteve procedurale të nenit 2. Ky është një aspekt tepër i rëndësishëm për një mbrojtje efektive të së drejtës së jetës sipas nenit 2<sup>51</sup>. Në rastin konkret Gjykata analizoi këtë aspekt të nenit 2 në tre këndvështrime, pjesmarrjen e të afërmeve në procedura<sup>52</sup>, pavarësinë e procedurave hetimore<sup>53</sup> dhe efektivitetin e tyre<sup>54</sup>. Pavarësisht nga mangësi që mund të jenë vënë re, sidomos në raport me dy elementët e parë, sipas shumicës të Dhomës së Madhe ato ishin barazpeshuar nga garanci të tjera në proces dhe nuk kishin qenë të tilla sa të përbënin shkelje të nenit 2 nën aspektin procedural.

49 Në lidhje me përdorimin e armëve të zjarrit nga policia shih gjithashtu Perk dhe të tjerëk. Turqisë, n. 50739/99, § 60, 28.03.2006, dhe Bakan k. Turqisë, n. 50939/99.

50 Shih testin e përpunuar nga Gjykata në *L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 9.06.1998, § 36, dhe sidomos më *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, [DH.M.], 28.10.1998, § 115.

51 Shih p.sh. *Ilhan k. Turqisë*, Dhomë e Madhe, ECHR 2000-VII, ose *Silih k. Sllovenisë*, [DH.M.], 9 prill 2009, *Ergi k. Turqisë*, 28.06.1998, § 82, *Assenov dhe të tjerë k. Bullgarisë*, 28.10.1998, §§ 101-106, *Mastromatteo k. Italisë*, i përfshirë në këtë botim.

52 Shih *Paul dhe Andrew Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar*, 14.3.2002, i përfshirë në këtë botim, apo *Hugh Jordan k. Mbretërisë së Bashkuar*, n. 24746/94, 4.05.2001, § 109, e *Varnava e altri k. Turqisë* [DH.M.], nr.16064/90, 16065/90, 16066/90, 16068/90, 16069/90, 16070/90, 16071/90, 16072/90 e 16073/90, § 191, 18.09.2009.

53 Shih *Güleç k. Turqisë*, 27.07.1998, §§ 81-82, e *Oğur k. Turqisë* [DH.M.], n. 21594/93, §§ 91-92.

54 Shih *Yaşa k. Turqisë*, 2.07.1998, §§ 102-104, *Tanrikulu k. Turqisë* [DH.M.], n. 23763/94, § 109, e *Mahmut Kaya k. Turqisë*, n. 22535/93, §§ 106-107.

## ÇELNIKU kundër GREQISË

(kërkesa nr. 21449/04)

5 korrik 2007

*kjo çështje analizon organizimin e një operacioni policor për kapjen e një shqiptari të dyshuar si autor veprash penale në Athinë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkueset, Mirela Çelniku dhe motra e saj Raimonda Çelniku, janë shtetase shqiptare që kanë lindur respektivisht më 1976 dhe 1974 dhe jetojnë në Athinë. Në pasditen e 21 nëntorit 2001, oficeri i policisë së Athinës I.R. po ecte në qendër të qytetit të Athinës, kur iu bë e ditur nga një informator se, Gentian Çelniku, i njohur nga policia si "kinezi", ishte në afërsi të sheshit Amerika. Gentjan Çelniku, dyshohej se ishte përfshirë në një incident në të cilin persona të tjerë me origjinë shqiptare ishin plagosur rëndë, dhe mendohej se ai lëvizte gjithmonë i armatosur me një thikë. Pasi u vu në dijeni nga I.R., oficeri i policisë V., i shoqëruar nga tre policë të tjerë, mbërriti në afërsi të kafenesë ku i dyshuari dhe katër shtetas të tjerë shqiptarë mendohej se ishin.

2. Pasi morën autorizimin për kapjen e pesë individëve në fjalë dhe i kërkuan I.R. të mos merrte pjesë në operacion, V. dhe tre policët hynë në kafene dhe urdhëruan të dyshuarit të ngrinin duart lart dhe të shtriheshin në dysheme. z. Çelniku nuk u bind dhe u përpoq të fuste dorën poshtë xhupit të tij. Duke besuar se kolegët e tij ishin në rrezik, I.R. ndërhyri, duke shkuar drejt z. Çelniku me një armë zjarri në dorë. Kur ky i fundit e goditi I.R. me shkelm në dorën e djathtë, arma shkrepri duke qëlluar z. Çelniku në kokë, i cili vdiq në vend.

3. Në dëshminë e tij të nesërmen e ngjarjeve, I.R. tha se ai kishte vepruar instiktivisht për të mbrojtur kolegët e tij dhe se menjëherë pas shtënës fatale ai kishte parë një thikë në një pellg gjaku. Tre policët që kishin qenë të pranishëm thanë se I.R. e kishte gjetur thikën pasi kishte kërkuar në trupin e viktimës, gjë të cilën e pranoi edhe vetë I.R. më vonë. Me qëllim që të verifikohej nëse përdorimi i forcës kishte qenë i justifikuar filloi menjëherë një hetim administrativ. Në korrik 2003, bordi disiplinor i policisë vendosi se nuk kishte bazë për marrjen e masave disiplinore ndaj I.R. pasi vetëm viktimja kishte qenë përgjegjës për të shtënë fatale. Ndërkohë, ndaj I.R. ishte hapur procedimi penal për vrasje pa dashje. Në nëntor të vitit 2003 ai u shpall i pafajshëm me arsyetimin se e shtëna fatale nuk kishte qenë për shkak të neglizhencës së tij. Komiteti Grek i Helsinkit, duke vepruar në emër të kërkueseve, i kërkoi prokurorit që ta apelonte këtë vendim, por nuk pati sukses.

4. Kërkueset pretenduan, duke u mbështetur në nenet 2 dhe 13 të Konventës, se policët që shkuan të arrestonin vëllain e tyre kishin përdorur armë zjarri në mënyrë të tepruar e cila kishte çuar në vdekjen e tij dhe u ankuan se nuk kishte pasur një hetim efektiv në lidhje me faktet e çështjes. Ato pretenduan gjithashtu, në bazë të nenit 14, se ngjarjet në fjalë kishin qenë rezultat i qëndrimeve diskriminuese ndaj personave me origjinë shqiptare.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

*i. Mbi përdorimin e forcës vdekjeprurëse që çoi në vdekjen e z. Çelniku*

5. Gjykata vlerësoi se, nuk kishte para saj ndonjë element që ta bënte të vinte në pikëpyetje faktet e konstatuara nga gjykatat greke, dhe për këtë arsye mbajti qëndrimin se e shtëna fatale nuk ishte shkaktuar nga ndonjë veprim i qëllimshëm nga ana I.R. Prandaj, Gjykata vlerësoi se përdorimi i forcës vdekjeprurëse nuk i atribuohet shtetit grek.

*ii. Mbi organizimin e operacionit policor*

6. Gjykata vërejti në mënyrë të veçantë që, në kundërshtim me urdhërat e eprorit të tij V., polici I.R. i ishte afruar z. Çelniku duke mbajtur në dorën e tij të shtrirë armën e zjarrit. Në këtë mënyrë, me nismën e tij ai i dha mundësi reagimit të viktimës gjë që kishte sjellë si pasojë të shtënë fatale. Sipas mendimit të Gjykatës, fakti që situata kishte degjeneruar në një shkallë të tillë ishte akoma më e pafalshme për faktin se ky ishte një operacion i planifikuar nga ana e policisë, të cilin oficerët përkatës duhet të kishin qenë në gjendje ta përgatitnin me kujdes.

7. Gjykata ishte gjithashtu e ndërgjegjshme për faktin se, në kohën e ngjarjeve, përdorimi i armëve nga forcat e rendit rregullohej nga një legjislacion, i cili ishte pranuar si problematik dhe i papërshtatshëm në një shoqëri moderne demokratike. Kuadri ligjor në fuqi nuk iu jepte forcave të zbatimit të ligjit udhëzime dhe kritere të qarta në lidhje me përdorimin e forcës në kohë paqeje. Në këto rrethana, edhe pse vdekja e viktimës në vetvete nuk i atribuohet autoriteteve greke, mënyra në të cilën është kryer operacioni i policisë tregoi se policia nuk kishte marrë masat e duhura dhe nuk kishte treguar kujdesin e kërkuar në këto raste, për të siguruar që çdo rrezik për jetën e z. Çelniku dhe personat e tjerë të pranishëm në vendin e ngjarjes të kufizohej në minimum. Ata kishin qenë pra, të pakujdesshëm në kryerjen e veprimeve të tyre. Prandaj, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 2.

*iii. Mbi hetimin e vdekjes së Gentjan Çelnikut*

8. Gjykata vuri në dukje se autoritetet kishin treguar gatishmërinë e tyre për të kryer një hetim administrativ, për të përcaktuar nëse, përdorimi i forcës ishte i justifikuar në rrethanat përkatëse. Megjithatë, ka pasur probleme sa i përket pavarësisë dhe profesionalizmit të hetimit. Gjykata vërejti para së gjithash që

oficerët e policisë të ngarkuar me hetimin, i përkasin strukturës së policisë së Atikës, njësoj si edhe policët e përfshirë në incident. Sipas mendimit të Gjykatës, ky fakt cenonte pavarësinë e hetimit dhe dëmtonte besimin e publikut dhe të individëve që kanë një interes në kryerjen objektive të hetimit.

9. Gjykata u shpreh e habitur nga fakti që policët e përfshirë nuk kishin marrë hapat e duhur për të bërë izolimin e skenës së ngjarjes dhe për të mbledhur provat menjëherë pas incidentit. Së fundmi, Gjykata vuri re mungesën e rregullave dhe udhëzimeve mbi procedurat e qarta që duhen ndjekur nga oficerët e policisë në situata të tilla. Në këto rrethana, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 2 në rastin në fjalë, për shkak të mungesës së një hetimi të pavarur dhe efektiv. Në funksion të këtij konstatimi, Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme të shqyrtojë nëse ka pasur shkelje edhe të nenit 13.

### **B. Në lidhje me nenin 14**

10. Gjykata nuk e konsideroi të provuar "përtej dyshimit të arsyeshëm" se veprimet e policëve grekë në këtë rast ishin motivuar nga paragjykime raciale kundër personave me origjinë shqiptare. Prandaj ajo e shpalli ankesën sipas nenit 14 të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

11. Gjykata i akordoi kërkuueseve së bashku 4 010 euro për dëmin material, 20 000 euro për dëmin jomaterial dhe 5 000 euro për kostot dhe shpenzimet.

## **III. Koment**

12. Kur shqyrton rastet e përdorimit të forcës vdekjeprurëse nga ana e forcave të zbatimit të ligjit, Gjykata, jo vetëm që vlerëson nëse forca e përdorur ishte e arsyeshme, por edhe nëse operacioni ishte planifikuar në një mënyrë që të minimizonte vënien në rrezik të jetës së personave. Gjykata në këtë çështje bën dallimin me situatën në çështjen *Makaratzis k. Greqisë* përderisa në atë çështje situata ishte e paparashikuar, ndërsa në çështjen *Çelniku* policia greke kishte pasur mundësi të marrte masa paraprake planifikuese, organizative dhe operative në mënyrë që të ulte deri në minimum rrezikun për jetën e Gentjan Çelnikut<sup>55</sup>. Gjykata vlerësoi se, ky aspekt material i nenit 2 është shkelur në rastin në fjalë. Në këto raste Gjykata zbaton testin e "përtej dyshimit të arsyeshëm" dhe jo atë të "barazpeshës së mundësive", i pari duke qenë shumë më strikt si test sesa i dyti. Kur merret me shqyrtimin e pretendimeve se operacioni ishte i motivuar për arsye raciale, Gjykata sqaron se çfarë nënkuptohet me testin "përtej dyshimit të arsyeshëm". Ajo theksoi se ky test nuk kërkon që të arrihet shkalla afër bindjes, nivel i cili kërkohet kur bëhet fjalë për gjetjen fajtor në rastet penale.

55 Krahaso gjithashtu me rrethanat e çështjes në *Alikaj k. Italisë*, përfshirë në këtë botim.



13. Rasti gjithashtu ngriti një çështje interesante procedurale sipas nenit 35 § 2 (b), i cili nuk lejon që e njëjta ankesë t'i paraqitet më shumë se një organi juridiksional ndërkombëtar<sup>56</sup>. Organizata Botërore kundër Torturës, e cila përfaqësonte kërkueset në çështjen në Strasburg, kishte paraqitur ndërkaq një ankesë për vrasjen sipas procedurës ankimore 1503 këtij Komiteti të OKB-së. Gjykata vlerësoi se meqë identiteti i kërkueseve në rastin në fjalë nuk ka qenë i njëjtë me procedurën në Strasburg, dhe meqë procedura 1503 në OKB është konfidenciale dhe nuk i lejon kërkueset të marrin pjesë në procedurë, nisja e asaj procedure në lidhje me disa aspekte të vrasjes, nuk e përjashton Gjykatën nga shqyrtimi i çështjes.

## PAUL & AUDREY EDWARDS kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 46477/99)

14 mars 2002

*kjo çështje ka bërë me detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur të drejtën e jetës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit janë Paul dhe Audrey Edwards, të dy shtetas britanikë. Çështja ka të bëjë me vrasjen e djalit të tyre Christopher Edwards, në moshën 30 vjeçare.

2. Christopher Edwards, ndaj të cilit ishin bërë përpjekje që të diagnostikohesh si skizofren më 1991, u arrestua më 27 nëntor 1994 dhe u çua në një stacion policie. Kjo masë u mor sepse ai iu drejtohej grave të reja në rrugë dhe u bënte deklaratata jo normale. Më vonë ai u dërgua në paraburgim në burgun e Chelmsford-it, duke u lënë fillimisht vetëm në qeli.

3. Të nesërmen u fut në të njëjtën qeli (qelia D1 - 6) me Christopher Edwards edhe Richard Linford. Ky i fundit kishte qenë arrestuar më 26 nëntor 1994 për shkak se kishte sulmuar një mikun e vet si dhe fqinjën e këtij. z. Linford kishte pasur një histori të tërë sulmesh dhe raportesh të dhunshme, përfshirë këtu edhe një sulm që kishte bërë në një qeli në burg. Ai kishte qenë pranuar në një spital për të sëmurë mendorë më 1988 dhe në vijim ishte diagnostikuar si skizofren.

4. Çdo qeli në burg kishte nga një buton për një thirrje emergjence, i cili bënte që të ndizej një dritë jeshile përmbi derën e qelisë përkatëse si dhe aktivizonte një zile dhe një dritë të kuqe në panelin e kontrollit të katit përkatës duke treguar edhe qelinë ku ishte shtypur butoni.

56 Shih p.sh. *Folgero v Norvegjisë*, 27 qershor 2007.



5. Në orën 21.00 të datës 28 nëntor 1994, një oficer i burgut vuri re se butoni i qelisë D1-6 nuk po funksiononte siç duhej. Megjithatë ai nuk e raportoi defektin e vënë re. Pak para orës 01:00 të natës të 29 nëntorit 1994, oficeri i burgut përgjegjës për katin D dëgjoi një zhurmë zileje por nuk vuri re dritë të kuqe në panelin e kontrollit të katit D. Ai pa një oficer të burgut që shkoi të kontrollonte katet e tjera. Pas pak kohe ai dëgjoi goditje të vazhdueshme në derën e një qelie të katit të tij dhe kur shkoi të shihte se ç'bëhej, pa dritën jeshile jashtë qelisë D1-6. Kur oficerët e burgut hynë në qeli panë se Christopher Edwards kishte qenë goditur për vdekje me shkelma dhe grushte. Richard Linford pas kësaj vazhdonte të thoshte se kishte qenë pushtuar nga shpirtra dhe nga djalli.

6. Richard Linford u dënua nga Gjykata Mbretërore e Chelmsford-it pasi kishte pranuar se ishte fajtor për vrasjen e Christopher Edwards dhe këtë e pranoi duke e ditur se kishte zbutje dënimi. Ai është aktualisht në një spital të posaçëm i diagnostikuar sikur vuan paranojë skizofrenike. Në vijim të pranimit të fajtisë hetimi i Prokurorit të Mbretëreshës u mbyll.

7. Në korrik 1995, filloi një hetim jo zyrtar i rrethanave të ngjarjes, i cili paraqiti një raport më 15 qershor 1998. Raporti arrinte në përfundimin se parimisht, Christopher Edwards dhe Richard Linford nuk duhet të ishin futur në burg dhe se, për më tepër, ata nuk duhet të ishin lënë në të njëjtën qeli. Raporti konstatoi një "kolaps të sistemit të mekanizmave të mbrojtjes që duhet të kishin funksionuar" për të mbrojtur Christopher Edwards. Ai nxori në pah një sërë mangësish, përfshirë një mbajtje të pamjaftueshme të të dhënave dhe dosjeve, komunikim të papërshtatshëm ndërmjet organeve të ndryshme shtetërore (policisë, prokurorisë, dhe autoriteteve gjyqësore e të burgut).

8. Kërkuesit u këshilluan nga avokati i tyre që nuk kishte mjete ankimore të hapura në dispozicion të tyre nën dritën e konstatimeve të hetimit të lartpërmendur dhe, më 25 nëntor 1998, Shërbimi Hetimor i Kurorës Mbretërore (Prokuroria Britanike) mbajti qëndrimin se kishte prova të mjaftueshme për të proceduar me akuzë penale.

9. Kërkuesit ankoheshin, në mënyrë të veçantë, se autoritetet kishin dështuar në mbrojtjen e jetës të djalit të tyre. Ato bazoheshin në nenet 2, 6, 8 dhe 13 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

#### a. Detyrimi për të mbrojtur të drejtën e jetës

10. Që në fillim Gjykata vuri në dukje se, personat e ndaluar janë në një pozitë të dobët e të pambrojtur dhe se autoritetet kanë për detyrë që t'i mbrojnë ata. I takon shtetit që të përgjigjet për çdo cenim të pësuar gjatë periudhës së ndalimit dhe ky detyrim është veçanërisht strikt kur personi në fjalë vdes.

11. Si i burgosur që ishte, Christopher Edwards ishte nën përgjegjësinë e autoriteteve të cilat, në bazë të së drejtës së brendshme si edhe të Konventës kishin detyrimin për të mbrojtur jetën e tij. Gjykata, në radhë të parë, analizoi nëse autoritetet e dinin ose duhet ta dinin ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e Christopher Edwards, nga aktet e Richard Linford dhe, së dyti, nëse ata kishin dështuar në marrjen e masave brenda qëllimit të kompetencave të tyre të cilat, sipas një gjykimi normal, mund të ishin marrë për të mënjanuar rrezikun e lartpërmendur.

12. Gjykata u bind se kishte pasur informacion të disponueshëm i cili bënte të qartë se Richard Linford vuante nga sëmundje mendore dhe se kishte një të kaluar me akte me një nivel të tillë dhune, sa meritonte të propozohej që ai të mbahej në izolim dhe se kjo, së bashku me qëndrimin e tij të çuditshëm dhe të dhunshëm gjatë dhe pas arrestimit, nxirrte në pah se kishte pasur një rrezik real dhe serioz për Christopher Edwards kur Richard Linford u vendos në qelinë e tij.

13. Në lidhje me masat që autoritetet duhet të kishin marrë normalisht për të mënjanuar këtë rrezik, Gjykata vuri në dukje se informacioni mbi dosjen mjekësore të Richard Linford si dhe rrezikshmëria që rezultonte prej saj duhet t'u ishin bërë të njohura autoriteteve të burgut dhe në veçanti, personave të ngarkuar me vendimmarrjen nëse ai duhej çuar në Qendrën e Kujdesit Mjekësor apo në një qeli të zakonshme bashkë me të burgosur të tjerë. Dhe rezultonte që kjo nuk ishte bërë. Pra ka pasur një sërë mangësish në transmetimin e informacionit tek autoritetet e burgut dhe se shqyrtimi i dosjes së Richard Linford me arritjen e tij në burg ishte i mangët dhe i përciptë. Dilte qartë gjithashtu nga hetimi se ka pasur një sërë mangësish në lidhje me mënyrën si Christopher Edwards ishte trajtuar që nga momenti i arrestimit të tij, e deri në vendosjen e tij në qeli me një person tjetër.

14. Gjykata arriti në përfundimin se mangësitë e organeve të angazhuara në këtë çështje (mjekët, policia, prokuroria dhe gjykata) për të përcjellë informacionin në lidhje me Richard Linford tek autoritetet e burgut dhe karakteri i papërshtatshëm i procesit të shqyrtimit të dosjes vinte në dukje një shkelje të detyrimit të shtetit për të mbrojtur jetën e Christopher Edwards. Pra ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës.

*b. Detyrimi për të kryer një hetim efektiv*

15. Detyrimi për të mbrojtur jetën në kuadrin e nenit 2 të Konventës, i lexuar së bashku me detyrimin e përgjithshëm të shtetit në bazë të nenit 1 të Konventës që t'i "sigurojnë çdokujt që ndodhet në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin e I të kësaj Konvente" nënkupton gjithashtu që duhet të ketë ndonjë formë hetimi zyrtar efektiv në rastet kur individë kanë qenë vrarë si rezultat i përdorimit të forcës. Qëllimi kryesor i një hetimi të tillë është ai që të sigurohet zbatimi efektiv i legjislacionit të brendshëm që mbron të drejtën e

jetës dhe, në rastet që përfshijnë agjentët ose organet shtetërore, të sigurohet konstatimi i përgjegjësisë së tyre eventuale për vdekje që kanë ndodhur nën kontrollin e tyre. Forma që hetimi mund të marrë në përmbushje të këtyre qëllimeve mund të jetë e ndryshme në rrethana të ndryshme.

16. Gjykata vuri në dukje se nuk ishte bërë ndonjë hetim dhe se procedimi penal në përfundim të të cilit Richard Linford u dënua nuk konsistoi edhe në një proces gjyqësor, në të cilin të pyeteshin edhe dëshmitarët, për shkak se ai u deklarua fajtor për vrasje pa paramendim duke pretenduar edhe se ndaj tij kishte një raport mjekësor në bazë të të cilit ai duhet të rrinte i izoluar dhe nën kujdes.

17. Duke vlerësuar nëse hetimi në lidhje me kujdesin dhe trajtimin e Christopher Edwards dhe Richard Linford parashikonte edhe një procedurë hetimi efektiv, Gjykata vuri në dukje se gjatë hetimit ishin dëgjuar një numër i madh dëshmitarësh dhe se ishin rishikuar në detaje mënyrat se si dy personat ishin trajtuar nga autoritetet mjekësore, policore, gjyqësore apo ato të burgut. Raporti i hetimit, i cili arrinte në 338 faqe, përfshinte konstatime të shumta në lidhje me mangësi të ndryshme dhe bënte rekomandime për praktikën e ardhshme. Ai ishte një dokument i hollësishëm dhe Gjykata nuk ngurroi të mbështetej në të përta i përket vlerësimit të fakteve dhe problemeve të çështjes në fjalë.

18. Megjithatë ky hetim nuk kishte pasur kompetencë t'i detyronte dëshmitarët të paraqiteshin për të dëshmuar dhe për pasojë dy oficerë të burgut nuk u paraqitën, një nga të cilët kishte kaluar përpara qelisë pak kohë përpara se të ishte zbuluar vdekja. Gjykata konstatoi se mungesa e detyrueshmërisë së paraqitjes së dëshmitarëve, qoftë të atyre okularë, qoftë të atyre që kishin prova materiale në lidhje me rrethanat e vdekjes, e ulte vlerën e nivelit të hetimit në lidhje me përcaktimin e fakteve që kishin të bënin me vdekjen dhe, për pasojë, nuk arrinte të përmbushte një prej qëllimeve të kërkuara nga neni 2 i Konventës.

19. Hetimi u zhvillua gjithashtu në mënyrë private gjatë seancave të ballafaqimit të provave dhe të pyetjes së dëshmitarëve. Kërkesit nga ana e tyre kishin qenë në gjendje të ishin të pranishëm vetëm për tre ditë dhe vetëm kur ata po dëshmoni vetë. Ata nuk ishin përfaqësuar nga ndonjë avokat dhe nuk kishin pasur as ndonjë mundësi për t'u bërë ndonjë pyetje dëshmitarëve. Atyre iu desh të prisnin derisa të bëhej botimi i versionit përfundimtar të raportit hetimor për tu njohur me thelbin e provave mbi çka kishte ndodhur. Për këtë arsye Gjykata konstatoi se nuk mund të thuhet se ata kishin qenë përfshirë në procedura në masën e kërkuar për të mbrojtur interesat e tyre.

20. Gjykata arriti në përfundimin se, mungesa e kompetencës për të thirrur dëshmitarët dhe karakteri privat i procedurave nuk arrinin të përshtateshin me kërkesat e nenit 2 për kryerjen e një hetimi efektiv në lidhje me vdekjen e Christopher Edwards. Për këtë arsye ka pasur shkelje të detyrimit procedural të parashikuar nga ana e nenit 2 të Konventës.

**B. Në lidhje me nenin 13**

21. Neni 13 i Konventës parashikon mundësinë që të shfrytëzohet brenda vendit një mjet që të mund të vërë në zbatim thelbin e të drejtave dhe të lirive të parashikuara nga Konventa në pavarësisht nga forma që kjo mbrojtje mund të duhet marrë sipas rendit të brendshëm ligjor.

22. Gjykata vuri në dukje se, një padi me karakter civil për neglizhencë ose në bazë të Ligjit për Aksidentet me Pasoja Fatale, mund të ketë ofruar një mundësi për konstatimin e të dhënave të tilla që të mund të përcaktohej edhe përgjegjësia për vdekjen e Christopher Edwards. Megjithatë, ashtu siç nuk ishte e qartë nëse mund të ishin akorduar dëmet jomateriale ose nëse do të ishte dhënë ndihmë juridike, Gjykata nuk e gjeti këtë rrugë sigurimi të të drejtave si me përdorim praktik. Po njësoj, ndërsa dukej se nuk ishte e pamendueshme që mund të fillohej një çështje në bazë të Ligjit për të Drejtat e Njeriut të vitit 1998, kjo do të kishte qenë e mundur vetëm në lidhje me ndonjë shkelje të ndonjë detyrimi procedural në bazë të nenit 2 por pas 2 tetorit 2000 dhe nuk do të kishte lejuar pagimin e dëmeve për vdekjen e Christopher Edëards e cila kishte ndodhur përpara hyrjes në fuqi të ligjit të lartpërmendur. Gjykata kujtoi gjithashtu se hetimi – i cili nuk arriti të përputhej me detyrimin procedural të kërkuar nga ana e nenit 2 – nuk parashikoi asnjë mundësi për shpërblimin e dëmeve.

23. Për këto arsye Gjykata konstatoi se kërkuarit nuk kishin pasur mundësi të përdornin mjete të përshtatshme për të pasur një vendim në lidhje me pretendimet e tyre se autoritetet nuk kishin arritur të mbronin të drejtën e djalit të tyre për jetën ose mundësinë për të pasur një kompensim të drejtë për dëmin që ata kishin vuajtur – që është një element thelbësor për një mjet ankimor në bazë të nenit 13 për një prind që i ka vdekur fëmija. Për këtë arsye pra ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

**C. Në lidhje me nenet 6 dhe 8**

24. Gjykata vlerësoi se nuk dilnin në pah probleme të veçanta në bazë të Neneve 6 dhe 8.

**D. Në lidhje me nenin 41**

25. Gjykata i akordoi kërkuarëve 20 000 sterlina britanike për dëm jo-material dhe 20 000 sterlina britanike për shpenzime dhe pagesa ligjore.

**III. Koment**

26. Ky vendim është i fundit i një radhe vendimesh në lidhje me detyrimet pozitive që kanë shtetet, në veçanti në kuadrin e neneve 2 dhe 3 të Konventës.

27. Shtetet janë, së pari, të ndaluara që të bëjnë vrasje pa gjyq ose të lejojnë përdorimin e dhunës nga ana e policisë ose e oficerëve të burgjeve. Por Konventa ka gjithashtu edhe të ashtuquajturin “efekt horizontal”. Në kuptimin e këtij koncepti, shteti ka

një përgjegjësi edhe për të mbrojtur të drejtat e parashikuara nga Konventa nga shkeljet e kryera nga persona privatë dhe jo të veshur me pushtet ose kompetenca shtetërore. Testi i kryer nga Gjykata në çështjen *Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar*, me vendimin e saj të 28 tetorit 1998 dhe i zbatuar edhe në këtë çështje ka të bëjë pikërisht me faktin nëse autoritetet e dinin ose duhet ta dinin në kohë që ekzistonte një rrezik real dhe i menjëhershëm për jetën e një personi të identifikuar nga akte kriminale të një personi të tretë, dhe nëse ato kishin marrë të gjitha masat që në një mënyrë dhe masë të pritshme duhet të kishin marrë për të mënjanuar këtë rrezik.

28. Gjykata konstatoi gjithashtu që disa prej garancive procedurale që ajo i konsideronte si përbërëse të nenit 2 nuk kishin gjetur vend në rastin tonë. Mungesa e kompetencës për t'i detyruar dëshmitarët të paraqiten për të dëshmuar, mungesa e karakterit publik të procesit dhe moslejimi i mjaftueshëm i pjesëmarrjes së familjes së të ndjerit në proces, përbënin, të gjitha së bashku, shkelje të aspekteve procedurale të nenit 2.

## ANGUELOVA kundër BULLGARISË

(kërkesa nr. 38361/97)

13 qershor 2002

*autoritetet shtetërore janë në parim përgjegjëse për dëmet ndaj jetës dhe shëndetit të personave që ndodhen nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë*

### I. Faktet kryesore

1. Assya Anguelova është shtetase bullgare e lindur më 1959 dhe jeton në Razgrad. Çështja ka të bëjë me vdekjen e djalit të saj 17 vjeçar, Anguel Zabchekov, ndërkohë që mbahej në rajonin e policisë në Razgrad, pasi ishte arrestuar për tentativë vjedhje me dhunë.

2. Gjatë pasdites së vonë të 28 janarit 1996 z. Zabchekov ka qenë duke pirë pije alkoolike me pjesëtarë të familjes dhe miq të tij në një bar. Këta të fundit pohuan se ai kishte qenë në gjendje të mirë kur ata e kishin parë për herë të fundit nga ora 22:30 deri pak pas orës 23:30.

3. Pak pas mesnate z. Zabchekov ishte parë nga disa banorë të apartamenteve fqinjë, duke u sjellë rreth disa automjeteve "duke bërë diçka", gjë që bëri që ata të lajmëronin një polic, rreshterin Mutafov, i cili në atë kohë nuk ishte në shërbim por që ndodhej në atë zonë. Rreshteri Mutafov e ndoqi z. Zabchekov dhe pretendoi që ky i fundit e qëllloi disa herë në fytyrë ndërkohë që përpiqej t'ia mbathte. z. Zabchekov u arrestua dhe u mbajt në rajonin e policisë pak para orës 1 të mëngjesit. Nuk pati një regjistrim të rregullt të heqjes së lirisë së tij.

4. Diku pas orës 3 të mëngjesit, oficerët e policisë të rajonit përkatës njoftuan oficerët përgjegjës për arrestin – që në atë moment ishin në patrullim e sipër – që shëndeti i z. Zabchekov po përkeqësohej. Ata u kthyen në rajon për të parë gjendjen dhe pastaj u nisën për në spital, duke u kthyer me një mjek dhe një ambulancë. z. Zabchekov u çua në spital ku, rreth orës 5 të mëngjesit, mjeku i spitalit konfirmoi që ai kishte vdekur.

5. Për hetimin e vdekjes u hap një dosje hetimore. Autopsia e bërë më 29 janar 1996 përcakttoi se ai kishte vdekur si rezultat i një frakture të kafkës, të cilën ai e kishte pësuar përafërsisht katër deri në gjashtë orë përpara vdekjes. Më vonë u paraqit një raport i dytë i bazuar vetëm në provat dokumentare, i cili, sidoqoftë, arriti në përfundimin se dëmtimi i z. Zabchekov duhet të kishte ndodhur të paktën 10 orë përpara vdekjes së tij. Në bazë të këtij raporti, hetimi u mbyll, mbi bazën e asaj që nuk kishte lidhje ndërmjet veprimeve të policisë dhe vdekjes së z. Zabchekov. Kërkuesja apeloj, por pa sukses. Një hetim shtesë u pezullua me argumentimin se ishte e pamundur të përcaktohej se si ishin shkaktuar dëmtimet ndaj z. Zabchekov.

6. Kërkuesja pretendoi se djali i saj vdiq pasi ishte keqtrajtuar nga ana e oficerëve të policisë, që policia nuk kishte arritur t'i ofronte trajtimin e duhur mjekësor për dëmtimet e tij dhe se autoritetet nuk kishin arritur të ndërmerrnin një hetim efektiv, gjë që ishte në kundërshtim me nenet 2 dhe 3 të Konventës (e drejta për jetën dhe ndalimi i torturës, trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese). Ajo pretendoi gjithashtu, në bazë të nenit 5, se ndalimi i djalit të saj ishte i paligjshëm, se ajo nuk kishte parur mundësi të përdorte një mjet efektiv për qëllimet e nenit 13 dhe se ka parur diskriminim mbi bazën e origjinës rome të djalit të saj, gjë që ishte në kundërshtim me nenin 14 (ndalimi i diskriminimit).

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

#### *i. Keqtrajtimi nën mbikëqyrjen e policisë*

7. Gjykata vuri në dukje se z. Zabchekov vdiq pasi ishte mbajtur për disa orë me radhë në rajonin e policisë së Razgrad-it dhe se raporti i parë mjeko-ligjor kishte vlerësuar se dëmtimi i kafkës së tij kishte ndodhur ndërmjet katër dhe gjashtë orëve përpara vdekjes së tij, pra mundet edhe gjatë kohës kur ai mbahej nga policia, qoftë përpara, qoftë pasi është çuar në rajon.

8. Gjykata vlerësoi gjithashtu edhe përfundimet e raportit të dytë mjeko-ligjor, sipas të cilit dëmtimet kishin ndodhur të paktën 10 orë përpara vdekjes së z. Zabchekov. Raporti ishte bazuar në një analizë vizuale të fotografive të mpiksjeve të gjakut të marra gjashtë orë pas vdekjes së z. Zabchekov. Ato ndryshonin në mënyrë të ndjeshme nga përfundimet e raportit të parë, të cilat ishin bazuar në vëzhgime të drejtpërdrejta të kufomës, dhe nuk shpjegonin përse. Në qoftë se z. Zabchekov ishte



dëmtuar përpara orës 19.00 të datës 29 janar 1996, atëherë do të thoshte se ai kishte shkuar të pinte me shokët dhe pastaj kishte vendosur të vidhte pjesë makinash ndërkohë që vuante nga një frakturë e kafkës – kjo dukej e pamundur.

9. Pretendimi i qeverisë se z. Zabchekov mund edhe të ishte plagosur duke rënë përtokë – përderisa ai ishte i pirë dhe kishte një histori me probleme shëndetësore – nuk mbështetet nga provat mjeko-ligjore.

10. Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat konkrete, Gjykata e vlerësoi si të papranueshëm shpjegimin e qeverisë në lidhje me vdekjen e z. Zabchekov, që bazohej në përfundimin e raportit të dytë mjeko-ligjor përse i përket kohës së plagosjes dhe supozimit se djali mund të ishte dëmtuar vetë duke u rrëzuar përtokë. Për këto arsye Gjykata gjeti shkelje të nenit 2 të Konventës.

*ii. Në lidhje me pretendimin për mungesë të ofrimit në kohë të kujdesit mjekësor*

11. Gjykata vuri në dukje se policia ishte vonuar në ofrimin e ndihmës mjekësore ndaj z. Zabchekov. Raporti i parë mjekësor dhe i ekspertit që u paraqit nga ana e kërkueses, gjeti se vonesa në sigurimin e ndihmës mjekësore kishte qenë fatale.

12. Gjykata pra konstatoi se sjellja e policëve ndërmjet orës 3 dhe 5 të mëngjesit të 29 janarit 1996 si dhe vonesa e çdo reagimi nga ana e autoriteteve përbënte një shkelje të detyrimit të shtetit për të mbrojtur jetën e atyre që ishin në gjendje ndalimi. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 2 § edhe në këtë drejtim.

*iii. Në lidhje me pretendimin për hetim joefektiv*

13. Gjykata vuri në dukje një numër mangësish në procesin hetimor të çështjes në fjalë. Në asnjë moment policët nuk ishin pyetur se përse regjistri i ndalimeve kishte qenë falsifikuar, se përse ata nuk kishin thirrur një ambulancë në çast apo përse ata i kishin dhënë informacione të rreme mjekut të spitalit. Dëshmia e policëve ishte konsideruar plotësisht e besueshme, pavarësisht nga qëndrimi i tyre i dyshueshëm. Për më tepër, pa mbajtur parasysh kontradiktat e hapura ndërmjet dy raporteve mjekësore, autoritetet pranuan përfundimet e raportit të dytë pa kërkuar të qartësoheshin mospërputhjet ndërmjet dy raporteve.

14. Për këto arsye, Gjykata konstatoi se, hetimi nuk kishte qenë as objektiv dhe as i plotë. Pra ka pasur shkelje të nenit 2 § 1 të Konventës në lidhje me moskryerjen e një hetimi efektiv për vdekjen e z. Zabchekov.

### ***B. Në lidhje me nenin 3***

15. Duke pasur parasysh se qeveria nuk ka parashtruar një shpjegim të pranueshëm përse i përket dëmtimeve trupore të z. Zabchekov (goditje në trung, fytyrë dhe krahun e djathtë) dhe se këto dëmtime ishin tregues të një trajtimi që binte poshtë ashpërsisë të lejuar në bazë të nenit 3, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.



**C. Në lidhje me nenin 5**

16. Nuk u diskutua aspak që ndalimi i z. Zabchekov nuk ishte bazuar në një urdhër me shkrim siç kërkohet nga seksioni 35 i Ligjit për Policinë e Shtetit .

17. Gjykata mbajti parasysh deklarinimin e kërkueses që, duke u përpjekur që të fshihnin faktin e ndalimit të djalit të saj, informacioni i parë që i kishte dhënë policia familjes mbi vdekjen e tij nuk i ishte referuar fare ndalimit. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se ndalimi i z. Zabchekov nuk ishte regjistruar rregullisht në fillim dhe se në vijim regjistri në rajonin e policisë ishte falsifikuar.

18. Mungesa e një urdhri me shkrim dhe i një regjistrimi të rregullt të ndalimit të Z. Zabchekov ishin të mjaftueshëm që Gjykata të konstatonte që mbajtja e tij për disa orë në rajonin e policisë më 29 janar 1996 ishin në shkelje të së drejtës së brendshme dhe në kundërshtim me kërkesat që rrjedhin nga neni 5 për një regjistrim të rregullt të të gjitha rasteve të privimit të lirisë.

**D. Në lidhje me nenin 14**

19. Gjykata konstatoi se, megjithëse pretendimet e kërkueses për diskriminim ishin bazuar në argumente seriozë, ishte e pamundur për të që të arrinte në përfundimin se këto pretendime ishin provuar plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Pra nuk ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës.

20. Në një mendim pjesërisht të kundërt me shumicën, gjyqtari Bonello shpjegoi se përse ai nuk ishte dakord me shumicën në këtë pikë. Ai kritikoi me forcë faktin që Gjykata, në më se 50 vjet vlerësim gjyqësor, nuk kishte gjetur, deri në këtë datë, një rast shkelje të së drejtës për të jetuar (neni 2) ose të së drejtës për të mos iu nënshtruar torturës apo trajtimeve ose dënimeve çnjerëzore (neni 3) të ardhura si shkak i racës, ngjyrës ose vendit të origjinës së viktimës. Arsyeja për këtë, sipas gjyqtarit Bonello, është rregulli që Gjykata i ka imponuar vetes se standardi i provës i kërkuar nga ana e Konventës është “prova përtej një dyshimi të arsyeshëm”. Gjyqtari Bonello mbronte pikëpamjen se ky standard ishte i pabazuar dhe, në praktikë, i paarritshëm.

**E. Në lidhje me nenin 41**

21. Gjykata i akordoi kërkueses 19 050 euro për dëm jomaterial dhe 3 500 euro për shpenzime dhe pagesa.

**III. Koment**

22. Dy aspekte të këtij rasti tragjik meritojnë vëmendje të veçantë. Së pari, Gjykata ka ritheksuar rëndësinë e regjistrimeve me shkrim të detajuara dhe të menjëhershme nga ana e policisë kur ata privojnë një person nga liria qoftë me anë të arrestimit, qoftë të ndalimit të tij. Regjistrimet e sakta të vendit, datës dhe orës së ndalimit si dhe emri, në qoftë se dihet, i të ndaluarit si dhe gjendja e tij

shëndetësore, emri i policit që e ndalon dhe arsyet për ndalimin janë elementë të detyrueshëm. Mosmbajtja e regjistrimeve të tilla në vetvete përbën shkelje të nenit 5 si në “mospërputhje me vetë qëllimin” e këtij neni. Këto të dhëna janë thelbësore jo vetëm për të parandaluar një qëndrim arbitrar përsa i përket kohëzgjatjes së një ndalimi të ligjshëm i cili bëhet i mundur pikërisht nga një regjistrim jo i rregullt i ndalimeve ose arrestimeve, por edhe për të siguruar që ekziston një informacion i besueshëm të raste kur ka pretendime për keqtrajtime gjatë heqjes së lirisë.

23. Së dyti, mendimi i kundërt mjaft i frymëzuar i gjyqtarit Bonello përfaqëson të gjithë atë mendim juridik që e ka pranuar mundësinë e keqtrajtimeve për shkaqe raciale. Gjyqtari Bonello kritikon në fakt Gjykatën për refuzimin e saj të vazhdueshëm për të konstatuar shkelje të nenit 14 në lidhje me nenet 2 ose 3 pavarësisht se sa të besueshme mund të jenë të dhënat që venë në dukje qëndrime të tilla si arsye për shkaktimin e trajtimit të ndaluar.

24. Ky vendim pati vlerat e veta imediate edhe në praktikën shqiptare. Rasti Tahirllari, në qytetin e Korçës, dhe ndërhyrja e menjëhershme e Avokatit të Popullit dhe Prokurorisë së Korçës gjejnë në këtë vendim një referencë të qartë dhe të sigurt për veprimin e tyre në mbrojtje të së drejtës së jetës së një njeriu, në përputhje të plotë me standardet e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

## OPUZ kundër TURQISË

(kërkesa nr. 33401/02)

9 qershor 2009

*ky është një vendim tepër i rëndësishëm i Gjykatës në lidhje me dhunën në familje dhe për detyrimet që i lindin autoriteteve shtetërore në raste të tilla*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Nahide Opuz, është një shtetase turke që ka lindur në vitin 1972 dhe jeton në Turqi. Në vitin 1990, zonja Opuz filloi të jetonte me H.O., djalin e bashkëshortit të nënës së saj. Zonja Opuz dhe H.O. u martuan në nëntor 1995 dhe patën tre fëmijë në vitet 1993, 1994 dhe 1996. Çifti kishte probleme serioze në marrëdhënien e tyre që në fillim të marrëdhënies dhe tashmë janë të divorcuar.

2. Në periudhën mes prillit 1995 dhe marsit 1998, ka pasur katër incidente për shkak të sjelljes së dhunshme dhe kërcënuese të H.O. kundrejt kërkueses dhe nënës së saj, incidente që iu bënë të ditura edhe autoriteteve. Këto incidente

përfshinin disa rrahje, një grindje të ashpër, gjatë së cilës H.O. nxorri edhe thikën, si edhe faktin se H.O. përdori makinën e tij për të goditur të dy gratë. Pas kësaj dhune të përsëritur, gratë u kontrolluan nga doktorët, raportet e të cilëve dëshmonin për dëmtimet e ndryshme, përfshirë këtu gjakosjet, të nxirat, gungat dhe gërvishtjet. Të dy gratë u çertifikuan nga mjeku se kishin marrë dëmtime që u vinin në rrezik jetën; kërkuesja si rezultat i një të rrahure veçanërisht të dhunshme dhe mamaja e saj pas goditjes me makinë.

3. Ndaj, H.O. nisi procedimi penal për tre prej këtyre rasteve për kërcënim për jetën, dëmtim të rëndë e të përsëritur të trupit dhe tentativë për vrasje. Për sa i përket incidentit me thikë, u vendos që të mos hetohej për mungesë provash. H.O. u arrestua dy herë dhe po kaq herë u vendos të hetohej në gjendje të lirë.

4. Megjithatë, kur kërkuesja dhe mamaja e saj tërhoqën paditë e tyre, gjykatat e brendshme i pushuan çështjet, për arsye se procedimi nuk mund të vazhdohej kryesisht sipas Kodit Penal nëse tërhoqeshin paditë. Megjithatë, procedimi në lidhje me incidentin me makinë ndaj nënës të kërkueses vazhdoi, duke parë dëmtimet e rënda të pësuar prej saj dhe H.O. u dënua me tre muaj burg, dënim që më vonë iu konvertua në gjobë.

5. Më 29 tetor 2001, kërkuesja u godit shtatë herë me thikë nga H.O. dhe u dërgua në spital. H.O. u dënua për sulm me thikë dhe mori një tjetër gjobë prej thujase 840 mijë lirash turke (rreth 385 euro), shumë të cilën mund ta paguante me tetë këste. Pas këtij incidenti, mamaja e kërkueses bëri një kërkesë që H.O. të mbahej në gjendje arresti, duke kujtuar se në disa raste të mëparshme ajo dhe vajza e saj ishin detyruar të tërhoqnin kallëzimet kundër tij për shkak të presionit të pareshtur dhe kërcënimeve për jetën e tyre.

6. Më në fund, më 11 mars 2002, mamaja e kërkueses, pasi kishte vendosur të shpërngulej në Izmir me vajzën e saj, po udhëtonte në furgonin e mbushur me mobiljet e shtëpisë, kur H.O. e detyroi automjetin të hapte krahun, hapi dorën e pasagjerit dhe e vrau gruan me armë zjarri. Mamaja e kërkueses vdiq në vend.

7. Më mars 2008, H.O. u dënua për vrasje dhe armëmbajtje pa leje. Ai u dënua me burgim të përjetshëm dhe u lirua gjatë procedurës në apel. Në prill 2008, kërkuesja paraqiti një tjetër kallëzim penal pranë prokurorisë, duke i kërkuar që të merrnin masa për ta mbrojtur atë, meqenëse pas liritimit ish-bashkëshorti i saj kishte filluar ta kërcënonte përsëri. Në maj dhe nëntor 2008, përfaqësuesi i kërkueses informoi Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut se nuk ishte marrë ende asnjë prej masave të kërkuara dhe Gjykata kërkoi shpjegim. Pas kësaj, autoritetet turke morën masa specifike për ta mbrojtur kërkuesen, si për shembull, duke shpërndarë fotografinë e ish-burrit të saj dhe gjurmët e tij të gishtërinjve në të gjitha stacionet e policisë me urdhrin për ta arrestuar, në rast se do të vëzhgohej pranë vendit të rezidencës së kërkueses.

8. Në janar 1998, në Turqi hyri në fuqi Akti për Mbrojtjen e Familjes, që parashikonte masa specifike për mbrojtjen kundër dhunës në familje.

## II. Vendimi i Gjykatës

9. Kërkuesja pretendoi se autoritetet turke kishin dështuar në mbrojtjen e së drejtës për jetë të nënës së saj dhe se ato ishin treguar neglizhente përballë përsëritjes së dhunës, kërcënimeve për vdekje dhe dëmtimeve, të cilat i kishte pësuar dhe ajo vetë. Kërkuesja u mbështet në nenet 2, 3, 6 dhe 13. Ajo u ankua gjithashtu, për mangësitë e ligjit turk për të mbrojtur gratë nga dhuna në familje, gjë që sipas saj binte ndesh me nenin 14.

### A. Në lidhje me nenin 2

*i) në lidhje me dështimin e autoriteteve për mbrojtjen e jetës së nënës së kërkueses*

10. Nën këtë aspekt, Gjykata përsëriti se detyra e shtetit sipas nenit 2 përfshin edhe detyrimin për të siguruar që e drejta për jetën të mos çenohet jo vetëm nga autoritetet por edhe nga individët e tjerë. Në analizën e këtij detyrimi Gjykata mori parasysh disa elementë. Së pari, ajo konstatoi se autoritetet e dinin, ose duhet ta kishin ditur në atë kohë, ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e kërkueses dhe të nënës së saj nga H.O. dhe për këtë arsye kishin përgjegjësi për të vepruar pozitivisht në përgjigje të thirrjeve të kërkueses dhe të nënës së saj se jetët e tyre ishin në rrezik. Në vijim, Gjykata vlerësoi se konsideroi se autoritetet nuk kishin arritur të merrnin masa brenda fushës së kompetencave të tyre, të cilat, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund të priteshin prej tyre për ta shmangur këtë rrezik. Ata nuk kishin marrë masa mbrojtëse kundër dhunës në familje, të parashikuara nga Ligji për Mbrojtjen e Familjes dhe nuk kishin urdhëruar që H.O. të mos ishte në kontakt me kërkuesen dhe nënën e saj. Gjykata pra, vlerësoi se dhuna e përshkallëzuar, në rastin e kërkueses, si për shembull, një sulm vdekjeprurës, jo vetëm që ishte i mundur, por edhe i parashikueshëm, duke parë historinë e sjelljes së dhunshme të H.O., precedentëve të tij penalë ndaj së shoqes dhe nënës së saj, si edhe kërcënimin e vazhdueshëm nga ana e tij për shëndetin dhe sigurinë e tyre.

11. Sipas praktikës së përbashkët juridike në shtetet anëtare, sa më serioze të jetë vepra penale ose sa më i madh të jetë rreziku për vepra penale të përshkallëzuara, aq më tepër duhet që ndjekja penale të vazhdojë kryesisht, në interes publik, edhe sikur viktimat t'i kenë tërhequr kallëzimet e tyre. Megjithatë, duke vendosur vazhdimisht për t'i pushuar procedimet kriminale kundër H.O., autoritetet i qenë referuar ekskluzivisht nevojës për t'iu shmangur ndërhyrjes në atë, që ato e perceptonin si një "çështje familjare". Me sa duket, autoritetet nuk i kishin marrë në konsideratë arsyet që qëndronin pas tërheqjes së kallëzimeve, megjithë deklaratat e nënës së kërkueses se ajo dhe vajza e saj kishin qenë të detyruara ta bënin këtë për shkak të kërcënimeve për vdekje dhe presionit të H.O. Gjykata e Strasburgut u shpreh se, pavarësisht nga tërheqja e kallëzimeve nga ana e viktimave, kuadri ligjor duhej t'i kishte dhënë mundësi organeve të akuzës që të

vazhdonin procedimin penal kundër H.O., për shkak se sjellja e tij e dhunshme kishte qenë aq serioze sa të përlligjte hetimet dhe se kishte pasur një kërcënim konstant për integritetin fizik të kërkuases.

12. Për pasojë, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kombëtare nuk kishin treguar kujdesin e duhur për të parandaluar dhunën ndaj kërkuases dhe nënës së saj, në veçanti duke marrë masa parandaluese penale apo të ndonjë lloji tjetër kundër H.O.

*ii) në lidhje me mungesën e një hetimi efektiv*

13. Gjykata kujtoi se në bazë të nenit 2 të Konventës autoritetet kanë për detyrë që të kryejnë një hetim efektiv për të zbuluar shkaqet e humbjes së jetës së një personi dhe për të vënë para drejtësisë përgjegjësit eventualë. Ajo theksoi se një detyrim i tillë përfshin edhe nevojën për procedura të menjëhershme dhe efektive. Në rrethanat e çështjes konkrete ajo konstatoi se procedurat penale në ngarkim të H.O. për vrasje, të cilën për më tepër e kishte pranuar vetë, kishin zgjatur ndërkaq për më shumë se gjashtë vjet dhe ishin ende përpara Gjykatës së Kasacionit. Në këto kushte këto procedura nuk mund të konsideroheshin si efektive. Për më tepër, sistemi ligjor penal nuk kishte pasur asnjë efekt parandalues në këtë rast. Për këto arsye, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 2 edhe nën këtë aspekt.

### ***B. Në lidhje me nenin 3***

14. Gjykata vlerësoi se reagimi i autoriteteve ndaj sjelljes së H.O. kishte qenë haptazi i papërshtatshëm, duke parë seriozitetin e kërcënimeve të tij. Vendimet gjyqësore, të cilat nuk kishin ofruar asnjë masë të dukshme ndaluese ose ndonjë efekt parandalues ndaj H.O., kishin qenë të paefektshme dhe madje shfaqnin njëfarë tolerance kundrejt veprimeve të tij. Veçanërisht, pas incidentit me makinë, H.O. kishte ndenjur vetëm 25 ditë në burg dhe ishte ndëshkuar vetëm me gjobë për dëmtimet e rënda që i kishte shkaktuar nënës së kërkuases. Edhe më e habitshme ishte se si ndëshkim për goditjen shtatë herë me thikë të kërkuases, ai mori thjesht një gjobë të vogël, të cilën mund ta paguante me këste.

15. Gjykata konstatoi se deri në janar 1998, kohë kur edhe hyri në fuqi Ligji për Mbrojtjen e Familjes, legjislacioni turk nuk ofronte masa specifike administrative dhe policore për të mbrojtur personat e brishtë nga dhuna në familje. Madje edhe pas kësaj date, autoritetet turke nuk i kishin aplikuar me efektivitet ato masa e sanksione në mbrojtje të kërkuases.

16. Në përfundim, Gjykata vërejti me shqetësim të madh se dhuna e pësuar nga kërkuësja në fakt nuk kishte marrë fund dhe se autoritetet vazhdonin të tregoheshin pasive. Megjithë kërkesën e kërkuases në prill 2008, asgjë nuk u bë deri kur Gjykata i kërkoi Qeverisë që t'i paraqiste informacion mbi masat që autoritetet kishin marrë në mbrojtje të kërkuases.

17. Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 3 për shkak të dështimit të autoriteteve për të marrë masa mbrojtëse në formën e ndalimit efektiv të cënimeve serioze të integritetit personal të kërkueses të pësuar nga ana e ish-bashkëshortit të saj.

### *C. Në lidhje me nenin 14*

18. Sipas raporteve të depozituara nga kërkuesja, të cilat u përpiluan nga dy organizata të rëndësishme të shoqërisë civile dhe që nuk u kundërshtuan nga Qeveria, numri më i lartë i viktimave të dhunës në familje ishte pikërisht në Diarbakir, ku kishte jetuar edhe kërkuesja në kohën kur ndodhën ngjarjet. Të gjitha viktimat ishin gra, shumica e të cilave me origjinë kurde, analfabete ose me një nivel të ulët arsimimi dhe në përgjithësi pa ndonjë burim të pavarur të ardhurash. Në fakt, raportet sugjeronin se dhuna në familje tolerohej nga autoritetet dhe se mjetet ankimore të treguara nga Qeveria nuk funksiononin në mënyrë efektive.

19. Për rrjedhojë, Gjykata konsideroi se kërkuesja kishte qenë në gjendje të vërtetonte se dhuna në familje prekte kryesisht gratë dhe se pasiviteti diskriminues dhe i përgjithshëm nga gjykatat turke kishte krijuar një klimë që favorizonte dhunën në familje. Duke pasur parasysh këtë, dhuna e pësuar nga kërkuesja dhe mamaja e saj mund të konsiderohej si e bazuar tek gjinia, që përbënte një formë të diskriminimit kundër grave. Megjithë reformat e ndërmarra nga Qeveria në vitet e fundit, mungesa e përgjithshme e reagimit nga ana e sistemit gjyqësor dhe mosndëshkikimi i dhunuesve, siç u vërtetua në rastin e kërkueses, treguan se kishte angazhim të pamjaftueshëm në marrjen e masave të duhura për të zgjidhur problemin e dhunës në familje. Për pasojë, Gjykata mbërriti në përfundimin se kishte pasur një shkelje të nenit 14, të lidhur me nenet 2 dhe 3.

### *D. Në lidhje me nenet e tjera*

20. Duke parë përfundimet e mësipërme, Gjykata nuk e mendoi të nevojshme shqyrtimin e të njëjtave fakte në kontekstin e neneve 6 dhe 13.

### *E. Në lidhje me nenin 41*

21. Gjykata i akordoi kërkueses 30 000 euro për dëmin jopasuror dhe 6500 euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

## **III. Koment**

22. Ky vendim është i një rëndësie thelbësore në luftën kundër dhunës në familje, një problem të cilin Gjykata e pranon hapur se ekziston në të gjitha Shtetet Anëtare dhe se nuk del gjithmonë në dritë, sepse shumë shpesh ndodh brenda marrëdhënieve personale dhe qarqeve të mbyllura dhe se nuk prek vetëm gratë. Me interes është gjithashtu të vihet re se Gjykata e hodhi poshtë kundërshtimin e Qeverisë Turke për papranueshmëri, meqë kërkuesja nuk



kishte arritur ta depozitonte padinë e saj brenda periudhës gjashtëmujore. Gjykata vendosi që kërkuesja dhe mamaja e saj kishin qenë viktime të sulmeve të përsëritura dhe megjithëse kishte pasur disa periudha kohore midis ngjarjeve, dhuna e përgjithshme duhej konsideruar si vazhduese – abuzimi, ndaj të cilit qenë subjekt ato, dhe dështimi autoriteteve për të vepruar duheshin konsideruar si një zinxhir i pandërprerë dhune.

23. Ky vendim ka një sërë elementësh të tjerë të rëndësishëm: së pari vendimi ka vlerë të veçantë në kuadër të nenit 2. Duke iu referuar dy kritereve Osman, Gjykata vlerësoi se autoritetet ishin në dijeni të kërcënimeve ndaj kërkueses dhe nënës të saj dhe se ato nuk kishin marrë masat e nevojshme, që normalisht mund të merreshin prej tyre, për të mbrojtur viktimat<sup>57</sup>. Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kishin dështuar në marrjen e masave mbrojtëse në formën e ndalimit efektiv dhe nuk duhet të kishin pritur që viktimat të bënin hapa konkretë dhe të kërkonin mbrojtje<sup>58</sup>. Pikërisht fakti, që viktimat i kishin tërhequr kallëzimet e tyre penale, nuk i shpëtonte autoritetet turke nga përgjegjësia e tyre. Ato kishin detyrimin për të hetuar arsyet për tërheqjen e kallëzimeve dhe të vepronin për të mbrojtur viktimat nëse ishte e rastit. Gjykata vuri re se ishte e habitshme që viktimat i tërhoqën kallëzimet e tyre gjatë kohës kur bashkëshorti i kërkueses ishte në liri ose menjëherë pas lirimit të tij nga burgu. Natyrisht që duhet nënvizuar që rrethanat e rastit lidheshin me marrëdhëniet familjare. Duket se në rrethana të tilla, Gjykata kërkon që autoritetet të jenë tepër të kujdesshme pasi viktimat e mundshme jetojnë bashkë me autorët e krimeve të mundshme dhe madje edhe nën kontrollin e plotë të tyre në një pjesë të madhe të rasteve. Nga kjo pikëpamje, duket se kriteri i parë Osman, pra ai i dijenisë së autoriteteve për kërcënimet, zbatohet në mënyrë më pak strikte nga ana e Gjykatës në rrethana të tilla<sup>59</sup>. Ajo çka është e rëndësishme të theksohet është se sipas Gjykatës, autoritetet nuk mund të përdornin si argument as sjelljen e viktimave për dështimin e tyre në marrjen e masave të përshtatshme. Kjo donte të thoshte, se autoritetet turke kishin dështuar në mbrojtjen e së drejtës për jetë të nënës së kërkueses, duke shkelur nenin 2.

57 Në mendimin e tij në pakicë në vendimin *Talpis k. Italisë*, (no. 41237/14), vendim i 2.3.2017, Gjyqtari Spano analizon në detaje testin e rrezikut të menjëhershëm, të përpunuar nga Gjykata në vendimin Osman. Me të drejtë ai thekson se testi Osman varet gjithmonë nga analiza e kujdesshme e rrethanave të çështjes. Por sipas kolegut tim Spano në rrethanat e çështjes Talpis ky karakter i menjehershëm nuk ishte i pranishëm sipas testit Osman sepse niveli i dhunës së bashkëshortit Talpis ishte ulur dhe sepse kërkuesja kishte tërhequr kallëzimin. Megjithatë leximi i kujdesshëm i Opuz sugjeron që tërheqja e kallëzimit nuk përjashton mungesën e rrezikut nga njëra anë. Nga ana tjetër, mendoj se në kushtet kur autori dhe viktime jetojnë vazhdimisht së bashku ose shumë afër testi nuk mund të zbatohet absolutisht në të njëjtën masë si në Osman, sepse në rastet e dhunës në familje rreziku është në vazhdimësi i pranishëm dhe indiciet më të vogla duhen trajtuar me kujdesin maksimal.

58 Shih ligjin shqiptar Nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" dhe trajtimin që i bën ky ligj këtij fenomeni në Shqipëri.

59 Shih gjithashtu *Kontrova k. Sllovakisë*, nr.7510/04, 31.05.2007, *Bljakaj dhe të tjerë k. Kroacisë*, nr.74448/12, 18.09.2014, *Halime Kılıçk. Turqisë*, no 63034/11, § 99, 28 juin 2016, etj.



24. Duket se Gjykata kërkon nga autoritetet kombëtare që të jenë tepër reaktive dhe efektive në situatat e dhunës në familje. Ky mesazh, del qoftë nga konstatimi i shkeljes së aspektit procedural të nenit 2 në lidhje me procesin penal mbi vrasjen e nënës së kërkueses, qoftë edhe nga konstatimi i shkeljes së nenit 3 në lidhje me dëmtimet dhe kërcënimet nga vetë kërkueses. Gjykata insiston që mekanizmat penalë duhet të jenë tepër konkretë qoftë përsa i përket efektit parandalues të dënimeve penale, qoftë përsa i përket masave mbrojtëse ndaj viktimave të mundshme. Për të përforcuar gjetjet e saj, Gjykata, iu referua edhe një praktike solide të organeve të tjera ndërkombëtare mbi dhunën në familje<sup>60</sup>.

25. Në mënyrë shumë interesante, Gjykata gjeti gjithashtu një shkelje të ndalimit të diskriminimit në nenin 14 mbi bazën e gjinisë, e lidhur kjo me nenet 2 dhe 3. Në arsyetimin e saj, Gjykata, u mbështet në jurisprudencën e Komitetit të Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAË) dhe organizmave të tjera ndërkombëtare. Ajo vendosi që dështimi i një Shteti në mbrojtjen e grave përballë dhunës në familje shkel të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë nga ligji, si edhe që ky dështim nuk ka pse të jetë patjetër i qëllimshëm. Kur kuptoi se në atë pjesë juglindore të Turqisë, ku kishte jetuar kërkuesja dhe mamaja e saj, pasiviteti gjyqësor diskriminues dhe i përgjithshëm krijonin një klimë që e favorizonte dhunën në familje, Gjykata Evropiane i mbështeti pohimet e saj mbi raportet e Amnesty International, si edhe mbi ato të organizatave të shoqërisë civile turke. Gjykata iu referua edhe vendimit të saj në çështjen *D.H. dhe të tjerë k. Republikës Çeke*<sup>61</sup>, që statistikave mund të përdoren për të përcaktuar se ka pasur një diferencë në trajtim midis dy grupeve<sup>62</sup>.

60 Shih vendimet e CEDAW, *A.T. k. Hungarisë*, 26.01.2005, dhe *Fatma Yıldırım k. Austrisë*, 1.10.2007, vendimin e Gjykatës Ndëramerikane për të Drejtat e Njeriut *Velazquez-Rodriguez k. Honduras*, 29.07.1988, apo vendimin e Komisionit Ndëramerikan *Maria Da Penha k. Brazilit*, 16.4.2001.

61 Shih gjithashtu në lidhje me nenin 14 në këtë kuadër *Eremia k. Moldavisë*, nr.3564/11, 28.05.2013, *Mudric k. Moldavisë*, nr.74839/10, 16.07.2013 dhe *T.M. dhe C.M. k. Moldavisë*, nr.26608/11, 7.01.2014, dhe krahaso konstatimin për shkelje të këtij neni me vendimin in *Rumor v. Italy*, nr. 72964/10, 27.05.2014.

62 Shih gjithashtu Mosher, J., "Grounding Access to Justice Theory and Practice in the Experiences of Women Abused by Their Intimate Partners", Windsor Yearbook of Access to Justice, 32.2(2015), p. 151

## VO kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 53924/00)

8 korrik 2004

*kjo çështje kishte të bënte me problemin tepër të diskutuar në Evropë dhe në Shqipëri në kuadrin e së drejtës së jetës – jetën e fetusit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkesa e kësaj çështje është bërë nga një shtetase franceze, znj. Thi-Nho Vo, e cila ka lindur më 1967 dhe jeton në Francë. Më 27 nëntor 1991, ajo shkoi në spitalin e përgjithshëm të Lionit për një vizitë mjekësore të programuar gjatë muajit të gjashtë të shtatzënisë. Në të njëjtën ditë një grua tjetër, znj. Thi Thanh Van Vo duhet të hiqte një kontrceptiv, në të njëjtin spital.
2. Për shkak të një ngatërrese që lindi si pasojë e faktit që dy gratë kishin të njëjtin mbiemër, mjeku që vizitoi kërkuesen shpoi membranën e saj amniotike duke e bërë abortin të pashmangshëm.
3. Pas një kallëzimi penal të kërkueses dhe të bashkëshortit të saj më 1991, mjeku u akuzua për veprën penale të plagosjes së kryer nga pakujdesia, akuzë që pastaj u ndryshua në vrasje nga pakujdesia. Më 3 qershor 1996, gjykata penale e Lionit vendosi se mjeku nuk ishte fajtor për këtë akuzë. Kërkuesja apeloj dhe më 13 mars 1997, Gjykata e Apelit të Lionit e prishi vendimin e gjykatës penale dhe e gjeti mjekun fajtor për vrasje nga pakujdesia duke e dënuar me gjashtë muaj burg me kusht dhe me një gjobë prej 10 000 frangash franceze. Më 30 qershor 1999, Gjykata e Kasacionit e prishi vendimin e apelit duke vendosur se faktet e çështjes nuk përbënin veprën e vrasjes nga pakujdesia. Në këtë mënyrë, ajo refuzoi që ta konsideronte fetusin si një qenie njerëzore e cila gëzonte mbrojtje nga e drejta penale franceze.
4. Duke u bazuar në nenin 2 të Konventës, kërkuesja ankohej për refuzimin e autoriteteve për ta klasifikuar humbjen e fëmijës së saj të palindur ende si vrasje nga pakujdesia. Ajo pretendonte se Franca ishte e detyruar që me ligj t'i konsideronte akte të tilla si vepra penale.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 2

5. Gjykata vlerësoi se përgjigja e pyetjes se kur fillon jeta i takon së drejtës së brendshme: së pari për shkak se ky problem nuk kishte gjetur përgjigje në

shumicën e shteteve që kanë ratifikuar Konventën, dhe veçanërisht në Francë ku çështja ka qenë subjekt i një debati publik; dhe së dyti sepse nuk kishte një konsensus në nivel evropian në lidhje me përkufizimin shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës. Duke pasur parasysh këto vlerësime, Gjykata u shpreh se nuk ishte as e dëshirueshme dhe as e mundur në këto kushte që t'i përgjigjej në mënyrë abstrakte çështjes nëse një fëmijë që nuk ka lindur ende është një person për qëllimet e nenit 2 të Konventës.

6. Në këto rrethana, Gjykata e vlerësoi të panevojshme që të shqyrtonte nëse fundi i papritur i shtatzënisë së kërkueses përfshihej në qëllimin e nenit 2, duke vlerësuar se, edhe po të prezumohej zbatueshmëria e kësaj dispozite në këtë rast, Franca nuk kishte dështuar në respektimin e kërkesave për ruajtjen e jetës në sferën e shëndetit publik. Fëmijët e palindur ende nuk ishin të privuar nga çdo mbrojtje në bazë të së drejtës Franceze. Përveç procesit penal që kërkuesja kishte nisur ndaj mjekut për plagosje nga pakujdesia, ajo mund të kishte nisur një padi për shpërblim dëmi në gjykatat administrative e cila mund të kishte pasur mundësi të mira suksesi. Një padi e tillë mund t'i kishte mundësuar kërkueses që të provonte neglizhencën profesionale të mjekut dhe të përfitonte shpërblim për dëmin e pësuar. Pra, nuk kishte pasur nevojë të fillonte një proces penal.

7. Në këto kushte Gjykata vendosi se, edhe po të prezumohej se neni 2 gjente zbatim në këtë rast, nuk ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

### III. Koment

8. Herë pas here Gjykata e Strasburgut thirret për të marrë në shqyrtim probleme të pazgjidhura dhe të debatueshme morale<sup>63</sup>. Dhe duket se deri tani kjo detyrë nuk ka qenë e lehtë për t'u zgjidhur prej saj. Vetëm 7 nga 17 gjyqtarët e Dhomës së Madhe që vendosi në lidhje me këtë çështje, ishin dakord me arsyetimin e shumicës, pavarësisht se 14 vendosën se nuk kishte shkelje. Shumica preferoi ta shmangte përgjigjen e pyetjes thelbësore që shtrohej në këtë çështje – konkretisht nëse fetusi gëzon mbrojtjen e nenit 2<sup>64</sup>. Gjykata vuri re se nuk kishte një konsensus në nivel evropian në lidhje me këtë çështje, megjithëse ajo u shpreh se dispozitat e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Bioetika mbrojnë edhe format embrionale të jetës njerëzore. Legjislacioni shqiptar duket se vendos një kriter që duket se shkencërisht është më i pranuari për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzënisë – deri në 12 javë nga konceptimi i fetusit dhe pranon në raste të veçanta ndërprerjen e shtatzënisë kur fetusi është deri në 22 javë<sup>65</sup>.

9. Ndërsa Gjykata e Strasburgut nga ana e saj e anashkaloi këtë çështje duke theksuar se “edhe në qoftë se prezumohej” që fetusi gëzon mbrojtje, detyrimet

63 Shih për shembull vendimin e saj të 29 prillit 2002 në lidhje me çështjen *Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar* ose të 13 shkurtit 2003 në lidhje me çështjen *Odièvre kundër Francës*.

64 Sidomos paragrafi 74 i vendimit.

65 Shih nenet 9 deri 11 të Ligjit Nr. 8045 të datës 7.12.1995 “Për ndërprerjen e shtatzënisë”.

pozitive të shtetit nuk shkojnë deri aty sa të ofrojnë instrumente ligjorë me karakter penal në rastet e eliminimit të paqëllimshëm të fetusit. Mundësia teorike e një ankimi civil normalisht do të mjaftonte sipas Gjykatës. Madje, kjo u shpreh se ankimi civil ishte teorikisht i mjaftueshëm për të mos konstatuar shkelje të Konventës edhe kur ai për arsye procedurale nuk ishte i mundshëm për t'u përdorur në praktikë nga znj. Vo.

10. Mendimi i përbashkët paralel i pesë gjyqtarëve shprehej se nuk ishte e logjikshme që të deklarohesh se Gjykata nuk ishte e detyruar të vendoste nëse neni 2 gjente zbatim në lidhje me fetusin por se duhej mbajtur qëndrimi se, duke qenë se zbatohet, ai nuk ishte shkelur. Mendimet e pakicës u përpoqën të argumentonin se qoftë një dënim penal, qoftë edhe një ndëshkim serioz disiplinor ndaj mjekut neglizhent, mund të kishin qenë të domosdoshëm në një rast të tillë. Katër nga gjyqtarët që votuan në pakicë vlerësuan se jeta e një fetusit gjashtë mujor në këtë çështje gëzon mbrojtjen e nenit 2. Me anë të këtij vendimi që është në fakt mjaft i kritikueshëm, Gjykata ndoshta përpiqet të ruajë rolin e saj neutral në marrëdhënien ndërmjet fetusit dhe nenit 2, por qëndrimi i mbajtur nga ana e gjykatave franceze dhe i mbështetur pastaj edhe nga shumica e Gjykatës në Strasburg e la nënën (vdekja e fëmijës të palindur të së cilës erdhi si pasojë e një neglizhence serioze mjekësore) pa asnjë mjet ose shpërblim për humbjen e pësuar. Legjislacioni shqiptar në këtë drejtim ofron në fakt mbrojtje në bazë të ligjit të lartpërmendur "Për ndërprerjen e shtatzënisë". Neni 17 i këtij Ligji na bën të kuptojmë se kemi të bëjmë me një mjet me karakter civil. Por, nga ana tjetër, kemi edhe mjete të parashikuara në Kodin tonë Penal ku interesante është të vlerësohet gjithsesi dallimi ndërmjet dispozitave të neneve 93 dhe 96 të këtij Kodi, ku i pari vjen në ndihmë të fetusit ndërsa i dyti (megjithëse do të ishte një përgjigje e qartë normative shqiptare ndaj fakteve franceze në këtë çështje) nuk ka të bëjë me fetusin.

## CALVELLI & CIGLIO kundër ITALISË

(kërkesa nr. 32967/96)

17 janar 2002

*kjo çështje kishte të bënte me dënimin e një mjeku për neglizhencë në ushtrimin e profesionit të tij, kur kjo neglizhencë çon në pasoja të rënda për shëndetin e pacientit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Pietro Calvelli dhe Sonia Ciglio, janë të dy shtetas italianë, fëmija i të cilëve kishte lindur në një klinikë private në Cosenza (Itali) më 7 shkurt 1987. Menjëherë pas lindjes, fëmija iu nënshtrua një trajtimi intensiv në një rajon të

spitalit të Cosenza-s për shkak se vuante nga sindroma e një post-asfiksie serioze respiratore dhe neurologjike të shkaktuar nga mënyra se si ai është mbajtur gjatë lindjes. Fëmija vdiq dy ditë më pas, më 9 shkurt 1987.

2. Më 10 shkurt 1987, kërkuesit bënë një ankim dhe Zyra e Prokurorit në Cosenza nisi një hetim. Kërkuesit u vunë në dijeni se akuza penale do të drejtohej kundër E.C., mjekut përgjegjës për lindjen e fëmijës dhe njëkohësisht bashkëpronar të klinikës, dhe, më 7 korrik 1989 ata u bënë palë civile në proces. Më 17 dhjetor 1993 Gjykata Penale e Cosenza-s e konstatoi E.C. fajtor *in absentia*, për vrasje pa paramendim nga pakujdesia dhe e dënoi atë me një vit burg si dhe e urdhëroi që t'i paguante palës civile shpenzimet dhe dëmshpërblimin.

3. Gjykata italiane konstatoi se i akuzuari ishte në dijeni që lindja në fjalë duhej konsideruar si lindje me rrezik për shkak se e ëma e fëmijës ishte një diabetike në nivelin A, si dhe kishte pasur probleme të tjera të vështira që kishin pasur të bënin me përmasat e fetusit. Prania e një rreziku të tillë, në këto rrethana që përmendëm më lart, nënkuptonte marrjen e masave paraprake dhe që mjeku i ngarkuar me këtë lindje duhet të kishte qenë i pranishëm gjatë saj. Gjykata Penale konstatoi se, megjithëkëtë, E.C., që kishte qenë edhe mjeku me të cilin nëna ishte këshilluar gjatë shtatzënisë, nuk kishte marrë asnjë masë paraprake kujdesi dhe për më tepër nuk kishte qenë i pranishëm gjatë lindjes së fëmijës, duke vizituar pacientë të tjerë në pavijone të tjera të klinikës. Kur u vunë re komplikacionet gjatë lindjes, mamive të spitalit iu deshën gjashtë deri në shtatë minuta për ta gjetur mjekun dhe vonesa në ndërhyrje, përpara pra se ky të kishte qenë në gjendje të kryente veprimet e nevojshme të posaçme për ta nxjerrë fetusin, i kishin zvogëluar në mënyrë domethënëse mundësitë e fëmijës për të mbijetuar.

4. Megjithatë, Gjykata italiane e pezulloi vendimin e saj dhe urdhëroi që dënimi nuk duhet të figuronte në dosjen personale penale të E.C.-së. Për më tepër, ajo hodhi poshtë pretendimin e kërkuesve për një akordim të përkohshëm të kompensimit. E.C. e apeloj vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Në një vendim të 3 korrikut 1995 Gjykata e Apelit e Katanxaros vendosi që ndjekja penale e veprës në fjalë ishte parashkruar dhe se afati kohor për ndjekjen e veprës për të cilën E.C. ishte akuzuar kishte mbaruar më 9 gusht 1994.

5. Ndërkohë, kërkuesit kishin paraqitur edhe një padi me karakter civil kundër E.C.. megjithatë, më 27 prill 1995, ndërsa procedurat penale nuk kishin mbaruar ende përpara Gjykatës së Apelit të Katanxaros, ata arritën një marrëveshje me mjekun dhe me shoqërinë siguroese të klinikës në bazë të së cilës kjo e fundit duhet t'u paguante kërkuesve një shumë prej 95 000 000 lireta italiane (ITL) për çdo dëm që iu ishte shkaktuar atyre. Në vijim, përderisa palët nuk u paraqitën në seancën e 16 nëntorit 1995, çështja u mbyll.

6. Kërkuesit ankoreshin, në bazë të nenit 2, që, për shkak të vonesave procedurale, kishte hyrë në veprim parashkrimi, duke e bërë të pamundur

ndjekjen penale të mjekut përgjegjës për trajtimin e fëmijës së tyre i cili vdiq pak pas lindjes. Ata u ankuan gjithashtu, në bazë të nenit 6 § 1, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, të cilat u zgjatën për gjashtë vjet, tre muaj dhe 10 ditë, (nga 7 korriku 1989, kur palët iu bashkëngjitën si palë civile procesit penal, deri më 17 tetor 1995, kur vendimi i Gjykatës së Apelit të Katanxaros mori formë përfundimtare).

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

7. Gjykata vuri në dukje se, në bazë të nenit 2, Italia duhet që të bënte rregullimet përkatëse ligjore që t'i detyronte spitalet, publike apo private qofshin, që të merrnin masat e përshtatshme për mbrojtjen e jetës së pacientëve. Ajo duhet të ofronte gjithashtu një sistem ligjor efektiv dhe të pavarur në mënyrë të tillë që të mund të përcaktohen shkaqet e vdekjes së pacientëve që janë nën kujdesin e mjekëve, qoftë në institucione publike apo private, dhe në rast se ka vend të ngarkohen me përgjegjësi personat fajtorë. Për këtë arsye, Gjykata konstatoi se neni 2 ishte i zbatueshëm në këtë rast dhe do të përbënte objekt gjykimi.

8. Gjykata vuri në dukje se procedimi penal kundër mjekut E.C. ishte parashkruar për shkak se mangësitë procedurale kishin çuar në vonesa, veçanërisht gjatë hetimit policor si dhe atij gjyqësor. Megjithatë, kërkuesit kishin pasur të drejtë të vinin në lëvizje procedura civile dhe kishin filluar procedurat në këtë drejtim. Është e vërtetë që nuk ka pasur deri më tani ndonjë rast ku një mjek të jetë gjetur përgjegjës nga ana e një Gjykate Civile. Megjithatë, kërkuesit kishin arritur një marrëveshje me mjekun duke hequr dorë vullnetarisht, pas kësaj marrëveshjeje, nga vazhdimi i procedurave. Këto procedura mund edhe të ishin çuar në një urdhër drejtuar mjekut që ky të paguante dëmet si dhe të botohej vendimi gjyqësor në shtyp. Një vendim nga një gjykatë civile mund edhe të kishte çuar në një masë me karakter disiplinor kundër mjekut. Për këto arsye, Gjykata vlerësoi se kërkuesit i kishin mohuar vetvetes përdorimin e mjeteve më të mira në dispozicion të tyre (të tilla që, në rrethanat e çështjes në fjalë, do të kishin përmbushur detyrimet pozitive që rridhnin nga neni 2) për të nxjerrë në dritë masën e përgjegjësisë së mjekut për vdekjen e fëmijës së tyre.

9. Gjykata ritheksoi se në rastet kur të afërmit e një personi të vdekur pranonin kompensim për zgjidhjen e një pretendimi civil për shkak të një neglizhence mjekësore, nuk mund të pretendohet më se ai person ishte viktimë. Nuk ishte më e nevojshme për Gjykatën që të shqyrtonte faktin që parashkrimi i procedimit kishte penguar që mjeku të ngarkohej me përgjegjësi për shkeljen e pretenduar të nenit 2. Për këtë arsye, Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 2.

### B. Në lidhje me nenin 6 § 1

10. Gjykata vuri në dukje se procedurat në fjalë ishin padyshim shumë komplekse. Për më tepër, megjithëse, pasi kërkuesit ishin paraqitur edhe si palë



civile në proces që nga 7 korriku 1989, procedurat në shkallën e parë kishin qenë cënuar nga vonesa të tepërta, nuk ka pasur ndonjë periudhë tjetër domethënëse pasiviteti për faj të autoriteteve (përveç shtyrjes së seancave në shkallë të parë e cila ishte shkaktuar nga greva e avokatëve). Për këtë arsye, Gjykata vlerësoi se një periudhe prej gjashtë vjetësh, tre muajsh dhe dhjetë ditësh për procedurat përpara katër shkallëve gjyqësore nuk mund të konsiderohej si e paarsyeshme. Për këtë arsye, ajo mendoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1.

### III. Koment

11. Del thujtë e qartë që rëndësia e problemeve të ngritura në këtë çështje do duhej gjykuar nga Dhoma e Madhe prej 17 gjyqtarësh dhe jo nga një Dhomë prej 7 gjyqtarësh. Është e çuditshme që vendimi ka qenë tepër i shkurtër në këtë rast (19 faqe gjithsej) dhe se arsyetimi ligjor i shumicës së gjyqtarëve nuk i ka kushtuar vëmendje dhe analizë të mjaftueshme jurisprudencës së Konventës që ka lidhje me raste të ngjashme, dhe zë, për çudinë tonë, veçse 5 faqe. Ky koment përpiket që të hedhë dritë në disa prej problemeve përkatëse më në detaj.

12. Gjykata Evropiane e ka bërë vazhdimisht të qartë që Konventa nuk kërkon përgjithësisht ndonjë përmbajtje të veçantë për të drejtën e brendshme penale<sup>66</sup>. Megjithatë kanë kaluar tashmë më se gjashtëmbëdhjetë vjet që kur Gjykata dha vendimin e saj në çështjen e famshme X dhe Y kundër Holandës, më 26 mars 1985. Në atë çështje ajo vendosi se kur ngjarjet që kanë ndodhur normalisht rregullohen nga e drejta penale, mjetet me karakter civil janë të pamjaftueshme. Çështje të tilla serioze kërkojnë ekzistencën e sanksioneve efektive penale përkrah mjeteve me karakter civil.

13. Gjykata, në mënyrë më specifike, ka vendosur që, në rastet kur, *prima facie*<sup>67</sup>, ka prova që është kryer një krim që ka çuar në humbjen e një jete njerëzore, ajo çfarë kërkohet konsiston në “një hetim tërësor dhe efektiv për identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës si dhe në përfshirjen efektive të të afërmeve të viktimës në procesin hetimor”. Mungesa e një hetimi efektiv në rastet kur është pasojë vdekja përbën në vetvete një shkelje e nenit 2<sup>68</sup>. I njëjti qëndrim është mbajtur po ashtu edhe për vepra penale që nuk kanë pasur si pasojë vdekjen<sup>69</sup>.

14. Në shpalljen e vendimit në këtë çështje Gjykata u nis nga përjasja e mbajtur në rastin e çështjes së lartpërmendur X dhe Y kundër Holandës por pa iu referuar vendimit përkatës. Ajo vuri në dukje se qëndrimi i mbajtur në

66 Shih për shembull vendimin *Lauko kundër Sllovakisë* të 2 shtatorit 1998

67 *prima facie* [lat.] - në pamje të parë.

68 Në këtë kuadër mjafton të kujtohen vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet *Aksoy kundër Turqisë*, i 18 dhjetorit 1996, *Aydin kundër Turqisë*, i 25 shtatorit 1997, *Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i 4 majit 2001 (shih në lidhje me këtë vendim të fundit Buletinin nr. 6 - Qershor 2001).

69 Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjen *Assenov kundër Bullgarisë*, të 28 tetorit 1998.

çështjen në fjalë – shkaktimi i vdekjes nga neglizhenca – ishte parashikuar dhe rregulluar juridikisht nga e drejta penale italiane por që vonesat procedurale kishin penguar përfundimin efektiv të procedimit penal në të cilin i akuzuari ishte gjetur fajtor. Në këtë mënyrë pra, sanksioni penal kishte ngelur “teorik dhe iluziv” dhe jo “praktik dhe efektiv”. Në mënyrë të veçantë, Italia është e njohur për vonesat e saj të tepërta procedurale në çështjet sa civile aq edhe penale, të cilat edhe e kanë ngarkuar së tepërmi Gjykatën për vite të tëra<sup>70</sup>. Disa qindra shkelje janë konstatuar në këtë drejtim – shumë më tepër se kundër çdo vendi tjetër në Evropë, aq sa Italia u detyruar që të përgatisë dhe miratojë një ligj të veçantë për të lehtësuar situatën në këtë drejtim – ligjin Pinto. Megjithatë, edhe pse vonesa të tilla kishin penguar veprimin e së drejtës penale, në këtë rast, Gjykata nuk konstatoi shkelje as të nenit 2 dhe as të nenit 6 § 1.

15. Në pjesën më të madhe të sistemeve ligjore, neglizhenca mjekësore, edhe kur ajo çon në vdekje, mund të mos ndiqet penalisht në mënyrë të menjëhershme, për shkak se mund të mungojnë disa prej elementëve që bëjnë që të fillojë në mënyrë të menjëhershme ndjekja penale për një shkelje të caktuar<sup>71</sup>. Megjithatë kjo nuk kishte ndodhur kështu në çështjen Calvelli, që për më tepër ishte edhe çështje italiane. Një gjykatë italiane e shkallës së parë e kishte dënuar mjekun për vrasje të shkaktuar nga neglizhenca dhe korrektësia mbi themelin e këtij vendimi nuk ishte kundërshtuar. Megjithatë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerësoi se e drejta për të nisur procedimin civil, që pastaj kishte marrë fund me arritjen e një marrëveshjeje, ishte e mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e nenit 2 sipas të cilit vdekja duhet të hetohet. Gjykata në këtë rast, nuk iu referua çështjes së ndëshkimit penal të cilën ajo e kishte theksuar qartë në çështjet turke të lartpërmendura.

16. Në një numër rastesh që kanë pasur të bëjnë me të drejtat civile (si për shembull e drejta për jetë private, liria e shprehjes), Gjykata ka konstatuar se ekzistenca e sanksioneve penale përbën një ndërhyrje joproporcionale me respektimin e tyre. Kjo është pranuar edhe në rastet kur rregullime përkatëse të qëndrimeve të caktuara në fushën e këtyre të drejtave janë konsideruar si të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe kur ndërhyrja është vlerësuar se ndiqte një “qëllim të ligjshëm” siç kërkohej në paragrafët e dyta të neneve përkatëse të Konventës që parashikojnë këto të drejta<sup>72</sup>. Në raste të tjera, ajo që ka vendosur Gjykata në thelb është, natyra e qëndrimit ose e sjelljes që mund ta bëjë sanksionin me karakter penal të nevojshëm dhe proporcional<sup>73</sup>.

70 Sipas statistikave të vitit 2000 Italia ishte shteti që kishte pasur më shumë raste në Gjykatën e Strasburgut, 2516 dhe është dënuar në 230 prej tyre kryesisht për shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

71 Shih për shembull vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen *Powell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 21 shkurtit 1990.

72 Shih vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar* të 7 dhjetorit 1976, *Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 22 tetorit 1981, *Norris kundër Irlandës* të 26 tetorit 1988.

73 Shih vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet *Laskey Jaggard dhe Brown kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 19 shkurtit 1997 dhe *Muller kundër Zvicrës*, të 24 majit 1998.

17. Shkelja e kryer nga mjeku në çështjen Calvelli ishte vlerësuar si “vrasje nga neglizhenca”. Megjithëse i akuzuari u gjet fajtor atij iu dha një dënim me kusht dhe që nuk u shënuar në dosjen e tij personale. Ndoshta, Gjykata në këtë çështje ka dashur të pasqyrojë parimin e proporcionalitetit të zbatuar prej saj në çështjet në lidhje me nenet 8 dhe 10 të përmendura më lart, megjithëse vendimi nuk bënte ndonjë referencë të qartë në këtë drejtim. Gjykatat italiane të cilat edhe kishin dëgjuar të gjitha faktet e çështjes, mbajtën haptazi qëndrimin që krimi që ato konstatuan se ishte kryer nuk kërkonte një sanksion të rëndë. Kjo gjë mund ta ketë çuar Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut të arrijë në përfundimin se nuk duhej fare një sanksion me karakter penal. Shumica e gjyqtarëve gjithsesi nuk e shpjeguan qartë qëndrimin e tyre dhe as se si ky vendim mund të ishte në përputhje me natyrën absolute të nenit 2 dhe me rëndësinë themelore që e drejta e jetës kishte, siç kishte dalë qartë në pah në rastet turke dhe britanike të lartpërmendura.

18. Përsa i përket afatit të arsyeshëm në kuadrin e nenit 6, Gjykata, pa shpjeguar pse, vlerësoi se afati fillonte të vepronte pas datës në të cilën kërkuesit ishin paraqitur formalisht si palë civile dhe jo nga data kur ata e kishin vënë në dijeni shtetin në lidhje me ankimin e tyre. Ky qëndrim, është i ndryshëm nga ai që është mbajtur në çështjet *Howarth kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 21 shtatorit 2000 dhe *Egmez kundër Qipros*, të 21 dhjetorit 2000, të cilat për më tepër as nuk u cituan në këtë vendim.

19. Tre gjyqtarë dhanë mendime të kundërta me shumicën duke arsyetuar shkelje të nenit 2 dhe një gjyqtar tjetër duke argumentuar shkelje të nenit 6 përse i përket problemit të afatit të arsyeshëm për gjykim të kërkuar nga ky nen.

## PRETTY kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 2346/02)

29 prill 2002

*në këtë çështje u mor në shqyrtim, nën këndvështrimin e disa neneve të Konventës, ndalimi i eutanazisë të cilin Gjykata e vlerësoi, si përfundim, jo në kundërshtim me Konventën.*

### I. Faktet kryesore

1. Diane Pretty ishte shtetase britanike e lindur më 1958 dhe që jetonte në Luton. Ajo ishte duke vdekur nga një sëmundje e neuroneve motore, që është një sëmundje që prek muskujt dhe ndaj të cilës nuk ka mjekim.

2. Sëmundja ishte në një stad të përparuar dhe kërkuesja ishte e paralizuar nga zverku e poshtë dhe shpresat e saj për të jetuar ishin tepër të vogla. Megjithatë,

intelekti i saj si dhe aftësia për të marrë vendime kishin ngelur të pacënuara. Pasur parasysh që statet përfundimtare të sëmundjes shoqërohen me vuajtje dhe për nga vetë karakteri e përuhin të sëmurin, kërkuesja shprehu dëshirën që të ishte në gjendje të kontrollonte se si dhe kur ajo mund të vdiste dhe t'i shpëtonte në këtë mënyrë vuajtjeve dhe humbjes së dinjitetit të saj.

3. Megjithëse vetëvraska nuk është krim sipas së drejtës angleze, kërkuesja nuk mund ta merrte këtë hap pa ndihmën e ndokujt për shkak të sëmundjes. Por nga ana tjetër, në bazë të nenit 2 § 1 të Ligjit mbi Vetëvrasken të vitit 1961 ndihma që i jepej dikujt për të kryer vetëvrasje përbente krim. znj. Pretty dëshironte që të ndihmohej nga ana e bashkëshortit të saj në kryerjen e vetëvrases por Prokurori i Rrethit e kishte refuzuar kërkesën e saj që bashkëshortit t'i garantohej që nuk do të ndiqej penalisht në qoftë se ai e bënte një gjë të tillë. Apelimet e saj kundër këtij vendimi kishin qenë të gjitha të pasuksesshme.

4. Kërkuesja ankohej, në bazë të nenit 2 të Konventës, se i takonte individit të zgjidhte nëse donte të jetonte apo jo dhe se drejta për të vdekur ishte pasojë e së drejtës për të jetuar dhe pra ishte gjithashtu e mbrojtur. Ajo ankohej në bazë të nenit 3 se qeveria e Mbretërisë së Bashkuar është e detyruar jo vetëm të mos marrë ajo vetë asnjë veprim që shkakton trajtim çnjerëzor dhe degradues, por edhe të marrë hapa pozitivë për të mbrojtur personat brenda juridiksionit të tyre që këta të mos i nënshtrohen trajtimeve të tilla. Ajo u bazua në vijim në nenin 8, duke argumentuar se ky nen shprehimisht njihë të drejtën për të vendosur vetë në lidhje me jetën, dhe në nenin 9, duke u ankuar se mungesa e dhënies së përgjegjësisë dhe e parashikimit të një skeme të ligjshme për të lejuar vetëvrasken me ndihmën e dikujt, shkelte të drejtën e saj për të shprehur besimin që kishte. Në bazë të nenit 14, ajo argumentoi se ndalimi i përgjithshëm për vetëvrasje me ndihmën e dikujt diskriminon personat që nuk janë të aftë të kryejnë vetëvrasje pa ndihmën e një personi tjetër, ndërkohë që personat e aftë fizikisht, sipas së drejtës së brendshme angleze mund ta bëjnë këtë gjë.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

5. Gjykata kujtoi që neni 2 mbron të drejtën e jetës, pa të cilën gëzimi i çdonjërës nga të drejtat dhe liritë e tjera të parashikuara në Konventë bëhej i pavlerë. Kjo mbrojtje mbulon jo vetëm vrasjen me paramendim, por gjithashtu edhe situatat në të cilat lejohej përdorimi i forcës i cili mund të rezultonte, si një pasojë e paparamenduar, në privimin e jetës. Për më tepër, Gjykata ka theksuar se fjalia e parë e nenit 2 § 1 i detyronte shtetet jo vetëm të mos merrnin akte që me paramendim dhe në mënyrë të paligjshme merrnin jetën e dikujt, por edhe të merrnin masat e duhura për të ruajtur jetën e personave brenda juridiksionit të tyre. Ky detyrim mund të kërkojë gjithashtu që në disa rrethana të përcaktuara qartë shtetet kanë një detyrim pozitiv për të marrë masa me karakter operativ parandalues për të mbrojtur individët jeta e të cilëve është në rrezik nga aktet kriminale të ndonjë apo disa individëve të tjerë.

6. Në jurisprudencën e saj në lidhje me këtë problem, Gjykata i ka kushtuar një vëmendje të veçantë detyrimit të shtetit për të mbrojtur jetën. Në këto rrethana, ajo nuk ishte e bindur se “e drejta për të jetuar” e garantuar nga ana e nenit 2 mund të interpretohej sikur konsistonte vetëm në një aspekt negativ. Pa pasur një shtrembërim gjuhësor, neni 2 nuk mund të interpretohej sikur njihte edhe të drejtën diametralisht të kundërt, konkretisht të drejtën për të jetuar, dhe as nuk mund të krijonte një të drejtë për të vendosur vetë në lidhje me jetën në kuptimin e akordimit një individi të së drejtës për të vdekur dhe jo të asaj për të jetuar.

7. Për këtë arsye, Gjykata konstatoi se nuk kishte asnjë të drejtë për të vdekur, qoftë me ndihmën e një personi të tretë apo të autoritetit publik, që të derivonte nga ana e nenit 2, pra, nuk ka pasur shkelje të dispozitës të këtij neni.

### ***B. Në lidhje me nenin 3***

8. Gjykata vuri në dukje se nuk kishte ndonjë mosmarrëveshje përsa i përket faktit që qeveria britanike nuk i kishte shkaktuar ajo vetë me aktet e saj ndonjë keqtrajtim kërkueses. Nuk kishte as ndonjë ankesë që kërkueses nuk po i kushtohej kujdes i mjaftueshëm nga ana e autoriteteve mjekësore të shtetit. Por, kërkuesja në fakt, pretendonte se refuzimi i Prokurorit të Rrethit për tu angazhuar se nuk do të ndiqte penalisht burrin e saj në qoftë se ky e ndihmonte znj. Pretty për të kryer vetëvrasje si dhe ligji penal i cili ndalonte ndihmën për vetëvrasje arrinte të përbënte trajtim çnjerëzor dhe degradues për të cilin shteti ishte përgjegjës.

9. Ky pretendim ngrinte një konceptim të ri dhe të zgjeruar në lidhje me konceptim e keqtrajtimit. Ndërkohë që Gjykata duhet të mbajë një përjasje dinamike dhe fleksibël në lidhje me interpretimin e Konventës, çdo interpretim duhet të përputhet me objektivat themelore të Konventës dhe me koherencën e saj si sistem i mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Neni 3 duhet perceptuar në harmoni me nenin 2, i cili ka të bëjë në radhë të parë me ndalimin e përdorimit të forcës vdekjeprurëse ose të mbajtjes të çfarëdo qëndrimi që mund të çojë në vdekjen e qenieve njerëzore, dhe nuk i ofron ndonjë individi të drejtën që të kërkojë nga ana e shtetit të vet që ky t'i lejojë ose t'i lehtësojë atij vdekjen.

10. Gjykata nuk mund të ishte e të njëjtit mendim me kërkuesen sipas së cilës në qoftë se ajo nuk i jepte fund jetës së saj përballej me perspektivën e një vdekjeje plot me vuajtje. Nga ana tjetër, detyrimi pozitiv i shtetit, që edhe u përmend në paragrafin e mësipërm, kërkon që shteti të sanksionojë veprimet që synojnë t'i japin fund jetës por ky nuk është një detyrim që rrjedh nga neni 3 i Konventës. Për këtë arsye, Gjykata arriti në përfundimin që asnjë detyrim pozitiv nuk rridhte nga eni 3 në këtë kontekst dhe, pra, nuk ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

### ***C. Në lidhje me nenin 8***

11. Kërkuesja pretendonte se ishte ndaluar me ligj që të ushtronte zgjedhjen e saj për të shmangur çfarë ajo konsideronte si një fund përulës dhe shqetësues

të jetës së saj. Gjykata nuk ishte e gatshme të mohonte që ky fakt përbënte një ndërhyrje në të drejtën e saj për respektimin e jetës private siç garantohet nga ana e nenit 8 § 1.

12. Gjykata kujtoi që një ndërhyrje në ushtrimin e një të drejtë të garantuar nga neni 8 nuk do të ishte në përputhje me nenin 8 § 2 në qoftë se ajo nuk do të ishte “në përputhje me ligjin”, nuk do të ndiqte qëllime që konsiderohen legjitime nën këtë paragraf dhe nuk do të ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për arritjen e këtyre qëllimeve. Çështja e vetme, nga kriteret e parashtruara më lart, që dilte në pah nga argumentet e palëve ishte karakteri i nevojshëm i ndërhyrjes dhe argumentet e palëve u fokusuan në proporcionalitetin e saj. Në këtë kuadër, kërkesja kundërshtoi natyrën e përgjithshme të ndalimit për vetëvrasjen me ndihmën e dikujt.

13. Gjykata, ashtu si edhe *House of Lords*, konstatoi se shtetet kanë të drejtë të rregullojnë me anë të veprimit të së drejtës së përgjithshme penale akte që çënojnë jetën dhe sigurinë e individëve të tjerë. Ligji në fjalë, ai “Mbi Vetëvrasjen” në seksionin 2, ishte formuluar në mënyrë të tillë që të ruante jetën me anë të mbrojtjes të personave të dobët dhe të pafuqishëm e sidomos të atyre që nuk ishin në gjendje të merrnin vendime të bazuara në informacione të sakta ndaj akteve që synojnë t'i japin fund jetës ose të ndihmojnë në dhënien fund të jetës.

14. Gjykata nuk ishte e mendimit se natyra e përgjithshme e ndalimit të vetëvrasjes me ndihmën e dikujt kishte karakter jo proporcional. Qeveria kishte deklaruar që ishte parashikuar edhe njëfarë fleksibiliteti për raste individuale duke pasur parasysh faktin që duhej dhënë pëlqimi i Prokurorit të Rrethit për të nisur ndjekjen penale si dhe nga fakti që ishte parashikuar vetëm dënimi maksimal duke lejuar kështu që të jepeshin edhe dënime më të ulëta si të ishte e përshtatshme. Nuk duket të jetë arbitrar fakti që ligji të pasqyrojë rëndësinë e së drejtës së jetës, duke ndaluar vetëvrasjen me ndihmën e dikujt me anë të parashikimit të një sistemi juridiksional i cili lejon që tu kushtohet vëmendje e veçantë rasteve specifike dhe, në respektim të interesit publik, fillon ndjekjen penale duke ruajtur barazinë dhe drejtësinë e dënimit si dhe të masave parandaluese.

15. Në rrethanat e çështjes, nuk dukej të kishte ndonjë disproporcionalitet në refuzimin e Prokurorit të Rrethit për të dhënë një premtim paraprak që nuk do të fillonte ndjekjen penale ndaj bashkëshortit të kërkueses. Argumente të forta të bazuara në parimin e shtetit të së drejtës mund të ngrihen ndaj çdo pretendimi nga ana e qeverisë në lidhje me përjashtimin e individëve ose të grupeve të individëve nga zbatimi i ligjit. Por sidoqoftë, serioziteti i aktit për të cilin u kërkua edhe mosfillimi i ndjekjes penale ishte i tillë sa vendimi i Prokurorit të Rrethit për të refuzuar atë çfarë iu kërkua nuk mund të thuhet se ishte arbitrar ose i palogjikshëm.



16. Gjykata arriti në përfundimin se, ndërhyrja mund të justifikohet si “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Pra, nuk ka pasur shkelje të nenit 8.

#### **D. Në lidhje me nenin 9**

17. Gjykata vuri në dukje se, jo të gjitha opinionet apo bindjet përbëjnë besime të tilla që të gëzojnë mbrojtjen e nenit 9 § 1. Pretendimet e kërkuases nuk përfshinin një formë të manifestimit të fesë apo besimit, nëpërmjet kultit, mësimdhënies, praktikimit apo riteve siç përshkruhet në fjalinë e dytë të paragrafit të parë. Termi “praktikave” nuk përfshin çdo akt që motivohet apo ndikohet nga feja apo besimi. Në bazë të këtyre arsytimit, Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 9.

#### **E. Në lidhje me nenin 14**

18. Për qëllimet e nenit 14, një diferencim në trajtim ndërmjet personave në pozita të njëjta ose të ngjashme në një masë të madhe është diskriminues, në qoftë se nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Diskriminim mund të ketë gjithashtu, edhe në rastet kur shtetet, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm nuk arrijnë të trajtojnë në mënyrë të ndryshme persona me situata krejtësisht të ndryshme.

19. Sipas pikëpamjes së Gjykatës, kishte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për të mos bërë një dallim në ligj ndërmjet atyre që ishin dhe atyre që nuk ishin fizikisht të aftë për të kryer vetëvrasje. Kufiri ndarës ndërmjet dy kategorive mund të jetë shpesh tepër i hollë dhe të kërkojë të parashikosh në ligj një përjashtim për personat që vlerësohen se janë të paaftë për të kryer vetëvrasje do të rrezikohet seriozisht mbrojtja e jetës të cilën Ligji i vitit 1961 synonte të mbronte si dhe, nga ana tjetër, do të rritej rreziku i abuzimit me të. Për pasojë, nuk ka shkelje të nenit 14.

### **III. Koment**

20. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut përbën një “instrument të gjallë” dhe Gjykata ka theksuar gjithmonë që jurisprudencën e saj duhet të jetë dinamike dhe evoluese. Të drejtat e parashikuara nga ana e Konventës pra, nuk janë të ngrira në qëndrimet sociale të viteve '40 kur edhe Konventa u përpunua për herë të parë. Megjithatë Gjykata ndjek zhvillimet e kohës ajo nuk u paraprin atyre, veçanërisht në lidhje me çështje morale ku ka qëndrime thellësisht divergjente.

21. Gjykata gjithmonë ka ngurruar për të vendosur në lidhje me çështje kaq problematike si ato të përmbajtura në çështjen Pretty. Ajo ka refuzuar edhe të njohë të drejtën për divorc, edhe nga ana tjetër, të konstatojë që aborti shkel të drejtën e jetës. Ajo ka refuzuar gjithashtu të konstatojë shkelje të Konventës kur një shtet nuk e njeh mundësinë e divorcit. Vendimi i Gjykatës në themel në lidhje me këtë çështje, ishte që Mbretëria e Bashkuar nuk e ka shkelur Konventën për shkak se nuk ka ofruar një kuadër ligjor në përputhje me të cilin bashkëshorti i znj. Pretty t'i përmbushte asaj dëshirën duke e ndihmuar që të vdiste.

22. Përjasja e mbajtur nga ana e Gjykatës do t'i japë këtij vendimi një karakter themelor për shqyrtimin e disa koncepteve themelore me karakter kushtetues në kuadrin e Konventës. Gjykata e ka njohur formalisht rolin e jurisprudencës së saj në përcaktimin e precendetëve ligjorë. Duke ripërsëritur qëndrimin që në bazë të nenit 34 të Konventës nuk i përket asaj që të japë opinione abstrakte por të zbatojë Konventën në lidhje me faktet konkrete të çështjes, sidoqoftë Gjykata ka shtuar se “gjykimet e dhëna në çështje konkrete përbëjnë precedentë... një vendim në këtë çështje nuk mundet që... të inkuadrohet në një mënyrë të tillë sa të parandalojë zbatimin e tij në raste të mëvonshme konkrete”.

23. Shpesh Gjykatës do t'i duhet të vendosë në lidhje me një çështje nën këndvështrimin e vetëm një neni në bazë të të cilit mund të jetë bërë edhe ankesa, duke deklaruar që nuk është e nevojshme ta analizojë kërkesën në bazë të neneve të tjera. E ndërjegjegjshme që ky vendim do të shqyrtohet me kujdes përsëri kur problemi i mprehtë objekt i saj do të dalë përsëri në pah, Gjykata u tregua e kujdesshme që të jepte përgjigje në lidhje me të gjitha nenet e pretenduara për shkelje. Siç edhe mund të parashikohej, ajo nuk konstatoi se neni 2 përfshin edhe të drejtën për të vdekur, ose qoftë të drejtën për të zgjedhur midis jetës dhe vdekjes. Në kuadrin e nenit 3, Gjykata vuri në dukje se keq-trajtimi i pretenduar kishte të bënte me mungesën e mbrojtjes së kërkuar nga vuajtjet duke i refuzuar asaj marrjen e një angazhimi se i shoqi nuk do të ndiqej penalisht në qoftë se e ndihmonte që të vdiste. Gjykata nuk mori përsipër që ta shtrinte kuptimin e termit “trajtim” deri në përfshirjen e kësaj situate, duke vënë në dukje se një gjë e tillë do të binte në kundërshtim me konstatimet e saj në bazë të nenit 2.

24. Qëndrimi i mbajtur në bazë të nenit 8 ishte krejt i ndryshëm. Gjykata e njohu faktin që ligji në bazë të të cilit bashkëshorti i kërkuar do të ndiqej penalisht e ndalonte atë nga ushtrimi i zgjedhjes së saj për të shmangur një vdekje jo dinjitoze. Kjo gjë përbënte ndërhyrje ndaj së drejtës së saj për “autonomi personale” të garantuar brenda kuadrin të konceptit të jetës private të mbrojtur nga ana e nenit 8 të Konventës. Sidoqoftë, ajo vlerësoi se kjo ndërhyrje ishte e justifikuar në bazë të paragrafit të dytë të të njëjtit nen. Ajo vuri në dukje se karakteri tejet i dobët i personave të sëmurë dhe pa shpresë jete i justifikonte ligjet në veprim e sipër. Në bazë të nenit 9, Gjykata vuri në dukje se jo të gjitha opinionet janë të mbrojtura në bazë të këtij neni.<sup>74</sup> Megjithëse nuk konstatoi shkelje të asnjë prej neneve të tjera ajo u detyrua ta vlerësonte pretendimin për diskriminim të ngritur në bazë të nenit 14 për shkak se kishte konstatuar një ndërhyrje, megjithëse të justifikueshme, në bazë të nenit 8. Sidoqoftë, në fund të fundit, Gjykata vlerësoi se nuk kishte pasur diskriminim në këtë çështje.

25. znj. Pretty vdiq për shkaqe natyrore vetëm pak ditë pas dhënies së vendimit të lartpërmendur.

74 Shih për shembull Raportin e Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut të 12 tetorit 1978 në lidhje me çështjen *Arrowsmith kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

## QENDRA PËR BURIME LIGJORE NË EMËR TË VALENTIN CAMPEANU kundër RUMANISË

(kërkesa nr. 47848/08)

17 korrik 2014

### Dhomë e Madhe

*një OJF sjell një rast para Gjykatës në emër të një të riu me aftësi të kufizuara mendore i cili vdiq në një spital psikiatrik*

#### I. Faktet kryesore

1. Kjo kërkesë u soll përpara Gjykatës nga një OJF rumune, Qendra për Burime Ligjore (tani e tutje QBL). Kjo OJF e solli kërkesën në emër të Valentin Campeanu, një shtetas rumun i cili kishte lindur në vitin 1985 dhe vdiq në vitin 2004. z. Campeanu ishte braktisur nga prindërit që në lindje dhe ishte vendosur në një jetimore.

2. Në vitin 1990, që kur ishte vetëm 5 vjeç, ai u diagnostikua si HIV-pozitiv dhe se vuante nga një paaftësi të rënda mendore. Në mars të vitit 1992, ai u transferua në Qendrën për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara në Craiova dhe më vonë në Qendrën e Kujdesit nr. 7 në Craiova (tani e tutje "Qendra e Kujdesit"). Në shtator 2003, Këshilli rajonal për Mbrojtjen e Fëmijëve urdhëroi që për z. Campeanu nuk duhet të kujdesej më shteti, për shkak se ai kishte arritur moshën 18 vjeç dhe nuk është regjistruar në ndonjë formë arsimimi. Në fillim të shkurtit të vitit 2004, pas refuzimeve të njëpasnjëshme nga një sërë institucionesh që ta pranonin z. Campeanu, në fund ai u pranua në një qendër të kujdesit mjekësor dhe social (tani e tutje "QKMS"), personeli i së cilës konstatoi se ai ishte në një gjendje të avancuar degradimi psikiatrik dhe fizik, se nuk kishte marrë ndonjë mjekim antiretroviral dhe se vuante nga kequshqyerja. Më 9 shkurt, pas një krize të papritur ku dyshohet se z. Campeanu ka reaguar në mënyrë agresive ai u dërgua në Spitalin neuropsikiatrik Poiana Mare (tani e tutje "SPM") për ekzaminim dhe trajtim. Megjithatë, ai u kthye në Qendrën e Kujdesit në të njëjtën ditë. Më 13 shkurt, z. Campeanu u dërgua përsëri për SPM për trajtim. Ai u mbajt aty një javë dhe u vendos në pavijone të ndryshme psikiatrike.

3. Më 20 shkurt ai u vu re nga një ekip vëzhguesish të Qendrës për Burime Ligjore (QBL) të cilët raportuan se z. Campeanu mbahej i izoluar në një dhomë pa ngrohje, me një shtrat, por pa shtroje, i veshur në mënyrë të pamjaftueshme vetëm me bluzë pizhamesh dhe pa ndihmën e nevojshme për të ngrënë ose për të përdorur pajisjet sanitare, përderisa punonjësit e spitalit mesa duket refuzonin

ta ndihmonin për shkak të frikës nga HIV. Përfaqësuesit e QBL deklaruan se ata kishin kërkuar që ai të transferohej menjëherë në Spitalin e Sëmundjeve Infektive të Krajovës, ku ai do të mund të merrte trajtimin e duhur. Megjithatë, drejtori i spitalit nuk kishte qenë dakord, duke besuar se pacienti nuk ishte një "rast urgjent, por një rast social", dhe se në çdo rast ai nuk do të ishte në gjendje të përballonte udhëtimin. Në të njëjtën ditë, më 20 shkurt 2004, z. Campeanu vdiq.

4. Duke mos pasur dijeni për vdekjen e z. Campeanu, QBL iu dërgoi urgjentisht disa letra një numri zyrtarësh vendorë dhe qendrorë, duke theksuar gjendjen e tij shumë kritike dhe faktin se ai ishte transferuar në një institucion që nuk ishte në gjendje t'i siguronte kujdesin e duhur. QBL kritikoi gjithashtu trajtimin e papërshtatshëm që ai kishte marrë dhe kërkoi marrjen e masave urgjente për të përmirësuar situatën. Ajo theksoi më tej se pranimi i z. Campeanu në QKMS dhe transferimi i tij i mëvonshëm në SPM ishte bërë në shkelje të të drejtave të tij njerëzore, dhe kërkoi që të fillonte një hetim në lidhje me këtë situatë. Më 22 shkurt 2004, QBL dha një deklaratë për shtyp ku nënvizonte kushtet dhe trajtimin e pacientëve në SPM, duke iu referuar të veçantë në rastit të z. Campeanu dhe duke bërë thirrje për masa urgjente.

5. Pas shumë ankesave nga QBL dhe pas hetimit penal të mëvonshëm mbi vdekjen e z. Campeanu, hetim që nuk dha asnjë rezultat konkret, QBL iu drejta Gjykatës së Strasburgut duke pretenduar se ishin shkelur të drejtat e z. Campeanu sipas neneve 2, 3, 5, 8, 13 dhe 14.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Mbi pranueshmërinë

6. Qeveria rumune pretendoi se QBL nuk legjitimohej për të paraqitur një kërkesë në emër të Valentin Campeanu, pasi nga njëra anë ajo nuk mund të pretendonte se ishte vetë viktimë e shkeljeve të pretenduara Konventës dhe, nga ana tjetër, nuk mund as të pretendonte se ishte përfaqësuese ligjore e autorizuar e z. Campeanu. Gjykata theksoi se Konventa garanton të drejta që janë praktike dhe efektive, dhe jo teorike dhe iluzive, dhe duke pasur parasysh natyrën serioze të pretendimeve, QBL duhet të kishte mundësi të vepronte si përfaqësuese e z. Campeanu.

### B. Mbi aspektet materiale të nenit 2

7. Gjykata deklaroi se vendimi i autoriteteve rumune për ta vendosur z. Campeanu në QKMS dhe më pas për ta transferuar në SPM u përcaktua kryesisht nga kriteri se cili institucion ishte i gatshëm për ta pranuar dhe jo aq nga kriteri se ku ai do të ishte në gjendje të merrte kujdesin dhe mbështetjen e duhur mjekësore. Duke pasur parasysh se QKMS nuk ishte e pajisur si duhej për trajtimin e pacientëve të sëmurë mendërisht, ata e transferuan atë në SPM, pavarësisht nga fakti se spitali më parë kishte refuzuar ta pranonte, dhe më pas ishte vendosur në një pavijon pa staf psikiatrik. Transferimi nga një objekt

në një tjetër kishte ndodhur pa ndonjë diagnostikim adekuat dhe përkujdesje e vazhdueshme dhe në mospërfillje të plotë të gjendjes shëndetësore të z. Campeanu dhe të nevojave të tij elementare mjekësore. Gjykata i kushtoi rëndësi të veçantë faktit që autoritetet nuk kishin arritur t'i administronin atij një mjekim antiretroviral. Ajo i kushtoi vëmendje të veçantë gjithashtu gjendjes të brishtë të z. Campeanu, dhe faktit që për të gjithë jetën e tij z. Campeanu kishte qenë në duart e autoriteteve, të cilat për këtë arsye ishin të detyruara të jepnin llogari për trajtimin e tij. Duke vendosur ta shtronin z. Campeanu në spitalin psikiatrik, edhe pse ishin në dijeni të kushteve të tmerrshme në atë spital, autoritetet e kishin vënë në mënyrë të paarsyeshme jetën e tij në rrezik. Dështimi për t'i siguruar atij kujdesin dhe trajtimin e duhur ka qenë një tjetër faktor vendimtar që çoi në vdekjen e tij të parakohshme. Në këto kushte Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet rumune kanë shkelur nenin 2 duke dështuar të sigurojnë mbrojtjen e nevojshme të jetës së z. Campeanu.

### *C. Mbi aspektet procedurale të nenit 2*

8. Duke pasur parasysh se autoritetet kishin dështuar të sqaronin rrethanat e vdekjes së z. Campeanu dhe të identifikonin personat përgjegjës për këtë vdekje, Gjykata konstatoi shkelje të aspekteve procedurale të nenit 2 të Konventës.

### *D. Në lidhje me nenin 13 të marrë sëbashku me nenin 2*

9. Gjykata konstatoi gjithashtu, se në Rumani nuk kishte një mekanizëm të përshtatshëm për ndreqjen e situatës ose dëmshpërblimin e personave me aftësi të kufizuara mendore që pretendojnë se janë viktimat sipas nenit 2. Për këtë arsye, Gjykata vendosi edhe shkelje të nenit 13 të Konventës të marrë në lidhje me nenin 2.

### *E. Në lidhje me e tjera*

10. Duke pasur parasysh konstatimet e saj sipas neneve 2 dhe 13, Gjykata u shpreh se nuk ishte e nevojshme për të shqyrtuar më vete edhe pretendimet në bazë të nenit 3, të marra veçmas dhe në lidhje me nenin 13, apo në bazë të neneve 5, 8 dhe 14.

### *F. Në lidhje me nenin 46*

11. Gjykata u shpreh se shteti i paditur, duhet të marrë masat e përgjithshme të nevojshme për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara mendore në situata të ngjashme t'u mundësohet përfaqësim i pavarur, duke u lejuar atyre që ankesat që kanë në bazë të Konventës në lidhje me shëndetin dhe trajtimin e tyre të shqyrtohen nga një gjykatë ose organ tjetër i pavarur.

### *G. Në lidhje me nenin 41*

12. QBL nuk kishte paraqitur ndonjë pretendim në lidhje me dëmin material ose jo-material, kështu asnjë shumë nuk u akordua nën këtë zë. Gjykata vendosi që Rumania duhet t'i paguajë 10 000 euro QBL dhe 25 000 euro organizatës Interights, i cili ka vepruar si këshilltarë e QBL, për kostot dhe shpenzimet.

### III. Koment

13. Ky vendim i shtohet një jurisprudence tashmë të pasur të Gjykatës në lidhje me çështje të personave me probleme të shëndetit mendor<sup>75</sup>. Megjithatë, ky vendim ka një rëndësi thelbësore në ngrehinën kushtetuese të Gjykatës për disa arsye tepër specifike.

14. Së pari ky është rasti i parë kur një OJF pranohet si përfaqësuese e një viktime të shkeljes së një neni të Konventës, konkretisht të nenit 2, ndërkohë që OJF jo vetëm që nuk mund të pretendonte të ishte vetë viktimë e ndonjë shkeljeje, por as nuk kishte asnjë lloj autorizimi për ta përfaqësuar viktimën reale, z. Campeanu, në Strasburg<sup>76</sup>. Megjithatë, duke iu referuar një prej parimeve themelore të jurisprudence së saj, atij të garantimit të të drejtave praktike dhe efektive dhe jo teorike dhe iluzive, Gjykata e pranoi QBL si përfaqësuese të Valentin Campeanu. Natyrisht që ky është një konkluzion tepër specifik që duhet kuptuar në kuadrin e rrethanave konkrete të çështjes. Nëse Gjykata nuk do e kishte pranuar QBL si përfaqësuese, atëherë të asnjë nga pretendimet në lidhje me trajtimin dhe vdekjen e z. Campeanu nuk do kishte marrë përgjigje<sup>77</sup>. Duhet pasur parasysh së pari se z. Campeanu kishte vdekur ndërkaq, se ai nuk kishte të afërm që mund ta përfaqësonin pas vdekjes sepse e kishin braktisur, se ai që i vogël vuante nga problemet mendore, se ai kishte qënë gjatë gjithë jetës nën kujdesin e autoriteteve, se QBL ishte e vetmja që ishte interesuar për fatin e tij në Rumani dhe, së fundmi, që legjislacioni rumun nuk parashikonte asgjë në lidhje me përfaqësimin e personave me probleme mendore. Madje në këtë pikë, m Gjykata dha edhe orientime në kuadrin e nenit 46 të Konventës në lidhje me masat që duheshin marrë nga autoritetet rumune. Gjyqtari Pinto de Albuquerque në mendimin e tij të pakicës, pretendon që ky rast duhet të kishte shërbyer si një udhërrëfyes për të sqaruar standardet e përfaqësimit në Gjykatë të personave me probleme mendore, dhe jo të ngelet si rast përjashtimor. Megjithëse ky argument nuk u pranua nga shumica, fakti është që rrethanat specifike dhe tepër të brishta të personave në kushte të tilla dhe që nuk kanë të

75 Shih për shembull *Shtukaturov k. Rusisë*, 27.03.2008, *Hadzic dhe Suljic k. Bosnjës dhe Hercegovinës*, 7.6.2011, *X dhe Y. k. Kroacisë*, 3.11.2011, *Stanev k. Bullgarisë*, 17.1.2012, *Pleso k. Hungarisë*, 2.10.2012, dhe *Mihailovs k. Letonisë*, 2.1.2013,). Shih gjithashtu *Musial k. Polonisë*, 2009

76 Është interesante të kujtohet që edhe gjatë parashtresës së qëndrimeve të tyre në seancën e Dhomës së Madhe në Strasburg, përfaqësuesit e QBL nuk ishin krejt të qartë për linjën që duhet të mbanin, herë duke iu referuar OJF-së së tyre si viktimë, herë si përfaqësuese. Kjo edhe për shkak se nuk kishte jurisrudencë deri në atë moment mbi një situatë të tillë, ose ajo që ekzistonte i kishte hedhur kërkesat poshtë në nivel Komiteti ose Gjyqtari të vetëm për mungesë të *locus standi*. Krahaso me vendimet e papranueshmërisë *Association des amis de Saint-Raphaël et de Fréjus dhe të tjerë k. Francës* (dec.), nr. 45053/98, 29.02.2000, *Smits, Kleyn, Mettler Toledo B.V. et al., Raymakers, Vereniging Landelijk Overleg Betuweroute et Van Helden k. Holandës* (dec.), nr. 39032/97, 39343/98, 39651/98, 43147/98, 46664/99 et 61707/00, 3.5.2001, *Dayras dhe të tjerë dhe shoqata « SOS Sexisme » k. Francës* (dec.), nr. 65390/01, 6.01.2005, *Grande Oriente d'Italia di Palazzo Giustiniani k. Italisë* (nr. 2), nr. 26740/02, 31.05.2007, *Ada Rossi dhe të tjerë k. Italisë* (nr 55185/08, 16.12.2008) ku shoqatave nuk iu pranua *locus standi* përpara Gjykatës.

77 Krahaso me *Nencheva dhe të tjerë k. Bullgarisë* (nr. 48609/06), 18.06.2013, përfshirë në këtë botim, ku cilësia si kërkues para Gjykatës e Shoqatës për Integrim Evropian dhe të drejtat e njeriut, ndryshe nka ky rast, nuk u pranua.



afërm, përbëjnë një bazë të fortë që OJF të ndryshme të arrijnë të përfaqësojnë me sukses këta persona edhe në mungesë të një prokure.

15. Pasi zgjidhi çështjen e *locus standi*, mënyra e trajtimit të z. Campeanu e bënte të qartë në sytë e Gjykatës se ai i ishte nënshtruar një trajtimi që gradualisht kishte çuar në vdekjen e tij, duke u lënë jo vetëm pa trajtimin e duhur mjekësor, por edhe në kushte tepër të rënda, aq më tepër për gjendjen e tij. Në fakt, ky është vendimi i parë i Gjykatës në lidhje me personat me probleme mendore që vendos mbi të drejtën e jetës së tyre. Përfundimi i Gjykatës mbështetet në një masë të madhe në faktin se z. Campeanu ishte në një gjendje tepër të brishtë dhe që foshnjë kishte qenë plotësisht nën kontrollin e autoriteteve, nga ku lind edhe përgjegjësie e tyre për trajtimin e tij. Gjykata gjeti gjithashtu, shkelje të aspektit procedural të nenit 2 pasi autoritetet nuk kishin bërë asgjë për të sqaruar rrethanat dhe gjetur përgjegjësit e trajtimit dhe vdekjes së z. Campeanu. Interesante është të theksohet se ndryshe një praktika e saj e zakonshme, ku pasi gjen shkelje procedurale të nenit 2, Gjykata nuk e vlerëson të nevojshme të analizojë edhe nenit 13, për vetë marrëdhënien juridike mes këtyre standardeve, në këtë rast, përjashtimisht, Gjykata përveç shkeljes procedurale të nenit 2 gjen edhe shkelje të nenit 13. Kjo sidomos, për faktin se sistemi rumun në përgjithësi kishte mangësi ligjore mbi garantimin e përfaqësimit të personave me probleme mendore të cilët nuk mund të përfaqësohet vetë. Me këtë konstatim lidhet dhe udhëzimi në bazë të nenit 46 të Konventës<sup>78</sup>.

16. Bashkë me kolegët Spielman dhe Nussberger, mbajta (L.B.) qëndrimin se ky vendim duhet të ishte ndalur më vehte edhe në një analizë të nenit 3 të Konventës. Shumica nuk e pranoi këtë qëndrim me pretendimin se gjetja e shkeljes së nenit 2 e bënte të panevojshme këtë analizë. Megjithatë, mendimi ynë ishte se gjetja një shkelje sipas nenit 3 mund të parandalonte situata kaq tragjike si ajo e z. Campeanu në të ardhmen<sup>79</sup>. Në qoftë se garancitë nuk operojnë ndërsa mund të ngrihen pretendime në lidhje me nenin 3, marrja e masave për mbrojtjen e jetës në bazë të nenit 2 mund të jetë tepër e vonë dhe fatkeqsisht edhe joefikase<sup>80</sup>, siç ishte në rastin e z. Campeanu.

78 Interesant është të kujtohet në këtë koment mendimi këshillimor i Gjykatës Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut (OC-17/2002, 28.08.2002). në këtë mendim ajo Gjykatë saktëson se jo vetëm që institucionet shtetërore duhet të ndërhyjnë për të mbrojtur interesin më të mirë të fëmijës, por ato duhet gjithashtu të kenë të gjithë "elementët e nevojshëm për të mbrojtur interesin më të mirë të fëmijës", duke përfshirë, "institucione të kualifikuara, me staf të përshtatshëm, lehtësi adekuate, mjete të përshtatshme dhe përovojë të provuar".

79 Shih gjithashtu *Ilbeyi Kemaloğlu e Meriye Kemaloğlu k. Turqisë*, nr. 19986/06, § 35, 10.04. 2012 dhe, po ashtu, në kuadrin e ndihmës dhe të përkujdesit mjekësor për fëmijë në moshë të njomë të vendosur në institucione publike shih *Nencheva e të tjerë k. Bullgarisë*, §§ 105-116, z. k. *Mbretërisë së Bashkuar ose A. k. Mbretërisë së Bashkuar në të cilën Gjykata u shpreh se autoritetet "duhet të ofrojnë mbrojtje efektive, sidomos, ndaj fëmijëve dhe personave të tjerë të brishtë dhe të marrin masa të arsyeshme për të parandaluar keqtrajtimit për të cilat autoritetet kishin ose duhet të kishin dijeni"*.

80 Shih Alastair R. Mowbray, "The development of positive obligations under the European Convention on Human Rights by the European Court of Human Rights", Oxford, 2004, pp. 43-65.

## NENCHEVA DHE TË TJERË kundër BULLGARISË

(kërkesa nr. 48609/06)

18 qershor 2013

*kjo çështje ka të bëjë me detyrimet që kanë autoritetet në rast vdekje të personave me aftësi të kufizuara që janë nën kujdesin e shtetit*

### I. Faktet kryesore

1. Tetë kërkuesit e parë janë prindër të shtatë nga pesëmbëdhjetë fëmijët dhe të rinjtë të moshës nën 22 vjeç, të cilët humbën jetën gjatë dimrit të viteve 1996-1997 në një shtëpi kujdesi për fëmijë me probleme të rënda të shëndetit mendor, në fshatin Dzhurkovo të Bullgarisë. Kërkuesja e nëntë është një shoqatë e njohur si Shoqata për Integrim Evropian dhe të drejtat e njeriut. Shtëpia e kujdesit në Dzhurkovo strehonte rreth tetëdhjetë fëmijë gjatë dimrit të vitit 1996-1997. Të gjithë fëmijët kishin aftësi të kufizuara fizike ose mendore. Disa prej tyre ishin vendosur në shtëpi me një vendim administrativ të nxjerrë pasi prindërit e tyre kishin rënë dakord që ata të birësoheshin, ndërsa të tjerët ishin vendosur atje me kërkesë të drejtpërdrejtë të prindërve të tyre.

2. Në vitet 1996-1997, Bullgaria përjetoi një krizë të rëndë ekonomike, financiare dhe sociale. Inflacioni u rrit në mbi 1.000%. Buxheti i caktuar për shtëpinë në Dzhurkovo, që ishte në përgjegjësinë e kryetarit të komunës, humbi një pjesë të konsiderueshme të vlerës së tij, dhe për pasojë autoritetet vendore nuk ishin më në gjendje të mbulonin shpenzimet e ushqimit dhe furnizimeve bazë. Duket se gjatë atij dimri, shtëpia e Dzhurkovo, kishte në dispozicion afërsisht 0.80 euro në ditë për fëmijë.

3. Në kohën e ngjarjeve në shtëpinë e kujdesit kishte një ndihmës mjek, pesë infermierë, katër kujdestare dhe një pastruese. Megjithëse struktura e parashikonte, nuk kishte mjek. Gjatë dimrit, shtëpia ishte e paarrtshme me makinë për shkak të kushteve klimaterike. Spitali më i afërt ishte 40 km larg dhe nuk kishte transport të përshtatshëm për fëmijë të sëmurë. Stafi duhej të ecte 5 km për të shkuar në punë. Ngrohja bëhej një orë në mëngjes dhe një orë në mbrëmje dhe ushqimi ishte shumë i papërshtatshëm. Stafi dhe banorët e fshatit aty pranë sillnin ushqim vullnetarisht që fëmijët të mos ngeleshin pa ngrënë dhe kushtet higjienike ishin të papërshtatshme.

4. Më 20 shtator 1996, drejtoresha e shtëpisë i dërgoi Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale një letër të nënshkruar nga kryetari i bashkisë të Lakit, duke raportuar për situatën shumë të vështirë në shtëpi. Ajo kërkoi që Ministria të

mernte masa dhe të specifikojnë sasinë e ushqimeve dhe ilaçeve të kërkuara. Më 10 dhjetor 1996, drejtoresha dhe kryetari i bashkisë iu drejtuan Agjencisë për ndihmë të huaj, duke e informuar atë se situata në shtëpi ishte shumë shqetësuese dhe se masa urgjente ishin të nevojshme për të siguruar karburant, ushqim dhe nevoja themelore, pasi bashkia nuk kishte fondet e nevojshme por kërkesat e tyre nuk morën përgjigje. Më 15 dhjetor 1996, vdiq fëmija i parë. Më 22 janar 1997, një grup prej tetë fëmijëve nga një shtëpi tjetër e kujdesit u vendosën në Dzhurkovo, në bazë të një vendimi nga shërbimet sociale bashkiake. Drejtoresha u ankua dhe më 17 janar 1997, bashkë me Kryetarin e Bashkisë së Lakit, iu drejtuan përsëri Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale, Ministrisë së Financave dhe Prefektit, duke kërkuar që të merren masa urgjente pasi ekziston rreziku që fëmijët të mos mbijetonin në kushtet e dimrit. Drejtoresha kërkoi ndihma private edhe me anë të radios. Kur Ministria akordoi ndihmën e parë prej 3 720 në shkurt 1997 pesëmbëdhjetë fëmijë kishin vdekur ndërkaq.

5. Më 30 korrik 1999, prokuroria e rrethit nisi procedimin penal kundër një ose disa personave të panjohur në lidhje me dhjetë nga pesëmbëdhjetë vdekjet në shtëpinë e kujdesit. Ajo urdhëroi një hetim që synonte të përcaktojë nëse ekzistonte një lidhje shkakësore midis vdekjeve dhe një shkelje të mundshme të detyrimit për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e pacientëve duke plotësuar nevojat e tyre në aspektin e ushqimit, ngrohjes dhe nevojave të tjera bazë. Hetuesi urdhëroi një raport mjeko-ligjor mbi shkaqet e vdekjes së katërmëdhjetë fëmijëve. Raportet thanë se, në mungesë të një autopsie, ishte e vështirë të përcaktohej shkaku i saktë i vdekjes.

6. Më 5 prill 2004, drejtoresha, ndihmësmjekja dhe kryeinfermjerja u akuzuan për vrasje nga pakujdesia. Më 4 tetor 2004, hetuesi kërkoi nga Ministria e Punës dhe Politikave Sociale dhe nga Ministria e Financave që të paraqiste dokumente në lidhje me ngjarjen. Ministria u përgjigj se në kohën e ngjarjeve, shtëpia e Dzhurkovo, nuk varej nga buxheti i Ministrisë, por nga ai i Bashkisë. Ajo shtoi se arkivat e Ministrisë nuk përmbanin asnjë korrespondencë nga ajo periudhë. Një zëvendësministër i Financave nga ana tjetër, e informoi hetuesin se dosjet në lidhje me periudhën në fjalë ishin shkatërruar me skadimin e afatit ligjor për mbajtjen e dokumenteve. Po këtë përgjigje, i dha hetuesit edhe Bashkia e Lakit.

7. Më 17 janar 2005, prokuroria paraqiti në gjykatë akuzën për neglizhencë profesionale, duke rezultuar në vdekjen e tremëdhjetë fëmijëve në rrethana veçanërisht të rënda, kundër drejtoreshës, ndihmësmjekes dhe kryeinfermjes. Me një vendim të 18 majit 2005, Gjykata i shpalli ato të pafajshme, vendim që u la në fuqi në apel dhe në Kasacion. Gjykatat bullgare konstatuan se vetëm dy prindër ishin interesuar dhe kishin vizituar fëmijët e tyre, dhe përveç njëri, asnjë nga prindrit e tjerë nuk morën pjesë as në funerale.

8. Duke u bazuar në nenet 2, 3 dhe 13, kërkuesit/prindër dhe shoqata për Integrim Evropian dhe të drejtat e njeriut pretenduan në Strasburg se autoritetet

bullgare kishin dështuar në detyrimet e tij pozitive për të mbrojtur jetën e personave në kujdesin e shtetit dhe për të kryer një hetim efektiv me qëllim identifikimin e atyre që janë përgjegjës për vdekjen. Ata pretenduan gjithashtu, se kushtet në shtëpinë e Dzhurkovo përbënin trajtim çnjerëzor dhe degradues si dhe për mungesën e mjeteve efektive sipas nenit 13, në raport me nenet 2 dhe 3. Duke u bazuar në nenin 6 (e drejta për dëgjim të drejtë), aplikantët të cilët kishin sjellë një ndjekje private në procedurën penale pretendonin se refuzimi i gjykatës për t'u dhënë atyre leje për t'u bashkuar me procedurat, pasi që palët civile i kishin privuar ata nga çdo mundësi për të pasur pretendimet e tyre për dëmshpërblim ndaj menaxherit të shtëpisë, infermieres së kokës dhe oficerit mjekësor të përcaktuar nga një gjykatë. Ata gjithashtu, u ankuan për kohëzgjatjen e procedurës penale.

## II. Vendimi i Gjykatës

### *a) Në lidhje me nenet 2, 3 dhe 13*

#### *i) në lidhje me detyrimet pozitive për mbrojtjen e jetës*

9. Gjykata vlerësoi se autoritetet duhet ta kishin ditur se ekzistonte një rrezik real për jetën e fëmijëve në shtëpi dhe se ato nuk kishin marrë masat e nevojshme brenda kufijve të kompetencave të tyre. Fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 22 vjeçare të vendosur në shtëpi, kanë qenë persona të brishtë që vuanin nga aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, të cilët ishin braktisur nga prindërit ose ishin vendosur në shtëpi me pëlqimin e prindërve. Të gjithë i ishin besuar kujdesit të shtetit në një strukturë publike të specializuar dhe kishin qenë nën mbikëqyrjen ekskluzive të autoriteteve.

10. Gjykata vuri në dukje se, në kushtet e një dimri të ashpër dhe krizës së rëndë ekonomike, njoftime dhe të dhëna specifike në lidhje me rrezikun për fëmijët për shkak të ngrohjes, ushqimit dhe ilaçeve të papërshtatshme dhe të pamjaftueshme iu ishin vënë në dispozicion autoriteteve të paktën që nga 10 shtatori 1996. Që në atë datë, Drejtoresha e shtëpisë, me mbështetjen e krybashkiakut të Lakit, kishte filluar të paralajmëronte autoritetet dhe të kërkonte ndihmën e duhur, duke theksuar vazhdimisht seriozitetin e kushteve në shtëpi dhe vështirësinë në sigurimin e kujdesit të nevojshëm. Ngjarjet tragjike nuk kishin ndodhur në një mënyrë të papritur, të njehershme dhe të paparashikuar, si në rastin e një ngjarjeje madhore me të cilën shteti mund të mos ishte në gjendje ta parashikonte dhe ta përballonte. Gjykata konsideroi se rasti në fjalë kishte të bënte me një situatë në të cilën ishte në rrezik jeta e personave të brishtë që janë nën kujdesin e shtetit, një situatë në të cilën autoritetet kishin qenë plotësisht të vetëdijshme dhe të cilat mund të përshkruheshin si një krizë kombëtare. Nga dosja e çështjes ishte e qartë se autoritetet nuk kishin marrë masa të shpejta, praktike dhe të mjaftueshme për të parandaluar vdekjet, pavarësisht se kishin njohuri të sakta për rrezikun real dhe të menjëhershëm ndaj jetës së personave në fjalë.

*ii) në lidhje me kryerjen e një hetimi efektiv*

11. Përsa i përket kryerjes së një hetimi efektiv, Qeveria bullgare pretendoi se kërkuesit mund të kishin pretenduar një kompensim civil. Megjithatë, Gjykata u shpreh se në rrethana të jashtëzakonshme, vetëm procedurat civile që mundësojnë që kërkuesit të kërkojnë dhe të marrin kompensim individual nuk mund të konsiderohen si një masë adekuate për qëllimet e detyrimit të shtetit të paditur për të filluar një hetim efektiv mbi rrethanat e rastit e për të dhënë një përgjigje në kuptim të nenit 2 të Konventës. Duke qenë se procedimet civile vareshin vetëm nga iniciativa e viktimave, Gjykata mori në konsideratë se ato nuk mund të merren parasysh në kontekstin e reagimit të kërkuar nga shteti, pasi neni 2 vendoste një detyrim ndaj autoriteteve për të kryer një hetim ex officio. Hetimi zyrtar nuk kishte filluar deri në dy vjet pas ngjarjeve dhe procedurat penale më pas kishin zgjatur rreth tetë vjet. Autoritetet nuk duket se kanë qenë aktive në mes të 2001 dhe prillit 2004. Mungesa e një zelli të tillë ngre dyshime nëse hetimet janë kryer në mirëbesim.

12. Gjykata vlerësoi se shteti i paditur kishte shkelur detyrimin e tij për të mbrojtur jetën e fëmijëve të vendosur në kujdesin e saj dhe kishte dështuar në detyrën e tij për të kryer një hetim efektiv. Prandaj, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 2 të Konventës.

***B. Në lidhje me nenin 13 të marrë së bashku me nenin 2***

13. Gjykata vuri në dukje se kërkesa për kompensim në parim mund të ishte parashtruar në kohën e ngjarjeve kundër Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale dhe komunës së Lakit, institucionet përgjegjëse për shtëpinë e Dzhurkovo. Gjykata u shpreh se dështimi i procedurës penale nuk i kishte penguar kërkuesit që të bënin padi civile për kompensim paralelisht me procedurën penale. Prandaj, konstatoi se ankesa sipas nenit 13 në lidhje me nenin 2 ishte e papabuar.

***C. Në lidhje me nenin 6***

14. Përsa i përket shkeljeve të pretenduara të së drejtës për akses në gjykatë për të shqyrtuar paditë civile, Gjykata vërejti se vendimi i Gjykatës për të mos bashkuar paditë civile me procedurën penale nuk ishte kontestuar dhe se refuzimi nuk kishte ndikuar negativisht në aftësinë e aplikantëve për të filluar procedimet në gjykatat civile paralelisht me procedurën penale. Meqë kërkuesit nuk e kishin parashtruar ankesën e tyre në Gjykatë brenda gjashtë muajve, ajo ishte jashtë afatit. Sa i përket ankesës lidhur me kohëzgjatjen e procedurës penale, neni 6 nuk ishte i zbatueshëm pasi që aplikantët nuk ishin bashkuar në procedurë si palë civile.

***D. Në lidhje me nenin 41 - shpërblimi i drejtë***

15. Gjykata u shpreh se Bullgaria duhet t'i paguajë secilit kërkuesve Georgi Vasilev Georgiev dhe Fani Filipova Evtimova 10,000 eurove ankuesve në lidhje me dëmin jomonetar dhe 2,000 euro në lidhje me shpenzimet atyre dhe Shoqatës

për Integritet Evropian dhe të Drejtat e Njeriut. Përsa u përket kërkuesve të tjerë, Gjykata vlerësoi se vendimi përbënte në vetvete një shpërblim të mjaftueshëm për dëmin jomonetar të pretenduar.

### III. Koment

16. Kjo është padyshim një nga çështjet më të dhimbshme që më është dashur të shqyrtoj në Strasburg. Pesëmbëdhjetë fëmijë dhe të rinj, të gjithë nën 22 vjeç, me aftësi të kufizuara dhe në pamundësi për të luftuar për jetën e tyre, që vdesin në kushte të tmerrshme të ftohti, urie dhe trajtimi të pamjaftueshëm. E gjitha kjo, binte në veshin e shurdhër të autoriteteve qendrore, të cilat ishin pre e procedurave të akordimit të fondeve. Çështja është akoma më tragjike se ajo që Dhoma e Madhe do vendoste një vit më vonë, *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Campeanu kundër Rumanisë*<sup>81</sup>, qoftë për nga numri i viktimave qoftë edhe nga rrethanat e rasteve.

17. Dyshimi fillestar që ka shqetësuar Gjykatën në këtë çështje është nëse tetë kërkuesit e parë, prindër të shtatë prej viktimave në shtëpinë e kujdesit në Dzhurkovo mund të kishin *locus standi* si kërkues përpara Gjykatës. Dilema ishte jo e vogël po të mbahet parasysh se ishin kërkuesit ata që për arsye të ndryshme i kishin lënë fëmijët e tyre nën kujdesin e shtetit, dhe ku pjesa më e madhe prej tyre nuk ishin interesuar për fatin e fëmijëve. Megjithatë, Gjykata përdor një kriter procedural të qartë, faktin se prindërit/kërkues ishin pranuar si palë në procedurat përpara gjykatave bullgare justifikon interesin e tyre të mjaftueshëm për qëllimet e ankimit në Gjykatë. Ndërkohë që Gjykata nuk pranoi cilësinë e viktimës të Shoqatës për Integritet Evropian dhe të drejtat e njeriut<sup>82</sup>.

18. Në lidhje me themelin e çështjes, vlerësimi i Gjykatës fillon duke kujtuar se fjalia e parë e nenit 2, që është një nga nenet thelbësore të Konventës, pasi i kushtohet një prej vlerave themelore të shoqërive demokratike që formojnë Këshillin e Evropës, i vendos shteteve detyrimin që jo vetëm të abstenojnë nga shkaktimi i vdekjes me « qëllim », por edhe të marrin masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës së personave nën juridiksionin e tyre<sup>83</sup>. Në një paragraf tepër të rëndësishëm të vendimit, 106, Gjykata ofron një kujtesë të rëndësishme të jurisprudencës së saj në lidhje me detyrimet me karakter pozitiv të shteteve për mbrojtjen e jetës. Ajo kujton se ky detyrim lind, ndër të tjera, por jo vetëm, në

81 Vendim i Dhomës së Madhe i 17.07.2014 (nr. 47848/08), përmbledhja e të cilit është përfshirë në këtë botim.

82 Id. krahaso me qëndrimin e Gjykatës në lidhje me Qendrën për Burime Ligjore.

83 Gjykata i referohet jurisprudencës *McCann dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar, L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 9.6.1998, Përmbledhje 1998 III, *Calvelli dhe Ciglio k. Italisë* [DH.M], nr. 32967/96, GJEDNJ 2002 I, *Vo k. Francës* [DH.M.], nr. 53924/00, GJEDNJ 2004 VIII, *Dodov k. Bullgarisë*, nr. 59548/00, 17.01.2008)



fushën e veprimtarive të rrezikshme<sup>84</sup>, të shëndetit publik<sup>85</sup>, të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore<sup>86</sup>, të sistemit social<sup>87</sup>, siguria e vendeve publike, për të shmangur lëndime apo vdekje të njerëzve që ndodhen aty<sup>88</sup>. Gjykata kujton se detyrimi i shtetit për të mbrojtur jetën është konsideruar se përfshin edhe detyrimin për të garantuar shërbimin e ndihmës së shpejtë, kur autoritetet informohen se jeta apo shëndeti i një personi është në rrezik për shkak të një aksidenti<sup>89</sup>. Çka është veçanërisht e rëndësishme për çështjen konkrete, ajo ka theksuar se ky detyrim zbatohet edhe ndaj autoriteteve në fushën e mësimdhënies shkollore, të cilët marrin përsipër detyrimin për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqënies së nxënësve, e më saktë të fëmijëve të vegjël, të cilët janë veçanërisht të brishtë dhe që ndodhen në kontrollin ekskluziv të autoriteteve<sup>90</sup>. Në prani të një mosveprimi dhe neglizhence evidente nga ana e autoriteteve, të cilat ishin vënë vazhdimisht në dijeni të situatës, Gjykata nuk mund të mos gjente shkelje të aspektit substancial të nenit 2.

19. Nga ana tjetër, në lidhje me kryerjen e një hetimi efektiv, Gjykata vuri re vonesa dhe një mungesë zelli të pajustificueshme. Hetimi filloi me vonesë të tepruar, për periudha të gjata nuk u mor asnjë masë hetimore. Për më tepër, objekti i hetimit ishte tepër i ngushtë dhe nuk nxirrte në pah të gjithë personat përgjegjës për çuarjen e situatës deri në një ekstrem fatal<sup>91</sup>. Në këto kushte, ajo konstatoi edhe shkelje të aspektit procedural të nenit 2.

84 Shih *Öneryıldız k. Turqisë*, i përfshirë në këtë botim, *Iliya Petrov k. Bullgarisë*, nr. 19202/03, 24.04.2012, *Kolyadenko dhe të tjerët k. Rosisë*, nr. 17423/05, 20534/05, 20678/05, 23263/05, 24283/05 dhe 35673/05, 28.02.2012.

85 *Calvelli dhe Ciglio k. Italisë*, i përfshirë në këtë botim.

86 *Boudaïeva dhe të tjerë k. Rosisë*, përfshirë në këtë botim, *Murillo Saldias dhe të tjerët k. Spanjës*, nr. 76973/01, 28.11.2006

87 *Dodov k. Bullgarisë*, nr. 59548/00, 17.01.2008.

88 *Ciechońska k. Polonisë*, nr. 19776/04, 14.06.2011.

89 *Furdik k. Sllovakisë*, nr. 42994/05, 2.12.2008.

90 *İlbeyi Kemaloğlu dhe Meriye Kemaloğlu k. Turqisë*, nr. 19986/06, 10.04.2012.

91 Theksojmë se për Gjykatën detyrimi procedural i nenit 2 nuk konsiston tek rezultati, aq më pak tek sanksionet penale ndaj personave përgjegjës (shih *Vo k. Francës*, apo *Armani da Siloa k. Mbretërisë së Bashkuar*, të përfshirë në këtë botim) por është njëdetyrim mjeti, në kuptimin që është procesi në vetvete dhe jo rezultati i procesit ai që është i rëndësishëm për të vlerësuar efektivitetin e hetimit të autoriteteve. (shih, *Nadrossov k. Rosisë*, nr. 9297/02, § 38, 31.07.2008).

## VARNAVA DHE TË TJERË kundër TURQISË

(kërkesat nr. 16064/90, 16065/90, 16066/90, 16068/90,  
16069/90, 16070/90, 16071/90, 16072/90 dhe 16073/90)

18 shtator 2009

### Dhomë e Madhe

*ky vendim konfirmon karakterin vazhdues të detyrimit të Shteteve për të kryer një hetim efektiv të zhdukjes dhe vdekjes së personave, edhe kur këto kanë ndodhur përpara pranimit të së drejtës së ankimit individual nga Shteti përkatës*

#### I. Faktet kryesore

1. Kërkesat në të cilat bazohet kjo çështje janë paraqitur para Gjykatës në emër dhe për llogari të 18 shtetasve qipriotë, nëntë prej të cilëve ishin zhdukur gjatë operacioneve ushtarake të kryera nga ushtria turke në Qipron veriore në korrik dhe gusht të vitit 1974. Nëntë kërkuesit e tjerë, janë apo kanë qenë të afërmit e personave të zhdukur.
2. Në mesin e personave të zhdukur, tetë ishin anëtarë të forcave greko-qipriote, që kishin tentuar të kundërshtonin përparimin e ushtrisë turke. Sipas një numri dëshmitarësh, ata kishin qenë në mesin e të burgosurve të luftës të kapur nga ushtria turke. Personi i nëntë, z. Hadjipanteli, një punonjës banke, është marrë në pyetje nga ushtarë turq më 18 gusht 1974. Trupi i tij, i cili mbante disa shenja plumbash, u gjet në vitin 2007, në kuadër të një misioni të kryer nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara të Personat e Zhdukur (K.P.ZH.).
3. Qeveria turke e kundërshtoi faktin se këta persona ishin marrë rob nga ushtria turke. Ata parashtruan se tetë të parët ishin personel ushtarak të cilët kishin vdekur në veprim e sipër dhe se emri i të nëntit nuk përfshihej në listën e të burgosurve greko-qipriote të hartuar në vendin e deklaruar të paraburgimit, të inspektuara nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar.
4. Kërkuesit pretenduan se të afërmit e tyre ishte zhdukur pasi u arrestuan nga forcat ushtarake turke në vitin 1974 dhe se që prej atëherë autoritetet turke nuk kishin dhënë asnjë informacion për ta. Kërkuesit u mbështetën në nenet 2, 3, 4, 5, 6, 8, 10, 12, 13 dhe 14 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Në një vendim të 10 janarit 2008, Dhoma konstatoi se ka pasur shkelje të neneve 2, 3 dhe 5 të Konventës dhe se nuk kishte çështje më vete që ngriheshin në bazë të neneve 4, 6, 8, 10, 12, 13 dhe 14 të Konventës. Ajo u shpreh gjithashtu se konstatimi i shkeljes përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për dëmin jopasuror pësuar nga kërkuesit.

6. Më 7 korrik 2008, në bazë të nenit 43 të Konventës çështja iu referua Dhomës së Madhe me kërkesë të Qeverisë turke.

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake të Qeveria turke

7. Qeveria argumentoi se kërkesat ishte jashtë juridiksionit kohor të Gjykatës për tre arsye. Së pari, ato kishin të bënin me rrethana për të cilat Gjykata ishte shprehur një herë, në vendimin e saj *Qipro k. Turqisë*<sup>92</sup>. Së dyti, qenë se ato lidheshin me fakte që kanë ndodhur para pranimit të së drejtës për ankim individual nga ana e Turqisë, më 28 janar 1987. Së treti, Qeveria pretendoi se kishte kaluar shumë kohë mes ndodhës së fakteve dhe paraqitjes së kërkesave të cilat është dashur të shpallen të papranueshme sepse nuk janë paraqitur para Gjykatës brenda gjashtë muajve pas pranimit të së drejtës për ankim individual nga ana e Turqisë.

8. Në lidhje me pikën e parë, interesin ligjor për t' u shprehur mbi çështjen, Gjykata u shpreh se një kërkesë "*është në thelb e njëjtë me një kërkesë të shqyrtuar më parë*", sipas nenit 35 § 2, b të Konventës, jo vetëm kur ka të bëjë me të njëjtat ankesa dhe ngjarje, por edhe kur është sjellë nga të njëjtët kërkues. Në këtë kuptim kjo çështje nuk konsiderohej si e njëjtë me atë ku pretendimet ishin ngritur nga Qeveria qipriote. Së dyti, Gjykata vërejti se kërkuesit kishin specifikuar se pretendimet e tyre lidheshin vetëm me situatën pas 28 janarit 1987. Ajo u shpreh se detyrimi për të dhënë llogari për fatin e personave të zhdukur duke kryer një hetim efektiv është i një natyre të vazhdueshme dhe megjithëse ata ishin zhdukur prej më shumë se 34 vjetësh dhe që prej atëherë nuk kishte asnjë lajm për ta, ky detyrim mund të vazhdojë për aq kohë sa nuk dihej gjë mbi fatin e personave të zhdukur. Prandaj, Gjykata e hodhi poshtë këtë pretendim të qeverisë.

9. Gjykata, në lidhje me pretendimin e tretë paraprak, vuri në dukje se kërkuesit kishin paraqitur kërkesat e tyre rreth 15 vjet pasi të afërmit e tyre ishin zhdukur në vitin 1974 dhe se nuk kishte qenë e mundur për ta për ta bërë këtë përpara vitit 1987. Duke pasur parasysh situatën e jashtëzakonshme si pasojë e konfliktit ndërkombëtar, Gjykata ishte e kënaqur se kërkuesit kishin vepruar me një shpejtësi të arsyeshme, edhe pse ata i kishin sjellë kërkesat e tyre rreth tre vjet pasi Turqia kishte pranuar të drejtën për ankim individual. Duke pasur parasysh faktin se ata gjithsesi i kishin sjellë kërkesat vetëm tre ditë pas pranimit

92 Vendim i 10 majit 2001, përmbledhja dhe komenti i të cilit janë përfshirë në këtë botim.

të juridiksionit të detyrueshëm të Gjykata nga ana e Turqisë, Gjykata e hodhi poshtë edhe këtë pretendim.

### ***B. Në lidhje me nenin 2***

10. Gjykata vuri në dukje se qeveria turke nuk ka paraqitur ndonjë informacion konkret për të treguar se ndonjë nga njerëzit e zhdukur ishte gjetur i vdekur ose ishte vrarë në zonën e konfliktit nën kontrollin e tyre. Ajo nuk dyshonte se shumë vite pas ngjarjeve do të ishte tepër e vështirë të përcaktoheshin faktet rreth vdekjeve, të gjendeshin dëshmitë okulare apo të identifikimin dhe nisnin procedurat ndaj personave përgjegjës. Megjithatë, duke kujtuar jurisprudencën e saj konsistente mbi detyrimin e qartë e shteteve për të hetuar në mënyrë efektive, Gjykata konstatoi se qeveria turke udhët të kishte bërë përpjekjet e nevojshme në këtë drejtim. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur një shkelje të vazhdueshme të nenit 2 për shkak të dështimit të Turqisë për të hetuar në mënyrë efektive fatin e nëntë personave të zhdukur në vitin 1974.

### ***C. Në lidhje me nenin 3***

11. Gjykata vlerësoi se koha gjatë së cilës vuajtjet e të afërmeve kanë vazhduar dhe qëndrimi zyrtar indiferent përballë ankthit të tyre në rritje për të ditur fatin e pjesëtarëve të afërm të familjeve të tyre, përbënte shkelje të nenit 3 në lidhje me kërkuesit.

### ***D. Në lidhje me nenin 5***

12. Gjykata konstatoi se kishte të dhëna të mjaftueshme se dy nga personat e zhdukur janë parë për herë të fundit në rrethana që ishin nën kontrollin e forcave qipriote-turke apo turke. Megjithatë, autoritetet turke nuk kishin pranuar se i kishin ndaluar ata dhe as nuk kishin dhënë ndonjë dokument që provonte zyrtarisht lëvizjet e tyre. Ndërsa nuk ka pasur prova që ndonjë prej personave të zhdukur ka qenë në paraburgim gjatë periudhës nën shqyrtimin e Gjykatës, qeveria turke duhet të kishte treguar se kishte kryer një hetim efektiv për pretendimet e ngritura se dy personat që mungonin ishin ndaluar dhe nuk ishin parë më. Për këtë arsye, ka pasur një shkelje e vazhdueshme e nenit 5 në lidhje me dy kërkuesit.

### ***E. Në lidhje me nenet e tjera***

13. Gjykata arriti në përfundimin se ajo kishte shqyrtuar çështjet kryesore ligjore të ngritura nga kërkesat e paraqitura para saj dhe se nuk ishte e nevojshme për t'u shprehur më vete për pretendimet e kërkuesve në bazë të neneve të tjera të Konventës.

### ***F. Në lidhje me nenin 41***

14. Gjykata iu akordoi secilit prej kërkuesve 12 000 euro në lidhje me dëmin jopasuror dhe 8 000 euro për kostot dhe shpenzimet.

### III. Koment

15. Ky vendim tepër i rëndësishëm ka të bëjë me detyrimin e vazhdueshëm që kanë shtetet për të hetuar zhdukje apo vdekje edhe nëse ato kanë ndodhur shumë vite më parë, madje edhe përpara se të pranohej e drejta e ankimit individual nga ana e këtij shteti pranë organeve të Strasburgut në atë kohë. Si anëtar i Këshillit të Evropës, që nga viti 1949, Turqia ka ratifikuar KEDNJ-në në vitin 1954. Në atë kohë, deri në hyrjen në fuqi të Protokollit 11, më 1 nëntor 1998, e drejta e ankimit individual në bazë të Konventës ka qenë një zgjedhje të cilën shtetet mund ta praninin ose jo<sup>93</sup>. Pavarësisht nga kjo, dispozitat e Konventës ishin të detyrueshme sipas së drejtës ndërkombëtare që nga momenti i aderimit e tutje dhe gjithmonë ekzistonte mundësia e ankimeve ndër-shtetërore në bazë të ish-nenit 24 (sot neni 33) të Konventës. Turqia e pranoi të drejtën e viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut për ankim në organet e Strasburgut në vitin 1987 dhe juridiksionin e detyrueshëm të Gjykatës deri në vitin 1990. Është kundrejt kundër këtij sfondi që duhet analizuar ky vendim i Gjykatës.

16. Zhdukjet dhe/ose vdekjet në fjalë ka ndodhur në kontekstin e dhunës ndëretnike në Turqi si pasojë e ngjarjeve në Qipro në 1974, ngjarje që ndodhën 20 vjet pasi Turqia kishte ratifikuar Konventën, por 14 vjet përpara se të kishte pranuar të drejtën për ankim petition individual. Këto zhdukje personash ishin tashmë subjekt i një numri procedurash ndërshtetërore mes Qipros dhe Turqisë. Në Strasburg, kërkuesit pretenduan se ishte detyrë e autoriteteve turke për të kryer hetime në lidhje me zhdukjet e të afërmeve të tyre. Është e rëndësishme të jetë e qartë që, në rastin në fjalë, Gjykata ripohoi se nuk ishte kompetente për të shqyrtuar ankesat në lidhje me skenarët faktikë (vdekje ose zhdukje) në lidhje me fatin e viktimave, skenarë që kishin ndodhur përpara datës së pranimit të së drejtës për ankim individual, por vetëm për pretendimet në lidhje me dështimin e vazhdueshëm për të hetuar pas kësaj date. Pra, çështja ishte nëse ajo mund të shqyrtonte dështimin e vazhdueshëm të Turqisë për të kryer hetimet e nevojshme mbi ato zhdukje ose vrasje nga viti 1974 e deri në momentin e shqyrtimit gjyqësor në Strasburg.

17. Me interes është të komentohet pretendimi i parë paraprak i Qeverisë Turke, sipas së cilës kërkesa duhej hedhur poshtë në bazë të nenit 35 § 2, b të Konventës sepse ishte në thelb e njëjtë me situatën juridike të shqyrtuar nga Gjykata në vendimin Qipro k. Turqisë. Gjykata i përgjigjet qartë dhe prerë këtij pretendimi me argumentin se, që një çështje të konsiderohet “në thelb e njëjtë” sipas këtij neni duhet të ketë të bëjë jo vetëm me të njëjtat pretendime dhe ngjarje por edhe të jetë sjellë nga të njëjtët ankues. Gjykata arrin në këtë përfundim, dhe kjo është tepër interesante, edhe kur çështja e mëparshme ka qenë një çështje ndërshtetërore, pra kur ankimi i Qipros kundër Turqisë mund të kishte përfshirë

93 Për të gjitha shtetet që kanë aderuar në Konventë pas 1 nëntorit 1998 njohja e juridiksionit të detyrueshëm të Gjykatës ishte e pashmangshme, përderisa Protokollit 11 u bë pjesë integrale e Konventës.

fare mirë edhe fatin e kërkuesve në çështjen Varnava. Sidoqoftë, Gjykata, në raste të tilla gjithmonë ka kryer një analizë të kujdesshme që nuk kufizohet në aspektet formale, por gjithmonë analizon se cilat janë palët, dispozitat ligjore në lojë, natyrën e pretendimeve, si edhe efektin që do të kishte përjashtimi i juridiksionit të Gjykatës në raste të tilla<sup>94</sup>.

18. Përsa i përket afatit 6 mujor, Gjykata vuri në dukje se edhe pse kërkesat nuk ishin paraqitur që më 1987, pas pranimit të drejtës për ankim individual, ata gjithsesi ishin sjellë brenda tre vjetëve nga pranimi nga e Turqisë të juridiksionin të detyrueshëm të Gjykatës.

19. Ky vendim i Dhomës së Madhe, ripohon detyrimin e vazhdueshëm të shteteve që të hetojnë vdekjet dhe zhdukjet, edhe nëse këto kanë ndodhur disa kohë më parë. Gjykata arriti në përfundimin se detyrimi procedural për të kryer një hetim efektiv sipas nenit 2 ka evoluar në një detyrim të veçantë dhe autonom. Edhe pse shkelja, pra vrasja ose zhdukja e personave, është shkaktuar nga akte që lidhen me aspektet materiale të nenit 2, ato bëjnë të lindë një detyrim më vete në bazë të nenit 2, sipas të cilit shtetet janë të detyruara që, edhe kur vdekja ka ndodhur para datës së aderimit ose pranimit të juridiksionit të Gjykatës, dhe konstatimit të një shkelje më vete, me karakter procedural të nenit 2, edhe kur vdekja ose zhdukja si të tilla nuk mund të gjykohen *ratione temporis*. Ky qëndrim i Dhomës së Madhe përforcon edhe një herë, por duke e shtrirë konstatimin në situatat e zhdukjes së personave, qëndrimin që Dhoma e Madhe kishte mbajtur vetëm gjashtë muaj më parë në vendimin *Silih k. Sllovenisë*<sup>95</sup>. Gjyqtari turk Turmen, përsëriti para Dhomës së Madhe mendimin që ai kishte dhënë edhe para Dhomës, se kompetenca e Gjykatës është përjashtuar përderisa ngjarjet në fjalë kishin ndodhur para 1987 dhe nuk mund të sillëshin kërkesa individuale në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur para pranimit të drejtës për ankim individual.

94 Shih ndërmjet çështjesh të tjera Smirnova k. Ruisë, (dec.) nos. 46133/99 dhe 48183/99, 3.10.2002, Calcerrada Fornieles dhe Cabeza Mato k. Spanjës, nr. 17512/90, vendim i Komisionit 6.7.1992, (DR) 73, Vesa Peltonen k. Finlandës (dec.), nr. 19583/92, 20.2.1995; Cereceda Martin dhe të tjerë k. Spanjës, nr. 16358/90, (vendim i Komisionit i 12.10.1992, Lukanov k. Bullgarisë (dec.), nr. 21915/93, (vendim i Komisionit i 12.01.1995; Çelniku k. Greqisë, nr. 21449/04, §§ 39-41, 5.7.2007, Peraldi k. Francës (dec.), nr. 2096/05, 7.7.2009, dhe Oao Neftyanaya Kompaniya Yukos k. Ruisë, nr. 14902/04, 20.09.2011.

95 Vendim i DHM i 9.4.2009, i përmbledhur dhe i komentuar në këtë botim.



## BAZORKINA kundër RUSISË

(kërkesa nr. 69481/01)

27 korrik 2006

*kjo çështje ka të bëjë me një problem të rëndë dhe të përsëritur, atë të zhdukjes së personave në Çeçeni pa pasur asnjë akt ose vendim formal mbi fatin e tyre, dhe me përgjegjësinë që kanë autoritetet shtetërore në raste të tilla*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Fatima Sergeyevna Bazorkina, është një shtetase ruse e cila ka lindur në vitin 1938 dhe jeton në Ingusheti, Rusi. Ajo u ankua në emër të saj dhe në emër të djalit të saj, Khadzhi-Murat Yandiyev, i lindur më 27 gusht 1975. Kërkuesja pretendonte se në gusht 1999 djali i saj kishte shkuar në Grozni, Çeçeni, dhe që atëherë ajo nuk kishte asnjë lajm prej tij. Në vjeshtë 1999 në Çeçeni filloi një konflikt mes një pjese të popullsisë lokale dhe autoriteteve ruse. Më 2 shkurt 2000, kërkuesja e kishte parë djalin e saj në një program televiziv lajmesh duke u marrë në pyetje nga një oficer rus në lidhje me sulmin e fshatit Alkhan-Kala. Ajo më vonë mori një kopje të plotë të regjistrimit, të bërë nga një gazetar për NTV (një televizion i pavarur rus) dhe CNN. Në fund të marrjes në pyetje të djalit të kërkueses oficeri rus i urdhëroi ushtarët "vriteni" dhe "qëllojeni". Gazetarët e CNN që kishin filmuar këtë ngjarje, identifikuan më vonë se oficerin rus ishte Kolonel-Gjenerali Baranov, komandant i trupave që vunë nën kontroll Alkhan-Kala.

2. Menjëherë pas 2 shkurtit 2000, kërkuesja filloi të kërkonte djalin e saj, duke vizituar rajonet e policisë dhe burgjet si dhe duke iu drejtuar autoriteteve të ndryshme. Në gusht 2000, ajo u informua se i biri nuk mbahej në asnjë burg rus. Në nëntor 2000, një prokuror ushtarak vendosi që të mos niste një hetim penal në lidhje me zhdukjen e z. Yandiyev. Në prill 2001, kërkuesja paraqiti kërkesën në Gjykatën e Strasburgut në lidhje me zhdukjen e djalit të saj në rrethana të panjohura, ndërsa në korrik 2001, zyra e Prokurorit në Çeçeni nisi një hetim mbi rrëmbimin e z. Yandiyev nga persona të pidentifikuar. Pasi Gjykata e konsideroi të pranueshme kërkesën, Qeveria ruse dorëzoi në gjykatë një kopje të dosjes hetimore.

3. Hetimi përcaktonte se djali i kërkueses ishte ndaluar në 2 shkurt 2000 në Alkhan-Kala. Menjëherë pas arrestimit, ai u ishte dorëzuar funksionarëve të Ministrisë së Drejtësisë për t' u çuar në një qendër paraburgimi. z. Yandiyev nuk ishte çuar në asnjë qendër paraburgimi dhe vendndodhja e tij më vonshme nuk dihej. Kolonel-Gjenerali Baranov u mor dy herë në pyetje në lidhje me ngjarjet

dhe deklaroi se ai nuk kishte dhënë ndonjë urdhër për ta "qëlluar" z. Yandiyev, por se ai kishte për qëllim për të ndaluar sjelljen e tij agresive dhe për të parandaluar trazirat e mundshme. Në mes të korrikut të vitit 2001 dhe në shkurt të vitit 2006, hetimi u shty dhe u rinis gjashtë herë. Shumica e dokumenteve në dosjen e kësaj çështje datonin pas dhjetorit 2003. Disa herë prokurorët i kishin urdhëruar hetuesit të merrnin hapa të caktuara në lidhje me hetimin. Në mënyrë të veçantë, në dhjetor 2003, një prokuror, duke theksuar se nuk kishte pasur asnjë hetim të vërtetë, urdhëroi që të merreshin masa për të identifikuar repartet e forcave federale ruse që mund të ishin të përfshirë në operacionin special në Alkhan-Kala në fillim të shkurtit të vitit 2000 dhe për të sqaruar se çfarë kishte ndodhur me personat e ndaluar.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesja pretendonte se djali i saj ishte i keqtrajtuar dhe vrarë nga forcat federale ruse dhe se asnjë hetim efektiv nuk ishte bërë mbi rrethanat e keqtrajtimit të tij dhe "zhdukjes". Ajo pretendonte gjithashtu se ajo vetë kishte vuajtur nga ankthi dhe shqetësimet emocionale në lidhje me "zhdukjen" e djalit të saj. Ajo mbështetej në nenet 2, 3, 5, 6, 8 dhe 13 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 2

*i. mbi vdekjen e supozuar të z. Yandiyev*

5. Gjykata kujton se personat e ndaluar janë në një pozitë shumë të brishtë dhe se autoritetet kishin për detyrë që t'i mbronin ata. Detyrimi i autoriteteve për të dhënë llogari për trajtimin e një individi të ndaluar ishte veçanërisht i fortë kur ai individ ka vdekur ose është zhdukur pasi është vendosur në paraburgim. Gjykata vërejtë se ishte e pakundërshtueshme se z. Yandiyev është arrestuar gjatë një operacioni kundër terrorizmit në fshatin Alkhan-Kala më 2 shkurt 2000. Më tej, ajo mbajti parasysh videokasetat dhe deklaratat e shumta të dëshmitarëve, të përfshira në dosjen hetimore, të cilat konfirmonin se ai ishte marrë në pyetje nga një oficer i lartë ushtarak i cili, në fund të marrjes në pyetje, kishte thënë se ai duhej ekzekutuar, dhe që nga ajo datë nuk kishte më asnjë lajm për të birin e kërkueses. Në mungesë të ndonjë shpjegimi bindës nga Qeveria Ruse, dhe duke pasur parasysh se asnjë informacion nuk kishte dalë në dritë në lidhje me vendndodhjen e tij për më shumë se gjashtë vjet, Gjykata u bind se z. Yandiyev duhet të konsiderohej i vdekur pasi ishte vendosur jo-zyrtarisht në paraburgim. Duke mbajtur parasysh se autoritetet nuk paraqitën asnjë justifikim në lidhje me përdorimin e forcës vdekjeprurëse nga ana e ushtarëve rusë, rezultonte se përgjegjësia i takonte Qeverisë Ruse. Prandaj, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 2.

*ii. pamjaftueshmëria e hetimit*

6. Gjykata vuri në dukje se hetimi mbi këto ngjarje filloi një vit e pesë muaj pasi ato ndodhën dhe u pengua nga vonesa të pashpjegueshme. Për më tepër, Gjykatës i rezultonte se shumica e veprimeve të nevojshme për zbardhjen e ngjarjeve kishin ndodhur vetëm pas dhjetorit 2003, kur ankimi i kërkueses iu

komunikua Qeverisë Ruse. Gjykata vuri në dukje një numër të mangësish të rënda, duke përfshirë, në veçanti, mungesën e identifikimit ose marrjes në pyetje të disa ushtarakëve që mbikëqyrnin të burgosurit. Shumë nga këto mangësi ishin vënë në dukje edhe nga prokurorët, të cilët kishin urdhëruar marrjen e disa hapave. Megjithatë, udhëzimet e tyre ose nuk u ndoqën ose u ndoqën me vonesa të papranueshme. Në dritën e këtyre rrethanave, Gjykata konstatoi se autoritetet dështuan të kryenin një hetim penal efektiv mbi rrethanat e zhdukjes dhe vdekjes së supozuar të z. Yandiyev dhe konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 2.

### ***B. Në lidhje me nenin 3***

7. Përsa i përket ankesës së kërkuësës mbi vuajtjet e vetë asaj për shkak të zhdukjes së djalit të saj, Gjykata vërejt se kërkuësja ishte e ëma e z. Yandiyev, dhe se kishte parë djalin e saj në video duke u marrë në pyetje dhe duke u marrë prej tyre pasi ishin dhënë urdhra që linin të kuptohej se ai do ekzekutohej. Për më tepër, pavarësisht kërkesave të saj, kërkuësës nuk i ishte dhënë asnjë shpjegim apo informacion i besueshëm mbi atë se çfarë ndodhi me djalin e saj pas arrestimit. Gjykata vlerësoi se për shkak të këtyre fakteve kërkuësja ka vuajtur nga stresi dhe ankthi. Ajo vlerësoi gjithashtu se mënyra sesi ishin trajtuar ankesat e saj nga autoritetet mund të konsiderohet se përbënte trajtim çnjerëzor. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 3.

### ***C. Në lidhje me nenin 5***

8. Gjykata vuri re se edhe pse ishte e qartë se djali i kërkuësës u arrestua më 2 shkurt 2000 nga autoritetet federale, ndalimi i tij nuk ishte i regjistruar në regjistrat përkatës të arrestimeve dhe se nuk ekzistonte asnjë gjurmë zyrtare e vendndodhjes apo fatit të tij të mëvonshëm. Gjykata vlerësoi se ky fakt në vetvete ishte një mangësi tepër e rëndë që u kishte mundësuar personave përgjegjës për heqjen e lirisë ta fshihnin përfshirjen e tyre në krim, të mbulonin gjurmët dhe t'i shpëtonin përgjegjësisë për fatin e një të arrestuari. Ky fakt në vetvete ishte i papajtueshëm me vetë qëllimin e nenit 5. Gjykata vlerësoi më tej se autoritetet nuk arritën të marrin masa të menjëhershme dhe efektive për të mbrojtur z. Yandiyev kundër rrezikut të zhdukjes. Prandaj, ajo konstatoi se z. Yandiyev u mbajt i ndaluar në mënyrë sekrete, në mungesë të plotë të garancive të parashikuara në nenin 5 dhe se për këto arsye ka pasur shkelje të së drejtës për liri dhe siguri të personit, të garantuar nga kjo dispozitë.

### ***D. Në lidhje me nenin 13***

9. Duke u mbështetur në konstatimet e saj në lidhje me nenet 2 dhe 3, Gjykata konstatoi se kërkuësja duhet të kishte qenë në gjendje të përdorte mjete juridike efektive dhe praktike të tilla që të mund të çonin në identifikimin dhe dënimin e atyre që ishin përgjegjës dhe në dhënien e një kompensimi. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se hetimi penale nuk kishte qenë efektiv, Gjykata konstatoi se autoritetet shtetërore kishin dështuar në respektimin e detyrimeve të tyre sipas nenit 13.

**E. Në lidhje me nenet 6, 8, 34 dhe 38**

10. Gjykata konstatoi se nuk kishte asnjë problem të veçantë që ngrihej në këtë çështje në bazë të neneve 6 dhe 8, dhe se Qeveria Ruse nuk kishte dështuar të respektonte detyrimet e saj sipas neneve 34 dhe 38 § 1 (a).

**F. Në lidhje me nenin 41**

11. Gjykata i akordoi kërkuases 35 000 euro për dëmin jopasuror dhe 12 241 euro për kostot dhe shpenzimet.

**III. Koment**

12. Ky rast që ka të bëjë me zhdukjen e një të riu në Çeçeni, është paraprirë, por edhe pasuar nga një sërë vendimesh që trajtojnë të njëjtin problem gjerësisht të hasur gjatë konfliktit të armatosur në Çeçeni<sup>96</sup>. Në përfundimet e saj, Gjykata, ndjek jurisprudencën e saj të mëparshme në lidhje me zhdukjen e personave, të cilën e ka zhvilluar sidomos në një sërë rastesh turke që trajtonin konfliktin në pjesën juglindore të Turqisë. Faktet në çështjen Bazorkina janë tepër të pazakonta. Fakti që kërkuësja vetë e sheh të birin në një emision televiziv ku edhe nënkuptohet ekzekutimi i tij nuk mund të mos ndikonin konsiderueshëm në vlerësimin e Gjykatës. Madje, Gjykata e administroi edhe vetë si provë një kopje të këtij regjistrimi.

13. Nga njëra anë, regjistrimi video provonte qartë para Gjykatës se i biri i kërkuases ishte ndaluar nga forcat ushtarake ruse në shkurt 2000 dhe se asgjë nuk dihej rreth tij që nga ai moment. Fakti që autoritetet ruse nuk ishin në gjendje të jepnin asnjë shpjegim në lidhje me këtë zhdukje të djalit të kërkuases, pasi ai kishte qenë në duart e tyre, mund të kishte mjaftuar për Gjykatën për të konstatuar shkelje të nenit 2 të Konventës<sup>97</sup>. Megjithatë, sikur të mos mjaftonte kjo, regjistrimi përmbante sekuenca që linin të kuptohej se ushtarakët rusë e kishin ekzekutuar djalin e kërkuases. Prandaj, Gjykata nuk pati ndonjë vështirësi të konstatonte shkelje të aspektit substancial të nenit 2 të Konventës. Duke pasur parasysh ecurinë e hetimit nga autoritetet ruse, tjetër problem gjerësisht i hasur në çështje të ngjashme ruse por edhe turke, ajo konstatoi gjithashtu edhe shkelje procedurale të këtij neni. Në rrethanat specifike të çështjes, në prani të këtyre provave materiale të pakundërshtueshme, do të ishte ndoshta e tepërt që ky rast të konsiderohej si ‘zhdukje’ e mirëfilltë. Megjithatë Gjykata preferoi të theksojë edhe në këtë rast detyrimin që kanë shtetet në raste të tilla ku fati i personave nën juridiksionin e tyre nuk dihet.

14. Nga ana tjetër, ekzistenca e regjistrimit e bëri të qartë në sytë e Gjykatës vuajtjen e vetë kërkuases për qëllimet e nenit 3 të Konventës, përderisa ajo e kishte parë vetë regjistrimin. Megjithatë, Gjykata nuk mungoi të theksonte se

96 Shih gjithashtu në lidhje me konfliktin çeçen, *Isayeva, Yusopova dhe Bazayeva k. Rusisë*, 24.02. 2005.

97 Krahaso me *Salman k. Turqisë* [DHM], nr 21986/93, CEDH 2000-VII, *Slimani k. Francës*, nr. 57671/00, CEDH 2004-IX dhe *Pankov k. Bullgarisë*, nr 12773/03, 7.10.2010.

edhe vetë fakti që ankesat e kërkueses nuk ishin mbajtur parasysht si duhet nga autoritetet ruse por ishin lënë, qëllimisht apo jo, pas dore për rreth 6 vjet, përbënte një trajtim çnjerëzor për qëllimet e nenit 3 të Konventës.

## TANLI kundër TURQISË

(kërkesa 26129/95)

10 prill 2001

*detyrimet me karakter pozitiv në kuadër të nenit 2 dhe elementët proceduralë të këtij neni i detyrojnë shtetet të jenë të kujdesshëm në çdo aspekt të hetimit për vdekjen e një personi*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Mustafa Tanli, është shtetas turk që kishte lindur më 1933. Ai është një bujk kurd, i cili jetonte në fshatin Örtülü, në rajonin e Dogubeyazit, në juglindje të Turqisë. I biri i tij, Mahmut Tanli, 22 vjeç, u ndalua nga xhandarët në Örtülü më 27 qershor 1994. Më 28 qershor 1994, familja u lajmërua nga oficerët e policisë që ai kishte vdekur nga një atak në zemër ndërsa ishte në gjendje ndalimi në zyrat e forcave të sigurimit në Dogubeyazit. Familja pretendoi se kishte pasur shenja dëmtimesh dhe mavijosjesh në trupin e birit të tyre. Autopsia që u bë me këtë rast arriti në konkluzionin se nuk kishte gjurmë dhune ose shenja mbi trupin e të riut dhe se shkaku i vdekjes kishte qenë një atak në zemër.

2. Prokurori i shtetit ndërmori një hetim në lidhje me këtë vdekje. Ai mori në pyetje tre oficerët e policisë që kishin marrë pjesë në seancat e pyetjeve, të cilët deklaruar se Mahmut Tanli ishte zbehur dhe tronditur pasi oficerët e policisë i kishin treguar se kishin prova për pjesëmarrjen e tij në Partinë Punëtore Kurde (PKK). Prokurori kishte marrë dëshmi gjithashtu nga oficerë të tjerë policie që kishin qenë pranë skenës së ngjarjes si dhe nga mjeku që ishte thirrur të vizitonte Mahmut Tanlin. Prokurori kërkoi gjithashtu edhe dosjen mjekësore të Mahmut Tanlit kur ky kishte qenë ushtar. Në gusht 1994, prokurori vendosi t'i ngarkonte me përgjegjësi tre oficerët e policisë dhe formuloi një akt-akuzë kundër tyre. Gjykata vendosi që të kërkonte prova të mëtejshme mjeko-ligjore dhe e dërgoi dosjen në Institutin e Mjekësisë Ligjore në Stamboll. Me kërkesën e Institutit, më 5 maj 1995 ajo vendosi që të bëhej një riekzaminim i trupit të Mahmut Tanlit.

3. Raporti i autopsisë i vitit 1995 deklaronte se trupi ishte prishur dhe nuk ishte e mundur që të konstatoheshin të dhëna mbi shkakun e vdekjes. Në raportin e tij të 13 marsit 1996, Instituti i Mjekësisë Ligjore të Stambollit kritikonte ashpër raportin e autopsisë së parë duke e quajtur si me vlerë të pakët shkencore dhe

duke vënë në dukje mungesën e një ekzaminimi të duhur të lëkurës dhe pjesëve të tjera të trupit. Sidoqoftë, në raportin e tij, Instituti nuk arriti të nxirrte ndonjë konkluzion nëse kishte pasur torturë apo jo, për shkak të prishjes së trupit.

4. Më 14 maj 1996, Gjykata i liroi tre oficerët e policisë për mungesë provash në mbështetje të akuzës ndaj tyre që Mahmut Tanli kishte vdekur si rezultat i torturës.

5. Kërkuesi pretendonte se djali i tij Mahmut Tanli kishte qenë torturuar dhe vrarë në kohën kur ishte në gjendje ndalimi nga policia. Ai bazohej në nenet 2, 3, 5, 13, 14 dhe 18 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

6. Gjykata vuri në dukje se, në rastet kur një individ, në gjendje të shëndoshë, merret nga policia dhe vihet në gjendje ndalimi ose arresti dhe pastaj vdes, i takon shtetit që të japë shpjegimet e duhura për këtë gjë.

7. Gjykata kujtoi se Mahmut Tanli, 22 vjeçar, ishte në një gjendje të mirë shëndetësore kur u ndalua nga policia dhe nuk kishte të dhëna mjekësore se kishte qenë më parë i sëmurë. Ai e kishte kryer shërbimin e tij ushtarak një vit më parë pa ndonjë problem mjekësor. Megjithatë, brenda një intervali kohor prej 24-30 orësh nga ndalimi i tij, ai vdes gjatë seancave të pyetjeve në stacionin e policisë së Uluyol-it.

8. Gjykata vlerësoi se procedura *post mortem* ishte problematike në aspekte themelore të saj. Instituti i Mjekësisë Ligjore të Stambollit, i cili ndërmoi një autopsi të dytë të trupit më 12 qershor 1995, konstatoi se nuk kishte pasur ekzaminim të zemrës. Ai arriti në përfundimin se, në këto rrethana, konstatimet e raportit të parë ishin pa vlerë shkencore. Raporti i ekspertizës i paraqitur nga ana e kërkuesit vlerësonin gjithashtu se shkaqet e pretenduara për sjelljen e vdekjes ishin regjistruar dhe detajuar në mënyrë jo aq të mjaftueshme sa të mund të besoheshin. Po ashtu, edhe ekzaminimi i trupit nuk arrinte të hidhte poshtë pretendimet e ngritura nga kërkuesi sipas të cilit i biri ishte torturuar deri në vdekje. Nuk ishte ndërmarrë, nga ana tjetër, asnjë test që të ishte në gjendje që të përcaktonte praninë e shenjave të padukshme të torturës. Për këtë arsye pra, procedurat e brendshme *post mortem*, nuk arritën të ofronin një shpjegim për vdekjen e Mahmut Tanli-t. Në këto kushte nuk mund të pranohej ajo që pretendohet nga ana e qeverisë, që ai kishte vdekur për shkaqe natyrore. Prandaj, Gjykata, konstatoi se qeveria nuk kishte qenë e përgjegjshme për vdekjen e Mahmut Tanli-t gjatë mbajtjes së tij në stacionin e policisë në Uluyol dhe prandaj angazhohej përgjegjësia e saj.

9. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se hetimi mbi bazën e autopsisë ishte me rëndësi themelore në përcaktimin e fakteve që rrethonin vdekjen e Mahmut



Tanli-t. Ky hetim, megjithëse i filluar menjëherë nga ana e prokurorit, kishte dalë në pah me të meta themelore në shumë aspekte të tij. Në mënyrë të veçantë, organet e trupit të tij nuk u morën të analizoheshin veç e veç dhe as nuk u peshuan; zemra nuk u ekzaminua; zona e qafës po ashtu nuk u ekzaminua; nuk u bënë teste histopathologjike apo analiza të tilla që të kishin nxjerrë në pah shenjat e formave elektrike ose të formave të tjera të torturës ose të keqtrajtimeve; nuk u bë asnjë analizë toksike; nuk u bënë fotografi dhe analizat e enëve të gjakut nuk ishin bërë dhe përshkruar siç duhet. Gjithashtu, dukej se mjekët që nënshkruan raportin *post mortem* nuk ishin patologë ligjore të specializuar, pavarësisht nga dispozita e Kodit të Procedurës Penale që kërkonte praninë e një mjeku ligjor.

10. Në dritën e këtij hetimi mjeko-ligjor të mangët, nuk ishte e çuditshme që procedurat gjyqësore të kishin arritur në lirim, për mungesë provash, të tre oficerëve të policisë të cilët kishin marrë në pyetje Mahmut Tanli-n përpara se ky të vdiste.

11. Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet nuk kishin arritur në ndërmerrnin një hetim efektiv në lidhje me rrethanat që kishin të bënin me vdekjen e Mahmut Tanli-t, dhe se për këtë arsye kishte shkelje të nenit 2 të Konventës.

### **B. Në lidhje me nenin 3**

12. Gjykata vuri në dukje se nuk kishte të dhëna për shenja ose dëmtime në trupin e Mahmut Tanli-t që të linin të mendoje për përdorimin e teknikave të torturës. Megjithëse kërkuesi dhe dëshmitarët e tjerë dëshmonin për mavijosje të trupit, nuk kishte konstatime mjekësore nëse këto ishin për shkak të dëmtimeve për shkak të torturave e keqtrajtimeve apo për shkak të transformimeve trupore pas vdekjes. Eksperti mjeko-ligjor i thirrur nga ana e kërkuesit deklaroi se ai nuk mund të nxirrte asnjë përfundim nga fotografitë e trupit të marra përpara varrosjes. Pra, nuk kishte prova që, përveç shkaqeve të pashpjeguara të vdekjes, të mbështesnin konstatimin e akteve të torturës ndaj Mahmut Tanli-t.

13. Në lidhje me vetë kërkuesin Gjykata, megjithëse nuk kishte asnjë dyshim për dhimbjen e thellë që ai ndjente si pasojë e vdekjes së të birit, nuk gjeti baza për të konstatuar shkelje të nenit 3 të Konventës.

### **C. Në lidhje me nenin 5**

14. Gjykata ishte e shqetësuar me faktin që oficerët e policisë kishin vepruar pa pasur një dyshim të arsyeshëm që Mahmut Tanli kishte kryer një vepër penale. Ajo nuk u bind, nga ana tjetër, që të ishte respektuar kriteri “i ligjshëm” i parashikuar nga neni 5, përsa i përket ndalimit të të riut në këtë rast, duke pasur parasysh sidomos mungesën e dokumentacionit të plotë në lidhje me ndalimin e tij. Për më tepër nuk u bë asnjë kërkesë nga ana e kërkuesit për të parë dosjen mbi rrethanat e ndalimit dhe nuk pati ndonjë pretendim në lidhje me faktin se kur ose ku Mahmut Tanli u mbajt.

15. Nuk ishte e mundur as që të përcaktohej se kur dhe çfarë të dhënash i ishin ofruar Mahmut Tanli-t, përpara vdekjes së tij. Nuk mund të thuhej pra, në mungesë të provave të shkruara, nëse arsyet e arrestimit ishin dhënë apo jo, apo nëse Tanli kishte qenë në gjendje, nga rrethanat, që të kuptonte arsyet e arrestimit të tij.

16. Gjykata vuri në dukje në vazhdim, se Mahmut Tanli ishte mbajtur në gjendje ndalimi nga 24 deri në 36 orë pa u çuar përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër me kompetenca të ngjashme. Ishte e vërtetë që nuk kishte të dhëna që ai do të kishte qenë çuar përpara një gjyqtari në qoftë se nuk do të kishte vdekur, duke qenë se sipas së drejtës turke në atë kohë një i ndaluar mund të mbahej pa u paraqitur tek gjyqtari deri në 30 ditë. Megjithatë, nuk ishte bërë asnjë kërkesë zgjatje të periudhës së ndalimit dhe ishte abuzive të mendohej se, në këtë rast, do të kishim të bënim me një shkelje e nenit 5. Mbi të njëjtat arsye, Gjykata nuk mund të arrinte në përfundimin që Mahmut Tanli-t i ishte mohuar mundësia për të kundërshtuar ligjërisht ndalimin e tij.

17. Si përfundim ajo vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 5 të Konventës.

#### ***D. Në lidhje me nenin 13***

18. Përderisa Gjykata konstatoi se qeveria ishte përgjegjëse në bazë të nenit 2 të Konventës për vdekjen gjatë periudhës së ndalimit të të birit të kërkuarit, pretendimet e kërkuarit ishin “të bazuara” për qëllimet e nenit 13, duke i vendosur autoritetet nën një detyrim për të kryer një hetim efektiv në lidhje me rrethanat e vdekjes të të birit.

19. Duke pasur parasysh karakterin e papërshtatshëm të analizave *post mortem*, Gjykata konstatoi se kërkuarit i ishte mohuar mjeti efektiv në lidhje me vdekjen e të birit dhe prandaj edhe mundësia për të përdorur çdo mjet tjetër të mundshëm në dispozicion të tij, përfshirë edhe pretendimin për kompensim. Pra, neni 13 ishte shkelur.

#### ***E. Në lidhje me nenet 14 dhe 18***

20. Gjykata nuk ishte e mendimit që pretendimet e kërkuarit në lidhje me faktin se i biri ishte objekt i një politike të qëllimshme diskriminuese për shkak të origjinës së tij etnike ose që ai të kishte qenë viktimë e kufizimeve që ishin në kundërshtim me qëllimet e Konventës në këtë kuadër.

#### ***F. Në lidhje me nenin 41***

21. Gjykata i akordoi kërkuarit 38 000 sterlina për dëm material dhe 20 000 sterlina për dëm jo-material, dhe këto shuma duhet të kalonin në favor të të vejës së të birit dhe fëmijës së tij. Gjykata i akordoi gjithashtu edhe 10 000 sterlina personalisht kërkuarit për dëmin jo-material të pësuar prej tij, si dhe 9 700 sterlina për shpenzime dhe pagesa.

### III. Koment

22. Ky vendim është në një linjë me rastet e tjera, ku Gjykatës i ishte kërkuar të vlerësonte rrethanat në të cilat një person ishte ndaluar nga policia në gjendje të mirë shëndetësore dhe në vijim kishte vdekur. Siç Gjykata e ka thënë edhe në të kaluarën, i takon shtetit që të ofrojë një shpjegim bindës, dhe në qoftë se kjo nuk arrihet nga ana e shtetit, Gjykata do të konstatojë se shteti ka shkelur nenin 2 dhe është përgjegjës për vdekjen e personit<sup>98</sup>. Gjykata ishte, në këtë rast, shumë kritike ndaj faktit që bërja e autopsisë ishte me shumë të meta dhe nuk ishte kryer në detaje të mjaftueshme ose me kujdesin e duhur.

23. Ka pasur një numër rastesh të çuara përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me përgjegjësinë e një shteti kontraktues për vdekjen e një individi. Sidoqoftë, këto çështje kanë pasur të bëjnë me situata në të cilat ka pasur dëshmitarë në momentin e vdekjes dhe jo me vdekje që ndodhnin brenda qelive, pra në rrethana që ngeleshin të paditura dhe të pamundura për t'u qartësuar. Në të kaluarën, Gjykata është luhatur në lidhje me ngarkimin me përgjegjësi të shtetit për vdekjen e një personi të ndaluar, kur rrethanat e vdekjes së tij janë të paqarta<sup>99</sup> por ka tentuar që të fokusohet në shqyrtimin e hetimit që pasonte vdekjen dhe e ka gjetur shtetin fajtor vetëm në qoftë se ky nuk e kishte bërë siç duhet një hetim të tillë.

24. Duke e pasur parasysh këtë çështje në kontekstin e rasteve të tjera që kanë pasur të bëjnë me vdekje në kushte ndalimi, ai paraqet pa dyshim një padurim nga ana e Gjykatës për të konstatuar përgjegjësinë e shteteve të cilat mbajnë një qëndrim moskokëçarës ndaj vdekjes së personave nën kujdesin e tyre si dhe për të ripohuar nevojën që shteti duhet të ofrojë shpjegime bindëse të mbështetura nga prova konkrete. Vetëm në këtë mënyrë, ata të mund të shpëtojnë pa u konsideruar përgjegjës për shkelje të nenit 2 të Konventës. Me fjalë të tjera, kriteret kanë ndryshuar dhe tashmë barra e provës në këto raste i takon shtetit dhe jo më kërkuarit ose familjes së tij.

98 Shih për shembull vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet *Salman kundër Turqisë*, të 27 qershorit 2000 ose *Cicek kundër Turqisë* të 27 shkurtit 2001.

99 Shih për shembull vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen *Kurt kundër Turqisë*.

## SILIH kundër SLOVENISË

(kërkesa nr. 71463/01)

9 prill 2009

*përgjegjësia e shteteve sipas KEDNJ për të hetuar vdekjet që kanë ndodhur përpara ratifikimit prej tyre të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Franja dhe Ivan Šilih janë shtetas sllovenë të lindur respektivisht në 1949 dhe 1940 dhe që jetojnë në Slovenj Gradec, Slloveni. Më 19 maj të vitit 1993, kur ishte vetëm 20 vjeç, djali i kërkuesve, Gregor Šilih, vdiq në një spital pasi vuajti nga një shok anapilaptik, ndoshta si rrjedhojë e reaksioneve alergjike nga një prej ilaçeve që iu dha atij nga doktori i urgjencës në përpjekje për të trajtuar urtikarian e tij.

2. Më 13 maj të vitit 1993, kërkuesit bënë një kallëzim penal kundër doktorit të urgjencës për neglizhencë mjekësore, por çështja u pushua më pas për mungesë provash të mjaftueshme.

3. Më 28 qershor 1994, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, hyri në fuqi në Slloveni. Më 1 gusht të vitit 1994, kërkuesit shfrytëzuan të drejtën e tyre sipas Ligjit slloven të Procedurës Penale<sup>100</sup>, për të dalë si prokurorë "zëvendësues" si palë e dëmtuar që ishin, dhe kërkuan rihapjen e hetimit penal. Hetimi u rihap më 26 prill të vitit 1996, dhe një akuzë penale u bë më 28 shkurt 1997. Çështja u rikthye dy herë për hetime të mëtejshme përpara se procedimi penal të pushohej më 18 tetor 2000, sërish me arësyetimin e provave të pa mjaftueshme. Kërkuesit apeloj por pa sukses.

4. Ndërkohë, në datën 6 qershor 1995, kërkuesit bënë padi civile kundër spitalit dhe doktorit në fjalë. Procedurat në gjykatën e shkallës së parë, që u zhvilluan nga tetori 1997 deri në maj 2001, u pezulluan, në pritje të procesit penal, dhe padia u pushua në 25 gusht 2006. Përpjekjet e kërkuesve për ta apeluar vendimin nuk patën sukses. Kur Dhoma e Madhe në Strasburg dha vendimin, çështja ishte në shqyrtim e sipër nga Gjykata Kushtetuese Sllovene.

5. Me një vendim të 28 qershorit 2007, një Dhomë e Gjykatës vendosi unanimitisht se nuk kishte juridiksion për të shqyrtuar ankimin e kërkuesve për shkelje të aspektit substancial të nenit 2, sepse vdekja kishte ndodhur përpara hyrjes në

---

100 neni 186 i Ligjit slloven për Procedurën Penale.

fuqi të Konventës në Slloveni, por gjeti shkelje të aspektit procedural të këtij neni. Më 27 shtator 2007, qeveria kërkoi që çështja t'i dërgohej për shqyrtim Dhomës së Madhe sipas nenit 43 dhe paneli i Dhomës së Madhe e pranoi këtë kërkesë.

6. Përpara Dhomës së Madhe, kërkuesit u ankuan për mungesën e efektivitetit të sistemit gjyqësor slloven në konstatimin e përgjegjësisë për vdekjen e djalit të tyre, në shkelje të nenit 2. Ata u ankuan gjithashtu se procedurat gjyqësore kishin zgjatur tej mase dhe se procedimet penale kishin qenë të padrejta, në shkelje të neneve 6 dhe 13 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

#### *i) në lidhje me juridiksionin kohor*

7. Dhoma e Madhe në këtë rast analizoi jurisprudencën e Gjykatës lidhur me juridiksionin e saj të përkohshëm për të shqyrtuar ankesat mbi aspektin procedural të nenit 2 në rastet kur vdekja ka ndodhur para datës së hyrjes në fuqi të Konventës në shtetin përkatës ose që quhet ndryshe "data kritike". Gjykata vlerësoi se detyrimi procedural për të kryer një hetim efektiv sipas nenit 2 kishte evoluar në një detyrim të veçantë dhe autonom, i cili megjithëse shkaktohej nga akte që kishin të bënin me aspektin substancial të nenit 2, mund të çonin në konstatimin e një "ndërrhyrjeje" të veçantë dhe të pavarur. Detyrimi procedural mund të konsiderohej si një detyrim më vete i detyrueshëm për shtetin edhe kur vdekja kishte ndodhur përpara datës kritike. Prandaj, Dhoma e Madhe vlerësoi se Gjykata kishte juridiksion kohor në raste të tilla.

8. Megjithatë, ajo theksoi se parimi i sigurisë juridike nënkuptonte se juridiksioni i saj në këto raste nuk ishte i pakufishëm: së pari, kur vdekja kishte ndodhur përpara datës kritike, vetëm veprimet dhe/ose mosveprimet procedurale që ndodhin pas kësaj date mund të përfshihen në juridiksionin kohor të Gjykatës; së dyti, duhet të ketë një lidhje të mirëfilltë mes vdekjes dhe hyrjes në fuqi të Konventës në shtetin e paditur në mënyrë që detyrimet procedurale të vendosura nga neni 2 të kishin fuqi. Kjo do të thoshte se një pjesë e rëndësishme e hapave proceduralë të kërkuar nga kjo dispozitë duhej të ishin marrë pas datës kritike.

9. Duke zbatuar këto parime në rrethanat e rastit të kërkuesve, Gjykata vuri në dukje se vdekja e djalit të tyre kishte ndodhur pak më shumë se një vit përpara hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me Slloveninë dhe se, përveç hetimit paraprak, të gjitha procedurat penale dhe civile ishin iniciuar dhe kryer pas kësaj date. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kishte juridiksion kohor në lidhje me ankesën për aspektet procedurale të nenit 2, për aq sa ajo lidhej me procedurat pas datës kritike. Si përfundim, ajo e hodhi poshtë pretendimin paraprak.

*ii) në lidhje me themelin e aspektit procedural të nenit 2*

10. Gjykata konstatoi se palët nuk e kundërshtonin faktin se kushtet shëndetësore të Gregor Šilih filluan të përkeqësoheshin ndjeshëm në spital dhe se vdekja e tij mund të lidhej me trajtimin e tij mjekësor atje. Duke patur parasysh se kërkuesit deklaruan se djali i tyre kishte vdekur si rezultat i neglizhencës mjekësore, shteti në fjalë, në mënyrë që të përmbushte detyrimet e tij sipas nenit 2, duhet të kishte në veprim një sistem gjyqësor efektiv dhe të pavarur i cili të përcaktonte shkakun e vdekjes dhe të vendoste për përgjegjësinë e shkaktarëve. Në përpjekje për të sqaruar rrethanat e ngjarjes dhe përgjegjësinë për vdekjen e djalit të tyre, kërkuesit përdorën dy mjete ligjore, penale dhe civile. Gjykata vlerësoi se kohëzgjatja e tepërt e procedurës penale, dhe në veçanti e hetimit, nuk mund të justifikohet as nga sjellja e kërkuesve, as nga kompleksiteti i çështjes.

11. Procedurat civile nga ana e tyre ishin ende në pritje prej më shumë se 13 vjetësh pasi kishin filluar dhe çështja ishte ende para Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, edhe pse procedura civile ishte pezulluar për tre vjet e shtatë muaj në pritje të përfundimit të procedurës penale, ajo kishte ngecur në fakt që dy vjet më parë. Prandaj, edhe pas pezullimit të procedurave kriminale në tetor 2000, gjykatave të brendshme iu deshën edhe pesë vjet e tetë muaj të tjerë për të vendosur mbi padinë civile të kërkuesve. Ndërsa kërkesat e kërkuesve për një ndryshim të vendbanimit dhe për zëvendësimin e disa gjyqtarëve kishin vonuar procedurat deri në njëfarë mase, shumë nga vonesat pas rifillimit të shqyrtimit gjyqësor ishin të pajustificueshme. Gjithashtu, për Gjykatën ishte e papranueshme që rasti i kërkuesve ishte trajtuar nga të paktën gjashtë gjyqtarë të ndryshëm në një seri procedurash në shkallë të parë, pasi ndryshimet e shpeshta të gjyqtarëve domosdoshmërisht cenonin efektivitetin e gjykimit. Disa seanca dëgjimore, për shembull, janë vonuar deri në nëntë ose dhjetë muaj thjesht për një ndryshim vendi si rezultat i faktit që çështja është marrë për gjykim nga një tjetër gjyqtar. Prandaj, autoritetet vendase kishin dështuar të trajtonin kërkesën e kërkuesve me zellin dhe efektivitetin e duhur. Për këto arsye, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të aspektit procedural të nenit 2 të Konventës.

***B. Në lidhje me nenet 6 dhe 13***

12. Duke patur parasysh konstatimin e shkeljes së nenit 2, Gjykata vendosi vendosi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte në mënyrë të veçantë çështjen edhe nën nenet 6 dhe 13.

***C. Në lidhje me nenin 14***

13. Gjykata i akordoi kërkuesve 7 540 euro për dëm jo-pasurore dhe 4,039 euro për kostot dhe shpenzimet.

**III. Koment**

14. Ky është një vendim shumë i rëndësishëm jo vetëm për shtetet të cilat i janë bashkuar së fundmi sistemit të Konventës, por edhe për shtete që janë prej



dekadash palë në Konventë. Vlera e veçantë e vendimi, konsiston në trajtimin e çështjes së detyrimeve që lindin pas ratifikimit në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur përpara se Konventa të hunte në fuqi në shtetin përkatës. Vlera e vendimit është shumë më e madhe për vendet me të kaluar komuniste dhe diktatoriale, pra dhe me shkelje në masë të të drejtave të njeriut. Kjo pyetje, kishte qenë ndërkaq objekt i një jurisprudence tepër të ngurtë nga Gjykatës<sup>101</sup> dhe kishte shkaktuar reagime qoftë nga vetë gjyqtarët e formacionit<sup>102</sup> qoftë edhe nga doktrina<sup>103</sup>.

15. Problemi është që sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dispozitat e Konventës nuk janë të detyrueshme për një palë kontraktuese në lidhje me ndonjë akt apo fakt që ka ndodhur ose ndonjë situatë që ka pushuar së ekzistuari para datës së hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me atë palë<sup>104</sup>. Por, thelbi i çështjes është se cila është "*data kritike*", pra kur ka pushuar së ekzistuar një situatë dhe nëse, pavarësisht se vdekja e djalit të kërkuesve kishte ndodhur përpara datës së hyrjes në fuqi të Konventës në Slloveni, vazhdimi i procedurave gjyqësore pas kësaj date i jepte juridision kohor Gjykatës për të shqyrtuar vetëm aspektin procedural të nenit 2.

16. Gjykata duket se më në fund i jep përgjigje pozitive por të përcaktuar qartë kësaj pyetjeje<sup>105</sup>. Pra, edhe kur vdekja ka ndodhur përpara hyrjes në fuqi të Konventës por procedurat e brendshme zhvillohen kryesisht pas datës së hyrjes në fuqi, atëherë Gjykata ka juridiksion kohor për të shqyrtuar pretendimet për shkelje të aspektit, e theksojmë, procedural të nenit 2. Kriteri tjetër që thekson Gjykata është ai që edhe vdekja në vetvete nuk duhet të ketë ndodhur shumë

101 Shih sidomos *Nikola Mladenic dhe të tjerë k. Kroacisë* (no. 48485/99), 07.09.2000, *Moldovan dhe të tjerë dhe Rostas dhe të tjerë kundër Rumanisë*, nr. 41138/98 dhe 64320/01, 13.03.2001. *Gauder k. Kroacisë*, (nr. 45132/98), 21.06.2001, *Moldovan dhe të tjerë dhe Rostas dhe të tjerë kundër Rumanisë*, nr. 41138/98 dhe 64320/01, 13.03.2001. *Voroshilov k. Ruisë*, nr. 21501/02, 8.12.2005, *Blecic kundër Kroacisë*, (DH.M.), 8.03.2006, *Kholodov dhe Kholodova k. Ruisë*, nr. 30651/05, 14.09.2006.

102 Gjyqtarët Zagrebelsky, Rozakis, Cabral Barreto, Spielman dhe Sajo ishin dakord me gjykimin por jo të kënaqur me interpretimin e shumicës. Gjykatësit Bratza dhe Turmen abstenuan duke qenë se ata nuk konsideruan se Sllovenia mund të quhej përgjegjëse sepse vdekja ka ndodhur përpara ratifikimit, dhe hetimi nuk mund të ndahej nga ajo ngjarje.

103 Shih për shembull Eirik Bjorge, pedagog i së drejtës ndërkombëtare në Bristol, i cili botoi një artikull të titulluar: "*Right for the Wrong Reasons: Silih v Slovenia and Jurisdiction Ratione Temporis in the European Court of Human Rights*" - *British Yearbook of International Law* (2013) 83 (1) 115-136. Ai shprehet se njohja e juridiksionit kohor për fakte të ndodhura përpara ratifikimit të një konvente janë pranuar ndërkaq nga Gjykata Permanente e së Drejtës Ndërkombëtare në çështjen *Kompania Elektriqe e Sofies dhe e Bullgarisë* që më 1939, dhe se Gjykata e Strasburgut nuk kishte nevojë përdorte instrumentin e interpretimit evolutiv për të arritur këtë rezultat. Megjithatë mendoj se kritika e Eirik Bjorge nuk qëndron sepse situata nuk ishte e njëjtë. Në çështjen Kompania Elektriqe debati lidhej me marrëdhënien mes një deklarate fakultative juridiksioni të GJPDN dhe një deklarate të detyrueshme të përfshirë në një traktat.

104 Shih nenin 28 "Mungesa e fuqisë prapavepruese të traktateve të Konventës së Vjenës mbi të drejtën e traktateve të 23.05.1969 i cili parashikon: "Në qoftë se një qëllim i ndryshëm nuk del nga traktati ose është vendosur ndryshe, dispozitat e tij nuk janë detyruese për një palë në lidhje me çdo akt ose fakt i cili ka ndodhur ose çdo situatë e cila ka pushuar së ekzistuari përpara datës së hyrjes në fuqi të traktatit për atë palë."

105 Shih paragrafët 8 dhe 9 të përmbledhjes së vendimit më lart.

më parë në kohë nga hyrja në fuqi e Konventës. Problemi që pason është sa e shkurtër duhet të jetë kjo kohë, pra nga vdekja deri tek hyrja në fuqi e Konventës dhe sa përcaktues është ky kriter? Duket se në vlerësimin e këtij kriteri Gjykata ka mbajtur parasysh në mënyrë të veçantë rrethanat specifike të secilit rast. Kështu për shembull në çështjen *Varnava kundër Turqisë*<sup>106</sup>, Dhoma e Madhe e hodhi poshtë pretendimin e tretë paraprak të Qeverisë Turke dhe pranoi se, megjithëse zhdukjet e të afërmeve të kërkuesve kishin ndodhur më 1974 dhe kërkesat ishin sjellë tre vjet pas pranimit të së drejtës për ankim individual nga ana e Turqisë, më 28 janar 1987<sup>107</sup>, kishte një lidhje të mirëfilltë në kohë mes të drejtës për ankim dhe bërjes së kërkesave. Duket se fakti që në këtë rast nuk ishte ratifikimi si data kritike por pranimi i së drejtës për ankim individual ishte me rëndësi që Gjykata ta hidhte poshtë pretendimin.

17. Gjykata në një sërë vendimet e ka konsideruar veten kompetente për vdekje të ndodhura përpara ratifikimit, sidomos ato që kishin ndodhur gjatë shtypjes së revolucionit rumun në 1989-1990<sup>108</sup>. Sidoqoftë në çështjen *Janoëiec k. Polonisë*<sup>109</sup>, duke sqaruar kriteret Silih<sup>110</sup>, Gjykata nuk pranoi se kjo lidhje mund të pranohej se ekzistonte për vrasjen e ushtarakëve polakë nga Ushtria Sovjetike në 1940. Gjykata kujtoi se Rusia e kishte ratifikuar Konventën vetëm më 1998 dhe theksoi se që të kishte një lidhje të mirëfilltë për qëllimet e juridiksionit kohor, duhet që periudha mes vdekjes dhe ratifikimit të mos ishte më e gjatë se 10 vjet. Gjithashtu, Gjykata kujton se vrasjet kishin ndodhur edhe përpara se vetë Konventa të hartohej. Prandaj në atë rast ajo vendosi se nuk kishte juridiksion kohor. Ky qëndrim i Gjykatës është konfirmuar gjithashtu në çështjen *Ana Mocanu k. Rumanisë*.<sup>111</sup>

18. Megjithatë, Gjykata pranon nga ana tjetër që mund të ekzistojnë situata të jashtëzakonshme të cilat nuk e plotësojnë kriterin e “lidhjes së mirëfilltë” ashtu siç parashtrohet më lart, por ku nevoja për t’i mbrojtur në mënyrë reale dhe efektive garancitë e ofruara nga Konventa dhe vlerat ku mbështetet ajo përbën një bazë të mjaftueshme për ta pranuar ekzistencën e një lidhjeje. Fjalja e fundit e paragrafit 163 të vendimit Silih nuk e përjashton një mundësi të tillë, e cila do të përbente atëherë një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm i përfaqësuar nga kriteri i një “lidhjeje të mirëfilltë”. Këtë qëndrim e konfirmoi në *Janoëiec*.

106 Vendim i 18.09.2009, i përfshirë në këtë botim.

107 Kujtojmë që deri me hyrjen në fuqi të Protokollit 11, më 1.11.1998, juridiksioni i Gjykatës nuk ishte i detyrueshëm si është tani por fakultativ dhe për këtë qëllim duhej bërë një deklaratë më vete.

108 Shih sidomos *Shoqata “21 Dhjetori 1989” me të tjerë k. Rumanisë*, nr. 33810/07 dhe nr. 18817/08, 24.04.2011; *Pastor e Ticlete k. Rumanisë*, nr. 30911/06 dhe nr. 40967/06, 19.04.2011; *Lăpușan me të tjerë k. Rumanisë*, nr. 29007/06, 30552/06, 31323/06, 31920/06, 34485/06, 38960/06, 38996/06, 39027/06 dhe 39067/06, 8.03.2011; *Șandru me të tjerë k. Rumanisë*, nr. 22465/03, 8.12.2009, dhe *Agache me të tjerë k. Rumanisë*, nr. 2712/02, 20.10.2009 dhe *Crăiniceanu e Frumușanu k. Rumanisë*, nr. 12442/04, 24.04.2012. Shih gjithashtu *Paçacı and Others k. Turqisë*, no. 3064/07, 8.11. 2011 dhe *Jularić k. Kroacisë*, nr. 20106/06, 20.01.2011.

109 *Janowiec dhe të tjerë k. Rusisë* [DHM], nr. 55508/07 dhe 29520/09, vendim i 21.10.2013.

110 Id, §§ 140 dhe 141.

111 *Shih Mocanu dhe të tjerë k. Rumanisë*, [DHM], nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, 17.09.2014. sidomos §§ 205-211.

Sipas Gjykatës raste të tilla do jenë ato ku janë cenuar vetë “vlerat e Konventës”. Dhoma e Madhe, ashtu si Dhoma në Janowiec, çmoi se referimi ndaj vlerave ku mbështetet Konventa nënkupton që ekzistenca e lidhjes së kërkuar mund të konstatohet atëherë kur fakti i zanafillës ka përmasa më të gjera sesa një vepër penale ordinere dhe përbën një mohim të vetë themeleve të Konventës. I tillë do të ishte rasti i krimeve të rënda sipas së drejtës ndërkombëtare, si krimet e luftës, gjenocidi ose krimet kundër njerëzimit, në përputhje me përkufizimet që japin për to instrumentet përkatëse ndërkombëtare. Në mbajtjen e këtij qëndrimi Dhoma e Madhe në këto raste duket se është bazuar në jurisprudencën e aplikuar prej institucioneve të tjera duke njohur lidhjet me dhunimin e të drejtave të njeriut<sup>112</sup>.

## SHOQATA “21 DHJETOR 1989” DHE TË TJERË kundër RUMANISË

(kërkesat nr. 33810/07 dhe 18817/08)

24 maj 2011

*kjo çështje ka të bëjë me protestat antikomuniste në Rumani 1989 dhe me pasojat e shtypjes së protestave dhe të hetimeve në lidhje me këto ngjarje, qoftë përsa i përket vrasjeve qoftë përgjimeve sekrete*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit në këtë çështje janë Shoqata “21 dhjetor 1989”, me seli në Bukuresht, presidenti i saj, Teodor Maries, shtetas rumun i cili ka lindur në vitin 1962 dhe jeton në Bukuresht, si dhe bashkëshortët Elena dhe Nikolae Vlase, dy shtetas rumunë që jetojnë në Brasov, Rumani. Ata janë ose përfaqësojnë pjesëmarrës, të plagosur ose të vdekur gjatë shtypjes së demonstratave kundër regjimit të Çausheekut në dhjetor 1989. Sipas të dhënave të ofruara nga autoritetet rumune në vitin 2008, gjatë ngjarjeve në fjalë mbi 1200 njerëz vdiqën, më shumë se 5,000 u plagosën dhe disa mijëra u keqtrajtuan apo u privuan në mënyrë të paligjshme nga liria.

2. Gjatë viteve 1990, prokurorët ushtarakë nisën një sërë hetimesh në lidhje me këto ngjarje. Hetimi kryesor – dosja nr. 97/P/1990 - filloi në korrik të vitit 1990. Më 20 shtator 1995 çështja u pushua sidomos për shkak se përgjegjësi penale për vrasjet dhe plagosjet e shkaktuar në Bukuresht para 22 dhjetorit 1989 nga ushtarë të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe udhëheqja

112 Shih vendimin e 26.04.2006 të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në rastin *Kouidis kundër Greqisë*, i cili mbajti qëndrimin se data kritike ishte data e vendimit gjyqësor përfundimtar dhe jo data në të cilën kishin ndodhur ngjarjet për të cilat ankoreshin ankuesit. Shih gjithashtu jurisprudencën e Gjykatës Ndëramerikane për të drejtat e njeriut, në çështjet *Velásquez Rodríguez k. Hondurasit*, 29.07.1988, *Gomes Lund dhe Almonacid Arellano k. Kilit*, 26.09.2006, *Heliodoro Portugal k. Panamasë*, 12.08.2008 *Gomes Lund k. Brazilit*, 27.11.2010,

*Securitate* (Sigurimi i Shtetit në Rumani), kishin vetëm personat që kishin urdhëruar të hapej zjarr, përkatësisht kreu i shtetit në atë kohë dhe ministrat e tij të mbrojtjes dhe të brendshëm si dhe kreu i *Securitate*, tashmë të dënuar ose të vdekur. Më 7 dhjetor 2004, seksioni ushtarak i Prokurorisë së Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë e anuloi këtë vendim si të paligjshëm dhe të pabazuar dhe urdhëroi ndjekjen penale për 102 persona, kryesisht oficerë të ushtrisë, policisë dhe të *Securitate*, për vrasje, gjenocid, nxitje dhe pjesëmarrje në kryerjen e këtyre veprave penale, ndërmjet 21 dhe 30 dhjetorit 1989. 16 civilë, përfshirë një ish-President rumun dhe një ish-kryetar të shërbimit sekret rumun u akuzuan gjithashtu.

3. Me një letër dërguar shoqatës kërkuese në qershor të vitit 2008, prokurori ushtarak informon se gjatë periudhës 2005-2007, u pyetën për këtë çështje 6,370 persona, u bënë 1100 ekspertiza balistike, më se 10.000 masa hetimore dhe 1000 këqyrje në terren. Letra shprehej gjithashtu se kishte pasur vonesa në hetim dhe përmend disa shkaqe, duke përfshirë faktin se veprimet e nevojshme hetimore nuk ishte bërë menjëherë pas vrasjeve dhe keqtrajtimeve të pretenduara, transferimet e përsëritura të dosjes nga një prokuror tek një tjetër, mos-njoftimi i menjëhershëm i të dëmtuarve për vendimet e pushimit të hetimeve, "mungesën e bashkëpunimit" të institucioneve të përfshira në shtypjen e demonstratave të dhjetorit 1989, si dhe transferimin me vendim të Gjykatës Kushtetuese të hetimit të dosjes nr. 97/P/1990 nga prokurorët ushtarakë prokurorëve civilë.

*i. hetimi mbi vdekjen e Nicusor Vlase, i biri i kërkuesve Elena dhe Nikolae Vlase*

4. Elena dhe Nikolae Vlase, duke parë shenjat e dhunës dhe plagët që i rridhnin akoma gjak, dyshuan menjëherë se djali i tyre u vra gjatë demonstratave në Brasov 23 dhjetor 1989. Sipas tyre, ai vdiq më vonë. Që nga 1991 deri më 2008, ata i dërguan letra dhe ankesa të shumta prokurorit publik dhe autoriteteve të tjera, duke kërkuar që ata që kishin vlarë djalin e tyre të identifikoheshin dhe të dënoheshin. Me një vendim të 28 dhjetorit 1994, prokurori ushtarak i Brasov e kishte pushuar hetimin me shkakun se kishte pasur një "gabim faktik, i cili përjashtonte çdo përgjegjësi penale". Ky vendim iu njoftua Elena dhe Nikolae Vlase vetëm më 9 korrik 1999. Pas apelimit të Elena Vlase ky vendim u prish në gusht të vitit 1999 dhe kërkuesit vazhduan të ngrinin pretendimet e tyre. Në janar 2006, ky hetim iu bashkëngjit dosjes nr. 97/P/1990. Në tetor 2008 dhe janar 2009, në përgjigje të një ankese nga Elena Vlase mbi kohëzgjatjen e hetimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor u përgjigj se kishte konstatuar se gjatë viteve 1994 deri 2001 dhe 2002 deri në vitin 2005, asnjë veprim hetimor nuk ishte ndërmarrë për të nxjerrë para drejtësisë përgjegjësit për vdekjen e djalit të saj, dhe se do vlerësohej nëse prokurorët kishin përgjegjësi disiplinore për këto vonesa. Këshilli specifikoi se hetimi kishte rifilluar pas dhjetorit 2004. Kërkuesit pretenduan një kompensim nga institucionet që pretendonin se ishin përgjegjës për vdekjen e djalit të tyre dhe për pengimin e hetimeve, por pa sukses.

*ii. rasti i Teodor Maries dhe shoqatës që ai drejton*

5. z. Maries mori pjesë aktivisht në protesta që më 21 dhjetor 1989. Ai ishte pjesë e turmës që u shpërnda me tanke dhe u qëllua nga forcat e rendit. Më 22 dhe 23 dhjetor 1989, ai ishte pjesë e protestuesve të cilët arritën të hyjnë në selinë e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe në atë të televizionit kombëtar. Ai mori pjesë në protesta deri në vitin 1990, duke kërkuar që të zbardhej përgjegjësia e vrasjeve të dhjetorit 1989. Teodor Maries pretendon se, si president i shoqatës kërkuese, është objekt i masave të mbikëqyrjes sekrete, veçanërisht nëpërmjet përgjimeve telefonike. z. Maries paraqet dy dokumente sekrete të qershorit dhe dhjetorit 1990 dhe një raport të Shërbimit Informativ Rumun (SRI), të nëntorit 1990 të cilat përmbajnë të dhëna të shumta, sidomos mbi jetën private të z. Maries. Në vitin 1998, shoqata kërkuese i kërkoi SRI që t'i bënte të njohura urdhrat mbi bazën e të cilave ishin kryer këto përgjime. SRI u përgjigj se nuk mund ta plotësonte këtë kërkesë për shkak se ia ndalonte legjislacioni për sigurinë kombëtare dhe funksionimin e tij si institucion. Gjatë vitit 2009, tre organizata të tjera që vepronin në fushën e sigurisë kombëtare iu përgjigjën z. Maries se ai nuk ishte përgjuar nga ana e tyre dhe se nuk kishin të dhëna në lidhje me të.

*iii. aksesi i kërkuesve në dosjet hetimore*

6. Në tetor 2009, një kopje e të gjitha dokumenteve të hetimit, si dhe regjistrime audio dhe video të klasifikuara në dokumentin nr. 97/P/1990, përveç atyre që ishin sekrete, iu dha shoqatës kërkuese. Me një vendime të Qeverisë në shkurt dhe mars 2010, disa informacione "sekret shtetëror" të mbajtura nga Ministria e Mbrojtjes u deklasifikuan dhe iu vunë në vijim në dispozicion kërkuesve. Kërkuesit pranojnë se tani pothuajse të gjitha dokumentet e dosjes u janë vënë në dispozicion me përjashtim të vendimeve të Këshillit të Ministrave.

*iv. ligji i amnistisë për aktet e kryera nga ushtria*

7. Në vitin 2008, një projekt-ligj për amnistimin e akteve të kryera nga ushtria në dhjetor 1989 iu përcoll për mendim prokurorive ushtarake.

8. Duke u bazuar në nenin 2, bashkëshortët Vlase, ankohen se nuk ka pasur hetimin efektiv në lidhje me vdekjen e djalit të tyre. Duke u bazuar në nenin 3, z. Maries u ankua për mungesën e hetimit efektiv mbi keqtrajtimet të cilëve ai thotë se u është nënshtruar ndërkohë që merrte pjesë në demonstratat e dhjetorit 1989. Duke u bazuar në nenin 8, ai u ankua gjithashtu (në emrin e tij dhe të shoqatës së tij), se ka qenë subjekt i masave të mbikëqyrjes sekrete, që përbënin sipas tij një mjet presioni nga autoritetet në lidhje me aktivitetin e tij kryetar i një shoqate që luftonte për një hetim efektiv mbi ngjarjet e dhjetorit 1989. Kërkuesit ankoheshin gjithashtu për shkelje të neneve 6, 13, 14 dhe 34.

**II. Vendimi i Gjykatës**

9. Gjykata vlerësoi, në bazë të nenit 35 të Konventës se vetëm pretendimet në



bazë të neneve 2 dhe 8 janë të pranueshme, dhe se konstatimet në lidhje me këto dy nene shmangnin nevojën për shqyrtimin e pretendimeve sipas neneve 6, 13, 14 dhe 34. Ajo konstatoi gjithashtu se "Shoqata 21 dhjetor 1989" nuk e kishte mbajtur ankesën e saj fillestare në lidhje me akuzat e vëzhgimit të fshehtë (neni 37, 1, a i Konventës). Së fundi, Gjykata vlerësoi se duhet ta shqyrtonte themelin vetëm në lidhje me efektivitetin e hetimeve për vdekjen e djalit të z. dhe znj. Vlase (neni 2) dhe mbikëqyrjen e fshehtë të pretenduar nga z. Maries (neni 8).

#### *A. Në lidhje me nenin 2 (mbi hetimin për vdekjen e djalit të z. dhe znj. Vlase)*

10. Neni 2 kërkon kryerjen e një hetimi efektiv, ku përdorimi i forcës, duke përfshirë forcën e ushtruar nga agjentët e shtetit, ka sjellë si pasojë vdekjen. Ky detyrim kërkon një shqyrtim të shpejtë, të plotë, të paanshëm dhe të thelluar të rrethanave të vrasjeve, për të arritur në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës.

11. Në lidhje me vdekjen e djalit të z. dhe znj. Vlase, Gjykata vuri në dukje se hetimi kishte nisur prej më se 20 vjetësh. KEDNJ ka hyrë në fuqi në lidhje me Rumaninë më 20 qershor 1994, dhe Gjykata mund ta shqyrtojë këtë kërkesë vetëm pas kësaj date.

12. Gjykata konstatoi se në vitin 1994, çështja ishte në shqyrtim e sipër nga prokurorët ushtarakë të Brasov. Këta ishin, ashtu si edhe shumica e të pandehurve, ndërmjet të cilëve zyrtarë të lartë ushtarakë ende në detyrë, ushtarakë që i nënshtroheshin parimit të hierarkisë. Ajo konstatoi më pas se, siç e kishte pranuar Këshilli i Lartë i Gjyqësorit me dy letrat e tetorit 2008 dhe janarit 2009, ndërmjet viteve 1994 dhe 2001 dhe pastaj ndërmjet viteve 2002 dhe 2005, pra dhjetë vjet në total, nuk ishte kryer asnjë veprim hetimor në lidhje me vdekjen e djalit të kërkuesve. Gjithashtu, në letrën e qershorit 2008, seksioni i prokurorisë ushtarake pranoi vonesat dhe tregoi një një listë të shkaqeve, duke përfshirë mosnjohimin e menjëhershëm të të dëmtuarve për vendimet e pushimit të hetimeve, "mungesën e bashkëpunimit" të institucioneve të përfshira në shtypjen e demonstratave të dhjetorit 1989. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se fshehja e qëllimshme e dëshmimeve hedh dyshime mbi kapacitetin e vërtetë të hetimeve për të sqaruar ngjarjet. Po kështu, klasifikimi "sekret" ose "tepër sekret" i informacioneve thelbësore për hetimin nuk justifikohet.

13. Gjykata kujton në vijim detyrimin procedural për të garantuar pjesëmarrjen e të afërmve të viktimës në procedura. Ajo vë re se nuk është dhënë asnjë justifikim që deri në korrik të vitit 1999 z. dhe znj. Vlase nuk kishin pasur asnjë informacion mbi hetimin, pavarësisht nga kërkesat e tyre të shumta në këtë drejtim. Në mënyrë të veçantë, as vendimi i pushimit i 28 dhjetorit 1994, as motivet e tij nuk u ishin njoftuar. Edhe pas kësaj date, komunikimet kanë qenë të kufizuara në një informacion të shkurtër në dhjetor 2003 në përgjigjet përsëritëse të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit në tetor 2008 dhe janar të vitit 2009. Vetëm në shkurt-mars të vitit 2010 informacione të rëndësishme për hetimin,



të klasifikuara më parë si "sekret" apo "tepër sekret" u vunë në dispozicion të kërkuesit dhe të palëve të tjera të dëmtuara.

14. Gjykata nuk e nënvlerëson kompleksitetin e çështjes, e cila që kur iu bashkua dosjes hetimore nr. 97/P/1990 në janar të vitit 2006, synon të sqarojë përgjegjësitë për shtypjen me dhunë të protestave në dhjetorit 1989 në disa qytete të Rumanisë. Ajo çmon gjithsesi që interesat politike dhe sociale të ngritura nga autoritetet rumune në argumentet e tyre nuk mund të justifikojnë, si të tilla as kohëzgjatjen e hetimeve as mënyrën se si ato janë kryer gjatë një periudhe të gjatë kohore, pa informuar palët e interesuara dhe as publikun mbi ecurinë e saj. Në të kundërt, rëndësia e saj për shoqërinë rumune duhet t'i kishte nxitur autoritetet për ta trajtuar dosjen menjëherë dhe pa vonesa të panevojshme, që të mos dukej sikur akte të caktuara mbrohen nga mos ndëshkimi.

15. Gjykata theksoi rëndësinë e të drejtës së viktimave dhe familjeve të tyre për të ditur të vërtetën në lidhje me rrethanat e ngjarjeve që përfshijnë shkelje masive të të drejtave themelore të tilla si e drejta e jetës, ku përfshihet e drejta për një hetim gjyqësor efektiv dhe një dëmshpërblim eventual. Për këtë arsye, në rastin e përdorimit masiv të forcës vdekjeprurëse kundër civilëve gjatë protestave anti-qeveritare që shoqëruan kalimin nga një regjim totalitar me një regjim demokratik, Gjykata nuk mund të pranojë se një hetim është efektiv kur ai mbyllet për shkak të parashkrimit të përgjegjësive penale, kur autoritetet nuk janë treguar aktive. Për më tepër, siç Gjykata e ka thënë vazhdimisht, amnistia dhe falja janë përgjithësisht të papajtueshme me detyrën e Shteteve për të hetuar aktet e torturës dhe për të luftuar kundër mosndëshkimit të krimeve ndërkombëtare. Në këto rrethana, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 2 në lidhje me z. dhe znj. Vlase.

***B. Në lidhje me nenin 8 (mbi pretendimet për përgjim të fshehtë të z. Maries)***

16. z. Maries paraqiti dy dokumente sekrete dhe një dokument përmbledhës të hartuar në lidhje me të themeluar në vitin 1990. Këto dokumente konfirmonin se ai ka qenë objekt i masave të përgjimit në vitin 1990. Këto dokumente mbaheshin ende nga shërbimet sekrete rumune ,të paktën deri në vitin 2006, kur ai mori një kopje të tyre.

17. Gjykata kujton se e ka shqyrtuar legjislacionin rumun mbi masat përgjimeve të fshehta të lidhura me sigurinë kombëtare për herë të parë në 2000<sup>113</sup>. Ajo pati arritur në përfundimin se legjislacioni për mbledhjen dhe arkivimin e të dhënave nuk përmbante garancitë e duhura për mbrojtjen e të drejtës së individëve për jetë private. Ky legjislacion nuk tregonte me qartësinë e duhur fushën e veprimit dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit të autoriteteve në këtë sferë. Megjithatë, pavarësisht nga një Rezolutë e ndërmjetme e Komitetit të Ministrave të Këshillit

113 Vendimi i Dhomës së Madhe dt. 04.05.2000 në lidhje me çështjen *Rotaru k. Rumanisë*.

të Evropës<sup>114</sup>, e cila bënte thirrje që të ndreqeshin menjëherë dhe plotësisht këto mangësi, ekzekutimi i atij vendimit nuk është mbyllur deri më sot. Për më tepër, siç e ka konstatuar Gjykata në vitin 2007<sup>115</sup>, pavarësisht ndryshimeve më 2003 dhe më 2006 të Kodit të Procedurës Penale, masat e përgjimeve në rastet e rrezikut për sigurinë kombëtare duket se ende sot mund të merren sipas procedurës së parashikuar me ligjin nr 51/1991, i cili nuk është shfuqizuar.

Mungesa e garancive të mjaftueshme në legjislacionin kombëtar ka lejuar që informacionet e mbledhura në vitin 1990 nga ana e shërbimeve sekrete në lidhje me z. Maries të mbahen ende nga ana e tyre më 2006, 16 vjet pasi janë mbledhur. Përveç kësaj, në mungesë të garancive në legjislacionin përkatës kombëtar, z. Maries i kërcënohet rreziku serioz që komunikimet e tij telefonike të përgjohen. Për këto arsye, ka pasur shkelje të nenit 8 në lidhje me z. Maries.

### **C. Në lidhje me nenin 46**

18. Gjykata vuri në dukje se konstatimi i shkeljes së nenit 2 për shkak të mungesës së një hetimi efektiv është një problem i përhapur, pasi disa qindra njerëz janë palë të dëmtuara në procedurat penale që u gjetën në shkelje të Konventës. Përveç kësaj, më shumë se njëqind raste të ngjashme janë në shqyrtim e sipër para Gjykatës. Ata mund të çojnë në të ardhmen të vendimeve të reja që gjejnë shkelje të Konventës. Gjykata rikujton në mënyrë të veçantë që, në parim, Rumania mbetet e lirë, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për të zgjedhur mjetet për të përmbushur detyrimin e saj ligjor sipas nenit 46 të Konventës. Ajo vë në dukje megjithatë, se masat e përgjithshme në nivel kombëtar janë padyshim pjesë e ekzekutimit të këtij vendimi. Ajo konsideron se Rumania duhet t'i japë fund situatës që çoi në konstatimin e një shkelje të nenit 2 në lidhje me z. dhe znj. Vlase, shkelje që prek të drejtat për një hetim efektiv të shumë njerëzve të dëmtuar. Kjo situatë nuk mund të mbyllet me efektet e parashkrimit të përgjegjësisë penale, duke marrë parasysh sidomos rëndësinë për shoqërisë rumune që të dihet e vërteta për ngjarjet e dhjetorit 1989. Rumania duhet të gjejë zgjidhjen e duhur për të përmbushur kërkesat e nenit 46 duke marrë parasysh parimet e praktikës gjyqësore të Gjykatës në këtë fushë.

19 Në këto rrethana, Gjykata e konsideron të panevojshme të shtyjë shqyrtimin e rasteve të ngjashme që janë para saj, në pritje që Rumania të marrë masat e nevojshme. Duke vazhduar shqyrtimin e rasteve të ngjashme ajo do t'i kujtojë rregullisht Rumanisë detyrimet që rrjedhin nga ky venim.

### **D. Në lidhje me nenin 41**

20. Si shpërblim i drejtë, Gjykata u shpreh se Rumania duhet tu paguante z. dhe znj. Vlase, si dëm jopasuror, nga 15 000 euro secilit, dhe 6 000 euro z. Maries. Ajo duhet gjithashtu tu paguajë një total prej 20 000 euro për kostot dhe shpenzime.

114 Document ResDH(2005)57.

115 Vendimi i 26.04.2007 në lidhje me çështjen *Dumitru Popescu k. Rumanisë* (n° 2).

### III. Koment

21. Shkelje të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkak të mungesës së hetimit të efektshëm në vdekjen e birit të kërkuesve Elena dhe Nikolae Vlase; dhe Shkelja e nenit 8, për shkak të vëzhgimit të fshehtë të kërkuesit Teodor Maries.

22. Rasti ka origjinën në shtypjen e protestave anti-qeveritare në Rumani në dhjetor 1989. Dy kërkuesit, djali i të cilit është vrarë me atë rast, u ankuan për efikasitetin të hetimit në këtë drejtim. Një tjetër Kërkuesi, kryetar i një shoqate pjesëmarrëse avokimit dhe viktimat e këtyre ngjarjeve, i mbështetur në mesin e subjektit tjetër të mbikëqyrjes ilegale.

23. Gjykata vuri në dukje se konstatimi i shkeljes së nenit 2 të cilat arritur për shkak të mungesës së një hetimi efektiv është një problem i përhapur, pasi disa qindra njerëz janë të përfshirë si të dëmtuarit në procedurën penale të kritikuar. Përveç kësaj, më shumë se njëqind raste të ngjashme me këtë janë në pritje para Gjykatës. Ajo vë në dukje se masat e përgjithshme në nivel kombëtar janë padyshim pjesë e ekzekutimit të këtij aktgjykimi.

## HUGH JORDAN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 24746/94)

4 maj 2001

*në një rast kur pretendohet se një person ishte vrarë nga policia, Gjykata konstatoi shkelje duke u fokusuar në aspektet procedurale të nenit 2*

### I. Faktet kryesore

1. Hugh Jordan, i cili ka dy shtetësi, irlandeze dhe britanike, jeton në Belfast, në Irlandën e Veriut.

2. Më 25 nëntor 1992, po në Belfast, i biri i kërkuesit, Pearse Jordan, 22 vjeç, duke qenë i paarmatosur, ishte qëlluar tre herë në shpinë dhe ishte vrarë nga forcat e Xhandarmërisë Mbretërore të Ulsterit. Në nëntor 1993, Drejtori i Ndjekjes Penale në Prokurori (tani e tutje DNP) nxori një direktivë për pushim të ndjekjes penale për mungesë provash. Më 4 janar 1995, filloi hetimi në lidhje me vdekjen nga ana e një hetuesi. Ai u shty për më 6 maj 1995, duke i dhënë të drejtë kërkuesit që të fillonte procedurat e kundërshtimit gjyqësisht të refuzimit të hetuesit për t'i dhënë mundësi familjes së viktimës të njihej me deklaratat e dëshmitarëve si dhe të akordimit nga ana e tij të anonimatit dëshmitarëve të Xhandarmërisë Mbretërore të Ulsterit. Procedurat hetimore nuk janë mbyllur ende. Më 7 dhjetor

1992 kërkuesi kishte filluar gjithashtu edhe procedimin civil, duke pretenduar se vdekja kishte ardhur si pasojë e një veprimi të gabuar. Këto procedura janë, gjithashtu, në shqyrtim e sipër.

3. Kërkuesi, ndër të tjera, ankohej se i biri ishte vrarë nga një përdorim i tepruar i forcës i cili ishte në kundërshtim me nenin 2 të Konventës. Ai ankohej gjithashtu se, në bazë të nenit 2, nuk kishte pasur ndjekje penale në lidhje me këtë vrasje të pajustificueshme dhe se kishte pasur pra mosplotësim të kriterëve procedurale në kuadrin e nenit 2 sipas të cilave duhej të kishte pasur një hetim efektiv mbi rrethanat e vdekjes së të birit. Ai ankohej gjithashtu për shkelje të nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt), të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) dhe të nenit 13 (e drejta për ankim efektiv).

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

4. Gjykata vendosi se ajo nuk mund të vlerësonte nëse kishte pasur shkelje të elementëve materialë të nenit 2 përderisa të gjitha pretendimet e ngritura po prisnin të shqyrtoheshin në dy instanca të brendshme (gjykatë civile në lidhje me vdekjen si pasojë e një veprimi të gabuar dhe hetim penal në lidhje me vdekjen). Për këtë arsye ajo mendoi se kërkuesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet e brendshme në këtë kuadër.

5. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se, në kuadrin e nenit 2, në rastet e pretendimeve për vrasje të paligjshme, duhet të ndërmerren hetime të tilla që të jenë në gjendje të arrijnë në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës. Për këtë arsye Gjykata mori në shqyrtim nëse janë respektuar këto kërkesa procedurale të parashikuara në kuadrin e nenit 2.

6. Gjykata konstatoi se nuk i takonte asaj që të vlerësonte në detaje se cilat procedura duhet të ishin respektuar nga autoritetet për të arritur një analizë të përshtatshme të rrethanave të një vrasjeje nga autoritetet në varësi shtetërore. Gjykata vlerësoi se, në qoftë se gjetja e fakteve, hetimi penal dhe ndjekja penale kryheshin veç e veç ose edhe bashkërisht nga disa autoritete, siç ishte rasti edhe në Irlandën e Veriut, kërkesat e nenit 2 mund të plotësoheshin gjithsesi për aq sa, duke mbajtur parasysh interesa të tjerë legjitimë si sigurimi kombëtar ose mbrojtja e të dhënave me rëndësi për hetime të tjera, këto procedura të lartpërmendura ofronin garancitë e nevojshme në një mënyrë të qartë dhe efektive.

7. Gjykata konstatoi se procedurat për hetimin e përdorimit të forcës vdekjeprurëse nga ana e policit përkatës nxirrnin në pah të metat vijuese: mungesën e pavarësisë të policëve që po hetonin nga policët që kishin pasur rol në ngjarjen në fjalë; mungesën e vënies në dijeni të publikut dhe të informimit

të familjes së viktimës, mbi arsyet e vendimit të Drejtorit të Ndjekjes Penale për të mos ndjekur penalisht asnjë polic; polici që qëlloi Pearse Jordan nuk mund të kërkohej të merrte pjesë në hetim si dëshmitar; procedura e hetimit nuk çoi në asnjë konstatim ose vlerësim të cilët të mund të luanin një rol efektiv në fillimin e një ndjekjeje penale në lidhje me ndonjë vepër që mund të kishte dalë në pah; mungesa e ndihmës ligjore për përfaqësimin e familjes së viktimës dhe mosbërja të njohura e deklaratave të dëshmitarëve përpara paraqitjes së tyre në seancën e pyetjeve cenoi aftësinë e kërkuesit për të marrë pjesë në hetim dhe kontribuoi në shtyrjen e tejzgjatur të procedurave; kështu procedurat e hetimit nuk u filluan në mënyrë të menjëhershme dhe nuk u ndoqën me zhdërvjelltësinë e duhur dhe të arsyeshme.

8. Gjykata vuri në dukje se mangësitë e vëna re në lidhje me transparencën dhe efektivitetin penguan rolin e gjykatave të brendshme në këtë kuadër duke i lënë vend dyshimeve dhe thashethemeve. Për më tepër ishin të domosdoshme procedura të përshtatshme për të siguruar vënien përpara përgjegjësisë të policëve me qëllim që të ruhej besimi i publikut dhe të plotësoheshin kërkesat legjitime që kërkonin një përdorim të forcës vdekjeprurëse. Mungesa e procedurave të tilla vetëm sa mund të shtonte më tej mosbesimin dhe pakënaqësinë, siç edhe kishte rezultuar, ndër të tjera, nga deklaratat e bëra për vrasje të policëve.

9. Për këto arsye, Gjykata konstatoi se, në secilin nga katër rastet ka pasur mosrespektim të detyrimit procedural të kërkuar nga ana e nenit 2 dhe se ka pasur pra, në këtë kuadër, shkelje të nenit 2.

#### ***B. Në lidhje me nenin 6 § 1***

10. Duke kujtuar se ligjshmëria e të shtënave ndaj Pearse Jordan ishte në shqyrtim e sipër në instancat civile të vëna në lëvizje nga vetë kërkuesi, Gjykata konstatoi se nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1.

#### ***C. Në lidhje me nenin 13***

11. Gjykata konstatoi se nuk dilte në pah ndonjë çështje më vete në bazë të nenit 13 dhe se për këtë arsye pra, nuk ka pasur shkelje të këtij neni.

#### ***D. Në lidhje me nenin 41***

12. Gjykata i akordoi kërkuesit një shumë prej 10 000 sterlina për dëm jo-material. Ajo i akordoi atij edhe një shumë prej 30 000 sterlina për shpenzime dhe pagesa gjyqësore, duke mbajtur parasysh edhe parimin *ex aequo et bono*.

### **III. Koment**

13. Gjykata është stepur gjithmonë për të konstatuar shkelje materiale të nenit 2, edhe në rastet kur vdekja duket se ka ardhur si pasojë e përdorimit të forcës

nga persona që merren me zbatimin e ligjit. Ajo ka preferuar të përqendrohet në garancitë procedurale që ajo i ka vlerësuar si përbërëse të nenit 2.

14. Në një numër të madh çështjesh kundër Turqisë, Gjykata ka kritikuar vazhdimisht mungesën e kryerjes nga ana e shtetit të 'një hetimi të plotë dhe efektiv, të aftë që të çojë në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës si dhe të ofrimit të mundësisë së pjesëmarrjes efektive të të afërmeve të viktimës në procesin hetimor'. Në rastin në fjalë Gjykata vuri në dukje edhe dy elementë të tjerë – së pari informimin e të afërmeve se përse u vlerësua se përdorimi i forcës nuk përbënte vepër penale duke i dhënë atyre 'një vendim të argumentuar që të siguronte edhe një publik të interesuar që parimi i shtetit ligjor kishte qenë respektuar' dhe së dyti, që të siguronte që të afërmit dhe të interesuarit të kishin mundësi të informoheshin në lidhje me hetimin përfshirë këtu këqyrjen e dokumenteve dhe, kur ishte e nevojshme, ofrimin e ndihmës ligjore falas.



# NENI 3

## NDALIMI I TORTURËS

## IRLANDA kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 5310/71)

18 janar 1978

*çështje tepër e rëndësishme shtet kundër shtet e cila nxjerr në pah elementë thelbësorë të nenit 3 të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje lindi nga kriza tragjike dhe e vazhdueshme që përjetoi Irlanda e Veriut. Në muajin mars 1975, trazirat e viteve të fundit në Ulster kishin shkaktuar më shumë se 1 100 të vdekur dhe 11 500 të plagosur, si dhe shkatërrime pasurish që arrinin shumën mbi 140 milionë livra. Ato merrnin formën herë si prishje rendi, herë si akte terrorizmi, që do të thotë dhunë e organizuar për qëllime politike.

2. Më 9 gusht 1971, qeveria e Irlandës së Veriut përdor kompetencat e saj speciale që përfshijnë arrestimin, paraburgimin dhe internimin e disa personave pa gjykim. Këto kompetenca "jogjyqësore" vazhduan të ushtroheshin edhe pas 30 marsit 1972, datë në të cilën funksionet e qeverisë dhe të parlamentit të gjashtë konteve<sup>116</sup> iu akorduan autoriteteve të Mbretërisë së Bashkuar. Sipas një burimi zyrtar, ato kishin në shënjestër Ushtrinë Republikane Irlandeze (IRA), organizatë klandestine paramilitare; pas 5 shkurtit 1973, ato u përdorën edhe kundër personave të dyshuar si terroristë "besnikë". Legjislacioni që i akordoi këto kompetenca dhe niveli i përdorimit të tyre kanë evoluuar gjatë zhvillimit të çështjes. Të interesuarit i ishin nënshtruar një ose disa masave që merrnin formën e një arrestimi fillimisht për t'i marrë në pyetje, të një paraburgimi të zgjatur për një shqyrtim plotësues dhe të një paraburgimi parandalues për një kohë të papërcaktuar me ligj. E drejta penale qëndroi në fuqi gjatë zbatimit të kompetencave speciale.

3. Më 16 dhjetor 1971, qeveria Irlandeze iu drejtua Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut me një kërkesë duke pretenduar se Mbretëria e Bashkuar kishte shkelur nene të ndryshme të Konventës në Irlandën e Veriut, kryesisht nenet 3, 5, 6, 14 dhe 15. Ajo pohoi në thelb se shumë persona të privuar nga liria e tyre me anë të kompetencave speciale janë keqtrajtuar, se këto kompetenca nuk janë të pajtueshme me Konventën dhe mënyra e zbatimit të tyre është një diskriminim i bazuar mbi opinione politike. Pra, Gjykata thirrej për t'u shprehur mbi ekzistencën e praktikave dhe jo mbi rastet individuale.

116 Njësi administrative sipas organizimit lokal të disa vendeve të sistemit anglo-sakson.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Së pari, Vendimi shqyrton pretendimet e kërkuesve për keqtrajtime nga ana e autoriteteve. Për të përcaktuar faktet, Komisioni kishte ndjekur një procedurë të bërë nga ai vetë dhe të pranuar nga të dyja qeveritë. Ai kishte analizuar nga afër, mbi bazën e raporteve mjekësore dhe të dëshmimeve gojore, gjashtëmbëdhjetë raste “përfaqësues”, të zgjedhur nga qeveria Irlandeze. Ai kishte studiuar dyzetënjë raste të tjerë nën dritën e raporteve mjekësore dhe vëzhgimeve të shkruara; ai kishte përmendur rastet e mbetura. Lidhur me pretendimet e keqtrajtimit, mendimi i Komisionit (raporti i 25 janarit 1976) përmbante një konstatim të dyfishtë: përdorimi i kombinuar në vitin 1971, i “pesë teknikave” si ndihmëse të pyetësorit të katërmëdhjetë personave, përbënte një praktikë trajtimesh çnjerëzore dhe torture duke shkelur kështu nenin 3; dhjetë persona të tjerë kishin përjetuar trajtime çnjerëzore në kundërshtim me nenin 3, dhe në vitin 1971, pranë Belfastit, gjatë seancave të pyetjes kishte pasur trajtime çnjerëzore dhe tortura në shkelje të këtij neni.

5. Përpara Gjykatës, qeveria Britanike nuk e kundërshtoi opinionin e Komisionit mbi këto dy pika: gjithashtu ai merrte zotimin pa kusht se “të pesë teknikat” nuk do të përdroreshin më në asnjë rrethanë si ndihmëse në seancat e pyetjeve. Për më tepër, ajo mbështeste mendimin se një vendim i Gjykatës mbi këto çështje nuk do të sillte ndonjë dobi, duke pasur parasysh zotimin dhe masat e marra nga Mbretëria e Bashkuar. Gjykata pranoi zotimin e Mbretërisë së Bashkuar; por pavarësisht nga mungesa e kundërshtimit të disa shkeljeve të nenit 3, ajo njëzëri u shpreh se duhej marrë një vendim lidhur me to. Ajo analizoi situatën në qendra të ndryshme pyetjesh ose paraburgimi.

6. Rasti i parë: qendra ose qendrat e paidentifikuara. Në gusht dhe tetor 1971, katërmëdhjetë persona të paraburgosur në një ose disa qendra i nënshtrohen një lloji seance pyetjesh “të tepruar”. Kjo përfshin zbatimin e pesë teknikave që konsistojnë në qëndrimin pas murit për disa orë me radhë, vënien e një kapuçi të zi ose të errët në kokën e të dënuarve, nënshttrimin e vazhdueshëm ndaj zhurmave të forta dhe irrituese, privimin nga gjumi dhe privimin nga ushqimi dhe uji. Dëshmi të detajuara nga dy të paraburgosur treguan se këto teknika, të quajtura ndonjëherë teknika “çorientimi” ose “privimi shqisash”, zbatoheshin tek ata gjatë katër ose pesë ditësh me disa pushime ndërmjetëse, kohëzgjatja e të cilave nuk mundi të përcaktohej. Gjykata theksoi se këto teknika ishin përdorur të gjitha së bashku, me paramendim, gjatë disa orëve dhe i kanë shkaktuar personave në mos dëmtime konkrete, të paktën vuajtje të forta fizike dhe morale dhe kanë shkaktuar tronditje të rënda psikike gjatë seancave të pyetjeve. Për më tepër, ato ngjallnin tek viktimat ndjenjë frike, ankthi, inferioriteti deri në poshtërim dhe thyenin rezistencën e tyre fizike ose psikike. Nga njëra anë, Gjykata konkludoi se përdorimi i pesë teknikave analizohej si një trajtim çnjerëzor dhe degradues (*gjashtëmbëdhjetë vota kundër një*). Nga ana tjetër, ajo vlerësoi se zbatimi i teknikave nuk mund të cilësohej si torturë, sepse

këto teknika nuk kishin shkaktuar vuajtje të një intensiteti të tillë dhe egërsie të veçantë që përmban fjala torturë (*trembëdhjetë vota kundër katër*).

7. Rasti i dytë: Palace Barracks. Në vjeshtën e vitit 1971, anëtarët e Royal Ulster Constabulary<sup>117</sup> keqtrajtuuan shumë të paraburgosur në këtë kamp ushtarak (për shembull me shqelma dhe grushte), gjë që i shkaktoi atyre vuajtje të mëdha dhe dëme trupore ndonjëherë të konsiderueshme. Gjykata njëzëri konstatoi ekzistencën e një praktike trajtimesh çnjerëzore, por gjykoi se nuk bëhej fjalë për një praktikë torture sepse intensiteti i vuajtjeve të provokuara nga veprimet e denoncuara nuk e arrinte nivelin e veçantë që implikonte nocioni i torturës. Për më tepër, ajo nuk e mori parasysh si fakt atë që praktika në fjalë të ketë vazhduar përtej vjeshtës së vitit 1971.

8. Rasti i tretë: Vendet e tjera. Gjykata e cilësoi trajtimin e të paraburgosurve në kampin ushtarak të Ballykinler (qarku i Doën-it) në gushtin e vitit 1971, që përmbante kryerjen e detyruar të ushtrimeve të rënda, si praktikë poshtëruese dhe përcmuese; por ajo vendosi që kjo praktikë nuk ishte në kundërshtim me nenin 3 (*pesëmbëdhjetë vota kundër dy*).

9. Së fundi, Gjykata çmoi se nuk mund ta këshillonte Mbretërinë e Bashkuar ashtu si e kërkonte qeveria Irlandeze, për të angazhuar ndjekje penale ose disiplinore kundër atyre që kishin kryer, mbuluar ose toleruar shkeljet e nenit 3 të konstatuara nga Gjykata.

10. Pjesa e dytë e vendimit bën fjalë për privimet “jogjyqësore” të lirisë. Gjykata arriti në përfundimin e Komisionit, i cili nuk kundërshtoj nga qeveria Britanike, sipas së cilit kompetencat speciale të arrestimit, të paraburgimit dhe/ose të internimit, ashtu si ato ishin ushtruar, shkelin nenin 5 në disa pika. Ajo më pas shqyrtoi çështjen e nenit 15, në bazë të të cilit një shtet, kur e kërkon situata, mundet që në rast lufte ose rreziku tjetër publik që kërcënon jetën e kombit, të derogojë disa nga detyrimet e parashikuara nga Konventa në shkallën më të vogël. Ajo pohoi se një rrezik i tillë ekzistonte me të vërtetë në Irlandën e Veriut në kohën e ngjarjes. Megjithatë, qeveria Irlandeze mbështeste idenë se derogimet e nenit 5 e tejkalonin “shkallën më të vogël”. Duke pasur parasysh hapësirën e vlerësimit që i është lënë shteteve palë nga neni 15, Gjykata vendosi se ky pretendim nuk gjente vend (*gjashtëmbëdhjetë vota kundër një*).

11. Qeveria irlandeze denonconte një shkelje të nenit 14 të kombinuar me nenin 5. Ajo pretendonte se një politikë ose një praktikë diskriminuese e bazuar mbi opinione politike rezultonte nga fakti se përpara shkurtit të vitit 1973 kompetencat speciale kanë shërbyer vetëm kundër personave të dyshuar si terroristë në radhët e IRA-s ose që kishin informacione në lidhje me të. Më pas ato u përdorën edhe kundra terroristëve të quajtur “luajalistë” por në një

117 Policia Mbretërore e Ulsterit.

masë shumë më të vogël. Gjykata konstatoi se para 30 marsit 1972, shumica e akteve të terrorizmit vinte nga IRA, e cila falë një organizimi më të konsoliduar, përbënte një kërcënim më të madh se ai i terroristëve “besnikë”. Në përgjithësi ishte më e lehtë të ndiqje përpara gjykatës këta të fundit se sa homologët e tyre “republikanë”, të cilët i thërrisnin shpesh përpara gjykatave. Pas marsit të vitit 1972 terrorizmi “besnik” njohu një rritje spektakolare. Megjithatë, Gjykata vlerësoi si pak realiste ndarjen në faza të përcaktuara të një situatë që përjetonte një evolucion konstant. Ajo pranoi se autoritetet kishin hezituuar lidhur me sjelljen që duhet të mbanin, se kishin kërkuar kuturu dhe kishin pasur nevojë për një afat të caktuar për t’iu adoptuar kërkesave të vazhdueshme të krizës. Si rrjedhim, ajo nuk mund të pohonte se ushtrimi i kompetencave speciale, para shkurtit 1973, vetëm kundër IRA-s përbënte një diskriminim: qëllimi i ndjekur deri në këtë datë për të eliminuar së pari organizatën më të dyshuar mund të merrej si legjitim dhe mjetet e përdorura nuk duken si joproporcionale. Gjykata tregoi në veçanti, që duke filluar nga shkurti i vitit 1973, privimet “jogjyqësore” të lirisë shërbyen për të luftuar terrorizmin si të tillë dhe jo vetëm një organizatë të caktuar; ato nuk qenë po aq të përdorura kundër terroristëve “besnikë” sa kundër IRA-s, por kjo e fundit vazhdonte të kryente akte terroriste. Duke marrë parasysh bashkësinë e masave të marra kundër dy kategorive të terroristëve, Gjykata konstatoi se dallimi fillestar i trajtimit nuk vazhdoi më që në shkurt të vitit 1973. Si përfundim, ajo vendosi se nuk është provuar asnjë diskriminim në kundërshtim me nenet 14 dhe 5 (*pesëmbëdhjetë vota kundër dy*).

12. Vendimi përmban një pjesë të tretë të shkurtër mbi nenin 6. Duke e marrë këtë të fundit si të zbatueshëm - nuk e vlerëson të nevojshëm shqyrtimin e çështjes - derogimet ndaj garancive rridhnin me siguri nga derogimet ndaj garancive të nenit 5 dhe janë si ato, të pajtueshme me nenin 15. Për më tepër, Gjykata nuk dalloi ndonjë diskriminim në kundërshtim me nenet 14 dhe 6 të marrë së bashku.

13. Qeveria Irlandeze pasi shprehu se ajo nuk kërkonte dëmshpërblimet dhe interesat e tyre në favorin e të dëmtuarve nga shkeljet e Konventës, Gjykata arriti në përfundimin se neni 50 (aktualisht neni 41) nuk gjente zbatim në këtë çështje.

### III. Koment

14. Një nga momentet për të cilat ky vendim mbahet mend dhe përmendet në kuadrin e jurisprudencës së Gjykatës është renditja e pesë teknikave të trajtimit të cilat ai i konsideroi si trajtime çnjerëzore dhe degraduese. Sipas Komisionit dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilët mbështetën pretendimin e Irlandës në lidhje me këtë moment, pesë teknikat e ndaluara sipas nenit 3 të Konventës në rastin konkret ishin:

- a) qëndrimi pas murit: detyrimi i të burgosurve që të qëndronin disa orë me radhë një pozicion stresues me fytyrë nga muri dhe me duart e mbështetura pas tij dhe duke qëndruar më majë të gishtave të këmbëve;

- b) vënia e një kapuçi të zi ose të errët në kokën e të dënuarve duke i lënë në këtë gjendje gjatë gjithë kohës përveç periudhës së marrjes në pyetje
- c) nënshtrimi i vazhdueshëm të burgosurve në dhomat e tyre ndaj zhurmave të forta dhe irrituese;
- d) privimi i të burgosurve nga gjumi;
- e) privimi i të burgosurve nga ushqimi dhe uji.

15. Në gjirin e Gjykatës pati qëndrime haptazi të ndryshme të disa prej gjyqtarëve, sidomos në lidhje me faktin nëse një akt përfshihet në një tërësi apo tjetër kategori të ndaluar nga neni 3, pra nëse përbën torturë, dënim apo trajtim çnjerëzor, ose dënim ose trajtim poshtëruës<sup>118</sup>. Pavarësisht se Gjykata ishte përpjekur ndërkaq t'i sqaronte këto koncepte në një vendim të mëparshëm të saj<sup>119</sup>, duket se kur arrijmë te zbatimi në praktikë i formulimeve konkrete situata nuk është aq e qartë.

16. Vendimi paraqet rëndësi edhe për dy arsye të tjera. Së pari, ai qartëson se neni 3 i Konventës nuk mund t'i nënshtrohet asnjë përjashtimi apo kufizimi dhe ndaj tij nuk mund të bëhet asnjë derogim në bazë të nenit 15 të Konventës. Së dyti, vendimi sqaron një moment me shumë rëndësi edhe për situatën aktuale – luftën kundër terrorizmit. Pikërisht faktin që qëndrimi ose sjellja e personit nuk e lejon shtetin që ndaj tij të ushtrojë akte të ndaluara nga ana e nenit 3, pavarësisht se personi mund të jetë kriminel i rrezikshëm ose terrorist. Vendimi i 16 dhjetorit 2004, i Dhomës së Lordëve në Britani, mbi papajtueshmërinë e ligjit anti-terrorizëm me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe me *Human Rights Act* të vitit 1998 vërteton se vlera këtij vendimi është më se aktuale.

## TOMASI kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 12850/87)

**27 gusht 1992**

*trajtimi gjatë ndalimit, kohëzgjatja e ndalimit të përkohshëm dhe kohëzgjatja e procedurës ankimore përbëjnë shkelje përkatësisht të neneve 3, 5 § 3 dhe 6 § 1 të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi është shtetas francez që quhet Felix Tomasi dhe ishte ndaluar nga policia më 23 mars 1983 në Bastia (Korsikë). Ai dyshohej si pjesëtar i një vrasje dhe për një tentative vrasje të kryer më 11 shkurt 1982 nga ish-FLNC (Fronti i Çlirimit Kombëtar të Korsikës). Ai u mbajt në gjendje arresti deri më 25 mars

118 Shumë interesante janë mendimet paralele ose në pakicë të gjyqtarëve Fitzmaurice, O'Donoghue, Evrigenis, Matscher, dhe Zekia.

119 E ashtuquajtura çështja greke e vitit 1969.



1983, datë në të cilën ai u gjykua dhe u dënua me burg. Më 22 tetor 1988 z. Tomasi u lirua nga gjykata penale e mbledhur posaçërisht në Zhironde. Më 8 nëntor 1991, Komisioni i dëmshpërblimit pranë Gjykatës së Kasacionit i akordoi atij 300 000 Franga Franceze.

2. Gjatë arrestit, z. Tomasi hartoi 23 kërkesa për lirim, të cilat ishin refuzuar. Ai ishte ankuar tek gjykatësi i hetimeve paraprake, i cili e kishte marrë në pyetje në fund të arrestit, se X ka ushtruar dhunë mbi të dhe për këtë ai kërkonte dëmshpërblim. Mjekët gjatë vizitave kishin konstatuar se ai kishte plagë në trup. z. Tomasi ishte pyetur së fundi nga gjyqtari i hetimeve paraprake më 24 qershor dhe 1 korrik 1983. Më 20 mars 1985, Gjykata e Kasacionit anuloi të gjitha aktet hetimore për arsye se, sipas saj, ata ishin bërë nga një gjyqtar jokompetent. Ajo emëroi një gjyqtar tjetër në Bordo, i cili e liroi kërkuuesin më 23 qershor 1987. Me kërkesë të z. Tomasi, prokurori i Gjykatës së Apelit të Bordosë kërkoi më 3 nëntor 1987 një hetim tjetër, por edhe ajo konfirmoi lirimin e të pandehurit më 12 korrik 1989.

3. Në kërkesën e 10 marsit 1987 bërë Komisionit, z. Tomasi i referohej neneve 3, 6 § 1, dhe 5 § 3 të Konventës. Ai pretendonte se gjatë arrestit kishte vuajtur trajtime çnjerëzore. Ai denonconte gjithashtu kohëzgjatjen e procedurës në lidhje me trajtimin e tij. Së fundi ai pretendonte se arresti kishte tejkaluar afatin e arsyeshëm.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake

4. Gjykata vlerësoi se ishte kompetente për të gjykuar dy prapësimet paraprake të qeverisë edhe pse Komisioni mbështeste të kundërtën përsa i përket të parës prej tyre. Qeveria i kundërvihet kërkuetit për faktin se ai duhej t'i ishte drejtuar më parë Komisionit të dëmshpërblimit se sa Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut. Gjykata e hodhi poshtë me unanimitet këtë pretendim. Së pari, e drejta për lirim dallon nga ajo për dëmshpërblimin për heqjen e parregullt të lirisë. Së dyti, neni 149 i Kodit të Procedurës Penale ia nënshtronte dhënien e dëmshpërblimit disa kushteve të cilat nuk gjendeshin në nenin 5 § 3 të Konventës. Së treti, Z. Tomasi e ndërmori padinë në Strasburg katër vjet pas arrestimit. Sipas Qeverisë, kërkueti kishte humbur cilësinë e viktimës sikurse e parashikon neni 149 i Kodit të Procedurës Penale, meqenëse Komisioni i dëmshpërblimit kishte njohur dhe ndrequr çështjen e tejkalimit të afatit të arsyeshëm. Gjykata vlerësoi njëzëri se ky argument nuk ishte i vonuar, por ishte i pabazuar, sepse ai përplasat me të njëjtat kundërshtime si ato të mos shfrytëzimit të Komisionit të dëmshpërblimit.

### B. Në lidhje me nenin 3

5. Duke u bazuar në nenin 3, z. Tomasi pretendonte se kishte pësuar dhunë gjatë ndalimit. Sipas pikëpamjes së qeverisë, z. Tomasi mund të kishte fituar dëmshpërblim nga gjykatat civile në emër të përgjegjësisë së shtetit për gabimet e kryera nga agjentët gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Ky argument i

moshfrutëzimit të rrugëve të brendshme të rivënies në vend të të drejtës, i pa prezantuar përpara Komisionit, nuk u pranua nga Gjykata. Ajo vlerësoi bazën e ankesës duke kërkuar fillimisht ekzistencën e një lidhjeje ndërmjet trajtimeve të denoncuara dhe plagëve të konstatuara. Qeveria pranonte se nuk mund të jepte asnjë shpjegim mbi shkakun e plagosjeve, por pohonte se ato nuk rridhnin nga trajtimet e denoncuara nga z. Tomasi. Duke u mbështetur në disa elemente Gjykata e kundërshtoi këtë qëndrim. Së pari, askush nuk mund të pretendonte se gjurmët në trupin e kërkuesit i përkisnin një periudhe kohore përpara arrestit, se rridhnin nga ndonjë veprim që i interesuari kishte kryer ndaj vetes, ose nga një tentativë arratisje. Për më tepër kërkuesi kishte njoftuar gjykatësin hetimor që në paraqitjen e parë për shenjat mbi trupin e tij. Katër mjekë të ndryshëm e vizituan të akuzuarin ditët që pasuan arrestimin. Certifikatat e tyre dëshmonin për analizat e sakta, të cilat përputheshin me njëra tjetrën dhe tregonin datat se kur kishin ndodhur plagosjet, të cilat përputheshin me ato të qëndrimit në rajonin e policisë.

6. Mbetej të analizohej ashpërsia e trajtimeve të denoncuara. Gjykata nuk mendoi se duhej analizuar sistemi dhe kushtet e ndalimit në Francë dhe as afati dhe frekuenca e seancave të pyetjeve që iu bënë kërkuesit. Asaj i mjaftoi të vlerësonte se certifikatat dhe raportet mjekësore të bëra në mënyrë të pavarur nga mjekët, dëshmonin intensitetin dhe shumën e rrahjeve të z. Tomasi. Pra ka elemente mjaft serioze për t'i quajtur çnjerëzore. Nevojat e hetimit dhe vështirësitë e pamohueshme të luftës kundër krimit, sidomos në fushën e terrorizmit, nuk mund të kufizonin mbrojtjen e duhur të integritetit fizik të personit. Për këtë arsye ajo arriti njëzëri në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 3.

### *C. Në lidhje me nenin 5 § 3*

7. Ankesa e bazuar mbi nenin 5 § 3 të Konventës lidhej me kohëzgjatjen e arrestit. Koha për të cilën flitej kishte zgjatur pesë vjet dhe shtatë muaj. Për të hedhur poshtë kërkesat z. Tomasi për t'u proceduar në gjendje të lirë, juridiksionet hetimore kishin dhënë, veç e veç nga njëra tjetra ose së bashku, katër arsye kryesore:

- Së pari serioziteti i fakteve. Ekzistenca e treguesve të qartë për fajësi përbënte padyshim një element me rëndësi. Megjithatë Gjykata vlerësoi se ata nuk legjitimonin një arrest kaq të gjatë.

- Së dyti, ruajtja e rregullit publik. Gjyqtarët e hetimeve dhe prokuroria analizuan në mënyrë abstrakte nevojën e heqjes së lirisë, duke u kufizuar me insistim në rëndësinë e veprave penale ose në përcaktimin e efekteve të tyre. Megjithatë, atentati në fjalë përbënte një akt të paramenduar terrorizmi. Pra logjikisht, prishja e rregullit publik që mund të kishte ekzistuar në fillim normalisht është zhdukur pas një kohe të caktuar.

- Së treti, rreziku i presionit mbi dëshmitarët dhe i bashkëpunimit midis të bashkë-akuzuarve. Gjykata pranoi se një rrezik i vërtetë presioni mbi dëshmitarët kishte ekzistuar që në fillim dhe se ishte zvogëluar pak nga pak por megjithatë, pa u fashitur plotësisht.

- Së fundi rreziku i ikjes. Vendimet e organeve hetimore nuk nxorën ndonjë motiv, që të mund të shpjegonte sepse ato e kishin gjykuar përcaktues rrezikun

e ikjes, dhe se nuk kërkuan aspak që të gjenin një mjet për ta penguar, për shembull, me anë të pagimit të një garancie ose vënies nën kontroll gjyqësor.

8. Si përfundim Gjykata arriti në përfundimin se disa nga argumentet që hidhnin poshtë kërkesat e z. Tomasi kishin qenë të drejta dhe të mjaftueshme, por ato i humbën këto karakteristika me kalimin e kohës. Nga dosja rridhte se, juridiksionet kompetente nuk vepruan në këtë rast me gatishmërinë e duhur. Prokurori i Përgjithshëm pranë gjykatës së Kasacionit e pranoi këtë përpara Komisionit të dëmshpërblimit. Gjithashtu, kohëzgjatja e arrestit për krimin nuk rridhte as nga kompleksiteti i çështjes, as nga sjellja e të pandehurit. Për këto arsye Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 5 § 3.

#### ***D. Në lidhje me nenin 6 § 1***

9. Përsa i përket nenit 6 § 1, z. Tomasi denonconte afatin e shqyrtimit të padisë së tij kundër X për goditjet që kishte pësuar, padi në të cilën ai dilte edhe si palë civile. Qeveria mbështeti argumentin se kërkuesi nuk kishte shfrytëzuar rrugët e brendshme gjyqësore, duke mos ngritur kundër shtetit padi për dëmshpërblim në bazë të nenit 781 të Kodit të Organizimit Gjyqësor. Gjykata e gjykoi këtë argument si të vonuar pasi qeveria e kishte paraqitur për herë të parë në seancën përpara saj dhe jo në fazën e pranueshmërisë.

10. Përsa i përkiste themelit të ankesës, qeveria pretendonte se dalja si palë civile në një proces penal lidhej me ekzistencën e një vepre penale dhe jo të një të drejte në kuptimin e nenit 6 § 1. Për këtë arsye, ajo pretendonte se kjo dispozitë nuk gjen zbatim në një rast të tillë. Gjykata gjithsesi nuk mund të pranonte këtë interpretim. E drejta e dëmshpërblimit të z. Tomasi varej nga dënimi i autorëve të goditjeve. Megjithëse ishin kompetente juridiksionet penale, kjo e drejtë kishte edhe një karakter civil. Pra neni 6 § 1 sipas saj gjente zbatim.

11. Në vijim Gjykata analizoi nëse kjo dispozitë ishte respektuar. Periudha për të cilën bëhej fjalë fillonte me ankesën dhe mbaronte me shpalljen e vendimit të Gjykatës së Kasacionit. Ajo kishte zgatur më shumë se pesë vjet e dhjetë muaj. Nga leximi i vendimeve të dhëna dilte se çështja nuk paraqiste ndonjë kompleksitet të veçantë. Për më tepër z. Tomasi nuk e kishte vonuar procedurën duke e kundërshtuar vendimin e prokurorit të Bordosë. Në këto kushte përgjegjësia e vonesave peshonte mbi autoritetet e drejtësisë dhe në veçanti mbi prokurorin e Republikës në Bastia dhe gjyqtarin hetimor në Bordo. Gjykata arriti njëzëri në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1.

#### ***E. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)***

12. Në bazë të nenit 50, kërkuesi kërkonte 2 600 000 franga franceze shpërblim. Gjykata gjykoi se kërkuesi kishte pësuar dëm moral dhe dëm material të pamohueshëm. Duke llogaritur të gjitha aspektet e çështjes, si edhe vendimin e Komisionit të Dëmshpërblimit, ajo i akordoi njëzëri 700 000 franga franceze. z. Tomasi kërkonte 513 700 franga franceze për shpenzimet e bëra përpara

juridiksioneve franceze dhe organeve të Konventës. Duke gjykuar *ex aequo e bono*, Gjykata njëzëri i akordoi edhe 300 000 franga franceze.

### III. Koment

13. Në këtë vendim, ku Gjykata e dënoi Francën për disa shkelje të Konventës, ajo theksoi në mënyrë të veçantë se ushtrimi i dhunës ndaj personave që mbahen nën kontrollin e autoriteteve shtetërore, edhe kur kjo dhunë nuk ka lënë pasoja serioze afatgjata, konsiderohet trajtim çnjerëzor. Në fakt gjyqtari De Meyer shkoi edhe më tej në mendimin e tij paralel me atë të shumicës, duke u shprehur se: *“çdo ushtrim i forcës fizike ndaj një personi të ndaluar e cila nuk është absolutisht e nevojshme si pasojë e sjelljes së vetë atij (si për shembull në rastin e një tentative për tu arratisur ose një akti të kryer kundër vetvetes) shkel dinjitetin njerëzor dhe duhet vlerësuar si shkelje e të drejtave të garantuara në bazë të nenit 3 të Konventës”*.

14. Është tepër interesant fakti që ky qëndrim i gjyqtarit De Meyer i shprehur në këtë çështje u përfshi në vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen *Ribitch kundër Austrisë*<sup>120</sup>, duke e shndërruar atë në një parim të interpretimit të nenit 3 të Konventës.

15. Në çështjen që po komentojmë kërkuesi pati vështirësi të konsiderueshme që të provonte faktet për të cilat ai ankohej në lidhje me keqtrajtimet. Ky element përbën në fakt një nga më problematikët në lidhje me nenin 3 të Konventës – vërtetimi i ushtrimit të dhunës psikologjike por edhe fizike nga ana e autoriteteve. Me këtë problem Gjykata është marrë në një numër rastesh në lidhje me nenin 3 dhe shpeshherë nuk ka arritur të vërtetojë shkelje të nenit 3 pikërisht sepse nuk arrihej të provohej me një siguri të mjaftueshme që dëmtimet eventuale ishin shkaktuar gjatë periudhës së ndalimit ose arrestimit<sup>121</sup>.

## SVINARENKO DHE SLYADNEV kundër RUSISË

(kërkesat nr. 32541/08 dhe 43441/08)

17 korrik 2014

Dhomë e Madhe

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit janë dy shtetas rusë që kanë lindur respektivisht më 1968 dhe 1970. Kërkuesi i parë, z. Svinarenko, në kohën e vendimit të Gjykatës ishte duke vuajtur dënimin me burg në rajonin Murmansk, kurse kërkuesi i dytë, z. Slyadnev, jetonte në Sinegorye në disktriktin e Yagodninskiy të rajonit Magadan.

120 Vendim i 4 dhjetorit 1995, shih në paragrafin 38 të vendimit.

121 Shih *Klaas kundër Gjermanisë*, përfshirë në këtë botim, *infra*.

2. Më 24 shtator 2002, Departamenti i Hetimeve i Distriktit Federal të Lindjes së Largët në Ministrinë e Brendshme mori në pyetje kërkuesin e parë, si një nga të dyshuarit në një hetim për disa vepra penale. Më 9 tetor 2002 ai u arrestua. Më 12 nëntor 2002 Gjykata e Qytetit Magadan urdhëroi paraburgimin e tij, në pritje të gjyqimit. Sipas pretendës përfundimtare, kërkuesi i parë akuzohej për grabitje me dhunë kundër z. A.S. dhe znj. T.S. në shtator 2002, si anëtar i një bande, dhe për blerje, ruajtje, transportim dhe posedim të paligjshëm të municioneve.

3. Më 20 janar 2003 kërkuesi i dytë, i cili po shlyente një dënim me burg për vrasje nga pakujdesia u mor në pyetje si një nga të dyshuarit në procesin e larpërmendur. Më 22 janar 2003 ai u akuzua për krijim bande të armatosur dhe pjesëmarrje në sulme mbi qytetarët, nga tetori 2001 deri në shtator 2002, për grabitje me armë dhe ushtrim dhune me rrezik për jetën ndaj z. V.B. në tetor të 2001, drejtor i një kompanie private rafinimi ari, si dhe kërcënimi për të përdorur dhunë me qëllim përvetësimin e pronës në vlerë të konsiderueshme të një personi tjetër për mbajtje dhe transportim të paligjshëm të metaleve të çmuara, për disa grabitje dhe për blerje, ruajtje, transportim dhe mbajtje të paligjshme të armëve të zjarrit.

4. Që nga shtatori 2003 deri në korrik 2009 ndaj kërkuesve u zhvilluan tre procese gjyqësore, për shkak se vendimet e Gjykatës Rajonale të Magadanit prisheshin dhe ktheheshin nga Gjykata e Lartë. Në procesin e tretë, që u mbyll në korrik 2009, Gjykata Rajonale e Magadanit e shpalli kërkuesin e parë të pafajshëm dhe dënoi kërkuesin e dytë me katër vjet e pesë muaj burgim për një sërë veprash penale, por vendosi se ai e kishte shlyer dënimin e tij gjatë periudhës që mbahej në paraburgim nga 24 prilli 2003 deri më 22 qershor 2004 dhe nga 6 dhjetori 2005 deri më 12 mars 2009, pra për një periudhë prej katër vjetësh, pesë muajsh dhe gjashtë ditësh në total. Ajo hodhi poshtë akuzat e mbetura.

5. Gjatë proceseve gjyqësore në ngarkim të tyre ata shoqëroheshin për në Gjykatën Rajonale të Magadan nga forcat e policisë. Gjatë seancave gjyqësore ata qëndronin të ulur në një stol të vendosur në një hapësirë të mbyllur nga të katër anët me shufra metalike me diametër 10 milimetra. Ky kafaz metalik ishte 255 centimetra i gjatë, 150 centimetra i gjerë dhe 225 centimetra i lartë, me një tavan me rrjetë çeliku dhe një derë me shufra metalike. Distanca ndërmjet shufrave metalike ishte 19 centimetra. Policë të armatosur qëndronin pranë bankës së të akuzuarve. Gjithmonë kishte dy oficerë policie për çdo të paraburgosur në këto procese, pra tetë në total gjatë gjyqit të parë dhe të dytë, dhe në gjyqin e tretë ishin gjashtë policë për kërkuesit dhe për një të bashkëakuzuar tjetër.

6. Pasi vendimi i pafajësisë të kërkuesit të parë mori formë të prerë, ai filloi procedurat kundër Shtetit për dëmet e pësuar si rezultat i procesit penal kundër tij. Atij iu akorduan 18,569 RUB për shkak të dëmit material të pësuar nga papunësia si pasojë e mbajtjes së tij në burg dhe 50,000 RUB në lidhje me dëmin jo material që kishte pësuar si pasojë e ndjekjes penale, mbajtjes në paraburgim dhe detyrimit për të mos u larguar nga vendbanimi i tij.



7. Përpara Gjykatës kërkuesit u ankuan për mbajtjen e tyre në një kafaz metalik në sallën e gjyqit gjatë proceseve në ngarkim të tyre. Ata pretenduan se një masë e tillë përbënte trajtim poshtëruës, të ndaluar me nenin 3 të Konventës. Kërkuesit theksuan kjo ishte një praktikë e përgjithshme që zbatohet pavarësisht rrethanave individuale, natyrës së veprave penale, qoftë krime ekonomike, vrasje, vjedhje apo shkelje të lehta, pavarësisht nëse procesi zhvillohet para gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe pa marrë parasysh nëse një person kishte apo jo një të kaluar kriminale. Ata pretenduan gjithashtu se proceset penale ndaj tyre ishin zgjatur përtej një afati të arsyeshëm.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

8. Gjykata ka deklaruar në mënyrë të përsëritur, se neni 3 i Konventës përbën një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Ajo ndalon në terma absolute torturën ose dënimet apo trajtimet çnjerëzore e poshtëruese, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës. Por që neni 3 të gjejë zbatim duhet që keqtrajtimi të arrijë një nivel minimal ashpërsie dhe vlerësimi i këtij minimumi është relativ; ai varet nga të gjitha rrethanat e rastit, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mendore dhe, në disa raste, nga seksi, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Në mënyrë që trajtimi të jetë "poshtëruës", vuajtja apo poshtërimi duhet të arrijnë një intensitet që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjeve apo poshtërimit normal të lidhura me një formë të caktuar të trajtimit të ligjshëm, dhe këtu përfshihet edhe burgimi. Trajtimi është konsideruar të jetë "poshtëruës" brenda kuptimit të nenit, kur ai ka për qëllim të poshtërojë ose përulë një person, duke treguar një mungesë të respektit dhe fyerje për dinjitetin e tij, dhe konsiderohet se shkakton tek viktimja ndjenja frike, ankthi apo inferioritetit që çojnë në thyerjen e rezistencës së tij morale dhe fizike. Por Gjykata kujtoi se, edhe në rast të mungesës së një qëllimi të tillë nuk mund të përjashtohet përfundimisht shkelja e nenit 3. Ajo vuri në dukje veçanërisht se natyra publike e trajtimit mund të jetë një faktor relevant ose rëndues në vlerësimin nëse trajtimi është "poshtëruës" brenda kuptimit të nenit 3.

9. Përsa i përket masave të shtrëngimit të tilla si prangosja, këto në pjesën më të madhe të rasteve nuk ngrenë ndonjë çështje sipas nenit 3 të Konventës, kur janë përdorur në rastet e ndalimeve të ligjshme dhe nuk kanë sjellë përdorimin e forcës apo ekspozimit publik përtej asaj çfarë konsiderohet në mënyrë të arsyeshme e domosdoshme në rrethanat përkatëse të çështjes. Në këtë drejtim, ka rëndësi për shembull, nëse ka arsye për të besuar se personi në fjalë do t'i rezistonte arrestimit ose do të përpiqej të arratiset, të plagoste, apo të dëmtonte apo manipulonte apo ndikonte në prova. Në veçanti në lidhje me vendosjen e të akuzuarve brenda kafazëve metalikë në sallën e gjyqit Gjykata e ka konsideruar trajtimin në fjalë si "të ashpër" dhe "poshtëruës". Ajo ka pranuar që një trajtim i tillë mund të justifikohet për arsye sigurie në raste të veçanta për shkak të personalitetit të kërkuesit, të natyrës së veprave penale për të cilat akuzohet, rekordit të tij penal, sjelljes së



tij ose të dëshmimeve të tjera të rrezikut të sigurisë në sallën e gjyqit dhe rrezikut të arratisje së kërkuesit. Gjithashtu prania e publikut dhe mbulimi mediatik i procesit janë elementë që Gjykata mban parasysh në analizën e vet në raste të tilla.

10. Gjithsesi në fund vendimtar është fakti nëse autoritetet nuk kanë cenuar dinjtetin e personit në mënyrë të paarsyeshme. Ka qenë pajustificueshmëria ose përdorimi i "tepruar" i një mase të tillë shtrëngimi që e kanë bërë Gjykatën të vendosë se vendosja e të akuzuarve në një kafaz metalik në sallën e gjyqit përbënte trajtim poshtërues, megjithëse ka pasur edhe raste kur kjo masë justifikohet, dhe se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3<sup>122</sup>.

11. Gjykata kujtoi se vendosja e të pandehurve që janë në paraburgim në kafaze metalike kur ata nxirren para një gjykate në një proces penal ka qenë praktikë standarde në disa prej Shteteve Kontraktuese, të cila më parë kishin qenë pjesë e Bashkimit Sovjetik. Megjithatë ajo konstatoi se ajo tashmë është një praktikë e braktisur gjerësisht. Ajo pranoi se nuk është detyrë e saj të vendosë arkitekturën e sallave gjyqësore apo për masat e sigurisë fizike në raste të veçanta dhe se rendi dhe siguria në sallën e gjyqit janë me rëndësi të madhe dhe mund të shihen si të domosdoshme për administrimin e duhur të drejtësisë. Megjithatë ajo theksoi se autoritetet, për të garantuar rendin dhe sigurinë në sallat e gjyqit, nuk mund të përdorin masa që për nga niveli i ashpërsisë janë në kundërshtim me nenin 3.

12. Në rastin konkret Gjykata analizoi së pari nëse niveli minimal i ashpërsisë është arritur në rastin e trajtimit të dy kërkuesve. Gjykata vuri re se kërkuesit ishin gjykuar nga një juri me dymbëdhjetë anëtarë. Seancat në procesin kundër tyre kishin qenë publike dhe në to kishin marrë pjesë shumë dëshmitarë dhe shumë persona të tjerë kishin qenë të pranishëm. Seancat gjyqësore kishin qenë të shpeshta dhe të tejzgjatura dhe kishin vazhduar për më shumë se një vit. Në këto kushte ajo vlerësoi se, ekspozimi i kërkuesve në sytë e publikut në një kafaz prej hekuri duhet të ketë dëmtuar imazhin e tyre dhe duhet të ketë ngjallur tek ta ndjenjën e poshtërimit, pafuqisë, frikës, ankthit dhe inferioritetit. Për më tepër një paraqitje e tillë në sallën e gjyqit ku vendosej mbi përgjegjësinë e tyre penale, sipas Gjykatës, ngrinte çështje të prezumimit të pafajësisë, sidomos duke pasur parasysh rëndësinë që ka paraqitja tek publiku e mirëadministrimit të sistemit të drejtësisë dhe e besimit tek gjyqësori. Për më tepër një izolim i tillë në sallën e gjyqit mund të nxjerrë në pah probleme të tjera në lidhje me të drejtat e mbrojtjes, të tilla si e drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proces dhe për të marrë ndihmë ligjore praktike dhe efektive. Në këto kushte Gjykata konstatoi se, vendosja e kërkuesve në një kafaz në sallën e gjyqit gjatë gjykimit të tyre në mënyrë të pashmangshme duhet ti ketë shkaktuar atyre ankth të një intensiteti që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes që normalisht ata përjetojnë në paraburgim dhe se trajtimi i kundërshtuar arrin nivelin minimal të ashpërsisë për trajtuar brenda fushëveprimit të nenit 3.

122 Shih Titarenko k. *Ukrainës*, nr. 31720/02, 20.09.2012.

13. Së dyti, Gjykata nuk gjeti as ndonjë arsye të veçantë në rastin e dy kërkuesve që ta bënin të mendonte se izolimi i tyre në kushtet e përshkruara ishte i nevojshëm për të penguar arrestimin e tyre ose mbrojtjen nga ndonjë sulm nga persona të tretë. Referencat në lidhje me kërkuesit, dhe sidomos të dytin, e në mënyrë të veçantë fakti që ndaj tyre dhe disa të bashkëakuzuarve ishin dënuar me kusht në procese të mëparshme dhe ishin shpallur të pafajshëm në pjesën dërrmuese të akuzave konkrete, nuk mbështesnin pretendimet e Qeverisë se ata kishin kryer krime të dhunshme.

14. Gjykata arriti në përfundimin se pavarësisht nga rrethanat e rastit konkret përdorimi i kafazit ashtu siç përshkruhet më sipër gjatë procesit gjyqësor nuk mund të justifikohet asnjëherë në bazë të nenit 3. Ajo ritheksoi se thelbi i vetë Konventës është respektimi i dinjitetit njerëzor dhe se objekti dhe qëllimi i Konventës, si instrument për mbrojtjen e qenieve njerëzore, kërkojnë që dispozitat e saj të interpretohen dhe zbatohen në mënyrë që t'i bëjnë masat e saj mbrojtëse praktike dhe efektive. Prandaj, ajo është e mendimit se mbajtja e një personi në një kafaz metalik gjatë zhvillimi të gjyqit të tij përbën në vetvete - duke pasur parasysh natyrën e saj objektivisht poshtëruese, e cila është e papajtueshme me standardet e sjelljes së qytetëruar që janë shenjë dalluese e një shoqërie demokratike - fyerje për dinjitetin e njeriut, në shkellje të nenit 3.

### **B. Në lidhje me nenin 6**

15. Gjykata konstatoi se proceset penale në ndarkim të kërkuesve kishin zgjatur përkatësisht 6 vjet e 10 muaj për kërkuesin e parë dhe 6 vjet e gjysmë për kërkuesin e dytë, në dy shkallë gjyqësore. Duke iu referuar vendimit të Dhomës ajo nuk gjeti arsye që të justifikonin një kohëzgjatje kaq të madhe në proceset ndaj kërkuesve. Prandaj ajo konfirmoi vendimin e Dhomës se kishte shkellje të nenit 6 § 1 për kohëzgjatje tej afatit të arsyeshëm.

### **III. Koment**

16. Vlera e padiskutueshme e këtij vendimi të Dhomës së Madhe konsiston pikërisht në lidhje me nenin 3 dhe me çështjen e trajtimit, të të arrestuarve, të të ndaluarve apo të të akuzuarve në momentin e arrestimit ose ndalimit, dhe sidomos në sallën e gjyqit gjatë procesit penal. Dhoma kishte vendosur shkellje të nenit 3 ashtu si edhe të nenit 6 § 1. Megjithatë rëndësia e problemit dhe debatet në mjediset institucionale<sup>123</sup>,

123 Rregullat Minimale Standarde për Trajtimin e të Burgosurve, të miratuara nga Kongresi i Parë i OKB-së mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Shkelësve në 1955 dhe aprovuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social me Rezolutat 663 C (XXIV) të 31.7.1957 dhe 2076 (LXII) të 13.05.1977, përfshijnë parimet e mëposhtme udhëzuese në lidhje me mjetet shtrënguese:

"33. Mjetet shtrënguese, të tilla si prangat, zinxhirët, hekurat dhe xhaketa e forcës, nuk duhet kurrë të përdoren si dënime. Për më tepër, zinxhirët apo pranga nuk përdoren si mjete ndaluese. Mjetet e tjera shtrënguese përdoren veçse në rrethanat vijuese:

(a) Si një masë parandaluese ndaj arratisjes së mundshme të një ndaluarit gjatë transferimit dhe i hiqen kur del përpara autoritetit gjyqësor ose administrativ;

..."

juridiksionale<sup>124</sup> dhe universitare ndërkombëtare dhe evropiane<sup>125</sup> kërkonin konfirmimin dhe përpunimin nga Dhoma e Madhe. Megjithëse Gjykata kishte pasur rast që të shprehej në lidhje me fenomenin e vendosjes së prangave ose të kafazëve prej hekuri në sallën e gjyqit, përhapja që ky fenomen kishte pasur sidomos në vendet e lindjes dhe vazhdonte të kishte sidomos në disa vende, përbënte një justifikim më shumë që Dhoma e Madhe të shprehej mbi fenomenin.

17. Dhoma e Madhe e shfrytëzoi këtë moment për të rikujtuar dhe konfirmuar parimet e vendosura nga Gjykata në vendimet e saj të mëparshme. Ajo kujtoi se neni 3 nuk e ndalon në vetvete vënien e prangave apo të masave të tjera të sigurisë gjatë arrestimit ose gjykimit. Megjithatë ajo theksoi se e ka konsideruar trajtimin në fjalë si "të ashpër" dhe "poshtërues"<sup>126</sup> dhe kjo është shumë më e vërtetë në rastin e kafazëve prej hekuri në sallën e gjyqit<sup>127</sup>. Ajo ka vlerësuar se një trajtim i tillë mund të justifikohet nëse ka arsye për të besuar se personi në fjalë do t'i rezistonte arrestimit ose do të përpiqej të arratisë, apo të dëmtonte apo zhdukte provat<sup>128</sup>. Ajo ka pranuar gjithashtu se trajtimi i tillë mund të pranohet për arsye të ruajtjes së sigurisë në rrethanat e një rasti të veçantë, të tilla si personaliteti i kërkuesit<sup>129</sup>, natyra e veprave penale për të cilat akuzohet, megjithëse sipas Gjykatës ky faktor i vetëm nuk mund të konsiderohet i mjaftueshëm<sup>130</sup>, historiku kriminal i të akuzuarit<sup>131</sup>, sjellja e tij ose dëshmi të tjera për rrezik ndaj sigurisë në sallën e gjyqit ose për arratisjen e të akuzuarit<sup>132</sup>. Ajo ka mbajtur veçanërisht në konsideratë edhe faktorë të tillë shtesë, si prania e publikut dhe mbulimi mediatik

124 Rregullat e Procedurës dhe Provave të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (neni 83 i Rregullores) dhe të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ruandën (neni 83 i Rregullores) parashikon se mjetet shtrënguese, të tilla si prangat, mund të përdoret vetëm si një masë parandaluese kundrejt arratisjes gjatë transferimit ose për arsye të tjera sigurie. Megjithatë sapo i akuzuarit del para gjykatës, këto mjete shtrënguese i hiqen. Komiteti i OKB-së të Drejtave të Njeriut, në çështjen *Mikhail Pustovoit k. Ukrainës*, u shpreh se vendosja e z. Pustovoit në një kafaz metalik gjatë procesit penal ndaj tij në publik, me duart e prangosura pas shpine, shkelte nenin 7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike për shkak të trajtimit poshtërues të cilit i ishte nënshtruar dhe nenin 14 (1) të tij, për shkak të trajtimit poshtërues i cili kishte ndikuar në drejtësinë e gjyqit ndaj tij. (komunikimi nr. 1405/2005, opinion i 20.3.2014.)

125 Shih gjithashtu Manualin e Gjykimi të Drejtë të *Amnesty International* i cili parashikon si më poshtë:

"15.3 Procedurat që cenojnë prezumimin e pafajësisë...

Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar faktit që asnjë shenjë faji të mos rëndojë mbi të akuzuarin gjatë gjykimit çka mund të ndikojë në prezumimin e tij të pafajësisë. Shenja të tilla mund të përfshijnë mbajtjen e të akuzuarit në një qeli brenda sallës së gjyqit..."

126 Shih *Ramishvili dhe Kokhreidze k. Gjeorgjisë*, nr. 1704/06, 27.01.2009, *Ashot Haroutyounian k. Armënie*, nr. 34334/04, § 118, 15.06.2010, *Piruzyan k. Armenisë*, nr. 33376/07, 26.06.2012.

127 Shih paragrafët 136, 137 dhe 139 të vendimit.

128 Shih *Raninen k. Finlandës*, 16.12.1997, Përmbledhje 1997-VIII; *Öcalan k. Turqisë* [GC], nr. 46221/99, ECHR 2005-IV; dhe *Gorodnitchev k. Rosisë*, nr. 52058/99, 24.05.2007 dhe *Miroslav Garlicki k. Polonisë*, nr. 36921/07, 14.06.2011.

129 Shih *Ramishvili dhe Kokhreidze k. Gjeorgjisë*, cituar më lart.

130 Shih *Piruzyan k. Armenisë*, cituar më lart.

131 Shih *Khodorkovskiy k. Rosisë*, no 5829/04, 31 mai 2011, dhe *Khodorkovskiy dhe Lebedev k. Rosisë*, nr. 11082/06 dhe 13772/05, 25 korrik 2013.

132 Shih *Ashot Harutyunyan*, cituar më lart.

i momenteve të arrestimit<sup>133</sup> ose të procesit penal në ngarkim të të akuzuarit<sup>134</sup>. Duke pasur parasysh të gjithë këta faktorë, Gjykata ka theksuar se Shtetet duhet të sigurojnë që, një person të mos arrestohet, ndalohet ose gjykohet në kushte të cilat cenojnë dinjitetin e tij njerëzor dhe mënyra e ekzekutimit të masës së arrestit ose e organizimit të procesit ndaj tij të mos ta vendosë atë në gjendje ankthi apo vuajtjesh fizike apo psikologjike të një intensiteti që tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjes normale dhe të nevojshme në rrethana të tilla<sup>135</sup>.

18. Në çështjen konkrete Gjykata vuri re se praktika e futjes të të akuzuarve në kafazë metalikë në sallat e gjyqit në Rusi ishte thuajse automatike, dhe të gjitha kriteret e përmendura në paragrafin e mësipërm zbatoheshin *a priori*. Pra një i akuzuar për një vepër penale në parim prezumohej që plotësonte këto kriteret dhe mbajtja e tij përtej kafazëve ishte e justifikuar. Për Gjykatën një interpretim i tillë i kufizimeve është i papranueshëm. Ajo vërejtë se Gjykata Rajonale e Magadan kurrë nuk e kishte vlerësuar nëse kufizimi fizik i kërkuesve ishte i nevojshëm gjatë seancave. Për më tepër nuk ishin dhënë arsye për mbajtjen e kërkuesve në kafaz. Këto arsye nuk paraqiteshin as në urdhrat e gjykatës për dhënien e masës së arrestit me burg, në kundërshtim me argumentin e Qeverisë se kërkuesit përbënin kërcënim për dëshmitarët dhe se kjo kishte qenë edhe arsyeja e vendosjes së tyre në paraburgim. Prandaj ajo pa asnjë mëdyshje dhe me unanimitet ajo gjen shkelje të nenit 3 të Konventës.

19. Megjithatë kjo mënyrë e arritjes në këtë përfundim bën që ky vendim është një nga situatat e rralla, për të mos thënë unike, kur në kuadrin e nenit 3, Gjykata bën një lloj analize nevoje apo proporcionaliteti e masës që bie nën fushën e veprimit të këtij neni<sup>136</sup>. Lexuesi mund të ketë të drejtë të jetë dakord me gjyqtarët Nicolau, Keller dhe Silvis të cilët në mendimet e tyre paralele ndalen në këtë aspekt. Është thënë në mënyrë të përsëritur që neni 3 garanton të drejta absolute dhe ndaj tyre nuk mund të bëhen as përjashtime dhe as derogime<sup>137</sup>. Megjithatë në këtë vendim shumica e Dhomës së Madhe bie në këtë kurth. Në paragrafin 127 të vendimit ajo vlerëson se niveli minimal i kërkuar nga neni 3 është arritur. Ky vlerësim mund dhe duhet normalisht të ishte përfundim i analizës së saj nën nenin 3. Por në paragrafin 135 ajo duket se analizon ekzistencën e arsyeve për ta justifikuar një trajtim të tillë. Gjithsesi rëndësi ka të kuptohet se përdorimi

133 Shih *sidomos Mirostaë Garlicki c. Pologne*, no 36921/07, 14.06.2011, ku megjithëse ky pretendim i kërkuesit u konsiderua i papranueshëm për mos-shërrim, Gjykata nuk e përjashtoi mundësinë që publiciteti i momentit të një arrestimi në kushte të tilla të përbëjë problem sipas nenit 3.

134 Shih *Khodorkovskiy, cituar më lart*, dhe *Sarban k. Moldavisë*, nr. 3456/05, 4.10.2005. Gjykata është shprehur gjithashtu që natyra publike e trajtimit mund të jetë një faktor relevant ose rëndës në vlerësimin nëse ai është "poshtërues" sipas kuptimit të nenit 3 (shih, për shembull, *Tyrer k. Mbretërisë së Bashkuar*, 25.4.1978, Seria A nr. 26, *Erdoğan Yağız k. Turqisë*, nr. 27473/02, 6.3.2007 dhe *Kummer k. Republikës Çeke*, nr. 32133/11, 25.7.2013).

135 Shih *Kudla k. Polonisë* [GC], nr. 30210/96, ECHR 2000-XI dhe *Pretty k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 2346/02, ECHR 2002-III.

136 Shih analizën me dy hapa të përmbledhur në paragrafët 12 dhe 13 më lart.

137 Shih ndër shumë vendime të tjera *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, 18.01.1978, série A no 25, *Saadi k. Italisë* [GC], no 37201/06, CEDH 2008, dhe *Gäfgen k. Gjermanisë* [GC], no 22978/05, CEDH 2010.

i kafazëve prej hekuri në sallën e gjyqit është i papranueshëm nën nenin 3 të Konventës. Gjithsesi nuk mund të arrihet në të njëjtin përfundim kaq kategorik në lidhje me vendosjen e prangave ose transportin e të akuzuarve apo të dënuarve të dhunshëm<sup>138</sup>.

20. Ky vendim të sjell ndër mend situata të ngjashme shqiptare kur proceset penale zhvillohen rëndom me mbylljen e të akuzuarve në kafazë hekuri. Lexuesit mund t'i kujtohen skenat e ish-Guvernatorit Fullani i cili mbyllej në kafazë hekuri i rrethuar me dy policë ndërkohë që vlerësohej masa e sigurisë ndaj tij. Rasti i tij të kujton gjithashtu skenat të bëra gjerësisht publike ku ai shoqërohej si një kriminel i dhunshëm për në gjykatë me pranga në duar. Sipas standardit Svinarenko ose Erdoğan Yağız, ish-Guvernatorit Fullani i janë shkelur të drejtat e garantuara nga neni 3.

## O'KEEFFE kundër IRLANDËS

(kërkesa nr. 35810/09)

28 janar 2014

Dhomë e Madhe

*strukturat e arsimit fillor në Irlandë në vitin 1970 nuk arritën të mbrojnë një vajzë nga abuzimi seksual prej mësuesit të saj*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, znj. Louise O'Keeffe, është një shtetase irlandeze, që ka lindur në vitin 1964 dhe banon në Cork, në Irlandë. Nga viti 1968 ajo ndoqi Shkollën Shtetërore të Dunderrow që ishte në pronësi të Peshkopit Katolik të Dioqezës së Cork dhe Ross i cili e administronte me anë të një bordi. Prifti O ishte *de facto* drejtori i shkollës. Shkolla njihej nga Ministria e Edukimit dhe e Shkencës. Njëri nga mësuesit laikë, L.H., i cili ishte i martuar, ishte edhe mësuesi kryesor i shkollës. Më 1971, nëna e një prej fëmijëve që ndiqnin shkollën ngriti akuza pranë drejtorit të shkollës se L.H. po abuzonte seksualisht me fëmijën e saj. Megjithatë drejtori i shkollës nuk i raportoi dhe nuk iu përgjigj këtyre akuzave. Kërkuesja, nga ana e saj kishte qenë subjekt i abuzimit të vazhdueshëm seksual nga L.H. gjatë mësimeve të muzikës në klasën e tij nga janari deri në mesin e vitit 1973. Nga fundi i vitit prindërit e kërkueses u vunë në dijeni për akuza të ngjashme në lidhje me L.H. nga prindërit e tjerë. L.H. dha dorëheqjen nga posti i tij, por asnjë veprim të mëtijshëm në lidhje me këto pretendime nuk u mor nga ndonjë autoritetet shtetëror. Në vitin 1974, L.H. rifilloi të jepte mësim në një tjetër shkollë shtetërore, ku ai qëndroi derisa doli në pension në vitin 1975.

138 Shih gjithashtu Erdoğan Yağız k. Turqisë, nr. 27473/02, 6.3.2007, të referuar më lart



2. Kërkuesja bëri një deklaratë në polici në janar të vitit 1997, si pjesë e një hetimi të policisë në lidhje me një ankesë të bërë kundër L.H. nga një ish-nxënës i Shkollës Shtetërore Dunderrow. Më pas, një numër nxënësish të tjerë bënë deklarata gjatë hetimit dhe si rezultat, L.H. u akuzua për 386 vepra penale për abuzim seksual. Pasi pranoi fajësinë ai u dënua me burgim dhe iu hoq e drejta për të dhënë mësim. Në vitin 1998, kërkuesja aplikoi në Tribunalin për Shpërblimin e Viktimave të Veprave Penale dhe asaj iu akorduan rreth 54,000 euro. Më pas, kërkuesja bëri një padi civile kundër L.H. dhe shtetit irlandez, duke pretenduar dëmshpërblim për dëmet personale të pësuar si rezultat i sulmeve ndaj saj, sidomos të abuzimit seksual nga ana e L.H. Ky i fundit nuk ngriti asnjë pretendim për tu mbrojtur kundër kësaj padie civile dhe u urdhërua të paguajë një dëmshpërblim prej afro 305,000 euro, por për shkak të pamundësive financiare të L.H., kërkuesja ka arritur të marrë vetëm rreth 30,000 euro. Megjithatë, pretendimet që kërkuesja ngritit ndaj Ministrisë së Arsimit në të njëjtën padi u hodhën poshtë nga Gjykata e Lartë në Irlandë, e cila vlerësoi se autoritetet irlandeze nuk kishin përgjegjësi civile për abuzimin seksual ndaj kërkueses. Arsyetimi i juridiksionit të lartë irlandez ishte se shteti vetëm ofronte të drejtën për arsim ndërsa administrimi i përditshëm i shkollave nuk varej nga autoritetet shtetërore por nga vetë shkollat.

3. Kërkuesja u ankua, në bazë të neneve 3, 8, 13 dhe 14, të nenit 2 të Protokollit 1, se autoritetet shtetërore kishin dështuar për ta mbrojtur atë nga abuzimi seksual prej një mësuesi në shkollën kombëtare dhe se ajo nuk kishte mjet efektiv kundër Shteti në këtë drejtim.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. në lidhje me nenin 3

#### *i) Në lidhje me aspektin substancial të nenit 3*

4. Gjykata e gjeti të nevojshme të vlerësonte çështjen e përgjegjesisë së shtetit në këndvështrimin e fakteve dhe të standardeve në vitin 1973. Gjykata vlerësoi se mbrojtja e fëmijëve nga keqtrajtimi është një detyrim i pandarë e autoriteteve, sidomos në kuadrin e arsimit fillor, dhe ky detyrim shtrihej gjithashtu edhe në vitin 1973. Mbi këtë bazë, Gjykata vazhdoi të vlerësojë nëse shteti kishte përmbushur obligimet e veta pozitive në këtë drejtim. Ajo pranoi se keqtrajtimi përfshihej në fushën e veprimit të nenit 3 dhe se nuk kishte mosmarrëveshje mes palëve për këtë çështje. Edhe në qoftë se shkollat kombëtare ishin institucionet arsimore të menaxhuara nga aktorë jo-shtetërorë, Shteti duhe të kishte qenë në dijeni të nivelit të krimeve seksuale ndaj të miturve në shkolla përmes veprimit dhe zbatimit të ligjeve të saj penale mbi këtë fushë. Sipas Gjykatës, autoritetet duhet të kishin qenë të vetëdijshme për rreziqet e mundshme ndaj sigurisë së fëmijëve në këtë kontekst, dhe se kuadri mbrojtës nuk kishte qenë i përshtatshëm. Përderisa mekanizmat në të cilën Shteti u mbështet nuk kishin qenë efektivë, Gjykata u shpreh se shteti kishte dështuar të përmbushë detyrimet e tij pozitive për të mbrojtur kërkuesen nga abuzimi seksual dhe kjo përbën shkelje të nenit 3.



ii) në lidhje me aspektin procedural të nenit 3

5. Gjykata konstatoi se sapo Shkolla Kombëtare në fjalë bëri një ankesë në vitin 1995 në lidhje me abuzimin seksual nga L.H., filloi një hetim dhe kërkuesja kishte qenë në gjendje të bënte deklaratë. Në këto kushte Gjykata u shpreh se nuk ka pasur shkelje të nenit 3, në këtë drejtim.

### **B. Në lidhje me nenin 13**

6. Gjykata u shpreh se, përderisa kërkuesja nuk kishte pasur mjete efektive juridike në dispozicion të saj në lidhje me ankesat e bëra sipas nenit 3, atëherë ka pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 3.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

7. Gjykata vlerësoi se Irlanda duhet t'i paguante kërkueses 30 000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 85 000 euro për kostot dhe shpenzimet.

## **III. Koment**

8. Kjo çështje iu kalua direkt Dhomës së Madhe nga një Dhomë e Seksionit V në bazë të nenit 30 të Konventës pikërisht për arsye se ngrinte "një problem serioz që prek interpretimin e Konventës ose të protokolleve të saj", pra për shkak të rëndësisë së çështjes. Ajo i dha fund një odiseje 15 vjeçare gjyqësore në Irlandë. Pyetja e parë përpara Dhomës së Madhe ishte që të përcaktonte nëse autoritetet irlandeze mund të konsiderohej se kishin shkelur Konventën në lidhje me dështimin për të mbrojtur kërkuesen, kur ishte fëmijë, nga abuzimi seksual prej një mësuesi në shkollën e saj. Faktet e çështjes kishin ndodhur në vitin 1973, pra 40 vjet përpara shqyrtimit të çështjes në Strasburg, gjithsesi në një kohë kur Irlanda e kishte ratifikuar Konventën. Nga pikëpamja e juridiksionit kohor pra, nuk kishte asnjë problem për Gjykatën në këtë rast, aq më tepër që procedurat e brendshme kishin vazhduar deri në vendimin e Gjykatës së Lartë Irlandeze në 09.05.2009. Sidoqoftë elementi kohor ishte i pranishëm edhe në këtë vendim. Një pyetje e cila mundonin disa gjyqtarëve ishte nëse një vetëdije të 21 shekulli i rrezikut të përgjithshëm të abuzimit të fëmijëve seksual (jashtë institucioneve të mbyllura dhe me një mësues të martuar laik) duhet të numërohet shtetit në një kohë kur vetëdija e këtij fenomeni nuk ishte ende duke pasur parasysh vëmendjen e publikut. Siç duket nga mendimet në pakicë, një nga problemet që shqetësoi disa nga gjyqtarët e Dhomës së Madhe ishte nëse ndjeshmëria e shekullit XXI mbi rrezikun e përgjithshëm ndaj abuzimit seksual të fëmijëve mund të luajë rol në njohjen e përgjegjësisë të shtetit për ngjarje që kanë ndodhur në një periudhë kur ndërgjegja ndaj këtij fenomeni nuk kishte një vëmendje publike si sot<sup>139</sup>.

9. Në këtë kuadër, pyetja themelore përpara Gjykatës në këtë çështje ishte nëse qeveria irlandeze ishte përgjegjëse për abuzime seksuale që kishin ndodhur në shkollat irlandeze në vitet 70 të cilat ajo pretendonte se nuk ishin në drejtimin

<sup>139</sup> Shih përgjigjen e shumicës ndaj këtij shqetësimi në § 147 të vendimit, duke konfirmuar që ky detyrim pozitiv i shteteve mund të pranohet se ekzistonte edhe në vitet 1970.

dhe administrimin e saj të përditshëm dhe çfarë lloj përgjegjësie kishte ajo në raste të tilla. Përgjigja e Gjykatës vjen në dy etapa, së pari duke konfirmuar se në një rast si ky, shteteve iu lindi detyrime me karakter pozitiv<sup>140</sup> dhe duke delimituar natyrën juridike të këtij detyrimi<sup>141</sup>. Duke iu referuar vendimit *Costello-Roberts k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>142</sup>, Gjykata u shpreh se Shtetet kanë përgjegjësi për trajtimin që iu bëhet fëmijëve edhe në shkollat private. Ajo theksoi se parandalimi i sulmeve seksuale, sidomos ndaj fëmijëve mund të bëhet vetëm duke ngritur dhe vënë në zbatim një kuadër ligjor efikas i cili të vërë para përgjegjësisë të gjithë autorët e sulmeve të tilla<sup>143</sup>.

10. Qeveria argumentoi se sistemi shkollor irlandez ishte i ndryshëm nga ai i të gjitha vendeve të tjera për shkak të marrëveshjeve historike mes Shtetit dhe Kishës në Irlandë. Në këtë kuadër, sipas Qeverisë, arsimimi, sidomos ai elementar, nuk drejtohej nga shteti por nga institucione të pavarura prej tij, dhe se mësuesit në këto shkolla nuk konsideroheshin si nëpunës civilë. Në këto kushte, duke iu referuar interpretimit të Gjykatës së Lartë irlandeze, nuk mund të thuhet se shteti kishte përgjegjësi civile indirekte<sup>144</sup> për akte të kryera nga mësuesit e punësuar në këto shkolla. Por Gjykata përgjigjet se sipas jurisprudencës së saj Shtetet nuk mund të shkarkohen nga detyrimi për të mbrojtur fëmijët në shkollat fillore duke ia deleguar këto detyrime organeve ose personave privatë<sup>145</sup>. Pa vënë në pikëpyetje modelin irlandez të menaxhimit jo-shtetëror të arsimit, pyetja ishte nëse kuadri i ligjor - veçanërisht mekanizmat për zbulimin dhe raportimin e abuzimit - iu siguronte fëmijëve që ndjekin një shkollë kombëtare një mbrojtje efektive kundër rrezikut të abuzimit seksual. Nga ana tjetër, sipas Gjykatës mund të thuhet se autoritetet kishin ose duhej të kishin pasur njohuri për këtë rrezik në vitin 1973. Për më tepër, theksoi Gjykata ky detyrim me karakter pozitiv për të mbrojtur merr një rëndësi të veçantë

140 Gjykata i referohet një jurisprudencë të konsiderueshme për të konfirmuar këtë parim të saj. Shih *Çështjen " në lidhje me disa aspekte të ligjeve mbi përdorimin e gjuhës në arsimin në Belgjikë"*, 23.07.1968, Seria A nr. 6, *Marckx k. Belgjikës*, 13.06.1979, Seria A nr. 31, *Airey k. Irlandës*, 9.10.1979, *X dhe Y k. Hollandës*, 26.03.1985, Seria A nr. 91, *A. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 23.09.1998, Reports 1998-VI, *Z dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, ECHR 2001-V; *D.P. dhe J.C. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 38719/97, 10.10.2002, *M.C. k. Bullgarisë*, nr. 39272/98, ECHR 2003-XII. Disa nga këto vendime kanë të bëjnë me nenin 8 të Konventës, megjithatë Gjykata i zbatoi ato në kuadrin e nenit 3, pasi natyrisht debatin e nivelit të ndërhyrjes e zgjidhi në favor të këtij neni të fundit.

141 Ka pasur kritika ndaj mënyrës se si Gjykata e ka saktësuar pasjen dhe natyrën e këtij detyrimi. Një kritikë e fortë dhe debat interesant u zhvillua mbi këtë pikë në takimin mes një delegacioni nga Gjykata e Lartë Irlandeze dhe një delegacioni nga Gjykata e Strasburgut, më 9.12.2016. Shih gjithashtu qëndrimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, Hardiman, në *Irish Times*, 5.9.2014, por edhe qëndrimin e gjyqtarës së Strasburgut Keller, në "*The Court's dilution of Hard International law: Justified by Human Rights values?*", Strasburg, 29.3.2017.

142 *Costello-Roberts k. Mbretërisë së Bashkuar*, 25.03.1993, Seria A nr. 247-C.

143 Shih *Conor O'Mahony*, "*State Liability for Abuse in Primary Schools: Systemic Failure and O'Keefe v. Hickey*", *Irish Educational Studies*, Vol. 28, No. 3, pp.315-331, 2009, e cila që në kohën e vendimit të Gjykatës së Lartë irlandeze shpresonte që sidomos problemi i detyrimeve të shtetit irlandez të shkonte të vendosej në Strasburg.

144 Për një nocion të ngjashëm me atë që u shqyrtua nga Gjykata e Lartë irlandeze shih në Kodin civil shqiptar nenin 609, sidomos paragrafin 2.

145 Shih vendimin *Doe k. Bennett*, të Gjykatës Supreme të Kanadasë në vitin 2003 e cila vendosi se në rastet e skandaleve seksuale ku përfshiheshin priftërinj katolikë, përgjegjësia rridhte nga kompetencat dhe autoritet që Kisha iu njihnte priftërinjve të saj.

në kontekstin e një shërbimi të rëndësishëm publik siç është arsimi fillor, ku autoritetet e shkollës që janë të detyruara të mbrojnë shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve dhe në veçanti të fëmijëve të vegjël të cilët janë veçanërisht të brishtë dhe ekskluzivisht nën kontrollin dhe kujdesin e këtyre autoriteteve. Ky është një mesazh tepër i rëndësishëm për të gjitha shtetet, që tregon se detyrimi i tyre për të shmangur apo ndëshkuar keqtrajtimet ndaj personave të brishtë nuk ndalon vetëm tek pragu i institucioneve shtetërore apo nën varësinë ose kontrollin shtetëror.

11. Së dyti, pasi përcakton kuadrin, Gjykata vlerëson se si detyrimi është zbatuar në praktikë. Dhoma e Madhe gjeti se Shteti kishte dështuar që të krijonte garancitë e duhura procedurale në lidhje me zbulimin e abuzimit dhe parandalimin e tij konsequent. Edhe pse pas disa ankesave mësuesi në fjalë ishte detyruar të largohej nga shkolla në vitin 1973, asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë për ta raportuar atë tek autoritetet për kryerjen e disa veprave shumë të rënda penale kundër fëmijëve. Nuk kishte asnjë sistem në vend për të siguruar që sjellja e tij të hetohej ose raportohet tek autoritetet shtetërore në mënyrë efektive. Ky është një vendim shumë i rëndësishëm, sepse qëndrimi i Gjykatës mund të jetë i zbatueshëm për analogji në rastet e keqtrajtimet, jo vetëm për fëmijët, por edhe të pjestarët e grupeve të tjera të dobëta, si të burgosurit ose personat me aftësi të kufizuara në institucionet e mirëqenies sociale apo që edhe i nënshtrohen abuzimit në shtëpitë e tyre<sup>146</sup>.

## KAÇIU DHE KOTORRI kundër SHQIPËRISË

(nr. 33192/07 dhe 33194/07)

25 qershor 2013

*kjo çështje merret me kriteret që zbatohen për cilësimet juridike të akteve sipas nenit 3 dhe me parimin që provat që përftohen si pasojë e një trajtimi në kundërshtim me nenin 3 nuk mund të përdoren në procedurat gjyqësore*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Olsi Kaçiu dhe Elidon Kotorri, janë dy shtetas shqiptarë që kanë lindur respektivisht më 1979 dhe 1975. z. Kaçiu jeton në Tiranë ndërsa z. Kotorri në kohën e vendimit të Gjykatës po vuante një dënim me burgim të përjetshëm në burgun e Sigurisë së Lartë të Peqinit<sup>147</sup>.

2. Më 11 janar 2000, tre persona u vranë dhe një u plagos rëndë. Në vendin e ngjarjes policia gjeti një numër objektesh, duke përfshirë dy kapuçë dhe doreza

146 Shih p.sh. Z dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar, vendimi 10.5.2001, apo A. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 25599/94, 23.09.1998.

147 Sipas vendimit të Gjykatës së Lartë të 5.11.2014 kërkuesi i dytë po e vuan dënimin aktualisht në IEVP Fushë-Krujë.

në të cilat u gjetën flokë. Tre muaj pas incidentit, kërkuesit u arrestuan. Kërkuesi i parë pohoi se gjatë marrjes në pyetje, ai kishte qenë subjekt i dhunës serioze dhe për pasojë kishte bërë deklaratata që inkriminonin edhe kërkuesin e dytë. Më tej, ai pohoi se i ishte mohuar takimi me një avokat gjatë dy javëve të para. Kërkuesi i dytë deklaroi se atij i ishin shkukur flokët me dhunë dhe pa pëlqimin e tij për të bërë testin e ADN-së dhe se ai kishte qenë rrahur dhe lënë pa ujë dhe pa ushqim.

3. Kërkuesi i parë u shpall fajtor se nuk kishte raportuar një vepër penale ndërsa kërkuesi i dytë u shpall fajtor për disa akuza, si vrasje me paramendim dhe armëmbajtje pa leje. Çështja ndaj tyre u rigjykua dy herë për shkak të problemeve me provat, por të dy rigjykimet u mbyllën me dënimin e të dy kërkuesve.

4. Kërkuesi i parë u ankua për keqtrajtim nga policia dhe për mungesë të hetimeve efektive në lidhje me pretendimet e tij.

## II. Vendimi i Gjykatës

### *A. Në lidhje me shkeljet materiale dhe procedurale të nenit 3*

5. Gjykata vërejti se, pavarësisht nga mungesa e ndonjë përshkrimi të plagëve dhe dëmtimeve të marra, kërkuesi kishte ngritur më shumë se një "pretendim të arsyeshëm" përpara autoriteteve vendase se ai ishte rrahur rëndë gjatë kohës së qëndrimit të tij në paraburgim. Pretendimi i tij krijon prezumimin që kërkuesi i ishte nënshtruar keqtrajtimit të parashikuar nga neni 3 në duart e funksionarëve publikë dhe në këto kushte i takonte Qeverisë të jepte një shpjegim bindës se si mund të ishte shkaktuar rrahja e pretenduar. Qeveria nuk i paraqiti Gjykatës asnjë shpjegim se si mund të ishin shkaktuar plagët e pretenduara nga kërkuesi i parë.

6. Duke pasur parasysh se kërkuesi i parë në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha shkallët e procedimit në Shqipëri kishte insistuar se ai ishte rrahur brutalisht dhe se autoritetet shqiptare nuk kishin marrë asnjë masë për t'i hetuar këto pretendime, ishte e arsyeshme që kërkuesi të presupozonte se mjetet e brendshme juridike nuk do të ishin efektive dhe për këtë arsye nuk mund të pritej që ai të shteronte mjetet kombëtare. Për këtë arsye, Gjykata pranoi se ai kishte pësuar një trajtim në kundërshtim me nenin 3 dhe që, në provat dhe pretendimet e paraqitura nga kërkuesi i parë, ata ishin aq të rënda sa të përbënin torturë sipas kuptimit të nenit 3. Gjykata u shpreh se një situatë e tillë nxirrte në pah edhe një shkelje procedurale të nenit 3 përderisa asnjë masë efektive hetimore nuk ishte marrë në lidhje me pretendimet e kërkuesit të parë.

### *B. Në lidhje me nenin 5*

7. Pretendimet e kërkuesve sipas nenit 5 u shpallën të papranueshme për shkak të mos-shterimit të mjeteve të brendshme juridike.

### *C. Në lidhje me nenin 6*

*i. në lidhje me përdorimin e provave të marra si pasojë e shkeljes së nenit 3 dhe pa praninë e avokatit*

8. Gjykata mori në shqyrtim një sërë argumentesh sipas nenit 6. Së pari, ajo u shpreh se pranimi si provë nga ana e gjykatave të brendshme e deklaratave të bëra nga kërkuesi i parë si rezultat i torturës përbënte shkelje të nenit 6 § 1, përderisa një deklaratë e bërë në kushte të tilla e bën gjithmonë në tërësi procedurën të padrejtë.

9. Për më tepër, deklaratat për heqjen dorë nga e drejta për të pasur akses tek një avokat, nuk mund të jetë e vlefshme, pasi heqja dorë është bërë si rezultat i trajtimit në kundërshtim me nenin 3, si rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) në lidhje me kërkuesin e parë. Kjo shkelje u konsiderua veçanërisht e rëndë nga Gjykata pasi deklaratat, të bëra pa praninë e një avokati dhe si rezultat i keqtrajtimit, ishin baza e vetme për dënimin e 2 kërkuesve. Deklaratat e marra si pasojë e një trajtimi në kundërshtim me nenin 3 gjithmonë i bëjnë procedurat të padrejta, aq më tepër kur bëhen pa praninë e avokatit, pavarësisht nga vlera provuese apo karakteri përcaktues i këtyre deklaratave në vendimin e gjykatave penale.

10. Në lidhje me provat kundër kërkuesit të dytë, të cilat ishin treguar nga kërkuesi i parë si pasojë e trajtimit në kundërshtim me nenin 3, Gjykata vlerësoi se procesi gjyqësor ndaj kërkuesit të dytë, në tërësinë e tij, ishte i padrejtë për shkak të pranimi dhe përdorimit të tyre për fajësimin e kërkuesit të dytë.

*ii. në lidhje me gjykimin nga një gjykatë e krijuar me ligj për shkak të transferimit të gjyqtarëve të Gjykatës Ushtarake të Apelit Tiranë*

11. Në lidhje me kërkesën e bërë nga të dy kërkuesit, që përbërja e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit me datë 2.12.2004, nuk ishte e ligjshme për shkak se disa prej gjyqtarëve në trupin gjyqësor që mori vendimin ishte transferuar nga gjykata ushtarake, Gjykata vuri në dukje se transferimi ishte bërë në përputhje me dispozitat ligjore. Gjithashtu, ajo vuri re se gjyqtarët ushtarakë kishin të njëjtin status, përgatitje, trajnim dhe garanci pavarësie si gjyqtarët e tjerë të Gjykatës së Apelit. Përveç kësaj, Gjykata konstatoi se arsyeja për transferimin ishte pikërisht fakti që të gjithë 16 gjyqtarët e tjerë në Gjykatën e Apelit kishin qenë të përfshirë më herët në gjykimin e çështjes së kërkuesve, pra transferimi ishte bërë për të garantuar paanshmërinë e trupit gjykues. Këto elementë bënë që transferimi i gjyqtarëve të mos përbënte asnjë problem nën këndvështrimin e nenit 6.

*iii. në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës*

12. Në përgjigje të argumentit të kërkuesve se procedura kishte zgjatur për një periudhë të paarsyeshme kohore, Gjykata vuri në dukje se procedura kishte filluar më 18 prill 2000 dhe kishte përfunduar më 6 shkurt 2007. Kjo periudhë e gjatë ishte për shkak të rikthimeve të shumta të çështjes nga gjykatat më të larta tek ato më të ulëta, diçka që Gjykata e ka shqyrtuar tashmë në një rast të

mëparshëm kundër Shqipërisë<sup>148</sup>. Në veçanti, pas seancës së parë të Gjykatës së Lartë, çështja u kthye në Gjykatën e Rrethit për rigjykim por procedurat e reja nuk i respektojnë udhëzimet e Gjykatës së Lartë. Ky fakt e vonoi procedurën për rreth dy vjet. Kjo vonesë i atribuohet tërësisht gjykatave të brendshme dhe për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 6 § 1.

#### **D. Në lidhje me nenin 6 § 2**

13. Kërkuesit pretenduan se fushata mediatike kundër tyre përbënte shkelje të së drejtës për prezumimin e pafajësisë. Gjykata e hodhi poshtë këtë pretendim të kërkuesve me arsyetimin se neni 6 § 2 nuk mund të pengojë informimin e publikut mbi hetimet ose proceset gjyqësore penale në vijim e sipër. Megjithatë ajo theksoi se raportimi i procedurave gjyqësore duhet bërë me të gjithë diskrecionin dhe maturinë e nevojshme që të respektohet prezumimi i pafajësisë dhe media të mos kapërcejë kufijtë e caktuar në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, veçanërisht kur seancat janë publike.

#### **E. Në lidhje me nenin 7**

14. Pretendimi i kërkuesit të dytë se ai ishte dënuar në zbatim prapaveprues të ligjit penal u gjet i papranueshëm për shkak të mosshterimit të mjeteve të brendshme ligjore.

#### **F. Në lidhje me nenin 41**

15. Kërkuesit të parë iu akorduan 15 600 euro në lidhje me dëmin jopasuror. Në lidhje me kërkuesit e dytë, Gjykata u shpreh se konstatimi i shkeljes përbën një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm. Në lidhje me shkeljen e nenit 6, Gjykata theksoi se kërkuesve duhet tu krijohet mundësia e rihapjes së procesit në ngarkim të tyre.

### **III. Koment**

16. Ky është një nga vendimet më të rëndësishme kundër Shqipërisë, i cili ofron edhe kontribute me vlerë në ngrehinën jurisprudenciale të Strasburgut në tërësi. Kontributi por edhe debati kryesor i vendimit lidhet me nenin 3 dhe sidomos me nenin 6 § 1 të Konventës.

17. Në lidhje me nenin 3, vlera e vendimit konsiston në ripohimin e qartë të Gjykatës të parimit të jurisprudencës së saj se, tortura dhe të gjitha format e tjera të trajtimit apo dënimit çnjerëzor dhe poshtëruës janë njësoj absolutisht të ndaluara sipas nenit 3 të Konventës. Gjykata thekson vazhdimisht që konstatimi i një shkelje të nenit 3 nuk është një shkelje e lehtë pasi ai mbron një të drejtë absolute. Aq më tepër kur shkelja ka të bëjë me torturën që është shprehja më e egër e trajtimeve të ndaluara sipas nenit 3, dhe ky ishte rasti në çështjen që po komentojmë. Ajo nuk lodhet së përsërituri se, kur një person nën kontrollin e

148 Bëhet fjalë për vendimin e 18.12.2007 në çështjen *Marini k. Shqipërisë*.



autoriteteve ankohe për trajtime që janë në kundërshtim me nenin 3, barra iu bie autoriteteve që të marrin masa për të hetuar trajtimin e pretenduar, për ta ndaluar atë nëse ka ndodhur vërtet, dhe për t'i dhënë shpjegime Gjykatës për dëmtimet e pësuar nga kërkuesit nën kontrollin e tyre. Sipas Gjykatës, elementi kritik i masave mbrojtëse procedurale të rrënjësura në nenin 3 është hetimi i shpejtë, i pavarur dhe efektiv i pretendimeve për keqtrajtime. Një hetim i tillë duhet të përfshijë urdhërimin e një ekzaminimi të pavarur mjekësor. Mungesa e një hetimi të tillë, përveçse përbën shkelje të qartë të aspektit procedural të nenit 3, pothuajse automatikisht e çon Gjykatën në përfundimin se ka pasur edhe shkelje materiale të nenit 3 si pasojë e teknikës së përfundimeve të kundërta në të cilat ajo arrin për shkak të pamundësisë të Qeverisë për ta bindur Gjykatën mbi rrjedhën e ngjarjeve<sup>149</sup>.

18. Në një opinion paralel, në të cilin bie dakord me përfundimin e shumicës për shkelje të nenit 3 por jo me arsyetimin e saj se në këtë rast kishte pikërisht torturë, nënvizova se testi që kolegët përdorën për të arritur në përfundimin se në rastin konkret kishte pasur torturë nuk është në përputhje, sipas mendimit tim, me parimet e jurisprudencës së Strasburgut. Ky test, i vendosur në çështjen *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>150</sup> bazohet të standardin e provës "përtej dyshimit të arsyeshëm". Por në kushtet ku nuk kishte asnjë përshkrim të saktë dhe të llogjikshëm të plagëve apo dëmtimeve të kërkuesit të parë<sup>151</sup>, shumica arrin në përfundimin se kishte torturë mbi bazën e prezumimit, duke "prezuar në mënyrë indirekte" qëllimin dhe me "shumë gjasa" kohëzgjatjen e keqtrajtit. Kjo analizë për mendimin tim nuk respekton testin e çështjes *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>152</sup>. Gjithsesi ky vendim dhe kjo situatë nxjerr në pah nevojën që autoritetet shtetërore të kryejnë menjëherë një hetim të pavarur në lidhje me rrethanat në të cilat keqtrajtimi ka ndodhur, për të shmangur një shkelje sa procedurale aq edhe materiale, eventualisht në formën e torturës, të nenit 3.

19. Elementi i dytë kardinal i këtij vendimi lidhet me nenin 6, sidomos me të drejtën për të mos u vetëinkriminuar ose për të mos bërë deklaratat që inkriminojnë persona

149 Shih *Tomasi k. Francës*, 27 Gusht 1992, §§ 108-11, Seria A nr. 241-A; *Selmouni k. Francës* [GC], nr. 25803/94, §§ 91-106, ECHR 1999-V, *Ribitsch k. Austrisë*, 4 Dhjetor 1995, § 34, Seria A nr. 336

150 Vendim i 18.01.1978, Seria A nr. 25. Shih sidomos paragrafin 167. Në përcaktimin nëse një formë e veçantë trajtimi arrin kufirin e përgjithshëm të nenit 3, Gjykata ka miratuar standardin e provës "përtej dyshimit të arsyeshëm" duke shtuar se "një provë e tillë mund të vijojë nga bashkëzistenca e konkluzioneve mjaft të forta, të qarta, dhe pajtuese ose të prezumimeve të pakundërshtueshme të ngjashme të faktit". Gjykata ka konfirmuar në mënyrë të përsëritur se "me qëllim që keqtrajtimi të bjerë në objektin e nenit 3, ai duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie. Vlerësimi i këtij minimumi varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore dhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës". Gjykata ka shtuar se "faktorë të mëtejshëm" përfshijnë qëllimin për të cilin është shkaktuar trajtimi së bashku me qëllimin apo motivimin pas tij..., si dhe kontekstin e tij, të tillë si atmosfera e emocioneve dhe tensioneve të shtuara" (shih *Gäfgen k. Gjermanisë* [GC], nr. 22978/05, § 88, ECHR 2010).

151 Siç e pranon edhe shumica në paragrafin 95 të vendimit.

152 Shih gjithashtu *Selmouni k. Francës*, cituar më lart, *Gäfgen*, cituar më lart, § 94; *Dedovskiy dhe të tjerë k. Rusisë*, nr. 7178/03, §§ 39-50, 59-61 dhe 80-86, ECHR 2008 (ekstrakte); *Savitskiy k. Ukrainës*, nr. 38773/05, §§ 15-18 dhe 129-139, 26.07.2012; *Virabyan k. Armenisë*, nr. 40094/05, §§ 17-29 dhe 31, 2.10.2012; dhe *Lenov k. Bullgarisë*, nr. 41452/07, §§ 111-18, 4.12.2012.

të tretë<sup>153</sup>. Vendimi vjen në vazhdim të vendimeve mjaft të njohura *Gäfgen k. Gjermanisë* dhe *Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>154</sup>. Të dy këto vendime duket se kanë luajtur një rol në analizën e Gjykatës, dhe sidomos të shumicës, në këtë vendim në raport me nenin 6 por edhe me nenin 3. Në të dy ato vendime kishim pasur të bënim qartë me kërcënim torture ose me rrezik real të ushtrimit të torturës. Megjithatë duhet kujtuar se në *Gäfgen* Gjykata nuk gjeti shkelje edhe të nenit 6 § 1, edhe pse nuk vlerësoi se kishte torturë por vetëm trajtim çnjerëzor, kurse në *Othman* pranoi se do kishte shkelje të nenit 6 § 1 në rast ekstradimi për shkak të përdorimit të dëshmitë të marra nën torturë. Duket se në *Kaçiu* dhe *Kotorri*, Gjykata preferoi që të pranonte se kishte torturë, për të arritur më kollaj në përfundimin se kishte pasur edhe shkelje të nenit 6 § 1, dhe duke hezitur të hedhë një hap më tej në jurisprudencën e Gjykatës. Kjo do të kishte qenë e mundur aq më tepër, mendoj, në rastin në fjalë ku dëshmitë inkriminuese vinin nga një i bashkëakuzuar dhe jo nga vetë i akuzuari. Në mendimin paralel u shpreha se Dhoma duhet të kishte konstatuar shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës pa pasur nevojë për të arritur, paraprakisht, në përfundimin se ankuesi i parë i ishte nënshtruar torturës, të cilin unë e vlerësova si konkluzion të pasigurtë mbi faktet e çështjes<sup>155</sup>. Për mendimin tim, fakti që ankuesi i parë është keqtrajtuar në kundërshtim me nenin 3, do të kish qenë i mjaftueshëm në vetvete për të bazuar një shkelje të nenit 6 në lidhje me të dy ankuesit<sup>156</sup>. Është interesant që në rastin në fjalë Gjykata i gjen dëshmitë inkriminuese të kërkuesit të parë vendimtare për dënimin e kërkuesit të dytë dhe nuk bën një vlerësim holistik të procedurës në ngarkim të tyre, siç bëri në çështjen *Gäfgen*.<sup>157</sup>

20. Ky vendim i Gjykatës së Strasburgut ka bërë që çështja të rihapet në sistemin e brendshëm shqiptar, në përputhje me sugjerimin e Gjykatës në paragrafin 163 të vendimit<sup>158</sup>. Me vendimin Nr.00-2014-1945 i Vendimit (209) dt. 5.11.2014, Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë vendosi ta rihapë çështjen dhe t'ia dërgojë Gjykatës së Rrethit Tiranë për rigjykim.

153 Shih *Andree Choo "The Privilege Against Self-Incrimination and Criminal Justice, Hart Publishing, 2013.*

154 Vendim i 17.01.2012, nr. 8139/09.

155 Shih gjithashtu *Funke k. Francës*, nr. 10828/84, A/256-A, [1993] 25.02.1993. Në atë vendim Gjykata vendosi që detyrimi i autoriteteve doganore franceze për ta detyruar z. Funke paraqiste dokumente për të cilat besonin se ekzistonin, por pa u përpjekur t'i gjenin vetë me mjete të tjera, përbënte shkelje të nenit 6 § 1. Megjithëse Kodi Doganor francez i lejonte veprimet e autoriteteve, ato ishin shkelje e qartë e të drejtës së individit për të heshtur dhe jo për të kontribuar në inkriminimin e tij. Ndërsa në *Saunders k. Mbretërisë së Bashkuar*, 43/1994, vendim i 17.12.1996, Gjykata hodhi poshtë argumentin e qeverisë britanike se kompleksiteti i rasteve të mashtrimit në masë dhe interesi publik për të siguruar një dënim justifikuan detyrimin për tu vetë inkriminuar. Gjykata gjithashtu hodhi poshtë argumentin se kompetenca e një gjyqtari për t'i përjashtuar deklaratat përbënte një mbrojtje të mjaftueshme në këtë rast. Gjykata deklaroi se "interesi publik nuk mund të thirret për të justifikuar përdorimin e deklaratave të marra me detyrim gjatë një hetimi jo gjyqësor për të inkriminuar të akuzuarin gjatë procesit gjyqësor" dhe "prokuroria në një çështje penale [duhet] të kërkojë të provojë akuzën kundër të akuzuarit pa përdorur dëshmi të fituara nëpërmjet metodave të shtrengimit ose presionit në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit". Shih gjithashtu vendimet *Deeër k. Belgjikës*, *Fayed k. Mbretërisë së Bashkuar*, *John Murray Mbretërisë së Bashkuar*.

156 Për më tepër dëshmitë ishin marrë pa praninë e avokatit në kundërshtim me vendimin *Salduz k. Turqisë*, [GC], nr. 36391/02, 27.11.2008.

157 Shih për më gjerë *Caroline Savvidis "Court Delay and Human Rights Remedies: Enforcing the Right to a Fair Hearing"*, Routledge, 2016.

158 Shih *Salduz* i cituar më lart, *Caka k. Shqipërisë*, nr. 44023/02, § 122, 8.12.2009; *Laska dhe Lika k. Shqipërisë*, nr. 12315/04 dhe 17605/04, §§ 74-76, 20.04.2010; *Berhani k. Shqipërisë*, nr. 847/05, § 91, 27.05.2010 dhe *Shkalla k. Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 77-79, 10.05.2011.

## EL MASRI kundër REPUBLIKËS ISH-JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

(kërkesa nr. 39630/09)

13 dhjetor 2012

Dhomë e Madhe

*kjo çështje ka të bëjë me bashkëpunimin e autoriteteve maqedonase në rrëmbimin e kërkuesit dhe dërgimin e tij në qendra sekrete burgimi, në kuadrin e luftës kundër terrorizmit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Khaled El-Masri, është shtetas gjerman i cili ka lindur më 1963, dhe jeton në Senden në Gjermani.

2. Në dhjetor 2003, kërkuesi u nis për pushime me autobus nga Ulm, në Gjermani drejt Shkupit. Në kufirin serbo-maqedonas, autoritetet kufitare patën dyshime për shkak se kërkuesi kishte një pasaportë gjermane të sapolëshuar. Autoritetet kontrolluan sendet e tij personale dhe kërkuesi u mor në pyetje, për rreth shtatë orë, në lidhje me lidhjet e tij të mundshme me disa organizata islamike. Pas marrjes në pyetje ai u çua me makinë në hotelin që kishte prenotuar, Merak Skopski, i shoqëruar nga njerëz të armatosur në veshje civile. Pas mbërritjes në hotel, kërkuesi u mbajt i ndaluar jo-zyrtarisht, dhe u mor në mënyrë të përsëritur në pyetje në anglisht, gjuhë të cilën ai nuk e zotëronte. Kërkuesi u informua se ai do të kthehej në Gjermani nëse ai nënshkruante një dëshmi si anëtar i Al-Kaedës. Pas u mbajt dhjetë ditë në këto kushte, kërkuesi filloi një grevë urie, dhe u çua në aeroportin e Shkupit, i prangosur dhe me sy të lidhur.

3. Në aeroport, kërkuesi u informua se do t'i nënshtrohej një "kontrolli mjekësor", dhe menjëherë pas kësaj iu tërhoqën dhe iu mbajtën krahët pas shpine dhe filluan ta rrihnin. Pas kësaj ai u përplas në dysheme, dhe një çizme mbi shpinë e detyronte të rrinte ashtu, dhe i futën një objekt të fortë në anus. Atij i mbuluan kokën me një kapuç dhe e hipën në një avion, i cili në aeroport ruhej nga forcat e armatosura maqedonase. Në avion kërkuesin e mbajtën të prangosur dhe të lidhur me zinxhirë në paretet e avionit. Në pasaportën e tij u vu një vulë dalje nga Maqedonia. Kërkuesin e çuan në Afganistan pas një ndalese në Irak. Ai u mbajt në një qendër paraburgimi për terroristë me rrezik të lartë, dhe në mars 2004, ai filloi një grevë urie, për shkak se po mbahej i ndaluar pa asnjë akuzë.

4. Në prill 2004, disa persona të maskuar e ngritën me forcë nga shtrati, e lidhën në një karrige dhe e ushqyen me forcë me anë të një tubi. Më pas kërkuesit

iu dhanë ushqime konservash dhe disa libra. Ushqyerja me forcë i shkaktoi probleme shëndetësore kërkuetit, i cili mori edhe mjekim për këtë qëllim. Në maj 2004, kërkueti u lidhën përsëri sytë dhe iu vunë prangat, u urdhërua të vishte rrobat që kishte pasur kur kishte udhëtuar drejt Shkupit, dhe e hipën në një tjetër avion.

5. Kërkueti u dërgua në Shqipëri, pa iu thënë fillimisht se ku ishte. Kur më në fund u lirua atij iu tha se ishte në Shqipëri dhe pasi i vendosën një vulë dalje nga Republika e Shqipërisë në Aeroportin Nënë Tereza, e hipën në një avion drejt Frankfurtit. Kur ai arriti në Gjermani ai peshonte 18 kg më pak nga pesha që kishte pasur kur u nis, vuante nga çrregullime mendore dhe u diagnostikua me çrregullime stresi post-traumatike, që mund të ishin shkakuar nga torturat dhe keqtrajtimet që ai pretendonte se kishte pësuar.

6. Kërkueti bëri një kallëzim penal për rrëmbim dhe ushtrim torture ndaj tij nga persona me funksione zyrtare por të paidentifikuar. Ai bëri gjithashtu një padi civile për shpërblim dëmi në lidhje me të njëjtat rrethana. Kallëzimi i tij penal u hodh poshtë nga prokuroria si i pabazuar ndërsa procesi civil, pas rreth gjashtëmbëdhjetë seancash dhe shumë shtyrjesh ishte ende në gjykim në gjykatën e shkallës së parë në Shkup.

## II. Vendimi i Gjykatës

7. Kërkueti pretendonte se ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ka qenë përgjegjës për keq-trajtimin të cilit ai i ishte nënshtruar në kundërshtim me nenet 3, 5, 8, 10 dhe 13 të KEDNJ. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe kompleksitetin e çështjes në këndvështrimin e Konventës, një Dhomë e Gjykatës hoqi dorë nga juridiksioni i saj duke ia kaluar drejtpërdrejt çështjen Dhomës së Madhe, në përputhje me nenin 30 të Konventës.

### *A. Në lidhje me pretendimet paraprake dhe me përgjegjësinë e shtetit*

8. Qeveria maqedonase mohoi çdo përgjegjësi për keqtrajtimin e kërkuetit dhe kundërshtoi besueshmërinë e raporteve të ekspertëve mbi shëndetin e tij mendor. Qeveria më tej pohoi se, edhe pse hetimi penal mbi pretendimet e kërkuetit kishte qënë jo-efektiv, kjo i atribuohet vonësës së kërkuetit në paraqitjen e ankesës së tij dhe faktit se ai ishte ankuar ndaj autorëve të paidentifikuar. Nga ana tjetër ajo pretendoi se kërkueti ishte ankuar përtej afatit prej 6 muajsh të parashikuar nga neni 35 § 1 i Konventës.

9. Gjykata vlerësoi së pari se kallëzimi penal ishte një mjet për t'u shteruar për qëllimet e nenit 35 § 1 të Konventës, dhe theksoi se afati gjashtë mujor fillon të ecë jo nga data kur prokurori ka marrë vendim për pushimin e çështjes, por nga data kur kërkueti ka marrë dënim për këtë vendim.

10. Disa nga palët e treta në procedurë argumentuan se e drejta për të vërtetën

në rastet e zhdukjeve me forcë të personave është e mishëruar në KEDNJ, si pjesë e neneve 2, 3 dhe 5, dhe sidomos 13. Për më tepër, ato argumentuan se taktikat e ndalimeve të jashtëzakonshme, si ato për të cilat ankohej kërkuesi, përbënin shkelje të parimit të moskthimit (non-refoulement) sipas së drejtës ndërkombëtare.

*a) Në lidhje me përcaktimin e fakteve dhe vlerësimin e provave*

11. Gjykata konstatoi se palët nuk binin dakord për versionin e fakteve, dhe se në mungesë të konstatimeve zyrtare në nivel të brendshëm, asaj i dilte për detyrë që ta bënte vetë përcaktimin e fakteve të çështjes. Ajo theksoi se, megjithëse në këtë rol standardi i zbatueshëm ishte ai i provave "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm", roli i saj specifik juridiksional në kuadër të nenit 19 të Konventës dhe procedurat në bazë të kësaj të fundit jo në çdo rast kushtëzohen nga parimi *affirmanti incumbit probatio*. Jurisprudenca e saj në bazë të neneve 2 dhe 3, por edhe të nenit 5, pranon se kur një person humb jetën, keqtrajtohet, ose mbahet në rrethana për të cilat autoritetet janë ose duhet të jenë në dijeni ose në vende nën kontrollin e autoriteteve atëherë barra e provës mund t'iu kalojë autoriteteve.

*B. Në lidhje me nenin 3*

12. Në fillim, Gjykata kujton se e drejta për të mos u torturuar, sipas nenit 3, është një nga të drejtat më themelore në një shoqëri demokratike. Për këtë arsye është absolutisht e detyrueshme për Shtetet që të hetojnë çdo akuzë për një trajtim në kundërshtim me nenin 3. Gjykata theksoi se ky detyrim pozitiv për të hetuar akuza të tilla lind nga një lexim i përbashkët i neneve 3 dhe 1 të KEDNJ. Gjykata theksoi se pa hetime efektive, të afta për të identifikuar autorët e akteve të tilla, të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga neni 3 do të jenë të paefektshme në praktikë, dhe persona me autoritet shtetëror do të mundën që, pa u ndëshkuar, të shkelin të drejtat që neni 3 iu garanton personave në kontrollin e tyre. Për këtë arsye, hetimi duhet të jetë i menjëhershëm, i plotë dhe i pavarur nga ekzekutivi.

13. Kërkuesi kishte bërë një kallëzim penal në prokurori në tetor 2008 për bashkëpunim të agentëve shtetërorë në dorëzimin dhe keqtrajtimin e tij. Pretendimet e tij mbështeteshin edhe nga prova plotësuese, të tilla si raporte të mediave të besueshme dhe hetime të tjera të huaja. Pas kallëzimit të kërkuesit, prokurori nuk bëri asgjë më shumë sesa një kontakt me Ministrinë e Brendshme dhe për këtë arsye nuk mund të justifikohet hedhja poshtë e pretendimit të kërkuesit për mungesë provash. Qeveria pranoi se hetimi në lidhje me ankesën e kërkuesit nuk ka qenë efektiv. Gjykata u shpreh se duhet luftuar pandëshkueshmëria e Shteteve të përfshira në abuzime të rënda të të drejtave të njeriut. Në këto kushte ajo vendosi se kërkuesi ishte privuar nga llogaridhënie e arsyeshme mbi çka i kishte ndodhur atij, dhe arsyet përkatëse.

14. Përveç kësaj, trajtimi i z. El-Masri nuk mund të justifikohet në bazë të sigurisë kombëtare, apo luftës ndaj terrorizmit. Gjykata theksoi se ndalimi i torturës ngelet një e drejtë absolute. Prandaj, Gjykata përsëriti se dështimi i autoriteteve



për të marrë hapa të arsyeshëm për shmangien e rrezikut të keqtrajtimit për të cilin Shteti kishte dijeni, ose duhej të kishte dijeni, mund të fusë në veprim nenin 3. Edhe pse nuk i ishte nënshtruar dhunës fizike ndërsa mbahej në hotel në Shkup, Gjykata vërejt se neni 3 nuk i referohet ekskluzivisht vuajtjeve fizike. Izolimi i zgatur i kërkuesit ishte i tillë sa i kishte shkaktuar atij shqetësime emocionale dhe ankth psikologjik. Kërkuesi ishte vendosur qëllimisht në një situatë ankthi të vazhdueshëm për shkak se autoritetet synonin që ai të rrëfehej. Autoritetet nuk kishin qenë në gjendje të jepnin ndonjë shpjegim për një trajtim të tillë. Kështu, Gjykata u shpreh se kushtet në hotel ishin aq të rënda sa të përbënin shkelje të nenit 3.

15. Gjykata vlerësoi se edhe keqtrajtimi i kërkuesit në aeroportin e Shkupit ishte gjithashtu nën përgjegjësinë e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Veprimet që agjentët e huaj ndërmorën me dijeninë apo pranimin e autoriteteve maqedonase i ngarkohen Shtetit palë në këtë çështje. Ashpërsia e keqtrajtimit nuk mund të justifikohet, pasi agjentët ishin qartazi më të shumtë në numër sesa kërkuesi dhe ai nuk përbënte asnjë rrezik për ta. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se zhveshja me forcë nga policia, e bërë në mënyrë krejt arbitrare synonte ta poshtëronte kërkuesin. Për më tepër transferimi i z. El-Masri në duart e agjentëve të CIA-s nuk është bërë në kuadrin e një kërkesë zyrtare dhe të ligjshme për ekstradim. Sipas të dhënave në dispozicion të Gjykatës, autoritetet maqedonase e njihnin destinacionin e avionit në të cilin kërkuesi ishte detyruar të hipte. Gjykata shprehu shqetësime përse i përket trajtimit të të dyshuarve si terroristë nga autoritetet amerikane, veçanërisht në qendra të paraburgimit të profilit të lartë të tilla si Guantanamo Bay. Informacioni në lidhje me këto qendra ishte bërë ndërkohë publik në momentin që kërkuesi u ishte dorëzuar autoriteteve amerikane. Prandaj Gjykata besonte se autoritetet maqedonase ishin ose duhet të ishin në dijeni për rrezikun e torturës dhe keqtrajtimit të kërkuesit. Kështu, Gjykata vendosi se autoritetet maqedonase kishin shkelur nenin 3 të KEDNJ-së edhe në këtë aspekt.

### *C. Në lidhje me nenin 5*

16. Gjykata ritheksoi jurisprudencën e saj, sipas së cilës shtetet shkelin të drejtën për liri të garantuar nga neni 5 në qoftë se ata transferojnë individë drejt shteteve të tjera ku ata janë në rrezik të "shkeljeve flagrante" të nenit 5. Në këtë rast, Gjykata konstatoi se mbajtja e kërkuesit në hotel në Shkup, pastaj në aeroport, në vijim në Afganistan dhe më pas kthimi i tij nëpërmjet Shqipërisë ishin të gjitha veprime që iu ngarkohen autoriteteve maqedonase. Autoritetet maqedonase ishin bashkëpërgjegjëse për burgimin e kërkuesit në Afganistan, meqënëse në mënyrë të vullnetshme ia kishin dorëzuar atë autoriteteve amerikane.

17. Përveç kësaj, Gjykata u shpreh se praktikat e dorëzimeve të jashtëzakonshme arrinin deri në zhdukje me forcë, e cila në vetvete përbën një burgim jashtë sistemit ligjor normal.



**D. Në lidhje me nenin 8**

18. Gjykata u shpreh se të drejtat e kërkuesit për jetë familjare dhe private, sipas nenit 8, ishin shkelur. Ndërhyrja ndaj këtyre të drejtave kishte qënë e asaj natyre sa nuk mund të konsiderohej "në përputhje me ligjin", pasi rrëmbimi i tij ishte bërë jashtë çdo baze ligjore.

**E. Në lidhje me nenin 13**

19. Gjykata konstatoi gjithashtu se ka pasur shkelje të së drejtës së kërkuesit për një mjet efektiv, sipas nenit 13 të Konventës. Sipas saj kërkuesi nuk ka pasur në dispozicion asnjë mjet efektiv dhe praktik për shkak të mungesës së një hetimi efektiv. Nuk kishte asnjë provë se vendimi për ta dorëzuar kërkuesin tek agjentët e CIA-s i ishte nënshtruar ndonjë forme shqyrtimi dhe praktikisht as mund t'i nënshtrohej në rrethanat konkrete. Prandaj Gjykata konstatoi shkelje të nenit 13, në lidhje me nenet 3, 5 dhe 8 të Konventës.

**F. Në lidhje me nenin 41**

20. Gjykata u shpreh se ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë duhet t'i paguajë z. El-Masri 60 000 euro për dëmet jo-materiale. Gjykata shtoi më tej për çdo vonesë të pagesës, duhej paguar një interes i barabartë me normën e interesit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës përkatëse, plus tre për qind.

**III. Koment**

21. Ky është vendimi i parë i një serie vendimesh që kanë pasur apo kanë të bëjnë me këtë fenomen që ka marrë emërtime të ndryshme – ai është quajtur rrëmbimet e jashtëligjshme, transferimet e jashtëligjshme, dorëzimet e jashtëzakonshme apo burgosja *incommunicado* e personave që, sidomos nga CIA, dyshoheshin se kishin lidhje me organizata terroriste e në veçanti Al-Qaeda, në kuadrin e Luftës Globale kundër Terrorizmit që filloi pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 në Nju Jork dhe Uashington<sup>159</sup>.

22. Ky është një vendim historik për disa arsye, dhe jo më kot çështja kaloi për shqyrtim menjëherë Dhomës së Madhe.

23. Çështja paraqet rëndësi, së pari, sepse erdhi para Gjykatës ndërkohë që debate të shumta po zhvilloheshin në mjedise të ndryshme institucionale, politike dhe juridike në lidhje me praktika të ndjekura nga CIA në bashkëpunim me shërbimet sekrete të disa shteteve të tjera për rrëmbimin dhe burgosjen e personave të dyshuar për lidhje me terrorizmin, numri më i madh i të cilëve

159 Me 17 shtator 2001 Presidenti Bush miratoi një dokument që i njihje kompetenca të gjera CIA, një nga të cilat ishte krijimi i burgjeve sekrete jashtë SHBA, në bashkëpunim me qeveri aleate. Ky dokument parashikonte krijimin e «Programit të të Burgosurve me Vlerë të Lartë» (HVD), dhe «Programin e Dorëzimit për Burgosje për tu marrë në pyetje» (RDI), pra programin e rrëmbimeve. (shih Nasr dhe Galli § 172).

pastaj dërgohej në burgun e Guantanamo<sup>160</sup>. Karakteri problematik i kësaj situatë nga pikëpamja ligjore është analizuar me kujdes nga Gjykata e Apelit të Qarkut të 9 në SH.B.A. në vendimin e saj në lidhje me çështjen Falen Gherebi k. George Ëalker Bush<sup>161</sup>. Në atë vendim ajo Gjykatë i përshkroi në këtë mënyrë argumentet e qeverisë amerikane para saj: "*... Në bazë të teorisë së qeverisë, ajo është e lirë që të burgosë Gherebi për kohë të pacaktuar, së bashku me qindra shtetas të tjerë të vendeve të huaja, mes tyre shteteve mike, dhe të bëjë me Gherebi dhe këta të ndaluar, si të dojë, kur të dojë, pa respektuar asnjë rregull të asnjë ligji, pa e lejuar atë të këshillohet me avokat dhe pa pranuar asnjë forum gjyqësor që kontrollojë veprimet e saj. Në fakt, në argumentet me gojë, qeveria pranoi se ky do të ishte pozicioni i saj edhe në qoftë se do të ishin ngritur pretendime për përdorim të akteve të torturës ose për ekzekutime pa gjyq të të burgosurve. Në dijeninë tonë, përpara ndalimit aktual të të burgosurve në Guantanamo, qeveria amerikane nuk e kishte pohuar asnjëherë më parë një propozim kaq të rëndë dhe befasues. Prandaj, ne e shohim Guantanamo si unike, jo vetëm për shkak se marrëdhënia territoriale e Shteteve të Bashkuara me bazën është pa paralele sot, por edhe për shkak se është hera e parë që qeveria ka shpallur në lidhje me një grup kaq të jashtëzakonshëm parimesh - një pozicion kaq ekstrem se ajo ngre shqetësime të rënda në bazë të së drejtës amerikane dhe ndërkombëtare." I njëjti shqetësim është mbajtur edhe nga Gjykata e Apelit e Anglisë dhe Uellsit në çështjen Abbasi dhe një tjetër k. Ministrit të Jashtëm dhe Ministrit të Brendshëm, vendim i cituar gjithashtu në vendimin që po komentojmë, dhe ku kjo gjykatë e konsideron mbajtjen në Guantanamo të paditësit në atë çështje si arbitrare dhe burgun e Guantanamo si "vrimë e zezë ligjore"<sup>162</sup>.*

24. Ky debat nuk është mbyllur ende dhe pas këtij vendimi janë dhënë ndërkaq edhe tre vendime të tjera nga Gjykata në lidhje me të njëjtin fenomen, dhe dy vendime të tjera janë në pritje.<sup>163</sup> Një numër i konsiderueshëm dokumentesh që vërtetonin akuzat për trajtime të tilla, objekt i analizës së Gjykatës në këtë çështje, u bënë publike më vonë. Është një koincidence e çuditshme që po më 13 dhjetor 2012, ditën e bërjes publike të këtij vendimi të Gjykatës, Senatorja Amerikane Diane Feinstein, nga pozita e Kryetares së Komitetit të Senatit Amerikan mbi Shërbimet Sekrete, u shpreh: "*Unë besoj fort se krijimi i 'zonave të errëta' klandestine për një afat të gjatë dhe përdorimi i të ashtuquajturave 'teknika intensive të marrjes në pyetje' ishin gabime të tmerrshme. Shumica e Komitetit është dakord...". Ky Raport prej rreth 6000 faqesh iu dorëzua Presidentit Obama dhe në 3 prill 2014 përmbledhja e tij u bë publike.*

160 Shih Rezolutën 60/148 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Raportet Marty të A.P. të Këshillit të Evropës, të 12 qershor 2006 dhe 11 qershor 2007, raportin Fava të Parlamentit Evropian, të 30 janar 2007, Opinionin 363/2005 të Komisionit të Venecias, Raportin e Komitetit Special mbi Shërbimet Sekrete të Senatit Amerikan, bërë publik me 9 dhjetor 2014, etj.

161 United States Court of Appeals for the Ninth Circuit, Falen Gherebi v. George Ëalker Bush; Donald H. Rumsfeld, 352 F.3d 1278, 18 dhjetor 2003.

162 Court of Appeal of England and Ëales (Civil Division), Abbasi and Another v. Secretary of State for Foreign and Commonwealth Affairs and Secretary of State for the Home Department, [2002] EËCA Civ 1598, 6 November 2002.

163 Pas vendimit El-Masri kundër Republikës Ish-Jugosllave të Maqedonisë janë dhënë vendimet në çështjet *Al Nashiri kundër Polonisë*, *Abu Zubaydah kundër Polonisë dhe Nasr dhe Galli kundër Italisë*. Ndërkohë janë ende në shqyrtim e sipër çështjet *Al Nashiri kundër Rumanisë dhe Abu Zubaydah kundër Lituaniës*.

25. Së dyti, vendimi është i rëndësishëm jo vetëm për gjetjen njëzëri se FYROM ka shkelur Konventën, por për të theksuar të gjithë çështjen e mosndëshkimit në përgjithësi dhe të drejtën për të ditur të vërtetën në mënyrë të veçantë. Gjykata vuri në dukje rëndësinë e madhe të këtij rasti jo vetëm për aplikuesit, por edhe për viktimat e tjera të krimeve të ngjashme dhe në veçanti referuar të drejtën e publikut të gjerë për të ditur se çfarë kishte ndodhur në kontekstin e "të drejtës për të vërtetën". Gjyqtarët Tulkens, Spielmann, Sicilianos dhe Keller bashkëngjiten një mendim paralel. Ashtu si shumica, ata e panë atë si një të drejtë si për ankuesit ashtu edhe për publikun e gjerë. Megjithatë, duke iu referuar vendimit të Gjykatës në çështjen Shoqata "21 dhjetorit 1989" dhe të tjerë k. Rumanisë<sup>164</sup>, ata vlerësuan se "e drejta për të vërtetën" duhet të analizohet si aspekt i nenit 13 dhe jo thjesht si aspekt procedural nën nenet 2 ose 3. Gjyqtarët Casadevall dhe Lopez Guerra në mendimet e tyre të veçanta, dolën në kahun tjetër, duke konsideruar se ishte e drejta për të vërtetën për ankuesit e drejta që mbrohej nga Konventa, pavarësisht rëndësisë së rastit për publikun e gjerë. Edhe pse vendimi ka të bëjë me një problematikë shumë specifike, me atë të rrëmbimeve të jashtëligjshme, ai trajton më gjerë edhe sjelljen e hetuesve dhe prokurorëve që trajtojnë raste të tjera të rënda si këto, ose edhe raste të zhdukjes së personave, dhe ndeshen me një 'mur' të vendosur nga autoritetet që shpeshherë janë edhe të përfshira në këto ngjarje. Gjykata ishte mjaft kritike ndaj dështimit të organeve hetimore dhe të drejtësisë për të çuar përpara hetimet e nevojshme me pavarësinë e kërkuar, kur prokurori stepej për ndjekjen e mëtejshme të hetimeve nga reagimet e autoriteteve të cilat ishin të edhe komplikuara në ngjarje.

26. Aspekti i tretë për të cilin ky vendim paraqet një rëndësi të jashtëzakonshme lidhet me përcaktimin e fakteve. Në këtë çështje nuk kishte pasur asnjë vendim të ndonjë gjykate të brendshme që të kishte konstatuar faktet, të cilat natyrisht që ishin tepër komplekse sepse ishin tërësisht sekrete dhe përfshinin disa juridiksione nacionale. Në procedurën me shkrim dhe me gojë përpara Dhomës së Madhe një numër i konsiderueshëm palësh të treta paraqitën opinionet e tyre dhe Dhomës së Madhe iu paraqitën edhe raporte hetimore nga ana e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (Raporti Marty), dhe nga Parlamenti Evropian (Raporti Fava). Në çështjen e *Al Nashiri kundër Polonisë*, *Abu Zubaydah kundër Polonisë*, Dhoma përkatëse e Gjykatës që shqyrtoi atë çështje mori në pyetje në seanca të veçanta me dyer të mbyllura Senatorët Marty dhe Pinior dhe deputetin e PE, Fava. Kjo procedurë unike përpara Gjykatës lidhej pikërisht me vështirësi në përcaktimin e fakteve. Në këtë kuptim është tepër i rëndësishëm paragrafi 151 i vendimit ku Gjykata, duke bërë dallimin me teknikën përpara gjykatave të brendshme, shprehet se: *"Sipas jurisprudencës konstante të Gjykatës, prova mund të rezultojë nga bashkëzistenca e përfundimeve të forta të qarta dhe që përputhen, ose nga prezumime të ngjashme dhe të pakundërshtueshme faktike. Për më tepër, niveli i bindjes së nevojshme për të arritur një përfundim të caktuar, dhe në këtë kuptim, shpërndarja e barrës së provës, lidhen pazgjidhshmërisht me karakterin specifik të fakteve, me natyrën e pretendimeve të ngritura dhe me të drejtat e Konventës që janë në lojë."*

164 Vendim i 24 majit 2011.

## REHBOCK kundër SLLOVENISË

(nr. 29462/95)  
28 nëntor 2000

*shteteve iu bie barra e provës për të shpjeguar rrethanat e dëmtimeve të pësuar nga personat gjatë arrestimit ose paraburgimit dhe habeas corpus duhet të shpалosë të gjitha efektet e saj në raste të tilla*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Ernst Rehbock, shtetas gjerman, ka lindur në vitin 1959 dhe jeton në Gjermani. Më 8 shtator 1995 ai bashkë me një shoqen e tij kaloi kufirin mes Austrisë dhe Sllovenisë afër Sentilit dhe u arrestua po atë ditë nga policia sllovene në Dolič. Palët nuk bien dakord mbi rrethanat e arrestimit.

2. Sipas versionit të kërkuesit, ai e gjeti veten të rrethuar nga gjashtë burra të armatosur me një pushkë me tytë të shkurtër dhe pistoleta. Ata ishin të veshur me të zeza dhe mbanin maska të zeza. Ata e sulmuan kërkuesin pa paralajmërim. Kërkuesi u vu shpejt nën kontroll dhe nuk bëri asnjë përpjekje për të rezistuar. Pavarësisht nga britmat e tij në gjuhën gjermane dhe angleze se ai nuk do bonte rezistencë, ai u tërhoq mizorisht mbi anën e përparme të një makine dhe u prangos me duart mbrapa. Në të njëjtën kohë katër burra të tjerë e godisnin me grushta në kokë. Ai mori plagë të rënda në fytyrë dhe pati dhimbje të forta. Sipas versionit të Qeverisë kërkuesi ishte arrestuar në kontekstin e një operacioni kundër trafikut të drogës. Kur formuan ekipin policor, autoritetet mbajtën parasysh faktin se kërkuesi, të cilin ata dyshonin se tregtonte drogë, ishte jashtëzakonisht i fortë pasi kishte fituar disa herë kampionatin gjerman të *body building*. Një raport i përgatitur mbi rrethanat e arrestimit dhe që iu paraqit Gjykatës më 23 maj 2000, tregonte se kërkuesi dhe shoqja e tij u ndaluan nga policia kriminale e cila iu tha atyre të qëndronin pa lëvizur. Dy policë iu afruan kërkuesit për ta kontrolluar por ai nuk iu bind urdhrat dhe u përpoq të largohej. Policët u përpoqën ta vinin nën kontroll por kërkuesi vazhdonte të rezistonte. Duke parë rezistencën e tij policët e shtrinë atë përtokë midis makinave të parkuara. Në përlëshje e sipër kërkuesi u përplas me fytyrë në parakolpin e një makine dhe në pllakat e parkimit, ndërsa policët i vunë prangat. Një mjek që vizitoi z. Rehbock një ditë pas arrestimit diagnostikoi një thyerje të dyfishtë të nofullës dhe nxirje në fytyrë. Kërkuesi nuk pranoi t'i nënshtrohej një operacioni.

3. Kërkuesi u akuzua për kontrabandë të lëndëve narkotike dhe u mbajt në paraburgim. Kërkesa e tij e 3 tetorit 1995 për t' u liruar u hodh poshtë më 26 tetor 1995. Një tjetër kërkesë për lirim e parashtruar nga kërkuesi më 29 nëntor 1995

u hodh poshtë më 22 dhjetor 1995. Më 29 prill 1996, Gjykata e Lartë e Mariborit mbështeti vendimin e shkallës së parë duke e dënuar kërkuesin për veprat penale të kontrabandës së narkotikëve dhe e dënoi me 17 muaj burg.

4. Kërkuesi u ankua se trajtimi të cilit ai i ishte nënshtruar gjatë arrestimit dhe paraburgimit të tij në Slloveni ka qenë në kundërshtim me nenin 3. Në veçanti, ai pretendoi se atij nuk i ishte siguruar kujdesi i duhur mjekësor. Ai ankohej se nuk ka qenë në gjendje të ndër marrë procedurat që do vendosnin mbi ligjshmërinë e paraburgimit të tij siç kërkohet nga neni 5 § 4 dhe se e drejta e tij për kompensim, siç garantohet me nenin 5 § 5 ishte shkelur. Ai pretendoi gjithashtu shkelje të nenit 8 për shkak se korrespondenca e tij me Komisionin ishte monitoruar gjatë burgimit të tij në Slloveni.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me prapësimet paraprahe të qeverisë

5. Qeveria pretendoi se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme juridike siç kërkohet nga neni 35 § 1 të Konventës pasi ai nuk kishte bërë një kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese. Gjykata e hodhi poshtë njëzëri këtë prapësim, pasi nuk ishte ngritur para vendimit të Komisionit mbi pranueshmërinë e kërkesës.

6. Qeveria më tej pretendoi se Komisioni kishte shqyrtuar faktet e çështjes sipas nenit 5 § 4 dhe 5, pavarësisht faktit se kërkuesi nuk i kishte përdorur këto dispozita në kërkesën e tij. Gjykata e hodhi poshtë njëzëri edhe këtë prapësim pasi sipas jurisprudencës së saj ajo është e lirë t'i atribuojë një karakterizim të ri juridik fakteve të çështjes, karakterizim që siç provohet para saj, mund të jetë krejt i ndryshëm nga ai që i ka dhënë kërkuesi.

### B. Në lidhje me neni 3

7. Në rastin konkret, kërkuesi nuk u arrestua gjatë një operacioni të rastësishëm, i cili mund të shkaktonte zhvillime të papritura për të cilat policia mund të ishte e papërgatitur paraprakisht. Dokumentet para Gjykatës treguan se policia kishte planifikuar më parë operacionin e arrestimit dhe se ata kishin kohë të mjaftueshme për të vlerësuar rreziqet e mundshme dhe për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të kryer arrestimin. Për më tepër, kërkuesi nuk i kërcënoi policët që e arrestonin atë, për shembull, duke mbajtur armë në mënyrë të hapur ose duke i sulmuar ata. Në këtë sfond, duke pasur parasysh natyrën veçanërisht serioze të lëndimit të kërkuesit dhe duke vënë re se rrethanat e ngjarjes, për të cilat palët nuk binin dakord, nuk ishin konfirmuar nga ndonjë gjykatë kombëtare, barra e provës i binte Qeverisë për të provuar me argumente bindëse, se përdorimi i forcës në arrestimin e kërkuesit nuk kishte qenë i tepruar.

8. Pavarësisht përfundimeve të raportit të policisë mbi sjelljen e policisë gjatë arrestimit të kërkuesit të datës 8 mars 1996, të cilën Qeveria ia parashtrij Gjykatës



më 23 maj 2000, Gjykata vlerësoi se Qeveria nuk kishte ofruar argumente bindëse ose të besueshme që të shpjegonin ose justifikonin shkallën e forcës së përdorur gjatë arrestimit. Ajo arriti në përfundimin se forca e përdorur kishte qenë e tepruar dhe e pajustificuar në rrethanat konkrete të çështjes. Një përdorim i tillë i forcës shkaktoi dëmtime të cilat padyshim rezultuan në vuajtje të rënda për kërkuesin, të një natyre që përbënte trajtim çnjerëzor.

9. Përsa i përket keqtrajtimit të pretenduar të kërkuesit gjatë paraburgimit të tij, Gjykata gjeti se kërkuesi ishte vizituar rregullisht nga mjekët dhe se ai vetë kishte refuzuar t'i nënshtrohej një operacioni të rekomanduar nga specialistët. Për këto arsye ajo arriti në përfundimin se asnjë çështje e veçantë nën nenin 3 nuk ngrihej në këtë drejtim.

10. Gjykata më tej konsideroi se trajtimi të cilit kërkuesi i ishte nënshtuar në burg, domethënë dështimi i stafit të burgut për t'i dhënë atij ilaçe në disa raste, nuk ishte aq i rëndë për të arritur në përfundimin se e drejta e tij sipas nenit 3 në këtë aspekt ishte shkelur.

#### *C. Në lidhje me nenin 5 § 4*

11. Gjykata kujtoi se neni 5 § 4, i cili u njeht të ndaluarve të drejtën për të filluar procedurën për të kundërshtuar ligjshmërinë e heqjes së lirisë së tyre, shpall gjithashtu të drejtën e tyre, pas fillimit të kësaj procedure, për një vendim gjyqësor të shpejtë mbi ligjshmërinë e heqjes së lirisë dhe urdhërimin e ndërprerjes nëse ajo konsiderohet e paligjshme. Ajo konstatoi se afati prej 23 ditësh, që iu desh gjykatës kompetente për të shqyrtuar kërkesat e 3 tetorit 1995 dhe 29 nëntorit 1995 që kërkuesi bëri për t'u liruar, ishte i papajtueshëm me kërkesën e një shqyrtimi të shpejtë të kërkuar nga neni 5 § 4.

#### *D. Në lidhje me nenin 5 § 5*

12. Gjykata gjeti shkelje të nenit 5 § 5 meqë e drejta e kërkuesit për kompensim në lidhje me shkeljen e nenit 5 § 4 të Konventës të konstatuar nga Gjykata nuk garantohej aq qartë sa duhej nga ligji sloven.

#### *E. Në lidhje me nenin 8*

13. Gjykata konstatoi se monitorimi i korrespondencës së kërkuesit me Komisionin përbënte një ndërhyrje në të drejtat e tij sipas nenit 8 § 1. Ajo kujtoi se, që të mos jetë në kundërshtim me nenin 8, një ndërhyrje e tillë duhet të ndjekë një qëllim legjitim sipas paragrafit 2 dhe të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur këtë qëllim.

14. Ndërhyrja kishte një bazë ligjore, nenin 211 § 3 të Kodit të Procedurës Penale dhe mund të supozohet se ka ndjekur qëllimin legjitim të "parandalimit të trazirave ose krimin". Përsa i përket nevojës së ndërhyrjes, Gjykata vlerësoi se nuk kishte arsye bindëse për të monitoruar korrespondencën përkatëse duke pasur parasysh rëndësinë e respektimit të natyrës konfidenciale të kësaj



korrespondence. Ajo arriti në përfundimin se kjo ndërhyrje nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike në kuptim të nenit 8 § 2 dhe se, rrjedhimisht, kishte pasur shkelje të nenit 8.

#### F. Në lidhje me nenin 41

15. Gjatë vlerësimit të dëmit jomaterial të pësuar nga kërkuesi, Gjykata mori parasysh faktin që kërkuesi nuk kishte qenë i gatshëm t'i nënshtrohej ndërhyrjes mjekësore për gjendjen e tij në Slloveni pavarësisht sugjerimit nga mjekët specialistë. Ajo i akordoi kërkuesit 25 000 DEM. Përsa i përket kërkesave të kërkuesit për rimbursimin e shpenzimeve të tij, Gjykata e konsideronte të arsyeshme të japë 7 000 DEM, duke zbritur 17 098.12 FF që i ishin akorduar si ndihmë juridike nga Këshilli i Evropës. Gjykata hodhi poshtë pjesën e mbetur të kërkesave të kërkuesit për një shpërblim të drejtë.

### III. Koment

16. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT), i cili viziton të gjitha shtetet anëtare të Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës, shpesh vëren në raportet e veta se një nga momentet më kritike kur mund të ndodhin keqtrajtime janë gjatë arrestimit ose gjatë orëve të para të ndalimit. Për këtë arsye, KPT i kushton rëndësi të madhe të drejtës së një individi që të mund të takohet vetëm për vetëm me avokatin e tij që nga momenti i arrestimit të tij<sup>165</sup>. Shkeljet e nenit 3 dhe nenit 5 § 3 janë ngushtësisht të lidhura me njera tjetrën. Çuarja e një të arrestuari ose të ndaluarit menjëherë përpara një gjyqtari është gjithashtu pjesë e kërkesave të nenit 5 § 3 në mënyrë që të përcaktohet ligjshmëria e paraburgimit të tij. Por gjyqtari duhet të jetë në gjendje ta shohë fizikisht personin e ndaluar në mënyrë që vëmendja e tij të sillet në ndonjë abuzim fizik të mundshëm<sup>166</sup>. Përveç kontradiktave në versionet e paraqitura nga Qeveria, duket se elementi kritik që e bëri Gjykatën të anojë nga shkelja e nenit 3 në këtë çështje ka qenë pikërisht ky boshllëk. Qeveria paraqiti raporte të hartuara nga policia, të përgatitura pa marrë për bazë dëshmi ose prova objektive, dhe për më tepër, gjyqtari i gjykatës së Slovenj Gradec, i cili vendosi për masën e sigurisë me burg ndaj kërkuesit dhe që duhet t'i kishte parë plagët e tij, nuk u shpreh fare për dëmtimet që ai kishte pësuar. Asnjë autoritet tjetër gjyqësor nuk bëri ndonjë vlerësim mbi rrethanat e arrestimit<sup>167</sup>. Për më tepër Gjykata ka theksuar se në rastet kur konstatohen ose pretendohen keqtrajtime, sidomos nga personat që janë nën kontrollin e autoriteteve, neni 3 kërkon që këto të fundit të kryejnë një hetim efektiv dhe

165 shih, p.sh. Raportin e Komisionit Europian të të Drejtave të Njeriut në çështjen *Can kundër Austrisë*, dhe shih sidomos vendimet e Dhomës së Madhe të Gjykatës në çështjet *Salduz k. Turqisë* dhe *Ibrahim dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*.

166 Që është i lidhur me vetë llogjikën e nocionit juridik të *habeas corpus*, i cili figuron që në Magna Carta, e nënshkruar më 15.6.1215.

167 Kjo situatë mund të krahasohet me atë në çështjen *Klaas k. Gjermanisë*, vendim i 22.09.1993, série A no 269. Në atë çështje gjykatat gjermane i vlerësuan faktet pasi dëgjuan vetë palët dhe dëshmitarët, si dhe besueshmërinë e tyre, gjë që çoi në një drejtim të ndryshëm nga ai i çështjes që po komentojmë

të ndalojnë keqtrajtimet e mëtejshme<sup>168</sup>. Interesante është se Sllovenia u gjet në shkëlje të nenit 3 në rrethana shumë të ngjashme me këtë çështje në çështjen *Matko k. Sllovenisë*<sup>169</sup>.

17. Vendimi ka rëndësi për mesazhin e prerë dhe të qartë që Gjykata jep në lidhje me nenin 5 § 4, duke vlerësuar se një periudhë prej 23 ditësh për të shqyrtuar kërkesën e kërkuarit për t'u liruar nga paraburgimi nuk mund të konsiderohej si në përputhje me kriteret e një rishikimi të shpejtë sipas nenit 5 § 4<sup>170</sup>.

18. Vendimi është interesant edhe nën këndvështrimin e nenit 8. Megjithatë Gjykata vendos shkëlje të këtij neni mbi bazën e testit të nevojës së masës, mendoj se do të kishte qenë më e llogjikshme që shkëlja të gjendej mbi testin e qëllimit legjitim. E them këtë për arsye se më duket e vështirë që të pranohet si qëllim legjitim monitorimi i komunikimit me një organ ndërkombëtar, ose edhe kombëtar qoftë, që trajton një ankesë me pretendime për shkëlje të të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër argumenti i Qeverisë që, pas miratimit të një amendamenti të Kodit të Procedurës Penale në vitin 1998, korrespondenca ndërmjet personave të ndaluar dhe Gjykatës kishte pushuar së qeni e monitoruar, nuk mund të ndikonte në rastin në shqyrtim dhe Gjykata e hodhi poshtë.

## GÄFGEN kundër GJERMANISË

(kërkesa nr. 22978/05)

**1 qershor 2010**  
**Dhomë e Madhe**

*kjo çështje që lidhet me fakte tepër tragjike ka të bëjë me problemin juridik tepër kompleks të kërcënimit të përdorimit të torturës nga policia kur mendohet se interesa kardinale, si jeta e një fëmije, janë në rrezik, dhe të pasojave juridike që prodhon një kërcënim i tillë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuari, Magnus Gäfgen, është shtetas gjerman i cili ka lindur në vitin 1975. Ai mbahet aktualisht në një burg në Gjermani. Më 27 shtator 2002, kërkuari e kishte gënjyer J, që ishte djali 11 vjeçar i një familje bankierësh nga Frankfurti,

168 Shih për shembull *Asenov kundër Bullgarisë*, vendim i 28.10.1998, kërkesa nr. 24760/94.

169 Vendim i 2.11.2006, kërkesa nr. 43393/98. Është tepër interesant fakti që duke u frymëzuar pikërisht nga vendimi *Rehbock*, vetëm tre muaj pas vendimit *Matko*, Gjykata Kushtetuese Sllovene në vendimin UP-555/3, UP-827/4, që kishte të bënte me vdekjen e një të dyshuari kur policia shkoi t'i kontrollonte shtëpinë, vendosi se sistemi ligjor slloven nuk lejonte për një vlerësim të pavarur të rrethanave të keqtrajtimit ose dëmtimeve të pësuar gjatë arrestit ose ndalimit.

170 Shih nenin 249 "Ankimi kundër masave të sigurimit" të KPP si dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 9.3.1999

të cilin ai e njihte nga e motra e tij. Kërkuesi e kishte ftuar J. në apartamentin e tij dhe e kishte mbytur duke i zënë frymën dhe pastaj kishte fshehur kufomën. Më pas, kërkuesi depozituar një kërkesë shpërblim në shtëpinë e prindërve të J., duke iu kërkuar që të paguanin një milion euro për ta parë përsëri fëmijën e tyre. Më 30 shtator 2002 z. Gäfgen mori shpërblimin e kërkuar në një stacion tramvaji. Ai u vu nën mbikëqyrjen e policisë dhe u arrestua nga policia disa orë më vonë. Më 1 tetor 2002, një nga oficerët e policisë, përgjegjës për marrjen në pyetje të z. Gäfgen, nën udhëzimet e Zëvendës Shefit të Policisë së Frankfurtit, e paralajmëroi kërkuesin se ai do të përballej me vuajtje të konsiderueshme në qoftë se këmbëngulte në refuzimin për të treguar vendndodhjen e fëmijës. Duke menduar se J. ishte ende gjallë, policia vlerësoi se kërcënimi ishte e nevojshëm përderisa jeta J. ishte në rrezik të madh nga mungesa e ushqimit dhe i ftohti. Si rezultat i këtyre kërcënimeve, kërkuesi zbuloi ku e kishte fshehur trupin e J. Pas këtij rrëfimi, policia shkoi në vendin e treguar dhe siguroi prova të mëtejshme, sidomos kufomën dhe gjurmët e gomave të makinës së kërkuesit në baltë.

2. Në fillim të procesit penal kundër kërkuesit, gjykata rajonale e Frankfurtit në një procedurë paraprake vendosi që jo të gjitha rrëfimet e tij të bëra gjatë hetimeve mund të përdoret si provë në gjykim përderisa ishin marrë nën shtrëngim, në shkellje të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3 të KEDNJ. Ajo madje vendosi se kërcënimet dhe presionet ndaj kërkuesit kishin shkelur nenin 136 a) të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 3 të KEDNJ. Megjithatë, gjykata rajonale lejoi përdorimin në procesin penal të provave materiale të marra si rezultat i deklaratave të nxjerra nga kërkuesit nën shtrëngim. Më 28 korrik 2003 kërkuesi u shpall fajtor për rrëmbimin dhe vrasjen e J. dhe u dënua me burgim të përjetshëm. Gjykata gjermane vlerësoi se krimi i tij ishte i një ashpërsie të veçantë, dhe prandaj ai do të mund të lirohej me kusht vetëm pas 15 vitesh burg. Ajo u shpreh se, pavarësisht nga fakti se kërkuesi ishte informuar në fillim të gjyqit të tij për të drejtën e tij për të heshtur dhe se të gjitha deklaratat e tij të mëparshme nuk mund të përdoren si provë kundër tij, ai megjithatë përsëri pranoi se ai kishte rrëmbyer dhe vrarë J. Konstatimet e gjykatës rajonale gjermane në lidhje faktet janë të bazuara kryesisht në këtë rrëfim. Gjykata u mbështet edhe në provat e siguruar si rezultat i rrëfimit të parë të kërkuesit, përkatësisht raportin e autopsisë dhe gjurmët e gomave në baltë dhe në prova të tjera të marra si rezultat i ndjekjes së kërkuesit pasi ai kishte marrë paratë, të zbuluara më vonë në banesën e tij ose të derdhura në llogaritë e tij.

3. Kërkuesi depozitoi një padi mbi pikat e ligjit në Gjykatën Federale të Drejtësisë e cila e hodhi poshtë atë. Ai më pas bëri një kërkesë në Gjykatën Federale Kushtetuese, e cila e konsideroi kërkesën të papranueshme. Gjykata Federale Kushtetuese konfirmoi vlerësimin e e gjykatës rajonale të Frankfurtit që kërcënimi i kërkuesit me ushtrim dhune në mënyrë që të tregonte përbënte një metodë të ndaluar të marrjes në pyetje në bazë të legjislacionit të brendshëm dhe ka shkelur nenin 3 të Konventës. Megjithatë ajo arriti në përfundimin se ky konstatim i kishte dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit dhe një konstatim

i tillë nuk nënkuptonte që procedura penale ndaj tij duhet të pushohej. Më 20 dhjetor 2004 dy policët e përfshirë në kërcënimin e kërkuesit u gjetën fajtorë për shtrëngim dhe nxitje të shtrëngimit gjatë ushtrimit të detyrës dhe u dënuan me gjobë me kusht. Në dhjetor 2005, kërkuesi kërkoi ndihmë ligjore në mënyrë që të niste procedurat për shpërblim dëmi ndaj Landit të Hesen për shkak të traumave të pësuar nga metodat hetimore të policisë. Këto procedura ishin në vijim e sipër kur Gjykata e Strasburgut dha vendimin e mëposhtëm.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesi u ankua se i ishte nënshtruar torturës kur u mor në pyetje nga policia, në shkelje të nenit 3. Duke u bazuar në nenin 6, ai pretendoi gjithashtu se e drejta e tij për gjykim të drejtë ishte shkelur në mënyrë të veçantë me përdorimin e provave të siguruara si rezultati i rrëfimeve të tij të marra nën shtrëngim. Në gjykimin e 30 qershorit 2008 një Dhomë e Seksionit V konstatoi se nuk ka pasur shkelje të neneve 3 dhe 6 të Konventës. Më 1 dhjetor 2008, çështja iu kalua Dhomës së Madhe nga Paneli, pas kërkesës së kërkuesit.

### A. Në lidhje me nenin 3

5. Gjykata konsideroi se në rastin konkret kërcënimet ndaj kërkuesit me qëllim nxjerrjen e informacionit prej tij ishin mjaft serioze për t'u kualifikuar si trajtim çnjerëzor dhe përfshiheshin brenda sferës së veprimit të nenit 3. Gjykata ishte e kënaqur që gjykatat gjermane, si në procedurën penale kundër kërkuesit edhe në atë kundër oficerëve të policisë, pranuan shprehimisht dhe në mënyrë të qartë se marrja në pyetje e kërkuesit kishte shkelur nenin 3. Ajo vuri re, megjithatë, që policët, pasi ishin gjetur fajtorë, respektivisht për shtrëngim dhe nxitje të shtrëngimit gjatë ushtrimit të detyrës, u dënuan me sanksione tepër modeste, me gjobë me kusht.

6. Për sa i përket kompensimit për të korrigjuar shkeljen e Konventës, Gjykata vërejtë se kërkesa e kërkuesit për ndihmë juridike për padi për shpërblim dëmi ndaj Landit të Hesse, është në shqyrtim prej më shumë se tre vjetësh dhe se nuk ishte marrë ende asnjë vendim mbi themelin e kësaj kerkese. Dështimi i gjykatave të brendshme për të vendosur mbi meritat e padisë ngre dyshime serioze për efikasitetin e procedurës për shpërblim dëmi ndaj autoritetit publik. Për këtë arsye Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet gjermane nuk i kishin ofruar kërkuesit një shpërblim të mjaftueshëm për trajtimin e pësuar dhe prandaj Gjermania kishte shkelur nenin 3.

### B. Në lidhje me nenin 6

7. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se përdorimi i provave të marra nga metoda që janë në shkelje të nenit 3 ngre çështje serioze në lidhje me drejtësinë e procedurës penale. Në këtë kuadër, ajo duhet të përcaktonte nëse procedurat kundër kërkuesit, në tërësinë e tyre, kanë qenë të padrejta për shkak të përdorimit të provave të tilla në procesin kundër tij. Në rastin në fjalë, ishte

rrëfimi i ri i kërkuesit gjatë seancave gjyqësore - pasi ishte informuar se të gjitha deklaratat e tij të mëparshme nuk mund të përdroreshin si prova kundër tij - që kishte përbërë bazën për gjetjen fajtor dhe dënimin e tij. Gjykata konstatoi se dëshmitë e tij të mëparshme nuk kishin qenë pra të nevojshme për të gjetur atë fajtor dhe për të caktuar dënimin e tij. Në dritën e këtyre konsideratave, Gjykata konstatoi se, në rrethanat e veçanta të rastit, dështimi i gjykatave vendase për të përjashtuar provat e kundërshtuara, të siguruar pas një deklaratë të nxjerrë me anë të trajtimit çnjerëzor, nuk ka pasur një ndikim në gjetjen fajtor dhe dënimin e kërkuesit. Të drejtat e mbrojtjes e kërkuesit ishin respektuar, dhe procesi ndaj tij, në tërësi, duhet konsideruar se ka qenë i drejtë. Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 6.

### C. Në lidhje me nenin 41

8. Kërkuesi nuk kërkoi asnjë shpërblim për dëmin pasuror ose jopasuror, por theksoi se qëllimi i kërkesës së tij në Strasburg ishte për të rifitonte një rigjykim të çështjes në Gjermani. Përderisa nuk gjeti shkelje të nenit 6, Gjykata konsideroi se nuk kishte arsye që të sugjerohej rigjykimi ose rihapja e çështjes së kërkuesit para gjykatave të brendshme.

### III. Koment

9. Skenari tronditës që çoi në sjelljen e këtij rasti në Dhomen e Madhe të Gjykatës së Strasburgut, shpaloste një sërë elementësh tepër kompleksë juridikë të cilët duhet të merrnin përgjigje në Strasburg. Komentin e kësaj çështje shumë të debatuar dhe të komentuar edhe në doktrinë po e ndajmë sipas dy neneve që u ngritën nga kërkuesi, përkatësisht nenet 3 dhe 6 të Konventës. Në lidhje me të dy këta nene vendimi paraqet një rëndësi kardinale.

10. Përsa i përket nenit 3 vlen të kujtohet se Gjykata e gjen me vend në një çështje të tillë të konfirmojë karakterin absolut të nenit 3. Ajo shprehet se: "*Ndalimi i keqtrajtimit të një personi zbatohet pavarësisht nga sjellja e viktimës ose arsyet e autoriteteve. Tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues nuk mund të shkaktohet as në rrethanat ku jeta e një individi është në rrezik. Asnjë përjashtim nuk lejohet as në rastin e një emergjencë publike që kërcënon jetën e kombit. Neni 3, i cili ka hartuar në terma të qartë, pranon se çdo qenie njerëzore ka një të drejtë absolute dhe të patjetërsueshme që të mos i nënshtrohet torturës ose trajtimit çnjerëzor ose degradues nën asnjë rrethanë, madje edhe në ato më të vështira. Baza filozofike që mbështet natyrën absolute të së drejtës sipas nenit 3 nuk lejon asnjë përjashtim apo faktor justifikues ose balancim të interesave, pavarësisht nga sjellja e personit në fjalë dhe të natyrës së veprës në fjalë.*"<sup>171</sup> Ky është një obiter tepër i rëndësishëm që përfshkruan themelin konceptual të ndalimit të torturës dhe trajtimeve çnjerëzore apo degraduese<sup>172</sup>.

171 Shih paragrafin 107 të vendimit.

172 Shih gjithashtu *Selmouni k. Francës* [DHM], nr. 25803/94, ECHR 1999-V, *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, 15.11.1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-V, *V. k. Mbretërisë së Bashkuar*



11. Pas këtij konfirmimi vlera e vendimit në lidhje me nenin 3 është e dyfishtë. Së pari pyetja që shtrohej përpara Gjykatës, e cila ishte një pyetje me rëndësi sa ligjore aq edhe filozofike dhe sociologjike, ishte nëse trajtimi që kishte pësuar kërkuesi, që ishte kërcënimi për ushtrim torture por jo ushtrimi i torturës, e cila nuk ishte materializuar, arrinte nivelin minimal të kërkuar që trajtimi të përfshihet në fushën e veprimit të nenit 3. Pra cili është cilësimi juridik i kërrij trajtimi për qëllimet e nenit 3? Gjykata konfirmoi se kërcënimi për ushtrim torture mund t'i shkaktojë personit frikë, ankth dhe vuajtje mendore të konsiderueshme aq sa të binin në fushën e veprimit të nenit 3. Gjykata pranoi, duke iu referuar edhe jurisprudencës së saj si dhe praktikës ndërkombëtare, se teorikisht, kërcënimi për ushtrim torture mund të arrinte të përbënte torturë<sup>173</sup>. Megjithatë, pasi analizoi me kujdes faktet dhe rrethanat e çështjes në fjalë, dhe duke vënë si kriter përshkallëzues nivelin e intensitetit të dhunës, ajo arriti në përfundimin se në rastin konkret nuk kishte pasur torture por vetëm trajtim çnjerëzor të ndaluar nga neni 3.

12. Aspekti i dytë i rëndësishëm nën nenin 3 është ai në lidhje me statusin e viktimës së kërkuesit. Siç e thamë më lart, gjykata rajonale e Frankfurtit kishte pranuar se në rastin e kërkuesit kishte pasur shkelje të nenit 136 a) të Kodit të Procedurës Penale gjermane dhe nenin 3 të KEDNJ. Një përfundim i tillë ishte konfirmuar edhe nga Gjykata Federale Kushtetuese. Për më tepër autorët e keqtrajtimit ishin ndëshkuar. Atëhere pyetja është çfarë mund të merrte më shumë kërkuesi në Strasburg? Gjykata kujton se një vendim ose masë në favor të kërkuesit nuk është, në parim, e mjaftueshme për ta privuar atë nga statusi i "viktimës" për qëllimet e nenit 34 të Konventës, përveçse kur autoritetet kombëtare kanë pranuar, shprehimisht ose në thelb shkeljen, dhe më pas i kanë ofruar zgjidhje për shkeljen e Konventës. Që shkelja e nenit 3 të vihet në vend në nivel nacional, Gjykata ka thënë se duhet që të kryhet gjithashtu një hetim i plotë i rrethanave<sup>174</sup>, që viktima të marrë një dëmshpërblim adekuat<sup>175</sup>, dhe, veçanërisht në rastet e trajtimeve të qëllimshme duhet gjithashtu që personat përgjegjës të ndëshkohen<sup>176</sup>. Duke vënë re se ndëshkimet e dy policëve ishin tepër modeste, madje njëri prej tyre ishte promovuar më vonë, dhe se procedurat për dëmshpërblimin e kërkuesit ishin zvarritur së tepërmi, Gjykata vendosi se kërkuesi mund të konsiderohej ende viktimë. Duke pasur parasysh trajtimin e pësuar Gjykata vendosi për pasojë se kishte shkelje të nenit 3.

---

[DHM], nr. 24888/94, ECHR 1999-IX; *Labita k. Italisë*, [DHM], nr. 26772/95, ECHR 2000-IV, *Ramirez Sanchez v. Francës* [DHM], nr. 59450/00, ECHR 2006-IX; *Saadi k. Italisë* [DHM], nr. 37201/06, ECHR 2008.

173 Shih *çështjen Greke*, raporti i Kom.EDNJ i 5.11.1969, (1969) 12 Yearbook 170, p. 461, *Akkoç k. Turqisë*, nr. 22947/93 dhe 22948/93, ECHR 2000-X, *Campbell dhe Cosans k. Mbretërisë së Bashkuar*, 25.02.1982, Seria A nr. 48. Shih gjithashtu opinionin e Komitetit të OKB për të Drejtat e Njeriut të 29.03.1983 në rastin *Estrella kundër Uruguait*, nr. 74/1980.

174 Shih *Krastanov k. Bullgarisë*, nr. 50222/99, 30.09.2004, *Matko v. Slovenia*, nr. 43393/98, 2.11.2006, dhe *Çamdereli k. Turqisë*, nr. 28433/02, 17.07.2008;

175 Shih sidomos *Vladimir Romanov v. Russia*, nr. 41461/02, 24.07.2008.

176 Shih ndër shumë raste të tjerë, *Nikolova and Velichkova v. Bulgaria*, nr. 7888/03, 20.12.2007 *Ali and Ayşe Duran v. Turkey*, nr. 42942/02, 8.04.2008 dhe *Çamdereli*, të përmendur më lart.



13. Shqyrtimi i kësaj çështje në bazë të nenit 6 ngrinte gjithashtu probleme tepër komplekse ligjore, morale dhe filozofike. Debati kryesor konsistonte në atë që quhej rregullli përjashtues i provave në procesin penal<sup>177</sup>. Sipas Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane: "*Në rastin në fjalë, gjykatat penale kanë gjetur se metodat e hetimit të përdorura nga policia ishin të ndaluara<sup>178</sup>, por dallonin nga kërkuesi përse i përket pasojave ligjore që rrjedhin nga ky konstatim. Ata kishin mbajtur qëndrimin se deklaratat e marra si rezultat i masave në fjalë nuk mund të përdreshin, por nuk kishte asnjë pengesë për ndjekjen e procedurave penale specifike.*" Gjithashtu, thelbi i debatit ishte nëse në këto procedura penale mund të përdreshin provat materiale që ishin përfutur si rezultat i deklarateve të marra nën shtrëngim<sup>179</sup>. Shumica në Strasburg e pranuan këtë interpretim, sidomos duke bërë një analizë holistike të procesit ndaj kërkuesit. Ata menduan se mospërjashtimi i këtyre provave materiale në fund të fundit nuk ndikoi në dënimin e kërkuesit pasi provat e tjera, si skema e rrëmbimit apo paratë që iu gjetën do kishin mjaftuar si prova. Ky përfundim duhet krahasuar me atë të arritur nga Dhoma e Madhe në Jalloh<sup>180</sup>, ku Gjykata u shpreh se "...edhe nëse nuk kishte qenë qëllimi i autoriteteve për t'i shkaktuar dhimbje dhe vuajtje kërkuesit, gjithsesi dëshmitë u siguruan nga një masë që shkeli një nga të drejtat themelore të garantuara nga Konventa. Për më tepër, medikamentet e marra nga kjo masë përbënin provën vendimtare për gjetjen fajtor të kërkuesit. Së fundi, interesi publik në sigurimin e dënimit të kërkuesit nuk mund të justifikonte që provat e marra në këtë mënyrë që të përdoren në gjykim. Rrjedhimisht, përdorimi si provë i drogave të përfutura nga administrimi i dhunshëm i emetikëve kërkuesit, e kishte bërë procesin në ngarkim të tij në tërësi të padrejtë."

#### 14. Megjithatë 6 gjyqtarë<sup>181</sup> ndër të cilët edhe komentuesi i këtij vendimi, mbajtën

177 Shih Kodin shqiptar të Procedurës Penale, neni 38 "Rregulla të përgjithshme për marrjen në pyetje" parashikon:

"1. I pandehuri, edhe kur është me masë sigurimi izoluese ose kur i është hequr liria për çdo lloj shkakut tjetër, merret në pyetje i lirë, përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të dhunës.

2. Nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e të pandehurit, metoda ose teknika për të ndikuar mbi lirinë e vullnetit ose për të ndryshuar aftësinë e kujtesës e të vlerësimit të fakteve.

3. Para se të ketë filluar pyetja, të pandehurit i shpjegohet se ka të drejtë të mos përgjigjet dhe se edhe po të mos përgjigjet, procedimi do të vazhdojë."

Kurse neni 151 "Marrja e provave" parashikon:

1. Gjatë hetimeve paraprake provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.

2. Në gjykim provat merren me kërkesën e palëve. Gjykata vendos me urdhër, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme. Disponimet mbi marrjen e provave mund të revokohen në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor.

3. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj.

4. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit."

178 Ajo që në të drejtën procedurale gjermane quhet "*fortëirkung*" dhe rregullohet nga neni 136 a i KPP.

179 Ajo që quhet "*fruti i pemës së kalbur*". Në gjermanisht "*fernëirkung*". Shih gjithashtu jurisprudencën e Gjykatës Supreme të SH.B.A. që nga, *mutatis mutandis* *Miranda k. Arizona*, 384 U.S. 436 (1966), deri tek *Nix v. Èilliams*, 467 U.S. 431 (1984), *Segura v. United States*, 468 U.S. 796 (1984), *Herring v. United States*, 555 U.S. ... (2009), part II. A.

180 *Jalloh k. Gjermanisë*, nr. 54810/00, vendim i 11.07.2006.

181 Shih mendimin e pakicës të gjyqtarëve Rozakis, Tulkens, Jebens, Ziemele, Bianku dhe Poëer.

qëndrimin se shumica kishte humbur një rast të shkëlqyer për të mbajtur një qëndrim të fortë i cili do të ofronte në fakt një mbrojtje absolute nga trajtimet në kundërshtim me nenin 3. Ata u shprehën se, nëse provat e tjera mjaftonin për gjetjen fajtor të kërkuesit, aq më tepër gjykatat gjermane duhet t'i kishin përjashtuar provat e debatueshme nga procesi penal. Prandaj edhe ata votuan për shkelje të neneve 6 § 1 dhe 3 të Konventës<sup>182</sup>.

## VAN DER VEN kundër HOLANDËS DHE LORSÉ DHE TË TJERË kundër HOLANDËS

(kërkesat nr. 50901/99 dhe 52750/99)

**4 shkurt 2003**

*kjo çështje ka të bëjë me trajtimin e të burgosurve në një burg të sigurisë së lartë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, të gjithë shtetas holandezë, janë z. Van der Ven, lindur më 1949, z. Lorsé, lindur më 1945, bashkëshortja e këtij të fundit, tre fëmijët e tyre dhe katër fëmijë të tij të lindur nga marrëdhënie të tij të mëparshme.

2. Çështjet kishin të bënin me trajtimin e z. Van der Ven dhe z. Lorsé kur ata mbaheshin në një burg të sigurisë së lartë (të quajtur EBI – *Extra Beveiligde Inrichting*) në Holandë. z. Van der Ven ishte arrestuar më 11 shtator 1995 dhe më 29 tetor 1997 u transferua në EBI. z. Lorsé u ndalua nga policia më 24 korrik 1994 dhe pastaj u kalua në gjendje arresti. Më 27 shtator 1994 ai u mbajt në një EBI të përkohshëm dhe pas 30 qershorit 1998 në transferua në një EBI tjetër.

3. Kërkuesit ankoreshin për mënyrën e trajtimit në EBI. Ndërmjet të tjerash vizitat përgjithësisht lejoheshin vetëm me një ndarje xhami ndërmjet të tyre dhe vizitorëve. Vizitat pa një ndarje të tillë (vizitat e hapura) lejoheshin vetëm një herë në muaj me bashkëshortet, të afërmit dhe fëmijët dhe i vetmi kontakt fizik ishte një e dhënë dore në fillim dhe fund të takimit. Personat që mbaheshin aty zhvisheshin për kontroll si përpara “vizitave të hapura” ashtu edhe për vizitat

---

Bashkë me koleget Tulkens dhe Ziemele mbajta qëndrimin se në rastin konkret përjashtimi i provave të gjetura si pasojë e deklaratave të marra nën shtrëngim do të ishte madje forma më e mirë për të vënë në vend shkeljen e nenit 3 të Konventës. Gjykata do ta hidhte hapin vendimtar në këtë drejtim në vendimin *Othman (Abu Qatada) k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8139/09, 17.01.2012, i përfshirë në këtë botim. Shih gjithashtu vendimet e Gjykatës Supreme të SHBA *Blackburn k. Alabama*, 361 U.S. 199, (1960) dhe *Toënsend k. Sain*, 372 U.S. 293 (1963).

182 Krahajo gjithashtu me vendimin *Kaçiu dhe Kotorri k. Shqipërisë*, nr. 33192/07 dhe 33194/07, 25.06.2013, i përfshirë në këtë botim.

e tyre në klinikë, tek berberi apo dentisti si dhe i nënshtroheshin kontrolleve të tilla një herë në javë, përfshirë edhe një kontroll anal, edhe atëherë kur ata nuk kishin pasur kontakte me botën e jashtme gjatë javës. Kërkuesit pretendonin se ky regjim kishte një efekt negativ në stabilitetin e tyre psikologjik, gjë e cila u konfirmua edhe nga raporte psikologjike.

4. Procesi penal kundër z. Van der Ven, i cili akuzohej për veprat penale si vrasje me paramendim, vrasje pa paramendim, plagosje të rëndë, përdhunim dhe përdorim e shpërndarje droge përfundoi më 26 mars 2002. Ai u dënua me 15 vjet burg. z. Lorsé u dënua për përdorim dhe shpërndarje droge si dhe armëmbajtje pa leje me 15 vjet burg dhe me gjobë. U vërtetua gjithashtu që ai kishte qenë dënuar edhe në Belgjikë me gjashtë vjet burg për vepra penale që kishin të bënin me drogën por procesi në apel nuk ishte mbyllur akoma.

5. Kërkuesit pretendonin se regjimi të cilit i nënshtroheshin z. Van der Ven dhe z. Lorsé në burgun e sigurisë së lartë përbënte shkelje të Neneve 3 dhe 8 të Konventës. Kërkuesit në çështjen Lorsé dhe të tjerë pretendonin gjithashtu shkelje të nenit 13.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

6. Kërkuesit ishin mbyllur në një EBI për shkak se ata ishin konsideruar nga gjykatat vendase si persona që kishte mundësi të përpiqeshin të largoheshin në kushte paraburgimi më pak strikte, dhe për shkak se, në qoftë se arrinin të iknin, ata do të përbënin një rrezik të papranueshëm për shoqërinë duke u përpjekur të kryenin përsëri krime serioze. Duke pasur parasysh natyrën tepër serioze të veprave penale për të cilat kërkuesit ishin akuzuar e në vijim dënuar, Gjykata e Strasburgut e pranoi këtë vlerësim.

7. Gjykata mori parasysh raportet psikologjike të paraqitura nga kërkuesit si dhe raportin nga Komiteti për Parandalimin e Torturës, pas një vizite që kishte bërë në kompleksin e burgjeve ku mbaheshin kërkuesit në nëntor 1997. Këto raporte arrinin në përfundimin se “regjimi që zbatohet në burgjet e sigurisë së lartë EBI qoftë edhe të përkohshme, mund të konsiderohej se arrinte deri në trajtim çnjerëzor. Nënshtrimi i të burgosurve të konsideruar si të rrezikshëm ndaj një regjimi të tillë mundet fare mirë t'i bënte ata edhe më të rrezikshëm”. Gjykata krijoi gjithashtu të njëjtin mendim, pra që gjendja në EBI ishte problematike dhe shqetësuese, veçanërisht kur të burgosurit mbaheshin aty për periudha të gjata kohe.

8. Gjykatës i bëri përshtypje fakti që kërkuesit i nënshtroheshin një kontrolli të imët trupor të përjavshëm përveç masave të tjera strikte të sigurisë brenda EBI. Duke pasur parasysh faktin që autoritetet holandeze ishin të ndërgjegjshme që kërkuesit kishin vështirësi serioze për tu përshtatur me këtë regjim dhe duke kujtuar që

asnjëherë gjatë qëndrimit të kërkuesve në EBI nuk u zbulua asgjë e dyshimtë gjatë kontrolleve trupore, Gjykata ishte e mendimit se justifikimi i kontrolleve të tilla sistematike ndaj kërkuesve kishte nevojë për më shumë argumente se ato që ishin paraqitur nga qeveria. Në kushtet e nënshtrimit ndaj një numri të madh masash kontrolli dhe në mungesë të nevojave bindëse për një siguri të tillë, Gjykata ishte e mendimit se zbatimi i një kontrolli javor trupor i zbatuar për një periudhë prej rreth tre vjet e gjysmë në rastin e z. Van der Ven, dhe më se gjashtë vjetësh në rastin e z. Lorsé, cenonte dinjitetin e tyre njerëzor dhe duhet t'i linte vend ndjenjave të ankthit dhe përlules të tilla që i fyenin dhe përçmonin ata. Për këto arsye Gjykata arriti në përfundimin se kombinimi i kontrolleve trupore me masa të tjera të rrepta sigurie në EBI arrinte deri në trajtim çnjerëzor dhe degradues ndaj z. Van der Van dhe z. Lorsé, në shkelje të nenit 3 të Konventës.

9. Ndërsa Gjykata pranoi se kushtet në të cilat kryheshin vizitat nga ana e kërkuesve të tjerë për z. Lorsé mund tu kishin shkaktuar atyre (të parëve) shqetësime emocionale, ajo vlerësoi se rrethanat e ankimuar nuk e arrinin nivelin minimal të trajtimit çnjerëzor dhe degradues në kuptimin e nenit 3 dhe se pra nuk ka pasur, në këtë vështrim, shkelje të këtij neni në lidhje me kërkuesit e tjerë.

#### ***B. Në lidhje me nenin 8***

10. Duke konstatuar se kufizimet ndaj së drejtës së kërkuesve për respektim të jetës së tyre private dhe familjare nuk shkonin përtej asaj që ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur qëllimet e synuara legjitime, Gjykata nuk gjeti në këtë këndvështrim shkelje të nenit 8 në asnjërin prej rasteve.

#### ***C. Në lidhje me nenin 13 (vetëm për sa i përket çështjes Lorsé dhe të tjerë)***

11. Gjykata vuri re se vendimi për ta mbajtur z. Lorsé në EBI ishte rishikuar çdo gjashtë muaj dhe se ai kishte qenë në gjendje të ankohej ndaj vendimit të zgjatjes së paraburgimit të tij përpara Bordit të Apelit. Përveç kësaj, kërkuesit kishin pasur mundësi që të nisnin procedura gjyqësore për vlerësimin e përqasjes së një trajtimi të tillë me nenin 3 të Konventës. Gjykata vlerësoi se këto procedura të vlerësuara në tërësinë e tyre u ofronin kërkuesve një mjet efektiv. Për këtë arsye nuk ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

#### ***D. Në lidhje me nenin 41***

12. Gjykata i akordoi z. Van der Ven 3000 euro dhe z. Lorsé 453.78 euro për dëm jo-material. Ajo i akordoi gjithashtu z. Lorsé 2195 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

### **III. Koment**

13. Disa përmbledhje vendimesh të përfshira në këtë botim përmbajnë raste shkeljesh që ndodhin në burgje. Disa prej tyre kanë pasur të bëjnë me kushtet

e vështira në burgje<sup>183</sup>, disa të tjera për kufizimet ndaj të drejtave të tjera të parashikuara nga Konventa<sup>184</sup>.

14. Dy ankesat e sapotrajtuara kanë të bëjnë me një fenomen paksa të ndryshëm, konkretisht me atë të një regjimi të ashpër burgimi të parashikuar në Holandë për një grup të burgosurish në kushtet e izolimit të sigurisë maksimale. Vendimi i Gjykatës në të dyja rastet i kushtonte një rëndësi të veçantë Raporteve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) dhe rekomandimeve të tij. Ajo pranoi vlerësimin e shtetit për nevojën për një regjim tepër strikt, veçanërisht në kushtet kur kërkuesit kishin pasur mundësi ligjore për ta kundërshtuar nevojën për një regjim të tillë përpara gjykatave vendase. Çfarë Gjykata konstatoi të papranueshme lidhej me kontrollet trupore, përfshirë edhe kontrollet e pjesëve intime të trupit, të cilat bëheshin në mënyrë rutinë pa pasur një vlerësim rast pas rasti nga ana e autoriteteve, nëse vërtet rrethanat e kërkonin një gjë të tillë. Gjykata, në paragrafin 51 të vendimit të saj, vë në dukje se neni 3 i Konventës kërkon që një person të mbahet në kushte që respektojnë dinjitetin njerëzor dhe se mënyra dhe metoda e ekzekutimit të masave të sigurisë nuk e vënë atë në kushte stresi ose vuajtjesh të një intensiteti që e kapërcen nivelin e pashmangshëm të vuajtjeve të një burgimi. Ajo shton gjithashtu, duke pasur parasysh kushtet konkrete të burgimit, që shëndeti dhe mirëqenia e të burgosurve të sigurohen në një mënyrë të përshtatshme. Gjykata më parë ka pranuar se zhveshjet dhe kontrollet e imëta trupore nuk përbëjnë *ipso facto* shkelje të Konventës<sup>185</sup> me kusht që të justifikohet se çdo kontroll i tillë ka qenë tepër i nevojshëm për arsye të qarta të sigurisë. Duket se parimi i proporcionalitetit luan përsëri një rol të rëndësishëm në këto vlerësime të Gjykatës së Strasburgut.

183 Kujtojmë vendimet e Gjykatës të 19 prillit 2001 në lidhje me çështjen *Peers kundër Greqisë*, të 6 marsit 2001 në lidhje me çështjen *Dougoz kundër Greqisë*, të 15 korrikut 2002 në lidhje me çështjen *Kalashnikov kundër Federatës Ruse*, të 8 nëntorit 2002 në lidhje me çështjen *Benzan kundër Kroacisë*.

184 Kujtojmë në këtë kuadër vendimet e Gjykatës së 12 nëntorit 2002 në lidhje me çështjen *Ploski kundër Polonisë*, të 15 nëntorit 2001 në lidhje me çështjen *Iëanczuk kundër Polonisë*, të 14 nëntorit 2002 në lidhje me çështjen *Mouisiel kundër Francës*.

185 Vendimi i Gjykatës i 24 korrikut 2001 në lidhje me çështjen *Valasinas kundër Lituaniës*.

## DULAŞ kundër TURQISË

(kërkesa nr. 25801/94)

30 janar 2001

*një kontroll i dhunshëm i forcave speciale turke jo vetëm që mund të çojë në shkelje të jetës private dhe të së drejtës për pronën por edhe në trajtim çnjerëzor në rastin e një personi të moshuar*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Zubeyde Dulaş, shtetase turke, ka lindur më 1931 dhe jeton në Stamboll. Ajo pretendonte se më 8 nëntor 1993 ushtarë të Hazros bënë një kontroll në fshatin e saj të Çitlibahçesë dhe filluan të digjnin shtëpitë. Ata i vunë gjithashtu zjarrin edhe shtëpisë së saj. Banesa e saj, pajisjet, sendet, ushqimet dhe drithërat që ndodheshin brenda u dogjën. Ushtarët e shkatërruan fshatin plotësisht dhe fshatarët u detyruan që të largohen. Më 10 tetor 1995, znj. Dulaş u thirr në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe bëri një deklaratë në lidhje me kërkesën e saj drejtuar Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut.

2. Sipas qeverisë, operacioni në këtë rast kishte të bënte me një hetim në lidhje me rrëmbimin dhe vrasjen e mësuesve dhe të një imami nga ana e PKK. Pretendimet e kërkueses nga ana tjetër, e cila nuk ishte ankuar pranë autoriteteve turke, ishin të paqarta, kontradiktore dhe të pambështetura në prova.

3. Kërkuesja ankohej se shkatërrimi nga ana e ushtarëve të shtëpisë dhe i sendeve në pronësi të saj kishin shkelur të drejtën për respektim të jetës private dhe familjare të garantuar nga neni 8, si dhe të drejtën e saj të pronësisë të garantuar nga neni 1 i Protokollit 1. Ajo ankohej gjithashtu se ky trajtim kishte qenë aq serioz sa që arrinte deri në trajtim çnjerëzor dhe degradues që bie në kundërshtim me nenin 3 dhe se ajo nuk kishte pasur mundësi për një ankim efektiv, gjë që garantohej nga neni 13.

4. Ajo pretendonte gjithashtu se shkatërrimi i shtëpisë dhe i sendeve në pronësi të saj nxirrnin në pah ekzistencën e një praktike të autorizuar, e cila lejon kufizime të kushtëzuara nga arsye të tjera në të drejtat e garantuara nga Konventa, por që si praktikë bie në kundërshtim me nenin 18. Së fundi, ajo ankohej për një ndërhyrje në të drejtën e saj për të mos iu penguar e drejta për të bërë kërkesë në bazë të Konventës, e garantuar nga neni 25 i Konventës, për shkak se asaj i ishin bërë pyetje në lidhje me kërkesën e saj drejtuar Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut.



## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Vlerësimi i fakteve nga ana e Gjykatës

5. Gjykata vuri në dukje se Komisioni kishte proceduar me një seancë pyetjesh për dëshmitarët në këtë rast. Ajo i pranoi faktet që ishin konstatuar nga Komisioni. Në lidhje me këtë ajo nuk i gjen me vend argumentet e ngritura nga ana e qeverisë turke në lidhje me pretendimin se vlerësimi i fakteve nga ana e Komisionit nuk ishte në përputhje me parimet e pranuar për vlerësimin e provave sipas sistemit të Konventës. Pra u konstatua se forcat e sigurimit ishin përgjegjëse për shkatërrimin e shtëpisë dhe të të mirave të kërkueses dhe se humbja e tyre solli si pasojë largimin e saj nga fshati ku ajo kishte banuar deri atëherë dhe shpërnguljen në vend tjetër.

### B. Në lidhje me nenin 3

6. Gjykata konstatoi se shkatërrimi i shtëpisë dhe i të mirave të kërkueses nga ana e forcave të sigurimit arrinte deri në trajtim çnjerëzor i cili bie në kundërshtim me nenin 3. Ajo mbajti qëndrimin që, edhe në rrethanat më të vështira, si ato të luftës kundër terrorizmit dhe krimin, Konventa e ndalon në terma absolutë trajtimin që është në kundërshtim me këtë dispozitë. Duke pasur parasysh rrethanat në të cilat shtëpia dhe të mirat e kërkueses kanë qenë shkatërruar si dhe rrethanat personale të saj, Gjykata vlerësoi se shkatërrimi në fjalë duhet t'i ketë shkaktuar asaj vuajtje të një shkalle të tillë që veprimet e ankuara të konsiderohen si çnjerëzore.

### C. Në lidhje me nenin 8 dhe nenin 1 të Protokollit 1

7. Pasi konstatoi se forcat e sigurimit ishin përgjegjëse për shkatërrimin e shtëpisë dhe të sendeve në pronësi të kërkueses, Gjykata vendosi se ka shkelje të nenit 8 dhe nenit 1 të Protokollit 1.

### D. Në lidhje me nenin 13

8. Gjykata vuri në dukje se ndërsa kërkuësja nuk iu drejtuar asnjë autoriteti vendas me ankesat e saj përpara se ta dërgonte kërkesën e saj në Komision, duket se, pas njoftimit të kërkesës qeverisë, Prokurori e kishte thirrur kërkuësen e cila vazhdoi të pretendojë se ushtarët i kishin djegur shtëpinë. Prokurori nuk ndërmori asnjë hap për të hetuar më tej, por dha një vendim për jo-kompetencë dhe ia kaloi çështjen Këshillit Administrativ.

9. Duke u bazuar në çështje të mëparshme në të cilat kishte konstatuar se Këshilli Administrativ, si një organ i përbërë nga punonjës së shërbimit civil të varur nga ekzekutivi nuk mund të konsiderohet si i pavarur<sup>186</sup>, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte pasur një hetim të plotë dhe efektiv në lidhje me pretendimet e kërkueses. Pra asaj i është mohuar një ankim efektiv për pretendimet e saj në shkelje të nenit 13.

186 Shih vendimin e Gjykatës të 27 korrikut 1998 në lidhje me rastin *Güleç kundër Turqisë*.

**E. Në lidhje me nenin 18**

10. Duke pasur parasysh përfundimet e saj të lartpërmendura, Gjykata nuk e vlerësoi të nevojshme ta shqyrtonte këtë pretendim.

**F. Në lidhje me nenin 25 (aktualisht neni 34).**

11. Gjykata kujtoi se në raste të mëparshme kishte vendosur se pyetja e kërkuesve në lidhje me kërkesat e tyre nga ana e autoriteteve mund të përbëjë një formë të paligjshme dhe të papranueshme presioni, e cila pengon ushtrimin e së drejtës për kërkesa individuale duke shkelur kështu ish-nenin 25. Kërkuesi në këtë rast ishte pyetur mbi kërkesën e saj drejtuar Komisionit, dhe në veçanti në se ajo kishte qenë e mirëpërgatitur dhe nëse ajo synonte që të insistonte me kërkesën. Kjo gjë përbën një ndërhyrje të parregullt me të drejtën e saj për kërkesë individuale. Për pasojë, Gjykata vendosi që qeveria turke nuk ka vepruar në përputhje me angazhimet e saj në bazë të ish-nenit 25.

**G. Në lidhje me nenin 41**

12. Gjykata i akordoi kërkueses 12 600 sterlina britanike për dëm material dhe 10 000 sterlina britanike për dëm jo-material. Për shpenzime dhe pagesat procedurale ajo i akordoi 14 900 sterlina hequr shumën që i ishte akorduar për ndihmë ligjore nga Këshilli i Evropës.

**III. Koment**

13. Ky është i gjashti vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me shkatërrimin e shtëpive në jug-lindje të Turqisë nga ana e forcave të sigurimit. Në rastin në fjalë kërkuesja ishte më e vjetër se 70 vjeç dhe pa shtëpinë dhe sendet të pronësi të saj t'i shkatërroheshin përpara syve. Ky është rasti i parë në të cilin Gjykata konstatoi shkelje të nenit 3 në rrethana të tilla. Në konstatimin e shkeljes, Gjykata mbajti parasysh moshën e kërkueses si dhe faktin që ajo ishte privuar nga mundësitë për strehë dhe jetesë. Ajo iu referua gjithashtu faktit se asnjë hap nuk ishte marrë në vijim nga ana e autoriteteve për ta ndihmuar kërkuesen. Gjykata vendosi që kërkueses duhet t'i kenë qenë shkaktuar vuajtje të një mase të tillë sa të konsiderohen si trajtim çnjerëzor. Gjykata në përputhje me jurisprudencën e vet të mëparshme, konstatoi gjithashtu shkelje të nenit 8 të Konventës dhe të nenit 1 të Protokollit 1.

14. Ky vendim është gjithashtu i rëndësishëm në lidhje me çështjen e shterimit të ankimeve të brendshme. Ndërkohë që kërkuesja nuk ishte përpjekur që ta zgjidhte çështjen sipas rrugëve procedurale të brendshme në Turqi, Gjykata kujtoi jurisprudencën e saj të mëparshme në bazë të së cilës, megjithë përhapjen e problemit të shkatërrimit të fshatrave të jug-lindje të Turqisë nuk ka pasur raste të ndonjë rast kompensimi nga ana e autoriteteve në të shkuarën. Gjykata mbajti gjithashtu parasysh faktin që pasiguria dhe të dobësia e kërkueses mund ta kenë stepur atë për t'iu drejtuar autoriteteve pasi ajo kishte parë ushtarët që t'i shkatërronin shtëpinë.

15. Vendimi është gjithashtu domethënës për debatin në lidhje me të drejtën e kërkesës individuale në bazë të nenit 34 të Konventës. Kërkesja kishte qenë pyetur nga ana e prokurorit në lidhje me kërkesën e saj pasi kjo e kishte dërguar këtë në Strasburg. Gjykata nënvizoi faktin se kërkesit duhet të jenë të lirë që të komunikojnë me organet e Konventës pa iu nënshtruar ndonjë presioni, i cili mund të konsistojë fare mirë jo vetëm në veprime drejtpërdrejta penguese dhe haptazi friksuese por gjithashtu në veprime dhe kontakte indirekte që synojnë të dekurajojnë kërkesit për bërjen e kërkesës në Strasburg. Përderisa qeveria nuk mund të jepte arsye të qëndrueshme mbi pyetjet e prokurorit dhe Gjykata nuk u kënaq me argumentin se ato ishin thjesht për mbledhjen e informacioneve nga prokurori, kjo arriti në përfundimin se pyetjet përbënin ndërhyrje të pajustificueshme në të drejtën për kërkesë individuale të znj. Dulaş.

## KALASHNIKOV kundër RUSISË

(kërkesa nr. 47095/99)

15 korrik 2002

*kjo çështje ka të bëjë me kushtet dhe kohëzgjatjen e ndalimit të cilat, sipas Gjykatës, vinin në kundërshtim me garancitë e parashikuara nga Konventa*

### I. Faktet kryesore

1. Valeriy Yermilovich Kalashnikov, është shtetas rus i lindur më 1955 dhe jeton në Moskë. Në shkurt 1995, ndërkohë që ishte president i një banke, z. Kalashnikov u akuzua për mashtrim. Gjykata e Rrethit të Magadanit filloi ta shqyrtonte çështjen e tij në nëntor 1996, por shqyrtimi u shty nga maji 1997 për në prill 1999. Ai u dënua më 3 gusht 1999 dhe më 29 shtator 1999 çështja u mbyll. Më 30 shtator 1999 z. Kalashnikov u akuzua edhe për begatim pa shkak. Ai nuk u gjet fajtor për këtë akuzë dhe kjo çështje u mbyll në 31 mars 2000. Më 26 qershor 2000 ai i lirua nga burgu në vijim të një amnistie.

2. Nga 29 qershori 1995 deri më 20 tetor 1999 kërkesi u mbajt në një qendër ndalimi në qytetin e Magadanit. Pas dhënies së vendimit të 3 gushtit 1999 nga ana e Gjykatës së Rrethit, më 20 tetor 1999, ai u dërgua për të vuajtur dënimin e tij në burg. Më 9 dhjetor 1999 ai u transferua përsëri në qendrën e ndalimit të qytetit të Magadanit, ku ndenji deri sa u lirua më 26 qershor 2000.

3. Kërkesi ankohej në lidhje me kushtet në qendrën e ndalimit të Magadanit, ku ai përfshinte elementët e mëposhtëm.

- Qelia e tij ishte 17 m<sup>2</sup> dhe në të kishte tetë shtretër të dykatësh; pothuajse vazhdimisht në të mbaheshin 24 persona; kishte tre veta për çdo shtrat dhe flihej me turne; për më tepër ishte e pamundur të flihej sepse televizori dhe

- drita e qelisë nuk fikeshin kurrë;
- Personi që përdorte tualetin shihej nga të gjithë të mbyllurit në qeli po ashtu edhe nga rojet e burgut; një tryezë ngrënieje ishte vetëm një metër larg tualetit;
- Qelia nuk kishte ajrosje dhe ishte e tepër e nxehtë në verë dhe shumë e ftohtë në dimër; ajo ishte e mbushur me parazitë; gjithashtu, duke qenë i rrethuar me pirës të vazhdueshëm të duhanit, kërkuesi u detyrua të bëhej një pirës pasiv;
- Ai vuajti nga një shumëllojshmëri dhimbjesh të shpinës dhe infeksionesh nga myku, duke humbur thonjtë e gishtave të këmbëve dhe të duarve; gjatë procesit nga 11 nëntori 1996 deri më 23 prill 1997 dhe nga 15 prilli 1999 deri më 3 gusht 1999 ai pati mundësi të kurohej për zgjebe; në gjashtë raste në qelinë e tij u çuan persona me tuberkuloz ose sifiliz dhe kërkuesi detyrohej të bënte gjilpëra profilaktike me antibiotikë.

4. Duke iu referuar kartelës mjekësore të kërkuesit, gjatë periudhës së heqjes së lirisë së tij ai kishte vuajtur nga zgjebja, alergji lëkure, infeksione myku në duar dhe këmbë dhe mukozë. Një raport i lëshuar në korrik 1999 nga ekspertë mjekësorë deklaronte që kërkuesi po vuante nga disteni neuroqarkulluese, lodhje nervore, sëmundje kronike të stomakut dhe duodenit, si dhe infeksion nga myku.

5. Kërkuesi ankohej në lidhje me kushtet e mbajtjes së tij – duke u bazuar për këto pretendime në nenin 3 të Konventës – si dhe për faktin se paraburgimi dhe procedimi penal kundër tij kishin shkelur të drejtat që i garantonin nenet 5 § 3 dhe 6 § 1 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

6. Ndërmjet të tjerash, Gjykata vuri në dukje se në çdo kohë kishte vetëm 0.9 – 1.9 m<sup>2</sup> hapësirë për çdo person brenda qelisë ku mbahej kërkuesi. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajttimeve ose Dënimeve Çnjerëzore dhe Degraduese ka përcaktuar një sipërfaqe prej 7 m<sup>2</sup> për të burgosur si sipërfaqe të përshtatshme që do të ishte e preferueshme të ndiqej në një qeli. Pra qelia e kërkuesit ishte në vazhdimësi tepër e mbipopulluar - një gjendje që në vetvete ngrinte një çështje të nenit 3.

7. Duke pasur parasysh mbipopullimin e qelisë, personat që mbaheshin në të duhet të flinin me turne, me ndërresa tetë orësh dhe kushtet e fjetjes rëndoheshin edhe më tepër nga ndriçimi i vazhdueshëm i qelisë si dhe nga gjullurdia dhe zhurma e përgjithshme për shkak të numrit të madh të personave. Privimi i gjumit që vinte si pasojë, sipas mendimit të Gjykatës duhet të ketë qenë një barrë e rëndë fizike dhe psikologjike për kërkuesin.

8. Gjykata vlerësoi gjithashtu mungesën e ajrimit të përshtatshëm në qelinë e kërkuesit në të cilën kishte një numër të tepërt personash të cilët me sa dukej ishin lejuar edhe të pinin duhan. Ajo mbajti gjithashtu parasysh mbushjen e qelisë me parazitë, gjendjen e shkatërruar dhe të papastër të qelisë dhe të pjesës së tualetit, mungesën e plotë të një jete private brenda qelisë, faktin që gjatë gjithë heqjes së lirisë së tij kërkuesi vuajti nga dhimbje shpine dhe infeksione myku. Gjykata vuri më tej në dukje me një shqetësim të madh se kërkuesi here pas here ishte mbajtur në një qeli me të dënuar që vuanin nga sifilizi dhe tuberkulozi.

9. Ndërkohë që Gjykata vuri me kënaqësi përmirësimet themelore që dukeshin të ishin bërë në zonën e burgut të Magadan ku edhe mbahej kërkuesi, ajo nuk mund të mos i kushtonte vëmendje tërësisë së kushteve të papranueshme me të cilat kërkuesi është dashur të përballet në kohën e vuajtjes së dënimit.

10. Gjykata gjeti se kushtet në të cilat mbahej kërkuesi, duke mbajtur parasysh edhe kohëzgjatjen e mbajtjes së kërkuesit në këto kushte, arrinin të përbënin një trajtim degradues. Për pasojë ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

### ***B. Në lidhje me nenin 5 § 3***

11. Gjykata vuri në dukje se e gjithë periudha e paraburgimit të kërkuesit arrinte deri në katër vjet, një muaj dhe katër ditë. Megjithatë, përderisa periudha përpara 5 majit 1998 - data kur Konventa ka hyrë në fuqi në Rusi - ngelej jashtë juridiksionit të Gjykatës, mund të merrej për bazë vetëm periudha prej një viti dy muajsh dhe 29 ditësh, e ngelur nga ajo datë, deri kur Gjykata e Rrethit të Magadanit dha vendimin më 3 gusht 1999. Pavarësisht nga kjo Gjykata e mbajti parasysh faktin që deri më 5 maj 1998 kërkuesi kishte qenë në gjendje të heqjes së lirisë për 2 vjet, dhjetë muaj dhe gjashtë ditë, duke qenë se ishte ndaluar më 29 korrik 1995.

12. Gjykata kujtoi gjithashtu se ekzistenca e një dyshimi të fortë në lidhje me pjesëmarrjen e një personi në krime të rënda, pavarësisht se përbën një element me rëndësi, nuk mundet në vetvete të justifikojë një kohë të gjatë paraburgimi. Në lidhje me arsyet e tjera në të cilat u mbështet Gjykata e Rrethit të Magadan në zgjatjen e periudhës së paraburgimit të kërkuesit, dhe veçanërisht atë të rrezikut të pengimit të hetimit të çështjes, Gjykata vuri në dukje se Gjykata e rrethit nuk përmendi asnjë rrethanë faktike ku të mbështeste përfundimet e saj, të cilat ishin identike më 1996, 1997 dhe 1999. Nuk kishte asnjë referim në interpretimet e saj në asnjë faktor që të mund të tregonte që rreziku vazhdonte gjatë të gjithë periudhës në fjalë. Gjykata gjeti se arsyet në të cilat u mbështetën autoritetet, pavarësisht se fillimisht kishin rëndësi dhe mund të konsideroheshin të mjaftueshme, me kalimin e kohës pushuan së justifikuari mbajtjen e kërkuesit në gjendje paraburgimi.

13. Duke mbajtur parasysh hetimin dhe vonesat e konsiderueshme në procedimet gjyqësore, Gjykata vlerësoi se autoritetet nuk kishin vepruar me

gjithë zhdërvjelltësinë e duhur. Për këtë arsye Gjykata konstatoi se periudha që kërkuesi kaloi në gjendje paraburgimi e kalonte atë të “afatit të arsyeshëm” dhe pra ka pasur shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës.

### **C. Në lidhje me nenin 6 § 1**

14. Periudha në vlerësim e sipër – që nga 8 shkurti 1995 deri më 31 mars 2000 – arrinte në një total prej pesë vjetësh, një muaji dhe 23 ditësh, për vetëm një nivel juridiksional, pavarësisht nga procedurat e shumta anësore në lidhje me çështjen. Por përderisa juridiksioni i saj mbulonte periudhën pas 5 majit 1998, Gjykata vuri në dukje se ajo mund të merrte parasysh vetëm situatën procedurale që ekzistonte në këtë datë.

15. Gjykata vlerësoi se autoritetet kishin dështuar në përmbushjen e detyrimit të tyre për zell të posaçëm, sidomos pas hyrjes në fuqi të Konventës pas 5 majit 1998. Për këtë arsye ajo vlerësoi se kohëzgjatja e procedurave nuk kënaqte kriterin e “afatit të arsyeshëm” dhe pra, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

### **D. Në lidhje me nenin 41**

16. Gjykata i akordoi kërkuesit 5 000 euro për dëm jo-material dhe 3 000 për shpenzime dhe pagesa.

## **III. Koment**

17. Ky vendim i rëndësishëm nxjerr në pah problemin e përdorimit të tepruar të paraburgimeve të gjata, gjë që ndodh në shumë prej vendeve të reja anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo ndërhyrje e papranueshme ndaj së drejtës së lirisë, shkel Konventën edhe kur kushtet e mbajtjes së personit të ndaluar janë “komode”.

18. Siç e ka thënë edhe vetë Gjykata në çështjet Dougoz kundër Greqisë, të 6 marsit 2001<sup>187</sup> dhe Peers kundër Greqisë, të 19 prillit 2001<sup>188</sup>, kur kushtet në burgje janë aq të këqija sa çojnë në shkelje të nenit 3, edhe vetë përdorimi i paraburgimit vihet në pikëpyetje. Neni 3 ka karakter absolut dhe vendosja e dikujt në kushte që shkelin atë nuk mund të justifikohet në asnjë lloj mënyre. Ndoshta e vetëdijshme për mijëra çështje të ngjashme që mund të vijojnë, Gjykata i akordoi kërkuesit vetëm 5 000 euro dëmshpërblim (në Dougoz dhe Peers secili prej kërkuesve kishte marrë nga 17 000 euro). Duhet theksuar se megjithëse Gjykata mund ta marrë parasysh periudhën totale të paraburgimit në vlerësimin e karakterit të arsyeshëm të kohëzgjatjes së tij, në akordimin e dëmshpërblimit në lidhje me kushtet ajo mund t'i referohet vetëm periudhës pasi Rusia ka ratifikuar Konventën.

187 Përfshirë në këtë botim.

188 *Id.*



## RAMIREZ SANCHEZ kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 59450/00)

4 korrik 2006

Dhomë e Madhe

*kjo çështje ka të bëjë me mbajtjen e gjatë në izolim të një personi të dënuar për terrorizëm dhe me justifikimin apo jo të masave të tilla*

### I. Faktet kryesore

1. Iliç Ramirez Sanchez, i njohur më shumë si "Carlos - Çakalli", është një shtetas 56 vjeçar venezuelan i cili mbahet në një burg në Francë. Hetimet mbi të filluan pas një serie sulmesh terroriste të kryera në Francë. Ai u arrestua për rolin e tij në këto sulme më 15 gusht 1994 dhe, më 25 dhjetor 1997, u dënua me burgim të përjetshëm për vrasjen e dy policëve dhe të një të njohuri të tij më 1975. Për tetë vjet e dy muaj - nga arrestimi i tij në 15 August 1994 deri në transferimin e tij në një burg tjetër, më 17 tetor 2002 - kërkuesi u mbajt në izolim. Arsyet e dhëna për të justifikuar vendimet mbi zgjatjen e periudhës së mbajtjes së tij në izolim ishin rrezikshmëria e kërkuesit, nevoja për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në burg si dhe rreziku i arratisjes të tij.

2. Kushtet e izolimit ishin të tilla që kërkuesi mbahej vetëm, në një qeli të matur 6.84 metra katrorë, e cila, sipas tij, ishte e rrënuar dhe e izoluar keq. Ai nuk kishte asnjë kontakt me të burgosurit e tjerë ose gardianët e burgut dhe i lejohej të dilte nga qelia e tij vetëm për një shëtitje të përditshme prej dy orësh. Kërkuesi pretendoi më tej se aktiviteti i tij i vetëm ishin gazetat dhe një televizor i marrë me qira, dhe të vetmit që e vizitonin ishin avokatët e tij dhe, një herë në muaj, një prift. Më 17 tetor 2002, kërkuesi u transferua në një burg tjetër, ku ai u mbajt në një regjim të zakonshëm burgu deri më 18 mars të vitit 2004. Megjithatë, pas një interviste telefonike për një program televiziv gjatë së cilës kërkuesi, ndër të tjera, nuk pranoi të shprehte ndonjë keqardhje për viktimat e krimeve të tij, kërkuesi u vu përsëri në izolim. Që nga 5 janari 2006 ai është mbajtur në një regjimin e zakonshëm burgu.

3. Kërkuesi ankohej se izolimi i tij i zgjatur përbënte trajtim çnjerëzor dhe poshtërues, duke shkelur nenin 4. Ai pretendoi gjithashtu se autoritetet nuk kishin ndjekur procedurën e saktë për zgjatjen e mbajtjes së tij në izolim, në shkelje të nenit 13 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës<sup>189</sup>

### A. Në lidhje me nenin 3

4. Gjykata konsideroi se duhet të kufizojë shqyrtimin e saj në kushtet në të cilat ishte mbajtur kërkuesi nga 15 gushti 1994 deri më 17 tetor 2002, pasi palët nuk kanë dhënë asnjë informacion mbi kushtet në të cilat kërkuesi ishte mbajtur i izoluar në qeli nga marsi 2004 deri në janar 2006. Gjykata vërejtë se, edhe në rrethanat më të vështira, të tilla si lufta kundër terrorizmit dhe krimet të organizuar, Konventa ndalon në terma absolutë torturën dhe dënimet ose trajtimet çnjerëzore ose poshtëruese. Ajo megjithatë pranoi se ndalimi i kërkuesit ka paraqitur vështirësi serioze për autoritetet franceze dhe mirëkuptoi që ato duhet ta kenë konsideruar të nevojshme marrjen e masave të jashtëzakonshme të sigurisë për burgimin e një njeriu i cili gjatë viteve 1970 konsiderohej si terroristi më i rrezikshëm në botë dhe që, përveç kësaj, nuk kishte shprehur asnjë keqardhje.

*i. Në lidhje me kushtet në të cilat u mbajt kërkuesi*

*i.i. në lidhje me kushtet materiale*

5. Gjykata konstatoi se kërkuesi mbahej në një qeli mjaft të madhe për një person të vetëm, ku kishte një krevat, një tavolinë me karrige dhe një kthinë për tualetin. Qelia kishte një dritare nga ku hynte drita natyrale dhe kërkuesi kishte akses në libra, gazeta, kishte një televizor në dhomë dhe mund të dilte shëtitje në oborrin e burgut dy orë në ditë dhe një orë në ditë mund të bënte ushtrime në një sallë sportive. Në këto rrethana Gjykata vlerësoi se kushtet fizike në të cilat mbahej kërkuesi ishin të përshtatshme dhe në përputhje me Rregullat Evropiane të Burgut të miratuara nga Komiteti i Ministrave më 16 janar 2006. Këto kushte ishin konsideruar gjithashtu si "përgjithësisht të pranueshme" nga KPT-ja (Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtërues) në vizitën e tij nga 14 në 26 maj të vitit 2000.

*i.ii. në lidhje me natyrën e izolimit*

6. Gjykata më tej vuri në dukje se kërkuesi ishte vizituar dy herë në javë nga një mjek, një herë në muaj nga një prift dhe vizita shumë të shpeshta nga një ose më shumë nga 58 avokatët e tij, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e tij në procedurat para Gjykatës, ku tashmë përfaqësohej nga gruaja e tij. Familjarët e kërkuesit, ndaj të cilëve nuk ka pasur asnjë kufizim të së drejtës për ta vizituar kërkuesin, asnjëherë nuk kishte kërkuar leje për ta vizituar dhe dy kërkesat e vetme që ishin refuzuar, ishin bërë nga gazetarë. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se kërkuesi nuk kishte qenë në izolim të plotë shqisor apo social, por në mënyrë të izoluar të pjesshme dhe relative.

<sup>189</sup> Më 27 janar 2005 një Dhomë e Gjykatës konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 dhe se ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës. Kërkuesi kërkoi që çështja t'i kalonte Dhomës së Madhe në bazë të nenit 43, dhe më 6 qershor 2005, kolegji i Dhomës së Madhe e pranoi këtë kërkesë.

*ii. në lidhje me kohëzgjatjen e vetmisë*

7. Gjykata vuri në dukje se izolimi i një të burgosurit nga komuniteti i burgut nuk përbën në vetvete trajtim çnjerëzor. Megjithatë, për të shmangur çdo rrezik arbitrariteti, duhet të jepen arsye të forta kur një periudhë e zgjatur izolimi zgjatet më tej dhe masa të tilla, të cilat përbëjnë një formë të "burgut brenda burgut", duhej të përdoren vetëm përjashtimisht dhe pasi të jetë marrë çdo masë paraprake. Duke ndarë shqetësimet e KPT-së në lidhje me efektet e mundshme afatgjata të izolimit të kërkuesit, Gjykata megjithatë konsideroi se, duke pasur parasysh në veçanti karakterin dhe rrezikun që ai paraqet, kushtet në të cilat u mbajt kërkuesi gjatë periudhës në shqyrtim nuk kanë arritur nivelin minimal të ashpërsisë së nevojshme për të përbëjnë trajtim çnjerëzor ose poshtëruës sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës. Pavarësisht rrethanave shumë të veçanta të rastit, Gjykata ishte e shqetësuar nga periudha veçanërisht e gjatë që kërkuesi kishte kaluar në izolim dhe vuri re se që nga 5 janari 2006 ai ishte mbajtur nën regjimin e zakonshëm të burgut, një situatë e cila, sipas Gjykatës, në parim nuk duhet të ndryshohet në të ardhmen. Në këto rrethana, ajo konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

***B. Në lidhje me nenin 13***

8. Në vitin 1996 kërkuesi ishte ankuar në gjykatën administrative kundër një urdhri për mbajtjen e tij në izolim. Ankesa u hodh poshtë më 25 nëntor 1998, me arsyetimin se urdhri ishte një masë e brendshme që nuk mund t'i nënshtrohej shqyrtimit të gjykatave administrative. Në lidhje me këtë, Gjykata vërejti se Këshilli i Shtetit kishte ndryshuar jurisprudencën e tij mbi këtë çështje në korrik 2003 duke pranuar se vendimi për të vendosur një të burgosur në dhomën e izolimit mund të shqyrtohen nga gjykatat administrative. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 13, për shkak të mungesës së një mjeti në sistemin ligjor francez që do t'i kishte lejuar kërkuesit të kundërshtonte vendimin për zgjatjen e mbajtjes së tij në izolim.

***C. Në lidhje me nenin 41***

9. Gjykata i akordoi kërkuesit 10 000 euro për kostot dhe shpenzimet. Ai nuk bëri asnjë kërkesë për dëmshpërblim.

**III. Koment**

10. Ky nuk ishte një vendim aspak i lehtë për Gjykatën. Kërkuesi, i cili edhe deklaronte se kishte si profesion të qenit "revolucionar", ishte një nga terroristët më të kërkuar në botë në atë kohë dhe që shprehej me njëfarë mburrje se viktimat e atentateve të tij ishin rreth 1500-2000. Megjithatë kjo nuk e ndaloi Gjykatën që të ritheksojë parimin se ndalimi i një trajtimi në kundërshtim me nenin 3 është absolut dhe as makabriteti i krimeve të kryera, as kërcënimi që i burgosuri përfaqëson, nuk justifikojnë një trajtim i cili kalon pragun e ashpërsisë së kërkuar që të hyjë në lojë nenin 3 i Konventës. Dhoma e Madhe në këtë vendim kujtoi Udhëzimet e Këshillit të Evropës mbi të Drejtat e Njeriut dhe Luftën kundër

Terrorizmit, të 11 korrikut 2002, dhe dispozitat përkatëse të Rregullave të reja Evropiane të Burgut të miratuara në janar të vitit 2006.

11. Duket se në përfundimin e saj për jo shkelje të nenit 3 në këtë rast, Dhoma e Madhe u ndikua shumë qoftë nga mundësia e kërkuarit për të dalë rreth tre orë në ditë nga qelia, qoftë edhe nga numri i vizitave nga 58 avokatët e tij, njëra nga të cilat ishte tashmë edhe bashkëshortja e tij. Gjykata theksoi hapur se këto vizita profesionale kompensojnë ndalimin e të gjitha formave të kontaktit thjesht shoqëror dhe e përshkroi gjendjen e kërkuarit si "izolimi social relativ". Megjithatë është e qartë se Gjykata nuk ishte e kënaqur me periudhën e gjatë të regjimit të izolimit. Ajo vuri në dukje se situata aktuale e kërkuarit nën regjimin e zakonshëm të burgut "në parim nuk duhet të ndryshohet në të ardhmen". Gjyqtari grek, andoran, maqedonas dhe serb dolën në pakicë, duke pretenduar se ka pasur shkelje të nenit 3 në këtë rast.

12. KPT-ja, në raportet e tij, ka qenë shumë kritik i regjimit të përgjithshëm të izolimit që zbatohet në Francë. Ndërsa konstatimi i Gjykatës se nuk kishte shkelje të nenit 3 nuk pasqyron këto shqetësime, ajo i referohet shqetësimit të KPT-së në lidhje me mungesën e masave mbrojtëse procedurale për ata që janë vendosur në izolim, dhe prandaj gjeti shkelje të nenit 13. Ankesa e kërkuarit ishte bërë në bazë të nenit 3, i cili kërkon arritjen e një "pragu ashpërsie" shumë të lartë që të mund të gjendet shkelje e këtij neni. Megjithëse nuk u gjet shkelje e nenit 3, ankesa e kërkuarit në bazë të këtij neni u konsiderua se nuk ishte pa asnjë lloj baze, prandaj edhe u shpall e pranueshme. Meqë ankesa ishte e pranueshme, kërkuari duhet të kishte një mjet efektiv zgjidhje në sistemin ligjor francez, dhe përderisa nuk kishte asnjë mjet të tillë Gjykata gjeti shkelje të nenit 13. Megjithatë kërkuari nuk ishte ankuar në bazë të nenit 8, të cilit kërkuarit i referohen zakonisht në lidhje me ankesat për kufizimet mbi kontaktet sociale të të burgosurve. Ka raste kur Gjykata, si zot i interpretimit të Konventës dhe kualifikimit të ankesave, me nismën e vet, zgjedh që situata të tilla t'i shqyrtojë, përveç nenit 3, edhe në bazë të nenit 8. Gjykata mund ta kishte shqyrtuar ankesën edhe sipas këtij neni<sup>190</sup>, dhe do ishte interesante se në çfarë përfundimi ajo do arrinte.

190 Shih p.sh. vendimin *Guerra k. Italisë*, 19.02.1998.

## TYRER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 5856/72)

25 prill 1978

*rast i trajtimit degradues që vjen në kundërshtim me nenin 3 të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Anthony Tyrer, shtetas britanik, rezident në Casteltown, në ishullin e Manit. Më 7 mars 1972, kur ishte pesëmbëdhjetë vjeç (deri atëherë kishte pasur një sjellje të mirë), ai është dënuar nga një gjykatë vendase për adoleshentë, sipas ligjit të zbatueshëm në ishull, me tre të rrahura me litar për shkak të një rrahje jo të provokuar që kishte shkaktuar tek viktima dëme trupore (i shoqëruar me tre djem, ai kishte plagosur një nxënës të shkollës së tij më të madh në moshë se ai). Ai apelon kundër këtij ndëshkimi përpara Gjykatës së Lartë të Drejtësisë të ishullit të Manit. Ajo e dëgjon çështjen e tij dhe e hedh poshtë apelin më 28 prill 1972. Dënimi ekzekutohet të njëjtën ditë në një rajon policie, në prani të të atit dhe të një mjeku. I dënuari duhet të ulte pantallonat dhe të mbathurat dhe të përkulej mbi një tavolinë.

2. Ndëshkimet gjyqësore trupore u shfuqizuan në Angli, në Uells dhe në Skoci në 1948 dhe në Irlandën e Veriut më 1968, por gjithsesi u mbajtën në fuqi për disa shkelle nga legjislacioni i ishullit të Manit. Ato kanë qenë të zbatueshme mbi individët meshkuj me moshë nga dhjetë deri në njëzetënjë vjeç. Numri i rrahjeve të përcaktuara nga gjykata nuk duhet të tejkalojë gjashtë për një fëmijë (nga dhjetë deri në trembëdhjetë vjeç) dhe dymbëdhjetë për një të ri. Përdorimi i tyre - i rrallë - duket të ketë qenë i kufizuar, që prej vitit 1969, vetëm për ushtrimin e dhunës kundër personave.

3. Ishulli i Manit nuk bën pjesë në Mbretërinë e Bashkuar por është në varësi të Kurorës; ai ka një qeveri, një asamble legjislative dhe gjykatat e tij. Qeveria Britanike e konsideron si një territor të cilit ajo i siguron marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe ajo ka deklaruar, duke u bazuar në ish nenin 63 §§ 1 dhe 4 të Konventës<sup>191</sup>, se kjo e fundit zbatohet edhe në këtë ishull.

4. Në kërkesën e tij të paraqitur më 21 shtator 1972 përpara Komisionit, Anthony Tyrer pretendonte kryesisht se ndëshkimi trupor me të cilin ai u dënua ishte në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Por, në janar të vitit 1976, ai bëri të ditur se dëshironte ta tërhiqte kërkesën. Komisioni e refuzoi këtë kërkesë në

191 Aktualisht është neni 56 i Konventës.

mars të vitit 1976, sepse çështja ngre probleme të karakterit të përgjithshëm që nuk respektojnë Konventën dhe kërkojnë një shqyrtim më të thellë. Në raportin e 14 dhjetorit 1976, me katërmbëdhjetë vota kundër një Komisioni shprehu mendimin se ndëshkimi gjyqësor trupor i kërkuesit shkelte nenin 3 për shkak të karakterit degradues.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake

5. Fillimisht, Gjykata duhet të shqyrtonte një pretendim paraprak. Në fakt, Prokurori i Përgjithshëm i ishullit të Manit, e ftonte Gjykatën ta çregjistronte çështjen nga regjistri i saj, duke dhënë dy argumente: së pari që Anthony Tyrer kishte shprehur dëshirën të tërhiqte kërkesën e tij. Së dyti, Parlamentit të ishullit të Manit i qe paraqitur një projekt ligj, i cili kishte për qëllim të hiqte dënimin gjyqësor trupor si ndëshkim penal për shkeljen ligjore për të cilën qe fajtor Tyrer. Gjykata mund ta çregjistrojë një çështje nga regjistri i saj vetëm në qoftë se ajo merr një njoftim, për shembull, të një “fakti me një natyrë të atillë që i jep një zgjidhje problemit” (ish neni 47 § 2 i rregullores së saj). Megjithatë, ajo vendosi njëzëri që të mos e miratojë kërkesën e çregjistrimit, duke vlerësuar që as deklarata e Anthony Tyrer as projekt-ligji nuk mund të konsiderohen si një fakt i tillë.

### B. Në lidhje me nenin 3

6. Duke kaluar tek trajtimi në themel i çështjes, Gjykata së pari çmoi se ndëshkimi i Anthony Tyrer nuk përbënte as “torturë”, as një “trajtim çnjerëzor” sipas kuptimit të nenit 3, meqenëse vuajtja e shkaktuar nuk ka arritur shkallën e duhur që implikon këto nocione. Atëherë, pyetja e vetme që lindte ishte nëse ndëshkimi ishte “degradues”.

7. Për Gjykatën, që një ndëshkim të jetë “degradues” dhe në kundërshtim me nenin 3, përbuzja ose poshtërimi që rrjedhin prej tij duhet të arrijnë një shkallë të veçantë që të ndryshojë nga elementët e zakonshëm të poshtërimit që përmbajnë pothuajse në mënyrë të paevitueshme dënimet gjyqësore. Vlerësimi për këtë është relativ. Ai varet kryesisht nga natyra e kontekstit të dënimit si edhe nga mënyrat e ekzekutimit të tij.

8. Gjykata vuri re se legjislacioni i ishullit të Manit ofronte disa garanci. Por, duke analizuar të gjitha rrethanat e ngjarjes, ajo vlerëson se ndëshkimi i dhënë personit në fjalë përbënte një trajtim degradues. Gjykata nënvizoi disa elemente. Dënimet gjyqësore trupore kanë një natyrë të tillë që shtyjnë një njeri të ushtrojë dhunë fizike mbi një njeri tjetër. Për më tepër bëhet fjalë për një dhunë të institucionalizuar, karakteri i së cilës kombinohet me të gjithë procedurën zyrtare që rrethon këtë dënim dhe me faktin se ekzekutuesit janë të gjithë të huaj për shkelësin. Megjithëse Anthony Tyrer nuk kishte plagë fizike të rënda ose të zgjatura, dënimi i tij që konsistonte në trajtimin si një objekt nga duart e pushtetit



publik, shkelte dinjitetin dhe integritetin e tij fizik. Gjithashtu ai ka jetuar me ankth priten e dhunës së cilës ai do t'i nënshtrohej. Së fundi, turpi i ushtrimit të dhunës mbi të ndenjurat ka rënduar më tepër karakterin degradues të dënimit, por ai nuk ka qenë faktori i vetëm ose përcaktues i këtij të fundit. Tezës sipas së cilës një pjesë e madhe e popullsisë së Manit e konsideron të rrahurën me shkop si një mjet kërcënues efikas, Gjykata i përgjigjet se përdorimi i dënimeve në kundërshtim me parimet e nenit 3 është i papranueshëm, pavarësisht nga efekti i tyre kërcënues.

9. Gjykata shqyrtoi më pas faktin nëse ky konkluzion ndryshohet nga disa argumente të dhëna në terrenin e ish nenit 63: Prokurori i Përgjithshëm i ishullit të Manit pretendonte se duke parë nevojat vendore ekzistuese në ishull, ndëshkimi i Anthony Tyrer nuk e shkelte Konventën.

10. Gjykata e hodhi poshtë njëzëri këtë argument. *Së pari* ajo vërejti se opinioni publik vendas nuk mund të konsiderohej si një provë sipas së cilës dënimet gjyqësore trupore ishin të nevojshme në ishullin e Manit si një armë frenimi për ruajtjen e rendit publik. *Së dyti* ajo njoftoi se asgjë nuk e bind se rendi publik në ishull nuk mund të ruhet pa përdorur ato ndëshkime. *Së treti*, praktika aktuale në shumicën e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës të bën të dyshosh se mbajtja e rregullit në një vend evropian kërkon zbatimin e dënimeve të tilla. Por ishulli i Manit është një shoqëri moderne që gëzon kushte politike, sociale dhe kulturore shumë të zhvilluara dhe ai ka qenë gjithmonë i pranishëm në familjen e kombeve evropiane. Mbi të gjitha, asnjë nevojë vendore e lidhur me ruajtjen e rendit publik nuk mund të autorizonte një shtet palë të Konventës, në emër të ish nenit 63 § 3 të përdorte një dënim në kundërshtim të nenit 3.

11. Si rrjedhim, Gjykata, me gjashtë vota kundër një, vendosi se ndëshkimi i vuajtur nga kërkuesi ka shkelur nenin 3.<sup>192</sup>

### III. Koment

12. Në këtë vendim Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi se një trajtim i caktuar, pavarësisht se mund të mos përbëjë torturë ose trajtim çnjerëzor, mund të përbëjë shkelje të nenit 3 të Konventës. Kjo në rast se trajtimi ka karakter degradues dhe nuk justifikohet si i nevojshëm për arsye të rendit publik. Për këtë arsye, Gjykata vendosi se në këtë rast kemi pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

13. Standardi i vendosur nga shumica në lidhje me ndëshkimet në shkolla në Britani hasi në një konceptim krejt të ndryshëm të gjyqtarit britanik Sir Gerald Fitzmaurice në këtë çështje, të shprehur në mendimin e tij në pakicë.

192 Kryetari i Gjykatës të Manit me këtë vendim i ka tërhequr vëmendjen juridiksioneve të gatshme për të dhënë një ndëshkim trupor.

14. Megjithatë vendimi ka një vlerë të jashtëzakonshme për disa arsye. Në radhë të parë ai ndikon në perceptimin social të llojeve të caktuara të marrëdhënieve, duke e shtrirë në këtë rast veprimin e nenit 3 të marrëdhëniet e shkollës si dhe duke ndikuar në perceptimin social të trajtimit të nxënësve në shkollë. Kjo për faktin se megjithëse trajtimi i Tyrer ishte konsideruar efikas nga popullsia e një vendi të caktuar për ruajtjen e rendit dhe moralit, ai nuk mund të lejohej në bazë të nenit 3. Nga ana tjetër ai i ofroi veprës jurisprudenciale të Konventës qartësimin e konceptit të ndëshkimit degradues.

15. Sidoqoftë duhet thënë se vendimi i Gjykatës në këtë çështje përbënte vetëm hapin e parë në drejtim të shfuqizimit të rrahjeve si praktikë. Duhet thënë se kjo jurisprudencë nuk është konsoliduar ende në mënyrë të mjaftueshme as në Britani e as në nivel Evropian. Mjafton të kujtohen rastet vijuese përpara Gjykatës në lidhje me nenin 3 në të cilat nuk u arrit të vendosej shkëlje e këtij neni nga ana e Gjykatës<sup>193</sup>. Në fund të fundit me vlerë është të përmendet edhe fakti se Britania e Madhe u detyrua që me *School Standards and Framework Act* të vitit 1998 të shfuqizojë ndëshkimet trupore në të gjitha shkollat.

## DOUGOZ kundër GREQISË

(kërkesa 40907/98)

6 mars 2001

*edhe kushtet në të cilat mbahet një person në burg mund të përbëjnë trajtim degradues dhe për pasojë edhe shkëlje të nenit 3 të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Mohamed Dougoz, një shtetas sirian, pretendonte se ishte dënuar me dënim me vdekje në mungesë në Siri. Ai ishte larguar për në Greqi, ku ishte arrestuar dhe dënuar me heqje lirie disa herë me radhë, sidomos për vepra penale që kishin të bënin me lëndët narkotike. Ndërsa ishte në Greqi atij iu akordua statusi i refugjatit.

2. Në qershor 1997, ndërsa po vuante dënimin me heqje lirie, ai kërkoi që të dërgohej sërish në Siri dhe pretendoi se atje i ishte akorduar një dënim më i butë. Në korrik 1997, në vijim të një vendimi që urdhëronte lirimin e tij me kusht dhe dëbimin e tij drejt Sirisë, ai u lirua dhe u vendos në gjendje ndalimi në polici deri në dëbimin e tij. Ai u mbajt për disa muaj me radhë në Stacionin e Policisë në Drapetsona, ku pretendoi se ishte mbyllur në një qeli të mbipopulluar dhe të pisët, me kushte të pamjaftueshme sanitare dhe fjetjeje, pa ujë të ngrrohtë, pa

193 Shih *Campbell dhe Cossans kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 25 shkurtit 1982 dhe *Costello-Roberts kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 25 marsit 1993.

ajër të pastër e dritë natyrore dhe pa një oborr ku të bënte ushtrime fizike. Në prill 1998, ai u transferua në Zyrat Qendrore të Policisë në Rrugën Alexandras, ku pretendonte se kushtet ishin të njëjta me ato në qendrën e ndalimit në Drapetona, po ku gjithsesi kishte dritë natyrore, ajër në qeli si dhe ujë të ngrohtë të mjaftueshëm. Ai u mbajti atje deri më 3 dhjetor 1998, datën e dëbimit të tij në Siri.

3. Më 2 shkurt 1998 ai bëri një kërkesë për shfuqizimin e urdhrit për dëbimin e tij. Kërkesa e tij u refuzua me arsyetimin se ai kishte pretenduar më parë se nuk ishte më subjekt persekutimi në Siri, por asnjë vendim nuk u dha në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit të tij që vazhdonte ende.

4. Kërkuesi ankohej, duke u mbështetur në Nenet 3, 5 § 1 dhe 4 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në lidhje me kushtet, ligjshmërinë dhe kohëzgjatjen e ndalimit të tij dhe mungesën e mjeteve të mundshme në të drejtën e brendshme për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

5. Gjykata vuri në dukje se pretendimet e kërkuesit mbështeteshin nga përfundimet e raportit të 29 tetorit 1994 të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) në lidhje me Zyrat Qendrore të Policisë në Rrugën Alexandras, i cili (komiteti) vinte në dukje se qëndrimi në qeli dhe regjimi i ndalimit ishin të pakëshillueshëm për një periudhë më të gjatë se pak ditë, duke qenë se numri i personave të ndaluar ishte jashtëzakonisht i tepërt dhe kushtet sanitare ishin të mangëta. Megjithatë KPT nuk kishte vizituar qendrën e ndalimit në Drapetona në atë kohë, Gjykata vuri në dukje se qeveria i kishte përshkruar kushtet në Aleksandras si të njëjta me ato në Drapetona. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se KPT rivizitoi Zyrat e Policisë në Aleksandras dhe qendrën e ndalimit në Drapetona më 1999.

6. Në dritën e sa u tha më lart, Gjykata konsideroi se kushtet e ndalimit të kërkuesit në Zyrat Qendrore të Policisë në Aleksandras dhe në qendrën e ndalimit në Drapetona, e në veçanti mbipopullimi i tyre dhe mungesa e kushteve për të fjetur, e kombinuar me kohëzgjatjen e papërcaktuar të ndalimit të tij, arrinin deri në një trajtim degradues që ishte në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

### B. Në lidhje me nenin 5 § 1

7. Duke vlerësuar nëse ndalimi i kërkuesit ishte “i ligjshëm” për qëllimet e nenit 5 § 1, Gjykata vuri në dukje se ligji i zbatueshëm grek parashikonte ndalimin e një të huaji në kushtet që ekzekutimi i një urdhri administrativ për dëbim i marrë nga Ministria e Rendit Publik ishte akoma pezull, si dhe kur ky i huaj konsiderohej të përbënte rrezik për rendin publik ose mund të fshihej. Megjithatë dëbimi i kërkuesit konsistonte në një vendim gjyqësor dhe jo administrativ dhe kërkuesi

nuk konsiderohej rrezik publik ose të dukej se donte të largohej. Gjykata, në vazhdim, vuri në dukje opinionin e Zëvendës Prokurorit Publik në Gjykatën e Kasacionit, më 1 prill 1993, sipas së cilit një vendim ministror mbi ndalimin e personave që janë subjekt i dëbimit administrativ zbatohet për analogji edhe në rastet e dëbimeve të urdhëruara nga gjykatat. Gjykata, megjithatë, nuk pohoi se mendimi i një prokurori publik edhe të një rangu të tillë përbënte “ligj” me “cilësinë” e mjaftueshme të kërkuar nga jurisprudenca e Gjykatës. Ajo arriti në përfundimin se në këtë rast kishte shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

### C. Në lidhje me nenin 5 § 4

8. Gjykata konstatoi se kërkesat e kërkuarit për t'u liruar, drejtuar Ministrave të Drejtësisë dhe të Rendit Publik, më 28 nëntor 1997 dhe 26 korrik 1998, mund të mos konsideroheshin mjete efektive, për shkak se ministrat mund të vendosnin ose t'i prapësonin ose të mos u përgjigjeshin këtyre kërkesave. Për më tepër, në vendimin e saj të 11 majit 1998, gjykata penale e shkallës së parë të Pireut, e mbledhur me dyer të mbyllura, nuk vendosi në lidhje me pretendimin e kërkuarit mbi ndalimin e tij. Për këtë arsye sistemi i brendshëm ligjor nuk i ofroi kërkuarit një mundësi për të kontrolluar ligjshmërinë e ndalimit të tij ndërkohë që priste dëbimin e vendosur nga një gjykatë e brendshme, siç kërkohej nga neni 5 § 4. Për këtë arsye ky Nen ishte shkelur.

### D. Në lidhje me nenin 41

9. Kërkuarit iu akorduan 5 000 000 dhrahmi (rreth sterlina 10 000) për shpenzime dhe dëm jo-material.

## III. Koment

10. E gjithë çështja e ndalimit të kërkuarve të azilit dhe personave që dëbohen ka qënë shqyrtuar nga Gjykata në çështjet *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>194</sup> dhe *Amuur k. Francës*<sup>195</sup> ku u konstatuan shkelje të nenit 5. Në çështjen *Selmouni kundër Francës*<sup>196</sup> u konstatua shkelje e nenit 3 për shkak se policia kishte keqtrajtuar një të ndaluar, kurse në çështjen *Aslan kundër Maltës* Gjykata e konsideroi të papranueshëm pretendimin se oficerët e policisë i ishin drejtuar të ndaluarit me një gjuhë raciste dhe provokuese.

11. Rasti Dougoz është rasti i parë ku nuk ka pasur pretendim për keqtrajtim të qëllimshëm nga ana e policëve që e ruajnë të ndaluarin dhe ku Gjykata ka konstatuar se kushtet në të cilat një person ishte mbajtur i ndaluar përbënin në vetvete shkelje të nenit 3. Rëndësia e rolit të luajtur nga ana e KPT-së ishte vënë në dukje dhe fakti që qeveria greke nuk kishte marrë masat për të përmirësuar kushtet në përgjigje të rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës, u pa si një faktor rëndësues për të.

194 Vendim i 15 nëntorit 1996

195 Vendim i 25 qershorit 1996.

196 Vendim i 28 korrikut 1999.

12. Gjykata ka pasur shpesh rast të shqyrtojë dhe të kritikojë, në kuadrin e nenit 5, raste ndalimesh në kontekstin penal. Ajo përsëriti në rastin në fjalë rëndësinë e detyrimit ndaj shteteve për të siguruar që çdo dispozitë e cila autorizon privim lirie, duhet të jetë qartësisht e ligjshme. Në rastet kur, si edhe në këtë rast, kishte një boshllëk në të drejtën e brendshme, kjo nuk mund të shmangej nga mendimi i prokurorit. Nga ana tjetër vendimi për ndalimin e personit në çfarëdo lloj konteksti duhet të jetë i rishikueshëm nga ana e një gjykate.

## PEERS kundër GREQISË

(kërkesa nr. 28524/95)

19 prill 2001

*kushtet në të cilat mbahet një i burgosur mund të përbëjnë një trajtim degradues por edhe shkelje të jetës private të personit*

### I. Faktet kryesore

1. Donald Peers është shtetas britanik. Në gusht 1994 z. Peers, i cili kishte qenë trajtuar me terapi si përdorues droge në Mbretërinë e Bashkuar, u arrestua në aeroportin e Athinës për vepra penale që kishin të bënin me narkotikët. Më 24 gusht ai u dërgua në burgun e Koridallos në Greqi në pritje të vendimit gjyqësor, që edhe e dënoi në vijim.

2. Së pari, ai u mbajt në spitalin psikiatrik të burgut dhe pastaj u dërgua në zonën e izoluar në krahun Delta e më pas në krahun Alfa. Ndërsa ishte në krahun Delta ai pretendoi se ndante një qeli të vogël me një të burgosur tjetër, me një tualet të hapur që shpesh nuk punonte, në kushte të vështira me dritë natyrore të pamjaftueshme dhe pa ajrosje. Edhe në krahun Alfa ai pretendonte se kushtet ishin gjithashtu në vështira dhe johigjienike. Ai nuk kishte pasur mundësi të merrte pjesë as në kurse ose aktivitete profesionale apo në ndonjë bibliotekë.

3. Kërkuesi ankohej se kushtet e burgimit të tij shkelnin nenin 3 të Konventës. Ai bazohej gjithashtu në nenin 6 § 2 në lidhje me pretendimin se trajtimi gjatë periudhës së paraburgimit me atë të burgimit kishin qenë identikë, si dhe në nenin 8 për shkak se letrat që i ishin drejtuar atij nga Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut ishin hapur nga administrata e burgut.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 3

4. Megjithëse Gjykata konsideroi se nuk kishte prova për ekzistencën e një synimi të qartë për të përlulur ose fyer kërkuesin, mungesa e një qëllimi të tillë

nuk mund të përjashtojë si përfundim konstatimin e një shkeljeje të nenit 3. Fakti që autoritetet kompetente nuk kishin marrë asnjë masë për të përmirësuar kushtet objektivisht të papranueshme në të cilat kërkuesi po vuante dënimin, nxirrnin në pah mungesën e respektit ndaj tij.

5. Gjykata mbajti parasysh në mënyrë të veçantë që, për të paktën dy muaj, kërkuesit i ishte dashur që të kalonte një pjesë të madhe të periudhës prej 24 orësh i struktur në krevatin e tij, në një qeli e cila nuk kishte ajrosje dhe as dritare dhe që në periudha të caktuara, bëhej e nxehtë në mënyrë të padurueshme. Atij i ishte dashur gjithashtu që të përdorte tualetin në prani të një burgosuri tjetër si dhe të ishte i pranishëm ndërsa tualeti përdorej prej tij. Gjykata ishte e mendimit se kushtet e burgut për të cilat kërkuesi ankohej e ulnin dinjitetin njerëzor të kërkuesit dhe bënë që të lindnin brenda tij ndjenjat e ankthit dhe të inferioritetit të cilat përrulnin dhe e fyenin atë dhe mund të arrinin deri në thyerje të qëndrueshmërisë së tij morale dhe fizike. Për këtë arsye Gjykata vlerësoi se kushtet e burgimit të kërkuesit në njësinë e izolimit në krahun Delta të burgut të Koridallos arrinin deri në trajtim degradues në kuptimin e nenit 3.

#### ***B. Në lidhje me nenin 6 § 2***

6. Gjykata kujtoi se Konventa nuk përmban ndonjë nen që parashikon trajtim të veçantë për personat e akuzuar ose të dënuar.

#### ***C. Në lidhje me nenin 8***

7. Gjykata vuri në dukje se letrat e Komisionit drejtuar kërkuesit ishin hapur në të vërtetë dhe se kjo gjë përbënte ndërhyrje ndaj të drejtës së kërkuesit për respektim të korrespondencës së tij. Përderisa Gjykata nuk gjeti arsye të qëndrueshme që të justifikonin hapjen e kësaj korrespondence, konfidencialiteti i të cilës ishte shumë i rëndësishëm, arriti në përfundimin se ndërhyrja e ankuar nuk përbënte masë të nevojshme në një shoqëri demokratike në kuptimin e nenit 8 § 2. Si përfundim, ajo konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 8 § 2<sup>197</sup>.

### **III. Koment**

8. Është shumë interesante se brenda një muaji Greqia konsiderohet dy herë me radhë përgjegjëse për shkelje të nenit 3 duke kujtuar vendimin e 3 marsit 2001 në lidhje me çështjen Dougoz kundër Greqisë, në të cilën u konstatua shkelje e nenit 3 përsa i përket kushteve në një qendër sigurie, për arsyet e izolimit. Pra, pas një muaj, Greqia gjendet përsëri përgjegjëse për një shkelje të ngjashme. Kësaj radhe, siç u tha, shkelja ka të bëjë me kushtet në të cilat të paraburgosurit dhe të burgosurit mbahen. Mbipopullimi dhe gjendja e papërshtatshme sanitare në burgje është një problem mbarëevropian. Ky vendim pra, rithekson se neni 3 mund të shkelet edhe kur nuk ka pasur synim për të përlulur ose turpëruar

<sup>197</sup> Interesant është të kujtohet se mund të ishte ngritur nga ana e kërkuesit në këtë pikë edhe pretendimi për shkelje të nenit 34 të Konventës, të drejtës për të bërë kërkesë përpara Gjykatës së Strasburgut.



viktimën në qoftë se kushtet e burgut në vetvete e ulin dinjitetin e personit në fjalë. Përderisa neni 3 ka karakter absolut, në qoftë se një shtet nuk është në gjendje të ofrojë kushtet minimale të kërkuara në bazë të tij, ky shtet do të jetë në shkelje të Konventës pikërisht për këtë arsye.

9. Kjo çështje lidhet gjithashtu edhe me dy aspekte të tjera të të drejtave të të burgosurve. Rregullat Minimum për Trajtimin e të Burgosurve të përcaktuara nga ana e Këshillit të Evropës parashikojnë standarde minimale të cilat përfshijnë edhe mbajtjen veç e veç të të paraburgosurve me të burgosurit. Megjithatë ky rast e bën të qartë se neni 6 § 2 (prezumimi i pafajësisë) nuk kërkon që personat e akuzuar por ende të padënuar duhet t'i nënshtrohen një regjimi më të mirë izolimi sesa ai të cilit i nënshtrohen personat e dënuar. Çështja e dytë e rëndësishme është konfidencialiteti i korrespondencës së privilegjuar ndërmjet një personi të dënuar dhe autoriteteve të Strasburgut. Në rastet kur kemi pasur të bëjmë me korrespondencën mes një të burgosuri dhe avokatit të tij, Komisioni ka konstatuar përgjithësisht që standardet e Konventës respektohen në rast se letra hapet në prani të të burgosurit dhe nuk lexohet. Në këtë rast Gjykata ka shkuar edhe më tej. Të gjithë anëtarët e saj me përjashtim të gjyqtarit grek (Rozakis), ishin të mendimit se hapja e letrave që vijnë nga Gjykata, edhe në prani të të burgosurit, përbën një shkelje për aq kohë sa qeveria nuk arrin ta justifikojë këtë ndërhyrje. Ky vendim përforcon rëndësinë që Konventa i jep konfidencialitetit të komunikimit të një të dënuari që ka filluar procedurat e ankimit përpara organit të saj gjyqësor. Në çështjen Can kundër Austrisë<sup>198</sup>, Gjykata dhe Komisioni konstatuan se përbënte shkelje të Konventës që oficerët e burgut ose të policisë të jenë të pranishëm në takimet ndërmjet të burgosurve dhe avokatëve të tyre, që në fazat e para të ndalimit të tyre.

## DYBEKU kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 41153/06)

18 dhjetor 2007

*në këtë çështje Gjykata vendosi se në rastin e një të burgosuri me probleme shëndetësore specifike, masa të përshtatshme duhet të merren nga autoritetet shqiptare që të mos ketë shkelje të nenit 3, dhe masa të tilla duhet të parashikohen për të gjithë të burgosurit në situata të ngjashme*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Ilir Dybeku, është një shtetas shqiptar i lindur në vitin 1971 dhe që, në kohën e vendimit të Gjykatës, vuante dënimin në burgun e sigurisë së

198 Vendim i Gjykatës i 30 shtatorit 1985.

lartë të Peqinit. Prej vitit 1996 e në vazhdim kërkuesi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë paranojake dhe për shumë vite ai ka qenë i shtruar për kurim në disa spitale psikiatrike në Shqipëri.

2. Më 23 gusht 2002 si pasojë e një shpërthimi që ndodhi në apartamentin e motrës së kërkuesit, mbetën të vdekur tre persona, dy nga të cilët fëmijë të moshës 10 dhe 13 vjeç, dhe disa persona të tjerë u plagosën. Më 24 gusht 2002, një ditë pas ngjarjes, ndaj kërkuesit u bë një kallëzim penal dhe po atë ditë ai u arrestua dhe u akuzua për veprën penale të vrasjes dhe posedimit të paligjshëm të lëndëve eksplozive. Ai u ndalua në dhomat e paraburgimit në Komisarriatin e Policisë së Durrësit, në një qeli me disa të paraburgosur të tjerë.

3. Në 27 maj 2003 duke u bazuar në ekspertimin mjekësor, i cili konkludonte se në kohën e kryerjes së veprës çrregullimi mendor i z. Dybeku ishte në periudhë qetësie, Gjykata e Rrethit Durrës vendosi, që kërkuesi ishte i aftë t'i nënshtrohej procesit gjyqësor. Për rrjedhojë kjo gjykatë e shpalli atë fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm. Në shtator 2003 dhe mars 2004, respektivisht, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. As Apeli as Gjykata e Lartë nuk e pranuan kërkesën e kërkuesit për një ekzaminim të ri mjekësor, duke konkluduar se ekspertimi i parë mjekësor ishte kryer nga ekspertë të paanshëm në përputhje me garancitë procedurale.

4. Që nga dhjetori 2003 kërkuesi u transferua në tre burgje të ndryshme për të ekzekutuar dënimin e tij. Gjatë qëndrimit në këto burgje z. Dybeku ndau qelinë me të burgosur të tjerë, të cilët gëzonin shëndet të plotë dhe u trajtua njësoj si ata. Në bazë të deklaratave të autoriteteve shqiptare, në pamundësi për t'i garantuar kërkuesit trajtimin mjekësor, që i nevojitej, atij i ishin dhënë barna të ngjashme me ato të parashikuara nga mjeku i tij. z. Dybeku u shtrua në Spitalin e Burgut të Tiranës vetëm në dy raste kur shëndeti i tij ishte përkeqësuar ndjeshëm, nga 26 maji 2004 deri më 2 qershor 2004 dhe nga 1 dhjetori 2004 deri më 26 janar 2005. Ankesat e babait dhe avokatit të z. Dybeku kundër administratës dhe stafit mjekësor të spitalit të burgut për pakujdesi dhe trajtim mjekësor jo të përshtatshëm, nuk u morën parasysh nga autoritetet.

5. Duke pasur parasysh gjendjen gjithnjë e më shqetësuese të kërkuesit, më 7 janar 2005, avokati i tij nisi një procedurë në Gjykatën e Rrethit Tiranë për të kërkuar lirim ose transferimin në një institucion mjekësor, me arsyetimin se kushtet e vuajtjes së dënimit ishin të papërshtatshme për gjendjen e tij shëndetësore dhe përbënin rrezik për jetën e tij. Bazuar në raportet e fundit mjekësore, avokati i kërkuesit kërkoi gjithashtu që të kryhen ekzaminime psikiatrike. Kjo kërkesë ashtu si dhe apeli dhe rekursi në Gjykatë të Lartë u refuzuan. Në qershor 2007, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e kërkuesit, me arsyetimin se pretendimet e tij në lidhje me vlerësimin e provave nuk ishin në juridiksionin e saj.

6. Kërkuesi pretendonte, në veçanti, se kushtet e tij të paraburgimit dhe trajtimi mjekësor që ai kishte marrë në burg nuk ishin të përshtatshme duke pasur parasysh gjendjen e tij shëndetësore. Ai gjithashtu u ankua për padrejtësinë e procedurave ligjore lidhur me ankesat e tij.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

7. Gjykata vlerësoi se pavarësisht se kërkuesi nuk u bazua shprehimisht në nenin 3 të Konventës, pretendimet e tij mbi kushtet e paraburgimit dhe trajtimit mjekësor në burg duheshin shqyrtuar sipas këtij neni.

8. Gjykata kujtoi se neni 3 i Konventës e ndalon absolutisht torturën dhe trajtimin e dënimit çnjerëzor pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës . Duke iu referuar jurisprudencës së saj Gjykata u shpreh se keqtrajtimi i pësuar gjatë mbajtjes në burg duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie për t'u cilësuar se shkel të drejtën e garantuar nga neni 3 i Konventës. Vlerësimi i nivelit të ashpërsisë së keqtrajtimit varet nga rrethanat specifike të një çështjeje dhe vlerësohet rast pas rasti duke marrë në shqyrtim një sërë faktorësh si kohëzgjatja e keqtrajtimit, efektet fizike dhe mendore të tij, si edhe mosha, gjinia dhe gjendja mendore të viktimës .

9. Gjykata vërejti se asnjë nga palët në proces nuk kundërshtoi faktin se kërkuesi vuante nga çrregullime të rënda mendore të një natyre kronike. Vlerësimi i fundit mbi shëndetin e kërkuesit ishte bërë në vitin 2002 dhe prej asaj kohe kërkuesi kishte marrë të njëjtin trajtim, duke mos iu nënshtruar asnjë ekzaminimi për përkeqësimin e gjendjes së tij. Gjykata pranoi se gjendja psikologjike e kërkuesit e bënte atë më vulnerabël se të paraburgosurit e tjerë, duke i shkaktuar ndjenja stresi, ankthi dhe pasigurie. Fakti që autoritetet shqiptare pranuan se kërkuesi ishte trajtuar në mënyrë të njëjtë me të burgosurit e tjerë pavarësisht gjendjes së tij të veçantë, tregoi se autoritetet shqiptare kanë dështuar në zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Evropës për trajtimin e të burgosurve me nevoja të veçanta.

10. Sipas Gjykatës autoritetet shqiptare nuk ofruan informacion të detajuar mbi kushtet e burgimit të kërkuesit, dhe as provuan që gjendja e tij mendore ishte e përshtatshme për të qëndruar në të njëjtin ambient me gjithë të burgosurit e tjerë. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se vizitat periodike të kërkuesit në spitalin e burgut nuk mund të konsiderohen si zgjidhje efektive përderisa z. Dybeku ishte duke kryer një dënim të përjetshëm. Gjykata vërejti se shumë nga mangësitë e vëna re mund të ishin rregulluar edhe në mungesë të mjeteve financiare të konsiderueshme. Sipas Gjykatës, mungesa e një trajtimi të tillë, duke marrë në konsideratë gjendjen shëndetësore të z. Dybeku nuk mund të justifikohet.

11. Gjykata, duke marrë në konsideratë efektet kumulative të kushteve krejtësisht të papërshtatshme të burgimit të cilave kërkuesi iu ishte nënshtruar, sidomos

natyrën, kohëzgjatjen dhe ashpërsinë e keqtrajtimit, të cilat në mënyrë të qartë kishin pasoja të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e tij, duke iu referuar raportit të Komitetit të Parandalimit të Torturës në Këshillin e Evropës, si dhe jurisprudencës së saj të mëparshme, arriti në përfundimin se trajtimi i kërkuesit kishte qenë çnjerëzor dhe degradues, në shkelje të nenit 3 të Konventës.

#### B. Në lidhje me nenin 6

12. Në lidhje me kërkesën e z. Dybeku për parregullsinë e proceseve gjyqësore dhe mos pranimin e kërkesës së tij për lirim nga burgu ose mbylljen në një institucion të specializuar, Gjykata, u shpreh se vendimi i marrë nga gjykatat e brendshme dhe pretendimet e kërkuesit, nuk përfshihen në përcaktimin e “një akuze penale” ose “të drejtave dhe detyrimeve civile” në kuptim të nenit 6 të Konventës. GJEDNJ vërejtë se Konventa nuk garanton të drejtën për lirim me kusht, ose vuajtjen e një dënimi në përputhje me regjimin burgimi të veçantë 4, për rrjedhojë kjo pjesë e kërkesës u deklarua haptazi e pabazuar dhe papranueshme me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

#### C. Në lidhje me nenin 41

13. Gjykata i akordoi kërkuesit 5 000 euro si shpërblim për dëmin jopasuror për shkak të shkeljes së nenit 3.

### III. Koment

14. Vlera kryesore e këtij vendimi konsiston kryesisht në lidhje me nenin 3 të Konventës dhe ai referohet vazhdimisht në jurisprudencën e Gjykatës në çështje që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë së personave të sëmure<sup>199</sup>.

15. Në vendim, Gjykata gjen rast të ritheksojë karakterin absolut të të drejtave të mbrojtura nga neni 3 i Konventës. Ajo saktësoi që neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet se përmban një detyrim të përgjithshëm për të liruuar për arsye shëndetësore një person që i është hequr liria. Por, vazhdon sqarimi i Gjykatës, ky nen përmban një detyrim për Shtetin që të mbrojë mirëqenien fizike të personave të privuar nga liria, për shembull duke i siguruar atyre ndihmën e kërkuar mjekësore dhe mungesa e kujdesit të përshtatshëm mjekësor mund të sjellë një shkelje të nenit 3. Në rastin e personave me sëmundje mendore, vlerësimi i kushteve të heqjes së lirisë mban parasysh vulnerabilitetin dhe paaftësinë e tyre, në disa raste edhe për të paraqitur ankesa apo për të kuptuar se si ata preken nga një trajtim i caktuar. Gjykata nënvizoi se, fakti që kërkuesi ishte deklaruar i përgjegjshëm penalisht për kryerjen e veprës penale të vrasjes dhe ishte dënuar me burgim të përjetshëm nuk ndikon në çështjen e zbatimit të detyrimeve të nenit 3. Kjo do të thotë që karakteri absolut i nenit 3 kërkon që natyra e veprës penale të një personi nuk mund të ketë asnjë ndikim në justifikimin e trajtimit të tij problematik.

199 Shih edhe L. Bianku "The Impact of the ECHR on Democratic Change in Central and Eastern Europe" Cambridge University Press, 2016, ed. Motoc, Ziemele, fq. 20.

16. Gjykata në analizën e regjimit të privimit të lirisë ndaj një kërkuesi me probleme shëndetësore vlerëson së bashku tre elementë:

- i) gjendjen shëndetësore të të burgosurit;
- ii) përshtatshmërinë e ndihmës mjekësore dhe të kujdesit mjekësor në burg; dhe
- iii) përshtatshmërinë e vazhdimit të masës së privimit të lirisë me gjendjen shëndetësore të një kërkuesi.

Në rastin Dybeku, Gjykata i vlerësoi të tre këta elementë njëri pas tjetrit përgjatë gjithë periudhës kur kërkuesi kishte qenë në kushtet e burgut dhe se si autoritetet shqiptare kishin vepruar në prizmin e këtyre tre kriterëve. Historia e ndalimit të tij në ambientet e paraburgimit në rajonin e policisë në Durrës dhe më pas në burgun e sigurisë së lartë në Peqin nga viti 2002 e më tej, tregonte se gjendja e tij ishte përkeqësuar. Gjykata vërejti gjithashtu se vlerësimi i fundit mbi gjendjen shëndetësore të kërkuesit daton përpara vitit 2002. Të dhënat mjekësore mbi ankuesin tregonin se atij i ishte rekomanduar i njëjti trajtim si të burgosurit e tjerë dhe se nuk ishte bërë asnjë përshkrim i detajuar mbi zhvillimin e sëmundjes së tij. Ndërkohë që, sipas jurisprudencës së Gjykatës, është detyrë e autoriteteve të vendosin mbi bazën e rregullave të njohura të shkencës së mjekësisë në lidhje me metodat terapeutike që duhet të përdoren për të trajtuar gjendjen fizike dhe mendore të personave të paaftë për të vendosur për veten e tyre, në analizë të fundit i takon autoriteteve gjyqësore kombëtare dhe pastaj vetë Gjykatës së Strasburgut për të vlerësuar nëse këto trajtime kanë respektuar të drejtat e të burgosurve sipas nenit 3.

17. Gjykata pranoi se natyra e kushteve psikologjike të kërkuesit e bëri atë më shumë të cenueshëm sesa mesatarja e të dënuarve të tjerë dhe se burgimi i tij mund të ketë acaruar në një nivel të caktuar ndjenjat e tij të ankthit, vuajtjes dhe frikës. Në këtë drejtim, Gjykata pret që të burgosur si kërkuesi, me probleme të tilla të shëndetit mendor, për shkak të gjendjes shëndetësore të veçantë, të mos trajtohen nga Shtetet si të burgosurit e tjerë. Një trajtim i përshtatshëm i këtyre të burgosurve kërkohet edhe nga Rregullat Evropiane të Burgut. Në shumë vendime, Gjykata ka tërhequr vëmendjen e Shteteve për rëndësinë e këtyre Rregullave, pavarësisht natyrës së tyre jo të detyrueshme për Shtetet Anëtare. Ato përfshijnë dispozita në lidhje me nevojën për të pasur në dispozicion burgjet e specializuara, ose seksionet nën kontrollin mjekësor, për vëzhgimin dhe trajtimin e të burgosurve që vuajnë nga çrregullime mendore, gjë që në atë kohë nuk ekzistonte në Shqipëri. Për këtë arsye Gjykata konsideroi, në bazë të nenit 46 të Konventës, se Shqipëria duhet të marrë masa të domosdoshme për të siguruar kushte të përshtatshme të paraburgimit dhe trajtim adekuat mjekësor për të burgosurit që kanë nevojë për kujdes të veçantë për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

18. Gjykata theksoi gjithashtu se kur gjykon çështje të tilla, ajo pret që autoritetet shtetërore t'i japin informacion të detajuar rreth kushteve materiale të vuajtjes së dënimit të një personi dhe të tregojnë se, pavarësisht qëndrimit të tij në një

burg të sigurisë së lartë, këto kushte ishin të përshtatshme për një person me çrregullime të tilla mendore. Gjithashtu, Gjykata konsideroi se vizitat e rregullta të kërkuesit në spitalin e burgut nuk mund të shihen si një zgjidhje, për sa kohë që kërkuesi ishte duke vuajtur një dënim me burgim të përjetshëm.

19. Vendimi i jep një përgjigje të qartë pretendimit të përsëritur të Qeverisë shqiptare në Strasburg se "nuk kemi para". Megjithëse ajo është e ndjeshme ndaj faktit se ndërtimi i burgjeve të reja sipas standardeve dhe trajtimi i duhur mjekësor mund të jetë i kushtueshëm ajo vëren se shumë prej mangësive të identifikuara mund të ishin ndrequr edhe në mungesën e mjeteve financiare të konsiderueshme. Në çdo rast ajo rithekson se mungesa e burimeve financiare nuk mundet të justifikojë kushte të tilla vuajtje dënimi, të cilat janë aq të varfra sa prekin nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të parashikuar nga neni 3 të Konventës. Në qoftë se ky pretendim do të pranohej *a priori* në Strasburg ashtu siç pretendon vazhdimisht Qeveria shqiptare, efekti i Konventës dhe i çdo pretendimi për mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut, sidomos të atyre me karakter civil dhe politik, do të merrte një goditje tepër të rëndë.

20. Duke pasur parasysh efektet kumulative të të gjitha kushteve të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit të kërkuesit dhe pasojat e dëmshme që këto kushte kanë shkaktuar në shëndetin e tij si dhe konstatimet e Komitetit për Parandalimin Torturës të Këshillit të Evropës (KPT) në raportet më të fundit në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare, në veçanti për sa i përket të burgosurve të sëmurë mendërisht, Gjykata vlerësoi se natyra, kohëzgjatja dhe keqtrajtimi ndaj të cilit është nënshtruar kërkuesi, si dhe efektet që ka pasur në tërësi mbi gjendjen e tij shëndetësore, janë të mjaftueshme për t'a kualifikuar keqtrajtimin si çnjerëzor dhe degradues. Prandaj ajo vendosi për shkelje të nenit 3 të Konventës.

21. Kërkuesi u ankua edhe një herë tjetër në Strasbourg më 2011 dhe pretendimet e tij u shqyrtuan nga Gjykata në mars 2014<sup>200</sup>. Kjo tregon që Gjykata pranon ta mbajë nën vëzhgim të vazhdueshëm ecurinë e të burgosurve të tillë, për shkak të gravitetit të shkeljeve të pretenduara, por edhe për të kontrolluar nëse autoritetet kanë marrë masat që rrjedhin nga vendimi i parë i Gjykatës. Në këtë vendim të dytë, Gjykata pasi konstatoi se kërkuesi ishte transferuar në burgun e specializuar të Krujës, pasi Avokati i Popullit konfirmonte se ai merrte trajtimin e kërkuar mjekësor, dhe pasi Komiteti i Ministrave kishte arritur në përfundimin se asnjë masë tjetër individuale nuk dukej e nevojshme për rastin e tij<sup>201</sup>, vendosi që nuk kishte më shkelje të nenit 3 në lidhje me kërkuesin.

200 Shih Ilir Dybeku k. Shqipërisë, nr. 557/12, 11.3.2014.

201 Përfundimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në takimin 1092 (14-15.09.2010) dhe në takimin 1164 (5-7.03.2013). Megjithatë zbatimi i këtij vendimi nuk u mbyll për sa i përket masave të përgjithshme që Gjykata iu kërkoi autoriteteve të marrin në lidhje me të gjithë të burgosurit e tjerë në situata të ngjashme të atë të kërkuesit Dybeku.



22. Kërkuesi pretendoi edhe shkelje të nenit 6 me argumentimin se gjykatat e brendshme nuk i kishin dhënë atij mundësinë për t'u ekzaminuar nga një psikolog i pavarur dhe paanshëm për të përcaktuar natyrën e çrregullimit të tij mendor, duke e vendosur atë në një dizavantazh ndaj prokurorisë dhe duke shkelur parimin e barazisë së armëve. Por Gjykata rikujtoi neni 6 i Konventës nuk gjen zbatim mbi procesin që lidhet me ekzekutimin e një vendimi të dhënë nga një gjykatë kompetente dhe as mbi procesin për lirimin me kusht. Po ashtu Konventa nuk garanton në vetvete, një të drejtë për lirim me kusht apo vuajtje të një vendimi për burgim në përputhje me një regjim burgimi të veçantë.

## ALEKSANYAN kundër RUSISË

(kërkesa nr. 46468/06)

**22 dhjetor 2008**

*dështim në sigurimin e trajtimeve mjekësore për një të burgosur të sëmurë me sida*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Vasiliy Georgiyevich Aleksanyan, është një shtetas rus, lindur më 1971. Deri në vitin 2003, ai punonte si shef i drejtorisë juridike të kompanisë Yukos Oil.

2. Në vitet 2003-2004 procedurat penale ishin hapur ndaj disa krerëve ekzekutivë të kompanisë me akuzat e mashtrimit dhe shpërdorimit. Në të njëjtën kohë autoritetet tatimore kishin hapur proces ndaj kompanisë, duke kërkuar taksat e papaguara të korporatës. Në mars 2006 administrimi i kompanisë Yukos Oil caktoi kërkuesin si zëvendës-president ekzekutiv të kompanisë. Ndërkohë filluan procedurat e falimentimit ndaj kompanisë. Me vendim të Gjykatës tregtare të Moskës të 4 gushtit 2006 kompania Yukos Oil u shpall e falimentuar. Vendimi u mbështet nga apeli dhe u bë përfundimtar. Më 12 nëntor 2007 procedurat e falimentimit mbaruan dhe kompania mbaroi së ekzistuari.

3. Nga marsi 2006 u morën hapa për të filluar ndjekjen penale ndaj kërkuesit. Më 4 dhe 5 prill 2006 vendbanimi i tij u kontrollua nga hetuesit dhe disa dokumente iu sekuestruan. Më 6 prill 2006 ai u arrestua dhe u mbajt në paraburgim. Paraburgosja e kërkuesit u zgjat disa herë, më së fundmi në janar 2009. Gjatë kësaj periudhe shëndeti i tij u përkeqësua. Shikimi i tij i cili ishte i pakët gjatë arrestimit u përkeqësua aq sa ai ishte efektivisht i verbër. Për më tepër në shtator 2006 ai u diagnostikua me SIDA. Në tetor 2007 SIDA iu zhvillua dhe ai vuante nga një sërë infeksionesh. Në tetor 2007 kërkuesi u transferua nga një qendër paraburgimi ku mbahej në një spital në një qendër tjetër. Hetuesi

i ngarkuar me rastin e kërkuesit kërkoi para gjykatave lirimin me kusht për shkaqe shëndetësore por gjykata refuzoi të shqyrtonte këtë kërkesë.

4. Më 26 nëntor 2007, dhe përsëri më 21 dhjetor 2007, Gjykata Evropiane ftoi qeverinë ruse, bazuar në rregullin 39 të rregullores së Gjykatës, për të siguruar menjëherë me mjetet e duhura, trajtimin e pacientit në një spital të specializuar dhe krijimin e një komisioni mjekësor, i përbërë mbi një bazë bipartizane, për të diagnostikuar problemet shëndetësore dhe sugjeruar trajtimet. Më 27 dhjetor 2007 qeveria u përgjigj se kërkuesi mund të merrte një trajtim mjekësor të përshtatshëm në shërbimin shëndetësor të qendrës së paraburgimit, dhe se ekzaminimi i tij nga një komision mjekësor ishte kundër legjislacionit rus. Më 31 janar 2008 mjekët diagnostikuan kërkuesin me një limfomë të lidhur me SIDA-n. Më 8 shkurt 2008 kërkuesi u vendos në një spital të jashtëm hematologjik. Në spital kërkuesi ruhej nga policë; dritaret e dhomës së tij ishin të mbuluara me një grilë hekuri.

5. Kërkuesi pretendonte, në veçanti se duke pasur parasysh gjendjen e tij shëndetësore, paraburgosja e tij ishte çnjerëzore dhe degraduese. Ai pretendonte gjithashtu se paraburgosja e tij ishte e paligjshme dhe e pajustificuar dhe se ishte motivuar nga ndjekja politike dhe ekonomike e kompanisë së tij. Ai u ankua dhe për kontrollet në shtëpinë e tij dhe për pasojat e ndalimit të tij në jetën familjare. Ai u mbështet në nenet 3, 5, 8, 13 dhe 18.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

6. Ishte e qartë se kërkuesi kishte qenë dhe ishte seriozisht i sëmurë, vuante nga SIDA e avancuar dhe se në 2006–2008 ai kishte zhvilluar një numër të madh infeksionesh dhe kancer limfatik. Duke pasur parasysh faktin se kërkuesi mund të ketë marrë ilaçe nga familja e tij edhe pse këto ilaçe nuk ishin në gjendje në farmacinë e burgut, Gjykata ishte e përgatitur të pranonte se mungesa e ilaçeve të tilla në farmacinë e burgut nuk binte në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Lidhur me dështimin për ti dhënë ndihmën mjekësore të specializuar, gjykata arriti në përfundimin se që nga fundi i tetorit 2007, gjendja e tij shëndetësore kërkonte transferimin e tij në një spital që trajtonte SIDA-n.

7. Gjykata konstatoi se autoritetet vendase kishin dështuar në marrjen e një kujdesi të mjaftueshëm për shëndetin e kërkuesit të paktën deri në transferimin e tij në një spital të jashtëm. Kjo kishte dëmtuar dinjitetin e tij dhe shkaktuar vuajtje të mëdha që tejkalonin vuajtjen e lidhur me dënimin me burgosje dhe sëmundjen nga e cila vuante, dhe çonte në një trajtim çnjerëzor dhe degradues. Pra kishte pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

### B. Në lidhje me nenin 5

8. Kërkuesi ishte mbajtur në paraburgosje për një periudhë rreth 2 vjet e 8 muaj. Një periudhë e tillë e gjatë paraburgosje ishte në vetvete një çështje

problematike dhe shumë arsye të rëndësishme duheshin për ta justifikuar atë. Lidhur me justifikimet e dhëna nga autoritet ruse, Gjykata konstatoi se rreziku i përsëritjes së një vepre penale nuk ishte provuar në mënyrë të bindshme nga gjykatat vendase. Përsa i përket mundësisë së ndërhyrjes së kërkuesit në gjetjen e së vërtetës, me kalimin e kohës ky justifikim u bë pak relevant. Përsa i përket rrezikut të arratisjes nga burgu, Gjykata observoi se me kalimin e kohës ky rrezik u bë i neglizhueshëm, duke pasur parasysh dobësinë e gjendjes shëndetësore të kërkuesit. Për më tepër në asnjë stad gjatë procedurave, gjykatat vendase nuk morën në shqyrtim mundësinë e lirimimit të kërkuesit me kusht edhe kur hetuesi i ngarkuar me çështjen e kërkuesit ishte në favor të një mase të tillë.

9. Së fundmi, më 6 shkurt 2008, procedurat u pezulluan për shkak të shëndetit të keq të kërkuesit. Në parim, ndërprerje të shkurtra të procesit gjyqësor bazuar në shkaqe mjekësore ishin të lejueshme. Sidoqoftë, kërkuesi kishte kaluar më shumë se 34 muaj në burg. Disa nga sëmundjet e tij ishin të pashërueshme. Si rrjedhim paraburgosja e tij mund të zgjasë pa fund dhe procesi të mos mbyllet kurrë. Në këto rrethana paraburgosja e tij kishte humbur çdo qëllim kuptimplotë, dhe vazhdimi i saj binte në kundërshtim me nenin 5 të Konventës. Pra Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës.

### *C. Në lidhje me nenin 8*

10. Gjykata vërejti se mandatet e kontrollit të prillit 2006 ishin formuluar në terma shumë të gjera që efektivisht i dha hetuesve një diskrecion pa limit në përcaktimin se cilat dokumente ishin “me interes” për ndjekjen penale. Kjo mangësi ishte në vetvete e mjaftueshme për të konkluduar se kontrollet e vendbanimit të kërkuesit ishin bërë në kundërshtim me nenin 8 të Konventës.

### *D. Në lidhje me nenin 34*

11. Gjykata i tregoi qeverisë dy masa të ndërmjetme. Lidhur me të parën, vetëm në 8 shkurt kërkuesi u transferua në një spital të jashtëm. Dhe duke supozuar se ky spital mund të konsiderojë “një institucion i specializuar”, ishte e qartë se për më shumë se dy muaj qeveria kishte refuzuar vazhdimisht zbatimin e masës së ndërmjetme treguar nga gjykata, duke vënë kështu shëndetin dhe jetën e kërkuesit në rrezik. Në lidhje me masën e dytë, autoritet ruse nuk lejuan ekzaminimin e kërkuesit nga një komision mjekësor miks përfshirë dhe mjekët e zgjedhur prej tij. Duke pasur parasysh se kërkuesi ishte seriozisht i sëmurë, ishte në paraburgosje, dhe i paaftë të mblidhte gjithë informacionin e nevojshëm pozicioni i autoriteteve në këto rrethana përbënte një përpjekje për të ndaluar kërkuesin në ndjekjen e kërkesës së tij bazuar në nenin 34 të Konventës. Pra, duke dështuar në respektin e masave të ndërmjetme të parashikuar në Rregullin 39 të rregullores së Gjykatës, qeveria ruse dështoi në respektimin e detyrimeve të saj sipas nenit 34 të Konventës.

### *E. Në lidhje me nenet 41 dhe 46*

12. Pasur parasysh shkeljet e Konventës, dhe veçanërisht gjendjen e rëndë shëndetësore të kërkuesit, Gjykata konsideroi se paraburgosja e vazhdueshme

e kërkuesit ishte e papranueshme. Si pasojë, Gjykata konkludoi se, me qëllim respektimin e detyrimeve të nenit 46, qeveria ruse kishte si detyrë të zëvendësonte paraburgimin me një masë tjetër më pak të rreptë, ose një kombinim masash, parashikuar nga legjislacioni rus.

### III. Koment

13. Ky ishte një rast me profil të lartë në Rusi që tërhoqi vëmendjen e një sërë mediash lokale dhe ndërkombëtare. Kishte të bënte me refuzimin e qeverisë ruse për të ofruar trajtim të specializuar mjekësor një të burgosuri me SIDA. Në procedurat para Gjykatës Evropiane, qeveria ruse kishte argumentuar se trajtimi i kërkuesit në spitalin e burgut që i mjaftueshëm, dhe se në çdo rast nuk mund të mbahej i përgjegjshëm për përkeqësimin e shëndetit të kërkuesit pasi ai vetë kishte refuzuar ekzaminimin mjekësor dhe trajtimin për infeksionin HIV.

14. Lidhur me argumentin e parë, gjykata konstatoi se mjekët e kërkuesit kishin rekomanduar një trajtim në një klinikë të specializuar në trajtimin e SIDA-s dhe sëmundjeve lidhur me të, ndërsa spitali i burgut nuk kishte trajtime të tilla. Sa për argumentin e dytë, gjykata vërejti se refuzimi i mjekimit nga kërkuesi në spitalin e burgut ishte i kuptimtë duke patur parasysh se mjekët e burgut kishin deklaruar, në kundërshtim me rekomandimet e mjekëve trajtues, se kërkuesi ishte i përshtatshëm për paraburgosje. Për më tepër, Gjykata mbledhi konkluzione të kundërta nga refuzimi i qeverisë për të zbatuar masat e ndërmjetme të parashikuara në rregullin 39.

15. Ky rast është i vlefshëm në atë që Gjykata dha vendimin para se rasti i kërkuesit t'i nënshtrohej procesit gjyqësor dhe ndërkohë që ai ishte në paraburgosje. Gjykata arriti në përfundimin se paraburgosja e vazhdueshme e kërkuesit humbi "çdo qëllim kuptimplotë" dhe ishte e papërputhshme me nenin 5 të Konventës dhe vendosi, bazuar në nenet 41 dhe 46, se paraburgosja duhet të ndërpritet. Është hera e parë që Gjykata urdhëroi lirimin e kërkuesit nga paraburgosja<sup>202</sup>.

202 Shih gjithashtu për marrjen e masave individuale konkrete në këtë drejtim *Assanidze k. Gjeorgjisë*, 8.4.2004 dhe *Ilascu dhe të tjerë k. Moldavisë dhe Rusisë*, 8.8.2004.

## SOERING kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 14038/88)

7 korrik 1989

*ekstradimi i një personi nga një shtet anëtar i Konventës drejt një shteti të tretë jo anëtar ku ai mund të detyrohet të rrijë në pritje të dhënies së një vendimi me vdekje ndaj tij në të ashtuquajturin "korridor të vdekjes" përbën shkelje të nenit 3 të Konventës.*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, z. Jens Soering, është shtetas gjerman, lindur më 1 gusht 1966. Ai u vendos në Shtetet e Bashkuara me prindërit e tij kur ishte 11 vjeç. Që nga prilli 1986 mbahej në gjendje arresti në Mbretërinë e Bashkuar.
2. Më 31 korrik 1986, qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkoi ekstradimin e z. Soering nga Mbretëria e Bashkuar në bazë të një marrëveshje ekstradimi midis dy shteteve. Ekstradimi i tij u kërkua në bazën e një akuze se më 30 mars 1985, në moshën 18 vjeç, ai kishte vrarë prindërit e të dashurës së tij në shtëpinë e tyre në Bedford County, në Shtetin e Virxhinias.
3. Më 11 mars 1987, qeveria e Republikës Federale Gjermane i kërkoi Mbretërisë së Bashkuar ekstradimin e z. Soering për ta gjykuar në lidhje me vrasjet e pretenduara. Dënimi me vdekje ishte shfuqizuar sipas Kushtetutës së Republikës Federale. Më 20 maj 1987, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar informoi Republikën Federale për kërkesën e Shteteve të Bashkuara dhe propozoi të merrte në konsideratë kërkesën e parë sipas procedurës në fuqi.
4. Më 1 qershor 1987, Prokurori i Bedford County, i cili drejtonte ndjekjen e hetimit në çështjen Soering, u angazhua se nëse z. Soering gjendet fajtor për një krim të rëndë siç akuzohej, Mbretëria e Bashkuar, me anë të përfaqësimit, do të mund të shprehte dëshirën e saj për mosdhënien dhe mosekzekutimin e dënimit kapital përpara gjyqtarit. Prokurori i Shtetit iu përmbajt synimit të tij për të kërkuar dënimin me vdekje në çështjen Soering.
5. Më 16 qershor 1987, procedura e ekstradimit u bë përpara Gjykatës së Magjistratëve pranë Bow Street. z. Soering paraqiti një raport psikiatrik se në kohën e kryerjes së krimit ai vuante nga një çrregullim psikik e cila e shkarkonte atë nga përgjegjësia. Megjithatë, Gjykata e Magjistratëve vendosi se kishte prova të mjaftueshme për ta ekstraduar atë dhe në këtë mënyrë i parashtrroi atij të priste urdhrin e Ministrit të Brendshëm për rikthimin e tij në Shtetet e

Bashkuara. Një kërkesë e mëtejshme drejtuar gjykatës Britanike për të drejtën e daljes në gjyq u hodh poshtë më 30 qershor 1988. Më 3 gusht 1988, Ministri i Punëve të Brendshme firmosi një mandat duke urdhëruar që z. Soering t'i dorëzohej autoriteteve të Shteteve të Bashkuara. Sidoqoftë, duke u nisur nga masat e përkohshme dhe të njëpasnjëshme të procedurave të Strasburgut, deri në datën e vendimit ai nuk ishte transferuar në Shtetet e Bashkuara.

6. Në bazë të ligjit të Virxhinias, dënimi me vdekje nuk duhej dhënë derisa njëra nga rrethanat rënduese të parashikuara nga ligji (kur i akuzuari paraqet "rrezikshmëri për të ardhmen" dhe kur vepra e tij penale është "e rëndë") të jetë provuar sipas dyshimeve të arsyeshme, nga hetimi gjatë një seancë gjyqësore të veçantë. Gjykata e Lartë e Virxhinias rishqyrton automatikisht çdo rast kur jepet dënim me vdekje. Ligji i Virxhinias njeh mbrojtjen për personat me të meta mendore por jo mbrojtjen me anë të kufizimit të përgjegjësisë. Sëmundja mendore e të akuzuarit mund të merret parasysh si një faktor lehtësues, së bashku me të tjerë, si moshë në momentin e përcaktimit të dënimit.

7. Një regjim i rreptë mbikëqyrës vepron në korridorin e vdekjes, në Qendrën Kriminale të Mecklenburgut, ku kërkuesi mund të mbahet në qoftë se ai dënohet me vdekje. Koha mesatare që kalon një i burgosur në korridorin e vdekjes përpara ekzekutimit është 6 deri në 8 vjet ndërsa apelimi automatik përpara Gjykatës së Lartë të Virxhinias kryhet brenda një periudhe prej 6 muajsh. Vonesat vijnë kryesisht për shkak të kundërpasive nga të dënuarit (sidomos në kuadrin e procedurës së Habeas Corpus) si në gjykatat e shteteve ashtu dhe në ato federale. Mjeti i ekzekutimit i përdorur është goditja elektrike.

8. Kërkesa e z. Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar u paraqit përpara Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut më 8 korrik 1988 dhe u pranua më 10 nëntor 1988. Gjatë shqyrtimit të kërkesës së tij, Komisioni i tregoi qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, me anë të masave të përkohshme, se ishte e dëshirueshme për interesat e palëve dhe për drejtimin e mirë të procedurave, që kërkuesi të mos ekstradohej në Shtetet e Bashkuara. Në raportin e tij të 19 janarit 1989, Komisioni shprehu mendimin se ka pasur shkelje të nenit 13, por jo shkelje të nenit 3 ose të nenit 6.

## II. Vendimi i Gjykatës

11. Çështja iu paraqit Gjykatës nga Komisioni më 25 janar 1989, nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar më 30 janar 1989 dhe nga qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë më 3 shkurt 1989. Pretendimi i qeverisë Gjermane bazohej në nenin 48 § (b) të Konventës, i cili i jep të drejtën shtetit të mbrojtje përpara Gjykatës shtetasin e tij, i cili pretendohet të jetë viktimë e shkeljes së Konventës. Ky është rasti i parë, që një qeveri e papërzier në procedurat përpara Komisionit, i është referuar këtij neni.



12. Më 26 janar 1989, në vijim të kërkesave për masa të përkohshme të bëra nga Komisioni dhe kërkuesi, Gjykata i bëri të njohur qeverisë së Mbretërisë Bashkuar se do të ishte i këshillueshëm mosekstradimi i kërkuesit i cili ishte në pritje të rezultatit të procedurave të ndjekura përpara Gjykatës.

#### *A. Në lidhje me nenin 3*

13. Problemi i parë i shqyrtuar në vendim ishte nëse ekstradimi nga një shtet palë i Konventës mund të implikojë përgjegjësinë e këtij shteti në bazë të nenit 3, për keqtrajtimin që personi i ekstraduar mund të vuajë në shtetin që e pret atë.

14. Gjykata bëri të njohur se Konventa nuk rregullon veprimet e shteteve të cilët nuk janë palë, e as nuk u kërkon shteteve palë t'u imponojnë standardet e Konventës shteteve të tjera. Për më tepër, avantazhi i ekstradimit për të parandaluar shmangien e drejtësisë nga shkelësit nuk mund të neglizhohet. Nga ana tjetër, ndalimi absolut i torturës dhe i trajtimeve çnjerëzore ose degraduese, apo ndëshkimeve sipas Konventës, tregon se neni 3 ruan një nga vlerat më themelore të shoqërive demokratike dhe të Këshillit të Evropës. Megjithatë, nuk është normale për institucionet e Konventës që të shprehen mbi ekzistencën ose dhunimet potenciale të Konventës; marrja në konsideratë e këtij rregulli, është e nevojshme për të siguruar efektivitetin e mbrojtjes së nenit 3.

15. Së fundi, Gjykata konkludoi se, ekstradimi i të arratisurit nga një shtet palë mund të shkelë nenin 3 dhe të angazhojë përgjegjësinë e këtij shteti në bazë të Konventës, kur ka rrethana thelbësore për të besuar se personi në fjalë në qoftë se ekstradohet, përballet me një rrezik të vërtetë për t'u torturuar ose trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe degraduese në shtetin kërkues.

16. Kur Gjykata gjeti rrethana thelbësore për të besuar se në qoftë se z. Soering kthehej në Virxhinia, mund të dënohej me vdekje dhe si rrjedhim t'i ekspozohej "fenomenit të korridorit të vdekjes", ajo pranoi se ky përbënte një burim të trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor dhe degradues të pretenduar nga kërkuesi. Duhet thënë se duhen pasur parasysh disa faktorë të rëndësishëm e lehtësues si gjendja shëndetësore e z. Soering në kohën e kryerjes së veprës penale. Megjithatë, edhe pse i dënuar për vrasje siç akuzohej, nuk mund të bëhej asnjë supozim se ai do të mund të dënohej me vdekje. Sidoqoftë, zotimi i bërë nga Prokurori i Shtetit për Bedford County nuk e eliminoi rrezikun e një dënimi me vdekje. Mbi të gjitha, përderisa Prokurori i Shtetit kishte marrë një pozicion kaq të vendosur në kërkimin e dënimit me vdekje, ishte e vështirë për Gjykatën të arrinte në një konkluzion të ndryshëm. Si rrjedhim neni 3 ishte i zbatueshëm<sup>203</sup>.

17. Vendimi shtjellon më pas faktin nëse ekspozimi drejt "fenomenit të korridorit të vdekjes" do të implikonte, në rastin e z. Soering, trajtime ose ndëshkime të kundërta me nenin 3. Sipas së drejtës së mbështetur në çështjet e mëparshme të

203 Shih sidomos paragrafët 91-99 të vendimit.

Gjykatës, keqtrajtimi duhet të arrijë një nivel minimal rreptësie që të përfshihet në qëllimin e nenit 3 dhe vlerësimi i nivelit minimal varet nga rrethanat e çështjes.

18. Duke pasur parasysh nenin 2 § 1 të Konventës (i cili lejon ndëshkimin kapital nën disa kushte), kërkuesi nuk pretendoi se dënimi me vdekje shkelte në vetvete nenin 3. Me këtë pohim, me të cilin ishte dakord edhe qeveria e Republikës Federale Gjermane, rrethanat që përbënin "fenomenin e korridorit të vdekjes", të marra së bashku, përbënin një trajtim të tillë problematik aq sa ekstradimi i tij mund të konsiderohej si shkelje e nenit 3. Gjithashtu, ai u mbështet në mundësinë e ekstradimit ose depërtimit në Republikën Federale, të cilën ai nuk do të mund ta kundërshtonte, ashtu sikur shtonte disproporcionalitetin e vendimit të Ministrisë së Brendshme. Megjithatë, Komisioni dhe qeveria e Mbretërisë së Bashkuar ishin të mendimit se niveli i rreptësisë i parashikuar nga neni 3 nuk do të mund të arrihej.

19. Pasi rishikoi faktet, Gjykata arriti në përfundimin se, për çdo të burgosur të dënuar me vdekje, vonesat ndërmjet shpalljes dhe ekzekutimit të dënimit dhe eksperiencës së jetuar me stres të madh në kushte të nevojshme për burgim të rreptë, janë të paevitueshme. Nga ana tjetër, karakteri demokratik i sistemit ligjor të Virxhinias dhe të procedurave të dënimit dhe të apelimit në veçanti, nuk u vunë në dyshim. Sidoqoftë, duke pasur parasysh periudhën tepër të gjatë të kaluar në korridorin e vdekjes (6 deri në 8 vjet mesatarisht) në kushte kaq ekstreme, gjithmonë me prezencën e ankthit që shtohet duke pritur ekzekutimin e dënimit me vdekje, dhe duke iu referuar rrethanave personale të kërkuesit, sidomos moshës së tij dhe gjendjes shëndetësore në kohën e kryerjes së krimit, ekstradimi i kërkuesit drejt Shteteve të Bashkuara mund ta ekspozonte atë përpara një rreziku të vërtetë duke e tejkaluar pragun e caktuar nga neni 3. Një fakt tjetër që duhej marrë në konsideratë në lidhje me këtë ishte se në rastin tonë qëllimi legjitim i ekstradimit mund të arrihej nga mjete të tjera (mund të ishte dërgimi i z. Soering në Republikën Federale për ta gjykuar atje) që nuk do të implikonin vuajtje kaq të mëdha dhe të zgjatura. Pra si rrjedhim, vendimi për të ekstraduar kërkuesin drejt Shteteve të Bashkuara, në qoftë se do të ishte zbatuar, do të kishte shkelur nenin 3."

## **B. Në lidhje me nenin 6**

### *a) Procedurat kriminale të Shteteve të Bashkuara*

20. Në kërkesën e z. Soering, ekstradimi i tij drejt Shteteve të Bashkuara do të mund të shkelte nenin 6 § 3 (c), për shkak të mungesës së ndihmës ligjore në Virxhinia për të financuar apelimet e ndryshme. Gjykata nuk përjashtoi faktin se një problem mund të ngrihej në mënyrë të veçantë mbi nenin 6, nga një vendim ekstradimi në rrethana ku i burgosuri rrezikonte mohimin e një gjykimi të drejtë në vendin kërkues. Sidoqoftë, faktet në këtë rast nuk i linin vend këtij rreziku. Si rrjedhim, asnjë problem nuk lindi lidhur me nenin 6 § 3 (c)<sup>204</sup>.

204 Shih sidomos paragrafët 112-113 të vendimit.

*b) Procedurat e ekstradimit në Angli*

21. Përpara Gjykatës, kërkuesi parashitroi për herë të parë faktin se refuzimi i Gjykatës së Magjistratëve për të vlerësuar prova si gjendja psikike shkelnin nenin 6 §§ 1 dhe 3. Kjo kërkesë u konsiderua se dilte jashtë fushës së çështjes që iu paraqit Gjykatës, dhe rezultoi se ajo nuk ishte kompetente për ta gjykuar atë.

*C. Në lidhje me nenin 13*

22. Zoti Soering pretendonte se nuk i qe njohur e drejta për një ankim efektiv në Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me ankesën e tij bazuar mbi nenin 3. Në veçanti, z. Soering pretendonte, ashtu si dhe Komisioni, se ankimi për rishikim gjyqësor ngushtonte shumë qëllimin e ankimit.

23. Gjykata nuk ra dakord. Mbi bazat e parimeve të së drejtës administrative angleze, në procedurat e rishikimit gjyqësor, një gjykatë duhet të kishte kompetencë të shfuqizonte një vendim të kundërshtuar për të dërguar të arratisurin në një vend, ku dihej se ekzistonte rreziku i një trajtimi çnjerëzor dhe degradues. Megjithëse Konventa nuk konsiderohet si pjesë e legjislacionit të Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata pranoi që gjykatat angleze mund të rishikonin "karakterin e arsyeshem" të ndonjë vendimi ekstradimi nën dritën e llojit të faktorëve të paraqitur nga z. Soering përpara institucioneve të Konventës në kontekstin e nenit 3. Si rrjedhim, Gjykata arriti në përfundimin se z. Soering e kishte gëzuar të drejtën e një ankimi efektiv të disponueshem për të sipas legjislacionit anglez në formën e rishikimit gjyqësor.

*D. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)*

24. Përsa i përket dëmit të pësuar nga kërkuesi, Gjykata vlerësoi se konkluzionet për shkelje të nenit 3 përbënin në vetvete "një shpërblim të drejtë" për qëllimet e nenit 50. Megjithatë ajo u shpreh se nuk ishte kompetente të jepte udhëzime ndihmëse, siç i kërkonte z. Soering, për të vënë në zbatim vendimin e saj. Përsa i përket shpenzimeve të kërkuesit ato iu njohën atij tërësisht dhe iu akorduan 26,752.80 sterlina dhe 5,030.60 FF.

**III. Koment**

25. Duhet theksuar se situata normative sot, edhe në gjirin e Këshillit të Evropës edhe të shteteve të tij anëtare, është shumë më e ndryshme nga sa ishte në vitin 1989 kur u dha vendimi Soering. Kjo jo vetëm për faktin se tanimë është miratuar edhe Protokollin 13 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut i cili parashikon heqjen e dënimit me vdekje edhe në kohë lufte, apo sepse pjesa më e madhe e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës e kanë ratifikuar Protokollin 6 të saj që heq dënimin me vdekje në kohë paqe. Situata ka ndryshuar edhe për faktin se një pjesë e vendeve anëtare i kanë bërë modifikime legjislacionit të tyre penal që parashikonte dënimin me vdekje paralelisht me këto qëndrime

evropiane<sup>205</sup>. Pra dënimi me vdekje duket se nuk gjend më vend në rendin publik evropian.

26. Megjithatë, vlera e vendimit Soering qëndron pikërisht në faktin që, duke i paraprirë kësaj situate, dhe duke mos u përqendruar në vetvete në dënimin me vdekje të kërkuesit, ajo ngre në art jurisprudencial një parim të interpretimit të Konventës, atë të efektivitetit<sup>206</sup>. Pra duke mos përdorur dënimin me vdekje dhe as nenin 2 të Konventës si bazë juridike për të mbrojtur jetën e z. Soering, por nenin 3 të saj, avokatët dhe pastaj edhe Gjykata arritën që efektivisht dhe në analizë të fundit të mbrojnë z. Soering nga marrja e jetës në Virxhinia. Megjithëse z. Soering si përfundim u ekstradua në SH.B.A., kjo u bë vetëm pasi Mbretëria e Bashkuar mori garanci të plota procedurale që ai nuk do të akuzohej për një figurë veprë penale që mund të çonte në dënimin e tij me vdekje.

27. Parimi Soering ka gjetur një përdorim të gjerë në jurisprudencën vijuese të Gjykatës<sup>207</sup>. Madje ai është shtrirë përveç rasteve të ekstradimeve edhe në raste dëbimesh nga vende anëtare të Konventës në drejtim të vendeve të treta, duke ofruar një garanci mjaft efektive të veprimit të Konventës edhe kur aktet që në vetvete përbëjnë shkelje ndodhin jashtë hapësirës së zbatimit territorial të Konventës.

## CRUZ VARAS DHE TË TJERË kundër SUEDISË

(kërkesa 15576/89)

20 mars 1991

*kjo çështje kishte të bënte me një masë dëbimi në drejtim të Kilit ndaj kërkuesit dhe familjes së tij, në kushtet ku kërkuesi pretendonte se rrezikonte t'i nënshtrohej torturës në vendin e tij*

### I. Faktet kryesore

1. z. Hector Cruz Varas, bashkëshortja e tij znj. Magaly Maritza Bustamento Lazo si dhe djali i tyre Richard Cruz janë shtetas kilianë. Pasi hyri në Suedi më

205 Republika e Shqipërisë e filloi këtë proces me Vendimin nr.65, date 10.12.1999, i cili vendosi shfuqizimin e dënimin me vdekje, ne kohe paqeje ne nenet 29/1, 31, 73, 74, 75, 77, 78, 79, 109, 141, 208, 209, 219, 221, 230 dhe 334 te Kodit Penal dhe nenet 59/2 dhe 77 te Kodit Penal Ushtarak. Ndërsa në Britaninë e Madhe dënimi me vdekje megjithëse nuk ishte aplikuar nga gjykatat britanike që më 1963, formalisht u hoq me Crime and Disorder Act dhe Human Rights Act, të dyja ligje të vitit 1998.

206 Në lidhje me këtë parim si dhe me referencën që i kam bërë vendimin Soering në shpjegimin e tij shih "Të Drejtat e Njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komente" fq. 37.

207 Mjafton të përmenden vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet *Cruz Varas kundër Suedisë* (përfshirë në këtë botim), *Vilvarajah kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar*, *HLR kundër Francës*, etj.

28 janar 1987, z. Cruz Varas kërkoi azil politik që të nesërmen. E shoqja dhe i biri i arritën pranë tij më 5 qershor të të njëjtit vit.

2. Më 21 prill 1988, Zyra kombëtare e emigracionit vendosi që t'i dëbojë dhe refuzoi që t'u japë atyre statusin e refugjatit. Ata iu drejtuan qeverisë, e cila nuk e pranoi ankesën e tyre me një vendim të 29 shtatorit 1988. Pas kësaj, z. Cruz Varas deklaroi përpara policisë së Varbergut se ai punonte në Suedi për një organizatë radikale e cila kishte tentuar të vriste gjeneralin Pinochet dhe që ai rrezikonte persekutimin për shkaqe politike në qoftë se do të kthehej në Kili. Ai pretendon gjithashtu se është torturuar disa herë në vendin e tij të origjinës. Policia ia bën të njohur dosjen e tij Zyres kombëtare të emigracionit, e cila nga ana e saj, ia kalon qeverisë (Ministrisë së Punës) duke shprehur mendimin që vendimi i dëbimit duhet vënë në ekzekutim. z. Cruz Varas i paraqet qeverisë dy certifikata mjekësore në lidhje me pretendimet e tij se ishte torturuar. Më 5 tetor 1989, qeveria gjykon se nuk ekziston, sipas neneve 77 dhe 80 të Ligjit të vitit 1980 mbi të huajt, asnjë pengesë për vënien në ekzekutim të vendimit të dëbimit. Në të njëjtën ditë, familja Cruz Varas paraqet një kërkesë në Komisionin Evropian të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

3. Më 6 tetor 1988, Zyra kombëtare e emigracionit vendosi përfundimisht që të mos e pengojë ekzekutimin e vendimit. Po më 6 tetor 1988, në orën 9 e 10 minuta, agjenti i qeverisë ishte informuar në lidhje me vendimin e marrë nga ana e Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut në bazë të nenit 36 të rregullores së tij të brendshme, sipas të cilit ishte e preferueshme, në interes të palëve dhe të vazhdimit normal të procedurës, që të mos dëbohej kërkuesi në drejtim të Kilit për aq kohë sa Komisioni të mos ketë pasur mundësinë që ta shqyrtojë paraprakisht kërkesën. Pavarësisht nga kjo, z. Cruz Varas u dëbua në drejtim të Kilit në orën 16 e 40 minuta të së njëjtës ditë; ai qëndroi atje për tre javë dhe pastaj u nis në drejtim të Argjentinës. E shoqja dhe i biri qëndruan në Suedi si klandestinë.

4. Përpara Komisionit, kërkuesit pretendonin se dëbimi i z. Cruz Varas kishte shkelur nenin 3 të Konventës sepse ky dëbim e kishte ekspozuar ndaj rrezikut të të qenit torturuar nga ana e autoriteteve kiliane. Ata pretenduan gjithashtu se edhe dëbimi i Richard ishte në kundërshtim me të njëjtin nen dhe mendonin se ndarja e familjes së tyre përbënte një shkelje të nenit 8. Ata iu referoheshin gjithashtu neneve 6 dhe 13 të Konventës.<sup>208</sup>

## II. Vendimi Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

5. Duke iu referuar vendimit të saj *Sering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata

<sup>208</sup> Më 7 dhjetor 1989, Komisioni i deklaroi të pranueshme pretendimet e ngritura në bazë të neneve 3 dhe 8 dhe si të papranueshme të tjerat; ai mban parasysht gjithashtu, për t'i shqyrtuar në një moment më të vonë, problemet që rezultojnë nga mos-respektimi, nga ana e qeverisë, e orientimeve të dhëna në bazë të nenit 36 të rregullores së brendshme. Në raportin e tij të 7 qershorit 1990, ai arrin në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të neneve 3 (tetë vota kundër pesë vota) dhe 8 (me unanimitet), por se Suedia ka dështuar në lidhje me respektimin e angazhimit që ajo ka marrë përsipër në bazë të nenit 25 § 1 (dymbëdhjetë vota kundër një)

ripohoi parimin e zbatueshmërisë së nenit 3 në rastet e ekstradimit, i cili është i vlefshëm njësoj si për vendimet e dëbimit edhe, *a fortiori*, për dëbimet në praktikë. Në vijim, ajo u shpreh në lidhje me zbatimin e nenit 3 në rastin në fjalë duke bërë dallimin ndërmjet katër çështjeve objekt i mosmarrëveshjes.

6. Çështja e parë që shtrohej kishte të bënte me konstatimin e fakteve. Sistemi i Konventës i beson në radhë të parë Komisionit të bëjë verifikimin dhe të vendosë në lidhje me faktet. Gjykata nuk i vë në përdorim kompetencat e veta në këtë fushë veçse në rrethana të jashtëzakonshme. Ajo nuk është e lidhur nga konstatimet e raportit dhe ngelet e lirë në vlerësimin e fakteve nga ana e saj, nën dritën e të gjitha elementeve që ajo disponon. Për të kontrolluar ekzistencën e rrezikut të keqtrajtimit, ajo duhet t'i referohet në radhë të parë rrethanave mbi të cilat shteti palë kishte ose duhet të kishte dijeni në momentin e dëbimit. Të dhëna të mëtejshme mund t'i shërbejnë asaj në lidhje me konfirmimin ose zhvleftësimin e mënyrës sipas së cilës shteti ka gjykuar bazueshmërinë e frikës së shprehur nga ana e kërkuarit.

7. Çështja e dytë kishte të bënte me pyetjen nëse dëbimi, si i tillë, e vinte z. Cruz Varas përballë një rreziku real të trajtimit çnjerëzor. Në qoftë se vërtetimet mjekësore të paraqitura mbështesin tezën, sipas së cilës i interesuari ka pësuar në të kaluarën trajtime çnjerëzore ose degraduese, heshtja e vënë re nga ana e këtij gjatë tetëmbëdhjetë muajsh pas pyetjes së tij të parë nga ana e policisë, në lidhje me aktivitetet klandestine me të cilat ai ishte marrë në vendin e tij si dhe në lidhje me torturat që i ishin bërë atij nga ana e autoriteteve kiliane, hedhin një hije dyshimi mbi besueshmërinë e tij. Kjo e fundit duhet të kishte një garanci për shkak të ndryshimeve që ai nuk ka reshtur së sjelli në lidhje me tregimin e tij pas çdo seance pyetjesh si dhe për shkak të faktit se asgjë në dosjen e tij nuk justifikonte pretendimet e tij për aktivitete politike klandestine. Nga ana tjetër, duhen mbajtur parasysh një larmi faktorësh: përmirësimi i situatës politike në Kili, rikthimi vullnetar i refugjatëve, njohja dhe përvoja e veçantë që autoritetet suedeze kishin në lidhje me pohime të llojit për të cilin bëhet fjalë, fakti që vendimi përfundimtar për dëbimin e kërkuarit ishte marrë pas një studimi të thelluar të rastit të tij. Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte arsye serioze dhe të vërtetuara për të besuar se dëbimi i z. Cruz Varas do ta vinte këtë të fundit përballë një rreziku real të nënshtrimit ndaj trajtimit çnjerëzor ose degraduese pas kthimit të tij në Kili.

8. Çështja e tretë konsistonte në pyetjen nëse, dëbimi i z. Cruz Varas i kishte shkaktuar apo jo një traumë të tillë sa të çonte në shkelje të nenit 3. Asnjë element prove thelbësore nuk justifikonte frikën e kërkuarit, kështu që dëbimi nuk mund të thuhet se ka rënë nën nivelin e përcaktuar nga ana e nenit 3.

9. Çështja e katërt ishte ajo nëse, dëbimi eventual i Richard do të mund të shkelte apo jo nenin 3. Kërkuarit nuk duket të kishin vazhduar t'i përmbaheshin këtij pretendimi. Pavarësisht nga kjo, faktet nuk nxirrnin në pah shkelje në lidhje me këtë moment. Si përfundim, nuk ka pasur shkelje të nenit 3.



**B. Në lidhje me nenin 8**

10. Në lidhje me nenin 8, Gjykata kujtoi se bashkëshortja dhe i biri i z. Cruz Varas kaluan në një gjendje klandestine me qëllim që të mos i nënshtroheshin ekzekutimit të vendimit të dëbimit. Duke pasur parasysh provat që iu paraqitën si dhe përfundimin në të cilin ajo arriti përsa i përkiste nenit 3, Gjykata konstatonte se nuk kishte pasur ndonjë pengesë që t'i kishte privuar të bënin një jetë familjare në vendin e tyre të origjinës. Prej këtej rrjedh se nuk mund t'i ngarkohej Suedisë përgjegjësia për ndarjen e familjes. Pra nuk ka pasur shkelje të nenit 8 (*me unanimitet*).

**C. Në lidhje me nenin 25 (aktualisht neni 34)**

11. Ngelej për t'u marrë në konsideratë neni 25 § 1. Në ndryshim nga instrumentet e tjerë ndërkombëtarë, Konventa nuk përmbante asnjë klauzolë të shprehur që t'u mundësojë organeve të saj të urdhërojnë masa të ndërmjetme<sup>209</sup>. Punimet përgatitore nuk nxjerrin në pah asnjë diskutim në lidhje me këtë çështje. I ftuar nga ana e Asamblesë Këshillimore që të hartojë një protokoll shtesë [rekomandimi 623 (1971)], Komiteti i Ministrave e ka çmuar këtë masë si të papërshtatshme. Asambleja, ashtu si edhe Komiteti në vazhdim kanë nxjerrë, respektivisht më 1977 dhe më 1980, rekomandime me anë të të cilave u bënin thirrje shteteve anëtare që të mos procedonin me ekstradimin ose me dëbimin në drejtim të shteteve të treta ndërkohë që Komisioni ose Gjykata janë në fazën e njohjes me pretendimet e ngritura mbi bazën e nenit 3.

12. Sa i takon masave të ndërmjetme, duke parë mungesën në Konventë të një teksti që t'i dedikohet atyre, një element që përfshihet në nenin 36 të Rregullores së brendshme të Komisionit nuk mund të konsiderohet si krijues i një detyrimi juridik. E dëshmojnë në vazhdim këtë gjë qoftë termat e kësaj dispozite qoftë edhe ato të kërkesave të bëra nga ana e Komisionit në këtë rast.

13. Neni 25 § 1 ndalon ndërhyrjet në ushtrimin e së drejtës së individit për të sjellë dhe për të mbrojtur në mënyrë efektive çështjen e tij përpara Komisionit. Megjithëse kjo e drejtë është e një karakteri procedural dhe bën dallim nga të drejtat e një natyre materiale të radhitura në Titullin I të Konventës, individët duhet të kenë mundësinë të ankohen ndaj mos respektimit të saj. Megjithatë, do të përforcohej kuptimi i nenit 25 në qoftë se deduktohej prej tij një detyrim për t'u përshtatur me një kërkesë të dhënë në nenin 36 të Rregullores së Gjykatës. Ky përfundim nuk e humbet vlerën e tij në qoftë se kombinohet neni 25 § 1 me nenin e lartpërmendur 36 ose me nenet 1 dhe 19 të Konventës. Në praktikë, shtetet palë deri tani i kanë respektuar pothuajse gjithmonë kërkesat për të cilat bëhet fjalë. Një praktikë e tillë do të mund të konsiderohej si konfirmuese e marrëveshjes së tyre në lidhje me mënyrën e interpretimit të një dispozite të caktuar por jo si krijuese e të drejtave dhe detyrimeve që nuk janë përfshirë fillimisht në Konventë. Në çdo rast, ajo pasqyron shqetësimin për të bashkëpunuar në mirëbesim me

209 Situata është zgjidhur tashmë me anë të nenit 39 të Rregullores së Gjykatës.

Komisionin ashtu siç e konfirmojnë edhe rekomandimet e ndryshme të organeve të lartpërmendura të Këshillit të Evropës.

14. Së fundmi, parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare nuk ofrojnë në këtë rast asnjë rrugëdalje për shkak se nuk ekzistojnë rregulla juridike uniforme. Duke u nisur nga këto argumente, Gjykata çmon se kompetenca për të urdhëruar masa të ndërmjetme nuk mund të deduktohet as në bazë të nenit 25 § 1 dhe as në bazë të burimeve të tjera. I përket shteteve kontraktuese që të vlerësojnë mundësinë për të dalë nga kjo gjendje. Megjithatë, në qoftë se një shtet vendos që të mosrespektojë një kërkesë që bëhet në bazë të nenit 36 të lartpërmendur, ai merr përsipër me ndërjegje rrezikun që të deklarohet fajtor nga organet e Strasburgut për një shkelje të nenit 3, të rënduar nga refuzimi për të plotësuar kërkesën në fjalë.

15. Megjithëse respektimi i kërkesës të bërë nga Komisioni do t'i kishte ndihmuar kërkesit që të mbronin interesat e tyre përpara tij, asgjë nuk nxjerr në pah se ata janë prekur në një shkallë të konsiderueshme në ushtrimin e të drejtës së tyre të kërkesës: z. Cruz Varas vazhdoi të ishte i lirë pas kthimit të tij në Kili dhe këshilltari i tyre ka qenë plotësisht në gjendje që të vepronte në emër të tyre përpara Komisionit. Nuk dilte në pah nga ana tjetër që pamundësia e z. Cruz Varas që të takohej me avokatin e tij, të kishte vështirësuar mbledhjen e elementëve të provës, përveç atyre që ishin mbledhur ndërkaq gjatë procedurës së gjatë të emigrimit në Suedi. *In fine*<sup>210</sup> me një shumicë tepër të ngushtë prej dhjetë vota kundër nëntë, Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 25 § 1.

### III. Koment

16. Në këtë vendim Gjykata zbaton parimin e përpunuar në çështjen *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>211</sup> por në lidhje me persona me shtetësinë e një shteti që nuk është palë në Konventë. Me këtë vendim pra pranohet se edhe këta persona, të huaj nga pikëpamja e një lidhjeje formale ligjore shtetësie me shtetet palë në Konventë, gëzojnë mbrojtje nga ana e kësaj të fundit në lidhje me aktet e kryera nga një shtet që është palë në Konventë. Kjo është e vërtetë madje, në vijim të jurisprudencës *Soering*, edhe kur këto akte e shprehin efektin e tyre jashtë territorit ku Konventa ka efekt. Me këtë çështje pra, përveç zgjerimit *ratione loci* të veprimit të Konventës, të realizuar me vendimin *Soering*, Gjykata zgjeron edhe veprimin *ratione personae*, duke i kombinuar të dy së bashku këto instrumente të zgjerimit të juridiksionit të saj në lidhje me akte të shteteve anëtare të Konventës.

17. Pavarësisht se Gjykata nuk arriti të konstatonte shkelje të nenit 3 të Konventës, duhet theksuar se ky konstatim ishte pasojë e një shqyrtimi faktik të çështjes. Elementët që e bënë Gjykatën që të vendoste për mos-shkelje të nenit 3 konsistonin

210 *In fine* - nga latinishtja që do të thotë "si përfundim".

211 Vendim i 7 korrikut 1989 i përfshirë në këtë botim.

në dyshimet në lidhje me deklaratat e kërkuarit mbi keqtrajtimet e tij në Kili, në faktin se në Kili në atë kohë ishte rivendosur demokracia, si dhe në faktin se pretendimet e tij ishin vlerësuar në mënyrë të kujdesshme nga autoriteteve suedeze të emigracionit. Në këto kushte, Gjykata nuk e pa të arsyeshme se mund ta vlerësonte situatën konkrete më me kujdes se autoritetet suedeze.

18. Ky vendim ka vlera të veçanta duke pasur parasysh formulimin e dispozitës së nenit 16 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sipas së cilës “1. *Të drejtat e liritë themelore si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë*”. Ky formulim të bën të kuptosh se, vështirë se Cruz Varas mund të gjente mbrojtje ndaj një akti nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë i cili gjithsesi do t'i shprehte efektet e veta në shkelje të Konventës në një territor jashtë atij të veprimit të Konventës<sup>212</sup>. Ndoshta mbrojtja në një rast të tillë mund të gjendet në dispozitën e nenit 17 § 2 të Konventës. Gjithsesi, në rast se një çështje në terma të tillë faktikë do të shkonte në Strasburg, përgjegjësia e Republikës së Shqipërisë do të angazhohej fare qartë në bazë të kësaj jurisprudence.

19. Vendimi ka vlerë edhe nën një këndvështrim tjetër – masat e ndërmjetme që mund të urdhërohen nga organet e Strasburgut. Në kohën e dhënies së këtij vendimi situata ishte më e paqartë nga sa është sot. Kjo për arsye se saktësimi i kësaj kompetence me nenin 39 të Rregullores së re të Gjykatës ose edhe miratimi i atyre që quhen orientime praktike nga ana e Kryetarit të saj, bëjnë të qartë se një shtet i cili nuk respekton masat e ndërmjetme të Gjykatës rrezikon të shkelë nenin 34 (në kohën e vendimit Cruz Varas neni 25) të Konventës<sup>213</sup>.

## J.K. DHE TË TJERË kundër SUEDISË

(kërkesë nr. 59166/12)

23 gusht 2016

Dhomë e Madhe

*dëbimi në Irak i ekspozon kërkuarit ndaj një rreziku real keqtrajtimi*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuarit, z. J.K., gruaja dhe djali i tij, janë shtetas irakianë të cilët kanë lindur në vitet 1964, 1965 dhe 2000 respektivisht. Që prej viteve 1990 z. J.K. drejtonte biznesin e tij të ndërtimit dhe transportit me klientë ekskluzivisht amerikanë.

212 Shih gjithashtu “Raporti i Përjasjes së Legjislacionit Shqiptar me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut”, fq. 49-52.

213 Shih në lidhje me situatën më të re vendimin e 6 shkurtit 2002 në lidhje me çështjen *Mamatkulov dhe Abdurasulovic kundër Turqisë*.

Zyra e tij ndodhej në bazën ushtarake të Shteteve të Bashkuara "Victoria Camp" në Bagdad, Irak.

2. Kërkuesit kishin qenë subjekt i kërcënimeve serioze dhe dhunës nga al-Kaeda në periudhën midis viteve 2004 dhe 2008. Në veçanti, në vitin 2004, ndaj kërkuesit të parë pati një tentativë për vrasje. Në vitin 2005, vëllai i tij u rrëmbye nga anëtarët e al-Kaidës, të cilët kërcënonin se do ta vrisnin për shkak të bashkëpunimit të kërkuesit të parë me amerikanët. Vëllai i tij u lirua përmes ryshfetit dhe kërkuesit u larguan menjëherë nga Iraku. Kërkuesit u vendosën në Jordani ku qëndruan deri në dhjetor 2006, përpara se të ktheheshin në Irak. Menjëherë pas kthimit të tyre, shtëpia e tyre ishte objektivi i një sulmi me bombë. Forcat amerikane arrestuan agresorin, i cili pranoi se ishte paguar nga al-Kaeda për të vrrarë z. J.K dhe gjithashtu deklaroi emrat e gjashtëmbëdhjetë njerëzve të cilët ishin caktuar për të vrojtuar kërkuesit. Më pas, kërkuesit u shpërngulën në Siri. Al-Kaeda shkatërroi shtëpinë e tyre në Irak, si dhe rezervat e biznesit të z. J.K.

3. Në janar 2008 kërkuesit u kthyen përsëri në Bagdad. Në tetor 2008 z. J.K. dhe vajza e tij u sulmua me armë zjarri ndërkohë që udhëtonin me makinë. Në atë atentat vajza e tij mbeti e vrrarë. Pas kësaj z. J.K e la punën dhe së bashku me familjen lëvizën nëpër vende të ndryshme në Bagdad. Rezervat e biznesit të J.K. u sulmuan katër ose pesë herë nga anëtarët e al-Kaidës, të cilët kishin kërcënuar rojet.

4. Në dhjetor 2010 z. J.K. aplikoi për azil dhe leje qëndrimi në Suedi. Në gusht të 2011 ai paraqiti një kërkesë tjetër dhe po ashtu gruaja dhe djali i tij në shtator 2011. Më 22 nëntor 2011 Agjencia e Migracionit refuzoi kërkesën e tyre për leje qëndrimi dhe urdhëroi dëbimin e tyre nga Suedia. Kërkuesit u ankuan në Gjykatën e Migracionit, e cila në prill të vitit 2012 la në fuqi vendimin e Agjencisë së Migracionit, me arsyetimin se ngjarjet e pretenduara nga kërkuesi kishin ndodhur në të kaluarën e largët dhe se z. J.K. nuk bënte më punën për shkak të së cilës Al-Kaeda e kishte kërcënuar e dhunuar. Gjithashtu, Gjykata e Migracionit vërejti se edhe nëse do kishte kërcënime të tjera, autoritetet irakiane të zbatimit të ligjit dukeshin se ishin të gatshme dhe në gjendje t'u ofronin kërkuesve mbrojtjen e nevojshme. Kërkuesit më pas u ankuan në Gjykatën e Apelit të Migracionit, por ankesa e tyre u refuzua në gusht 2012. Më 29 gusht 2012, kërkuesit paraqitën një kërkesë në Agjencinë e Migracionit për rishqyrtim të çështjes së tyre, e cila u refuzua 26 shtator 2012.

5. Kërkesa u parashtrua në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 13 shtator 2012. Më 18 shtator 2012, Presidenti i Seksionit të Tretë vendosi të zbatonte nenin 39 të Rregullores së Gjykatës, duke i kërkuar shtetit suedez mos dëbimin e kërkuesve ndërkohë që çështja e tyre ishte në shqyrtim nga kjo Gjykatë. Më 4 qershor 2015, një Dhomë e Gjykatës konstatoi se zbatimi i urdhrit për dëbim nuk përbënte shkelje të nenit 3. Me kërkesë të kërkuesve, çështja iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43 të KEDNJ-së. Kërkuesit pretenduan se nëse ktheheshin në Irak ishin nën një rrezik real të keqtrajtimit, në shkelje të nenit 3.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

6. Gjykata vërejt se, për shkak se kërkuesit ende nuk ishin ekstraduar apo deportuar në kohën që shqyrtohej çështja e tyre, periudha e kohës për të cilën do të bëhej vlerësimi i rrezikut ishte ajo para procedurave para kësaj Gjykate. Gjatë shqyrtimi të pretendimeve të kërkuesve sipas nenin 3, Gjykata iu referua raporteve nga departamentet qeveritare të vendeve të ndryshme dhe nga shoqata të pavarura ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ajo pranoi që, edhe pse situata e sigurisë në Bagdad ishte përkeqësuar që prej vlerësimit të bërë nga Agjencia e Migracionit dhe Gjykata e Migracionit, intensiteti i dhunës nuk kishte arritur në nivelin që do të përbënte një rrezik real të trajtimit në kundërshtim me nenin 3. Megjithatë, Gjykata konstatoi se rrethanat personale të kërkuesve të marrë së bashku me reduktimin e kapaciteteve të autoriteteve autoriteteve irakiane për t'i mbrojtur ata, krijonte një rrezik real të keqtrajtitimit në rast të kthimit të tyre në Irak.

7. Sa i përket rrethanave personale të kërkuesve, Gjykata konstatoi në veçanti se ata dhanë një dëshmi koherente dhe të besueshme të ngjarjeve, e cila ishte në përputhje me informacionet e marra nga burime të besueshme dhe objektive rreth gjendjes së përgjithshme në Irak por edhe kishte element të cilët e bënë historinë e tyre të dallueshme nga rreziqet e përgjithshme në vend. Në veçanti, z. J.K. i përkiste një grupi personash që kishin pasur dhe vazhdonin të kishin marrëdhënie me forcat e armatosura amerikane dhe në të vërtetë kërkuesit, në të kaluarën, ishin keqtrajtuar nga Al Kaeda. Gjykata pranoi që konsideratat e mësipërme ishin një tregues i fortë se kërkuesit vazhdonin të ishin nën rrezikun e keqtrajtitimit në rast kthimi në Irak. Edhe pse ishte detyrim i autoriteteve suedeze të përjashtonin çdo dyshim për një rrezik të tillë të mundshëm, ata kishin dështuar ta bënë këtë në rastin në fjalë.

8. Sa i përket aftësisë së autoriteteve irakiane për të mbrojtur kërkuesit, Gjykata, duke marrë parasysh informacionet nga burime të besueshme dhe objektive, konstatoi se pavarësisht mungesës në rritje që prej vitit 2010 të kapaciteteve dhe integritetit të forcave të sigurisë dhe sistemit ligjor të Irakut, niveli i mbrojtjes i ofruar nga autoritetet irakiane mund të konsiderohej i mjaftueshëm për publikun e gjerë në Irak. Megjithatë, ajo nuk ishte e bindur nëse autoritetet irakiane do të ishin në gjendje t'u siguronin mbrojtje efektive personave që i përkisnin një grupi të targetuar nga forcat terroriste, siç ishin kërkuesit.

9. Duke pasur parasysh faktorët e lartpërmendur, të marrë në mënyrë kumulative, Gjykata vendosi se ishin parashtruar dëshmi substanciale për të besuar se kërkuesit rrezikonin realisht të trajtoheshin në kundërshtim me nenin 3 nëse do të ktheheshin në Irak. Kështu, dëbimi i tyre në Irak do të cenonte nenin 3 të Konventës.

**B. Në lidhje me nenin 41**

10. Gjykata hodhi poshtë kërkesën për kompensimin e dëmit material, me arsyetimin se nuk ishte vërtetuar një dëm i tillë. Gjithashtu, ajo refuzoi edhe pretendimin e kërkuësve për dëmin jomaterial, duke argumentuar se konstatimi i shkeljes së nenit 3 përbënte në vetvete shpërblim të drejtë. Gjykata u njohu kërkuësve të drejtën për të marrë 10 000 euro për kostot dhe shpenzimet.

**III. Komente**

11. Çështja J.K. dhe të tjerë k. Suedisë shënon një zhvillim tjetër në jurisprudencën e Gjykatës. Në kushtet e një situatë të përkeqësuar të sigurisë në përgjithësi, e shënuar nga një rritje e dhunës sektare, sulmeve dhe përhapjes së grupit të ISIS, Gjykata vërejtë se zona të mëdha të territorit të Irakut ishin jashtë kontrollit efektiv të qeverisë së Irakut. Në dritën e situatës komplekse dhe të paqëndrueshme të sigurisë, ajo vuri në dukje se kapacitetet e autoriteteve irakiane për të mbrojtur qytetarët ishin reduktuar. Megjithëse në kohën e vendimit, mbrojtja nga autoritetet irakiane ende mund të konsiderohej e mjaftueshme për publikun e gjerë, situata ishte e ndryshme për individët që i përkisnin një grupi të targetuar nga forcat terroriste, siç ishin kërkuësit. Rrethanat personale të kërkuësve të marra së bashku me kapacitetet e reduktuara të autoriteteve irakiane për t'i mbrojtur ata, krijojnë një rrezik real keqtrajtimi në rast të kthimit të tyre në Irak.

12. Mund të thuhet se faktet e këtij rasti janë tipike për një rast që ka të bëjë me azilin përpara GJEDNJ-së. Megjithatë, siç tha Gjyqtari Bianku në fjalën e tij në seminarin për hapjen e vitit gjyqësor të GJEDNJ-së më 27 janar 2017 në Strasburg, Dhoma e Madhe në mënyrë të matur dhe të mirëmenduar gjeti mundësinë për të risjellë, sistemuar dhe konsoliduar parimet e zbatueshme në rastet e azilit. Vlera e shtuar e vendimit në rastin J.K. qëndron në faktin se ai jep një përmbledhje të kriterëve ligjorë që duhet të merren parasysh në rastet e azilit. Kështu, Gjykata, pas analizimit të parimeve udhëzuese që rrjedhin nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe Komisioneri i Lartë për Refugjatë, ofroi listën e mëposhtme të parimeve të përgjithshme të zbatueshme në rastet e azilit:

13. Natyra e përgjithshme e detyrimeve që rrjedhin nga neni 3 - duke ritheksuar karakterin absolut të të drejtave të mbrojtura nga ky nen;

- a) Parimi i mos kthimit – qoftë direkt apo indirekt në vendet ku ata janë në rrezik<sup>214</sup>;
- b) Parimet e përgjithshme mbi zbatimin e nenit 3 në rastet e dëbimit - duke kujtuar të drejtën e shteteve për të rregulluar hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve, përveç rasteve kur ata ishin nën rrezikun e torturës ose trajtimeve të krahasueshme në vendin e destinacionit.;
- c) Rreziku i keqtrajtimit nga grupe private – jo vetëm rreziku që mund tu

214 Shih *Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë*, vendim [DHM] i datës 24 shkurt, nr. 27765/09, dhe *Khlaifia dhe të tjerët kundër Italisë*, vendim [DHM] i datës 15 dhjetor 2016, nr. 16483/12, të dyja të përfshira në këtë seksion.



- kanoset nga autoritet shtetërore<sup>215</sup>;
- d) Parimi *ex nunc* i vlerësimit të rrethanave – të përgjithshme dhe individuale<sup>216</sup>;
- e) Parimi i subsidiaritetit;
- f) Vlerësimi i ekzistencës së një rreziku real<sup>217</sup>;
- g) Shpërndarja e barrës së provës<sup>218</sup>;
- h) Kqtrajtimet e mëparshme, tregues të ekzistencës së një rreziku real;
- i) Përkatësia në një grup të targetuar<sup>219</sup>.

14. Ky dekalog i ofruar nga vendimi në rastin J.K. është, sipas mendimit të Gjykatës, testi që do të përdoret në shqyrtimin dhe vlerësimin e çështjeve të azilit sipas KEDNJ-së, të paktën në lidhje me nenin 3. Vendimi në rastin J.K. ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të rasteve të azilit si në nivel kombëtar ashtu edhe në Gjykatën e Strasburgut. Ajo është hartuar në një mënyrë të tillë kryesisht për të kodifikuar jurisprudencën lidhur me çështjen e azilit dhe për të lehtësuar bashkëpunimin dhe dialogun me juridiksionet kombëtare në mënyrë që të mundësohet më në fund zgjidhja e rasteve të azilit në nivel kombëtar në përputhje me këto parime të përgjithshme të Konventës.

15. Ajo që e bën veçanërisht interesant këtë vendim të Gjykatës është se, duke përcaktuar parimet përmes të cilave do të shqyrtohen rastet e azilit, ajo derivon nga qëndrimi tradicional i saj. Qëndrimi tradicional, gjithmonë kishte si pikënisje “... të drejtën e Shteteve kontraktuese për të kontrolluar hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve, e drejtë kjo e mirë përcaktuar në të drejtën ndërkombëtare dhe që i nënshtrohej detyrimeve që rridhnin nga traktatet, përfshirë Konventën”<sup>220</sup>. Më pas, Gjykata vërejtiti se “Dëbimi, ekstradimi ose ndonjë masë tjetër për të larguar një të huaj mund të ngrejë një çështje sipas nenit 3 të Konventës dhe për rrjedhojë të sjellë përgjegjësinë e shtetit dëbues sipas Konventës, kur janë parashtruar dëshmi substanciale që të bëjnë të besosh se personi në fjalë, nëse dëbohet në vendin pritës, do të përballlet me një rrezik real trajtimi në kundërshtim me nenin 3. Në rrethana të tilla, neni 3 nënkupton një detyrim për të mos e dëbuar personin në atë vend”<sup>221</sup>. Interesante është që ky rregull është përmbysur disi në vendimin në rastin J.K. Është me të vërtetë e rëndësishme të theksohet se në vendimin J.K.

215 Shih p.sh. *Salah Sheekh kundër Hollandës*, vendim i datës 11 janar 2007, nr. 1948/04, *Ahmed kundër Austrisë*, vendim i datës 17 dhjetor, nr. 25964/94 dhe *Sufi dhe Elmi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 28 qershor 2011, nr. 8319/07 dhe 11449/07, të gjitha të përfshira në këtë seksion.

216 Shih *F.G. k. Suedisë*, [DHM] vendim i datës 23 mars 2016, nr. 43611/11.

217 Shih *Sufi dhe Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 28 qershor 2011, nr. 8319/07 dhe 11449/07, gjithashtu të përfshira në këtë seksion.

218 Shih *Tarakhel k. Zvicrës*, [DHM] vendim i datës 4 nëntor 2014, nr. 29217/12.

219 Në vendimin për çështjen *Salah Sheekh kundër Hollandës*, të datës 11 janar 2007, nr. 1948/04, gjithashtu i përfshirë në këtë udhëzues, Gjykata konstatoi se kërkuesve, të cilët i përkisnin një grupi njerëzish që ishin nën rrezikun e keqtrajtimit të ndaluar, nuk u kërkohet domosdoshmërisht të tregojnë se ata ishin më në rrezik sesa anëtarët e tjerë të grupit, por testi mbetet personal për të gjithë ata që i përkisnin një grupi të caktuar.

220 Shih, ndër të tjera, *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i datës 28 maj 1985, nr. 9214/80, 9473/81 dhe 9474/81, *Boujlifa kundër Francës*, vendim i datës 21 tetor 1997, nr. 25404/94 dhe *Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë*, vendim [DHM] i datës 23 shkurt 2012, nr. 27765/09.

221 Shih p.sh. *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i datës 7 korrik 1989, nr. 14038/88, *Ahmed kundër Austrisë*, vendimi i datës 17 dhjetor, nr. 25964/94, *Jabari kundër Turqisë*, vendim i datës 11 korrik 2000, nr. 40035/98 dhe *Salah Sheekh kundër Hollandës*, vendim i datës 11 janar 2007, nr. 1948/04, nga të cilat tre të fundit janë përfshirë gjithashtu në këtë seksion.

Dhoma e Madhe kujton së pari karakterin absolut të nenit 3 dhe pastaj vazhdon me kriteret e tjera. Pavarësisht interpretimit kumulativ të të gjitha kriterëve, pyetja është nëse një riorganizim i tillë shërben si udhërrëfyes për analizën gjyqësore të rasteve të azilit në Strasburg ose në nivel kombëtar, duke treguar se cili element ka përparësi ndaj të tjerëve në marrjen e një vendimi në një rast konkret.

## PAPOSHVILI kundër BELGJIKËS

(kërkesa nr. 41738/10)

13 dhjetor 2016

Dhomë e Madhe

*dështimi i autoriteve për të marrë në konsideratë shëndetin e kërkuarit gjatë procedurave të dëbimit të tij, do të kishte çuar në trajtim cnjerezor dhe poshtërues, në shkelje të nenit 3*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuari, Georgie Paposhvili, ishte një shtetas gjeorgjian i lindur në vitin 1958 që jetonte në Bruksel. Ai ndërroi jetë më 7 qershor 2016. Më 20 qershor 2016 gruaja e kërkuarit dhe tre fëmijët e tyre shprehën dëshirën për të vazhduar procedurat para Gjykatës.

2. Z. Paposhvili mbërriti në Belgjikë më 25 nëntor 1998, shoqëruar nga gruaja e tij dhe fëmija i tyre gjashtë vjeçar. Çifti më pas pati edhe dy fëmijë të tjerë. Midis viteve 1998 dhe 2007 z. Paposhvili u shpall fajtor për një numër veprash penale, përfshirë grabitje me dhunë dhe pjesëmarrje në një organizatë kriminale. Ndërkohë që vuante dënimet me burgim, z. Paposhvili u diagnostikua me një sërë sëmundjesh, përfshirë leukeminë limfotike kronike dhe tuberkulozin, për të cilat mori trajtim spitalor. Duke u mbështetur në nenet 3 dhe 8 të Konventës, ai paraqiti disa kërkesa të pasuksesshme për rregullimin e statusit të tij të qëndrimit në Belgjikë për arsye të jashtëzakonshme dhe mjekësore, me pretendimin se nëse kthehej në Gjeorgji nuk do mund të merrte trajtimin e nevojshëm.

3. Në gusht të vitit 2007, Ministri i Brendshëm lëshoi një urdhër për dëbimin e kërkuarit dhe ndalimin për t'u rifutur në Belgjikë për dhjetë vjet pasi përbënte rrezik për rendin publik. Urdhri do të bëhej i zbatueshëm pasi z. Paposhvili të përfundonte dënimin e tij, por në fakt nuk u zbatua, pasi ai ishte duke u trajtuar. Më 7 korrik 2010, Zyra e të Huajve lëshoi një urdhër për largimin e tij nga vendi, së bashku me një urdhër për ndalimin e tij. Kërkuari u transferua në një vendqendrim për emigrantët e paligjshëm me qëllim kthimin e tij në Gjeorgji dhe u pajis me dokumentet e udhëtimit.

4. Më 23 korrik 2010, z. Paposhvili bëri kërkesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për zbatimin e një masë të përkohshme sipas nenit 39 të Rregullores me qëllim pezullimin e dëbimit të tij nga Belgjika. Gjykata vendosi pezullimin e dëbimit të tij. Më pas kërkuesi u lirua. Afati për zbatimin e urdhrit për të lënë territorin belg u shty disa herë. Në nëntor të vitit 2009, gruaja e kërkuesit dhe tre fëmijët e tij u lejuan të qëndronin në Belgjikë. Midis viteve 2012 dhe 2015 z. Paposhvili u arrestua disa herë për vjedhje dyqani.

5. Kërkuesi, duke u mbështetur në të drejtën e jetës sipas nenit 2 dhe ndalimin e trajtimit çnjerëzor ose poshtëruar sipas nenit 3, pretendonte se kishte arsye të konsiderueshme për të besuar se nëse dëbohej në Gjeorgji, do të përballej me rrezikun real të trajtimit çnjerëzor e degradues apo vdekje të parakohshme. Ai gjithashtu pretendoi, sipas nenit 8, se nëse dëbohej nuk do mund të qëndronte me familjen e tij, e cila ishte mbështetja e vetme morale për të.

## II. Vendimi i Gjykatës

6. Më 17 prill 2014, një Dhomë e Gjykatës vendosi se nuk ka pasur shkelje të neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës. Më 20 prill 2015, kolegji i Dhomës së Madhe pranoi kërkesën në emër të kërkuesit për referimin e çështjes tek Dhoma e Madhe sipas nenit 43 të Konventës. Gjykata konstatoi se duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve dhe rolin e sistemit të Konventës, fakti që kërkuesi kishte ndërruar jetë nuk përbënte pengesë për vazhdimin e gjykimit të çështjes.

### A. Në lidhje me nenet 2 dhe 3

7. Gjykata ripohoi të drejtën e të gjitha Shteteve Kontraktuese për të kontrolluar hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve. Megjithatë, nëse ekzistonte besimi i bazuar se personi në fjalë, pas dëbimit, do të përballej me një rrezik real për t'iu nënshtruar torturës ose trajtimit çnjerëzor dhe degradues, neni 3 i detyronte shtetet të mos e dëbonin personin në fjalë. Cfarë konsiderohej keqtrajtim varej nga rrethanat e rastit, të tilla si kohëzgjatja e trajtimit, efektet fizike dhe mendore, dhe në disa raste, gjinia, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Vuajtjet e shkaktuara për shkak të një sëmundje mund të përfshihen në fushëveprimin e nenit 3, nëse ato përkeqësohen për shkak të trajtimit nga ana e autoriteteve shtetërore.

8. Gjykata pasi analizoi jurisprudencën e saj, arriti në përfundimin se zbatimi i deritanishëm i nenit 3 nuk ofronte mbrojtjen e nevojshme për të huajt të cilit ishin të sëmurë rëndë (në ndryshim nga ata që ishin në prag të vdekjes). Gjykata vlerësoi se "rastet e tjera shumë të jashtëzakonshme", në kuptimin e vendimit në çështjen *N. kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>222</sup> të cilat mund të ngrenë një çështje sipas nenit 3, i referohen situatave që kanë të bëjnë me dëbimin e një personi të sëmurë rëndë, kur ka arsye thelbësore për të besuar se ai do të përballej me rrezikun real, për shkak të mungesës së trajtimit të duhur në vendin pritës ose

222 *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [DHM] i 27 majit 2008, nr. 26565/05, i përhurë në këtë seksion.

mungesës së aksesit ndaj një trajtimi të tillë, të përkeqësimit serioz, të shpejtë dhe të pakthyeshëm të gjendjes së tij shëndetësore, çka do të çonte në vuajtje të shtuara ose në një reduktim të ndjeshëm të jetëgjatësisë.

9. Shteti është i detyruar të vlerësojë rreziqet me të cilat kërkuesi mund të përballet nëse do të dëbohet në vendin pritës, në mënyrë që të përmbushë detyrimin e tij negativ për të mos ekspozuar personat ndaj rrezikut të keqtrajtimin. Shteti duhet të verifikojë nëse trajtimi shëndetësor në shtetin pritës është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm në praktikë për trajtimin e sëmundjes së kërkuesit dhe nëse personi në fjalë ka faktikisht mundësi për ta marrë një trajtim të tillë. Nëse ekzistojnë dyshime serioze në lidhje me ndikimin e dëbimit, Shteti kthyes duhet të marrë garanci individuale dhe të mjaftueshme nga Shteti pritës që personit do ti ofrohet trajtimi i duhur. Në rastin në fjalë, kërkuesi, kishte parashtruar informacione të hollësishme mjekësore, se si trajtimi në Belgjikë kishte bërë që gjendja e tij shëndetësore të ishte e qëndrueshme dhe se nëse trajtimi ndërpritej, nuk do ti mbeteshin më shumë se gjashtë muaj jetë. Gjithashtu kërkuesi kishte pohuar se në Gjeorgji mungonte qoftë trajtimi, qoftë transplantimi i organeve të dhuruara.

10. Pavarësisht fakteve të mësipërme, kërkesat e z.Paposhvili për tu pajisur me letra të rregullta qëndrimi për arsye mjekësore u refuzua nga Zyra e të Huajve. Bordi i Ankesave për të Huajt konstatoi se, kur autoriteti administrativ parashtronte arsyet për përjashtim, nuk ishte e nevojshme që ai të shqyrtonte provat mjekësore të paraqitura. Lidhur me ankesat e bazuara në nenin 3 të Konventës, Bordi i Ankesave për të Huajt vuri në dukje se vendimi që refuzonte lejen për të qëndruar nuk ishte shoqëruar me një masë largimi, kështu që rreziku i ndërprerjes së trajtimit mjekësor të kërkuesit në rast se kthehej në Gjeorgji ishte thjesht hipotetik. Këshilli i Shtetit, në të cilin kërkuesi apeloj për çështje të ligjit, mbështeti arsyetimin e Bordit të Ankesave për të Huajt.

11. Duke qenë se raportet mjekësore të kërkuesit nuk ishin marrë parasysh nga Zyra për të Huajt apo Bordi i Ankesave për të Huajt në prespektivën e nenit 3 gjatë procedurave për lejimin ose jo të qëndrimit të kërkuesit, Gjykata arriti në përfundimin se nëse kërkuesi kthehej në Gjeorgji, do të shkelej neni 3 i Konventës. Kështu, Gjykata e konsideroi të panevojshme shqyrtimin e pretendimeve sipas nenit 2 të Konventës.

### ***B. Në lidhje me nenin 8***

12. Bordi i Ankesave për të Huajt e hodhi poshtë kërkesën e z. Paposhvili sipas nenit 8, me arsyetimin se vendimi që refuzonte lejen e qëndrimit nuk ishte i shoqëruar me një masë largimi. Megjithatë, Gjykata vlerësoi se autoritetet kombëtare duhet të bënin një vlerësim të ndikimit që do të kishte dëbimi i z. Paposhvili në jetën familjare të tij në dritën e gjendjes së tij shëndetësore; kjo përbënte një detyrim procedural për autoritetet në mënyrë që të garantonin efektivitetin e së drejtës për respektimin e jetës familjare. Shteti duhet të kishte shqyrtuar nëse do të mundej familja e kërkuesit ta ndiqte atë në Gjeorgji

nëse dëbohej dhe nëse nuk do mundej, a kërkonte respektimi i të drejtës së z. Paposhvili për respektimin e jetës së tij familjare që atij ti jepej leja e qëndrimit në Belgjikë, për kohën që i kishte mbetur për të jetuar. Kështu, Gjykata vendosi që nëse z. Paposhvili do të ishte dëbuar në Gjeorgji pa vlerësuar këto faktorë, do të kishte pasur gjithashtu një shkelje e nenit 8 të Konventës.

### C. Në lidhje me nenin 42

13. Gjykata u shpreh se konstatimi i shkeljes së neneve 3 dhe 8 të Konventës përbënte shpërblim të drejtë në lidhje me çdo dëm jo material që z. Paposhvili mund të kishte pësuar. Gjithashtu ajo vendosi që Belgjika t'i paguante familjes së z. Paposhvilit 5,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

## III. Koment

14. Ky vendim është me interes për një numër të madh rastesh që kanë të bëjnë me dëbimin e personave të sëmurë në një destinacion, ku mungesa e trajtimit të duhur mjekësor mund të angazhojë nenin 3. Është e njohur tashmë se Konventa ndalon dëbimin ose ekstradimin e personave, nëse ata do të ekspozoheshin ndaj një rreziku real të torturës ose trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor ose poshtërues, qoftë nga agjentë shtetërorë apo joshetërorë. Megjithatë, këto raste nuk kanë të bëjnë me keqtrajtim të qëllimshëm, por me pamundësinë e autoriteteve të shtetit pritës për t'i ofruar personit në fjalë një trajtim të përshtatshëm për kushtet e tij mjekësore. Përveç parimit të përgjithshëm që Shtetet kanë të drejtën të rregullojnë hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve, në raste specifike që kanë të bëjnë me kushtet shëndetësore të personave, arsyetimi i Gjykatës bazohet edhe në premisën se të huajt që janë subjekt i dëbimit, nuk mundën, në parim, të pretendojnë të drejtën për të qëndruar në territorin e një Shteti Kontraktues në mënyrë që të vazhdojnë të përfitojnë nga trajtime mjekësore, sociale ose forma të tjera ndihme dhe shërbimesh të ofruara nga shteti që e dëbon. Prandaj shumica e këtyre rasteve shpallen të papranueshme nga Gjykata.<sup>223</sup>

15. Megjithatë, në rastin *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>224</sup>, për herë të parë Gjykata konstatoi se kur ekziston një kombinim i jashtëzakonshëm i faktorëve, largimi i një individi i cili edhe pse nuk rrezikonte të keqtrajtohej, do të përballej me kushte çnjerëzore dhe degraduese për shkak të mungesës së trajtimit të duhur mjekësor në vendit të tij të destinacionit, do të përbënte një shkelje të nenit 3. Në atë rast rrethanat e jashtëzakonshme ishin se kërkuesi gjendej në situatë kritike shëndetësore dhe dukej të ishte afër fundit të jetës, nuk mund t'i garantohej një kujdes mjekësor në vendin e tij të origjinës dhe nuk kishte familjarë atje të gatshëm apo të aftë për t'u kujdesur për të apo t'i ofronin qoftë strehim, ushqim apo mbështetje sociale.

223 Shih për shëmbull *Karara k. Finlandës*, vendim i 29 majit 1998, nr. 40900/98, *S.C.C. k. Suedisë*, vendim i 15 shkurtit 2000, nr. 46553/99, *Arcila Henao k. Hollandës*, vendim i 24 qershorit 2003, nr. 13669/03, *Ndangoya k. Suedisë*, vendim i 24 qershorit 2004, nr. 17868/03, dhe *Amegnigan k. Hollandës*, vendim i 25 nëntorit 2004, nr. 25629/04.

224 *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 2 majit 1997, nr. 30240/96.



16. Pas rasti të D.-së, Gjykata pati mundësinë të gjykonte themelin e çështjes *N. kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>225</sup>. Gjykata në këtë vendim konfirmoi parimet e përgjithshme të zbatuara në rastin e D.-së Megjithatë, shumica e Dhomës së Madhe, duke kujtuar pragun e lartë të kërkuar në zbatimin e nenin 3, vendosi se dëbimi i N. nuk do të shkelte nenin 3. Shumica vlerësuan se N. në ndryshim nga D. nuk ishte në fund të jetës së tij dhe medikamentet e AIDS gjendeshin në Ugandë, megjithëse jo aq të aksesueshme apo në cilësinë që gjendeshin në Mbretërinë e Bashkuar. Shumica e gjyqtarëve pohuan se KEDNJ-ja ishte kryesisht për mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike dhe jo për mbrojtjen e të drejtave ekonomike, sociale apo kulturore. Tre gjyqtarë të Dhomës së Madhe dolën fuqimisht kundra arsyetimit dhe gjetjeve të fakteve të shumicës, duke i konsideruar si të papranueshme. Ata ishin veçanërisht kritikë ndaj supozimit se shqetësimet rreth burimeve në vendin pritës mund të ndikonin situatat në të cilat angazhohej qartazi neni 3.<sup>226</sup>

17. Pas vendimit *N. kundër Mbretërisë së Bashkuar* e njëjta pyetje është ngritur në mënyrë të përsëritur para Gjykatës dhe duket se tërheq veçanërisht vëmendjen e Gjykatës së Strasburgut.<sup>227</sup> Një përpjekje tjetër nga Dhoma e Madhe për t'u marrë me këtë çështje në rastin e *S.J. k. Belgjikës*, u përjashtua pas një oferte nga autoritetet belge për lejimin e qendrimit të pakufizuar për kërkuesin dhe tre fëmijët e saj, bazur në "konsiderata të forta humanitare".<sup>228</sup>

18. Rasti *Paposhvili* ishte hera e katërt që Gjykata e trajtoi këtë temë në një formacion të Dhomës së Madhe. Siç tha gjykatësi Lemmens në mendimin e tij paralel, vendimi i Paposhvilit "qartëson jurisprudencën tonë në mënyrë që të plotësohet ky boshllëk duke ruajtur pragun e lartë për zbatimin e nenit 3 të Konventës". Ai vazhdoi duke thënë se "vendimi mund të shihet si përgjigje e Gjykatës ndaj shqetësimit të shprehur nga Bordi i Gjyqtarëve për të Huajt, lidhur me problemin e zbatimit të rreptë të jurisprudencës së *N. kundër Mbretërisë së Bashkuar*". Pavarësisht nga fakti se vendimi unanim i Dhomës së Madhe ruan pragun e lartë "të rrethanave të jashtëzakonshme" të vendosur në çështjen *D. k. Mbretërisë së Bashkuar* dhe të konfirmuar në çështjen *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, sqaron se në këto lloj rastesh është i nevojshëm një vlerësim më rigoroz i rrezikut. Në fakt vendimi pranon se jo vetëm kur jemi në kushte të kërcënimit të jetës kemi të bëjmë me rrethana të jashtëzakonshme. Kjo qasje ofron një interpretim më autonom të nenit 3 krahasuar me nenin 2 dhe konfirmon edhe një herë qëndrimin në rastin *F.G. k. Suedisë*<sup>229</sup>, duke theksuar nevojën për një analizë të të gjithë faktorëve relevantë në situatën personale dhe familjare të azilkërkuesit sipas nenit 3 dhe gjithashtu nenit 8 të Konventës.

225 *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim [DHM] i 27 majit 2008, nr. 26565/05, i përfshirë në këtë seksion.

226 Shih mendimin e fortë kundra të gjyqtarëve Tulkens, Bonello dhe Spielman.

227 Shih për shëmbull *S.H.H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 29 janarit 2013, nr. 60367/10, *I.K. k. Austrisë*, vendim i 28 marsit 2013, nr. 2964/12, dhe *Senchishak k. Finlandës*, vendim i 18 nëntorit, nr. 20145049/12.

228 *S.J. k. Belgjikës*, vendim [DHM] i 19 marsit 2015, nr. 70055/10.

229 *F.G. k. Suedisë*, vendim [DHM] i 23 marsit 2016, nr. 43611/11.



## HENAF kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 65436/01)

27 nëntor 2003

*në këtë çështje Gjykata vendosi se kishte shkelje të nenit 3 në lidhje me mënyrën se si ishte trajtuar një i burgosur në pozita të veçanta*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Albert Hénaf është shtetas francez i cili ka lindur më 1925 dhe aktualisht është i burgosur në Nantë. Ai ishte dënuar për kryerjen e disa veprave penale. Në veçanti ishte dënuar me dhjetë vjet burg për vjedhje me armë. Në vitin 1998 ai ishte dënuar gjithashtu me gjashtë muaj burg sepse nuk ishte kthyer në burg pas një leje që i ishte dhënë për largim të përkohshëm. Ekspertët që e analizuan gjendjen e tij e argumentuan qëndrimin me një çrregullim psikologjik që kishte cenuar aftësinë e tij për të gjykuar, duke pasur veçanërisht parasysh edhe moshën e tij të madhe.

2. Më 7 nëntor 2000 u transferua në Spitalin e Bordosë me qëllim që të nesërmen t'i nënshtrohej një operacioni. Drejtori i burgut kishte dhënë orientime të sakta në lidhje me kushtet në të cilat kërkuesi duhet të çohet në spital, duke kërkuar një eskortë policie që ta shoqëronte gjatë gjithë kohës që ai do qëndronte atje dhe duke zbatuar një nivel normal mbikëqyrjeje por që do të zbatohet sipas vlerësimit të oficerit të policisë që drejtonte eskortën.

3. Ndërkohë që e çonin në spital kërkuesit iu vunë prangat, të cilat nuk iu hoqën edhe për pjesën tjetër të ditës. Natën përpara operacionit kërkuesi u lidh me pranga në krahun e krevatit. Ai u ankua në lidhje me kushtet çnjerëzore në të cilat u mbajt në spital dhe për këtë arsye refuzoi të operohej dhe u kthye në burg. Ai bëri një padi penale kundër oficerëve të policisë që e kishin shoqëruar duke pretenduar trajtime serioze çnjerëzore dhe torturë. Në maj 2001 padia e tij u deklarua e papranueshme për shkak se nuk i ishte paguar gjykatës shuma për mbulimin e shpenzimeve procedurale.

4. Pasi vuajti dënimin e tij kërkuesi u lirua në 1 tetor 2001. Më vonë ai u fut përsëri në burg në lidhje me vepra të tjera penale.

5. Duke u bazuar në moshën dhe në gjendjen e tij shëndetësore, kërkuesi ankohej në lidhje me kushtet e mbajtjes së tij në spital dhe pretendonte se ai i ishte nënshtruar një trajtimi që ishte në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

6. Përsa i përket rrezikut që përfaqësonte kërkuesi, Gjykata mbajti parasysh se ai ishte dënuar disa herë më parë, por që nuk kishte pasur ndonjë referencë të qartë në akte dhune. Gjykata e vlerësoi gjithashtu faktin që më 1998 kërkuesi nuk ishte kthyer në burg pas një periudhe leje, por kjo ngjarje që sipas ekspertëve kishte ardhur si pasojë e një “çrregullimi psikologjik”, kishte qenë jo e dhunshme dhe nuk ishte e përsëritur.

7. Sipas mendimit të Gjykatës nuk doli në pah që në kohën e shtrimit në spital kërkuesi të përfaqësonte ndonjë rrezik. Kjo dilte mjaft qartë nga direktivat e dhëna nga drejtori i burgut i cili rekomandonte një nivel normal dhe jo të rreptë mbikëqyrjeje gjatë kohës kur kërkuesi do transferohej në spital si dhe gjatë qëndrimit të tij atje. Sidoqoftë, niveli i rrezikut që pretendohet se ai përfaqësonte nuk mund të justifikonte lidhjen e tij në spitalin e burgut një natë përpara operacionit të tij, sidomos duke pasur parasysh që dy policë bënë rojë tek dera e dhomës së tij.

8. Duke pasur parasysh moshën e kërkuesit, gjendjen e tij shëndetësore, mungesën e precedentëve që të bënin të mendoje se ai përfaqësonte një rrezik për sigurinë, direktivat me shkrim të drejtorit të burgut që rekomandonin një nivel normal dhe jo të përforcuar mbikëqyrjeje si dhe faktin se të nesërmen e transferimit në spital kërkuesi duhet t'i nënshtrohej një operacioni, Gjykata vlerësoi se kufizimet ndaj lirisë së tij të lëvizjes nuk kishin qenë në proporcion me kërkesat e sigurisë. Kjo aq më tepër po të rivlerësohej fakti që dy policë bënë rojë tek dera e dhomës së tij.

9. Gjykata e vlerësoi të rëndësishme mbajtjen parasysh të faktit që në raportin drejtuar qeverisë franceze në vijim të vizitës së tij të majit 2000, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve Çnjerëzore ose Degraduese (KPT) ndërmjet të tjerash kishte rekomanduar që praktika e lidhjes për arsye sigurie të të burgosurve në shtretërit e spitaleve ku ata mjekoheshin, ishte e paligjshme.

10. Në këto rrethana, trajtimi i kërkuesit nga ana e autoriteteve franceze nuk ka qenë në përputhje me nenin 3 të Konventës.

## III. Koment

11. Ky vendim plotëson qëndrimet e Gjykatës të mbajtura në rastet e çështjeve *Mousiel kundër Francës*<sup>230</sup> dhe *Van der Ven dhe Lorse kundër Holandës*<sup>231</sup> pikërisht në

230 Vendim i 14 nëntorit 2002.

231 Vendim i 4 shkurtit 2003.

lidhje me respektimin e dinjitetit njerëzor në trajtimin e të burgosurve, veçanërisht të atyre në pozita të dobëta si ato të një të moshuari 75 vjeçar, në këtë rast. Duhet vënë në dukje se sistemet ligjore të disa shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, personat në një moshë të tillë ose të përafërt nuk mbahen fare në burg.

12. Duhet ripërsëritur me forcë në kuadrin e këtij vendimi një nga konceptet më të rëndësishme të Konventës – ai që një i burgosur gëzon të paprekura të gjitha të drejtat e parashikuara nga Konventa me përjashtim të së drejtës për të qenë i lirë. Çdo ndërhyrje ndaj këtyre të drejtave, sado e parëndësishme që të jetë, duhet të justifikohet si e nevojshme dhe në proporcion me ruajtjen e rendit dhe rregullit në burg, ose për arsye sigurie. Në raste si ky që po komentojmë, veprimet e autoriteteve shkelën ndalimin absolut të parashikuar nga ana e nenit 3 kështuqë nuk mund të pranohet asnjë justifikim në lidhje me ndërhyrjen.

## PRICE kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 33394/96)

10 korrik 2001

*dënimi me burg i personave të sëmurë mund të çojë në shkelje të nenit 3 të Konventës kur kushtet nuk iu përshtaten nevojave të tyre specifike*

### I. Faktet kryesore

1. Adele Price, shtetase britanike, është e paralizuar në të katër gjymtyrët e saj si rezultat i fokomelisë të shkaktuar nga Talidomidi. Ajo vuan gjithashtu nga probleme me veshkat.

2. Më 20 janar 1995, gjatë procedurave në një proces civil në Gjykatën e Rrethit Lincoln në lidhje me një vendim për pagim borxhi, ajo refuzoi që t'u përgjigjej pyetjeve që iu bënë në lidhje me gjendjen e saj financiare dhe u dënua me shtatë ditë burg për cenim të rolit të gjykatës. Gjyqtari i çështjes nuk ndërmori asnjë hetim në lidhje me mundësinë e ndalimit të kërkuases përpara se ta dënonte menjëherë me burgim. Duke pasur parasysh që seanca në lidhje me çështjen në fjalë ishte zhvilluar një pasdite, nuk kishte qenë e mundur që ajo të çohet në burg deri të nesërmen dhe kështu që ishte detyruar që ta kalonte natën në një qeli në Stacionin e Policisë në Lincoln. Kjo qeli, vetëm me një krevat druri dhe me një dyshek, nuk ishte posaçërisht e përshtatshme për persona me të meta fizike. Kërkuësja pretendoi që kishte qenë e detyruar të flinte në karrigen e saj me rrota përderisa krevati ishte i fortë dhe mund t'i kishte shkaktuar dhimbje në vertebrat e saj, se butonat e ndihmës së shpejtë dhe çelësat e dritave ishin jashtë mundësive të saj për t'i arritur dhe se ajo nuk kishte qenë në gjendje të përdorte tualetin përderisa ishte më i lartë sesa karrigia e saj me rrota.

3. Gjatë ndalimit të saj në qelinë e policisë, të dhënat nga rojat treguan se ajo ishte ankuar çdo gjysmë ore për të ftohtin – që është një problem serioz për personat që vuajnë nga veshkat dhe që për më tepër, për shkak të paralizës së gjymtyrëve, nuk mund as të lëviznin për t'u ngrohur. Si përfundim u thirr një mjek, i cili vuri në dukje se ajo nuk mund të përdorte krevatin dhe se i ishte dashur të flinte në karrigen e saj me rrota, se kushtet e qelisë nuk ishin të përshtatshme për nevojat e një personi me të meta fizike dhe se qelia ishte shumë e ftohtë. Asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë nga ana e oficerëve të policisë, përgjegjës për ruajtjen e kërkueses, për të siguruar që ajo të çohet në një vend më të përshtatshëm ndalimi ose edhe të lirohet. Përkundrazi, ajo kishte qenë e detyruar të qëndronte në qeli për gjithë natën, pavarësisht se mjeku e mbuloi atë me një batanije dhe i dha disa ilaçe qetësuese.

4. Të nesërmen ajo u çua në Burgun e ri të Grave në Wakefield, ku u mbajt në Qendrën e Kujdesit Shëndetësor të burgut deri në pasditen e 23 janarit 1995. Qelia e saj kishte një derë të madhe në të cilën mund të hyhej me karrocë me rrota, një tualet me mbështetëse si dhe një krevat hidraulik spitali. Megjithatë, kërkuesja kishte pasur probleme me gjumin përderisa krevati ishte shumë i madh dhe kushtet higjienike jo të përshtatshme. Gjatë natës së parë të burgut, regjistri i kujdestarëve shënonte se kujdestarja që kishte pasur shërbimin atë natë kishte qenë e pafuqishme ta ngrinte vetëm kërkuesen dhe kishte pasur vështirësi për ta ndihmuar atë të përdorte tualetin. Kërkuesja pretendoi se, si rezultat, ajo i ishte nënshtruar një trajtimi tejet poshtërues në duart e oficerëve meshkuj të burgut. Qeveria e mohoi dëshminë e saj, por gjithsesi dukej qartë se oficerët meshkuj ishin thirrur në ndihmë për ta çuar kërkuesen në tualet.

5. Që nga koha e lirimit të saj, kërkueses i ishte dashur të urinonte me aparatura të posaçme për arsye se vështirësia për të shkuar në tualet i kishte shkaktuar probleme në urinim. Ajo pretendonte se kishte vuajtur probleme shëndetësore për afro dhjetë javë pas lirimit, por që nuk kishte asnjë provë mjekësore për të mbështetur pretendimin e saj.

6. Kërkuesja pretendonte se burgimi i saj dhe trajtimi i gjatë burgimit përbënin shkelje të nenit 3.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

7. Gjykata e vlerësoi si domethënës faktin që provat shkresore të paraqitura nga ana e qeverisë, përfshirë ato të burgut si dhe raportet mjekësore, vinin në dukje se policia dhe autoritetet e burgut nuk ishin në gjendjen e kërkuar për të plotësuar nevojat e veçanta të kërkueses.

8. Gjykata vuri në dukje se kishte shënime, në dosjen e pranimit të kërkueses në burg, nga ana e mjekut dhe e kujdestarëve të cilët shprehnin shqetësime

në lidhje me problemet që ajo do të duhej të përballonte gjatë burgimit të saj, përfshirë këtu edhe mundësinë për t'iu afruar krevatit apo tualetit, higjienën dhe ushqimin, si dhe mundësinë për të lëvizur nëse bateria e karrocës së saj binte. Për shkak të këtyre shqetësimeve drejtori i burgut e kishte autorizuar stafin që të përpiqej për t'i gjetur kërkueses një vend në një spital jashtë burgut. Sidoqoftë, ata nuk kishin qenë në gjendje ta transferonin atë për shkak se, sipas tyre, ajo nuk po ankohej për ndonjë arsye të veçantë mjekësore.

9. Gjykata nuk gjeti ndonjë provë në lidhje me ndonjë synim për ta fyer ose përrulur kërkuesen. Megjithatë, ajo konsideroi se burgimi i një personi krejt të paaftë në kushtet ku ajo ishte në të ftohtë në mënyrë të rrezikshme për shëndetin e saj, rrezikonte të krijonte dhimbje për shkak se krevati i saj ishte tepër i fortë dhe i paarritshëm prej saj, fakti që ajo nuk ishte në gjendje të shkonte në tualet ose të pastrohej pa probleme të mëdha, përbënin trajtim degradues në kundërshtim me nenin 3.

### ***B. Në lidhje me nenin 41***

10. Në bazë të nenit 41 të Konventës Gjykata i akordoi kërkueses 4 500 sterlina për dëm jo-material dhe 4 000 sterlina për shpenzime dhe pagesa ligjore.

## **III. Koment**

11. Gjykata pra, konstatoi se mbajtja e një personi me të meta fizike themelore në kushte të tilla si ato të rastit në fjalë, përbënte një shkelje të nenit 3. Pati dy mendime të kundërta në këtë çështje. Sipas mendimit të gjyqtarëve Bratza dhe Costa, përgjegjësia themelore për çfarë ndodhi nuk i takonte policisë ose autoriteteve të burgut, por autoriteteve gjyqësore të cilat e dënuan kërkuesen me një burgim me efekt të menjëhershëm. Megjithatë, gjyqtarja Greve, ishte e mendimit se të gjithë bashkë, edhe gjyqtari dhe policia dhe autoritetet e burgut kishin pasur rol në kryerjen e shkeljes. Vendimi i Gjykatës duket se e shmang përgjegjësinë në lidhje me ndonjë autoritet të veçantë<sup>232</sup>, dhe përqendrohet në qartësimin e faktit që trajtimi në fjalë ishte çnjerëzor dhe degradues dhe përbënte një shkelje të nenit 3.

12. Përpara këtij vendimi asnjë rast nuk kishte arritur që të kishte sukses në kuadrin e nenit 3, përsa i përket mungesës së ofrimit të kujdesit të duhur mjekësor një të burgosuri. Në shqyrtimin e çështjeve në lidhje me gjendjen shëndetësore të një të burgosuri Gjykata i kushton vëmendje të veçantë qëndrimit të shteteve në mbajtjen e raporteve mjekësore dhe veprimeve sipas rekomandimeve të dhëna nga mjekët. Në qoftë se autoriteti në fjalë ka qenë në gjendje të tregojë se ai ka marrë masat e arsyeshme dhe të nevojshme për të trajtuar të burgosurit, si për shembull transferimin në një spital ose repart të posaçëm të pajisur me kushtet e përshtatshme për nevojat e personave me të meta fizike ose mendore, është e vështirë që Gjykata të konstatojë shkelje. Në qoftë se gjendja e vështirë

<sup>232</sup> Shih në lidhje me këtë pozicionim të Gjykatës së Strasburgut "*Të drejtat e njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komentë*", fq. 35. Botim i Qendrës Evropiane, Tiranë 2001.

shëndetësore e të burgosurit është shkaktuar nga vetë burgimi, Gjykata do të vlerësojë trajtimin mjekësor që i është ofruar të burgosurit si dhe vullnetin e tij për t'i përdorur mundësitë që i jepen në mbrojtje të shëndetit të tij.

13. Paragrafi 1 i Rekomandimit të Komitetit të ministrave Nr. R (87) 3 në lidhje me Rregullat Evropiane të Burgjeve shpall se “privimi i lirisë duhet të kryhet në kushte të tilla materiale dhe morale që respektojnë dinjitetin njerëzor dhe janë në përputhje me këto rregulla”. Në Rekomandimin e tij Nr. R (98) 7 në lidhje me Aspekte Etike dhe Organizative të Kujdesit Mjekësor në Burgje, Komiteti vë në dukje se që të jenë në përputhje me këtë paragraf që ka të bëjë me të burgosur me të meta serioze fizike, duhen nxjerrë dispozita të përshtatshme për të mundësuar përdorimin e karrocave me rrota, ndihmesën në veprimtaritë e përditshme, etj.. Siç e vë në dukje gjyqtari Greve në mendimin e tij paralel, trajtimi që nuk do të mund të konsiderohej as çnjerëzor, as degradues për një person të aftë fizikisht, mund të konsiderohej i tillë për një person me nevoja të veçanta. Kërkuesja në këtë rast do duhej të ishte trajtuar ndryshe nga persona të tjerë për shkak se gjendja e saj shëndetësore ishte krejtësisht e ndryshme.

## HILAL kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa 45276/99)

6 mars 2001

*mosdhënia e statusit të azilantit ndaj personave që rrezikojnë t'i nënshtrohen torturës ose trajtimeve çnjerëzore apo degraduese në vendet e destinacionit përbën shkelje të nenit 3 të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Said Mohamed Hilal, një shtetas Tanzanez nga Pemba, një prej ishujve të Zanzibarit, kërkoi azil në Mbretërinë e Bashkuar më 9 shkurt 1995. Azili iu refuzua për shkak se pretendimi i tij nuk ishte i besueshëm dhe se përgjigjet që ai dha gjatë intervistës së tij të bërë për këtë qëllim, nuk qëndronin në lidhje me faktet të cilave u referoheshin. As apelimet e tij nuk patën sukses.

2. z. Hilal pretendonte se, përpara se të largohej nga Zanzibari, ai kishte qenë një anëtar aktiv i Frontit të Bashkuar Qytetar (FBQ), që ishte një parti opozitare në atë vend. Ai pretendoi se ishte mbajtur në gjendje ndalimi në stacionin e policisë në Madema (Zanzibar) duke filluar nga gushti 1994 për tre muaj me radhë për shkak të pjesëmarrjes së tij në FBQ si dhe ishte torturuar. Ishte mbyllur herë pas here në një qeli plot me ujë të ftohtë për disa ditë me radhë, varur me kokëposhtë me këmbët e lidhura bashkë derisa i dilte gjak nga hundët si dhe i ishte nënshtuar goditjeve elektrike.



3. Kërkuesi pretendonte se dëbimi i tij drejt Tanzanisë do ta vinte atë në një rrezik torture ose trajtimi çnjerëzor ose degradues, se ai nuk do t'i nënshtrohej një gjykimi të drejtë dhe se nuk do të kishte mjet efektiv ankimor në dispozicion. Ai mbështetej në Nenet 3, 6, 8 dhe 13 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

4. Gjykata konstatoi se kërkuesi dhe i vëllai ishin ndaluar për shkak se ata ishin aktivizuar me FBQ. Ajo konstatoi gjithashtu se kërkuesi ishte keqtrajtuar gjatë ndalimit të tij, ndërmjet të tjerash, duke u varur me kokë poshtë, dhe se raportet mjekësore dhe certifikata e vdekjes e të vëllait tregonin se ky i fundit kishte vdekur pak pasi ishte lënë i lirë, fakte të cilat nuk ishin të papajtueshme me pretendimet e kërkuesit se i vëllai ishte keqtrajtuar gjatë ndalimit nga policia. Raportet në lidhje me Tanzaninë nga ana e Amnistsisë Ndërkombëtare dhe nga Departamenti i Shtetit i SH.B.A. vinin në dukje se atje kishte një persekutim aktiv të anëtarëve të FBQ, se standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nga ana e qeverisë ishin të ulëta, se policia kryente vrasje pa gjyq dhe keqtrajtime të personave të dyshuar, se kushtet në burgje ishin të këqija deri në kërcënim të jetës dhe se ndalimet e tejkgjatura dhe arbitrare ishin ende problem.

5. Gjykata hodhi poshtë argumentin e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar që, edhe duke prezumuar se kërkuesit ishin në rrezik në Zanzibar, ai mund të jetonte në pjesën kontinentale të Tanzanisë ku situata e të drejtave të njeriut ishte më e sigurt. Gjykata vuri në dukje gjithashtu probleme të të drejtave të njeriut në pjesën e Tanzanisë, si keqtrajtime dhe rrahje të të ndaluarve, kushte çnjerëzore dhe degraduese në burgje me një ushqim të pamjaftueshëm dhe trajtim mjekësor që arrinin deri në vënie në rrezik të jetës, lidhje institucionale ndërmjet policisë në Tanzani dhe Zanzibar si dhe mundësi ekstradimi ndërmjet tyre.

6. Gjykata konstatoi se dëbimi i kërkuesit drejt Tanzanisë do të përbënte shkelje të nenit 3, përderisa ai do të përballej me një rrezik serioz të nënshtimit ndaj torturës ose trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese.

### B. Në lidhje me nenin 13

7. Duke konstatuar se thelbi i ankimit të kërkuesit ishte marrë në shqyrtim nga ana e Gjykatës të Apelit, e cila kishte mundësi që t'i akordonte atij shmangien e shkeljes për të cilën ankohej, Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 13.

### C. Në lidhje me nenin 41

8. Gjykata i akordoi kërkuesit dëmshpërblimin prej 12 583 sterlinash për kosto dhe shpenzime gjyqësore.

### III. Koment

9. Kjo çështje tregon qartë ndërlidhjen ndërmjet Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe instrumenteve të tjerë ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Ndërsa z. Hilal mund të kishte qenë konsideruar si refugjat në bazë të Konventës së Gjenevës së vitit 1951 mbi Statusin e Refugjatit në të cilën Mbretëria e Bashkuar ishte palë, dhe ai nuk u konsiderua pra si i tillë, ndërhyrja e Gjykatës Evropiane mundësoi që atij t'i ofrohej mbrojtje në kuadrin e nenit 3 të Konventës Evropiane.

10. Pretendimi i z. Hilal për statusin e refugjatit kishte dështuar për dy arsye: së pari ai nuk ishte besuar nga ana e autoriteteve britanike dhe së dyti autoritetet e Mbretërisë së Bashkuar vlerësuan se ai mund të kishte shkuar në një pjesë tjetër të vendit të tij duke ushtruar atë që njihet si “alternativa e largimit të brendshëm”. Gjykata Evropiane u mbështet në konstatimet e veta dhe vlerësoi se nuk kishte arsye për të hedhur poshtë dokumentet dhe historinë e z. Hilal përderisa ato qëndronin. Përsa i përket alternativës së largimit të brendshëm, duke pasur parasysh lidhjet ndërmjet policisë në vendbanimin e z. Hilal dhe policisë në pjesën tjetër të vendit si dhe duke vlerësuar abuzimet e tjera të të drejtave të njeriut në të gjithë vendin, Gjykata nuk u bind se zgjidhja e largimit të brendshëm ofronte një garanci të besueshme kundër keqtrajtimeve.

11. Ka qenë në fakt një problem i vazhdueshëm i Konventës së vitit 1951 mbi Statusin e Refugjatit që nuk ka një gjykatë ndërkombëtare mbikëqyrëse dhe asnjë garanci kundrejt interpretimeve shumë të ngushta të dispozitave të saj dhe e detyrimeve përkatëse nga ana e shteteve palë. Përdorimi i koncepteve si “mundësia e largimit të brendshëm” i cili duhet të ketë një zbatueshmëri shumë të kufizuar në raste kur individët përballen me persekutim nga ana e vetë shtetit të tyre, është një shembull i një interpretimi të tillë të ngushtë. Megjithatë çështja Hilal do të shërbejë si një kujtesë për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ofron mbrojtje të ngjashme ndaj *refoulement*<sup>233</sup> ashtu si edhe Konventa e Gjenevës e 1951 dhe se Gjykata Evropiane është gjithmonë mbikëqyrësi i respektimit të parimeve dhe standardeve të këtij neni.

233 Fr. – “kthim mbrapa – në vendin e shtetësisë ose nga ku ka ardhur personi”. Ky term është pranuar përgjithësisht nga e drejta ndërkombëtare dhe nga Konventa e Gjenevës e vitit 1951 “Mbi statusin dhe të drejtat e Refugjatëve” neni 33.

## M. DHE M. kundër KROACISË

(kërkesa nr. 10161/13)

3 shtator 2015

*ky vendim nxjerr në pah lidhjen mes elementëve përbërës të detyrimeve pozitive të Shteteve sipas nenit 3, si dhe konkludon se dështimi i Shtetit për të hetuar në mënyrë efektive abuzimin e pretenduar të fëmijëve përbën shkelje të nenit 3 kurse kohëzgjatja e tepërt e procedurave të kujdestarisë shkel nenin 8*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuueset, znj. M. dhe M., nëna dhe vajza e saj e mitur, ishin shtetase kroate që kanë lindur përkatësisht në vitet 1976 dhe 2001, dhe jetonin në Zadar, Kroaci. znj. M. u martua me z. I.M. më 23 qershor 2001, dhe më 4 shtator 2001 lindi vajza e tyre. Megjithatë, marrëdhëniet e çiftit u përkeqësuan dhe filluan procedurat e divorcit. Më 24 gusht 2007 Gjykata e Rrethit të Zadarit vendosi divorcin e çiftit. Sipas vendimit të gjykatës kroate, babait iu dha kujdestaria e vajzës ndërsa nënës e drejta e kontaktit, së bashku me pagesën për rritjen e saj.

2. Sipas një deklaratë që M. bëri para policisë, më 1 shkurt 2011 kishte ndodhur një episod serioz i abuzimit në familje: babai i saj e kishte goditur në fytyrë, e kishte kapur nga fyti dhe e kishte sharë. Një oftalmolog e diagnostikoi atë me nxirje të syrit të majtë dhe të indit të syrit gjë që tregonte se lëndimi ishte shkaktuar nga një goditje me dorë. M. kishte raportuar edhe raste të tjera të dhunës fizike dhe psikologjike nga babai i saj gjatë tre viteve të fundit duke pranuar se kishte frikë nga ai sepse ishte i dhunshëm. Si rrjedhojë e situatës problematike në familje, një sërë procedurash të lidhura me njëra tjetrën kishin filluar përpara gjykatave kroate, njëra penale për të vendosur mbi abuzimin e pretenduar ndaj vajzës së mitur, tjetra civile për të vendosur mbi kujdestarinë dhe divorcin si dhe një procedurë administrative nga autoritetet e mirëqenies sociale. Pas incidentit të 1 shkurtit 2011, z. I.M. ishte paditur nga Prokuroria më 30 mars 2011 për kryerjen e një veprë penale të lëndimit trupor. Në tetor 2014, procedurat po vijonin ende pasi gjykata e Zadarit ishte duke pritur për të marrë një paisje komunikimi video me të cilën të merrej në pyetje M. gjatë seancave gjyqësore. Më 27 prill 2011, znj. M. bëri një kallëzim penal kundër z. I.M. duke e akuzuar atë për abuzim me vajzën e tyre, duke iu referuar incidentit të 1 shkurtit 2011 si dhe pretendimeve nga vajza e tyre se ky episod nuk kishte qenë i izoluar. Kallëzimi u hodh poshtë në janar 2012, pasi nuk u gjetën elemente të mjaftueshme për të provuar abuzimin.

3. Më 30 mars 2011, znj. M. kishte bërë edhe një padi civile për të anuluar urdhrin e kujdestarisë të 24 gushtit 2007 dhe duke kërkuar që të merrte kujdestarinë e përkohshme të vajzës së saj. Megjithatë, kërkesa për kujdestarinë e përkohshme u refuzua dy muaj më vonë për shkak të mungesës së provave se abuzimi i pretenduar kishte ndodhur. Kurse procedura për kujdestarinë e vajzës ishin në vijim e sipër në gjykatën e shkallës së parë në kohën e vendimit të Gjykatës së Strasburgut. Në procedurat para organeve të mirëqenies sociale, me vendimin e 7 nëntorit 2006, u urdhërua marrja në mbrojtje e vajzës dhe mbikëqyrja e ushtrimit të autoritetit prindëror me qëllim përmirësimin e komunikimit ndërmjet anëtarëve të familjes. Masa zgjati deri në gusht 2008. E njëjta masë u vendos edhe nga shtatori 2011 deri në mars 2014 pasi gjendja familjare nuk kishte parë ndonjë përmirësim të qëndrueshëm. Gjatë procedurave të mësipërme, M. ishte vizituar nga një sërë psikiatresh dhe psikologësh të cilët kishin arritur të gjithë në përfundimin se fëmija ishte traumatizuar emocionalisht nga ndarja e prindërve dhe nga marrëdhënia e tyre konfliktuale dhe se ajo vazhdimisht kishte shprehur dëshirën që të jetonte me nënën e saj. Megjithatë, u vlerësua se nuk kishte asnjë rrezik që vajza të vazhdonte të jetonte me babain e saj, pasi pretendimet se M. ishte abuzuar nga babai i saj nuk ishin mjaft bindëse për të justifikuar largimin e menjëhershëm të saj nga kujdesi i tij.

4. Në kërkesën e tyre në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të bërë më 3 janar 2013, kërkuet pretenduan se autoritetet vendase nuk kishin përmbushur detyrimet e tyre pozitive sipas Konventës, pasi as nuk e ndoqën penalisht z. I.M. për veprën penale serioze të abuzimit me vajzën e tij, dhe as nuk e mbrojtën këtë të fundit nga veprimet e dhunshme të mëtejshme duke e larguar nga shtëpia dhe nga kujdesi i tij, në kundërshtim me nenin 3 dhe nenin 8.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3

#### *i. në lidhje me aspektin procedural*

5. Duke pasur parasysh faktin se M. ishte keqtrajtuar dhe se kishte dëshmi të këtij keqtrajtimi, dhe në veçanti për faktin se M. ishte fëmijë dhe viktimë e supozuar e dhunës në familje, Gjykata vlerësoi se rasti aktual bënte që të lindnin detyrime pozitive të Shtetit sipas nenit 3 të Konventës për të hetuar rastet e supozuara të abuzimit dhe për ta mbrojtur atë nga keqtrajtimet e tjera të mundshme.

6. Autoritetet kroate kishin filluar procedurat penale vetëm lidhur me incidentin e 1 shkurtit 2011, duke vendosur që të injoronin tërësisht pretendimet për një seri abuzimesh më të hershme që M. ishte detyruar të duronte, dhe nuk e kishin akuzuar z. I.M. edhe me vepra ose kundërvajtje penale të afta hetonin edhe të gjitha rastet e keqtrajtimit përpara asaj date. Si pasojë, ata nuk kishin arritur të trajtonin situatën e M.-së në tërësinë e saj. Për më tepër, kohëzgjatja e procedurës penale ka qenë tepër e madhe që të kishte një hetim efektiv, duke shkelur kërkesën për shpejtësi dhe kohë të arsyeshme, të nënkuptuara në kontekstin e nenit 3. Prandaj, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të këtij neni.

*ii. në lidhje me detyrimin pozitiv për ta mbrojtur M. nga keqtrajtimet e pretenduara nga babai*

7. Përsa i përket shkeljes së pretenduar të detyrimeve pozitive të autoriteteve për të parandaluar keqtrajtimin e mundshëm në të ardhmen duke marrë të gjitha masat e nevojshme të arsyeshme, Gjykata gjeti se autoritetet vendase kishin ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm të nevojshëm për të vlerësuar dhe peshuar rrezikun e keqtrajtimeve të mundshme, dhe parandalimin e tyre duke marrë parasysh mendimet dhe rekomandimet e ndryshme të dhëna nga disa autoritete sociale dhe duke shqyrtuar me kujdes të gjitha materialet përkatëse. Prandaj, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3 në këtë pikë.

### ***B. Në lidhje me nenin 8***

8. Në shqyrtimin e shkeljes së pretenduar të nenit 8 për shkak të keqtrajtit, Gjykata vlerësoi se ankesat e M. sipas këtij neni përthitheshin nga ankesat e saj sipas nenit 3. Kërkueset u ankuan gjithashtu sipas nenit 8 se autoritetet vendase kishin injoruar dëshirën e M. për të jetuar me nënën e saj dhe se ajo nuk ishte dëgjuar në procedurat mbi kujdestarinë, të cilat vazhdonin prej më shumë se katër vjetësh. Pas tre vjet e gjysmë, M. kishte filluar të shfaqte sjellje vetëlënduese, të cilën ajo e kishte përshkruar si një reagim ndaj frustrimit nga fakti se asaj nuk i ishte lejuar të zgjidhte me kë të jetonte, dhe për këtë arsye liria e saj e veprimit dhe e drejta për autonomi personale ishin kufizuar. Këto rrethana ngrinin çështje lidhur me të drejtën e kërkueseve për respektimin e jetës private dhe familjare, më vete nga ato të analizuara në kontekstin e nenit 3 dhe prandaj, sipas mendimit të Gjykatës, kërkohet një shqyrtim i veçantë. Sipas Gjykatës, ky rast bënte thirrje për një kujdes më të madh nga gjykatat dhe autoritetet kombëtare, pasi kishte të bënte me një fëmijë të traumatizuar, e cila kishte vuajtur një ankth të madh mendor që kulmoi me veprime vetëlënduese. Megjithatë, gjykatat vendase nuk kishin kuptuar seriozitetin dhe urgjencën e situatës së M. Ajo që ishte edhe më e habitshme për Gjykatën ishte se nuk u ndërmorën hapa për të përshpejtuar procedurat mbi kujdestarinë edhe pasi M. kishte filluar të shfaqte sjellje vetë-lënduese.

9. Ekspertët mjeko-ligjorë në psikologji dhe psikiatri të përfshirë në këtë rast kishin gjetur se të dy prindërit ishin po aq të papërshtatshëm për t'u kujdesur për fëmijën e tyre, dhe këtë pikëpamje kishte edhe qendra lokale e mirëqenies sociale. Ata kishin konstatuar gjithashtu se M. kishte shprehur disa herë një dëshirë të fortë për të jetuar me nënën e saj. Siç përcaktohet në nenin 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, fëmijët që janë në gjendje të formojnë pikëpamjet e tyre kanë të drejtë t'i shprehin ato dhe këtyre pikëpamjeve t'u jepet rëndësia e duhur, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre, në çdo procedurë që prek interesat e fëmijëve. M. ishte nëntë vjeç e gjysmë në kohën e fillimit të procedurës dhe trembëdhjetë e gjysmë në kohën e vendimit të Gjykatës. Prandaj, do të ishte e vështirë të argumentohej se, duke pasur parasysh moshën dhe pjekurinë e saj, ajo nuk kishte qenë e aftë të formonte pikëpamjet e veta dhe t'i shprehte lirshëm.

10. Gjykata konstatoi se mosrespektimi i dëshirave të M. se me cilin prind ajo donte të jetonte përbënte shkelje të së drejtës së saj për respektimin e jetës private dhe familjare në kundërshtim me nenin 8 të Konventës. Gjetjet në lidhje me karakterin e zgjatur të procedurave të kujdestarisë zbatoheshin gjithashtu po njësoj në situatën e znj. M. në lidhje me të drejtën e saj për respektimin e jetës së saj private dhe familjare.

### C. Në lidhje me nenin 41

11. Gjykata u shpreh se Kroacia duhej t'i paguante M. 19 500 euro dhe nënës së saj 2 500 euro për dëmin jomaterial dhe 3 600 euro të dyjave bashkë për shpenzimet dhe pagesat gjyqësore.

## III. Koment

12. Ky vendim ngre një numër çështjesh të rëndësishme, qoftë në kuadrin e nenit 3, qoftë të nenit 8, por është klasifikuar në kuadrin e nenit 3 për të analizuar në mënyrë të veçantë detyrimet me karakter pozitiv në kuadrin e këtij neni, dhe sidomos në kontekstin e marrëdhënieve familjare. Është theksuar në mënyrë të përsëritur dhe është e qartë në jurisprudencë dhe në doktrinë tashmë se, Konventa në përgjithësi dhe neni 3 në veçanti, përveç detyrimeve me karakter negativ, pra që shteti nuk duhet të keqtrajtojë individët, autoritetet kanë edhe detyrime me karakter pozitiv, pra që duhet të marrin masa që individët të mos keqtrajtohen nga individë të tjerë<sup>234</sup>. Ky detyrim me karakter pozitiv shprehet kryesisht në dy aspekte, i pari me karakter kryesisht material dhe e dyti me karakter kryesisht procedural. Interesi i jashtëzakonshëm i këtij vendimi konsiston pikërisht në analizën, ose më saktë në mungesën e analizës nga ana e Gjykatës të marrëdhënies mes këtyre dy aspekteve të detyrimit me karakter pozitiv në kuadrin e nenit 3. Megjithëse vetë Gjykata e pranon këtë lidhje në paragrafin 136 të vendimit<sup>235</sup>, analiza e saj e mëtejshme nuk e tregon këtë ndërvarësi.

13. Së pari, Gjykata analizon aspektin procedural të nenit 3. Me të drejtë Gjykata gjen shkelje të nenin 3 në këtë aspekt duke iu referuar karakterit të cunguar, të paplotë dhe tepër të tejzgjatur të procedurave penale ndaj I.M. për keqtrajtimet e pretenduara nga e bija. Mangësi të tilla çenojnë kërkesat e aspektit procedural të nenit 3. Në një hap të dytë, ajo ndalet tek masat pozitive që duhet të marrin autoritetet për të mbrojtur individët, dhe sidomos fëmijët nga keqtrajtimet e mundshme nga persona të tretë, situatë tepër delikate kur kjo ndodh në marrëdhëniet familjare. Megjithatë kjo analizë e Gjykatës paraqet një disa mangësi të çuditshme për mendimin tim. Nga njëra anë është e pashpjegueshme sesi gjatë kësaj analize ajo nuk mban parasysh dhe nuk iu referohet mangësive procedurale që kishte vënë vetë në dukje në analizën e parë. Më duket e vështirë

234 Ajo që quhet ndryshe edhe si *drittëirkung* ose efekti horizontal i normave juridike, sidomos atyre mbi të drejtat themelore.

235 Sipas Gjykatës: "Këto detyrime pozitive, të cilat shpesh mbivendosen, përbëhen nga: (a) detyrimi për të parandaluar keqtrajtimin për të cilin autoritetet kanë njohur ose duhet ta kenë njohur (shih, p.sh., Gjorgjeviq k. Kroacisë, nr. 41526/10, §§ 138-139, KEDNJ 2012), dhe (b) detyrim (procedural) për të kryer një hetim zyrtar efektiv kur një individ ngre një pretendim të arsyeshëm për keqtrajtim (shih, p.sh., Dimitar Shopov k. Bullgarisë, nr.17253 / 07, § 47, 16.04.2013).



të pranosh që nuk kishte asnjë rrezik për M. që të vazhdonte të banonte me babain e saj, kur vetë Gjykata pranon se autoritetet vendore nuk kishin kryer një hetim të plotë dhe efektiv mbi keqtrajtimet e pretenduara nga M, për më tepër në seri. Këto më duken të paktën qëndrime kontradiktore, dhe pohimet e qendrës lokale për mirëqenie sociale ose fakti që edhe nëna nuk ishte e përshtatshme për të jetuar me vajzën vështirë se mund të shmangin nevojën për mbrojtje kur keqtrajtimet e pretenduara nuk janë hetuar si duhet. Nga ana tjetër, Gjykata duhet të kishte hulumtuar më me kujdes çështjen e pragut të ashpërsisë që duhet arritur të plotësohet për trajtim të papërshtatshëm nga një prind që të përfshihet në objektin e nenit 3<sup>236</sup>. Ky është një përfundim i pasigurt për aq kohë sa Gjykata arrin në përfundimin se detyrimi procedural nuk është përmbushur dhe Gjykatës i takonte të analizonte vetë elementët faktikë në një situatë të tillë, sipas standartit përtej dyshimit të arsyeshëm<sup>237</sup>. Nën kuadrin e detyrimeve pozitive, aspekti procedural i nenit 3 dhe masat mbrojtëse të viktimave mund të kenë një varësi të ngushtë me njëra tjetrën, dhe vetëm një përfundim i sigurt dhe i pavarur që rreziku nuk ekziston mund ta tjetërsojë këtë marrëdhënie<sup>238</sup>. Gjithsesi është e rëndësishme të theksohet se Gjykata kujton karakterin tejet të brishtë të viktimave të dhunës në familje<sup>239</sup>.

14. Vendimi paraqet rëndësi edhe në lidhje me nenin 8. Ky vendim ashtu si edhe shumë të tjerë nxjerr në pah një situatë tepër delikate për Gjykatën, ku fëmijët bien viktimë e luftës ndërmjet dy prindërve. Siç vunë në dukje gjyqtarët e pakicës, është tragjike që shumë shpesh që prindërit përdorin fëmijën e tyre si armë në betejat e tyre me njëri-tjetrin pa mbajtur parasysh ose duke qenë fare indiferentë ndaj efektit që sjelljet e tyre kanë në mirëqenien e fëmijës së tyre. Një prind shpesh – dhe kjo u sugjerua për të dy prindërit në këtë rast - manipulojnë fëmijën në favor të zgjidhjes që dëshirojnë. Në rastet familjare në Strasburg, një prind e sjell çështjen në emër të tij ose të saj dhe gjithashtu në emër të fëmijës ose fëmijëve në qendër të mosmarrëveshjes. Gjykata normalisht e pranon këtë dhe nuk e vë në dyshim të drejtën e prindit për të përfaqësuar fëmijën. Kur ekzistojnë kundërshti të papajtueshme qëndrimesh për zgjidhjen që do të ishte ose do të kishte qenë në interesin më të mirë të fëmijës, nëse prindi tjetër kërkon të ndërhyjë si një palë e tretë, Gjykata zakonisht është e hapur për këtë<sup>240</sup>. Babai në këtë rast duket se nuk kishte kërkuar të ndërhynte si palë e tretë.

236 Shih Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar, 18.01.1978, sidomos § 167, Series A no. 25, Costello-Roberts k. Mbretërisë së Bashkuar, 25.03.1993, Series A no. 247-C, A. k. Mbretërisë së Bashkuar, 23.09.1998, Reports of Judgments and Decisions 1998-VI, and në kontekstin e dhunës në familje Sultan Öner and Others k. Turqisë, no. 73792/01, 17.10.2006.

237 Nga ana tjetër nuk jam dakord as me mendimin në pakicë të kolegëve Berro dhe Mose, të cilët pretendojnë se analiza kontekstuale e situates nuk është mbajtur sa duhet parasysh dhe se nuk mund të konkludohet se keqtrajtimet kanë arritur nivelin e nenit 3.

238 Shih gjithashtu *Opuz k. Turqisë*, nën kuadrin e nenit 2, përfshirë në këtë botim.

239 Shih gjithashtu *Bevacqua dhe S. k. Bullgarisë*, nr. 71127/01, § 65, 12.06.2008.

240 Shih ndër të tjera, *Neulinger dhe Shuruk k. Zvicrës*, nr. 41615/07, vendim i 6.7.2010 në lidhje me rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijës, zgjidhur nën këndvështrimin e nenit 8.

15. Në lidhje me problematika, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës luan një rol të rëndësishëm në bazë të nenit 53 të KEDNJ-së në raste të tilla. Gjykata ka marrë parasysh pikëpamjet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës sipas të cilit ndjekja penale e një prindi për sjellje abuzive, sidomos me urdhër të prindit tjetër, rallë përbën një zgjidhje optimale për uljen ose zhdukjen e abuzimeve të pretenduara<sup>241</sup>.

16. Sidoqoftë, flagrant në këtë rast, ishte fakti që pavarësisht një tërësie dispozitash ndërkombëtare dhe nacionale<sup>242</sup>, pas katër vitesh dhe tre muajsh, kërkuesja e parë ende nuk ishte dëgjuar në procedurat mbi kujdestarinë që t'i jepej mundësia për të shprehur pikëpamjet e saj për çështjen me të cilën fëmija donte të jetonte. Gjykata vuri në dukje se Gjykata e Qarkut e kishte udhëzuar Gjykatën e Rrethit që të vlerësonte nëse M. ishte në gjendje të kuptonte rëndësinë e procedurës dhe, nëse po, ta lejonte atë të shprehte mendimin e saj dhe të merrte dëshminë e saj. Sidoqoftë, më shumë se një vit dhe shtatë muaj kaluan pa ndërmarrë hapa për të përmbushur këtë udhëzim. Kjo mungesë procedurale ishte e mjaftueshme për të gjetur shkelje të nenit 8 në lidhje me M. Nga ana tjetër, kohëzgjatja e procedurave, përveçse problematike në raport me M, dhe nuk ka si të jetë ndryshe kur bëhet fjalë për një fëmijë që zhvillohet dita ditës, e bëri Gjykatën të gjejë shkelje të nenit 8 edhe në raport me të ëmën. Ky përfundim është gjithashtu i rëndësishëm për të konfirmuar të drejtën e prindërve që procedurat mbi kujdestarinë e fëmijëve të tyre të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm<sup>243</sup>.

## JALOUUD kundër HOLANDËS

(kërkesa nr. 47708/08)

20 nëntor 2014

Dhomë e Madhe

*hetimi jo efektiv në lidhje me vrasjen e një shtetasi irakian nga ushtarët holandezë gjatë pushtimit të Irakut në vitin 2004 ishte brenda juridiksionit të Holandës*

### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje ka të bëjë me vdekjen e Azhar Sabah Jaloud në një pikë kontrolli të automjeteve e cila ishte nën drejtimin e ushtarëve holandezë dhe Trupave Irakiane të Mbrojtjes Civile (TIMC). Më 21 prill 2004, një makinë iu drejtua

241 Shih dhe krahaso me vendimin e 11.02.2016 në lidhje me vendimin *Mitrova dhe Savik k. Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 42534/09, ku bashkë me gjyqtarin Spano shprehëm një mendim në pakicë, ndër të tjera në lidhje me këtë problem.

242 Të tilla si Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, Konventa Evropiane për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve) dhe dispozita të ndryshme kombëtare të cilave iu referua,

243 Shih gjithashtu *Bajrami k. Shqipërisë*, përfshirë në këtë botim.

me shpejtësi pikës së kontrollit të automjeteve, duke goditur një prej fuçive të vendosura në mes të rrugës për të krijuar këtë pikë kontrolli. Automjeti u qëllua disa herë dhe shoferi ndaloi. Disa nga të shtënat ishin qëlluar nga togeri A, i cili komandonte ushtarët hollandezë dhe të shtëna të tjera mund të jetë qëlluar nga ushtarë të TIMC. Azhar Sabah Jaloud, i cili ishte ulur në vendin e pasagjerit, ishte qëlluar në disa pjesë të trupit dhe pavarësisht nga përpjekjet e ushtarëve hollandezë për t'i dhënë ndihmën e parë, ai u shpall i vdekur një orë më vonë.

2. Në lidhje me këtë ngjarje filloi një hetim nga Policia Ushtarake Mbretërore. Prokurori Publik Ushtarak i mbylli hetimet në qershor të vitit 2004 dhe vendosi të mos e ndjekë penalisht togerin A, duke arritur në përfundimin se Azhar Sabah Jaloud ishte qëlluar mesa duket nga plumba irakianë. Megjithëse prokuroria pranoi se ishte qëlluar edhe nga togeri A, nuk kishte prova se ishte ai që kishte shkaktuar vdekjen Azhar Sabah Jaloud. Prokuroria deklaroi që edhe në rast se nuk kishte qenë kështu, vrasja mund të justifikohet me supozimin se togeri A kishte vepruar në vetëmbrojtje. Gjykata e Apelit në Angli e la në fuqi vendimin e prokurorit për të mos ndjekur penalisht togerin A. Ai arriti në përfundimin se togeri A kishte reaguar ndaj të shtënave të qëlluara nga kolegët e tij nga ana tjetër e rrugës, duke menduar se ishin të shtëna armiqësore të bëra nga brenda makinës. Për këtë arsye ai ka vepruar brenda udhëzimeve që kishte marrë, dhe vendimi për të mos ndjekur atë penalisht ishte i arsyeshëm.

3. Përpara Gjykatës, kërkesa u soll nga z. Sabah Jaloud, që është babai i të ndjerit z. Azhar Sabah Jaloud. Kërkesi u ankua në bazë të nenit 2, duke pretenduar se hetimi mbi rrethanat e vdekjes së djalit të tij nuk kishte qenë i pavarur dhe efektiv sa duhej. Qeveria holandeze ngriti një prapësim paraprak duke pretenduar se viktimi nuk ishte brenda juridiksionit holandez për qëllimet e nenit 1. Më 9 korrik 2013, një Dhomë e Seksionit II të Gjykatës hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe. Duke pasur parasysh seriozitetin dhe kompleksitetin e aspekteve faktike dhe juridike të kësaj çështje, Dhoma e Madhe vendosi të bashkojë prapësimet paraprake me themelin e çështjes dhe e deklaroi çështjen të pranueshme.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me juridiksionin

4. Qeveria holandeze pretendoi se rrethanat e çështjes nuk binin në juridiksionin e Hollandës, sepse së pari, Holanda nuk ka qenë një nga "fuqitë pushtuese" në Irak. Së dyti, theksoi ajo, ushtarët hollandezë nuk kishin ushtruar autoritet dhe kontroll përderisa pika e kontrollit ishte ngritur dhe drejtohej nga TIMC. Gjykata theksoi se një Shtet nuk mund të çlirohet nga detyrimet e tij sipas nenit 2 duke thënë se ka ekzekutuar ose zbatuar një vendim ose urdhër të dhënë nga një autoritet i një shteti tjetër, që në rastin konkret ishte Mbretëria e Bashkuar.<sup>244</sup>

244 Kjo sepse Rezoluta 1483 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së caktonte vetëm Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe si vetëm fuqi pushtuese. Shih gjithashtu vendimin Al-Skeini k. Britanisë së Madhe, të përfshirë në këtë botim.

Gjykata konstatoi se Holanda kishte "komandë të plotë" mbi personelin e saj ushtarak. Holanda kishte marrë përgjegjësinë për të garantuar sigurinë në atë zonë në ditën e ngjarjeve dhe TIMC ishte thjesht nën varësinë e saj. Në këto kushte, Gjykata konstatoi se Holanda kishte juridiksion dhe hodhi poshtë kundërshtimin paraprak të qeverisë.

### ***B. Në lidhje me nenin 2***

6. Në lidhje me aspektin procedural të nenit 2, kërkuesi u ankua se Policia Ushtarake Mbretërore dhe prokurori publik ushtarak nuk kishin qenë të pavarur sa duhej, sepse ata ndanin kapononet e banimit me personelin ushtarak ushtresë holandez. Gjykata konstatoi se ky fakt nuk kishte ndikuar në pavarësinë e Xhandarmërisë Ushtarake Mbretërore.

7. Kërkuesi pretendoi gjithashtu se hetimi nuk kishte qenë adekuat. Gjykata konstatoi se hetimet kishin qenë të papërshtatshme në një numër pikash: autoritetet gjyqësore dhe paditësi nuk kishin pasur akses në dokumentet që përmbanin informacion të rëndësishëm në lidhje me rrethanat e rastit, si p.sh. listën e emrave të personelit TIMC që kishin qëlluar, informacione të cilat togeri A i kishte. Gjithashtu, nuk ishin marrë masat për të parandaluar togerin A që të mund të koordinohet me dëshmitarë të tjerë para se ai të merrej në pyetje. Në vijim u konstatua se kushtet në të cilat ishte bërë autopsia ishin të papërshtatshme për qëllimet e hetimeve dhe provat materiale, të tilla si copëza plumbash, kishin humbur. Gjykata konstatoi se këto mangësi mund të ishin shmangur dhe vlerësoi se Holanda kishte dështuar në përmbylljen e detyrimeve të saj procedurale sipas nenit 2 të Konventës. Për pasojë ajo vendosi se ka pasur shkelje procedurale të këtij neni.

### ***C. Në lidhje me nenin 41***

8. Gjykata i akordoi kërkuesit 25 000 euro për dëmet jomateriale si dhe 1 372 euro për kostot dhe shpenzimet.

## **III. Koment**

9. Ky vendim i Dhomës së Madhe është i fundit i një serie të gjatë të çështjeve në lidhje me përgjegjësinë e shteteve për veprimet dhe mosveprimet e personelit të tyre ushtarak të angazhuar në operacione jashtë territorit kombëtar. Rëndësia e Jaloud qëndron në arsyetimin e përdorur nga Gjykata për të gjetur se vdekjet kanë ndodhur brenda juridiksionit të Hollandës. Gjykata konstatoi se fakti që Holanda nuk ishte një "fuqi pushtuese" sipas Konventës së Hagës nuk ishte përcaktues për qëllimet e pasjes së juridiksionit sipas nenit 1 të Konventës. Sipas Gjykatës nuk ishte përcaktues as fakti që trupat holandeze vepronin nën kontrollin e përgjithshëm operativ të Mbretërisë së Bashkuar, si fuqi pushtuese, që nga momenti që Holanda kishte pasur "komandën e plotë" mbi personelin e saj ushtarak.

10. Duke hedhur poshtë këto arsye të në lidhje me pretendimin e mospasjes së juridiksionit, Gjykata vazhdoi në përcaktimin e kuptimit të bazës konceptuale të juridiksionit. Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës ka bërë të qartë se thjesht vrasja e dikujt nuk e sjell atë person brenda juridiksionit të shtetit të autoriteteve ose individëve që kanë kryer vrasjen. Në këtë rast nuk ka pasur civilë që ishin arrestuar nga forcat ushtarake të Shtetit të paditur, siç kishte qenë rasti në çështje të mëparshme (Al-Skeini al Jedda). Në fakt, dhe kjo përbën risinë më të rëndësishme të vendimit, Gjykata konstatoi se Shteti i paditur kishte ushtruar juridiksionin e saj me qëllim që "ushtronte autoritet dhe kontroll mbi personat që kalojnë nëpër pikën e kontrollit". Në këtë mënyrë, Gjykata pranoi një kriter të ri për njohjen e juridiksionit. Do të jetë interesante të shihet nëse Gjykata do ta zbatojë këtë kriter edhe për situata të tjera analoge me kontrollet në postbllok, të tilla si kontrollet ekstraterritoriale kufitare. Gjykata kishte gjetur tashmë se juridiksioni mund të lindi si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve në det të hapur (shih Medvedyev dhe të tjerët v. France dhe Hirsi Jamaa DHM).





# NENI 4

## NDALIMI I SKLLAVËRISË DHE I PUNËS SË DETYRUAR

## SILIADIN kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 73316/01)

26 korrik 2005

*shtetet janë të detyruara të marrin masa efektive për ndalimin e skllavërisë dhe robërisë moderne e cila haset ende edhe në shtete me traditë demokratike në Evropë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Siwa-Akofa Siliadin, është një vajzë 26 vjeç me shtetësi togoleze që jeton në Paris. Në janar 1994, kërkuesja, që në atë kohë ishte 15 vjeç e gjysmë, arrin në Francë e shoqëruar nga znj. D, shtetase franceze me origjinë togoleze. Kjo e fundit kishte marrë përsipër që të rregullonte situatën administrative të kërkueses dhe të merrej me shkollimin e saj, ndërkohë që kërkuesja duhet të punonte në shtëpinë e znj. D për aq kohë sa të arrinte të nxirrte paratë e biletës së saj të avionit. Në fakt, znj. Siliadin ishte veçse një shërbyese pa pagesë në shtëpinë e bashkëshortëve D. Për më tepër asaj i ishte konfiskuar edhe pasaporta.

2. Në tetor 1994, znj. D ia "huazoi" kërkuesen bashkëshortëve B, miq të familjes, me qëllim që t'i ndihmonte në menaxhimin e shtëpisë dhe të merrej me fëmijët e tyre. Ky transferim duhet të zgjaste veçse disa ditë, derisa znj. B të lindte fëmijën që priste. Megjithatë, edhe pas lindjes, znj. B vendosi që ta mbante kërkuesen. Kërkuesja u bë në fakt shërbëtorja e plotë e bashkëshortëve B. të cilët e bënë të punonte çdo ditë të javës nga ora 7.30 deri më 22.30, pa asnjë ditë pushim dhe duke i dhënë vetëm një leje të jashtëzakonshme për të shkuar ndonjëherë në meshë të dielave. Kërkuesja flinte në dhomën e fëmijëve, në një dyshek të shtruar përtokë dhe vishte rroba të përdorura. Ajo nuk u pagua asnjëherë, me përjashtim të një ose dy rasteve kur e ëma e znj. B i dha 500 franga franceze, me një vlerë prej 76,22 euro.

3. Në korrik 1998, znj. Siliadin i tregoi një fqinje e cila vuri në dijeni Komitetin kundër Skllavërisë Moderne, i cili nga ana e tij iu drejtua prokurorisë. Bashkëshortët B. nga njëra anë u ndoqën penalisht për mbajtje abuzive të një personi të dobët ose në nevojë, për mospagim qoftë tërësor qoftë të pjesshëm të punës - vepra penale të parashikuara nga neni 225-13 i Kodit Penal - dhe nga ana tjetër, për nënshtrim të kërkueses ndaj kushteve të punës dhe të jetesës të papajtueshme me dinjitetin njerëzor - vepra penale të parashikuara nga neni 225-14 i Kodit Penal.

4. Bashkëshortët B u dënuan nga gjykata e shkallës së parë me 12 muaj burg nga të cilët 7 me kusht. Megjithatë ata u liruan në apel më 19 tetor 2000. Ndërsa

Gjykata e Apelit të Versajës, pas kthimit të çështjes nga Gjykata e Kasacionit, me një vendim të 15 majit 2003 çmoi se bashkëshortët B. ishin fajtorë sepse e kishin bërë të punonte pa pagesë znj. Siliadin, e cila ishte një person i dobët dhe në nevojë, por vlerësoi se kushtet e punës dhe të jetesës së saj nuk ishin të papajtueshme me dinjitetin njerëzor. Për pasojë, Gjykata e Apelit e Versajës i dënoi bashkëshortët B. që t'i paguanin kërkueses shumë prej 15245 euro për shpërblim dëmi përfshirë dhe interesat përkatës. Në tetor 2003 Këshilli i Punës<sup>245</sup> i akordoi kërkueses 31238 euro si shumë e rrogave që duhet të kishte marrë.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Duke u bazuar në nenin 4 të Konventës, kërkuësja pretendonte se e drejta penale franceze nuk i kishte ofruar një mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive kundër “robërisë” ndaj të cilit ishte nënshtruar pa pëlqimin e saj, kundër punës “me dhunë dhe të detyruar” të kërkuar prej saj, që në realitet nuk e kishte bërë atë asgjë tjetër veçse një skllave shtëpiake.

### A. Në lidhje me nenin 4

*a. në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 4*

6. Gjykata çmoi se neni 4 i Konventës sanksionon një prej vlerave themelore të shoqërive demokratike që formojnë Këshillin e Evropës. Ajo kujtoi se, përveç Konventës, ka një sërë traktatesh ndërkombëtare që kanë si objekt mbrojtjen e qenieve njerëzore kundër skllavërisë dhe punës së detyruar ose me dhunë. Ajo kujtoi që Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka theksuar se megjithëse skllavëria është shfuqizuar që prej më se 150 vjetësh, situata të “skllavërisë shtëpiake” hasen ende në Evropë, dhe kanë të bëjnë me mijëra persona, pjesa më e madhe femra.

*b. në lidhje me detyrimet pozitive që rrjedhin prej saj*

7. Sipas Gjykatës, fakti që një shtet abstenon nga shkelja prej tij e këtyre të drejtave nuk mjafton për të arritur në përfundimin se ai respekton detyrimet e tij në bazë të këtij neni. Në bazë të këtij neni shteteve iu lindi detyrime pozitive që konsistojnë në marrjen dhe zbatimin efektiv të dispozitave penale që ndëshkojnë praktikën e parashikuara nga neni 4.

### B. Në lidhje me shkeljen e nenit 4

*a. nëse ka pasur punë të detyruar*

8. Për të vlerësuar gjendjen në të cilën mbahej kërkuësja, Gjykata vuri në dukje se gjatë viteve, znj. Siliadin kishte punuar tek bashkëshortët B. pa pushim dhe në kundërshtim me dëshirën e saj dhe për më tepër nuk ka marrë asnjë shpërblim. Në kohën e fakteve të çështjes ajo ishte e mitur dhe në situatë të parregullt në një shtet të huaj dhe kishte frikë se mund të arrestohej nga policia. Për më tepër bashkëshortët B. e ushqenin këtë frikë dhe e bënë atë të shpresonte një rregullim

<sup>245</sup> Bëhet fjalë për ‘Conseil Prud’Homale’ - organ që ekziston në Francë dhe që mbron interesat e punëtorëve. Në të marrin pjesë përfaqësues të qeverisë dhe të sindikatave.

të situatës së saj juridike. Në këto rrethana, Gjykata çmoi se znj. Siliadin i është nënshtruar të paktën një pune të detyruar në kuptimin e nenit 4 të Konventës.

*b . nëse ka pasur skllavëri*

9. Përsa i përket skllavërisë, megjithëse kërkuesja ishte privuar nga vullneti i saj i lirë, nga dosja përpara Gjykatës nuk del që ajo të ishte mbajtur në skllavëri në kuptimin e plotë të fjalës. Pra nuk mund të thuhet që bashkëshortët B. kishin ushtruar ndaj saj një të drejtë të mirëfilltë pronësie, duke e shndërruar në gjendjen juridike të një objekti . Gjykata pra çmoi se Znj . Siliadin nuk ishte mbajtur në skllavëri në kuptimin “klasik” të këtij nocioni.

*c. nëse kishte robëri*

10. Nocioni i robërisë, i përfshirë gjithashtu në nenin 4 të Konventës, konsiston në detyrimin për të ofruar shërbime në kushtet e detyrimit. Gjykata kujtoi në këtë kuadër që kërkuesja e ofronte këtë shërbim shtatë ditë në javë për 15 orë në ditë. Për më tepër ajo nuk kishte zgjedhur që të punonte tek bashkëshortët B. Duke qenë e mitur dhe pa burime financiare, e dobët dhe e izoluar, ajo nuk kishte asnjë mjet jetese përveçse tek bashkëshortët B ku ajo ndante të njëjtën dhomë me fëmijët.

11. znj. Siliadin ishte tërësisht në varësi të bashkëshortëve B. pasi asaj i ishin konfiskuar dokumentet. Bashkëshortët B. i kishin premtuar që t'i rregullonin situatën e saj ligjore, gjë që nuk e bënë kurrë. Duke mos pasur asnjë kohë të lirë, me frikën se mos arrestohej nga policia, duke mos pasur mundësi të shkonte në shkollë – ndryshe nga çfarë i ishte premtuar të atit të saj dhe duke mos pasur as leje për të dalë në mjedise publike ajo ishte plotësisht nën varësinë e bashkëshortëve B.

12. Në këto kushte Gjykata çmoi se znj. Siliadin, e mitur në kohën e ngjarjeve në shqyrtim, ishte mbajtur në gjendje robërie sipas kuptimit të nenit 4 të Konventës.

*d. nëse legjislacioni francez i ka garantuar mbrojtje të mjaftueshme kërkueses*

13. Pasi arriti në përfundimin se Franca, ashtu si edhe çdo shtet tjetër anëtar kishte detyrime me karakter pozitiv në bazë të nenit 4 të Konventës, ajo kujtoi që në Rekomandimin 1523 (2001), Asambleja Parlamentare kishte shprehur “keqardhjen që asnjë prej shteteve anëtare të Këshillit të Evropës nuk e parashikonte shprehimisht skllavërinë shtëpiake në kodin penal”<sup>246</sup>.

14. Ndërsa në të drejtën penale franceze, as skllavëria as robëria nuk dënohen shprehimisht. Duke qenë se ishin ndjekur penalisht në bazë të neneve 255-13 dhe 225-14 të Kodit Penal, bashkëshortët B nuk u dënuan penalisht. Në

<sup>246</sup> Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë skllavëria parashikohet si veprë penale në kuadrin e krimeve kundër njerëzimit, (neni 74) por unë nuk mendoj se ky parashikim e zgjidh problemin pasur parasysh kriteret e veçanta juridike që duhen që të hyjnë në veprim dispozita për krime të tilla si ato kundër njerëzimit, gjenocidi, etj. Në këtë drejtim vendimi në fjalë ka rëndësi edhe për situatën normative shqiptare.

këtë drejtim Gjykata vuri re se prokurori e kishte kundërshtuar në Kasacion vendimin e gjykatës së apelit të 19 tetorit 2000, veçse në aspektin civil. Në këtë mënyrë vendimi për pafajësisë e bashkëshortëve B. u konsiderua përfundimtar. Për më tepër, sipas një raporti të paraqitur më 2001 nga misioni informativ në lidhje me format e ndryshme të skllavërisë moderne në Asamblenë Kombëtare franceze, këto dispozita të Kodit Penal francez mund të interpretoheshin në mënyrë tepër të gjerë dhe interpretimet ndryshonin së tepërmi nga një gjykatë franceze të tjetra. Në këto kushte Gjykata çmoi se legjislacioni penal në fuqi nuk i ka siguruar kërkueses mbrojtjen konkrete efektive kundër akteve viktime e të cilave ajo kishte qenë. Për pasojë ajo vendosi se ka pasur shkelje të nenit 4 të Konventës pasi Franca nuk ka respektuar detyrimet pozitive që ka në bazë të këtij neni.

### III. Koment

15. Ky vendim është sa i rëndësishëm për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës aq edhe tronditës për realitetin social dhe juridik francez, por jo vetëm. Një prej vendeve të para të shfuqizimit të skllavërisë në botë<sup>247</sup> dhe të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, Franca, në shekullin XXI rezulton se nuk ka një legjislacion aq efektiv sa të ofrojë mbrojtjen e duhur ndaj akteve të skllavërisë, robërisë, punës së detyruar apo me dhunë. Vendimi ka edhe një impakt tjetër – mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore kërkon një punë të konsiderueshme të përditshme, që fillon që nga marrja e masave legjislative e mbaron në interpretimin dhe vënien e tyre në jetë në mënyrë efektive.

16. Me qëllimin për të dhënë një tablo më të qartë të situatës Evropiane e cila në disa raste nuk është fort e lumtur<sup>248</sup>, Gjykata i referohet si akteve të tjera ndërkombëtare ashtu edhe rekomandimeve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Këtë reference duket se Gjykata e përdor për t'iu kujtuar shteteve kujdesin që duhet treguar në marrjen e masave ndaj fenomeneve që duket se Evropa i konsideron të tejkaluara por që faktikisht, siç e provon edhe ky rast hasen ende në zemrën e saj. Vendimi shërben si një mesazh i fortë ndaj shteteve në lidhje me të gjitha format e skllavërisë moderne, duke filluar nga shfrytëzimi i prostitucionit, pedofilia, pornografia me të miturit, etj.

17. Është interesante teknika e kujdesshme që adopton Gjykata në trajtimin e kësaj çështje. Ajo analizon së pari nëse neni 4 gjen zbatim në situatën e kërkueses dhe pastaj kërkon të përcaktojë figurat juridike të nenit 4 që i përshtaten më shumë situatës. Për këtë qëllim ajo i referohet përsëri si akteve të tjera

247 Megjithëse ishte dënuar për herë të parë nga Papa Pali III më 1537, skllavëria u shfuqizua për herë të parë në Europë nga Konventa e dalë nga Revolucioni Francez, më 4 shkurt 1793. Napoleon Bonaparti e rivendosi me një dekret të 20 majit 1802 por skllavëria u shfuqizua edhe një herë dhe kësaj radhe përfundimisht në Francën e Republikës së II, më 27 prill 1848, ndërkohë që Danimarka e kishte bërë më 1804 ndërsa Britania e Madhe më 1807.

248 Parasysh kam në mënyrë të veçantë situatën shqiptare sidomos deri para rreth dy vjetëve ku trafikimi dhe shfrytëzimi i prostitucionit dhe i fëmijëve ishte një problem madhor.

ndërkombëtare<sup>249</sup> ashtu edhe jurisprudencës së saj të mëparshme<sup>250</sup>. Pas një analize të gjithë këtyre referencave ajo arrin në përfundimin se në rastin e znj. Siliadin nuk kishte skllavëri por robëri. Në qoftë se i rrimë strikt formulimit tradicional konvencional të skllavërisë si *"gjendja ose kushtet kur mbi një person ushtrohen atributet e së drejtës së pronës ose disa prej tyre"* mund të jemi dakord me këtë klasifikim të Gjykatës. Një pjesë e konsiderueshme e doktrinës është e mendimit se këtij formulimi i duhen shtuar edhe dy elementë:

- pamundësia e individit për të ndryshuar sadopak statusin e vet
- karakteri i pavullnetshëm i punës që ai person kryen.

Mund të shtrohet pyetja nëse fakti i transferimit të znj. Siliadin nga znj. D. tek bashkëshortët B. dhe qëndrimi i pavullnetshëm tek ata mund të klasifikohet si një atribut i së drejtës së pronësisë. Ekzistenca e qartë edhe e dy elementëve të tjerë të lartpërmendur të nocionit të skllavërisë duket se do të mund ta klasifikonin situatën e znj. Siliadin si skllavëri.

## VAN DER MUSSELE kundër BELGJIKËS

(kërkesa nr. 8919/80)

**23 nëntor 1983**

*ushtrimi i profesionit për periudha të caktuara pa shpërblim mund të mos përbëjë punë të detyruar në prani të kritereve të qarta paraprake profesionale*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Eric Van der Mussele, shtetas belg i lindur më 1952 punon avokat në Anversë. Ndërsa ai ishte ende asistent avokat në 31 korrik 1979, ai caktohet nga zyra e këshillimit dhe mbrojtjes e Dhomës së Avokatisë së Anversës, që të mbronte kryesisht z. Ebrima, nga Gambia. Ky i fundit ishte dënuar në shkallë të parë dhe në apel por në vijim të një kërkesë drejtuar Ministrit të Drejtësisë nga mbrojtja lihet i lirë më 17 dhjetor 1979. Të nesërmen zyra e këshillimit dhe mbrojtjes e vë në dijeni z. Van der Mussele që ai nuk do të merret më me këtë dosje dhe se gjendja financiare e të akuzuarit bënte të pamundur që të merrte honorar dhe t'i paguheshin shpenzimet gjyqësore.

2. z. Van der Mussele iu drejtua Komisionit më 7 mars 1980. Ai pretendonte

249 Gjykata i referohet Konventës për ndalimin e skllavërisë të 9 marsit 1927, Konventës shtesë në lidhje me shfuqizimin e skllavërisë, të trajtimit të skllavëve dhe të instituteve dhe praktikave të ngjashme me skllavërinë të 30 prillit 1956, Konventën e ONP "Mbi punën e detyruar" të 28 qershorit 1930, Rekomandimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës nr. 1523 (2001) të miratuar më 26 qershor 2001, dhe nr. 1663 (2004) të miratuar më 22 qershor 2004, Konventa e Këshillit të Europës mbi luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, të sapo hapur për nënshkrim, më 16 maj 2005.

250 Vendimi i Gjykatës i 9 korrikut 1980 në lidhje me çështjen *Van Droogenbroeck kundër Belgjikës*, si dhe vendimi i 7 marsit 2000 në lidhje me çështjen *Seguin kundër Francës*.



se shërbimi i tij kryesisht në mbrojtje të z. Ebrima përbënte “punë të detyruar ose me dhunë” që vinte në kundërshtim me nenin 4 § 2 të Konventës si dhe cenim të pasurive të tij, që vinte në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit 1. Në vijim ai ankohej për një diskriminim ndërmjet profesionit të avokatit në raport me profesionet e tjera, i cili sipas tij shkelte nenin 14 të Konventës të marrë së bashku me nenin 4 § 1 të saj. Me shumica mjaft të ngushta, sidomos në lidhje me nenin 14 ku vendosi vota e Kryetarit, në raportin e tij të 3 marsit 1982 Komisioni arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të asnjërit prej këtyre neneve.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimin paraprak

3. Belgjika ngrinte një pretendim paraprak duke argumentuar se detyrimi për ndihmë ligjore falas nga një avokat në çështjet penale bazohej në nenin 6 § 3 c) ndërkohë që për çështjet civile ai synon të përmbushë objektivat e paragrafit 1 të të njëjtit nen. Është e natyrshme, përgjigjet Gjykata, që shteti belg të marrë masat për të respektuar këto detyrime por kjo nuk do të thoshte që *a priori* autoritetet belge të mos respektojnë detyrimet e tjera që iu takojnë në bazë të Konventës.

### B. Në lidhje me nenin 4 § 1

4. Para së gjithash Gjykata detyrohet të theksojë se teksti i dispozitës së nenit 4 nuk shpjegon se çfarë kupton me “punë me dhunë ose me detyrim”. Për këtë arsye ajo iu referua Konventave 29 dhe 105 të Organizatës Botërore të Punës, në të cilat ishin anëtare pothuajse të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, përfshirë edhe Belgjikën. Sipas nenit 2 § 1 të Konventës 29, shprehja “punë me dhunë ose me detyrim” kupton “çdo punë ose shërbim që i kërkohet një individ nën kërcënimin e ndonjë dënimi dhe për të cilën ai individ nuk është ofruar me dëshirën e tij të lirë”. Pasur parasysh se në rastin e z. Van der Mussele nuk kishte të bënte me shtrëngim fizik ose moral Gjykata vlerësoi se shërbimet e tij nuk mund të konsideroheshin si punë me dhunë sipas kuptimit të nenit 4. Për këtë arsye ajo kaloi në vlerësimin nëse kishte të bënte me punë me detyrim. Sipas Gjykatës rreziqet me të cilat përballej z. Van der Mussele në rastin e një refuzimi përbënin vërtet kërcënimin e një dënimi. Duke mos e vlerësuar si përcaktues argumentin e përdorur nga qeveria belge dhe Komisioni – pëlqimin e dhënë nga vetë kërkuesi në momentin që ai kishte zgjedhur profesionin e avokatit, Gjykata e çmon të nevojshëm vlerësimin e tërësisë së rrethanave të çështjes nën dritën e interesave që luajnë rol në kuadrin e nenit 4 si karakteri normal i shërbimit, interesi i përgjithshëm dhe solidariteti social.

5. Shërbimet që z. Van der Mussele duhet të ushtronte nuk dilnin jashtë kuadrin të aktiviteteve normale të një avokati. Nga ana tjetër ato baraspeshoheshin me përfitime të lidhura me profesionin e avokatit si monopoli profesional i mbrojtjes dhe përfaqësimit në gjykatë dhe ndihmonin në formimin profesional të z. Van der Mussele. Për më tepër ky detyrim, duke ndihmuar në garantimin e të drejtave të z. Ebrima në kuadrin e nenit 6 § 3 (d) të Konventës, dukej se përfshihej në “*detyrimet normale qytetare*” të përmendura në nenin 4 § 3 (d).

Gjykata vlerësoi gjithashtu se kërkuesit nuk i ishte ngarkuar një barrë e tepërt në lidhje me mbrojtjen kryesisht duke pasur parasysh se e kishte ofruar këtë shërbim vetëm në lidhje me 50 çështje gjatë tre vjetëve të stazhit.

6. Gjykata vuri re se kërkuesi nuk ankohej ndaj detyrimit në parim por ndaj dy aspekteve të ekzekutimit të tij që ishin mungesa e honorarit dhe mosrimbursimi i shpenzimeve. Në këtë drejtim Gjykata vlerësoi se nuk kishte një barrë të tepërt dhe të paarsyeshme pasi kjo barrë baraspeshohej me pranimin në dhomën e avokatëve. Në këto kushte, duke pasur parasysh se nuk kishte të bënte me një rast të punës së detyruar Gjykata me unanimitet vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 4 të Konventës.

### *C. Në lidhje me nenin 14 të marrë së bashku me nenin 4*

7. z. Van der Mussele pretendonte se profesioni i avokatit në një rast të tillë diskriminohej në raport me profesione të tjera. Duke interpretuar se neni 14 ndalon diskriminimin në trajtim të personave që ndodhen në situata të ngjashme ose të përafërta dhe duke marrë si bazë krahasimi profesionin, Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 të marrë së bashku me nenin 4, kjo për shkak se situata e profesionit të avokatit nuk ishte e ngjashme me atë të gjyqtarit, funksionarit publik, mjekëve, dentistëve, etj.

### *D. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1*

8. Duhet pasur parasysh se neni 1 i Protokollit 1 të Konventës garanton të drejtën e pasurive reale aktuale. Në këto kushte përsa i përket shpërblimit të z. Van der Mussele, situata ekonomike e z. Ebrima nuk e lejonte lindjen e një të drejte pasurore. Problemi shtrohej ndryshe në lidhje me shpenzimet. Kjo për arsye se z. Van der Mussele kishte qenë i detyruar që të paguante disa shpenzime nga të ardhurat e veta. Megjithatë Gjykata vlerësoi se ato ishin fare të ulëta dhe përbënin një pasojë të një detyrimi për të realizuar një punë që ishte në përputhje me nenin 4 të Konventës.

## **III. Koment**

9. Ky vendim përbën ende përpunimin më të rëndësishëm jurisprudencial të realizuar në Strasburg në lidhje me nenin 4 të Konventës. Vendimi jo vetëm që shpjegon thelbin e nenit 4, por edhe mënyrën sesi paragrafët e tij mund të interpretohen në një mënyrë kontekstuale – në marrëdhënie me njëri tjetrin. Nga ana tjetër vendimi sqaron konceptet që ky nen përfshin si edhe mënyrën e kuptimit dhe të interpretimit të tyre. Ai sqaron në mënyrë të veçantë konceptet e ‘punës’, të ‘detyrimit’ dhe ‘dhunës’ në lidhje me punën. Është interesant fakti që Gjykata për sqarimin e këtyre termave i referohet Konventave të ONP, nr. 29 “Mbi punën e detyruar” të vitit 1930 dhe atë që e plotëson, me nr. 105 “Mbi eliminimin e punës së detyruar” të vitit 1957. Ky është i shpjegueshëm si fakt po të kihet parasysh se neni 4 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në momentin e formulimit ka mbajtur parasysh pikërisht Konventën nr. 29.

10. Me rëndësi të veçantë është të theksohet fakti se në këtë vendim, në lidhje me një të drejtë që ka karakter absolut dhe që është e paderogueshme, Gjykata zbaton parimin e proporcionalitetit. Pretendimeve të qeverisë belge në lidhje me faktin se Van der Mussele e kishte zgjedhur vetë profesionin e avokatit, i cili përfshinte edhe detyrimin e shërbimit pa shpërblim sipas rregullave të parashikuara nga vetë Dhoma e Avokatëve, Gjykata nuk i kushton një rëndësi vendimtare. Më i rëndësishëm në sytë e Gjykatës duket fakti se profesioni i avokatit, në shkëmbim të këtyre detyrimeve për shpërblim pa pagesë, i përgjigjen disa përfitime të tjera specifike, përfshirë të drejtën ekskluzive për përfaqësim në gjykatë, të faktit që ky shërbim e ndihmonte për t'u përgatitur dhe pranuar në Dhomën e Avokatisë. Nga ana tjetër Gjykata theksoi se ky shërbim kontribuonte të realizimin e një të drejte të garantuar nga neni 6 § 1 (c) i Konventës dhe se mund të konsiderohej se përfshihej në detyrimet normale civile<sup>251</sup>.

## CHOWDURY DHE TË TJERË kundër GREQISË

(kërkesa nr. 21884/15)

30 mars 2017

*shkelje e detyrimit të Shtetit për të parandaluar, hetuar dhe dënuar personat përgjegjës për trafikimin e qënieve njerëzore*

### I .Faktet kryesore

1. Kërkuesit, 42 shtetas nga Bangladeshi që jetojnë në Greqi, kishin punuar si mbledhës luleshtrydhës në një fermë në Manolada nga tetorit i vitit 2012 deri në shkurt të vitit 2013, pa pasur leje pune, Për punën e bërë atyre u ishte premtuar një rrogë prej 22 € për shtatë orë punë dhe 3 € për çdo orë shtesë mbi orarin e punës. Ata punonin çdo ditë nga ora 7:00 deri në orën 19:00 nën mbikëqyrjen e rojeve të armatosur. Punëdhënësit e tyre i kishin kërcënuar se do të paguheshin vetëm nëse vazhdonin të punonin. Kërkuesit jetonin në kasolle të improvizuara pa tualete e ujë të rrjedhshëm.

2. Në shkurt 2013, mars 2013 dhe prill 2013 punëtorët zhvilluan greva duke kërkuar të paguheshin për punën e bërë, por pa sukses. Më 17 prill 2013 punëdhënësit rekrutuan më shumë emigrantë nga Bangladeshi. Duke qënë të frikësuar për mos marrjen e pagave, 100-150 punëtorë të sezonit të vjeljes së luleshtrydheve 2012-2013 tentuan tu afroreshin dy punëdhënësve për të kërkuar pagat e tyre. Një nga rojet hapi zjarr në drejtim të tyre duke plagosur rëndë 30 punëtorë, ku përfshihesin dhe 21 prej kërkuesve. Të plagosurit u dërguan në spital dhe u morën në pyetje nga policia.

251 Në lidhje me këtë element të fundit shih gjithashtu çështjen *Iversen kundër Norvegjisë*.

3. Dy punëdhënësit, së bashku me rojen i cili kishte hapur zjarr dhe një rojë tjetër të armatosur, u arrestuan dhe u gjykuan për veprën penale të tentativës për vrasje - më pas u riklasifikua si dëmtime të rënda trupore - dhe për trafikim të qenieve njerëzore. Me një vendim të datës 30 korrik 2014, gjykata rrëzoi akuzat ndaj tyre për trafikimin e qenieve njerëzore dhe dënoi rojën e armatosur dhe një nga punëdhënësit për dëmtime të rënda trupore dhe përdorim të paligjshëm të armëve të zjarrit. Dënimet e tyre me burgosje u zëvendësuan më dënime me gjobë. Gjithashtu, ata u urdhëruan t'u paguanin 35 punëtorëve, të cilët ishin njohur si viktimat, 1 500 euro, pra 43 € secilit prej tyre. Dy të dënuarit apeluan kundër këtij vendimi. Në kohën e vendimit të Gjykatës, ankesa e tyre ishte në pritje dhe kishte efekt pezullues.

4. Më 21 tetor 2014 punëtorët kërkuan nga prokurori pranë Gjykatës së Kasacionit të apelonte vendimin e gjykatës, duke argumentuar se akuzat për trafikimin e qenieve njerëzore nuk ishin shqyrtuar siç duhej. Kjo kërkesë u hodh poshtë dhe pjesa e vendimit të gjykatës asiz që rrëzonte akuzat për trafikimin e qenieve njerëzore mori formë të prerë.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesit pretenduan, duke u mbështetur në nenin 4 § 2 të Konventës, se kishin kryer punë të detyruar. Gjithashtu, ata pretenduan se Shteti kishte detyrimin të parandalonte trafikimin e tyre, duke miratuar masa parandaluese dhe të ndëshkonte punëdhënësit.

### A. Në lidhje me nenin 4

6. Gjikata bëri dallimin ndërmjet robërimit dhe punës së detyruar. Ajo vërejti se gjykatat kombëtare e kishin barazuar në mënyrë efektive konceptin e trafikimit me robërimin; një koncept që kërkon që viktimat të ndiejë se gjendja e tij është e përhershme. Ky nuk mund të konsiderohet rasti i kërkuesve, pasi ata ishin punëtorë sezonalë. Megjithatë, faktet në fjalë, dhe në veçanti kushtet e punës së kërkuesve, çonin në konstatimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të punës së detyruar të përcaktuar në nenin 3a të "Protokollit të Palermos" dhe nenin 4 të Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, ku parashikohet se shfrytëzimi përmes punës është një aspekt i trafikimit njerëzor. Gjikata riafirmoi se puna e detyruar nënkuptonte kufizime, qoftë fizike apo morale. Gjithashtu, e rëndësishme për Gjykatën në konstatimin nëse kishin të bënin me trafikim të qenieve njerëzore dhe punë të detyruar, ishte natyra e punës dhe intensiteti i saj.

7. Gjikata më pas shqyrtoi detyrimet e Shtetit sipas nenit 4 § 2 dhe vuri në dukje se ato kishin detyrimin të miratonin një kuadër ligjor dhe administrativ që ndalonte dhe dënonte punën me dhunë ose të detyruar, robërimin apo skllavërimin. Lidhur me këtë, Gjikata vuri në dukje se Greqia kishte ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në vitin 2014. Më tej, Gjikata konkludoi se, në mënyrë që për Shtetin

të lindte një detyrim pozitiv, siç është detyrimi për të hetuar, shteti duhet të ketë qenë i vetëdijshëm për rrethanat që mund të çonin drejt përfundimit se kishte njerëz që i nënshtroheshin trajtimit të ndaluar. Në rastin në fjalë, Gjykata vërejtë se Shteti ishte njoftuar, edhe para ngjarjeve të 17 prillit 2013, për situatën në plantacione e luleshtrydheve në Manolada nga raporte dhe artikuj të shtypit. Debate kishte pasur edhe në Parlament, ku tre ministra urdhëruan inspektive dhe hartimin e akteve ligjore që synonin përmirësimin e situatës së migrantëve. Edhe Zyra e Ombudsmanit kishte paralajmëruar disa ministra dhe organe shtetërore, por nuk u arritën rezultate të prekshme deri në vitin 2013. Për më tepër, punonjësit e stacionit të policisë të Amaliada duket se ishin në dijeni për mos pagimin e punëtorëve nga punëdhënësit e plantacioneve të luleshtrydhes, pasi një oficer i policisë kishte pranuar gjatë dëshmisë së dhënë në gjykatë, se punonjësit e fermës ishin ankuar për këtë situatë. Kështu, Gjykata vërejtë se masat operacionale të marra nga autoritetet nuk kishin qenë të mjaftueshme për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore dhe për të mbrojtur kërkuesit nga trajtimi të cilit u ishin nënshtuar.

8. Për të shqyrtuar efektivitetin e hetimit dhe procedurat gjyqësore të ndërmarra, pra për të parë nëse Shteti kishte përmbushur detyrimin e tij sipas nenit 4, Gjykata i ndau kërkuesit në dy grupe, ata që kishin marrë pjesë në procedurat para gjykatës kompetente dhe ata të cilët nuk kishin marrë pjesë. Lidhur me këta të fundit, Gjykata vuri në dukje se ata kishin paraqitur një ankesë më 8 maj 2013 duke pretenduar se ishin punësuar në fermën që i përkiste T.A. dhe N.V në kushtet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të punës së detyruar. Ankesa e tyre ishte hedhur poshtë pasi prokurori vërejtë që nëse vërtetë ata do të kishin qenë viktimë, do ta kishin raportuar ngjarjen më 17 prill 2013, në vend që të prisnin deri më 8 maj 2013. Gjykata u shpreh se duke mos verifikuar vërtetësinë e akuzave, prokurori nuk kishte respektuar detyrimin e tij për të kryer një hetim. Neni 13 i Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore parashikonte një "periudhë rikuperimi dhe reflektimi" prej së paku 30 ditësh, në mënyrë që personi në fjalë të mund ta rimerrte veten nga situata e krijuar, t'i shpëtonte ndikimit të trafikantëve dhe të merrte një vendim pasi të ishte mirë informuar për të bashkëpunuar me autoritetet kompetente. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 4 § 2 të Konventës në lidhje me detyrimin procedural për të kryer një hetim efektiv.

9. Për sa i përket kërkuesve të cilët kishin marrë pjesë në procedurat para gjykatës kompetente, Gjykata vuri në dukje se gjykata kombëtare e kishte liruar të pandehurit nga akuzat për trafikim, pasi lëvizja e punëtorëve nuk ishte e kufizuar. Sidoqoftë, kufizimi i lëvizjes nuk është një kushti i vetëm që të jemi në kushtet e punës së detyruar apo trafikim njerëzor. Në çdo rast, Gjykata vërejtë se kërkuesit nuk kishin leje pune apo leje qëndrimi në Greqi dhe për rrjedhojë çdo përpjekje për të lënë punën mund të sillte rrezikun e dëbimit. Për më tepër, duke qenë se nuk ishin paguar nuk mund ta linin punën për shkak të pamundësisë financiare.

10. Për më tepër, dënimi me burgim i të pandehurve për lëndime të rënda trupore ishte konvertuar në një dënim financiar prej 5 € për cdo ditë me burgim. Gjykata kishte urdhëruar T.A. dhe një nga rojet e armatosura për të paguar të dy 1,500 €, ose 43 € për cdo punonjës të dëmtuar. Megjithatë, neni 15 i Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore kërkonte që Shtetet Kontraktuese, përfshirë Greqinë, të garantonin të drejtën e viktimave për t'u kompensuar nga personat që kanë kryer veprën penale ndaj tyre dhe, ndër të tjera, për të krijuar një fond kompensimi për viktimat. Kështu, Gjykata konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 4 § 2 të Konventës në lidhje me detyrimin procedural të Shtetit për të kryer një hetim efektiv mbi gjendjen e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të punës së detyruar të pretenduar nga kërkuesit dhe për të garantuar procedura efektive gjyqësore.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

11. Gjykata vendosi se Greqia duhet t'i paguante secilit prej kërkuesve, të cilët kishin marrë pjesë në procedurat para gjykatës kompetente 16,000 € dhe 12,000 € kërkuesve të tjerë në lidhje me të gjitha dëmet e pësuar, si dhe 4,363.64 € për të gjithë kërkuesit në lidhje me kostot dhe shpenzimeve.

## **III. Komente**

12. Qëndrimi që mbajti Gjykata në këtë vendim është një risi dhe përbën një shtojcë dhe sqarim thelbësor për praktikën gjyqësore të Gjykatës sipas nenit 4, e cila deri më tani ka qenë mjaft e kufizuar. Analiza e Gjykatës ndjek hapa progresivë dhe impakti i këtij vendimi është në katër aspekte.

13. Aspekti i parë i rëndësishëm i këtij vendimi ka të bëjë me fushën e zbatimit të nenit 4 dhe përkufizimin e punës së detyruar. Situata e kërkuesve në rastin në fjalë ishte e ndryshme nga ajo në rastet e tjera ku Gjykata kishte përdorur nenin 4 e për rrjedhojë ajo vërejti se situata e tyre nuk përbënte robërim,<sup>252</sup> kryesisht për shkak se kërkuesit ishin punonjës sezonalë dhe, të paktën në teori, mund të largoheshin nga fermat e luleshtrydheve në Manolada ku punonin. Megjithatë, Gjykata vendosi se kërkuesit ishin në situatën e punës së detyruar dhe trafikimit njerëzor. Fakti që kërkuesit i frikësoheshin mos pagimit të detyrimeve financiare të prapambetur nga punëdhënësi, fakti që ata punonin për orë të tëra dhe të rrethuar nga rojet, nën kërcënimet e vazhdueshme të punëdhënësit e tyre që i paguanin shumë pak, i mjaftuan Gjykatës për të konkluduar se kërkuesit ishin në situatën e punës të detyruar dhe trafikimit njerëzor. Qendra AIRE, në cilësinë e palës së tretë ndërhyrëse në këtë çështje, theksoi veçanërisht rëndësinë e përcaktimit të elementeve përbërës të nenit 4 § 2.<sup>253</sup>

252 Shih në krahasim me çështjen *Siliadin k. Francës*, vendim i 26 korrikut 2005, nr. 73316/01, dhe *C.N. dhe V. k. Francës*, vendim i 11 tetorit 2012, nr. 67724/09.

253 Shih ndërhyrjen nga Qendra AIRE në paragrafin 85 të vendimit.



14. Shumë i lidhur me aspektin e parë të impaktit të këtij vendimi është aspekti i dytë - përdorimi në arsyetimin e Gjykatës së Konventës së Këshillit të Evropës mbi Veprimin Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Për të arritur në përfundimin se situata e kërkuesve duhej të konsiderohej punë e detyruar dhe trafikim, si dhe për të qartësuar përcaktimin e situatës së tyre nga gjykatat vendase, Gjykata e Strasburgut e bazoi analizën e saj mbi këtë Konventë,<sup>254</sup> dhe në Protokollin e Palermos<sup>255</sup> të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar. Gjykata e përdori Konventën e Trafikimit të Këshillit të Evropës edhe për të përcaktuar fushëveprimin e detyrimeve pozitive që Shtetet kanë sipas nenit 4 të Konventës. Gjykata theksoi se detyrimet pozitive të Shteteve Anëtare sipas nenit 4 të Konventës duhet të interpretohen në bazë të Konventës për Trafikimin dhe interpretimeve të GRETA-s (një grup ekspertësh përgjegjës për monitorimin e zbatimit të saj). Është e rëndësishme të theksohet se në kohën e ngjarjeve në fjalë, Konventa e Trafikimit ende nuk ishte në fuqi në Greqi, por kjo nuk e pengoi Gjykatën që t'i referohej asaj me qëllim qartësimin e përkufizimit të punës së detyruar, trafikimit të qenieve njerëzore dhe shtrirjen e detyrimeve pozitive të Shteteve në situata të tilla.

15. Analiza e detyrimeve pozitive të Shteteve përbën kontributin e tretë të madh të këtij vendimi. Duke iu referuar *Siliadin kundër Francës*, Gjykata rikujtoi se, përveç miratimit të masave parandaluese, mbrojtjes së viktimave dhe kryerjes së hetimeve, detyrimet pozitive të Shtetit përfshijnë edhe kriminalizimin dhe dënimin efektiv të çdo akti që synon mbajtjen e një personi në situata të tilla - ky është një udhërrëfyes për Gjykatën gjatë kryerjes së analizës së saj. Gjykata analizoi së pari detyrimin për të pasur një kornizë ligjore dhe rregulluese, së dyti, masat operationale dhe së treti, efektivitetin e hetimit dhe të procedurave gjyqësore. Megjithëse Gjykata konstatoi se Greqia kishte përmbushur aspektin e parë të detyrimeve të saj pozitive sipas nenit 4 § 2, ajo kishte dështuar të respektonte elementët e dytë dhe të tretë të këtyre detyrimeve.

16. Arsyeja e katërt se pse ky vendim është veçanërisht i rëndësishëm, qëndron në statusin e 42 kërkuesve. Ata ishin të gjithë emigrantë nga Bangladeshi dhe vulnerabiliteti i tyre jo vetëm që kishte kontribuar në abuzimin e tyre nga punëdhënësi dhe faktin që shtetet duhet të tregonin një vëmendje të veçantë në këtë drejtim, por ka një rëndësi vendimtare në kualifikimin ligjor të abuzimit të tyre. Gjykata në mënyrë specifike iu referua situatës së tyre vulnerabël që i bëri kërkuesit të pranorin të punonin në ato kushte në fermën në Manolada.

254 Konventa e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e hapur për firmosje më 16 maj 2005 dhe hyrë në fuqi më 1 shkurt 2008.

255 Protokollin për të Parandaluar, Shtypur dhe Dënuar Trafikimin e Personave, Vecanërisht i Grave dhe Fëmijëve i miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 55/25. Ai hyri në fuqi më 25 dhjetor 2003.



# NENI 5

## E DREJTA PËR LIRI DHE SIGURI

## ENGEL DHE TË TJERË kundër HOLLANDËS

(kërkesat 5100/71; 5101/71; 5102/71 dhe 5103/7)

8 qershor 1976

*kjo çështje kishte të bënte me zbatimin e të drejtave të njohura nga Konventa edhe në kushtet e shërbimit ushtarak dhe me efektet reale që mund të kenë masat me karakter disiplinor të marra në një regjim të tillë*

### I. Faktet kryesore

1. Pesë kërkuesit janë Cornelis J. M Engel, Peter van der Wiel, Gerrit Jan de Wit, Johannes C. Dona dhe Willem A.C. Schul, të gjithë shtetas holandezë, të cilët në 1970 dhe 1971 ishin rekrutuar si ushtarë në shërbim të radhëve pa shpërblim të forcave të armatosura holandeze. Në raste të veçanta, kërkuesit ishin ndëshkuar nga oficerët e tyre për shkelje të disiplinës ushtarake. z. Engel dhe z. van der Wiel ishin akuzuar për mungesë pa leje, z. de Wit për drejtim të makinës pa kujdes dhe moszbatim urdhrash. z. Dona dhe z. Schul ishin redaktues të një gazete të botuar nga shoqata e rekrutëve në shërbim; ata u ndëshkuan si rrjedhojë e paraqitjes në gazetë të disa shkrimeve të konsideruar shkatërrues për disiplinën ushtarake.

2. Ndëshkimi i parë kundër z. de Wit, z. Dona dhe z. Schul i qe lënë në kompetencë një njësie ushtarake. z. Engel dhe z. van der Wiel ishin dënuar disa herë me disa ditë "të lehta", "të rënduara" ose "arrest i rreptë". Duke mos përfillur ndëshkimin e tij të parë, z. Engel është mbajtur në arrest të rreptë, përpara se të dënohej përsëri. Çdo kërkues apeloi vendimet e oficerëve, dhe më pas i kundërshtoi ato përpara Gjykatës të Lartë Ushtarake, e cila la në fuqi vendimet e diskutuara. Sidoqoftë, kjo e fundit i lehtësoi ndëshkimet në 12 ditë arrest të rënduar për z. Wit dhe për z. Schul burgim nga katër në tre muaj. Në pritje të vendimeve të apelit, z. Dona dhe z. Schul u vunë përkohësisht për një muaj në një arrest të rëndë. Ndëshkimet e tyre u ekzekutuan menjëherë pas vendimit të Gjykatës së Lartë Ushtarake. Dy ndëshkimet e fundit u anuluan më 1974.

3. Një ushtarak i zakonshëm ose një oficer pa shpërblim në arrest të lehtë do të thoshte izolim në një kazermë, por ai mund të lëvizte lirshëm nga kazerma e tij gjatë orëve të pushimit. Ndëshkimi i dhënë nga një njësi disiplinore, të cilës iu nënshtroheshin vetëm ushtarë të thjeshtë, e nënshtronte shkelësin në një disiplinë më të rreptë duke e dërguar atë në një vend të veçantë për një periudhë tre deri në gjashtë muaj.

4. Kërkuesit dërguan çështjet e tyre përpara Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut në data të ndryshme gjatë vitit 1971. Së bashku me njëri tjetrin ata u ankuan se ndëshkimet e tyre përbënin heqje lirie në kundërshtim me nenin 5, se procedura përpara autoriteteve ushtarake dhe Gjykatës së Lartë Ushtarake nuk i plotësonte kërkesat e nenit 6 dhe se trajtimi i tyre ishte diskriminues duke shkelur nenin 14 marrë së bashku me nenet 5 dhe 6. z. Engel pretendonte, lidhur me arrestin e kushtëzuar, se ishte shkelur neni 5. Të njëjtën gjë pretendonin z. Dona dhe z. Schul lidhur me arrestimin e tyre të përkohshëm. Këta të fundit u ankuan edhe për shkelje të neneve 10, 11, 14, 17 dhe 18. Në raportin e tij të 19 korrikut 1974, Komisioni u shpreh se, me përjashtim të atyre në lidhje me arrestimet e lehta, të gjithë kërkuesit pretendonin shkelje të nenit 5 §§ 1 dhe 4, dhe se arrestimi i përkohshëm i z. Engel shkelte nenin 5 § 1, por nuk kishte shkelje të Konventës në lidhje me ankimet e tjera. Çështja u dërgua përpara Gjykatës nga Komisioni më 8 tetor 1974 dhe më pas nga qeveria Holandeze më 17 dhjetor 1974.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. *Konventa dhe shërbimi ushtarak*

6. Fillimisht, Gjykata pohoi se "Konventa zbatohet edhe kundrejt forcave të armatosura, dhe jo vetëm civilëve". Sidoqoftë, karakteristikat e jetës ushtarake duhet të mbahen gjithsesi parasysh gjatë interpretimit dhe zbatimit të Konventës.

### B. *Në lidhje me nenin 5*

7. Nën dritën e shpalljes së parimit të përgjithshëm, Gjykata e pranoi të drejtën për liri të një individ në kontekstin e shërbimit ushtarak. "Një ndëshkim disiplinor ose një masë, e cila po të analizohej, do të gjykohej si një heqje lirie po të zbatohej kundrejt një personi civil, mund të mos kishte këtë karakter në qoftë se do t'i imponohej një ushtari. Sidoqoftë, ky ndëshkim ose masë nuk i shpëton termave të nenit 5. Ai merr formën e një kufizimi që devijon qartë nga kushtet normale të jetës brenda forcave të armatosura të palëve kontraktuese".

8. Mbi bazën e këtij kriteri, arresti i rreptë dhe ndëshkimi nga një njësi disiplinore, duke mos qenë as një arrest i lehtë as i rënduar ishin vlerësuar si heqje lirie. Gjykata konkludoi se vetëm arresti i përkohshëm (i rreptë) dhe ndëshkimi i z. Dona dhe z. Schul nga një njësi ushtarake kërkonin një shqyrtim tërësor nën dritën e nenit 5; ishin të përjashtuar nga ky vlerësim, arrestimi i thjeshtë i z. Engel dhe i z. van der Wiel, arresti i rënduar i z. de Wit dhe mbikëqyrja e përkohshme (arrest i rënduar) e z. Dona dhe z. Schul.

9. Më pas, Gjykata kishte për të përcaktuar nëse rastet e heqjes së lirisë ishin ose jo të justifikuar nga njëri prej përjashtimeve të paraqitura në nenin 5 § 1. Burgimi i z. Dona dhe z. Schul u gjykua si i pajtueshëm me paragrafin 1 pika (a), i cili lejon "ndalimin legjitim të një personi pas dënimit nga një gjykatë kompetente", ndërsa arresti i përkohshëm i z. Engel u gjykua në mospërputhje me nenin 5 § 1.

### *C. Në lidhje me nenin 6 § 1*

10. Problemi i përgjithshëm i ngritur në këtë aspekt ishte nëse dhe në çfarë mase kërkesat e nenit 5 ishin të zbatueshme në procedurat ushtarake disiplinore. Në rrethana të veçanta, nuk ishte nevoja të vendosej nëse, procedura disiplinore e kundërshtuar lidhej me përcaktimin e të drejtave civile sipas kuptimit të nenit 6 § 1.

11. Duke kufizuar vetveten në fushën e shërbimit ushtarak, Gjykata analizoi në mënyrë të detajuar çështjen e përcaktimit të kufirit midis “një veprë të sanksionuar penalisht” dhe “një shkelje disiplinore”. Në fakt, Gjykata vendosi se shteti nuk mund t’i shpëtojë detyrimit themelor për t’i akorduar një gjykim të drejtë një personi të akuzuar për kryerjen e veprë penale, thjesht duke e klasifikuar këtë si një shkelje disiplinore. Gjykata tregoi një numër kriteresh të rëndësishëm për të përcaktuar nëse një shkelje konkrete e veshur nga Shteti me një karakter disiplinor të llogaritet si penale sipas nenit 6. Përtej kategorizimit sipas së drejtës së brendshme Gjykata u shpreh se një faktor i rëndësishëm është natyra e shkeljes në vetvete. Në këtë mënyrë, “kur një ushtarak akuzohet për një veprim ose mosveprim që pretendohet të ketë shkelur një rregull të ligjshëm që udhëheq operacionin e forcave të armatosura, shteti në parim mund të zbatojë kundrejt tij një “ligj disiplinor” në vend të një “ligji penal”. Rreptësia e ndëshkimit duhet të merret gjithashtu parasysh. Ato që i përkasin sferës “penale” janë “heqja e lirisë e konsideruar si ndëshkim, me përjashtim të atyre që nga natyra, nga zgjatja ose mënyra e ekzekutimit nuk mund të vlerësohen si të dëmshme”.

12. z. de Wit, z. Dona dhe z. Schul rrezikonin përpara “gjykatës” përkatëse, Gjykatës së Lartë Ushtarake, një ndëshkim shumë serioz që nënkuptonte heqje të gjatë lirie. Akuzat me karakter disiplinor të ngritura ndaj tyre, ndryshe nga ato ndaj z. Engel dhe të z. Van der Wiel, kishin një karakter penal. Konventa nuk kërkonte ndjekjen penale të këtyre “akuzave penale” përpara një gjykate ushtarake, por për më tepër kërkonte zbatimin e garancive të nenit 6 në procedurat e ndjekura.

13. Duke shqyrtuar procedurat në fjalë, Gjykata konstatoi se të tre kërkuesit kishin gëzuar garancitë e ndryshme të parashikuara nga paragrafët e nenit 6, por vetëm me një përjashtim: dëgjimi përpara Gjykatës së Lartë Ushtarake ishte bërë në dhomë dhe jo në publik. Si rrjedhim ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në këtë aspekt.

### *D. Në lidhje me nenin 10 § 2 dhe nenin 11*

14. Duke njohur se ndëshkimi i z. Dona dhe z. Schul shkelte të drejtën e tyre për lirinë e shprehjes, Gjykata pranoi pretendimin e qeverisë se imponimi i tij kishte qenë i rëndësishëm në një shoqëri demokratike për parandalimin e çrregullimit në forcat e armatosura të Holandës, sipas kuptimit të nenit 10 § 2. “Sigurisht, liria e shprehjes e garantuar nga neni 10 gjen zbatim tek ushtarët ashtu si te personat e



tjerë në jurisprudencën e shteteve kontraktuese. Sidoqoftë, funksionimi i duhur i një ushtrie është vështirë të imagjinohet pa norma ligjore, të cilat parandalojnë veprimet e ushtarëve për të shkatërruar disiplinën ushtarake, për shembull shkrimet". Duke qenë të disiplinuar nga këto rregulla z. Dona dhe z. Schul nuk kanë qenë të privuar nga liria e shprehjes, por vetëm të ndëshkuar nga ushtrimi abuziv i kësaj lirie. Pra Gjykata nuk gjeti ndonjë shkelje të neneve 10, 17 dhe 18.

15. Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të së drejtës së lirisë së shoqatës të z. Dona dhe z. Schul, ashtu si i parashikon neni 11 § 1. Ky përfundim nënkupton se është e panevojshme të shqyrtohen nenet 14, 17 dhe 18 në këtë kontekst.

#### *E. Në lidhje me nenin 14 marrë së bashku me nenet 5 § 1, 6 dhe 10*

16. Gjykata vlerësoi se nuk ka pasur diskriminim në shkelje të nenit 14 për sa i përket gëzimit të të drejtave të mbrojtura nga neni 5 § 1, neni 6 dhe neni 10. Në veçanti, dallimet e pranuar ose mos barazitë midis ushtarëve dhe civilëve në këto fusha ishin legjitimisht të shpjgueshme nga "kushtet dhe kërkesat e jetës ushtarake, të cilat janë nga natyra të ndryshme nga ato të jetës civile". Kërkuarit kishin kundërshtuar dallimet e bëra midis radhëve të ushtarëve, për sa i përket shtrirjes dhe mënyrës së ekzekutimit të ndëshkimeve disiplinore. Mbi këtë pikë, "ruajtja e disiplinës nga metoda të përshtatshme për çdo kategori ushtarësh" ishte gjykuar si një qëllim legjitim i aftë për të justifikuar këto dallime.

#### *F. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)<sup>256</sup>*

17. Së fundi, për sa i përket shkeljes së Konventës, Gjykata e shtyu zgjidhjen e çështjes së akordimit të një shpërblyeri të drejtë katër kërkuarëve mbi bazën e nenit 50. Gjykata e dha vendimin në një seancë plenare, në përputhje me nenin 48 të Rregullores të Gjykatës.<sup>257</sup>

### **III. Koment**

18. Vendimi në lidhje me këtë çështje paraqet interes të veçantë në radhë të parë sepse ka të bëjë me një nga parimet më të rëndësishme por edhe më karakteristike të interpretimit të Konventës – pikërisht me parimin e koncepteve autonome në interpretim<sup>258</sup>. Duke filluar nga paragrafi 81 i vendimit e në vijim, Gjykata theksoi se kategorizimi i një akuze sipas së drejtës së brendshme nuk e kushtëzon Gjykatën që ta zbatojë Konventën në bazë të këtij kategorizimi. Përkundrazi, Gjykata e Strasburgut, e udhëhequr edhe nga parimi tjetër i efektivitetit të garantimit të të drejtave të parashikuara nga Konventa do të procedojë me kategorizimin e vet. Me vlerë themelore në këtë vendim paraqiten tre kriteret që ofron Gjykata për të kategorizuar një akuzë si penale apo jo:

256 Vendim i 23 nëntorit 1976

257 Dhoma e shtatë gjyqtarëve e formuar fillimisht për të gjykuar çështjen, u tërhoq duke ia kaluar Gjykatës Plenare, më 1 tetor 1975.

258 Shih në lidhje me këtë parim "Të Drejtat e Njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komentë", 2001. fq. 40.

- i. familja e së drejtës së brendshme të përfshin shkeljen e caktuar;
- ii. natyra në vetvete e sjelljes konkrete që ndalohej nga dispozita e brendshme;
- iii. ashpërsia e sanksionit që parashikon e drejta e brendshme.

19. Në prani të këtyre tre kritereve, në gjirin e Gjykatës pati katër mendime paralele. Gjyqtarët Cremona dhe Zekia në mendimet e tyre paralele u shprehën se në të gjitha rastet kur ushtarët akuzoheshin me një akuzë që mund të çonte në dënimin e tyre me burg, qoftë edhe për një periudhë të shkurtër, neni 6 § 1 i Konventës gjente zbatim. Ndërsa gjyqtarët O'Donoghue dhe Pedersen u shprehën se procedimet ndaj kërkuessve kishin natyrë kryesisht disiplinore kështu që neni 6 nuk gjente zbatim<sup>259</sup>.

20. Nga ana tjetër, është tepër i rëndësishëm pohimi i bërë nga Gjykata në këtë vendim se Konventa gjen zbatim dhe në situatat e reparteve ushtarake apo të përqendrimeve të ngjashme në përgjithësi dhe jo vetëm ndaj popullsisë civile.

## **GILLAN DHE QUINTON kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(kërkesa nr. 4158/05)

**12 janar 2010**

*ndalimi dhe kontrolli i personave nga policia britanike në bazë të legjislacionit kundër terrorizmit ngre probleme sipas neneve 5 dhe 8 të Konventës*

### **I. Faktet kryesore**

1. Kërkuessit, Kevin Gillan dhe Quinton Pennie, janë shtetas britanikë të cilët kanë lindur respektivisht në vitet 1977 dhe 1971 dhe jetojnë në Londër. Në shtator 2003 ata u ndaluan dhe kontrolluan nga policia britanike në bazë të neneve 44-47 të Ligjit mbi Terrorizmit të vitit 2000, ndërsa po shkonin për të marrë pjesë në një demonstratë pranë një panairi armatimesh në zonën e Docklands në Londrën Lindore. z. Gillan ishte mbi biçikletë dhe të mbante një çantë shpine, kur u ndalua dhe u kontrollua nga dy oficerë të policisë. z. Quinton, që ishte gazetar, u ndalua dhe u kontrollua nga një oficer i policisë dhe i cili edhe urdhëroi të ndaluar filmimin, pavarësisht nga fakti se ai i tregoi cartën e tij profesionale si gazetar.

<sup>259</sup> Këto kritere të përpunuara në këtë çështje janë përdorur në një sërë vendimesh të tjera nga ana e Gjykatës nga të cilat vlen të shihen Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar, Ozturk kundër Gjermanisë, Deweer kundër Belgjikës.

2. Në bazë të Ligjit të vitit 2000, një oficer i lartë i policisë kur vlerëson të "dobishme për parandalimin e akteve të terrorizmit" mund të autorizojë çdo polic me uniformë brenda një zone të veçantë gjeografike për të ndaluar çdo person dhe për ta kontrolluar atë dhe çdo gjë që ai ka me vete. Autorizimi duhet të konfirmohet nga Sekretari i Shtetit brenda 48 orësh. Kontrolli mund të kryhet pavarësisht nëse polici në fjalë arsye që të dyshojë, por synon vetëm objekte që mund të përdoren në lidhje me terrorizmin.

3. Ankesat dhe apelet e kërkuessve në lidhje me ndalimet dhe kontrollet e tyre nuk patën sukses. Dhoma e Lordëve u shpreh se ishte e dyshimtë nëse një kontroll rutinë dhe sipërfaqësor i një personi mund të thuhet se tregon mungesë respekti për jetën private, në mënyrë që të fusë në veprim nenin 8 të Konventës. Edhe në qoftë se neni 8 gjen zbatim, vazhduan Lordët britanikë, procedura ka qenë në përputhje me ligjin dhe se do të ishte e pamundur që një ushtrim si duhet i pushtetit të konsiderohet se nuk është proporcional kur ka për qëllim që të parandalojë rrezikun e madh të terrorizmit.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuessit u ankuan se përdorimi i kompetencës së parashikuar nga neni 44 i Ligjit kundër Terrorizmit për të ndaluar dhe të kontrolluar secilin prej tyre ka shkelur të drejtat e tyre sipas neneve 5, 8, 10 dhe 11.

### A. Në lidhje me nenin 8

5. Gjykata u shpreh se përdorimi i kompetencave të parashikuara nga ligji për t'i kërkuar një individ që ti nënshtorhet një kontrolli të imët të personit, veshjeve dhe sendeve personale përbën një ndërhyrje të qartë ndaj të drejtës për respektimin e jetës private. Natyra publike e kërimit, duke e vënë në pozitë të vështirë personat të cilët detyrohen të nxjerrin në publik të dhënat personale, në raste të caktuara mund edhe rëndojë seriozitetin e ndërhyrjes, për shkak të elementit të poshtërimit dhe sikletit që përmban. Në vlerësimin nëse ndërhyrja është në përputhje me ligjin, Gjykata vërejt se në fazën e autorizimit nuk kishte kritere që ndalimi dhe kontrolli të konsideroheshin si të "nevojshme". Vetëm kriteri "të përshtatshme" figuronte në këtë drejtim. Megjithëse autorizimi i nënshtrohej konfirmimit brenda 48 orëve nga ana e Sekretarit të Shtetit, nuk ishte e mundur të ndryshohej zona gjeografike e mbuluar. Gjithashtu, edhe pse Sekretari i Shtetit mund ta refuzonte konfirmimin ose ta kufizonte në kohë, dukej se në praktikë kjo nuk kishte ndodhur.

6. Një garanci shtesë ofrohej nga Kontrollori i Pavarur i emëruar sipas Ligjit të vitit 2000. Por kompetencat e tij ishin të kufizuara në raportimin mbi funksionimin e përgjithshëm të dispozitave ligjore dhe ai nuk kishte të drejtë të anulonte ose ndryshonte autorizimet, edhe pse ai ishte shprehur vazhdimisht se priste që neni 44 të përdorej më pak. Diskrecioni i gjerë që i njihej secilit polic ishte edhe më shqetësues, pasi vendimi i një polici për të ndaluar dhe për të kontrolluar një

individ bazohej ekskluzivisht në një "instikt" ose "intuitë profesionale". Provat statistikore tregonin se shkalla në të cilën policët vinin në zbatim kompetencat e tyre për të ndaluar dhe të kontrolluar persona në bazë të nenit 44 ishte tronditëse, dhe tregonin se ekzistonte një rrezik i qartë arbitrariteti në dhënien e një diskrecioni kaq të gjerë policëve individualisht.

7. Megjithëse kjo çështje nuk ka të bëjë me kërkues me origjinë etnike afrikane ose aziatike, rreziku i përdorimit diskriminues të kompetencave të tilla nga policia kundër personave të tillë ishte një mundësi reale dhe statistikisht treguan se persona me origjinë të tillë ishin prekur në mënyrë disproporcionale nga ushtrimi i një diskrecioni të tillë. Përveç kësaj, Gjykata pranoi se ekziston rreziku që një kompetencë e përkufizuar kaq gjerë mund të keqpërdoret kundër demonstruesve dhe protestuesve në shkelje të neneve 10 dhe 11. Edhe pse kompetenca e shefit të policisë dhe e Sekretarit të Shtetit për të autorizuar dhe konfirmuar ish-in objekt i shqyrtimit gjyqësor, akordimi i një diskrecioni të gjerë do të thoshte se çdo kërkues përballëshin me pengesa të jashtëzakonshme për të provuar se një autorizim dhe konfirmim ishin ultra vires ose abuzim kompetencash.

8. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kompetencat e autorizimit dhe të konfirmimit, si dhe ato për të ndaluar dhe të kontrolluar persona në bazë të neneve 44 dhe 45 të Ligjit të vitit 2000 nuk ishin as mjaft të qarta dhe të përkufizuar dhe as nuk i nënshtroheshin një mbrojtjeje adekuate ligjore kundër abuzimit. Ata nuk ishin pra në përputhje me ligjin, dhe kjo përbënte një shkelje të nenit 8.

#### ***B. Në lidhje me nenet 5, 10 dhe 11***

9. Duke pasur parasysh konstatimin e mësipërm, Gjykata u shpreh se nuk ishte e nevojshme që të shqyrtonte pretendimet e kërkuesve edhe nën këndvështrimin e neneve 5, 10 dhe 11.

#### ***C. Në lidhje me nenin 41***

10. Gjykata u shpreh se konstatimi i shkeljes përbën një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me çdo dëm jopasuror të pësuar nga kërkuesit. Ajo iu akordoi atyre 33 850 euro për kostot dhe shpenzimet.

### **III. Koment**

11. Ky vendim analizon karakteristikat e Ligjit Britanik kundër Terrorizmit të vitit 2000 nën këndvështrimin e nenit 8 të Konventës. Por duhet theksuar që ai është i një rëndësie kardinale jo vetëm për këtë nen por mbi të gjitha për nocionin e ligjit dhe të ligjshmërisë që përshkon të gjithë strukturën juridike të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

12. Gjykata konstatoi se autorizimi dhe konfirmimi që njihte një kompetencë

diskrecionare për të ndalimuar dhe kontrolluar personat kërkimet kanë shkelur të drejtat e kërkuesve "sipas nenit 8, pasi ndërhyrja nuk ishte në përputhje me ligjin". Është thënë në mënyrë të përsëritur që neni 8 i Konventës, i cili garanton një të drejtë të cilësuar, është strukturuar në atë mënyrë që, në paragrafin e parë të tij parashikon të drejtën dhe në paragrafin e dytë kriteret se kur mund të justifikohet një ndërhyrje ndaj të drejtës të parashikuar nga paragrafi i parë. Testi që duhet plotësuar në rast se ka pasur ndërhyrje ndaj së drejtës fillon me kriterin e parë, atë të ligjshmërisë. Pra që çdo ndërhyrje duhet të jetë e parashikuar me ligj. Gjykata ka pasur mundësi ta theksojë shumë herë, ligji i brendshëm që parashikon ndërhyrjen në fjalë duhet të tregojë me qartësi të mjaftueshme qëllimin e çdo pushteti diskrecionar që i jepet ekzekutivit dhe mënyrën e ushtrimit të tij. Pra ligji duhet të jetë i qartë dhe të shmangë çdo abuzim të mundshëm. Për këtë qëllim duhen parashikuar garanci të përshtatshme. Në këtë rast, masat mbrojtëse që ishin parashikuar nuk ishin të mjaftueshme, sipas Gjykatës.

13. Është me interes të theksohet analiza që Gjykata i bën legjislacionit britanik në këtë rast. Duke pasur parasysh se Gjykata normalisht nuk bën kontroll ose përjasje legjislacionesh me KEDNJ ajo gjithmonë tregohet tepër e kujdesshme kur shprehet mbi kriterin e ligjshmërisë. Gjithsesi ajo nuk ngurron të kujtojë se ligji i brendshëm që parashikon ndërhyrjen duhet që të respektojë parimet e Konventës, të jetë i aksesueshëm i qartë dhe i detajuar, si dhe të paraqesë garanci të mjaftueshme kundër abuzimeve. Në paragrafin 80 i cili mund të konsiderohet edhe paragrafi kyç i vendimit. Në vlerësimin e kompetencës diskrecionare për ndalim dhe kontroll Gjykata konstaton se neni 44 § 4 i ligjit britanik i jepte të drejtën çdo polici që të ndalonte dhe kontrollonte një person kurdo që ai "e konsideron të përshtatshme për parandalimin e akteve të terrorizmit". Megjithatë, 'i përshtatshëm' nuk është më shumë se 'e dobishme' ose 'që ndihmon'" vlerëson Gjykata. Ky kriter legjislativ nuk pajtohet me testin e nevojës së ndërhyrjes në një shoqëri demokratike, dhe prandaj legjislacioni nuk është i pajtueshëm me nenin 8 § 2 të Konventës.

14. Gjykata shpesh ka theksuar se nuk i nënvlerëson luftën dhe vështirësitë për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në një shoqëri moderne, dhe sfidat me të cilat autoritetet shtetërore përballen kur kanë të bëjnë me aktet e terrorizmit dhe krimin të organizuar. Megjithatë në këtë proces Shtetet palë në Konventë nuk mund të nxjerrin ligje dhe praktika të cilat shkelin të drejtat themelore të njeriut. Ky vendim u dha me një votim unanim nga shtatë gjyqtarët e Dhomës që kanë gjetur shkelje të nenit 8. Qeveria Britanike reagoi menjëherë duke deklaruar në media se kishte për qëllim që t'i kërkonte Gjykatës që vendimi të rishikohej në Dhomë të Madhe kërkesë që iu hodh poshtë më 10.6.2010. Gjithsesi, edhe Ministria e Brendshme kishte deklaruar se do ta analizonte këtë legjislacion<sup>260</sup> edhe Komisioni mbi të Drejtat e Njeriut në Parlamentin Britanik kishte theksuar se rishikimi i neneve 44-47 të Ligjit mbi Terrorizmit të vitit 2000 ishte i nevojshëm

260 Shih: <http://news.bbc.co.uk/1/hi/uk/10471005.stm>

për t'i bërë ato të pajtueshme me KEDNJ<sup>261</sup>. Shtetet e tjera anëtarë të Këshillit të Evropës mund të duhet gjithashtu të rishohin legjislacionin e tyre kundër terrorizmit nën prizmin e këtij vendimi, nëse nuk e kanë bërë ndërkaq.

15. Interesant është të mbyllet ky koment me kujtesën se Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 5 në këtë rast. Ajo nuk e pa të nevojshme për shkak se gjeti shkelje të nenit 8, por me peshë duket të ketë qenë edhe fakti që ndalimet ishin të kufizuara në kohë, rreth 30 minuta, dhe ajo e pa me vend të fokusohet në qëllimin e ndalimeve që ishte kontrolli personal, gjë që përfshihet në nenin 8.

## GRORI kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 25336/04)

7 korrik 2009

*kjo çështje ka të bëjë me kushtet e trajtimit në burg të personave në situata specifike si dhe me bazën ligjore për paraburgimin gjatë një periudhe kohe të caktuar*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Arben Grori, është shtetas shqiptar i cili ka lindur në 1971. Në kohën e dhënies së vendimit ai mbahej në një burg të sigurisë së lartë në Shqipëri dhe vuante një dënim prej 15 vjet burg për trafik ndërkombëtar droge dhe një dënim me burgim të përjetshëm për vrasje me paramendim dhe posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit, vepra penale të kryera në territorin italian.

2. Më 2 shkurt 2001, Gjykata e Apelit e Milanos e dënoi kërkuesin në mungesë me burgim të përjetshëm për vrasje dhe me pesë vjet për posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit. Megjithatë, ata nuk mund të kërkonin zbatimin e dënimit në Shqipëri, pasi në atë kohë asnjëri prej dy vendeve nuk ishte palë e ndonjë marrëveshje ndërkombëtare përkatëse.

3. z. Grori u ndalua në Shqipëri, më 30 prill 2001 mbi bazën e një urdhër-arresti të lëshuar në Itali më 16 shkurt 2001, për një akuzë tjetër, në lidhje me përfshirjen e tij të dyshuar në trafikun e drogës. Në të njëjtën ditë, Interpol Roma i kërkoi autoriteteve shqiptare të fillonin procedurën penale kundër kërkuesit për veprat penale të kryera në territorin italian. Në korrik 2002 Prokuroria shqiptare e akuzoi z. Grori me veprën penale të trafikut ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe në 29 dhjetor 2003 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e shpalli atë fajtor, fajësi që mbeti në fuqi dhe në qershor 2006, Gjykata e Lartë e dënoi me 15 vjet burg.

261 Shih "Twelfth Report of 2009-10, Legislative Scrutiny: Crime and Security Bill; Personal Care at Home Bill; Children, Schools and Families Bill, HL 67/HC 402, paras 1.91 - 1.97."



4. Gjatë paraburgimit, në pritje të procedurës penale në Shqipëri për trafikimin e drogës në Itali, më 15 maj 2002 ndaj z. Grori u dha një vendim nga gjykatat shqiptare që urdhëronte arrestimin e tij në pritje të procedurës për vlefshmërinë e dënimit të dhënë në Itali për vrasje dhe posedim të paligjshëm të armëve të zjarrit.

5. z. Grori u ankua para gjykatave shqiptare se nuk kishte kërkesë për vlefshmërinë e dënimit në mungesë të dhënë në Itali bërë nga autoritetet italiane ndaj Ministrit shqiptar të Drejtësisë. Ai gjithashtu pohoi se nuk kishte pasur asnjë marrëveshje ndërkombëtare në fuqi midis dy vendeve në atë kohë për vlefshmërinë e një dënimi të tillë. Ai u mbështet edhe në faktin se ai nuk kishte dhënë pëlqimin e tij për vlefshmërinë siç kërkohet dhe nga Kodi i Procedurës Penale. Gjykatat shqiptare vendosën kundër tij, duke konkluduar se sipas rregullave e së drejtës penale ndërkombëtare, bashkëpunimi midis vendeve mund të ndodhë edhe në mungesë të traktateve dypalëshe, në bazë të vullnetit të mirë, rregullave të njohura përgjithësisht dhe parimit të reciprocitetit.

6. Më 23 prill 2002, Qeveria italiane dhe ajo shqiptare nënshkruan një marrëveshje për transferimin e personave të dënuar, e cila u ratifikua nga parlamentet e tyre përkatësisht në vitin 2003 dhe 2004.

7. Gjatë periudhës shtator 2003 dhe shkurt 2004, z. Grori kërkoi një ekzaminim mjekësor të përshtatshëm për shkak të përkeqësimit të shëndetit të tij. Në gusht 2004 ai u diagnostikua me sklerozë të shumëfishtë, mjekët raportuan se sëmundja e tij mund shkaktonte gjendje shoku, dëmtim organesh, paaftësi të përhershme ose vdekje. Në 2005, ai nisi disa procedura penale kundër prokurorisë dhe Drejtorit të Spitalit të Burgut Tiranë duke u ankuar për neglizhencën në sigurimin e kujdesit mjekësor të tij, duke qenë se ai kishte qenë i vonuar dhe se ishte trajtuar kryesisht me mjekime për trajtimin e reumatizms.

8. Më 10 janar 2008, me kërkesën e tij, Gjykata Evropiane e urdhëroi Qeverinë shqiptare me një masë të përkohshme në bazë të nenit 39 të Rregullores së Gjykatës që kërkuesi të transferohej menjëherë në një spital civil për ekzaminimin dhe trajtimin e duhur mjekësor. Më 28 janar 2008, Qeveria e transferoi atë në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës, ku ai kaloi një ekzaminim të specializuar mjekësor. Që nga 17 qershori 2008, z. Grori ka marrë rregullisht trajtimin e duhur mjekësor për sëmundjen e tij.

## II. Vendimi i Gjykatës

9. z. Grori u ankua se ka marrë trajtim mjekësor të papërshtatshëm dhe se burgimi i tij ka qenë i paligjshëm për shkak të pavlefshmërisë dhe zbatimit në Shqipëri të dënimit me burgim të përjetshëm të vendosura nga gjykatat italiane në mungesë të tij. Ai u mbështet në nenet 3, 5 § 1, 6 § 1 dhe 7 të Konventës dhe të nenit 2 të Protokollit 7. Ai u ankua gjithashtu se transferimi i tij në një spital

civil në janar 2008, siç u kërkua nga Gjykata në bazë të nenit 39 të Rregullores së Gjykatës së, ishte shtyrë, në shkelje të nenit 34.

#### *A. Në lidhje me nenin 3*

10. Gjykata vuri në dukje me shqetësim se nga prilli 2005 deri në 28 janar 2008 z. Grori ishte lënë për periudha të gjata kohore pa trajtim mjekësor të përshtatshëm, pavarësisht se vuante nga një sëmundje e rëndë. Në mënyrë të veçantë, në raportin e fundit të mjekësor mbi gjendjen e tij shëndetësore ishte konfirmuar se avancimi i sëmundjes në vite kishte ndodhur për shkak të mungesës së kujdesit mjekësor. Qeveria nuk dha ndonjë justifikim se pse ajo kishte refuzuar trajtimin mjekësor të dhënë nga mjekët civile, duke pasur parasysh se kjo ishte falas për personat në spitalet publike në atë kohë. Qeveria nuk arriti të shpjegojë se si trajtimi me vitamina dhe me qetësues mund të konsiderohej i përshtatshëm në këto rrethana dhe pse shëndeti i kërkuesit ishte përkeqësuar në burg. Gjykata arriti në përfundimin se trajtimi i përshkruar më lart kishte krijuar një ndjenjë të tillë të fortë pasigurie të z. Grori që, e kombinuar me vuajtjet e tij fizike, kishte arritur në trajtim degradues, në shkelje të nenit 3.

#### *B. Në lidhje me nenin 5 § 1*

11. Gjykata theksoi se periudha për tu marrë në shqyrtim për qëllimet e paraburgimit është ajo mes 15 majit 2002 dhe dhjetorit 2003. Ajo vuri në dukje se Gjykata e Lartë shqiptare ishte përpjekur të gjente një bazë ligjore për të justifikuar paraburgimin e kërkuesit, dhe kishte bërë një "importim" në dispozitat e legjislacionit vendas të instrumenteve të drejtës ndërkombëtare që nuk kishin hyrë ende në fuqi në Shqipëri. Pra, sipas Gjykatës baza ligjore e gjetur nga Gjykata e Lartë zor se mund të thuhet se plotëson kërkesat për "ligjshmërinë" përse i përket paraburgimit të kërkuesit dhe konvertimit të dënimit të tij të vendosur nga gjykatat italiane. Gjykata arriti në përfundimin, pra, që, nga 15 maji 2002 deri më 29 dhjetor 2003, z. Grori nuk ishte ndaluar në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj, në shkelje të nenit 5 § 1.

#### *C. Në lidhje me nenin 34*

12. Gjykata vuri në dukje se pavarësisht se autoritete shqiptare ishin njoftuar në mëngjesin e 11 janarit 2008 për transferimin e kërkuesit në një spital, Qeveria e kishte bërë transferimin e tij vetëm më 28 janar 2008. Urdhri i Gjykatës Evropiane nuk ishte zbatuar për 17 ditë dhe nuk duket të kishte pasur ndonjë pengesë objektive të autoriteteve shqiptare për ta bërë këtë. Kishte pra një shkelje të nenit 34.

#### *D. Në lidhje me pretendimet e tjera*

13. Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme t'i shqyrtonte veçmas edhe në bazë të nenit 6 § 1 pretendimet e kërkuesit në lidhje me paligjshmërinë e procedurës për vlefshmërinë dhe zbatimin në Shqipëri të dënimit të dhënë në Itali. Gjykata gjithashtu hodhi poshtë ankesat e tjera të kërkuesit.

### E. Në lidhje me nenin 41

14. Gjykata i akordoi kërkuesit 8 000 euro për dëmin moral dhe 7 000 euro për shpenzimet dhe pagesat.

### III. Koment

15. Rasti Grori, megjithëse përmban edhe shkelje të nenit 3<sup>262</sup> dhe 34 të Konventës, interesin kryesor e ofron në lidhje me nenin 5 të Konventës. Kriminaliteti është bërë gjithnjë e më shumë ndërkombëtar në natyrë, dhe kështu sistemet e drejtësisë penale duhet të përshtaten në përputhje me rrethanat. Ky rast kundër Shqipërisë që përfshin dënimin e një individi si në Shqipëri dhe në Itali nënvizon rëndësinë e kriterëve të ligjshmërisë të parashikuara në nenin 5 § 1 të KEDNJ. Ky nen kërkon që paraburgimi të ketë një bazë në ligjin e brendshëm dhe të jetë në përputhje me të, dhe që e drejta e brendshme të mos shkelë Konventën, pra nuk duhet të jetë arbitrare.

16. Siç është deklaruar shumë herë nga Gjykata, kur një individ privohet nga liria duhet të respektohet parimi i përgjithshëm i sigurisë juridike. Gjykata thekson se është shumë e rëndësishme që të përcaktohen qartë kushtet e mohimit të lirisë në të drejtën e brendshme dhe që ligji vetë të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të plotësojë standardin e “ligjshmërisë” së parashikuar nga Konventa, një standard që kërkon që i gjithë legjislacioni të jetë mjaftueshmërisht i saktë që t’i lejojë personit, - nëse nevojitet, me këshillim përkatës – të parashikojë, deri në një nivel që është i arsyeshëm për rrethanat, pasojat që mund të japë një veprim i caktuar<sup>263</sup>. Me interes është të analizohet mënyra se si Gjykata specifikon periudhën që duhet marrë në shqyrtim për qëllimet e vlerësimit të paraburgimit. Megjithëse kërkuesi ishte ndaluar nga autoritetet shqiptare që në 30.04.2001 mbi bazën e një urdhër-arresti të lëshuar në Itali, për qëllimet e nenit 5 § 1, Gjykata theksoi se periudha për t’u marrë në shqyrtim ishte ajo mes 15.05.2002 dhe 29.12.2003. Megjithëse për mendimin tim Gjykata mund të kishte vlerësuar edhe periudhën përpara datës kritike 15.5.2002 në kuadrin e justifikueshmërisë së kohëzgjatjes së paraburgimit në bazë të urdhër-arrestit italian, ajo fokusohet në atë që është problemi kryesor në kuadrin e nenit 5 § 1, vendimi i gjyqtarit të gjykatës së Tiranës së 15.5.2002 për ndalimin e kërkuesit në pritje të proceseve për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos të datës 2 shkurt 2001. Përfundimi mund të mos ndryshonte asgjë në situatën e kërkuesit i cili ishte ndërkaq në paraburgim për një akuzë tjetër. Por kjo nuk e pengoi Gjykatën që të fokusohet tek thelbi i çështjes.

17. Konkretisht vendimi shqyrtonte situatën kur veprimet e autoriteteve nuk kanë bazë në të drejtën e brendshme dhe as në të drejtën ndërkombëtare, por përpiqen

262 Në lidhje me shkelje të ngjashme të nenit 3 shih vendimin *Dybeku k. Shqipërisë*, si dhe *Gülay Çetin k. Turqisë*, nr. 44084/10, 5.03.2013. Në lidhje me shkelje të nenit 34 shih vendimin *Rrapo k. Shqipërisë*, përfshirë në këtë botim.

263 Gjykata i referohet vendimit *Baranowski k. Polonisë*, nr. 28358/95, ECHR 2000-III.

ta përdorin këtë të fundit, në mënyrë jo-korrekte, për të justifikuar qëndrimet e tyre. Pavarësisht se Gjykata e rrethit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë kishin vendosur drejt se pëlqimi i kërkuarit ishte kusht për njohjen e vendimit gjyqësor italian në Shqipëri sipas nenit 514, e) të Kodit shqiptar të Procedurës Penale<sup>264</sup>, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe Gjykata Kushtetuese përdorën dy traktate ndërkombëtare dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare për të justifikuar paraburgimin e kërkuarit në bazë të vendimit gjyqësor italian pa marrë parasysh miratimin e tij.

18. Thënë pak, dy vendimet e fundit janë të paktën të çuditshme dhe subjektive. Së pari ato i referohen dy traktateve ndërkombëtare, përkatësisht Konventës Evropiane për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale dhe Konventës për Transferimin e Personave të Dënuar dhe Protokollit Shtesë të tij. Ndërsa Konventa e fundit nuk është e zbatueshme në rrethanat e rastit në fjalë pasi kërkuari ndodhej në Shqipëri, Konventa për Njohjen e Vendimeve Penale nuk ishte ende në fuqi. Pavarësisht nga kjo Gjykata e Lartë dhe ajo Kushtetuese i përdorin këto Konventa në arsyetimin e tyre jo për të interpretuar një dispozitë ligjore shqiptare por për ta shmangur atë dhe kriterin ligjor të qartë dhe të saktë që ajo përmban<sup>265</sup>. Së dyti, ato përdorin normat dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, por e bëjnë këtë pa përcaktuar cilat janë këto parime dhe i interpretojnë në mënyrë krejt subjektive dhe të paqartë. Së treti ato i japin fuqi prapavepruese shfuqizimit të paragrafit e) të nenit 514 KPP nga Parlamenti shqiptar më 13.06.2002<sup>266</sup>.

19. Në këto kushte Gjykata Evropiane konstatoi në mënyrë të qartë se "baza ligjore" e gjetur nga ana e Gjykatave të Lartë dhe Kushtetuese nuk i plotësonte kriteret e "ligjshmërisë". Gjykata, duke iu referuar një jurisprudence të saj të mirënjohur<sup>267</sup> thekson se *"vetëm një interpretim i ngushtë i këtyre përjashtimeve është në përputhje me qëllimin e kësaj dispozite, përkatësisht për t'u siguruar se askujt nuk i mohohet në mënyrë arbitrare liria e tij ose e saj."* Leximi i vendimeve dhe qëndrimeve të autoriteteve shqiptare nxjerr në pah që jo vetëm nuk është bërë një interpretim i ngushtë i përjashtimit, por është bërë një interpretim përjashtues i

264 neni 514 i Kodit të Procedurës Penale, para se të ndryshohej me ligjin nr. 8813 të datës 13 qershor 2002, parashikonte se: "vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet kur: a) vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë; b) vendimi përmban dispozita në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar; c) vendimi nuk është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ose i pandehuri nuk është thirrur të paraqitet në gjykim ose nuk i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës; ç) ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit çështje lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike; d) fakti për të cilin është dhënë vendimi nuk parashikohet si veprë penale nga ligji shqiptar; dh) për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formës së prerë ose zhvillohet një procedim penal ose e) personi i dënuar ose përfaqësuesi i tij nuk e kanë dhënë pëlqimin e tyre."

265 Pikërisht paragrafin e të nenit 514 të KPP, të lartpërmendur.

266 Bërë me ligjin nr. 8813, dt. 13.06.2002, i cili hyri në fuqi më 11.07.2002.

267 Shih *Engel dhe të tjerët k. Holandës*, 8.06.1976, Seria A nr. 22, f. 25, § 58, i përfshirë në këtë botim, dhe *Amuur k. Francës*, 25.06.1996, Reportet 1996-III, f. 848, § 42.

dispozitës procedurale penale<sup>268</sup>. Ky është një rast kur dhënia e drejtësisë sipas juridiksioneve shqiptare mund të bëhet edhe duke përjashtuar një kriter të qartë ligjor të brendshëm<sup>269</sup>, madje edhe duke e bërë të panevojshëm përfundimin sipas së drejtës ndërkombëtare të traktateve ndërkombëtare, të cilat janë hartuar pikërisht për të plotësuar boshllëkun që nuk mund ta mbyshin, të paktën për momentin, parimet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare.

## LAWLESS kundër IRLANDËS

(kërkesa nr. 332/57)

1 korrik 1961

*kjo çështje kishte të bënte me justifikimin e ndalimit të personave në përjashtim nga procedura normale për shkak të situatës së jashtëzakonshme*

### I. Faktet kryesore

1. z. Gerard Richard Lawless, i lindur në 1936, punonte në një ndërmarrje

268 Kurioz është interpretimi i Kolegjeve të Bashkuara të cilat haptazi shmangin jo vetëm interpretimin e ngushtë por edhe atë literal të nenit 514, e) KPP duke thënë: "Në rast të njohjes dhe të zbatimit të një vendimi penal të huaj, referenca dhe zgjidhja e çështjes në përputhje me pikën (e) të nenit 514 të KPP-së, në kohën materiale, nuk ka kuptim. Nëse gjykata e konsideron pëlqimin e personit të dënuar si thelbësor, ky pëlqim do të çonte në interpretimin ad literam të dispozitës, ashtu siç është zbatuar nga gjykata e rrethit dhe gjykata e apelit. Por, interpretimi i një dispozite ligjore është shumë kompleks. Në rast se një interpretim ad literam çon në absurditet [situatë pa kuptim], mbizotëron interpretimi logjik dhe sistematik. Sipas këtij interpretimi, dispozita në fjalë do të interpretohet në mënyrë të arsyeshme. Kjo do të thotë se nocioni "i pëlqimi të personit të dënuar", nuk mund të interpretohet gjerësisht. Ai duhet të interpretohet ngushtë në mënyrë që të mos çojë në absurditet, siç do të ishte rasti ku ankuesi duhet të japë pëlqimin për të vuajtur dënimin penal në vendin e tij. Siç rrjedh nga aktet, ankuesi është gjykuar in absentia pasi i fshihej drejtësisë italiane." Gjykata Kushtetuese vazhdon: "Gjykata Kushtetuese është e mendimit se argumentet e ngritura në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [i 30 janarit 2003] nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën ose konventat [ndërkombëtare]. Njohja [vlefshmëria] e ndërsjellë e vendimeve të gjykatës shërben për të forcuar bashkëpunimin juridik ndërmjet shteteve dhe për të arritur objektiva të caktuara në lidhje me lirinë, sigurinë dhe drejtësinë. Parimi i reciprocitetit presupozon përdorimin e instrumenteve të ndërsjella dhe ligjore në marrëdhëniet ndërshtetërore. Në të drejtën ndërkombëtare, reciprociteti përkufizohet si e drejta e barazisë dhe e respektit të ndërsjellë ndërmjet shteteve. Doktrina dhe jurisprudenca ndërkombëtare penale kanë konfirmuar se bashkëpunimi ndërmjet vendeve mund të ndodhë dhe në mungesë të traktateve dypalëshe, mbi bazën e parimi të reciprocitetit. Si rregull, parimi i reciprocitetit zbatohet në instrumente ndërkombëtare, si në traktate dhe në marrëveshje, që parashikojnë të drejta dhe detyrime të ndërsjella. Por, në raste përjashtimore, në mungesë të marrëveshjeve të ndërsjella, shtetet nuk janë të përjashtuara nga zbatimi i drejtpërdrejtë i parimit të reciprocitetit, nga normat përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare dhe nga vullneti i mirë. Zbatimi i tyre është në interes të forcimit të bashkëpunimit të shteteve për të luftuar krimin e organizuar dhe kriminalitetin. Gjykata Kushtetuese thekson se vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara, në lidhje me nenet 512 dhe 514 nuk është jokushtetues. Ajo [Gjykata e Lartë] me të drejtë arriti në përfundimin se nuk kishte konflikt ndërmjet këtyre dispozitave dhe ndërmjet dispozitave të konventave ndërkombëtare. Dispozitat e brendshme zbatohen në përputhje me interpretimin e bërë nga Kolegjet e Bashkuara [të Gjykatës së Lartë]. (...) Mund të kuptohet (...) se kërkesa për njohje të një vendimi të një gjykate të huaj mund të bëhet dhe në mungesë të një marrëveshjeje mbi bazën e vullnetit të mirë, normat e njohura gjerësisht dhe parimit të reciprocitetit."

269 Sipas pretendimeve të Prokurorit të Përgjithshëm përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë "... paçarësisht nga fakti se pëlqimi i personit të dënuar kërkohet nga neni 514 (e) i KPP-së për njohjen në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga një organ i huaj, kjo duhet të interpretohet vetëm në rrethanat që lidhen me transferimin e personave të dënuar dhe jo në një mënyrë të tillë që të pengojë dhënien e drejtësisë. Për më tepër, Parlamenti, nëpërmjet ligjit nr. 8813 të 13 qershorit 2002, e shfuqizoi pikën (e) të nenit 514 të KPP-së ..."



ndërtimi dhe banonte në Dublin. Më 21 shtator 1956, ai ndalohet, së bashku me tre burra, në një hangar të braktisur ku policia gjen armë. Gjykata Penale e qarkut të Dublinit dha vendimin për lirim të katër të akuzuarve më 23 nëntor 1956. I dyshuar për veprimtari të paligjshme, z. Lawless ndalohet përsëri më 14 maj 1957. Gjatë një kontrolli në shtëpinë e tij, u gjet një dokument dorëshkrimor mbi guerilen. Më 16 maj, Gjykata Penale e qarkut të Dublinit e dënoi me një muaj heqje lirie për këtë fakt, por jo për anëtarësimin në IRA.

2. Më 5 korrik 1957, në Gazetën Zyrtare, Qeveria Irlandeze shpall hyrjen në fuqi, që nga 8 korriku, të kompetencave për arrestim dhe paraburgim që u janë dhënë ministrave të shtetit në bazë të ligjit nr 2, të vitit 1940, i cili ndryshonte ligjin e vitit 1939 mbi shkeljet e sigurisë shtetërore. Në zbatim të këtij ligji, Ministri i Drejtësisë, më 12 korrik 1956, nxjerr një vendim për paraburgimin e z. Lawless, i cili ishte ndaluar një ditë më parë, kur ai po përpiquej të shkonte në Angli. Kërkuesi internohet në një kamp ushtarak, në shoqërinë e pothuaj njëqind personave të tjerë, pa u paraqitur përpara një gjyqtari. Më 10 dhjetor 1956, ai paraqitet përpara Komisionit të paraburgimit: ai zotohet gojarisht se nuk do të merret me asnjë veprimtari të paligjshme sipas kuptimit të legjislacionit të vitit 1939 dhe 1940. Të nesërmen, Ministri i Drejtësisë urdhëroi lirim të tij.

3. Ndërkohë, më 11 tetor 1957, Gjykata e Lartë kishte dhënë një vendim që hidhte poshtë një ankim për shkelje të *Habeas Corpus* të bërë nga i interesuari, i cili apeloj kundër këtij vendimi përpara Gjykatës Supreme, por pa sukses.

4. z. Lawless iu drejtua Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut më 8 nëntor 1957. Ai pretendonte se Konventa ishte shkelur për shkak të paraburgimit të tij pa një vendim gjyqësor, që nga 13 gushti i vitit 1957. Në raportin e tij të 19 dhjetorit 1959, Komisioni çmoi se neni 7 nuk gjente zbatim dhe arrin në një përfundim në lidhje me nenin 15. Sipas tij, përderisa një rrezik publik kërcënonte ekzistencën e shtetit masat e arrestimit dhe të paraburgimit të marra nga Qeveria Irlandeze justifikoheshin nga situata<sup>270</sup>.

## II. Vendimi i Gjykatës

*Për sa i përket themelit të vendimit, Gjykata ishte thirrur për të shqyrtuar pesë çështje*

### A. Në lidhje me nenin 17

5. Çështja e parë: A mundej që qeveria Irlandeze t'i kundërvihet z. Lawless në lidhje me nenin 17? Gjykata vlerësoi se kjo dispozitë ka një vlerë negative dhe nuk mund të privojë kërkuesin nga të drejtat themelore të garantuara nga nenet 5 dhe 6. Në fakt, z. Lawless nuk u mbështet në Konventë për të justifikuar ose kryer veprime në kundërshtim me të drejtat dhe liritë e garantuara prej saj.

270 Vendimi u arrit me një shumicë të ngushtë 8 me 6.



**B. Në lidhje me nenet 5 dhe 6**

6. Çështja e dytë: A ishte paraburgimi i z. Lawless pa paraqitje në Gjykatë, në kundërshtim me detyrimet e Irlandës në bazë të nenit 5 dhe 6 të Konventës? neni 6 nuk merrej parasysh, meqenëse kërkuesi nuk iu nënshtrua ndonjë akuze penale. Për sa i përket nenit 5, bëhej fjalë vetëm për §§ 1 (c) dhe 3. Për Gjykatën ata krijonin një tërësi dhe kanë një kuptim të qartë dhe natyral: ata imponojnë detyrimin e paraqitjes përpara një gjyqtari, me synimin për të shqyrtuar problemin e heqjes së lirisë ose të një vendimi lidhur me themelin e çështjes, të çdo personi të ndaluar që dyshohet se do të kryejë një vepër penale. Por, ky nuk ishte rasti i kërkuesit. Paraburgimi i tij nuk mund të justifikohet në arsyet e paraqitura në nenin 5 §§ 1 (c) dhe 3.

**C. Në lidhje me nenin 7**

7. Çështja e tretë: A ishte paraburgimi i z. Lawless në kundërshtim me detyrimet e Irlandës në bazë të nenit 7 të Konventës? Gjykata iu përgjigj negativisht kësaj çështje, sepse ky neni i cili ndalonte prapaveprimin e dënimit, ishte i pazbatueshëm në këtë çështje. Paraburgimi i kërkuesit përbënte një masë parandaluese dhe nuk mund të konsiderohej si rezultat i një dënimi penal.

**D. Në lidhje me nenin 15**

8. Çështja e katërt: A bazohej paraburgimi i z. Lawless mbi të drejtën e derogimit të shteteve palë të garantuar nga neni 15 § 1? Gjykata shprehet pozitivisht, pasi kishte verifikuar se tre kushtet e kërkuara nga ky tekst ishin plotësuar. Në radhë të parë, qeveria mund të deklaronte, legjitimisht, se një rrezik publik i kanosej kombit gjatë periudhës në fjalë: në territorin e Republikës së Irlandës ndodhej një ushtri sekrete që vepronte jashtë kuadrit kushtetues dhe përdorte dhunë për të arritur objektivat e saj; kjo ushtri vepronte edhe jashtë territorit të shtetit, duke vështirësuar kështu marrëdhëniet e këtij të fundit me vendet fqinjë; aktivitetet terroriste ishin rritur në mënyrë alarmuese që nga vjeshta e vitit 1956 dhe gjatë semestrit të parë të vitit 1957.

9. Së dyti, paraburgimi pa paraqitje përpara një gjyqtari dukej si një masë që zbatohet vetëm për shkak të vështirësive të kohës. Në fakt, zbatimi i legjislacionit të zakonshëm nuk kishte mundur të frenonte rritjen e rrezikut që i kanosej Republikës në vitin 1957. Funksionimi i gjykatave penale të zakonshme, i gjykatave penale speciale ose i gjykatave ushtarake nuk mjaftonte për të vendosur paqen dhe rendin publik; në veçanti, mbledhja e provave të mjaftueshme për të bindur personat e lidhur me IRA-n dhe grupet e saj disidente ndeshet me vështirësitë më të mëdha për arsye të karakterit ushtarak dhe sekret të tyre dhe të frikës që ata shkaktonin në popull. Për sa i përket mbylljes së kufirit me Irlandën e Veriut, ky veprim do të sillte për të gjithë popullatën, pasoja shumë të rënda që do të kishin tejkaluar kërkesat e rastit të urgjencës. Për këtë arsye paraburgimi administrativ i personave që dyshoheshin se donin të merrnin pjesë në veprimtari terroriste dukej i justifikueshëm. Për më tepër, Gjykata vërejtë se ligji nr 2 i vitit 1940 parashikonte një sërë garancish kundër

abuzimeve: Kontroll i vazhdueshëm i Parlamentit mbi zbatimin e ligjit; krijimi i një komisioni paraburgimi i përbërë nga një oficer dhe dy magistratë, të cilit mund t'i drejtohet çdo i paraburgosur; vendimi i këtij komisioni për lirimin e këtij të fundit ishte i detyrueshëm për qeverinë. Kjo e fundit i garanton lirimin personit të ndaluar, në qoftë se ai zotohet se do të respektojë ligjin. Së fundi, asnjë element nuk i lejonte Gjykatës që të vlerësonte se masat e marra nga qeveria duke deroguar nga Konventa binin ndesh me detyrimet e tjera që rridhnin nga e drejta ndërkombëtare.

10. Çështja e pestë: A përbënte një njoftim të mjaftueshëm, letra e dërguar më 20 korrik 1957 nga qeveria, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në bazë të nenit 15 § 3 të Konventës? Përsëri, Gjykata dha një përgjigje pohuese. Ajo çmoi se njoftimi ishte bërë pa vonesë dhe se asgjë nuk e pengonte shtetin të shpallte në territorin e tij vendimin e derogimit.

11. Si rrjedhim, në bazë të përgjigjeve të dhëna në lidhje me këto pesë çështje të shqyrtuara, Gjykata arriti në përfundimin se Konventa nuk ishte shkelur.

### III. Koment

12. Në këtë çështje, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut duhej të vendoste në lidhje me pretendimin e z. Lawless se Irlanda kishte shkelur nenet 5, 6, 7, dhe 15 §§ 1 dhe 3 të Konventës për shkak se e kishte mbajtur z. Lawless në gjendje paraburgimi pa vendim të një organi gjyqësor. Çështja që po komentojmë ka rëndësi për një sërë arsyesh. Ka pasur në fakt tre vendime në lidhje me këtë çështje. Më 14 nëntor 1960 Gjykata iu përgjigj tre pyetjeve të ngritura nga qeveria irlandeze dhe nga Komisioni në formën e pretendimeve paraprake kurse me vendimin e 7 prillit 1961 ajo iu dha përgjigje disa mosmarrëveshjeve procedurale. Këto dy vendime paraprake kishin rëndësi sidomos për rolin e Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut në kuadrin e mekanizmit të zbatimit të të drejtave të garantuara nga Konventa.

13. Vendimi ka vlerë edhe për një arsye tjetër – masat e jashtëzakonshme që merren nga shtetet në situata të veçanta dhe impakti i tyre në lidhje me të drejtat e njeriut. Ky fenomen që ka vlerë të jashtëzakonshme edhe për situatën aktuale të luftës ndaj terrorizmit. Nën këtë këndvështrim vlen të krahasohet ky vendim në kuadrin e neneve 5 dhe 6 të Konventës me vendimin *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* në kuadër të nenit 3 të Konventës duke pasur parasysh se ky nen i fundit është i paderogueshëm në bazë të nenit 15 të Konventës<sup>271</sup> siç mund të jenë nenet 5 dhe 6. Sidoqoftë edhe në lidhje me aspekte të këtyre neneve më 16 dhjetor 2004 Dhoma e Lordëve në Britani vendosi se ndalimi pa afat i personave që akuzohen për terrorizëm dhe sidomos kur këta janë të huaj bie ndesh me nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në këtë vendim Gjykata

271 Shih paragrafin 2 të nenit 15 të Konventës si dhe nenin 175 të Kushtetutës së R.SH.

gjithashtu pranoi se ndalimi me karakter parandalues nuk mund të justifikohet në parim në bazë të nenit 5 § 1 (c) në qoftë se nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm<sup>272</sup>.

14. Nga ana tjetër vendimi sqaron edhe një sërë aspektesh të tjera konceptuale dhe procedurale që kanë të bëjnë me nenin 15 të Konventës dhe që kanë vlerë *post factum* edhe për situatën të vitit 1997 në Shqipëri<sup>273</sup>. Vendimi sqaron konceptet e ‘emergjencës publike që kërcënon jetën e kombit’<sup>274</sup>, parimin e proporcionalitetit në kuadrin e nenit 15<sup>275</sup>, konceptin e detyrimeve të tjera në bazë të së drejtës ndërkombëtare<sup>276</sup>, si dhe aspektet procedurale të njoftimit për qëllimet e paragrafit 3 të nenit 15<sup>277</sup>.

## D.G. kundër IRLANDËS

(kërkesa nr. 39474/98)

16 maj 2002

*kjo çështje ka të bëjë me ndalimin e një të mituri për qëllimet e një edukimi nën mbikëqyrje*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, D.G. është shtetas irlandez i lindur më 9 korrik 1980. Në kohën e fakteve që po merren në shqyrtim ai ishte një i mitur me një të kaluar të mbarsur me vepra penale, i cili u konsiderua se kishte një çrregullim personaliteti dhe përbente një rrezik për vete dhe për të tjerët. Më 14 mars 1997 u vendos që ai duhet të vendosej në njësinë e terapisë intensive për moshat nga 16-18 vjeç.

2. Më 27 qershor 1997 Gjykata e Lartë vendosi që, përderisa nuk kishte mundësi të sigurta edukimi në Irlandë, D.G. duhet të dërgohej për tre javë në Institucionin St. Patrick (një burg në Irlandë) si “më i miri” ndërmjet të gjitha mundësive “të papërshtatshme” që ekzistonin. Ndërkohë u bënë përpjekje që të gjendej një vend i kënaqshëm për të.

3. Urdhri i lartpërmendur i Gjykatës së Lartë u ripërsërit më 18 korrik 1997 me të njëjtin argumentim. Një urdhër i tretë u dha më 23 korrik 1997 duke e zgjatur

272 Shih në vijim në këtë botim mbi konceptin e “dyshimit të arsyeshëm”, vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

273 Republika e Shqipërisë ka bërë derogim në bazë të nenit 15 të Konventës më 23 mars 1997 derogim që zgjati deri më 14 gusht 1997 dhe që pati edhe papajtueshmëri me frymën e Konventës sipas interpretimit të dhënë në kuadrin e Raportit të Përqasjes së Legjislacionit Shqiptar me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, fq. 64.

274 Paragrafët 23 deri 30 të vendimit.

275 Paragrafët 31 deri 38 të vendimit.

276 Paragrafët 39 deri 41 të vendimit.

277 Paragrafët 42 deri 47 të vendimit.

burgimin e D.G. me arsyetimin se kushtet e “rregullimit dhe kujdesit” për të po përgatiteshin dhe do të ishin gati më 28 korrik 1997. Meqenëse D.G. u largua nga këto kushte që iu ofruan, Gjykata e Lartë riurdhëroi burgimin e tij në St. Patrick në gusht 1997. Pas kësaj D.G. u vendos në një rregullim të përkohshëm dhe pas 16 shkurtit 1998 në rregullim për një kohë të shkurtër me mbikëqyrje 24 orësh.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesi ankohej se mbajtja e tij në St. Patrick, nga 27 qershori deri më 28 korrik 1997, përbënte shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës (e drejta për lirinë dhe sigurinë). Ai pretendonte gjithashtu se, në bazë të nenit 5 § 5, nuk i njihej e drejta subjektive për një kompensim.

5. Nga ana tjetër, në bazë të nenit 3 (ndalimi i trajtimeve apo dënimeve çnjerëzore dhe degraduese) ai ankohej se, megjithëse ishte një i mitur që kishte nevojë për kujdes të veçantë, ai ishte mbajtur në një institucion penal, gjë e cila, duke pasur parasysh statusin e tij unik si dikush i paakuzuar dhe i padënuar, bëri që të burgosurit e tjerë të besonin se ai ishte autor i veprave penale seksuale, duke e sharë, poshtëruar, kërcënuar dhe abuzuar me të dhe se ai prangosej me një oficer burgu sa herë që çohej përpara gjykatave. Ai bazohej gjithashtu në nenet 8 (e drejta për jetë private) dhe 14 (ndalimi i diskriminimit).

### A. Në lidhje me nenin 5 § 1

6. Gjykata shqyrtoi nëse mbajtja në burg e D.G. mund të konsiderohej si masë e përkohshme dhe paraprake për të arritur tek regjimi i një edukimi nën mbikëqyrje, në kuptimin e nenit 5 § 1.

7. Gjykata vuri në dukje se Gjykata e Lartë e zgjati afatin e mbajtjes në burg të kërkuesit me argumentimin se kushtet e “rregullimit dhe kujdesit” të përkohshëm po përgatiteshin dhe do të ishin gati më 28 korrik 1997. ngjarjet vijuese treguan se këto lehtësi nuk ishin të sigurta (kërkuesi u largua) dhe Gjykata e Lartë i konsideroi ato të papërshtatshme përderisa riurdhëroi burgimin e kërkuesit në St. Patrick në gusht 1997 vetëm 18 ditë pas lirim të tij. Në këto rrethana, Gjykata nuk është e mendimit se mbajtja e kërkuesit në qershor dhe korrik 1997 në St. Patrick mund të konsiderohet sikur ka qenë një masë përkohshme ndalimi që paraprante një regjim të edukimit nën mbikëqyrje. Dy urdhrat e parë të Gjykatës së Lartë nuk ishin bazuar në asnjë propozim specifik në lidhje me edukimin e tij të sigurt dhe nën mbikëqyrje dhe i treti ishte bazuar në një propozim për një rregullim të përkohshëm i cili, sidoqoftë, rezultoi që nuk ishte as i sigurt dhe as i përshtatshëm duke çuar në mënyrë të pashmangshme në një urdhër tjetër të Gjykatës së Lartë për ta mbajtur kërkuesin në St. Patrick. Edhe në qoftë se do të pranohej se mbajtja e tij nga shkurti 1998 ishte mjaft e sigurt dhe e përshtatshme nga pikëpamja edukative, kjo u realizua më se gjashtë muaj pas lirim të tij nga St. Patrick në korrik 1997.

8. Për pasojë, Gjykata arriti në përfundimin se mbajtja e kërkuesit në St. Patrick ndërmjet 27 qershorit dhe 28 korrikut 1997 përbënte shkelje të nenit 5 § 1.

### ***B. Në lidhje me nenin 5 § 5***

9. Gjykata konstatoi se mbajtja e D.G.-së në burg përbënte shkelje të nenit 5 § 1 dhe se urdhrat e ndalimit të tij ishin të ligjshëm sipas së drejtës së brendshme. Duke pasur parasysh edhe faktin se Irlanda në atë kohë nuk e kishte bërë Konventën pjesë të së drejtës së brendshme Gjykata arriti në përfundimin se nuk ishte parashikuar një e drejtë subjektive për kompensim, duke çuar kështu në shkelje të nenit 5 § 5.

### ***C. Në lidhje me nenin 3***

10. Gjykata pranoi se synimi i Gjykatës së Lartë, duke urdhëruar burgimin e kërkuesit, ishte që ta mbronte atë dhe se nuk mund të thuhet se kjo masë përbënte “dënim” në kuptimin e nenit 3.

11. Gjykata nuk pranoi as që provat e ofruara mbështesnin përfundimin se burgimi i D.G.-së (si i mitur, i paakuzuar dhe i padënuar për ndonjë krim) në një institucion penal do të mund të përbënte në vetvete një trajtim “çnjerëzor apo degradues”. Kërkues ishte mbajtur në një burg i cili ofronte aktivitete edukuese dhe rikrijuese, të cilat ishin të përshtatshme për nevojat e të ndaluarve të mitur dhe se në këtë burg kishte një numër të madh bashkëmoshatarësh ose thujse bashkëmoshatarësh të kërkuesit. Për më tepër, fakti që kërkuesi ishte subjekt i disiplinës së burgut, në vetvete, nuk nxirrte në pah ndonjë problem në bazë të nenit 3, duke pasur parasysh historikun kriminal të kërkuesit, rrezikun ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve.

12. Në lidhje me ndonjë trajtim të kërkuesit si i burgosur në institucionin penal të St. Patrick-ut dhe në përputhje me regjimin e tij disiplinor, Gjykata vuri re se nuk kishte asnjë provë psikologjike, mjekësore apo tjetër të ofruar nga ndonjë ekspert që të mbështeste impaktin mendor ose fizik të pretenduar nga ana e kërkuesit. Për më tepër, ai nuk kishte ofruar asnjë provë në lidhje me pretendimin se ai ishte keq-trajtuar nga të burgosurit e tjerë.

13. Për sa i përket prangosjes së tij, Gjykata nuk vlerësoi se ky akt i bërë në publik – pavarësisht se kërkuesi ishte i mitur – arrinte deri në një shkelje të nenit 3. nga Gjykata e Lartë ai ishte konsideruar, ashtu siç mund të konsiderohej edhe cilido i rritur, një rrezik për vetveten dhe për të tjerët.

14. Për këto arsye Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 3.

### ***D. Në lidhje me nenin 8***

15. Gjykata arriti në përfundimin se ankimi i kërkuesit në lidhje me ligjshmërinë e burgosjes së tij nuk ngrinte ndonjë çështje më vete në kuadrin e nenit 8 të Konventës.

**E. Në lidhje me nenin 14**

16. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, kishte pasur një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për çdo dallim në trajtimin e të miturve që kërkonin një sistemim dhe edukim dhe të të rriturve me të njëjtat kërkesa, dhe për këtë arsye nuk ka pasur shkelje të nenit 14.

**F. Në lidhje me nenin 41**

17. Gjykata i akordoi kërkuarit 5 000 euro për dëm jo-material dhe 16 138.96 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

**III. Koment**

18. Kjo çështje me rëndësi të madhe është e dyta në të cilën Gjykata jep një vendim në zbatim të nenit 5 § 1 (d).

19. Neni 5 § 1 (d) legalizon privimin e një të mituri nga liria e tij kur nuk ka asnjë akuzë apo dënim penal për ta justifikuar këtë në bazë të nenit 5 § 1 (a) ose (c). Ky vendim nxjerr në pah përgjegjësinë e shtetit ndaj të miturve sjellja jonormale e të cilëve është e tillë sa autoritetet vendase vlerësojnë se ata nuk mund të lihen të lirë por edhe nuk ka bazë, për momentin, për t'i akuzuar apo për t'i dënuar për ndonjë vepër penale. nuk ka ndonjë dispozitë të ngjashme për të justifikuar privimin e të rriturve nga liria të cilët mund të kenë shenja të ngjashme sjelljeje<sup>278</sup>.

20. Individët – të rritur apo të mitur – mund të privohen nga liria e tyre vetëm në qoftë se plotësohet një prej kushteve të parashikuara në nenin 5 § 1 nga (a) deri në (e). Natyrisht që në një i mitur i cili mbahet i ndaluar në kuadrin e një sjelljeje kriminale në bazë të dispozitave të nenit 5 § 1 (a) deri në (c) normalisht do të vihet nën një mbikëqyrje me karakter edukues por Konventa nuk e kërkon këtë mbikëqyrje shprehimisht me qëllim që një privim lirie të jetë i ligjshëm në kuptimin e nenit 5 § 1. Përderisa neni 5 § 1 (d) autorizon privimin e lirisë në rrethana kur ai nuk mund të justifikohet ndryshe, Gjykata është e kujdesshme për të siguruar që mbikëqyrja me karakter edukues e cila kërkohet nga ky paragraf të jetë ofruar. Gjykata deklaroi qartë që Irlanda ishte e detyruar që të ngrinte një sistem të përshtatshëm lehtësisht institucionale të citë mund të plotësonin kërkesat e sigurisë dhe të edukimit në një masë që të përputhej me nenin 5 § 1 (d). Pa pasur këto lehtësi në këmbë mund të thuhej se ndalimi ishte i paligjshëm.

21. Gjykata kishte deklaruar si të papranueshme një kërkesë<sup>279</sup> ku kërkuarja ishte ankuar se ndalimi i saj nuk mund të ishte i ligjshëm në bazë të nenit 5 § 1 (d) për shkak se, megjithëse e mitur, ajo e kishte kaluar moshën për të cilën parashikohej edukimi nën mbikëqyrje. Gjykata konstatoi se kjo nuk kishte rëndësi për atë sa mbikëqyrja e kërkuar me karakter edukues kishte filluar ndërkaq.

278 Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 22 shkurtit 1989 në lidhje me çështjen *Ciulla kundër Italisë*.

279 *Koniarska kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi në lidhje me pranueshmërinë e 12 tetorit 2001.



## DE WILDE, OOMS & VERSYP kundër BELGJIKËS

(kërkesat nr. 2832/66; 2835/66; 2899/66)

18 qershor 1971

*garancitë procedurale në rastin e heqjes së lirisë edhe ndaj dukurive të tilla si vagabondazhi duhet t'iu nënshtrohen garancive të qarta procedurale*

### I. Faktet kryesore

1. z. Jacques De Wilde, i lindur në Belgjikë më 1928, ka kaluar një pjesë të madhe të fëmijërisë së tij në jetimore. Ai përfitonte një pension të pjesshëm invaliditeti luftime dhe ushtron, qoftë edhe me raste, zanatin e bujkut. Më 18 prill 1966, De Wilde paraqitet në komisariatit e policisë së Charleroi ku deklaroi se është lodhur duke kërkuar më kot punë dhe tani nuk ka as strehë dhe as para. Policia ia kaloi çështjen zyrës së prokurorisë dhe kërkoi një dosje të dhënash e cila nxori në dritë se nga prilli 1951 deri në nëntor 1965, z. De Wilde ishte dënuar trembëdhjetë herë me heqje lirie ose me gjoba dhe ishte ndaluar pesë herë nga policia për vagabongazh. Të nesërmen, tribunali i policisë në Charleroi e dënoi me mbyllje në një institucion për lypësit për dy vjet. z. De Wilde rifitoi lirinë e tij më 16 nëntor 1966, në bazë të një vendimi të Ministrit të Drejtësisë. Ai u dënua me shtatë muaj burg, tre nga të cilët për vjedhje shtëpie.

2. z. Franz Ooms, i lindur më 1934, çohet përpara Komisarariatit të policisë së Namyrut me qëllim që, në qoftë se nuk gjendet ndonjë strukturë e shërbimit social që t'ia gjejë mundësi punësimi, strehimi dhe ushqimi në pritje të një pune të rregullt, të mbyllet si vagabond në institucionet përkatëse. Ooms kishte humbur punën e tij si montator skelash dhe e ëma nuk mund ta mbante më. Në të njëjtën ditë, tribunali i policisë së Namyrut e dënoi me qëndrim të detyruar në një azil. Dënimi i tij zgjat një vit dhe ai lirohet saktësisht një vit pas vendimit të dënimit të lartpërmendur.

3. z. Edgard Versyp ka lindur më 1911 dhe ushtronte, të paktën herë pas here, zanatin e disenjatorit. Më 3 nëntor 1965, ai paraqitet në policinë e Brukselit dhe, duke u deklaruar si pa strehë, pa punë dhe pa të ardhura, kërkoi me insistim dërgimin e tij në një azil. Të nesërmen, zyra e riaftësimit social e mori në ngarkim dhe verifikoi që asgjë nuk pengonte që ai t'ia dërgohet prokurorisë. Kjo për shkak se zyra e riaftësimit social e njëjtte mirë dhe se përpjekjet e saj të mëparshme për ta riaftësuar kishin dështuar për shkak të apatisë, përtacisë dhe prirjes së tij për pijet alkoolike. Disa orë më pas tribunali i policisë së Brukselit e dënoi me mbyllje në një institucion për lypësit për dy vjet. Më 10 gusht 1967, pra më tepër se një vit e nëntë muaj pas mbylljes së tij në institucion, z. Versyp rifitoi lirinë e tij

në sajë të një vendimi ministror. Disa ditë më parë, drejtori i institucionit kishte dhënë një mendim pozitiv ndaj një kërkesë për lirim të tij.

4. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të 27 nëntorit 1891 “Për ndalimin e vagabondazhit dhe lypjes”, vagabondazhi nuk konsiderohet në vetvete si një akt që përbën shkelje penale. Çdo individ i gjendur në një gjendje të tillë ndalohet dhe çohet përpara tribunalit të policisë, të përbërë nga një gjyqtar i vetëm, ai i shkallës së parë (paqes). Seanca u zhvillohet brenda 24 orëve por në qoftë se i interesuari kërkon kohë për të përgatitur mbrojtjen mund të procedohet me një shtyrje prej tre ditësh. Asnjëri nga të tre personat e lartpërmendur përkatësisht në paragrafët 1, 2 dhe 3 nuk e kishin shfrytëzuar këtë të drejtë. Nëse gjyqtari, pas verifikimeve të rastit, çmon se personi i çuar para tij është një vagabond, gjejnë zbatim nenet 13 dhe 16 të ligjit të vitit 1891. Neni 13 ka të bëjë me lypësit e rregullt dhe me individët të cilët për dembelizëm, dehje ose për shkak se bëjnë një jete të çrregullt, jetojnë në gjendje vagabondazhi. Gjyqtari i dënon me mbyllje në institucione lypësish – ashtu siç ishte rasti i z. De Wilde dhe i z. Versyp – minimumi 2 dhe maksimumi 7 vjet. Ky dënim regjistrohet në dosjen gjyqësore penale dhe përfshin gjithashtu edhe heqjen e disa të drejtave elektorale. Neni 16, që ishte zbatuar në rastin e z. Ooms, ka të bëjë me individët e gjetur në gjendje vagabondazhi ose lypjeje pa qenë në asnjë nga rrethanat shkakësore të përmendura në nenin 13. Mbyllja bëhet në azile për një kohëzgjatje deri në një vit.

5. Vendimet e dhëna nga ana e gjyqtarit të shkallës së parë (paqes) në bazë të këtyre dy neneve janë konsideruar si akte administrative, dhe jo si vendime gjyqësore. Ato as nuk mund të kundërshtohen, as të apeloohen dhe, përveç rastit të kapërcimit të kompetencave, as të ankohen në Kasacion.

6. Në 1966, dhe pikërisht më 17 qershor, 20 maj dhe 16 gusht, të tre këta persona i paraqitën kërkesat e tyre përpara Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut. Duke përmendur një numër nenesh të Konventës, ndërmjet të cilëve nenin 4, nenin 5 §§ 1, 3 dhe 4, nenin 6 §§ 1 dhe 3 (b) dhe (c), 7, 8 dhe 13 të Konventës. Ata u ankuan, në veçanti në lidhje me faktin se nuk kishin pasur mundësi të apelonin vendimet që urdhëruan dënimin e tyre. Ata pretendonin se ky fakt shkelte nenin 5 § 4 të Konventës, sipas të cilit çdo person i dënuar me heqje lirie ka të drejtë të fillojë procedurat e duhura për të vendosur ligjshmërinë e dënimin të tij nga një gjykatë. z. De Wilde dhe z. Versyp pretendonin gjithashtu për shkelje të nenit 3.

7. Më 1967, Komisioni duke i deklaruar çështjet të pranueshme, procedoi me bashkimin e tyre, dhe më 19 korrik 1969 përgatit raportin e tij. Në këtë raport ai arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të neneve 4, 5 § 4 dhe 8, por që nuk ka pasur shkelje të neneve 3 dhe 5 § 1. Ai i gjykoi si të pazbatueshëm nenet 5 § 3, 6 §§ 1 dhe 3 dhe 7. Së fundi, ai e çmoi të panevojshëm shqyrtimin e çështjes nën këndvështrimin e nenit 13.

## II. Vendimet e Gjykatës

### A. Mbi çështje të procedurës - vendimi i 18 nëntorit 1970

8. Gjykata, të cilës i ishte paraqitur çështja nga Qeveria belge më 24 tetor 1969, u vu në dijeni nga përfaqësuesi i Komisionit se kërkuesit synonin të përfaqësoheshin përpara saj nga z. Magnée, avokat në Bruksel, i cili do t'i ofronte Gjykatës edhe shpjegime më të plota mbi çështjen në fjalë. Agjenti i Qeverisë belge e kundërshtoi këtë kërkesë me arsyetimin, se së pari, Komisioni e kishte përgatitur Raportin e tij, gjë që do të thoshte se çështja kishte qenë mjaft e qartë në sytë e tij dhe, së dyti, se vetëm Komisioni dhe Shtetet anëtare kishin të drejtë të paraqiten përpara Gjykatës.

9. Duke hedhur poshtë këto pretendime, Gjykata u lejoi kërkuesve përpara Komisionit që të përfaqësohen përpara saj nga z. Magnée (gjashhtëmbëdhjetë vota kundër një) duke u bazuar në nenin 29 § 1 të Rregullores së saj sipas të cilit, kërkuesit para saj mund të përfaqësohen nga një person i zgjedhur prej tyre i cili mund edhe të thirret për të marrë fjalën.

### B. Në lidhje me pretendimet paraprake - vendimi i 18 qershorit 1971

10. Përpara se të kalojë në shqyrtimin e themelit të çështjes, Gjykatës iu desh të vendoste në lidhje me çështje të kompetencës së saj dhe të pranueshmërisë së çështjes.

11. Pyetja e parë: a ishte Gjykata kompetente për të marrë në shqyrtim pretendimet për mos shterim të rrugëve të brendshme dhe të vonesës, të ngritura nga ana e qeverisë Belge në drejtim të pranimit të kërkesave nga ana e Komisionit? Gjykata u përgjigj në mënyrë pohuese (dymbëdhjetë vota kundër katër) duke u mbështetur në nenin 45 të Konventës i cili përcakton kompetencën e saj *ratione materiae* dhe që ka një vlerë të përgjithshme. Natyrisht që Gjykata duhet të sigurojë respektimin e kushteve të përcaktuara në nenet 47 dhe 48, por pasi një çështje i është parashtruar rregullisht për shqyrtim, ajo gëzon një juridiksion të plotë dhe mund të analizojë çdo çështje mbi të drejtën ose mbi faktet që do të mund të shtrohen gjatë shqyrtimit të çështjes. Nuk ka pse pra, problemet e interpretimit dhe të zbatimit të nenit 26 të ngritura përpara saj të dilnin jashtë kompetencës së saj.

12. Pyetja e dytë: a duhej të konsiderohej se qeverisë Belge i ishte parashkruar e drejta për të ngritur pretendimet për shterim të mjeteve të brendshme? Gjykata bëri një dallim në këtë plan. Nga njëra anë, qeverisë nuk i është parashkruar e drejta për të ngritur këto pretendime për sa i përket vendimeve të gjyqtarëve të paqes të Charleroi, të Namyrut dhe të Brukselit. Dy muaj pas vendimit të Komisionit në lidhje me pranueshmërinë, Këshilli i Shtetit kishte dhënë një vendim me të cilin ndryshonte jurisprudencën e tij të deriatëhershme dhe e deklaronte si të pranueshëm dhe të justifikueshëm një ankim për anulimin e një vendimi internimi për vagabondazh. Qeveria i ishte drejtuar atëherë

Komisionit, por gjithsesi më kot, që ky të jepte një vendim të dytë në lidhje me pranueshmërinë për të konstatuar që kërkuesit kishin në dispozicionin e tyre një mjet ankimor që nuk e kishin përdorur. Nga ana tjetër, qeverisë i ishte parashkruar e drejta që të pretendonte vonesën në bërjen e kërkesës nga z. Versyp (me unanimitet) dhe shterimin e rrugëve të brendshme në lidhje me vendimet e Ministrisë të Drejtësisë, të cilat prapësonin kërkesat për lirim të tre kërkuesve (me unanimitet). Përpara Komisionit, qeveria nuk i ishte referuar asnjëherë nenit 26 në lidhje me këto dy pika.

13. Pyetja e tretë: a është i bazuar pretendimi i ngritur nga Komisioni, për mos shterim të mjeteve të brendshme të ankimit kundër vendimeve të gjyqtarëve të paqes për dënim për vagabondazh? Së pari, Gjykata çmoi, me unanimitet, se ky pretendim nuk është i bazuar dhe hodhi poshtë argumentin e përdorur në lidhje me ndryshimin e jurisprudencës së Këshillit të Shtetit për pranueshmërinë e ankimeve kundër vendimeve të llojit të lartpërmendur. Kërkuesit nuk mund të qortoheshin për shkak se kishin mbajtur një qëndrim të njëjtë me atë që vetë qeveria mbante në Strasburg mbi ndryshimin e jurisprudencës së lartpërmendur, dhe që në fund të fundit, ishte edhe qëndrimi që mbisundonte në atë kohë në Belgjikë. Së dyti, pas njohjes me vendimin e Këshillit të Shtetit, të interesuarit nuk kanë pasur më mundësi që të përfitojnë nga ankimi para tij, për shkak se afati ligjor prej gjashtëdhjetë ditësh ishte parashkruar prej kohësh.

#### ***C. Në lidhje me një interpretim në parim të nenit 5***

14. Duke filluar shqyrtimin e themelit të çështjes, Gjykata që në fillim nuk e pranoi argumentin e qeverisë Belge sipas të cilit kërkuesit ishin paraqitur me vullnetin e tyre të lirë në polici dhe se dënimi i tyre kishte ardhur si pasojë e një kërkesë të shprehur në rastet e z. Ooms dhe të z. Versyp dhe të një kërkesë të nënkuptuar në rastin e z. De Wilde, dhe se ai nuk mund të konsiderohej si privim i lirisë së tyre. Sipas Gjykatës, paraqitja e personit në polici me qëllim që ta çojnë në një institucion mund të nxitet nga vuajtja ose nga skamja kalimtare. Kjo nuk do të thotë që personi ndodhet në një gjendje vagabondazhi. Në vazhdim, dhe mbi të gjitha, e drejta për liri ka një rëndësi shumë të madhe në një “shoqëri demokratike”, dhe nuk mundet që një person ta humbasë atë vetëm për shkak të faktit se është paraqitur vetë për t’u burgosur. Një heqje lirie, mendon Gjykata, mund ta shkelë nenin 5 po njësoj, edhe kur personi i interesuar e pranon atë.

#### ***D. Në lidhje me nenin 5 §§ 1 dhe 3***

15. Duke e shqyrtuar çështjen nën këndvështrimin e nenit 5 § 1, Gjykata konstatoi se z. De Wilde, z. Ooms dhe z. Versyp ishin vagabondë. Atyre mund t’u hiqej liria me kusht që vendimi të merrej nga autoritetet kompetente dhe në përputhje me procedurat ligjore belge. Ajo nuk vuri në dukje as paligjshmëri dhe as arbitraritet në këtë rast të heqjes së lirisë së tre kërkuesve dhe nuk kishte asnjë arsye që ta konsiderojë si të papajtueshme me nenin 5 § 1 (e), heqjen e lirisë që merret në shqyrtim. Gjykata arriti njëzëri në përfundimin se neni 5 § 3 nuk gjen zbatim përderisa vagabondazhi nuk përbën një vepër penale sipas së drejtës belge.

**E. Në lidhje me nenin 5 § 4**

16. Megjithëse nuk konstatoi shkelje të nenit 5 § 1, Gjykata shqyrtoi nëse do të arrinte në të njëjtin përfundim edhe në lidhje me paragrafin 4, për shkak se respektimi i të parit nuk sjell automatikisht edhe respektimin e të dytit. Në këtë kuadër, kërkuesit pretendonin se nuk kishin pasur në dispozicion asnjë mjet ankimi qoftë kundër vendimeve që çuan në heqjen e lirisë së tyre, qoftë kundër hedhjes poshtë të kërkesave të tyre për t'u liruar.

17. Në lidhje me vendimet e heqjes së lirisë, Gjykata filloi me shqyrtimin e kushteve në të cilat z. De Wilde, z. Ooms dhe z. Versyp janë çuar përpara gjyqtarit të paqit. Sipas tij, neni 5 § 4 e pranon veprimin e një organi unipersonal, por me kusht që procedura e ndjekur të ketë një karakter gjyqësor dhe t'i japë të interesuarit garancitë e përshtatshme për natyrën dhe rëndësinë e heqjes së lirisë që ai rrezikon. Heqja e lirisë, për të cilën ankoheshin tre kërkuesit, ngjan me një dënim të dhënë nga një juridiksion penal. Për këtë arsye edhe procedura e zbatueshme nuk duhet t'u ofronte kërkuesve garanci haptazi më të vogla se ato që ekzistojnë në fushën penale në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Procedura e parashikuar nga legjislacioni belg, sipas Gjykatës, duket se merrte karakterin administrativ të vendimit që jepet dhe nuk siguronte garancitë e krahasueshme me dënimet që jepen në fushën penale. Nuk është e mundur që personat e arrestuar për vagabondazh t'i nënshtrohen një procedure të shkurtuar, ndërkohë që personat që mund të dënohen me dënime më të vogla se ato të parashikuara nga ligji i vitit 1891, përfitojnë garanci shumë më të mëdha që parashikohen nga Kodi Penal. Natyrisht që procedura belge paraqet disa aspekte gjyqësore, siç janë karakteri publik i marrjes në pyetje të të interesuarit si dhe i dhënies së vendimit, por këto nuk mjaftojnë për t'i dhënë gjyqtarit të paqes karakterin e një "gjykate" në qoftë se mbahet mirë parasysh rëndësia e çështjes. Kemi të bëjmë me një heqje lirie për një periudhë afatgjatë të shoqëruar me pasoja të tjera për humbjen e personalitetit. Pra, duhej të ishin hapur mundësi ankimi për z. De Wilde, z. Ooms dhe z. Versyp. Për këtë arsye, me nëntë vota kundër shtatë Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 5 § 4.

18. Nga ana tjetër, duke iu referuar hedhjes poshtë të kërkesës për ndërprerjen e heqjes së lirisë, drejtuar autoritetit administrativ, Gjykata vendosi (pesëmbëdhjetë vota kundër një) se neni 5 § 4 nuk ishte shkelur. Kjo për shkak se në qoftë se z. De Wilde, z. Ooms dhe z. Versyp do të pretendonin se ministri kishte shkelur ligjin e vitit 1891, ata do të mund t'i ishin drejtuar Këshillit të Shtetit. Por në fakt, asnjëri prej tyre nuk mund ta bënte një gjë të tillë, përderisa nuk gjendej në një pozitë të tillë për të cilën ligji kërkonte marrjen fund të heqjes së lirisë.

**F. Në lidhje me nenet 6, 7, 4, 8, 3 dhe 13**

19. Duke qenë se ka konstatuar shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës, Gjykata gjykoi se nuk ishte e nevojshme që të shqyrtonte nëse në rastin në fjalë gjen zbatim neni 6 dhe në rast se po, a ka qenë respektuar. Për sa i përket nenit 7, ai nuk merret për bazë përderisa vagabondazhi nuk përbën një vepër penale dhe se kërkuesit nuk kanë qenë dënuar me asnjë vepër penale.



20. Në kundërshtim me Komisionin, Gjykata vlerësoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 4 § 3 (a) (me unanimitet). Ky nen e lejon punën e kërkuar normalisht personave të privuar nga liria e tyre. Siç u konkludua më lart, neni 5 § 1 (e) nuk ishte shkelur, në rastin e kërkuësve. Për më tepër, detyrimi i këtyre të fundit për të punuar nuk i kalonte kufijtë e të “normales” sepse synonte riklasifikimin dhe integrimin social të kërkuësve.

21. Gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit kishte pasur kontrole të korrespondencës së z. De Wilde, të z. Ooms dhe të z. Versyp. Duke njohur faktin që ky kontroll përbën një shkelje në ushtrimin e një të drejte të garantuar nga neni 8 § 1, Gjykata konstatoi që një masë e tillë ishte parashikuar nga ligji dhe se autoritetet belge nuk i kanë kapërcyer kufijtë e hapësirës së vlerësimit që neni 8 § 2 u lë në kompetencë shteteve. Për më tepër, asgjë nuk nxirrte në pah që të ketë pasur diskriminim ose kapërcim kompetencash nga ana e autoriteteve në dëm të kërkuësve. Pra nuk ka pasur shkelje të nenit 8.

22. Gjithashtu, Gjykata nuk gjeti asnjë element shkeljeje të nenit 3, të ngritur nga z. De Wilde, z. Ooms dhe z. Versyp të cilët ankoheshin në lidhje me dënimet disiplinore që ishin dhënë për shkak të refuzimit të tyre për të punuar.

23. Së fundi, kërkuësit i referoheshin nenit 13. Ata ankoheshin se nuk kishin pasur një mjet efektiv përpara një organi kombëtar ku të mund të pretendonin mbrojtjen e të drejtave të garantuara nga nenet 5, 3, 4, 6, 7 dhe 8. Në lidhje me nenin 5 § 4, përderisa ka konstatuar një shkelje, Gjykata nuk e mendoi të nevojshme ta shqyrtojë edhe nën dritën e nenit 13. Për sa u përket pretendimeve të tjera, ajo u mjaftua duke nënvizuar se nenet 3 dhe 8 janë drejtpërdrejt të zbatueshëm në të drejtën belge dhe se vendimet administrative të kundërshtuara nga kërkuësit do të mund të ishin ankuar edhe përpara Këshillit të Shtetit. Pra sipas Gjykatës nuk ka pasur shkelje të nenit 13.

24. Duke qenë se z. De Wilde, z. Ooms dhe z. Versyp kanë qenë viktimat të një shkeljeje të nenit 5 § 4 të Konventës, Gjykata u rezervoi të drejtën për të kërkuar një shpërblim të drejtë, çështje të cilën Gjykata e shtyu për një gjykim të mëvonshëm.

### ***G. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41) – vendimi i 10 marsit 1972***

25. Avokati i kërkuësve i drejtohej Gjykatës duke pretenduar për secilin prej klientëve të tij një dëmshpërblim prej 300 frangash belge për çdo ditë “heqje të parregullt lirie”. Nga ana tjetër, qeveria Belge pretendonte që këto kërkesa nuk duheshin pranuar, përderisa mjetet e brendshme të ankimit nuk ishin shteruar. Ajo i referohej si nenit 26 që vlen edhe për kërkesat e shpërblimit të drejtë, ashtu edhe nenit 50, për shkak se kërkuësit nuk kishin provuar që e drejta belge nuk ishte në gjendje të ndreqte plotësisht shkeljen e Konventës të konstatuar me vendimin e 18 qershorit 1971, të referuar më lart.



26. Gjykata i hodhi poshtë këto dy argumente dhe njëzëri i deklaroi kërkesat për dëmshpërblim të pranueshme. Kjo për shkak se, nga njëra anë, këto kërkesa lidheshin vetëm me fazën e fundit të procedurës përpara Gjykatës dhe nuk përbënin kërkesa të reja, kështu që neni 26 nuk gjente zbatim. Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh se neni 50 nuk ka të njëjtin karakter si neni 26. Ai përfshin si hipotezën ashtu edhe pamundësinë e *restitutio in integrum* i cili rrjedh nga vetë natyra e dëmit.

27. Megjithatë Gjykata deklaroi se kërkesat për dëmshpërblim nuk janë të bazuara, për shkak se Gjykata, në vendimin e saj mbi themelin, nuk gjeti ndonjë arsye që ta konsideronte të paligjshëm ose arbitrar procedimin ose heqjen e lirisë të tre kërkuessve. Prandaj ajo edhe nuk vlerësoi se një dënim në përputhje me kërkesat e nenit 5 § 4 mund t'u kishte lejuar atyre një lirim të parakohshëm. Nga ana tjetër, të interesuarit kanë përfituar një ndihmë juridike pranë Komisionit, pranë të dërguarve të tij dhe nuk kanë bërë shpenzime ose pagesa që nuk u janë kthyer ndërkaq. Së fundi, Gjykata nuk vlerësoi se në rastin në fjalë, për mungesë të një mjeti ankimor që do t'u përgjigjej kërkesave të nenit 5 § 4, kërkuessve u takonte e drejta për shpërblim të dëmit moral.

### III. Koment

28. Kjo çështje e njohur ndryshe edhe si çështja e “vagabondazhit” është një nga më interesantet që janë paraqitur përpara Gjykatës. Çështja ka rëndësi themelore në vazhden e vendimeve të dhëna nga Gjykata, së pari në lidhje me sqarimin e disa elementëve proceduralë të zhvillimit të procesit gjyqësor përpara Gjykatës. Me një vendim të ndërmjetëm të 18 nëntorit 1970, Gjykata pranoi se, pavarësisht se i është paraqitur çështja nga Komisioni, në seancën e zhvilluar para saj kërkuessit mund të përfaqësohen nga një person i zgjedhur prej tyre i cili edhe mund të thirret për të marrë fjalën. Ky interpretim i ish nenit 29 § 1 të Rregullores së Gjykatës ka vlera të konsiderueshme për zhvillimin e të gjitha proceseve vijuese në Strasburg, pasi u bë e qartë që në këtë mekanizëm ndërkombëtar kontrolli nuk kanë të drejtë të paraqiten vetëm Komisioni dhe shtetet anëtare por edhe individët ose përfaqësuesit e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ky pohim ka vlera të veçanta historike për të gjithë të drejtën ndërkombëtare. Çështja është interesante edhe për interpretimin e ish-neneve 26 dhe 50 të Konventës dhe nxjerr në dritë disa parime të rëndësishme të interpretimit të Konventës.

29. Gjykata në këtë çështje sqaron gjithashtu natyrën që duhet të ketë organi gjyqësor për qëllimet e nenit 5 dhe të paragrafit 4 të tij në veçanti. Sipas saj, organi gjyqësor pavarësisht se mund të jetë i përbërë nga një gjyqtar i vetëm duhet të jetë i pavarur nga ekzekutivi dhe nga palët në proces. Këtë kriter Gjykata e kishte pranuar ndërkaq edhe në çështjen *Neumeister kundër Austrisë* në vitin 1968. Gjykata pranoi gjithashtu se ky organ duhet të jetë në gjendje që të marrë edhe vendime me karakter të detyrueshëm<sup>280</sup>.

280 Shih në lidhje me këtë aspekt vendimin e Gjykatës të 25 nëntorit 1996, në lidhje me çështjen *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

30. Në këtë çështje është interesante të vlerësohet gjithashtu kriteri i konstatimit të shkëljes së Konventës nga ana e shtetit belg. Pra shkëlja konsistonte në faktin se kërkuesve nuk u ishin siguruar nga shteti belg të gjitha garancitë procedurale që i përgjigjeshin rëndësisë së dënimit që ata kishin marrë, pavarësisht se ky dënim mund të konsiderohet penal apo administrativ sipas së drejtës së brendshme<sup>281</sup>.

## MIHAILOVS kundër LETONISË

(kërkesë nr. 35939/10)

22 janar 2013

*heqja e lirisë personave me aftësi të kufizuara*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Genadijs Mihailovs, është një banor i përhershëm i Letonisë por jo shtetas i saj. Ai u lind në vitin 1947 dhe jeton në një institucion shtetëror të kujdesit social. Kërkuesi vuante nga epilepsia, dhe njihej si me aftësi të kufizuara që nga viti 1994.

2. Më 13 mars 2000, kërkuesi u shtrua në një spital psikiatrik në Riga. Më 19 prill 2000, ekspertët e psikiatrisë dolën në përfundimin se, kërkuesi nuk vuante nga një sëmundje mendore, por e diagnostikuan atë me epilepsi e cila ishte "organike në natyrë", duke e bërë atë të prirur ndaj sindromave dhe simptomat psikopatikë. Ai vuajti nga kriza epilepsie, të menduarit obsesiv, disforia, depresioni dhe arsytimi të reduktuar. U rekomandua që ai të deklarohej ligjërisht i paaftë. Gjithashtu ata vërejtën se ai ishte i paaftë për të marrë pjesë në seancat dëgjimore dhe të jepte shpjegime të përshtatshme.

3. Në një datë të paspecifikuar, gruaja e kërkuesit aplikoi që t'i hequr atij zotësinë juridike. Për qëllimet e këtij procesi gjykata vendase urdhëroi një ekzaminim psikiatriko-ligjor të kërkuesit. Në mungesë të kërkuesit, ai u deklarua ligjërisht i paaftë në qershor 2000, dhe gruaja e tij u deklarua kujdestari i tij. Gruaja e kërkuesit e vizitonte atë rregullisht, dhe vuri re (në një moment të caktuar) se shëndeti i tij ishte përkeqësuar. Në nëntor të vitit 2000, gruaja aplikoi që kërkuesi të transferohej në një institucion shtetëror të specializuar të kujdesit social, por pa dhënë asnjë arsye. Më vonë, atë muaj, Autoriteti i Ndihmës Sociale e vendosi kërkuesin në listën e pritjes për "transferim në institucionin e kujdesit social për njerëzit me çrregullime mendore." Në janar 2002, spitali ku qëndronte kërkuesi rekomandoi që ai të transferohej në një institucion social shtetëror dhe kështu ai u zhvendos në një Qendër Rehabilitimi Psikologjik.

281 Shih gjithashtu vendimin e 8 qershorit 1976, në lidhje me çështjen *Engel dhe të tjerë kundër Holandës*.

4. Në vitin 2007, kërkuesi kërkoi të deklarohet ligjërisht i aftë. Lidhur me këtë atij iu shpjegua se, duhej të dëgjohej në gjykatën e kujdestarisë. Gjykata kërkoi një raport mbi shëndetin e tij. Shëndëti i tij mendon u vlerësuar si i qëndrueshëm, i pakthyeshëm dhe progresiv. Ai paraqiste distrofobi, axhitim dhe agresivitet. Kërkuesi u vizitua nga z. Petrovs dhe z. Braginskis në tetor 2009, anëtarë të një OJF-je lokale. Në përgjigje të kërkesave të z. Braginskis lidhur me ndërprerjen e kujdesit social të kërkuesit, gjykata shpjegoi se, kujdestari i kërkuesit duhet të aplikojnë për këtë.

5. Më 17 gusht 2007, gruaja e kërkuesit kërkoi që z. Petrovs t'i mohohet e drejta për t'iu afruar kërkuesit me pretendimin se shëndeti i tij ishte përkeqësuar që nga vizita e z. Petrovs. Ajo kërkoi gjithashtu që kërkuesit t'i mohoheshin të gjithë vizitorëve pa pëlqimin e saj me shkrim. Ajo i dha një prokurë një punonjësi social në Qendrën në Île për t'a lejuar atë që të hapë korrispodencën e kërkuesit. Në korrik 2009, ajo paraqiti kërkesën për divorc, por u tërhoq kur mësoi se kërkuesi kishte shfaqur dëshirën që të kishte si kujdestar të ri z. Bragnitskis. Në shkurt 2010, Qendra e Rehabilitimit në Île e vlerësoi gjendjen e tij si të qëndrueshme, por të pakthyeshme. Nuk ishte e këshillueshme që ai të jetonte në shtëpi, ose pa mbikëqyrje të vazhdueshme.

6. Ndërkohë, z. Bragnitskis po përpiqej të merrte kujdestarin e kërkuesit me qëllim t'i rikthente zotësinë juridike dhe t'a lironte atë nga Île. Megjithatë gjykata e kujdestarisë refuzoi kërkesën e z. Bragnitskis dhe në gusht 2010, i biri i kërkuesit u deklaruar bashkëkujdestar me gruan e kërkuesit. Në një tjetër proces në shtator të vitit 2011, gjykata vlerësoi përshtatshmërinë e gruas së kërkuesit dhe djalit të tij si kujdestarët e tij. Gjykata i deklaroi ata të papërshtatshëm pasi kurrë kërkuesi nuk ishte nxjerrë nga Qendra e Rehabilitimit në Île, dhe as ishte cuar për të vizituar varret e prindërve të tij, kërkesë që ai e kishte bërë prej kohësh. Gjykata caktoi kujdestar z. Petrovs, sic edhe kërkuesi dëshironte.

7. Në prill 2010 Qendra u zhvendos në mjedise të reja, ku kërkuesi vazhdoi të qëndrojnë, duke refuzuar të lëvizte në një tjetër Qendër duke deklaruar se, ndjehej mirë aty ku ishte. Më vonë ai ndonjëherë do të të qëndronte në shtëpinë e z. Petrovs.

## II. Vendimi i Gjykatës

8. Kërkuesi pretendoi se, mbajtja e tij në Qendrën e Rehabilitimit përbënte shkelje të së drejtës së tij për liri, duke qenë se, ishte mbajtur kundër vullnetit të tij, në kundërshtim me nenin 5. Për më tepër, kërkuesi pretendoi gjithashtu se vazhdimi i qëndrimit të tij në Qendrën e Rehabilitimit përbënte shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 8.

### A. Në lidhje me nenin 5

9. Në lidhje me situatën e kërkuesit pasi Qendra u zhvendos në prill 2010, kërkuesi vetë kishte deklaruar se ai dëshiron të qëndronte aty, dhe liria që ai

gëzonte prej tij ishte e tillë që çoi Gjykatën në përfundimin se, nuk kishte pasur asnjë heqje të lirisë së kërkuesit në kundërshtim me nenin 5 § 1, pasi ai kishte rënë dakord për të qëndruar atje.

10. Megjithatë ndërkohë që qëndronte në Qëndër para se të zhvendosej me godina diku tjetër, kërkuesi nuk ishte në gjendje të largohej pa lejen e menaxhmentit. Ndërsa ai kishte jetuar në një institucion të tillë për më shumë se tetë vite, ai kishte ndjerë efektin e tërësisht të kundërt të kufizimeve të vendosura ndaj tij. Ai ishte vendosur në këtë Qendër kundër vullnetit të tij dhe kështu ishte privuar nga liria e tij nga janari i vitit 2002 deri në prill të vitit 2010. Qëndrimi i tij në Qendër kishte pasur pëlqimin e gruas së tij, i cili ishte kujdestari i tij ligjor, kështu që kishte një bazë ligjore për këtë veprim. Megjithatë, qëndrimi nuk mund të konsiderohet i ligjshëm pa garancitë e mjaftueshme kundër arbitraritetit. Raporti mjekësor i ekspertëve i paraqitur gjatë proceseve shprehte në mënyrë specifike se kërkuesi nuk vuante nga sëmundje mendore, dhe nuk kishte asnjë arsye tjetër objektive mjekësore për të arsyetuar qëndrimin e tij në Qendër. Së fundi, Gjykata theksoi se nuk ishin marrë në konsiderate mjete të tjera më pak kufizuese të ndihmës sociale. Prandaj, duke qenë se mbajtja në Qendër nuk ishte e justifikuar, ajo ishte e pa ligjshme sipas nenit 5 § 1.

11. Legjislacioni letonez nuk lejon rishikimin automatik gjyqësor të ligjshmërisë së vendimit të pranimit dhe mbajes së kërkuesit në institucionin e kujdesit social, dhe një rishikim nuk mund të fillohet nga dikush që nuk ka zotësi juridike. Kështu kërkuesi nuk kishte pasur mundësi të kundërshtonte qëndrimin e tij në një institucion pa vullnetin e tij, dhe rrjedhimisht ka pasur shkelje të nenit 5 § 4 deri në prill të vitit 2010.

### **B. Në lidhje me nenin 8**

12. Gjykata vendosi se, nuk ngriheshin çështje të ndara sipas nenit 8, i cil garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

13. Kërkuesit iu akordua 15 000 euro në lidhje me dëmin jo material. Gjykata më tej shtoi se, interesi i mospagimit, duhet të bazohet në përqindjen ditore të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane, së cilës duhet t'i shtohen tre pike përqindjeje.

## **III. Komente**

14. Ky rast mund të krahasohet me rastin *Pleso kundër Hungarisë*<sup>282</sup>. Ajo përfshin heqjen e lirisë së një individi i cili (ndryshe nga kërkuesi në Pleso) ishte privuar edhe nga zotësia e tij juridike - mungesa e kësaj mase u konsiderua si e rëndësishme tek rasti i Pleso. Në rastin konkret heqje e zotësisë juridike ishte

urdhëruar me kërkesën e gruas së tij, kërkesë e cila u mbështet edhe nga një rekomandimi i një psikiatri, i cili e kishte vizituar atë dhe kishte konkluduar se, ai nuk vuante nga një sëmundje mendore, por nga epilepsia. Më pas, kërkuesi ishte vendosur në një institucion të kujdesit social dhe ishte pranua në disa raste në spitale psikiatrike. Gjykata vuri në dukje, në mënyrë të veçantë se ‘nevoja objektive për strehim dhe ndihmë sociale nuk duhet automatikisht të çojë në marrjen e masave që përfshijnë heqjen e lirisë’. Gjykata u trondit nga vlerësimet e papërshtatshme, e pasaktë dhe të vjetëruar psikiatrike, në të cilat ishin mbështetur për ta mbajtur atë në Qendër, si dhe mungesën e një rishikim të vazhdueshëm me qëllimin specifik për të përcaktuar nëse ai duhet të mbetet subjekt i mbajtjes së detyrueshme në Qëndër. Gjykata arrin në përfundimin disi shqetësues se, vendosja e tij më vonë në një institucion të ndryshme me një regjim më pak të ashpër nuk përbënte heqje të lirisë. Gjykata iu referua nenit 12 të Konventës së OKB mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRC) e cila rregullon zotësinë juridike dhe rolin vendimtar që ka kujdestari i caktuar për të folur në emër të atyre të cilëve u është hequr zotësia juridike dhe duhet të sigurojë që ky person është i pavarur dhe përfaqëson sic duhet interesat e personit (dhe jo interesa të tjerë). Gjithashtu, neni 14 (1) (b) i UNCRC thekson se, ‘ekzistenca e aftësisë së kufizuar nuk duhet në asnjë rast të justifikojë heqjen e lirisë’. Komiteti i Konventës Evropiane për të Bimjeksionin dhe të Drejtat e Njeriut është aktualisht në procesin e hartimit të një protokoll i cili në mënyrë specifike do të adresojë trajtimin e pavullnetshme dhe vendosjen e detyruar në institucione të personave me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore.

## ÇONKA kundër BELGJIKËS

(kërkesa nr. 51564/99)

5 shkurt 2002

*në këtë çështje u vlerësua se mënyra e dëbimit të një kërkuesi azili shkelte disa prej garancive të parashikuara nga Konventa*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, të quajtur Ján Čonka, Mária Čonková si dhe fëmijët e tyre, janë shtetas sllovakë me origjinë rumune. Në nëntor 1998 ata u larguan nga Sllovakia në drejtim të Belgjikës ku edhe kërkuan azil politik me argumentin se ishin sulmuar në mënyrë të dhunshme disa herë me radhë nga nazishtë në Sllovakia. Më 3 mars 1999 Ministri i Brendshëm e deklaroi kërkesën e tyre për azil të papranueshme me argumentimin se ata nuk kishin ofruar prova të mjaftueshme për të treguar se jeta e tyre ishte në rrezik në Sllovakia. Më 18 qershor 1999 Komisari i Përgjithshëm për Refugjatët dhe Personat pa Shtetësi e la në fuqi këtë vendim dhe kërkuesve iu kërkua që të largoheshin nga territori belg brenda pesë ditëve.

2. Më 3 gusht 1999 kërkuesit iu drejtuan *Këshillit të Shtetit*<sup>283</sup> për rishikim gjyqësor të vendimit të 18 qershorit 1999 dhe për një pezullim ekzekutimi në bazë të procedurës të zakonshme gjyqësore administrative belge. Ata iu kërkuan gjithashtu edhe ndihmë ligjore. Më 23 shtator 1999 *Këshilli i Shtetit* e hodhi poshtë kërkesën për ndihmë ligjore përderisa kjo nuk ishte shoqëruar me certifikatën përkatëse mbi të ardhurat e kërkuesve dhe i urdhëroi kërkuesit që të paguanin shpenzimet gjyqësore brenda pesëmbëdhjetë ditësh. Përderisa këta nuk arritën t'i përgjigjeshin kësaj ftese, kërkesë-padia e tyre u hoq nga regjistri i gjykatës.

3. Në shtator 1999 policia e Gentit<sup>284</sup> i dërgoi një njoftim një numri familjesh Sllovaqe me origjinë rumune, përfshirë këtu edhe kërkuesit e kësaj çështjeje, duke u kërkuar atyre që të paraqiteshin në rajonin përkatës të policisë më 1 tetor 1999. Njoftimi bënte të ditur që paraqitja në rajonin e policisë ishte e nevojshme për të mundësuar plotësimin e dosjeve në lidhje me kërkesat që ata kishin bërë për azil në Belgjikë.

4. Sapo arritën në rajonin e policisë, kërkuesve iu dha një urdhër i ri për t'u larguar nga territori dhe një vendim për largimin e tyre në drejtim të Sllovakisë si dhe arrestimi i tyre për këtë qëllim. Një përkthyes i gjuhës sllovaqe ishte i pranishëm kur ata u arrestuan. Kërkuesit u mbajtën, bashkë me familje të tjera sllovaqe me origjinë rumune në një Qendër Paraburgimi pranë Brukselit. Më 5 tetor 1999 kërkuesit së bashku me rreth 70 të ardhur të tjerë me origjinë rumune, të cilëve u ishin refuzuar gjithashtu kërkesat për azil, i çuan në një aeroport ushtarak dhe i nisën me avion për në Sllovaki.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Duke u mbështetur në nenet 5 dhe 13 të Konventës dhe në nenin 4 të Protokollit 4, kërkuesit u ankuan, në veçanti, në lidhje me rrethanat e arrestit dhe të dëbimit të tyre në drejtim të Sllovakisë.

### A. Në lidhje me nenin 5 § 1

6. Konventa kërkon që çdo masë që e privon individin nga liria e tij duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 5, në mënyrë që individi të jetë i mbrojtur nga arbitraritetet e mundshme. Megjithëse Gjykata nuk e përjashtoi aspak legjitimitetin e përdorimit të dredhive nga ana e policisë, për shembull, për t'u bërë ballë veprimtarive kriminale në mënyrë më efektive, aktet në fjalë, me anë të të cilave autoritetet kërkonin të fitonin besimin e azil kërkuesve por që kishin në fakt qëllimin e dëbimit të tyre, mund të vlerësoheshin si akte që vinin në kundërshtim me parimet e përgjithshme të shpallura ose të nënkuptuara në Konventë.

283 Gjykata e Lartë e juridiksionit administrativ në Belgjikë. Po njësoj quhet edhe në juridiksionin francez.

284 Qytet i rajonit të Flandrës në Belgjikë rreth 100 km nga Brukseli.



7. Nga kjo pikëpamje, kishte arsye të forta të besohej që, ndërsa fjala e përdorur në njoftim ishte "fatkeqësisht", ajo nuk kishte qenë rezultat pakujdesie; përkundrazi, ajo ishte zgjedhur me qëllim, në mënyrë që të sigurohej paraqitja sa më e madhe e azil kërkuesve. Edhe në lidhje me të huajt me qëndrim ilegal, mund të thuhet se një vendim e vetëdijshëm i autoriteteve për të lehtësuar ose përmirësuar rezultatit e një operacioni të planifikuar për dëbimin e të huajve duke i gënjyer ata në lidhje me qëllimin e njoftimit dhe në mënyrë të tillë që ta bënte më të lehtë privimin e lirisë së tyre nuk ishte në përputhje me nenin 5 të Konventës. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 5 § 1.

8. Gjykata e hodhi poshtë pretendimin paraprak të qeverisë sipas së cilës kërkuesit nuk kishin arritur të shteronin mjetet e brendshme (ankim pranë seksionit përkatës të gjykatave penale), duke arritur në përfundimin se autoritetet nuk u kishin ofruar kërkuesve një mundësi konkrete për të përdorur këto mjete (shih për më tepër në kuadrin e nenit 5 § 4).

#### B. Në lidhje me nenin 5 § 2

9. Gjykata vuri në dukje se në momentin e arritjes në rajonin e policisë, kërkuesit ishin vënë në dijeni me arsyet e arrestimit të tyre si dhe mbi mjetet e mundshme ankimore. Një përkthyes i sllovakishtes kishte qenë i pranishëm gjithashtu. Edhe pse këto masa në vetvete nuk ishin të mjaftueshme për t'u lejuar kërkuesve të ushtronin disa mjete ankimore, informacionet që u ishin dhënë kërkuesve kënaqnin kërkesat e nenit 5 § 2 të Konventës. Pra nuk ka pasur shkelje të kësaj dispozite të Konventës.

#### C. Në lidhje me nenin 5 § 4

10. Gjykata vuri në dukje një numër faktorësh që padyshim e kishin bërë ankimin në seksionin penal të gjykatave belge më pak të mundur. Ndër to përfshihej fakti që informacioni në lidhje me mjetet e mundshme ankimore që iu shpërnda kërkuesve kur këta arritën e rajonin e policisë ishte printuar me karaktere të vogla, në një gjuhë që ata nuk e kuptonin. Për më tepër vetëm një përkthyes kishte qenë i pranishëm për të ndihmuar numrin e madh të familjeve për të kuptuar njoftimet me goje ose me shkrim që u ishin dhënë dhe që, megjithëse ai kishte qenë në rajonin e policisë nuk kishte qëndruar me këto familje në pjesën e izoluar. Në këto rrethana, kërkuesit kishin pasur pa dyshim pak mundësi që të ishin në gjendje të kontaktonin një avokat që nga rajoni i policisë me ndihmën e këtij përkthyesi dhe, qoftë edhe po të kishin kontaktuar me një avokat nëpërmjet telefoni, nuk do të kishin mundur të përfitonin ndihmën përkthyesit. Pavarësisht nga këto vështirësi autoritetet nuk kishin ofruar asnjë formë ndihme ligjore as në rajonin e policisë dhe as në qendrën e izolimit.

11. Për më tepër - dhe ky faktor ishte themelor në sytë e Gjykatës - avokati i kërkuesve kishte qenë njoftuar në lidhje me ngjarjet dhe mbi gjendjen e klientit të tij vetëm në ora 22.30 të premtën, më datë 1 tetor 1999, duke e bërë çdo mundësi ankimi të pakuptimtë për shkak se, edhe në qoftë se ai do të mund

të kishte paraqitur një ankim në gjykatë, të hënën më datë 4 tetor, çështja nuk do të mund të ishte marrë në shqyrtim deri më 6 tetor, një ditë pas dëbimit të kërkuesve më datë 5 tetor. Kështu që avokati i kërkuesve nuk kishte qenë në gjendje të paraqiste një ankim në seksionin penal të gjykatës. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës.

#### ***D. Në lidhje me nenin 4 të Protokollit 4***

12. Gjykata vuri në dukje se urdhrat e arrestimit dhe dëbimit ishin nxjerrë për të ekzekutuar një urdhër që ishte marrë në lidhje me kërkuesit dhe familjet e tjera me origjinë rumune. Ky urdhër i fundit ishte bazuar vetëm në seksionin 7 § 1 (2) të Ligjit mbi të Huajt, dhe se referenca e vetme ndaj rrethanave personale të kërkuesve ishte në lidhje me faktin që qëndrimi i tyre në Belgjikë i kishte kaluar tre muajt. Në mënyrë të veçantë urdhri nuk bënte asnjë referencë tek kërkesa e tyre për azil ose të urdhrat e tjerë të dhënë për këtë qëllim. Në këto rrethana dhe duke pasur parasysh numrin e madh të personave të të njëjtës origjinë të cilët kishin pasur të njëjtin fat me kërkuesit, Gjykata vlerësoi se procedura e ndjekur nuk mund të mos të linte dyshime se dëbimi mund të kishte pasur një karakter kolektiv.

13. Ky dyshim u përforcua edhe nga një numër faktorësh: së pari, përpara dëbimit të kërkuesve autoritetet politike kompetente kishin bërë të ditur se do të kishte operacione të një tipi të tillë dhe se ato u kishin dhënë instruksionet përkatëse autoriteteve administrative për vënien e tyre në zbatim; së dyti, të gjithë të huajve që u dëbuan iu kërkua që të paraqiteshin në rajonin e policisë në të njëjtën kohë; së treti urdhrat që iu dhanë atyre për lënien e territorit si dhe ato për arrestimin e tyre ishin formuluar në terma të njëjtë; së katërti, kishte qenë tepër e vështirë për të huajt që të kontaktonin një avokat dhe; së fundmi, procedura e azilit nuk kishte qenë përfunduar ende.

14. Si përfundim mund të thuhet se në asnjë fazë të periudhës ndërmjet bërjes së njoftimit të të huajve për t'u paraqitur në rajonin e policisë dhe dëbimit të tyre procedura e ndjekur nuk u kishte ofruar atyre garanci të mjaftueshme që të kishin treguar se rrethanat personale të secilit prej tyre ishin mbajtur parasysh si duhej dhe në mënyrë individuale.

#### ***E. Në lidhje me nenin 13***

15. Në çështjen në fjalë Këshilli i Shtetit ishin thirrur që t'i shqyrtonte ankimet e kërkuesve në themel në lidhje me rishikimin gjyqësor që ata kërkonin. Duke pasur parasysh kohën që i duhej shqyrtimit të çështjes si dhe faktin që ata ishin nën kërcënimin e dëbimit, kërkuesit kishin bërë edhe një kërkesë për pezullimin e ekzekutimit sipas një procedure normale. Qeveria nga ana e saj kishte pretenduar se procedura nuk kishte qenë e rregullt për rrethanat e çështjes në fjalë dhe se kërkuesit duhet të kishin përdorur procedurën tjetër me karakter tepër urgjent.

16. Megjithatë, Gjykatës iu desh të vinte në dukje se, një kërkesë për një pezullim të ekzekutimit në bazë të një procedure të zakonshme ishte një prej mjeteve që, sipas dokumentit që përmban vendimin e të 18 qershorit 1999 të Komisarit të Përgjithshëm, u ofronte mundësinë kërkuësve për të kundërshtuar këtë vendim. Përderisa, sipas këtij vendimi, kërkuësit kishin vetëm pesë ditë në dispozicion për t'u larguar nga territori shtetëror, një kërkesë për pezullim në bazë të procedurës së zakonshme nuk kishte në vetvete një efekt pezullues dhe se Këshilli i Shtetit kishte në dispozicion dyzetepesë ditë për të vendosur në lidhje me këto kërkesa, vetëm fakti që kërkesat ishin përmendur si mjet i mundshëm, kishte qenë i tillë që i kishte çorientuar kërkuësit, për të mos thënë më tepër.

17. Nga ana tjetër as një kërkesë e bërë në kuadrin e një procedure tepër urgjente për shtyrje ekzekutimi të urdhrit nuk kishte efekt pezullues. Shfrytëzimi i këtij mjeti ishte, për shkak të disa faktorëve, tepër i paqartë për të mundësuar përmbushjen e kërkesave të nenit 13 të Konventës. Si përfundim, kërkuësit nuk kishin pasur në dispozicion një mjet të kërkuar nga ana e nenit 13 për të për të shpjeguar pretendimin e tyre në kuadrin e nenit 4 të Protokollit 4. Për këtë arsye, ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

#### *F. Në lidhje me nenin 41*

18. Gjykata u akordoi kërkuësve 10 000 euro për dëm jo-material dhe 9 000 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

### **III. Koment**

19. E drejta për të pranuar ose dëbuar të huajt ka qenë konsideruar gjithmonë si një prejtributeve kryesore të sovranitetit shtetëror. Në këtë kuadër duhet thënë se Konventa nuk përmban ndonjë dispozitë që të rregullojë shprehimisht çështjet materiale të imigrimit ose të azilit. Protokollit 4 i saj ndalon vetëm dëbimin ose nxjerrjen jashtë të shtetasve nga shteti shtetësinë e të cilit ata kanë. Referencat e tjera të vetme që mund të gjenden në lidhje me kontrollin e imigracionit kanë të bëjnë me garancitë procedurale të ë parashikuara në nenet 5 § 1 (f) dhe 5 § 4 në lidhje me ndalimin, arrestimin, ose dëbimin kolektiv në kuadrin e nenit 4 të Protokollit 4 si dhe garancitë procedurale për rezidentët e ligjshëm të parashikuara në nenin 1 të Protokollit 7. Jurisprudenca e Gjykatës ka zhvilluar në këtë drejtim, gjithashtu, edhe doktrina në lidhje me nenin 3 të Konventës.

20. Ky vendim rithekson rëndësinë që Konventa i jep mbrojtjes së individëve nga arbitrariteti shtetëror. Gjykata i referohet këtij momenti disa herë në vendimin e saj; ajo kritikon përdorimin e një dredhie për t'i sjellë personat e dëmtuar në rajonin e policisë; kritikon mjetet ankimore që u ishin vënë në dispozicion kërkuësve duke vënë në dukje se rishikimi i vendimit ishte kufizuar vetëm në ligjshmërinë e ndalimit dhe nuk kishte marrë në shqyrtim edhe karakterin proporcional të kësaj mase; Gjykata vuri në dukje gjithashtu mungesën e garancive procedurale që duhet të ishin ofruar në mënyrë që rrethanat personale të çdo individi të ishin marrë siç duhej parasysh.

21. Qëndrimi i mbajtur nga ana e Gjykatës në lidhje me nenin 5 § 2 është më i vështirë për t'u ndjekur. Gjykata kujtoi që në vendimin e saj të 30 gushtit 1990 në lidhje me çështjen *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ajo kishte konstatuar se qëllimi i nenit 5 § 2 ishte që t'i mundësonte një individ të kundërshtonte ligjshmërinë e masës së heqjes së lirisë ndaj tij. Duke hedhur poshtë pretendimin paraprak të Qeverisë për mos-shterim të mjeteve të brendshme në lidhje me nenin 5 § 1, Gjykata shprehu qartë konstatimin e saj se rrethanat e krijuara nga ana e autoriteteve nuk u jepnin kërkuesve një mundësi reale për t'i përdorur këto mjete. I vetmi element procedural që ata menduan se ishte në përputhje me nenin 5 ishte informacioni që u ishte dhënë kërkuesve mbi shkaqet për heqjen e lirisë së tyre. Ndërsa informacioni në lidhje me mjetet që këta mund të përdornin, mungonte.

22. Vendimi që po komentojmë është i pari në të cilin Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 4 të Protokollit 4. Gjykata nxjerr në pah pesë faktorë që e çuan atë në këtë përfundim. Në çdo vlerësim të ardhshëm në lidhje me pretendime për shkelje të kësaj dispozite, duhen marrë pra parasysh këto pesë faktorë janë respektuar apo jo.

23. Së fundmi, Gjykata bëri një deklaram të rëndësishëm në lidhje me nenin 13 duke vënë në dukje se "kërkesat e tij marrin formën e një garancie dhe jo vetëm të një shpalljeje synimesh apo të një rregullimi praktik."

## LOULED MASSOUD kundër MALTËS

(kërkesa nr. 24340/08)

27 korrik 2010

*ndalimi i paligjshëm i një shtetasi algjerian në Maltë*

### 1. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, z. Louled Massoud, ishte shtetas algjerian i lindur në 1960.

2. z. Louled Massoud kishte hyrë në Maltë nga Libia, me anije, në qershor të vitit 2006. Ai nuk kishte asnjë dokument me vete dhe u dërgua menjëherë në ambientet e policisë. Më pas ai u akuzua dhe u shpall fajtor nga Gjykata e Magjistratëve me akuzën se kishte ndihmuar persona të tjerë për të hyrë në Maltë. Ai u dënua me tetëmbëdhjetë muaj burg.

3. Më 17 prill 2007, ndërkohë që ishte në burg, kërkuesi aplikoi për azil dhe u intervistua në të njëjtën ditë. Pasi shleu dënimin dhe u lirua më 27 qershor 2007, z. Louled Massoud u vendos në një qendër ku mbaheshin personat në

pritje të vendimit në lidhje me të kërkesën e tyre për azil. Kërkesa e tij për azil ishte refuzuar më 24 prill 2007. Ai e kundërshtoi këtë vendim por ankesa e tij u hodh poshtë, me argumentin se nuk kishte paraqitur dëshmi bindëse që do të përballej me rrezikun real të persekutimit, nëse kthehej në vendin e tij.

4. z. Louled Massoud qëndroi i ndaluar, në pritje të dëbimit, sipas politikës së emigracionit të qeverisë, deri më 6 janar 2009, kur urdhri i tij largimi u shfuqizua duke pasur parasysh pamundësinë e dëbimit të tij eventual. Kërkuesi u ankua se kushtet në ambientet ku ishte mbajtur i ndaluar kishin qenë të papërshtatshme, të mbipopulluara, jo higjienike, me kujdes të kufizuar mjekësor, pa mundësi për aktivitete konstruktive dhe me mundësi të kufizuara rekreative.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. z. Louled Massoud pretendoi se ishte trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese si pasojë e kushteve në të cilat mbahej i ndaluar, në shkelje të nenit 3 të Konventës. Ai deklaroi se, sistemi ligjor maltez, nuk kishte vënë në dispozicion të tij asnjë mjet ligjor të shpejtë dhe efikas, në kundërshtim me nenin 5 § 4. Më tej, kërkuesi u ankua se ndalimi i tij pas marrjes së vendimit në lidhje me kërkesën e tij për azil kishte qenë arbitrar dhe i paligjshëm, në shkelje të nenit 5 § 1. Së fundmi, z. Louled Massoud pohoi se, pasi ishte arrestuar në mbërritje, pas një udhëtimi të gjatë në det, ishte mbajtur i ndaluar pa u informuar rreth bazës ligjore dhe faktike, siç kërkohet nga neni 5 § 2 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 3

6. Kërkesa nuk u pranua pasi nuk ishin shteruar mjetet e brendshme ligjore, duke qenë se kërkuesi nuk kishte ngritur padi në lidhje me pretendimet sipas nenit 3 në gjykatat e brendshme kombëtare.

### B. Në lidhje me nenin 5 § 4

7. Gjykata vlerësoi efektivitetin e çdo mjeti ekzistuese ligjor sipas së drejtës së brendshme malteze.

8. Në radhë të parë, Gjykata vërejti se, në bazë të nenit 409A të Kodit Penal, gjykatat të cilat kishin kompetencë për shqyrtimin e kërkesave i kishin të kufizuara këto kompetenca. Në veçanti, ata nuk mund të shqyrtonin rrethanat e tjera të cilat e bënë ndalimin të paligjshëm, të tilla si papajtueshmëria me të drejtat e mbrojtura nga Konventë, parimet e përgjithshme të mishëruara në të, dhe qëllimin e kufizimeve të nenit 5 § 1. Rrjedhimisht, Gjykata hodhi poshtë argumentin e Qeverisë se kërkuesi duhet t'i kishte përdorur këto mjete ligjore.

9. Gjykata më tej mori në analizë të drejtën e ankimit përpara Bordit të Ankesave për Migracionin (BAM). Ai vuri në dukje se dispozitat ligjore përkatëse e kufizonin lirimimin nga paraburgimi në rastet kur identiteti i të paraburgosurit ishte verifikuar. Për më tepër, duke pasur parasysh se këto procedura zgjatën të

paktën një muaj dhe se mund të zgjasnin tre muaj ose më shumë, Gjykata theksoi se ka pasur raste që vendimi nuk ishte dhënë akoma ndërkohë që personi ishte liruar, duke e bërë këtë procedurë pa ndonjë efekt ligjor në praktikë. Kështu, procedurat para BAM-it nuk mund të konsideroheshin se përmbushin kërkesat e një afati të shkurtër shqyrtimi, siç kërkohet nga neni 5 § 4.

10. Së fundi, përsa i përket ankimit kushtetues, Gjykata u shpreh se këto procedura ishin komplekse për qëllimet e neni 5 § 4 dhe paraqitja e një kërkesë në kushtetuese nuk garantonte një rishikim të shpejtë të ligjshmërinë së ndalimit të kërkuarit.

11. Në përfundim, Gjykata u shpreh se z. Louled Massoud nuk kishte pasur në dispozicion të tij një mjet ligjor efektiv dhe të shpejtë, të parashikuar në të drejtën e brendshme për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tij. Për këtë arsye, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 5 § 4.

### *C. Në lidhje me nenin 5 § 1*

12. Periudha e ndalimit, për qëllimet të kërkesës, llogaritej nga 27 qershori i vitit 2007, data kur kërkuari ishte vendosur në një qendër ndalimi, në pritje të shqyrtimit të kërkesës së tij për azil, deri në 6 janar 2009, kur ai u lirua. Pra, ajo zgjati tetëmbëdhjetë muaj dhe nëntë ditë. Gjykata duhet të vlerësojë nëse kjo ishte e tepërt dhe nëse autoritetet e kishin kryer procedurën e dëbimit me kujdesin e duhur.

13. Vonesa, pavarësisht se nuk ishte aq problematike sa në raste të tjera, nuk ka ardhur për shkak pritjes së vendimit të gjykatave, pasi vendimi në lidhje me kërkesën e tij për azil ishte marrë para ndalimit të tij. Edhe duke pasur parasysh se kërkuari ishte pa dokumente, Gjykata konstatoi se Qeveria nuk e kishte ndjekur çështjen aktivisht dhe nuk kishte hyrë në negociata me autoritetet algjeriane për të përshpejtuar dërgimin e një dokumenti identiteti. Për më tepër, ishte e pamundur që autoritetet të mos kishin në dispozicion asnjë masë tjetër për të ndërmarrë përveç ndalimit të zgjatur të kërkuarit për të siguruar dëbimin e tij të mundshëm, në mungesë të një perspektive të afërt të dëbimit të tij.

14. Në dritën e sa më sipër, Gjykata dyshonte se arsyet e ndalimit të kërkuarit - veprimet e ndërmarra me qëllim dëbimin e tij sipas nenit 5 § 1 (f) - kishin mbetur të vlefshme për të gjithë periudhën e ndalimit të tij, edhe pas refuzimit të kërkesës së tij për azil, për shkak të mungesës të një perspektive reale të dëbimit të tij dhe dështimit të mundshëm të autoriteteve për të ndjekur procedurën me kujdesin e duhur.

15. Më tej, Gjykata vlerësoi nëse ndalimi ishte i ligjshëm sipas të drejtës së brendshme, pra nëse ishte "në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj" dhe nëse kishte garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit.



16. Ligji për emigracionin nuk vendoste kufizime kohore për ndalimet dhe kërkuesi ishte mbajtur i ndaluar për një periudhë të pakufizuar. Kështu, garancitë procedurale ishin vendimtare, megjithatë Gjykata kishte vendosur tashmë se, z. Louled Massoud nuk kishte pasur asnjë mjet ligjor efektiv në dispozicion, për të kundërshtuar ligjshmërinë dhe kohëzgjatjen e ndalimit të tij. Ajo vazhdoi më tej duke konstatuar se sistemi ligjor maltez, nuk parashikonte një procedurë që të mund të shmangte ndalimet arbitrare në pritje të dëbimit.

17. Gjykata arriti në përfundimin se sistemi kombëtar dështoi në detyrimin e tij për të mbrojtur kërkuesin nga ndalimi arbitrar dhe ky ndalim nuk kishte qenë "i ligjshëm" për qëllimet e nenit 5.

18. Rrjedhimisht, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

#### **D. Në lidhje me nenin 5 § 2**

19. Gjykata vendosi mos pranimin e pretendimeve të kërkuesit sipas nenin 5 § 2, për arsye të mosrespektimit të afatit kohor prej gjashtë muajsh.

#### **E. Në lidhje me nenin 41**

20. Gjykata i akordoi kërkuesit 12 000 euro në lidhje me dëmin jo material.

### **III. Koment**

21. Ky është një vendim shumë i rëndësishëm në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit të azilkërkuesve dhe shqyrtimin e masave të ndalimit në nivel kombëtar.

22. Gjykata shqyrtoi së pari pretendimet e kërkuesit sipas nenit 5 § 4 të Konventës, i cili parashikon se "*Çdo person, të cilit i është hequr liria [...], ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm*". Gjykata i analizoi një nga një të gjitha kundërshtimet e Qeverisë Malteze për sa i përket ekzistencës së mjeteve ligjore efektive për shqyrtimin e ligjshmërisë së ndalimit të kërkuesit. Gjykata u shpreh se këto mjete ligjore ose kishin objekt të kufizuar, për qëllimet e nenit 5 § 1 të Konventës - si në rastin e mjetit ligjor të parashikuar nga neni 409A i Kodit Penal - ose nuk ofronin një zgjidhje të shpejtë apo ishin të komplikuar për të bërë një shqyrtim brenda një afati të shkurtër në bazë të nenit 5 § 4 - siç ishte rasti i ankesës para Bordit të Ankesave për Migracionin dhe ankimi kushtetues. Duke iu referuar gjetjeve të saj të mëparshme, në lidhje me rastet e Maltës<sup>285</sup>, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës.

23. Më pas, Gjykata mori në shqyrtim çështjen e ligjshmërisë së ndalimit të z.

<sup>285</sup> Shih *Sabeur Ben Ali k. Maltës*, vendim i datës 29 qershor 2000, nr. 35892/97, dhe *Kadem k. Maltës*, vendim i datës 9 janar të vitit 2003, nr. 55263/00.

Louled Massoud, si azilkërkues, në bazë të nenit 5 § 1 të Konventës. Gjykata konstatoi se, pasi shleu dënimin dhe u lirua, kërkuesi u ndalua përsëri në pritje të përgjigjes të kërkesës së tij për azil. Gjykata arriti në përfundimin se mbajtja në paraburgim e një azilkërkuesi për më shumë se 18 muaj, ndërkohë që kërkesa e tij për azil dhe kundërshtimi i refuzimit të azilit, ishin rrëzuar të dyja, dhe nuk kishte asnjë perspektivë që kërkuesi të largohej, nuk mund të justifikohet për qëllimet e nenit 5 § 1 (f) të Konventës. Gjykata vuri në dukje se periudha e ndalimit të kërkuesit në këtë rast kishte qenë më e shkurtër se në raste të tjera që ajo kishte gjykuar<sup>286</sup>, megjithatë ajo vendosi se autoritetet malteze nuk kishin marrë hapat e duhura për lirin e kërkuesit, pasi kishin marrë vesh se ishte i pamundur dëbimi i tij në Algjeri<sup>287</sup>. Kështu, ky vendim e bën të qartë se, ndalimi "në një procedurë dëbimi" mund të justifikohet vetëm për atë kohë sa ekziston një mundësi realiste për dëbimin e personit. Kur bëhet e qartë se dëbimi ishte i pamundur për arsye të ndryshme, ndalimi nuk është më në përputhje me nenin 5 § 1 (f)<sup>288</sup>.

## LAZOROVSKI kundër ISH-REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

(kërkesa nr. 4922/04)

8 tetor 2009

*mbajtje e paligjshme në polici*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Jovče Lazoroski, është një shtetas i FYROM-it i lindur në vitin 1973 dhe që jeton në Kičevo.

2. Më 6 gusht 2003, një oficer i lartë në Shërbimin Inteligjent dha një urdhër me shkrim për arrestimin e kërkuesit mbi dyshimet se ai ishte i armatosur dhe se mund të arratiset nga Shteti. Në orën 23.15 të së njëjtës ditë, z. Lazoroski u arrestua nga policia pranë Tabanovces, një pike kufitare me Serbinë. Ai u dërgua në stacionin e policisë të Tabanovces, ku u mbajt në gjendje arresti deri në orën 9 të mëngjesit të ditës pasardhëse.

286 Iu referua vendimit në çështjen *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, [Dhoma e Madhe] vendim i 15 nëntorit 1996, nr. 22414/93, gjithashtu i përfshirë në këtë kapitull, dhe *Raza k. Bullgarisë*, vendim i 11 shkurtit 2010, nr. 31465/08.

287 Krahaso me vendimin në çështjen *Ali k. Zvicrës*, i 5 gushtit 1998, nr. 24881/94, ku u vendos se kishte pasur shkelje dhe me *Eid k. Italisë*, vendim i 22 janarit 2002, nr. 53490/99, ku e njëjta periudhë prej 18 muajsh nuk u konsiderua në shkelje të nenit 5 (1) të Konventës.

288 Shih gjithashtu vendimin e GJDBE-së, të 15 shkurtit 2016, C-601/15, *J.N. k. Staatssecretaris van Veiligheid en Justitie*, ku Gjykata e Luksemburg përsëriti se Direktiva për Kushtet e Pritjes nuk e shpërfill nivelin e mbrojtjes të garantuar nga neni 5(1)f i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili lejon arrestimin e një personi, ndaj të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi.

3. Gjatë natës së kaluar në gjendje arresti, kërkuesi firmosi një raport ku ai refuzonte të drejtën e tij për t'u përfaqësuar nga një avokat. Edhe pse nuk ka asnjë dokument ku të jetë regjistruar ndonjë seancë marrjesh në pyetje, z. Lazoroski pretendoi se ai u pyet në lidhje me disa anëtarë të partisë së atëhershme opozitare dhe me disa gazetarë të mirënjohur.

4. Më 7 gusht 2003, z. Lazoroski e kundërshtoi ligjshmërinë e arrestimit të tij përpara Ministrisë së Brendshme dhe përpara një gjyqtari hetues në Gjykatën e Shkallës së Parë së Kumanovës. Më 26 janar 2005, gjyqtari hetues arriti në përfundimin se atij i ishte hequr në mënyrë të paligjshme liria mbi dyshimet për trafik armësh. Apelimi i zotit Lazoroski u hodh poshtë në shkurt 2005.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Mbështetur veçanërisht në nenet 5 §§ 1, 2 dhe 3 dhe mbi nenin 6 § 1, z. Lazoroski u ankua se atë e kishin arrestuar në mënyrë të paligjshme, se nuk ishte informuar për arsyet e arrestimit të tij, se avokati i tij nuk ishte lejuar të merrte pjesë në seancën e marrjes së tij në pyetje, se arrestimi ishte kryer pa një urdhër gjykatë dhe se ai nuk kishte pasur mundësi të merrte pjesë në mënyrë efektive në procedimet që kundërshtonin ligjshmërinë e arrestimit të tij, si edhe se këto procedime kishin qenë tepër të gjata.

### A. Në lidhje me nenin 5

6. Gjykata vuri re se autoritetet e brendshme gjyqësore nuk kishin dhënë fare informacion mbi kundravajtjen për të cilën dyshohej zoti Lazoroski dhe as ndonjë provë që të vërtetonte përfshirjen e tij. Duke parë se nuk kishte asnjë dëshmi që të sugjeronte se ai ishte përfshirë në trafikun e armëve, Gjykata vendosi se mbajtja e tij në gjendje arresti nuk ishte bazuar mbi dyshime të arsyeshme dhe për rrjedhojë kishte qenë e pajustificuar, një shkelje kjo e nenit 5 § 1 (c).

7. Për më tepër, asnjë prej raporteve të parashtruara nga Qeveria nuk tregonte se kërkuesi ishte informuar për arsyet e arrestimit të tij. Asnjë raport nuk ishte përpiluar në lidhje me marrjen e tij në pyetje teksa ishte në gjendje arresti dhe nuk kishte pasur asnjë provë tjetër që zotit Lazoroski i qenë shpjeguar arsyet për arrestimin e tij. Për këtë arsye, Gjykata vendosi se kishte pasur një shkelje të nenit 5 § 2.

### B. Në lidhje me nenin 6

8. Në përfundim, për sa i përket pretendimit të zotit Lazoroski se ai nuk mundi të merrte pjesë në procedime, Gjykata vuri re se provat e paraqitura nga Ministria e Drejtësisë tek gjyqtari hetues, i cili do të vendoste mbi ligjshmërinë e mbajtjes në gjendje arresti, nuk i qenë treguar zotit Lazoroski. Për më tepër, ai nuk ishte ftuar për të marrë pjesë në seancën dëgjimore përpara gjyqtarit, që kishte vendosur mbi pretendimin e tij. Në këtë drejtim ankesat e tij u lanë pa përgjigje në apel. Për pasojë, Gjykata vendosi që zotit Lazoroski e kishin shmangur nga pjesëmarrja efektive në procedime, një shkelje kjo e nenit 6 § 1.

9. Gjykata konsideroi se procedimet përpara gjyqtarit hetues në lidhje me ligjshmërinë e mbajtjes së kërkuesit në gjendje arresti, gjë që kishte zgjatur një vit e gjysmë, nuk kishte qenë shumë e gjatë duke qenë se nuk kishte pasur nevojë për nxitim, meqë z. Lazoroski e kishin liruar përpara se të depozitonte padinë e tij.

10. Gjykata vendosi që ankesat e mbetura ishin të papranueshme dhe për rrjedhojë duheshin hedhur poshtë.

### *C. Në lidhje me nenin 41*

11. Gjykata i caktoi kërkuesit 2 000 euro për dëm jopasuror dhe 180 euro për kostot dhe shpenzimet.

### **III. Komenti**

12. Në këtë vendim, Gjykata nënvizon edhe një herë rëndësinë e masave mbrojtëse të ofruara nga neni 5 i Konventës. Heqja e lirisë është një shkelje e rëndë e të drejtave të një njeriu dhe është thelbësore, që Shtetet të përmbushin detyrimet e tyre për të mbrojtur të drejtat themelore në këtë kontekst. Sipas nenit 5, duhet të ketë një “dyshim të arsyeshëm” në mënyrë që heqja e lirisë të jetë në përputhje me Konventën. Kjo, siç është bërë e qartë nga Gjykata, presupozon ekzistencën e fakteve ose informacionit që do të bindte një vëzhgues të pavarur që personi mund ta ketë kryer kundravajtjen. Edhe pse këto fakte nuk kanë pse të jenë të të njëjtit nivel me ato, që janë të nevojshme për të justifikuar dënimin, në çështjen në fjalë Qeveria kishte dështuar në gjetjen e ndonjë prove se kërkuesi kishte qenë i përfshirë në trafikun e armëve dhe prandaj kishte pasur një shkelje të nenit 5 § 1, c. Gjykata shtoi se për shkak se vetë kërkuesit nuk i qenë treguar arsytet për arrestimin e tij, kjo përbënte një shkelje të nenit 5 § 2.

13. Kërkuesi u ankua gjithashtu se atij i ishte mohuar aksesimi tek avokati. Megjithatë ishte e qartë se ai kishte firmosur për lënien e kësaj të drejte në rajonin e policisë dhe meqë ai nuk kishte paraqitur asnjë dëshmi se e kishte bërë këtë nën detyrim, kjo ankesë u deklarua e papranueshme.

14. Megjithatë Gjykata gjeti gjithashtu dy shkelje të nenit 6, meqë kërkuesi nuk kishte qenë në gjendje të komentonte dhe të kundërshtonte provat e paraqitura nga Ministria gjatë procedimeve, në mënyrë që të kundërshtonte ligjshmërinë e mbajtjes në gjendje arresti dhe meqë procedimet, të cilat përfshinin një periudhë tremujore gjatë së cilës gjyqtari hetues ishte me leje shëndetësore, kishte qenë më e gjatë se afatet e arsyeshme.

## ASSENOV kundër BULLGARISË

(kërkesa nr. 24760/94)

28 tetor 1998

*pretendimi për keq-trajtim të bërë nga policia si dhe gjatë periudhës së paraburgimit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, z. Anton Assenov, znj. Fidanka Ivanova dhe z. Stefan Ivanov ishin një familje cigane me shtetësi bullgare. Kërkesat e tyre lidheshin pothuajse tërësisht me ndalimin e z. Anton Assenov, kërkuesit të parë.

2. Më 19 shtator 1992, ndërkohë që po luante kumar në sheshin e qytetit Shoumen, z. Assenov u ndalua nga një polic dhe u shoqërua në stacionin më të afërt të autobusit. Ai u lëshua më vonë. Më 21 shtator kërkuesi bëri një vizitë mjekësore dhe i shpjegoi mjekut se ai dhe e ëma, që është edhe kërkuesja e dytë, ishin keqtrajtuar nga tre policë. Mjeku lëshoi disa certifikata mjekësore në të cilat përshkruante në mënyrë të hollësishme dëmtimet që kishin pësuar të dy kërkuesit. Mjeku arrinte në përfundimin se dëmtimet ishin shkaktuar nga rrahjet që policët u kishin bërë kërkuesve me shkopinj. Kërkuesit bënë një ankim në stacionin lokal të policisë në lidhje me këtë keqtrajtim të policisë. Nisur nga ky ankim filloi një hetim nga një zyrtar i policisë lokale, hetim i cili arriti në përfundimin se nuk kishte prova se policët i kishin rrahur kërkuesit dhe se për këtë arsye nuk mund të ngriheshin akuza penale kundër tyre. Zyrtari i policisë pranoi versionin e policëve në lidhje me ngjarjen, sipas të cilit babai i kërkuesit të parë e kishte rrahur atë dhe jo policët. Kërkuesit e apeluan këtë vendim po pa pasur sukses.

3. Më 1994 dhe 1995, autoritetet e prokurorisë së Shoumen-it hapën një sërë hetimesh paraprake dhe procedimesh penale në lidhje me rastet që kishin të bënin me vjedhje dhe grabitje të personave. Kërkuesi i parë i rastit në fjalë u arrestua dhe u ngarkua me përgjegjësi penale për një numër veprash penale që kishin të bënin me vjedhje peliçesh, televizorësh dhe sendesh të tjera. Hetuesi që merrej me dosjen e tij vendosi që ta ndalojë z. Assenov. Hetimi vazhdoi dhe u bënë edhe pyetje dëshmitarësh si dhe kontrole të identitetit dhe të personalitetit të kërkuesit. Megjithatë dukej se nuk kishte më arsye për të vazhduar hetimet sepse që pas shtatorit 1995 nuk kishte pasur më mbledhje provash. Kërkuesi i parë, avokati i tij, si dhe prindërit e tij paraqitën përpara organeve të prokurorisë kërkesa të vazhdueshme për lirimin e z. Assenov. Kërkesat parashtronin pretendime të gjendjes shëndetësore të z. Assenov dhe sidomos të gjendjes

së zembrës. Kërkuesi i parë u vizitua në burg nga disa mjekë të cilët arritën në përfundimin se ai nuk vuante nga zemra. Më tej kërkuesi i parë u ankua, ndër të tjera, që ka pasur një persekutim kundër tij për shkak se ai kishte bërë kërkesë pranë Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut në lidhje me incidentin e parë. Kërkesat për lirim ishin refuzuar që të gjitha megjithëse z. Assenov ishte transferuar nga një stacion policie në një qendër riedukimi për të miturit. Kërkuesi i parë ankohej në vijim në lidhje me kushtet në të cilat ai ishte mbajtur gjatë qëndrimit të tij në burg dhe në veçanti në lidhje me mungesën e lehtësive për ushtrimin e besimit fetar dhe për përmasat dhe kushtet e qelisë së tij.

4. Kërkuesi paraqiti një kërkesë pranë Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut duke pretenduar për secilin prej rasteve shkelje të nenit 3 dhe, në lidhje me ngjarjet e vitit 1992 shkelje të neneve 3, 6 dhe 13 të Konventës, kurse në lidhje me ngjarjet e vitit 1995 shkelje të nenit 5 të Konventës.

5. Komisioni arriti në përfundimin se në asnjërin prej rasteve nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës dhe të nenit 6 në lidhje me ngjarjet e vitit 1992. Megjithatë ai shprehu mendimin se ka pasur shkelje të nenit 3 në bashkëpunim me nenin 13 të Konventës në lidhje me ngjarjet e vitit 1992 dhe shkelje të nenit 5 të Konventës në lidhje me ngjarjet e vitit 1995.

## II. Vendimi i Gjykatës

- *Në lidhje me ngjarjet gjatë dhe pas 19 shtatorit 1992*
- i. Prapësimet paraprake*

6. Qeveria ngrinte pretendimin se kërkuesit nuk kishin shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore për të rivënë në vend të drejtën e shkelur të tij me anë të padisë civile për shpërblimin e dëmit që ai ka pësuar. Qeveria mendonte gjithashtu se ka pasur abuzim të së drejtës për ankim nga ana e kërkuesit.

7. Në lidhje me këtë pikë, Gjykata mendon se kërkuesi, duke qenë se ka shteruar të gjitha rrugët e mundshme në sistemin penal të drejtësisë dhe pa arritur në ndjekjen penale të oficerëve të policisë që pretendon ta kenë keqtrajtuar atë, nuk ka kërkuar të rivërë në vend gjendjen e tij me anë të një padie civile për shpërblim dëmi. Për këtë arsye, sipas Gjykatës nuk ka kuptim që të pranohet prapësimi i ngritur nga ana e qeverisë. Gjykata gjithashtu hodhi poshtë njëzëri edhe pretendimin tjetër paraprak të qeverisë për abuzim të së drejtës për ankim pasi përpara saj nuk u paraqitën prova që të vërtetonin një abuzim të tillë nga ana e kërkuesit.

- ii. Në lidhje me thelbin e çështjes.*

### **A. Në lidhje me nenin 3**

8. Është e pamundur për Gjykatën që në bazë të provave që i janë servirur asaj, të konstatojë nëse dëmet kërkuesit i janë shkaktuar nga ana e policisë apo jo. Fakti që incidenti kishte ndodhur më shumë se dy vjet e gjysmë më parë ishte e



pamundur që të vlerësohej nëse ishte kërkuesi apo ishin policët që tregonin të vërtetën. Nga ana tjetër, edhe raporti mjekësor ndihmonte pak për shkak se ai ishte lëshuar dy ditë pas incidentit. Për pasojë ishte e pamundur për Gjykatën të konstatonte shkelje në lidhje me pretendimin e keq trajtimeve nga ana e policisë (*tetë vota kundër një*).

### **B. Në lidhje me nenin 6 § 1**

9. Kërkuesi pretendonte se çdo padi civile e bërë nga ana e tij në lidhje me keqtrajtimin e pretenduar nga ana e policisë do të ishte deklaruar e papranueshme në përputhje me nenin 182 (d) të Kodit të Procedurës Civile - megjithatë jurisprudenca që iu servir Gjykatës nxirrte në pah që gjykatat civile nuk janë të lidhura nga vendimi i autoriteteve të prokurorisë për të mbyllur hetimin penal. Nga ana tjetër, kërkuesit pretendonin se kishte shkelje në lidhje me mënyrën se si autoritetet e prokurorisë i kishin trajtuar kallëzimet e tyre. Në lidhje me këtë çështje Gjykata është e mendimit se këto procedura nuk kishin të bënin as me përcaktimin e të drejtave me karakter civil të kërkuesit dhe as me akuzë penale kundër tyre dhe prandaj nuk hyjnë në fushën e zbatimit të nenit 6. Si përfundim Gjykata vendosi që nuk kemi të bëjmë me shkelje të nenit 6 të Konventës.

### **C. Në lidhje me nenin 13**

10. Në rastet kur një individ ngre një pretendim të argumentuar se ka qenë keq trajtuar dhe se për këtë fakt kemi të bëjmë me shkelje të nenit 3, përveç hetimit të hollësishëm dhe efektiv të kërkuar gjithashtu nga neni 3, hyn në lojë edhe nocioni i mjetit efektiv, si mundësi efektive e ankuesit për të përfituar nga procedurat hetimore dhe të arrijë që të ketë edhe pagimin e kompensimit në rastet kur ky mendohet si i përshtatshëm. Pra dispozita e nenit 3 të Konventës e interpretuar së bashku me nenin 13 kërkon për pasojë që duhet të ketë një hetim zyrtar efektiv.

11. Kërkuesi nuk kishte pasur mundësinë e një ankimi efektiv sipas kuptimit të nenit 13 të Konventës në lidhje me pretendimet e tij qoftë me karakter penal qoftë me karakter civil kundër policisë. Një sërë faktorësh, ndërmjet të cilëve mungesa e një mundësie apelimi ndaj refuzimit për të filluar ndjekjen penale kundër oficerëve të policisë dhe mungesa e një hetimi të pavarur në lidhje me ankimet e kërkuesve, bëjnë që të arrihet në një përfundim të tillë. Mundësia e një ankimi me karakter civil për shkak të dëmi do të kishte qenë sidoqoftë një mundësi e papërshtatshme për shkak se në vetvete nuk do të mund të kishte shmangur shkeljen e pretenduar të nenit 3 të Konventës. Si përfundim, gjykata arriti të konstatojë se ka pasur shkelje të bazuar në mos kryerjen e një hetimi zyrtar efektiv.

- *Në lidhje me ngjarjet gjatë dhe pas korrikut 1995*  
*i. pretendimet paraprake*

12. Qeveria ngrinte edhe një herë pretendimin se kërkuesit nuk kishin shteruar të gjitha mjetet të brendshme ligjore për të rivënë në vend të drejtën e shkelur.

Përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut u vërtetua se kërkuesi u kishte bërë autoriteteve të ndjekjes penale dhe Gjykatës së Rrethit të Shoumen-it disa kërkesa për ta liruar. Pra si përfundim, prapësimi i ngritur nga ana e qeverisë nuk u pranua.

*ii. Në lidhje me themelin e çështjes*

**A. Në lidhje me nenin 3**

13. Gjykata mund të marrë në shqyrtim nën dritën e nenit 3 kërkesat e bëra në lidhje me kushtet e ndalimit të ngritura në përputhje me nenin 5 § 1 - dhe në këtë plan kushtet duhen marrë në konsideratë prej saj si një tërësi. Kjo konsideratë nuk arriti në konkluzionin se kushtet ishin aq të këqija sa të binin në nivelin e zbatimit të nenit 3. Për këtë arsye, Gjykata arriti në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me shkelje të nenit 3 të Konventës (*tetë vota kundër një*).

**B. Në lidhje me nenin 5 § 1**

14. Kërkuesi ishte ndaluar për shkak të një dyshimi për kryerjen e një vepre penale, dyshim i cili u vlerësua si i arsyeshëm. Për këtë arsye, nuk pati prova të një ndalimi të paligjshëm sipas së drejtës bullgare. Kjo e fundit e parashikonte plotësisht ndalimin për veprat për të cilat z. Assenov akuzohej. Mbështetur në këto rrethana Gjykata njëzëri arriti në përfundimin se nuk ka shkelje të këtij paragrafi në nenit 5.

**C. Në lidhje me nenin 5 § 3**

15 Në lidhje me aspektin e parë të paragrafit 3 të nenit 5 të Konventës që parashikon të drejtën për t'u çuar menjëherë përpara një gjykatësi ose «një magjistrati tjetër», Gjykata konstatoi se kërkuesi ishte çuar përpara një hetuesi, vendimet e të cilit do të mund të anuloheshin nga një prokuror, i cili nuk është aq i pavarur sa duhet. Ky fakt i fundit, sipas mendimit të Gjykatës, bën që kjo të vendosë për një shkelje në këtë rast të nenit 5 § 3.

16. Në lidhje me aspektin e dytë të paragrafit 3 të nenit 5, pra të drejtën e kërkuesit për t'ju drejtuar gjykatës brenda një afati të arsyeshëm ose për t'u gjykuar në gjendje të lirë, vihet re se kërkuesi ishte mbajtur në gjendje paraburgimi për një periudhë prej afro dy vjetësh. Autoritetet shtetërore nuk provuan nga ana tjetër që të ekzistonte një frikë për kryerjen e përsëritur të veprave penale nga ana e kërkuesit. Doli në pah se për rreth një vit, nga shtatori 1995 deri në shtator 1996, asnjë veprim nuk ishte marrë në lidhje me hetimin, gjë që të çon në arsyetimin se autoritetet shtetërore nuk kishin vepruar me devotshmërinë e duhur. Prandaj edhe Gjykata arriti njëzëri në përfundimin se kemi të bëjmë me shkelje të nenit 5 § 3.

**D. Në lidhje me nenin 5 § 4**

17. Në lidhje me nenin 5 § 4 të Konventës vihet re se kërkuesi, përveçse në një rast, nuk kishte qenë në gjendje që, përpara një gjykate, të pretendonte vlerësimin e ligjshmërisë së paraburgimit të tij. Edhe në këtë rast nuk kishte pasur vend një

procedurë me gojë para gjykatës ku kërkuesi të mund të shprehte pretendimet e tij. Kështu, Gjykata arrin në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës. Nga ana tjetër, në lidhje me afatin i cili sipas Konventës duhet të jetë i shkurtër, shihet se z. Assenov e ka pasur mundësinë të kontaktojë personalisht me një autoritet gjyqësor kompetent dhe të pavarur, sipas kuptimit të Konventës, i cili të mund të vlerësonte apo rishikonte ligjshmërinë e masës që ishte marrë ndaj tij vetëm më 6 shkurt 1997. Pra rreth 19 muaj pas ndalimit të tij.

#### ***E. Në lidhje me nenin 25 § 1***

18. Dy prej kërkuesve ishin pyetur nga ana e autoriteteve hetimore në lidhje me kërkesat përpara Komisionit në mënyrë të tillë që t'i bënte ata që të mohonin me anë të një deklaratë me betim bërjen e çdo aplikimi. Nga ana tjetër, aplikimet përfshinin pretendime serioze në lidhje me keqtrajtme nga ana e të njëjtave autoritete, dhe gjatë periudhës së pyetjeve kërkuesi i parë ishte mbajtur në gjendje arresti nën kontrollin e autoriteteve të ndjekjes penale. Në të gjitha këto raste, pyetjet arrinin deri në presione të papërshtatshme sa mund të vlerësoheshin si përpjekje për të frenuar ose ndëshkuar mos heqjen dorë nga kërkesat. Gjykata për këto arsye arriti në përfundimin se kemi të bëjmë me shkelje të nenit 25 të Konventës.

#### ***F. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)***

19. Pavarësisht nga kundërshtimet e qeverisë, duke mbajtur parasysh tërësinë e shkeljeve të Konventës nga të cilat kishin vuajtur kërkuesit, Gjykata iu akordoi atyre një shumë prej 6 000 000 levash bullgare si shpërblim për dëm jo-material. Për shpenzimet dhe pagesat ajo iu akordoi kërkuesve 14 860 sterlina për avokatët bullgarë dhe 7 800 sterlina për avokatët britanikë, të dy këto shuma të shtuara me përqindje vjetore respektive prej 5.08% dhe 7.5%<sup>289</sup>. Këto shuma iu duheshin paguar kërkuesve nga qeveria bullgare brenda tre muajsh nga dhënia e këtij vendimi.

### **III. Koment**

20. Vendimi i Gjykatës në lidhje me çështjen Assenov konfirmon përfundimisht qëndrimin e Gjykatës në lidhje me natyrën e autoritetit që duhet të vendosë në lidhje me lirinë e personit, i cili sipas nenit 5 § 3 të Konventës duhet çuar menjëherë përpara një "një gjykatësi ose një magjistrati tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore" i cili duhet të vendosë në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit të tij.

21. Kujtojmë se në një vendim të vitit 1979, në lidhje me çështjen *Schiesser kundër Zvicrës* Gjykata kishte vendosur se një prokuror rrethi, i cili kishte vendosur për arrestin me burg të kërkuesit por që nuk kishte përfaqësuar akuzën në procesin kundër tij, konsiderohej si një magjistrat tjetër i autorizuar me ligj për

289 Sipas normave të interesit përkatësisht në Bullgari dhe Britani.

kryerjen e funksioneve gjyqësore për qëllimet e nenit 5 § 3 të Konventës, duke mos konstatuar shkelje të këtij neni. Gjykata e ndryshoi qëndrimin e saj në lidhje me këtë pikë për herë të parë në një çështje tjetër kundër Zvicrës në vitin 1990, në lidhje me znj. Huber, ku Gjykata vendosi se prokurori i rrethit të Zyrihut nuk përbënte për qëllimet e nenit 5 § 3 një magjistrat të autorizuar nga ligji për ushtrimin e pushteteve gjyqësore, përderisa ai mund të merrte pjesë në procesin penal ndaj kërkueses.

22. Në çështjen Assenov, Gjykata jo vetëm që e konfirmoi përfundimisht këtë qëndrim por u ndal në mënyrë specifike edhe në vetë nivelin e pavarësisë së hetuesit, vendimet e të cilit për më tepër mund të shfuqizoheshin nga ana e prokurorit. Që prej atëherë sistemi bullgar ka ndryshuar dhe vendimet për masën e arrestit, të cilat tani merren nga një gjykatë. Qëndrimin e mbajtur në çështjen Assenov Gjykata e çoi më tej në vendimin e saj në lidhje me çështjen *Neidbala kundër Polonisë*<sup>290</sup> ku vendosi se në qoftë se vendimet për masën e sigurimit merren nga prokurori duhet të ketë një rishikim gjyqësor automatik për të shmangur shkeljen e Konventës.

## MILOŠEVIĆ kundër SERBISË

(kërkesa nr. 31320/05)

28 prill 2009

*kërkesa për kontroll gjyqësor mbi ndalimin sipas KEDNJ-së*

### I. Fakte kryesore

1. Kërkuesi Slaviša Milošević ishte shtetas i Shtetit Federativ të Serbisë dhe Malit të Zi ku ai depozitoi aplikimin e tij përpara Gjykatës. Ai lindi në 1972 dhe jeton në Beograd.

2. Në dhjetor të vitit 1999, një investigim gjyqësor u hap në lidhje me z. Milošević në lidhje me dyshimin që ai kishte kryer një sërë vjedhjesh. Në janar të vitit 2000, pretendimet e z. Milošević nuk i ishin bërë të ditura gjykatës dhe gjyqtari lëshoi një urdhër ndalimi për një periudhë prej deri në një muaj. Në prill të vitit 2005 një gjyqtar u caktua prej gjykatës për të përfaqësuar z. Milošević në procedimet kundrejt tij.

3. z. Milošević u arrestua në 20 janar të vitit 2005, në bazë të mandatit të gjykatës së janarit 2001 dhe u çua në burgun e rrajonit në Beograd. Pasi bëri një përpjekje të pasuksesshme për të kontaktuar avokatët e kërkuesit, gjykata i caktoi atij një avokat tjetër.

290 Vendim i 4 korrikut 2000

4. Më 27 janar të vitit 2005, z. Milošević u dëgjua nga një gjykatës në prezencë të avokatit të tij. Ai mohoi të gjitha akuzat dhe theksoi qartësisht se ai nuk do të apelonte kundër ndalimit të tij. Në 4 shkurt të vitit 2005, ndalimi i tij u zgjat prej gjykatës pa e dëgjuar më parë atë ose avokatin e tij personalisht. z. Milošević apelooi kundër këtij shtimi të periudhës së ndalimit të tij e cila u hodh poshtë prej gjykatës, sërish në prani të tij dhe të avokatit të tij.

5. Në maj të vitit 2005 z. Milošević u gjet fajtor, dhe u dënua me një vit e dy muaj me burg. Gjykata liroi atë nga ndalimi gjatë periudhës që ai priste apelin e çështjes së tij.

## II. Vendimi i Gjykatës

6. Duke u bazuar në nenin 5 § 3 dhe nenin 2 të Protokollit 4, z. Milošević u ankua se nuk kishte qenë çuar në mënyrën e duhur përpara një gjyqtari me fuqinë për të urdhëruar lirimin e tij prej ndalimit si rrjedhojë e së cilës liria e tij e lëvizjes është përguar në mënyrë të panevojshme.

### A. Në lidhje me nenin 5 § 3

7. Gjykata vërejt se ankesa e z. Milošević kishte lidhje me një deficiencë të vazhdueshme në legjislacionin e brendshëm përkatës, Kodin e Procedimeve Kriminale dhe në mënyrën sesi ai interpretohej nga gjykatat e brendshme dhe në mënyrën sesi ai i aplikohej çështjes së tij. Në veçanti z. Milošević ose avokati i tij nuk kishin patur të drejtën eksplicite që të dëgjohehin personalisht prej gjykatave të brendshme ose të ishin present kur u konsiderua apeli kundër vendimit për ndalimin e tij prej një gjykate më të lartë. Po kështu gjykatësi që dëgjoi z. Milošević në 27 janar të vitit 2005 nuk kishte obligim sipas ligjit të brendshëm për të rishikuar ndalimin e tij ose fuqinë që të urdhëronte në mënyrë të pavarur lirimin e tij.

8. Gjykata ritheksoi se çdo individ nën arrest ka të drejtën që t'i ushtrohet një kontrolli gjyqësor në mënyrën e duhur dhe prej një gjykatësi të autorizuar nga ligji i cili mund të urdhërojë lirimin e tyre ndërsa ata presin vendim. z. Milošević nuk u soll personalisht përpara një gjykatësi i cili ka detyrimin të rishikojë dhe fuqinë të urdhërojë lirimin e tij derisa, minimalisht, në më shumë se 41 ditë prej arrestimit të tij. Si rrjedhojë këtu ka një shkelje të nenit 5 § 3.

### B. Në lidhje me nenin 2 Protokollit 4

9. Gjykata vendosi se, sipas gjetjeve të saj lidhur me nenin 5 § 3 nuk ishte e nevojshme të ekzaminohej ankimi i z. Milošević sipas këtij neni.

### C. Në lidhje me nenin 41

10. Gjykata i dha kërkesit 3 000 euro lidhur me dëmet jo material dhe 500 euro për kostot dhe shpenzimet.

### III. Koment

11. Një individ i cili arrestohet sipas ligjit ose ndalohet me dyshimin se ka kryer një ofensë kriminale duhet, sipas nenit 5 § 3 të Konventës të mbrohet prej një kontrolli të caktuar gjyqësor. Ky kontroll duhet të kënaqë kërkesat për kohën e duhur, duhet të jetë “automatik” që do të thotë se nuk duhet të jetë i varur prej një aplikimi të mëparshëm nga personi përkatës, dhe i ndaluar duhet të silltë personalisht përpara “një gjykatësie ose oficerëve të tjerë të autorizuar nga ligji” për të vendosur për lirin e tij ose të saj kur pret vendimin. Ndërsa ndalimi fillestar u urdhërua prej një gjykate të brendshme kjo nuk parashikon aplikimin në vazhdim të “kriterit të kohës së duhur” nëse përshembull mbrojtësi nuk u dëgjua gjatë konsiderimit të masës së tij të ndalimit.

12. Në rastin konkret Gjykata analizoi me detaje provizionet e Kodit Serb të Procedimeve Kriminale dhe konsideroi se si këto provizione dhe aplikimet e tyre në praktikë çojnë në dhunimin e nenit 5 § 3. Gjykata nuk urdhëroi ndonjë masë të përgjithshme si amendamente të ligjit actual por ky mund të jetë një hap i kujdesshëm për Serbinë në mënyrë që ajo të mos kryejë dhunime në çështje të tilla në të ardhmen.

## BROGAN DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesat nr. 11209/84;11234/84;11266/84; 11386/85)

**29 nëntor 1988**

*zbatimi i kriterëve procedurale të arrestimit dhe zgjatjes së periudhës së ndalimit në kushtet e një situatë të rënduar nga aktet terroriste*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, z. Terence Brogan, z. Dermot Coyle, z. William McFadden dhe z. Michael Tracey, janë qytetarë britanikë, me banim në Irlandën e Veriut.

2. Në vjeshtën e vitit 1984 ata u arrestuan në bazë të nenit 12 të Ligjit të vitit 1984 “Për Parandalimin e Terrorizmit” (dispozita të përkohshme) sipas dyshimeve të arsyeshme se ata merreshin me kryerjen, përgatitjen ose nxitjen e akteve terroriste të lidhura me ngjarjet në Irlandën e Veriut. “Terrorizmi” përkufizohet në Ligjin e vitit 1984 si “përdorimi i forcës për qëllime politike”, duke përfshirë “përdorimin e dhunës me qëllim për të frikësuar publikun ose një pjesë të tij”. Në secilën çështje, periudha fillestare e paraburgimit prej dyzetetë orësh e lejuar nga legjislacioni u zgjat me një vendim të Sekretarit të Shtetit për Irlandën e Veriut. Kërkuesit ishin mbajtur respektivisht për periudha prej pesë ditë e njëmbëdhjetë orë, gjashtë ditë e gjashtëmbëdhjetë orë e gjysmë, katër ditë e



gjashtë orë, dhe katër ditë e njëmbëdhjetë orë. Të katërt ishin pyetur për incidente konkrete me karakter terrorist, por asnjëri prej tyre nuk u akuzua apo dërgua përpara një autoriteti gjyqësor deri në momentin e lirimit të tyre.

3. Situata e emergjencës në Irlandën e Veriut në vitet 1970 dhe niveli i pranishëm i akteve terroriste formonin rrethanat e miratimit në vitin 1974 të legjislacionit fillestar që parashikonte kompetencat speciale kundër terrorizmit mbi bazën e të cilave kërkuesit ishin arrestuar dhe paraburgosur. Që nga miratimi i kompetencave speciale, nevoja për vazhdimësinë e tyre ka qenë vëzhguar në mënyrë konstante nga Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar dhe zbatimi i tyre ka qenë rregullisht i shqyrtuar nga personalitete të pavarura. Autorët e këtyre rishikimeve arritën në përfundimin, midis të tjerash, se duke pasur parasysh problemet përbërëse të parandalimit dhe hetimit të terrorizmit, përdorimi i vazhdueshëm i kompetencave speciale të arrestit dhe paraburgimit ishte i domosdoshëm. Sugjerimi sipas të cilit vendimet që zgjasnin periudhën e paraburgimit duhet të merreshin nga gjykatat u hodh poshtë, sepse informimi rreth këtyre vendimeve ishte tepër i prekshëm dhe nuk mund t'i njoftohej personave të burgosur ose përfaqësuesve të tyre ligjorë.

4. Të katër kërkesat iu paraqitën Komisionit midis tetorit të vitit 1984 dhe shkurtit 1985. Komisioni urdhëroi bashkimin e tyre më 10 korrik 1986 dhe të nesërmen i deklaroi të pranueshme. Në raportin e tij të 14 majit 1987, Komisioni arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 5 në çështjet e z. Brogan dhe z. Coyle, por jo në çështjet e z. McFadden dhe z. Tracey; se nuk ka pasur shkelje të paragrafëve 1 dhe 4 të nenit 5; dhe së fundi se asnjë problem tjetër nuk lindi në bazë të nenit 13. Çështja iu paraqit Gjykatës nga Komisioni më 15 korrik 1987 dhe nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar më 3 gusht 1987.

## II. Vendimi i Gjykatës

### *Hapësira e kompetencës së Gjykatës për të vendosur*

6. Kërkuesit donin të shtonin një kërkesë në bazë të nenit 5 § 2 (e drejta e individit për t'u informuar menjëherë për arsyet e arrestimit të tij) të cilën ata e kishin tërhequr gjatë fazës së pranueshmërisë përpara Komisionit. Gjykata vërejti se pas tërheqjes së kërkesës, Komisioni kishte ndërprerë shqyrtimin e pranueshmërisë së saj në lidhje me nenin 5 § 2. Në këto kushte, pa pasur një vendim pranueshmërie në lidhje me këtë aspekt, pretendimi i shkeljes së nenit 5 § 2 nuk mund të merrej në shqyrtim.

### *A. Vlerësime të përgjithshme*

7. Gjykata pasi kishte konstatuar një rritje të akteve terroriste në shoqëritë moderne, njohu nevojën, e cila është edhe pjesë përbërëse e sistemit të Konventës, për një ekuilibër të duhur midis mbrojtjes së institucioneve demokratike në interesin e përbashkët dhe mbrojtjes të të drejtave të individëve. Në këto procedura nuk u ngrit çështja e shqyrtimit nëse, derogimet nga detyrimet e

Mbretërisë së Bashkuar, që rridhnin nga Konventa, mund të lejoheshin në bazë të nenit 15, për shkak të ekzistencës së një fushate terroriste në Irlandën e Veriut. Megjithatë, ky problem nuk pengoi vlerësimin e duhur të rrethanave të çështjes.

### **B. Në lidhje me nenin 5 § 1**

8. Kërkuesit pretendonin se heqja e lirisë së tyre në bazë të seksionit 12 të Ligjit të vitit 1984 nuk përputhej me nenin 5 § 1 (c), përderisa ata nuk ishin arrestuar mbi dyshimin e kryerjes së një “vepre penale”, dhe se qëllimi i arrestimit të tyre nuk kishte qenë për t’i dërguar ata përpara autoritetit kompetent.

9. Ligji i vitit 1984 në të vërtetë, nuk kërkon që arresti të bazohet mbi dyshimin e kryerjes së një vepre penale të përcaktuar, por mbi dyshimin e pjesëmarrjes në “akte terrorizmi”. Sidoqoftë, sipas këndvështrimit të Gjykatës, përcaktimi ligjor i “terrorizmit” përputhet më së miri me nocionin e “veprës penale” të parashikuar nga Konventa. Për më tepër, çdo kërkues është marrë në pyetje për disa orë gjatë arrestit për dyshimin mbi pjesëmarrjen e tij në vepra penale specifike.

10. Në bazë të argumentit të dytë të kërkuesve, sipas të cilit ata as nuk ishin akuzuar as dërguar përpara një gjykate, ekzistenca e një qëllimi të duhur duhej të merrej si i pavarur nga realizimi i tij. Ndoshta ishte e pamundur të mblidhje prova të mjaftueshme ose, duke pasur parasysh natyrën e veprave penale për të cilat akuzoheshin, t’i sillje përpara gjykatësit pa vënë në rrezik jetën e tjetrit. Asgjë nuk të bën të mendosh se heqja e lirisë së tyre nuk kishte si qëllim plotësimin e hetimeve të policisë për të konfirmuar ose zhdukur dyshimet konkrete që justifikonin ndalimin e tyre.

11. Si rrjedhim, kushtet e një ndalimi dhe heqje lirie të drejtë të parashikuar nga neni 5 § 1 (c) qenë plotësuar në çështjet e kërkuesve. Pra nuk ka pasur shkelje të nenit 5 § 1.

### **C. Në lidhje me nenin 5 § 3**

12. Kërkuesit pretendonin gjithashtu se ishin privuar nga e drejta për t’u dërguar përpara një gjyqtari ose magjistrati tjetër kur ishin nën mbikëqyrjen e policisë. Në përputhje me nenin 5 § 3, në qoftë se personi nuk është liruar, ai ka të drejtë të paraqitet menjëherë përpara gjyqtarit. Sipas Gjykatës, termi “*promptly*” kuptohet sikur lejon një hapësirë fare të vogël fleksibiliteti, po atë që konfirmon termi në frëngjisht “*aussitot*” që do të thotë menjëherë. Në qoftë se shpejtësia vlerësohet sipas kushteve të veçanta të çdo çështjeje, rëndësia që i akordohet atyre nuk mund të shkojë deri aty sa të shkelë në thelb të drejtën e garantuar nga neni 5 § 3, pra që ta lirojë shtetin nga detyra e dërgimit të menjëhershëm të personit të ndaluar përpara një autoriteti gjyqësor.

13. Duke iu rikthyer fakteve, Gjykata pranoi se hetimi mbi veprat penale i vendos autoritetet e Irlandës së Veriut përpara disa problemeve të veçanta. Ajo merr gjithashtu parasysh, garancitë e kontrollit të ministrive, mbikëqyrjen konstante

për nevojën e legjislacionit nga Parlamenti dhe shqyrtimin e rregullt të zbatimit të tij nga personalitete të pavarura. Konteksti i terrorizmit në Irlandën e Veriut ka për qëllim të zgjasë periudhën e mbikëqyrjes policore përpara se i arrestuari të çohet përpara një gjykate ose një magjistrati tjetër. Për më tepër, vështirësia e kontrollit gjyqësor të vendimit të arrestimit ose paraburgimit të terroristit të dyshuar, mund të kërkojë kujdes të veçantë procedural. Megjithatë, sipas këndvështrimit të Gjykatës, edhe koha më e shkurtër nga të katër periudhat, pra katër ditët dhe gjashtë orët e mbikëqyrjes policore të z. McFadden, i tejkalon kufizimet e lejuara nga termi “menjëherë”. Në qoftë se do t'i konsideronim karakteristikat e çështjes të një rëndësie të veçantë për të justifikuar një mbikëqyrje policore kaq të gjatë pa ballafaquar personin me gjykatësin ose me një magjistrat tjetër, do të arrinim në pasoja në thelb të kundërta me të drejtën për një shqyrtim gjyqësor të menjëhershëm, të garantuar nga neni 5 § 3. Pra ky nen është shkelur.

#### *D. Në lidhje me nenin 5 § 4*

14. Neni 5 § 4 i garantonte kërkuesve të drejtën për të bërë një ankim në gjykatë, i cili lejon shqyrtimin e kërkesave mbi aktet procedurale dhe mbi themelin, të nevojshëm për “ligjshmërinë” e heqjes së lirisë së tyre, sipas kuptimit të nenit 5 § 1 (c). Sipas Gjykatës së Strasburgut e drejta për t'u ankuar përpara një gjykate mund t'i lejonte juridiksioneve gjyqësore të Irlandës së Veriut verifikimin në të njëjtën kohë të vëzhgimit të rregullave procedurale të ligjit të vitit 1984, të karakterit të arsyeshëm të dyshimeve që justifikonin ndalimin si dhe legjitimitetin e qëllimit të ndjekur nga ky i fundit, dhe më pas të mbikëqyrjes policore (arrestimit). Megjithatë, kërkuesit kishin vendosur të mos e mbështesnin këtë pretendim. Pra neni 5 § 4 nuk ishte shkelur.

#### *E. Në lidhje me nenin 5 § 5*

15. Në kundërshtim me qeverinë Britanike, Gjykata vlerësoi se e drejta e dëmshpërblimit e garantuar nga neni 5 § 5 nuk ka të bëjë vetëm me rastet e një privimi lirie të parregullt ose arbitrar sipas së drejtës së brendshme. Teksti i nenit 5 § 5 flet për arrestim ose burgim “që bien ndesh me dispozitat e këtij neni”. Por shkelja e nenit 5 § 3 e konstatuar nga Gjykata, nuk mundej as nuk mundet, edhe pas këtij vendimi, t'i lërë vend kërkesave për dëmshpërblim të viktimave përpara gjykatave vendase; qeveria nuk e kundërshtonte këtë. Pra edhe neni 5 § 5 është shkelur.

#### *F. Në lidhje me nenin 13*

16. Duke qenë se Gjykata arriti në përfundimin se neni 5 § 4 nuk qe shkelur, ajo nuk e vlerësoi të nevojshëm shqyrtimin e çështjes në bazën e nenit 13.

#### *G. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)*

17. Në bazë të nenit 50, kërkuesit nuk pretendonin për një rimbursim të shpenzimeve dhe pagesave, por kërkonin një dëmshpërblim të madh për riparimin e dëmit të pësuar. Meqenëse kjo çështje nuk ishte gati për gjykim, Gjykata e shtyu atë për më vonë.

18. Duke qenë se vendimi i vitit 1988 ishte përfundimtar, Gjykata nuk mund të merrte parasysh kërkesa të tjera mbi rimbursimin e shpenzimeve dhe të pagesave të bëra gjatë procedurës së ndjekur përpara institucioneve të Strasburgut. Ajo nuk përjashtoi faktin se shkelja e nenit 5 § 3 t'i ketë shkaktuar një dëm moral viktimave. Por në vendimin e saj të 30 majit 1989 ajo çmoi se vendimi i vitit 1988 përbën në vetvete një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm.

### III. Koment

19. Vendimi në lidhje me këtë çështje sqaron disa elementë, që edhe për arsye të situatave të ndryshme faktike Gjykata nuk kishte mundur t'i sqaronte në çështjen e saj *Lawless kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>291</sup>. Vendimi sqaron në mënyrë të veçantë një element me mjaft rëndësi në kuadrin e nenit 5 të Konventës – kohëzgjatjen e mbajtjes së një personi nga policia deri në paraqitjen e tij përpara një gjyqtari ose magjistrati tjetër që ushtron funksione gjyqësore sipas ligjit. Siç e përmendim edhe në komentet e vendimeve të tjera të Gjykatës të përfshira në këtë përmbledhje<sup>292</sup>, çështja e zbatimit të Konventës dhe e respektimit të të drejtave të njohura prej saj në kushtet e luftës kundër terrorizmit përbën një moment delikat qoftë për shtetet e interesuara qoftë edhe për mekanizmin e kontrollit të Konventës.

20. Në fakt përgjigja britanike ndaj vendimit Brogan ishte derogimi ndaj nenit 5 § 3 të Konventës në bazë të nenit 15 të saj, në lidhje me situatën e emergjencës që ekzistonte në Irlandën e Veriut për shkak të akteve terroriste. Megjithëse Mbretëria e Bashkuar disa here me radhë kishte bërë derogime në bazë të nenit 15, asnjë prej tyre nuk vepronte në lidhje me faktet e çështjes Brogan dhe prandaj ajo u konsiderua përgjegjëse për shkelje të nenit 5 § 3.

21. Sidoqoftë me rëndësi është të theksohet *obiter-i* i Gjykatës sipas së cilit pavarësisht nga kushtet, të emergjencës kombëtare, të terrorizmit apo çfarëdo qoftë, në qoftë se nuk është bërë derogim në bazë të nenit 15 të Konventës, të drejtat e njohura dhe të garantuara prej kësaj nuk mund të zhvishen nga çdo lloj kuptimi për shkak të paaftësisë, pamundësisë apo vështirësive të autoriteteve shtetërore për t'i zbatuar ato. Natyrisht që parimet e hapësirës së vlerësimit dhe të proporcionalitetit do të luajnë gjithmonë një rol në vlerësimin e Gjykatës por gjithsesi nuk mund të shkohet deri aty sa të drejtat të dhunohen deri në thelbin e tyre<sup>293</sup>.

291 Vendim i 1 korrikut 1961, i përfshirë në këtë botim.

292 Konkretisht vendimin e 1 korrikut 1961 në lidhje me çështjen *Lawless kundër Mbretërisë së Bashkuar* që paraprin në këtë botim, si dhe vendimin e 18 janarit 1978 në lidhje me çështjen *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* gjithashtu të përfshirë edhe në këtë botim.

293 Shih në këtë kuptim jo vetëm nenin 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë por edhe vendimet e Gjykatës të 26 majit 1993 në lidhje me çështjen *Brannigan dhe McBride kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe të 18 dhjetorit 1996 në lidhje me çështjen *Aksoy kundër Turqisë*.

## SHANNON kundër LETONISË

(kërkesa nr. 32214/03)

24 nëntor 2009

### *mbajtja në paraburgim e një kundravajtësi seksual*

#### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Lindsej Hjujxhs Shenon, është një shtetas i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i lindur në vitin 1955 dhe që aktualisht mendohet se jeton në Shtetet e Bashkuara.
2. Teksa ndodhej përkohësisht në Letoni, zoti Shenon u arrestua dhe u dërgua në paraburgim më 1 tetor 2002 me dyshimin se kishte ngacmuar seksualisht të mitur gjatë një udhëtimi të mëparshëm në Letoni. Dyshimet ndaj tij u mbështetën mbi deklaratat e katër viktimave dhe dëshminë e një dëshmitari, që nuk i dihet emri. Ai u akuzua zyrtarisht për ngacmim seksual më 31 tetor 2002.
3. Mbajtja e tij në paraburgim u zgjat për shkak të dy niveleve të juridiksionit në pesë raste (4 tetor 2002, 29 nëntor 2002, 30 janar, 31 mars dhe 30 maj 2003). Të gjitha apelimet e tij kundër urdhrave për ta mbajtur në paraburgim u refuzuan mbi bazën e besueshmërisë së dyshimeve kundër tij, seriozitetit të krimit për të cilin ishte akuzuar, faktit që ai nuk kishte leje qëndrimi dhe/ose rezidencë fikse në Letoni, rrezikut që ai mund të humbiste gjurmët dhe se ai mund të pengonte hetimet.
4. Në qershor 2003, prokurori e akuzoi gjithashtu kërkuesin se kishte ngacmuar seksualisht djem të rinj gjatë udhëtimeve të mëparshme në Letoni në korrik, gusht dhe shtator 2001. Akuzat rënduan nga ngacmim seksual në ngacmim të rëndë dhe me forcë, nënshtrim me forcë (sodomi) dhe shtyrje të të rinjve për të marrë pjesë në prostitucion dhe/ose prodhim pornografie.
5. z. Shenon u dënua për të gjitha akuzat në janar 2003 me pesë vite burg; më vonë atij iu rrëzuan akuzat për pornografi fëmijësh dhe dënimi u reduktua në katër vite burg.
6. I liruar me kusht më 10 korrik 2006, pasi kishte vuajtur tre të katërtat e dënimit, z. Shenon u dëbua nga Letonia tri ditë më vonë.

## II. Vendimi i Gjykatës

7. z. Shenon u ankua se mbajtja e tij në paraburgim gjatë procedimeve kundër tij kishte qenë e paligjshme dhe e pajustificuar, në shkellje të nenit 5 §§ 1 (c). Ai u ankua gjithashtu sipas nenit 5 § 4 mbi procedurën, me të cilën ishte detyruar të kundërshtonte ligjshmërinë e mbajtjes së tij në paraburgim, ndërsa depozitoi ankime të tjera sipas nenit 8.

### A. Në lidhje me nenin 5 § 1 (c)

8. Gjykata konsideroi se, edhe pse kërkuesi kishte qenë në gjendje të provonte se nuk kishte ndërmend të largohej nga Letonia nëse lirohej nga paraburgimi, dyshimi i arsyeshëm ndaj tij për kryerjen e një krimi, që me kalimin e kohës ishte mbështetur nga prova të reja, kishte qenë një arsye e mjaftueshme për ta mbajtur atë në paraburgim deri sa të dilte për gjykim dhe të merrte dënimin e tij. Për pasojë, Gjykata Evropiane vendosi se nuk kishte pasur asnjë shkellje të nenit 5 § 1 (c).

### B. Në lidhje me nenin 5 § 4

#### *Arsyetimi pas shtyrjeve të mbajtjes së kërkuesit në paraburgim*

9. Edhe pse arsyetimi i përdorur për të aplikuar dhe shtyrë mbajtjen e kërkuesit në paraburgim kishte qenë i përmbledhur dhe disi abstrakt për rrethanat specifike të çështjes së kërkuesit, pikërisht fakti se ai nuk kishte asnjë lidhje tjetër me territorin e Letonisë, ilegaliteti i statusit të rezidencës së tij mund të ishte marrë me të drejtë në konsideratë nga gjykatat kombëtare për të vendosur për mbajtjen e tij në paraburgim. Gjykata vendosi për rrjedhojë se nuk kishte pasur asnjë shkellje të nenit 5 § 4 në këtë drejtim.

#### *Shpejtësia e rishikimit të vendimit për mbajtjen në paraburgim të kërkuesit*

10. Në lidhje me vendimin e 29 nëntorit 2002, Gjykata vuri re se vonesa prej 89 ditësh për të marrë vendimin për apelimin e kërkuesit kundër mbajtjes së tij në paraburgim ishte shkaktuar kryesisht nga vendimi i gabuar i Gjykatës së Qendrës së Rrethit për t'ia kthyer apelimin vetë kërkuesit për përkthim, prandaj vendosi që kishte pasur një shkellje të nenit 5 § 4.

11. Në lidhje me vendimin e 31 marsit 2003, Gjykata vendosi se vonesa prej një muaji e tetë ditësh nuk ishte shpjeguar nga autoritetet, prandaj kishte pasur një shkellje të nenit 5 § 4.

12. Vendimet e tjera mbi apelimet e kërkuesit kundër mbajtjes së tij në paraburgim ishin në përputhje me kërkesën për shpejtësinë e rishikimit sipas nenit 5 § 4.

### C. Në lidhje me nenin 8

13. Gjykata i konsideroi këto ankime si të papranueshme ose se e kishte marrë në shqyrtim çështjen, ose sepse kërkuesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet ankimore të vëna në dispozicion nga ligji leton.



**D. Në lidhje me nenin 41**

14. Gjykata vendosi, se gjetja e një shkeljeje përbënte në vetvete dëmshpërblim të drejtë për çdo dëm jopasuror të pësuar nga kërkuesi.

**III. Komenti**

15. Siç kemi nënvizuar në shumë raste në këtë Buletin, neni 5 i Konventës përcakton rëndësinë e madhe të së drejtës për liri në një shoqëri demokratike. Gjykata Evropiane ka pasur gjithashtu shpesh mundësinë, për të shpjeguar se qëllimi i përgjithshëm i nenit 5 është që të sigurojë se askujt nuk i mohohet liria në mënyrë arbitrare.

16. Çështja në fjalë kishte lidhje me situatën e mbajtjes në paraburgim të një shtetasi të huaj, që dyshohej për kundravajtje penale në një Shtet Palë. Edhe pse nuk u gjend asnjë shkelje e nenit 5 § 1 – ekzistonte një “dyshim i arsyeshëm” kundër kërkuesit – Gjykata e shqyrtoi gjithashtu rastin sipas nenit 5 § 4.

17. Teksa vihej në diskutim arsyetimi i gjykatave të brendshme për zgjatjen e mbajtjes në paraburgim të kërkuesit, Gjykata vuri re se ishte përdorur si pikë referimi fakti që ai nuk kishte as një leje të vlefshme qëndrimi në Letoni dhe as vendbanim. Kjo përkrahte dyshimin se ekzistonte rreziku që ai mund të humbiste gjurmët dhe arsyetimi i gjykatave të brendshme ishte në përputhje me Konventën. Megjithatë, meqenëse kishte pasur një sërë vonesash gjatë procedimeve të cilat vinin dukshëm për shkak të autoriteteve, u gjend një shkelje e nenit 5 § 4.

18. Si përfundim, kjo çështje shërben si rikujtim për rëndësinë që ka për kërkuesit dhe avokatët paraqitja e dokumenteve mbështetëse, për të vërtetuar pretendimet për kostot dhe shpenzimet në rast se gjenden një apo më shumë shkelje të Konventës. Meqenëse në çështjen Shannon kundër Letonisë nuk ndodhi kështu, Gjykata nuk caktoi asnjë shumë të këtij lloji.

## CAMPBELL DHE FELL kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 7819/77;7878/77)

28 qershor 1984

*ky vendim përveç sqarimit të disa koncepteve themelore të nenit 6 në kuadrin e procesit penal, pohon parimin se e drejta e Konventës që i mohohet një të burgosuri është vetëm ajo e lirisë dhe jo, vetëm për këtë shkak, edhe të drejtat e tjera të njohura prej saj*

### I. Faktet kryesore

1. Në nëntor 1973, z. Campbell dhe Ati Fell u dënuan për një numër shkeljesh respektivisht me dhjetë dhe dymbëdhjetë vjet burg. Gjatë kësaj kohe ata ishin të klasifikuar në një kategori sigurie të veçantë të ashtuquajtur kategoria A.
2. Më 16 shtator 1976, një incident ndodhi në burgun e Albany. Oficerët e burgut ndërhyjnë për t'i dhënë fund një proteste të bërë nga gjashtë të burgosur, përfshirë këtu kërkuesit, të cilët mbetën të plagosur ashtu si edhe disa anëtarë të personelit. Kërkuesit u akuzuan për shkelje të rregullores së burgut; në procedurën përpara Bordit të Vizitorëve, ata u deklaruan fajtorë dhe u ndëshkuan edhe me heqje të së drejtës për të përfitur nga ulja e dënimit e cila akordohej për sjellje të mirë.
3. Në shtator dhe nëntor 1976, respektivisht, Ati Fell dhe z. Campbell i kërkuan Ministrin të Brendshëm leje për të kërkuar ndihmë ligjore për procedurat civile lidhur me incidentin dhe plagosjen e tyre. Sipas praktikave të zbatueshme në atë kohë, atyre iu refuzohej leja derisa të plotësohej një hetim i brendshëm mbi plagosjen e tyre (deri në shtator për Ati Fell dhe deri në dhjetor për z. Campbell).
4. Kërkesat e bëra nga kërkuesit pas incidentit për një kontroll mjekësor të pavarur u refuzuan gjithashtu nga autoritetet. Bazuar në rregulloren e burgut dhe të praktikës, lehtësira për kontrole të tilla nuk akordohen në rastin e një të burgosuri, përveçse po të jetë palë në një procedurë ligjore.
5. Pasi iu dha leja për të kontaktuar avokatin e tij, Ati Fell nuk u lejua të këshillohej me të pa praninë e një oficeri të burgut deri më 12 maj 1977; në këtë datë "pa përgjim" iu hap rruga për të paraqitur kërkesën e tij Komisionit.
6. Gjatë kohës që ishte nën mbikëqyrje, Ati Fell i nënshtrohej kufizimeve në korrespondencën e tij, sipas rregullores së burgut dhe praktikave të zbatueshme për të burgosurit që ndodheshin në kategorinë e sigurimit. Në mënyrë të veçantë ai ankohej për ndalimin e korrespondencës me dy murgesha, Motrat Power dhe Benedict.

7. Prej kohës së ngjarjeve që çuan në këtë çështje, sistemi i zbatueshëm në Angli dhe Uells për korrespondencën dhe vizitat e të burgosurve kishte pësuar ndryshime thelbësore, sidomos përsa i përket identitetit të personave me të cilët të burgosurit mund të komunikojnë, momentit kur këshillat ligjore për procedurat civile mund të merren dhe kushteve të vizitave nga këshilltarë ligjorë.

8. Në dy kërkesat drejtuar Komisionit më 1977. z. Campbell dhe Ati Fell pretendonin ndërmjet të tjerash, se ata ishin dënuar nga Bordi i Vizitorëve të burgut për akuza disiplinore të cilat i shtoheshin në thelb akuzave "penale", pa një gjykim që plotësonte kërkesat e nenit 6, nuk iu ishte akorduar një afat për të marrë këshilla ligjore gjë që përbënte shkelje të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, të garantuar nga neni 6, dhe të drejtës së respektimit të korrespondencës së tyre, të garantuar nga neni 8 i Konventës. Ata ankoheshin gjithashtu se refuzimi për të lejuar një kontroll mjekësor të pavarur përbënte një tjetër shkelje të të drejtave të tyre bazuar mbi nenin 6. Ati Fell gjithashtu pretendonte se refuzimi për t'iu këshilluar vetëm për vetëm me avokatin e tij përbënte një shkelje të neneve 6 dhe 8, se refuzimi për t'iu lejuar atij të kishte korrespondencë me disa individë çonte në një shkelje të nenit 8 dhe se atij nuk iu sigurua një ankim efektiv për pretendimet që kishte, gjë që përbënte një shkelje të nenit 13.

9. Në vendimet e 6 majit 1978, 9 tetorit 1980 dhe 14 e 19 marsit 1981, Komisioni pranoi kërkesat; midis të tjerave, ankimi i Atit Fell bazuar mbi nenin 6 të Konventës, lidhur me procedurën e Bordit të vizitorëve, u deklarua i papranueshëm për shkak se rrugët e brendshme të ankimit nuk ishin shterur. Në vendimin e 19 marsit 1981, Komisioni urdhëroi bashkimin e dy kërkesave.

10. Në raportin e tij të 12 majit 1982, Komisioni shprehu mendimin e tij duke u shprehur se procedurat përpara Bordit të Vizitorëve në rastin e z. Campbell shkelnin të drejtën e tij të garantuar nga neni 6. Ai mbajti njëzëri qëndrimin se refuzimi për të lejuar dy kërkuesit të komunikonin me avokatët e tyre derisa të bëheshin hetime të brendshme shkelte nenin 6 §§ 1 dhe 8 por se refuzimi i një kontrolli mjekësor i pavarur nuk përbën shkelje të nenit 6 § 1. Ai mbajti gjithashtu njëzëri qëndrimin se refuzimi i konsultimit të Atit Fell me avokati e tij pa qenë i përgjuar nga një oficer burgu përbënte një shkelje të nenit 6 § 1 dhe se nuk ishte e nevojshme të merrej parasysh nëse shkelte apo jo nenin 8. ai u shpreh gjithashtu se refuzimi i komunikimit të Atit Fell me Motrat Power dhe Benedict përbënte shkelje të nenit 8. Po njëzëri, Komisioni pranoi se asnjë ankim efektiv nuk ishte i vlefshëm për Atin Fell në lidhje me ankesën e tij të bazuara mbi nenin 8, pra kishte shkelje e nenit 13 të Konventës. Komisioni ia paraqiti çështjen Gjykatës më 14 tetor 1982.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake

11. Së pari, Gjykata hodhi poshtë njëzëri një kërkesë të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar se ankimi i z. Campbell lidhur me procedurat e Bordit të Vizitorëve

ishte i papranueshëm për shkak se rrugët e ankimeve vendase përpara gjykatave angleze për rishikim gjyqësor nuk ishin shterrur. Gjithashtu, Gjykata vendosi unanimisht se ajo nuk ishte kompetente për të analizuar pretendimin e Atit Fell se kërkesa e tij lidhur me procedurat e Bordit ishte e pranueshme tanimë: vendimi i parë i Komisionit se ankimet nuk pranoheshin ishte përfundimtar.

***B. Në lidhje me nenin 6 § 1-Procedurat e Bordit të Vizitorëve në rastin e z. Campbell***

*a) mbi zbatueshmërinë e nenit 6 § 1 në rrethanat e kësaj çështje*

12. Duke iu referuar një rasti të mëparshëm, Gjykata rikujtoi se Konventa nuk ndalon Shtetet palë për të dalluar ligjin penal nga ai disiplinor; sidoqoftë ata nuk kanë liri të plotë për zbatimin e nenit 6 dhe 7 të Konventës, sepse përndryshe ajo do të varej nga dëshira e tyre e plotë. Këto parime gjenin zbatim, *mutatis mutandis*, edhe në një mjedis burgu, dhe si rrjedhim duhet të përcaktohet nëse procedurat kundër z. Campbell duhet të konsideroheshin si "penale" për qëllimet e Konventës. Në të drejtën angleze, shkeljet për të cilat z. Campbell është akuzuar (kryengritje dhe ushtrim dhune personale mbi një oficer burgu) i përkisnin ligjit disiplinor por natyra e tyre (serioziteti dhe ngjashmëritë e mundshme me të drejtën penale) i dha atyre një karakter që nuk përputhej plotësisht me një çështje të vërtetë disiplinore. Natyra dhe shkalla e rreptësisë së ndëshkimeve aktuale dhe potenciale (humbje thelbësore e së drejtës së faljes) ishin të tilla sa që ato duhet të konsideroheshin si "penale" për qëllimet e Konventës. Gjykata arriti në përfundimin me katër vota kundër tre, se neni 6 ishte i zbatueshëm në procedurat e Bordit të Vizitorëve.

*b) nëse Bordi i vizitorëve kishte tiparet e një gjykate*

13. z. Campbell pretendonte se procedurat e Bordit nuk i plotësonin kërkesat e nenit 6 në disa pika. Përfundimet e Gjykatës mbi këto kërkesa ishin si vijon:

- a. pasi vlerësoi rolin gjykues dhe kontrollues të Bordit, mënyrën dhe kohëzgjatjen e caktimit të anëtarëve të tij, Gjykata nuk pa asnjë arsye për të mos arritur në përfundimin se Bordi ishte një gjykatë "e pavarur";
- b. Bordi ishte gjithashtu një gjykatë "e paanshme": nuk kishte arsye për të dyshuar për paanshmërinë e anëtarëve të tij dhe nuk rezultoi se testet objektive të paanshmërisë të mos jenë përmbushur;
- c. fakti se Bordi nuk gjykoi në publik u justifikua nga arsyet e rregullit publik dhe problemet e sigurimit që do të lindnin nëse gjyqi i Bordit do të zhvillohej në publik dhe si rrjedhim nuk kishte shkelje të nenit 6;
- d. fakti se Bordi nuk e bëri publik vendimin e tij kishte shkelur nenin 6;
- e. pamundësia e z. Campbell për t'u këshilluar më parë me një avokat dhe për t'u përfaqësuar ligjërish në gjyqin e Bordit përbente një shkelje të nenit 6: Konventa kërkon, në veçanti, që një individ i akuzuar për shkelje penale, i cili nuk dëshiron të mbrojë vetveten duhet të jetë në gjendje t'i drejtohet asistencës ligjore sipas zgjedhjes së tij;
- f. këtu nuk u tregua se gjykimi i z. Campbell nuk ishte "i drejtë", se ai nuk u mirëinformua për akuzën e tij, se atij i ishin hequr disa të drejta të Konventës si ajo lidhur me dëshmitarët ose prezumimi i pafajësisë.

***Rruga e kërkuesit për ndihmë ligjore lidhur me kërkesat mbi plagosjet personale***

14. Duke u bazuar në një rast të mëparshëm, gjykata vendosi unanimitisht se afati për akordimin e një ndihme ligjore përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tyre për t'iu drejtuar gjykatës duke shkelur nenin 6 § 1 si dhe një ndërhyrje me të drejtën e respektimit të korrespondencës, e cila nuk ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike" dhe si rrjedhim shkelte nenin 8.

***Kushtet e vizitave të avokatit të Atit Fell***

15. Gjkata u pajtua njëzëri me vendimin e Komisionit se refuzimi për të lejuar Atin Fell për t'iu këshilluar me avokatin e tij në fshehtësi përbënte një ndërhyrje në të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, në shkelje të nenit 6 § 1, dhe se nuk ishte e nevojshme të merrej parasysh nëse ishte shkelur edhe neni 8.

***E drejta e kërkuesve për t'iu drejtuar një këshille mjekësore të pavarur***

16. Gjkata vendosi se nuk ishte e nevojshme për të analizuar këtë çështje, e cila nuk është përmendur nga kërkuesit përpara gjykatës.

***C. Në lidhje me nenin 8***

17. Në përputhje me jurisprudencën e saj të mëparshme<sup>294</sup>, Gjkata vendosi unanimitisht se ndalimi i Atit Fell për të komunikuar me disa individë përbënte një ndërhyrje në të drejtën e respektimit të korrespondencës së tij, e cila nuk ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike" dhe si rrjedhim ishte një shkelje e nenit 8.

***D. Në lidhje me nenin 13***

18. Gjkata analizoi çështjen nëse "ankimi efektiv" ishte i disponueshëm për Atin Fell në Mbretërinë e Bashkuar, lidhur me ankesën e tij për kufizimet e të drejtës për ndihmë ligjore dhe korrespondencën e tij. Ajo vlerësoi mundësitë e ndryshme për ankim (kërkesë Bordit të Vizitorëve ose Komisionarit Parlamentar për administrimin, institutit të procedurave të gjykatës, lutje Ministrisë së Brendshme) dhe, duke u mbështetur mbi faktet e çështjes si edhe mbi çështjet e mëparshme, arriti unanimitisht në përfundimin se nuk kishte pasur një ankim të tillë në lidhje me të drejtat e parashikuara nga neni 8. Pra si rrjedhim ka pasur shkelje të nenit 13.

***E. Në lidhje me ish nenin 50 (aktualisht neni 41)***

19. Kërkesat e bëra nga z. Campbell për dëm "të përgjithshëm" dhe "të veçantë" dhe nga Ati Fell për dëme "të përgjithshme" u hodhën poshtë nga Gjkata me arsyetimin se nuk kishte një lidhje shkakësore midis shkeljeve të vërejtura dhe dëmeve të pretenduara, ose se kërkuesit nuk treguan se ata kishin pësuar dëme, ose se një shpërblim i drejtë ishte parashikuar nga konstatimi i shkeljes.

20. Nga ana tjetër, Gjkata unanimitisht vendosi se kërkuesve duhet t'ju akordohej një shumë për pagesat dhe shpenzimet në lidhje me procedurat e Strasburgut.

<sup>294</sup> Sidomos vendimin e Gjykatës se 21 shkurtit 1975 në lidhje me çështjen Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar të 21 shkurtit 1975.

Pasi bëri disa zbritje të shumës që ata kërkonin, ajo caktoi shumën që Mbretëria e Bashkuar duhet t'u paguante, e cila ishte 13 000 sterlina.

### III. Koment

21. Me këtë vendim që mori në shqyrtim disa aspekte të nenit 6 të Konventës si dhe nenin 8 të saj Gjykata u has me vështirësi të konsiderueshme në dallimin e dispozitave dhe sanksioneve me karakter disiplinor nga ato me karakter penal në kushtet e burgut. Ndarja e Gjykatës në një shumicë tepër të ngushtë në lidhje me këtë pikë e vërteton këtë vështirësi<sup>295</sup>. Me rëndësi është të theksohet se edhe në këtë çështje del në pah parimi i konceptimit autonom të termave dhe nocioneve të Konventës, pasi Gjykata arrin të quajë penale dhe t'i përfshijë në veprimin e nenit 6 edhe masa që sipas së drejtës britanike konsideroheshin normalisht si disiplinore në kushtet e burgut<sup>296</sup>. Duket pra me këtë vendim Gjykata shkon më tej se vendimi i saj në lidhje me çështjen Engel, duke aplikuar të njëjtat kritere dhe duke arritur të njëjtat rezultate në lidhje me zbatimin e nenit 6 këtë herë në kushte më të vështira se ato të repartit ushtarak – në kushtet e burgut<sup>297</sup>.

22. Në këtë çështje Gjykata u mor gjithashtu me konceptet e gjykatës së pavarur dhe të paanshme. Në paragrafët 75 deri 102 të vendimit Gjykata analizoi me kujdes jo vetëm tiparet strukturore të Bordit të Vizitorëve për qëllimet e konsiderimit të tij si gjykatë, por sidomos garancitë procedurale që një organ duhet të plotësojë për t'u konsideruar gjykatë për qëllimet e nenit 6.

23. Vendimi bën një kombinim tepër interesant të elementëve të nenit 6 me elementë të nenit 8 të Konventës. Duke arritur në përfundimin se në lidhje me disa elementë të nenit 8 ka pasur shkelje edhe në kushtet e burgut për Atin Fell, Gjykata na përsërit konkluzionin e arritur në çështjen *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* – që të burgosurve ju hiqet vetëm liria por kjo nuk do të thotë që iu hiqen edhe të drejtat e tjera të njohura nga Konventa të cilat mund të respektohen edhe në kushtet e burgut. E tillë është e drejta për korrespondencë ose e drejta për mjete ankimore efektive ndaj shkeljes së të drejtave të ofruara nga Konventa.

295 Dhoma e arriti vendimin në lidhje me këtë çështje me një shumicë 4 kundër 3.

296 Shih gjithashtu vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet *Ozturk kundër Gjermanisë*, *Deweer kundër Belgjikës* si dhe *Engel dhe të tjerë kundër Holandës* të përfshirë në këtë botim si dhe komentimin përkatës.

297 Me interes janë në mënyrë të veçantë paragrafët 64-73 të vendimit të Gjykatës.



## MURRAY kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 14310/88)

28 tetor 1994

*ndalimi ose arrestimi i një personi mund të justifikohet në bazë të nenit 5 § 1 vetëm kur ekziston një dyshim i arsyeshëm*

### I. Faktet kryesore

1. Gjashtë kërkuesit janë qytetarë irlandezë. Kërkuesi i parë, znj. Margaret Murray, dhe i dyti, z. Thomas Murray, janë bashkëshortë. Katër kërkuesit e tjerë (Mark, Alana, Michaela dhe Rosina Murray) janë fëmijët e tyre. Në vitin 1982, të gjashtë kërkuesit banonin së bashku në të njëjtin vendbanim në Belfast, në Irlandën e Veriut. Dy nga vëllezërit e kërkueses së parë ishin dënuar në qershor të vitit 1982 në SHBA për blerje armësh për llogari të Ushtrisë Republikane Irlandeze të Përkohshme.

2. znj. Murray u arrestua nga ushtria në vendbanimin e saj në Belfast në orën 07.00 të mëngjesit të datës 26 korrik 1982, në bazë të nenit 14 të Ligjit të Irlandës së Veriut të vitit 1978, nen që kishte të bënte me situata emergjente. Kjo dispozitë, sipas interpretimit të gjykatave të brendshme, i jepte kompetencë ushtrisë për të arrestuar ose ndaluar deri në katër orë një person të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, mjaft që dyshimi mbi personin e ndaluar të ishte i ndershëm dhe i sigurt. Sipas ushtrisë, znj. Murray u arrestua sepse dyshohej të kishte marrë pjesë në blerjen e armëve për IRA-n në SHBA. Ndërsa ajo po vishej, kërkuesit e tjerë ishin zgjuar nga gjumi dhe ishin mbledhur në dhomën e ndenjes. Ndërkohë ushtarët mblidhnin detaje për kërkuesit dhe shtëpitë e tyre. Pyetjes se në bazë të cilit ligj znj. Murray arrestohej, oficeri, një tetare, iu përgjigj, "neni 14". znj. Murray u dërgua në Springfield Road Army në një qendër ekzaminimi dhe u mor në pyetje për rreth dy orë. Ajo refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve përveç emrit të saj. Gjatë kohës së qëndrimit në këtë qendër ajo fotografohej pa dijeninë dhe pa dëshirën e saj. Ajo u lirua në orën 9.45. të mëngjesit pa iu komunikuar ndonjë akuzë.

3. Në vitin 1984 znj. Murray bëri një padi në Gjykatën e Lartë kundër Ministrisë së Mbrojtjes për heqje lirie të gabuar dhe dëme të tjera. Megjithatë ankimi i saj nuk pati sukses. Në seancë u ofruan prova nga znj. Murray dhe nga oficerja. Edhe pse oficerja nuk kishte një dosje të plotë të pyetjeve të znj. Murray në qendrën ushtarake, ajo mbante mend se pyetjet ishin bërë rreth parave dhe Amerikës. Gjyqtari e pranoi dëshminë e oficeres si të vërtetë. znj. Murray apeloi përsëri duke kundërshtuar ligjshmërinë e arrestit të saj si dhe në lidhje me disa çështje të lidhura me arrestin përpara Gjykatës së Apelit, por kjo e fundit e hodhi poshtë

kërkesën e saj në shkurt të vitit 1987. Gjykata e Apelit i akordoi asaj lejen për të apeluar në *House of Lords*. Ky apel i fundit u hodh poshtë në maj 1988.

4. Ligji i vitit 1978, në bazë të të cilit znj. Murray u arrestua bën pjesë në legjislacionin që veproi në Mbretërinë e Bashkuar gjatë sulmeve terroriste në Irlandën e Veriut. Neni 14 u zëvendësua në vitin 1987 me një dispozitë që kërkonte që arrestimi të bazohej mbi një dyshim të arsyeshëm.

5. Në kërkesën drejtuar Komisionit më 28 shtator 1988, znj. Murray ankohej se arresti i saj për ta marrë në pyetje përbënte një shkelje të nenit 5 § 1 dhe 2, për të cilën ajo nuk kishte pasur të drejtë dëmshpërblimi ashtu siç e parashikon neni 5 § 5 dhe se fotografimi i saj dhe marrje e detajeve mbi të kanë shkelur të drejtën e respektimit të jetës private bazuar në nenin 8. Pesë kërkuesit e tjerë pretendonin një shkelje të nenit 5 §§ 1, 2, dhe 5 si rezultat i urdhrit për t'u mbledhur në njërën dhomë të shtëpisë, ndërsa znj. Murray përgatitej të largohej me ushtrinë. Ata më pas pretenduan se marrja e disa të dhënave mbi ta si emrat dhe marrëdhëniet me kërkuesen e parë, kishin shkelur të drejtën e tyre për respektimin e jetës private bazuar në nenin 8. Të gjithë kërkuesit pretenduan se hyrja e ushtrisë për kontroll në shtëpinë e tyre ishte në kundërshtim me të drejtën e tyre për respektimin e jetës private dhe familjare si dhe të vendbanimit të tyre të parashikuar nga neni 8 i Konventës, dhe se në kundërshtim me nenin 13, kërkuesve nuk iu dha mundësia për të bërë një ankim efektiv në gjykatat e brendshme për pretendimet e tyre bazuar në Konventë.

6. Më 10 dhjetor 1991, Komisioni shpalli të pranueshme në tërësi ankesën e kërkueses së parë dhe kërkesat e të tjerëve bazuar në nenin 8 për hyrjen dhe kontrollin në vendbanimin familjar. Pjesa tjetër e kërkesave u hodh poshtë. Në raportin e 17 shkurtit 1993, Komisioni shprehu opinionin se në rastin e kërkueses së parë, ishin shkelur neni 5 § 1, neni 5 § 2 dhe neni 5 § 5, që nuk ishte shkelur neni 8 dhe se nuk ishte i nevojshëm shqyrtimi i pretendimit të kërkueses së parë bazuar në nenin 13 lidhur me hyrjen dhe kontrollin e vendbanimit familjar ose fotografimi dhe marrja e detajeve personale të saj.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Vlerësime të përgjithshme

7. Ashtu siç është thënë në gjykimet e mëparshme, rreth interpretimit dhe zbatimit të dispozitave të Konventës, duhet të merret parasysh natyra e krimeve terroriste, kërcënimi i shoqërisë demokratike dhe kërkesat e marrëveshjes me të.

### B. Në lidhje me nenin 5 § 1

8. znj. Murray pretendonte se në kundërshtim me nenin 5 § 1 (c), ajo nuk ishte arrestuar mbi bazën e një “dyshimi të arsyeshëm” për kryerjen e një vepre penale dhe se qëllimi i arrestimit të saj dhe paraburgimi nuk ishte për ta sjellë atë përpara një autoriteti ligjor kompetent.

*a) "Një dyshim i arsyeshëm"*

9. Fakti që legjislacioni në atë kohë parashikonte një dyshim të ndershëm dhe të sigurtë dhe jo të arsyeshëm ishte një tregues, por gjithsesi jo vendimtar. Dyshimi i arsyeshëm parashikonte ekzistencën e fakteve ose informimit që do të kënaqte një vëzhgues objektiv që personi në fjalë mund të ketë kryer një shkelje.

10. Ajo që do të ishte "e arsyeshme" në lidhje me dyshimin varej nga rrethanat e në një çështje të veçantë. Duke pasur parasysh vështirësitë e brendshme të hetimit dhe të ndjekjes së veprimtarisë terroriste në Irlandën e Veriut, karakteri "i arsyeshëm" i dyshimit, që ishte baza për arrestimin e një personi të dyshuar, nuk mund të gjykohej gjithmonë sipas standardeve të njëjta që zbatoheshin për krime në një kohë normale. Gjykata e pranoi se kompetenca e arrestimit që i qe akorduar ushtrisë nga neni 14 i ligjit të vitit 1978 përfaqësonte, me mirëbesim, një përpjekje nga një parlament i zgjedhur në mënyrë demokratike që në një shtet të së drejtës, që të zgjidhte problemin e terrorizmit, dhe Gjykata ishte e prirur t'i besonte qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, duke marrë parasysh ekzistencën e një informacioni të besueshëm por konfidencial ku bazohej dyshimi kundër z. Murray. Megjithatë, Gjykatës duhet t'i jepeshin disa fakte ose informacione, që ta bindnin se personi i arrestuar dyshohej, në mënyrë të arsyeshme, për kryerjen e veprës penale të pretenduar, në veçanti aty ku legjislacioni i brendshëm kishte vendosur një standard të ulët duke kërkuar thjesht një dyshim të ndershëm.

11. Në vijim, Gjykata mori parasysh provat e ofruara nga znj. Murray dhe të pranuar nga gjykatat e brendshme, në lidhje me dënimin e fundit të vëllezërve të saj në SHBA për vepra që kishin të bënin me blerjen e armëve për IRA-n, për vizitat e saj në SHBA dhe kontaktet me vëllezërit e saj atje, si dhe për bashkëpunimin me njerëz "të besuar" që banonin në Irlandën e Veriut që ishin përfshirë në veprat penale për të cilat qenë dënuar vëllezërit e saj.

12. Gjykata konkludoi se në rrethana të veçanta ekzistonin fakte ose informacione që mund të përbënin baza të pranueshme dhe objektive për të dyshuar se znj. Murray mund të ketë kryer veprën penale për mbledhjen e fondeve për IRA-n.

*b) Qëllimi i arrestimit*

13. znj. Murray pretendonte se ishte e qartë nga rrethanat që ajo nuk ishte arrestuar me qëllimin për ta çuar përpara një autoriteti ligjor kompetent por thjesht për ta marrë në pyetje me synim mbledhje faktesh. Gjykatat e brendshme, pasi kishin pyetur dëshmitarët, kishin vënë re se qëllimi i arrestimit të saj kishte qenë gjetja e fakteve për kryerjen e veprës penale për të cilën ajo dyshohej. Asnjë element i bashkëngjitur nuk ishte paraqitur në procedurat përpara institucioneve të Konventës që ta bënte Gjykatën të bazohej në këtë zbulim faktesh. Mund të mendohej se nëse dyshimi ndaj znj. Murray do të vërtetohej, ajo do të ishte akuzuar për kryerjen e një vepre penale dhe do të dërgohej përpara një gjykate. Arrestimi i saj dhe paraburgimi përputheshin me qëllimin e parashikuar në

nenin 5 § 1 (c). Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 në lidhje me kërkuesen e parë.

### *C. Në lidhje me nenin 5 § 2*

14. znj. Murray pretendonte se gjatë arrestimit të saj dhe paraburgimit ajo nuk ishte informuar për arsyet e arrestimit të saj. Gjykata nënvizoi se përmbajtja dhe shpejtësia e informimit të dhënë duhet të vlerësoheshin nëse ishin të mjaftueshëm në çdo rast sipas tipareve të veçanta të tyre. Arsyet e arrestimit nuk i ishin treguar qartë znj. Murray gjatë mbikëqyrjes policore por ato i ishin bërë të ditura gjatë seancës së pyetjeve. Për më tepër, intervali prej disa orësh ndërmjet arrestimit dhe seancës së pyetjeve nuk mund të konsiderohet sikur i tejkalon kufizimet e kohës të caktuara nga nocioni i shpejtësisë. Në këto kushte Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 5 § 2.

### *D. Në lidhje me nenin 5 § 5*

15. Përderisa nuk u ngrit asnjë problem i veçantë në bazë të nenit 5 § 5 Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të tij.

### *E. Në lidhje me nenin 8*

16. Së pari, Gjykata vlerësoi se çdo masë e marrë nga autoritetet dhe që ishte ankimuar nga kërkuesit ishte “në përputhje me ligjin”. Ajo vijoi më tej duke thënë se masat e marra, të cilat kishin një qëllim legjitim për parandalimin e krimit, ishin “të nevojshme në një shoqëri demokratike”. Duke vënë në baraspeshë të drejtën e individit të garantuar nga neni 8 § 1 dhe domosdoshmërinë e shtetit për të marrë masa efektive për parandalimin e terrorizmit, duhet pasur parasysh përgjegjësia e një qeverie të zgjedhur në një shoqëri demokratike për të mbrojtur qytetarët dhe institucionet nga rreziku që përbën terrorizmi dhe problemet e veçanta që lindin në arrestimin dhe paraburgimin e personave të dyshuar për pjesëmarrje në veprimtari terroriste. Gjykatat e brendshme kishin njoftuar me të drejtë për kushtet e tensionuara në ekstrem nën të cilat ishin bërë arrestimet në Irlandën e Veriut. Për sa i përket hyrjes dhe kontrollit të vendbanimit, mjetet e përdorura nga autoritetet nuk mund të konsideroheshin si në disproporcion me qëllimin legjitim të ndjekur. Një përfundim i ngjashëm u arrit lidhur me marrjen e sendeve personale, përfshirë fotografinë e znj. Murray.

### *F. Në lidhje me nenin 13*

17. Së pari, Gjykata vendosi se nuk ishte i nevojshëm shqyrtimi në bazë të nenit 13 të ankesës për arrestimin, paraburgimin, mungesën e informacionit për arsyet e arrestimit të saj (neni 5 §§ 1 dhe 2), përderisa ajo nuk e kishte ngritur këtë problem në bazë të nenit 5 § 4, dispozita e Konventës që parashikon një emërtim të posaçëm për ankimin lidhur me arrestimin dhe paraburgimin. Në lidhje me kërkesat e hyrjes dhe kontrollit si dhe të marrjes së të dhënave personale dhe të fotografisë, Gjykata çmoi se ankime efektive ishin të mundshme në bazë të legjislacionit të brendshëm. Mundësitë e saj të vogla për të fituar, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të rastit të saj, nuk e ulnin efektivitetin e qëllimit të nenit 13. Si rrjedhim, faktet e çështjes së saj nuk nxirrnin në pah ndonjë shkelje të nenit 13.

### III. Koment

18. Ky vendim i dhënë nga Dhoma e Madhe e Gjykatës bën pjesë në një sërë çështjesh në lidhje me situatat terroriste në Britaninë e Madhe<sup>298</sup>, shqetësimi në lidhje me të cilat është rishfaqur pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 në SH.B.A. Në të gjitha këto çështje Gjykata haset me një situatë tepër të vështirë të baraspeshimit të interesave të individit ndaj atyre të shoqërisë në përgjithësi, baraspeshë që shpeshherë është thuar se pamundur për t'u ruajtur drejt.

19. Në këtë kuadër ky vendim i Gjykatës trajton një prej aspekteve themelore të vlerësimit të karakterit të drejtë të kësaj baraspeshë – të konceptit të *arsyeve të besueshme për të dyshuar* që personi i cili ndalohet ose arrestohet ka kryer një vepër penale. Duke ripohuar qëndrimin e mbajtur në çështjen *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>299</sup>, në të cilën për herë të parë e kishte analizuar këtë koncept, Gjykata saktëson disa elementë përbërës të tij. Ajo shprehet se në analizë të fundit ndershmëria dhe *bona fides*<sup>300</sup> e një dyshimi përbëjnë një element të domosdoshëm të karakterit të arsyeshëm të një dyshimi. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se edhe kohëzgjatja e ndalimit të një personi përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin e justifikueshmërisë së dyshimit të arsyeshëm. Kujtojmë që në çështjen pararendëse në këtë botim, *Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata kishte pranuar se, në bazë të nenit 5 § 1 të Konventës, pasja e një dyshimi të arsyeshëm justifikonte arrestimin e një personi edhe pa i komunikuar formalisht akuzën.

## GUSINSKIY kundër RUSISË

(kërkesa nr. 70276/01)

19 maj 2004

*kjo çështje kishte të bënte me kufizimin e lirisë së kërkuesit për një qëllim që nuk lejohej nga ana e nenit 5*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Vladimir Aleksandrovich Gusinskiy, është shtetas rus dhe izraelit, i cili ka lindur më 1952. Në kohën e ngjarjeve ai ka qenë Kryetar i Bordit dhe aksioneri kryesor i ZAO Media Most, e cila përfshinte NTV, një kanal televiziv popullor rus.

298 Për sa i përket situatave terroriste shih në këtë botim vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet *Lawless kundër Irlandës* si dhe *Brogan dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

299 Vendim i 30 gushtit 1990, në të cilin Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 duke përdorur si kriter pikërisht dyshimin e arsyeshëm.

300 Lat. 'Mirëbesim'.

2. Më 13 qershor 2000, z. Gusinskiy u arrestua për shkak se dyshohej për mashtrim. U pretendua se duke krijuar subjekte të ndryshme tregtare (përfshirë edhe Media Most) ai kishte transferuar në mënyrë të paligjshme të drejta transmetimi nga Video Rusia, një shoqëri shtetërore, tek Video Rusia OOO, një shoqëri private, duke e zhveshur praktikisht Video Rusia nga 11 kanale televizive me një vlerë prej afro 10 milion dollarë amerikanë. Më 16 qershor, pasi u akuzua formalisht për veprën penale të mashtrimit, z. Gusinskiy u la i lirë por dha garanci se nuk do të largohej nga vendi.

3. Gjatë ndalimit të z. Gusinskiy, Ministri i Shtypit dhe Komunikimit i kishte ofruar kërkuesit që t'i hiqte akuzën penale me kusht që ai t'ia shiste Media Most një shoqërie të kontrolluar nga shteti dhe që kishte monopolin mbi gazin – Gazprom. Kjo e fundit ishte në mosmarrëveshje e sipër me Media Most në lidhje me disa borxhe të kësaj të fundit në favor të saj. Pas nënshkrimit të një marrëveshjeje të tillë në korrik 2000, procesi penal u mbyll. Pas heqjes së urdhrit për moslargim nga vendi kërkuesi shkoi në Spanjë. Pas kësaj Media Most refuzoi të respektonte “marrëveshjen e korrikut” duke pretenduar se ajo ishte përfunduar nën presion.

4. Në shtator 2000 ndaj kërkuesit u ngritën akuza të tjera në lidhje me marrjen e paligjshme të huave nga Media Most. Në dhjetor 2000, pas një urdhri ndërkombëtar arresti ai u arrestua në Spanjë, por u lirua në bazë të një garancie pasurore dhe u mbajt në arrest shtëpie në vilën e tij në Sotogrande. Në 4 prill 2001 autoritetet spanjolle e hodhën poshtë kërkesën për ekstradim të bërë nga autoritetet ruse.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. z. Gusinskiy ankohej se ndalimi i tij kishte qenë i paligjshëm dhe arbitrar duke përbërë shkelje të nenit 5 të Konventës. Në mënyrë të veçantë, ai ankohej se nuk kishte pasur asnjë dyshim të arsyeshëm në lidhje me kryerjen e veprës penale nga ana e tij. Ai pretendonte gjithashtu se ndalimi i tij nuk kishte respektuar procedurat e brendshme dhe se ai duhet të kishte përfituar nga një imunitet që e mbronte atë nga heqja e lirisë përderisa ai kishte marrë çmimin e Urdhrit të Miqve të Popullit. Ai pretendonte gjithashtu se qëllimi i vërtetë i ndalimit të tij ishte për ta detyruar që të shiste aktivitetin e tij mediatik në terma dhe kushte të pafavorshme.

### A. Në lidhje me nenin 5

6. Gjykata konstatoi se, duke pasur parasysh kërkesën e “dyshimit të arsyeshëm” të përfshirë në nenin 5 § 1 (c), provat e mbledhura nga autoritetet hetimore mund t'i kishin bërë ata vërtet të besonin se kërkuesi mund të kishte kryer një vepër penale.

7. Për sa i përket faktit nëse ndalimi ishte bërë “në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji” (neni 5 § 1), Gjykata kujtoi se kjo nënkupton jo vetëm



respektimin e legjislacionit të brendshëm por edhe faktin që ky legjislacion duhet të përmbushë disa kritere cilësore. Në mënyrë të veçantë ai duhet të jetë i qartë dhe i saktë në një mënyrë të mjaftueshme me qëllim që të shmangë çdo rrezik keqinterpretimi. Në bazë të Kodit Rus të Procedurës Penale, ndalimi përpara formulimit të akuzës (ashtu si në rastin e kërkuesit) lejohej vetëm “në rrethana të jashtëzakonshme”. Palët ranë dakord që kjo shprehje nuk sqarohet në kod dhe qeveria nuk ofroi asnjë shembull të rasteve të mëparshme në të cilat ishin konstatuar këto “rrethana të jashtëzakonshme”. Për këtë arsye, ky formulim nuk tregonte të kishte përmbushur cilësinë e ligjit të kërkuar nga neni 5 § 1.

8. Gjykata vlerësoi se ka pasur gjithashtu shkelje të së drejtës së brendshme për shkak se organet hetimore duhet t'i kishin ndërprerë procedurat pasi kishin marrë dijeni për faktin se kërkuesi kishte imunitet në sajë të marrjes së Urdhrit të Miqve të Popullit. Për këto arsye ka pasur shkelje të nenit 5 të Konventës.

### ***B. Në lidhje me nenin 18 të marrë së bashku me nenin 5***

9. Në lidhje me ankesën e kërkuesit se qëllimi i vërtetë i ndalimit të tij kishte qenë për ta detyruar të shiste aktivitetin e tij mediatik tek Gazprom në terma të pafavorshëm, Gjykata vuri në dukje se neni 18 i Konventës nuk kishte një pozitë autonome dhe mund të gjente zbatim vetëm i marrë së bashku me nene të tjera të saj. Për më tepër, mundësia e shkeljes së nenit 18 ekziston vetëm kur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa i nënshtrohen kufizimeve të lejuara nga vetë ajo.

10. Duke konstatuar se liria e kërkuesit ishte kufizuar, Gjykatës iu desh të vlerësonte nëse ai ishte ndaluar për ndonjë qëllim të ndryshëm nga ato të parashikuara në nenin 5 § 1 (c) duke çuar kështu në shkelje të nenit 18.

11. Nga palët nuk u kundërshtua që “marrëveshja e korrikut” e lidhte mbylljen e hetimit penal të filluar ndaj kërkuesit me shitjen e strukturës së tij mediatike Gazpromit, një kompanie që kontrollohej nga shteti. Sipas mendimit të Gjykatës qëllimi i aspekteve të së drejtës publike si procedimi penal ose ndalimi nuk ishte ai që ato të përdroreshin si pjesë e negociatave dhe strategjive tregtare. Në rrethanat e çështjes konkrete Gjykata nuk mundi të mos konstatonte se kufizimi i lirisë së kërkuesit të lejuar nga neni 5 § 1 (c) ishte bërë jo vetëm për qëllimin e çuarjes së tij përpara një autoriteti kompetent në bazë të dyshimit të arsyeshëm se ai kishte kryer një vepër penale, por gjithashtu edhe për arsye të tjera.

12. Për këtë arsye Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 18 të marrë së bashku me nenin 5 të Konventës.

### ***C. Në lidhje me nenin 41***

13. Gjykata vlerësoi se konstatimi i shkeljes në vetvete përbënte një shpërblim të drejtë për dëmin jomaterial të pësuar nga kërkuesi. Nga ana tjetër ajo ai akordoi atij 88 000 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

### III. Koment

14. Ashtu si në çështjen *Maestri kundër Italisë*<sup>301</sup>, kjo çështje merr gjithashtu në shqyrtim konceptin e “cilësisë së ligjit” i cili e përshkon të gjithë filozofinë e Konventës. Që ndërhyrjet ndaj të drejtave të parashikuara nga Konventa të jenë “të ligjshme”, e drejta e brendshme e zbatueshme duhet të jetë e saktë në mënyrë të mjaftueshme. Kodi rus i Procedurës Penale deklaronte se një i dyshuar, përpara se të “akuzohej” në bazë të së drejtës së brendshme, mund të ndalohej vetëm “në rrethana të jashtëzakonshme”. Por në ligj nuk qartësohej se çfarë kuptohej me rrethana të jashtëzakonshme. Ligji pra nuk ishte aq i qartë sa duhej që të përmbushte kriterin e “cilësisë së ligjit”. Si rezultat i këtij vendimi shtetet anëtare në të gjithë Evropën duhet të marrin në shqyrtim legjislacionin e tyre të brendshëm për të parë nëse kanë dispozita të tilla të pasakta të cilat iu referohen “rrethanave të jashtëzakonshme”, pa specifikuar ose të paktën pa nënkuptuar se çfarë janë këto rrethana.

15. Kjo çështje është gjithashtu një nga rastet shumë të rralla kur Gjykata vendos në lidhje me nenin 18 të Konventës. Çështja *Bozano kundër Francës*<sup>302</sup> e ka bërë ndërkaq të qartë që çdo privim lirie duhet të bëhet vetëm për qëllime të specifikuar, të cilat natyrisht duhet të jenë ato që përfshihen në nenin 5 § 1 germat (a) deri (f). Kjo çështje e bën të qartë se, edhe në qoftë se ka filluar ndërkaq një hetim penal i cili mund të justifikojë ndalimin, privimi i lirisë nuk mund të justifikohet nëse qëllimi i tij i vërtetë është arritja e një rezultati që nuk përfshihet në bazë të nenit 5 § 1 germat (a) deri (f).

## LAVENTS kundër LETONISË

(kërkesa nr. 58442/00)

**28 nëntor 2002**

*kjo çështje kishte të bënte me disa shkelje të garancive të Konventës në lidhje me lirinë dhe sigurinë e personit si dhe me gjykimin e drejtë*

### I. Faktet kryesore

1. Aleksandrs Lavents është shtetas letonez i lindur më 1959. Aktualisht ai mbahet nën mbikëqyrje në një spital në Riga. Më parë kërkuesi ka qenë kryetar i bordit mbikëqyrës të bankës më të madhe Letoneze. Banka në atë kohë kaloi në likuidim, duke shkaktuar dëme të rënda për ekonominë e vendit si dhe shkatërrimin financiar të qindra mijëra njerëzve. Prokurori që merrej me dosjen e kërkuetit ngriti dyshime se ky kishte kryer veprën penale të sabotimit, duke

301 Vendim i 17 shkurtit 2004.

302 Vendim i 18 dhjetorit 1986.

qënë se kishte autorizuar transferimin e pothuajse 139 milion Euro në një bankë ruse me seli në Moskë, në shkëmbim të një angazhimi për një pagesë në formën e obligacioneve të qeverisë ruse. Kërkuesi u akuzua gjithashtu për kryerjen e veprimeve mashtruese, duke pasur si qëllim që të krijonte idenë e një situatë të qëndrueshme dhe fitimprurëse të bankës.

2. Më 1 qershor 1995 kërkuesi u deklarua formalisht i dyshuar me akuzën e sabotimit, u mor në pyetje dhe, më 28 qershor 1995 dhe ndaj tij filluan hetimet. Ai u arrestua më 14 korrik 1995 në pritje të gjykimit të tij. Pavarësisht nga një numër ankesash nga ana e kërkuesit, periudha e tij a paraburgimit u shty disa herë me radhë. Për më tepër, ai vuante nga probleme shëndetësore, sidomos të zemrës, dhe ishte shtruar dy herë në spital gjatë periudhës së paraburgimit, duke u mbajtur nën mbikëqyrje për të shmangur mundësinë e largimit.

3. Më 12 qershor 1997 filloi procesi gjyqësor në Gjykatën e Rrethit të Rigës. Gjykata nuk e pranoi kërkesën për lirim të bërë nga ana e z. Lavents, duke e argumentuar këtë vendim me pretendimin se ai akuzohej për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe se gjendja e tij shëndetësore nuk shtronte nevojën e ndryshimit të masës së sigurimit të vendosur ndaj tij. Pasi kishte pësuar një atak në zemër gjatë një seance më 14 tetor 1997, z. Lavents u vu në arrest shtëpie, ku mbahej nën mbikëqyrje, dhe në mënyrë të veçantë, i ishte ndaluar që të largohej nga apartamenti i tij. Një ditë pas këtij vendimi, gazeta më e madhe e përditshme letoneze në atë kohë, botoi një deklaratë të Kryeministrit dhe të Ministrit të Drejtësisë në të cilën ata shprehnin pakënaqësinë e tyre për ndryshimin e masës së sigurimit ndaj z. Lavents. Një ditë më vonë, gjyqtarët që merreshin me çështjen u tërhoqën për shkak të presionit “nga qeveria dhe nga opinioni publik”, dhe çështja iu besua një trupi tjetër gjykues në të njëjtën gjykatë. Po në tetor të vitit 1997, me urdhër të një gjyqtari, korrespondenca e z. Lavents, përfshirë edhe atë me avokatin e tij, u bllokua dhe u kontrollua. Deri më sot kjo masë nuk është hequr ende.

4. Më 14 shtator 1998 kërkuesi u dërgua përsëri në burg. Ai bëri nëntë kërkesa për t'u liruar, por të gjitha u refuzuan me arsyetimin se karakteri i tij dhe natyra serioze e akuzave të ngritura ndaj tij e bënë të nevojshme mbajtjen e tij në gjendje paraburgimi. Si pasojë e gjendjes së tij shëndetësore ai u shtrua përsëri në spital, si në atë të burgut – ku nuk i lejoheshin vizitat nga familjarët – ashtu edhe në qendra spitalore jashtë burgut.

5. Disa herë me radhë gjatë procesit gjyqësor kërkuesi kërkoi ndryshimin e trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit, si të kryetares së tij, znj. Šteinerte ashtu edhe të dy gjyqtarëve të tjerë, duke i akuzuar për njëanshmëri dhe për fshehjen e një prove të rëndësishme në favor të pafajësisë së z. Lavents. Një urdhër i nxjerrë nga dy gjyqtarë të tjerë për heqjen e dosjes nga gjykimi i znj. Šteinerte, u prapësua më 14 dhjetor 1999 nga Senati i Gjykatës së Lartë me kërkesë të prokurorit të çështjes. Prapësimi i këtij urdhri iu kalua përsëri Gjykatës së Rrethit të Rigës, e cila me të

njëjtën përbërje gjyqtarësh, të kryesuar po nga znj. Šteinerte e hodhi poshtë atë. Në vijim, në nëntor dhe dhjetor 1999, znj. Šteinerte bëri një sërë deklaratash në dy të gazeta të përditshme letoneze. Në këto deklarata ajo kritikonte qëndrimin e mbrojtjes dhe aludonte për rezultatin e procesit gjyqësor; ajo shprehte gjithashtu habinë e saj në lidhje me faktin që kërkuesi këmbëngulte në pafajësinë e tij dhe e ftoi atë ta provonte atë.

6. Me një vendim të 28 dhjetorit 2001 kërkuesi u deklarua fajtor dhe u dënua me 9 vjet heqje lirie. Procedurat në apel janë ende në rrugë e sipër.

## II. Vendimi i Gjykatës

7. z. Lavents ankohej në bazë të nenit 5 për kohëzgjatjen e periudhës së heqjes së lirisë së tij gjatë gjykimit dhe për mungesë të mundësive efektive për të rishikuar masat e sigurimit të marra ndaj tij. Ndërsa në bazë të nenit 6 ai ankohej se çështja e tij nuk ishte gjykuar brenda një afati të arsyeshëm dhe nga një gjykatë e paanshme e krijuar me ligj, dhe se deklaratat e bëra në shtyp nga ana e gjyqtares që merrej me çështjen e tij tregonin se ajo ishte e bindur për fajësinë e tij. Në vijim ai pretendonte se bllokimi dhe kontrolli i korrespondencës së tij, si dhe moslejimi i vizitave nga familjarët gjatë një pjese të kohës së paraburgimit, përbënte shkelje të të drejtave të tij të garantuara nga ana e nenit 8.

### A. Në lidhje me nenin 5 § 3

8. Gjykata vuri në dukje se për 11 muaj kërkuesi ishte mbajtur i mbyllur dhe vazhdimisht nën mbikëqyrje në apartamentin e tij, duke u ndaluar rreptësisht të largohej. Ajo konstatoi se shkalla e ashpërsisë së kësaj mase ishte e tillë që mund të konsiderohej si privim lirie në kuptimin e nenit 5 të Konventës. I njëjti konstatim sipas Gjykatës gjen zbatim edhe në lidhje me periudhat e kaluara në spital.

9. Gjykata mund të merrte në shqyrtim vetëm periudhën pas 27 qershorit 1997, datë në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi në lidhje me Letoninë. Megjithatë ajo mbajti parasysh periudhën e kaluar në paraburgim edhe përpara kësaj date, me qëllim që të vlerësonte nëse kohëzgjatja e heqjes së lirisë ishte e arsyeshme. Në këtë drejtim ajo saktësoi se kishin kaluar gjashtë vjet, pesë muaj e 14 ditë nga data e arrestimit të kërkuesit dhe data në të cilën gjykata kishte vendosur mbi themelin e akuzave të ngritura ndaj tij. Këtu përfshiheshin edhe katër vjet e gjashtë muaj nga data e hyrjes në fuqi të Konventës në lidhje me Letoninë.

10. Gjykata vuri në dukje se pas hyrjes në fuqi të Konventës në Letoni, Gjykata e Rrethit për nëntë herë me radhë kishte refuzuar kërkesat për lirim të kërkuesit, duke i parashtruar arsyet e vendimeve të saj në një mënyrë abstrakte dhe të përmbledhur dhe duke iu referuar thjesht kritereve të parashikuara në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale. Sipas mendimit të Gjykatës, argumente të tillë nuk mund të justifikojnë heqjen e lirisë të kërkuesit për një periudhë kaq

të gjatë dhe nuk i qëndrojnë testit të kohës së nevojshme për mbajtjen e procesit. Për këtë arsye Gjykata mendon se ka pasur shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës.

#### **B. Në lidhje me nenin 5 § 4**

11. Gjykata ka juridiksion për ta shqyrtuar këtë çështje vetëm për sa i përket periudhës pas 27 qershorit 1997. Kjo nënkupton që shqyrtimi nga ana e saj i efektivitetit të rishikimeve të masave të sigurimit kufizohet vetëm në fazën e procedimit gjyqësor.

12. Në këtë çështje Gjykata e Rrethit e Rigës duhej ta vlerësonte themelin e çështjes si dhe kishte për detyrë të shqyrtonte kërkesat e z. Lavents për tu liruar. Në lidhje me këtë pikë, Gjykata iu referua përfundimeve të saj në bazë të nenit 6 § 1 duke arritur në përfundimin se kërkuesi nuk ishte gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe se trupi gjykues që gjykonte çështjen e tij nuk ishte "krijuar me ligj" për sa i përket periudhës pas 14 dhjetorit 1999. Për këtë arsye Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës.

#### **C. Në lidhje me nenin 6 § 1**

##### *a. E drejta për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm*

13. Gjykata vlerësoi se në rastin e kërkuesit, procedurat kishin filluar kur ai ishte marrë për herë të parë në pyetje si i dyshuar, më 1 qershor 1995, dhe kishin përfunduar me dhënien e vendimit në shkallë të parë më 28 dhjetor 2001. Pra këto procedura, të cilat vazhdonin ende në apel, kishin zgjatur thuajse gjashtë vjet e shtatë muaj. Megjithëse Gjykata kishte kompetencë ta shqyrtonte këtë çështje vetëm pas datës në të cilën Konventa kishte hyrë në fuqi për Letoninë, ajo theksoi se duhej mbajtur parasysh faza në të cilën kishin arritur procedurat deri në atë datë, pikërisht për qëllimet e vlerësimit të afatit të arsyeshëm. Deri në këtë datë pra, hetimi i çështjes kishte kërkuar dy vjet dhe 27 ditë.

14. Gjykata e pranoi faktin se çështja ishte tepër komplekse dhe që vonesa të konsiderueshme ishin shkaktuar nga gjendja shëndetësore e kërkuesit, por mbajti qëndrimin se kërkuesi nuk mund të konsiderohej përgjegjës për vonesa të tilla përderisa ato kanë qënë rezultat i një force madhore. Në lidhje me sjelljen e autoriteteve kombëtare, Gjykata vuri në dukje se pothuaj 11 muaj kishin kaluar nga data kur gjyqtarët hoqën dorë nga çështja duke nxjerrë si arsye presionin qeveritar, dhe datës në të cilën çështja iu dha për gjykim një trupi tjetër gjykues, dhe se asnjë arsye nuk ishte dhënë për një vonesë të tillë. Kështu Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet gjyqësore nuk kishin vepruar me zellin e kërkuar për një ecuri të mirë procedurale dhe vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

##### *b. E drejta për një gjykim nga një gjykatë e vendosur me ligj*

15. Gjykata rikujtoi faktin se urdhri për heqjen dorë të znj. Šteinerte u revokua nga Senati i Gjykatës së Lartë me kërkesë të prokurorit. Në kundërshtim me instruksionet e dhëna nga Senati në urdhrin e tij, çështja iu dha përsëri për gjykim

të njëjtit trup gjykues të Gjykatës së Rrethit të Rigës e cila edhe kishte hequr dorë prej saj. Në vijim Gjykata vuri në dukje se, pasi vendimi i këtij trupi gjykues ishte revokuar, gjyqtarët në përbërje të tij, ligjërisht nuk mund të merrnin më pjesë në gjykimin e kësaj çështje. Kjo do të thotë se trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit nuk ishte krijuar në përputhje me ligjin dhe se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në këtë drejtim.

*c. E drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e pavarur*

16. Gjykata vuri në dukje se znj. Šteinerte kishte kritikuar në shtyp qëndrimin e mbrojtjes në procedimin gjyqësor, kishte bërë parashikime mbi rezultatin e procesit gjyqësor dhe kishte shprehur habinë e saj për këmbënguljen e kërkuarit për pafajësinë e tij, duke i kërkuar këtij që të provonte këtë pafajësi. Sipas mendimit të Gjykatës, këto deklarata arrinin në marrjen e një qëndrimi të palëkundur në lidhje me rezultatin e procesit, duke shfaqur një preferencë të qartë për një vendim fajësie në dëm të kërkuarit. Këto deklarata kishin bërë që kërkuari të dyshonte për mungesën e paanësisë së gjyqtarës. Për këtë arsye Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me mungesën e paanshmërisë së gjykatës dhe vlerësoi se ishte e panevojshme për ta shqyrtuar më vete çështjen e “pavarësisë” së saj.

**D. Në lidhje me nenin 6 § 2**

17. Gjykata nënvizoi se nga deklaratat e znj. Šteinerte për shtypin se ajo ishte e bindur për fajësinë e kërkuarit. Ajo kishte arritur deri aty sa të sugjeronte që ai të provonte pafajësinë e tij, një qëndrim që sipas mendimit të Gjykatës vinte në kundërshtim me parimin themelor të prezumimit të pafajësisë. Për këtë arsye Gjykata vlerësoi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 2 të Konventës.

**E. Në lidhje me nenin 8**

*a. Bllokimi dhe kontrolli i korrespondencës*

18. Gjykata vlerësoi se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkuarit për respektimin e korrespondencës. Ajo vuri në dukje se masa në fjalë, pra bllokimi dhe kontrolli i korrespondencës, ishte urdhëruar nga një gjyqtar në bazë të Kodit të Procedurës Penale, i cili autorizonte marrjen e masave të tilla në rastin e personave të akuzuar për vepra penale të një rrezikshmërie të madhe. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo dispozitë u linte gjykatave një hapësirë mjaft të madhe duke parashikuar vetëm llojet e veprave penale për të cilat kjo masë gjen zbatim, por duke mos specifikuar periudhën e vlefshmërisë së masës ose arsyet subjektive që mund të kërkojnë vendosjen e saj. Ligji që ishte zbatuar nuk saktësonte me një qartësi të mjaftueshme qëllimin dhe mënyrën e ushtrimit të kompetencave që u ishin njohur autoriteteve në këtë fushë. Për këto arsye, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja nuk ishte parashikuar nga ligji<sup>303</sup> dhe se ka pasur shkelje të nenit 8.

303 Kujtojmë me këtë rast testin cilësor që duhet të kalojë një formulim i caktuar me qëllime normative, që të përmbushë kriteret e nocionit ligj sipas kuptimit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.



*b. Ndalimi i vizitave nga familjarët*

19. Gjykata nënvizoi se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për respektim të jetës së tij familjare. Gruaja dhe vajza e z. Lavents nuk ishin lejuar që ta vizitonin atë gjatë tre periudhave kohore, më e gjata e të cilave kishte zgjatur gati një vit e shtatë muaj. Për më tepër, ndalimi i vizitave kishte pasur karakter absolut. Në vijim Gjykata vuri re se kërkuesi nuk kishte bërë përpjekje gjatë periudhës kur kishte qënë në arrest shtëpie, pra në kushte kontaktesh të pandërprera me familjen e tij, që në ndonjë mënyrë të fshihte provat apo të dëmtonte hetimin e çështjes së tij. Për këtë arsye Gjykata nuk u bind që zbatimi i një mase të tillë shtrënguese kishte qënë i nevojshëm për arritjen e qëllimeve të ligjshme që ajo mund të kishte pasur. Pra sipas Gjykatës ka pasur shkelje të nenit 8 edhe në këtë këndvështrim.

*F. Në lidhje me nenin 41*

20. Gjykata i akordoi kërkuesit 15 000 euro për shpenzime gjatë procesit.

**III. Koment**

21. Mbulimi tërësor që ky vendim u bën disa prej problemeve të rëndësishme që dalin nga nenet 5 dhe 6 e bën në fakt të tepërt çdo koment. Ka shumë të ngjarë që kjo çështje të citohet shpesh gjatë viteve në vijim nga Gjykata e Strasburgut ashtu edhe, siç duhet shpresuar në fakt, nga ana e gjykatave të brendshme. Për më tepër, ky vendim është një instrument i dobishëm për të gjithë ata që duan të zgjerojnë më tej njohuritë e tyre në jurisprudencën e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

**YANKOV kundër BULLGARISË**

*(kërkesa nr. 39084/97)*

**11 dhjetor 2003**

*kjo çështje kishte të bënte me shkeljen e disa të drejtave dhe lirive të një të burgosuri, ku interes të veçantë paraqesin ato me karakter procedural*

**I. Faktet kryesore**

1. Kërkuesi, Todor Antimov Yankov, është shtetas bullgar që ka lindur më 1943 dhe jeton në Plovdiv në Bullgari. Ai ishte drejtor ekzekutiv i një fondi investimesh bujqësore dhe i një kompanie financiare. Ai ishte gjithashtu pedagog i shkencave ekonomike dhe kishte edhe një doktoratë në këtë fushë.

2. Më 12 mars 1996 ai u arrestua me dyshimin se ishte përfshirë në operacione financiare të paligjshme dhe në pritje të gjykimit u mbajt në gjendje arresti në burg për 2 vjet dhe gati 4 muaj.

3. Gjatë periudhës së paraburgimit z. Yankov kërkoi në mënyrë të përsëritur që të gjykohej në gjendje të lirë duke pretenduar, ndërmjet të tjerash, që:

- fakti që të gjitha provat kundër tij ishin mbledhur gjatë muajve të parë të hetimit kufizonin mundësitë që ai të pengonte procesin pas gjithë kësaj kohe;
- që ai nuk kishte qenë dënuar më parë; dhe që
- nuk kishte rrezik që ai të largohej duke pasur parasysht moshën e tij, lidhjet familjare dhe gjendjen shëndetësore (ai vuante ndërmjet të tjerash nga tensioni, arterio-skleroza, gurët në veshka, diabeti dhe depresioni).

Ai pretendonte gjithashtu se provat kundër tij ishin të dobëta dhe se akuzat ndaj tij ishin bazuar në interpretim të gabuar të ligjit.

4. Në shkurt 1998 ai u dërgua në spital për t'iu nënshtruar një trajtimi të specializuar mjekësor.

5. Më 10 mars 1998, ndërsa kërkuesi po i nënshtrohej një kontrolli përpara se të takohej me avokatët e tij, projekti i një libri që ai po shkruante u konfiskua nga një polic i burgut me arsyetimin se kërkuesi kishte për qëllim t'ia jepte atë avokatit të tij. Teksti i projektit, i cili përshkruante paraburgimin e kërkuesit dhe procesin penal kundër tij, i quante rojet e burgut “përtacë të ushqyer mirë” dhe “fshatarë të shkretë” kurse një polic e quante “i zbritur nga fshati”, ndërsa hetuesve dhe prokurorëve dukej se iu referohej si “njerëz të fuqishëm pa skrupuj”. Kërkuesi pretendoi se ai vetëm kishte për qëllim t'i lexonte pasazhe nga dorëshkrimi i tij përderisa ai ishte vetëm një version fillestar. Në të njëjtën ditë drejtori i burgut nxori dhe vuri në ekzekutim një masë disiplinore ndaj kërkuesit “për deklarata fyese dhe shpifëse ndaj oficerëve, hetuesve, gjyqtarëve, prokurorëve dhe institucioneve shtetërore”. Kërkuesit i rruajtën kokën dhe e vendosën në izolim deri më 17 mars. Ai pretendonte se qelia e tij nuk kishte tualet dhe atij i duhej të përdorte një oturak i cili nuk zbrazej rregullisht. Ai pretendonte gjithashtu se kushtet e higjienës ishin tepër të vështira dhe se nuk kishte dritë të mjaftueshme. Më 19 mars 1998, kur kërkuesi u paraqit në një seancë publike përpara Gjykatës së Rrethit, ishte e dukshme që sapo i kishin rruajtur kokën.

6. Kërkuesi u shtrua në spital më 25 mars 1998. Më 10 korrik 1998 ai u lirua kundrejt një garancie pasurore për arsye shëndetësore. Më 30 tetor 1998, Gjykata e Rrethit të Plovdivit e shpalli kërkuesin fajtor, kryesisht për shkak se kishte urdhëruar transferime të paligjshme parash, dhe e dënoi me pesë vjet burg. Më 5 qershor 2000 vendimi i dënimit të tij u prish në apel dhe rifilloi sërish hetimi. Procedurat vazhdonin ende deri në nëntor 2002, dhe që prej atëherë Gjykata nuk ka marrë informacione të tjera në lidhje me këtë çështje.

## II. Vendimi i Gjykatës

7. Kërkuesi ankohej se trajtimi i tij në paraburgim kishte qenë në kundërshtim me nenin 3 të Konventës për shkak të faktit se ai ishte izoluar në një qeli dhe ishte detyruar të rruante kokën. Ai pretendonte gjithashtu se masat me karakter

disiplinor për shkak se kishte shkruar një libër shkelnin nenin 10, se ndalimi i tij ishte në kundërshtim me nenin 5 dhe se kohëzgjatja e procedurave penale ishte e paarsyeshme duke përbërë shkelje të nenit 6 § 1. Ai bazohej gjithashtu në nenin 13 që parashikon të drejtën për mjet efektiv.

#### **A. Në lidhje me nenin 3**

8. Gjykata vuri në dukje se një i burgosur të cilit i rruhet koka me forcë ka shumë të ngjarë që të perceptojë një ndjenjë inferioriteti. Prova e këtij trajtimi për më tepër do të jetë e qartë menjëherë edhe për të tretët, përfshirë personelin e burgut, të burgosurit e tjerë dhe vizitorët ose publikun, nëse i burgosuri çohet në një vend publik pak kohë pas këtij akti. Gjykata vlerësoi se rruajtja me forcë e kokave të të burgosurve është në parim një akt që mund të ketë pasojë uljen e dinjitetit të tyre njerëzor ose mund të bëjë që atyre t'u lindin ndjenja inferioriteti të tilla që t'i përrulin dhe t'i përçmojnë ata.

9. Ky akt nuk kishte një bazë ligjore dhe as ndonjë justifikim të vlefshëm. Edhe në qoftë se nuk synonte t'i përçmonte, qethja e flokëve të kërkuesit pa ndonjë justifikim specifik ishte në vetvete arbitrare e ndëshkimore dhe kishte të ngjarë që të burgosurit t'i dukej si akt që synonte ta përulte dhe nënshtronte atë. Moshë e kërkuesit, 55 vjeç në kohën e ngjarjeve, dhe fakti që ai doli në një seancë publike nëntë ditë pasi i ishte rruar koka, kishin gjithashtu rëndësinë e tyre.

10. Rruajtja e kokës të kërkuesit dhe izolimi i tij në një qeli vetëm sepse kishte shkruar komente kritike dhe fyese përbënte një trajtim të pajustificueshëm dhe me një nivel të mjaftueshëm ashpërsie sa të karakterizohej si degradues. Pra ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

#### **B. Në lidhje me nenin 10**

11. Gjykata vuri në dukje se autoritetet bullgare e ndëshkuan kërkuesin pa përmendur fare në deklaratat e tyre se përse ata i konsideronin deklaratat e tij si shpifëse.

12. Megjithëse komentet e bëra mund të konsideroheshin sharje, përsëri nuk ishin tepër fyese. Ato nga ana tjetër figuronin në një dorëshkrim të shkruar në gjuhë dhe stil karakteristik për kujtime personale ose shkrimesh me karakter të ngjashëm dhe në kontekstin e kritikës ndaj administratës së drejtësisë dhe zyrtarëve të përfshirë në të. Autoritetet bullgare duhet të ishte përmbajtur nga kundërveprimi i tyre.

13. Gjykata u shtang gjithashtu nga fakti se kërkuesi ishte ndëshkuar sepse kishte regjistruar mendimet e tij në një dorëshkrim personal të cilin, mesa dukej, nuk ia kishte treguar askujt në kohën kur iu konfiskua. Ai as nuk kishte "folur" dhe as "përhapur" asnjë deklaratë fyese ose shpifëse. Në veçanti, nuk kishte asnjë pretendim që ai ta kishte shpërndarë tekstin ndërmjet të dënuarve të tjerë.

14. Funkionarët e administratës së burgjeve duhet të jenë ndjerë të fyer personalisht nga disa prej shënimeve në lidhje me ta kur kanë parë dorëshkrimin e kërkuesit pas sekuestrimit. Megjithatë, është e vështirë të pranohet se kishte një arsye të mjaftueshme për ta ndëshkuar kërkuesin. Në këtë drejtim, nuk mund të thuhet se është ruajtur një baraspeshë e drejtë ndërmjet të drejtës së kërkuesit për lirinë e shprehjes dhe nevojës për të respektuar autoritetin e pushtetit gjyqësor dhe për të mbrojtur reputacionin e funksionarëve publikë. Duke e dënuar kërkuesin me shtatë ditë izolim në një qeli vetëm sepse kishte shkruajtur disa sharje në një dorëshkrim personal kritik në lidhje me sistemin e drejtësisë, i cili nuk iu ishte dhënë të burgosurve të tjerë, autoritetet e kishin kapërcyer hapësirën e tyre të vlerësimit. Pra ka pasur shkelje të nenit 10.

### **C. Në lidhje me nenin 13 të marrë së bashku me nenet 3 dhe 10**

15. Qeveria Bullgare nuk e kundërshtoi faktin se nuk kishte pasur ndonjë mjet efektiv ankimor në dispozicion të kërkuesit ndaj rruajtjes së kokës së tij, i cili ishte një akt pa asnjë bazë ligjore.

16. Në lidhje me ndërhyrjen ndaj lirisë së shprehjes së kërkuesit, Gjykata vuri në dukje se dorëshkrimi ishte sekuestruar menjëherë dhe se kërkuesi ishte mbyllur në izolim menjëherë pas nxjerrjes së urdhrit të izolimit ndaj tij. Nuk u tregua që atij t'i ishte dhënë ndonjë mundësi konkrete që të ankohej përpara ekzekutimit të ndëshkimit. Në kohën e ngjarjeve dhe deri në vitin 2002 e drejta bullgare nuk parashikonte asnjë ankim gjyqësor ndaj një urdhri me karakter disiplinor për izolimin e një të burgosuri në qeli.

17. Duke konstatuar se kërkuesi nuk kishte pasur në dispozicion të përdorte asnjë mjet efektiv ankimor qoftë ndaj trajtimeve degraduese të cilave iu ishte nënshtruar qoftë ndaj lirisë së shprehjes, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 13.

### **D. Në lidhje me nenin 5 § 3**

#### *a. E drejta për t'u çuar përpara një gjyqtari*

18. Pas arrestimit kërkuesi u çua përpara një hetuesi i cili nuk kishte kompetencë që të merrte një vendim me karakter të detyrueshëm në lidhje me masën e sigurimit ndaj kërkuesit. Duke pasur parasysh rolin aktiv që luajtën në akuzën e kërkuesit dhe pjesëmarrjen e tyre të mundshme në procesin penal ndaj tij, mund të thuhet se as hetuesi dhe as prokurori që e konfirmoi në vijim arrestin në burg nuk ishin aq të pavarur dhe të paanshëm sa e kërkonte neni 5 § 3. Për këtë arsye, ka pasur shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës për shkak se kërkuesi nuk u çua përpara një gjyqtari ose zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore.

#### *b. E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose për t'u gjykuar në gjendje të lirë*

19. Gjykata konstatoi se duke mos marrë parasysh fakte të rëndësishme, duke u bazuar vetëm në prezumimin ligjor të rëndësisë së veprave penale për të cilat

akuzohej kërkuesi dhe duke i kaluar këtij barrën e provës duke mos pasur asnjë rrezik hipotetik që ai të fshihej ose largohej ose të fshihte provat, autoritetet e kishin zgjatur arrestin në burg të kërkuesit me arsye të cilat nuk mund të konsideroheshin si të mjaftueshme.

20. Për këto arsye, Gjykata konstatoi se autoritetet dështuan në justifikimin e mbajtjes së kërkuesit në burg për një periudhë prej 2 vjetësh dhe gati 4 muajsh. Pra ka pasur shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës për shkak se arresti në burg i kërkuesit nuk justifikohej për të gjithë kohëzgjatjen e tij dhe se ishte tepër i gjatë.

#### *E. Në lidhje me nenin 5 § 4*

21. Gjykata kujtoi se, megjithëse kërkuesi kishte ofruar argumente që vinin në dyshim ligjshmërinë mbajtjes në gjendje arresti në burg, gjykatat bullgare në vendimet e tyre nuk i kushtuan aspak vëmendje ndonjërit prej këtyre argumenteve, duke i konsideruar, siç duket, të parëndësishme për çështjen e ligjshmërisë së arrestit në burg të kërkuesit. Mosmarrja parasysh nga ana e gjykatave e fakteve që mund të venë në dyshim ekzistencën e kushteve thelbësore të “ligjshmërisë” së mbajtjes në arrest në burg të kërkuesit përbën shkelje të nenit 5 § 4.

#### *F. Në lidhje me nenin 5 § 5*

22. Duke konstatuar se e drejta bullgare nuk i jepte kërkuesit një të drejtë reale për kompensim në lidhje me mbajtjen e tij të paligjshme në burg, Gjykata vendosi se ka pasur edhe shkelje të nenit 5 § 5 të Konventës.

#### *G. Në lidhje me nenin 6 § 1*

23. Duke pasur parasysh se procesi kishte zgjatur për të paktën gjashtë vjet dhe pesë muaj si dhe ngadalësinë e procedurave, Gjykata vendosi se ka pasur edhe shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

#### *H. Në lidhje me nenin 41*

24. Gjykata i akordoi kërkuesit 8 000 euro për dëm jomaterial dhe 4 000 euro për shpenzime dhe pagesa.

### **III. Koment**

25. E vetmja e drejtë e parashikuar nga Konventa që i kufizohet të burgosurve është pikërisht e drejta e tyre për liri. Çdo ndërhyrje tjetër ndaj të drejtave dhe lirive të tyre duhet të justifikohet sipas kriterëve shumë strikte dhe vetëm për arsye të ruajtjes dhe administrimit të një burgu. Ky vendim tepër i rëndësishëm në lidhje me të drejtat e të burgosurve i shton jurisprudencës së mëparshme në këtë fushë disa momente të rëndësishme:

- i. Gjykata, për herë të parë në këtë çështje, konstatoi se kemi të bëjmë me shkelje të nenit 3 në qoftë se ndryshohet me forcë pamja e një njeriu si për shembull duke i qethur atij plotësisht flokët. Gjykata vlerësoi se ai person

kishte shumë të ngjarë që të përjetonte një ndjenjë inferioriteti në rast se pamja e tij e jashtme ndryshon në kundërshtim me vullnetin e tij dhe se, në një rast të tillë, përlulja e tij është menjëherë e dukshme në sytë e të tjerëve. Nuk ishte qethja në vetvete akti që përbënte shkëlqje të nenit 3 por fakti që ajo nuk ishte e justifikueshme. Gjykata nuk e pranoi pretendimin e qeverisë sipas së cilës kjo ishte një masë higjienike, përderisa në burg nuk kishte pasur ndonjë problem mbipopullimi dhe se të burgosurit që nuk mbaheshin në izolim nuk qetheshin. U vu gjithashtu në dukje se raporti i Komitetit për Parandalimin e Torturës për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë kritikonte praktikën e rruajtjes së kokës të të burgosurve të rinj në burg dhe të atyre të kthyer pas arratisjeve të mundshme, kur këto nuk kishin “justifikim mjekësor”, dhe rekomandonte që autoritetet maqedonase t’i jepnin fund kësaj praktike.

- ii. Në lidhje me konfiskimin e dorëshkrimit të librit të kërkuesit, Gjykata vlerësoi gjithashtu se ky akt ishte i pajustificueshëm përderisa ishte një dokument me karakter privat. Ky dokument nuk ishte qarkulluar ndërmjet të burgosurve të tjerë që të mund të kishte prishur rendin në burg.
- iii. Për sa i përket të drejtës për mjet efektiv, Gjykata në këtë çështje u mor vetëm me aspektin nëse kërkuesi kishte pasur në dispozicion një mjet me anë të të cilit të kundërshtonte masat për të cilat ankohej, përpara se ato të ekzekutoheshin. Gjykata vuri në dukje se që nga koha e ngjarjeve, në vitin 2002, ligji ishte ndryshuar në mënyrë të tillë që të parashikonte një ankim gjyqësor kundër izolimit në qeli. Dhoma e Madhe e Gjykatës kishte vendosur ndërkaq në çështjen *Ezeh dhe Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>304</sup> që në rastet kur procedurat disiplinore në burg mund të arrijnë në një masë me karakter penal duhet krijuar mundësia për t’iu drejtuar një gjykate.

---

304 Vendim i 9 tetorit 2003 i përfshirë në këtë botim.



# NENI 6

## E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT

## KREUZ kundër POLONISË

(kërkesa nr. 28249/95)

19 qershor 2001

*shpenzimet e larta gjyqësore mund të përbëjnë shkelje të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatave*

### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje ka të bëjë me një kërkesë të paraqitur nga Henryk Kreuz, i lindur më datë 1955 dhe ka shtetësi të dyfishtë, Polake dhe Austriake. Aktualisht ai jeton në Austri.
2. Në 9 maj 1994 kërkuesi u ankua ndaj Bashkisë së Płock në Gjykatën e Rrethit Płock, duke pretenduar dëmshpërblimin për mos-nxjerrjen e një vendimi administrativ nga ana e të paditurit (leje ndërtimi për një lavazh makinash). Ai pretendonte se vonesa i kishte kushtuar atij para si dhe kishte dëmtuar marrëdhëniet me partnerët e tij sipërmarrës.
3. Sipas së drejtës polake një palë në procedurat me karakter civil duhet të paguajë shpenzimet gjyqësore për bërjen e një padie në një gjykatë dhe, sipas çështjes, pagesa paraprake mund të arrijë deri në 6-8 % të vlerës që pretendohet në rrugë gjyqësore. Sidoqoftë, autoritetet publike janë të përjashtuara nga ky rregull. Z. Kreuz kërkoi që edhe ai të përjashtohet nga kjo pagesë paraprake duke pretenduar që ai ishte i papunë dhe se i kishte shpenzuar të gjitha kursimet e tij në përgatitjen e një investimi në Poloni. Megjithëse kjo kërkesë iu hodh poshtë, shumica paraprake që duhet të paguante i'u reduktua. Si përfundim atij iu kërkua që të paguante një shumë prej 100 000 000 Zloty (të vjetra) polake, që ishte një shumë e barabartë me një rrogë vjetore neto në Poloninë e asaj kohe. Përderisa ai nuk arriti ta paguante këtë shumë, Gjykata e Rrethit të Płock e mbylli çështjen.

### II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesi ankohej, në bazë të nenit 6 § 1, se e drejta e tij për t'iu drejtuar gjykatës ishte shkelur përderisa niveli i shpenzimeve gjyqësore që kërkohet për t'u paguar e kishte detyruar atë të hiqte dorë nga ankimi i tij.

#### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

5. Gjykata vendosi se kërkesa për të paguar shpenzimet e gjykatave civile në raport me pretendimin e ngritur për të cilin ato ftoheshin të vendosnin mund të konsideroheshin edhe si kufizime ndaj të drejtës për t'iu drejtuar gjykatave, gjë që *per se* ishte në kundërshtim me nenin 6 § 1 të Konventës. Gjykata nënvizoi se as një e

drejtë e përgjithshme për të patur ndihmë ligjore nga shteti në proceset civile dhe as drejta për procedura të hapura për të gjithë në lidhje me çështjet civile nuk mund të kufizoheshin nga një dispozitë e tillë. Në vijim, sidoqoftë, ajo theksoi se vlerësimi i shumës që duhej paguar nën dritën e rrethanave të veçanta të një çështjeje të caktuar, mundësia e palës paditëse për t'i paguar ato si dhe faza e procedimit në të cilin ky kufizim gjente vend, ishin faktorë të rëndësishëm për të vendosur nëse e drejta e një personi për t'iu drejtuar gjykatës ishte shkelur apo jo.

6. Në këtë kuadër Gjykata vuri në dukje se, edhe pse shumica e kërkuar si përfundim ishte reduktuar mjaft në raport me atë fillestare, gjithsesi ishte e barabartë me një rrogë mesatare vjetore në Poloni në atë kohë, e cila, parë nga këndvështrimi i një pale paditëse normale, ishte padyshim e madhe. Për më tepër, konstatimet që gjykatat përkatëse bënë në lidhje me situatën financiare të kërkuarit duket se kishin qënë mbështetur më tepër mbi prezumimin e aftësive të tij për të siguruar të ardhura se sa mbi faktet që ai kishte paraqitur. Autoritetet gjyqësore refuzuan gjithashtu që të praninin argumentin e kërkuarit sipas të cilit ai nuk ishte në gjendje të paguante shpenzimet gjyqësore pa iu marrë parasysh ndonjë nga faktet që ai paraqiste në deklaratën e tij në lidhje me të ardhurat, dhe se gjykatat bënë disa supozime në lidhje me gjendjen financiare të kërkuarit, të cilat nuk mbështeteshin plotësisht nga materialet që kishin përpara. Gjykata në vijim vuri në dukje se, sipas së drejtës polake, në çdo kohë mund të bëhej revokimi i përjashtimit nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore në qoftë se bazat për përjashtimin e bërë kishin pushuar së ekzistuari. Lejimi i kërkuarit që të procedonte me padinë e tij në fazën fillestare nuk do t'i kishte penguar gjykatat polake që të merrnin shpenzimet gjyqësore në qoftë se, në një fazë të mëtejshme, situata e tij financiare do të ishte përmirësuar.

7. Gjykata vlerësoi se autoritetet gjyqësore kishin dështuar në sigurimin e një balance të drejtë ndërmjet, nga njëra anë, interesave të shtetit për të mbledhur shpenzimet gjyqësore për vlerësimin e ankimeve dhe, së dyti, interesat e kërkuarit për të pretenduar të drejtat e tij në rrugë gjyqësore. Shumica e kërkuar e shpenzimeve për procedurat në lidhje me pretendimin e tij ishte e tepruar dhe çoi në tërheqjen e tij nga ngritja e pretendimit përpara një gjykate, gjë e cila, sipas mendimit të Gjykatës, cenoi thelbin e vërtetë të së drejtës së tij për t'iu drejtuar një gjykate. Për këtë arsye Gjykata konstatoi se ka patur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

### ***B. Në lidhje me nenin 41***

8. Gjykata nuk u bind në lidhje me faktin se dëmi material i pretenduar ishte shkaktuar nga privimi i së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate dhe, për këtë arsye, nuk akordoi asnjë shumë në këtë kuadër. Duke bërë një vlerësim mbi baza barazie Gjykata i akordoi kërkuarit 30 000 Zloty Polake për dëm jo-material dhe 12 442 Zloty për shpenzime dhe pagesa.

### III. Koment

9. Kjo çështje ripohon parimet Ashingane<sup>1</sup> sipas të cilave e drejta për t'iu drejtuar gjykatave nuk është absolute dhe mund të jetë objekt kufizimesh. Kufizimet që gjejnë zbatim, sidoqoftë, nuk duhet të kufizojnë ose të reduktojnë mundësitë e individëve në një masë apo mënyrë të tillë sa të cenojnë vetë thelbin e së drejtës në fjalë. Për më tepër, kufizimet nuk do të jenë të pajtueshme me nenin 6 § 1 në qoftë se nuk ndjekin një qëllim legjitim dhe në qoftë se nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. E drejta për t'iu drejtuar një gjykate duhet të jetë “praktike dhe efektive” dhe jo “teorike apo iluzive”.

10. Në raste të tjera Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vlerësuar që mosofrimi i ndihmës ligjore në disa rrethana mund të përbëjë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përderisa ajo mund të pengojë të drejtën e personave për t'iu drejtuar gjykatave<sup>2</sup>.

11. Nuk ka një të drejtë për procedura falas ose të drejtë për rikthimin e pagesave dhe shpenzimeve gjyqësore në çështjet civile dhe, pra, ka një qëllim legjitim kërkesa e mundshme e pagimit të shpenzimeve gjyqësore në momentin e bërjes së kërkesë-padisë në një gjykatë, siç mund të jetë ai i stepjes së fillimit të proceseve të panevojshme dhe të pakuptimta. Megjithatë, shpenzimet e larta të procedurave mund të nxjerrin probleme në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës në qoftë se mund të nxirret në pah se kanë pasoja penguese ndaj padisë. Natyrisht që në çështjen në fjalë mund të thuhet se shpenzimet ishin të tilla që e pengonin mundësinë e kërkesë-padisë duke patur parasysh që ato arrinin në nivelin e një rroge vjetore në Poloni. Shpenzimet gjyqësore në juridiksione të tjera si për shembull në Mbretërinë e Bashkuar përgjithësisht përfaqësojnë vetëm një përqindje të vogël (më pak se 5 %) të një rroge normale vjetore.

<sup>1</sup> Shih vendimin e 28 majit 1985 në lidhje me çështjen Ashingane kundër Mbretërisë së Bashkuar.

<sup>2</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të vitit 1979 në lidhje me çështjen Airey kundër Irlandës.

## MARINI kundër SHQIPËRISË<sup>3</sup>

(kërkesa nr. 3738/02)

18 dhjetor 2007

*te zgjatja e proceseve gjyqësore tej afatit të arsyeshëm dhe pamundësia e vendimarrjes nga Gjykata Kushtetuese cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor*

### I. Faktet kryesore

1. Z. Marini dhe qeveria shqiptare në vitin 1991 themeluan ndërmarrjen e përbashkët “Marini-Albplastik” me afat dhjetë vjeçar, e specializuar në prodhimin e materialeve plastike. Statuti i shoqërisë u njoh me vendim të Këshillit të Ministrave të datës 23 prill 1991. Shoqëria e re u regjistrua në regjistrin tregtar në bazë të procedurave përkatëse.

2. Asetet e shoqërisë përbëheshin nga një fabrikë dhe pajisjet e saj, me vlerë totale 1,500,000 lekë (afërsisht 12,497 euro), të cilat më parë i përkisnin një shoqërie me kapital shtetëror, të quajtur “Mandimpeks”. Kontributi i kërkuarit në kapitalin themeltar të shoqërisë ishte me vlerë totale 1,100,000 USD (afërsisht 834,098 euro), për t’u përdorur për rinovimin e fabrikës dhe blerjen e teknologjisë së re. Secila palë zotëronte 50% të aksioneve.

3. Në maj 1991, për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në statut, kërkuari nënshkroi me Edil-Plastic, kompani italiane, një kontratë në emër të shoqërisë “Marini-Albplastik” për blerjen e teknologjisë së re për prodhimin e materialeve plastike duke paguar një shumë prej 228,000 USD (afërsisht 173 000 euro). Një shumë e dytë parash do të investohej pas fazës së parë të rinovimit të fabrikës.

4. Pasi ishte kryer 60% e rinovimit të fabrikës, shteti ndërpreu veprimtarinë e shoqërisë dhe i kërkoi kërkuarit të propozonte kushte të reja bashkëpunimi. Kërkuari nuk ra dakord. Për rrjedhojë, me një vendim të datës 3 prill 1993, Këshilli i Ministrave anuloi vendimin e tij të prillit 1991 dhe në mënyrë të njëanshme shfuqizoi marrëveshjen për themelimin e shoqërisë “Marini-Albplastik”.

#### *a) Procedimi përpara Arbitrazhit shtetëror*

5. Për të përfituar dëmshpërblim, kërkuari u ankua në Arbitrazhin Shtetëror, i cili në atë kohë ishte organi kompetent për mosmarrëveshjet ku përfshiheshin ndërmarrjet me kapital shtetëror.

<sup>3</sup> Ky vendim është marrë në mënyrë integrale nga libri i znj. Dajena Kumbaro “Versus Albania: jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, botim i Qendrës Evropiane dhe Civil Rights Defenders 2014. Znj. Kumbaro ka miratuar përdorimin e materialit për efekt të këtij botimi.

6. Në maj 1993, Arbitrazhi Shtetëror njohu vlefshmërinë e statutit të shoqërisë “Marini-Albplastik” dhe urdhëroi shtetin t’i paguante kërkuetit 341,608 euro në lidhje me fitimin e munguar shkaktuar si rezultat i ndërprerjes së vepritarisë së shoqërisë dhe 569 Euro për të mbuluar interesin bankar për investimin e shumës 228,000 USD. Gjithashtu, u urdhërua të përfundoheshin punimet e rikonstruksionit të fabrikës brenda tetorit 1993. Arbitrazhi Shtetëror rrëzoi kërkesën e kërkuetit për t’u kompensuar për pjesën e tij të aksioneve.

7. Në korrik 1993, Mbledhja e Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror ku u apelua vendimi i parë nga autoritetet shtetërore, la në fuqi pjesë të vendimit që e urdhëronte shoqërinë të përmbushte detyrimet e saj për të vazhduar veprimtarinë e ndërmarrjes së përbashkët. Ndërkohë, u hodh poshtë pjesa e vendimit në lidhje me dëmshpërblimin për interesin bankar dhe fitimin e munguar. Gjithashtu, çështja u ridërgua në Arbitrazhin Shtetëror për një përlllogaritje të re të fitimit të munguar. Pjesa e parë e vendimit mori formë të prerë në atë datë.

8. Në nëntor 1993, Arbitrazhi Shtetëror me vendim të formës së prerë urdhëroi shtetin t’i paguante kërkuetit shumën prej 217 286 euro për fitimin e munguar në vitin 1992.

9. Në vitin 1993, në përputhje me vendimin e sipërpërmendur të formës së prerë, përmbartuesit ngrinë asetet e shoqërisë me kapital shtetëror dhe i paguan kërkuetit shumën që i takonte.

10. Pas refuzimit të Këshillit të Ministrave për të ekzekutuar vendimin e arbitrazhit, kërkueti i bëri kërkesë Gjykatës Kushtetuese për dëmshpërblim. Në nëntor 1995, Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje të të drejtave kushtetuese të kërkuetit dhe urdhëroi që ndaj tij të ekzekutohej vendimi i Mbledhjes së Përgjithshme të Arbitrave. KM e ekzekutoi vendimin dy vjet pas daljes së tij.

*b) Seria e parë e procedimeve gjyqësore*

11. Përfaqësuesit e ortakut shtetëror të “Marini-Albplastik” i u drejtuan Gjykatës së Rrethit Tiranë për shpalljen absolutisht të pavlefshëm të vendimit të Arbitrazhit të datës 5 nëntor 1993, me arsyetimin se ai ishte marrë pasi Arbitrazhi kishte pushuar së qeni një trup vendimmarrës më 4 nëntor 1993. Gjithashtu, ata kërkuan të anulohet urdhëri i përmbartimit për ngrirjen e aseteve të shoqërisë.

12. Në nëntor 1996 dhe qershor 1997, respektivisht Gjykata e Tiranës dhe Gjykata e Apelit lanë në fuqi vendimin e Arbitrazhit Shtetëror. Vendimet e gjykatave morën formë të prerë në qershor 1997.

13. Në shtator 1996 dhe janar 1997, respektivisht, Agjencia Kombëtare e Privatizimit i shiti F-së godinën e fabrikës dhe tokën ngjitur saj, pavarësisht se ato ishin aktive të shoqërisë “Marini-Albplastik”. Kërkueti filloi procesin kundër vendimit të privatizimit.



14. Në qershor 1998, dhjetor 1998, dhjetor 1999, dhjetor 2000 dhe maj 2001, respektivisht Gjykata e Rrethit, Gjykata e Apelit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara të GJL dhe Gjykata Kushtetuese i konstatuan aktet e privatizimit absolutisht të pavlefshme dhe urdhëruan ndër të tjera që fabrika të trajtohet si pjesë e asetëve të shoqërisë “Marini-Albplastik”. Së fundi, gjykatat vendase urdhëruan F-në. t’u kthejë pronësinë e fabrikës dhe tokës ngjitur saj ortakëve të shoqërisë “Marini-Albplastik”.

15. Pas një kërkesë të kërkuarit, Gjykata e Tiranës nxori në janar 2000 një urdhër për ekzekutimin e vendimit të qershorit 1998. Pavarësisht urdhrit të sipërpërmendur, Ministria e Ekonomisë dhe Financave lidhi më 4 korrik 2001, një kontratë qiraje 20 vjeçare me shoqërinë D, e cila do ta përdorte fabrikën në fjalë për prodhim këpucësh. Shoqëria D, e zotëronte tashmë fabrikën dhe operonte në bazë të një kontrate qiraje 4 vjeçare të lidhur me F. në 1998. Me qëllim pezullimin e ekzekutimit të urdhrit të gjykatës të janarit 2000, shoqëria D. bëri kërkesë në Gjykatën e Tiranës për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Gjykata e pranoi kërkesën në shkurt 2000.

*c) Seria e dytë e procedimeve gjyqësore*

19. Në një vendim të majit 2000, Gjykata e Tiranës shprehej se kërkuari duhej të zbatonte kushtet e kontratës së qirasë të lidhur mes F-së dhe shoqërisë D. Në shkurt 2001, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët.

20. Në dhjetor 2002, GJL u shpreh se përderisa vendimet e privatizimit u shpallën absolutisht të pavlefshme F. nuk kishte mundësi të kryente veprime juridike civile për pronën objekt gjykimi, ndaj kontrata e qirasë ishte absolutisht e pavlefshme. GJL prishi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe pushoi gjykimin e çështjes.

21. Në kohën e marrjes së vendimit kishte mbaruar kontrata 4 vjeçare e qirasë dhe shoqëria D., me të cilën kishte lidhje procesi, e përdorte tashmë fabrikën në bazë të një kontrate të re qiraje, këtë herë të lidhur me Qeverinë.

*d) Krijimi i shoqërisë së re*

22. Në shkurt 2001, ndërsa vazhdonte procesi kundër shoqërisë D, Ministria e Punës dhe kërkuari ranë dakord të formojnë një shoqëri të re “Marini-Albplastik”. Shoqëria e re u krijua në bazë të statutit të shoqërisë së parë “Marini-Albplastik” të datës 11 mars 1991, vendimit të Arbitrazhit Shtetëror të majit 1993 dhe vendimit përfundimtar në favor të kërkuarit të qershorit 1998.

23. Në statut palët njohën përgjegjësitë e tyre për moszbatim të detyrimeve të përcaktuara në kontratën e parë dhe ranë dakord të paguajnë dëmet përkatëse në bazë të vendimit të Gjykatës së Tiranës të qershorit 1998. Kapitali themeltar u nda 50% për secilën palë për një periudhë 10-vjeçare. Kërkuari do të kishte rolin e administratorit të shoqërisë. Në maj 2001, Gjykata e Tiranës regjistroi shoqërinë e re me emrin “Marini-Albplastik” sh.p.k., me objekt aktiviteti prodhimin e materialeve plastike.

24. Në shtator 2001, ortakët organizuan mbledhjen e parë të përgjithshme të asamblesë për të përcaktuar vlerën e tyre të aksioneve. Përfaqësuesi i ndërmarrjes shtetërore parashitri se shteti do t'i regjistronte aksionet e tij në emër të shoqërisë "Marini-Albplastik" kur kërkuesi të investonte pjesën e tij të aksioneve. Kërkuesi nuk ra dakord, me arsyetimin se ligji parashikonte që ortakët duhej t'i investonin pjesët e tyre të kapitalit në të njëjtën kohë.

25. Në korrik 2001, pavarësisht regjistrimit të shoqërisë së re në shkelje të detyrimeve të marra përsipër nga Ministria e Punës në shkurt 2001, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, pa miratimin e kërkuesit, lidhi një kontratë qiraje 20 vjeçare me shoqërinë D. Në bazë të kontratës së re, shoqëria D, do t'a përdorte fabrikën që i përkiste shoqërisë "Marini-Albplastik" për prodhim këpucësh.

26. Në lidhje me sa më sipër, Ministria e Ekonomisë dhe Financave urdhëroi në korrik 2001 fshirjen e aktiveve të "Marini-Albplastik" nga Regjistri i Pasurive të Paluajtshme duke e regjistruar fabrikën dhe tokën si prona shtetërore.

*e) Seria e katërt e procedimeve gjyqësore*

27. Në gusht 2001, Gjykata e Tiranës urdhëroi pezullimin e ekzekutimit të urdhrin pas ankesës së Z. Marini për urdhrin e Z.R.P.P-së dhe institucioneve të tjera shtetërore. Në qershor 2002, kjo gjykatë pas konstatimit të fshirjes së aktiveve nga regjistri vendosi ri-regjistrimin e aktiveve të shoqërisë në regjistër. Në janar 2003, Gjykata e Apelit prishi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për shkelje procedurale dhe i'a dërgoi çështjen për rigjykim kësaj gjykate. Në mars 2004, Gjykata e Lartë nuk pranoi rekursin e kërkuesit, me arsyetimin se shkak i rekursit nuk përfshihej në parashikimet e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

*f) Seria e pestë e procedimeve gjyqësore*

28. Në një datë të papërcaktuar, Gjykata e Tiranës, gjatë rigjykimit të çështjes, i kërkoi likuiduesit të shoqërisë së kërkuesit të ndërhynte në proces si palë e tretë. Në janar 2005, kjo gjykatë rrëzoi padinë e kërkuesit me arsyetimin se ai përfaqësonte një shoqëri në likuidim dhe për rrjedhojë nuk mund të ishte palë ndërgjyqëse. Vendimi u la në fuqi nga Gjykata e Apelit në maj 2005. Në janar 2007, GJL nuk pranoi rekursin e kërkuesit, me arsyetimin se shkak i rekursit nuk përfshihej në parashikimet e nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

*g) Seria e gjashtë e procedimeve gjyqësore*

29. Ndërkohë, shoqëria D, kishte bërë kërkesë në Gjykatën e Tiranës për pezullim ekzekutimi të vendimit të nxjerrë nga e njëjta gjykatë në janar 2000. Gjykata e pranoi kërkesën në tetor 2002.

30. Më janar 2003, Gjykata e Apelit konstatoi që shoqëria D, nuk ishte palë në procesin që çoi në nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit të janarit 2000, ndaj nuk plotësonte kushtet për të bërë një kërkesë të tillë.

31. Në prill, maj 2002 dhe nëntor 2002 respektivisht, Avokati i Popullit dhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri u bënë thirrje autoriteteve të respektonin vendimet e marra për çështjen e kërkuarit. Në një letër të janarit 2003, Ministri i Ekonomisë i kërkonte Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor të mos zbatonte urdhrin e gjykatës të janarit 2000. Në shkurt 2003, Zyra e Përmbarimit vendosi të mos zbatonte urdhrin e ekzekutimit.

32. Në shkurt 2003, gjatë një mbledhjeje të përgjithshme të asamblesë së shoqërisë, përfaqësuesi i shoqërisë shtetërore njoftoi kërkuarin për vendimin e tij për të revokuar kontratën me shoqërinë “Marini-Albplastik”. Kërkuari e kundërshtoi këtë gjë. Për rrjedhojë, Ministria e Ekonomisë i kërkoi gjykatës të urdhëronte likuidimin e shoqërisë “Marini-Albplastik” dhe të aktiveve të saj, për mungesë interesimi nga ana e kërkuarit për veprimtaritë e shoqërisë.

*h) Seria e shtatë e procedimeve gjyqësore*

33. Gjykata e rrethit në mars 2003 dhe Gjykata e Apelit të qershorit 2003 pranuan kërkesën e kërkuarit dhe urdhëruan Zyrën e Përmbarimit të ekzekutonte urdhrin.

34. Në maj 2003, gjykata caktoi një likuidues dhe vendosi likuidimin e “Marini-Albplastik”. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë u la në fuqi nga gjykata e apelit me vendim të nëntorit 2003. Në korrik 2004, Gjykata e Lartë nuk pranoi rekursin që pasoi këtë vendim, me arsyetimin se shkak për rekursin nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile. Në mars 2004, Kolegjet e Bashkuara të GJL rrëzuan vendimet e gjykatave më të ulëta dhe e dërguan çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

*i) Seria e fundit e procedimeve gjyqësore*

35. Gjatë rigjykimit gjykata e shkallës së parë u kërkoi likuiduesve të shoqërisë “Marini-Albplastik” të bashkonin paditë në një gjykim të vetëm. Kërkuari kundërshtoi me arsyetimin se mosmarrëveshja kishte të bënte me interesat e tij dhe jo ato të shoqërisë në likuidim.

36. Në tetor 2004, me kërkesë të likuiduesit, gjykata pushoi procesin, vendim që u la në fuqi edhe nga gjykatat më të larta respektivisht shkurt 2005 dhe prill 2006. Kërkuari paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar parregullsi të proceseve gjyqësore.

37. Në tetor 2004, likuiduesi i shoqërisë “Marini-Albplastik” i kërkoi kërkuarit të dorëzonte llogaritë dhe vulën e shoqërisë. Më pas, likuiduesi i kërkoi gjykatës së rrethit të vërtetonte llogaritë përfundimtare të shoqërisë dhe të urdhëronte fshirjen e saj nga regjistri tregtar. Kërkuari kërkoi pezullim të gjykimit deri në daljen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

38. Në janar 2005, Gjykata e Tiranës vërtetoi llogaritë përfundimtare të shoqërisë dhe urdhëroi përfundimin e procesit të likuidimit. Ajo urdhëroi gjithashtu që

përfundimi i procesit të likuidimit të shënohej në regjistrin tregtar. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit në qershor 2005.

39. Në prill 2005, Gjykata Kushtetuese në seancë plenare me praninë e 7 nga 9 gjyqtarëve, refuzoi kërkesën e kërkuarit, meqenëse çështja nuk ishte votuar nga shumica e kërkuar/votat ishin ndarë në mënyrë të barabartë.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me shkeljen e nenit 17

40. Gjykata kundërshtoi pretendimin e autoriteteve se neni 17 i Konventës nuk i lejonte kërkuarit t'u referohej parashikimeve të nenit 6 të Konventës për deklarimin e vendimeve të gjykatave vendase si jo kushtetuese. Në vlerësim të GJEDNJ, neni 17 i Konventës nuk mund të interpretohet me supozim të ndërsjelltë, se privon personat fizikë nga liritë themelore të individit të garantuara nga nenet 5 dhe 6 të Konventës<sup>4</sup>.

### B. Në lidhje me shkeljen e nenit 6 § 1

41. Kërkuari u ankua për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për mosekzekutim të vendimeve të formës së prerë të dhëna në favor të tij, tejzgjatje në kohë të proceseve, mungesë arsyetimi të vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe kufizim të së drejtës së tij për t'u dëgjuar nga gjykata. Në lidhje me vendimin e GJL të datës 27 janar 2006 kërkuari paraqiti argumentat e tij për mungesën e paanshmërisë së kolegjit të GJL më datë 11 dhjetor 2006.

42. Në lidhje me paanshmërinë e kolegjit të GJL, Gjykata e Strasburgut çmoi se kërkesa ishte bërë në tejkallim të afatit gjashtë mujor nga data e vendimit, për këtë arsye kjo kërkesë nuk mund të shqyrtohej nga Gjykata.

43. Ndërkohë, në lidhje me mungesën e arsyetimit të vendimit të GJL, GJEDNJ u shpreh se drejta që i garantohet një ndërgjyqësi prej nenit 6 të Konventës, përfshin të drejtën për arsyetimin e vendimeve të marra nga një gjykatë vendase. Megjithatë, detyrimi për të arsyetuar vendimet varet nga natyra e çdo vendimi. Sipas GJEDNJ-së arsyetimi i kufizuar i GJL tregonte se kërkuari nuk kishte paraqitur si bazë ligjore një nga pikat e parashikuara në dispozitën e brendshme përkatëse. Për këto arsye, Gjykata çmoi se kërkesa e kërkuarit në lidhje me nenin 6 të Konventës ishte haptazi e pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3, ndaj e deklaroi të papranueshme në zbatim të nenit 35 § 4 të Konventës.

44. GJEDNJ theksoi se neni 6§1 i Konventës i garanton çdo personi të drejtën për t'u dëgjuar nga një gjykatë. "E drejta për një proces të rregullt" në aspektin civil nis pikërisht me të drejtën për t'u dëgjuar nga një gjykatë. Megjithatë, kjo e drejtë është objekt edhe i disa kufizimeve, të cilat nuk duhet të kufizojnë thelbin e të drejtës së personit për t'u dëgjuar nga gjykata.

<sup>4</sup> Shih çështjen *Lawless* k. Irlandës (nr.3), 1 korrik 1961, Seria A.

45. Gjykata u shpreh se e ka konfirmuar në praktikën e saj se rreziku në një sistem të tillë qëndron në faktin se ai mund të kufizojë në mënyrë të paarsyeshme të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata, veçanërisht nëse proceset tejzgjaten. Ndërkohë, u vu re se procedurat e likuidimit zgjatën 4 vjet. Gjatë këtyre procedurave, kërkuesi pati mundësi të apelonte procedurat e likuidimit, për këtë arsye nuk mund të konsiderohet se atij i janë kufizuar të drejtat. GJEDNJ arriti në përfundimin se procedurat e likuidimit nuk çuan në shkelje të së drejtës së kërkuesit për t'u dëgjuar nga gjykatat vendase.

46. Në lidhje me cenimin e të drejtave të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ si pasojë e mos arritjes së shumicës së votave në seancën e mbajtur nga Gjykata Kushtetuese, GJEDNJ arriti në përfundimin se GJK nuk mori një vendim në lidhje me kërkesën e kërkuesit jo për shkak të ndarjes së votave, por për shkak të pamundësisë të saj për të siguruar shumicën në ndonjë nga çështjet e paraqitura për gjykim, problematikë kjo e pazgjidhur nga sistemi i brendshëm rregullues. Sipas GJEDNJ-së praktikisht nuk u pranua të merrej një vendim, për këtë arsye Gjykata nuk mund të pranojë faktin se nëse rrethanat do të plotësoheshin, kërkuesi do të kishte në dorë një vendim përfundimtar në lidhje me kërkesën e tij, duke përbushur kështu parimin e sigurisë juridike në favor të kërkuesit. Për këtë arsye, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

47. Gjykata e Strasburgut vërejt se parashikimet e nenit 6 § 1 i Konventës për proces gjyqësor të drejtë, publik dhe të shpejtë nuk do të kishin vlerë në rast se nuk mbrohet procedura e ekzekutimit të vendimeve, për këtë arsye kjo procedurë duhet të konsiderohet si pjesë e "procesit të rregullt gjyqësor". GJEDNJ çmoi se autoritetet shtetërore kishin dështuar në ekzekutimin e pjesës së dytë të vendimit të Arbitrazhit Shtetëror, mangësi kjo e përmendur dhe në vendimin gjyqësor të qershorit 1998. Gjithashtu, Gjykata vërejt se pavarësisht krijimit të shoqërisë së re, kjo shoqëri nuk operoi asnjëherë, ndërsa autoritetet shtetërore lidhën kontrata me palë të treta duke cenuar detyrimet kontraktuale me kërkuesin. Sipas Gjykatës autoritetet shtetërore nuk kishin ndërmarrë veprime konkrete për ekzekutimin e vendimeve dhe për këto arsye është shkelur neni 6 § 1 i Konventës.

48. Gjykata vërejt se periudha që duhet marrë në shqyrtim për kërkesat në tërësi fillon me momentin kur Shqipëria dorëzoi instrumentat ratifikues të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 2 tetor 1996. Sipas GJEDNJ, kohëzgjatja "e arsyeshme" e procesit duhet vlerësuar në bazë të rrethanave të çështjes dhe në lidhje me kriteret e: kompleksitetit i çështjes, qëndrimit i kërkuesit dhe i autoriteteve përkatëse dhe interesat e kërkuesit në mosmarrëveshje<sup>5</sup>.

49. Në vështrim të këtyre kriterëve Gjykata vlerësoi se procesi i tretë, i katërt dhe i pestë janë zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm. Në anën tjetër, Gjykata vlerësoi se procesi i parë dhe i dytë ishin zhvilluar në tejkalim të afateve të arsyeshme.

<sup>5</sup> Shih çështjen Comingersoll S.A. k. Portugalisë, nr. 35382/97, GJEDNJ 2000-IV.

Këto procese nuk mund të konsideroheshin komplekse. Kështu, Gjykata vëren se duke dhënë një sërë vendimesh kontradiktore në shkallë të ndryshme të gjykimit, autoritetet shqiptare kanë shfaqur një mangësi të sistemit gjyqësor për të cilin janë përgjegjës. Për këto arsye GJEDNJ arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me këto procese.

### *C. Në lidhje me shkeljen e nenit 13*

50. Gjykata vërejtë se kërkuesi kishte një pretendim të argumentuar sipas nenit 13 të Konventës. Sipas GJEDNJ, përveç apelimit kushtetues, sistemi ligjor shqiptar nuk siguron mjete të veçanta ankimi. Gjithashtu autoritetet shqiptare nuk mund të jepnin ndonjë rast ku GJK kish marrë vendim për një kërkesë për kohëzgjatje të tepruar. Sipas GJEDNJ nuk kishte prova të mjaftueshme për t'a konsideruar kërkesën sipas nenit 131 të Kushtetutës së RSH, kërkesë të një shkalle të mjaftueshme sigurie. Për këto arsye, Gjykata e Strasburgut konstatoi në rastin konkret shkelje të nenit 13 të Konventës.

### *D. Në lidhje me shkeljen e nenit 1 të Protokollit 1*

51. Gjykata konstatoi se aksionet e Z. Marini kishin vlerë financiare dhe përbënin pronë në kuptim të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës. Në rastin konkret Gjykata vërejtë se nuk kishte një privim të drejtpërdrejt të së drejtës së pronës në llogari të kërkuetit, por mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale nga ana e shtetit derivoi për kërkuetin humbjen e kontrollit efektiv mbi aktivitetet e shoqërisë. Gjykata çmoi se mosekzekutimi i vendimeve nga shteti në favor të kërkuetit çoi në prishjen e "ekuilibrit të drejtë" që duhet ruajtur mes kërkesave të interesit publik dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e kërkuetit për gëzim të qetë të pronës së tij. Për pasojë kërkuetit nuk ju siguroa e drejta për gëzim efektiv të pronës së tij duke shkelur kështu të drejtën e parashikuar në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës.

### *E. Në lidhje me shkeljen e nenit 14*

52. Z. Marini paraqiti kërkesën se ai ishte diskriminuar për shkak të dy shtetësisë së tij shqiptaro-amerikane. Gjykata vërejtë se kërkuesi nuk mundi t'a provonte pretendimin e tij duke e rrëzuar atë në përputhje me nenin 35 § 3 dhe § 4 të KEDNJ.

### *F. Në lidhje me nenin 41*

53. Në kuadër të shpërblimit të drejtë, që i duhej akorduar kërkuetit, Gjykata vlerësoi se shteti shqiptar duhet t'a dëmshpërblente Z. Marini në total me një shumë prej 330,000 euro për dëmin material dhe jomaterial, si edhe 5,700 euro për shpenzime gjyqësore.

## **III. Koment**

54. Çështja Marini është komplekse. Ajo lidhet me pesë seri procedimesh në gjykatat e brendshme mbi një konflikt të kërkuetit me qeverinë shqiptare për një shoqëri të përbashkët tregtare të krijuar në vitin 1991. GJEDNJ shqyrtoi në themel disa pretendime të kërkuetit lidhur me nenin 6 të Konventës e konkretisht: mosekzekutimi



i vendimeve të formës së prerë në favor të kërkuetit; kohëzgjatja e procesit të afatit të arsyeshëm; kufizimi i të drejtës së kërkuetit për aksesin në gjykatë në dy drejtime: refuzimi i kërkesës nga Gjykata Kushtetuese për shkak të mos marrjes së një vendimi dhe urdhri për likuidimin e kompanisë që e kishte penguar kërkuetin nga ndërmarrja e hapave ligjorë në mbrojtje të interesave të tij.

55. Gjykata e Strasburgut nënvizoi se në rastet e tejzgjatjes së procedurave të falimentimit individit mund t'i kufizohet në mënyrë të parsyeshme e drejta për t'u dëgjuar nga një gjykatë. Për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me mohimin e të kësaj të drejte, duhet të shqyrtohet nëse pasojat që i vijnë individit janë në përpjestim me mohimin e të drejtës, që i bëhet atij nga legjislacioni vendas.

56. Në përgjigje të ankimit për mosekzekutim të vendimeve përfundimtare, GJEDNJ vërejti se vonesat e tejzgjatura në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë mund të derivojnë shkelje të Konventës. Koha, që nevojitet për zbatimin e vendimeve vlerësohet duke patur parasysh kompleksitetin e procedurave të zbatimit, sjelljen e kërkuetit dhe organeve kompetente, si edhe masën e dëmshpërblimit. Ajo që është shumë e rëndësishme në këtë rast, është rikonfirmimi i standartit që GJEDNJ e kishte shprehur te çështja *Metaxas k. Greqisë* se një person në favorin e të cilit ka dalë një vendim gjyqësor nuk mund të pritët që të ngrejë padi të veçanta për zbatimin e vendimit<sup>6</sup>. Në këto raste, autoriteti përkatës shtetëror duhet të njoftohet për vendimin dhe të marrë të gjitha nismat e nevojshme që ta zbatojë apo t'ia transmetojë atë një autoriteti tjetër përgjegjës për ekzekutim.

57. Në çështjen *Marini*, GJEDNJ çmoi se dy nga pesë seritë e procedimeve e kishin tejkaluar afatin e arsyeshëm. Ndërkohë, Gjykata u shpreh se pretendimi për mosekzekutim i vendimeve përfundimtare të gjykatave vendase në favor të shtetasve, lidhet në thelb me mungesën e një mjeti efektiv vendas, i cili do të bënte të mundur ekzekutimin e vendimeve. Gjykata përsëriti se një mjet ankimi do të konsiderohet "efektiv" në rastet kur ai mund të parandalojë shkeljen e pretenduar nga kërkueti, ose të ndërpresë vazhdimin e shkeljes, duke siguruar dëmshpërblimin e duhur. Tek çështja *Marini*, por edhe duke ju referuar çështjeve të mëparshme të shqyrtuara prej saj, GJEDNJ vërejti se ankimi në Gjykatën Kushtetuese nuk përbente një mjet efektiv meqenëse nuk përmbushte të teori dhe praktikë kushtet e "efektivitetit" të mjeteve.

58. Përsa i përket të drejtës së pronës, edhe në këtë çështje GJEDNJ ritheksoi tre rregullat për të cilësuar në jurisprudencën e saj<sup>7</sup>. Në rastin konkret Gjykata theksoi se e drejta e pronës nuk ishte respektuar si pasojë e mosrespektimit të detyrimeve pozitive nga ana e shtetit të paditur dhe tejzgjatjes së proceseve jashtë afatit të arsyeshëm.

<sup>6</sup> Shih çështjen *Metaxas k. Greqisë*, nr. 8415/02, 27 maj 2004

<sup>7</sup> Shih çështjen *Mullai* dhe të tjerë k. Shqipërisë.

## GOLDER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 4451/70)

21 shkurt 1975

*refuzimi ndaj një të burgosuri të dënuar në Angli, që të këshillohet me një avokat për të bërë një padi civile kundër një gardiani shkel nenin 6 § 1 dhe nenin 8 të Konventës.*

### I. Faktet kryesore

1. Z. Sidney Elmer Golder është shtetas britanik i lindur më 1923. Ai ka qenë dënuar më 1965 me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie për vjedhje me armë. Më 24 tetor 1969, ndërkohë që vuan dënimin në burgun e Parkhurst, në ishullin e Wight, turbullira të rënda ndodhin në një lokal të destinuar për argëtimin e të burgosurve, ku gjendej edhe Z. Golder. Të nesërmen, një gardian që ishte plagosur duke u përpjekur që të shtypte rebelimin bëri një deponim duke identifikuar si një prej agresorëve të tij, një të burgosur që ai e njihte nga pamja i cili, besonte gardiani, quhej Golder.

2. Ky i fundit, së bashku me të dyshuar të tjerë, ishte veçuar përkohësisht nga pjesa më e madhe e të burgosurve. Inspektorë të policisë e morën atë në pyetje dhe i bënë të ditur, më 30 tetor, që faktet do t'u bëhen të ditura autoriteteve me qëllim që mund të vendosin në lidhje me hapjen e çështjes penale në ngarkim të tij për ushtrim dhune. Pavarësisht nga kjo, më 5 nëntor gardiani ndryshoi deklaratat e bëra në deponimin e tij të mëparshëm: ai vë në dukje se nuk është i sigurt nëse ka qenë sulmuar nga Z. Golder. Dy ditë më vonë, një gardian tjetër saktësoi se i interesuari kishte qëndruar pranë tij gjatë pjesës më të madhe të incidenteve dhe se nuk ka qenë përzier me to. Z. Golder rifitoi menjëherë pas kësaj qelinë e tij të zakonshme dhe nuk vazhdoi të hetohet më. Duke pasur frikë se deponimi fillestar mund ta cenonte atë, ai iu lut Ministrin të Brendshëm që, në përputhje me rregulloren e brendshme, t'i lejonte atij të konsultohet me një avokat me qëllim që ta padisë për shpifje gardianin në fjalë. Kërkesa e tij, e paraqitur më 20 mars 1970, u hodh poshtë më 6 prill të të njëjtit vit. Z. Golder u lirua më kusht më 12 korrik 1972.

3. Z. Golder iu drejtua Komisionit më 18 prill 1970. Ai pretendoi para së gjithash se refuzimi për ta lejuar që të këshillohet me një avokat e ka penguar që të hapë një proces dhe për këtë arsye ishte në kundërshtim nenin 6 § 1 të Konventës, i cili i garanton të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate në lidhje me çështjet civile. Ai pretendoi në vazhdim shkeljen e nenin 8, sepse i njëjti refuzim që u përmend më lart e ka privuar nga e drejta e korrespondencës me një avokat.

4. Në raportin e tij të 1 qershorit 1973, Komisioni hartoi një opinion sipas të cilit

neni 6 § 1 garanton një të drejtë për t'iu drejtuar gjykatave; qoftë i marrë në mënyrë të veçantë qoftë së bashku me nene të tjera të Konventës ai nuk përmban asnjë kufizim të nënkuptuar në lidhje me të drejtën e një të burgosuri që të ngrejë një padi dhe për këtë qëllim të këshillohet lirisht me një avokat, nga ku del në pah se kufizimet e vendosura nga praktika e autoriteteve britanike nuk janë të pajtueshme me të. Përsa i përket nenit 8, Komisioni çmoi se ai gjen zbatim në lidhje me faktet e çështjes dhe pra edhe ky ka qenë shkelur gjithashtu.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

#### a) Mbi interpretimin në parim

5. Duke analizuar faktet, Gjykata vë në dukje që Z. Golder, pa iu mohuar formalisht e drejta për t'iu drejtuar një gjykate, ka qenë penguar në praktikë që të vërë në lëvizje në vitin 1970 procesin penal të menduar nga ai vetë. Ajo çmoi se neni 6 § 1, megjithëse nuk shpall në terma të shprehur një të drejtë për t'iu drejtuar gjykatave, e nënkupton të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate në lidhje me çështje civile, e cila përbën një aspekt të asaj që quhet «e drejta për proces të rregullt». Ajo e mbështet këtë përfundim, të motivuar gjerësisht, në tekstin dhe në kontekstin e nenit 6 § 1, në qëllimin dhe në objektin e Konventës dhe në disa parime të përgjithshme të së drejtës.

6. Ajo u frymëzua gjithashtu nga Konventa e Vjenës e 23 majit 1969, mbi të drejtën e traktateve, e cila nuk kishte hyrë ende në fuqi, por që megjithatë, nenet nga 31 deri më 33 të saj shpallnin në thelb disa rregulla të interpretimit, përgjithësisht të pranuar në të drejtën ndërkombëtare dhe të cilave Gjykata iu është referuar edhe në të kaluarën. Ashtu siç e parashikon edhe «rregulla e përgjithshme» e nenit 31 të Konventës së Vjenës, procesi i interpretimit të një traktati përbën një të tërë, një operacion të vetëm dhe kompleks. Ashtu siç saktëson edhe neni 31 § 2 i Konventës së Vjenës, preambula e një traktati përbën pjesë përbërëse të kontekstit të tij. Për më tepër ajo ofron normalisht një ndihmë të madhe për përcaktimin e «objektit» dhe të «qëllimit» të instrumentit që duhet interpretuar.

7. Në rastin tonë, fjalia më domethënëse në Preambulën e Konventës Evropiane është ajo ku qeveritë nënshkruese shprehën «të vendosura si qeveri të shteteve evropiane që shtyhen nga e njëjta frymë dhe që kanë një pasuri të përbashkët të idealeve dhe të traditave politike, të respektimit të lirisë dhe të shtetit të së drejtës, të marrin masat e para të duhura për të siguruar garancinë kolektive të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale» të 10 dhjetorit 1948. Pra, në qoftë se qeveritë nënshkruese kanë vendosur që «të marrin masat e para të duhura për të siguruar garancinë kolektive të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale», kjo për arsye të dedikimit të tyre të sinqertë ndaj parimit të shtetit të së drejtës. Duket sa e natyrshme aq edhe në përputhje me parimin e mirëbesimit (neni 31 § 1 i Konventës së Vjenës) që të mbahet parasysh kjo arsye, e shpallur me zë të lartë, kur bëhet interpretimi i termave të nenit 6 § 1 në kontekstin e tyre dhe nën dritën e objektit dhe të qëllimit të Konventës.

8. Në nenin e saj 31 § 3 (c) Konventa e Vjenës udhëzon që të mbahet parasysh, në të njëjtën kohë me kontekstin, edhe «çdo rregulli së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në marrëdhëniet ndërmjet palëve». Ndërmjet këtyre rregullave figurojnë «parimet e përgjithshme të së drejtës të njohura nga kombet e civilizuarat»<sup>8</sup>. Një parim sipas të cilit një pretendim i karakterit civil duhet çuar përpara një gjykatësi përmban një numër parimesh themelore të së drejtës të njohura në rang universal; në të njëjtin drejtim shkon edhe parimi i së drejtës ndërkombëtare i cili ndalon mohimin e dhënies së drejtësisë nga një gjykatë. Pra, neni 6 § 1, duhet lexuar nën dritën e tyre.

9. Gjykata theksoi se e drejta për t'iu drejtuar gjykatave nuk është absolute. Duke qenë se bëhet fjalë për një të drejtë që njihet nga ana e Konventës (shih gjithashtu nenet 13, 14, 17 dhe 25) por pa e përcaktuar, në kuptimin e ngushtë të fjalës ka vend edhe përtej kufijve që rrethojnë përmbajtjen e çdo të drejte, për kufizime që pranohen në mënyrë të nënkuptueshme.

*b) Mbi interpretimin në rastin konkret*

10. Gjykata refuzoi të ngrejë në këmbë një teori të përgjithshme të kufizimeve të pranueshme në rastin e të dënuarve me heqje lirie, dhe njëkohësisht të vendosë *in abstracto* në lidhje me pajtueshmërinë e rregullores së burgjeve me Konventën. Ajo angazhohet vetëm të vërë në dukje faktin se Z. Golder kërkonte që të hidhte poshtë një akuzë të ngritur kundër tij, pavarësisht nëse incidenti kishte ndodhur gjatë periudhës së heqjes së lirisë së tij, nëse kishte pasur të bënte me jetën e tij në burg apo nëse padia e parashikuar do të ishte drejtuar kundër një anëtari të personelit të burgjeve të vendosur nën autoritetin e Ministrisë të Brendshme.

11. Në këto kushte, i interesuari mund të donte me plotë të drejtë të hynte në kontakt me një avokat me qëllim që t'i drejtohej një organi gjyqësor dhe Ministri nuk kishte se çfarë të vlerësonte në lidhje me mundësitë e suksesit të kësaj padie. I përkiste një gjykatë të pavarur dhe të paanshme që të vendoste. Pra, ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

**B. Në lidhje me nenin 8**

12. Gjykata shqyrtoi në vijim ankesën në lidhje me nenin 8. Ajo gjykoi se edhe në qoftë se nuk ka pasur as ndërhyrje dhe as censurë të një mesazhi, siç mund të ishte një letër që Z. Golder do t'i kishte dërguar një avokati, një pengesë ndaj vetë mundësisë për të komunikuar përfaqëson formën më të rëndë të ndërhyrjes në ushtrimin e së drejtës për respektimin e korrespondencës. Ajo shtoi që kjo e drejtë nuk i nënshtrohet disa «kufizimeve të nënkuptuara» dhe që ajo nuk sheh se si paragrafi 2 i nenit 8 do të mund ta justifikonte vendimin e Ministrisë të Brendshme. Ajo arrin në përfundimin se mospranimi i kërkesës të bërë nga Z. Golder ka shkelur nenin 8.

<sup>8</sup> Neni 38, § 1 (c) i Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

13. Duke pasur parasysh që çështja e zbatueshmërisë së nenit 50 duhet marrë në shqyrtim (Komisioni nuk kishte paraqitur kërkesa nga ana e kërkuarit), Gjykata çmoi se konstatimi i një shkeljeje të dyfishtë të Konventës përbën në vetvete një shpërblim mjaftueshmërisht të drejtë.

### III. Koment

14. Kjo çështje është tepër e rëndësishme sepse sanksionon një parim tepër të rëndësishëm që bën pjesë në konceptin e procesit të rregullt gjyqësor – pikërisht mundësinë për të pasur akses ose për t’iu drejtuar gjykatave për mbrojtjen e pretendimeve përkatëse. Megjithatë nuk është i thënë shprehimisht as në nenin 6 dhe as në ndonjë nen tjetër të Konventës (mundësia për apel në çështjet penale parashikohet në nenin 2 të Protokollit 7) kjo e drejtë u konsiderua nga ana e Gjykatës së Strasburgut si një element thelbësor i së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, pa të cilin kjo e fundit nuk mund të kishte kuptim në vetvete. Është shumë interesant perifrasi që Gjykata i bën kësaj të drejte për Z. Golder në këtë rast i cili sipas saj duhet të kishte mundësi që pretendimet e tij të bazuara apo jo në lidhje me një të drejtë me karakter civil t’i ngrinte përpara një gjykate.

15. Ky konkluzion jo vetëm që frymëzohet nga një interpretim i Konventës i orientuar nga qëllimi dhe objekti i saj, por edhe nga parimi i rrënjësor në frymën e Konventës për një mbrojtje efektive dhe konkrete të të drejtave dhe jo vetëm iluzive. Nga ana tjetër, ai bën të qartë një teknikë tjetër të interpretimit të Konventës, atë të garancive të nënkuptuara<sup>9</sup>, duke ofruar interes edhe në lidhje me mënyrën e interpretimit funksional të neneve të Konventës. Duke i referuar mënyrës së interpretimit të një dispozite ndërkombëtare sipas Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve të vitit 1969, Gjykata ofroi edhe mënyrën sesi duhen kuptuar garancitë e ofruara nga ana e nenit 6 të Konventës por edhe të neneve të tjera të saj. Shumë interesante në këtë çështje është edhe teknika që përdor Gjykata duke iu referuar versionit zyrtar të Konventës i cili ofron qartësi më të madhe në lidhje me formulimin e dispozitës përkatëse<sup>10</sup>.

16. Nga ana tjetër, vendimi ofron një parim themelor për qëllimet e zbatimit të të drejtave të Konventës në kushtet e burgut – që të burgosurve ju hiqet vetëm liria por kjo nuk do të thotë që iu hiqen edhe të drejtat e tjera të njohura nga Konventa të cilat mund të respektohen edhe në kushtet e burgut. Pra një i burgosur vazhdon të gëzojë edhe në kushtet e burgut të drejta të tjera të njohura nga ana e Konventës, si e drejta për t’iu drejtuar gjykatave për çështje me karakter civil ose penal, ajo e këshillimit me avokatin e tij, apo të drejta të garantuara nga ana e nenit 8 të Konventës.

<sup>9</sup> Shih në lidhje me këtë teknikë interpretimi “Të Drejtat e Njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komentë”, fq. 46, Tiranë 2001. Kjo teknikë e interpretimit në këtë rast hasi në kundërshtimin e gjyqtarëve Fitzmaurice, Verdross dhe Zekia, të cilët në mendimin e tyre të pakicës u shprehën se në qoftë se shtetet palë do të kishin synuar që t’ju akordonin individëve një të drejtë të tillë për të pasur akses në gjykatat vendase atëherë do ta kishin parashikuar shprehimisht në Konventë.

<sup>10</sup> Shih paragrafin 32 të vendimit ku Gjykata i referohet shpesh versionit frëngjisht e madje edhe fjalorëve të gjuhës frënge por edhe angleze për të nxjerrë kuptimin e plotë të dispozitës.

## KUTIĆ kundër KROACISË

(kërkesa nr. 48778/99)

1 mars 2002

*vonesat e tejzgjatura në miratimin e legjislacionit të ri shkelnin të drejtën e kërkesit për t'iu drejtuar gjykatave*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkesit Vojin Kutić dhe Ana Kutić, janë të dy shtetas kroatë. Çështja ka të bëjë me pretendimet e tyre për kompensim, të paraqitura në Gjykatën e Rrethit të Zagrebit, në vijim të shpërthimeve të shumta që kishin shkatërruar pronën e tyre – shtëpinë e tyre në fshatin Martinec, Kroaci më 26 dhjetor 1991, dhe garazhin barakën bashkangjitur si dhe një depo për konservimin e mishit në Bjelovar, më 13 nëntor 1994. Gjykata e Zagrebit i pezulloi të dyja ankimet përkatëse në bazë të një amendamenti në Ligjin për Detyrimet Civile të miratuar nga Parlamenti Kroat në 17 janar 1996.

2. Amendamenti parashikonte, që të gjitha procedimet në lidhje me ankimet për dëme që rezultojnë nga akte terroriste të pezullohen deri në miratimin e një ligji të ri në lidhje me këtë subjekt. Duket se ka pasur disa kërkesa kushtetuese në këtë kuadër - ndonëse jo nga kërkesit - për ta kundërshtuar këtë amendament por Gjykata Kushtetuese ende nuk kishte marrë ndonjë vendim.

### II. Vendimi i Gjykatës

3. Kërkesit pretendonin, në mënyrë të veçantë, se ata nuk kishin pasur mundësi t'i drejtoheshin gjykatës, në kuptimin që atyre nuk iu dha mundësia të kishin një vendim gjyqësor në lidhje me pretendimet që kishin, për shkak të legjislacionit amendues të miratuar. Ata u ankuan gjithashtu në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave.

#### A. Në lidhje me nenin 6

4. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se kërkesit në çështjen në fjalë kishin pasur mundësi të fillonin proces gjyqësor; ata vetë kishin qënë në gjendje të padisnin shtetin në Gjykatën e Rrethit të Zagrebit për dëme shkaktuar pronës së tyre.

5. Sidoqoftë kujtoi Gjykata, kjo nuk i kënaq në vetvete kërkesat e nenit 6 § 1. Gjithashtu, duhet theksuar se shkalla e aksesit në gjykatë ishte e mjaftueshme për të siguruar “të drejtën për gjykatë” të individit, duke patur parasysh konceptin e shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike. Gjykata kujtoi se Konventa synon të garantojë jo të drejta që janë teorike apo iluzione por të drejta, që janë praktike dhe efektive.



6. Në këtë drejtim Gjykata ritheksoi se neni 6 § 1 i Konventës garanton të drejtën për t'iu drejtuar një gjykatë për të vendosur në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me karakter civil. Gjykata vlerësoi se kjo e drejtë për t'iu drejtuar gjykatave nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces por edhe të drejtën për të patur nga ana e një gjykatë një 'zgjidhje përfundimtare' në lidhje me mosmarrëveshjen. Do të ishte një iluzion në qoftë se një sistem i brendshëm ligjor i një shteti kontraktues do t'i lejonte një individ për të bërë padi civile pa siguruar, që çështja do të gjente zgjidhje me anë të një vendimi përfundimtar. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 § 1 të arrinte të përshkruante në detaje garancitë procedurale që u duhen njohur palëve në proces – karakterin e drejtë, publik dhe të shpejtë të procedurave – pa u garantuar atyre një zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjeve civile që mund të kenë.

7. Gjykata pranoi, që në një situatë kur kundër shtetit ishin paraqitur një numër domethënës pretendimesh për dëme mund të kishte nevojë për një rregullim të mëtejshëm. Por, në çështjen në fjalë, megjithëse procedurat ishin pezulluar për më se gjashtë vjet, më shume se katër nga të cilat pas hyrjes së Konventës në fuqi për Kroacinë, asnjë ligj i ri që tu lejonte kërkuesve që të kishin një zgjidhje mbi pretendimet e tyre nuk ishte kaluar nga ana e Parlamentit kroat. Për këtë arsye Gjykata konstatoi se ka patur një shkelje të nenit 6 § 1 (e drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me të drejtën e kërkuesve për t'iu drejtuar gjykatave. Ajo mbajti nga ana tjetër qëndrimin se nuk dilte në pah më vete ndonjë çështje në kuadrin e nenit 6 § 1 në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

8. Kërkuesve iu akorduan 10 000 euro për dëm jomaterial.

### **III. Koment**

9. Jo gjithmonë Gjykata e gjen të arsyeshme ta vlerësojë një kërkesë sipas termave të formuluar nga ana e kërkuesit. Disa herë ajo vendos që ta shqyrtojë çështjen vetëm nën dritën e një neni ose të vetëm një aspekti të tij dhe të vijoje duke deklaruar se nuk e sheh të arsyeshme ta shqyrtojë çështjen në fjalë nën dritën e paragrafëve të tjera të të njëjtit nen ose në bazë të Neneve të tjera të Konventës. Është mjaft interesant në këtë rast fakti se qeveria kroate nuk duket se u përpoq të argumentonte se miratimi i legjislacionit të amenduar do të nënkuptonte se kërkuesit nuk do të mundeshin më të pretendonin se kishin një pretendim civil në bazë të nenit 6 të Konventës<sup>11</sup>.

10. Në këtë çështje Gjykata vlerësoi se vonesat, që kishin rezultuar nga dështimi i qeverisë kroate për të nxjerrë legjislacionin, që ajo kishte premtuar dhe i cili do të kishte lejuar që çështja e kërkuesve të avanconte përpara gjykatave kroate, përbënte një shkelje të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe jo një shkelje të së drejtës për të patur një vendim brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata vuri në dukje se shtetet

<sup>11</sup> Shih vendimin e Gjykatës të 10 majit 2001 në lidhje me çështjen Z dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar.

gëzojnë një farë hapësire vlerësimi në miratimin e legjislacionit të ri që e shtyn për njëfarë kohe marrjen e vendimit për në lidhje me një numër të madh padish civile me objekt pretendimin e shumave të mëdha të parave ose zgjidhjen e situatave që nënkuptojnë kosto të mëdha sociale në ngarkim të shtetit. Në Itali, legjislacioni që parandalon ekzekutimin e vendimeve të gjykatave i cili u miratua për të rregulluar një problem urgjent në lidhje me shtëpitë e banimit nuk u konstatua në vetvete sikur shkelte Konventën. Ajo çfarë është e papranueshme për shtetin konsiston pikërisht në pasivitetin e tij për të zgjidhur problemin – pikërisht çfarë Kroacia bëri në rastin në fjalë.

## CRIȘAN kundër RUMANISË

(kërkesa nr. 42930/98)

27 maj 2003

*e drejta për t'iu drejtuar gjykatave për përcaktimin e të drejtave me karakter civil një personi të përndjekur gjatë regjimit komunist në Rumani*

### I. Faktet kryesore

1. Ioan Crișan është shtetas rumun i cili ka lindur më 1932 dhe jeton në Bukuresht. Më 1990 dhe 1993 ai i kërkoi Komisionit për Zbatimin e Dekretit Legjislativ nr. 118/90 që të konfirmonte se ai kishte statusin e personit të persekutuar për arsye politike gjatë periudhës së regjimit komunist. Kërkesa e tij e parë, në të cilën ai pohonte se kishte qenë subjekt i një hetimi policor dhe ishte hequr nga puna për motive politike, u refuzua nga ana e Komisionit. Sidoqoftë Komisioni pranoi kërkesën e tij të dytë duke njohur faktin që ai ishte mbajtur në institute për të sëmurë mendorë për 2 muaj dhe 25 ditë ndërmjet viteve 1973 dhe 1981, dhe i akordoi për këtë një kompensim të pagueshëm në këste mujore.

2. Kërkuesi u ankua kundër vendimeve të Komisionit në gjykatën e rrethit të Bukureshtit, ndërmjet të tjerash, për vlerësimin nga Komisionit të kohëzgjatjes së mbajtjes së tij në institutet për të sëmurë mendorë dhe për hedhjen poshtë të kërkesës së tij të parë. Gjykata e Rrethit në shtator 1995 vendosi që t'i bashkonte këto dy kërkesa. Gjithsesi gjykata e rrethit e në vijim edhe gjykata e apelit i hodhën poshtë këto pretendime me argumentimin se, që nga hyrja në fuqi më 1997 e Urdhrit për Emergjencat me nr. 41/1997 që amendonte Dekretin Legjislativ nr. 118/90, gjykatat nuk kishin më juridiksion për të rishikuar ligjshmërinë e vendimeve të Komisionit.

### II. Vendimi i Gjykatës

3. Duke u bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës kërkuesi ankohej ndaj refuzimit të gjykatave për të rishikuar ligjshmërinë e vendimeve të Komisionit. Ai pretendonte

gjithashtu se nuk kishte patur një mjet efektiv ankimor, gjë që ishte në kundërshtim me nenin 13 të Konventës.

#### *A. Në lidhje me nenin 6*

4. Gjykata vuri në dukje se për shkak të përbërjes së tij dhe të anëtarësimit të organit që rishikonte vendimet e tij, Komisioni nuk përmbushte kërkesat e pavarësisë si ndaj pushtetit ekzekutiv ashtu edhe ndaj palëve dhe prandaj nuk mund të konsiderohej si gjykatë në kuptimin e nenit 6 § 1 të Konventës. Për pasojë, me qëllim që të përmbusheshin kërkesat e kësaj dispozite, kërkuesi duhet të ishte në gjendje që t'ia nënshtronte vendimet e Komisionit një organi gjyqësor me juridiksion të plotë. Por gjykatat në të cilat ai u ankua vendosën se ato nuk ishin kompetente për të rishikuar ligjshmërinë e vendimeve të Komisionit për shkak të miratimit të një legjislacioni që u kufizonte juridiksionin ndërkohë që procedurat gjyqësore kishin filluar. Natyrisht që nuk ka qënë qëllimi i amendamenteve ligjore që t'i jepte përparësi njëres prej palëve në këtë çështje por në fakt rezultati i tyre ka qënë privimi i kërkuetit nga mundësia për t'ia nënshtruar vendimet në fjalë shqyrtimit të një organi gjyqësor me juridiksion të plotë.

5. Gjykata në vijim vuri në dukje se në vendimin e saj në lidhje me pranueshmërinë ajo kishte konstatuar se efektiviteti i ankimeve të mundshme për kërkuetin, në ndryshim nga sa pretendonte qeveria, nuk ishte provuar që të ishte në një shkallë të mjaftueshme.

6. Nën dritën e vlerësimeve të mësipërme, Gjykata vendosi se e drejta për t'iu drejtuar gjykatave ishte shkelur, duke mos respektuar kështu nenin 6 § 1 të Konventës. Ajo në vijim vendosi se nuk ishte e nevojshme ta shqyrtonte çështjen në bazë të nenit 13.

#### *B. Në lidhje me nenin 41*

7. Për qëllimet e shpërblimit të drejtë, Gjykata i akordoi kërkuetit 4 000 euro për dëm material dhe jo-material dhe 600 euro për shpenzime dhe pagesa.

### **III. Koment**

8. Ky vendim nxjerr edhe njëherë në pah se, kur kemi të bëjmë me përcaktimin e të drejtave që Konventa i konsideron si civile, shtetet janë të detyruara që të ofrojnë mundësinë për t'u ankuar pranë gjykatave që kanë juridiksion të plotë dhe që përmbushin kriteret e pavarësisë dhe paanësisë të parashikuara në nenin 6. Ndërsa nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me vendimin fillestar apo edhe me rishikimin e tij nga një organ administrativ, individi që pretendon se është i dëmtuar duhet të jetë gjithmonë në gjendje që vendimi dhe rishikimi i tij të rishqyrtohen nga një gjykatë e krijuar me ligj.

9. Ky vendim nuk është me rëndësi vetëm për situatën në të cilën u gjet Z. Crişan por gjen zbatim edhe në lidhje me situata të tilla si e drejta e një çifti të pamartuar

për t'iu drejtuar gjykatave për çështje që kanë të bëjnë me fëmijët e tyre. Gjykata e Strasburgut natyrisht që nuk mund të spekulojë në lidhje me rezultatin e çështjeve të tilla.

10. Nga ana tjetër vihet re se në rastet e ngjashme të mëparshme ajo iu ka akorduar 14 000 euro kërkuesve<sup>12</sup> nga Evropa përëndimore për pamundësi për t'iu drejtuar gjykatave. Në këtë çështje ajo akordoi vetëm 4 000 euro për një ankesë nga Rumania.

## ANAGNOSTOPOLOUS kundër GREQISË

(kërkesa nr. 54589/00)

3 prill 2003

*kjo çështje kishte të bënte me të drejtat e palëve civile në një proces penal*

### I. Faktet kryesore

1. Dionysios Anagnostopoulos është shtetas amerikan i cili ka lindur më 1945 dhe jeton në Athinë.

2. Më 1991 Banka Kombëtare Greke e njoftoi kërkuesin se një çek prej 8,000,000 dhrahmish greke që ishte paguar nga një ortak i kërkuesit në llogarinë bankare të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar që kërkuesi përfaqësonte ishte i falsifikuar dhe për këtë arsye banka nuk e konsideronte të depozituar shumën e lartpërmendur. Kërkuesi lëshoi dy çeqe personale për të mbuluar në llogari shumën përkatëse dhe i kërkoi bankës që t'i kthente çekun fallco. Përderisa çeku nuk iu kthye - banka pretendonte se kishte humbur - kërkuesi filloi një proces penal kundër kësaj të fundit. Banka nga ana tjetër bëri një kallëzim penal kundër kërkuesit për "përdorim dokumentesh fallco". Gjatë hetimit kërkuesi u çua përpara një gjyqtari dhe vuri re, duke parë dosjen gjyqësore, dokumente të ndryshëm përfshirë edhe çekun e falsifikuar të cilit nga mbrapa i ishte vënë një vulë dhe një nënshkrim.

3. Më 10 janar 1994 kërkuesi bëri një kallëzim penal kundër disa punonjësve të bankës duke pretenduar falsifikim dhe përgatitje dokumentesh fallco, veprime që ata i kishin kryer në qershor 1993. Në vijim ai kërkoi që të dilte si palë civile në procesin penal dhe kërkoi 15 000 dhrahmi greke shpërblim për dëm jomaterial. Personat e akuzuar u thirrën nga gjyqtari vetëm më 1998, pra katër vjet pasi ishte hapur dosja penale në ngarkim të tyre. Në kohën kur procedimi penal ndaj tyre kishte filluar, pra më 1994 aktet për të cilat ata akuzoheshin përbënin "krime" dhe parashkruheshin për 15 vjet. Më 1996 ligji përkatës u amendua dhe këto akte u riklasifikuan si "kundravajtje penale" dhe parashkruheshin për një afat pesë vjeçar. Më 21 dhjetor 1998 Prokurori i

<sup>12</sup> Shih për shembull vendimin e datës 10 prill 2003 në lidhje me çështjen Sigurdsson kundër Islandës.

Gjykatës Penale të Athinës vendosi se ndjekja penale e akteve për të cilat punonjësit e bankës akuzoheshin se i kishin kryer më 1993 ishte parashkruar. Ky vendim u la në fuqi nga Prokurori i Gjykatës së Apelit të Athinës më 19 tetor 1999.

4. Gjykatat penale nuk mundën ta dërgonin ankesën civile të kërkuesit në gjykatat civile për shkak se shuma e kërkuar ishte më pak se 15 000 dhrahmi greke (rreth 45 euro). Megjithatë parashkrimi i ndjekjes penale nuk pati të njëjtin efekt edhe ndaj ankesës me karakter civil të kërkuesit.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Duke u bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës, kërkuesi pretendoi se për shkak të qëndrimit të autoriteteve gjyqësore që bënë që të parashkruheshin veprat penale, personat e akuzuar nuk u gjykuan për veprat që kishin kryer.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

6. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e mori në shqyrtim këtë çështje nga këndvështrimi i konceptit të mundësisë për t'iu drejtuar një gjykate. Ajo ishte dakord me sugjerimin e qeverisë që kërkuesi mund të kishte bërë ankim civil për të përfituar dëmshpërblim për dëmin e pësuar dhe në këtë rast nuk do të kishte pasur asnjë problem përse i përket mundësisë për t'iu drejtuar gjykatave.

7. Megjithatë, Gjykata i kushtoi vëmendje të veçantë rrethanave vijuese. Veprat penale për të cilat akuzoheshin punonjësit e bankës ishin kryer në qershor 1993. të akuzuarit ishin thirrur katër vjet pas bërjes së kallëzimit dhe pesë vjet pas kryerjes së veprave dhe për pasojë ato ishin parashkruar. Për më tepër, një ligj i ri i miratuar më 1996 i kishte deklasifikuar këto vepra nga krime në kundravajtje penale duke e ulur periudhën e parashkrimit. Së fundmi, kërkuesi kishte paraqitur një pretendim për një dëmshpërblim prej 15 000 dhrahmish dhe për një shumë të tillë, sipas Kodit të Procedurës Penale, gjykatat penale duhet të merrnin në shqyrtim të gjitha rrethanat pa qenë të detyruara t'ia përcillnin çështjen gjykatave civile. Në këtë drejtim, Gjykata vlerësoi se në rastet kur sistemi ligjor shtetëror u ofronte palëve një ankim të tillë si mundësia për të bërë një kallëzim penal dhe për të dalë si palë civile në të njëjtën çështje, shteti është i detyruar që të sigurojë gëzimin prej këtyre palëve të garancive themelore të parashikuara në Nenin 6.

8. Në çështjen aktuale, vonesa me të cilën autoritetet përkatëse e morën në shqyrtim çështjen kishte bërë që ndjekja e veprave penale të parashkruhej dhe për pasojë, bëri të pamundur që të merrej një vendim në lidhje me pretendimin e kërkuesit për dëmshpërblim. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, nuk mundet që një palë të lihet të presë që pretendimet e tij të parashkruhen për faj të autoriteteve gjyqësore duke argumentuar se pastaj ai mund ta ngrinte të njëjtin pretendim në një çështje civile. Për këto arsye Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe se konstatimi i shkeljes në vetvete përbënte, në kuadrin e nenit 41 të Konventës, një shpërblim të drejtë për dëmin jo-pasuror të pësuar nga kërkuesi nga kjo shkelje.

### III. Koment

9. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e vlerësoi këtë çështje vetëm nën këndvështrimin e mundësisë për t'iu drejtuar një gjykatë dhe jo, siç do të kishin preferuar gjyqtarët e pakicës në gjirin e saj, nën këndvështrimin e kohëzgjatjes së pajustificueshme të një procesi gjyqësor. Kjo kryesisht për shkak se kjo çështje ishte deklaruar e pranueshme nga një Dhomë që përfshinte edhe gjyqtarët e pakicës si një 'çështje mbi mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës'. Kur një Dhomë e Gjykatës e deklaroi të pranueshme një kërkesë, ajo mund ta pranojë nën një aspekt të caktuar të nenit që pretendohet se është shkelur në qoftë se e mendon të përshtatshme. Por kur e merr në shqyrtim çështjen në lidhje me themelin e saj Gjykata duhet të vendosë vetëm mbi ato aspekte të kërkesës që janë deklaruar si të pranueshme<sup>13</sup>.

10. Gjyqtarët e pakicës në këtë çështje vlerësuan se nuk mund të arrihej në përfundimin se kërkuessit i ishte mohuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatave përderisa ai kishte pasur mundësi për të bërë një padi civile dhe se vendimi i dhënë nga Gjykata shënonte një ndryshim në jurisprudencën e Gjykatës, gjë që kërkon një vendim nga Dhoma e Madhe.

11. Shumica e gjyqtarëve të Dhomës ritheksuan një qëndrim tepër interesant të Gjykatës sipas të cilit një individ të cilit i janë cenuar të drejtat nuk ka një të drejtë të përgjithshme për të insistuar që të fillojë apo të përfundojë me sukses procedimi penal ndaj personave të dyshuar<sup>14</sup>. Megjithatë, ata theksuan se në rastet kur një individ ka dalë si palë civile në një proces penal ai ka një të drejtë legjitime të procesi të zhvillohet dhe të përfundojë me zellin e nevojshëm për përcaktimin e pretendimeve të tij civile. Ky vendim shton një element tjetër në kërkesat e nenit 6 në lidhje me proceset penale duke ripohuar të drejtat e palëve civile në kuadrin e këtyre proceseve.

<sup>13</sup> Shih Nenin 29 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

<sup>14</sup> Megjithatë duhet pasur kujdes në këtë kuadër nga detyrimi për një procedim efektiv i cili ka rëndësi të veçantë në interpretimin e Neneve 2, 3, 5, 6, 8, etj të Konventës nën këndvështrimin e detyrimit pozitiv të shtetit të interpretuar në bazë të Nenit 1 të Konventës.



**MCELHINNEY kundër IRLANDËS, AL-ADSANI kundër  
MBRETËRISË SË BASHKUAR DHE FOGARTY kundër  
MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(kërkesat nr. 31253/96, 35763/97 dhe 37112/97)

**21 nëntor 2001**

**Dhomë e Madhe**

*në këtë çështje kemi të bëjmë me debatin tepër interesant të mohimit të mundësisë për t'iu drejtuar gjykatës për shkak të zbatimit të doktrinës së imunitetit shtetëror*

**I. Faktet kryesore**

*i) Mc Elhinney kundër Irlandës*

1. John McElhinney është një polic irlandez i lindur më 1944 në Greencastle. Në vijim të një incidenti në Mars 1991 në kufirin me Irlandën e Veriut, gjatë të cilit një ushtar britanik u mor këtej kufirit duke u tërhequr me kavo me automjetin e kërkuesit, ku ky i fundit pretendonte se ishte sulmuar nga ushtari në Republikën e Irlandës. Rrethanat e sakta të incidentit nuk janë të qarta dhe debatoheshin ndërmjet palëve. Sidoqoftë kërkuesi në vijim të arrestimit me dyshimin e konsumimit të një sasive të tepërt alkooli, u ndoq penalisht dhe u dënua për refuzimin e tij për të lejuar analizat e gjakut dhe të urinës së tij. Në qershor 1993 kërkuesi paraqiti një padi kundër ushtarit dhe Qeverisë Britanike duke kërkuar edhe dëmshpërblim. Gjykata e Lartë Irlandeze e pranoi pretendimin e Qeverisë Britanike për hedhjen poshtë të padisë, duke zbatuar doktrinën e imunitetit sovran, me argumentimin se kërkuesi nuk kishte të drejtë të ngrinte një padi përpara gjykatave Irlandeze kundër një pjestari të një qeverie të huaj sovrane. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata Supreme Irlandeze.

*ii) Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*

2. Kërkuesi Sulaiman Al-Adsani, i cili kishte një shtetësi të dyfishtë britanike dhe Kuvajtiane, kishte lindur më 1961 dhe jeton në Londër. Ai është pilot. Kërkuesi shërbente në Forcat Ajrore Kuvajtiane gjatë Luftës së Gjirit Persik dhe, pas pushtimit Irakian, ai qëndroi në Kuvajt si pjestar i lëvizjes së rezistencës kuvajtiane. Atij i ranë në dorë videokaseta me filmime marrëdhëniesh seksuale që kompromentonin Sheikun Jaber, i cili ishte pjestar i familjes së Emirit të Kuvajtit. Në rrugë të paqartësuar ende këto videokaseta u futën në një qarkullim të përgjithshëm dhe për këtë Sheiku konsideroi si përgjegjës kërkuesin. Më ose rreth 2 majit 1991, Sheiku dhe dy persona të tjerë u futën në shtëpinë e kërkuesit, e goditën dhe nën kërcënimin e armëve e morën në një Jeep dhe e çuan në Burgun e Sigurimit të Shtetit të Kuvajtit, ku ai u mbajt i mbyllur në një gjendje të keqe për disa ditë me rradhë dhe ku vazhdimisht ishte rrahur nga rojet e burgut. Ai u lirua më 5 maj 1991, pasi ishte detyruar që të

nënshkruante një dëshmi të rreme. Rreth datës 7 maj 1991 Sheiku e mori përsëri kërkuesin nën kërcënimin e armës dhe me një automjet qeveritar e çoi në palatin e vëllait të Emirit të Kuvajtit. Atje kërkuesit ia zhytnin vazhdimisht kokën në një pishinë noti ku kishte kufoma dhe pastaj ai u tërhoq me forcë në një dhomë të vogël në të cilën Sheiku i vuri zjarrin dyshekëve që i kishte njomur më parë me naftë. Kërkuesi kaloi gjashtë javë në një spital në Londër ku u mjekua për djegie që kishin përfshirë 25% të trupit të tij. Ai vuante gjithashtu dëme psikologjike dhe ishte diagnostikuar se vuante nga një formë e rënduar çrregullimi dhe stresi post-traumatik.

3. Në gusht 1992 ai bëri një padi civile në Angli për kompensim, kundër Qeverisë Kuvajtiane dhe Sheikut dhe, në dhjetor 1992, padia kundër Sheikut nuk upranua për mosparaqitje të tij. Në janar 1994 Gjykata e Apelit akordoi një rihapje të procesit duke lejuar thirrjen me shkrim drejtuar Qeverisë Kuvajtiane. Në maj 1995 Gjykata e Lartë vendosi që padia të mos pranohej me konstatimin se imuniteti shtetëror gjente zbatim në këtë rast në bazë të Ligjit të Imunitetit Shtetëror të vitit 1978, i cili iu akordonte imunitet shteteve sovraane për akte të kryera jashtë juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar, pa ndonjë përjashtim qoftë edhe në rastin e akteve të torturës. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit dhe kërkuesit iu refuzua apelimi në House of Lords<sup>15</sup>. Përpyekjet e kërkuesit për të arritur pagimin e kompensimit nga autoritetet kuvajtiane në rrugë diplomatike u provuan që të ishin të pasuksesshme.

*iii) Fogarty kundër Mbretërisë së Bashkuar*

4. Mary Fogarty është shtetase irlandeze, e lindur më 1959 dhe jeton në Londër. Më 8 nëntor 1993 ajo filloi të punonte si asistente administrative në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Londër, në Shërbimin e Transmetimit të Jashtëm të Informacionit, që është një degë e Agjencisë Qendrore të Informacionit (CIA). Pasi u pushua nga puna në shkurt 1995, ajo filloi një proces gjyqësor kundër Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Ajo pretendonte se pushimi i saj kishte qënë rezultat i diskriminimit seksual, që ishte në kundërshtim me Ligjin mbi Diskriminimin Seksual të vitit 1975, duke pretenduar se kishte vuajtur nga ngacmime të vazhdueshme seksuale nga eprori i saj dhe se, si pasojë, marrëdhëniet e punës ishin ndërprerë. Më 13 maj 1996 gjykata e pranoi ankimin e saj dhe ajo përfitoi 12.000 sterlina si kompensim.

5. Në qershor 1996 dhe në gusht 1996 ajo aplikoi përsëri për dy poste në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara por pa sukses. Më 15 shtator 1996 ajo bëri një ankim të dytë pranë gjykatës, duke pretenduar se Ambasada kishte refuzuar që ta ripunësonte për shkak të ankimit të saj të mëparshëm mbi diskriminimin seksual, që kishte qënë pra i suksesshëm, gjë që, sipas saj, përbënte diskriminim dhe i shkaktonte asaj një dëm të ndaluar në bazë të Ligjit të vitit 1975. Në 6 shkurt 1997 kërkuesja u këshillua se qeveria e Shteteve të Bashkuara kishte të drejtë të pretendonte iminitetin e saj në bazë të Ligjit të Imunitetit Shtetëror të vitit 1978, i cili u akordon imunitet nga procedimi gjyqësor stafit administrativ dhe teknik të një misioni diplomatik në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me kontratat e tyre të punësimit.

<sup>15</sup> Përbën juridiksionin më të lartë gjyqësor në Mbretërinë e Bashkuar.

## II. Vendimi i Gjykatës<sup>16</sup>

6. Z. McElhinney kryesisht ankohej se, duke zbatuar doktrinën e imunitetit sovran gjykatat irlandeze i kishin mohuar atij të drejtën për një zgjidhje gjyqësore të pretendimit të tij për kompensim, duke shkelur kështu nenin 6 § 1 të Konventës.

7. Z. Al-Adsani pretendonte se Mbretëria e Bashkuar nuk kishte arritur të garantonte të drejtën e tij për të mos u torturuar, të ndaluar nga ana e nenit 3, të interpretuar së bashku me nenet 1 dhe 13. Ai ankohej gjithashtu për shkelje të së drejtës së tij për t'iu drejtuar gjykatës të garantuar nga neni 6 § 1.

8. Znj. Fogarty ankohej, duke u bazuar në nenet 6 § 1 dhe 14, për pamundësi për t'iu drejtuar gjykatës dhe për diskriminim e ushtruar ndaj saj.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

9. Gjykata vuri në dukje se imuniteti sovran është një koncept i së drejtës ndërkombëtare, në bazë të të cilit një shtet nuk është subjekt i juridiksionit të një shteti tjetër<sup>17</sup>. Ajo vlerësoi se akordimi i imunitetit sovran një shteti në procese civile ishte një akt që ndiqte qëllimin e ligjshëm të respektimit të së drejtës ndërkombëtare për të nxitur bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e mira ndërmjet shteteve nëpërmejt respektimit të sovranitetit të një shteti tjetër.

10. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhet interpretuar sa më tepër që të jetë e mundur në harmoni me normat e tjera të së drejtës ndërkombëtare, pjesë e së cilës ajo është, përfshirë këtu edhe ato norma që kanë të bëjnë me imunitetin shtetëror. Si pasojë mund të thuhet se masat që pasqyrojnë norma përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare publike në lidhje me imunitetin shtetëror nuk mund të shiheshin në parim sikur vendosnin një kufizim joproporcional ndaj të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës siç parashikohet në nenin 6 § 1 të Konventës.

### i) *McElhinney kundër Irlandës*

11. Duket se ka një tendencë të përgjithshme në të drejtën ndërkombëtare dhe të krahasuar ndaj kufizimit të sovranitetit shtetëror në respektim të një cënimi të një

<sup>16</sup> Në këtë kuadër na duket me vend të kujtojmë se, në përputhje me nenin 43 të Rregullores së saj të Brendshme, Gjykata, mund të marrë në shqyrtim dhe të vendosë të bashkojë kërkesa të veçanta. Sipas këtij Neni, të titulluar "Bashkimi dhe shqyrtimi i njëkohshëm i kërkesave":

"1. Dhoma mundet që, qoftë me kërkesën e palëve ose me nismën e vet, të urdhërojë bashkimin e dy ose më shumë kërkesave.

2. Presidenti i Dhomës, pas këshillimit me palët, mund të urdhërojë që procedurat në kërkesa që i janë caktuar të njëjtës Dhomë të ndiqen njëkohësisht, pa cënuar vendimin e Dhomës në lidhje me bashkimin e kërkesave."

Pikërisht ky ka qënë rasti edhe në kuadrin e vendimit që po analizojmë ku të tre kërkesat e veçanta kishin në thelb një çështje juridike të përbashkët – imunitetin shtetëror ndaj procedimit gjyqësor.

<sup>17</sup> Shih në këtë kuadër Konventën e Vjenës së vitit 1961 'Mbi Marrëdhëniet Diplomatike' dhe Konventën e Vjenës së Vitit 1963 'Mbi Marrëdhëniet Konsullore', të dyja në ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

personi të shkaktuar nga një veprim ose mosveprim brenda juridiksionit të shtetit ku ka ndodhur çënimi, por një praktikë e tillë nuk mund të thuhej aspak se ka karakter universal. Në vijim, duket se kjo tendencë i referohet në radhë të parë me dëme personale 'të sigurueshme', siç janë incidentet që vijnë si pasojë e aksidenteve normale të trafikut, dhe jo aq çështjeve që kanë të bëjnë me vetë thelbin e sovranitetit shtetëror, të tilla si aktet e një ushtari në territor të huaj, të cilat për vetë natyrën e tyre mund të angazhojnë probleme shumë të ndjeshme që prekin marrëdhëniet diplomatike ndërmjet shteteve si dhe sigurimin kombëtar. Gjykata u shpreh në favor të qëndrimit të Gjykatës Supreme Irlandeze, duke patur parasysh stadin aktual të zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare, nuk ishte e mundur të arrihej në përfundimin se e drejta irlandeze vinte në kundërshtim me parimet e saj të përgjithshme.

12. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se kërkuesi kishte pasur mundësinë që të ngrinte në Irlandën e Veriut një padi kundër Sekretarit Britanik të Shtetit për Mbrojtjen. Gjykata kujtoi në lidhje me këtë se ajo e kishte konsideruar të papranueshme për mos-shërim të mjeteve të brendshme, ankimin e kërkuesit sipas të cilit ai nuk kishte patur mundësi të ngrinte një padi kundër Mbretërisë së Bashkuar në Irlandën e Veriut.

13. Për këto arsye, vendimet e gjykatave irlandeze që kishin pranuar pretendimin e Mbretërisë së Bashkuar për imunitet nuk mund të thuhej se kishin tejkaluar hapësirën e vlerësimit që u lejohet shteteve në kufizimin e së drejtës së individëve për t'iu drejtuar gjykatave. Pra nuk ka patur shkelje të nenit 6 § 1.

*ii) Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*

14. Duke theksuar rëndësinë gjithnjë e më të madhe që i kushtohet ndalimit të torturës, Gjykata nuk arriti të konstatonte se kishte një qëndrim të tillë në të drejtën ndërkombëtare sipas të cilit shtetet nuk kishin të drejtë për shkak të imunitetit sovran të shqyrtononin pretendimet me karakter civil për dëme ose torturë, të kryera jashtë shtetit të fori-t<sup>18</sup>. Ligji britanik i vitit 1978, i cili u akordonte imunitet shteteve në lidhje me pretendimet individuale për dëme përveç rasteve kur dëmi ishte shkaktuar brenda Mbretërisë së Bashkuar, nuk ishte në kundërshtim me ato kufizime përgjithësisht të pranura nga bashkësia e shteteve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror. Zbatimi nga ana e gjykatave angleze i dispozitave të Ligjit të vitit 1978 për të pranuar pretendimin e Kuvajtit për imunitet të tij nuk mund të thuhej, se arrinte të përbënte një kufizim të pajustificuar të së drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar gjykatës. Si pasojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1.

*iii) Fogarty kundër Mbretërisë së Bashkuar*

15. Gjykata shprehet se duket të ketë një tendencë të përgjithshme në të drejtën ndërkombëtare dhe të krahasuar që synon drejt kufizimit të imunitetit shtetëror në raport me mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës. Megjithatë,

<sup>18</sup> Fori - term latin që përdoret, veçanërisht në të drejtë ndërkombëtare private por edhe publike, për të treguar juridiksionin sidomos gjyqësor dhe administrativ i cili është kompetent për të marrë në shqyrtim një çështje të caktuar kryesisht për shkak të kompetencës territoriale.

në një rast kur procesi ka të bëjë me punësimin në një mision të huaj ose në një ambasadë, praktika ndërkombëtare ishte e ndarë në lidhje me pyetjen nëse imuniteti shtetëror vazhdonte të gjente zbatim në këtë plan dhe, në qoftë se po, nëse ai mbulonte mosmarrëveshjet që kishin të bënin me kontratat e të gjithë stafit apo vetëm me personelin e lartë të misionit. Natyrisht që nuk mund të thuhet se Mbretëria e Bashkuar ishte i vetmi vend që mbante qëndrimin se imuniteti kishte të bënte me ankimet e bëra nga të punësuarit në misionet diplomatike ose që, duke njohur veprimin e imunitetit në këtë rast, Mbretëria e Bashkuar ishte jashtë çdo standarti të pranuar nga e drejta ndërkombëtare në fazën e tanishme të zhvillimit të saj.

16. Procedimi që kërkuesja synonte të fillonte nuk kishte të bënte, nga ana tjetër, me të drejtat e saj kontraktuale si e punësuar e ambasadës, por me diskriminimin e pretenduar në procesin e marrjes në punë. Çështjet që kanë të bëjnë me marrjen në punë dhe me zgjedhjen e stafit nga ana e misioneve dhe ambasadave nga vetë natyra e tyre mund të përfshijnë probleme shumë të ndjeshme dhe konfidenciale, që lidhen me politikën diplomatike dhe organizative të shtetit të huaj.

17. Për këto arsye Gjykata vlerësoi se, duke i njohur imunitet Shteteve të Bashkuara të Amerikës në rastin në fjalë në bazë të dispozitave të Ligjit të vitit 1978, nuk mund të thuhet se Mbretëria e Bashkuar kishte kapërcyer hapësirën e vlerësimit që u lejohet shteteve në kufizimin e së drejtës së individëve për t'iu drejtuar gjykatave. Për pasojë pra Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte patur shkelje të nenit 6 § 1.

### **B. Në lidhje me nenin 3**

18. Në çështjen Al-Adsani kërkuesi nuk pretendoi se tortura për të cilën ai ankohej kishte gjetur vend brenda juridiksionit të Mbretërisë së Bashkuar ose se autoritetet britanike kishin patur ndonjë lidhje, qoftë edhe të rastësishme, me ushtrimin e saj. Në këto rrethana, nuk mund të thuhet se Mbretëria e Bashkuar ishte nën detyrimin për t'i ofruar një mjet ankimor civil kërkuesit në lidhje me torturën nën të cilën ai pretendonte se e kishin nënshtruar autoritetet kuvajtiane. Për këtë arsye rridhte se nuk kishte patur shkelje të nenit 3 të Konventës.

### **C. Në lidhje me nenin 14**

19. Në kuadrin e çështjes Fogarty Gjykata kujtoi se kërkueses nuk i ishte lejuar që të përvijonte ankimin e saj në gjykatë në bazë të neneve 1 dhe 16 § 1 (a) të Ligjit të vitit 1978, i cili njihte imunitetin juridiksional në lidhje me procedurat që kishin të bënin me marrjen në punë të stafit të ambasadave. Ky imunitet gjente zbatim në lidhje me të gjitha mosmarrëveshjet e punës të një karakteri të tillë, pavarësisht nga objekti i tyre apo seksi, shtetësia, vendbanimi apo cilësi të tjera, eventualisht të veçanta, të kërkuesit. Për pasojë mund të thuhet se kufizimi që i ishte bërë të drejtave të saj për t'iu drejtuar gjykatave nuk kishte karakter diskriminues dhe se nuk ka patur shkelje të nenit 14 të interpretuar së bashku me nenin 6 § 1 të Konventës.

### III. Koment

20. Impakti i këtyre tre vendimeve tepër të rëndësishme duhet thënë se do të ndihet edhe shumë larg Evropës, për shkak se ato kanë vlerë të jashtëzakonshme për një nga pjesët më interesante të së drejtës ndërkombëtare publike – të drejtën diplomatike<sup>19</sup> – dhe se e shtrijnë efektin mbi koncepte themelore të së drejtës publike dhe private siç është ai i juridiksionit. Të tre këto çështje kishin të bënin me ankime që kërkuesit kishin bërë për shkak se u ishte mohuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatave në përpjekjet e tyre për të filluar procese kundër qeverive të huaja në gjykata e brendshme. Të gjitha këto gjykata kishin mbajtur qëndrimin se doktrina e imunitetit shtetëror gjente zbatim në një mënyrë të tillë që pengonte marrjen në shqyrtim të padive që kishin ngritur kërkuesit përpara tyre. Gjykata Evropiane konstatoi se nuk kishte patur shkelje të Konventës në asnjërin prej rasteve. Sidoqoftë duhet thënë se në dy nga këto raste Gjykata ishte ndarë qartë në dy pjesë në marrjen e vendimit dhe ky, për mosshkelje pra, u mor me një shumicë të vogël.

21. Siç e thamë, zbatimi i një ndalese të tillë në tendencën në zhvillim e sipër të kufizimit të imunitetit shtetëror u jep këtyre rasteve një rëndësi themelore për juristët e së drejtës ndërkombëtare publike të përgjithshme. Por ka gjithashtu edhe çështje shumë interesante për juristët specialistë të Konventës.

22. Në çështjen Fogarty Gjykata vlerësoi se kishte një 'shkak për të ngritur një padi sipas së drejtës Angleze' i mbuluar nga një status imuniteti, por që fatkeqësisht Gjykata nuk u shpreh në lidhje me faktin nëse kishim të bënim në këtë rast me një mosmarrëveshje të "karakterit të një të drejte civile"<sup>20</sup>. Jurisprudenca e vazhdueshme e Gjykatës në këtë drejtim ka qënë ajo sipas së cilës në qoftë se nuk kishte një 'të drejtë me karakter civil' si objekt të mosmarrëveshjes, neni 6 nuk mund të gjente zbatim dhe për këtë arsye ishte e panevojshme të vlerësohej nëse kishte patur apo jo shkelje të këtij neni. Gjykata e ka marrë në shqyrtim paraprakisht këtë fushë në lidhje me punësimin në shërbimin civil në çështjet Pelligrin kundër Francës, vendim i 8 dhjetorit 1999 dhe Frydlander kundër Francës, vendim i 27 qershorit 2000. Gjykata duket se donte të merrte në shqyrtim çështjen shumë të rëndësishme të imunitetit shtetëror në kuadrin e tre rasteve të mësipërme dhe për këtë arsye vijoi me marrjen në shqyrtim të tyre duke prezumuar, në një mënyrë jo të preferueshme për ne<sup>21</sup>, se neni 6 gjente zbatim. Përderisa faktet e kësaj çështjeje kishin të bënin me marrjen në punë dhe jo me një punonjës në funksion e sipër një vendim i Gjykatës në lidhje me këtë çështje do të kishte qënë tepër i rëndësishëm për të sqaruar jurisprudencën e

<sup>19</sup> Kujtojmë për shembull vendimin e House of Lords në çështjen Pinoçet, e cila e justifikon, kujtojmë, mosndjekjen penale dhe mos-ekstradimin, jo me imunitetin e tij si ish-kryetar shteti, por me pamundësinë e tij fizike dhe morale për shkak të moshës dhe sëmundjes, për të përballuar një proces gjyqësor. Në këtë kuadër nuk mund të mos kujtohet gjithashtu procedimi në vijim e sipër i Millosheviçit në Tribunalin e Krimeve në Ish-Jugosllavi, në vijim e sipër.

<sup>20</sup> Shih Nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

<sup>21</sup> Pasi edhe çështja e karakterit civil të të drejtave sidomos në marrëdhëniet e punës në sektorin publik jo vetëm që është shumë e diskutueshme edhe në vetë gjirin e Gjykatës por paraqet rëndësi potenciale edhe për çështje shqiptare.



mëparshme të saj si dhe për çështje të tjera të mëpasme që mund të mos kenë të bëjnë me imunitetin shtetëror. Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare e ka bërë të qartë që imuniteti shtetëror nuk duhet përdorur si argument për përjashtim nga juridiksioni në mosmarrëveshje pune që kanë të bëjnë me të punësuar lokal në shtetin e fori-t.

23. Në çështjen McElhinney faktet që çuan në ngritjen e padive përpara gjykatave të brendshme kishin ndodhur në Irlandë. Qeveria irlandeze i kishte njohur imunitet Mbretërisë së Bashkuar edhe pse e drejta angleze nuk do t'ia kishte njohur qeverisë irlandeze në qoftë se aktet objekt i padisë do të ishin kryer nga pjesarë të qeverisë irlandeze në territorin e Mbretërisë së Bashkuar. Në këtë rast pati pesë gjyqtarë që dhanë mendim të kundërt, tre nga të cilët mbështeteshin, në mendimet e tyre, pikërisht në këtë fakt. Kurse shumica ishte e mendimit se nuk kishte pengesë për njohjen e imunitetit përderisa veprimet nuk ishin kryer nga një civil por nga një ushtar. Nuk duket që e drejta britanike të bënte ndonjë dallim në këtë drejtim.

24. Në çështjen Al Adsani ngjarjet e pretenduara kishin ndodhur në një shtet të huaj i cili ishte paditur në gjykatat britanike. Çështja në këtë rast ishte nëse ndalimi universal i torturës, që tashmë bën pjesë në *ius cogens*, duhet të vepronte në një mënyrë të tillë sa të fitonte përparësi ndaj normave të tjera të së drejtës ndërkombëtare duke e bërë kështu njohjen e imunitetit të papajtueshme me qëllimin e ligjshëm që ndiqej ose qoftë edhe jo në proporcion me të. Në këtë kuadër një referencë e zgjeruar iu bë vendimeve të Tribunalit Penal për Krimet në ish-Jugosllavi.

25. Një sërë problemesh me interes për Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dalin në pah në këtë vendim përveç interesit që ky ka edhe për të drejtën ndërkombëtare publike. Është një jurisprudencë e konsoliduar tashmë në kuadrin e Konventës ajo sipas së cilës shtetet kanë përgjegjësi në kuadrin e nenit 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimeve degraduese ose çnjerëzore) për dëbim ose ekstradim të një personi që mund t'i nënshtrohet trajtimeve ose kushteve çnjerëzore ose degraduese në një shtet tjetër<sup>22</sup>. Shtetet janë gjithashtu të përgjegjshme për akte, që ato kryejnë në territore të huaja në të cilat ato ushtrojnë juridiksionin e tyre<sup>23</sup>. Në rastet kur të dëmtuarit ose të afërmit e viktimave nuk janë në gjendje të venë në vend pretendimet e tyre me karakter civil për vrasje të paligjshme ose akte torture apo trajtimeve të ndaluara me ligj të kryera brenda juridiksionit të një shteti anëtar të Këshillit të Evropës, qoftë edhe nga persona që nuk veprojnë nën autoritetin shtetëror por në raste kur shteti mund të konsiderohet përgjegjës, Gjykata ka konstatuar edhe shkelje të neneve 3 dhe 13<sup>24</sup>. Në raste kur, si edhe ky që po komentojmë sipas mendimit të Gjykatës, nuk ka edhe një të drejtë me karakter civil të njohur në të drejtën e brendshme, është konstatuar shkelje e nenit 6 edhe kur është akorduar

<sup>22</sup> Shih vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, të 7 korrikut 1989, të përfshirë në këtë përmbledhje.

<sup>23</sup> Shih vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen Loizidou kundër Turqisë, të 18 dhjetorit 1996, të përfshirë në këtë përmbledhje.

<sup>24</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjen Z kundër Mbretërisë së Bashkuar të 10 majit 2001, të përfshirë në këtë botim.

një imunitet joproporcional<sup>25</sup>. Ky rast paraqiste në fakt një mundësi për për t'i sjellë këto dy mënyra argumentimi afër e afër, por shumica e Gjykatës nuk e pranoi këtë gjë. Kjo shumicë vlerësoi se as neni 3 dhe as neni 6 nuk përbënin një pengesë për t'u akorduar shteteve të huaja imunitet nga procedimi civil në raste kur tortura ka ndodhur jashtë shtetit të juridiksionit. Kjo shumicë vlerësoi se, megjithëse kishte një tendencë të qartë në këtë drejtim, nuk kishte ende një normë të konsoliduar të së drejtës ndërkombëtare që t'i pengonte shtetet që të njihnin imunitet në procedimet civile në qoftë se ato dëshironin ta bënin një gjë të tillë<sup>26</sup>. Sidoqoftë duhet kujtuar se nuk është ky rasti edhe për procedimin penal dhe sidomos për norma që kanë fituar karakterin ius cogens. Gjyqtarët e shumicës nuk vlerësuan nëse ishte e përshtatshme për Gjykatën që të ishte juridiksioni që ta çonte këtë tendencë në një normë të së drejtës ndërkombëtare. Mendimet e veçanta të dy gjyqtarëve<sup>27</sup> i detajojnë edhe më tepër disa nga konceptimet e Gjykatës. Ata ishin veçanërisht të shqetësuar se konstatimi i një shkeljeje mund të dekurajonte shtetet për t'u përshtatur me detyrimet e tyre në të drejtën ndërkombëtare të refugjatëve, në qoftë se pra një konstatim i tillë do t'i detyronte gjykatat e këtyre shteteve që të merrnin në shqyrtim paditë për dëme kundër vendeve të origjinës së këtyre refugjatëve. Ata ishin të shqetësuar gjithashtu se neni 6 kërkon që vendimet duhet të ekzekutohen<sup>28</sup> dhe se në rastet e torturës ekzekutimi i vendimeve kundër shteteve të huaja mund të ishte problematik. Gjykata pra nuk konstatoi shkelje të nenit 6 me nëntë vota kundër tetë. Ndër tetë gjyqtarët e pakicës bënin pjesë gjithashtu Kryetari dhe Zv.Kryetari i Gjykatës. Mendimi i tyre i kundërt mbështetej, inter alia, në faktin që gjykatat britanike kishin mohuar që ndalimi i torturës kishte karakter ius cogens si dhe kishin dështuar në bërjen e dallimit ndërmjet procedimit civil dhe atij penal gjë që e kishte bërë shumicën të arrinte në përfundimet e saj, të reflektuara në vendim. Gjyqtari italian vuri në dukje se Gjykata kishte 'humbur një mundësi për të dhënë një vendim të rëndësishëm'. Sidoqoftë problemi i marrë në analizë nga kjo çështje nuk mund të thuhet se është mbyllur.

<sup>25</sup> Id. si në poshtëshënimin paraardhës. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjen Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar të 28 tetorit 1998.

<sup>26</sup> Shih në këtë kuadër pozicionimin e Kodit të Procedurës Civile në Nenin 36-40 të tij apo në Nenin 468 si dhe zgjidhjen që jep Kodi i Procedurës Penale me Nenin 10. shih gjithashtu Nenin 7 dhe 9 të Kodit Penal si dhe Nenin 31 §§ 1 dhe 3 të Konventës së Vjenës të vitit 1961 'Mbi marrëdhëniet diplomatike'.

<sup>27</sup> Pellonpaa – finlandeze dhe Bratza – britanik.

<sup>28</sup> Shih vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen Hornsby kundër Greqisë, të 19 marsit 1997, të përfshirë në këtë përmbledhje.

## A kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 35373/97)

17 dhjetor 2002

*kjo çështje kishte të bënte me problemin e proporcionalitetit të kufizimit të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës për arsye të imunitetit parlamentar*

### I. Faktet kryesore

1. A. është shtetase britanike e lindur më 1971 dhe jeton në Bristol. Ajo është një grua e re me ngjyrë dhe ka dy fëmijë të vegjël.
2. Gjatë një debati parlamentar në lidhje me politikën lokale të strehimit, në korrik 1996, anëtari i parlamentit i zgjedhur në zonën e A. e përmendi atë gjatë fjalimit të tij, deklaroi që vëllai i saj ishte në burg, saktësoi adresën e saj të plotë dhe bëri komente përulëse për sjelljen e saj dhe të fëmijëve të saj. Ai përmendi sharjet, rrugaçëritë, vandalizmat e drogën, dhe e quajti familjen “fqinjët e ardhur nga ferri”, një shprehje që në vijim u citua edhe në gazetata lokale dhe kombëtare.
3. A. pretendoi se asnjë prej aludimeve të cilave iu referua parlamentari nuk ishin vërtetuar apo pranuar nga autoritetet hetimore, dhe se shumë prej tyre vinin nga fqinjët për arsye racizmi dhe keqdashje. Në vijim të fjalës së deputetit dhe të daljes së artikujve që i referoheshin asaj, kërkuesja mori letra që përmbanin urrejtje racore. Shoqata përgjegjëse për strehimin, tre javë pas mbajtjes së fjalimit u këshillua që kërkuesja dhe fëmijët e saj duhet të largoheshin prej banesës së tyre me urgjencë. Ata u ri-strehuan në tetor 1996 dhe fëmijët u detyruan të ndërronin shkollën e tyre.
4. Deklarata e deputetit mbrohej nga një imunitet absolut parlamentar në bazë të “Bill of Rights” të vitit 1689. Raportet e shtypit, për aq sa ato riprodhonin debatin parlamentar, mbrohen nga një imunitet i kufizuar. Ky imunitet kërkon që raportimi të jetë i drejtë dhe i kujdesshëm dhe humbet në qoftë se botimi bëhet me keqdashje ose me “indiferencë të pakujdesshme” ndaj të vërtetës.

### II. Vendimi i Gjykatës

5. A. ankohej në bazë të nenit 6 të Konventës, se duke pasur parasysh karakterin absolut të imunitetit parlamentar, asaj i ishte mohuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatave për të mbrojtur reputacionin e saj, dhe se nuk kishte pasur ndihmë ligjore për procedimin për shpifje. Ajo bazohej gjithashtu në nenet 8, 13 dhe 14 të Konventës, me argumentimin se ajo nuk trajtohej njësoj krahasuar me një person ndaj të cilit deklarata të ngjashme, ishin bërë në kushtet e mospasjes nga autori i deklaratave të një imuniteti të tillë.

## A. Në lidhje me nenin 6 § 1

### a. Imuniteti Parlamentar

6. Gjykata vuri në dukje se imuniteti parlamentar që anëtarët e parlamentit gëzojnë, edhe në rastin në fjalë, ndjek qëllimet e ligjshme të mbrojtjes së fjalës së lirë në parlament dhe respektimin e ndarjes së pushteteve ndërmjet legjislativit dhe gjyqësorit. Gjykata mbajti qëndrimin se rregulli i imunitetit parlamentar, i cili ishte në përputhje me këto qëllime dhe që njihej përgjithësisht në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian, nuk mund të shihej në parim sikur vendoste një kufizim joproporcional ndaj së drejtës për t'iu drejtuar gjykatave, e cila parashikohet nga neni 6 § 1 i Konventës.

7. Imuniteti që i'u njihet deputetëve në Mbretërinë e Bashkuar në disa aspekte duket të jetë më i ngushtë se ai që i'u njihet deputetëve në disa shtete të tjera evropiane. Në mënyrë të veçantë imuniteti kishte të bënte vetëm me deklarata të bëra gjatë debateve parlamentare, dhe jo edhe me deklarata të bëra jashtë parlamentit. Karakteri absolut i imunitetit që gëzojnë deputetët synonte më tepër që të mbronte interesat e parlamentit si të tërë, dhe jo të deputetëve si individë, gjë që pasqyrohej nga fakti që imuniteti nuk gjente zbatim jashtë parlamentit. Nga ana tjetër, imuniteti që gëzojnë personat që bëjnë raportimin e debateve parlamentare apo personat e zgjedhur në nivelin lokal të qeverisjes, ishte për vetë natyrën e tij i kufizuar.

8. Gjykata vuri në dukje se personat e dëmtuar nga deklaratat shpifëse në Parlament, nuk ishin tërësisht të privuar nga mjetet për vënien në vend të së drejtës së tyre. Në mënyrë të veçantë, kur përfaqësuesi i tyre në parlament kishte bërë deklarata fyese, ata mund t'i drejtonin një peticion Parlamentit me anë të një parlamentar tjetër, me qëllim që të arrihej një tërheqje e deklaratës fyese. Në rastet ekstreme, deklarata keqdashëse të bëra me qëllim mund të ishin të dënueshme nga Parlamenti si rast përcmimi dhe fyerje.

9. Pra, vijonte që zbatimi i një rregulli që parashikon imunitet absolut parlamentar, nuk mund të thuhet se kapërcen hapësirën e vlerësimit që i'u lejohet shteteve, në kufizimin e së drejtës së individëve për t'iu drejtuar gjykatave.

10. Gjykata u shpreh dakord me pretendimet e kërkuases që aludimet e bëra në lidhje me të nga deklarata e deputetit, ishin tepër serioze dhe haptazi të panevojshme në kuadrin e një debati mbi politikën lokale të strehimit. Referenca e përsëritur e deputetit ndaj emrit dhe adresës së saj ishte veçanërisht për të ardhur keq. Gjykata madje vlerësoi se pasojat e pakëndshme të komenteve të deputetit për jetën e kërkuases dhe të fëmijëve të saj kishin qënë plotësisht të parashikueshme. Sidoqoftë, këta faktorë nuk mund të ndryshonin përfundimin në të cilin kishte arritur Gjykata në lidhje me proporcionalitetin e imunitetit parlamentar në një rast të tillë, përderisa lejimi i përjashtimeve ndaj këtij imuniteti, të cilat do gjenin zbatim në përputhje me faktet e veçanta të çdo rasti konkret, do të rrezikonte seriozisht qëllimet e ligjshme që ky imunitet ndjek. Për këto arsye, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me imunitetin parlamentar që mbronte deputetin që kishte bërë deklaratat e ankimuar.

*b. Në lidhje me ndihmën ligjore*

11. Gjykata vuri në dukje se kërkuesi kishte të drejtë për një këshillim ligjor fillestar prej dy orësh pa pagesë, dhe pas korrikut 1998 mund të kishte marrë një këshilltar ligjor me një pagesë të kufizuar. Megjithëse ajo mund të ishte detyruar që të paguante shpenzimet gjyqësore në rast se vendimi nuk do të kishte qenë në favor të saj, ajo do të kishte qenë në gjendje ta vlerësonte këtë rrezik përpara se të fillonte procesin, në qoftë se do të kishte përfituar nga këshillimi ligjor prej dy orësh pa pagesë. Gjykata arriti në përfundimin se mos akordimi i ndihmës ligjore për qëllimet e fillimit të një procesi për shpifje ndaj një deklarate të bërë nga shtypi i cili nuk gëzonte imunitet, nuk e pengonte kërkuesen që t'i drejtohej efektivisht gjykatës. Për këtë arsye nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me pamundësinë për të pasur ndihmë ligjore.

*B. Në lidhje me nenin 8*

12. Pasi konstatoi se çështjet kryesore që ngriheshin në kuadrin e pretendimeve të kërkueses në bazë të nenit 8 ishin të njëjta me ato që dilnin në kuadrin e pretendimeve të ngritura në bazë të nenit 6 § 1, në lidhje me imunitetin parlamentar që gëzonte deputeti, Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës.

*C. Në lidhje me nenin 14*

13. Gjykata vlerësoi se ankesa e kërkueses në bazë të nenit 14 ngrinte probleme identike me ato që ishin shqyrtuar ndërkaq në bazë të nenit 6 § 1 dhe nuk konstatoi shkelje të nenit 14.

*D. Në lidhje me nenin 13*

14. Gjykata kujtoi se neni 13 i Konventës nuk shkonte aq larg sa të garantonte një mjet ankimor i cili të bënte të mundur që legjislacioni i një shteti anëtar, të kundërshtohet përpara një autoriteti kombëtar me argumentimin se ai binte në kundërshtim me Konventën. Për këtë arsye Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 13.

**III. Koment**

15. Dhoma që e mori në shqyrtim këtë çështje nuk mbajti parasysh se ajo duhej të hiqte dorë nga juridiksioni për t'ia kaluar çështjen Dhomës së Madhe në bazë të nenit 30 të Konventës, me argumentimin se kjo çështje nxjerr në pah një çështje të rëndësishme të së drejtës së Konventës.

16. Megjithatë, tetë qeveri të tjera e vlerësuan problemin kaq të rëndësishëm sa dorëzuan ndërhyrjet e tyre gjatë procedurës me shkrim, dhe të gjitha ato mbështesnin me forcë respektimin e parimit që asnjë procedim ligjor nuk mund të nisë për ato çka thuhet dhe deklarohen në parlament. Nuk kishte gjasa në këto kushte që Gjykata të shprehej në favor të kërkueses në këtë pikë.

17. Çfarë ishte ndoshta më e habitshme, Gjykata vlerësoi, përsëri, se mungesa e ndihmës ligjore në Angli për procedimin e shpifjes nuk përbën shkelje të Konventës. Megjithëse ajo gjithmonë ka pranuar se ndihma ligjore mund të kërkohej në

proceset me karakter civil si pjesë e aspektit të nenit 6 § 1 - “barazi e përgjithshme”, të vetmet çështje me karakter civil në të cilat Gjykata deri tani ka gjykuar se interesat e drejtësisë e kërkojnë dhënien e kësaj ndihme ligjore kanë qënë mosmarrëveshje martesore, kujdestari fëmijësh dhe hetime për vdekjen e personave.

18. Natyrisht që për juristët e orientuar drejt mbrojtjes të të drejtave të njeriut një vendim i tillë është mjaft i interpretueshëm. Ky qëndrim bën të qartë se ende disa lloj të drejtash të njeriut hasen me rregulla tepër strikte dhe tradicionale të rendit publik në vendet evropiane, por jo vetëm ne to. Kjo çështje natyrisht që na kujton edhe debatin e zhvilluar disa herë në mediat, politikën dhe rrethet tona juridike për imunitetet e deputetëve, gazetarëve dhe për karakterin funksional apo institucional të këtyre imuniteteve. Një debat që mesa duket do të vazhdojë edhe për disa kohë, për aq sa të ruhet kjo baraspeshë proporcionaliteti e sanksionuar nga Gjykata e Strasburgut me këtë vendim.

## CORDOVA kundër ITALISË

(kërkesat nr. 40877/98 dhe 45649/99)

30 janar 2003

*kjo çështje kishte bërë me një kufizim të pajustificuar të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatave, në rastet kur si palë e paditur dalin persona me imunitet parlamentar*

### I. Faktet kryesore

1. Agostino Cordova është shtetas italian i cili ka lindur më 1936 dhe jeton në Napoli. Në kohën kur ndodhën faktet e çështjes në trajtim e sipër ai ishte prokuror në Palmi.

2. Kërkesa e parë me nr. 40877/98 (Cordova nr. 1) kishte të bënte me ngjarje që ndodhën më 1993, gjatë një hetimi të drejtuar nga kërkuesi në kuadrin e detyrës së tij si prokuror. Personi të cilin ai po hetonte në atë kohë kishte pasur lidhje me ish Presidentin e Italisë Francesco Cossiga, i cili ishte bërë pastaj “senator për jetë”. Z. Cossiga i kishte dërguar kërkuesit disa letra sarkastike dhe dhurata të ndryshme në formë lodrash. Kërkuesi vlerësoi se ishin cenuar nderi dhe reputacioni i tij, dhe bëri një ankim penal kundër Z. Cossiga për fyerje të një zyrtari publik. Në qershor të vitit 1997 kërkuesi bëri një kërkesë që të dilte edhe si palë civile në proces.

3. Senati vlerësoi se aktet për të cilat ishte akuzuar Z. Cossiga mbulohehin nga imuniteti i tij parlamentar i parashikuar nga neni 68 § 1 i Kushtetutës Italiane, dhe se mendimet e tij ishin shprehur në përmbushje të detyrave të tij parlamentare. Në bazë të këtij vlerësimi, gjyqtari i Mesinës që ishte ngarkuar me çështjen e mbylli



atë. Kërkuesi iu drejtua prokurorit kompetent për ta apeluar këtë vendim, por kërkesa e tij u refuzua me argumentimin se arsyet e dhëna nga Senati nuk ishin as të palogjikshme dhe, as haptazi arbitrare.

4. Kërkesa e dytë me nr. 45649/99 (Cordova nr. 2) kishte të bënte me komente të bëra më 1994 në dy tubime elektorale nga Vittorio Sgarbi, anëtar i Parlamentit Italian. Ndërsa fliste në këto tubime, Z. Sgarbi nisi një sulm personal ndaj kërkuesit me fjalë fyese. Kërkuesi bëri një kallëzim penal për shpifje me qëllim, si dhe kërkoi që të dilte edhe si palë civile në procesin penal.

5. Z. Sgarbi u dënua me dy muaj burg dhe u urdhërua të paguante dëmet e shkaktuara. Gjykata italiane vendosi se komentet e tij nuk ishin bërë në përmbushje të detyrave të tij parlamentare, dhe prandaj edhe nuk mbroheshin nga imuniteti i tij parlamentar i parashikuar në nenin 68 § 1 të Kushtetutës italiane. I akuzuari e apeloj vendimin për dënimin e tij në Gjykatën e Apelit por pa sukses. Ai iu drejtua në vijim Gjykatës së Kasacionit e cila u shpreh se procesi duhet të pezullohej dhe se çështja duhet t'i kalonte Dhomës së Deputetëve të Parlamentit italian. Dhoma e Deputetëve shprehu pikëpamjen se Z. Sgarbi kishte vepruar në përputhje me detyrat e tij parlamentare. Më 6 maj 1998, Gjykata e Kasacionit i prishi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe e mbylli çështjen, duke vendosur se interpretimi i zgjeruar i Dhomës së Deputetëve në lidhje me konceptin e “detyrave parlamentare”, që përfshinte të gjitha aktet me natyrë politike, edhe kur këto ndodhin jashtë Parlamentit, nuk vinte në kundërshtim me frymën e Kushtetutës.

## II. Vendimi i Gjykatës

6. Duke u bazuar në nenin 6 § 1 dhe nenin 13 të Konventës, kërkuesi ankohej se procedurat përpara gjykatave italiane kishin qënë jo të drejta. Ai ankohej gjithashtu në bazë të nenit 14 në lidhje me shkallën e gjerë të lirisë së shprehjes që gëzonin Z. Cossiga dhe Z. Sgarbi.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

7. Gjykata e Strasburgut mori parasysh se kërkuesi kishte bërë një kallëzim, kundër dy anëtarëve të Parlamentit, duke pretenduar shpifje ndaj tij, dhe se kishte kërkuar që të dilte në vijim edhe si palë civile në proceset penale. Pra, proceset përkatëse duket se kanë pasur të bëjnë me një të drejtë me karakter civil të kërkuesit, respektimin e së cilës ai kishte të drejtë të kërkonte - pikërisht me të drejtën për të pasur një reputacion të mirë.

8. Në vijim të debateve në Senat (në rastin e Z. Cossiga) dhe në Dhomën e Deputetëve (në rastin e Z. Sgarbi), u arrit në përfundimin se deklaratat e ankimura mbulohehin nga imuniteti parlamentar. Aktet parlamentare të miratuara për këtë qëllim e bënë të pamundur vazhdimin e proceseve që ishin hapur ndërkaq, dhe e privonin kërkuesin nga mundësia për të kërkuar kompensim për dëmin që ai kishte pësuar.

9. Gjykata vuri në dukje se legjitimiteti i këtyre akteve parlamentare ishte vlerësuar nga gjyqtari kompetent i Mesinës në rastin e parë, dhe nga Gjykata e Kasacionit në të dytin. Megjithatë një vlerësim i një lloji të tillë nuk mund të krahasohej me një vendim që të përcaktonte kufijtë e të drejtës së kërkuesit për të pasur një reputacion të mirë dhe as mund të pranohej se mundësia që i ishte ofruar kërkuesit për t'iu drejtuar gjykatave – e cila në fakt ishte kufizuar vetëm në ngritjen e pretendimeve paraprake – ka qënë e tillë sa t'i siguronte atij “të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate”. Kërkuesit i është mohuar e drejta për të kërkuar kompensim për dëmin e pretenduar si pasojë e dy akteve të miratuara nga ana e Senatit dhe e Dhomës së Deputetëve, dhe e refuzimit të gjyqtarit kompetent të Mesinës dhe të Gjykatës së Kasacionit për t'ia kaluar këtë mosmarrëveshje juridiksionale Gjykatës Kushtetuese. Për pasojë, Gjykata vlerësoi se ka pasur një ndërhyrje ndaj të drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar gjykatave.

10. Gjykata pranoi se imunitetet parlamentare përbëjnë një praktikë të qëndrueshme e cila synon që të sigurojë lirinë e shprehjes ndërmjet përfaqësuesve të popullit, dhe të parandalojë mundësinë e persekutimeve të motivuara politikisht të cilat të mund të ndërhyjnë në përmbushjen e detyrave parlamentare. Për pasojë Gjykata ishte e mendimit se ndërhyrja që ishte bërë në këtë çështje, e cila gjente bazë ligjore pikërisht në nenin 68 § 1 të Kushtetutës italiane, kishte qëllime të ligjshme për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në parlament dhe ruajtjen e ndarjes së pushteteve ndërmjet legjislativit dhe gjyqësorit.

11. Në lidhje me karakterin proporcional të ndërhyrjes, Gjykata theksoi se kur një shtet i akordon imunitet anëtarëve të Parlamentit të tij, mundet që për pasojë të preken të drejtat themelore të njeriut. Ajo sqaroi se, në parim, njohja e imunitetit parlamentar nuk përbënte një kufizim jo-proporcional ndaj së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate, siç parashikohet nga neni 6 § 1 i Konventës.

12. Gjykata vuri re se në të dyja çështjet, deklaratat e bëra dhe veprimet e ndërmarra nga ana e Z. Cossiga dhe Z. Sgarbi nuk kishin të bënin me përmbushjen e detyrave parlamentare në *strictu sensu*, por duket të kishin qënë bërë në kuadrin e mosmarrëveshjeve dhe grindjeve personale. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar sistemit gjyqësor për vënien në vend të të drejtave të shkelura, nuk mund të justifikohet vetëm në bazë të argumentit që mosmarrëveshja mund të jetë e një natyre politike ose mund të ketë të bëjë me aktivitet politik. Sipas mendimit të Gjykatës mungesa e një lidhjeje të qartë me ndonjë lloj aktiviteti parlamentar, nënkupton se nocioni i proporcionalitetit ndërmjet qëllimeve të ndjekura dhe mjeteve të përdorura duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur kufizimet e së drejtës për tu ankuar përpara gjykatave pranoreshin me akte të miratuara nga një organ me karakter politik. Pra kjo do të arrinte të përbënte një kufizim, në një mënyrë të papajtueshme me nenin 6 § 1 të Konventës, të së drejtës së individëve për tu ankuar përpara një gjykate në çdo rast kur deklarata ose akte të ngjashme janë kryer nga një anëtar i parlamentit.

13. Pasi pranon këtë interpretim në lidhje me parimin e proporcionalitetit, Gjykata vlerëson se vendimi për mbylljen e çështjes kundër Z. Cossiga dhe vendimi për prishjen e vendimeve kundër Z. Sgarbi, kishte prishur balancën e drejtë që duhet mbajtur ndërmjet kërkesave të interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Gjykata i kushtoi rëndësi të veçantë faktit se pas miratimit të akteve nga ana e Senatit dhe Dhomës së Deputetëve, kërkuesi nuk kishte pasur në dispozicion mjete të tjera të mundshme që të mund t'i përdorte për mbrojtjen e të drejtave të tij të garantuara nga Konventa. Për këto arsye, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

#### **B. Në lidhje me nenin 13**

14. Ankesa e kërkuetit në bazë të nenit 13 kishte të bënte me të njëjtat fakte që Gjykata mori në analizë në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës, kështu që nuk ishte e nevojshme që të shqyrtohej nëse ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

#### **C. Në lidhje me nenin 14**

15. Duke pasur parasysh përfundimet e arritura në lidhje me nenin 6 § 1, Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme që të ndërmerrej një shqyrtim më vete i pretendimeve të kërkuetit në bazë të nenit 14 të Konventës.

#### **D. Në lidhje me nenin 41**

16. Në të dyja rastet Gjykata i akordoi kërkuetit 8 000 euro për dëm jo-material. Përsa i përket shpenzimeve dhe pagesave ligjore, ajo i akordoi kërkuetit 8 745 euro për rastin e parë dhe 5 000 euro për rastin e dytë.

### **III. Koment**

17. Ky vendim ofron një perspektivë të ndryshme nga ajo që kemi parë në vendimin e Gjykatës të 17 dhjetorit 2002 në lidhje me çështjen *A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në lidhje me imunitetin nga procedimi civil që parlamentarët gëzojnë në lidhje me deklaratat që mund të përbëjnë shkak për ngritjen e padive për shpifje.

18. Në çështjen A. Gjykata nuk konstatoi shkelje të së drejtës së kërkuetes për t'iu drejtuar gjykatave në lidhje me deklaratat që mbroheshin nga imuniteti parlamentar. Ndërsa në çështjen Cordova (1) Gjykata bëri dallimin nga vendimi i saj në çështjen A., duke nxjerrë në pah se deklaratat dhe veprimet e ankimuara nuk ishin bërë në përmbushje të funksioneve parlamentare *strictu sensu*, dhe i ngjanin më shumë një grindje private qoftë ajo edhe ngushtësisht e lidhur me politikën. Në Cordova (2) u bë një konstatim i ngjashëm në lidhje me komentet e bëra në një tubim elektoral. Pra duket se imuniteti që u mbajt parasysh nga Gjykata në çështjen A. duket se kufizohej në deklaratat të bëra në sallën e Parlamentit.

19. Në arritjen e përfundimeve të saj në këto dy çështje Gjykata vuri qartë në dukje rëndësinë që Konventa i jep garantimit të së drejtës së personave për t'iu drejtuar gjykatave për çështje me objekt shpifje. Në çështjen A. Gjykata vendosi se mungesa

e ndihmës ligjore në Angli, e tillë që e pengon një person të varfër për të nisur procedurat për shpifje (në lidhje me komente që nuk mbroheshin nga imuniteti parlamentar), nuk e shkelte nenin 6. Ky konstatim nuk duket se përputhet fort me qëndrimin e vetë Gjykatës për një garantim praktik dhe efektiv të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatave, që vetë ajo pranon në vendimin Cordova. Është interesante të kujtohet se, megjithëse pretendimet e palëve në çështjet Cordova kundër Italisë ishin dëgjuar përpara se të jepej vendimi në çështjen A. kundër Mbretërisë së Bashkuar, nuk pati ndonjë ndërhyrje si palë të treta nga ndonjë prej qeverive të tjera, siç ndodhi në çështjen A.

20. Është interesant të lexohet ky vendim duke pasur ndër mend botëkuptimin mbi imunitetin që ekziston në Shqipëri sidomos në rrethet e deputetëve, politikanëve gazetarëve, por pse jo edhe juristëve. Një debat i hapur që me tryezën e rrumbullakët të organizuar nga ish Presidenti i Republikës Mejdani më 12 prill 2002 në lidhje me Statutin e Romës mbi Gjykatën Ndërkombëtare Penale, vinte përballë konceptimet e ndryshme mbi imunitetin parlamentar. Një debat që është reflektuar edhe në çështje konkrete gjyqësore si ajo Genc Pollo kundër Erjon Braçe e cila nuk u mor në shqyrtim nga ana e Gjykatës së Lartë<sup>29</sup> apo edhe Fatos Nano kundër Nikollë Lesi. Duket se vendimi Cordova më në fund i jep preferencë një botëkuptimi funksional në raport me atë statusor të konceptit të imunitetit.

## LAUKO kundër SLOVAKISË

(kërkesa 26138/95)

2 shtator 1998

*një masë në dukje me karakter disiplinor por në thelb me natyrë penale duhet t'i nënshtrohet vlerësimit në përputhje me garancitë e nenit 6*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Z. Ivan Lauko, shtetas sllovak, ka lindur më 1953 dhe jeton në Povazská Bystrica, Sllovakia. Në qershor 1992 ai kërkoi, në bazë të legjislacionit të miratuar së fundmi, që një apartament në të cilin ai banonte dhe që ishte i vendosur në një bllok apartamentesh në Dubnica nad Váhom, në Sllovakia, duhej t'i shitej atij.

2. Në vijim fqinjët e tij si dhe individë të tjerë e shqetësuan kërkuesin me anë të veprimeve të zhurmshme dhe të mërzitshme, me tallje dhe kërcënime. Në disa raste dera dhe dritaret e apartamentit të tij si dhe kutia e letrave të tij kanë qënë dëmtuar. Kërkuesi mendon se qëllimi i këtyre ndërhyrjeve ishte ai që ta dekurajonte atë në lidhje me blerjen e apartamentit.

<sup>29</sup> Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 1 dt. 01.04.2002.

3. Në një sërë rastesh kërkuesi i ka kërkuar departamentit të policisë në Dubnica nad Váhom që të hetojë në lidhje me shqetësimet që i shkakttoheshin atij dhe të ndiqte penalisht personat përgjegjës. Policia e informoi atë që faktet në lidhje me të cilat ai ankohej nuk mund të merren për bazë dhe se për këtë arsye hetimi që kishte të bënte me ankesat e tij ishte mbyllur. Më 15 prill 1994 departamenti i policisë, duke vepruar në bazë të seksionit 63 të Aktit mbi Kundravajtjet e Vogla të vitit 1990, njoftoi Zyrën Lokale (Obvodný úrad) të Dubnica nad Váhom në lidhje me ankesat e paraqitura nga kërkuesi.

4. Më 11 maj 1994 Zyra Lokale vendosi se kërkuesi kishte kryer një kundravajtje penale (priestupok) sipas seksionit 49 (1) (d) të Aktit të Kundravajtjeve të Vogla për shkak se pa asnjë justifikim ai kishte akuzuar familjen B. se kjo kishte shkaktuar shqetësime. Vendimi ishte bazuar në provat që i ishin servirur nga departamenti i policisë në Dubnica nad Váhom si dhe në faktet që kishin dalë në pah gjatë rrjedhës së procedurave para Zyrës Lokale. Kërkuesi u gjobit me 300 korona sllovaqe dhe u urdhërua gjithashtu të paguajë kostot e procedurave të cilat arrinin një shumë prej 150 koronash sllovaqe. Vendimi i Zyrës Lokale u nënshkrua nga drejtori i drejtorisë së saj ligjore. Kërkuesi u ankua nga ana e tij kundër këtij vendimi në Zyrën Rajonale të Povazská Bystrica (Okresný úrad).

5. Më 28 korrik 1994, Zyra Rajonale e hodhi poshtë ankimin dhe rikonfirmoi vendimin e dhënë nga ana e Zyrës Lokale. Rasti i kërkuesit në këtë instancë ishte shqyrtuar nga ana e drejtorisë ligjore të Zyrës Rajonale e cila nuk e pranoi apelimin e tij me anë të një vendimi të nënshkruar nga ana e drejtorit të asaj drejtorie. Më 19 gusht 1994 kërkuesi bëri një kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese. Në parashtrimet e tij përpara kësaj gjykate ai pretendoi, ndërmjet të tjerash, një shkelje të nenit 6 të Konventës në lidhje me faktin se nuk kishte pasur një proces të drejtë dhe publik në rastin e tij dhe se autoritetet administrative që ishin marrë me rastin e tij nuk kishin qënë të paanshme. Më 24 nëntor 1994, Gjykata Kushtetuese nuk e pranoi kërkesën e kërkuesit me argumentimin se ai kishte qënë në një mënyrë të qartë një ankim i pabazuar. Më 2 korrik 1997 Gjykata Kushtetuese nuk e pranoi kërkesën e kërkuesit për të rishikuar vendimin e saj të datës 24 nëntor 1994.

6. Kërkesa në Komision, që iu paraqit këtij më 13 qershor 1994 u deklarua pjesërisht e pranueshme më 21 tetor 1996. Pasi u përpoq pa asnjë sukses që të arrinte një zgjidhje miqësore, Komisioni nxori një raport më 30 tetor 1997 në të cilin ai vinte në dukje faktet dhe shprehte njëzëri mendimin sipas të cilit ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe shtrohej edhe zbatimi i nenit 13 në këtë çështje.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me qëllimin e çështjes

7. Kërkuesi ngriti disa pretendime në lidhje me shkelje të neneve 3, 6 § 1, 8, 13 dhe 14 të Konventës. Gjykata vuri në dukje nga ana e saj që Komisioni kishte deklaruar si të pranueshme vetëm ankesat e kërkuesit të ngritura në lidhje me nenet 6 § 1 dhe 13

të cilat kishin të bënin me procedurat që nga ana e tyre çuan në vendosjen e gjobës. Për këtë arsye edhe Gjykata e kufizoi shqyrtimin e saj vetëm në lidhje me ankesat e bëra përsa i përket shkeljeve të pretenduara të neneve 6 § 1 dhe 13<sup>30</sup>.

### **B. Në lidhje me nenin 6 § 1**

8. Kërkuesi mbështeste argumentin se mungesa e çdo rishikimi gjyqësor ndaj vendimit që e ngarkonte atë me pagimin e një gjobe përbënte një shkelje të së drejtës së tij për një proces nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.

#### *a) Mbi zbatueshmërinë e nenit 6 në këtë rast*

9. Gjykata vuri në dukje që ishte e qartë nga seksionet 2 (1) dhe 49 të Aktit mbi Kundravajtjet e Vogla, që kundravajtjet e vogla për të cilat kërkuesi kishte qënë dënuar nuk kishin qënë konsideruar nga ana e të drejtës së brendshme si «penale». Sidoqoftë, ajo vlerësoi se treguesit e ofruar nga ana e të drejtës së brendshme të shtetit të thirrur si palë, kishin vetëm një vlerë relative.

10. Gjykata i përmbahej pikëpamjes sipas së cilës ishte e nevojshme të shqyrtohej natyra e shkeljes së kryer nga ana e kërkuesit. Ajo iu referua faktit se ai ishte dënuar në bazë të seksionit 49 (1) (d) të Ligjit mbi Kundravajtjet e Vogla duke qënë se kishte akuzuar, pa asnjë justifikim, fqinjët e tij për shkaktim zhurmash dhe për këtë arsye ai ishte dënuar me një gjobë. Kjo dispozitë rregullonte kundravajtjet e vogla kundër pronës të individëve dhe ishte formuluar për të ruajtur qetësinë ndërmjet fqinjëve. Për pasojë, norma ligjore e shkelur nga kërkuesi ishte e drejtuar ndaj të gjithë qytetarëve dhe jo vetëm ndaj një grupi të caktuar i cili të kishte ndonjë status të veçantë. Karakteri i përgjithshëm i normës juridike në rastin në fjalë ka qënë konfirmuar edhe më tej nga ana e seksionit 1 të Ligjit mbi Kundravajtjet e Vogla i cili i referohej faktit që të gjithë qytetarët janë të detyruar të sigurojnë respektimin e normave ligjore dhe të të drejtave të qytetarëve të tjerë, si dhe nga ana e seksionit 2 (1) të të njëjtit Ligj i cili e përcaktonte një shkelje të vogël si një akt të gabuar që cenonte ose shkaktonte rrezik për interesin publik.

11. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje që Z. Lauko ishte dënuar nga ana e Zyrës Lokale me një gjobë si dhe ishte urdhëruar gjithashtu që të paguante edhe shpenzimet e bëra gjatë procedurave. Gjopa që i ishte vënë kërkuesit kishte pasur për qëllim që ta dënonte. Ajo kishte një karakter ndëshkues, i cili është edhe karakteri tradicionalisht dallues i dënimeve penale. Gjykata vlerësonte gjithashtu që elementët në të cilët mbështetej qeveria, të tillë si fakti që kryerja e shkeljes nuk ishte ndëshkuar me burgosje dhe nuk i kishte lënë vend hapjes të ndonjë çështje penale, nuk kishin qënë përcaktues për klasifikimin e shkeljes në përputhje me qëllimet e zbatueshmërisë apo jo të nenit 6 § 1.

12. Si përfundim, karakteri i përgjithshëm i dispozitës ligjore të shkelur nga ana e kërkuesit, së bashku me qëllimin ndëshkues dhe të rëndë të ndëshkimit që i ishte dhënë atij, mjaftonin për të vënë në dukje që shkelja në fjalë ishte, sipas kuptimit

<sup>30</sup> Shih paragrafët 47 dhe 48 të vendimit



të nenit 6 § 1 të Konventës, një shkelje e natyrës penale. Për pasojë nuk ishte e nevojshme që ajo të merrej në shqyrtim edhe në lidhje me ashpërsinë e dënimit në fjalë, përderisa mungesa e ashpërsisë në këtë rast nuk do të mund ta privonte shkeljen nga karakteri i saj i rrënjosur penal. Nën dritën e atyre sa u thanë më lart Gjykata vlerësoi se neni 6 § 1 gjente zbatim në rastin në fjalë.

### *C. Në lidhje me çështjen në se ka apo jo shkelje të nenit 6 § 1*

13. Gjykata iu referua para së gjithash shpjegimit të faktit që e drejta për një gjykim të drejtë, në kuadrin e së cilës e drejta për tu dëgjuar para një gjykate të pavarur ishte një përbërës thelbësor, mbante një pozitë të karakterit parësor në një shoqëri demokratike. Sipas Gjykatës kjo e drejtë e mbante këtë pozitë pikërisht me qëllimin që të përcaktohej nëse një organ mund të konsiderohet që është «i pavarur» nga ekzekutivi ishte e nevojshme që të merrej në konsideratë mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre zyrtar, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme si dhe çështja nëse organi në fjalë paraqet një pavarësi edhe në dukjen e tij.

14. Gjykata vuri në dukje se Zyra Lokale në Dubnica nad Váhom dhe Zyra Rajonale në Povazská Bystrica ishin të ngarkuara që të merreshin me detyrat e administratës lokale shtetërore nën kontrollin e qeverisë. Emërimi i kryetarëve të këtyre organeve ishte i kontrolluar nga ekzekutivi dhe nga zyrtarët e tij, kontratat e punësimit të tyre rregulloheshin nga dispozitat e Kodit të Punës, dhe ata kishin statusin e punëmarrësve me shpërblim. Për këto arsye, mënyra e emërimit të këtyre zyrtarëve të Zyrave Lokale dhe Rajonale së bashku me mungesën e çdo lloj garancie kundër presioneve të jashtme dhe e çdo pavarësie në dukje, tregonin qartë se këto organe nuk mund të konsideroheshin «të pavarura» nga ekzekutivi sipas kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës.

15. Gjykata nënvizoi se, megjithëse lënia në kompetencën e organeve administrative të ndjekjes dhe të ndëshkimit të shkeljeve të vogla nuk ishte në kundërshtim me Konventën, personi i prekur duhet të ketë një mundësi që të ndryshojë çdo lloj vendimi që është dhënë në ngarkim të tij përpara një gjykate e cila të ofrojë garancitë e kërkuara nga ana e nenit 6. Përsa i përket rastit në fjalë, megjithatë, kërkuesi nuk kishte qënë në gjendje që të arrinte një rishikim të vendimeve të Zyrave Lokale dhe Rajonale nga ana e një gjykate të pavarur dhe të paanshme.

16. Duke pasur parasysh sa u tha më lart, Gjykata vlerësoi që ka pasur një shkelje të së drejtës së kërkuesit për një dëgjim nga ana e një gjykate të pavarur dhe të paanshme. Për këtë arsye ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1<sup>31</sup>.

### *D. Në lidhje me nenin 13*

17. Kërkuesi parashtroi që, në kundërshtim me nenin 13, ai nuk kishte pasur mjete efektive për të vënë në vend të drejtat e cenuara nga shkeljet e pretenduara të nenit. 6. Gjykata vuri në dukje që kërkesat e nenit 13 ishin më pak strikte, dhe prandaj edhe ishin përfshirë nga ato të nenit 6. Për këtë arsye, duke pasur parasysh konkluzionet

<sup>31</sup> Shih paragrafët nga 66 deri në 68 të vendimit.

e arritura nga ana e saj në kuadrin e nenit 6, Gjykata nuk e pa të nevojshme që ta merrte në konsideratë rastin edhe në lidhje me nenin 13<sup>32</sup>.

### *E. Në lidhje me ish-nenin 50 (aktualisht neni 41)*

18. Kërkuesi pretendoi 1,000,000 korona sllovaqe për dëm jo-material. Ai e mbështeti këtë pretendim në argumentimin se si rezultat i shkeljes të të drejtave të tij ai kishte humbur vendin e tij të punës dhe pozitën shoqërore dhe se ky fakt kishte prekur, në drejtim të përkeqësimit, shëndetin e tij. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit në fjalë, Gjykata duke vendosur mbi baza barazie i akordoi kërkuesit shumën prej 5,000 koronash sllovaqe.

19. Kërkuesi i kërkoi gjithashtu Gjykatës që t'i akordonte atij shumën prej 52,046 koronash sllovaqe të cilat ai i kishte shpenzuar gjatë procedurave të brendshme dhe në ato të Strasburgut. Gjykata vuri në dukje se kërkuesi nuk ishte përfaqësuar në proceset përpara institucioneve të Konventës. Megjithatë, ajo vlerësoi që ai duhet të ketë bërë shpenzime në realizimin e ankesës së tij me shkrim. Duke vendosur mbi një bazë barazie, Gjykata i akordoi kërkuesit shumën prej 1,000 koronash sllovaqe.

20. Kërkuesi parashtroi edhe disa pretendime që kishin të bënin, ndër të tjera, me anulimin e vendimeve të autoriteteve kombëtare, ndëshkimin e personave të cilët mendoheshin të kishin kryer vepra penale kundër tij si dhe ta orientonte qeverinë e thirrur palë në proces që të merrte përsipër disa angazhime. Gjykata vuri në dukje që ajo nuk kishte juridiksion në përputhje me Konventën që të urdhëronte masa të tilla.

### **III. Koment**

21. Ky vendim i Gjykatës paraqet rëndësi në mënyrë të veçantë në lidhje me çështjen e zbatueshmërisë së nenit 6 të Konventës në çështje që duken me karakter disiplinor. Vendimi nxjerr në pah se elementët thelbësore për të vlerësuar nëse një masë ka karakter penal apo jo dhe nëse për pasojë thërret në veprim nenin 6 të Konventës, janë karakteri normativ i dispozitës ligjore që parashikon masën në fjalë nga njëra anë dhe karakteri ndëshkimi i kësaj mase nga ana tjetër. Në këtë çështje Gjykata u shpreh se fakti që ndëshkimi nuk ishte i ashpër nuk përbënte një kriter përcaktues për qëllimet e zbatueshmërisë së nenit 6 të Konventës. Nga ana tjetër, as fakti që ndjekja e kundravajtjeve të vogla, për një nga të cilat akuzohej edhe kërkuesi, nga ana e organeve me karakter administrativ nuk bënte që masa të humbiste karakterin e saj penal në qoftë se ka elementët e lartpërmendur.

22. Pas këtij përfundimi paraprak, në këtë çështje Gjykata analizon edhe elementët e pavarësisë së një organi që merr në shqyrtim ankesat e kërkuesit. Duke vlerësuar se emërimi i anëtarëve të këtij organi kontrollohej nga ana e ekzekutivit dhe se statusi i tyre rregullohej nga dispozitat e kodit të punës, Gjykata arrin në përfundimin se ky organ nuk përmbush kriteret e elementit “gjykatë ose tribunal” për qëllimet e nenit 6 të Konventës.

<sup>32</sup> Ibid

## TRUHLI kundër KROACISË

(kërkesa 45424/99)

28 qershor 2001

*karakteri subsidiar i mekanizmit të Konventës e kufizon Gjykatën e Strasburgut në vlerësimin vetëm të aspekteve procedurale të respektimit të nenit 6*

### I. Faktet kryesore

1. Nikola Truhli, shtetas kroat dhe ish oficer i Ushtrisë Popullore Jugosllave përfitoi një pension ushtarak pas daljes së tij nga shërbimi më 1987. Pas shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative Jugosllave, pagesat e pensionit të tij, duke filluar nga tetori 1992, fillimisht u ndaluan dhe pastaj u rivlerësuan nga ana e Fondit Kroat të Sigurimeve Shoqërore deri në 63.22 % të shumës fillestare.

2. Z. Truhli paraqiti dy kërkesa përpara Gjykatës Kushtetuese. Në të parën, ai pretendoi se vendimet e organeve administrative dhe të Gjykatës Administrative për uljen e shumës së pensionit të tij shkelnin të drejtat e tij kushtetuese. Ai pretendoi në mënyrë të veçantë se vendimet nuk kishin bazë ligjore. Me kërkesën e dytë, ai pretendonte se ligjet që kishin shërbyer si bazë për uljen e pensionit të tij ishin antikushtetuese. Gjykata Kushtetuese në lidhje me pretendimin e dytë arriti në përfundimin se kishte patur një legjislacion të ri që kishte hyrë në fuqi dhe që parashikonte se pensionet e ish oficerëve të Ushtrisë Popullore Jugosllave duhet të ishin 63.22 % të shumës të paguar në dhjetor 1991. Në vijim të këtij vendimi kërkuesi u ankua pranë organeve të Strasburgut se vendimi i Gjykatës Kushtetuese shkelte të drejtën e tij për t'iu drejtuar gjykatës.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

3. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se e drejta kroate pa dyshim që i kishte akorduar kërkuesit mundësinë e fillimit të procedurave gjyqësore me qëllim që të kishte zgjidhje të mosmarrëveshjes në të cilën ishte palë, dhe këtë e kishte bërë të mundur me një kërkesë-padi të paraqitur në Gjykatën Administrative. Në vijim ai pati dy mundësi për të vijuar çështjen e tij – bërjen e një kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se të drejtat e tij kushtetuese ishin shkelur nga vendimet e organeve më të ulëta, ose duke paraqitur një pretendim kushtetues për të kundërshtuar kushtetutshmërinë e ligjeve që kishin shërbyer si bazë ligjore për uljen e pensionit të tij ushtarak. Ai në fakt i përdori të dyja këto mjete.

4. Gjykata konstatoi se kërkuesi kishte patur mundësi konkrete për t'iu drejtuar një

gjykate për të patur një vendim në lidhje me të drejtat e tij. Nga ana tjetër Gjykata Kushtetuese kishte vendosur mbi kërkesën individuale të kërkuarit të paraqitur asaj. Në këto rrethana, fakti që Gjykata Kushtetuese kishte vendosur për t'i dhënë fund procedurave, me arsyetimin se legjislacioni i kundërshtuar nuk ishte më në fuqi, nuk e kishte kufizuar ushtrimin e së drejtës së kërkuarit për t'iu drejtuar gjykatës në një mënyrë që të ishte cenuar thelbi i së drejtës. Gjykata pra vendosi se nuk ka patur shkelje të nenit 6 § 1.

### III. Koment

5. Ky është një shembull klasik i kufirit të veprimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Përderisa kjo e fundit nuk është asgjë tjetër veçse mbikëqyrëse e zbatimit të Konventës, ka deklaruar vazhdimisht që nuk përbën një instancë të katërt ankimore në sistemet e brendshme juridiksionale dhe nuk mund të ndërhyjë me argumentimin se gjykatat e brendshme kanë dhënë një vendim të gabuar mbi bazën e së drejtës së brendshme. Roli i saj është që të sigurojë respektimin me dispozitat e Konventës nga ana e shtetit palë. Kështu pra që pjesa më e madhe e jurisprudencës së Konventës orientohet drejt vlerësimeve procedurale dhe jo aq ndaj rishikimit të fakteve apo provave të rastit konkret.

6. Rezultati i kësaj çështjeje pasqyron faktin që Gjykata mund të mjaftohet me faktin që problemet e pretenduar ishin shqyrtuar nga gjykatat e ndryshme të apelimit në Kroaci, në këtë rast, dhe se kërkuari mund të thuhet se kishte patur mundësi t'i drejtohej gjykatave në lidhje me pretendimet e tij. Në rastet që ka ndryshime në të drejtën e brendshme, siç është edhe rasti në fjalë, të tilla që mund të sjellin modifikime në juridiksionin e gjykatave të brendshme, Gjykata Evropiane preferon të mos bëjë komente në lidhje me këto ndryshime duke rritur në përfundimin se përgjithësisht ato janë në përputhje me Konventën.

## DAUTI kundër SHQIPËRISË

*(kërkesa nr. 19206/05)*

**3 shkurt 2009**

*kontrolli gjyqësor i vendimeve administrative sipas nenit 6 § 1*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuari, Ramiz Dauti, është një nënshtetas shqiptar i lindur në vitin 1947 dhe që jeton në Tiranë. Më 14 prill 1992, kërkuari pësoi një aksident serioz në punë dhe për pasojë nuk ishte më në gjendje të vazhdonte punën.

2. Në mars 2001, kërkuesi i është drejtuar Komisionit lokal të Ekzaminimit Mjekësor për Aftësitë në Punë duke kërkuar që të përcaktohej statusi i tij si invalid dhe të përfitonte pension. I pakënaqur me vendimin, i cili i jepte pension për një periudhë të kufizuar kohe, kërkuesi paraqiti apelim në Komisionin e Apelit. Më 30 janar 2003, Komisioni i Apelit e anuloi në tërësi vendimin e Komisionit të Rrethit, duke e shpallur kërkuesin të aftë për punë dhe të papërshtatshëm për të përfituar pensionin e invaliditetit.

3. Kërkuesi nisi një proces gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Tiranë, për të kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të Apelit. Gjykata e Rrethit e hodhi poshtë kërkesën e kërkuesit me arsyetimin se vendimet e Komisionit të Apelit ishin të formës së prerë dhe me karakter detyrues, duke mos u bërë kështu subjekt i shqyrtimit nga gjykatat. Kërkuesi e apeloj këtë vendim në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Kushtetuese lidhur me pamundësinë e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të Komisionit të Apelit, por apelimi ishte i pasuksesshëm.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Duke u mbështetur në nenin 6 § 1 dhe në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zoti Dauti pretendoi se ai nuk kishte qenë në gjendje për të kundërshtuar përpara gjykatave të brendshme vendimet e dhëna nga organet administrative në lidhje me pensionin e invaliditetit.

### A. Në lidhje me nenin 6

5. Gjykata tregoi se sipas nenit 6 § 1 të Konventës është e nevojshme, që vendimet e autoriteteve administrative, të cilat në vetvete nuk i përmbushin kërkesat e këtij Neni, duhet të bëhen subjekt i kontrollit të mëvonshëm të një “organi gjyqësor që zotëron juridiksion të plotë”. Për rrjedhojë ishte e nevojshme, që të përcaktohej nëse Komisioni i Apelit përbënte një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” sipas kuptimit të nenit 6 § 1.

6. Gjykata deklaroi se Komisioni i Apelit ishte tërësisht i përbërë nga specialistë mjekësorë, të caktuar nga një organ administrativ, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e së cilës punojnë mjekët. Asnjë individ i kualifikuar nga pikëpamja ligjore apo anëtar i trupës gjyqësore nuk është pjesë e Komisionit të Apelit.

7. Për më tepër, ligji dhe rregulloret e brendshme nuk përmbajnë asnjë normë që të rregullojë afatin e qëndrimit në detyrë të anëtarëve, largimin e tyre nga puna, dorëheqjen apo ndonjë garanci tjetër për pandryshueshmërinë e tyre. Ishte e qartë se ata mund të largohen nga detyra në çdo kohë, sipas tekave të Ministrisë së Shëndetësisë, e cila kishte liri të plotë veprimi. Poizicioni i anëtarëve të Komisionit të Apelit ishte rrjedhimisht i hapur ndaj trysnive të jashtme. Një situatë e tillë e vinte në rrezik pavarësinë e tij.

8. Duke pasur parasysh faktin, se Komisioni i Apelit nuk përbënte një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” dhe se vendimet e tij nuk mund të kundërshtoheshin përpara një gjykate të brendshme, Gjykata mbërriti në përfundimin se kishte pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

**B. Në lidhje me nenin 13**

9. Gjykata shpalli se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej ankesa e kërkuarit sipas Nenit 13.

**C. Në lidhje me nenin 41**

10. Gjykata caktoi për kërkuarin 6,000 euro në lidhje me dëmin jopasuror.

**III. Koment**

11. Ky ishte vendimi i 13-të i dhënë kundër Shqipërisë për çështje të shqyrtuara në themel, që kur ajo e ratifikoi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1996. Thujse të gjitha vendimet kanë përfshirë nenin 6, të drejtën për një proces të rregullt ligjor, deri në një nivel të caktuar. Ky është gjithashtu neni më i trajtuar në përgjithësi përpara Gjykatës së Strasburgut. Kjo Gjykatë ka saktësuar në shumë raste, se e drejta për një proces të rregullt ligjor zë një vend tepër të rëndësishëm në një shoqëri demokratike, prandaj nuk mund të ketë asnjë justifikim për interpretimin e saj në mënyrë të kufizuar.

12. Megjithatë kjo nuk do të thotë, siç shprehet edhe Gjykata në këtë çështje se shtetet duhet t’ia nënshtrojnë konfliktet mbi të drejtat dhe detyrimet civile një procedure, e cila përmbush kërkesat e nenit 6 në çdo fazë përpara gjykatave të brendshme. Ajo që kërkon Konventa është që vendimet e autoriteteve disiplinore, të cilat në vetvete nuk i përmbushin kërkesat e nenit 6, duhet të bëhen subjekt i kontrollit të plotë gjyqësor.

13. Kërkuari argumentoi se ai nuk kishte pasur akses t’i drejtohej gjykatës me pretendimet e tij për pensionin e invaliditetit. Gjykata vendosi ta shqyrtojë këtë ankesë në aspektin nëse Komisioni i Apelit përbënte ose jo një gjykatë të pavarur dhe të paanshme sipas kuptimit të nenit 6. Komisioni i Apelit nuk i plotësonte kushtet, prandaj meqënëse vendimi nuk mund të kundërshtohet ligjërisht përpara një gjykate të brendshme, kishte një shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.



## DEVLIN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 29545/95)

30 tetor 2001

*në këtë vendim Gjykata mbajti qëndrimin se kufizimi i mundësisë për t'iu drejtuar gjykatës në lidhje me një mosmarrëveshje në marrëdhëniet e punës shkel Nenin 6 § 1 të Konventës.*

### I. Faktet kryesore

1. Në qershor 1991, Francis William Devlin, shtetas irlandez, aplikoi për një post si asistent administrativ në shërbimin civil të Irlandës së Veriut.

2. Më 15 shtator 1992 ai u informua se pranimit i tij në postin për të cilin kishte aplikuar "varej nga rezultati i kënaqshëm i shqyrtimit të posteve që ai kishte pasur më parë". Më 21 tetor ai u informua se ky rezultat nuk kishte qënë i kënaqshëm. Kërkuesi besonte se vendimi për të mos e emëruar atë ishte marrë mbi bazën e besimit të tij fetar, ai është katolik dhe anëtar i një shoqate të njohur me emrin Pyjetarët Kombëtare Irlandezë, dhe jo për shkak të arsyes ligjore mbi sigurimin publik. Një numër i të afërmeve të tij ishin pranuar në shërbimin publik në nivele të ndryshme dhe as ai apo ndonjë anëtar tjetër i familjes nuk ishte përzier ndonjëherë me ndonjë formë veprimtarie kriminale.

3. Nëpërmjet Komisionit të Punësimit të Drejtë, kërkuesi bëri një ankese në Gjykatën e Punësimit të Drejtë, duke pretenduar diskriminim në kundërshtim me Ligjin për Punësimin e Drejtë të vitit 1976. Shërbimi Civil i Irlandës së Veriut pohoi se refuzimi ishte bërë për arsye të sigurimit publik dhe për këtë arsye nuk gjente zbatim ligji i lartpërmendur i vitit 1976. Më 21 shtator 1993, Sekretari i Shtetit për Irlandën e Veriut nxori një certifikatë në bazë të seksionit 42 të Ligjit për Punësimin e Drejtë të vitit 1976, duke vërtetuar se refuzimi i punësimit ishte bërë "për qëllimin e mbrojtjes së sigurimit kombëtar dhe të ruajtjes së sigurisë publike". Në fakt, efekti i seksionit 42 § 1 të lartpërmendur është që të nxjerrë tërësisht nga sfera e zbatimit të legjislacionit mbi punësimin e drejtë aktet që merren me qëllimin e mbrojtjes së sigurimit kombëtar dhe të ruajtjes së sigurisë publike.

4. Kërkesa e Z. Devlin për rishikim gjyqësor të vendimit të Sekretarit të Shtetit nuk u pranua.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesi ankohej se ai ishte privuar nga e drejta që pretendimi i tij i ngritur në bazë të Ligjit mbi Punësimin e Drejtë të përcaktohej nga një gjykatë, duke iu referuar për këtë qëllim nenit 6 § 1 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

6. Gjykatës i'u desh të përcaktonte së pari nëse neni 6 § 1 i Konventës gjente zbatim në rastin në fjalë, dhe në veçanti nëse pretendimi i paraqitur nga ana e kërkuesit përpara Gjykatës së Punësimin të Drejtë kishte të bënte me përcaktimin e një të drejte me karakter civil. Gjykata kujtoi se në vendimin e saj të 10 korrikut 1998 në lidhje me çështjen *Tinnelly kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ajo kishte vlerësuar se Ligji i vitit 1976, të cilit i ishte referuar gjithashtu kërkuesi në këtë rast, i garantonte personave një të drejtë që të mos diskriminoheshin në tregun e punës për shkak të besimit fetar ose mendimit politik. Kjo e drejtë e përcaktuar qartë, duke pasur parasysh kontekstin në të cilin ajo zbatohet dhe natyrën e saj pasurore, ishte klasifikuar nga ana e Gjykatës si një “e drejtë civile” në kuptimin e nenit 6 § 1 të Konventës. Përderisa kërkuesi po aplikonte për postin e asistentit administrativ ku nuk mund të thuhej posti në fjalë përfaqësonte “një pjesë të pushtetit sovran të shtetit” nuk kishte arsye për ta përjashtuar pretendimin e kërkuesit nga kuadri i zbatimit të nenit 6 § 1.

7. Gjykata kujtoi se neni 6 § 1 mishëron ‘të drejtën për t’iu drejtuar një gjykate’, në kuadrin e së cilës e drejta për të filluar procedura përpara një gjykate në lidhje me çështje civile përbën një aspekt. Kjo e drejtë, sidoqoftë nuk është absolute përderisa mund të jetë subjekt i kufizimeve të ligjshme. Në rastet kur mundësia e individit për t’iu drejtuar një gjykate kufizohet qoftë për shkak të ligjit ose të fakteve të çështjes konkrete, Gjykata do të vlerësojë nëse kufizimi që është zbatuar ka cenuar thelbin e së drejtës dhe në veçanti nëse ajo ndiqte një qëllim legjitim dhe nëse kishte një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që donte të arrihej.

8. Në këtë çështje Gjykata vuri në dukje se në asnjë fazë të procedurave të filluara nga ana e kërkuesit, nuk kishte pasur, nga ana e organeve të shqyrtimit të fakteve të krijuara në bazë të Ligjeve të viteve 1976 dhe 1989, një shqyrtim të pavarur të fakteve që e shtynë Sekretarin e Shtetit për të nxjerrë vërtetimin përfundimtar në bazë të Seksionit 42 të Ligjit të vitit 1976. Gjykatës për Punësimin e Drejtë nuk iu paraqit asnjë provë për arsyet e vlerësimit të kërkuesit si rrezik për sigurimin kombëtar, dhe as nuk pati ndonjë shqyrtim të bazave faktike të vendimit të Sekretarit të Shtetit në procedurat për rishikim gjyqësor të filluara në Gjykatën e Lartë. Gjykata konstatoi se dhënia e një vërtetimi nga ana e Sekretarit të Shtetit në bazë të seksionit 42, përbënte një kufizim jo proporcional në lidhje me të drejtën e kërkuesit për t’iu drejtuar një gjykate. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

### III. Koment

9. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në mosmarrëveshjet e punës mund të jetë paksa e vështirë për t'u kuptuar. Ka pasur një jurisprudencë të vazhdueshme të Gjykatës së Strasburgut sipas së cilës neni 6 § 1 gjen zbatim në mosmarrëveshjet e punës në përgjithësi përderisa këto kanë të bëjnë me “të drejta dhe detyrime me karakter civil”. Këtu mund të përfshihen mosmarrëveshjet në lidhje me pagesat dhe pensionet megjithëse mund të mos përfshihen procedimet e brendshme disiplinore.

10. Megjithatë kur një person është i punësuar në sektorin publik mosmarrëveshjet e tij të punës mund të mos jenë domosdoshmërisht të mbuluara nga ana e Nenit 6 § 1 kur puna e tyre përfshin detyra që synojnë të ruajnë interesat e përgjithshme të shtetit. Në çështjen Pellegrin kundër Francës<sup>33</sup> Gjykata e Strasburgut iu referua individëve të punësuar në sektorin publik si “mbajtës së një pjese të pushtetit sovran të shtetit”. Natyrisht që jo çdo person i punësuar në sektorin publik do ta përmbushë një kriter të tillë dhe për pasojë ata persona që kanë vende pune me kompetenca e kufizuara ose një sferë influence të reduktuar mund t'u akordohet mbrojtja e nenit 6 § 1 në mosmarrëveshjet e tyre të punës. Pasur parasysh që kërkuesi në rastin në fjalë ishte grada më e ulët në shërbimin civil jo-industrial nuk është e habitshme që Gjykata Evropiane konstatoi se nuk kishte arsye që mosmarrëveshja e tij të përjashtohet nga mbrojtja e nenit 6 të Konventës.

11. Pasi arrihet në përfundimin se një mosmarrëveshje bie në fushën e veprimit të nenit 6 § 1 është e nevojshme të vlerësohet nëse ka pasur shkelje të së drejtës konkrete. Në këtë çështje kërkuesi ankohej në lidhje me pamundësinë për t'iu drejtuar një gjykate për shkak se nuk kishte pasur një shqyrtim të pavarur të çështjes së tij nga një gjykatë e caktuar me ligj. Mundësia për t'iu drejtuar një gjykate nuk është e pakufizuar dhe mund t'i nënshtrohet kufizimeve legjitime siç janë për shembull afatet e përcaktuara me ligj. Në çështjen në fjalë Qeveria ishte përpjekur të argumentonte se mosmarrëveshja nuk mund të shqyrtohej nga Gjykata e Punësimit të Drejtë për arsye të sigurimit kombëtar. Gjykata e Strasburgut në këtë rast analizon nëse kufizimi që ishte vënë kishte cenuar thelbin e së drejtës dhe nëse ai ishte në proporcion me qëllimin e ndjekur<sup>34</sup> dhe se edhe në rastin kur ngrihen argumente të sigurimit kombëtar Gjykata e Strasburgut nuk do të ndalet në vlerësimin e karakterit të nevojshëm të kufizimit. Ashtu si në çështjen Tinnelly kundër Mbretërisë së Bashkuar të lartpërmendur, Gjykata priti që shteti të mund të kishte parashikuar procedura alternative në bazë të të cilave një gjykatë e pavarur ose një institucion i ngjashëm të ishte në gjendje të shqyrtonte të gjitha provat. Mund të jetë me vend për shembull, kur sigurimi kombëtar është në lojë, të kujtohet që shteti, duke mos qënë në favor të shfrytëzimit të procedurave normale gjyqësore, të parashikojë procedura të posaçme për zhvillimin e proceseve me dyer të mbyllura.

<sup>33</sup> Vendim i 8 dhjetorit 1999, paraardhës në këtë botim.

<sup>34</sup> Shih vendimin e Gjykatës të 28 majit 1985 në lidhje me çështjen Ashingdane kundër Mbretërisë së Bashkuar.

## COOPER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR DHE GREVIES kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesat nr. 48843/99 dhe 57067/00)

16 dhjetor 2003

Dhomë e Madhe

*këto dy vendime të Dhomës së Madhe kishin të bënin me garancitë e procesit të rregullt ligjor në procedurat përpara një gjykate ushtarake*

### I. Faktet kryesore

1. Këto dy çështje kishin të bënin me faktin nëse gjykimi nga gjykatat ushtarake në Mbretërinë e Bashkuar, në fuqi që nga koha e miratimit të Ligjit për Forcat e Armatosura, ishte apo jo i pajtueshëm me nenin 6 § 1 të Konventës.

#### A. Në lidhje me z. Cooper

2. Graham Cooper, shtetas britanik, kishte lindur më 1968 dhe jetonte në Birmingham. Në kohën e ngjarjeve ai shërbente si anëtar i RAF (Flotës Ajrore Mbretërore).

3. Më 18 shkurt 1998 Z. Cooper u dënua për grabitje në bazë të Ligjit të vitit 1968 "Për grabitjen" nga një gjykatë rajonale ushtarake e aviacionit. Ai u dënua me 56 ditë heqje lirie, u zbrit në rang dhe u lirua nga detyra. Gjykata ushtarake përbëhej nga një kryetar i përhershëm, dy oficerë të tjerë në një rang më të ulët dhe një gjyqtar-avokat<sup>35</sup>. Kryetari i trupit gjykues po përmbushte funksionin e tij të fundit përpara daljes në pension dhe ndaj tij nuk ishin bërë më kontrollle ose raporte vlerësuese profesionale që në gusht 1997. Dy anëtarët e trupit gjykues kishin marrë pjesë në një kurs trajnimi më 1993 i cili kishte trajtuar gjithashtu çështje të procedimit disiplinor.

4. Më 3 prill 1998 Autoriteti Rishikues, pas opinionit nga gjyqtari-avokat i përgjithshëm, la në fuqi vendimin e gjykatës rajonale ushtarake. Kërkuesi apeloj në Gjykatën Ushtarake të Apelit por pa sukses.

#### B. Në lidhje me z. Grieves

5. Mark Anthony Grieves, shtetas britanik, ka lindur më 1968 dhe jeton në Devon në Mbretërinë e Bashkuar. Në kohën e ngjarjeve ai ishte anëtar i Marinës Mbretërore.

<sup>35</sup> Gjyqtar Avokat [ang. judge advocate] - Sidomos në sistemin e common law është oficer-jurist i cili këshillon komandat ushtarake në lidhje me interpretimin e ligjit dhe sidomos të Kodit Uniform të Drejtësisë Ushtarake dhe që mund të shërbejë edhe si avokat (si në rastet në fjalë) ose si prokuror në gjyqet ushtarake.

6. Më 18 qershor 1998 Z. Grieves u dënua nga një Gjykatë Ushtarake e Marinës Mbretërore për plagosje të rëndë me qëllim shkaktimin e dëmeve të rënda trupore, akt që dënohej nga Ligji i “Veprave penale ndaj personit” i vitit 1861. Ai u dënua me tre vjet burg, u ul në gradë, u lirua nga shërbimi dhe u urdhërua të paguajë 700 sterlina si kompensim për dëmin. Gjykata ushtarake përbëhej nga një kryesues (një kapiten të Marinës Mbretërore), gjashtë oficerë të marinës dhe një gjyqtar-avokat, i cili shërbente si oficer i marinës dhe këshilltar ligjor për FLEET (komanda përgjegjëse për organizimin dhe lundrimin e të gjitha anijeve të marinës).

7. Më 29 shtator 1998 Bordi i Admiraliatit, pas opinionit që mori nga gjyqtari-avokat i FLEET, la në fuqi konstatimet e gjykatës ushtarake si dhe vendimin e saj. Kërkuesi apeloj në Gjykatën Ushtarake të Apelit por pa sukses.

## II. Vendimi i Gjykatës

8. Të dy kërkuesit ankoheshin se gjykatat ushtarake që i kishin gjykuar ata, ashtu siç ato ishin strukturuar në bazë të ligjit të vitit 1996, nuk ishin të pavarura dhe të paanshme dhe se kërkuesve iu ishte mohuar një gjykim i drejtë dhe publik nga ana e një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj. Ata bazoheshin në nenin 6 § 1 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

#### a. Mbi pranueshmërinë

9. Duke patur parasysh natyrën e akuzave kundër kërkuesve si dhe natyrën dhe ashpërsinë e dënimeve të dhëna, Gjykata vlerësoi se proceset përpara gjykatave ushtarake kishin të bënin me gjykimin për akuza me karakter penal ndaj kërkuesve. Duke konstatuar se ankesat e kërkuesve ngrinin çështje të së drejtës të cilat ishin mjaft serioze dhe se vendimi në lidhje me to varej në shqyrtimin e themelit, Gjykata i deklaroi kërkesat të pranueshme.

#### b. Në lidhje me themelin

##### i. Përsa i përket Z. Cooper

10. Gjykata e hodhi poshtë pretendimin e përgjithshëm të kërkuesit sipas të cilit gjykatat brenda shërbimeve të veçanta, në koncept, nuk mund të gjykonin në lidhje me akuza penale ndaj personelit sepse nuk përmbusheshin në një rast të tillë kërkesat e nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me pavarësinë dhe paanësinë.

11. Gjykata hodhi gjithashtu poshtë ankesën e tij për mungesën e pavarësisë dhe paanësisë së gjykatës ushtarake që e gjykoi atë. Argumentet e kërkuesit nuk hodhën ndonjë dyshim në lidhje me ndarjen e roleve të akuzës dhe të gjykimit gjatë procesit ushtarak ose në lidhje me pavarësinë e organeve vendimmarrëse nga komanda ushtarake, rangjet apo ndonjë ndikim tjetër për shkak të shërbimit ushtarak.

12. Gjykata deklaroi se nuk kishte arsye për të vënë në pikëpyetje pavarësinë e gjyqtarit-avokat të Flotës Ajrore përderisa ai ishte funksionar civil i emëruar

nga Lordi Kancelar (funksionar civil) dhe u caktua që të merrte pjesë në një gjyq ushtarak nga Gjyqtari-Avokat i Përgjithshëm që ishte gjithashtu funksionar publik. U konstatua se prania e një funksionari civil me cilësi të tilla dhe me një rol qendror në zhvillimin e procedurave në gjyqin ushtarak, përbënte një prej garancive më domethënëse për pavarësinë e këtij procesi. Gjithashtu, Kryetari i Përhershëm i Gjykatave Ushtarake i caktuar në këtë gjykatë ushtarake ishte i pavarur dhe dha një kontribut të rëndësishëm për pavarësinë e kësaj gjykate *ad hoc*.

13. Përsa i përket anëtarëve të trupit gjykues, Gjykata konstatoi se emërimi i tyre *ad hoc* dhe rangu relativisht i ulët në vetvete nuk e cenonin pavarësinë e tyre përderisa kishte garanci ndaj presionit të jashtëm që mund të ushtrohej ndaj tyre. Këto garanci konsistonin në praninë e Kryetarit të Përhershëm të Gjykatave Ushtarake dhe të gjyqtarit-avokat dhe në ndalimin e raportimit nga ana e anëtarëve të trupit gjykues.

14. Gjykata vuri në dukje se Autoriteti Rishikues përbënte një anomali të sistemit aktual të gjykatave dhe shprehu shqetësimin e saj në lidhje me një sistem të procedurës penale i cili autorizonte një autoritet jogjyqësor të ndërhynte në konstatimet me karakter gjyqësor. Megjithatë, Gjykata konstatoi se roli i Autoritetit Rishikues nuk e cenonte pavarësinë e gjykatës ushtarake për shkak se vendimi përfundimtar gjatë procesit varej gjithmonë nga një trup gjyqësor, gjykata rajonale ushtarake e aviacionit.

15. Për këto arsye, Gjykata arriti në përfundimin se nuk mund të thuhet se procedurat përpara gjykatës ushtarake ishin të padrejta dhe vendosi se nuk ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

*ii. Përsa i përket Z.Grieves*

16. Gjykata vuri në dukje se gjykatat e Marinës Mbretërore ndryshonin në disa aspekte të rëndësishme nga sistemi i Flotës Ajrore.

17. Ishte domethënës fakti që posti i Kryetarit të Përhershëm të Gjykatave Ushtarake nuk ekzistonte në sistemin e marinës. Në marinë kryetari i gjykatës së Marinës Mbretërore emërohej nga secila prej gjykatave sipas rastit. Gjykata vlerësoi se mungesa e një Kryetari të Përhershëm të Gjykatave Ushtarake me kohë të plotë, i cili të mos kishte interes promovimi dhe frikë largimi, dhe të mos i nënshtrohej detyrës për raportim në lidhje me vendimet e tij gjyqësore, i privonte gjykatat e Marinës Mbretërore nga një aspekt i rëndësishëm i pavarësisë së një gjykate *ad hoc*.

18. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se megjithëse gjyqtarët-avokatë të Marinës Mbretërore përmbushnin të njëjtin rol themelor në gjykatat ushtarake si edhe homologët e tyre në Flotën Ajrore, ata ishin oficerë të marinës në shërbim e sipër të cilët, kur nuk shërbenin në një proces gjyqësor, kryenin detyra normale për një oficer të marinës. Gjyqtari-Avokat i Flotës Ajrore ishte një funksionar civil i cili punonte me kohë të plotë për Gjyqtarin-Avokat të Përgjithshëm, që gjithashtu ishte një funksionar civil. Për më tepër, gjyqtarët-avokatë të Marinës Mbretërore emëroheshin nga një oficer marine, që ishte Gjyqtari-Avokat i Përgjithshëm i Marinës.



19. Me njëfarë shqetësimi Gjykata vuri re disa praktika raportimi të cilave iu nënshtroheshin gjyqtarët-avokatë të Marinës Mbretërore në kohën e ngjarjeve. Gjykata vlerësoi se edhe në qoftë se gjyqtari-avokat i caktuar në procesin përpara gjykatës ushtarake mund të konsiderohej si i pavarur pavarësisht këtyre ndërhyrjeve, pozita e tij nuk mund të konsiderohej si një garanci e fortë për pavarësinë e një gjykate ushtarake të Marinës Mbretërore. Për këtë arsye, mungesa e një funksionari civil në rolin themelor të gjyqtarit-avokat e privonte Marinën Mbretërore nga një prej garancive themelore të pavarësisë që gëzonin gjykatat e tjera ushtarake.

20. Në vijim Gjykata vlerësoi përmbledhjet që iu dërgoheshin anëtarëve të gjykatave ushtarake të Marinës Mbretërore të cilat në vijim përmbledheshin edhe më tej dhe bëheshin shumë më pak të qarta se relacionet që bënin për qëllime të ngjashme zyrtarët e Forcave Ajrore. Për këtë arsye ato ishin shumë më pak efektive në garantimin e pavarësisë të anëtarëve të zakonshëm të gjykatave ushtarake nga ndikimet e papërshtatshme që u vinin nga jashtë.

21. Duke konstatuar dallimet ndërmjet sistemit të gjykatave ushtarake të Forcave Ajrore të vlerësuara në çështjen Cooper dhe të sistemit të gjykatave ushtarake në Marinën Mbretërore në çështjen Grieves ishin të tilla që, sipas Gjykatës, dyshimet e Z. Grieves në lidhje me pavarësinë dhe paanësinë e gjykatës ushtarake që shqyrtoi çështjen e tij në bazë të ligjit të vitit 1996, mund të konsideroheshin objektivist të justifikuara.

22. Për këtë arsye ajo vendosi se procesi gjyqësor ushtarak në ngarkim të tij kishte qënë i padrejtë dhe ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

23. Gjykata i akordoi kërkuesit Grieves 8,000 euro për shpenzime dhe pagesa duke zbritur shumën që ai kishte marrë ndërkaq si ndihmë ligjore.

### **III. Koment**

24. Kjo çështje thekson parimin e rëndësishëm që mbrojtja e ofruar nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk mbaron tek dyert e garnizoneve apo reparteve ushtarake. Ashtu si edhe civilët, anëtarët e forcave të armatosura të akuzuar penalisht kanë të drejtë të gjykohen nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

25. Gjatë dhjetë vjetëve të shkuar ka patur një sërë vendimesh kundër Mbretërisë së Bashkuar në lidhje me përbërjen e gjykatave ushtarake dhe garancitë procedurale për një pavarësi të trupit gjykues të kërkuar nga neni 6. Në përgjigje të këtyre vendimeve janë ndërmarrë disa reforma ligjore. Sidoqoftë shpresojmë që këto dy vendime të Dhomës së Madhe të ofrojnë të paktën, jo vetëm për Britaninë e Madhe por për të gjitha vendet anëtare, orientimin përfundimtar në lidhje me karakteristikat që duhet të ketë një gjykatë ushtarake me qëllim që të jetë “e pavarur dhe e paanshme” siç kërkohet nga neni 6.

26. Një numër pikash janë gjithsesi të qarta. Jo të gjitha aspektet e procedimit disiplinor ushtarak gëzojnë mbrojtjen e nenit 6. Kjo do të varet nga natyra e shkeljes. Megjithatë në rastet kur një gjykatë ushtarake gjykon një anëtar të forcave të armatosura për një vepër penale të kryer si civil, neni 6 gjen gjithmonë zbatim.

27. Gjykimi i anëtarëve të forcave të armatosura nga gjykata speciale ushtarake nuk është i papranueshëm *per se*. Megjithatë neni 6 kërkon që një gjykatë të jetë e pavarur. Nuk pati ndonjë konstatim nga ana e Gjykatës në asnjërin prej këtyre rasteve që anëtarët e trupave gjykues të kishin vepruar në mënyrë të parregullt ose të padrejtë. Çështja qëndronte tek pavarësia e tyre institucionale. Në Britaninë e Madhe, ushtria dhe flota ajrore kanë Kryetarë të Përhershëm të Gjykatave Ushtarake të cilët janë oficerë të rangut të lartë dhe që kryejnë këtë detyrë para daljes së tyre në pension. Në lidhje me vendimet e tyre me karakter gjyqësor nuk ka asnjë procedurë raportimi nga ana e ndonjë oficeri tjetër të lartë. Kurse në marinë, Kryetari i Gjykatës Ushtarake emërohet mbi baza *ad hoc* dhe kur nuk shërben si i tillë shërben si oficer që kryen detyrat normale të një oficeri marine.

28. Në çështjen Cooper, Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 6 për shkak se gjykatat ushtarake në forcat tokësore dhe ajrore drejtoheshin nga një "Gjyqtar-Avokat" roli i të cilit ishte i krahasueshëm me atë të një gjyqtari në një gjyq civil i cili orienton jurinë. Për këtë arsye, në pikëpamjen e Gjykatës ishte më pak e rëndësishme që kryetari dhe anëtarët e tjerë të trupit gjykues, të cilët ashtu si në një proces civil vendosën për fajësi ose pafajësi, ishin ushtarakë në detyrë. Kurse në marinë, në çështjen Grieves, "Gjyqtari-Avokat" që drejtonte procesin ishte një ushtarak në shërbim e sipër. Në lidhje me përmbushjen e funksioneve të tij gjyqësore mund t'i dërgoheshin raporte eprorëve të tij. Gjykata konstatoi se ky element i privonte procedurat nga shkalla e pavarësisë e kërkuar nga ana e nenit 6.

29. Në çështjen Grieves nuk u kërkua dhe as nuk u akordua ndonjë shumë për shpërblim të drejtë. Avokatët që mbrojnë çështje në Gjykatën e Strasburgut duhet të mbajnë parasysh se pretendimet e kërkuesve për shpenzime dhe pagesa ligjore u reduktuan në 75% në këtë rast për shkak të mosparaqitjes së dokumenteve dhe të specifikimit të shpenzimit të kohës si dhe mos ndarjes së shpenzimeve për të dy çështjet (përderisa Cooper nuk fitoi atëherë nuk mund të akordoheshin shuma për honoraret e avokatit).

## PELLEGRINI kundër ITALISË

(kërkesa nr. 30882/96)

20 korrik 2001

*në urdhërimin e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të juridiksioneve të huaja, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që janë respektuar kriteret e nenit 6 të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, znj. Pellegrini është shtetase italiane. Ajo u martua me Z. Gigliozzi më 1962 me një ceremoni fetare e cila ishte e ligjshme sipas së drejtës civile. Më 1987 ajo kërkoi një ndarje me gjyq në Gjykatën e Shkallës së Parë të Romës. Procedurat përfunduan me një vendim të 2 tetorit 1990, me të cilin Gjykata e Shkallës së Parë të Romës e urdhëroi ish-bashkëshortin e kërkueses që t'i paguante asaj shuma mujore për të përballuar jetesën e saj.

2. Ndërkohë, më 20 nëntor 1987 kërkuesja ishte thirrur për t'u paraqitur përpara Gjykatës Kishtare Rajonale të Arqipeshkvisë së Romës 'për të dëshmuar në lidhje me martesën Gigliozzi-Pellegrini'. Ajo ishte e pranishme në seancën gjyqësore në ditën e kërkuar dhe atje u vu në dijeni se i shoqi kishte kërkuar deklarin nullo të martesës me arsyetimin se ata kishin qënë tepër të afërm me njëri-tjetrin nga pikëpamja farefisnore. Në analizën nga ana e gjyqtarit kërkuesja pranoi se ajo ishte një e afërt familjare e të shoqit por që nuk ishte në gjendje të thoshte nëse ajo kishte marrë ndonjë leje të posaçme për martesë në kohën e kësaj. Më 12 dhjetor 1987 kërkuesja mori një njoftim nga sekretaria e gjykatës kishtare e cila e njoftonte se ishte shpallur nulliteti i martesës me procedura të përsheptuara më 6 nëntor 1987 me arsyetimin se ajo dhe i shoqi kishin qënë mjaft të afërt nga pikëpamja farefisnore.

3. Kërkuesja apeloi kundër këtij vendimi të Gjykatës Kishtare në Gjykatën e Roman Rota<sup>36</sup>, duke u bazuar në pretendimin për shkelje të të drejtave të saj të mbrojtjes dhe të parimit të kontradiktoritetit përderisa ajo ishte thirrur për t'u paraqitur në Gjykatën Kishtare pa u njoftuar më parë në lidhje me kërkesën për nulitet të martesës ose për arsytet mbi të cilat kjo kërkesë ishte bazuar. Për më tepër ajo nuk ishte ndihmuar nga një avokat. Në një vendim të 13 prillit 1988, që u regjistrua në sekretari më 10 maj 1988, Gjykata e Roman Rota-s la në fuqi vendimin për nulitetin e martesës për shkak të lidhjeve familjare të të martuarve. Kërkesa e kërkueses për një kopje të plotë të vendimit u refuzua dhe ajo mori vetëm një kopje të dispozitivit të vendimit.

<sup>36</sup> Roman Rota është një gjykatë e përbërë nga 20 gjyqtarë dhe që ka juridiksionin apeli vetëm në lidhje me çështje të pavlefshmërisë së martesës të lidhur sipas së drejtës kishtare. Kjo gjykatë funksionon në Romë.

4. Në shtator 1989 ish-bashkëshorti i kërkueses kërkoi që kjo të paraqitej përpara Gjykatës së Apelit të Firences e cila po shqyrtonte çështjen mbi nxjerrjen e urdhrin të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Roman Rota-s. Kërkuesja u paraqit në këtë proces dhe ngriti edhe pretendimin për marrjen e një vendimi që hidhte poshtë vendimin e Gjykatës së Roman Rota-s me argumentin se ishin shkelur të drejtat e saj për t'u mbrojtur. Ajo vuri në dukje gjithashtu se asnjëherë nuk kishte marrë kopje të vendimit të nulitetit dhe as që kishte patur mundësi të shihte dokumentet e procedurës.

5. Më 8 nëntor 1991 Gjykata e Apelit e Firences nxori urdhrin e ekzekutimit të vendimit. Ajo vlerësoi se fakti që kërkuesja ishte pyetur më 1 dhjetor 1987 mjaftonte për të garantuar respektimit me parimin e kontradiktoritetit dhe se ajo kishte vendosur që t'i fillonte procedurat në Gjykatën e Roman Rota-s me dëshirën e saj dhe se kishte qënë në gjendje të ushtronte të drejtat e saj të mbrojtjes përpara kësaj gjykate "pavarësisht nga aspektet e veçanta të procedurës të së drejtës kanonike". Kërkuesja apeloj në Gjykatën e Kasacionit, përsëri mbi bazën e pretendimit të mohimit të të drejtave të saj të mbrojtjes në procedimin përpara gjykatave kishtare përderisa asaj nuk i ishte dhënë informacioni në lidhje me vendimin e nulitetit të martesës ose për shkak se nuk ishte ndihmuar nga një avokat. Ajo pretendoi gjithashtu se Gjykata e Apelit duket se nuk e kishte shqyrtuar dosjen e çështjes në lidhje me procedurat përpara gjykatave kishtare dhe se ajo mund të kishte ofruar prova përpara saj për të mbrojtur pretendimet që ngrinte. Në vijim, kërkesa e saj pranë sekretarisë së gjykatës kishtare për një kopje të dokumenteve të dosjes së çështjes së nulitetit të martesës, të cilat dëshironte t'i paraqiste në Kasacion, ishte hedhur poshtë.

6. Më 10 mars 1995 Gjykata e Kasacionit e hodhi poshtë kërkesën duke mbajtur qëndrimin se parimi i kontradiktoritetit kishte qënë respektuar në procedimet përpara gjykatave kishtare. Ajo shtoi se kishte një qëndrim të konsoliduar në lidhje me faktin se ndihma e një avokati në bazë të së drejtës kanonike nuk ishte e detyrueshme, por as edhe e ndaluar - kështu që kërkuesja mund të kishte kërkuar ndihmë ligjore. Gjykata e Kasacionit nuk bëri asnjë koment në lidhje me pamundësinë e këqyrjes së dosjes gjyqësore në procedurat e gjykatave kishtare.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

7. Kërkuesja ankohej për shkelje të Nenit 6 të Konventës në lidhje me faktin se gjykatat Italiane kishin njohur efektin e detyrueshëm dhe të ekzekutueshëm të një vendimi për nulitet, të dhënë nga gjykatat kishtare me procedime që kishin shkelur të drejtat e saj për t'u mbrojtur.

8. Gjykata së pari vuri në dukje se vendimi i nulitetit të martesës ishte marrë nga gjykatat e Vatikanit dhe ishte bërë i ekzekutueshëm nga një urdhër i dhënë nga gjykatat italiane. Përderisa Vatikani nuk e kishte ratifikuar Konventën dhe kërkesa drejtohej kundër Italisë, detyra e Gjykatës nuk ishte që të vlerësonte nëse procedurat gjyqësore kishtare respektonin apo jo Nenin 6 të Konventës por të shqyrtonte nëse

gjykatat Italiane kishin verifikuar siç duhej nëse garancitë e Nenit 6 ishin respektuar në procedurat përkatëse që çuan në një vendim të cilit vetë ato i dhanë efekt të ekzekutueshëm. Gjykata shpjegoi se një rishikim i tillë ishte i nevojshëm kur vendimi në lidhje me të cilin kërkohet një urdhër ekzekutimi vinte nga gjykatat e një vendi që nuk zbatonte Konventën, veçanërisht kur një çështje me rëndësi themelore ishte në lojë për autoritetet që do të jepnin këtë urdhër ekzekutimi.

9. Gjykata i vlerësoi edhe arsyet e dhëna nga Gjykata e Apelit e Firences dhe Gjykata e Kasacionit për mospranimin e ankimit të kërkuases ndaj procedurave përpara gjykatave kishtare. Ajo vuri në dukje se gjykatat italiane nuk duket se i kishin kushtuar rëndësi faktit që kërkuases i kishte qënë mohuar mundësia për të parë provat në të cilat ishte bazuar ish-bashkëshorti i saj si dhe dëshmitarët e pretenduar. Pjesë përbërëse e një procesi me palë kundërshtare është edhe mundësia që secila palë në proces, qoftë ky penal apo civil, ka në parim mundësinë për të shqyrtuar dhe kundërshtuar çdo provë ose pretendim që i paraqitet gjykatës me synimin për të ndikuar në vendimin e saj. Kjo mundësi nuk mund të mohohet, siç kishte pretenduar në fakt qeveria, mbi bazën se kërkuesi nuk kishte të drejtë të mbrohet ndaj një vendimi për nulitetin e martesës i cili bazohet në një fakt objektiv dhe padyshim të verifikueshëm. Sipas Gjykatës i takonte vetëm palëve në një mosmarrëveshje që të vendosnin nëse duhej dhënë një përgjigje ndaj provave të paraqitura nga pala tjetër ose nga dëshmitarët.

10. Në vijim, Gjykata vlerësoi se kërkuases duhet t'i ishte dhënë një mundësi për të kërkuar ndihmë nga një avokat, në qoftë se ajo do ta kërkonte një gjë të tillë. Gjykatat kishtare duhet të kishin prezumuar se kërkuësja, e cila nuk ishte e përfaqësuar nga një avokat, nuk ishte e familjarizuar me jurisprudencën që ka të bëjë me ndihmën ligjore në procedurat e së drejtës kanonike. Përderisa kërkuësja kishte qënë thirrur për t'u paraqitur përpara gjykatave kishtare pa ditur qëllimin e procedurave, këto kishin detyrimin për ta njoftuar atë për të drejtën e saj për t'u ndihmuar nga një avokat përpara se të vinte të paraqitej në gjykatë për të dëshmuar. Në këto rrethana, Gjykata vendosi se gjykatat italiane, përpara se të lëshonin një urdhër për ekzekutimin e Gjykatës së Roman Rota-s, nuk kishin arritur të siguronin që kërkuësja të kishte një seancë të drejtë në procedurat pranë gjykatave kishtare. Pra ka patur në këtë rast shkelje të Nenit 6 § 1.

### ***B. Në lidhje me nenin 41***

11. Në bazë të Nenit 41 të Konventës, Gjykata njëzëri i akordoi kërkuases 10 000 000 lireta për dëm jo-material dhe 18 253 940 lireta për shpenzime dhe pagesa ligjore.

### **III. Koment**

12. Gjykata ka patur rast ta vlerësojë edhe më parë situatën kur detyrimet e një shteti në bazë të Konventës vihen në lëvizje nga marrëdhëniet e tij me procese gjyqësore në juridiksione të tjera. Kështu për shembull çështja Drozd dhe Janousek kundër Francës

dhe Spanjës<sup>37</sup>, kishte të bënte me burgosjen në këto dy shtete si pasojë e dënimeve të dhëna në Andorra, e cila në atë kohë nuk ishte palë e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata vlerësoi se tendencat aktuale drejt forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në administrimin e drejtësisë, nuk i shkarkojnë shtetet nga detyrimi për të refuzuar bashkëpunimin e tyre nëse del në pah se një dënim vjen si pasojë e një mohimi flagrant të drejtësisë. Zbatimi ekstraterritorial i detyrimeve të Konventës kërkon gjithashtu që shtetet të stepen nga dërgimi i personave që ndodhen në juridiksionin e tyre në situata ku ata mund të jenë në rrezik të një trajtimi çnjerëzor, degradues ose të kushteve në kundërshtim me Nenin 3<sup>38</sup>, ose ku ata mund t'i nënshtrohen rrezikut të cenimit të integritetit të tyre moral dhe fizik që mund të mos jetë i justifikueshëm në bazë të Nenit 8 § 2<sup>39</sup>, ose ku të mund t'i nënshtrohen procedurave gjyqësore që në mënyrë të hapur nuk respektojnë garancitë e Nenit 6. Këto situata dalin në pah kryesisht në raste imigrimi dhe ekstradimi.

13. Vendimi në çështjen Pellegrini është veçanërisht i rëndësishëm për shtetet anëtare të BE-së të cilat janë të detyruara në bazë të Rregullores së BE Nr. 1347/2000 (të njohur edhe si Konventa e Bruksel II) që t'u japin efekt vendimeve gjyqësore të njëri tjetrit në lidhje me çështjet martesore. Kjo rregullore bën tashmë pjesë në *acquis communautaire* i cili duhet adoptuar nga të gjitha shtetet që në të ardhmen duan të bëjnë pjesë në BE. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka marrë në shqyrtim gjithashtu edhe marrëdhëniet ndërmjet detyrimeve në bazë të traktateve të tjera ndërkombëtare dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në një serë rastesh. Në çështjen *Ignaccolo Zenide kundër Rumanisë të 25 janarit 2000*, Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 8 për shkak se shteti Rumun nuk kishte arritur të vinte në zbatim një vendim të dhënë në bazë të Konventës së Hagës mbi aspektet civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve.

14. Në lidhje me organizatat ndërkombëtare Gjykata ka vendosur se “kur shtetet krijojnë organizata ndërkombëtare, ose mutatis mutandis marrëveshje ndërkombëtare, për të ndjekur qëllime të bashkëpunimit në disa fusha ose veprimtari, kjo mund të sjellë pasoja për mbrojtjen e të drejtave themelore. Do të ishte e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës në qoftë se shtetet kontraktuese do të çliroheshin nga përgjegjësia mbi bazë të Konventës në lidhje me fushën e veprimtarisë të mbuluar nga një pjesëmarrje e tillë”<sup>40</sup>. Ky parim është analizuar edhe në vendime të tjera të Gjykatës, që në këtë botim janë përfshirë në kuadrin e nenit 1 si Bankoviç dhe të tjerë kundër shteteve anëtare të NATO-s që janë edhe anëtare të Këshillit të Evropës apo Ilascu dhe të tjerë kundër Moldavisë dhe Rusisë.

<sup>37</sup> Vendim i 26 qershorit 1992.

<sup>38</sup> Shih në lidhje me këtë një jurisprudencë të tillë të Gjykatës së Strasburgut vendimin e saj të 7 korrikut 1989 në lidhje me çështjen Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, të përfshirë në këtë botim. Shih gjithashtu edhe vendimet e saj në lidhje me çështjet Vilvarajah dhe Pushparajah kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës.

<sup>39</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 6 shkurtit 2001 në lidhje me çështjen Bensaïd kundër Mbretërisë së Bashkuar.

<sup>40</sup> Shih vendimet e saj në lidhje me çështjet T.I kundër Mbretërisë së Bashkuar (7 Mars 2000), Ëaite dhe Kennedy kundër Republikës Federale Gjermane (18 shkurt 1999) dhe M kundër Republikës Federale Gjermane.



## KLEYN DHE TË TJERË kundër HOLANDËS

(kërkesat nr. 39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99)

6 maj 2003

### Dhomë e Madhe

*në këtë vendim u ngrit çështja e ndarjes së pushteteve dhe i konfliktit të mundshëm institucional për shkak të ushtrimit këshillimor dhe gjyqësor nga i njëjti organ*

#### I. Faktet kryesore

1. Çështja ka të bëjë me katër kërkesa të veçanta të bëra nga 23 shtetas holandezë dhe nga 12 shoqëri holandeze, shtëpitë dhe mjediset e aktivitetit tregtar të cilëve ndodheshin në ose afër rrugës ku do kalonte një hekurudhë e re, e quajtur *Betuweroute*, e cila kishte filluar të ndërtohej dhe që bashkonte portin e Roterdamit me kufirin gjerman.
2. Të gjithë kërkuesit ishin ankuar për të kundërshtuar vendimin për përcaktimin e itinerarin e saktë të *Betuweroute*, të ashtuquajtur Vendimi mbi Itinerarin. Ky vendim ishte marrë në bazë të një procedure që parashikohej në Ligjin për Planifikimin e Infrastrukturës së Transportit, në fuqi që më 1994. Në vendimin e tij të 28 majit 1998 Seksioni Gjyqësor Administrativ i Këshillit të Shtetit hodhi poshtë pjesën më të madhe të ankesave të kërkuesve. Për pjesën e ankesave që u pranuan si të bazuara, u morën vendime të reja më 1998. Duke mos qenë të kënaqur as me këtë vendime kërkuesit u ankuan edhe ndaj tyre por këto ankesa u hodhën poshtë me vendime që u morën në periudhën 16 prill 1999 deri 25 korrik 2000.

#### II. Vendimi i Gjykatës

3. Kërkuesit ankoheshin se, në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës, Seksioni Gjyqësor Administrativ i Këshillit të Shtetit nuk mund të konsiderohej si gjykatë e paanshme dhe e pavarur përderisa Këshilli i Shtetit ushtronte kompetenca edhe këshillimore, duke dhënë mendimet e tij në lidhje me projekt ligjet, ashtu edhe funksione gjyqësore duke vendosur mbi ankimet me karakter administrativ. Duke u bazuar në konstatimet e Gjykatës në vendimin e dhënë prej saj më 28 shtator 1995 në lidhje me çështjen Procola kundër Luksemburgut<sup>41</sup>, kërkuesit ankoheshin se Këshilli i Shtetit e kishte këshilluar qeverinë në lidhje me projektin e ligjit për Planifikimin e Infrastrukturës së Transportit dhe se Vendimi mbi Itinerarin që ata kishin kundërshtuar në vijim përpara Seksionit Gjyqësor Administrativ të Këshillit të Shtetit ishte marrë në bazë të të njëjtit akt.

<sup>41</sup> Në këtë vendim Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se ushtrimi i njëpasnjëshëm i funksioneve këshillimore dhe gjyqësore nga ana e Gjykatës së Lartë Administrative në lidhje me të njëjta vendime ishte i tillë që të hidhte hije dyshimi mbi pavarësinë strukturore të institucionit.

**A. Mbi pranueshmërinë e kërkesës**

4. Qeveria holandeze pretendonte se, përveç z. dhe znj. Raymakers, të gjithë kërkuessit e tjerë nuk kishin shteruar mjetet e brendshme për shkak se ata nuk e kishin kundërshtuar juridiksionin e Seksionit Gjyqësor Administrativ të Këshillit të Shtetit dhe as nuk ishin ankuar në gjykatat civile me argumentimin se procedurat administrative në fjalë nuk ofronin garancitë e mjaftueshme të barazisë. Por përderisa edhe kundërshtimi i bërë nga çifti Raymakers<sup>42</sup> nuk ishte pranuar Gjykata nuk shihte sesi ndonjë kundërshtim tjetër nga ana e kërkuessve të tjerë dhe që mbështetej në të njëjtët argumente si ato të çiftit Raymakers mund të kishte çuar në një vendim të ndryshëm. Në vijim kërkuessit argumentuan se ankimi civil të cilit i referohej edhe Qeveria nuk ofronte ndonjë perspektivë suksesi. Për këtë arsye, kërkesat nuk mund të hidheshin poshtë për mos shterim të mjeteve të brendshme.

5. Në vijim Gjykata vlerësoi se ankesat në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës ngrinin çështje të tilla ligjore që ishin të tilla sa kërkonin shqyrtim të kërkesës në themel.

**B. Në lidhje me nenin 6 § 1**

6. E vetmja pikë të cilës duhej t'i përgjigje Gjykata në këtë çështje ishte ajo nëse, në rrethanat specifike, Seksioni Gjyqësor Administrativ kishte patur nivelin e kërkuar të një pavarësie subjektive dhe të një paanësie objektive.

7. Gjykata nuk konstatoi asgjë në mënyrën dhe kushtet e emërimit të anëtarëve të Këshillit të Shtetit në Holandë ose në mandatin e tyre funksional që të konfirmonte shqetësimet e kërkuessve në lidhje me pavarësinë e Këshillit të Shtetit. Nga ana tjetër nuk kishte asnjë të tregues për ndonjë anësi personale nga ana e ndonjë anëtari të trupit gjykues që mori në shqyrtim ankesat e kërkuessve kundër Vendimit të Itinerarit.

8. Nga ana tjetër Gjykata nuk ishte aq e bindur sa qeveria holandeze se masat e brendshme të marra nga ana e Këshillit të Shtetit me qëllim që të pasqyronin pasojat e vendimit Procola në Holandë, ishin të tilla sa të siguronin që në tërësinë e tyre ankimet përpara Seksionit Gjyqësor Administrativ përbënin një gjykatë të paanshme në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës. Megjithatë, nuk ishte detyra e Gjykatës që të vendoste in abstracto në lidhje me përjasjen e sistemit ligjor holandez me Konventën në këtë këndvështrim<sup>43</sup>. Çështja që ngrihej përpara Gjykatës ishte nëse, në lidhje me ankesat e kërkuessve, ishte e pajtueshme me kërkesat e paanësisë objektive që struktura institucionale e Këshillit të Shtetit tu lejonte disa prej këshilltarëve të vet që të ushtronin si funksione këshillimore ashtu edhe gjyqësore.

9. Këshilli i Shtetit kishte dhënë mendime në lidhje mbi projekt ligjin “Për Planifikimin e Infrastrukturës së Transportit” ndërkohë që ankesat e kërkuessve

<sup>42</sup> Madje është interesant sepse ky kundërshtim ishte bazuar në konstatimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen Procola kundër Luksemburgut.

<sup>43</sup> Shih për këtë qëllim edhe paragrafin 4 të Parathënies së Raportit të Përjasjes së Legjislacionit Shqiptare me kërkesat e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Tiranë - qershor 2003.

ishin drejtuar kundër Vendimit mbi Itinerarin Gjykata konstatoi se mendimet këshillimore në lidhje me projekt ligjet dhe procedurat e mëvonshme në lidhje me ankesa kundër Vendimit mbi Itinerarin nuk mund të konsideroheshin sikur kishin të bënin me “të njëjtën çështje” ose “të njëjtin vendim”. Megjithëse planifikimi i hekurudhës *Betuweroute* ishte referuar në këshillat që i ishin dhënë qeverisë nga ana e Këshillit të Shtetit, kjo nuk mund të konsiderohej si një përcaktim paraprak i ndonjë qëndrimi që do të mbahej në vijim nga ministrat kompetentë për të nxjerrë Vendimin mbi Itinerarin. Gjykata nuk mund të ishte dakord me kërkuesit sipas të cilëve, duke sugjeruar pikënisjen dhe pikëmbërritjen e *Betuweroute*, Këshilli i Shtetit kishte paragjykuar në ndonjë farë mënyre itinerarin e saktë të hekurudhës.

10. Për këtë arsye pretendimi i kërkuesve për mungesë pavarësie dhe paanësie të Seksionit Gjyqësor Administrativ nuk mund të vlerësohej si objektivisht i justifikuar. Për këtë arsye Gjykata vendosi se nuk ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

### III. Koment

11. Një fakt tepër interesant në këtë vendim është fakti se pjesë e gjyqtarëve që përbënin mendimin e pakicës ishte edhe gjyqtari i shtetit palë. Normalisht në raste kur shumica konstaton shkelje gjyqtari i shtetit kundër të cilit jepet vendimi në disa raste voton kundra. Por është tepër e rrallë, gjithsesi, ajo që ndodhi në këtë rast ku shumica nuk konstaton shkelje ndërsa gjyqtari i shtetit palë nuk është dakord.

12. Duke kaluar në analizën thelbësore të vendimit, kujtojmë se në vendimin Procola kundër Luksemburgut Gjykata ka konstatuar shkelje të Nenit 6 në një çështje të ngjashme që përfshin ndarjen e pushteteve dhe konfliktin që mund të lind si pasojë e ushtrimit të kompetencave këshillimore dhe gjyqësore nga i njëjti organ. Në bazë të Nenit 46 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shtetet janë të detyruara të përshtaten me vendimet e Gjykatës, përfshirë këtu ndryshimet legjislative ose të praktikave administrative që janë vlerësuar se shkelin Konventën. Megjithëse Konventa nuk përmban asnjë dispozitë të qartë ku t'u kërkojë shteteve që të marrin hapa për të ndryshuar praktikat e tyre nën dritën e vendimeve kundër shteteve të tjera, shtetet gjithsesi duhet t'i marrin këto hapa në qoftë se duan të shmangin që Gjykata të konstatojë në të ardhmen se ata e kanë shkelur Konventën.

13. Në këtë çështje Gjykata i kushtoi rëndësi faktit se qeveria holandeze, në dritën e jurisprudencës Procola kundër Luksemburgut, kishte ndërmarrë hapa që synonin të siguronin që Seksioni Gjyqësor Administrativ të përbënte vërtet një gjykatë të paanshme në bazë të nenit 6. por përsëri Gjykata u shpreh se nuk ishte e kënaqur me çfarë ishte arritur. Në këtë rast, ajo përballet me kufijtë e juridiksionit të saj. Siç e pranon edhe në këtë çështje, në ndryshim nga shumë Gjykata Kushtetuese, ajo nuk mund të vendosë in abstracto<sup>44</sup> në lidhje me përfaqshen e së drejtës apo sistemit juridiksional të brendshëm me Konventën, por ajo kufizohet në shqyrtimin e zbatimit të saj në kuadrin e fakteve të

<sup>44</sup> Shih në lidhje me këtë rol të kufizuar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në “Për një rend publik evropian” vëllimi 1, fq. 26, botim i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut. - Tiranë

çështjes që i janë paraqitur për shqyrtim. Më e shumta që mund të thuhet prej Gjykatës në këtë çështje ishte që, në kuadrin e fakteve specifike të çështjes, ajo vlerësoi se nuk kishim të bënim me “të njëjtën çështje” ose “të njëjtin vendim” në ushtrimin e dy funksioneve të lartpërmendura. Por duhet thënë se, duke mos konstatuar shkelje në këtë çështje, ajo e la qeverinë holandeze edhe qeveritë e vendeve të tjera me strukturë të ngjashme kushtetuese (jo më kot qeveritë e Francës dhe Italisë ndërhyjnë si palë të interesuara në këtë çështje) në një pozitë të paqartë. Dhoma e Madhe nuk ofroi një linjë të qartë se cili do të ishte rezultati i një çështje të ngjashme në të ardhmen.

## PLATAKOU kundër GREQISË

(kërkesa nr. 38460/97)

11 janar 2001

*individët duhet të përfitojnë njësoj si shteti nga normat procedurale*

### I. Faktet kryesore

1. Foula Platakou, shtetase greke, u ankua në lidhje me shpronësimin e pronës së saj duke pretenduar se ajo ishte dëmtuar nga një gabim i bërë nga ana e organeve gjyqësor pasi kërkesa e saj për kompensim u deklarua e papranueshme për shkak se zyra e përmbarimit nuk kishte njoftuar brenda afatit ligjor të detyrueshëm për kërkesën e saj. Ajo pretendonte në vazhdim se në qoftë se ajo do të kishte përfituar nga pezullimi i ecjes së afatit ligjor gjatë pushimeve të organeve gjyqësore, siç përfituan vetë këto organe, kërkesa e saj do të kishte qënë në kohë dhe prandaj ky rregull kishte karakter “diskriminues” përderisa vjen në kundërshtim me parimin e “barazisë së mjeteve”.

2. Në vazhdim Znj. Platakou pretendonte se asnjë gjykatë nuk kishte shqyrtuar në parim ose në thelb ankimin e saj në lidhje me gabimin në fjalë dhe se ajo nuk kishte marrë një kompensim të plotë dhe të drejtë përderisa shuma që ajo kishte marrë korrespondonte vetëm me një të katërtën e vlerës së pronës që i ishte shpronësuar.

### II. Vendimi i Gjykatës

3. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi njëzëri se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 dhe të nenit 1 të Protokollit 1, por që nuk ishte e nevojshme që të shqyrtohej ankimi i kërkuases në kuadrin e nenit 14. Znj. Platakou iu akorduan 90 000 000 dhrahmi greke për dëm material, 3 000 000 për dëm jo-material dhe 6 710 000 për shpenzime dhe pagesa.

---

2001. Natyrisht që këtu duhet mbajtur parasysh edhe roli subsidiar që qoftë Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut qoftë Gjykata e Strasburgut kanë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në raport me legjislacionin ose me juridiksionet kombëtare. Nën këtë logjikë siç e kemi thënë (në “Të drejtat e Njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komentë” fq. 30) frymëzohet edhe ekzistenca e Nenit 35 të Konventës për shterimin e mjeteve të brendshme.

### III. Koment

4. Gjykatës shpesh herë i arrijnë kërkesa që kanë të bëjnë me pretendime të shkeljes së nenit 6 duke vendosur procedura të padrejta kufizuese në lidhje me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Gjykata ka theksuar se afatet gjyqësore janë parashikuar dhe vendosur për të siguruar një administrim siç duhet të drejtësisë dhe në përputhje me parimet e sigurisë juridike (të cilat ajo i konsideron një "qëllim të ligjshëm") por është e kujdesshme madje e tërhequr në shqyrtimin e kërkesave në lidhje me pamundësinë e respektimit të afateve ligjore. Megjithatë duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohej të arrihej. Në *Perez de Rada Cavanilles kundër Spanjës*<sup>45</sup> Gjykata gjeti shkelje në një rast kur kërkuesi kishte patur vetëm tre ditë në dispozicion për të përgatitur dhe paraqitur dosjen e tij në apel në një pjesë tjetër të vendit ndërkohë që vendimi që ajo kundërshtonte ishte dhënë në kryeqytet. Në *Vaser kundër Francës*<sup>46</sup> Gjykata gjeti shkelje kur një kërkesë apeli ishte pushuar përpara se pretendimet e ndërmjetme mbështetëse të ishin paraqitur. Kjo megjithëse nuk ishte caktuar ndonjë datë për paraqitjen e këtyre pretendimeve dhe, nga ana tjetër, kërkuesi nuk ishte njoftuar qoftë në lidhje kohën e vlerësimit të tyre qoftë që periudha kohore do të ishte më e shkurtër sesa ajo që gjykatës i duhej normalisht për të shqyrtuar një çështje të caktuar. Në çështjen *Stubblings kundër Mbretërisë së Bashkuar*<sup>47</sup> u konsiderua se Mbretëria e Bashkuar nuk kishte bërë shkelje të Konventës kur ajo kishte vendosur një afat ligjor prej gjashtë vjetësh për bërjen e padive për vepra penale kundër personit, por gjithsesi një afat fleksibël ligjor për padi që kishin të bënin me raste neglizhence. Rasti *Plakatou* është paksa i ndryshëm. Ai ka të bëjë me rregullat e së drejtës së brendshme që kanë të bëjnë me shtyrjen e afateve ligjore gjatë periudhës së verës, shtyrje që gjente zbatim në lidhje me shtetin por jo edhe me individët. Detyra e Gjykatës, për pasojë, ishte që të përcaktonte nëse zbatimi i një rregulli të tillë ishte apo jo në përputhje me parimin e barazisë së mjeteve. Çdo lloj pabarazie në rregullat procedurale në lidhje me zbatimin e të cilave përfiton shteti por jo individët përbën një shkelje potenciale.

<sup>45</sup> Vendim i 28 tetorit 1998.

<sup>46</sup> Vendim i 17 dhjetorit 1996.

<sup>47</sup> Vendim i 22 tetorit 1996.

## C.G. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 43373/98)

19 dhjetor 2001

*ky vendim ka të bëjë me një rast tepër interesant në lidhje me sjelljen e gjyqtarit në një proces gjyqësor në raport me palët*

### I. Faktet kryesore

1. Znj. C.G., me shtetësi britanike ka lindur në vitin 1970 dhe jeton në veri në Anglisë. Ajo u akuzua për vjedhje të afërsisht 2 900 sterlinave britanike në vendin e saj të punës. Ajo pretendoi se ishte e pafajshme por në prill 1997, pas një procesi tre ditor në një gjykatë angleze në prani të një gjykatësi dhe të një jurie ajo u shpall fajtores dhe u dënua me burg me kusht dhe me 100 orë shërbim me karakter civil.

2. Ajo u ankua kundër këtij dënimi me pretendimin se, ndërmjet të tjerash, gjyqtari i çështjes kishte ndërprerë dhe trajtuar me arrogancë avokatin e saj gjatë procesit dhe se kishte bërë një parashtrësë përmbledhëse me të meta përpara jurisë, duke e privuar atë nga një gjykim i drejtë. Në mënyrë të veçantë ajo pretendoi se gjatë pyetjes nga ana e avokatit të saj të dëshmitarit të akuzës, S., gjyqtar kishte ndërhyrë aq shpesh sa që avokati nuk e kishte patur të mundur që të testonte rregullsinë e kalendarit të pagesave bankare të përgatitura nga ky dëshmitar, i cili përbënte edhe provën materiale bazë për ndjekjen penale. Në këtë mënyrë avokati ishte penguar që të përpunonte linjat e tij të mbrojtjes. Kërkesja ankohej gjithashtu se gjyqtari i kishte ndërprerë vazhdimisht deklaratimet e saj për pyetjet që i bëheshin, duke e bërë të pamundur për të, që t'i ofronte jurisë provat në një mënyrë koherente, dhe se e kishte fyer avokatin deri në një masë të tillë sa ky ishte detyruar të ndërpriste pyetjet ndaj klientes së tij përpara jurisë. Në shkurt 1998 Gjykata e Apelit nuk e pranoi apelimin e saj me argumentimin se, megjithëse kishte disa baza për pretendimin e saj për qëndrim jo të rregullt nga ana e gjyqtarit të çështjes, kjo nuk do të thoshte se dënimi i saj ishte i papabazuar dhe i paargumentuar për qëllimet e çështjes në fjalë.

### II. Vendimi i Gjykatës

3. Znj. C.G. e bazonte kërkesën e saj në kuadrin e nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut pikërisht me pretendimin se asaj i ishte mohuar e drejta për një gjykim të drejtë.

#### A. Në lidhje me nenin 6

4. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se, megjithëse provat e ofruara nga ana e S. dhe e kërkueses, gjatë të cilave u bënë edhe ndërhyrjet e



kontestuara, ato përbënin gjithsesi vetëm një pjesë të procedurës gjyqësore. Në vijim, ndërsa disa nga ndërhyrjet e gjyqtarit të çështjes ishin vlerësuar nga Gjykata e Apelit si të pajustificueshme, ndërhyrjet e tjera u gjetën se ishin bërë me vend. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nga ana e saj e pranoi vlerësimin e Gjykatës së Apelit në lidhje me faktin se avokati i kërkueses ishte hutuar nga ndërprerjet e gjyqtarit. Ajo ishte dakord me Gjykatën e Apelit edhe duke iu referuar shqyrtimit nga ana e vet të dosjes së çështjes, duke vlerësuar se avokati i kërkueses nuk ishte penguar të vazhdonte linjën e vetë të mbrojtjes. Gjykata i dha rëndësi faktit që avokati i kërkueses kishte qënë në gjendje t'i drejtohej jurisë me një parashtrim përfundimtar që zgjati për rreth 45 minuta pa ndonjë ndërprerje, përveç një ndërprerjeje e cila u vlerësua si e justifikueshme. Ajo mbajti gjithashtu parasysh faktin se thelbi i mbrojtjes së kërkueses ishte përfshirë edhe në përmbledhjen e bërë nga gjyqtari, megjithëse në një formë të shkurtuar. Për këtë arsye Gjykata konstatoi se ndërhyrjet gjatë seancës nga ana e gjyqtarit të çështjes, megjithëse ishin të tepruara dhe të padëshirueshme, në fund të fundit nuk e bënë procesin gjyqësor në tërësi të padrejtë.

5. Për këtë arsye Gjykata vendosi se nuk ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe se pretendimet e tjera të kërkueses në kuadrin e Nenit 6 nuk nxirrnin në pah ndonjë problem tjetër që duhej marrë në shqyrtim veçmas.

### III. Koment

6. Shtetet që janë anëtare të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kanë sisteme të ndryshme ligjore. Nga ana tjetër edhe qëllimi i Konventës nuk është aspak ai i unifikimit të sistemeve ligjore të vendeve anëtare të saj. Kështu pra disa vende kanë sisteme penale inkuizitore; disa përdorin gjyqtarë hetimorë ndërsa në të tjerë i gjithë procesi hetimor zhvillohet nga prokurori; disa kanë ndihmës gjyqtarë bashkë me gjyqtarë profesionistë, disa përdorin një panel jurie jo-profesionale të kryesuar nga një gjyqtar profesionist, ndërsa vende të tjera kanë vetëm gjyqtarë profesionistë. Nga ana tjetër disa sisteme juridike mbështeten shumë në jurisprudencën e mëparshme, të tjerë në tekstet e dispozitave ligjore ndërsa të tjerë akoma i japin rëndësi edhe komentarëve të juristëve të shquar. Disa sisteme i lejojnë palët që të paraqiten vetë në procedimet gjyqësore ndërsa të tjerë kërkojnë përfaqësimin me avokat në këto procedura. Disa sisteme kanë gjykata administrative më vete ndërkohë që sisteme të tjera jo. Disa shtete kanë sistemin me avokatë të caktuar nga gjykata për personat që nuk kanë mundësi t'i paguajnë vetë ndërsa në të tjerë është vetë shteti që paguan për avokatët e zgjedhur nga personi që nuk ka mundësi ta paguajë. Në asnjërin nga këto drejtime Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk u dikton shteteve se cilin sistem ato duhet të adoptojnë por vetëm u kërkon që sistemi i zgjedhur prej tyre të funksionojë efektivisht në drejtim të garantimit të të drejtave të parashikuara nga ana e Konventës. Kjo e bën të vështirë që, duke u nisur nga jurisprudenca e Gjykatës, të përvijohen parime koherente të zbatimit të përgjithshëm të nenit 6 të Konventës.

7. Në ndryshim nga sistemet *civil law*, në të drejtën penale angleze gjyqtari nuk ka një rol hetimor-pyetës dhe nuk pretendohet që ai të bëjë pyetje drejt dëshmitarëve.

Ka një jurisprudencë të konsoliduar tashmë që bën të qartë se një ndërhyrje e tepruar gjyqësore gjatë procesit çon në një proces të padrejtë gjyqësor. Kjo jurisprudencë nuk u mbajt parasysh nga Gjykata Angleze e Apelit kur ajo vendosi që të mos ndryshonte vendimin e dënimit të kërkuësës. Nuk është roli i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të vendos nëse gjykatat angleze e kishin zbatuar siç duhej të drejtën angleze. Gjykata nuk është një ‘instancë e katërt’ dhe kërkesat në kuadrin e Nenit 6 nuk kanë të bëjnë përgjithësisht me çështjen nëse gjykatat e brendshme arritën në përfundimin e duhur apo nëse ato e zbatuan siç duhej të drejtën e brendshme në një rast të caktuar, por në të vërtetë kanë të bëjnë me faktin nëse procedurat që u përdorën ishin, në tërësinë e tyre, të drejta apo jo. Vetëm dy nga shtatë gjyqtarët e Gjykatës në këtë çështje u përkisnin juridiksioneve me sistem të *common law* dhe të dy ata vunë në dyshim qëndrimin e gjyqtarit të çështjes – njëri me një mendim më vete paralel ndërsa tjetri me një mendim prej 6 faqesh të kundërt me shumicën.

## PAPON kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 54210/00)

25 korrik 2002

*kjo çështje ka të bëjë me moslejimin e ankimit në apel të një person që nuk iu dorëzua organeve gjyqësore*

### I. Faktet kryesore

1. Maurice Papon është shtetas francez i lindur më 1910 dhe aktualisht mbahet në Burgun ‘Santé’ në Paris.
2. Me një vendim të 2 prillit 1998 Gjykata e Krimeve e gjeti atë fajtor për ndihmën dhe mbështetjen që kishte dhënë për arrestimet e paligjshme dhe burgosjet e padrejta të Hebrenjve të cilët ishin internuar në Auschwitz në korrik, gusht dhe tetor 1942 dhe në janar 1944, vepra që përbënin krime kundër njerëzimit. Z. Papon u dënua me dhjetë vjet burg dhe u zhvesh nga të gjitha të drejtat e tij civile, qytetare dhe familjare për dhjetë vjet.
3. Më 3 prill 1998 kërkuësi apeloj kundër këtij vendimi në lidhje me interpretimin e dhënë nga ana e Gjykatës së Krimeve, dhe në 17 shtator 1999 ai kërkoi të që të përjashtohet nga detyrimi për t’u dorëzuar në gjendje arresti përpara seancës në Gjykatën e Kasacionit, por kërkesa e tij u refuzua. Në atë kohë ky detyrim parashikohej nga Neni 583 i Kodit të Procedurës Penale Franceze, i cili parashikonte se personat e dënuar të cilëve u ishte akorduar ky përjashtim dhe nuk dorëzoheshin, humbisnin të drejtën e tyre për të apeluar mbi çështje të së drejtës. Duke qënë se përjashtimi nga detyrimi për dorëzim i ishte refuzuar, Z. Papon nuk u dorëzua dhe iku në Zvicër. Autoritetet zvicerane i kërkuan që të largohej nga vendi.

4. Më 21 tetor 1999 Seksioni Penal i Gjykatës së Kasacionit deklaroi se kërkuesi e kishte humbur të drejtën e tij të ankimit pranë kësaj gjykate për çështje të së drejtës kundër vendimit të Gjykatës së Krimeve të 2 prillit 1998.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Duke u bazuar në nenin 6 § 1, kërkuesi ankohej se ai nuk kishte patur mundësi t'i drejtohej Gjykatës së Kasacionit, përderisa atij i ishte hequr e drejta për të ankuar mbi çështje të së drejtës. Ai ankohej gjithashtu se, si rezultat i heqjes së kësaj të drejte, ai ishte privuar nga e drejta për të apeluar ndaj vendimeve me karakter penal, gjë që garantohej nga neni 2 i Protokollit 7 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

6. Duke u mbështetur në vendimet e saj të mëparshme kundër Francës me objekt heqjen e së drejtës për të apeluar një vendim gjyqësor, Gjykata e Strasburgut konstatoi se të drejtat e Z. Papon të garantuara nga neni 6 § 1 kishin qënë shkelur.

7. Gjykata vuri në dukje rëndësinë e rishikimit nga ana e Gjykatës së Kasacionit në çështjet me karakter penal, veçanërisht në rastet kur personat janë dënuar me burgim të gjatë, dhe u shpreh se mohimi i së drejtës për t'u ankuar mbi çështje të së drejtës ishte një sanksion veçanërisht i rëndë ndaj së drejtës për t'iu drejtuar gjykatave.

8. Ajo ritheksoi se respektimi i prezumimit të pafajësisë, së bashku me efektin pezullues të ankimit mbi çështje të së drejtës, bëjnë që një i akuzuar i lirë të mos detyrohet të dorëzohet në gjendje arresti, sado e shkurtër të jetë periudha e heqjes së lirisë së tij. Për më tepër, mundësia për të kërkuar një përjashtim nga detyrimi për t'u dorëzuar, sipas mendimit të Gjykatës, nuk e vinte në vend karakterin proporcional të sanksionit. Gjykata vlerësoi gjithashtu se autoritetet kishin në dispozicion të tyre mjete të tjera për të kapur një person, qoftë përpara qoftë pas ankimit për çështje të së drejtës.

9. Së fundi, Gjykata deklaroi se, megjithëse ishte plotësisht e vetëdijshme për natyrën jashtëzakonisht ekstreme të veprave penale për të cilat ishte akuzuar kërkuesi, fakti që ai akuzohej dhe ishte shpallur fajtor për ndihmën dhe lehtësimin e kryerjes së krimeve kundër njerëzimit nuk e privonte atë nga mbrojtja që ofron Konventa.

10. Si përfundim, duke patur parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, Gjykata shprehu mendimin se kërkuesi ishte cenuar nga një kufizim i tepruar i së drejtës së tij për t'iu drejtuar gjykatës, pra edhe të së drejtës për një gjykim të drejtë.

### B. Në lidhje me nenin 2 të Protokollit 7

11. Gjykata vuri në dukje se ajo ka patur ndërkaq rast të vendos se sistemi francez në fuqi në kohën e mosmarrëveshjes kishte qënë në parim i pajtueshëm me nenin 2 të Protokollit 7 të Konventës. Pra ajo arriti në përfundimin se nuk ka patur shkelje të kësaj dispozite të Konventës.

### III. Koment

12. Një moment me vlerë i këtij vendimi të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut qëndron pikërisht në faktin e hedhjes poshtë të argumentit të qeverisë sipas të cilit ashpërsia e krimeve të kryera nga ana e kërkuesit justifikonte mohimin e së drejtës së ankimit. Gjykata i kushtoi kujdes këtij momenti duke shprehur se “fakti që kërkuesi ishte akuzuar dhe dënuar për bashkëpunim për krime kundër njerëzimit nuk e privon atë nga garancia e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa”. Për këtë qëllim Gjykata u bazua në një vendim të para 40 vjetëve të Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut në çështjen Ilse Koch kundër Gjermanisë<sup>48</sup>. Në fakt Gjykata vlerësoi se sidomos personat që dënoheshin me burgime të gjata kishin nevojë të veçantë për t'u mbrojtur nga ana e Konventës. Arsyeimi i Gjykatës në lidhje me këtë pikë mund të jetë veçanërisht i rëndësishëm duke patur parasysh që shumë prej ligjeve kundër terrorizmit të miratuara nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës ngushtojnë ose edhe mënjanojnë mbrojtjen e ofruar nga ana e Konventës duke e justifikuar këtë me ashpërsinë e krimeve që lidhen me terrorizmin.

13. Në vijim, ka edhe dy aspekte të tjera të këtij vendimi që ia vlen të përmenden. I pari, siç u vu në dukje nga gjyqtari Costa në një deklaratë bashkangjitur vendimit, është që Franca e ka amenduar legjislacionin e saj më 15 qershor 2000 me qëllim që të abrogonte nenet që binin në kundërshtim me Konventën. Kjo ndodhi ndërkohë që edhe Gjykata e Kasacionit ndryshonte jurisprudencën e saj të deriatëhershme në këtë drejtim. Të dyja këto ndryshime, legjislative dhe jurisprudenciale, ishin në përgjigje të vendimeve të shumta të Gjykatës së Strasburgut që dënonin legjislacionin francez pikërisht për shkak të mohimit të së drejtës të apelimit<sup>49</sup>. Aspekti i dytë është që ky vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mund t'i lejojë Z. Papon që të kërkojë rishikimin e vendimit të gjykatave franceze që e dënonin atë. Sipas Kodit të Procedurës Penale Franceze, një vendim penal përfundimtar mund të rishikohet në vijim të një vendimi nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut që deklaron një shkelje, por që me dëmshpërblimin e tij në bazë të Nenit 41 nuk e shpërblen në mënyrë adekuate dëmin e pësuar.

<sup>48</sup> Vendim i 8 marsit 1962.

<sup>49</sup> Shih vendimet kundër Francës të përfshira në këtë botim në lidhje me çështjet Krombach, Goth dhe Karatas dhe Sari.

## OMAR OTHMAN (ABU QATADA) kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 8139/09)

9 janar 2012

*në mungesë të garancive diplomatike, kthimi i një refugjat në Jordani do të përbënte mohim flagrant të drejtësisë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Omar Othman (Abu Qatada), ishte shtetas jordanez. Ai arriti në Mbretërinë e Bashkuar në shtator të vitit 1993 dhe paraqiti një kërkesë për azil, duke pretenduar në mënyrë të veçantë se kishte qenë i burgosur dhe ishte torturuar nga autoritetet jordaneze në vitin 1988 dhe ndërmjet viteve 1990-1991. Atij iu dha statusi i refugjatit në vitin 1994.

2. Në tetor të vitit 2002 ai u arrestua në bazë të ligjit Kundër Terrorizmit, Krimin dhe Sigurisë. Në mars 2005 ligji u shfuqizua, kërkuesi u lirua me kusht dhe ndaj tij u dha një urdhër kontrolli sipas ligjit për Parandalimin e Terrorizmit. Ndërkohë që shqyrtimi i ankesës së tij kundër urdhrin të kontrollit ishte ende në pritje, në gusht të vitit 2005, Sekretari i Shtetit njoftoi kërkuesin për dëbimin e tij në Jordani.

3. Z. Othman u ankua kundër vendimit të dëbimit. Për shkak se ishte dënuar në mungesë në Jordani për përfshirje në dy komplete terroriste në vitet 1999 dhe 2000, Z. Othman pretendoi se, nëse kthehej do të rigjykohej, duke rrezikuar kështu të torturohej, të qëndronte në paraburgim gjatë dhe t'i nënshtrohej një gjykimi të parregullt, pasi provat kundër tij ishin marrë duke torturuar të pandehurit e tjerë në proces.

4. Komisioni Special i Apelit për Emigrantët i Mbretërisë së Bashkuar (KSPE) hodhi poshtë ankesën e tij dhe vendosi, në veçanti se, Z. Othman nuk rrezikonte të torturohej apo keqtrajtohej pasi kishte një marrëveshje të negociuar mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Jordanisë e vitit 2005. Në këtë aspekt, Memorandumi i Mirëkuptimit (MiM) përcaktonte një sërë garancish të detajuara, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat duhet të plotësoheshin kur një individ transferohej nga një shtet tek tjetri. Gjithashtu, KSPE vendosi se rigjykimi nuk do të në mohonte plotësisht të drejtën e tij për një gjykim të rregullt.

5. Gjykata e Apelit e pranoi pjesërisht ankesën e Z. Othman. Ajo konstatoi se ekzistonte rreziku i përdorimit të dëshmimeve të marra me anë të torturës kundër tij, në qoftë se kthehej në Jordani, dhe se kjo do të shkelte ndalimin ndërkombëtar mbi

torturën, duke rezultuar në një mohim flagrant të drejtësisë, në shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Më 18 shkurt 2009, Dhoma e Lordëve mbështeti gjetjet e KSPE-së. Ata vërejtën se garancitë diplomatike do ta mbronin Z. Othman nga aktet e torturës. Gjithashtu, ata vendosën se, edhe në rast se do të përdoreshin provat e marra nëpërmjet torturës në procesin penal kundër tij në Jordani, kjo nuk nënkuptonte një mohim flagrant të drejtësisë.

## II. Vendimi i Gjykatës

6. Kërkuesi pretendoi se, nëse dëbohej në Jordani, rrezikonte t'i nënshtrohej torturës dhe keqtrajtimit dhe një mohimi flagrant të drejtësisë, për shkak, ndër të tjera, pranimit të dëshmvive të marra nëpërmjet torturës. Kërkuesi u mbështet në nenet 3, 5, 6 dhe 13. Kërkesa u paraqit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 11 shkurt 2009. Më 19 shkurt 2009 Gjykata urdhëroi vendosjen e një mase të përkohshme, sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, ku i kërkonte Mbretërisë së Bashkuar pezullimin e vendimit të dëbimit të kërkuesit në Jordani, deri në marrjen e një vendimi nga kjo Gjykatë.

### A. Në lidhje me nenin 3

7. Duke iu referuar jurisprudencës së saj të mirë-përcaktuar, Gjykata u shpreh se Z. Othman nuk mund të dëbohej në Jordani, nëse ekzistonte rreziku real që ai të torturohej apo t'i nënshtrohej trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës. Raportet e organeve të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të të drejtave të njeriut dëshmonin se tortura në Jordani ishte "e përhapur dhe e përsëritur", veçanërisht kundër të dyshuarve si terroristë islamikë dhe se gjykatat apo organe të tjera në Jordani nuk garantonin mbrojtje kundër këtyre akteve. Si islamik i një profili të lartë, Z. Othman i përkiste një kategorie të të burgosurve në rrezik real keqtrajtimi, madje ai pretendonte se kishte qenë objekt i torturës në kohën që jetonte në Jordani. Kështu, Gjykata duhet të vendoste nëse garancitë diplomatike të qeverisë jordanëze, të marra nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, kishin qenë të mjaftueshme për t'i garantuar mbrojtje Z. Othman.

8. Gjykata vendosi se, Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet dy qeverive ishte specifik dhe gjithëpërfshirës. Garancitë diplomatike ishin dhënë në mirëbesim nga Qeveria jordanëze, marrëdhëniet e së cilës me Mbretërinë e Bashkuar kishte qenë gjithmonë të forta. Garancitë ishin miratuar në nivelet më të larta të qeverisë, mbështetur edhe nga vetë Mbreti. Duke marrë parasysh profilin e lartë të Z. Othman, autoritetet jordanëze do të vepronin me kujdes për të siguruar që ai të trajtohej siç duhej dhe përveç kësaj, çdo keqtrajtim do të kishte pasoja të rënda për marrëdhëniet e Jordanisë me Mbretërinë e Bashkuar. Së fundmi, në përputhje me MiM, kërkuesi do të vizitohej rregullisht nga një organizatë e pavarur e të drejtave të njeriut në Jordani, Qendra Adaleh, e cila do të monitoronte respektimin e garancive diplomatike dhe do të kishte akses të plotë tek Z. Othman gjatë qëndrimit në burg. Si përfundim, Gjykata vendosi se, kthimi i kërkuesit në Jordani nuk do të shkelte nenin 3, pasi ai nuk rrezikonte të keqtrajtohej.



**B. Në lidhje me nenin 13**

9. Gjykata vërejtí se procedurat e KSPE-së përmbushnin kërkesat e nenit 13, prandaj vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

**C. Në lidhje me nenin 5**

10. Më parë, Gjykata duhej të përcaktonte nëse neni 5 ishte i zbatueshëm në rastet e dëbimit. Ajo u shpreh se, nëse neni 6 mund të zbatohet në raste të tilla - dhe për këtë arsye një kërkuar mund të mbështetet tek ky nen për të parandaluar dëbimin e tij në një shtet, ku rrezikonte të përballej me burgim, pas një gjykimi haptazi të padrejtë - edhe neni 5 mund të zbatohet për të parandaluar dëbimin në një shtet ku kërkuarisi ishte dënuar me burg pas një gjykimi të padrejtë. Prandaj, Gjykata u shpreh se neni 5 gjente zbatim në një rast dëbimi e për rrjedhojë, një Shtet Kontraktues që dëbonte një kërkuar në një shtet ku rrezikonte realisht të mos i respektohet e drejta për liri dhe siguri, do të shkelte detyrimet sipas kësaj dispozite. Megjithatë, duhej zbatuar një prag i lartë.

11. Gjykata konstatoi se Jordania, qartësisht kishte për qëllim të hapte procedurat në gjykatë kundër Z. Othman dhe sipas së drejtës së brendshme jordaneze duhet ta bënte këtë brenda 50 ditëve nga ndalimi i tij. Gjykata u shpreh se, periudha 50 ditore e ndalimit nuk mund të thuhet se shkelte në mënyrë flagrante kërkesat kohore sipas nenit 5 dhe, si pasojë, nuk do të kishte shkelje të nenit 5, nëse kërkuarisi dëbohej në Jordani.

**D. Në lidhje me nenin 6**

12. Në jurisprudencën e Gjykatës është përcaktuar se një vendim dëbimi ose ekstradimi, kur personi ishte përballur ose rrezikonte të përballej me një mohim flagrant të drejtësisë në vendin pritës, mund të ngrinte, në raste shumë përjashtimore, një çështje në bazë të nenit 6. Termi "mohim flagrant i drejtësisë" ishte bërë sinonim i një procesi që ishte haptazi në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 dhe parimet e mishëruara në të.

13. Në rastin konkret, Gjykata vërejtí se një mohim flagrant i drejtësisë, siç pretendonte kërkuarisi, nuk përfshinte thjesht parregullsitë apo mungesën e masave mbrojtëse në procedurat e gjyqimit. Në fakt, duhej të kishte një shkelje të parimeve kryesore të gjyqimit të drejtë, në mënyrë të tillë që të ishin aq thelbësore sa të bënin nul ose shkatërronin vetë thelbin e së drejtës së garantuar nga neni 6.

14. Në këtë drejtim, Gjykata u shpreh se, përdorimi i provave të marra nëpërmjet akteve të torturës gjatë një procesi penal, do të përbënte mohim flagrant të drejtësisë, në shkelje të nenit 6. Aktet e torturës dhe përdorimi i provave të marra nëpërmjet ushtrimit të torturës, ishin të ndaluara sipas së drejtës ndërkombëtare. Pranimi, nga një gjykatë penale, i provave të marrë nëpërmjet ushtrimit të torturës do të thoshte të legjitimohej ushtrimi i torturës tek dëshmitarët dhe të dyshuarit. Për më tepër, provat të marra nga ushtrimi i torturës konsideroheshin të pabesueshme, pasi një person që torturohet pranon gjithçka vetëm që të mos torturohet më.

15. Gjykata vërejtë se aktet e torturës ishin të përhapura në Jordani, siç ishte edhe përdorimi i provave të marra nëpërmjet torturës nga gjykatat jordaneze. Për më tepër, Gjykata, në lidhje me dy akuzat për terrorizëm kundër Z. Othman, konstatoi se provat e përfshirjes së tij ishin marrë nga një prej të bashkë-akuzuarve të tjerë në të njëjtin proces nëpërmjet ushtrimit të torturës. Kur dy të pandehurit e tjerë u gjykan, gjykatat jordaneze nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me ankesat e tyre për ushtrim të torturës. Gjykata u shpreh se ishte shumë e mundshme që në rigjykimin e Z. Othman do të pranoheshin prova inkriminuese të marra nëpërmjet ushtrimit të torturës dhe ato mund të ishin me rëndësi të konsiderueshme, në mos vendimtare. Në mungesë të një garancie diplomatike nga qeveria jordaneze se nuk do të përdoreshin prova të marra nëpërmjet torturës kundër Z. Othman, Gjykata, arriti në përfundimin se dëbimi i tij në Jordani për t'u rigjykuar do të përbënte një mohim flagrant të drejtësisë, në shkelje të nenit 6.

### *E. Në lidhje me nenin 41*

16. Kërkuesi nuk parashtrroi pretendime për shpërblim të drejtë.

### **III. Koment**

17. Ky ishte një rast i një profili shumë të lartë, duke qenë kërkuesi ishte një person i akuzuar për disa akte terrorizmi. Rasti është raportuar gjerësisht në media dhe diskutuar në detaje në Parlamentin britanik. Ky vendim është i rëndësishëm për dy arsye. Së pari, Gjykata duhet të vendoste nëse garancitë e veçanta diplomatike të dhëna nga qeveria Jordaneze qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ishin të mjaftueshme për të shmangur rrezikun e trajtimit në kundërshtim me nenin 3 në rastin e kërkuesit, ndërkohë që raportet e organizatave ndërkombëtare sugjerorin se aktet e torturës ishin një praktikë e përhapur në Jordani. Për këtë qëllim, Gjykata analizoi kushtet e Memorandumit të Mirëkuptimit, i nënshkruar nga dy qeveritë respektive. Gjykata konstatoi se Memorandumi ishte specifik dhe gjithëpërfshirës, garancitë ishin dhënë në frymën e mirëbesimit dhe autoritetet më të larta jordaneze e kishin miratuar këtë angazhimin. Në këtë kuadër, Gjykata e konsideroi të rëndësishëm faktin që, një OJQ e pavarur do vizitonte dhe të monitoronte respektimin e termave të garancive diplomatike në lidhje me kërkuesin. Për këtë arsye, Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte asnjë rrezik keqtrajtimi për kërkuesin nëse kthehej në Jordani.

18. Së dyti, për herë të parë, Gjykata e Strasburgut vendosi që dëbimi i një personi do të shkelte nenin 6 të Konventës, pasi ai mund të ishte viktimë e mohimit flagrant të drejtësisë në Jordani. Gjykata theksoi se termi "mohim flagrant i drejtësisë" ishte sinonim i procesit që ishte haptazi në kundërshtim me parashikimet e nenit 6 ose parimet e mishëruara në të. E tillë ishte, sipas Gjykatës, situata e kërkuesit, ku provat kundër Z. Othman për përfshirjen e tij në komplete terroriste, ishin marrë duke torturuar një nga të pandehurit e tjerë në të njëjtin proces. Fakti se përdorimi i torturës ishte i përhapur në Jordani dhe provat e nxjerra nëpërmjet torturës pranoheshin nga gjykatat jordaneze, e bënë Gjykatën të arrinte në përfundimin se kërkuesi do të përballlej me një rrezik të ngjashëm gjatë rigjyimit të tij pas kthimit dhe për këtë

arsye ajo vendosi se kërkuesi mund të ishte viktimë e mohimit flagrant të drejtësisë. Ky është një shembull i përsosur i interpretimit të të drejtave të Konventës si të drejta efektive dhe praktike dhe jo thjesht teorike. Nëse Gjykata do të vendoste ndryshe, do të thoshte të pranonte praktikën e torturës dhe përdorimin e saj në gjykimet penale.

## **CRAXI kundër ITALISË (NR. 2)**

*(kërkesa nr. 34896/97)*

**5 dhjetor 2002**

*e drejta e të akuzuarit që çdo provë materiale kundër tij të shqyrtohet në procedura kontradiktorialiteti*

### **I. Faktet kryesore**

1. Benedetto Craxi ishte shtetas italian i lindur më 1934. I njohur më shumë me emrin Bettino Craxi, ai kishte qenë Sekretar i Partisë Socialiste Italiane dhe Kryeministër i Italisë. Ai vdiq në Tunizi në Janar të vitit 2000. E veja dhe dy fëmijët e tij bënë të ditur se ata dëshironin t'i vijonin procedurat e nisura prej tij pranë Gjykatës së Strasburgut.
2. Z. Craxi kishte filluar procedimi për disa vepra penale, pasi ishin zbuluar parregullsi në negociatat për arritjen e një marrëveshjeje ndërmjet grupeve Eni dhe Montedison për krijimin e shoqërisë Enimont. Më 1992 kërkuesi dhe shumë persona të tjerë u akuzuan për përgatitjen e bilanceve fallco, financimin e paligjshëm të partive politike, korrupsion, rryshfet dhe keqadministrim, të gjitha këto të kryera në mënyrë të veçantë në kohën e shitjes së disa pjesëve të Montedison tek Enimont. Në total u bënë 26 njoftime për fillimin e procedimit penal ndaj Z. Craxi. Procedimi penal ndaj tij dhe figurave të tjera politike, ekonomike dhe të sipërmarrjes u bë i njohur në shtyp.
3. Kërkuesi u gjykua nga Gjykata e Rrethit të Milanos në gjashtë procedime të veçanta. Ai u deklarua fajtor për pesë prej tyre dhe u dënua me tetë vjet e gjysëm burg.
4. Në njërin prej procedimeve, në çështjen Eni-Sai, kërkuesi u mor në përgjegjësi penale për korrupsion. Ai u akuzua se kishte ndikuar dhe lehtësuar krijimin e një joint-venture të paramenduar ndërmjet tre shoqërive që operonin në sektorin e sigurimeve. U pretendua se ai dhe disa prej të bashkëakuzuarve të tij u kishin paguar shuma të mëdha zyrtarëve publikë dhe drejtorëve të shoqërive të sipërpërmendura.
5. Sipas avokatëve të tij, kërkuesi nuk mori pjesë në seancën e parë të kësaj çështje për arsye shëndetësore dhe të sigurisë personale. Më pas ai nuk ishte i pranishëm

në asnjë prej 55 seancave ndërmjet prillit dhe dhjetorit 1994 për shkak se u largua në Tunizi në 16 maj 1994. Gjatë procesit, disa prej të bashkëakuzuarve deklaruan se ata dëshironin të rrinin në heshtje, dhe këto deklarata u përfshinë në dosjen gjyqësore. Të akuzuar të tjerë në çështje të lidhura me këto u morën në pyetje në gjykim, dhe një transkriptim i dëshmimeve të tyre u përfshi gjithashtu në dosjen gjyqësore.

6. Me një vendim të 6 dhjetorit 1994 kërkuesi u dënua *in absentia* me pesë vjet e gjysëm burg. Ai apeloj kundër këtij vendimi por pa sukses, duke kundërshtuar në mënyrë të veçantë përdorimin e transkriptimeve të deklaratave të bëra nga ana e dëshmitarëve, të cilave ai nuk kishte patur mundësi tu kundërpërgjigjej. Gjykata e Kasacionit e hodhi gjithashtu poshtë ankimin e kërkuesit me një vendim të 12 nëntorit 1996, duke argumentuar se dënimi i tij nuk ishte mbështetur vetëm në këto deklarata por ato ishin mbështetur gjithashtu edhe në prova të paraqitura në proces.

## II. Vendimi i Gjykatës

7. Duke u mbështetur në Nenin 6 të Konventës, kërkuesi ankohej për pabarazinë e procedimit penal ndaj tij. Ai pretendonte se nuk kishte patur kohë dhe lehtësi të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij, dhe se nuk kishte qenë në gjendje t'u bënte pyetje dëshmitarëve të akuzës ose tu kundërpërgjigjej atyre. Ai pretendonte gjithashtu se fushata mediatike kundër tij i kishte ndikuar gjyqtarët në përcaktimin e akuzave që i ishin bërë.

### A. Në lidhje me nenin 6 §§ 1 dhe 3 (b)

8. Gjykata bëri të qartë që në fillim, se kërkesa në fjalë ishte deklaruar e pranueshme vetëm përse i përket pretendimeve të ngritura për pabarazi në procesin Eni-Sai.

9. Gjykata vuri re se që nga 18 tetori 1994, deri në dhënien e vendimit mbi themelin e çështjes më 6 dhjetor 1994, seancat ishin programuar sipas një kalendari për të cilin avokatët e kërkuesit kishin rënë dakort. Pra, kërkuesi nuk mund të ankohej në lidhje me ecurinë e seancave, në një proces për të cilat kishin rënë dakord avokatët e tij. Përse i përket periudhës përpara 18 tetorit 1994, Gjykata vuri në dukje se ishin mbajtur 38 seanca në çështjen Eni-Sai, në të njëjtën ose thuhet në të njëjtën kohë me seanca të çështjeve të tjera në të cilat kërkuesi ishte akuzuar.

10. Gjykata vuri në dukje se kërkuesi, i cili nuk kishte marrë pjesë në seancën e parë, me vullnetin e tij ishte larguar nga Italia dhe kishte shkuar në Tunizi. Pra, kishte zgjedhur në liri të plotë që të mos ishte i pranishëm në gjykatë. Për pasojë mbrojtja e kërkuesit ishte drejtuar nga avokatët e tij, të cilët ishin detyruar të merrnin pjesë në një numër tepër të madh seancash brenda një kohe të shkurtër. Gjithsesi nga provat e paraqitura përpara Gjykatës nuk doli në pah se mbrojtja prej tyre e kësaj çështjeje kishte qenë e mangët ose joefektive. Për më tepër, avokatët e kërkuesit nuk i kishin ofruar Gjykatës ndonjë shpjegim, se përse ata deri më 9 nëntor 1994, nuk ia kishin bërë të njohura autoriteteve shtetërore problemet me të cilat ata po ndesheshin në përgatitjen e mbrojtjes. Për këto arsye, Gjykata vendosi se nuk ka patur shkelje të Nenit 6 në këtë drejtim.

**B. Në lidhje me nenin 6 §§ 1 dhe 3 (d)**

11. Gjykata vuri në dukje se Kodi i Procedurës Penale, parashikonte mundësinë që në vlerësimin e themelit të një akuze, të përdroreshin deklaratat të bëra përpara procesit gjyqësor nga të bashkëakuzuar të cilët në vijim kishin ushtruar të drejtën e tyre për të qëndruar në heshtje, ose nga persona të cilët kishin vdekur përpara se të kishin patur mundësi që të dëshmonin në seancë gjyqësore. Megjithatë, ky fakt nuk e privonte një të akuzuar nga e drejta që çdo provë materiale kundër tij t'i nënshtrohej shqyrtimit në kuadrin e procedurave kontradiktore. Në çështjen në fjalë, Gjykata nënvizoi se nga vendimi i Gjykatës së Kasacionit të 12 nëntorit 1996, dilte që kërkuesi ishte dënuar vetëm në bazë të deklaratave të bëra përpara procesit nga të akuzuar të tjerë, të cilët kishin preferuar që të mos dëshmonin në proces dhe nga një person që pastaj kishte vdekur. Kërkuesi dhe avokatët e tij nuk kishin patur mundësi që t'u drejtonin pyetje këtyre dëshmitarëve, dhe për pasojë nuk kishin qenë në gjendje të kundërshtonin deklaratat që përbënin bazën ligjore për dënimin e kërkuesit.

12. Në këtë drejtim, Gjykata vuri në dukje se avokatët e kërkuesit nuk kishin ngritur asnjë pretendim në Gjykatën e Rrethit të Milanos për të kundërshtuar paligjshmërinë ose moskujdesin e treguar, duke i përfshirë këto deklaratat në dosjen gjyqësore. Megjithatë, përderisa deklaratat ishin përfshirë në dosje në përputhje me legjislacionin italian të zbatueshëm në atë kohë, Gjykata vlerësoi se çdo kundërshtim i tillë nga ana e kërkuesit do të kishte patur mundësi të kufizuara suksesi. Fakti që avokatët e tij nuk e kishin bërë këtë kundërshtim nuk mund të vlerësohej si një heqje dorë në heshtje nga e drejta e tij për t'iu drejtuar pyetje dëshmitarëve të akuzës, duke pasur parasysh në mënyrë të veçantë që avokatët e kishin ngritur këtë çështje në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Kasacionit. Për këtë arsye, Gjykata vendosi se ka patur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) në këtë këndvështrim.

**C. Në lidhje me nenin 6 në tërësi**

13. Gjykata theksoi se interesi i medias dhe i publikut në çështjen Eni-Sai buronte nga pozita e veçantë që kishte kërkuesi, nga konteksti politik në të cilin kishin ndodhur veprat penale për të cilat ai akuzohej, nga natyra dhe rëndësia e vetë këtyre. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, është e paevitueshme në një shoqëri demokratike që shtypi në disa raste të bëjë komente të ashpra mbi një çështje të ndjeshme si kjo në fjalë, e cila vinte pikëpyetje mbi moralin e zyrtarëve të lartë publikë si dhe mbi marrëdhënie ndërmjet botës politike dhe asaj të biznesit. Gjykata në vijim vuri në dukje se gjykatat që kishin shqyrtuar çështjen ishin përbërë vetëm nga gjyqtarë profesionistë, dhe se kërkuesi ishte gjetur fajtor vetëm në përfundim të procedurave që respektonin parimin e kontradiktorialitetit. Është e vërtetë që Gjykata konstatoi një shkelje të kërkesave të "gjykimit të drejtë" në këtë çështje, por kjo erdhi si pasojë e zbatimit nga ana gjyqtarëve të dispozitave ligjore me një qëllim tepër të përgjithshëm dhe të zbatueshme ndaj kujtdo, dhe jo vetëm ndaj kërkuesit apo pozitës së veçantë të tij. Nuk duket asgjë në këtë çështje që të bën të mendosh se gjyqtarët ishin ndikuar nga deklaratat e bëra në shtyp. Për këto arsye, Gjykata vendosi se nuk ka patur shkelje të nenit 6 në këtë drejtim.

**D. Në lidhje me nenin 41**

14. Gjykata ishte e mendimit se konstatimi i shkeljes përbënte në vetvehte një shpërblim të drejtë.

**III. Koment**

15. Natyrisht që emri i Bettino Craxi-t është tepër i njohur edhe për opinionin publik shqiptar, si ish kryeministër i Republikës Italiane, dhe për të interesuarit në çështet ligjore si një nga të akuzuarit kryesorë dhe më të bujshëm të proceseve tronditëse për shoqërinë dhe politikën italiane të viteve 90 – të ashtuquajtura “Le mani pulite” ose “Tangentopoli” të iniciuar nga prokurorët Borelli, Di Pietro, Colombo, etj., të Prokurorisë së Milanos. Çështja në fjalë ka të bëjë me procedurat e ndjekura gjatë njërit prej këtyre proceseve, dhe duke patur parasysh figurën publike të personave të akuzuar e në veçanti të Craxi-t, nxjerr në pah çështjen e publicitetit që shoqëron procese të tilla. Ky problem është sqaruar në tërësi në çështjen Lavents të përmbledhur në këtë numër të Buletinit.

16. Çështja Craxi ngrinte gjithashtu probleme të rëndësishme në lidhje me bazueshmërinë e dëshmimeve të dëshmitarëve të cilët për çfarëdolloj arsye, nuk ishin në gjendje të ishin të pranishëm në seancat gjyqësore, ose nuk mund të pyeteshin dhe kundërshtoheshin në lidhje me dëshminë që ata i kishin dhënë gjyqtarit të hetimeve paraprake. Gjykata e Strasburgut normalisht i respekton rregullat kombëtare në lidhje me pranimin e provave, të cilat në fakt variojnë në mënyrë të theksuar nga një shtet te tjetri. Atëhere kur, si në rastin në fjalë, konstatimi fajtor i kërkuesit në lidhje me disa akuza bazohet vetëm në dëshmi të dëshmitarëve të cilët nuk mund të pyeten nga mbrojtja, jo vetëm që shkelet neni 6 § 3 (d) por edhe procedurat, “në tërësinë e tyre”, nuk mund të konsiderohen si të drejta. Vetëm fakti që avokatët e të akuzuarit nuk e kundërshtuan procedurën e parashikuar në të drejtën e brendshme, nuk do të thotë që kërkuesi kishte hequr dorë nga të drejtat e tij të parashikuara nga ana e Nenit 6 në këtë kontekst.

17. Ky moment i fundit ngre hipoteza interesante interpretuese në lidhje me kërkesat përpara Gjykatës sonë Kushtetuese, dhe me kombinimin e mundësive për deklarinimin antikushtetues të një ligji nga njëra anë, dhe të shterrimit të mjeteve të brendshme efektive nga ana tjetër për qëllimet e Konventës në bazë të nenit 35 të saj.



## TIMOFEYEV kundër RUSISË

(kërkesa nr. 58263/00)

23 tetor 2003

*mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore për një periudhë të gjatë kohe bie në kundërshtim me shtetin e së drejtës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Nikolay Vasilyevich Timofeyev, është shtetas rus, ka lindur më 1948 dhe jeton në Orsk në Rusi. Më 1981 ai ishte akuzuar për propagandë antisovjetike. Policia kishte bërë kontrolle në shtëpinë e tij dhe kishte sekuestruar një radio, audioregjistrues, libra, artikuj gazetash dhe dorëshkrime që kishin të bënin me akuzën e ngritur kundër tij.
2. Në prill 1982 kërkuesi u konsiderua se nuk ishte fajtor për akuzën në fjalë për shkak të një sëmundje mendore dhe u mbajt i izoluar në një spital psikiatrik. Ai u lirua në prill 1986. Në shtator 1992 Zyra e Prokurorit të Rrethit bëri një deklaratë që pranonte fakti se kërkuesi ishte ndjekur penalisht në mënyrë të kundraligjshme.
3. Nga viti 1995 deri më 1997 Z. Timofeyev u përpoq të rimerrte objektet që i ishin konfiskuar por pa sukses. Më 22 korrik 1998 Gjykata e Rrethit të Orsk urdhëroi Departamentin Federal të Thesarit që t'i paguante kërkuesit 2 570.92 rubla ruse kompensim dhe 200 rubla ruse për shpenzime ligjore. Megjithatë këto shuma nuk iu paguan asnjëherë kërkuesit për shkak të procedurave tepër të gjata të ekzekutimit të këtij urdhri.
4. Më 29 qershor 2001 Gjykata e Rrethit dha një urdhër të dytë në lidhje me këtë çështje, duke i akorduar kërkuesit 2 869.50 rubla kompensim dhe 1 000 rubla për shpenzimet ligjore.
5. Më 18 dhjetor 2001 zyra e përmbarimit vendosi se urdhri ishte ekzekutuar përderisa llogaria bankare e kërkuesit ishte kredituar me shumën e lartpërmendur më 30 nëntor 2001. Kërkuesi e kundërshtoi këtë vendim në gjykatë duke pretenduar se ai nuk e kishte shumën në fjalë. Më 15 shkurt 2002 Gjykata e Rrethit vendosi se nuk kishte prova të mjaftueshme pasi shuma përkatëse ishte paguar dhe prishi vendimin e zyrës së përmbarimit.
6. Me një letër të 31 tetorit 2002 Qeveria Ruse vuri në dijeni Gjykatën se shuma e akorduar më 29 qershor 2001 i ishte paguar kërkuesit më 30 nëntor 2001, por kjo kundërshtohet nga kërkuesi me një letër që i drejtonte Gjykatës më 18 tetor 2002.

## II. Vendimi i Gjykatës

7. Z. Timofeyev ankohej në bazë të neneve 6 § 1 dhe 1 të Protokollit 1 të Konventës për shkelje të të drejtës së tij për proces të rregullt ligjor si dhe të së drejtës së pronës.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1 dhe nenin 1 të Protokollit 1

8. Gjykata vuri në dukje se vendimi i 22 korrikut 1998 i cili kishte marrë formë të prerë më 8 dhjetor 1998 nuk ishte zbatuar të paktën deri më 30 nëntor 2001, që do të thotë gati tre vjet më vonë. Vonesat në këtë ekzekutim duket se ishin shkaktuar nga aktet e paligjshme të përmbaruesve, të vonesave të shpeshta për shkak të ndërhyrjes së autoriteteve që e rishikonin këtë vendim, si dhe të paqartësive në vendim. Gjykata vlerësoi se nuk ishte kërkuesi ai që duhet të vuante pasojat e këtyre mangësive nga ana e autoriteteve shtetërore dhe e konsideroi të papranueshëm faktin që një vendim që parashikonte një detyrim financiar ndaj shtetit duhet të ngelej i pazbatuar për një periudhë kaq të gjatë.

9. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se për këtë arsye ka patur shkelje të nenit 6 § 1 dhe të nenit 1 të Protokollit 1.

## III. Koment

10. Ky vendim është mjaft i ngjashëm me atë në lidhje me çështjen Burdov kundër Ruisë<sup>50</sup>, i cili është edhe vendimi i parë kundër Ruisë pasi kjo ratifikoi Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata në të dy vendimet ka theksuar se moszbatimi i vendimeve gjyqësore ka të ngjarë të çojë në situata të papajtueshme me konceptin e shtetit të së drejtës të cilin shtetet anëtare kanë marrë përsipër ta respektojnë që nga momenti kur kanë ratifikuar Konventën.

11. Vendimi në lidhje me çështjen Timofeyev thekson gjithashtu se vonesat në zbatimin e vendimit në fjalë ishin shkaktuar pjesërisht edhe nga ndërhyrja e autoriteteve që kishin kompetencë të rishikonin vendimin. Më parë Gjykata ka marrë në shqyrtim një numër çështjesh që përfshijnë procedurën e rishikimit nga një organ më i lartë, dhe në më të fundit ndër këto çështje, atë të Ryabykh kundër Ruisë, konstatoi se procedura e rishikimit binte në kundërshtim me nenin 6 të Konventës.

12. Është me interes të vihet në dukje se si Gjykata vlerësoi çështjen e shpërblimit të drejtë në këtë rast ashtu edhe në atë *Steur kundër Holandës*. Në asnjërin prej këtyre rasteve Gjykata nuk akordoi shpërblim për qëllimet e nenit 41 të Konventës. Në çështjen *Steur* kërkuesi nuk kishte paraqitur asnjë kërkesë për shpërblim të drejtë, ndërsa në rastin që po marrim në shqyrtim Gjykata theksoi se kërkuesi nuk e kishte paraqitur pretendimin e tij brenda afatit kohor të kërkuar. Gjykata prej kohësh ka qënë e angazhuar t'i ruajë shpërblimet që iu akordon kërkuesve brenda një kuadri të arsyeshëm dhe shpesh nuk i pranon kërkesat për shpërblime që i vlerëson si të tepruara. Siç shihet, në këtë rast Gjykata nuk merr parasysh me nismën e vet

<sup>50</sup> Vendim i 7 majit 2002.

asnjë pretendim për shpenzime ose dëme materiale apo jomateriale. Kujtojmë që pretendimet për shpërblim të drejtë duhen paraqitur brenda një afati të caktuar dhe të shoqërohen me dokumentet e duhura.

## **RAJAK kundër KROACISË**

*(kërkesa nr. 49706/99)*

**28 qershor 2001**

*kohëzgjatja e një procesi civil në një afat të paarsyeshëm shkel nenin 6 § 1 të Konventës*

### **I. Faktet kryesore**

1. Rajko Rajak, shtetas kroat, ishte ankuar në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave në një çështje civile që ai kishte filluar duke pretenduar shpërblimin për përmirësime teknike dhe të natyrave të tjera që ai kishte bërë në një shoqëri pronë shtetërore. Kjo çështje kishte 25 vjet që ishte në gjykim por nga këto vetëm tre vjet dhe shtatë muaj hynin në juridiksionin e vlerësimit të Gjykatës, patur parasysht datën e ratifikimit të Konventës nga ana e Kroacisë, 5 nëntorit 1997.

### **II. Vendimi i Gjykatës**

2. Gjykata nuk konstatoi që kërkuesi të kishte paraqitur argumente që të mund të vërtetonin pretendimin e tij në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave. Gjykata vuri në dukje se kërkuesi kishte ndryshuar dy herë shumën e kërkuar të parave, gjë e cila mund t'i kishte vonuar procedurat deri në këtë fazë, por që nga këndvështrime të tjera sjellja e kërkuetit nuk mund të justifikonte në vetvete karakterin e tejzgjatur të procedurave. Në lidhje me qëndrimin e autoriteteve, Gjykata konstatoi se, në periudhën e marrë në shqyrtim prej saj, çështja nuk kishte avancuar në periudhat 5 nëntor 1997 deri 18 maj 1998 dhe përsëri 18 maj 1998 deri në 22 korrik 1999, të cilat përbënin respektivisht gjashtë muaj dhe 13 ditë dhe një vit, dy muaj dhe katër ditë. Megjithëse gjykata e shkallës së parë dha një vendim më 12 maj 2000, vendimi i saj u hodh poshtë nga gjykata e apelit dhe çështja ishte përsëri përpara gjykatës së shkallës së parë.

3. Gjykata kujtoi se u përkiste Shteteve Palë që të organizonin sistemet e tyre ligjore në një mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të garantonin të drejtën e çdokujt që, brenda një afati të arsyeshem, të kishte një vendim përfundimtar në lidhje me mosmarrëveshje mbi të drejta dhe detyrime me karakter civil. Gjykata vlerësoi se procedurat në fjalë, të cilat nuk kishin përfunduar ende, nuk përmbushnin kërkesën e afatit të arsyeshem. Për këtë arsye, ka patur shkelje të nenit 6 § 1. Përsa i përket nenit 41 Gjykata nuk e pranoi pretendimin e kërkuetit për dëm material; ajo i akordoi kërkuetit 30 000 kuna Kroate për dëm jo-material dhe 5 800 kuna për shpenzime dhe pagesa.

### III. Koment

4. Është e rëndësishme të vihen në dukje pasojat e këtij vendimi në lidhje me periudhën kohore që Gjykata e Strasburgut mund të mbajë parasysh në shqyrtimin e një çështjeje.
5. Ndërsa procedurat filluan më 1975, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mori në shqyrtim në këtë rast vetëm periudhën pas datës në të cilën Konventa kishte hyrë në fuqi në Kroaci, datë që ishte 5 nëntori 1997. Në lidhje me periudhën përpara 5 nëntorit 1997, Gjykata e mbajti parasysh atë por nuk e mbështeti vendimin e saj vetëm në periudhën pas 5 nëntorit 1997<sup>51</sup>.
6. Ky trajtim, i mbajtjes parasysh të periudhës përpara hyrjes në fuqi të Konventës është paksa i veçantë në lidhje me natyrën e rasteve mbi kohëzgjatjen e procedurave përderisa është krejt e pamundur për Gjykatën e Strasburgut për të vlerësuar justifikueshmërinë e kohëzgjatjes pa mbajtur parasysh ecurinë e çështjes përpara hyrjes në fuqi të Konventës dhe fazën në të cilën ajo kishte arritur në kohën e shqyrtimit prej saj. Në raste të tjera është mjaft e qartë që fakti që ngjarjet kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të Konventës nuk përjashtojnë mundësinë e shqyrtimit të tyre nga Gjykata Evropiane në kuadrin e një kërkesë në lidhje me to, me kusht që shkelja e Konventës të ketë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Konventës. Në rastet kur ka një sërë shkeljesh, vetëm ato që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Konventës do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga ana e Gjykatës së Strasburgut.

## HORNSBY kundër GREQISË

(kërkesa nr. 18357/91)

19 mars 1997

*moszbatimi i vendimeve gjyqësore nga organet të cilave iu drejtohen përbën shkelje të vetë thelbit të procesit të drejtë dhe të parimit të shtetit të së drejtës*

### I. Faktet kryesore

1. Z. David Hornsby dhe Znj. Ada Ann Hornsby kanë lindur në Mbretërinë e Bashkuar respektivisht më 1937 dhe më 1939. Ata jetonin në ishullin e Rodit dhe ishin të dy mësues të kualifikuar të anglishtes.
2. Më 5 qershor 1984, kërkuesi i dytë iu drejtua Autoritetit të Arsimit të Shkallës së Dytë të Prefekturës së Dodekanezës me qëllimin që të merrte një autorizim për të ngritur një shkollë private për gjuhë të huaj (*frontistirio*) në Rod. Megjithatë kërkuesit ishin informuar se sipas legjislacionit grek në fuqi, shtetasve të huaj nuk mund tu jepej asnjë autorizim i tillë.

<sup>51</sup> I ashtuquajtur i veprim *ratione temporis* i Konventës.

3. Më 15 mars 1988, Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane e deklaroi legjislacionin përkatës si në kundërshtim me Traktatin e K.E.E. Më 1 prill 1988, kërkuesit paraqitën dy aplikime të reja, të cilat gjithashtu nuk u pranuan nga autoritetet arsimore duke u mbështetur në të njëjtat arsye si më 1984.

4. Më 8 qershor 1988, kërkuesit paraqitën në Gjykatën e Lartë Administrative dy padi me objekt shpalljen si të paligjshme të vendimeve të Drejtorit Autoritetit të Arsimit të Shkallës së Dytë. Në vendimin e saj të 9 majit 1989 Gjykata e Lartë Administrative vendosi që, në përputhje me gjykimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, shtetas të shteteve anëtare të Komunitetit Evropian nuk mund të ndaloheshin, duke filluar që nga 1 janari 1981, të ngrinin shkolla private në gjuhë të huaj në Greqi për shkak të faktit se ata nuk ishin shtetas grekë.

5. Më 8 gusht 1989, kërkuesit i kërkuan Autoritetit të Arsimit të Shkallës së Dytë që të vepronte në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë Administrative dhe t'u jepte atyre autorizimin që ata kërkonin, por pa sukses. Më 28 mars 1990, ata filluan procedurat kundër Drejtorit të Arsimit të Shkallës së Dytë si dhe kundër disa zyrtarëve të tjerë dhe më 14 nëntor 1990 ata iu drejtuan autoritetit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rodit duke pretenduar kompensim për pësimin e dëmeve materiale dhe jo-materiale si dhe fitimin e munguar. Më 3 korrik 1992 ata ngritën një padi tjetër për kompensim në Gjykatën Administrative të Rodit. Një sërë letrash që i ishin dërguar Ministrisë të Arsimit nga ana e kërkuesve si dhe nga ana e vetë Drejtorit të Arsimit të Shkallës së Dytë të Rodit nuk morën përgjigje.

6. Më 10 gusht 1994, me anë të një Dekreti Presidencial nr. 211/94, shtetasit e vendeve anëtare të Komunitetit Evropian fituan të drejtën që të ngrinin shkolla private në gjuhë të huaj me kusht që ata të kalonin një provim për gjuhën dhe historinë greke. Më 20 tetor 1994, Ministria e Arsimit e ftoi Drejtorin e Arsimit të Shkallës së Dytë që ta merrte në konsideratë rastin e kërkuesve nën këndvështrimin e këtij dekreti.

7. Kërkesa u paraqit para Komisionit më 7 janar 1990; ajo u deklarua e pranueshme më 31 gusht 1994. Pasi u përpoq, por pa sukses, që të arrinte një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, Komisioni përgatiti një raport më 23 tetor 1995 në të cilin ai paraqiti faktet e rastit në fjalë dhe shprehte opinionin me njëzet e shtatë vota kundër një, se në këtë rast ka patur një shkelje të nenit 6 § 1. Ai ia kaloi çështjen Gjykatës më 11 dhjetor 1995.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Pretendimet paraprake të qeverisë

8. Ashtu siç kishte bërë edhe përpara Komisionit, Qeveria ngriti si prapësim kryesor nga ana e saj pretendimin se kërkesa ishte e papranueshme për shkak të mosrespektimit të afatit kohor prej gjashtë muajsh të parashikuar nga ish neni 26 i

Konventës<sup>52</sup> si dhe për mos shterim të mjeteve të brendshme për rivënien në vend të shkeljes.

*a) Mos respektimi i afatit kohor prej gjashtë muajsh*

9. Ashtu si Komisioni, edhe Gjykata vuri në dukje se situata në lidhje me të cilën ankohen kërkuesit e ka origjinën e saj në refuzimin e autoriteteve përkatëse që t'u akordonin këtyre autorizimin që kërkonin, pavarësisht nga vendimet e Gjykatës së Lartë Administrative - dhe që ka vazhduar edhe pas paraqitjes së kërkesave të tyre në Komision, më datë 7 janar 1990. Për këtë arsye, prapësimi i lartpërmendur bie poshtë.

*b) Mos shterimi i mjeteve të brendshme*

10. Qeveria parashtroi pretendimin se kërkuesit nuk i kishin shteruar rrugët e mundshme për ta sipas ligjit grek ashtu siç e kërkonte edhe ish neni 26 i Konventës.

11. Përsa i përket padive për dëme të parashikuara nga nenet 57 dhe 59 të Kodit Civil grek, Gjykata ishte e mendimit që në rastin në fjalë ato nuk mund të konsideroheshin si të mjaftueshme për të vënë në vend pretendimet e kërkuesve. Përsa i përket rivlerësimit gjyqësor nga ana e Gjykatës së Lartë Administrative, nuk kishte ndonjë arsye që të supozohet se kërkuesit do të kishin mundur të merrnin autorizimin që ata kërkonin. Duke u vënë përballë mungesës së vazhdueshme të përgjigjeve nga ana e autoriteteve ndaj kërkesave të tyre të përsëritura, normalisht kërkuesit nuk mund të prisnin që një rrugë e tillë t'u jepte atyre rezultatin që ata pretendonin. Së fundi, përsa i përket procedurave në gjykatën administrative të Rodit, Gjykata vlerësoi se ato ishin vendimtare vetëm në lidhje me çështjen e akordimit të një shpërblimi të drejtë sipas ish neni 50 të Konventës. Për këtë arsye edhe ky prapësimi paraparak bie poshtë.

**B. Në lidhje me nenin 6 § 1**

12. Kërkuesit pretendonin se refuzimi i autoriteteve administrative për të vënë në zbatim vendimet e Gjykatës së Lartë Administrative të 9 dhe 19 majit 1989, ka shkelur të drejtën e tyre për një mbrojtje gjyqësore efektive të të drejtave të tyre me karakter civil.

13. Gjykata ritheksoi që, duke u mbështetur në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, neni 6 § 1 i siguronte çdokujt të drejtën që çdo ankesë që ka të bëjë me të drejtat dhe detyrimet e tij civile ta paraqesë përpara një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë është rrënjosur e «drejta për një gjykatë», një aspekt i së cilës përbëhet pikërisht nga e drejta e personave që të lejohen t'i drejtohen asaj.

14. Megjithatë, kjo e drejtë do të ishte një iluzion në qoftë se sistemi i brendshëm ligjor i ndonjërës prej palëve të larta kontraktuese do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe i detyrueshëm të ngelej pa efekt dhe në dëm të ndonjërës

<sup>52</sup> Neni 35 aktual i Konventës.



nga palët në proces. Do të kishte qënë e pakonceptueshme që neni 6 § 1 të duhej të përshkruante në detaje garancitë procedurale të ofruara palëve në mosmarrëveshje - procedura të cilat qenë të drejta publike dhe me efekt të drejtpërdrejtë, pa mbrojtur vënien në zbatim të vendimeve gjyqësore. Një interpretim i tillë i nenit 6, që të ketë të bëjë vetëm me mundësinë për t'iu drejtuar një gjykate dhe me ecurinë e procedurave para saj, do të mund të çonte në situata të papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës, parim të cilin shtetet kontraktuese morën përsipër që ta respektojnë kur ratifikuan Konventën.

15. Që këtej del se ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga ana e çdo gjykate duhet të konsiderohet si një pjesë përbërëse e «gjykimit» për qëllimet e nenit 6; për më tepër që Gjykata e ka pranuar ndërkaq këtë parim në raste që kanë patur të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurave.

16. Parimet e përmendura më lart kanë një rëndësi edhe më të madhe në kuadrin e procedurave administrative që kanë të bëjnë me një mosmarrëveshje zgjidhja e së cilës do të ishte vendimtare për një të drejtë civile të ndonjëres nga palët. Duke paraqitur një aplikim për një rishikim gjyqësor në gjykatën më të lartë administrative të shtetit, pala në mosmarrëveshje kërkon jo vetëm anulimin e vendimit të goditur por gjithashtu, dhe para së gjithash, revokimin e të gjitha pasojave të tij. Mbrojtja efektive e një pale para procedurave të tilla dhe rivendosja e ligjshmërisë presupozon një detyrim nga ana e autoriteteve administrative që të veprojnë në përputhje me një vendim të kësaj gjykate.

17. Gjykata vuri në dukje, në lidhje me këtë, që autoritetet administrative përbënin një nga elementët e një shteti që është subjekt i ligjshmërisë dhe interesat e tyre përputhen me nevojën për një administrim ashtu siç duhet të drejtësisë. Në rastin kur autoritetet administrative nga ana e tyre refuzojnë ose dështojnë në lidhje me respektimin, ose qoftë edhe vonojnë ta bëjnë këtë gjë, garancitë e parashikuara nga neni 6 dhe të gëzuara nga njëra nga palët gjatë fazës gjyqësore të procedurave, bëhen të tilla që humbasin edhe vetë qëllimin e tyre.

18. Gjykata vuri në dukje që, duke patur parasysh vendimin e Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane të 15 marsit 1988 (në të cilin ishte vendosur që «duke u ndaluar shtetasve të Shteteve Anëtare që të krijojnë "frontistiria" Republika Helenike kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas neneve 52 dhe 59 të Traktatit të K.E.E.»<sup>53</sup>

19. Gjykata e Lartë Administrative i ka konsideruar si të pazbatueshme dy vendimet me anë të të cilave Drejtori i Arsimit të Shkallës së Dytë u ka refuzuar kërkesave - vetëm duke u bazuar në shtetësinë e tyre - autorizimin që ata kërkonin. Në përfundim të këtyre vendimeve gjyqësore të lartpërmendura kërkesit do të mund të konfirmoheshin të drejtën e përmbushjes së kërkesave të tyre.

<sup>53</sup> Aktualisht nenet 43 dhe 49 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian.

20. Duke i përsëritur edhe njëherë këto më 8 gusht 1989 ata nuk po bënë asgjë tjetër veçse po i kujtonin autoritetet administrative në lidhje me detyrimin e tyre për të marrë një vendim që të ishte në përputhje me parashikimet ligjore, shkelja e të cilave kishte çuar pastaj në shfuqizimin e dy vendimeve të kundërshtuara. Pavarësisht nga kjo, autoritetet nuk kishin kthyer përgjigje deri më 20 tetor 1994.

21. Nga 15 marsi 1988, kur Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane dha vendimin, e sidoqoftë që nga 9 dhe 10 maji 1989, kur Gjykata e Lartë Administrative shpalli qëndrimin e saj në çështjen e parashtruar nga kërkuesit, dhe duke vazhduar deri në miratimin e Dekretit Presidencial nr. 211/1994 më 10 gusht 1994, legjislacioni grek në fuqi nuk parashikonte për hapjen e një *frontistiria* kritere të posaçme për shtetasit e shteteve anëtare të Komunitetit Evropian në raport me shtetasit grekë. Pra konkretisht kërkohet vetëm pasja e një diplome universitare, kërkesë të cilën kërkuesit nga ana e tyre e përmbushnin.

22. Duke mos vepruar për më tepër se pesë vjet për marrjen e masave të nevojshme që të përshtateshin me një vendim gjyqësor përfundimtar dhe të ekzekutueshëm, autoritetet greke i kanë zhveshur dispozitat e nenit 6 § 1 të Konventës nga çdo lloj efekti i dobishëm. Për këtë arsye kemi patur të bëjmë me një shkelje të këtij neni.

### C. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41) - vendim i 1 prillit 1998

23. Kërkuesit paraqitën pretendime të shumta në bazë të nenit 50 të Konventës. Gjykata vlerësoi nga ana e saj se çështja e zbatimit të nenit 50 nuk ishte e gatshme për vendim dhe që duhet të lihej për një fazë të dytë, duke patur parasysh mundësinë e një marrëveshjeje ndërmjet shtetit përgjegjës nga njëra anë dhe kërkuesve nga ana tjetër. Vendimin në lidhje me çështjen e shpërblimit të drejtë ajo e dha më 1 prill 1998.

24. Data që u mor parasysh për vlerësimin e dëmit të pësuar ishte ajo e vendimit të Gjykatës të Lartë Administrative me anë të të cilit kjo Gjykatë konsideron si të paligjshëm refuzimin e autoriteteve nacionale për t'u akorduar kërkuesve autorizimin për të hapur një *frontistiria*.

25. Nuk është e qartë se çfarë elementi dhe çfarë metode bazë të përlllogaritjes kishin përdorur kërkuesit për të provuar fitimin e tyre të munguar, vlerësime të cilat, prej vetë natyrës së tyre, mund të çonin veçse në spekulime. Mungesa e të ardhurave e cila, sidoqoftë, nuk ishte e mundur të vlerësohej me saktësi, mund të mendohej që të përbëhej nga ndjenja e pasigurisë dhe ankthit të kërkuesve nëse do të arrinin të qëndronin në vendin e tyre të punës, si dhe nga ndjenja e thellë e padrejtësisë për shkak të faktit se autoritetet greke nuk kishin respektuar vendimet e një gjykate ndërkombëtare dhe të gjykatës më të lartë administrative greke.

26. Shuma e akorduar sipas parimit *ex æquo et bono*, mbante parasysh të gjitha arsyet e dëmit të marra së bashku. Si përfundim, u arrit në konkluzionin se shteti grek duhet t'u paguajë kërkuesve 25 milion dhrahmi. Kërkuesit ishin rimbursuar në lidhje me pagesat e procedurave përpara Gjykatës së Lartë Administrative. Ata e kishin paraqitur vetë

çështjen e tyre para Komisionit dhe nuk morën pjesë në procedurat përpara Gjykatës. Kështu që nuk ishte e nevojshme që atyre t'u akordohej një shumë tjetër të hollash.

### III. Koment

27. Në shkrime të ndryshme në lidhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe me Gjykatën e Strasburgut është vlerësuar roli i kësaj të fundit në shndërrimin e Konventës në një instrument të gjallë, të orientuar nga qëllimi, që synon një mbrojtje sa më efektive dhe sa më të plotë të të drejtave të njeriut dhe që ofron garanci më të gjera se sa ato që në vitin 1950 u parashikuan nga hartuesit e tekstit të saj. Vendimi që po komentojmë përbën jashtë çdo dyshimi një prej rasteve më të qarta të shprehjes së magjisë interpretuese të Gjykatës së Strasburgut në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Për ta sqaruar më tej vlerën e këtij vendimi mund të thuhet madje se ai e sqaron deri në një domethënie ekzistenciale nenin 6 të Konventës. Vendimi arrin deri atje sa të shkojë qartazi përtej dispozitave të nenit 6 të Konventës dhe t'i referohet kuptimit të vetë këtij neni dhe pse jo edhe frymës së Konventës. Logjika interpretuese është më se e qartë – nuk do të kishte kuptim, shprehet Gjykata, asnjë prej garancive të parashikuara nga neni 6 i Konventës, në qoftë se vendimi që do të rezultonte në përfundim të një procedure që i respekton këto garanci, nuk do të zbatohet nga autoritetet administrative apo çfarëdo tjetër qoftë të një shteti të caktuar.

28. Kuptimi i vendimit ka të bëjë në vetvete me vetë thelbin konceptual të parimeve të shtetit ligjor dhe të ndarjes së pushteteve. Mosrespektimi i një vendimi gjyqësor, sado i diskutueshëm që një vendim i tillë të jetë nga pikëpamja doktrinale e së drejtës, cenon vetë thelbin e një shteti të së drejtës, ku pastaj procesi legjislativ dhe pushteti administrativ rrezikojnë të shndërrohen në leva të një autoritarizmi e pse jo diktature.

## QUFAJ CO. SH.P.K. kundër SHQIPËRISË

*(kërkesa nr. 54268/00)*

**2 tetor 2003 & 18 nëntor 2004**

*vendimi i parë i marrë nga Gjykata ndaj Shqipërisë i cili ka të bëjë me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor por që paraqet aspekte mjaft interesante në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës*

### I. Faktet kryesore

1. Shoqëria kërkuese “Qufaj Co. sh.p.k.” është një joint venture Austrialiano-Shqiptare, e krijuar me vendimin nr. 5883 të Gjykatës së Rrethit Tiranë të 20 korrikut 1992, me objekt investimin në aktivitetin e ndërtimit. Ajo përfaqësohet përpara Gjykatës nga Drejtori Manaxherial, Z. Avenir Ballvora, shtetas shqiptar i lindur më 1957 dhe që tani jeton në Montauban (Francë).

2. Bashkia e Tiranës, me anë të vendimit nr. 165 të 9 qershorit 1992 i shiti shoqërisë kërkuese një truall prej 15,788 m<sup>2</sup> në një zonë të banuar të Tiranës. Me vendimin nr. 174 të 15 qershorit 1992 Bashkia i dha shoqërisë kërkuese një leje projektimi për ndërtimin e 500 apartamenteve. Përpara se të fillonte projekti duhej dhënë gjithashtu një leje ndërtimi por Bashkia nuk arriti ta miratonte për një kohë të gjatë duke penguar fillimin e punimeve të ndërtimit. Pasi Bashkia refuzoi të jepte një leje ndërtimi, shoqëria kërkuese nisi procesin gjyqësor në Gjykatën e Rrethit të Tiranës duke kërkuar një kompensim prej 60,000,000 për humbjet që kishte pësuar. Pretendimi i saj u hodh poshtë me vendimin nr. 4064 të 23 qershorit 1995.

3. Gjykata e Apelit e Tiranës e prishi vendimin e shkallës së parë dhe e urdhëroi Bashkinë t'i paguajë kërkueses 60,000,000 lek (vendimi nr. 1197 i 23 shkurtit 1996). Në mungesë të një ankimi në Gjykatën e Kasacionit nga ana e Bashkisë, vendimi i Gjykatës së Apelit u bë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm. Më 16 korrik 1996 Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, në një dokument që i dërgonte Bashkisë, sqaronte se me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Civile ai nuk kishte më të drejtë në vinte në lëvizje një rishikim të ligjshmërisë së vendimeve të gjykatave më të ulëta.

4. Më 16 korrik 1997 shoqëria në fjalë i kërkoi Gjykatës së Rrethit të Tiranës që të nxirrte një urdhër për ekzekutimin e shumës së akorduar si kompensim. Më 25 qershor 1998 Gjykata e Rrethit të Tiranës e refuzoi kërkesën e Bashkisë për rishikimin e vendimit nr. 5492 të 20 dhjetorit 1994 duke e gjetur si të pabazuar në ligj dhe në fakte. Më 23 korrik 1997, dokumentin nr. 704/gj të 23 korrikut 1997, Zyra e Përmbaramit njoftoi Bashkinë se ajo duhet të ekzekutonte vendimin e Gjykatës së Apelit duke i paguar shoqërisë kërkuese 60,000,000 lek.

5. Megjithatë, Bashkia në mënyrë të përsëritur refuzonte ta respektonte vendimin, duke pretenduar se ajo nuk kishte buxhet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Në këto kushte Zyra e Përmbaramit i kërkoi Departamentit të Buxhetit dhe Tatimeve në Ministrinë e Financave (institucioni më i lartë financiar përgjegjës për pagesa të tilla) që të respektonte vendimin duke parashikuar fondet përkatëse (neni 589, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Civile).

6. Me aktet nr. 2018/3 të 19 shtatorit 1997, 2018/5 të 7 nëntorit 1997 dhe 4670 të 22 shtatorit 1999, Ministria e Financave i hodhi poshtë kërkesat e Zyrës së Përmbaramit duke pretenduar se Neni 589 i Kodit të Procedurës Civile nuk gjente zbatim dhe se nuk kishte mundësi të gjendeshin fonde në bazë të Ligjit për Buxhetin e Shtetit. Ajo shtoi se Bashkia duhet të kontaktonte me "Degën e Thesarit të Rrethit të Tiranës", për të specifikuar fondin nga i cili duhet të paguhet borxhi si dhe duhet të shkojë ky fond.

7. Duke qënë se vendimi nuk u ekzekutua, shoqëria kërkuese e çoi çështjen në Gjykatën Kushtetuese duke pretenduar se institucionet lokale qeveritare janë të detyruara të garantojnë ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe

jo ti pengojnë ato. Gjykata Kushtetuese refuzoi ankesën e kërkuesit duke thënë se “ankesa nuk mund të merrej parasysh pasi zbatimi i vendimeve gjyqësore është jashtë juridiksionit të kësaj gjykate.

8. Në Strasburg shoqëria kërkuese u ankua për shkelje të të drejtave të parashikuara nga nenet 6 §1 dhe 13 dhe 14 të Konventës, shkelje që vinte si pasojë e refuzimit të autoriteteve për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë të datës 23 Shkurt 1996.

## II. Vendimet e Gjykatës (i 2 tetorit 2003 dhe i 18 nëntorit 2004)

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake

9. Përsa i përket nenit 6 § 1 të Konventës, qeveria ngre dy pretendime paraprake në lidhje me kritere të nenit 35 § 1:

#### *i) për mos shterim të mjeteve të brendshme*

10. Autoritetet argumentojnë se shoqëria nuk i ka shterur mjetet efektive ligjore. Autoritetet arsyetojnë se kërkuesi nuk e ka çuar çështjen për shqyrtim te Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me Ligjin 8812 të datës 17 Maj 2001 të Zyrës së Përmbarrimit. Autoritetet shtojnë se në bazë të ligjit; në rast moszbatimi të një vendimi gjyqësor, Zyra e Përmbarrimit do t’i vërë palës debitore një gjobë prej 50.000 lekësh (euro 350). Rrjedhimisht, kërkuesi nuk ka mundur që të shfrytëzojë këtë mjet ligjor.

11. Shoqëria ka vënë në dyshim efektivitetin e dy rrugëve ligjore të ofruara nga qeveria. Përsa i përket Institucionit të Avokatit të Popullit, shoqëria argumentoi se ky institucion nuk mund të sigurojë një mjet ligjor efektiv sipas kuptimit të Konventës. Me tej argumentoi se kompetencat e Zyrës së Përmbarrimit për të gjobitur palën debitore nuk përputhen me objektivin kryesor të kërkuesit, i cili është ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës. Si pasojë, kërkuesi arsyetoi se deklaratat e qeverisë ishin të pabazuara.

12. Gjykata ritheksoi se parimi i shterimit të mjeteve ligjore sipas nenit 35 të Konventës e detyron kërkuesin që të përdorë ato mjete të mundshme dhe mjaftueshme ligjore që mund të gjenden në sistemin e brendshëm ligjor, të cilat i ofrojnë atij kompensim për shkeljet e supozuara të ligjit. Ekzistenca e këtyre mjeteve ligjore duhet të jetë mjaft e sigurt, si në teori ashtu edhe në praktikë. Neni 35 § 1 parashikon se kërkesat që paraqiten para gjykatës duhen të paraqiten përpara institucioneve vendase dhe në thelb duhet të jenë në përputhje me kërkesat formale të gjendura në legjislationin e brendshëm, por nuk duhet tu bëhet rekurs mjeteve ligjore të papërshtatshme dhe të paefektshme.

13. Përsa i përket mundësisë për të aplikuar te Avokati i Popullit, Gjykata vëren se duke qënë një institucion i pavarur nga ekzekutivi, Ombudsmeni nuk mund të marrë vendime me karakter shtrëngues kundrejt autoriteteve qeveritare (Ligji 8554 i datës 4 Shkurt 1999). Pra një aplikim i bërë te Avokati i Popullit nuk mund të quhet si mjet ligjor efektiv sipas kuptimit të nenit 35 § 1. Si pasojë, ky pretendim fillestar duhet të rrëzohet.

*ii) në lidhje me mospasjen e cilësisë të të dëmtuarit nga shoqëria kërkuese*

14. Shoqëria kërkuese “Qufaj Co. sh.p.k.” është regjistruar si shoqëri tregtare me datën 2 Korrik 1992 në bazë të një vendimi të Gjykatës së Faktit Tiranë, dhe është themeluar nga Z. Qufaj, kryetar dhe Z. Ballvora si drejtor menaxhimi dhe përfaqësues ligjor. Për më tepër, në zbatim të Ligjit të Shoqërive Tregtare nr. 7638 të vitit 1992, Regjistrit Tregtar dhe Ligjit të Regjistrimit të Shoqërive nr. 7667 të vitit 1993), shoqëritë tregtare duhet që të ri-regjistroheshin brenda 6 muajve duke nisur nga data 1 Janar 1993 ose në të kundërt regjistrimi do të bëhet i pavlefshëm.

15. Në rastin konkret, sipas dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit shoqëria “Qufaj Co. sh.p.k.” nuk është regjistruar. Si pasojë, autoritetet shqiptare pretendojnë se regjistrimi i saj ka skaduar automatikisht. Ashtu siç thuhet edhe në vendimin nr. 17369/97 të gjykatës së Faktit Tiranë, shoqëria nuk është reregjistruar zyrtarisht deri në vitin 1997. Në bazë të atij vendimi, menaxhimi i Shoqërisë “Qufaj Co. sh.p.k.” bëhet nga Z. Ballvora që është drejtor menaxhimi dhe përfaqësues ligjor si dhe z. Qufaj në rolin e ortakut. Sipas autoriteteve, shoqëria “e re” “Qufaj Co. sh.p.k.”, që është shoqëria kërkuese në këtë rast nuk është e njëjta shoqëri me atë që ishte palë e procedurave përpara gjykatave shqiptare, jo vetëm sepse shoqëria nuk ka ekzistuar zyrtarisht ndërmjet viteve 1993-1997, kur është regjistruar, por edhe për shkak të drejtimit të ri të saj. Në këtë këndvështrim, autoritetet argumentojnë se drejtori menaxhues i kompanisë nuk ka autoritetin e duhur për të përfaqësuar kompaninë e cila nuk është e regjistruar para autoriteteve shqiptare ose në gjykatë. Rrjedhimisht, përderisa shoqëria e vjetër pushoi së ekzistuari në 1993, atëherë Shoqëria kërkuese nuk mund të quhet “e dëmtuar” sipas nenin 34 § 3 të Konventës.

16. Kërkuesi e kundërshtoi këtë argument duke shtuar se Gjykata e Apelit Tiranë e ka kundërshtuar këtë pretendim. Për më tepër, legjislacioni që i referohen autoritetet qeveritare është i zbatueshëm për ato shoqëri që nuk kanë mundur të plotësojnë formalitetet e regjistrimit dhe shoqërisë kërkuese. Si pasojë, regjistrimi i saj nuk ka skaduar ashtu siç pretendojnë autoritetet. Për më tepër, procesi i reregjistrimit ishte pasojë e ri-organizimit të kompanisë që ka ardhur si pasojë e një ndryshimi me karakter financiar.

17. Gjykata ripërsërit se shkeljet e pretenduara nga kompania kërkuese kanë të bëjnë me pamundësinë për të zbatuar vendimin e datës 23 Shkurt 1996. Autoritetet shqiptare e kanë nxjerrë atë vendim pas hyrjes në fuqi të ligjeve të sipërpërmendura nga autoritetet. Në këtë drejtim, Gjykata konsideroi se pretendimi i qeverisë në lidhje me mos-qenien e kërkuesit “i dëmtuar” nuk ka vend, pasi faktet materiale kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të ligjit për ri-regjistrimin e shoqërive. Si pasojë, kërkuesi ishte “i dëmtuar” në kuptimin e nenit 34 të Konventës. Për më tepër, Z. Ballvora ishte dhe ngelet përfaqësuesi ligjor i të dy kompanive, dhe se kapaciteti i tij për të vepruar si përfaqësues ligjor i të dy kompanive ishte i padiskutueshëm. Si pasojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i mësipërm duhet të rrëzohet.



**B. Në lidhje me nenin 6 § 1**

18. Autoritetet theksuan se vendimi përfundimtar nuk ishte zbatuar si rezultat i rrethanave objektive, siç janë mungesa e fondeve dhe konfuzionit në lidhje me rolet respektive të autoriteteve shqiptare. Për më tepër, duke marrë parasysh kaosin legjislativ dhe politik si dhe situatën ekonomike dhe politike në Shqipëri, zbatimi i këtij vendimi ishte gati i pamundur. Për më tepër, buxheti i shtetit ishte dhe mbetet i pamjaftueshëm për kërkesat e bëra në drejtim të rrugave, shëndetit, edukimit dhe infrastrukturës.

19. Duke iu referuar jurisprudencës së saj të padiskutueshme në lidhje me këtë aspekt të nenit 6 § 1<sup>54</sup>, keqinterpretimit të konceptit të “grykimit të drejtë” nga autoritetet shqiptare, vonesës së autoriteteve shqiptare në ekzekutimin e vendimit, si dhe justifikimeve përkatëse të qeverisë për këtë vonesë, Gjykata vendosi se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

**C. Në lidhje me nenin 13**

20. Gjykata konsideroi se neni 6 § 1 i Konventës merr përparësi si “lex specialis” për çështjet e mos-zbatimit të vendimeve, pra ishte i panevojshëm ekzaminimi i çështjes sipas nenit 13<sup>55</sup>.

**D. Në lidhje me nenin 14 të interpretuar së bashku me nenin 6 § 1**

21. Së fundmi, shoqëria kërkuese theksoi se autoritetet shqiptare kane shkelur nenin 14, dhe nenin 6 § 1 të Konventës, dhe shkoi aq larg sa mendoi se pamundësia për të zbatuar vendimin e Gjykatës të Apelit bazohet në opinionet politike të anëtarëve të saj. Ajo theksoi se autoritetet shqiptare kanë preferuar kreditorë të tjerë me kah tjetër politik dhe social. Gjykata ishte e mendimit se shoqëria kërkuese nuk ka mundur që të vërtetojë pretendimet e saj që ajo ishte diskriminuar si kreditorë private dhe e konsideroi këtë pjesë të kërkesës të papranueshme.

**E. Në lidhje me nenin 41**

22. Gjykata i akordoi shoqërisë kërkuese 60 000 000 lekë (shumën e vendosur nga Gjykata e Apelit të Tiranës) 70 000 euro shpërblim për dëmin material dhe jomaterial të pësuar si dhe 2000 euro për shpenzime dhe pagesa gjyqësore.

**III. Koment**

23. Megjithëse gjykimi mbi themelin në lidhje me këtë çështje mund të thuhet se përbënte një qëndrim të pritshëm të Gjykatës së Strasburgut<sup>56</sup>, vlera e tij qëndron në shmangien e çdo dyshimi për perspektivën e zgjidhjes së problemit të mosekzekutimit

<sup>54</sup> Gjykata për këtë qëllim i referohet vendimeve të saj të 19 marsit 1997 në lidhje me çështjen Hornsby kundër Greqisë, të 7 majit 2002 në lidhje me çështjen Burdov kundër Rusisë si dhe të 6 marsit 2003 në lidhje me çështjen Jasiūnienė kundër Lituaniës, të tria vendime të përfshira në këtë botim.

<sup>55</sup> Në lidhje me këtë pikë Gjykata i referohet përsëri vendimit të saj Jasiūnienė – shih poshtëshënimi paraardhës.

<sup>56</sup> Shih komentet e mia në lidhje me këtë pritshmëri në Konferencën Kombëtare të Avokatit të

të vendimeve gjyqësore në Shqipëri. Vlen të theksohet se Gjykata ishte unanime në konstatimin e shkeljes nga Republika e Shqipërisë në këtë çështje.

24. Sidoqoftë për mendimin tim vlera thelbësore e vendimit qëndron në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës. Kjo për disa arsye, një pjesë e të cilave mund të jetë objekt i një debati interesant teorik, ndërsa pjesa tjetër duhet të jenë të qarta për strukturat shtetërore të interesuara.

25. Objekt të një debati juridik mund të përbëjë momenti nëse shoqëria tregtare Qufaj Co. sh.p.k. përbën apo jo subjektin e dëmtuar për qëllimet e nenit 34 § 3 Konventës. Qeveria shqiptare e ka ngritur dy herë me radhë këtë moment edhe në fazën e pranueshmërisë edhe në fazën e gjykimit të themelit, megjithëse në këtë të fundit pa perspektivë të besueshme suksesi duke pasur parasysh vendimin në lidhje me pranueshmërinë. Objekti teorik mund të zhvillohet në lidhje me faktin nëse një person juridik i cili nuk ekziston në bazë të legjislacionit të brendshëm mund të pranohet se ka cilësinë e të dëmtuarit për qëllimet e nenit 34 § 3 të Konventës. Pavarësisht se në parim për aspekte të tilla organet e Strasburgut do t'i referoheshin normalisht legjislacionit të brendshëm përderisa nuk ka një standard evropian për këtë qëllim<sup>57</sup>, Gjykata i referohet qëndrimit që kanë mbajtur gjykatat shqiptare të cilat gjatë procedurave të brendshme e kanë njohur Qufaj Co. sh.p.k. si person juridik, pavarësisht nga veprimi i nenit 64 të Ligjit për Regjistrin Tregtar i cili gjente zbatim edhe ndaj Qufaj Co. sh.p.k. në këtë rast<sup>58</sup>. Mund të jetë me vlerë të theksohet që në këtë rast, ndonëse pa e shprehur Gjykata zbaton parimin e njohur të së drejtës ndërkombëtare ex in iure jus non oritur, duke e vënë gjithmonë në një pozitë të vështirë shtetin përballë organeve ndërkombëtare kur duhet të mos njohë qëndrime të mbajtura prej organeve të vetë atij shteti – në këtë rast Shqipërisë.

26. Përveç këtij momenti të fundit të paragrafit të mësipërm organet shqiptare të interesuara, por edhe të gjithë avokatët dhe personat që synojnë t'i drejtohen Gjykatës së Strasburgut, duhet kenë të qartë se cilat janë mjetet efektive ankimore në Shqipëri për qëllimet e nenit 35 § 1 të Konventës. Pra është e qartë tashmë se Avokati i Popullit në Shqipëri nuk përbën një mjet efektiv për qëllimet e Konventës<sup>59</sup>. Nga ana tjetër vendimi duhet të shërbejë si një guidë e qartë për Gjykatën Kushtetuese e cila me qëndrimin e saj në lidhje me këtë çështje, pra me mospranimin për shqyrtim,

---

Popullit më 19 dhjetor 2003 "Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në mbrojtje të të drejtave të individëve", botuar në përmbledhjen përkatëse fq. 59 me titullin "Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore – element thelbësor i së drejtës për gjykim të drejtë në konceptin evropian" ku referohet edhe një jurisprudencë e pasur e Strasburgut në këtë drejtim.

<sup>57</sup> Përveçse në kuadrin e së drejtës komunitare, e cila nuk gjen zbatim në këtë rast.

<sup>58</sup> Ky nen parashikon "Shoqëritë Tregtare të regjistruara para hyrjes në fuqi të këtij Akti, dokumentacioni i të cilave nuk përputhet me këtë akt, duhet të ri-regjistrohen jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Çdo shoqëri që nuk arrin të ri-regjistrohet ose të paraqesë dokumentet përkatëse çregjistrohet automatikisht prej kësaj date. Ato mund të aplikojnë për një periudhë shtyrje tre-mujore deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit përkatës. Shoqëritë e ri-regjistruara do të ruajnë të gjitha të drejtat që gëzojnë para ri-regjistrimit."

<sup>59</sup> Për të bazuar këtë qëndrim Gjykata i referohet vendimeve të saj të vitit 1996 në lidhje me çështjet Aksoy kundër Turqisë dhe Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë si dhe vendimit të vitit 2000 në lidhje me çështjen Valasinas kundër Lituaniës.

për mendimin tim jo vetëm që nuk ka respektuar Konventën por as Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe konkretisht nenet 5, 17 § 2, 42, 44 dhe 122 § 1 dhe 2 të Kushtetutës<sup>60</sup>. Gjykata Kushtetuese por edhe organet e tjera gjyqësore dhe administrative shqiptare duhet të mbajnë parasysh mirë obiter dicta-n themelore të Gjykatës së Strasburgut në paragrafin 38 të këtij vendimi sipas të cilit “ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të dhënë nga cilado gjykatë duhet konsideruar si pjesë përbërëse e ‘procesit të drejtë’ për qëllimet e nenit 6. Autoriteteve shtetërore nuk iu lejohej që të justifikohen me mungesën e fondeve për mosrespektimin e një detyrimi që rrjedh nga një vendim gjyqësor. Sidoqoftë, në rrethana të veçanta mund të justifikohet ndonjë vonesë në ekzekutimin e një vendimi. Por kjo vonesë nuk mund të jetë e tillë sa të cenojë vetë thelbin e së drejtës të mbrojtur nga neni 6 § 1.”<sup>61</sup>

27. Nga ana tjetër, ky vendim sqaron një çështje që ka qenë pjesë e debatit me kolegë të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me mënyrën e interpretimit të nenit 131 f) të Konventës, për një konceptim të ngushtë dhe formalist të kësaj dispozite apo për një interpretim të gjerë, por të nisur nga koncepti dhe qëllimi i dispozitës dhe nga roli i saj në një sistem të bazuar në shtetin e së drejtës dhe në sundimin e ligjit. Nuk do më ngelej gjë tjetër në këtë kuadër veçse të riprodhoja paragrafët 41 dhe 42 të vendimit të Gjykatës të cilët janë të një qartësie tepër të spikatur për këtë qëllim:

*“41. në bazë të vlerësimeve të mësipërme Gjykata mendon se dispozitat në lidhje me procesin e drejtë në Shqipëri duhet të ishin interpretuar në një mënyrë të tillë që të garantonin një mjet ankimor efektiv për shkeljen e pretenduar të nenit 6 § 1 të Konventës.*

*42. Për këtë arsye, sipas mendimit të Gjykatës, Gjykata Kushtetuese, në kuadrin e juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për një proces të drejtë, ishte kompetente të shqyrtonte ankesën e shoqërisë kërkuese për mos-respektim të një vendimi përfundimtar”.*

## ALLENET DE RIBEMONT kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 15175/89)

10 shkurt 1996

*çështja ka të bëjë me prezumimin e pafajësisë si dhe me efektet që mund të ketë çënimi i këtij parimi në kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore*

### I. Faktet kryesore

1. Pas vrasjes të Z. Jean de Broglie, ish-ministër dhe deputet i Eures, më 24 dhjetor 1976, Z. Poniowski, i asistuar nga drejtori i policisë juridike, Z. Ducret dhe nga

<sup>60</sup> Me vlerë për qartësimin e juridiksionit të Gjykatës sonë Kushtetuese është edhe vendimi i Gjykatës së Strasburgut i 28 tetorit 2004, në lidhje me pranueshmërinë në çështjen Balliu kundër Shqipërisë. Në këtë vendim Gjykata e Strasburgut shprehet se Gjykata jonë Kushtetuese është kompetente për të shqyrtuar në themel një ankim për mospraninë e avokatit gjatë një procesi penal në Gjykatën e Shkallës së Parë.

<sup>61</sup> Paragrafi 38 i vendimit.

shefi i brigadës kriminale, Z. Ottavioli, mbajti, më 29 dhjetor 1976, një konferencë shtypi gjatë së cilës përmendi si autor emrin e Z. Patrick Allenet de Ribemont. Po atë ditë ky i fundit ishte ndaluar duke u akuzuar për bashkëpunim në një vrasje të qëllimshme. Më 14 janar 1977 ndaj tij u mor masa e arrestit, por ai e rifitoi lirinë e tij me një vendim të 21 marsit 1980 i cili e konsideroi akuzën si të pabazuar.

2. Allenet de Ribemont, i akuzuar publikisht si organizatori i vrasjes, i kërkoi kryeministrin shpërbllim të dëmit moral dhe material që ai kishte pësuar, duke u mbështetur mbi artikujt e shtypit të cilët tregonin hollësisht konferencën e shtypit të 29 dhjetorit 1976. Megjithatë kërkesa e tij nuk pati sukses.

3. Në vijim, ai iu drejtua në mënyrë të njëpasnjëshme, me të njëjtin pretendim, juridiksioneve administrative (20 shtator 1977) dhe atyre gjyqësore (29 shkurt 1984). Pas një procedure e cila zgjati pesë vjet e tetë muaj, Gjykata Administrative e Parisit dhe Këshilli i Shtetit deklaruan se nuk kishin kompetencë për ta pranuar këtë kërkesë. Ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit, si dhe Gjykata e Kasacionit e hodhën poshtë kërkesën e Z. Allenet de Ribemont për mungesë provash. Kjo procedurë e dytë zgjati katër vjet e nëntë muaj, dhe u mbyll më 30 nëntor 1988.

4. Duke u mbështetur në nenet 6 §§ 1 dhe 2 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut Z. Allenet de Ribemont ia paraqiti kërkesën e tij Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut. Më 8 shkurt 1993, Komisioni e pranoi kërkesën duke konsideruar se rasti në fjalë përbënte një mosrespektim të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe një zgjatje të tepruar të procedurave gjyqësore. Në raportin e tij të 12 tetorit 1993, ai njëzëri parashtrroi mendimin se ka patur një shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 2 dhe ia kaloi çështjen Gjykatës për gjykim.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake mbi zbatueshmërinë e nenit 6 § 2

5. Qeveria mbrojt i idenë se dhunimi i prezumimit të pafajësisë mund të shkaktohet vetëm nga një autoritet gjyqësor dhe të shfaqet në fund të procedurës, kur vërtetohet se vendimi i dënimit të të pandehurit lejon të supozohet së gjykatësi e trajtonte *a priori* të interesuarin si fajtor.

6. Sipas Gjykatës, një shkelje e tillë mund të bëhet jo vetëm nga një gjykate apo një gjyqtar por dhe nga autoritete të tjera publike. Në rastin tonë, ndalimi dhe pyetja e kërkuesit ishin zhvilluar në kuadrin e një hetimi të hapur disa ditë më parë nga një hetues dhe Z. Allenet de Ribemont quhej i akuzuar. Si rrjedhim, të dy nëpunësit e lartë të policisë ishin të ngarkuar të udhëhiqnin hetimin. Duke qënë të ngarkuar me hetimin gjyqësor dhe të mbështetur nga Ministri i Brendshëm, arsyetimet e tyre kishin një lidhje direkte me të. Pra, në këtë rast gjen zbatim neni 6 § 2.

**B. Në lidhje me nenin 6 § 2**

7. Disa nga nënpunësit më të lartë të policisë e cilësuan Z. Allenet de Ribemont si një nga drejtuesit dhe bashkëpunëtor në vrasje. Këtu bëhet fjalë për një deklaratë fajësie, e cila nga njëra anë e shtynte publikun e gjerë ta besonte atë dhe nga ana tjetër të paragjykonte vlerësimin e fakteve nga gjyqtarët kompetentë. Sipas Gjykatës ka pasur shkelje të nenit 6 § 2.

**C. Në lidhje me nenin 6 § 1**

8. Në këndvështrimin e nenit 6 § 1, koha që duhej llogaritur fillonte më 23 mars 1977, data e paraqitjes të ankimit tek kryeministri, dhe mbaronte më 30 nëntor 1988, data e hedhjes poshtë nga Gjykata e Kasacionit të kërkesës të Z. Allenet de Ribemont. Kjo procedurë zgjati rreth njëmbëdhjetë vjet e tetë muaj.

9. Çështja ishte e ndërlikuar, por kjo nuk justifikonte një kohëzgjatje të tillë të procedurës. Megjithëse Z. Allenet de Ribemont kishte qënë shkaktari i një vonese prej tre vjetësh e katër muajsh, përsëri mbeteshin rreth tetë vjet të tjera. Autoritet shtetërore ishin përgjegjëse për një periudhë të gjatë mosveprimi. Si autoritetet administrative ashtu edhe ato gjyqësore, e kishin penguar shpesh herë rishfaqjen e regjistrimit televiziv, i cili lejonte që Z. Allenet de Ribemont të sillte provën e deklaratës së mbajtur gjatë konferencës së shtypit.

10. Gjykata nuk dyshoi aspak se pikërisht ky ishte shkaku kryesor i ngadalësimit të procedurës. Përsa i përket sidomos sjelljes së gjykatave, duhet kujtuar se gjyqtarëve administrativë iu deshën jo më pak se pesë vjet e tetë muaj për të deklaruar se nuk kanë kompetencë në lidhje me këtë çështje. Megjithëse një këshilltar i ngarkuar me dosjen në Gjykatën e Apelit të Parisit punoi vërtet për të përshpejtuar procedurën, asnjë gjyqtar nuk veproi në këtë mënyrë në juridiksionet e tjera gjyqësore. Pra ka patur shkelje të nenit 6 § 1.

**D. Në lidhje me nenin 10**

11. Gjykata u shpreh se liria e shprehjes, e cila është e parashikuar nga neni 10 i Konventës, përfshin atë të marrjes dhe të komunikimit të informacioneve. Neni 6 § 2 nuk mund të ndalojë autoritetet që të njoftojnë publikun në lidhje me hetimet që zhvillohen, por ai kërkon që ky informim të bëhet në respektim të parimit të prezumimit të pafajësisë.

**E. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)**

12. Përsa i përket nenit 50, Gjykata e vlerësoi pjesërisht të bazuar kërkesën për shpërblim të dëmit material. Gjykata konstatoi se i interesuari kishte pësuar një dëm të padiskutueshëm nga vërtetimi i shkeljes së nenit 6 § 1, por mbi të gjitha nga shkelja e nenit 6 § 2. Dëmi ka vlerën e 2 000 000 franga franceze. Së fundi, ajo i akordoi kërkuarit 100 000 franga franceze, plus tatimin mbi vlerën e shtuar, për shpenzimet dhe pagesat e bëra pranë organeve të Konventës.<sup>62</sup>

<sup>62</sup> Një ligj i 4 janarit 1993 i cili bëri ndryshime në procedurën penale - dhe i adoptuar përpara se Gjykata të merrte vendimin - parashikoi në Nenin e tij 47, titulli V, që gjyqtari mund të konstatojë

### III. Koment

13. Komentin e kësaj çështje do ta filloja me një fakt shumë interesant. Më 15 janar 2002, kanali televiziv francez TF1 bënte nekrologjinë e ish Ministrit të Brendshëm francez Z. Michel Poniatowski i cili kishte vdekur po atë ditë. Gjatë nekrologjisë momenti që më tërhoqi më tepër vëmendjen ishte përmendja e faktit se Z. Poniatowski gjatë kohës që kishte qënë ministër i brendshëm kishte bërë një deklaratë, më 29 dhjetor 1976, në lidhje me vrasjen e Z. Jean de Broglie. Nekrologjia vazhdonte duke saktësuar se Z. Poniatowski kishte shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë duke shpallur Z. Patrick Allenet de Ribemont fajtor për vrasjen, ndërkohë që ky më vonë ishte shpallur i pafajshëm me vendim gjykatë.

14. Çështja ka një rëndësi themelore pikërisht për këtë element – prezumimin e pafajësisë. Për t'u vënë në veçanti në dukje është momenti që shkelja e këtij parimi themelor të Konventës në procesin penal në këtë rast nuk u bë nga organe gjyqësore ose që kishin kompetencë të vendosnin në lidhje me fajësinë apo jo të kërkuesit, por u bë nga struktura të ekzekutivit – ministri i brendshëm dhe bashkëpunëtorët e tij në radhët e policisë. Ky moment i kundërshtuar në parim nga qeveria Franceze në pretendimet paraprake u hodh poshtë prerazi nga ana e Gjykatës, e cila u shpreh se shkelja e këtij parimi mund të bëhet edhe nga autoritetet me karakter administrativ. Ky pohim ka rëndësi të veçantë në praktikën shqiptare parlamentare të krijimit të komisioneve të hetimit të cilat në disa raste me radhë kanë shkuar deri të formulimin e deklaratave të tilla të ngjashme të ato të Z. Poniatowski.

15. Nga ana tjetër vendimi ka rëndësi për nxjerrjen në pah të efektit që mund të kenë deklaratat të tilla mbi prezumimin e fajësisë ose të përgjegjësisë së një personi në lidhje me zhvillimin e procedurave gjyqësore, penale, administrative ose civile, në lidhje me çështjen në të cilën ai është palë. Në këtë vendim Gjykata jo më kot konstatoi njëzëri shkelje edhe të nenit 6 § 1 të Konventës pasi ka konstatuar shkelje të paragrafit 2 të të njëjtit nen. Po të shihet edhe në kuadrin e nenit 50 të Konventës, në lidhje me shpërblimin e drejtë, duket se shkelja e paragrafit 2 të nenit 6 i ka shkaktuar kërkuesit një dëm shumë më të rëndë sesa shkelja e paragrafit 1 të të njëjtit nen.

---

një shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë dhe që gjatë procedurës të urdhërojë një masë me qëllim që të shmangë këtë shkelje.



## HEANEY DHE MCGUINNESS kundër IRLANDËS DHE QUINN kundër IRLANDËS

(kërkesa nr. 34720/97)

21 dhjetor 2000

*në këtë çështje Gjykata shprehet se shkelja e së drejtës për të ndenjur në heshtje dhe për të mos u vetëakuzuar mund të çojë në shkelje edhe të drejtës për prezumimin e pafajësisë së një personi*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit Anthony Heaney, lindur më 1955, William McGuinness, lindur më 1956 dhe Paul Quinn, lindur më 1973 janë shtetas irlandezë.

2. Të tre kërkuesit u arrestuan me dyshimin se kishin kryer akte të rënda terrorizmi. Pasi ishin paralajmëruar nga policia se kishin të drejtë të rrinin pa folur, iu kërkua, në bazë të Seksionit 52 të Ligjit Mbi Veprat Penale kundër Shtetit, që të jepnin të dhëna në lidhje me veprimet dhe lëvizjet e tyre në kohën e ndodhjes së veprave në fjalë.

3. Z. Heaney dhe Z. McGuinness refuzuan që tu përgjigjeshin të gjitha pyetjeve. Ata u akuzuan për pjesëmarrje në IRA dhe për mostregim të veprimeve të tyre. Ata u konsideruan të pafajshëm në lidhje me akuzën e parë por u konsideruan fajtorë për të dytën dhe u dënuan me 6 muaj heqje lirie. Z. Quinn mohoi çdo lloj lidhjeje me ngjarjet për të cilat ishte marrë në pyetje dhe refuzoi të jepte të dhëna në lidhje me lëvizjet dhe veprimet e tij. Ai u dënua, me gjashtë muaj heqje lirie, në bazë të Nenit 52 për mosdhënie të informacioneve në lidhje me lëvizjet e tij.

4. Në lidhje me çështjen Heaney dhe McGuinness kundër Irlandës Gjykata e Lartë nuk e pranoi kërkesën për jo-kushtetutshmëri të Seksionit 52 ndërsa apelimet e kërkuesve ndaj dënimeve të tyre u shtynë deri në një datë që të shpallej rezultati i kërkesave të tyre pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

### II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesit pretendonin se dënimet e tyre me heqje lirie në bazë të nenit 52 përbënin një shkelje të të drejtave të tyre të garantuara nga neni 6 §§ 1 dhe 2 dhe neni 10 i Konventës. Z. Heaney dhe Z. McGuinness pretenduan gjithashtu se ishte shkelur e drejta e tyre për jetë private e mbrojtur nga neni 8.

**A. Në lidhje me nenin 6 §§ 1 dhe 2***a) Mbi zbatueshmërinë e këtij Neni*

6. Gjykata konstatoi se kërkuesit ishin “akuzuar” sipas kuptimit të nenit 6, edhe pse Z. Quinn nuk ishte akuzuar me një vepër penale bazë dhe Z. Heaney dhe Z. McGuinness nuk ishin akuzuar formalisht kur u ishin bërë kërkesat e parashikuara nga Seksioni 52 i lartpërmendur. Gjykata rikujton me këtë rast që një person mund të konsiderohet se është akuzuar sipas kuptimit të nenit 6 § 1 kur ky gjendja e tij individual ka qënë “cenuar në thelb”. Gjykata konsideroi se kërkuesit kanë qënë “të cenuar në thelb” në këtë kuptim dhe prandaj ishin “akuzuar” për anëtarësim në IRA, gjë që binte në kundërshtim me Ligjin e vitit 1939, dhe me pjesëmarrje në disa nga veprat penale për të cilat bëhej fjalë në çështjen kundër tyre.

7. Edhe pse deklarimi tërësisht i pafajshëm ose mungesa e procedimit në themel mund ta pengojë një kërkues të pretendojë se i janë shkelur të drejtat për garancitë procedurale të parashikuara nga neni 6, Gjykata në vendime të sajat të mëparshme ka vendosur për shkelje të nenit 6 § 2. Në rastin në fjalë, në qoftë se kërkuesit kanë qënë në pamundësi që t'i referohen nenit 6 §§ 1 dhe 2, kjo do të thotë se pafajësia ose mungesa e procedimit në themel (in rastin e Z. Quinn) nuk lejonte shqyrtimin e ankimeve të tyre në lidhje me dënimet që kishin marrë përpara deklarimit të pafajshëm apo vendimit që të mos vazhdohej ndjekja penale, vetëm sepse kërkuesit pretenduan mbrojtjen e garantuar nga neni 6 i Konventës. Kjo nuk do të ishte në përputhje me nevojën e interpretimit të Konventës në një mënyrë të tillë që të garantonte të drejtat që janë praktike dhe efektive dhe jo teorike dhe iluzive. Për këto arsye paragrafët 1 dhe 2 të nenit 6 gjejnë zbatim.

*b) A ka shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 2*

8. Gjykata konstatoi se garancitë e parashikuara nga ana e qeverisë nuk mund të kufizonin në mënyrë efektive dhe të mjaftueshme shkallën e detyrimit të kërkuar nga Seksioni 52 deri në masën që të mos prekeshin të drejtat në fjalë, përderisa gjithsesi e vetmja zgjedhje ngelej ndërmjet dhënies së informacionit ose heqjes së lirisë. Shkalla e detyrimit të kërkuar nga zbatimi i nenit 52 në fakt shkatërronte vetë thelbin e mbrojtjes kundër vetë-akuzimit dhe të së drejtës për të mos folur.

9. Shqetësimet e karakterit të rendit publik dhe të sigurisë publike të pretenduara nga ana e qeverisë nuk mund të justifikonin një dispozitë me pasoja të tilla. Prandaj ka patur shkelje të së drejtës së kërkuesve për të ndenjur në heshtje dhe të së drejtës së tyre për të mos u vetëakuzuar, të drejta të garantuara nga neni 6 § 1. Për më tepër, duke patur parasysh lidhjen e ngushtë me prezumimin e pafajësisë të garantuar nga neni 6 § 2, ka patur edhe shkelje të kësaj dispozite.

**B. Në lidhje me nenet 8 dhe 10**

10. Gjykata vlerësoi se nuk kishin pse ngriheshin probleme më vete nën këndvështrimin e këtyre dispozitave.

### C. Në lidhje me nenin 41

11. Gjykata u akordoi të tre kërkuesve 4000 sterlina irlandezë për dëme jo-pasurore, një total prej 9 377.50 sterlina për pagesat dhe shpenzimet dy kërkuesve të çështjes Heaney dhe McGuinness kundër Irlandës dhe 11341.08 sterlina kërkuesit në çështjen Quinn kundër Irlandës (duke hequr 5 000 franga franceze, në secilin rast të akorduara si ndihmë ligjore).

### III. Koment

12. Këto vendime përmbajnë ripohime të rëndësishme të dy aspekteve të mbrojtjes së parashikuar nga neni 6. Së pari, ato konfirmojnë karakterin autonom të konceptit të akuzës penale në kuadrin e Konventës. Në çështjen *Deweer* Gjykata e kishte bërë të qartë që kemi të bëjmë me një akuzë penale në kuptimin e Nenit 6 në qoftë se gjendja individuale ka qënë “cenuar në thelb” nga ana e një veprimi zyrtar në kuadrin e një procedimi të mundshëm penal. Kjo është e vlefshme edhe kur individit nuk ka qënë “akuzuar” ende (ose aspak) formalisht për një vepër penale në bazë të së drejtës së brendshme. Në rastin *Serves* Gjykata kishte vlerësuar se Neni 6 gjente zbatim edhe përpara bërjes formalisht të çdo lloj akuze penale, në qoftë se individit ishte detyruar me ligj që të jepte të dhëna për një magjistrat në një procedurë hetimore, jo si person i akuzuar por si dëshmitar edhe pse mund të ketë patur prova thelbësore për pjesëmarrjen e këtij personi në veprën penale për të cilën bëhet fjalë. *Serves* ishte gjobitur për shkak se nuk kishte vepruar siç i ishte kërkuar. Ai ishte dënuar gjithashtu për pjesëmarrje në këtë krim. Në rastet Irlandeze kërkuesit ishin të detyruar me ligj që të jepnin në dhëna mbi lëvizjet e tyre përpara se ata të “akuzoheshin” me veprën penale thelbësore.

13. Në çështjen *Serves* Gjykata vendosi (me 6 vota kundër 3) se neni 6 § 1 nuk ishte shkelur sepse në vend që të mos pranonte të dëshmonte fare (e cila ishte edhe vepra për të cilën ishte dënuar) *Serves* mund të kishte të pranuar të dëshmonte duke refuzuar tu përgjigjej pyetjeve që mund ta ngarkonin me përgjegjësi penale. Komisioni nga ana e tij kishte konstatuar shkelje me 25 vota kundër 2.

14. Rastet Irlandeze janë të ndryshme. Ligji u kërkonte atyre që të jepnin të dhëna në lidhje me lëvizjet e tyre dhe mosdhënia e këtyre të dhënave përbënte një vepër më vete për të cilën ata ishin dënuar me heqje lirie. Për më tepër nuk kishte garanci të qarta në bazë të së drejtës së brendshme të zbatueshme që informacioni i dhënë nën këtë detyrim ligjor nuk do të mund të përdorej në gjykimin me objekt veprën themelore.

15. Aspekti i dytë i rëndësishëm i këtyre vendimeve ishte që Gjykata ka vendosur për herë të parë që shkeljet e nenit 6 mund të ndodhin në rrethana kur individët e akuzuar janë deklaruar të pafajshëm në lidhje me akuzat themelore kundër tyre. Komisioni kishte vendosur më parë për papranueshmëri të rasteve që pretendonin shkelje të nenit 6 kur kërkuesit ishin deklaruar të pafajshëm<sup>63</sup>. në bazë të argumentimit se ata nuk mund të konsideroheshin të dëmtuar nga një shkelje. Megjithatë në rastet

<sup>63</sup> Shih për shembull X kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Dyrn kundër Danimarkës.

Irlandeze kërkuesit kishin vuajtur në mënyrë të hapur dëmet që u ishin shkaktuar (dënim dhe heqje lirie). Këto vendime nuk shkojnë deri aty sa të vendosin se kemi të bëjmë me shkelje të nenit 6 në qoftë se nuk ka vuajtje ose dëm si pasojë e procedurës. Në këtë drejtim neni 6 ndryshon nga të drejta të tjera të parashikuara nga Konventa në lidhje me të cilat konstatimi i një vuajtjeje ose i një dëmi vlerësohet vetëm në lidhje me shpërblimin e drejtë dhe jo edhe në lidhje me deklarimin e një shkeljeje<sup>64</sup>.

## LAMANNA kundër AUSTRISË

(kërkesa nr. 28923/95)

10 korrik 2001

*dyshimet e vazhdueshme të ngritura ndaj një personi mund të çojnë në shkelje të së drejtës së tij për prezumimin e pafajësisë*

### I. Faktet kryesore

1. Salvatore Lamanna, shtetas francez, ishte mbajtur në gjendje paraburgimi dhe pastaj ishte deklaruar i pafajshëm në lidhje me një tentativë vrasje, pengmarrje personi në rrethana rënduese dhe armëmbajtje pa leje. Ai kishte kërkuar kompensim për periudhën e tij të paraburgimit por pa sukses. Ai u ankua në Gjykatën Rajonale të Salzburgut dhe Gjykata e Apelit të Linzit e hodhi poshtë pretendimin e tij për kompensim me argumentin se dyshimi ndaj tij nuk ishte larguar, gjë që shkelte parimin e prezumimin e pafajësisë të parashikuar në Nenin 6 § 2. Ai bazohej gjithashtu në nenin 6 § 1 me argumentin se vendimet nuk ishin dhënë në seanca me dyer të hapura.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

2. Duke patur parasysh procedurat e kompensimit në tërësinë e tyre si dhe karakteristikat e tyre të veçanta, Gjykata konstatoi që qëllimi i nenit 6 § 1, sidomos në lidhje me nënshtrimin e vendimeve gjyqësore kontrollit të publikut, dhe mundësimin pra të këtij të fundit që të studiojë mënyrën në të cilën gjykatat trajtojnë përgjithësisht pretendimet mbi kompensimet për periudhat e paraburgimit, ishte përmbushur në rastin në fjalë nga dhënia publikisht e vendimit të Gjykatës së Apelit.

#### B. Në lidhje me nenin 6 § 2

3. Duke vlerësuar pretendimin e ngritur në bazë të nenit 6 § 2, Gjykata kujtoi se njëherë që shpallja e pafajësisë ka marrë formë përfundimtare, zërat për çdo lloj dyshimi në lidhje me fajësinë, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me arsyet e

<sup>64</sup> Shih për shembull Norris kundër Irlandës, 22 tetor 1981 dhe Campbell dhe Cosans kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 shkurt 1982.

lirimit, janë të papajtueshme me prezumimin e pafajësisë. Edhe Gjykata Rajonale e Salzburgut edhe Gjykata e Apelit e Linzit dhanë deklarata në lidhje me procedurat e kompensimit pas lirimit përfundimtar të kërkuesit, duke shprehur pikëpamjen se kishte një dyshim të vazhdueshëm ndaj tij, duke e vënë në dyshim pafajësinë e tij.

4. Si përfundim, Gjykata vendosi se nuk ka patur shkelje të nenit 6 § 1 dhe se ka patur shkelje të nenit 6 § 2. Duke mos gjetur lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së konstatuar të Konventës dhe të dëmit të pretenduar material në formën e humbjes së të ardhurave si rezultat i paraburgimit të tij, Gjykata nuk akordoi ndonjë shumë për dëm. Kërkuesit, gjithsesi iu akorduan 75 135 shilinga austriake për shpenzime dhe pagesa gjyqësore.

### III. Koment

5. Neni 5 § 5 i Konventës kërkon që personave që u është hequr liria në kundërshtim me Konventën duhet t'u paguhet një kompensim. Paraburgimi i një personi i cili në vijim lirohet duke u shpallur i pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat është në pamje të parë i ligjshëm në qoftë se përputhet me nenin 5 § 1 (c), 5 §§ 2, 3 dhe 4. Konventa nuk kërkon që në raste të tilla të paguhet kompensim. Megjithatë ka dy parime themelore që gjejnë zbatim në këtë rast. Së pari, neni 6, e drejta për një gjykim të drejtë, gjen zbatim në lidhje me procedurat për kompensim në rastet kur një e drejtë e tillë parashikohet nga e drejta e brendshme. Së dyti, kur një person është shpallur i pafajshëm, një vendim që ka për objekt akordimin e kompensimit, ose përcaktimin e masës së këtij nuk duhet që në asnjë mënyrë të hedhë ndonjë dyshim në lidhje me pafajësinë e tij. I njëjti parim gjen zbatim edhe në lidhje me shpenzimet gjyqësore. Një veprim i kundërt do të shkelte nenin 6 § 2 të Konventës<sup>65</sup>. Gjykata në këtë çështje përforconte vendimin që ajo kishte dhënë më 21 mars 2000 në lidhje me çështjen Rushiti kundër Austrisë.

## GOTH kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 53613/99)

16 maj 2002

*ky vendim ka të bëjë me të drejtat e një personi të akuzuar gjatë një procesi gjyqësor kur ky person nuk dorëzohet për tu gjykuar në gjendje arresti*

### I. Faktet kryesore

1. Christian Goth është shtetas Francez dhe ka lindur më 1945. Ai u gjet fajtor për një emërtim të rremë tregtar nga ana e Gjykatës së Apelit të Versajës dhe u dënua me dy vjet burg, një prej të cilëve u pezullua.

<sup>65</sup> Shih vendimin e 25 marsit 1983 në lidhje me çështjen Minelli kundër Zvicrës.

2. Ai iu drejtua për prishjen e këtij vendimi Gjykatës së Kasacionit dhe ndërkohë kërkoi një urdhër nga ana e Gjykatës së Apelit të Versajës që ta përjashtonte atë nga arresti gjatë fazës së gjykimit. Në mbështetje të kërkesës së tij ai argumentoi se gjendja e tij e vështirë shëndetësore do të bënte që në burg ai të ishte në rrezik. Gjykata e Apelit e Versajës e hodhi poshtë kërkesën e tij me arsyetimin se ai nuk kishte ofruar garancitë e nevojshme se nuk do të fshihej, përderisa ai nuk kishte respektuar asnjë prej vendimeve gjyqësore që e kishin dënuar më parë. Në shkurt 1999 Gjykata e Kasacionit nuk e pranoi kërkesën e tij me arsyetimin se ai nuk ishte dorëzuar për t'u gjykuar në gjendje arresti dhe kërkesa e tij për t'u përjashtuar nga arresti nuk ishte pranuar.

## II. Vendimi i Gjykatës

3. Kërkuesi ankohej në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës për shkelje të së drejtës së tij për t'iu drejtuar një gjykate.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

4. Gjykata vlerësoi se kushtëzimi i pranimit të një kërkesë ankimore pranë Gjykatës së Kasacionit me dorëzimin e kërkuesit në gjendje arresti e detyronte këtë të fundit që ta privonte vetveten nga liria e tij në bazë të vendimit që ai kundërshtonte përpara Gjykatës së Kasacionit edhe pse ky vendim nuk është ende përfundimtar. Ky detyrim cenonte vetë thelbin e së drejtës për të apeluar duke vendosur një barrë jo të baraspeshuar në ngarkim të apeluesit, gjë që prishte balancën e drejtë që duhej ruajtur ndërmjet nevojës për të ekzekutuar vendimet gjyqësore dhe nevojës që të sigurohet mundësia për t'iu drejtuar Gjykatës së Kasacionit dhe që mbrojtja të jetë efektive.

5. Në vijim, Gjykata vuri në dukje se detyrimi për një të akuzuar që të dorëzohej në gjendje arresti nuk ishte në përputhje me prezumimin e pafajësisë dhe me efektin pezullues të kërkesave përpara Gjykatës së Kasacionit, të marra së bashku. Ajo theksoi, së fundmi, se mundësia për të apeluar për një përjashtim nga detyrimi për t'u dorëzuar në gjendje arresti nuk përjashtonte të drejtën për të apeluar një vendim gjyqësor. Kjo gjë pra përbënte një penalizim jo të baraspeshuar.

6. Për këto arsye Gjykata vendosi se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

### B. Në lidhje me nenin 41

7. Gjykata i akordoi kërkuesit 3000 euro për dëm jomaterial.

## III. Koment

8. Kjo çështje ka të bëjë me të drejtat gjatë një procesi gjyqësor të një të akuzuari i cili nuk dorëzohet për t'u gjykuar në gjendje arresti. Atij i është mohuar mundësia për të shprehur ankesat e tij për shkak se nuk është dorëzuar.



9. Në ndryshim nga çështja Karatas dhe Sari kundër Francës<sup>66</sup> e cila konsistonte në fakte tepër të ngjashme çështjen Goth Gjykata konstatoi për shkak se kërkesa që ai duhej të dorëzohej në gjendje arresti me qëllim që të ushtronte të drejtën e tij të apelimit nënkuptonte edhe njohjen e dënimit për të cilin ai donte të ankohej.

## TELFNER kundër AUSTRISË

(kërkesa nr. 33501/96)

20 mars 2001

*kalimi i barrës së provës një të akuzuari për të provuar pafajësinë përbën shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë*

### I. Faktet kryesore

1. Thomas Telfner, shtetas austriak, ishte dënuar për shkak se kishte plagosur një person gjatë një aksidenti automobilistik. Z. Telfner ankohej se, gjatë procedurave penale kundër tij, gjykatat nuk kishin respektuar prezumimin e pafajësisë së tij të garantuar nga neni 6 § 2 i Konventës.

### II. Vendimi i Gjykatës

2. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se edhe Gjykata e Rrethit edhe Gjykata Rajonale të cilat e shqyrtuan këtë çështje u bazuan vetëm në një raport sipas të cilit vetëm Z. Telfner ishte përdoruesi kryesor i automjetit dhe se ai nuk kishte qënë në shtëpi natën kur kishte ndodhur aksidenti. Megjithatë, viktimi e aksidentit nuk kishte qënë në gjendje që ta identifikonte drejtuesin e automjetit, apo qoftë edhe të thoshte nëse ai kishte qënë mashkull apo femër, dhe se Gjykata Rajonale kishte konstatuar se automjeti në fjalë ishte përdorur gjithashtu edhe nga motra e kërkuetit. Duke i kërkuar vetë kërkuetit që të ofronte një shpjegim, gjykatat e zhvendosën detyrimin për barrën e provës nga akuza drejt mbrojtjes. Gjykata e Rrethit ashtu edhe ajo Rajonale spekuloan gjithashtu në lidhje me faktin se kërkueti kishte qënë nën ndikimin e alkoolit, konstatim i cili nuk mbështetej në asnjë provë dhe që nuk dukej të kishte patur ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me akuzat për të cilat kërkueti ishte dënuar. Të gjitha këto kontribuuan në krijimin e përshtypjes që gjykatat kishin krijuar paraprakisht mendimin e tyre në lidhje me fajësinë e kërkuetit.

3. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi njëzëri se ka patur shkelje të nenit 6 § 2 të Konventës dhe i akordoi kërkuetit shumën prej 20 000 shilingash austriake për dëm jo-material.

<sup>66</sup> Vendim i së njëjtës datë, 16 maj 2002, i përfshirë në këtë përmbledhje në kuadrin e nenit 6 § 3 (c).

### III. Koment

4. Shumë shkelje të karakterit penal dhe aq më tepër ato të karakterit administrativ në raste të ngjashme, kërkojnë domosdoshmërisht kujdes në çështjen e identifikimit të personit të akuzuar për shkak se mund të jetë pronari i mjetit por mjaft shpesh edhe përdoruesi i tij ai që ka kryer shkeljen. Pasi të ketë qënë identifikuar saktësisht mjeti, në pjesën më të madhe të sistemeve juridike evropiane, pronari i mjetit akuzohet automatikisht (për shembull për tejkalim të limiteve të shpejtësisë ose shkelje të tjera të rregullave të qarkullimit), përveç rastit kur ai ia kalon përgjegjësinë për këtë shkelje një përdoruesi tjetër të automjetit. Kjo zgjidhje është konsideruar se nuk e shkel Konventën<sup>67</sup> për shkak se pronari i mjetit ka një përgjegjësi të plotë në lidhje me përdorimin e automjetit me të cilin është kryer shkelja. Sidoqoftë, në rastin konkret, Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 6 § 2. Kjo për shkak se nuk u pretendua në radhë të parë që automjeti ishte drejtuar nga pronarja e tij, që ishte e ëma e kërkuesit, e cila nga ana e saj kishte shfrytëzuar të drejtën e saj për të mos dëshmuar. Të njëjtën qëndrim kishte mbajtur e motra e kërkuesit e cila gjithashtu e përdorte automjetin. Kërkuesi pretendoi nga ana e tij se nuk ishte ai fajtor për këtë shkelje. Gjykata shfrytëzoi rastin që t'u kujtojë shteteve që prezumimi i pafajësisë shkelet në qoftë se barra e provës kalohet nga akuza tek mbrojtja, duke i kërkuar një të akuzuari që të japë shpjegime ndërkohë që akuza nuk e ka parashtruar akuzën e saj kundër tij qoftë edhe prima facie.

## VAUDELLE kundër FRANCËS

(kërkesa 35683/97)

30 janar 2001

*informimi i një personi mbi akuzën ndaj tij duhet të jetë efektiv dhe jo thjesht formal*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Marsel Vaudelle, është shtetas francez i lindur më 1934 në Tours. Kërkesa e tij kishte të bënte me procedimin penal i cili kishte filluar ndaj tij ndërkohë që ai kishte qënë nën kujdestarinë mbikqyrëse të të birit. Thirrja për t'u paraqitur në seancën gjyqësore ishte dërguar vetëm kërkuesit, i cili e mori këtë më 7 tetor 1995 në një letër të protokolluar.

2. Kërkuesi nuk u paraqit në seancën që zhvillohej në lidhje me gjykimin e tij. Duke qënë se u konsiderua se ai kishte qënë njoftuar siç duhej në përputhje me ligjin për seancën në fjalë, ai u gjykua në mungesë. Vendimi i gjykatës penale u mor më 19 tetor

<sup>67</sup> Shih kërkesën 2381/94 kundër Spanjës.

1995 dhe e dënoi atë me 12 muaj heqje lirie, tetë nga të cilat me kusht për një periudhë prove prej 18 muajsh, dhe me pagimin e një dëmshpërblimi për sulme të turpshme ndaj dy të miturve nën 15 vjeç. Ai nuk e apeloj këtë vendim i cili për pasojë mori formë të prerë dhe Vaudelle vuajti dënimin e tij nga 16 prilli deri më 19 korrik 1996.

## II. Vendimi i Gjykatës

3. Kërkuesi ankohej se thirrja dhe njoftimi në lidhje me seancën gjyqësore i ishte dërguar vetëm atij dhe jo edhe kujdestarit të tij, kështu që ai nuk kishte qënë në mundësi që të ushtronte të drejtën për t'u mbrojtur të garantuar nga neni 6 i Konventës. Kjo për arsye se ai nuk kishte aftësitë mendore për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes, veçanërisht të drejtën për të marrë pjesë në seancë dhe mbrojtur vetveten – siç rezulton edhe nga fakti që ka qënë e nevojshme që ai të vihej nën kujdestarinë mbikqyrëse të të birit.

### A. Në lidhje me nenin 6

4. Gjykata vlerëson se në rastin në fjalë, i cili kishte të bënte me një akuzë penale serioze dhe me një të rritur të vendosur nën kujdestari, autoritetet shtetërore kishin dështuar të siguronin që kërkuesi të kuptonte thelbin e procedurave, ta informonin atë në detaje dhe lidhje me natyrën dhe me shkakun e akuzës në përputhje me kuptimin e Nenit 6 § 3 (a), dhe të bënin të mundur që gjykata penale të gjykonte në mënyrë të drejtë në lidhje me çështjen. Gjykata për pasojë vlerëson se ka patur shkelje të Nenit 6.

### B. Në lidhje me nenin 41 të Konventës

5. Gjykata vendosi t'i akordojë kërkuesit 50000 franga franceze si kompensim për dëmet jopasurore të pretenduara.

## II. Koment

6. Në këtë rast Gjykata ka përsëritur detyrimin që kanë shtetet për të marrë masa pozitive për t'u siguruar personave më të dobët ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre të parashikuara nga Neni 6 në procedimet e brendshme penale. Gjykata ka vlerësuar në raste të mëparshme pozitën e të miturve në sistemin penal të të miturve sidomos në rastet T. kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe V. kundër Mbretërisë së Bashkuar ku ajo konstatoi se gjykimi i një dhjetëvjeçari dhe i një njëmbëdhjetëvjeçari në një gjykatë për të rritur i pengonte ata nga pjesmarrja efektive në mbrojtjen e tyre. Në Perks kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>68</sup>, një burrë me të meta mendore u dërgua në burg për gjashtë ditë për shkak se nuk kishte paguar një taksë lokale në procedura në lidhje me të cilat ai nuk kishte të drejtë për ndihmë ligjore. Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c). Personat e vetëm të dobët të mbrojtur specifikisht nga Konventa janë ata që nuk flasin gjuhën në të cilën zhvillohen procedurat gjyqësore. Ata kanë një të drejtë të shprehur dhe të pakufizuar për përkthim falas në bazë të nenit 6 § 3 (e).

<sup>68</sup> Vendim i datës 12 tetor 1999.

## LANZ kundër AUSTRISË

(kërkesa nr. 24430/94)

31 janar 2002

*në këtë çështje u konstatua se përgjimi i kontakteve të një personi të ndaluar me avokatin e tij ka shkelur të drejtat e tij për t'u mbrojtur*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Z. Bernhard Lanz, është një shtetas austriak. Më 25 tetor 1991 gjyqtari hetimor në Gjykatën e Rrethit të Gracit dha një urdhër për arrestimin e Z. Lanz mbi bazën e dyshimit se ky kishte qënë autor i një mashtrimi dhe kishte fallsifikuar dokumenta në lidhje me veprimtarinë e tij tregtare. Gjyqtari hetimor e mori në pyetje kërkuesin dhe urdhëroi paraburgimin e tij me qëllim që t'i hiqte mundësinë për t'u fshehur ose për të ndikuar mbi provat. Më 11 nëntor 1991 gjyqtari hetues urdhëroi që komunikimet e kërkuesit me avokatin e tij mbrojtës të bëheshin nën mbikqyrjen e gjykatës.

2. Më 21 qershor 1992 Gjykata e Rrethit të Gracit e dënoi kërkuesin për mashtrim në rrethana rënduese me katër vite e gjysëm burg. Ajo, nga ana tjetër e shpalli të pafajshëm atë në lidhje me një akuzë tjetër për mashtrim nga ana e Prokurorit Publik.

3. Kërkuesi e apeloj këtë vendim dhe bëri një kërkesë për pavlefshmëri absolute, por të dyja këto kërkesa u hodhën poshtë. Edhe Prokurori Publik nga ana e tij bëri një kërkesë për pavlefshmëri kundër pjesës së vendimit gjyqësor mbi pafajësinë e kërkuesit si dhe e apeloj këtë vendim. Më 30 gusht 1993 Gjykata e Apelit e Gracit e mori parasysh këtë apelim të fundit dhe e rriti masën e dënimit të kërkuesit deri në pesë vjet e gjysëm burg.

### II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesi pretendoi se e drejta e tij për t'u mbrojtur, e garantuar nga neni 6 i Konventës, ishte cenuar për shkak se kontaktet e tij me avokatin mbrojtës gjatë dy muajve të parë të paraburgimit ishin zhvilluar nën mbikqyrjen e gjyqtarit hetues. Ai ankohej gjithashtu se, gjatë procesit penal në ngarkim të tij, disa pretendime të formuluar me shkrim nuk i ishin paraqitur dhe se gjatë procedurave në lidhje me kërkesën e tij për t'u lënë i lirë, pala e akuzës kishte parashtruar pretendime të cilave ai nuk kishte patur mundësi t'u përgjigjej, gjë që sipas tij ishte në kundërshtim me Nenin 5 të Konventës.

**A. Në lidhje me nenin 6 § 3 (b) dhe (c)**

5. Gjykata vuri në dukje se mbikqyrja nga ana e një gjyqtari hetimor të kontakteve të një të paraburgosuri me avokatin e tij mbrojtës përbënte një ndërhyrje të rënd në të drejtat e të akuzuarit për t'u mbrojtur dhe arsye shume të forta do të duhej të jepeshin për të arritur në justifikimin e saj. Megjithatë gjykatat austriake ishin bazuar kryesisht në rrezikun e fshehjes së provave - e cila ishte edhe arsyeja për të cilën paraburgimi ishte urdhëruar prej tyre. Kufizimi i kontakteve me avokatin mbrojtës të një personi të paraburgosur ishte një masë më tej e cila kërkonte gjithashtu edhe argumenta shtesë. Duke konstatuar se gjykatat ose qeveria austriake nuk kishin ofruar argumenta bindës në këtë drejtim, Gjykata vendosi, me unanimitet, se ka patur shkelje të nenit 6 § 3 (b) dhe (c) të Konventës, pra të së drejtës për kohë dhe mundësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe të së drejtës për t'u mbrojtur vetë ose me anë të ndihmës ligjore të zgjedhur lirisht.

**B. Në lidhje me nenin 6 § 1**

6. Gjykata vendosi gjithashtu se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës (e drejta për gjykim të drejtë) gjatë procesit penal, në lidhje me parashtrimin e qëndrimeve të Prokurorit të Përgjithshëm para Gjykatës së Lartë pa u vënë në dijeni kërkuesi si dhe në lidhje me parashtrirat e Prokurorit publik përpara Gjykatës së Apelit.

**C. Në lidhje me nenin 5**

7. Duke vënë në dukje se, gjatë procedurave që kishin të bënin me kërkesën e kërkuesit për t'u lënë i lirë, nga ana e Prokurorit ishte paraqitur një koment me shkrim përpara gjykatës por që nuk i ishte dhënë kërkuesit, Gjykata vendosi me unanimitet se ka patur një shkelje të Nenit 5 § 4 të Konventës (e drejta për të patur një vendim gjyqësor sa më të shpejtë në lidhje me ligjshmërinë e heqjes së lirisë).

**D. Në lidhje me nenin 41**

8. Kërkuesit iu akorduan 3,000 euro për dëm jo-material dhe 493.96 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

**III. Koment**

9. E drejta e një individi për të komunikuar privatisht me avokatin e tij është konsideruar nga ana e Gjykatës si “një prej kërkesave bazë për një gjykim të drejtë në një shoqëri demokratike” dhe është një prej elementëve thelbësorë ndërlidhës të mbrojtjes së garantuar nga ana e Neneve 6 dhe 8. Më se dhjetë vjet më parë, në çështjen S. kundër Zvicrës, të 28 nëntorit 1991, Gjykata ka vendosur se “në qoftë se një avokat nuk është në gjendje të takohet me klientin e vet dhe t'i jap atij këshilla konfidenciale pa u mbikqyrur prej ndokujt, ndihma e tij do të humbiste shumë prej dobisë së saj, ndërkohë që Konventa synon të garantojë të drejta të cilat janë praktike dhe efektive”. Në S. kundër Zvicrës, shkelja konsistonte në faktin që autoritetet zvicerane kishin insistuar në mbikqyrjen e bisedave për shkak se i akuzuari kishte zgjedhur dhe ushtruar të drejtën e tij për të mos folur gjatë gjithë procesit. Është pranuar gjithashtu që e drejta për takime konfidenciale me një avokat

të zgjedhur vetë nuk mund të varet nga një autorizim paraprak nga ana e një gjyqtari apo prokurori. Çdo lloj urdhëri për të mbikqyrur vizita dhe takime të tilla do të kërkonte arsye tepër serioze dhe përjashtimore. Parimet Bazë të OKB-së mbi Rolin e Avokatëve (parimi 8) dhe Rregullat Minimum të Këshillit të Evropës për Trajtimin e të Burgosurve theksojnë se: “takimet ndërmjet të burgosurve dhe këshilltarëve të tyre ligjorë mund të jenë nën vështrim por jo nën dëgjimin qoftë të drejtpërdrejtë apo jo të një polici apo organi tjetër”. Në një rast më të hershëm, Can kundër Austrisë, të 25 shtatorit 1985, qeveria austriake ishte përpjekur të argumentonte se e drejta për takime konfidenciale me avokatët nuk gjente zbatim në fazat fillestare të hetimit. Por edhe ky argument u hodh poshtë nga ana e Gjykatës.

10. Në çështjen Lanz që po shqyrtojmë Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 § 3 (c) konstatoi se kjo kishte çuar edhe në një shkelje të nenit 6 § 3 (b). Shkelja e konfidencialitetit të takimeve ishte konsideruar në vetvete që në çështjen S. kundër Zvicrës si shkelje e Konventës pa patur nevojë të provohej që kishte patur gjithashtu pasoja të dëmshme edhe ndaj të drejtave të tjera të garantuara nga ana e Konventës. Gjykata ka konstatuar gjithashtu shkelje edhe në mjaft raste ku ishte hapur nga ana e autoriteteve të burgut korrespondenca ligjore ndërmjet një individi dhe avokatit të tij ose një gjykate<sup>69</sup>.

## ARTICO kundër ITALISË

(kërkesa nr. 6694/74)

13 maj 1980

*mungesa e një mbrojtje efektive nga ana e një avokati të caktuar kryesisht*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Ettore Artico është shtetas italian që ka lindur më 1917 dhe ushtron profesionin e ekspertit kontabël. Në janar 1965 gjyqtari i shkallës së parë të Veronës e dënoi me tetëmbëdhjetë muaj burg dhe me gjobë për mashtrim. Në tetor 1970 ai e dënoi me njëmbëdhjetë muaj burg dhe gjobë për mashtrim të përsëritur, fshehje identiteti dhe lëshim çeqesh të rreme. Pasi u ankua në apel pranë gjykatës së apelit të Veronës kërkuesi iu drejtua edhe Gjykatës Kushtetuese por edhe kjo e hodhi poshtë kërkesën e tij më 12 nëntor 1973.

2. Në gusht 1972 ai kishte përfituar nga ndihma ligjore falas për bërjen e ankesave në apel dhe kasacion por në shtator avokati i caktuar kryesisht, Z. Della Rocca, e informoi që angazhime të tjera nuk e lejonin të vazhdonte ta përfaqësonte dhe i

<sup>69</sup> Shih për shembull vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet Petra kundër Rumanisë, të 23 shtatorit 1998, dhe Peers kundër Greqisë të 19 prillit 2001, kjo e fundit e përfshirë në këtë botim.



rekomandoi emrin e një kolegu të tij. Kërkuesi bëri përpjekje të vazhdueshme pranë kryetarit të dhomës kompetente, të kryetarit të Gjykatës së Kasacionit dhe Prokurorit të Përgjithshëm të Gjykatës së Kasacionit që t'i caktohej një avokat tjetër. Ai pretendoi gjithashtu se i ishte shkelur e drejta e tij për t'u mbrojtur sepse në qoftë se në këtë fazë do kishte zgjedhur në avokat të vetin do të kishte humbur të gjitha përfitimet e deriatëhershme nga ndihma ligjore. Megjithatë nuk u gjet askush që të zëvendësonte avokatin e parë dhe as këtij nuk iu kërkua që të çonte deri në fund rolin e vet si mbrojtës i kërkuesit. Në 5 gusht 1975 Gjykata e Kasacionit anuloi pjesërisht vendimet e gjykatës së Veronës me argumentimin se kërkuesi përfitonte nga parashkrimi i disa prej veprave penale që kishte kryer. Ky ishte një argument që kërkuesi e kishte ngritur edhe përpara gjykatave më të ulëta. Pas pak kohësh kërkuesi lirohet pasi kishte bërë pa të drejtë një vit e 16 ditë burg.

3. Në kërkesën e tij të 26 prillit 1974 drejtuar Komisionit, kërkuesi pretendonte shkelje të nenit 5 § 1 për ndalim të parregullt dhe të nenit 6 § 3 (c) sepse nuk ishte përfaqësuar nga një avokat në procesin që u mbyll me vendimin e datës 12 nëntor 1973. Komisioni në raportin e tij të 8 marsit 1979 ndërsa konsideroi njëzëri të papranueshme kërkesën në lidhje me nenin 5 § 1 për mosshkrim të mjeteve të brendshme u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 6 § 3 (c).

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake

4. Qeveria italiane ngriti tre pretendime paraprake në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës në kuadrin e nenit 6 § 3 (c):

- së pari, një pretendim *ratione temporis* sepse deklarata italiane e njihte të drejtën e ankimit individual vetëm për fakte të ndodhura pas 31 korrikut 1973 dhe faktet në lidhje me të cilat bëhej ankimi kishin ndodhur pas kësaj date;
- së dyti, duke mos u ankuar në lidhje me sjelljen e avokatit të tij as në dhomën e avokatëve dhe as me anë të ndonjë padie civile ose të ndonjë ankimi për “mbrojtje të pabesë”, kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme të ankimit;
- së treti, shkelje të afatit gjashtë mujor sepse vendimi i Gjykatës së Kasacionit që kishte refuzuar caktimin e një avokati tjetër kryesisht datonte më larg se gjashtë muaj nga data e bërjes së kërkesës.

5. Duke iu referuar jurisprudencës së saj të mëparshme<sup>70</sup> si edhe parimit *estoppel* në të drejtën ndërkombëtare, Gjykata nuk i pranoi këto pretendime paraprake të qeverisë italiane me argumentimin se i dyti nuk ishte ngritur fare përpara Komisionit kurse dy të tjerët ishin ngritur para tij pas raportit mbi pranueshmërinë, pra përtej afatit të duhur.

<sup>70</sup> Vendimi i Gjykatës i 1971 në lidhje me çështjen *De Eilde, Ooms dhe Èersyp kundër Belgjikës*.

**B. Në lidhje me themelin**

6. Duke kaluar në shqyrtimin e themelit të çështjes Gjykata hodhi poshtë tezën e qeverisë italiane sipas së cilës thjesht caktimi i një avokati kryesisht i përgjigjej kërkesave të Konventës. Ajo ishte e mendimit se detyrimi që iu përket shteteve anëtare nuk mund të kufizohet thjesht tek caktimi i një avokati kryesisht sepse ky mund të vdesë, të sëmuret rëndë, të mos mund ta ofrojë përfaqësimin për një kohë të gjatë ose thjesht të heqë dorë prej tij. Në kushte të tilla shtetet duhet ta bëjnë plotësisht të mundshme të përmbushë funksionet e veta ose ta zëvendësojnë atë. Duke mos e bërë një gjë të tillë në rastin në fjalë kërkuuesi nuk kishte pasur një ndihmë ligjore adekuate përpara Gjykatës së Kasacionit.

7. Sipas nenit 6 § 3 (d) të Konventës ofrimi i ndihmës juridike falas bëhet i detyrueshëm vetëm kur e kërkojnë interesat e drejtësisë. Në lidhje me këtë pikë, në ndryshim nga qeveria italiane, Gjykata u shpreh se në rastin në fjalë interesat e drejtësisë e kërkonin një gjë të tillë sepse një avokat i kualifikuar do të kishte mundur që të paktën problemin e parashkruar ta kishte nxjerrë në pah dhe ta kishte argumentuar me një sukses të mundshëm. Nga ana tjetër Gjykata vlerësoi se për të pretenduar shkelje të nenit 6 § 3 (c) nga ana e kërkuetit ose për ta konstatuar këtë prej saj nuk është aspak e nevojshme që të provohet se mungesa e një avokati të caktuar kryesisht ka shkaktuar një dëm material. Pasi hodhi poshtë disa pretendime të qeverisë italiane në lidhje me qëndrimin e Z. Artico gjatë procesit në kasacion, Gjykata pranoi se shteteve nuk mund t'iu ngarkohej çdo mangësi e avokatëve të caktuar kryesisht. Megjithatë, vlerësoi ajo, në rastin në fjalë detyrimet pozitive në bazë të Konventës kërkonin që autoritetet italiane ta kishin zëvendësuar avokatin ose t'i kishin kërkuar atij të çonte deri në fund rolin e tij në lidhje me çështjen konkrete. Në këto kushte Gjykata arriti njëzëri në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 6 § 3 (c).

**C. Në lidhje me ish nenin 50 (aktualisht neni 41)**

8. Z. Artico pretendoi dëmshpërblim në lidhje me honorarët e avokatit që e kishte përfaqësuar përpara Komisionit dhe Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Duke pasur parasysh se Z. Artico kishte marrë ndihmë ligjore përpara organeve të Strasburgut dhe se nuk kishte bërë asnjë shpenzim shtesë, Gjykata nuk i akordoi asnjë shpërblim të drejtë kërkuetit në lidhje me këtë pretendim.

9. Përsa i përket shpërblimit të drejtë në lidhje me mbajtjen pa të drejtë në burg për një periudhë më të gjatë, Gjykata pranoi se kjo situatë ishte shkaktuar, qoftë edhe në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga mungesa e një përfaqësimi efektiv me avokat. Pasi njohu faktin se në këto kushte kërkuetit i ishte shkaktuar një dëm moral, Gjykata pranoi se kërkuetsi kishte pësuar dëm moral edhe për shkak të ndjenjës së lënies pas dore dhe braktisjes nga avokati i tij dhe nga institucionet italiane. Prandaj ajo me unanimitet vendosi t'i akordonte kërkuetit të drejtën për një shpërblim prej 3 000 000 liretash.

**III. Koment**

10. Ky vendim përbën një moment të qartë të tendencës së Gjykatës për një interpretim të Konventës në përputhje me qëllimin dhe funksionin e saj real – mbrojtjen efektive

të të drejtave të njeriut. Megjithëse Gjykata tregon kujdes në evidentimin e faktit se neni 6 § 3 (c) bën fjalë për 'ndihmën' dhe jo thjesht për 'caktimin' e një avokati në favor të personave të akuzuar, interpretimi teleologjik që orientohet drejt mbrojtjes dhe ndihmës 'efektive' që duhet të ofrojë një avokat ndaj klientit të vet duket se përbën thelbin e këtij vendimi të Gjykatës së Strasburgut. Në mbajtjen e këtij qëndrimi duket se rëndësi themelore ka pasur edhe vlerësimi i fakteve specifike të çështjes. Në sytë e Gjykatës ishte e qartë se një rol efektiv i Avokatit Della Rocca, do të kishte qenë qartë në interes të drejtësisë pasi një avokat me një eksperiencë do të kishte pasur mundësi reale që jo vetëm të pretendonte në emër të Z. Artico parashkrimin e veprës penale për të cilën akuzohej por edhe të kundërshtonte pretendimet e prokurorit duke kërkuar gjykimin në themel të çështjes në Kasacion.

11. Është e qartë pra se Gjykata shkon më tej sesa qëndrimet e saj në çështjet Airey kundër Irlandës<sup>71</sup>, Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>72</sup> dhe Quaranta kundër Zvicrës<sup>73</sup> duke kërkuar në mënyrë të qartë se detyrimi i qeverisë së shteteve anëtare të Konventës nuk kufizohet në parashikimin e legjislacionit për ofrimin e ndihmës ligjore, edhe për çështjet civile dhe disiplinore dhe madje edhe në fazën përpara procesit gjyqësor. Ky detyrim kërkon që shtetet të sigurojnë një "mbrojtje efektive" nga ana e avokatëve të caktuar kryesisht.

## GUTFREUND kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 45681/99)

12 qershor 2003

*e drejta për ndihmë ligjore*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Allan Gutfreund, është shtetas Francez që ka lindur më 1963 dhe jeton në Francë. Ai u akuzua sepse kishte ushtruar dhunë fizike ndaj të shoqes. Në proces Z. Gutfreund kërkoi që të kishte ndihmë ligjore për tu mbrojtur por kërkesa e tij u refuzua.
2. Ai ankohej në bazë të nenit 6 § 1 për njëanshmëri të gjyqtarit që vendosi rrëzimin e kërkesës së tij për ndihmë ligjore.

### II. Vendimi i Gjykatës

3. Gjykata vuri re se kërkesa e Z. Gutfreund ishte kufizuar në kërkimin e ndihmës ligjore. Kjo procedurë dukej se nuk kishte patur të bënte me përcaktimin e akuzës

<sup>71</sup> Vendim i Gjykatës i 9 tetorit 1979.

<sup>72</sup> Vendim i Gjykatës i 28 qershorit 1984, i përfshirë në këtë botim.

<sup>73</sup> Vendim i Gjykatës i 24 majit 1991.

penale në ngarkim të tij ose të të drejtave dhe detyrimeve të tij me karakter civil, në kuptimin e nenit 6 § 1. Për këtë arsye Gjykata vendosi se kjo dispozitë e Konventës nuk gjente zbatim në këtë rast.

### III. Koment

4. Në radhë të parë Gjykata vuri re se kërkuesi në këtë çështje nuk kishte patur të drejtë për ndihmë ligjore në bazë të nenit 6 § 3 (c) të Konventës edhe në qoftë se nuk kishte mjete për ta siguruar vetë atë. Gjykata ka vendosur gjithmonë se në rastet kur një akuzë penale parashikon mundësinë e paraburgimit, qoftë edhe të shkurtër, interesat e drejtësisë kërkojnë gjithmonë që të sigurohet përfaqësimi ligjor ndaj atyre që nuk mund t'i lejojnë vetes të kenë një avokat<sup>74</sup>. Edhe në rastet kur nuk mund të jepet një masë sigurie me burg, serioziteti i çështjes mund të kërkojë që i akuzuari të përfitojë ndihmë ligjore falas. Megjithatë, dënimi maksimal për kundravajtjen për të cilën kërkuesi akuzohej dhe mund të dënohej ishte një gjobë prej 5000 frangash franceze (rreth 750 euro) dhe se nuk mund të dënohej me burg. Gjykata konstatoi gjithashtu se refuzimi i ndihmës ligjore nuk e cënoi rezultatit e procesit penal dhe nuk ndikoi aspak në akuzën konkrete që i ishte bërë kërkuesit. Kjo situatë është e ndryshme nga ajo kur i njëjti gjyqtar vendos edhe për masën e sigurisë edhe për themelin e çështjes<sup>75</sup>.

5. Në vijim Gjykata vlerësoi nëse procedurat mbi ndihmën ligjore në vetvete bënin që të gjente zbatim Neni 6, dhe arriti në përfundimin që ky nen nuk gjente zbatim. Ato nuk kishin të bënin as me përcaktimin e një përgjegjësie penale dhe as me të drejtat apo detyrimet me karakter civil të kërkuesit – dy llojet e vetme të procedurave administrative apo gjyqësore që rregullohen nga neni 6. Sidoqoftë, Gjykata shtoi se në rast se mohimi i së drejtës për të patur ndihmë ligjore mund të çojë në mohim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatave atëhere neni 6 § 1 hyn në veprim dhe kjo mund të angazhojë përgjegjësinë juridiko-ndërkombëtare të shtetit. Edhe më interesante është të përmendet se, anga ana tjetër ajo nuk e pa të nevojshme që të sugjeronte që në këto raste ose në raste që kanë të bëjnë me nenin 6 § 3 (c), procedurat dhe kërkesat për ndihmë ligjore duhet të jenë në vetvete në përputhje me nenin 6 të Konventës.

<sup>74</sup> Shih për shembull vendimet e Gjykatës së Strasburgut të 24 majit 1991 në lidhje me çështjen Quaranta kundër Zvicrës, dhe të 12 tetorit 1999 në lidhje me çështjen Perks kundër Mbretërisë së Bashkuar.

<sup>75</sup> Shih vendimin e Gjykatës të 24 majit 1989 në lidhje me çështjen Huaschildt kundër Danimarkës.

## EZEH DHE CONNORS kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesat nr. 39665/98 dhe 40086/98)

9 tetor 2003

### Dhomë e Madhe

*kjo çështje kishte të bënte me të drejtat e të burgosurve të akuzuar me shkelje disiplinore në burg*

#### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, të dy shtetas britanikë, quhen Okechukwiw Ezeh lindur më 1967, dhe Lawrence Connors, lindur më 1954. Të dy vuajnë dënimin me burg në Mbretërinë e Bashkuar.
2. Gjatë vuajtjes së dënimeve të tyre afatgjata me burg, kërkuesit u akuzuan për shkelje të disiplinës në burg në bazë të rregullores së burgjeve. Z. Ezeh u akuzua sepse kishte përdorur gjuhë kërcënuese ndërsa Z. Connors sepse kishte sulmuar një oficer. Nga ana e qeverisë britanike u pretendua se secila prej këtyre akteve ndiqej penalisht edhe në bazë të legjislacionit penal britanik. Pretendimi i kërkuesve që tu lejohej të kishin përfaqësim ligjor për gjykimin e tyre respektiv u hodh poshtë nga Drejtori i burgut.
3. Të dy kërkuesit u konsideruan fajtorë në një seancë të drejtuar nga Drejtori i burgut. Asnjëri prej kërkuesve nuk u përfaqësua me avokat në këtë seancë. Dënimi maksimal i parashikuar ishte 42 ditë shtesë burg dhe Z. Ezeh u dënua me 40 ditë shtesë ndërsa Z. Connors me 7 ditë. Në vijim atyre iu refuzua mundësia për rishikim gjyqësor të këtij dënimi.

#### II. Vendimi i Gjykatës

4. Në vendimin e Dhomës të 15 korrikut 2002 në lidhje me këtë çështje, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 3 (c) ndaj të dy kërkuesve. Gjykata në vijim vendosi se konstatimi i shkeljes përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë për çdo dëm jopasuror të pësuar nga kërkuesit. Ajo iu akordoi atyre 17 124 sterlina për shpenzime dhe pagesa duke hequr nga kjo shumë 2 287.50 euro të paguara si ndihmë ligjore.
5. Duke pasur parasysh natyrën e akuzave ndaj kërkuesve dhe natyrën dhe ashpërsinë e dënimeve me të cilat ata mund dhe u dënuan në fakt, Gjykata konstatoi se të dy këto raste përbënin akuza penale në kuptimin e nenit 6 § 1 të Konventës. Për këtë arsye ajo vendosi se Neni 6 gjente zbatim edhe ndaj procedurave të zhvilluara përpara drejtorit të burgut.

6. Gjykata kujtoi se Konventa kërkonte që një person i akuzuar me një vepër penale i cili nuk dëshironte të mbrohej vetë duhet të kishte mundësinë t'i drejtohej ndihmës ligjore që ai zgjidhte vetë. Nga ana e agentit britanik nuk u kundërshtua fakti që të dy kërkuesit kishin pretenduar të kishin ndihmë ligjore në seancën përpara drejtorit të burgut, gjë të cilën ky i fundit e refuzoi duke e konsideruar të panevojshme. Gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Lartë<sup>76</sup> kishte konfirmuar gjithashtu se kërkuesit nuk kishin të drejtë për tu përfaqësuar me avokat dhe se refuzimi i drejtorit për këtë ndihmë nuk ishte i paarsyeshëm. Në këto rrethana, Gjykata vlerësoi se kërkuesve iu ishte mohuar e drejta për tu përfaqësuar me avokat në procedurat përpara drejtorit të burgut dhe vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 3 (c). Gjykata nuk e pa të nevojshme që të merrte në shqyrtim ankimin alternativ të kërkuesve që atyre u ishte mohuar ndihma ligjore pa pagesë për procedurat e lartpërmendura përpara drejtorit të burgut.

7. Më 8 tetor 2002 qeveria e Mbretërisë së Bashkuar kërkoi që çështja t'i kalohej Dhomës së Madhe në bazë të Nenit 43 të Konventës dhe më 6 nëntor 2002 paneli i Dhomës së Madhe e pranoi këtë kërkesë dhe seanca përkatëse përpara Dhomës së Madhe u mbajt më 5 mars 2003.

8. Thelbi i ankesës ishte përsëri pretendimi i kërkuesve për shkelje të nenit 6 të Konventës për shkak se ata nuk kishin pasur mundësi të mbroheshin me avokat dhe, si pretendim alternativ, nuk iu ishte ofruar ndihmë ligjore falas në procedurat përpara drejtorit të burgut.

#### *A. Në lidhje me nenin 6 § 3 (c)*

9. Duke vlerësuar nëse çështja kishte të bënte me vepra penale në kuptimin e Nenit 6 të Konventës, Gjykata rikujtoi se fakti që një akt konsiderohej si penal ose disiplinor në bazë të së drejtës së brendshme është vetëm pika e nisjes. Një rëndësi thelbësore ka natyra e shkeljes dhe parasysh duhet mbajtur gjithashtu shkalla e ashpërsisë së dënimit që mund të jepet. Për më tepër, çështja duhej vlerësuar duke pasur parasysh kushtet e burgut si dhe arsyet e vërteta që qëndrojnë pas krijimit të një regjimi të posaçëm disiplinor në burg.

10. Duke mbajtur parasysh kushtet e burgut, Gjykata nuk e pranoi argumentin e qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar sipas së cilës zhveshja e drejtorëve të burgut nga kompetenca për të dënuar të burgosurit me ditë burgu shtesë, do të çonte në rrezikimin e disiplinës në burg. Kjo për më tepër kur nuk ishte shpjeguar përse tërësia e dënimeve të tjera të mundshme – të cilat që prej asaj kohe ishin shtuar në numër – nuk do të kishte pasur një efekt të krahasueshëm për ruajtjen e sistemit të disiplinës në burg. Nga ana tjetër, nuk u vërtetua që nevojat për disiplinë në burgje në Skoci, ku dënimi me ditë burg shtesë ishte pezulluar, të ishin tepër të ndryshme nga ato në Angli dhe Uells.

<sup>76</sup> Në sistemin anglez përfaqëson juridiksionin e apelit



11. Duke mbajtur parasysh natyrën e shkeljeve, Gjykata vuri në dukje se ato kishin të bënin me të burgosurit dhe jo me të gjithë qytetarët. Megjithatë këto dënime me karakter disiplinor i korrespondojnë edhe veprave penale sipas së drejtës britanike. Mundësia teorike për një përgjegjësi konkurruese penale dhe disiplinore ishte në fakt një moment thelbësor që bënte që të dy veprat në fjalë të konsideroheshin si vepra “miks”. Për më tepër, dënimi me ditë burg shtesë bëhej pas konstatimit të fajësisë për ndëshkimin e kërkuesve për shkeljet e tyre dhe për parandalimin e veprave të mëtejshme prej tyre ose prej të tjerëve. Këta faktorë iu jepnin veprave një ngjyrim që nuk korrespondonte tërësisht me atë të veprave thjesht disiplinore.

12. Gjykata pranoi se dënimet e parashikuara kishin bazë ligjore. Shtyrja e datës së lirimit të kërkuesve deri me vuajtjen edhe të ditëve shtesë nuk bënte që kërkuesit të vuanin dënim me burg më të gjatë sesa dënimi i tyre fillestar. Përderisa baza e dënitimit të tyre edhe me këto ditë burg shtesë ngeleshin dënimet e tyre fillestare, dënimi shtesë i tyre konsiderohej i ligjshëm në bazë të së drejtës së brendshme angleze.

13. Megjithatë, realiteti i dënitimit me ditë të tjera burg të kërkuesve bënte që të burgosurit të mbaheshin në burg përtej datës në të cilën ata, në mungesë të këtij dënimi, të liroheshin. Dhe kjo shtyrje e lirimit të tyre vinte si pasojë e proceseve të veçanta disiplinore të cilat juridikisht nuk kishin të bënin me dënimin fillestar të tyre. Për këtë arsye Gjykata vlerësoi se dënimi me ditë burg shtesë nga ana e drejtorit të burgut përbënte privim të ri të lirisë së personit për arsye ndëshkimore pas konstatimit të fajësisë.

14. Duke pasur parasysh privimin e lirisë në çështjen konkrete, sipas vlerësimit të Gjykatës bëhej fjalë për akuza me karakter penal. Duke pasur parasysh nga ana tjetër se afati maksimal i dënitimit ishte 42 ditë burg, dënimet prej 40 ditësh dhe 7 ditësh nuk mund të vlerësoheshin si tepër të parëndësishme ose të pamjaftueshme për t'i dhënë ngjyrim penal natyrës së akuzave. Për këto arsye Gjykata ishte e mendimit se akuzat ishin me karakter penal dhe Neni 6 gjente zbatim.

15. Dhoma e Madhe e pranoi arsyetimin e Dhomës sipas të cilit refuzimi i drejtorit për t'i lejuar kërkuesve që të përfaqësoheshin me avokat përbënte shkelje të nenit 6 § 3 (c). Në këto kushte ishte e panevojshme që të merrej në shqyrtim ankesa alternative në lidhje me ofrimin e ndihmës juridike falas.

#### ***B. Në lidhje me nenin 41***

16. Gjykata vendosi se konstatimi i shkeljes përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë për dëmet jopasurore të pësuar nga kërkuesit. Ajo i akordoi kërkuesve 44 000 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore, duke i hequr kësaj shume 4 294.79 euro të paguar si ndihmë ligjore nga ana e Këshillit të Evropës.

### III. Koment

17. Ky vendim nxjerr në pah parimin e rëndësishëm që edhe të burgosurit vazhdojnë të gëzojnë të gjitha të drejtat e garantuara nga Konventa kur ata vuajnë dënimin e tyre. Çdo ndërhyrje ndaj këtyre të drejtave duhet të ketë të bëjë me privimin e lirisë të të dënuarve dhe të jetë absolutisht e nevojshme për ruajtjen e sigurisë dhe të rendit në qendrën e vuajtjes së dënimit. Vendime të tjera që kanë pasur të bëjnë me këtë problem, pra të drejtat e të burgosurve dhe të përfshira në këtë botim janë ato në lidhje me çështjet Engel dhe të tjerë kundër Holandës<sup>77</sup>, Ploski kundër Polonisë, Mousiel kundër Francës dhe Van der Ven dhe Lorse kundër Holandës<sup>78</sup>. Vendimi i Dhomës së Madhe në lidhje me çështjen Stafford kundër Mbretërisë së Bashkuar në maj të vitit 2002 e bëri të qartë që sapo një person të ketë mundësi të lirohet me kusht në bazë të ligjit të brendshëm, çdo vendim për ta mbajtur atë në burg apo për ta lëshuar duhet marrë nga një institucion i pavarur që plotëson kërkesat e nenit 5 § 4.

18. Të gjitha sistemet e burgjeve parashikojnë sanksione për shkeljen e disiplinës në burg. Në shumë shtete evropiane shkeljet e disiplinës në burg mund të çojnë në ditë burg shtesë për një të burgosur. Në qoftë se pasoja e ndëshkimeve të tilla do të ishte zgjatja e dënimit me burg atëherë në lidhje me procedurat që e parashikojnë këtë ndëshkim natyrisht që do të gjenin zbatim garancitë e parashikuara në nenin 6. Vendimi i Dhomës së Madhe në lidhje me çështjen Ezech dhe Connors e bëjnë të qartë që garancitë e nenit 6 gjejnë zbatim në qoftë se procedurat me karakter disiplinor në burg përfshihen në konceptin autonom të Konventës të një “akuze penale” edhe pse ato nuk janë konsideruar si akuza penale në të drejtën e brendshme. Dhoma e Madhe vlerësoi se këto procedura si dhe ditët shtesë burg që duhet të kryenin kërkuesit ishin “juridiksht të pavarura nga akuza dhe dënimi i tyre fillestar” dhe dënimet e reja që iu dhanë atyre ishin të barazvlefshme me 11 (kërkuesi i parë) dhe 2 (kërkuesi i dytë) javë burg të vendosura nga një gjykatë për kryerjen e një vepre penale. Për këtë arsye Gjykata ishte e mendimit se neni 6 gjente zbatim dhe se kërkuesve duhej t’ju ishte lejuar përfaqësimi ligjor në seancat disiplinore përpara drejtorit të burgut.

<sup>77</sup> Vendim i përfshirë në këtë përmbledhje.

<sup>78</sup> Ibid.

## BRENNAN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 39846/98)

16 tetor 2001

*kjo çështje ka të bëjë me praninë e një oficeri policie gjatë takimit të parë të kërkuesit me avokatin e tij, gjë që sipas Gjykatës, kishte shkelur të drejtat e kërkuesit në bazë të nenit 6 të Konventës.*

### I. Faktet kryesore

1. Thomas Brennan, shtetas Irlandez, u arrestua më 21 tetor 1990 në bazë të ligjit të vitit 1984, në lidhje me vrasjen e një anëtari të Regjimentit të Mbrojtjes së Ulsterit. Ai ishte mbajtur në gjendje ndalimi nga 21 deri më 25 tetor dhe u takua për herë të parë me avokatin e tij 24 orë pas arrestit, takim gjatë të cilit ishte i pranishëm edhe një oficer policie. Si përfundim kërkuesi u gjet fajtor për vrasje.

### II. Vendimi i Gjykatës

2. Z. Brennan ankohej në lidhje me rrethanat në të cilat ai u mor në pyetje nga ana e policisë pas arrestimit të tij duke pretenduar, ndërmjet të tjerash, që atij i ishte mohuar e drejta për t'u këshilluar me avokatin e tij gjatë fazës fillestare të ndalimit në polici, se ai kishte bërë pohime përpara se të kishte ndihmë juridike, që nuk i ishte lejuar të kishte edhe avokatin e tij të pranishëm gjatë pyetjeve të policisë ose në një ambient më vete, dhe se, për pasojë, i ishte privuar e drejta për një gjykim të drejtë për shkak se për dënimin e tij ishin marrë për bazë pohimet që ai kishte bërë pa praninë e avokatit. Ai bazohej në nenin 6 §§ 1 dhe 3 (c).

#### A. Në lidhje me nenin 6

3. Gjykata vuri në dukje se kërkuesit i ishte mohuar takimi me avokatin e tij për 24 orë. Megjithatë Gjykata konstatoi se fakti që avokati nuk arriti ta shihte klientin e tij deri një ditë më vonë nuk mund t'i ngarkohej ndonjë masë të vendosur nga ana e autoriteteve. Për më tepër, ndërsa kërkuesi u intervistua nga ana e policisë gjatë kësaj periudhe të parë prej 24 orësh, ai nuk kishte bërë pohime që e ngarkonin me përgjegjësi penale. Pohimet e para të bëra prej tij ishin ato gjatë seancës së pyetjeve të pasdites së 22 tetorit 1990, kur ai ishte takuar me avokatin e tij. Për këtë arsye Gjykata nuk konstatoi në këtë drejtim, shkelje të të drejtave të kërkuesit në bazë të nenit 6 § 1 ose të nenit 6 § 3 (c).

4. Gjykata vuri në dukje se rrethanat në të cilat pohimi ishte marrë si provë i kishin qënë nënshtruar një kontrolli të rreptë gjyqësor. Kërkuesi kishte qënë përfaqësuar edhe në procesin në shkallë të parë edhe në procesin në apel nga avokatë me eksperiencë. Gjyqtarët e seancave i kishin dëgjuar personalisht edhe kërkuesin

edhe policët që e kishin marrë atë në pyetje. Gjyqtari i seancës në shkallë të parë u bind në lidhje me besueshmërinë dhe ndershmërinë e mënyrës së marrjes së provave. Ky pozicion u konfirmua edhe në apel. Gjykata vlerësoi se procedura me palë kundërshtare e mbajtur përpara procesit në të cilin u dëgjuan provat nga ana e kërkuarit, ekspertëve psikologë, nga oficerët e ndryshëm të policisë që kishin marrë pjesë në seancat e pyetjeve si dhe nga mjekët e policisë që e kishin vizituar kërkuarin gjatë ndalimit, ishte në gjendje të nxirrte në dritë ndonjë sjellje imponuese nga ana e policisë. Për këtë arsye Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka patur shkelje të nenit 6 § 1 ose të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me pyetjet nga ana e policisë.

5. Gjykata, nga ana tjetër, arriti në përfundimin se prania e oficerit të policisë në parim padyshim që e kishte penguar kërkuarin për të folur në mënyrë të hapur me avokatin e tij dhe mund të kishte qënë arsye që ta bënte atë të hezitonte për t'i drejtuar avokatit pyetje që mund të kishin rëndësi në lidhje me procesin kundër tij. Edhe kërkuari edhe avokati i tij ishin paralajmëruar që nuk duheshin përmendur emra dhe se takimi do të ndërpritej nëse do të thuhej diçka që do të vlerësohej sikur pengonte hetimin. Nuk pati rëndësi pra që nuk arriti të tregojë se kishte patur çështje të veçanta për të cilat kërkuari dhe avokati i tij ishin detyruar të ndërprisnin diskutimin. Mundësia e një të akuzuari për të komunikuar lirisht me avokatin e tij mbrojtës i ishte nënshtruar pra një kufizimi të qartë. Kërkuari kishte bërë pohime përpara këshillimit me të dhe bëri edhe pas këtij. Ishte e padiskutueshme që ai kishte patur nevojë për këshilla ligjore në këtë kohë dhe se përgjigjet e tij në seancat e mëvonshme të pyetjeve pa praninë e avokatit të tij, kishin vazhduar që të kishin rëndësi për procesin kundër tij dhe padyshim që kishin çenuar mbrojtjen e tij. Për këto arsye Gjykata konstatoi se prania e oficerit të policisë në një distancë dëgjimi, gjatë takimit të parë të këtij me avokatin e tij shkelte të drejtën e tij për një ushtrim efektiv të të drejtës së mbrojtjes, dhe pra ka patur në këtë drejtim, shkelje të nenit 6 § 3 (c) të interpretuar bashkë me nenin 6 § 1.

### ***B. Në lidhje me nenin 41***

6. Në bazë të nenit 41 të Konventës, Gjykata vendosi se këto konstatime përbënin në vetvete një shpërbim të drejtë të mjaftueshëm për dëmin jo-material të pësuar nga ana e kërkuarit dhe i akorduan Z. Brennan 6 920 sterlina për shpenzime dhe pagesa ligjore.

## **III. Koment**

7. Kjo çështje është e rëndësishme në ripohimin e vendimeve të mëparshme të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut sipas të cilave mbrojtja e të drejtave dhe garancive të parashikuara nga ana e nenit 6 § 3 shtrihet edhe në situatat e paraburgimit<sup>79</sup>. Testi që përdor Gjykata e Strasburgut është nëse procedimet në fazën e paragjyqimit, të tilla si marrjet në pyetje nga ana e policisë, kanë patur apo jo ndonjë pasojë ndaj karakterit të drejtë dhe të barabartë të procesit gjyqësor. Në këtë çështje të veçantë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut preferoi që ta vlerësonte zbatimin e të drejtave të parashikuara nga ana e nenit 6 § 3 që nga momenti kur kërkuari ishte arrestuar.

<sup>79</sup> Shih vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 24 nëntorit 1993 në lidhje me çështjen *Imbrioscia kundër Zvicrës* dhe të 8 shkurtit 1996 në lidhje me çështjen *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

8. Konstatimi i shkeljes të nenit 6 § 3 të marrë së bashku me nenin 6 § 1 për shkak të mohimit të mundësisë të kërkuesit për t'u takuar me avokatin e tij pa praninë e policisë ka një rëndësi themelore. Autoritetet e policisë kanë provuar që ta justifikojnë praninë e oficerit të policisë për shkak të natyrës së ndjeshme të akuzave ndaj kërkuesit dhe të mundësisë së kalimit të të dhënave ndaj personave të tjerë të dyshuar. Por duhet thënë që forcat e policisë dhe të sigurimit kanë një detyrë të vështirë kur përballen me terrorizmin dhe me krime të tjera që kanë të bëjnë me sigurimin kombëtar. Atyre mund t'u duhet të përballen me organizma që janë tepër të sofistikuara dhe anëtarët e të cilëve janë trajnuar në mënyrë që të mos bëjnë pohime por edhe që kur arrestohen, të arrijnë të paralajmërojnë anëtarët e tjerë të organizatës. Marrja e informacionit dhe e provave që mund të çojnë në një dënim të të akuzuarve janë tepër të vështira dhe për këtë arsye do të ketë normalisht përpjekje nga ana e policisë dhe e forcave të sigurimit për të marrë çdo hap që e mendojnë të arsyeshëm për të marrë informata.

9. Megjithatë, duhet thënë se është pikërisht në këto situata që merr rëndësi të veçantë respektimi i standarteve dhe të drejtave minimale të parashikuara në nenin 6 § 3 me qëllim që të sigurohet që integriteti i sistemit, respektimi i shtetit ligjor dhe besimi në forcat e policisë të mos vihen në dyshim sa herë që një i dyshuar terrorist të arrestohet. Rregullat Minimale për Trajtimin e të Burgosurve të përpunuara në gjirin e Këshillit të Evropës parashikojnë udhëzime shumë të vlefshme për spjegimin e këtyre të drejtave dhe standarteve. Mundësia për të folur veçmas me një avokat dhe për të marrë këshilla konfidenciale përbën pa dyshim një element thelbësor të mbrojtjes për të qënë kjo në gjendje të ketë një ndihmë të përshtatshme ligjore, element që bëhet edhe më i rëndësishëm kur një person akuzohet për një krim shumë serioz.

## KARATAS DHE SARI kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 38396/97)

16 maj 2002

*ky vendim ka të bëjë me të drejtat e një personi të akuzuar gjatë një procesi gjyqësor kur ky person nuk dorëzohet për tu gjykuar në gjendje arresti*

### I. Faktet kryesore

1. Dursun Karatas dhe Zerrin Sari janë shtetas turq. Z. Karatas ishte dënuar në Turqi me më shumë se dhjetë vjet burg për aktivitetet e tij si udhëheqësi i një lëvizjeje të njohur si Devrimci Sol ose e majta revolucionare. Shërbimet Sekrete Turke kishin përgatitur disa raporte mbi këtë lëvizje, e cila kishte kryer akte dhune në Turqi dhe jashtë saj. Raportet vinin gjithashtu në dukje karakterin e paligjshëm të themelimit të kësaj lëvizjeje. Z. Karatas ishte arratisur nga burgu i Stambollit më 1989. Z. Sari, i njohur për aktivizimin e tij politik ishte avokat pranë Dhomës së Avokatisë së Stambollit.

2. Ata u arrestuan në Francë më 1994 pasi kishin pasaporta të falsifikuara dhe nën shoqëruarinë e një terroristi të kërkuar nga autoritetet turke. Pasi u akuzuan për përgatitje në bashkëpunim të një vepre terroriste, mbajtje të sendeve të vjedhura, falsifikim të dokumenteve zyrtare dhe hyrje të paligjshme në Francë, ata u vunë në gjendje paraburgimi dhe në vijim u lëshuan duke u hetuar të lirë në bazë të një garancie pasurore. Menjëherë pas këtij lirimi ata u larguan duke iu fshehur organeve hetimore dhe nga ana e gjyqtarit hetues u lëshua një urdhër ndërkombëtar arresti.

3. Në këto kushte Gjykata Penale e Parisit procedoi me regjistrimin e fshehjes së tyre dhe vijoi me gjykimin in absentia<sup>80</sup>. Avokati i kërkuesve, i cili merrte pjesë në proces edhe si përfaqësues i të akuzuarve të tjerë, deklaroi se kërkesa e tij për të bërë parashtresa në emër të kërkuesve nuk ishte pranuar. Gjykata Penale e Parisit i dënoi kërkuesit respektivisht me katër dhe dy vjet burg dhe lëshoi një urdhër arresti kundër tyre.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Duke u bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kërkuesit ankoheshin për pamundësinë e tyre për t'u ankuar kundër dënimit të tyre në qoftë se nuk dorëzoheshin më parë pranë organeve gjyqësore. Ata ankoheshin gjithashtu, në bazë të Nenit 6 § 3 (c), për shkelje të së drejtës së tyre për një gjykim të drejtë me argumentimin se avokatit të tyre nuk i ishte dhënë mundësia të bënte parashtresa në emër të tyre.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

5. Gjykata vuri në dukje se kërkuesit ishin lënë të lirë në bazë të një sërë kushteve të cilët ata nuk i kishin përmbushur dhe për pasojë ishin lëshuar edhe urdhra arresti ndaj tyre. Ajo konstatoi se si pasojë e kësaj kërkuesit e kishin privuar veten nga mundësia për tu mbrojtur vetë përpara gjykatës që po vendoste në lidhje me çështjen e tyre pa u dorëzuar paraprakisht dhe se, edhe përpara se të fillonte procesi gjyqësor kundër tyre ata ishin nën një detyrim për t'u dorëzuar në bazë të një urdhri për arrest të lëshuar nga gjyqtari hetues i çështjes. Rezultonte pra që detyrimi për t'u dorëzuar në gjendje ndalimi me qëllim që të mund të ngrinin pretendimet e tyre përpara gjykatës, për të cilin edhe ankoheshin, rezultonte nga detyrimi paraekzistues të cilin ata nuk e kishin respektuar, konkretisht ai që kërkuesit të rrinin në dispozicion të gjykatave me qëllim që të mund të ngrinin pretendimet që kishin para tyre.

6. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se në qoftë se një kërkesë ishte bërë me qëllimin që të prishte një vendim të gjykatave të brendshme atëherë kjo kërkesë nuk duhej pranuar. Duke pasur parasysh rrethanat e posaçme të çështjes si dhe ecurinë e procedurave të brendshme, Gjykata shprehu qëndrimin se detyrimi i parashikuar për kërkuesit nuk përbënte një kufizim jo proporcional të së drejtës së tyre për t'iu drejtuar një gjykate. Për pasojë Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

<sup>80</sup> Lat. - në mungesë.



**B. Në lidhje me nenin 6 § 3 (c)**

7. Përsa i përket të drejtës për t'u ndihmuar nga një avokat, të pretenduar gjithashtu nga kërkuesit, Gjykata vlerësoi se mosparaqitja e një të akuzuari, në këtë rast e kërkuesve, përpara gjykatave për t'u mbrojtur nuk mund të justifikonte privimin e tyre nga e drejta për ndihmë ligjore. Ajo vuri në dukje se duke u fshehur, kërkuesit e kishin bërë të qartë synimin e tyre për të mos u paraqitur në seancat gjyqësore të çështjes së tyre dhe, për pasojë, edhe për t'u mbrojtur vetë përpara gjykatës. Për pasojë Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 3 (c) të Konventës.

**C. Në lidhje me nenin 41**

8. Gjykata vendosi se konstatimi i shkeljes përbënte në vetvete një shpërblim mjaftueshmërisht të drejtë. Ajo u akordoi kërkuesve 4600 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

**III. Koment**

9. Në këtë çështje Gjykata nuk konstatoi shkelje të së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate, për shkak se detyrimi i tyre për t'u dorëzuar datonte përpara dënimin të cilin ata donin të apelonin dhe konkretisht që nga data e lirimit të tyre mbi bazën e një garancie pasurore në fazën e hetimit, si dhe për shkak të shkeljes nga ana e tyre të këtyre garancive. Në këtë çështje Gjykata ripohoi jurisprudencën e saj të qëndrueshme që refuzimi për t'u dorëzuar në gjendje arresti nuk mund të justifikojë refuzimin e parashtrimit të pretendimeve të tij nga ana e avokatit apo e përfaqësuesit të personit të akuzuar. Për këtë arsye kjo çështje është përfshirë në kuadrin e nenit 6 § 3 (c) të Konventës dhe jo në kuadrin e nenit 6 § 1 të saj<sup>81</sup>.

**BALLIU kundër SHQIPËRISË**

(kërkesa nr. 74727/01)

16 qershor 2005

*një individ nuk mund të pretendojë shkeljen e së drejtës së tij për proces të rregullt kur nuk ka arritur të përfitojë nga garancitë përkatëse për faj të tij ose të mbrojtësit dhe kur shteti ka bërë çka kishte në dorë për t'i ofruar këto garanci*

**I. Faktet kryesore**

1. Kërkuesi, Taulant Balliu, ka lindur në vitin 1971 dhe aktualisht po vuan dënimin me burgim në Burgun e Peqinit në Shqipëri. Ai ishte akuzuar si pjesëtar dhe një

<sup>81</sup> Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës të së njëjtës datë në lidhje me çështjen Goth kundër Francës, si dhe vendimin e 3 shkurtit 2001 në lidhje me çështjen Krombach kundër Francës, të përfshirë në këtë përmbledhje në kuadrin e nenit 6 § 1 si dhe vendimin pararendës në këtë botim në lidhje me çështjen Krombach kundër Francës.

nga drejtuesit e Bandës së Kateshit gjatë trazirave të vitit 1997. Më 1999 kërkuesi u akuzua përpara Gjykatës së rrethit Durrës me pesë akuza për vrasje, me dy akuza për vrasje të mbetura në tentativë, për armëmbajtje të paligjshme dhe për pjesëmarrje në bandë të armatosur.

2. Në procesin ndaj tij ai u përfaqësua fillimisht nga avokati Leli i cili ishte i pranishëm në seancat e zhvilluara gjatë vitit 1999 por në seancat e zhvilluara pas 10 dhjetorit 1999 e deri në 15 shkurt 2000 kërkuesi nuk u përfaqësua as nga avokati Leli dhe as nga ndonjë avokat tjetër. Kërkuesi nuk kishte avokat gjatë seancave kur u morën në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të mbrojtjes, në seancat e administrimit të provave dhe seancën e pretendimeve përfundimtare. Ai pretendonte se i kishte kërkuar gjykatës që t'i caktonin një avokat kryesisht por kjo kërkesë nuk ishte mbajtur parasysht.

3. Qeveria shqiptare nga ana e saj pretendonte se i kishte caktuar kërkuesit kryesisht një avokate e cila edhe ishte paraqitur në një seancë, por kërkuesi nuk kishte pranuar të përfaqësohej nga një avokate që nuk ishte zgjedhur prej tij. Qeveria pretendonte ndër të tjera se Gjykata e rrethit të Durrësit i kishte dërguar një letër Ministrit të Drejtësisë në lidhje me sjelljen e avokatit të kërkuesit por ndaj tij nuk u mor asnjë masë. Më 15 shkurt 2000 Gjykata e rrethit Durrës e shpalli kërkuesin fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm. Kërkuesi u ankua ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit të Durrësit, duke pretenduar sidomos që i ishin shkelur të drejtat e tij për proces të drejtë, duke qenë se nuk ishte mbrojtur me avokat dhe nuk kishte pasur mundësi që të ndihmohej nga një avokat në pyetjen e dëshmitarëve dhe në përgatitjen e pretendimeve përfundimtare. Në procedimin në Gjykatën e Apelit, kërkuesi është mbrojtur nga i njëjti avokat që e kishte zgjedhur vetë dhe që e kishte përfaqësuar pjesërisht në gjykimin në shkallë të parë. Në vendimin e 19 prillit 2000 Gjykata e Apelit e Durrësit rishikoi disa nga fajësimet e kërkuesit por kjo nuk e ndryshoi dënimin e tij me burgim të përjetshëm.

4. Më 19 maj 2000 kërkuesi, nëpërmjet të njëjtit avokat, iu drejtua Gjykatës së Lartë para së cilës ai pretendoi shkelje të të drejtave të tij kushtetuese nga dy gjykatat më të ulëta, pikërisht për shkak të mospërfaqësimit të tij me avokat. Më 7 dhjetor 2000 Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit duke argumentuar se para asaj gjykate ishin rishqyrtuar në themel akuzat ndaj kërkuesit dhe ishin mbajtur parasysht këto pretendime të tij. Kërkesa e Z. Balliu paraqitur Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131 (f) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë u hodh poshtë *de plano* nga ana e kësaj të fundit duke e konsideruar kërkesën të papranueshme për shkak se ishte jashtë juridiksionit të kësaj Gjykate.

5. Kërkuesi u ankua përpara Gjykatës së Strasburgut me pretendimin se nga gjykatat shqiptare atij i ishin shkelur të drejtat e parashikuara nga neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kurse qeveria pretendonte se kërkuesi kishte pasur mundësi që të mbrohej me avokat në përputhje me kërkesat e nenit 6.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake

6. Në lidhje me këtë çështje u zhvillua edhe seanca e parë me gojë përpara Gjykatës së Strasburgut kundër Republikës së Shqipërisë – më 27 maj 2004. Kjo seancë kishte për objekt si pranueshmërinë e kërkesës ashtu edhe thelbin e çështjes<sup>82</sup>[1]. Qeveria shqiptare pretendoi se kërkesa ishte e papranueshme *ratione temporis*, duke përdorur argumentin se Gjykata Kushtetuese shqiptare nuk përbën mjet efektiv që duhet shteruar për qëllimet e nenit 35 të Konventës dhe se kërkesa ishte bërë më shumë se 6 muaj pas vendimit të Gjykatës së Lartë. Duke e hedhur poshtë këtë pretendim, me një vendim të 30 shtatorit 2004 Gjykata e konsideroi të pranueshme kërkesën<sup>83</sup>[2].

### B. Në lidhje me nenin 6

7. Duke vlerësuar se elementët e paragrafit 3 (c) dhe (d) të nenit 6 mund të konsiderohen si *lex specialis* në raport me të drejtën për një gjykim të drejtë të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, Gjykata gjykoi si më të përshtatshme ta shqyrtonte çështjen në kuadrin e paragrafit 3.

#### a. Në lidhje me nenin 6 §§ 1 dhe 3 (c)

8. Kërkuesi pretendoi se avokati i zgjedhur prej tij nuk kishte pasur mundësi ta mbronte atë përpara Gjykatës së rrethit të Durrësit. Qeveria e kundërshtoi pretendimin e kërkuesit duke argumentuar se pavarësisht nga mungesat e pajustificuara të avokatit të kërkuesit, Gjykata e Rrethit të Durrësit i kishte shtyrë disa herë seancat për t'i dhënë mundësi avokatit të paraqitej. Në prani të pamundësisë së vazhdueshme gjykata e rrethit i kishte caktuar kërkuesit një avokate kryesisht por vetë ai nuk e kishte pranuar këtë pasi donte të kishte avokatin e tij. Sipas qeverisë, fakti që përpara Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë kërkuesi ishte përfaqësuar nga i njëjti avokat i zgjedhur prej tij bënte të qartë që atij nuk i ishin shkelur të drejtat themelore për një proces të drejtë.

9. Pasi ripohoi parimin tashmë të njohur se një person i akuzuar për një vepër penale duhet të mbrohet me avokat qoftë të zgjedhur prej vetë atij qoftë të caktuar kryesisht<sup>84</sup>[3], Gjykata gjithsesi theksoi se një shtet nuk mund të konsiderohet përgjegjës për çdo mangësi në mbrojtjen ligjore që i ofrohet nga avokatët personit të akuzuar. Pikërisht në këtë kuadër u fokusua edhe analiza e Gjykatës – për të vlerësuar nëse qeveria shqiptare mund të konsiderohej përgjegjëse për mangësitë në mbrojtjen ligjore të kërkuesit dhe për pasojë edhe në shkelje të të drejtave të tij në bazë të Konventës. Gjykata konstatoi se kërkuesi nuk kishte pranuar të mbrohej vetë, nuk kishte pranuar as ndonjë avokat tjetër qoftë të zgjedhur prej tij qoftë të caktuar kryesisht dhe se në kushtet e pavarësisë organizative të Dhomës së Avokatëve

<sup>82</sup> Sipas nenit 54 § 3 të Rregullores së Gjykatës.

<sup>83</sup> Shih në vijim tek Komenti (seksioni III)

<sup>84</sup> Gjykata i'u referua jurisprudencës së saj të mëparshme në lidhje me çështjet Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar, (vendim i 28 qershorit 1984 i përfshirë në këtë përmbledhje) dhe Pakelli kundër Gjermanisë (vendim i 25 prillit 1983).

autoritetet gjyqësore, nuk mund ta detyronin avokatin e kërkuesit që të përmbushte detyrat e tij. Në vijim Gjykata konstatoi që kërkuesi nuk e kishte informuar Gjykatën e rrethit Durrës për problemet që ai kishte në lidhje me përfaqësimin e tij me avokat dhe megjithatë kjo e fundit i kishte shtyrë disa herë me radhë seancat gjyqësore pikërisht në prani të këtyre problemeve. Në prani të këtyre konstatimeve ajo arriti në përfundimin se autoritetet shtetërore i kishin respektuar detyrimet e tyre për të siguruar mbrojtjen me avokat të kërkuesit dhe në kushtet kur ato duhet të respektonin edhe detyrimin tjetër ligjor për një proces “brenda një afati të arsyeshëm” sipas nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata u shpreh se nuk kishte në këtë rast shkelje të të drejtave të kërkuesit në bazë të nenit 6 § 3 (c) të Konventës.

*b. në lidhje me nenin 6 § 3 (d)*

10. Kërkuesi ankohej se ai nuk kishte pasur mundësi që të merrte në pyetje dëshmitarët, qoftë ata të akuzës qoftë ata në favor të tij. Sipas tij, pamundësia e tij për t'u mbrojtur me avokat në shkallë të parë e kishte kompromentuar ushtrimin e kësaj të drejte edhe në Apel.

11. Gjykata vlerësoi se si kërkuesi ashtu edhe avokati i tij kishin pasur mundësi që të merrnin në pyetje dëshmitarët, qoftë ata të akuzës qoftë ata në favor të kërkuesit, por kishin preferuar të mos e bënin këtë gjë – i pari duke qëndruar në heshtje ndërsa i dyti duke mos u paraqitur në mënyrë të përsëritur. Në këto kushte Gjykata arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje as të nenit 6 § 3 (d).

### III. Koment

12. Çështja në fjalë paraqet një vlerë të jashtëzakonshme për juristët dhe autoritetet shqiptare për një sërë arsyes. Për mendimin tim vlera e saj duhet vënë në dukje fillimisht në lidhje me fazën e pranueshmërisë e cila shtronte një pyetje themelore si për procedurën e ankimit të individëve kundër Republikës së Shqipërisë ashtu edhe për qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me konceptin e procesit të rregullt dhe të juridiksionit të saj mbi kërkesat individuale. Për këtë arsye do të preferoja ta filloja komentin në fjalë nga vendimi i Gjykatës së Strasburgut i 30 shtatorit 2004 në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës. Përpara zhvillimit të seancës dëgjimore të 27 majit 2004 Gjykata i drejtoi qeverisë shqiptare pesë pyetje në bazë të nenit 54 § 3 të Rregullores së Gjykatës të cilat do të përbënin edhe bazën e debatit juridik në seancë<sup>85</sup>[4]. Pyetja më interesante për qëllimet e pranueshmërisë por ndoshta edhe të vlerës së vendimit për juridiksionet shqiptare është e treta, pra “Përsa i përket çështjes konkrete, a konsiderohet e drejta për ndihmë ligjore e pretenduar

<sup>85</sup> Pesë pyetjet e drejtuara qeverisë shqiptare nga ana e Gjykatës ishin:

- a. Në çfarë kushtesh individët mund të apelojnë në mënyre efektive në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë?
- b. A është përmbushur nga kërkuesi kushti i afatit 6 mujor, i nevojshëm për të aplikuar në Gjykatën Evropiane sipas nenit 35 § 1 të Konventës?
- c. Përsa i përket çështjes konkrete, a konsiderohet e drejta për ndihmë ligjore e pretenduar nga kërkuesi, si pjesë e procesit të drejtë ligjor në Shqipëri në mënyrë të tillë që ankimi në Gjykatën Kushtetuese përbën një mjet të brendshëm që kërkuesi duhet ta shteronte

nga kërkuesi, si pjesë e procesit të drejtë ligjor në Shqipëri në mënyrë të tillë që ankimi në Gjykatën Kushtetuese përbën një mjet të brendshëm që kërkuesi duhet ta shteronte megjithëse kërkesa e tij u deklarua e papranueshme *de plano*<sup>86</sup>[5]?”. Thënë ndryshe – a mund të konsiderohet e papranueshme *de plano* si jashtë juridiksionit një kërkesë që i drejtohet Gjykatës Kushtetuese në bazë të nenit 131 § f të Kushtetutës me pretendimin se është shkelur e drejta për një proces të drejtë? Ose akoma më thjeshtë – a mund t'i konsiderojë Gjykata Kushtetuese të papranueshme për shkak se janë jashtë juridiksionit dhe pa u shprehur me një vendim të arsyetuar kërkesat që i bëhen për shkelje të së drejtës për proces të drejtë përpara gjykatave të tjera shqiptare? Kjo pyetje shtrohet në prani të vendimit të 19 prillit 2001 të dhënë nga Gjykata Kushtetuese e cila me një fjali e konsideron kërkesën e Z. Balliu të papranueshme si jashtë juridiksionit.

13. Qeveria shqiptare e konsideroi ankimin përpara Gjykatës Kushtetuese shqiptare si një ankim me karakter përjashtimor dhe subsidiar në raport me ankimet përpara juridiksioneve të tjera<sup>87</sup>[6]. Në ndihmë të këtij qëndrimi u përdorën gjithashtu argumentet se përpara Gjykatës Kushtetuese kërkuesi ishte ankuar vetëm në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij përpara Gjykatës së rrethit Durrës ndërkohë që mangësitë eventuale të saj ishin korrigjuar përpara Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë<sup>88</sup>[7]. Përgjigja e Gjykatës ishte e prerë – ankimi në Gjykatën Kushtetuese shqiptare për shkelje të procesit të drejtë në bazë të nenit 131 § f, përbën mjet efektiv për qëllimet e nenit 35 § 1 të Konventës pasi koncepti i procesit të drejtë duhet interpretuar qoftë në dritën e nenit 6 të Konventës qoftë në dritën e neneve 31 dhe 42 të Kushtetutës. Mesazhi del qartë – Gjykata Kushtetuese nuk mund t'i konsiderojë të papranueshme për shkak se janë jashtë juridiksionit dhe pa u shprehur me një vendim të arsyetuar kërkesat që i bëhen për shkelje të së drejtës për proces të drejtë përpara gjykatave të tjera shqiptare.

14. Komenti në lidhje me themelin mund të përqendrohet kryesisht në një aspekt – parim i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare por edhe i *common law*. Ky parim që në të drejtë ndërkombëtare njihet me termin *ex injuria jus non oritur* kurse në të

---

megjithëse kërkesa e tij u deklarua e papranueshme *de plano*?

- d. A ishte ankuesi në gjendje të mbronte vetveten nëpërmjet asistencës ligjore të zgjedhur prej tij, siç kërkohet nga neni 6 paragrafi 3 (c) i Konventës?
- e. A ishte ankuesi në gjendje të pyeste dëshmitarët kundër tij si dhe të përfitonte nga dëshmitarët në favor të tij, në të njëjtat kushte si pala kundërshtarë, siç kërkohet nga neni 6 § 3(d) i Konventës?

<sup>86</sup> De plano (Lat.) – menjëherë, tërësisht, pa shqyrtim në themel.

<sup>87</sup> Në këtë kuadër u përdor argumentimi i Gjykatës së Strasburgut i dhënë në çështjen *Tumilovich kundër Ruisisë*, (vendim mbi pranueshmërinë i 22 qershorit 1999) “ankimet me karakter përjashtimor, përdorimi i të cilave varet nga kompetenca diskrecionare..., për këtë arsye nuk përbën mjet efektiv në kuptimin e nenit 35 § 1 të Konventës. Për pasojë mospranimi i kërkesave të kërkuesit për një shqyrtim kushtetues nuk merren parasysh për përcaktimin e kompetencës *ratione temporis* të Gjykatës.”

<sup>88</sup> Shih gjithashtu vendimet e Gjykatës së Strasburgut në lidhje me çështjet *Ekbatani kundër Suedisë* (vendim i 26 majit 1988), *Tëalib kundër Greqisë* (vendim i 9 qershorit 1988), *Levages Prestations Services kundër Francës* (vendim i 23 tetorit 1996) dhe *Bruala Gómez de la Torre kundër Spanjës* (vendim i 19 dhjetorit 1997).

drejtën angleze me termin estoppel<sup>89</sup>[8], nënkupton që një subjekt - në rastin tonë në mënyrë mjaft interesante një individ - nuk mund të pretendojë që t'i lindin të drejta nga qëndrime të tij të paligjshme ose nga mos-ushtrimi i këtyre të drejtave në instanca të mëparshme. Në këto kushte, përderisa kërkuesi në këtë çështje nuk kishte bërë përpjekje që të kishte një proces të rregullt përpara juridiksioneve shqiptare, qoftë për mangësi të tij, qoftë të avokatit, nuk mund të pretendonte se i lindnin të drejta në dëm të shtetit shqiptar.

## DESTREHEM kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 56651/00)

18 maj 2004

*edhe procesi në apel, atëherë kur ekziston i nënshtrohet garanciove të parashikuara nga neni 6*

### I. Faktet kryesore

1. Jean-Noël Destrehem është shtetas francez i cili ka lindur më 1958 dhe jeton në Francë. I dyshuar për dëmtim të një makine të maskuar policie me një çekiç gjatë një demonstrate paqësore në Reims në shkurt 1998, kërkuesi u akuzua për veprën penale të sulmit të armatosur me pasojë plagosje. Gjykata e Reimsit e shpalli atë të pafajshëm pasi dëgjoi disa deklaratatë të dëshmitarëve që kërkuesi kishte kërkuar të merreshin në pyetje.

2. Akuza dhe pala civile në proces e apelian këtë vendim. Pa thirrur dëshmitarët e mbrojtjes, siç kishte kërkuar edhe vetë kërkuesi, Gjykata e Apelit dha një vendim duke u bazuar vetëm në dokumentet e përfshirë në dosjen gjyqësore. Pasi kishte vënë re një "kontradiktë themelore" në provat që ishin përfshirë në dosje, ajo vendosi se asnjë prej dëshmitarëve që ishin marrë në pyetje nuk kishte qënë në gjendje të kundërshtonte provat e ofruara nga oficerët e policisë. Për pasojë, në një vendim të 31 marsit 1999, ajo e shpalli Z. Destrehem fajtor përse akuzohej dhe e dënoi atë, përveç të tjerash, edhe me tetë muaj burg, pesë nga të cilat me kusht. Gjykata e Kasacionit nuk e pranoi ankimin e bërë nga kërkuesi për çështje të ligjit.

### II. Vendimi i Gjykatës

3. Duke u bazuar në nenin 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kërkuesi u ankua ndaj refuzimit të gjykatës së apelit për të thirrur dhe marrë në pyetje dëshmitarët.

<sup>89</sup> Injohur nga e drejta ndërkombëtare që nga vendimi i Gjykatës Permanente të së Drejtës Ndërkombëtare i 26 korrikut 1926 në lidhje me juridiksionin e saj në çështjen mbi Fabrikën e Chorzóë (Seria A, Nr. 9) e pastaj në një sërë vendimesh të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës së Strasburgut në lidhje me çështjen Artico kundër Italisë (paragrafi 5) supra.



**A. Në lidhje me nenin 6 §§ 1 dhe 3 (d)**

4. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se Gjykata e Apelit e kishte bazuar dënimin e kërkuesit në një interpretim të ri që iu kishte bërë deklaratave të dëshmitarëve të cilët ajo nuk i kishte marrë vetë në pyetje, pavarësisht nga pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim. Dukej se Gjykata e Apelit, duke dyshuar në besueshmërinë e dëshmitarëve të palës mbrojtëse, nuk i kishte “administruar” dëshmitë e tyre pa i dëgjuar vetë ato dhe ishte bazuar në këtë përshtypje për të prishur vendimin e Shkallës së Parë. Në këto kushte kërkuesi ishte shpallur fajtor në bazë të dëshmive të cilat ai kishte patur fare pak mundësi t'i kundërshtonte. Kjo situatë bëhej edhe më komplekse nga fakti se vetë Gjykata e Apelit e kishte përshkruar dënimin që ajo vetë dha si “të ashpër”. Për këtë arsye Gjykata vlerësoi se Z. Destrehem nuk kishte patur një gjykim të drejtë dhe vendosi se ka patur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d).

**B. Në lidhje me nenin 41**

5. Gjykata i akordoi kërkuesit 5000 euro shpërblim për dëm jomaterial dhe 9797.95 Euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

**III. Koment**

6. E drejta për apel në çështjet penale nuk është e përfshirë në nenin 6 të Konventës. Ajo iu shtua katalogut të të drejtave të mbrojtura nga Konventa me Protokollin 7 më 1984. Megjithatë, garancitë e parashikuara nga neni 6 gjejnë zbatim në të gjitha fazat e gjykimit. Kjo çështje kishte të bënte me seancat në apel ku “palët civile në një proces penal” dhe akuza apelian ndaj shfajësimit të të akuzuarit dhe refuzimit të pretendimit të palëve civile për kompensim. Gjykata e Apelit konstatoi se vendimi fillestar ishte bazuar në vlerësimin nga gjykata më e ulët e provave kontradiktore të ofruara nga dëshmitarë të ndryshëm të thirrur nga i akuzuari. Megjithatë ajo refuzoi që t'i lejonte këta dëshmitarë që të paraqiteshin para saj, duke preferuar që të bazohej në dosjen gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë por duke arritur në një përfundim të kundërt. Në këto kushte Gjykata e Strasburgut konstatoi se ishte thelbësore për kërkesat e nenit 6 që kërkuesi të kishte qënë në gjendje t'i thërriste dëshmitarët e tij në Gjykatën e Apelit me qëllim që kjo gjykatë ta vlerësonte vetë besueshmërinë dhe peshën që duhet t'iu jepte këtyre dëshmive.

## LUCA kundër ITALISË

(kërkesa nr. 33354/96)

27 shkurt 2001

*e drejta për të pyetur në proces dëshmitarët, deklaratat e të cilëve përdoren për të mbështetur akuzën*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Nicola Luca është shtetas italinë i lindur më 1955 dhe aktualisht vuan dënimin me burg në burgun e Kozencës.
2. Më 7 mars 1994 Gjykata Penale e Lokrit e dënoi kërkuesin me tetë vjet e katër muaj burg për trafik droge. Dënimi i tij, që u la në fuqi nga Gjykata e Apelit në nëntor 1994 dhe nga Gjykata e Kasacionit në nëntor 1995, bazohej vetëm në deklaratat e bëra gjatë pyetjeve nga ana e prokutorit një të bashkë-akuzuari në një çështje tjetër të ngjashme.
3. Megjithëse as kërkuesit dhe as përfaqësuesit të tij nuk u ishte dhënë ndonjë mundësi për të pyetur personin që kishte bërë deklaratat, qoftë gjatë procesit gjyqësor (duke kujtuar që i akuzuari tjetër kishte të drejtë të rrinte në heshtje në përputhje me Nenin 210 të Kodit Italian të Procedurës Penale) qoftë gjatë ndonjë faze tjetër të procedurave, deklaratat ishin pranuar si provë dhe, për më tepër, përbënë edhe bazën kryesore për dënimin e kërkuesit. Neni 513 i Kodit të Procedurës Penale, me formulimin e dispozitës së tij, që edhe është kuptuar po njësoj nga Gjykata Kushtetuese Italiane në vendimin e saj Nr. 254 të vitit 1992 (i cili nga ana e tij nuk bënte referenca në garancitë e një gjykimi të drejtë të parashikuara në Nenin 6 të Konventës ose në kriteret e tjera të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës në këtë drejtim) i mundësonte gjykatës që t'i përdorte deklaratat e bëra nga një i bashkëakuzuar në një proces tjetër që ka lidhje me procesin në fjalë edhe kur ky i bashkëakuzuar kishte ushtruar të drejtën e tij për të qëndruar në heshtje dhe kishte refuzuar që t'i përsëriste ato në proces, pavarësisht se personit, kundër të cilit këto deklarata synohej të përdoshin, nuk i ishte dhënë ndonjë mundësi për ta pyetur deklaruesin në ndonjërin nga fazat e procesit.

### II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij për një gjykim të drejtë, përfshirë të drejtën e tij për të pyetur drejtpërdrejt ose jo çdo dëshmitar që dëshmonte kundër tij, të drejta këto të garantuara nga neni 6 § 1 dhe § 3 (d) i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ai ankohej se kishte qënë dënuar në bazë të deklaratave të bëra

nga një i akuzuar në një çështje tjetër që lidhet me të tijën, dhe se nuk kishte patur mundësi që ta pyeste të bashkëakuzuarin vetë ose nëpërmjet një personi të tretë.

#### *A. Në lidhje me nenin 6 § 1 dhe § 3 (d)*

5. Gjykata ritheksoi se çështja e pranueshmërisë së provave është së pari një problem që duhet rregulluar nga legjislacioni i brendshëm dhe si rregull i përgjithshëm janë gjykatat e brendshme ato që duhet të pranojnë dhe të vlerësojnë provat që u paraqiten. Detyra e Gjykatës në bazë të Konventës është që të shqyrtojë nëse procedurat në tërësinë e tyre, pra përfshirë edhe mënyrën sesi janë marrë dhe vlerësuar provat, janë apo jo të drejta.

6. Si rregull i përgjithshëm, paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6 kërkojnë që palës së akuzuar t'i ofrohet një mundësi e përshtatshme dhe e hapur për të kundërshtuar dhe për të pyetur dëshmitarët e palës akuzuese, qoftë në momentin kur këta bëjnë dëshmitë e tyre qoftë edhe në një moment më të vonë. Në këtë kuadër, fakti që deklaratat ishin bërë nga një i akuzuar tjetër për një vepër të ngjashme dhe jo nga një dëshmitar, nuk kishte rëndësi, përderisa termi “dëshmitar” kishte një kuptim “autonom” në sistemin e Konventës. Kështu pra, kur një deponim mund të shërbejë në një masë të madhe si bazë për gjetjen fajtor të një të akuzuari, atëhere pavarësisht nga fakti nëse ajo është bërë nga një dëshmitar në kuptimin e ngushtë të fjalës apo nga një i akuzuar tjetër, ai përbën një provë në favor të akuzës dhe ndaj saj gjejnë zbatim garancitë e parashikuara nga neni 6 § 1 dhe § 3 (d) të Konventës.

7. Ashtu si Gjykata ka vendosur në një numër rastesh, mund të jetë e nevojshme në disa raste që të bëhet referim në deponimet dhe deklaratat e bëra gjatë fazës së hetimit (në veçanti kur një dëshmitar refuzon ta përsërisë deponimin e tij në publik për shkak të frikës për sigurinë e tij, gjë që ndodh jo rrallë në proceset kundër organizatave mafioze). Si të tilla, pranimi i këtyre deponimeve si prova nuk do të përbente shkelje të nenit 6 § 1 dhe § 3 (d) të Konventës. Megjithatë në rastet kur një fajësim dhe dënim mbështetet vetëm ose kryesisht në deponimet që janë bërë nga një person të cilin i akuzuari nuk ka patur mundësi ta pyesë direkt ose indirekt, qoftë gjatë fazës së hetimit qoftë gjatë procesit gjyqësor, atëhere të drejtat e mbrojtjes janë kufizuar në një masë që është e papajtueshme me garancitë e parashikuara nga Neni 6.

8. Duke ndjekur jurisprudencën e saj në lidhje me çështje të ngjashme, Gjykata theksoi se ishte e qartë në vazhdim se një seancë pyetje-përgjigje me dëshmitarët e akuzës, në kuptimin e gjerë sipas sistemit të Konventës, duhet të zhvillohet domosdoshmërisht në seancë gjyqësore. Megjithëse prova të tilla normalisht duhen marrë në seancë gjyqësore, disa rrethana të veçanta si ato të përmendura më lart mund ta bëjnë të vështirë, ose edhe të pamundur, përsëritjen, në seancë gjyqësore publike, të deklaratave të bëra gjatë fazave të hetimit. Në raste të tilla neni 6 kërkon se vetëm të akuzuarit duhet t'i jetë dhënë një mundësi e përshtatshme dhe konkrete për t'i kundërshtuar provat në fjalë edhe gjatë seancës gjyqësore.

9. Gjykata hodhi poshtë gjithashtu, në mënyrë të nënkuptuar argumentin e qeverisë të bazuar në nevojën për të mbrojtur të drejtën për të ndenjtur në heshtje të të akuzuarit tjetër të thirrur për të përsëritur në një seancë publike deklaratat që ai kishte bërë më parë. Nuk ishte e drejta për të qëndruar në heshtje që ishte në shqyrtim këtu. I akuzuari tjetër e ruante të drejtën për të qëndruar në heshtje dhe për të mos u vetëakuzuar. Megjithatë, në qoftë se ai e ushtronte këtë të drejtë, si në rastin në fjalë, deklaratat e tij të mëparshme do të mund të përdoren kundër personave të tjerë si prova materiale të fajësisë së këtyre vetëm në qoftë se i akuzuari do të ketë patur mundësinë e një seance pyetje-përgjigje në ndonjë nga fazat e procedimit.

10. Në çështjen përpara Gjykatës, gjykatat e brendshme e kanë gjetur kërkuesin fajtor vetëm në bazë të deklaratave të bëra nga një i akuzuar në një çështje tjetër, përpara procesit gjyqësor, dhe as kërkuesi as avokati i tij nuk kishin patur mundësi që, në ndonjë nga fazat e procesit, ta pyesnin atë. Për këtë arsye Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit nuk i ishte dhënë një mundësi konkrete dhe e përshtatshme për të kundërshtuar deklaratat në bazë të të cilave ai kishte qënë gjetur fajtor.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

11. Gjykata vlerësoi se ajo nuk mund të spekulonte me atë që do të mund të kishte qënë përfundimi i procesit në qoftë se ai do të kishte qënë në përputhje me nenin 6 § 1 dhe § 3 (d). Për këtë arsye ajo akordoi vetëm një shumë për dëm jo-material në vlerën e 15 000 000 lireta italiane. Kërkuesit iu akorduar gjithashtu një shumë totale prej 3 000 000 për shpenzimet që ai kishte bërë në procesin përpara Gjykatës.

## **III. Koment**

12. Ky rast ka të bëjë me çështjet shumë problematike që rrethojnë proceset gjyqësore në të cilat ka më shumë se një të akuzuar ose kur agjentë sekretë kanë qënë përfshirë në arrestimin e të akuzuarit. Megjithatë, në rastet kur të bashkëakuzuarve u është ofruar ulje dënimi si shkëmbim për dhënien e deklaratave në favor të akuzës, gjykatat duhet të mbajnë një qëndrim kritik në vlerësimin e këtyre deklaratave. Por, nga ana tjetër, fakti që akuza kërkon që të bëjë të njohura të gjitha provat që disponon nuk do të thotë që të bëhen të njohura edhe raportet psikike në lidhje me të bashkëakuzuarit të cilët ishin bërë gati të dëshmonin në favor të akuzës<sup>90</sup>. Është e qartë që bazueshmëria vetëm në deklaratat e bëra nga një person i cili në vijim kishte refuzuar t'i përsëriste deklaratat e tij në publik nuk mund të përjashtohet ipso facto për aq sa edhe i akuzuari ka mundësi që t'i kundërshtojë këto prova. Në çështjen Ferrantelli dhe Santangelo kundër Italisë<sup>91</sup>, Gjykata konstatoi se nuk kishte shkelje në një rast kur akuza ishte bazuar në deklarata të bëra nga një i bashkëakuzuar, i cili nuk jetonte më, për shkak se këto deklarata ishin plotësuar në mënyrë të mjaftueshme nga prova të tjera të cilat i akuzuari kishte patur mundësi t'i kundërshtonte gjyqësisht. Ky problem u ngrit gjithashtu në çështjen e deklaratave

<sup>90</sup> Shih vendimin e 28 shkurtit 1996 në lidhje me pranueshmërinë në çështjen Hardiman k. Mbretërisë së Bashkuar.

<sup>91</sup> Vendim i 7 gushtit 1996.

të bëra nga agentë sekretë si dhe nga dëshmitarë që kanë frikë nga hakmarrje të mundshme. Qëndrimi i Gjykatës është i pandryshueshëm pavarësisht nga fakti nëse “dëshmitari” është thjesht një dëshmitar apo, si në rastin që po trajtojmë, një i bashkëakuzuar që kapet fort mbas së drejtës së tij për të ndenjur në heshtje. Në lidhje me pranueshmërinë e provave të marra në mënyrë të paligjshme, problemi qëndron në shkallën në të cilën gjykatat e brendshme janë mbështetur në deklaratat të cilat nuk mund të debatohen nga pala tjetër. Sidoqoftë përdorimi i agentëve provokues është gjithmonë i papranueshëm<sup>92</sup>.

## SOLAKOV kundër ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË

(kërkesa nr. 47023/99)

31 tetor 2001

*kërkuesi ankohej se nuk kishte patur mundësi ta pyeste siç duhej dëshimitarin*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Blagoj Solakov, është shtetas i Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë (tani e tutje ‘Maqedonia’). Më 30 shtator 1997 ai u arrestua me akuzën e importimit të rreth 10.5 kg drogë nga Bullgaria dhe nga ‘Maqedonia’ në drejtim të Shteteve të Bashkuara si dhe të ngritjes së një rrjeti ndërkombëtar për trafikun e drogës.
2. Më 28 nëntor 1997 hetuesi i çështjes thirri avokatin e parë të Z. Solakov për të marrë pjesë në një seancë hetimore në Shtetet e Bashkuara. Atij nuk iu dha viza për këtë qëllim, por iu tha që do t’i jepej sapo ai të kishte paraqitur dokumentet e duhura. Në këto kushte kërkuesi caktoi një avokat tjetër që ta përfaqësonte, i cili pretendoi se nuk kishte mundësi të paguante shpenzimet e udhëtimit dhe se pra nuk mund të shkonte të ishte e pranishëm në procesin që zhvillohej në Shtetet e Bashkuara.
3. Deklaratat e dëshmitarëve të paraqitura në procesin e zhvilluar në Shtetet e Bashkuara i’u lexuan kërkuesit në procesin që u mbajt në Gjykatën e Rrethit të Shkupit, e cila hodhi poshtë të dyja kundërshtimet e kërkuesit sipas së cilave mbrojtja nuk kishte qënë në gjendje të merrte në pyetje dëshmitarët në Shtetet e Bashkuara si dhe që të merreshin në pyetje dy dëshmitarë të tjerë. Më 28 janar 1998 Gjykata e Shkupit e gjeti kërkuesin fajtor për trafik droge dhe e dënoi atë me 10 vjet burg. Më 6 mars 1998 ai apeloj në Gjykatën e Apelit të Shkupit por pa sukses. Në vijim të një apeli nga ana e prokurorit publik Gjykata e Apelit ia rriti dënimin kërkuesit nga dhjetë në trembëdhjetë vjet burg. Rekursi i tij pranë Gjykatës së Lartë për interpretim të ligjit, nuk u pranua prej saj më 2 korrik 1998.

<sup>92</sup> Shih vendimin Texeiro de Castro kundër Portugalisë, të 9 qershorit 1998.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesi e bazonte ankimin e tij mbi bazën e nenit 6 § 1 dhe 6 § 3 (d) (e drejta për një gjykim të rregullt) të Konventës duke pretenduar se procesi në ngarkim të tij nuk ishte i drejtë, për shkak se ai nuk pati mundësi të pyeste dëshmitarët, pohimet e të cilëve shërbyen si prova të vetme për dënimin e tij dhe se as nuk kishte patur dikë që t'i pyeste në emër të tij.

### A. Në lidhje me nenin 6

5. Gjykata vuri në dukje se të dy avokatët e kërkuesit ishin ftuar të merrnin pjesë në seancat në ngarkim të tij në Shtetet e Bashkuara. Argumenti i kërkuesit që avokati i tij i dytë nuk ishte ftuar të merrte pjesë nuk mbështetej nga dokumentat e paraqitur përderisa kishte nënshkruar ftesat që i ishin bërë, pavarësisht se jo në vendin e duhur. Nuk kishte gjithashtu as ndonjë tregues që të nxirrte në pah se kërkuesi ose avokati i tij i dytë kishin shprehur ndonjë shenjë se donin to merrnin pjesë në pyetjen e dëshmitarëve në Shtetet e Bashkuara. Më 4 dhjetor 1997 kërkuesi deklaroi përpara hetuesit se ia kishte lënë në dorë marrjen e vendimit avokatit të tij të dytë dhe se ai kishte mjete të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit. Avokati i dytë i kërkuesit as që nuk bëri kërkesë për vizë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara dhe as që kërkoi që seanca të shtyhej. Nga ana tjetër avokati i parë i kërkuesit nuk e ripërsëriti kërkesën e tij për vizë dhe më 2 dhjetor 1997 kërkuesi e tërhoqi prokurën e tij për mbrojtje nga ky avokat.

6. Gjykata vuri në dukje se, gjatë procedurave të gjyimit në shkallë të parë dhe në apel, kërkuesi asnjëherë nuk ishte ankuar në lidhje me pamundësinë për të pyetur dëshmitarët përkatës për shkak mungese kohe ose informacioni, dhe as që kishte kërkuar shprehimisht që dëshmitarët të merreshin në pyetje për llogari të tij. Nga ana tjetër deri në këto faza të procedimit ai nuk dukej as që ta kishte kundërshtuar përmbajtjen e deklaratave të dëshmitarëve dhe as që kishte parashtruar pyetje që ai të dëshironte t'i bëheshin dëshmitarëve. Për më tepër, vetëm gjatë gjyimit në apel ai kishte pretenduar se nuk i ishte dhënë mundësia për të pyetur dëshmitarët. Gjykatat e brendshme bënë një analizë të plotë dhe të kujdesshme të deklaratave të dëshmitarëve dhe mbajtën parasysh faktorët e ndryshëm që paraqisnin rëndësi për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarëve, si dhe vërtetësinë e peshën që u duhej njohur deklaratave të tyre. U morën gjithashtu në analizë edhe elementë të tjerë që kishin bënë me deklaratat e dëshmitarëve.

7. Në lidhje me ankimin e kërkuesit që ai nuk kishte qënë në gjendje të përfitonte praninë dhe pyetjen e dy dëshmitarëve të tjerë, Gjykata vuri në dukje se ai e kishte patur mundësinë e bërjes së kërkesës për thirrjen e dëshmitarëve gjatë fazës së hetimeve paraprake, kur kishte pretenduar se nuk kishte asnjë çështje për të cilën ai duhej të përgjigjej. Ai e kishte patur këtë mundësi gjithashtu edhe në seancën e 12 dhe 13 janarit 1998. Megjithatë, ai e paraqiti një kërkesë të tillë vetëm në seancën e 22 janarit 1998. Gjykata vuri në dukje se do të kishte qënë e vështirë që të thirreshin për t'u pyetur të dy dëshmitarët, të cilët jetonin në Bullgari ose në Shtetet



e Bashkuara, për shkak se adresat e tyre nuk ishin të njohura. Duke patur parasysh arsyet e pretenduara nga ana e kërkuesit për dëgjimin e dëshmitarëve, Gjykata konstatoi se refuzimi për t'i dëgjuar ata në rrethanat konkrete nuk ishte, në vetvete, në kundërshtim me nenin 6 § 3 (d).

8. Si përfundim Gjykata u bind se kërkuesit i ishin dhënë mundësitë adeqate për të ushtruar mbrojtjen e tij dhe se refuzimi për të thirrur dy dëshmitarët e kërkuar prej tij nuk i kufizonte të drejtat e tij të mbrojtjes deri në një masë të tillë sa që të mund të thuhej se nuk i ishte bërë një gjykim i drejtë në kuptimin e paragrafëve 1 dhe 3 (d) të nenit 6.

### III. Koment

9. Jurisprudenca e Gjykatës i ka zgjeruar mjaft nga të drejtat e Konventës deri në përfshirjen e mbrojtjeve që nuk janë të dukshme nga teksti i dispozitës së Nenit përkatës<sup>93</sup>. Të drejtat e garantuara nga neni 6 § 3 (d) kanë qënë zgjeruar në mënyrë të veçantë nga jurisprudenca. Në një vlerësim në këtë kuadër Gjykata nuk do të rishqyrtojë përshtatshmërinë e vendimeve të gjykatave të brendshme në pranimin apo mospranimin e provave të caktuara, por do të shohë në tërësi nëse procedurat e marra në tërësi janë të drejta.

10. Gjykata në këtë çështje ndryshon pozicionin që kishte mbajtur në vendimin A.M. kundër Italisë, të 14 dhjetorit 1999 – që ishte një çështje që gjithashtu kishte të bënte me një gjykim që zhvillohej në Europë për vepra penale të kryera në SH.B.A. dhe që ngrinin shumë probleme të ngjashme. Në çështjen A.M. nuk u konstatua shkelje në lidhje me pamundësinë e të akuzuarit për të kundërshtuar provat e dhëna nga akuza. Qëndrimi i përgjithshëm i Gjykatës kishte çuar në pranimin si në pajtim me Nenin 6 të dënimeve të bazuara në provat e dëshmitarëve të cilët nuk ka patur mundësi t'i pyesë i akuzuari. Gjykata e ka konstatuar si të pranueshëm pranimin e provave të dhëna nga dëshmitarë që nuk mund të pyeten të tillë si bashkëshortët, dëshmitarë që kanë vdekur ose dëshmitarë që ishin zhdukur duke parashikuar në këtë rast edhe përpjekjet që ishin bërë për të siguruar pjesmarrjen e tyre.

11. Gjykata i ka kushtuar vëmendje të veçantë detyrimit të shtetit në bazë të neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës për të mbrojtur paprekshmërinë e dëshmitarëve të 'dobët'<sup>94</sup>. Nga ana tjetër, ajo konstatoi se neni 6 § 3 (d) ishte shkelur kur gjykatat lokale nuk kishin marrë masa për të siguruar pjesmarrjen e dëshmitarëve që fshiheshin ose nuk paraqiteshin<sup>95</sup> ose kur një agjent sekret i maskuar nuk thirrej për të dëshmuar

<sup>93</sup> Shih në këtë kuadër në "Të drejtat e njeriut në Europë - Jurisprudencë dhe Komentë" - Botim i Qendrës Evropiane, 2001, në lidhje me interpretimin evolues (fq. 37-38) dhe të zgjeruar të garancive (fq.46) nga ana e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

<sup>94</sup> Shih për shembull vendimin e saj të 26 marsit 1996 në lidhje me çështjen Doorson kundër Hollandës e cila kishte të bënte gjithashtu me trafik droge ose vendimin e 27 tetorit 1995 në lidhje me çështjen Baegen kundër Hollandës që kishte të bënte me një viktimë të një përdhunimi.

<sup>95</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 19 dhjetorit 1990 në lidhje me çështjen Delta kundër Francës.

në gjyq<sup>96</sup>. Gjykata vendosi gjithashtu se vetëm rrethanat më përjashtimore mund të justifikojnë përdorimin e dëshmitarëve anonimë dhe që janë oficerë policie<sup>97</sup>. Me shumë rëndësi është qëndrimi i saj sipas së cilit do të ketë shkelje të Nenit 6 kur dënimi bazohet vetëm në shtytjen për të kryer një shkelje<sup>98</sup>. Ka gjithmonë një detyrim të gjyqtarit të çështjes për të ushtruar një kontroll shumë strikt ndaj çdo kërkesë të akuzës për të mos bërë publike provat për arsye, për shembull, të mbrojtjes së sigurisë publike, të metodave të hetimit të policisë sekrete ose të dëshmitarëve 'të dobët'<sup>99</sup>.

## RACHDAD kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 71846/01)

13 nëntor 2003

*e drejta e një personi për të kundërshtuar provat në bazë të të cilave ai akuzohet*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Abdelfettah Rachdad, është shtetas maroken i lindur më 1963 dhe aktualisht jeton në Bordo. Ndaj tij është marrë një vendim për arrest shtëpie.
2. Në dhjetor 1991 dhe pastaj në nëntor dhe dhjetor 1992, Gjykata Penale e Reimsit, në mungesë të kërkuesit e konsideroi atë fajtor si bashkëpunëtor në tregtimin e paligjshëm të lëndëve narkotike, për mbajtje dhe shitje të lëndëve narkotike, për bashkëpunim në blerjen e lëndëve narkotike dhe për transport dhe import lëndësh narkotike. Gjykata e Reims e dënoi atë me pesë vjet burg për secilën prej këtyre akuzave.
3. Në janar 1998 kërkuesi kundërshtoi duke pretenduar prishjen e këtyre vendimeve dhe kërkoi marrjen në pyetje të dëshmitarëve mbi bazën e dëshmive të të cilëve ai ishte dënuar. Gjykata e Reimsit e refuzoi kërkesën e tij dhe i la në fuqi dënimet. Në seancat gjyqësore në apel u thirrën të gjashtë dëshmitarët e kërkuar nga Z. Rachdad por vetëm njëri prej tyre ridëshmoi kurse të tjerët nuk u paraqitën.
4. Duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve gjatë hetimit policor dhe gjyqësor

<sup>96</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 15 qershorit 1992 në lidhje me çështjen Ludi kundër Zvicrës.

<sup>97</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 23 prillit 1997 në lidhje me çështjen Van Mechelen kundër Hollandës të përfshirë në këtë botim.

<sup>98</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 9 qershorit 1998 në lidhje me çështjen Teixeira de Castro kundër Portugalisë.

<sup>99</sup> Shih vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 16 shkurtit 2000 në lidhje me çështjet Roëe dhe Davis kundër Mbretërisë së Bashkuar, Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Fitt kundër Mbretërisë së Bashkuar.

Gjykata e konsideroi kërkuesin fajtor në lidhje me dy nga akuzat e sipërpërmendura. Me një vendim të 2 dhjetorit 1998 ajo e dënoi atë me gjashtë vjet burg dhe urdhëroi edhe dëbimin e tij të përhershëm nga territori francez.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesi ankohej në bazë të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) me pretendimin se ai ishte dënuar vetëm në bazë të dëshmimeve të dëshmitarëve të cilët ai nuk kishte qënë në gjendje t'i pyeste në asnjërin nga fazat e procesit.

### A. Në lidhje me nenin 6 §§ 1 dhe 3 (d)

6. Gjykata vuri në dukje se në lidhje me dy prej akuzave të ngritura ndaj tij, kërkuesi ishte dënuar vetëm në bazë të dëshimive të dëshmitarëve të cilët ai nuk kishte patur mundësi që t'i pyeste drejtpërdrejt ose jo në asnjë fazë të procesit.

7. Ishte e vërtetë që gjykatat franceze e kishin marrë në shqyrtim kërkesën e tij shtatë vjet pas ngjarjeve, kështu që mund të ketë pasur vështirësi në evidencimin e vendodhjes së dëshmitarëve dhe se kërkuesi mund të kishte kontribuar për keq në këtë drejtim duke mos iu përgjigjur thirrjeve të gjykatave, duke ndikuar që këto ta gjykonin atë në mungesë. Megjithatë, duke patur parasysh rëndësinë e veçantë të garantimit të të drejtës së mbrojtjes në procedimin penal si dhe faktin që këto garanci të parashikuara në Nenin 6 ishin njësoj të vlefshme si kur gjykatat shqyrtonin një çështje ashtu edhe rishikonin një vendim të dhënë më parë, ky faktor nuk mund të konsiderohej përcaktues. Kjo pasi në rastin e fundit, pra në apel, Gjykata e Apelit nuk e kishte bazuar vendimin e vet në dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve.

8. Për këtë arsye Gjykata vendosi se ka patur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës.

## III. Koment

9. Rëndësia themelore e mundësisë të një të akuzuari për të kundërshtuar provat e paraqitura kundër tij është njohur tashmë në mënyrë mjaft të qartë nga Gjykata e Strasburgut<sup>100</sup>. Jurisprudenca ka bërë të qartë që i takon shtetit të marrë të gjitha masat e arsyeshme që të sigurojë që këta dëshmitarë të paraqiten në gjykatë me qëllim që dëshmitë e tyre të kenë mundësi të kundërshtohen nga i akuzuari. Një dënim i bazuar vetëm provat që i akuzuari nuk ka patur mundësi t'i kundërshtojë do të ishte i papajtueshëm me nenin 6. Në çështjen që po komentojmë pati edhe një mangësi tjetër pasi kërkuesi ishte dënuar in absentia në bazë të provave që ai nuk kishte patur mundësi t'i kundërshtonte. Kjo mangësi rëndohej nga refuzimi i gjykatave franceze për të përmirësuar situatën kur u paraqit rasti i përshtatshëm, edhe pse vendodhja e disa prej dëshmitarëve ishte e ditur.

<sup>100</sup> Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 19 dhjetorit 1990 në lidhje me çështjen Delta kundër Francës, të 20 shtatorit 1993 në lidhje me çështjen Saidi kundër Francës ose edhe vendimin e 23 prill 1997 në çështjen Van Mechelen dhe të tjerë kundër Hollandës.

10. Gjykata e Strasburgut e ka pranuar gjithmonë faktin që në çështje që kanë të bëjnë me trafik ose krim të organizuar dëshmitarët janë më të çnueshëm dhe ka qënë e ndërgjegjshme për nevojën për të barazpeshuar detyrimin e shtetit për të mbrojtur dëshmitarët dhe viktimat me të drejtat e të akuzuarit në bazë të nenit 6 § 3 (d). Shteteve i'u është dashur të miratojnë procedura komplekse për të siguruar respektimin e kësaj barazpeshë. Përderisa procedura të tilla evoluojnë, vendimi i Gjykatës në lidhje me çështjen Rachdad merr vlera sepse bën të qartë edhe një herë se nëse një dënim bazohet vetëm në provat me të cilat i dënuari nuk ka patur mundësi të ballafaqohet dhe t'i kundërshtojë, atëhere kemi shkelje të nenit 6 të Konventës.

# NENI 7

**NUK KA DËNIM PA LIGJ**

## WELCH kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 17440/90)

9 shkurt 1995

*efekti prapaveprues i një mase që në formë nuk parashikon dënim administrativ, por në thelb përbën shkelje të nenit 7 § 1*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi u arrestua më 3 nëntor 1986 dhe u akuzua për trafik droge, që pretendohet të ishte kryer midis 1 janarit 1986 dhe ditës që ai u arrestua. Më 24 gusht 1988 ai u shpall fajtor në lidhje me pesë akuza që kishin të bënin me narkotikët dhe u dënua gjithsej me 22 vjet burg. Për më tepër, gjyqtari dha një urdhër që kërkuesit t'i konfiskoheshin 66,914 sterlinave në përputhje me Ligjin mbi Veprat Penale në lidhje me Trafikun e Drogës i vitit 1986. Në rast mos pagese, kërkuesi duhet t'i nënshtrohej dy viteve të tjera burgimi. Dispozitat e këtij Ligji hynë në fuqi vetëm më 12 janar 1987, pra, pas datave të kryerjes së shkeljes.

2. Kërkuesi e apeloj vendimin në Gjykatën e Apelit, e cila e uli dënimin me burg me dy vjet dhe gjobën me 7,000 sterlina.

3. Kërkesa iu paraqit Komisionit më 22 qershor 1990 dhe ajo u pranua më 12 shkurt 1993 sepse ngrinte probleme në bazë të nenit 7 të Konventës. Në pamundësi për arritur një zgjidhje me pajtim, Komisioni bëri një raport më 15 tetor 1993, në të cilin ai paraqiti faktet dhe shprehu mendimin se kishte shkelje të nenit 7<sup>101</sup>. Komisioni e dërgoi çështjen në Gjykatë më 15 janar 1994.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 7

4. Së pari, Gjykata theksoi se efekti prapaveprues i urdhërit për konfiskim nuk ishte kundërshtuar në këtë rast nga ana e qeverisë. Urdhëri u lëshua pas një dënimi lidhur me shkeljen për përdorim droge, e kryer përpara se Ligji i vitit 1986 të hynte në fuqi. Problemi i vetëm që duhej përcaktuar ishte nëse urdhëri përbente një dënim sipas kuptimit të nenit 7, pra, një dënim të dytë.

5. Pikënisja e çdo përcaktimi lidhur me ekzistencën e një dënimi penal është nëse masa në fjalë gjen zbatim duke u bazuar mbi bindjen e kryerjes së "një vepre penale".

<sup>101</sup> Është interesant të theksohet se ky qëndrim i Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut u votua me shtatë vota pro dhe shtatë kundër dhe ishte vota e Presidentit vota vendimtare për mbajtjen e këtij qëndrimi.



Disa faktorë të tjerë që mund të merren parasysh si të rëndësishëm janë natyra dhe qëllimi i sanksionit në këtë çështje, karakterizimi sipas ligjit kombëtar, procedurat e zbatueshme në aplikimin e masës, si dhe rreptësia e saj. Duke pasur parasysh lidhjen me një vepër penale duhet vlerësuar fakti se përpara se urdhëri të lëshohet mbi bazën e Ligjit të vitit 1986, i akuzuari duhet të jetë dënuar për një ose më shumë shkelje për trafik droge.

6. Gjykata ra dakord me qeverinë dhe Komisionin se rreptësia e urdhërit nuk është në vetvete vendimtare, përderisa shumë masa me karakter jopenal, të një natyre parandaluese, mund të kenë një ndikim thelbësor mbi personin në fjalë.

7. Megjithatë, elementet vijuese nxorën në pah se urdhëri i konfiskimit përbënte në fakt një dënim: prezumimi i parashikuar me ligj se çdo pasuri që kalon në duart e autorëve të veprave penale për një periudhë gjashtë vjeçare ishte fryt i trafikut të drogës, përveçse kur ai provonte të kundërtën; fakti se urdhëri i drejtohej produkteve të trafikut dhe nuk kufizohej në të ardhurat apo përfitimin efektiv të këtij trafiku, diskrecioni i gjyqtarit në caktimin e shumës së konfiskimit.

8. Duke parë përtej elementeve të dukshëm, cilido qoftë cilësimi i masave të konfiskimit sipas legjislacionit të brendshëm, fakti është se kërkuesi pësoi një dëm më të rëndë nga urdhëri i konfiskimit, sesa nga dënimi i tij për trafik droge.

9. Duke marrë në konsideratë ndërthurjen e elementeve të ndëshkimit, urdhëri i konfiskimit i shtohet, në rrethanat e këtij rasti, një ndëshkimi. Pra, ishte shkelur neni 7 § 1 i Konventës. Megjithatë, Gjykata nënvizoi se ky përfundim lidhet me zbatimin prapaveprues të legjislacionit që e parashikonte konfiskimin dhe nuk vuri në dyshim kompetencën e lëshimit të urdhërit të konfiskimit dhënë gjykatave si armë në luftën për zhdukjen e trafikut të drogës.

### **B. Në lidhje me ish nenin 50 (aktualisht neni 41)**

10. Gjykata nënvizoi se urdhëri i konfiskimit nuk kishte hyrë akoma në fuqi për shkak të procedurave përpara saj. Ajo konsideroi se në këto rrethana, çështja e shpërblimit të drejtë nuk ishte gati për gjykim. Çështja duhej të rezervohet dhe procedurat e mëtejshme të përcaktoheshin, me synimin për të arritur në një marrëveshje midis qeverisë dhe kërkuesit. (neni 54 §§ 1 dhe 4 i Rregullores A të Gjykatës). Gjithashtu, Gjykata i njohu kërkuesit të drejtën për shpërblim në masën prej 13,852.60 sterlina për shpenzimet ligjore, duke i zbritur shumën e paguar për ndihmë ligjore dhe duke marrë parasysh shpenzimet e procedurave të Strasburgut.

### **III. Koment**

11. Në këtë çështje Gjykata u mor me një aspekt interesant të nenit 7 § 1 në vetvete, pikërisht me faktin nëse urdhëri i konfiskimit për të cilin ankohej kërkuesi në këtë rast përbënte apo jo një dënim penal për qëllimet e nenit 7 të Konventës. Për të arritur përfundimin në lidhje me këtë element Gjykata iu referua jurisprudencës

së saj në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës<sup>102</sup> përsa i përket konceptit të “akuzës penale”, ku ajo vetë i ishte referuar thelbit të masës dhe pasojave të saj dhe jo formës dhe klasifikimit që masa konkrete kishte sipas të drejtës së brendshme.

12. Për të arritur në një përfundim në lidhje me këtë pikë Gjykata bën një analizë krahasimore tepër interesante të gjendjes së kërkuesit në kohën e kryerjes së veprës penale me kohën e zbatimit të urdhërit të konfiskimit. Me kujdes Gjykata vlerësoi se rasti ndryshonte në mënyrë thelbësore dhe se një përkeqësim të tillë mund ta sillte vetëm një masë me karakter penal. Me këtë teknikë tepër interesante, ajo arriti në përfundimin se masa e konfiskimit e urdhëruar nga autoritetet britanike kishte në thelb tiparet e një dënimi penal dhe jo të një mase me karakter administrativ. Që nga arritja e këtij përfundimi, deklarimi i shkeljes së nenit 7 § 1 të Konventës në këtë çështje ishte më se i pritshëm, meqenëse efekti prapaveprues i Ligjit mbi Veprat Penale në lidhje me Trafikun e Drogës i vitit 1986 nuk ishte kundërshtuar as nga qeveria britanike.

## S.W. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 20166/92)

22 nëntor 1995

*Në kushtet e zhvillimeve të qarta jurisprudenciale, edhe kur legjislacioni nuk parashikon shprehimisht një vepër penale mund të mos kemi shkelje të nenit 7 kur kjo vepër është zbatuar në vazhdimësi nga gjykatat vendase*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi ishte shtetas britanik. Pas shumë vitesh jete të vështirë bashkëshortore, gruaja e tij më 18 shtator 1990 i tha se për të martesa kishte marrë fund. Gjatë pasdites vonë kërkuesi e detyroi gruan të kryente marrëdhënie seksuale me të kundër dëshirës së saj. Kërkuesi u akuzua për përdhunim, për kërcënime për vrasje dhe fyerje. Gjyqi ndaj tij filloi më 16 prill 1991.

2. Një muaj më parë, Gjykata e Apelit në Angli e kishte lënë në fuqi dënimin për çështjen R. kundër R. të një burri tjetër, i cili ishte përpjekur të përdhunonte gruan e tij. Kryetari i Gjykatës së Lordëve, Lordi Lane, vendosi se megjithëse Matthew Hale kishte shkruar më 1736, se burri nuk mund të përdhunonte gruan e tij pasi ajo kishte pranuar të kishte marrëdhënie seksuale me të që ditën e martesës, që prej asaj kohe ligji zakonor kishte përpunuar shumë përjashtime të këtij rregulli. Ky ishte një përdorim legjitim i ligjit zakonor, i cili duhet dhe mund t'i adoptohej ndryshimeve shoqërore. Përderisa Rregullit Hale iu bënë shumë përjashtime dhe përderisa rregulli

<sup>102</sup> Shih vendimin e 28 qershorit 1984 në lidhje me çështjen Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar, të përfshirë në këtë përmbledhje.

qe i vjetruar dhe përçmues, ishte detyra e Gjykatës të mos e zbatonte atë në qoftë se qe e mundur. Lordi Lane vlerësoi se arsyetimi për fjalën "jo e ligjshme" në seksionin 1 (1) të Ligjit mbi Krimet Seksuale të vitit 1976, përjashtonte marrëdhëniet gjatë martesës nga përkufizimi i përdhunimit, por doli në përfundimin se kjo dispozitë e parashikuar me ligj nuk ishte një pengesë për të deklaruar se imuniteti i regjimit bashkëshortor nuk ekzistonte më.

3. Në rastin e kërkuarit, Gjyqtari Rose e vijoi jurisprudencën e Gjykatës së Apelit. Mbrojtja tregoi se ky vendim kishte pasur në të kaluarën një rrjedhojë që vinte në kundërshtim me nenin 7 § 1 të Konventës. Megjithatë, gjyqtari u shpreh se imuniteti bashkëshortor nuk ishte pranuar më nga gjykatat angleze gjatë 40 vjetëve të fundit me qëllimin që ky imunitet të mos ekzistonte më dhe se ky zhvillim i ligjit zakonor ishte i pajtueshëm me nenin 7. Kërkuari u dënua nga juria për të tria shkeljet me pesë vjet burg. Ai e apeloj vendimin për fajësinë dhe dënimin të dhënë, por e tërhoqi të parin kur Dhoma e Lordëve la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit në çështjen R. kundër R.

4. Kërkesa që kërkuari bëri më 29 mars 1992 u pranua nga Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut më 14 janar 1994. Në mungesë të arritjes së në një zgjidhje me pajtim, Komisioni bëri një raport më 26 qershor 1994, ku paraqiti faktet dhe shprehu mendimin e tij se nuk kishte shkelje të nenit 7 § 1 të Konventës. Komisioni ia paraqiti çështjen Gjykatës më 9 shtator 1994.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Mbi parimet e përgjithshme

5. Garancia e parashikuar në nenin 7 zë një vend parësor në sistemin mbrojtës të Konventës. Kjo duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të sigurojë një mbrojtje efektive kundër një hetimi, një dënimi apo ndëshkimi arbitrar. Ajo tregon se vetëm ligji mund të përkufizojë një krim dhe të urdhërojë një ndëshkim, se ligji penal nuk duhet të analizojë gjerësisht dënimin e të akuzuarit dhe se një shkelje duhet të përcaktohet qartë nga ligji.

6. Megjithatë, sado i qartë të jetë teksti i ligjit, në një sistem ligjor ka gjithmonë një hapësirë interpretimi, shpjegim të pikave të dyshimta dhe përshtatje ndaj rrethanave të ndryshueshme. Neni 7 nuk duhet të interpretohet sikur nxjerr jashtë parashikimit të ligjit këtë proces, ai parashikon se zhvillimi që rrjedh përputhet me thelbin e shkeljes dhe në mënyrë të arsyeshme mund të parashikohet.

### B. Mbi zbatimin e parimeve të lartpërmendura

7. Gjykata rikujtoi se autoritetet vendase kishin për detyrë të interpretonin dhe zbatonin ligjin e brendshëm dhe nuk gjeti asnjë arsye për të mos rënë dakord me Gjykatën e Apelit në çështjen R. k. R. për kuptimin e termit "të paligjshëm" në seksionin 1 (1) të Ligjit të vitit 1976, mbi Krimet Seksuale. Ky vendim nuk ishte gjë tjetër veçse një vazhdim i rasteve ku zhvillohej një zëbrithim i imunitetit bashkëshortor.

8. Duke u bazuar në ligj, nuk vihej në dyshim fakti se kur një burrë e detyronte me forcë gruan e tij për të pasur marrëdhënie seksuale me të, mund të quhej fajtor për përdhunim në rrethana të posaçme. Për më tepër, në vendimet e dhëna dallohej një orientim i qartë, i cili e pranonte në thelb si vepër penale këtë akt dhe e konsideronte këtë akt brenda qëllimit të përdhunimit. Ky zhvillim arriti një nivel të tillë ku njohja juridike e mungesës së imunitetit u bë në mënyrë normalisht e parashikueshme. Karakteri poshtëruës i përdhunimit ishte kaq i dukshëm sa që vendimet e gjykatave vendase nuk mund të quheshin si të ndryshme nga objekti dhe qëllimi i nenit 7, as me synimet kryesore të Konventës dhe as për respektin ndaj dinjitetit dhe lirisë njerëzore.

9. Pra, duke vijuar jurisprudencën e Gjykatës së Apelit në çështjen R. kundër R., në çështjen e kërkuarit gjyqtari Rose mori një vendim të pajtueshëm me nenin 7 § 1 të Konventës.

### III. Koment

10. Gjykata në këtë vendim, ashtu si edhe në një tjetër të ngjashëm të dhënë në të njëjtën datë në lidhje me çështjen *CR kundër Mbretërisë së Bashkuar*, mbështet një doktrinë interesante, atë të sqarimit të përshkallëzuar të normave mbi përgjegjësinë penale, i cili megjithëse është mjaft i përdorur në sistemin ligjor të *common law*, duket se mund të gjejë vlerën e vet edhe në sistemin ligjor të *civil law*, sikundër është sistemi ligjor shqiptar. Sidoqoftë, Gjykata thekson se kjo doktrinë mund të jetë e pranueshme në kuadrin e nenit 7 § 1 të Konventës për aq sa sqarimi gradual është ‘në përputhje me thelbin e veprës penale dhe është normalisht i parashikueshëm’.

11. Nga ana tjetër, kjo doktrinë shpreh nevojën e një njohjeje të vazhdueshme të jurisprudencës të gjykatave të brendshme jo vetëm nga gjyqtarët dhe prokurorët, por edhe nga avokatët. Sidoqoftë, kjo doktrinë nuk mund të përbëjë një udhëzues absolutisht të qartë dhe zbatimi i një dënimi penal në raste si ky që po komentojmë nuk është një detyrë aspak e lehtë. Ndoshta në vendimin e Gjykatës së Strasburgut ka ndikuar edhe brutaliteti i aktit të përdhunimit, por gjithsesi duhet pasur parasysh edhe një prirje e përgjithshme e jurisprudencës së saj, por edhe e legjislacionit të vendeve evropiane për të dënuar çdo formë të këtij akti<sup>103</sup>.

<sup>103</sup> Shih për shembull vendimin e saj të 4 dhjetorit 2003, në lidhje me çështjen M.C. kundër Bullgarisë, të përfshirë në këtë botim.

## VEEBER kundër ESTONISË (NR. 2)

(kërkesa nr. 45771/99)

21 janar 2003

*në këtë çështje efekti prapaveprues i së drejtës penale u gjet në kundërshtim me Konventën*

### I. Faktet kryesore

1. Tiit Veeber ka lindur më 1948 dhe jeton në Tartu, Estoni. Ai është pronari i shoqërisë AS Giga dhe kryetar i Bordit të saj. Ai është gjithashtu kryetar i Bordit të shoqërisë AS Tartu Jõujaam.

2. Më 7 tetor 1996, si kryetar i Bordit të këtyre dy shoqërive dhe si pronar i së parës, ai u akuzua në bazë të nenit 148/1 § 7 të Kodit Penal për falsifikim dokumentesh dhe krijim dokumentesh të rreme në pesë raste në periudhën 1993-1994 për të treguar marrëdhënie tregtare me një shoqëri të paqenë, për përdorim të dokumenteve të rreme në lidhje me dokumentet e pagave më 1994 dhe 1995 dhe për lidhjen, më 12 maj 1995, të një kontrate fiktive për të shmangur pagimin e taksave.

3. Më 13 tetor 1997 kërkuesi u gjet fajtor për akuzat të cilat i ishin ngarkuar dhe iu dha një dënim me burg me kusht prej tre vjet e gjashtë muaj. Në vendimin e dënimit të kërkuesit për shmangie nga detyrimet fiskale në bazë të nenit 148/1 § 7 të Kodit Penal, gjykata interpretoi se veprat penale kishin filluar të konsumoheshin në tremujorin e katërt të vitit 1993 dhe se vepra e fundit u konsumua më 12 maj 1995. Ajo vlerësoi se këto akte përbënin një vepër penale me karakter vazhdues. Kërkuesi u urdhërua gjithashtu që t'u paguante autoriteteve fiskale 853 550 korona estoneze.

4. Kërkuesi e apeloj këtë vendim duke pretenduar se neni 148/1 § 7 i Kodit Penal kishte pasur efekt prapaveprues, përderisa ai kishte hyrë në fuqi vetëm më 13 janar 1995. Dënime në bazë të këtij neni, për akte të kryera përpara kësaj date, mund të zbatoheshin vetëm nëse personi përgjegjës kishte qenë subjekt i një dënimi me karakter administrativ, ose ishte dënuar penalisht më parë për të njëjtat akte. Megjithatë, apelimi i tij nuk u pranua.

### II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesi pretendonte ndërmjet të tjerash, se dënimi i tij përbënte një zbatimin me efekt prapaveprues të një ligji penal, duke shkelur kështu nenin 7 § 1 të Konventës.

**A. Në lidhje me nenin 7 § 1**

6. Gjykata e Strasburgut vuri në dukje se një numër i konsiderueshëm aktesh, për të cilët kërkuesi u gjet fajtor, kishin ndodhur tërësisht përpara janarit 1995 dhe se dënimi që iu dha atij mbante parasysh aktet e kryera si përpara, ashtu edhe pas janarit 1995.

7. Gjykata i mori parasysh argumentet e qeverisë estoneze, sipas të cilës jurisprudenca e Gjykatës së Lartë estoneze mbi zbatimin dhe interpretimin e variantit të vitit 1995, të nenit 148/1 të Kodit Penal, e bënte më se të parashikueshëm dënimin për kërkuesin dhe për çdo të interesuar. Megjithatë, vendimet e Gjykatës së Lartë që ravigëzonin këtë jurisprudencë ishin dhënë vetëm në prill të vitit 1997 dhe janar të vitit 1998. Ankesa e kërkuesit kishte të bënte me akte të kryera ndërmjet viteve 1993 dhe 1994, periudhë gjatë së cilës ai nuk mundej që, duke pasur parasysh legjislacionin penal të zbatueshëm në atë kohë, të parashikonte që rrezikonte një dënim penal sapo të zbuloheshin aktet e tij.

8. Duke nënvizuar në bazë të këtij interpretimi që gjykatat estoneze e kishin zbatuar në mënyrë prapavepruese ligjin e vitit 1995 në lidhje me sjellje që më parë nuk përbënin vepra penale, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 7 § 1.

**B. Në lidhje me nenin 41**

9. Gjykata i njohu kërkuesit të drejtën për dëmshpërblim në shumën prej 2 000 eurosh për dëm jomaterial dhe 840.90 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

**III. Koment**

10. Parimi se ligji penal nuk ka fuqi prapavepruese, i parashikuar në nenin 7 § 1 të Konventës ka qenë objekt i një jurisprudence mjaft të kufizuar përpara Gjykatës. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se ai mishëron një parim të përgjithshëm, sipas të cilit çdo veprë penale duhet të parashikohet me ligj dhe që një individ duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë nga perifrazimi i dispozitave të zbatueshme dhe në qoftë se është nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të dispozitës, se çfarë veprimeve dhe mosveprimeve do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Kjo nënkupton që ligji duhet të jetë i kuptueshëm në mënyrë të përshtatshme dhe se një individ duhet të jetë në gjendje të parashikojë pasojat e veprimeve të tij me qëllim që të jetë në gjendje të shmangë sanksionet penale ndaj tij.

11. Kur bëhet fjalë për parashikueshmëri, pra, për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e akteve të veta, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe për këtë arsye një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm. Megjithatë, dallimi ndërmjet koncepteve të arsyeshme dhe të paarsyeshme nuk është gjithmonë i qartë. Në çështjen *S.W. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkuesi arriti të kundërshtonte zhvillimet e jurisprudencës angleze, e cila kishte arritur deri në njohjen si përgjegjës penalisht të burrave që kryenin marrëdhënie seksuale me dhunë



me gratë e tyre. Gjykata nuk pati ndonjë vështirësi që të pranonte se pasojat e këtij veprimi ishin të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme, duke pasur në mënyrë të veçantë parasysh edhe natyrën e aktit, marrëdhënie seksuale me dhunë, i cili ishte tepër degradues. Kritikën që i janë bërë kësaj jurisprudence kanë argumentuar se Gjykata kishte shkuar tepër larg dhe se ky lloj zhvillimi ligjor duhej bërë me legjislacion dhe jo në mënyrë prapavepruese nga gjykatat. Vendimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen Veeber duket se zbulon faktin se zhvillimet jurisprudenciale që janë në përputhje me thelbin dhe kuptimin e Konventës do të mund të deklarohen më shpesh si të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme.

## ALIMUÇAJ kundër SHQIPËRISË<sup>104</sup>

(kërkesa nr. 20134/05)

7 shkurt 2012

*veprimi prapaveprues i ligjit penal cenon të drejtën e garantuar nga neni 7 i Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi ishte administrator i shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k, e cila zhvilloi aktivitet tregtar nga viti 1992 deri në 1997. Ndër aktivitetet e tjera tregtare shoqria u përfshi edhe në skemën piramidale të kredimarrjes. Pas shpalljes së falimentimit nga kompania ajo u morr në dorëzim nga administratorë të caktuar për të përmbyllur procesin e falimentit<sup>105</sup>. Ndërkohë, në prill 1998 kërkuesi u akuzua se kishte pëer veprën penale të mashtrimit, në bashkëpunim dhe u arrestua.
2. Pas dy serish procedurash apeli ndaj masës së sigurimit kërkuesi nuk arriti të zhvleftësojë atë. Afati i masës së sigurimit personal “arrest me burg” u zgjat deri në maj 2000 me argumentimin se kërkuesi ishte akuzuar edhe për krijimin e një organizate kriminale dhe se hemiti i është ishte tepër kompleks.
3. Në maj 2000 Gjykata e Rrethit Tiranë e deklaroi kërkuesin fajtor për mashtrim dhe e dënoi atë me pesë vjet heqje lirie. Ndërkohë, gjykata nuk e deklaroi atë fajtor për veprën penale të krijimit të një organizate kriminale. Gjykata vërejti se mashtrimi ishte kryer në dëm të 68,85 kreditorëve dhe arrinte në vlerën totale 325 300.00 dollarë.
4. Pas apelit të bërë nga prokurori, në dhjetor 2002 Gjykata e Apelit deklaroi kërkuesin

<sup>104</sup> Ky vendim është marrë në mënyrë integrale nga libri i znj. Dajena Kumbaro “Versus Albania: jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, botim i Qendrës Evropiane dhe Civil Rights Defenders 2014. Znj. Kumbaro ka miratuar përdorimin e materialit për efekt të këtij botimi.

<sup>105</sup> Detaje të hollësishme mbi aktivitetin e kompanisë “Vefa Holding” sh.p.k mund të konsultohen në vendimin Vefa Holding sh.p.k dhe Alimuçaj k. Shqipërisë, nr. 24096/05, 14 qershor 2011, i cili është shpallur papranueshëm nga GJEDNJ.

fajtor për mashtrimin e 57 923 kreditorëve dhe e dënoi atë me 20 vjet heqje lirie në bazë të nenit 143 § 3 të Kodit Penal, i cili kishte hyrë në fuqi në janar 2001. Gjykata uli numrin e kreditorëve të kompanisë i pasojë e një rilogaritjeje të bërë gjatë fazë së likuidimit.

5. Në nëntor 2002 Gjykata e Lartë duke u mbështetur në faktet e evidentuara nga gjykatat më të ulëta e shpalli fajtor kërkuesin. GJL uli masën e dëmit të shkaktuar si pasojë e mashtrimit.

6. Në dhjetor 2004 Gjykata Kushtetuese e deklaroi ankimin kushtetues të kërkuesit të papranueshëm.

7. Prej prillit 1998 kërkuesi kishte shfaqur gjendje shëndetësore jo të mirë. Ai ishte diagnostikuar me një sërë sëmundjesh për pasojë ai u transferua disa herë në spital gjatë kohës së vuajtjes së dënimit për të marrë trajtimin e duhur mjekësor.

8. Gjatë viteve 2002-2007 dënimi i kërkuesit u ul si pasojë e amnistive të dhëna dhe punës së kryer prej tij në burg. Ai u lirua në maj 2010.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimin për shkelje të neneve 2 dhe 3

9. Gjykata çmoi se pretendimi i kërkuesit duhet të trajtohej nën dritën e parashikimeve të nenit 3<sup>106</sup> të Konventës. GJEDNJ vërejti se autoritetet nuk kishin lënë pas dore trajtimin mjekësor të kërkuesit, duke i siguruar atij mjekimet dhe kujdesin e duhur gjatë periudhës kur Z. Alimuçaj kishte shfaqur probleme serjoze shëndetësore. Në bazë të gjithë të dhënave të dosjes Gjykata vërejti se nuk ishte shkaktuar shkelje e të drejtës së parashikuar nga neni 3 i KEDNJ dhe për rrjedhojë e deklaroi ankimin e kërkuesit haptazi të pabazuar në bazë të nenit 35 § 1 dhe 4 të Konventës.

### B. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 5 dhe 6

10. Gjykata vërejti se kërkuesi ishte ankuar për tejzgjatje të periudhës së tij të paraburgimit në tejkallim të afatit gjashtë mujor nga vendimi i fundit i gjykatëve të brendshme, kështuqë për rrjedhojë kjo kërkesë e tij nuk mund të merrej në konsideratë. Gjykata e deklaroi atë haptazi të pabazuar dhe e rrëzoi në bazë të nenit 35 § 1 dhe 4 të Konventës. Gjykata mbajti të njëjtin qëndrim edhe për pretendimin e kërkuesit se ndaj tij nuk ishte respektuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor.

### C. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 7

11. Gjykata vërejti se kërkuesi u akuzua dhe u dënua në bazë të nenit 143 § 1 të Kodit Penal, i cili parashikoi veprën penale të mashtrimit. GJEDNJ çoi se gjykatat shqiptare përdorën për cilësimin e veprës dhe dënimit e kërkuesit ligjin në fuqi në kohën kur po zhvillohej gjyqi. Gjykatat vendase cilësuan se kërkuesi në mënyrë të qëllimshme kishte konsumuar veprën penale të mashtrimit. GJEDNJ u shpreh se

<sup>106</sup> Shih çështjen Douglas-William k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 564613/00, 8 janar 2002.

ky cilësim i kryer nga gjykatat vendase nuk ishte arbitrar ose i paarsyeshëm. Për rrjedhojë Gjykata nuk vërejtë shkelje të nenit 7 të Konventës në këtë aspekt.

12. Gjykata e Strasburgut vlerësoi dhe mënyrën e llogaritjes së dënimit për kërkuesin. GJEDNJ vërejtë se në kohën kur kishte ndodhur vepra penale ajo dënohej në maksimum me pesë vjet heqje lirie dhe neni respektiv i Kodit Penal nuk parashikonte asnjë rrethanë rënduese e cila të rriste masën e dënimit për veprën. Megjithatë, gjykatat shqiptare kishin llogaritur dënimin e kërkuesit në bazë të ndryshimeve, që i`u bënë dispozitës në fjalë në vitin 2001. Për më tepër Gjykata e Lartë shqiptare në shtator 2000 kishte miratuar një vendim unifikues në të cilin shprehej se dënimi për veprën penale të mashtrimit do të llogaritej aq herë sa herë ishte konsumuar vepra. Në këtë llogjikë kërkuesi u dënua 57 923 herë, po dënimi i tij final nuk mund të kalonte kufirin e maksimumit të dënit parashikuar nga Kodi Penal, kështu që gjykatat e dënuan atë me 20 vjet burg.

13. GJEDNJ vërejtë se dënimi i kërkuesit ishte llogaritur në bazë të një dispozite, e cila ishte miratuar pasi vepra penale ishte kryer. Kështu dispozitës në fjalë i ishte dhënë fuqi prapavepruese edhe në kohën kur kërkuesi kishte kryer veprën penale. Për rrjedhojë Gjykata e Strasburgut e cilësoi këtë vendim të gjykatave shqiptare si të paligjshëm dhe çmoi se z. Alimuçaj i ishin shkelur të drejtat e parashikuara nga neni 7 i Konventës.

#### ***D. Në lidhje me zbatimin e nenit 41***

14. Gjykata vërejtë se nuk kishte evidentuar lidhje shkakësore mes shkeljes së të drejtave të kërkuesit dhe shpërblimit monetar të pretenduar. Gjithsesi GJEDNJ i akordoi z. Alimuçaj 8 000 euro në kuadër të shpërblimit jo monetar.

### **III. Koment**

15. Në shqyrtimin e çështjes Alimuçaj kundër Shqipërisë, Gjykata e Strasburgut ka vërejtur cenim të të drejtave të garantuara nga neni 7 i Konventës për kërkuesin. Gjykata në këtë vendim ka risjellë edhe një herë në vemendje parashikimin e nenit 7 dhe standardet, që duhet të aplikohen në zbatim të tij.

16. Sipas GJEDNJ garancia e dhënë nga neni 7 KEDNJ se nuk ka dënim pa ligj është një ndër garancitë themelore të mbi të cilat mbështetet shteti i së drejtës, nga kjo e drejtë nuk mund të ketë asnjë derogim, as në kohë lufte ose emergjencash publike<sup>107</sup>. Neni 7 i Konventës nuk pengon vetëm veprimin prapaveprues të ligjeve penale, por gjithashtu trajton në mënyrë të përgjithshme parimin nullum crimen, nulla poena sine lege. Pra, nëse nuk ka krim nuk mund të ketë ndëshkim. Kur cilëson termin “ligj”, neni 7 i KEDNJ i referohet çdo akti tjetër normativ ose vendimi gjyqësor, i cili ka karakter detyrues. Megjithatë, Gjykata u shpreh se neni 7 i Konventës nuk pengon Shtetet Palë të ndryshojnë dënimet për veprat penale duke rritur kështu ashpërsinë e tyre<sup>108</sup>.

<sup>107</sup> Shih çështjen Scoppola k. Italisë (nr. 2), nr. 10249/03, GJEDNJ-2009.

<sup>108</sup> Shih Çështjet Streletz, Kessler dhe Kenz k Gjermanisë, nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, GJEDNJ 2001-II, Konomov k. Letonisë, nr. 36376/04, GJEDNJ 2010 dhe K. H. W k. Gjermanisë, nr. 37201/97 GJEDNJ 2001-II.

## STRELETZ, KESSLER DHE KRENZ kundër GJERMANISË DHE K-H. W kundër GJERMANISË

(kërkesat 34044/96; 35532/97; 44801/98 dhe 37201/97)

22 mars 2001

*në një vendim me rëndësi themelore për gjendjen post-komuniste shqiptare, Gjykata thekson se një akt duhet të dënohet edhe në qoftë se nuk parashikohet si vepër penale nga e drejta e brendshme, për aq kohë sa parashikohet si i tillë nga e drejta ndërkombëtare*

### I. Faktet kryesore

1. Tre nga kërkuesit, shtetas gjermanë, kishin qenë zyrtarë të lartë në Republikën Demokratike Gjermane (R.D.Gj.): Fritz Strelets, lindur më 1926 kishte qenë Zëvendës Ministër i Mbrojtjes; Heinz Kessler, lindur më 1920, kishte qenë Ministër i Mbrojtjes; Egon Krenz, lindur më 1937 kishte qenë President i Këshillit të Shtetit.
2. Kërkuesi i katërt, z. K-H. W., po ashtu shtetas gjerman, kishte lindur më 1952. Ai kishte qenë anëtar i Ushtrisë Popullore Kombëtare të R.D.Gj.-së (NVA) dhe kishte qenë roje në kufirin ndërmjet dy shteteve gjermane të asaj kohe.
3. Të katër kërkuesit ishin dënuar nga gjykatat e Republikës Federale Gjermane (R.F.Gj.) pas bashkimit të dy Gjermanive më 3 tetor 1990, në bazë të dispozitave përkatëse të Kodit Penal të R.D.Gj.-së, dhe në vijim në bazë të dispozitave të Kodit Penal të R.F.Gj.-së, të cilat ishin më të buta se ato të Kodit Penal të R.D.Gj.-së.
4. Z. Streletz, z. Kessler dhe z. Krenz ishin dënuar me heqje lirie respektivisht pesë vjet e gjysmë, shtatë vjet e gjysmë dhe gjashtë vjet e gjysmë, si pjesëmarrës kryesorë indirekt në vrasje me paramendim (*Totschlag in mittelbarer Täterschaft*), mbi bazën e argumentimit që në sajë të pjesëmarrjes së tyre në vendimarrjen nga autoritetet më të larta të R.D.Gj.-së, siç ishte Këshilli Kombëtar i Mbrojtjes ose *Politbüro*, në lidhje me regjimin e kontrollit dhe ruajtjes së kufirit të R.D.Gj.-së (*Grenzregime*) ata ishin përgjegjës për vdekjen e një numri njerëzish, të cilët ishin përpjekur të iknin nga R.D.Gj.-ja duke kaluar kufirin midis dy Gjermanive ndërmjet viteve 1971 dhe 1989.
5. Z. W. u dënua me një vit dhe dhjetë muaj heqje lirie, për vrasje me paramendim (*totschlag*), pasi duke përdorur armën e tij të zjarrit kishte shkaktuar vdekjen e një personi që ishte përpjekur të ikte nga R.D.Gj.-ja duke kaluar kufirin më 1972.
6. Dënimet e kërkuesve u lanë në fuqi nga Gjykata Federale e Drejtësisë dhe u deklaruan nga Gjykata Kushtetuese Federale si në përputhje me Kushtetutën.

## II. Vendimet e Gjykatës

7. Kërkuesit pretendonin se veprimet e tyre, në kohën që ato ishin kryer nuk përbënin vepra penale në bazë të së drejtës së R.D.Gj.-së, ose të së drejtës ndërkombëtare dhe se dënimet e tyre nga ana e gjykatave gjermane, për këtë arsye, përbënin shkelje të nenit 7 § 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (s'ka dënim pa ligj). Ata bazoheshin gjithashtu në nenet 1 (detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut) dhe 2 § 2 (përjashtimet e së drejtës për të jetuar) të Konventës.

8. Arsyetimi nga ana e Gjykatës e të dy vendimeve është pothuajse i njëjtë, me përjashtim të rasteve kur është vënë në dukje shprehimisht në vijim.

### A. Në lidhje me nenin 7 § 1

9. Gjykata vuri në dukje se detyra e saj ishte që të vlerësonte, nën këndvështrimin e nenit 7 § 1 të Konventës, nëse aktet e kërkuesve, në kohën kur ishin kryer, përbënin shkelje të përkufizuara me një parashikueshmëri dhe mundësi të mjaftueshme për t'u njohur në bazë të së drejtës së R.D.Gj.-së ose të së drejtës ndërkombëtare.

#### a) E drejta e brendshme e R.D.Gj.-së

##### i. Baza ligjore për dënimet

10. Gjykata vuri në dukje se baza ligjore për dënimet e kërkuesve ishte e drejta penale e R.D.Gj.-së, e zbatueshme në kohën e kryerjes së veprës dhe se dënimet e tyre i korrespondonin në parim atyre të parashikuara në dispozitat përkatëse të legjislacionit të R.D.Gj.-së. Në rastin në fjalë madje, dënimet e dhëna ndaj kërkuesve kishin qenë më të ulëta në sajë të parimit të zbatimit të ligjit më të favorshëm, pra, ai i R.F.Gj.-së.

##### ii. Bazat për justifikimin sipas së drejtës së R.D.Gj.-së

11. Kërkuesit bazoheshin në mënyrë të veçantë në seksionin 17 § 1 të Aktit të Policisë Popullore të R.D.Gj.-së dhe në seksionin 27 § 2 të Aktit mbi Kufijtë Shtetërorë. Nën dritën e parimeve të mishëruara në Kushtetutën e R.D.Gj.-së dhe në dispozitat e tjera ligjore (të cilat përfshinin shprehimisht parimin e proporcionalitetit dhe nevojën për të ruajtur jetën njerëzore kur përdoreshin armët e zjarrit), Gjykata konsideroi se dënimi i kërkuesve nga ana e gjykatave gjermane, të cilat kishin interpretuar këto dispozita dhe i kishin zbatuar ato në rastin konkret, nuk dukej në pamje të parë që të kishte qenë arbitrar ose në kundërshtim me nenin 7 § 1 të Konventës.

##### iii. Bazat për justifikimin sipas praktikës shtetërore të R.D.Gj.-së

12. Gjykata vuri në dukje se megjithë se qëllimi i praktikës shtetërore të R.D.Gj.-së ka qenë që të mbrojë "me çdo kusht" kufirin ndërmjet dy shteteve gjermane me synim që të ruajë ekzistencën e R.D.Gj.-së e cila ishte e kërcënuar nga eksodi masiv i popullsisë së vet, ky "raison d'Etat" duhej kufizuar nga parimet e shpallura në Kushtetutën dhe legjislacionin e vetë R.D.Gj.-së. Para së gjithash, duhej respektuar nevoja për të ruajtur jetën njerëzore e mishëruar kjo në Kushtetutën e R.D.Gj.-së, në Ligjin mbi Policinë Popullore dhe Ligjin mbi Kufirin Shtetëror, duke mbajtur

parasysh edhe faktin që edhe në kohën e kryerjes së veprës e drejta për të jetuar ishte ndërkaq vlere më e lartë në hierarkinë e të drejtave të njeriut në nivel ndërkombëtar.

*iv. Parashikueshmëria e dënimit*

13. Në lidhje me çështjen *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë*, Gjykata vlerësoi se hendeku i madh ndërmjet legjislacionit dhe praktikës së R.D.Gj.-së ishte në një masë të madhe rezultat edhe i punës së vetë kërkuesve. Për shkak të pozitave tepër të larta që ata mbanin në aparatet shtetëror, ata nuk mund të mos kishin qenë në dijeni të Kushtetutës dhe të legjislacionit të R.D.Gj.-së, ose të detyrimeve të saj ndërkombëtare dhe kritikave ndërkombëtare ndaj regjimit policor të kufirit të tyre. Për më tepër ata vetë kishin vënë në zbatim ose ruajtur këtë regjim, duke dalë përmbi ligjin, që ishte botuar edhe në *Gazetën Zyrtare të R.D.Gj.-së*, me anë të urdhërave sekrete dhe udhëzimeve të shërbimit në lidhje me përforcimin dhe përmirësimin e mbrojtjes së kufirit dhe mbi përdorimin e armëve të zjarrit. Pra, kërkuesit kishin qenë drejtpërdrejt përgjegjës për gjendjen në kufirin ndërmjet dy shteteve gjermane që nga fillimi i vitit 1960 deri në rënien e Murit të Berlinit më 1989.

14. Në lidhje me çështjen *K-H.W. kundër Gjermanisë* Gjykata mbajti qëndrimin se edhe një ushtar i thjeshtë mund të mos kishte treguar bindje të verbër dhe të plotë ndaj urdhrave që në mënyrë flagrante shkelin jo vetëm parimet ligjore të R.D.Gj.-së, por edhe të drejtat e njeriut të njohura në nivel ndërkombëtar, e në veçanti të së drejtës për të jetuar, vlerës mbizotëruese në hierarkinë e të drejtave të njeriut.

15. Edhe pse kërkuesi kishte qenë në një pozitë veçanërisht të vështirë duke pasur parasysh situatën politike në R.D.Gj. në kohën e veprës, urdhëra të tillë nuk do të mund të justifikonin përdorimin e zjarrit ndaj personave të paarmatosur, të cilët vetëm po përpiqeshin të largoheshin nga vendi.

16. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se gjykatat gjermane kishin vlerësuar deri në hollësi rrethanat lehtësuese në dobi të kërkuesit dhe kishin mbajtur siç duhej parasysh ndryshimet në përgjegjësi ndërmjet ish liderëve të R.D.Gj.-së dhe kërkuesit duke i dënuar të parët me heqje lirie dhe të fundit me dënim me kusht.

17. Gjykata duke arsyetuar njësoj për të dyja çështjet vlerësoi se ishte e ligjshme për një shtet të qeverisur nga e drejta, që të fillonin një proces penal ndaj personave që kishin kryer një krim në një regjim të mëparshëm. Nga ana tjetër, gjykatat e këtij shteti duke pas marrë vendin e atyre që kishin ekzistuar më parë nuk mund të kritikohen për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore në fuqi në kohën e kryerjes së akteve në dritën e parimeve që sundojnë një shtet që respekton parimin e shtetit të së drejtës.

18. Për më tepër, duke pasur parasysh përparësinë e të drejtës për të jetuar të parashikuar në të gjitha instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë edhe vetë Konventën, në të cilën e drejta për të jetuar garantohet nga neni 2, Gjykata vlerësoi se interpretimi i ngushtë nga gjykatat gjermane i



legjislacionit të R.D.Gj.-së në rastin në fjalë ishte në përputhje me nenin 7 § 1 të Konventës.

19. Së fundi, Gjykata vlerësoi se praktika e një shteti, sikundër politika policore kufitare e R.D.Gj.-së, e cila shkelte në mënyrë të dukshme të drejtat e njeriut dhe për më tepër të drejtën për jetën, nuk mund të përfshihej në mbrojtjen e nenit 7 § 1 të Konventës. Kjo praktikë, e cila zhvlerësonte vetë thelbin e legjislacionit në të cilin ajo supozohej të mbështetej dhe që detyronte të gjitha organeve të R.D.Gj.-së përfshirë ato gjyqësore, nuk mund të karakterizohet si "ligj" në kuptimin e nenit 7 të Konventës.

20. Duke pasur parasysh të gjitha sa më lart, Gjykata ishte e mendimit se në kohën kur u kryen aktet e kërkuesve përbënin vepra penale të përcaktuara me mundësi njohjeje dhe parashikueshmërie të mjaftueshme nga e drejta e R.D.Gj.-së.

*b) E drejta ndërkombëtare*

*i. E drejta e zbatueshme*

21. Gjykata vlerësoi se ishte detyra e saj që të shqyrtonte rastet që i paraqiteshin edhe nga këndvështrimi i parimeve të së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht atyre që lidheshin me mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në të cilat gjykatat gjermane ishin referuar.

*ii. Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtës për të jetuar*

22. Në këtë kuadër, Gjykata vuri së pari në dukje se në procesin e zhvillimit të kësaj mbrojtjeje konventat përkatëse dhe instrumentet e tjerë kishin pohuar vazhdimisht përparësinë e së drejtës për të jetuar.

23. Ajo, duke patur parasysh argumentet e lartpërmendura, vendosi se veprimet e kërkuesve nuk ishin të justifikueshme në asnjë nga mënyrat e përjashtimeve të së drejtës për të jetuar të parashikuara në nenin 2 § 2 të Konventës.

*iii. Mbrojtja ndërkombëtare e lirisë për të lëvizur*

24. Si neni 2 § 2 i Protokollit 4 të Konventës, ashtu edhe neni 12 § 2 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike parashikojnë se "Çdokush duhet të jetë i lirë të largohet nga çdo vend, përfshirë edhe vendin e vet".

*iv. Përgjegjësia shtetërore e R.D.Gj.-së dhe përgjegjësia individuale e kërkuesve*

25. Në qoftë se R.D.Gj.-ja do të kishte vazhduar të ekzistonte ajo do të ishte përgjegjëse si shtet nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare për veprimet në fjalë. Ngelej të përcaktohej nëse përveç kësaj përgjegjësie shtetërore kishin përgjegjësi edhe kërkuesit apo jo në kohën kur ishin kryer aktet e vrasjeve në kufi. Edhe në qoftë se supozojmë se një përgjegjësi e tillë nuk dilte drejtpërdrejt në pah nga aktet ndërkombëtare të lartpërmendura mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ajo mund të rridhte nga leximi i këtyre instrumenteve së bashku me nenin 95 të Kodit Penal të R.D.Gj.-së, që parashikonte shprehimisht dhe për më tepër që nga viti

1968, se përgjegjësia individuale penale lindte për personat që shkelnin detyrimet ndërkombëtare ose të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

26. Në dritën e parashtrimeve të mësipërme, Gjykata vlerësoi se në kohën kur ishin kryer aktet e kërkuesve ato përbënin vepra penale të përcaktuara nga dijenia dhe parashikueshmëria e mjaftueshme mbi rregullat e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Për më tepër, sjelljet e kërkuesve mund të vlerësoheshin, si nën dritën e nenit 7 § 1 të Konventës, ashtu edhe nën dritën e rregullave të tjera të së drejtës ndërkombëtare, sidomos të atyre që kishin të bënin me krimet kundër njerëzimit. Megjithatë, përfundimi i arritur nga Gjykata e bëri vlerësimin më vete të kësaj çështje të panevojshëm.

### *c. Përfundimi*

27. Për pasojë, dënimi i kërkuesve nga ana e gjykatave gjermane pas bashkimit të Gjermanive nuk e kishte shkelur nenin 7 § 1 të Konventës. Duke pasur parasysh këtë përfundim, Gjykata nuk kishte pse të vlerësonte nëse dënimet ishin të justifikueshme në bazë të nenit 7 § 2 të Konventës.

### *B. Në lidhje me nenin 1*

28. Në lidhje me nenin 1 kërkuesit pretendonin se si ish shtetas të R.D.Gj.-së ata nuk mund të mbështeteshin në parimin kushtetues se ligji penal nuk ka fuqi prapavepruese.

29. Gjykata vendosi se pretendimet e kërkuesve nuk mund të mbështeteshin në nenin 1 të Konventës, i cili përmbante një dispozitë kuadër që nuk mund të shkelej e vetme. Sidoqoftë ai mund të merrej në shqyrtim në kuadrin e nenit 14 të Konventës të analizuar së bashku me nenin 7 përderisa kërkuesit ishin ankuar në thelb për diskriminim viktime të të cilit ata pretendonin të kishin qenë si ish-shtetas të R.D.Gj.-së.

30. Megjithatë, Gjykata vlerësoi se parimet e zbatuara nga Gjykata Kushtetuese Federale kishin një objekt të përgjithshëm dhe për pasojë ishin njëlloj të vlefshme edhe ndaj personave që nuk ishin ish-shtetas të R.D.Gj.-së.

31. Si rrjedhojë, nuk ka pasur diskriminim në kundërshtim me nenin 14 të Konventës të marrë së bashku me nenin 7 të saj.

32. Në çështjen Streletz, Kessler dhe Krenz, Gjyqtarët Loucaides (Qipro), Zupançiq (Slloveni) dhe Levits (Letoni) shprehën mendime të kundërta, të cilat i janë bashkangjitur vendimit. Në çështjen K-H. W. Gjyqtarët Loucaides (Qipro) dhe Sir Nicolas Bratza (Mbretëria e Bashkuar) shprehën mendime të kundërta dhe Gjyqtarët Cabral Barreto (Portugali) dhe Pellonpää (Finlandë) mendime pjesërisht të kundërta, të cilat i janë bashkangjitur vendimit.

### III. Koment

33. Këto vendime të rëndësishme kanë përcaktuar trajtimin që Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut do të mbajë në lidhje me gjykime që janë marrë pasi të jetë shuar konflikti objekt i gjykimit. Vendimi i parë kishte të bënte me dënimin e disa politikanëve përgjegjës për miratimin e politikave për të qëlluar personat që tentonin të iknin nga Gjermania Lindore dhe, i dyti me dënimin e një ushtari të ri, i cili duke vepruar nën urdhëra, i kishte zbatuar këto politika. Gjykata ishte unanime kur vërejti faktin që këto dënime nuk shkelnin nenin 7 të Konventës. Gjithashtu, njëzëri, ajo ishte e mendimit se edhe e drejta e R.D.Gj.-së, edhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare në kohën e kryerjes së veprave, ishin mjaftueshëm të qarta për të përcaktuar se cilat nga aktet e kërkuesve përbënin vepra penale në kohën kur ishin kryer sipas këtyre dy burimeve normative. Gjykata iu referua në mënyrë të veçantë faktit se R.D.Gj.-ja (ashtu si edhe ish Jugosllavia) kishte qenë palë e Paktit ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike në atë kohë dhe si e tillë detyrohej të respektonte dispozitat e tij. Gjyqtari slloven, ai lituanes dhe ai qipriot e vlerësuan të nevojshme të shtonin mendimet e tyre veçmas. Gjyqtari Levits në veçanti mendonte se dispozitat e një të drejte të brendshme të hartuara në një regjim jodemokratik kërkojnë që të mbahet një qëndrim i ndryshëm. Ai preferoi që të mbështeste arsyetimin e vet, i përkrahur nga gjyqtarët Loucaides dhe Zupançiq, në faktin se veprat në fjalë ishin krime në bazë të së drejtës ndërkombëtare.

34. Megjithatë Gjykata ishte e ndarë në vota (14 me 3) në lidhje me dënimin e rojës kufitare, i cili kishte qenë 20 vjeç në kohën e kryerjes së veprës. Gjykata vuri në dukje në paragrafin 84 që është legjitime për një shtet të qeverisur nga parimi i ligjshmërisë që të fillojë ndjekjen penale kundër personave që kanë kryer krime në regjimin paraardhës. Pjesa më e madhe e Gjykatës ishte e mendimit se, në kohën e kryerjes së aktit, ushtari nuk e kishte menduar se po kryente një vepër penale për të cilën ai mund të ndiqej penalisht më vonë.

35. Në të kundërt, ai madje, e dinte se do t'i ishte nënshtruar një hetimi nëse nuk do të kishte vepruar siç veproi. Gjithsesi, gjyqtarët vlerësuan se ai duhej ta kishte ditur se ajo çfarë po bënte ishte e paligjshme. Për më tepër, gjyqtarët vlerësuan se praktika e R.D.Gj.-së në atë kohë, e cila "e zbrazte nga thelbi legjislacionin në të cilin supozohej të mbështetej", nuk mund të përfshihej në mbrojtjen e nenit 7 të Konventës. Gjyqtari britanik, ai qipriot dhe ai kroat votuan përkrah shumicës, por duke shtuar mendime më vete. Gjyqtari Loucaides (Qipro) iu referua në mënyrë të veçantë vendimeve të TNPY (Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavinë) në çështjet Tadiç dhe spitalet e Vukovarit. Gjyqtarët Cabral Barreto (Portugali), Pellonpää (Finlandë) dhe Zupançiq (Slloveni) dolën kundra duke qenë të mendimit se neni 7 ishte shkelur për shkak se e drejta e R.D.Gj.-së në kohën e kryerjes së veprave nuk e përmbushte testin e parashikueshmërisë të parashikuar nga Konventa dhe e drejta për të jetuar, siç garantohej nga instrumentet e të drejtave të njeriut, nuk krijonte më 1972 përgjegjësi individuale penale për llojin e aktit të kryer nga kërkuesi.

36. Është e rëndësishme të vihet në dukje se këto dy vendime nuk paracaktojnë regjimin juridik që duhet adoptuar nga ana e shteteve për të rregulluar drejtësinë *post facto* dhe as legjislacionin që rregullon amnistinë, si ai i miratuar për shembull në Kroaci, që nuk bie në kundërshtim me Konventën. Ajo çfarë këto raste vlerësojnë është fakti nëse krimet e kryera nën një regjim që nxiste kryerjen e tyre mund të ndiqen penalisht në vazhdim pasi ky regjim të jetë përmbysur. Përgjigja që Gjykata e dha qartë në këto raste është se kjo gjë është e mundur.

# NENI 8

## E DREJTA PËR RESPEKTIMIN E JETËS PRIVATE DHE FAMILJARE

## X DHE Y kundër HOLANDËS

(kërkesa nr. 8978/80)

26 mars 1985

*detyrimet me karakter pozitiv nga ana e shteteve për mbrojtjen e të drejtave të parashikuara nga neni 8 i Konventës duhen kuptuar si pjesë e vetë të drejtës që garanton Konventa nëpërmjet tij*

### I. Faktet kryesore

1. Y, e lindur më 13 dhjetor 1961 ishte e sëmurë mendërisht. Ajo ishte shtruar në një shtëpi për fëmijë me probleme mendore dhe fizike ku i ishte nënshtruar edhe një trajtimi të posaçëm. Gjatë natës të 14 dhe 15 dhjetorit 1977, personi B., abuzoi me të seksualisht. Më 16 dhjetor 1977, X, babai i Y, bëri një kallëzim në organet e policisë duke përdorur autoritetin e tij prindëror për shkak se e bija, megjithëse ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç, nuk kishte zotësi juridike për të vepruar për shkak të problemeve mendore.

2. Më 29 maj 1978, zyra e Prokurorit, vendosi që të mos fillonte ndjekje penale ndaj B, sepse viktima nuk kishte ngritur padi vetë brenda afatit të duhur. Më 12 korrik 1979, Gjykata e Apelit të Arnhem e hodhi poshtë ankesën e X kundër këtij vendimi: kjo për shkakun se neni 248 i Kodit Penal, i cili edhe ndalonte të tilla akte, nuk gjente zbatim përveçse në rastin kur kishte vepruar vetë viktima. Në këtë rast, pretendimi i të atit nuk e zëvendësonte atë çka vetë Y do të duhej të kishte paraqitur në qoftë se do të kishte mundur, gjë të cilën ajo nuk e ka bërë. Pra ekzistonte në një farë mënyre një boshllëk në ligj.

3. X iu drejtua Komisionit më 10 janar 1980, në emër të tij dhe në emër të Y. Në kërkesën e tij ai radhiti një sërë ankesash: e bija kishte pësuar një trajtim çnjerëzor dhe degradues (neni 3 i Konventës), dhe që të dy kishin pësuar cënim të së drejtës së tyre për jetë private (neni 8) dhe të së drejtës së respektimit të jetës familjare (neni 8) e cila përmban në vetvete edhe mundësinë për prindërit që të ushtrojnë të drejtën e ankesës ndaj dhunës seksuale të shkaktuar ndaj fëmijëve të tyre dhe në mënyrë të veçantë kur bëhet fjalë për të mitur dhe kur i ati është edhe përfaqësuesi i tyre ligjor; e bija dhe ai vetë nuk kanë pasur mundësinë e shfrytëzimit të një mjeti efektiv përpara një instance shtetërore (neni 13); situata objekt i mosmarrëveshjes vishte një karakter diskriminues i cili vinte në kundërshtim me nenin 14.

4. Në raportin e tij të 5 korrikut 1983, Komisioni arriti njëzëri në përfundimin, për sa i takon Y, se ka pasur shkelje të nenit 8, por jo të nenit 3 (me pesëmbëdhjetë vota kundër një), dhe që nuk e gjeti të arsyeshme ta shqyrtonte kërkesën as nën këndvështrimin e nenit 14 të marrë së bashku me nenet 8 ose 3, dhe as nën



këndvështrimin e nenit 13. Përsa i përket X, asnjë problem më vete nuk shtrohej në lidhje me respektimin e së drejtës së tij për jetë familjare.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

5. Në radhë të parë, Gjykata mori në shqyrtim pretendimet e Y. Ajo filloi me ato të mbështetura në nenin 8 të marrë në shqyrtim më vete. Zbatueshmëria e nenit 8, në rastin në fjalë, nuk kishte qenë objekt kundërshtimesh nga ndonjëra prej palëve: faktet në themel të çështjes kishin të bënin me «jetën private», e cila mbulon integritetin fizik dhe moral të personit si dhe përfshin jetën e tij seksuale.

6. Gjykata kujton, nga ana tjetër, se në qoftë se neni 8 ka si objekt kryesor ruajtjen e individit nga ndërhyrjet arbitrare të pushtetit publike, ai nuk mund të mjaftohet në vetvete vetëm duke i kërkuar shtetit që të abstenojë në lidhje me ndërhyrje të tilla - këtij angazhimi kryesisht negativ mund t'i shtohen edhe detyrime pozitive që janë pjesë përbërëse e respektimit efektiv të jetës private ose familjare. Ato mund të kërkojnë edhe marrjen e masave të cilat synojnë respektimin e jetës private, deri në marrëdhëniet e individëve ndërmjet tyre.

7. Për këto arsye, Gjykata e çmoi si të pamjaftueshme mbrojtjen që e drejta civile holandeze bënte në rastin e dhunimeve të këtij lloji, viktimë e të cilave ka qenë Y. Kemi të bëjmë në këtë rast me vlera themelore dhe aspekte thelbësore të jetës private. Vetëm një legjislacion penal do të mund të siguronte një parandalim efikas dhe, nga ana tjetër, të nevojshëm në këtë fushë. Në fakt është një legjislacion i tillë që rregullon normalisht këtë çështje. Përsa ishin në dijeni Komisioni dhe Gjykata, e drejta penale holandeze paraqiste një boshllëk të vetëm dhe që ka të bëjë me personat në gjendje si ajo e Y - pra që nuk kanë zotësi për të vepruar. Në lidhje me këta persona vënia në jetë e këtij legjislacioni has në pengesa të karakterit procedural të cilat legjislatori holandez nuk i kishte parashikuar që më parë.

8. Pra, as neni 248 dhe as neni 239, § 2 i Kodit Penal nuk i siguronte Y një mbrojtje konkrete dhe efektive. Kështu, duke pasur parasysh natyrën e ngjarjeve për të cilat bëhet fjalë, arrihet në përfundimin se Y ka qenë viktimë e një shkeljeje të nenit 8 të Konventës.

### B. Në lidhje me nenin 14, nenin 3 dhe nenin 13

9. Shqyrtimi i çështjes nën dritën e nenit 14 nuk shtrohet në qoftë se Gjykata konstaton një mangësi ndaj kërkesave të një neni që sanksionon një të drejtë, përveç se kur është një pabarazi e hapur trajtimi në lidhje me gëzimin e kësaj të drejte ajo që përbën aspektin themelor të çështjes. Meqenëse nuk ishte kështu në rastin konkret, Gjykata nuk vlerësoi se ishte e dobishme që të merrej me këtë aspekt të çështjes.

10. Meqenëse ka konstatuar një shkelje të nenit 8, njëzëri Gjykata nuk gjykoj se duhet të zhvendosej gjithashtu edhe në fushën e respektimit të nenit 3, të marrë në konsideratë më vete apo së bashku me nenin 14.

11. Përsa i përket mungesës së mjeteve të ankimit, Gjykata e mori në shqyrtim këtë çështje nën dritën e nenit 8. Kështu që njëzëri arriti në përfundimin se nuk kishte nevojë ta vlerësonte edhe mbi bazën e nenit 13.

12. Së fundi, po njëzëri, Gjykata vendosi që të mos marrë një qëndrim më vete në lidhje me pretendimet e X, meqenëse edhe pala kërkuese nuk u ndal në këtë aspekt të çështjes gjatë seancës gjyqësore.

### C. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)

13. Në bazë të nenit 50, Gjykata i akordoi Y 3000 forinta për dëmin moral.<sup>109</sup>

## III. Koment

14. Vendimi i Gjykatës në lidhje me këtë çështje paraqet një vlerë themelore në lidhje me konceptin e detyrimeve pozitive që kanë shtetet anëtare të Konventës për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njohura prej saj. Këtë element të sistemit të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive themelore nga ana e Konventës, Gjykata e kishte prezantuar ndërkaq në disa vendime të saj të mëparshme. Për të arritur këtu ajo nisej nga parimi i efektivitetit të mbrojtjes që duhet të ofrojnë dispozitat e Konventës në lidhje me të drejtat dhe liritë që ato vetë garantojnë. Nga ana tjetër, neni 13 i Konventës por sidomos neni 1, iu kërkojnë Palëve të Larta Kontraktuese që t'i "sigurojnë çdokujt që ndodhet në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin e I të kësaj Konvente." Termi sigurojnë, i interpretuar nga Gjykata duke u bazuar me përparësi në versionin anglez "shall secure" ndaj atij francez "reconnaissent" nënkupton pikërisht një detyrim që shkon përtej mosveprimit nga ana e autoriteteve shtetërore. Në vendimin e saj të 9 tetorit 1979 në lidhje me çështjen Airey kundër Irlandës Gjykata shprehet se "Një pengesë në fakt dhe në praktikë mund të çojë në shkelje të Konventës po njëllor si një pengesë me karakter thjesht ligjor. Ekzekutimi i një angazhimi të marrë në bazë të Konventës kërkon ndonjëherë masa pozitive nga ana e shtetit; në një rast të tillë ky i fundit nuk mund të mjaftohet duke qëndruar pasiv dhe nuk ka vend këtu për të bërë dallime ndërmjet 'veprimeve dhe mosveprimeve'."<sup>110</sup>

15. Momenti i dytë që do ishte me vlerë të komentohej në lidhje me këtë vendim të Gjykatës është ai të cilin Gjykata analizon sidomos në paragrafët 25-29 të vendimit – karakterin efektiv të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, shtrirë ky efektivitet edhe në lidhje me detyrimet me karakter pozitiv nga ana e shteteve. I përpunuar në mënyrë mjaft interesante në çështjen Artico kundër Italisë<sup>111</sup>, ky karakter është ngritur tashmë në një parim të interpretimit të dispozitave të Konventës nga ana e Gjykatës dhe nënkupton që shtetet nuk duhet që të ofrojnë, me veprim ose mosveprim, vetëm

<sup>109</sup> Një ligj i 27 shkurtit 1985, i cili hyri në fuqi më 1 prill 1985, amendoi nenin 65 të Kodit Penal. Ai autorizoi përfaqësuesit ligjorë të një personi të prekur nga një handicap mendor dhe që pretendohet të jetë viktimë e një shkeljeje që të ngrejë padi.

<sup>110</sup> Vendim i 9 tetorit 1979. Në lidhje me këtë parim të Konventës shih në shqip, "Të Drejtat e Njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komentë", fq. 31-32.

<sup>111</sup> Vendim i 13 majit 1980.

garanci formale në respektimin e të drejtave dhe lirive që mbron Konventa, por të ofrojnë garanci dhe mjete që në praktikë janë efektive<sup>112</sup>.

16. I lidhur me parimin e detyrimeve pozitive dhe me interpretimin efektiv të Konventës, por që sigurisht vlen të nxirret në pah në mënyrë të veçantë është edhe një parim tjetër i vetë Konventës i përpunuar nga Gjykata në këtë vendim – ai i efektit horizontal të disa prej dispozitave të Konventës. Në paragrafin 23 të vendimit, Gjykata shprehet se detyrimet me karakter pozitiv të shtetit në kuadrin e Konventës mund të kërkojnë marrjen e masave që përpiqen të sigurojnë respektimin për jetë private edhe në sferën e marrëdhënieve të individëve me njëri-tjetrin<sup>113</sup>.

## GLASS kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 61827/00)

9 mars 2004

*në këtë çështje Gjykata u shpreh se vendimi për të detyruar një person t'i nënshtrohet trajtimit mjekësor pa pëlqimin e tij shkel integritetin e personit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Carol dhe David Glass, janë të dy shtetas britanikë. David, i lindur më 1986, ka të aftësi të kufizuara të rënda fizike dhe mendore dhe kërkon një kujdes të vazhdueshëm prej 24 orësh. Znj. Glass është nëna e Davidit dhe njëkohësisht kujdestarja e tij ligjore.

2. Në korrik 1998, Davidi u pranua në Spitalin St. Mary, një prej dy spitaleve që i përkasin Shërbimit Kombëtar Shëndetësor të Spitaleve të Portsmuthit. Pas një operacioni që synonte të zbuste një shtrembërim në rrugët e sipërme të frymëmarrjes, David pësoi komplikacionet duke u përkeqësuar aq sa t'i nënshtrohej frymëmarrjes artificiale. Gjatë trajtimit të tij, znj. Glass u vu në dijeni se David po vdiste dhe se mjekimi i mëtejshëm mjekësor ishte i papërshtatshëm. Megjithatë, kushtet e David u përmirësuan dhe ai mundi të kthehej në shtëpi më 2 shtator 1998.

3. Më 8 shtator 1998, kur David u rishtrua në spital për një infeksion në rrugët e frymëmarrjes, mjekët diskutuan me znj. Glass përdorimin e mundshëm të morfinës për të ulur dhimbjet. Znj. Glass u shpreh kundra, duke iu bërë të qartë mjekëve se në qoftë se zemra e David pushonte atëherë do të duhej rivënia e saj në punë qoftë edhe me goditje elektrike. Dr. W. vlerësoi se kjo nuk do të ishte në të mirën e David

<sup>112</sup> Shih "Të Drejtat e Njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komente", fq. 37.

<sup>113</sup> Edhe në lidhje me këtë parim shih "Të Drejtat e Njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komente", fq. 32-33. Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen Stubbings kundër Mbretërisë së Bashkuar të 22 tetorit 1996.

dhe deklaroi në raportet e tij se ishte i nevojshëm “një mendim i dytë”, qoftë edhe nga gjykatat. Dr. H. shënoi gjithashtu se “në rast mosmarrëveshjeje të plotë ne do të jemi të detyruar të shkojmë përpara gjykatave”.

4. Kushtet e David u përkeqësuan. Më 20 tetor 1998, mjekët që e kuronin vlerësuan se ai po vdiste dhe rekomanduan që t'i jepej diamorfinë në mënyrë që t'i pakësoheshin dhimbjet. Znj. Glass nuk ishte dakord që i biri i saj po vdiste dhe ishte e shqetësuar se mjekimi me diamorfinë do të komprometonte mundësitë e tij për shërim. Znj. Glass i shprehu këto shqetësime në një takim me mjekët, në të cilin ishte i pranishëm edhe një oficer policie.

5. Pas kësaj, ajo kërkoi që ta çonte Davidin në shtëpi përderisa po vdiste, por një oficer policie i bëri të qartë që nëse përpiqej ta bënte këtë gjë do të arrestohej. Davidit iu dha diamorfinë në orën 19:00 të datës 20 tetor 1998.

6. Jashtë spitalit shpërtheu një zënkë mes pjesëtarëve të tjerë të familjes dhe mjekëve. Të afërmit e David besonin se ai po i nënshtrohej një eutanazie të pushpallur dhe u përpoqën që t'i ndalonin mjekët të futeshin në dhomën e tij. Autoritetet e spitalit thirrën forcat e sigurimit dhe kërcënuan që ta nxirrnin familjen nga spitali me forcë.

7. Pa u vënë në dijeni znj. Glass, në faqen e parë të dosjes mjekësore të kërkuesit u shënuar urdhri “të mos ringjallet” (TMR).

8. Të nesërmen znj. Glass vuri re se gjendja e të birit u përkeqësua në mënyrë alarmante dhe u frikësua se kjo vinte për shkak të diamorfinës. Në vijim familja e kërkuesit, kërkoi që trajtimi me diamorfinë të ndërpritej. Dr. W. deklaroi se kjo ishte e mundur vetëm në qoftë se ata binin dakord që David të mos ringjallej. Megjithatë, të afërmit u përpoqën ta risillnin Davidin në jetë dhe mes tyre dhe mjekëve shpërtheu një zënkë. Ndërkohë që zënka vazhdonte, znj. Glass arriti që ta risillte Davidin në jetë.

9. Në spital ndërhyjnë edhe forcat e policisë. Dr. W. Dr. A. si dhe disa policë u plagosën dhe një nga fëmijët që ndodheshin në vendin e ngjarjes u evakuua.

10. Gjendja e Davidit u përmirësua dhe ai u dërgua në shtëpi më 21 tetor 1998.

11. Znj. Glass kërkoi një shqyrtim gjyqësor dhe u përpoq t'i drejtohej Gjykatës së Apelit në lidhje me vendimet e marra nga autoriteti spitalor, por pa sukses.

12. Këshilli i Përgjithshëm Mjekësor konstatoi se mjekët e përfshirë në ngjarje nuk kishin qenë përgjegjës për sjellje në kundërshtim serioz me etikën profesionale ose për mospërmbushje të detyrës së tyre dhe se trajtimi i kundërshtuar nga familjarët kishte qenë i justifikuar. Prokuroria e Kurorës nga ana e saj nuk hapi ndonjë hetim penal ndaj mjekëve për mungesë provash.

13. Kërkuesit pretenduan se e drejta dhe praktika britanike nuk garantonte respektimin e integritetit fizik dhe moral të Davidit, të kërkuar nga neni 8 i Konventës. Në veçanti, vendimet për trajtimin me diamorfinë të Davidit, në kundërshtim me dëshirën e nënës së tij dhe për të shënuar urdhrin TMR në dosjen e tij mjekësore përbënin ndërhyrje ndaj të drejtave të tyre në bazë të nenit 8.

14. Ata pretenduan gjithashtu se lënia e vendimit, për të angazhuar ose jo gjykatat, në diskrecion të mjekëve ishte plotësisht e pabazuar dhe nuk u lejonte pacientëve të lënduar të siguronin mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

15. Gjykata vlerësoi se vendimi për ta detyruar Davidin të marrë një trajtim të caktuar pa marrë parasysh kundërshtimin e nënës së tij, përbënte një ndërhyrje ndaj së drejtës së tij për respektim të jetës private, dhe në veçanti të integritetit të tij fizik. Ajo vlerësoi se nuk kishte pse shqyrtonte nëse trajtimi në fjalë përbënte gjithashtu ndërhyrje ndaj së drejtës së znj. Glass për respektim të jetës së saj familjare.

16. Gjykata konstatoi se ndërhyrja ndaj integritetit fizik të Davidit ishte në përputhje me ligjin. Kuadri rregullues në Britaninë e Madhe bazohej qartë në detyrimin për të ruajtur jetën e pacientit, përveçse në rrethana përjashtimore. I njëjti kuadër i jepte përparësi pëlqimit të prindërve dhe, përveçse në raste emergjente, i detyronte mjekët që të kërkonin ndërhyrjen e gjykatave në rast kundërshtimi nga ana e prindërve.

17. Gjykata vlerësoi gjithashtu se veprimet e ndërmarra nga personeli i spitalit ndiqnin një qëllim legjitim. Ato synonin, sipas një gjykimi klinik, që t'i shërbenin interesit të Davidit. Gjykata hodhi poshtë çdo pretendim sipas të cilit synimi i mjekëve ishte që të përshpejtonin vdekjen e David duke i dhënë diamorfinë ose duke vënë shënimin TMR në kartelën e tij mjekësore.

18. Në lidhje me çështjen nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata vlerësoi se situata që u krijua në spitalin St. Mary ndërmjet 19 dhe 21 tetorit 1998, nuk mund të analizohej më vete nga diskutimet më të hershme mes disa anëtarëve të personelit të spitalit dhe znj. Glass në lidhje me kushtet e David. Mjekët në spital ishin haptazi të shqetësuar në lidhje me hezitimin e znj. Glass për të ndjekur këshillat e tyre, dhe veçanërisht këshillën që Davidit t'i jepej morfinë. Edhe Dr. W. edhe Dr. H., menduan se opinioni i gjykatave mund të ishte i nevojshëm.

19. Gjykata nuk u bind me shpjegimin se përse Shërbimi Mjekësor nuk iu drejtua që në këtë fazë Gjykatës së Lartë. Të gjithë mjekët në këtë fazë, ishin të mendimit për një prognozë shqetësuese të aftësisë së David për të përballuar kriza të tjera. Por për ta nuk pati asnjë dyshim që trajtimi që propozonin nuk do të gjente pëlqimin e së ëmës. Gjithashtu mund të pranohet se edhe znj. Glass mund ta kishte

çuar çështjen përpara Gjykatës së Lartë. Megjithatë, Gjykata vlerësoi se i takonte Shërbimit Mjekësor që të ndërmerre veprim dhe ta zgjidhte situatën përpara ndonjë emergjence tjetër. Gjykata pranoi se mjekët nuk mund ta kishin parashikuar nivelin e përballjes dhe të ashpërsisë me familjarët e David, më 18 tetor 1998. Gjithsesi duhet thënë se mosçuarja nga ana e Shërbimit Mjekësor të çështjes në Gjykatën e Lartë në një fazë më të hershme, kontribuoi në këtë situatë konfliktuale.

20. Pasi pohoi sa më lart, Gjykata shprehu dyshimet e veta që një kërkesë urgjente në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhej më nga Shërbimi Mjekësor kur u bë e qartë se znj. Glass e kundërshtonte me ngulm trajtimin e David me diamorfinë. Shërbimi Mjekësor që në gjendje të siguronte praninë e një polici për të mbikëqyrur negociatat me znj. Glass por, në mënyrë të çuditshme, nuk vlerësoi bërjen e një kërkesë në Gjykatën e Lartë edhe pse mund të kishte qenë e mundur brenda një afati të shkurtër.

21. Gjykata vlerësoi se vendimi i autoriteteve për të mos mbajtur parasysh kundërshtimin e znj. Glass në lidhje me trajtimin e propozuar, në mungesë të një autorizimi nga një gjykatë, përbënte shkelje të nenit 8.

22. Duke pasur parasysh këtë përfundim, Gjykata nuk e vlerësoi të nevojshme ta shqyrtonte më vete ankimin e kërkuesve në lidhje me shënimin TMR në kartelën mjekësore të David, pa pëlqimin dhe dijeninë e së ëmës. Sidoqoftë ajo theksoi se ky shënim ndalonte vetëm aplikimin e goditjeve të fuqishme elektrike kardiake dhe ndihmën respiratore intensive dhe nuk e përjashtonte përdorimin e teknikave të tjera, si frymëmarrja artificiale me oksigjen, për ta mbajtur David në jetë.

### ***B. Në lidhje me nenin 41***

23. Gjykata i akordoi kërkuesve 10 000 euro shpërblim për dëm jomaterial dhe 15 000 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

### **III. Koment**

24. Neni 34 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut parashikon se Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, mund "t'i paraqiten kërkesa nga çdo person, organizëm jo-qeveritar ose grup individësh që pretendojnë se janë të dëmtuar nga ndonjë shkelje". Fakti që një person mund të mos dalë dot si palë përpara gjykatave të brendshme, përgjithësisht nuk e cënon të drejtën e ankimit përpara Gjykatës – rregullorja e saj është mjaft fleksibël në këtë pikëpamje. Ka një jurisprudencë të konsoliduar në Strasburg sipas së cilës fëmijët mund të paraqesin kërkesa në Gjykatë, qoftë së bashku me të rritur që kanë të njëjtat ankesa, qoftë më vete. Edhe prindërit mund të përfaqësojnë fëmijët e tyre dhe të paraqesin kërkesa në emër të tyre.

25. Në këtë çështje dy kërkuesit, fëmija dhe e ëma, ankoheshin për shkelje të të drejtave të kërkuesit të parë për respektim të integritetit moral dhe fizik dhe të të drejtës së të dy kërkuesve bashkë për respektim të jetës së tyre familjare.



26. Gjykata vuri gjithashtu në dukje, se nëna kishte vepruar si kujdestare ligjore e të birit dhe se ajo kishte autoritetin ligjor për të mbrojtur interesat e tij, përfshirë ato që kishin të bënin me trajtimin mjekësor. Vendimi për të bërë një trajtim që nuk mbante parasysh kundërshtimin e saj përbënte një ndërhyrje ndaj së drejtës së tij për respektim të integritetit fizik. Duke pasur parasysh kundërshtimin e vazhdueshëm të nënës në lidhje me trajtimin e propozuar nga mjekët, shërbimi mjekësor duhet t'ia kishte përcjellë çështjen gjykatave. Mosmarrja e këtij hapi çoi në shkelje të të drejtave të fëmijës në bazë të nenit 8 të Konventës.

27. Megjithatë, Gjykata nuk e mori në shqyrtim faktin nëse ishin shkelur edhe të drejtat e nënës për respektim të jetës së saj familjare dhe u shpreh se do ta shqyrtonte çështjen nga këndvështrimi i fëmijës, duke pasur parasysh rolin e kërkueses së dytë si nëna dhe kujdestarja e tij ligjore. Për fat të keq, Gjykata nuk dha asnjë arsye për të shpjeguar se pse ajo e pa të arsyeshme që të mos e shqyrtonte më vete ankesën e nënës.

## WORWA kundër POLONISË

(kërkesa nr. 26624/95)

27 nëntor 2003

*urdhërat e përsëritur për analiza psikiatrike u vlerësuan se shkelin të drejtën e kërkuetit për jetë private*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuësja, Władysława Worwa, është shtetase polake që ka lindur më 1947 dhe jeton në Rdzawka.

2. Një mosmarrëveshje e saj dhe e fëmijëve të saj me disa prej fqinjëve në lidhje me të drejtën e kalimit çoi në një numër çështjesh gjyqësore<sup>114</sup>. Gjatë një prej këtyre proceseve, gjykata e rrethit të Nowy Targ, urdhëroi që kërkuësja t'i nënshtrohej një analize psikiatrike për të vlerësuar nëse ajo ishte plotësisht e ndërgjegjshme në atë kohë. Pasi ajo refuzoi që tu përgjigjej disa urdhrave tillë të njëpasnjëshëm, Gjykata urdhëroi arrestimin e saj.

3. Më 12 tetor 1994, oficerë policie shkuan në shtëpinë e kërkueses dhe e arrestuan. Rrethanat në të cilat kërkuësja ishte arrestuar ishin të diskutueshme. Znj. Worwa pretendonte se vajza e saj dhjetë vjeçare kishte qenë e pranishme në kohën e arrestit dhe një polic ia kishte shkëputur asaj nga duart duke e lënë në shtëpi vetëm. Në vijim znj. Worwa pretendoi se asaj i ishte refuzuar leja për të kontaktuar familjarët

<sup>114</sup> I ngjashëm me sa parashikohet nga Neni 277 të Kodit Civil të RSH.

dhe mjekun e saj. Kurse qeveria polake pretendoi se raporti mbi arrestimin nuk bënte fjalë fare për praninë e një fëmije në momentin e arrestit dhe se në qoftë se do të kishte pasur fëmijë pohoi se do të ishin marrë masat për kujdesin e duhur ndaj fëmijës.

4. Kërkuesja u gjet fajtores për nxitje të fëmijëve të saj për të fyer dhe gjuajtur me gurë fqinjën e saj dhe për kërcënime për dhunë fizike ndaj saj. Në lidhje me të gjitha akuzat e bëra ndaj saj, kërkuesja ishte urdhëruar që t'i nënshtrohej disa herë analizave psikiatrike.

5. Kërkuesja pretendoi se arrestimi i saj kishte shkelur nenin 5 § 1 (b) të Konventës që i garantonte të drejtën për liri dhe siguri. Duke u bazuar në nenin 8 ajo pretendonte gjithashtu në lidhje me rrethanat e arrestimit të saj dhe për abuzim përsa i përket urdhrave të përsëritur për analiza psikiatrike.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 5 § 1 (b)

6. Përderisa nuk kishte asnjë provë në dosje që të provonte se arrestimi i kërkueses kishte qenë i paligjshëm, Gjykata vlerësoi se arrestimi i saj kishte qenë në përputhje me nenin 5 § 1 (b) të Konventës dhe vendosi se nuk ka pasur shkelje të kësaj dispozite të Konventës.

### B. Në lidhje me nenin 8

7. Përsa i përket pretendimit të kërkueses në lidhje me të drejtën e saj për respektim të jetës familjare, e vetmja provë që iu paraqit Gjykatës ishte raporti i përgatitur në kohën e arrestimit të saj. Kërkuesja e kishte nënshkruar këtë raport por kishte deklaruar qëllimin e saj për tu ankuar në lidhje me rrethanat e arrestimit dhe se nuk preferonte të njoftonte ndonjë të njohur ose të afërm në lidhje me ngjarjen. Në vijim, ajo e kishte ndryshuar përmbajtjen e kësaj deklarate. Në këto kushte, Gjykata vlerësoi se nuk kishte prova se kishte pasur ndonjë fëmijë në shtëpi në momentin e arrestimit dhe deklaroi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 në këtë drejtim.

8. Përsa i përket ankesës së kërkueses në lidhje me të drejtën e respektimit të jetës së saj private, Gjykata vlerësoi se rrethanat në të cilat ishte urdhëruar të bëheshin analizat dhe të përgatiteshin raportet psikiatrike përbënin ndërhyrje në jetën e saj private. Autoritetet gjyqësore të së njëjtës gjykatë e kishin urdhëruar kërkuesen në mënyrë të njëpasnjëshme dhe në intervale të shkurtra kohore që t'i nënshtrohej testeve psikiatrike. Për këtë arsye baraspesha e drejtë që duhet ruajtur ndërmjet të drejtës së individit për respektim të jetës private dhe mirëadministrimit të drejtësisë nuk është respektuar si duhet. Për pasojë, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja e autoriteteve publike ndaj së drejtës së kërkueses për respektim të jetës private nuk ishte justifikuar, veçanërisht në lidhje me urdhrat për përsëritjen në një kohë të shkurtër të analizave dhe raporteve psikiatrike, dhe vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në këtë drejtim.

### C. Në lidhje me nenin 41

9. Gjykata i akordoi kërkuases 3 000 euro dëmshpërblim për dëmin jomaterial. Kërkuësja nuk bëri asnjë kërkesë për shpenzime dhe pagesa ligjore.

### III. Koment

10. Në këtë çështje ishin pikërisht urdhrat e njëpasnjëshëm dhe në intervale të shkurtra kohe nga ana e autoriteteve gjyqësore ata që përbënin aspektin që bëri që Gjykata të vendoste për shkelje të nenit 8. Raste të mëparshme kundër Polonisë, kanë çuar në konstatimin e shkeljeve të nenit 5 në lidhje me privimin e lirisë kur individë ishin detyruar të qëndronin në institucione për të sëmuret mendorë për kontrolle<sup>115</sup>. Gjykata, në këtë çështje konstatoi se thjesht urdhërimi i bërjes së testeve përbënte ndërhyrje ndaj së drejtës së kërkuases për jetë private. Duke adoptuar përqsajen e saj normale të strukturuar në lidhje me të drejtat e cilësuar ku bën pjesë edhe e drejta e garantuar nga ana e nenit 8, për të vendosur nëse ndërhyrjet përbënin shkelje, ajo konstatoi së pari që ndërhyrjet ishin në përputhje me të drejtën e brendshme dhe se ato synonin të siguronin miradministrimin e drejtësisë. Megjithatë, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të kësaj të drejte për shkak të përdorimit abuziv të kompetencës për të urdhëruar analiza psikiatrike. Ky abuzim konsistonte në thirrje që i bëheshin edhe në ditë kur nuk ishin parashikuar vizita të saj mjekësore si dhe në urdhërimin, dukej të pajustificuar, të analizave të njëpasnjëshme gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor.

11. Mësimi që na jep ky rast konsiston në faktin se urdhërimi i analizave psikiatrike edhe gjatë një procesi penal përbën një ndërhyrje ndaj së drejtës së kërkuësit për respektim të jetës private. Normalisht, kjo ndërhyrje mund të justifikohet për qëllimet e miradministrimit të drejtësisë dhe të një procesi të rregullt. Megjithatë, në qoftë se kjo ndërhyrje ushtrohet nga autoritetet pa i kuptuar caqet e saj dhe pa respektuar parimin e proporcionalitetit në çdo aspekt, mund të shkohet deri në pamundësinë e justifikimit të saj dhe për pasojë edhe në shkelje të nenit 8 të Konventës.

## M.C. kundër BULLGARISË

(kërkesa nr. 39272/98)

4 dhjetor 2003

*kjo çështje kishte të bënte me detyrimin pozitiv të shteteve për të ngritur dhe zbatuar me efektivitet një sistem penal që ndëshkon të gjitha format e përdhunimit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuësja, M.C., është shtetase bullgare që ka lindur më 1980 dhe që pretendonte

<sup>115</sup> Vendimi i 20 qershorit 2002 në lidhje me çështjen Berlinski kundër Polonisë.

se kur kishte qenë 14 vjeç, që është edhe mosha për e lejuar për kryerjen e marrëdhënieve seksuale të vullnetshme në Bullgari, ishte përdhunuar nga dy djem, A. dhe P., përkatësisht 20 dhe 21 vjeç.

2. M.C. pretendonte se më 31 korrik 1995, ajo shkoi në një disko me dy djemtë dhe një shoqe të saj. Në vijim, ajo pranoi që të shkonin së bashku në një disko tjetër. Në kthim, A. sugjeroi që të ndalonin për të notuar në një rezervuar. M.C. qëndroi në makinë. P. u kthye përpara të tjerëve, dhe sipas pretendimeve të kërkueses e detyroi atë që të kryenin marrëdhënie seksuale. M.C. pretendonte se mbeti në një gjendje shumë të shqetësuar. Në orët e para të mëngjesit vijues, kërkuesja u çua në një shtëpi. Atje, sipas pretendimit të saj, A. e detyroi që të kryenin marrëdhënie seksuale ndërsa ajo vazhdonte të qante gjatë dhe pas përdhunimit. Më vonë ajo u gjet nga e ëma dhe u çua në spital ku analizat mjekësore arritën në përfundimin se membrana e saj vaginale ishte çarë. A. edhe P. e mohuan faktin që ta kishin përdhunuar M.C.

3. Ndjekja penale që filloi në lidhje me këtë ngjarje nuk gjeti prova të mjaftueshme që M.C. ishte detyruar të kryente marrëdhënie seksuale me A. dhe P. Hetimi u mbyll në 17 mars 1997 nga prokurori i rrethit i cili arriti në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme për përdorimin e forcës ose për kërcënime për kryerjen e marrëdhënieve të tilla. Në mënyrë të veçantë, nuk u vërtetua që kërkuesja të kishte rezistuar ose të kishte bërë përpjekje për të kërkuar ndihmë nga persona të tjerë. Kërkuesja apeloi ndaj këtij vendimi por pa sukses.

4. Mendimet me shkrim të ekspertëve, të paraqitura përpara Gjykatës së Strasburgut nga M.C., diagnostikuan “frikën e ngrirë” që është një sindromë traumatike psikologjike infantile dhe që konsiderohet si pasoja më normale e përdhunimit, kur viktimat e terrorizuara ose i nënshtrohen në mënyrë pasive ose përpiqen t’i largohen psikologjikisht konceptit të përdhunimit. Nga 25 raste përdhunimi të analizuar në Bullgari në lidhje me vajza të moshës nga 14 deri 20 vjeç, 24 prej viktimave i ishin përgjigjur përdhunuesve të tyre në këtë mënyrë.

5. M.C. ankohej se e drejta dhe praktika bullgare nuk ofronin mbrojtje efektive ndaj përdhunimit dhe abuzimit seksual, përderisa hetohen vetëm rastet kur viktimat rezistojnë në mënyrë aktive. Ajo ankohej gjithashtu se autoritetet nuk i kishin hetuar në mënyrë efektive ngjarjet në fjalë. Për pretendimin e saj ajo mbështetej në nenin 3, nenin 8, nenin 13 dhe në nenin 14 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenet 3 dhe 8

6. Gjykata vuri në dukje se, në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës, shtetet anëtare kanë një detyrim pozitiv të dyfishtë. Nga njëra anë ato duhet të nxjerrin një legjislacion penal që të ndëshkojë në mënyrë efektive përdhunimin dhe nga ana tjetër duhet ta zbatojnë me efikasitet këtë legjislacion me hetim dhe ndjekje penale.

7. Në vijim Gjykata vuri re se, historikisht, në bazë të së drejtës dhe praktikës juridike të shteteve të ndryshme, normalisht kërkohej prova e përdorimit të forcës fizike nga përdhunuesi dhe i rezistencës fizike nga ana e viktimës. Megjithatë, dukej se kjo nuk ishte më një praktikë e kërkuar në vendet Evropiane. Në vendet e *common-law*, ashtu si edhe në Evropën kontinentale por edhe më gjerë legjislacioni dhe praktika nuk kërkonin më ekzistencën e një reference në lidhje me përdorimin e forcës fizike. Madje, megjithëse në shumë prej vendeve evropiane të ndikuara nga sistemi kontinental i *civil-law* përkufizimi i përdhunimit përmbante referenca në përdorimin e dhunës ose të kërcënimit për dhunë nga shkaktuesi i saj, nga jurisprudenca dhe doktrina juridike dukej se mungesa e pëlqimit, dhe mospërdorimi i forcës, përbëjnë elementin thelbësor në përkufizimin e përdhunimit.

8. Gjykata vuri re gjithashtu se shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë rënë dakord se penalizimi i akteve seksuale të pavullnetshme, pavarësisht nëse viktimja ka rezistuar apo jo, ishte i nevojshëm për mbrojtjen e grave ndaj dhunës dhe ka kërkuar vënien në jetë të reformave të mëtejshme në këtë drejtim. Nga ana tjetër, Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ka arritur së fundmi në përfundimin se, në të drejtën ndërkombëtare penale, çdo penetrim seksual pa vullnetin e viktimës përbën përdhunim, duke pasqyruar kështu një tendencë universale që e sheh mungesën e pëlqimit si një element thelbësor të përdhunimit dhe të abuzimit seksual. Në përgjithësi, ligji dhe praktika ligjore në lidhje me përdhunimin janë në zhvillim e sipër për të pasqyruar qëndrimet sociale në ndryshim të cilat kërkojnë respektim të autonomisë seksuale të individit dhe barazi. Duke pasur parasysh standardet dhe tendencat aktuale, detyrimi pozitiv i shteteve anëtare në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës kërkon penalizimin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual të pavullnetshëm, edhe kur viktimja nuk ka rezistuar fizikisht.

9. Kërkuesja pretendonte se qëndrimi i autoriteteve në rastin e saj justifikohet me një legjislacionin të mangët dhe pasqyrore një praktikë për ndjekjen e përdhunuesve vetëm kur ka pasur prova për një rezistencë fizike të fortë nga ana e viktimës. Qeveria Bullgare nuk ishte në gjendje të ofronte kopje të vendimeve gjyqësore ose mendimin juridik bullgar, që të hidhnin poshtë pretendimet e kërkueses për një përjasje të ngushtë në konceptimin dhe penalizimin e përdhunimit. Pretendimi i saj bazohej pra, në argumente të logjikshëm të cilët nuk u hodhën poshtë.

10. Ofrimi i dy versioneve të papajtuësme në lidhje me faktet, natyrisht që kërkonte vlerësim të kujdesshëm të kontekstit në lidhje me besueshmërinë e deklaratave të bëra si dhe verifikim të të gjitha rrethanave. Megjithatë, ishte bërë shumë pak për vlerësimin e besueshmërisë së versionit të ngjarjeve të ofruar nga P. dhe A., apo për të provuar besueshmërinë e dëshmitarëve të thirrur nga të akuzuarit ose përcaktimin e kohës së saktë të ngjarjeve. As kërkuesja dhe as përfaqësuesit e saj nuk kishin qenë në gjendje t'u bënin pyetje dëshmitarëve të cilët kërkuesja i kishte akuzuar për dëshmi të rreme. Në vijim të këtyre fakteve, autoritetet nuk kishin ndërmarrë ndonjë veprim për të shfrytëzuar ndonjë mundësi për qartësimin e të gjitha rrethanave dhe nuk kishin vlerësuar si duhej besueshmërinë e deklaratave që ishin bërë e që ishin të

papajftueshme me njëra-tjetrën. Arsyeja e këtij mosveprimi dukej se ishte për shkak të faktit se hetuesi dhe prokurori vlerësonin se ishin përpara një “marrëdhënie seksuale të detyruar mes personave që njihen” dhe, në mungesë të një prove “të drejtpërdrejtë” përdhunimi të tilla si gjurmë dhune dhe rezistence ose thirrje për ndihmë, ata nuk mund të deduktonin një provë për një mungesë pëlqimi dhe, për këtë arsye, një përdhunim duke u nisur vetëm nga vlerësimi i të gjitha rrethanave të ngjarjes.

11. Pa shprehur ndonjë mendim në lidhje me fajësinë ose jo të P. dhe A., Gjykata konstatoi se efektiviteti i hetimit të çështjes së kërkuesit dhe, në veçanti, qëndrimi i mbajtur nga hetuesi dhe prokurorët, nuk respektonte detyrimet pozitive të Bullgarisë në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës. Nën dritën e standardeve të zbatueshme të së drejtës moderne ndërkombëtare dhe të krahasuar, këto detyrime kërkojnë ngritjen dhe funksionimin efektiv të një sistemi ligjor penal që dënon të gjitha format e përdhunimit dhe abuzimit seksual.

### **B. Në lidhje me nenet 13 dhe 14**

12. Gjykata konstatoi se nuk dilte në pah ndonjë problem i veçantë në bazë të nenit 13 dhe se nuk ishte e nevojshme që të shqyrtohej ankesa në bazë të nenit 14.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

13. Gjykata i akordoi kërkueses 8 000 euro shpërblim për dëm jomaterial dhe 4 110 euro për shpenzime dhe pagesa.

## **III. Koment**

14. Në këtë çështje, Gjykata shqyrtoi qëllimin e detyrimeve pozitive të shteteve në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës<sup>116</sup>. Gjykata ritheksoi se neni 3 i marrë së bashku me nenin 1 iu kërkon shteteve të marrin masat e duhura për të garantuar që individët që ndodhen në juridiksionin e tyre të mos i nënshtrohen keqtrajttimeve, përfshirë edhe ato të kryera nga individët jo në pozita zyrtare. Në lidhje me nenin 8, Gjykata deklaroi se brenda mbrojtjes që ajo ofron përfshihen detyrimet që mund të kërkojnë marrjen e masave edhe në sferën e marrëdhënieve ndërmjet individëve.

15. Gjykata iu referua çështjes *X dhe Y kundër Holandës*, i 26 marsit 1985, në të cilën autori i një sulmi seksual nuk ishte ndjekur penalisht, për shkak se në bazë të së drejtës holandeze fakti që viktima ishte një vajzë 16 vjeçare me çrregullime mendore nuk e lejonte të bënte “kallëzim penal”. Kishte pasur një mundësi për të ngritur një padi civile për kompensim, por Gjykata deklaroi se mbrojtja e ofruar nga e drejta civile në një çështje ku janë në lojë vlerat themelore dhe aspektet thelbësore të jetës private nuk është e mjaftueshme. Gjykata vijoi duke u shprehur se një parandalim efektiv është i domosdoshëm në këtë fushë dhe se ai mund të arrihet vetëm me anë të dispozitave të së drejtës penale.

16. Në këtë çështje, pasi kishte shqyrtuar zhvillimin e konceptit të përdhunimit në

<sup>116</sup> Për më tepër në lidhje me detyrimet pozitive shih *Kmetty kundër Hungarisë*, të përfshirë në këtë botim.



shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe në të drejtën ndërkombëtare, Gjykata u përqendrua në shqyrtimin e themelit të çështjes së kërkueses. Ajo gjeti një sërë mangësish në hetim, përfshirë deklaratat kontradiktore të dëshmitarëve, të cilat për më tepër nuk ishin marrë në shqyrtim siç duhej, besueshmërinë e dyshimtë të deklaratave të të akuzuarve, faktin që i ishte kushtuar një vëmendje e pakët karakterit të dobët të personave në moshë të re dhe faktorët psikologjikë në raste që kishin të bënin me përdhunimin e të miturve. Ajo konstatoi se shteti kishte shkelur detyrimet e tij pozitive në bazë të neneve 3 dhe 8 të Konventës. Me anë të këtij vendimi, Gjykata përpunoi edhe më tej parimin e shpallur në çështjen *X dhe Y kundër Holandës* sipas të cilit dispozitat e së drejtës penale janë parandalues i domosdoshëm i akteve të rënda si përdhunimi dhe se është e nevojshme që këto dispozita të zbatohen me efektivitet.

## S. DHE MARPER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesat nr. 30562/04 dhe 30566/04)

4 dhjetor 2008

Dhomë e Madhe

*ruajtja e gjurmëve të gishtërinjve dhe shembujt e AND-së nga autoritetet*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, S. dhe Michael Marper, janë që të dy shtetas britanikë që kanë lindur më 1989 dhe 1963 respektivisht. Ata jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar.
2. Më 19 janar 2001, S. u arrestua dhe u akuzua për tentativë vjedhje. Ai ishte 11 vjeç në atë kohë. Atij iu morën gjurmët e gishtërinjve dhe të ADN-së. Ai u lirua më 14 qershor 2001. Z. Marper u arrestua më 13 mars 2001 dhe u akuzua për kërcënim të partnerit të tij. Atij iu morën gjurmët e gishtërinjve dhe të ADN-së. Më 14 qershor 2001, çështja u mbyll formalisht dhe ai me partnerin e tij u pajtuan.
3. Pas mbarimit të procedurave, të dy kërkuesit kërkuan pa sukses që gjurmët e gishtërinjve dhe ADN-ja e tyre të shkatërroheshin. Informacioni u ruajt në bazë të një ligji që autorizonte ruajtjen e tij pa asnjë limit kohor.
4. Kërkesa u paraqit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut më 16 gusht 2004. Dhoma së cilës iu caktua çështja vendosi t'ia kalonte juridiksionin Dhomës së Madhe më 10 Korrik 2007<sup>117</sup>.

<sup>117</sup> Teksti i nenit 30 të Konventës: Heqja dorë nga juridiksioni në Dhomën e Madhe kur një çështje e mbetur pezull para një Dhome ngre një çështje serioze që cenon interpretimin e Konventës ose të protokolleve të saj ose kur zgjidhja e një çështjeje para Dhomës mund të ketë një rezultat të papajtueshëm me një vendim të dhënë më parë nga Gjykata, në çdo kohë para se të ketë dhënë vendimin e saj, Dhoma mund të heqë dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe, nëse një prej palëve të çështjes nuk kundërshton.

5. Kërkuesit u ankuan në bazë të neneve 8 dhe 14 të Konventës për ruajtjen e gjurmëve të gishtërinjve, për qelizat dhe profilet e ADN-së pas lirimit të tyre.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

6. Gjykata konsideroi se qelizat dhe profilet e ADN-së, si dhe gjurmët e gishtërinjve, përmbanin informacion personal tepër delikat dhe se ruajtja e tyre çonte në një ndërhyrje me të drejtën për respektin e jetës private të kërkuesit, sipas nenit 8 § 1 të Konventës. Gjykata vuri re se ruajtja e gjurmëve të gishtërinjve, e qelizave dhe profileve të ADN-së kishte një bazë të qartë në ligjin vendas sipas Aktit të vitit 1984, dhe se ndiqte një qëllim legjitim, më saktësisht, identifikimin dhe parandalimin e krimit.

7. Gjykata tregoi se legjislacioni i brendshëm duhet të ofronte garancitë e duhura për të parandaluar ndonjë përdorim të të dhënave personale që mund të mos jetë në përputhje me garancitë e nenit 8 të Konventës. Gjykata shtoi se nevoja për këto garanci ishte dhe më e madhe kur bëhej fjalë për mbrojtjen e të dhënave personale të cilat i nënshtroheshin një procedimi automatik, dhe jo vetëm kur këto të dhëna përdroreshin për qëllime policore. Çështja që duhej marrë në konsideratë nga Gjykata në këtë rast, ishte nëse ruajtja e gjurmëve të gishtërinjve dhe e të dhënave të ADN-së së kërkuesve, si persona të dyshuar, por jo të dënuar, për disa krime, ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

8. Gjykata mori parasysh parimet thelbësore të instrumenteve të përshtatshëm të Këshillit të Europës si dhe ligjin dhe praktikën e shteteve të tjera kontraktuese, sipas të cilave ruajtja e të dhënave duhej të ishte proporcionale me qëllimin e mbledhjes së tyre dhe e limituar në kohë. Gjykata vërejti se Mbretëria e Bashkuar dukej se ishte juridiksioni i vetëm në KE që lejonte ruajtjen e përhershme të gjurmëve të gishtërinjve dhe të materialit të ADN-së të çdo personi në çdo moshë të dyshuar për veprë penale. Të dhënat në fjalë mund të mbaheshin pavarësisht nga natyra ose rëndësia e veprës penale për të cilën individit ishte akuzuar ose nga mosha e personit të dyshuar; ruajtja nuk qe e limituar në kohë; dhe ekzistonin vetëm disa mundësi të kufizuara që të dhënat e një individit të liruar të fshiheshin nga baza e të dhënave kombëtare ose materialet të shkatërrheshin.

9. Gjykata shprehu një shqetësim të veçantë për rrezikun, që rridhte nga fakti se personat në situatën e kërkuesve, që nuk qenë dënuar dhe përfitonin nga parimi i prezumimit të pafajësisë, trajtoheshin njësoj si personat e dënuar. Ruajtja e të dhënave të personave të padënuar mund të ishte e dëmshme sidomos në rastet e të miturve, siç ishte rasti i kërkuesit të parë, pasur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe rëndësinë e zhvillimit të tyre dhe integrimin e tyre në shoqëri.

10. Si përfundim, Gjykata konstatoi se natyra arbitrare dhe e gjerë e kompetencave të ruajtjes së gjurmëve të gishtërinjve, qelizave dhe profileve të ADN-së të personave

të dyshuar por jo të dënuar për vepër penale, siç ishte zbatuar në çështjet në fjalë, nuk siguronte një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave publikë dhe privatë, dhe se shteti përgjegjës kishte shkelur çdo hapësirë vlerësimi të pranueshme në lidhje me këtë. Si vijim, ruajtja në fjalë përbënte një ndërhyrje joproporcionale me të drejtën e kërkuësve për respekt të jetës private dhe nuk mund të konsiderohej si e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 8 të Konventës.

#### **B. Në lidhje me nenin 14 dhe nenin 8**

11. Nën dritën e arsytimit të mësipërm, Gjykata konsideroi se nuk ishte e nevojshme të analizonte ankesën sipas nenit 14.

#### **C. Në lidhje me nenin 41**

12. Gjykata konsideroi se konstatimi i një shkelje, me pasojat që kjo mund të ketë në të ardhmen, mund të shihet si një dëmshpërblim i drejtë në lidhje me dëmin moral të pretenduar nga kërkuësit. Gjykata i akordoi kërkuësve 42 000 euro përse i përket shpenzimeve, dhe më pak se

2 613.07 euro të paguara për ndihmën juridike.

#### **D. Në lidhje me nenin 46**

13. Ajo vuri re se, në përputhje me nenin 46 të Konventës, shteti përgjegjës duhet të zbatojë, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e duhura të përgjithshme dhe/ose masat individuale për të përmbushur detyrimet e tij për të siguruar të drejtën e kërkuësve dhe personave të tjerë në situatën e tyre për të respektuar jetën e tyre private.

### **III. Koment**

14. Neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që mbron të drejtën për të respektuar jetën private dhe familjare, shtëpinë dhe korrespondencën, ka një zbatim të gjerë dhe është ndoshta një nga dispozitat më të përshtatshme kur diskutohet mbi faktin se Konventa është një dokument i gjallë, e cila duhet interpretuar nën dritën e kushteve të sotme. Me teknologjitë e reja të shpikura për të luftuar krimin ose përmirësuar zbatueshmërinë dhe suksesin e tyre, është e rëndësishme të ekzaminosh se si jeta private e një individi mund të cenohet ndërkohë që njihet rëndësia e rolit të shtetit në parandalimin, ndjekjen dhe dënimin e krimeve, detyrim ky që rrjedh nga Konventa.

15. Dhe pse njohja e ADN-së dhe se si mund të përdoret ajo nuk është një gjë e re (shumë progres në këtë fushë u arrit në vitet '50), nuk u përdor njësor në luftën kundër krimin deri në vitet 1990. Rasti në fjalë ka të bëjë me te drejtat e jetës private të individëve, të cilëve iu morën qeliza gjatë një kohe ku dyshoheshin për kryerjen e një krimi, por që nuk ishin dënuar. Në vendimin marrë me unanimitet nga Dhoma e Madhe, ajo që ishte befusuese për Gjykatën, kishte të bënte me faktin se Mbretëria e Bashkuar (me përjashtim të Skocisë) ishte juridiksioni i vetëm ndërmjet 47 shteteve anëtare të Këshillit të Europës) ku lejohej ruajtja pa limit e gjurmëve të gishtërinjve

dhe materialeve të ADN-së të çdo personi të çdo moshe, të dyshuar për një vepër penale. Duke qenë se Mbretëria e Bashkuar pretendonte të ishte pararendëse e zhvillimit të kësaj teknike, mbante një përgjegjësi të veçantë për të siguruar një ekuilibër të përshtatshëm ndërmjet interesave të individëve dhe të autoriteteve.

16. Me qëllim për tu përshtatur me vendimin, Mbretëria e Bashkuar duhet të rishikojë legjislacionin dhe praktikën lidhur me bazën e të dhënave të ADN-së dhe gjurmëve të gishtërinjve, dhe të adoptojë dhe përshtatë ligje të cilat marrin parasysh të drejtat e jetës private të individëve, shembuj të ADN-së të të cilëve janë marrë dhe ruhen nga autoritetet.

## M.G. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

*(kërkesa nr. 39393/98)*

**24 shtator 2002**

*e drejta e një personi për t'u njohur me dosjen e tij personale*

### I. Faktet kryesore

1. M.G. është shtetas britanik, i cili ka lindur më 1960 dhe jeton në Leicester. Ai kishte qenë nën kujdestarinë e autoriteteve lokale në periudhat 8 shtator deri 6 nëntor 1961, 15 shkurt deri 20 korrik 1962, 26 tetor deri 23 dhjetor 1962, 4 prill 1963 deri 4 prill 1966 dhe 16 janar deri 8 prill 1967. Gjatë këtyre periudhave, e ëma i nënshtrohej trajtimeve periodike psikiatrike dhe i ati kishte vështirësi t'i përballonte i vetëm fëmijët. Ndërkohë që ishte nën kujdestari M.G., kishte pasur kontakte me të dy prindërit.

2. Me një letër të 10 prillit 1995, kërkuesi kërkoi që të njëjët me të dhënat që shërbimet sociale kishin në lidhje me të. Me dy letra të tjera, të 5 dhe 9 qershorit 1995, ai kërkoi të dinte nëse ai ishte përfshirë ndonjëherë në “regjistrin e rrezikut”, nëse i ati ishte hetuar ose dënuar për krime ndaj të miturve si dhe në lidhje me përgjegjësinë e autoriteteve lokale për abuzimin viktimë e të cilit ai kishte qenë.

3. Me një letër të 12 qershorit 1996 drejtuar autoriteteve vendore, avokati i kërkuesit qartëson se kërkuesit i ishin ofruar të dhëna të përmbledhura dhe me disa dokumente. Ata kërkonin që ai të kishte mundësi të njëjët me të gjithë dosjen e tij. Në përgjigjen e tyre autoritetet lokale saktësonin se të dhënat e shërbimeve sociale ishin krijuar përpara hyrjes në fuqi të Ligjit për t'u Njohur me Dosjet Personale të vitit 1987. Pas pyetjeve të vazhdueshme të kërkuesit, autoriteti lokal konfirmoi se nuk kishte të dhëna në lidhje me të pas vitit 1967 dhe fare pak të dhëna mbi keqtrajtimin e pretenduar prej tij.

4. Në letrën e tij të 21 janarit 1997, kërkuesi deklaroi se po merrte këshilla juridike në lidhje me abuzimet të cilave iu ishte nënshtruar kur ishte fëmijë dhe avokatët e tij po vlerësonin një padi për neglizhencë kundër autoritetit vendor. Ai kërkoi gjithashtu të dhëna të posaçme në lidhje me pretendimet për keqtrajtim që i ishte shkaktuar në nëntor 1966 si dhe në lidhje me abuzimin nga i ati përgjatë tetë vjetëve në vijim. Autoriteti vendor iu përgjigj me një letër të 17 shkurtit 1997, duke e referuar kërkuesin në të dhënat që i ishin ofruar ndërkaq më 1995 si dhe në ndryshimet ndërmjet standardeve dhe procedurave të shërbimeve sociale më 1997 në krahasim me vitet '60.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesi ankohej në lidhje me mënyrën jo të përshtatshme në të cilën autoriteti vendor i kishte bërë të njohura atij të dhënat personale të shërbimeve sociale. Ai saktësoi se nuk i kishte marrë ende të gjitha të dhënat e shërbimeve sociale mbi të dhe iu referua në veçanti periudhës prill 1967-1976 për të cilën ai nuk kishte marrë asnjë lloj të dhëne. Ai pretendoi se moslejimi i tij për të pasur mundësi të njihej plotësisht me të gjitha të dhënat që shërbimet sociale kishin në lidhje me të gjatë gjithë këtyre periudhave përbënte shkelje të nenit 8 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 8

6. Gjykata kujtoi se e kishte marrë në shqyrtim çështjen e njohjes së një individi me të dhënat e shërbimeve sociale mbi fëmijërinë e tij, në bazë të nenit 8 të Konventës, në çështjen Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>118</sup>. Në atë çështje, Gjykata kishte pranuar se dosja e z. Gaskin ofronte një regjistrim zëvendësues të kujtimeve dhe eksperiencave të prindërve të një fëmijë që ishte vendosur në kujdestari. Ajo gjithashtu përmbante të dhëna në lidhje me aspekte tepër personale të fëmijërisë, zhvillimit dhe jetës së z. Gaskin dhe se përbënte një burim kryesor informacioni mbi vitet e rritjes dhe formimit të tij. Gjykata arriti në përfundimin se të dhënat e z. Gaskin lidheshin pa dyshim me jetën e tij private dhe familjare në mënyrë të tillë që çështja e njohjes me to binte në fushën e zbatimit të nenit 8 të Konventës.

7. Në përcaktimin e faktit nëse kishte një detyrim pozitiv në bazë të nenit 8, Gjykata mbajti parasysh baraspeshën e drejtë që duhej ruajtur ndërmjet interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe interesit të individit përkatës. Ajo shkoi më tej duke vënë në dukje se personat në pozitën e z. Gaskin kishin një interes jetësor, të mbrojtur nga Konventa, për marrjen e të dhënave të nevojshme për të njohur dhe kuptuar fëmijërinë dhe zhvillimin e tyre të hershëm. Ajo pranoi se fakti që autoriteti që kishte krijuar dosjen duhet të jepte pëlqimin për njohjen me këto të dhëna mund të ishte në përputhje me Konventën. Sidoqoftë, ajo konstatoi se mungesa e çdo autoriteti të pavarur që të vendoste në instancë të fundit mbi njohjen me këto të dhëna në rastet kur autoriteti që kishte krijuar dosjen nuk shprehej dot ose pengonte njohjen në mënyrë të papërshtatshme, përbënte shkelje të detyrimit të shtetit në bazë të nenit 8 të Konventës.

<sup>118</sup> Vendim i Gjykatës i 7 korrikut 1989.

8. Në çështjen që po marrim në shqyrtim në lidhje me M.G., Gjykata vlerësoi se të dhënat e shërbimeve sociale të cilat përbënin burimin kryesor të informacionit në lidhje me periudha përcaktuese të viteve të formimit të kërkuesit, kishin të bënin me jetën e tij private dhe familjare. Gjykata vuri në dukje se një prej arsyeve kryesore që e bënin kërkuesin të kërkonte të njihej me të dhënat e tij ishte besimi i tij i sinqertë se kur ai kishte qenë fëmijë i ati kishte abuzuar fizikisht me të dhe se ai kishte nevojë të merrte sa më tepër të dhëna që të ishte e mundur në lidhje me këtë periudhë me qëllim që të vlerësonte pasojat emocionale dhe psikologjike të ndonjë abuzimi të tillë dhe të kuptonte qëndrimet e tij përkatëse të mëvonshme.

9. Gjykata vuri në dukje që kërkuesit i ishte bërë e mundur të njihej vetëm në mënyrë të kufizuar me të dhënat mbi të më 1995, duke e krahasuar me të dhënat që iu paraqitën Gjykatës nga ana e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Për më tepër, nuk parashikohej në favor të kërkuesit me ligj ndonjë e drejtë për t'u njohur me këto të dhëna ose ndonjë akt në të cilin ai të mund të mbështetej për të kërkuar njohjen me këto të dhëna ose të kundërshtonte mohimin e mundësisë për t'u njohur me to. Për më tepër kërkuesi nuk kishte asnjë mundësi ankimi ndaj refuzimit përpara ndonjë organi të pavarur. Të dhënat e lejuara nga ana e qeverisë, nxorën në pah nevojën për një mundësi të tillë ankimi, pasur parasysh sasitë e mëdha të dokumenteve që ishin bllokuar si dhe të dokumenteve që nuk ishin dhënë me justifikimin se duhej ruajtur konfidencialitetin e personave të tretë.

10. Në rrethana të tilla, Gjykata arriti në përfundimin se nga ana e autoriteteve shtetërore ka pasur mangësi në përmbushjen e detyrimit pozitiv për mbrojtjen e jetës private dhe familjare të kërkuesit në lidhje me të drejtën e tij për t'u njohur me të dhënat mbi të të shërbimeve sociale duke filluar nga muaji prill i vitit 1995. Sidoqoftë, që nga 1 marsi 2000 (data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave të vitit 1998) kërkuesi, megjithëse nuk e kishte bërë një gjë të tillë, mund të ishte ankuar pranë një autoritete të pavarur kundër bllokimit të disa të dhënave për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të personave të tretë. Për këtë arsye, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8 përsa i përket kësaj të drejte në periudhën prill 1995 deri 1 mars 2000.

### ***B. Në lidhje me nenin 41***

11. Kërkuesit iu akorduan 4 000 euro si dëmshpërblim për dëm jo-material.

### **III. Koment**

12. Megjithëse edhe një lexim i shpejtë i nenit 10 të bën të mendosh se e drejta për të marrë informacion përfshihet në këtë nen, Gjykata për mëse pesëmbëdhjetë vjet ka mbajtur qëndrimin që neni 10 mbulon vetëm informacionin që të tjerët dëshirojnë të japin. E drejta për të marrë informacion që ka të bëjë me mirëqenien e një personi dhe që të tjerët, në veçanti organet shtetërore, nuk dëshirojnë ta bëjnë të njohur normalisht rregullohet nga ana e nenit 8 të Konventës.



13. Kërkesa e trajtuar në këtë çështje fillimisht përfshinte edhe keq-trajtimin që kërkuesi kishte pësuar nga i ati. Kjo pjesë e kërkesës u deklarua e papranueshme nga Gjykata për shkak se M.G. nuk e kishte dërguar kërkesën e tij në Strasburg brenda gjashtë muajve nga marrja dijani për keqtrajtimet dhe për neglizhencën përkatëse të autoriteteve vendore. Ai ishte ankuar gjithashtu edhe në bazë të nenit 3. Gjykata kishte vlerësuar se trajtimi nuk ishte aq i ashpër sa të gjente zbatim neni 3 dhe kështu që e riklasifikoi ankesën në kuadrin e nenit 8.

14. Në vitin 2000, qeveria britanike përmirësoi më së fundi legjislacionin e saj për të shmangur boshllëqet procedurale që ishin konstatuar nga ana e Gjykatës në çështjen Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar. Edhe përpara kësaj date, Gjykata vazhdimisht kishte theksuar se shtetet jo vetëm që duhet të mos i shkelin me veprime të drejtat e mbrojtura nga Konventa por ka shtuar se neni 1 parashikon detyrimin pozitiv që shtetet duhet të krijojnë kuadrin ligjor të nevojshëm për të mbrojtur të drejtat e parashikuara nga Konventa edhe materialisht edhe proceduralisht. Këto garanci procedurale, ashtu si edhe në këtë rast, duhet të jenë parashikuar konkretisht në rastet kur individët kërkojnë informacion me qëllim që t'u japin fund vuajtjeve që kanë pësuar në të shkuarën. Gjykata ka konstatuar gjithashtu që, a fortiori<sup>119</sup>, në rastet kur vetë shtetet kanë qenë përfshirë në veprime që kanë pasojë të diskutueshme për mirëqenien fizike dhe psikologjike të personave të cenuar, neni 8 kërkon "të krijohen procedura efektive dhe të tilla që t'u lejojnë personave që të njihen me të gjitha të dhënat që u duhen dhe që janë të rëndësishme me qëllim që të nisin procedimet përkatëse"<sup>120</sup>. Në vendimin T.P. dhe K.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar të 10 majit 2001, Gjykata shkoi edhe më tej dhe u shpreh se këto detyrime pozitive në bazë të nenit 8 në disa rrethana mund të kërkojnë që shteti t'a bëjë të mundur dhënien e informacionit përkatës, edhe në mungesë të ndonjë kërkesë nga ana e individëve të interesuar.

## MIKULIĆ kundër KROACISË

(kërkesa nr. 53176/99)

7 shkurt 2002

*gjendja e pasigurisë së kërkueses në lidhje me identitetin e saj personal u vlerësua si në kundërshtim me nenet 6 dhe 8 të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Montana Mikulić është shtetase kroate e lindur më 1996 nga një lidhje jashtë martesore, të cilës i ati nuk ia kishte njohur atësinë. Më 30 janar 1997, ajo dhe e

<sup>119</sup> Nga latinishtja – për më tepër; aq më tepër.

<sup>120</sup> Siç shprehet Gjykata në vendimin e saj të 9 qershorit 1998 në lidhje me çështjen L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar.

ëma bënë një kërkesë-padi kundër H.P.-së për njohjen e atësisë përpara Gjykatës së Rrethit të Zagrebit. Një numër seancash që u caktuan nga ana e kësaj gjykate u shtynë për shkak se H.P., nuk iu bind as urdhrave të Gjykatës për t'u paraqitur për kryerjen e analizave të ADN-së, të cilat u shtynë për 6 herë me radhë. Pas tre vjetësh e gjysmë, Gjykata arriti në përfundimin se H.P. ishte i ati i kërkueses. Ajo e mbështeti përfundimin e saj në dëshminë e nënës së kërkueses dhe në faktin që H.P. vazhdimisht iu ishte shmangur analizave të ADN-së.

2. H.P. apeloj në Gjykatën e Apelit të Zagrebit e cila e prishi vendimin e shkallës së parë, me konstatimin se atësia e H.P.-së nuk mund të vendoset duke pasur si kriter kryesor shmangien e tij nga testet e ADN-së. Çështja iu dërgua përsëri gjykatës së rrethit e cila u urdhërua gjithashtu nga apeli që të dëgjonte dëshmitarë të cilët, sipas H.P., kishin pasur marrëdhënie intime me nënën e kërkueses gjatë periudhës së lindjes së kësaj të fundit. Më 19 nëntor 2001, Gjykata e Rrethit, vendosi përsëri për atësinë e H.P.-së dhe caktoi pjesën e detyrimit të këtij për mbajtjen e kërkueses. H.P. apeloj përsëri. Procedurat në Gjykatën e Apelit nuk ishin mbyllur ende kur kërkuësja iu drejtua GJEDNJ-së.

3. Kërkuësja ankohej, në bazë të nenit 8, se dështimi i gjykatave të brendshme në marrjen e një vendimi në lidhje me rastin e saj e kishte lënë atë në një gjendje të pasigurt përsa i përket identitetit të saj personal. Ajo u ankua gjithashtu, në bazë të nenit 6 § 1, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave dhe, në bazë të nenit 13, se ajo nuk kishte pasur në disponim mjete për të përshpejtuar procedurat dhe se e drejta kroate nuk i detyronte palët e paditura në padi për njohjen e atësisë për të respektuar urdhrin e një gjykate për të bërë një test ADN-je.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

4. Gjykata vuri në dukje se procedurat gjyqësore kishin filluar më 30 janar 1997. Megjithatë, periudha që bie brenda juridiksionit të Gjykatës, nuk fillon më këtë datë, por më 6 nëntor 1997, datë në të cilën Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka hyrë në fuqi në Kroaci. Por gjithsesi, me qëllim që të përcaktohet karakteri i arsyeshëm i kohëzgjatjes së çështjes në fjalë, duhet mbajtur parasysh stadi i ecurisë së çështjes deri më 5 nëntor 1997, pra fakti që deri në këtë datë procedurat gjyqësore i kishin kaluar ndërkaq 9 muaj.

5. Gjykata ritheksoi se kërkohet një zell i veçantë në çështje që kanë të bëjnë me statusin dhe zotësinë juridike civile të personave fizikë. Duke pasur parasysh se ç'ishte në lojë për kërkuesen në rastin në fjalë, autoritetet kompetente kombëtare duhet të vepronin me një zell të veçantë për të siguruar ecjen përpara të procedurave.

6. Gjykata vuri në dukje se Gjykata e Brendshme, kishte parashikuar në programin e saj 15 seanca, gjashtë nga të cilat ishin shtyrë për shkak se H.P. nuk ishte paraqitur, ndërsa nëntë të tjerat ishin shtyrë për shkak se nuk ishte paraqitur kërkuësja. Në

lidhje me pretendimin e qeverisë, sipas së cilës Gjykata e Brendshme ishte penguar në zhvillimin e procesit për shkak se pala e paditur në këtë proces nuk ishte paraqitur në seancat gjyqësore apo në testet e ADN-së, Gjykata theksoi se u takonte shteteve që të organizonin sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre t'i garantonin çdokujt të drejtën për të pasur një vendim në lidhje me të drejtat dhe detyrimet me karakter civil brenda një kohe të arsyeshme. Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata vlerësoi se koha gjatë së cilës ishte shtrirë procesi nuk e kënaqte kërkesën e afatit të arsyeshëm. Për këtë arsye ka pasur, shkelje të nenit 6 § 1.

### **B. Në lidhje me nenin 8**

7. Në çështjen në fjalë mënyra e vetme me anë të së cilës kërkuesi mund të vërtetonte nëse H.P. ishte apo jo babai i saj biologjik, ishte ajo me anë të procedurave gjyqësore përpara një Gjykate Civile. Gjykata vuri re se nuk ekzistonin masa në të drejtën kroate për ta detyruar H.P. për të respektuar urdhrin e gjykatës për kryerjen e testit të ADN-së. Nga ana tjetër, nuk kishte as ndonjë dispozitë të drejtpërdrejtë që të parashikonte pasojat e një mosrespektimi të tillë. Sidoqoftë, ishte e vërtetë që gjykatat në procese civile ishin të lira që të arrinin në përfundime që mbanin parasysh faktin që njëra nga palët ishte përpjekur që të pengonte daljen në pah të disa fakteve. Megjithatë, një dispozitë procedurale me karakter të përgjithshëm, e cila u jepte një pushtet diskrecionar gjykatave për vlerësimin e provave, nuk përbënte në vetvete një mjet të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për të përcaktuar atësinë në raste kur personi që pretendohet nga fëmija si babai, i shmangej urdhrin të gjykatës për bërjen e testit të ADN-së. Për më tepër, Gjykata e Shkallës së Parë, nuk kishte arritur të zgjidhte çështjen e atësisë me anë të vlerësimit të provave të tjera të rëndësishme.

8. Gjykata vlerësoi se persona që ishin në situata të ngjashme me atë të kërkuetit kishin një interes jetësor, të mbrojtur nga Konventa, për të marrë informacionin e nevojshëm për zbulimin e së vërtetës në lidhje me një aspekt të rëndësishëm të identitetit të tyre personal. Nga ana tjetër, duhet mbajtur mirë parasysh që mbrojtja e personave të tretë mund të ndalojë thirrjen e tyre për t'ia nënshtruar testeve mjekësore të çdo lloji, përfshirë këtu edhe ADN.

9. Një sistem ligjor si ai kroat, që nuk parashikon mjete për ta detyruar babain e pretenduar për të respektuar një urdhër gjykatë për kryerjen e testit të ADN-së, mund të konsiderohet në parim si i pajtueshëm me nenin 8 të Konventës. Por sidoqoftë, Gjykata vlerësoi se, në bazë të një sistemi të tillë, interesat e individit që kërkon të vendoset në lidhje me atësinë e tij duhet të përmbushen edhe kur nuk mund të vendoset mbi bazën e një testi të ADN-së. Mungesa e çdo mase procedurale gjyqësore të tillë që ta detyronte babain e pretenduar që të respektonte urdhrin e gjykatës, mund të ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm në qoftë se ajo parashikonte mjete alternative që i mundësonin një autoriteti të pavarur që të vendoste shpejt në lidhje me pretendimin për njohjen e atësisë. Dhe mesa duket, në rastin në fjalë, nuk kishte ndonjë procedurë të tillë në dispozicion të kërkuetit.

10. Për më tepër, në marrjen e vendimit në lidhje me një kërkesë padi për njohjen e

atësisë, gjykatave u kërkohej që të mbanin parasysht parimin themelor të interesit të fëmijës. Gjykata konstatoi se procedura e parashikuar nuk ofronte një baraspeshë të drejtë ndërmjet të drejtës së kërkuases për të sqaruar paqartësinë që ajo kishte në lidhje me identitetin e saj personal pa ndonjë vonesë. Për këtë arsye, mungesa e efektivitetit të gjykatave e kishte lënë kërkuesen në një gjendje të zgjatur paqartësie përsa i përket identitetit të saj personal. Për pasojë ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

### C. Në lidhje me nenin 13

11. Gjykata konstatoi se kërkuësja nuk kishte pasur mjete efektive në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave dhe se, për këtë arsye, ka pasur shkelje të nenit 13 të marrë së bashku me nenin 6 § 1 të Konventës.

12. Në lidhje me ankimin e saj për mangësi të masave në të drejtën e brendshme për ta detyruar të paditurin të merrte pjesë në seancat gjyqësore për njohjen e atësisë, Gjykata vlerësoi se e kishte mbajtur ndërkaq parasysht këtë aspekt në konstatimet e saj në kuadrin e nenit 8 dhe se, për këtë arsye, ishte e panevojshme që të shqyrtohej e njëjta çështje në bazë të nenit 13.

### D. Në lidhje me nenin 41

13. Gjykata i akordoi kërkuases 7 000 euro për dëm jomaterial.

## III. Koment

14. Duhet theksuar që në fillim se kjo kërkesë kishte të bënte me kohëzgjatjen e procedurave, një çështje, që trajtohet nga neni 6 i Konventës dhe që Gjykata gjithashtu e vlerëson në kuadrin e këtij neni.

15. Sidoqoftë, Gjykata ka parë në nenin 8 të Konventës një numër elementesh që nuk dalin hapur në pah nga vetë teksti i dispozitës. I pari nga këta elementë është ai sipas të cilit e drejta për jetë private përfshin të drejtën për të vendosur marrëdhënie me të tjerët edhe pse këto marrëdhënie mund të mos jenë përfshirë në përcaktimin e familjes sipas Konventës. Nëse baballarë të pamartuar mund të konsiderohen si familje për qëllimet e nenit 8 të Konventës, kjo do të varet nga rrethanat konkrete të çdo rasti të dhënë. Kjo e drejtë përfshin gjithashtu të drejtën për informacione të çdo lloji që mund të jenë të rëndësishme për të drejtë të përfshira në kuadrin e nenit 8, të tilla si e drejta për 'integritet fizik dhe moral' që është formulimi që Gjykata përdor për të nënkuptuar të drejtën për mirëqenie fizike dhe mendore. Kjo e drejtë përfshin gjithashtu të drejtën për të marrë pranë organeve shtetërore informacion që është i nevojshëm për arsye shëndetësore<sup>121</sup>. E drejta për të marrë dhe dhënë informacione, e cila përfshihet në nenin 10 të Konventës, është konsideruar nga ana e Gjykatës sikur mbulon vetëm informacionin që një person apo institucion dëshiron të bëjë të njohur. Neni 8 përfshin të drejtën për përcaktuar faktet në lidhje me identitetin

<sup>121</sup> Shih për shembull vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet Guerra kundër Italisë, të 19 shkurt 1998, dhe L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar të 9 qershorit 1998.

personal, përfshirë këtu edhe atësinë. Në një rast mjaftë të hershëm, Gaskin kundër Mbretërisë së Bashkuar, të 7 korrikut 1989, Gjykata mbajti qëndrimin se mundësia për t'u njohur me dosjet që shteti kishte mbi fëmijërinë e kërkuesit kur ky kishte qenë në kujdes publik, ishte një e drejtë e mbrojtur nga ana e nenit 8 të Konventës.

16. Gjykata kishte mbajtur gjithashtu mjaft shpesh qëndrimin sipas të cilit neni 8 përmban "garanci procedurale të mishëruara në të" të cilat duhet të parashikohen dhe respektohen nga veprimet ose mosveprimet shtetërore që këto të mund të jenë në përputhje me Konventën. Dhe duhet kujtuar gjithashtu që ky është një detyrim më vete nga ai për të respektuar të drejtat me karakter material të Konventës. Kërkesat e bëra përpara Gjykatës së Strasburgut kanë qenë të suksesshme në rastet kur këto garanci procedurale kanë munguar, edhe pse veprimi ose mosveprimi në vetvete mund të mos kishte përbërë shkelje të Konventës. Ky parim ka qenë zbatuar shpesh në raste kur fëmijët janë marrë në kujdes publik dhe ky veprim mund të kishte qenë konsideruar në përputhje me Konventën në qoftë se do të ishin respektuar edhe garancitë e duhura procedurale. Doktrina e "hapësirës së vlerësimit" nënkupton që shtetet nuk kanë pse parashikojnë ndonjë procedurë të parashikuar shprehimisht që të jetë në përputhje me detyrimet e parashikuara nga ana e Konventës, por në qoftë se nuk ekzistojnë procedura të tilla, mekanizma të tjerë duhen parashikuar për të mbrojtur të drejtat e individit. Në rastin në fjalë jo vetëm që nuk kishte pra mjete detyruese që t'i detyronin baballarët që të pranonin kryerjen e testeve të ADN-së, por nuk kishte as ndonjë procedurë alternative të tillë që të mund t'i lejonte kërkuesit që të njihin identitetin e tij.

## ANTUNES ROCHA kundër PORTUGALISË

(kërkesa nr. 64330/01)

31 maj 2005

*mbledhja e të dhënave personale në këtë rast përbënte sipas Gjykatës shkelje të respektimit të jetës private të kërkueses*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Garcia Maria Antunes Rocha, është shtetase portugeze e cila ka lindur më 1954 dhe jeton në Portugali. Në maj 1994 ajo nënshkroi një kontratë të përkohshme punësimi si asistente administrative për Këshillin Kombëtar të Planifikimit të Emergjencave Civile (CNPCE). Kjo strukturë jepte llogari drejtpërdrejt tek kryeministri. Në të njëjtën ditë ajo plotësoi edhe dy formularë, njërin të NATO-s dhe tjetrin të Autoritetit të Sigurisë Kombëtare. I pari i kërkonte që të jepte informata në lidhje me veten dhe të afërmit e saj, ndërsa i dyti parashikonte zotimin e saj që të respektonte rregullat e sigurisë së NATO-s.

2. Në shtator 1994, kërkuesja dha dorëheqjen pasi zbuloi se ajo dhe familja e saj kishin qenë subjekt i një hetimi i cili përfshinte vënien e shtëpisë nën mbikëqyrje dhe marrjen në pyetje të miqve dhe fqinjëve të saj. Sipas informatave të Ministrisë së Mbrotjtjes, i gjithë stafi i CNPCE i cili punonte me NATO-n, mund t'i nënshtrohej një mbikëqyrje në mënyrë që të konsiderohej si i përshtatshëm për arsye sigurie.

3. Kërkuesja bëri një padi duke pretenduar shkelje të jetës private dhe për pasojë filloi një hetim kundër një apo disa personave të panjohur. Në qershor 1999, prokurori kompetent e pushoi çështjen me argumentimin se shkelja ishte amnistuar. Megjithatë, në 21 janar 2000, gjyqtari që administronte çështjen pranoi që ta kalonte për gjykim çështjen me kërkesën e kërkueses. Kërkuesja pretendoi shpërblimin e dëmit që kishte pësuar nga shkelja e së drejtës së saj për jetë private. Por, Gjykata Penale e Lisbonës, më 26 tetor 2001, e hodhi poshtë kërkesën e Znj. Antunes Rocha, *inter alia*, me argumentimin se shkelja e pretenduar ishte amnistuar.

4. Kërkuesja ankohej në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore në të cilat ishte palë. Ajo ankohej gjithashtu se, pa i marrë pëlqimin ose pa e vënë në dijeni, ndaj vetë asaj dhe familjes së saj ishin bërë hetime të cilat vinin në kundërshtim me nenin 8 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

5. Procedurat kishin zgjatur një vit e tetë muaj, përderisa ato kishin filluar efektivisht vetëm kur kërkuesja kishte kërkuar hapjen e shqyrtimit gjyqësor në janar 2000 dhe ishin mbyllur me vendimin e Gjykatës Penale të Lisbonës. Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes e cila nuk paraqiste ndonjë vështirësi të veçantë, Gjykata vlerësoi se ajo periudhë nuk ishte në përputhje me kërkesat e një “afati të arsyeshëm”. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

### B. Në lidhje me nenin 8

6. Gjykata mendoi se vendimi i autoriteteve për të mbledhur informacion në lidhje me kërkuesen, përbënte ndërhyrje në jetën e saj private. Në shqyrtimin e faktit nëse ndërhyrja ishte apo jo “në përputhje me ligjin”, Gjykata vuri së pari në dukje se kishte një bazë ligjore për një ndërhyrje të tillë dhe që ishte një Rezolutë e Këshillit të Ministrave nr. 50/88 të vitit 1988. Ajo e vlerësoi qëllimin e këtij akti si mjaftueshmërisht të qartë, sidomos në lidhje me përcaktimin e ndershmërisë dhe të besnikërisë së personit të interesuar, në lidhje me zakonet, jetën sociale, sjelljen dhe diskrecionin e saj në nivele të tilla që ta lejonin atë të punonte me dosje sekrete. Megjithatë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë në lidhje me mënyrën në të cilën ishin kryer hetimet përkatëse. Legjislacioni ishte tepër i vagët dhe nuk i paralajmëronte personat e interesuar në lidhje me faktin se ata mund t'i nënshtroheshin disa masave të veçanta, të tilla si mbikëqyrja e shtëpive të tyre ose testimi i njohurive të tyre. Për më tepër, legjislacioni nuk ofronte asnjë mekanizëm kontrolli dhe as ndonjë garanci ndaj abuzimeve për individët e interesuar.



7. Për pasojë, Gjykata konstatoi se ligji portugez nuk e rregullonte me qartësi të mjaftueshme qëllimin e hetimeve për qëllime sigurie ose mënyrën në të cilën ato duheshin kryer. Në këto kushte, Gjykata konstatoi se ishte shkelur neni 8 i Konventës.

### C. Në lidhje me nenin 41

8. Gjykata i akordoi kërkuases një shumë prej 7 500 euro si shpërblim për dëmin jomaterial të pësuar.

## III. Koment

9. Megjithëse procedurat në rastin në fjalë ishin penale dhe jo civile dhe personi i interesuar (kërkuessa në këtë rast), nuk ishte ngarkuar me ndonjë akuzë penale për qëllimet e zbatimit të nenit 6, jurisprudenca e Gjykatës e ka bërë ndërkaq të qartë që palët civile në proceset penale mund të dëmtohen nga shkelje të nenit 6 të Konventës. Kjo mund të ndodhë kur aspekte të procesit penal shkelin interesat e tyre, siç mund të jetë (si në këtë rast) kohëzgjatja e procesit, mosakordimi i shpejtë i dëmshpërblimit eventual në përfundim të procesit ose mosekzekutimi i vendimit.

10. Kjo çështje ka një vlerë të jashtëzakonshme për t'iu kujtuar shteteve detyrimet që ato kanë kur mbledhin apo ruajnë dosje me të dhëna personale. Gjykata kujtoi që, pavarësisht nëse një e dhënë e caktuar nuk është private por njihet publikisht, mbledhja dhe ruajtja e saj nga ana e organeve shtetërore përbën një ndërhyrje ndaj jetës private e cila duhet justifikuar në bazë të disa kriterëve tepër strikte të përfshira në paragrafin e dytë të nenit 8<sup>122</sup>. Duke iu referuar jurisprudencës së saj të mëparshme të përmendur në poshtëshënimin paraardhës, Gjykata vuri në dukje se një sistem i mbikëqyrjes sekrete që ka për synim të mbrojë sigurinë kombëtare mund të rrezikojë ose edhe të shkatërrojë thelbin e vetë shoqërisë demokratike të cilën ai synon të mbrojë. Ndërhyrja, si pasojë e mbledhjes dhe ruajtjes të të dhënave personale në këtë rast, nuk rezultoi nga një hetim penal apo hetim në lidhje me sigurinë kombëtare por nga një akt vullnetar që bëhej me qëllim që kërkuessa të pranohej në një funksion të caktuar. As dokumentet që ajo kishte nënshkruar dhe as legjislacioni që autorizonte hetimet sekrete nuk ishin aq transparente për të sa të parashikonte pasojat e këtij akti të vullnetshëm të saj. Për këtë arsye, ndërhyrja ishte e paligjshme dhe në kundërshtim me Konventën. Në vijim të këtij konstatimi, për fat të keq (të paktën sipas mendimit tim), Gjykata nuk kishte përse të vazhdonte më tej në analizën e justifikueshmërisë së ndërhyrjes.

11. Një analizë tërësore e justifikueshmërisë në lidhje me legjitimitetin e ndërhyrjes, karakterin e saj të nevojshëm në një shoqëri demokratike dhe eventualitetin e një zbatimi diskriminues të saj do t'i kishin dhënë këtij vendimi të Gjykatës, një vlerë të jashtëzakonshme për qëllimet e debatit të bërë në vitin 2004 në lidhje me Ligjin nr. 9049 datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" dhe me vendimin

<sup>122</sup> Shih vendimet e Gjykatës të 26 marsit 1987 në lidhje me çështjen Leander kundër Suedisë sidomos paragrafi 48 si dhe atë të në lidhje me çështjen Rotaru kundër Rumanisë sidomos paragrafi 43.

përkatës të Gjykatës Kushtetuese nr. 16 të 11 nëntorit 2004. Mendoj se pozicionimet përkatëse juridike, sidomos të atyre që mendonin se nuk kishte ndërhyrje në jetën private të individit nga dispozitat e këtij ligji, do të duhet të rishikoheshin edhe një herë në kuadrin e vendimit të Gjykatës së Strasburgut që po komentojmë<sup>123</sup>.

12. Kjo çështje merr vlera edhe në kuadrin e një debati tepër interesant që ka filluar në Europë përsa i përket raportit mes luftës ndaj terrorizmit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Deklarata e ministrit të brendshëm britanik, Charles Clarke, se Britania e Madhe mund të rikonsiderojë pjesëmarrjen e saj në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut hasi në reagimin e menjëhershëm të Presidentit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës Z. René van der Linden<sup>124</sup>.

**CHAPMAN kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR,  
COSTER kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR,  
BEARD kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR,  
LEE kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR DHE  
SMITH kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR**

(kërkesa 27238/95, 24876/94, 24882/94, 25289/94, 25154/94)

18 janar 2001

**Dhomë e Madhe**

*në këtë çështje interesante Gjykata vlerëson se mënyra e jetesës së ciganëve, ne karvanë, përfshihet në konceptin e jetës së tyre private dhe familjare, por se ushtrimi i kësaj të drejte nuk duhet të çenojë mbrojtjen e mjedisit*

**I. Faktet kryesore**

1. Çështjet kanë të bëjnë me kërkesa të paraqitura nga kërkues që u përkisnin 5 familjeve britanike cigane: Sally Chapman, lindur më 1954 dhe banuese në Hertfordshire; Thomas dhe Jessica Coster, lindur më 1962 dhe 1964 dhe banues në Kent; John dhe Katherine Beard, lindur më 1935 dhe 1937 dhe aktualisht pa adresë të qëndrueshme për karvanët e tyre; Jane Smith, lindur më 1955 dhe banuese në Surrey; dhe, Thomas Lee, lindur më 1943 dhe banues në Kent.

2. Sally Chapman bleu një truall më 1985 në Distriktin e Three Rivers në Hertfordshire, në të cilin synonte të vendoste karvanin e saj, por pa marrë paraprakisht për këtë gjë një leje për planimetri ndërtimi. Asaj iu refuzua leja e planimetrisë së ndërtimit për karvanin

<sup>123</sup> Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës së Strasburgut të 24 qershorit 2004 në lidhje me çështjen von Hannover kundër Gjermanisë, si dhe komentim tim përkatës (çështja paraardhëse në këtë botim).

<sup>124</sup> Njoftim për Shtyp i Këshillit të Europës më 9 shtator 2005.

e saj si dhe leja për të ndërtuar një shtëpi njëkatëshe. Trualli që ajo kishte blerë ndodhej në një zonë të vijës së gjelbër. U pranua gjithashtu, gjatë procedurave të vlerësimit të lejes, që nuk kishte truall zyrtar për ciganë në zonën në fjalë dhe për këtë arsye u zgjat afati i zbatimit të urdhrit të ekzekutimit. Znj. Chapman u gjobit për moszbatim të urdhrit dhe u largua nga trualli i saj për tetë muaj, duke u kthyer si pasojë e mungesës së mundësive të tjera dhe sepse e kishte humbur gjithë kohën duke u detyruar të largohet sa nga njëri kampim i paligjshëm tek tjetri. Ajo ende banon në truallin e saj me të shoqin dhe me të atin i cili është tejet të nëntëdhjetave dhe vuan nga senile dementia.

3. Thomas dhe Jessica Coster, burrë dhe grua, pretendojnë se kishin qenë të detyruar, për arsye të mungesës së mundësive, që të jetonin në një shtëpi pronë shtetërore, nga 1983 deri më 1987. Më 1988 duke qenë se blenë truall pranë Maidstone në Kent, ata u shpërngulën atje dhe banonin në karvanë. Kërkesa e tyre për leje të planimetrisë së ndërtimit u rrëzua dy herë me arsyetimin se një ndërtim i tillë do të përbënte cënim të një zone rurale tërheqëse. Ata u ndoqën penalisht dhe u gjobitën më 1989, 1990 dhe 1992. Në vijim të procedurave gjyqësore, më 1992 ata u larguan nga trualli i tyre por u kthyen përsëri pas pak. Ata u gjobitën përsëri më 1994, u vunë përpara procedimeve gjyqësore përsëri më 1996 të cilat u zëvendësuan me procedime administrative për largim në bazë të seksionit 178 të Ligjit të vitit 1990 mbi Planimetrinë e Qytetit dhe të Rrethit. Ata pretendonin se, në vijim të këtij procedimi, më 1997 nuk u ngeli mundësi tjetër veçse të pranonin të banonin në shtëpitë pronë bashkiake.

4. John dhe Cathenine Beard, burrë dhe grua, e vendosën karvanin në truallin e blerë prej tyre në Lancashire. Atyre iu refuzua dy herë radhazi leja e planimetrisë së ndërtimit me argumentimin se pengohej një pamje e këndshme dhe për arsye të sigurisë në autostradë. Ata u ndoqën penalisht katër herë nga 1991 deri më 1995 dhe u proceduan më 1996, gjë që bëri që John Beard të dënohej me një heqje lirie me kusht për tre muaj për moslëvizje të karvanit. Që prej atëherë, ata janë larguar prej andej dhe deri tani janë pa ndonjë adresë të përcaktuar të karvanëve të tyre.

5. Thomas Lee dhe familja e tij i vendosën karvanët në një truall të blerë prej tyre në një zonë veçanërisht të shtrirë në Kent. Leja e planimetrisë së ndërtimit u refuzua me argumentimin se një inspektor përkatës konstatoi se ky truall ishte veçanërisht i dukshëm dhe ndërtimi do të dëmtonte zonën përreth. Në lidhje me zonat publike në afërsi, Kent u ankua se ato nuk ishin të përshtatshme për banim pasi janë pranë territoreve ku hidheshin plehrat. Megjithatë, leje u dha për përdorim të një karvani për qëllime bujqësore në një truall në afërsi me të tijin si dhe në lidhje me një kompleks të madh banimi rreth 550 metra larg truallit të tij.

6. Jane Smith dhe familja e saj blenë një truall për karvanët e tyre në një zonë të vijës së gjelbër në Surrey dhe iu refuzua leja e planimetrisë së ndërtimit për shkak se prona e tyre cenonte një zonë të veçantë të rrethinave të qytetit. Kërkesa e saj për një shtëpi njëkatëshe u refuzua, me arsyetimin që të mos çënohej karakteri rural i rrethinave të qytetit. Procedurat penale filluan kundër saj më 1994, në vijim të të cilave familja bëri kërkesë që të strehohej si e pastrehë. Ajo ankohej që shtëpia e ofruar ose ka

qenë në apartamente ose që zona urbane ose ka qenë në troje të papërshtatshme për banim për shkak të ndotjes. Ajo vazhdon të qëndrojë në truallin e saj nën kërcënimin për largim ose për dërgim në burg për mosrespektim të vendimit.

7. Kërkuesit pretendonin se masat e marra ndaj tyre, për të zbatuar masat e planimetrisë, por që nuk lejonin që ata të vendosnin karvanët në trojet në pronësi të tyre shkelnin nenin 8 dhe nenin 14 të Konventës.

8. Të gjithë kërkuesit, përveç familjes Beard, argumentonin se këto masa përbënin gjithashtu ndërhyrje në gëzimin paqësor të pronës së tyre, gjë që binte në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit 1.

9. Sally Chapman dhe Jane Smith pretendonin gjithashtu për pamundësi për t'iu drejtuar efektivisht Gjykatës për të kundërshtuar vendimet e planimetrisë dhe të largimit të tyre të marra nga ana e autoriteteve. Ndërsa familja Coster, Jane Smith dhe Thomas Lee iu referuan gjithashtu nenit 2 të Protokollit 1 duke pretenduar se masat e largimit privonin fëmijët dhe nipërit e tyre nga mundësia për arsimim.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

10. Në të pesë rastet, Gjykata vlerësoi se mënyra e banimit të kërkuesve në karvanë, ishte pjesë përbërëse e identitetit të tyre etnik si ciganë dhe se masat e largimit dhe vendimet në lidhje me planimetrinë në secilin prej rasteve kishin përbërë ndërhyrje në të drejtën e kërkuesve për respektim të jetës së tyre private dhe familjare.

11. Megjithatë, Gjykata, konstatoi se masat ishin “në përputhje me ligjin” dhe se ato ndiqnin qëllimin e ligjshëm të “mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve” me anë të ruajtjes së mjedisit.

12. Përsa i përket karakterit të nevojshëm të masave të marra në përmbushje të këtij qëllimi të ligjshëm, Gjykata konsideroi se një hapësirë e madhe interpretimi u duhej njohur autoriteteve vendase të cilat ishin shumë më në gjendje për të marrë vendime që lidheshin me vlerësime të planimetrisë në një zonë të caktuar. Në këto raste, Gjykata konstatoi se inspektorët e planimetrisë kishin nxjerrë në dukje argumente të fortë mjedisore të cilat vinin në kundërshtim dhe zhvleftësonin interesat individuale të kërkuesve për përdorim të trojeve të tyre.

13. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se ciganët ishin të lirë të ngrinin kampet e tyre në çdo zonë karvanësh që kishte leje planimetrike. Megjithëse kishte zona të pamjaftueshme të konsideruara nga ciganët si të pranueshme e të akordueshme dhe, në të cilat, ata do të mund të vendosnin në mënyrë të ligjshme karvanët e tyre, Gjykata nuk u bind se nuk kishte zgjedhje të tjera të mundshme për kërkuesit, përveç atij të zënies së trojeve pa leje planimetrie në disa raste në zonat e gjelbra ose në zonat e parqeve të veçanta.

14. Gjykata nuk e pranoi që, për shkak se statistikisht numri i ciganëve ishte më i madh se sa numri i vendeve të mundshme në zona të autorizuar për ciganët, vendimet për të mos i lejuar kërkuesit të shkonin në troje ku ata dëshironin për të vendosur karvanët e tyre përbënin shkelje të nenit 8. Ajo nuk u bind, nga ana tjetër, se neni 8 mund të interpretohej në një mënyrë të tillë sikur detyronte Mbretërinë e Bashkuar, apo ndonjë nga palët e tjera kontraktuese të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut, që të vinte në dispozicion të bashkësisë së ciganëve një numër të përshtatshëm zonash të pajisura me lehtësitë e nevojshme për ta. Neni 8 nuk ofronte të drejtën për tu pajisur me një shtëpi, dhe asnjë nga vendimet e mëparshme të Gjykatës nuk e kishte njohur një të drejtë të tillë. Nëse shteti gjen apo jo fonde për t'i mundësuar çdokujt që të ketë një shtëpi është një çështje me karakter politik dhe jo juridik.

15. Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të nenit 8.

#### ***B. Në lidhje me nenin 14***

16. Në të pesë rastet, Gjykata mbajti parasysht konstatimet e lartpërmendura në lidhje me nenin 8 që çdo ndërhyrje në të drejtat e kërkuesve kishte qenë në proporcion me qëllimin legjitim të ruajtjes së mjedisit dhe prandaj nuk gjeti shkelje të këtij neni.

#### ***C. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1***

17. Për të njëjtat arsye të parashtruara në lidhje me nenin 8, Gjykata konstatoi se çdo ndërhyrje ndaj gëzimit paqësor të pronave të kërkuesve ishte në proporcion dhe arrin një baraspeshim të drejtë në lidhje me kërkesat e nenit 1 të Protokollit 1.

#### ***D. Në lidhje me nenin 6***

18. Në rastin Chapman dhe Jane Smith Gjykata konstatoi se rishikimi nga ana e Gjykatës së Lartë, gjë e cila ishte e hapur për kërkuesit pas një procedimi publik përpara një inspektori, ishte në vetvete i mjaftueshëm për të qenë në përputhje me kërkesat e nenit 6 § 1 të mundësisë për t'iu drejtuar një gjykate të pavarur. Ai mundësonte që vendimi edhe të ndryshohej në bazë të argumenteve që ai ishte jo-normal, i paarsyeshëm, nuk ishte i bazuar në prova ose ishte marrë në bazë të faktorëve të parëndësishëm ose pa pasur parasysht faktorët e rëndësishëm, gjë e cila ofronte një kontroll gjyqësor adekuat të vendimit administrativ në fjalë.

#### ***E. Në lidhje me nenin 2 të Protokollit 1***

19. Në Coster, Lee dhe Jane Smith, Gjykata konstatoi se kërkuesit nuk kishin arritur të argumentonin kërkesat e tyre në lidhje me faktin që fëmijët dhe nipërit e tyre ishin efektivisht të privuar nga e drejta për tu arsimuar si pasojë e masave të planifikimit për të cilat ato ankoheshin. Në lidhje me Coster, Gjykata vuri në dukje se fëmija i tyre më i madh, tashmë më i madh se 16 vjeç, e kishte lënë shkollën dhe kishte filluar punë dhe se fëmijët e tyre më të vegjël po ndiqnin shkollën pranë shtëpisë. Në lidhje me Lee nipërit e kërkuesit ndiqnin shkollën pranë banesës së tyre në truallin e kërkuesit dhe, në lidhje me Jane Smith, kërkuesi kishte banuar në truallin e tij që më 1993.

### III. Koment

20. Në lidhje me këto raste, vendosi Dhoma e Madhe. Vetëm ato ankime në lidhje me të cilat vendimi nuk mund të merret mbi bazën e një jurisprudence të konsoliduar ose të cilat ngrenë çështje mbi zbatimin ose interpretimin e Konventës, çohen përpara Dhomës së Madhe. Vendimi i Dhomës së Madhe është i dëshirueshëm në raste të tilla, sepse shmang mundësinë që çështja të zgjidhet vetëm nga një numër i vogël gjyqtarësh në një Dhomë. Dhoma e Madhe përbëhet nga Presidenti, Zëvendës-Presidenti i Gjykatës, Presidentët e Dhomave bashkë me një numër gjyqtarësh të emëruar në bazë të kritereve të një shpërndarjeje të barabartë gjeografike dhe të përfaqësimit të sistemeve të ndryshme ligjore.

21. Në të pesë rastet Dhoma e Madhe vendosi, me dhjetë vota kundër shtatë, që nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës. Pasur parasysh se qëllimi i shqyrtimit të një rasti nga një Dhomë e Madhe është ai i zgjidhjes së çështjeve themelore dhe i ofrimit të linjave të qarta të orientimit për të ardhmen, një shumicë e tillë e ngushtë në vendim i jep këtij një vlerë të kufizuar. Në të ardhmen nuk do të ishte e pamundur që një Dhomë e përbërë nga disa prej gjyqtarëve të cilët ishin në pakicë të konstatonte një shkelje të nenit 8 të Konventës në një rast të ngjashëm.

22. Ndërsa çështjet kishin të bënin me ciganë që dëshironin të jetonin në karvanë, ndoshta fakti që ciganët në Mbretërinë e Bashkuar përgjithësisht nuk vuajnë atë nivel kërcënimesh dhe përbuzjeje sociale si romët në disa vende të Evropës Qendrore dhe Lindore, mund të ketë ndikuar në vendimin e shumicës së Gjykatës. Natyrisht që pjesë e argumentimit të Gjykatës ishte fakti që rastet nuk kishin të bënin me “stilin e lëvizshëm të jetës cigane” por më thjesht me refuzimin e autoriteteve lokale të lejeve të planimetrive të përdorimit të trojeve.

## SLIVENKO kundër LETONISË

(kërkesa nr. 48321/99)

9 tetor 2003

Dhomë e Madhe

*largimi i kërkuësve nga Letonia shkelte të drejtat e tyre për jetë private*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuësit, Tatjana Slivenko dhe e bija Karina Slivenko, kanë banuar në Letoni dhe kanë origjinë ruse. Ato tani jetojnë në Kursk, në Rusi.
2. Tatjana Slivenko, babai i së cilës kishte qenë një oficer i ushtrisë së Bashkimit



Sovjetik, kishte lindur në Estoni më 1959 dhe u transferua në Letoni me prindërit e saj kur ishte veçse një muajsh. Ajo u martua me një oficer tjetër sovjetik, Nikolaj Slivenko më 1980 dhe më 1981 lindi vajza e saj Karina.

3. Pasi Letonia rifitoi pavarësinë e saj, kërkuesit u regjistruan si banorë Letonezë por si “ish shtetas së BRSS”. Më 1994, bashkëshorti i Tatjanës, i cili ishte shkarkuar nga detyra pasi Federata Ruse kishte fituar kontrollin e të gjitha forcave ushtarake sovjetike, bëri një kërkesë për një leje qëndrimi të përkohshëm me argumentin se ishte martuar me një banorë të përhershme. Kërkesa e tij u refuzua për shkak se atij i ishte kërkuar që të largohej nga Letonia në bazë të Traktatit të prillit 1994 mbi largimin e trupave ruse, në veçanti të oficerëve që kishin qenë në shërbim deri më 28 janar 1992. Për pasojë u anulua edhe regjistrimi i kërkueseve.

4. Urdhëri për largimin e tre anëtarëve të familjes u mor në gusht 1996. Ata u nxorën nga apartamenti i tyre në Riga dhe në vijim Nikolaj Slivenko u largua drejt Rusisë. Ndërsa kërkueset bënë një padi në gjykatë për të kundërshtuar largimin e tyre nga Rusia. Gjykatat letoneze arritën në përfundimin se Nikolaj Slivenko duhej të largohej dhe se vendimi për anulimin e regjistrimit të kërkueseve ishte i ligjshëm.

5. Më 28 tetor 1998, kërkueset u arrestuan dhe u mbajtën në një qendër për imigrantët e paligjshëm. Ato u liruan të nesërmen me urdhër të Drejtorit të Autoritetit të Shtetësisë dhe të Migrimit, me argumentin se arrestimi i tyre ishte “i parakohshëm”, përderisa pranë këtij Autoriteti ishte bërë një apel kundër anulimit të regjistrimit. Sidoqoftë, në vijim ato u urdhëruan të largohen nga vendi dhe më 16 mars 1999 kërkuesja e dytë u arrestua përsëri dhe u mbajt në gjendje ndalimi për 30 orë.

6. Më 11 korrik 1999 ato shkuan në Rusi për t'u bashkuar me Nikolaj Slivenko dhe në vijim fituan edhe shtetësinë ruse. Urdhri i dëbimit ndaj kërkueseve i ndalonte ato që të ktheheshin në Letoni për pesë vjet dhe pas kësaj periudhe periudhat e vizitave të tyre në Letoni ishin kufizuar në 90 për vit. Prindërit e Tatjana Slivenkos kishin qëndruar të Letoni dhe ajo pretendonte se ata ishin të sëmurë rëndë.

7. Kërkuesit ankoheshin në bazë të nenit 8 të Konventës për shkelje të së drejtës për jetë private dhe familjare, të nenit 14 për diskriminim ndaj tyre për arsye të origjinës dhe në bazë të nenit 5 §§ 1 dhe 4 për shkelje të së drejtës për liri dhe siguri për shkak të arrestimit të tyre të paligjshëm.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

8. Gjykata vuri re se Tatjana Slivenko kishte shkuar në Letoni kur ajo kishte qenë veçse një muaj dhe kishte jetuar atje deri në moshën 40 vjeçare. Në Letoni ajo kishte shkuar në shkollë, kishte punuar dhe ishte martuar. E bija, Karina kishte lindur në Letoni dhe kishte jetuar atje deri në moshën 18 vjeç, pasi kishte përfunduar shkollën e mesme. Për këto arsye, që nga lindja e tyre ato kishin zhvilluar një rrjet

marrëdhëniesh personale, sociale dhe ekonomike, të cilat janë përbërës të një jete private në Letoni. Ato humbën gjithashtu një apartament në Letoni, në të cilin ato edhe kishin banuar. Për këto arsye largimi i tyre nga Letonia përbënte një ndërhyrje ndaj së drejtës së tyre për jetë private dhe banesë.

9. Megjithatë, masat e marra nga autoritetet Letoneze nuk çuan në prishje të lidhjeve të tyre familjare, përderisa dëbimi kishte të bënte me të tre anëtarët e familjes dhe nuk kishte ndonjë të drejtë në bazë të Konventës për të zgjedhur vendin në të cilin do vazhdohet ose rifillohet jeta familjare. Prindërit e Tatjanës ishin të rritur që nuk i përkisnin boshtit familjar dhe nuk ishte pretenduar se ata vareshin nga familja e Tatjanës. Megjithatë, lidhjet e saj me prindërit duheshin marrë parasysh në kontekstin e jetës së saj familjare.

10. Traktati mbi tërheqjen e trupave ruse (i cili ishte baza kryesore ligjore për dëbimin e kërkuesve) nuk ishte më në fuqi në kohën kur kërkuesit u regjistruan si “ish shtetas të BRSS”. Megjithatë, e drejta e brendshme mund të interpretohet dhe zbatohet me plot të drejtë edhe më vonë nën dritën e këtij traktati. Për më tepër, kërkuesit duhet të kishin qenë në gjendje të parashikonin në një masë të arsyeshme, qoftë edhe me ndihmën e një avokati, se ata do të shiheshin si subjekte situata juridike e të cilëve prekej nga ky traktat. Kjo do të thotë se vendimet e gjykatave letoneze nuk dukeshin arbitrare. Pra, mund të thuhet se largimi i kërkuesve nga Letonia ka qenë “në përputhje me ligjin”.

11. Duke mbajtur parasysh një kontekst më të gjerë të rregullimeve kushtetuese dhe ndërkombëtare letoneze pas fitores së pavarësisë, Gjykata pranoi se traktati dhe masat e zbatimit të tij kishin synuar të mbronin interesat e sigurisë kombëtare të Letonisë. Mund të thuhet gjithashtu se masat përkatëse, përfshirë në këtë rast dëbimin, nuk e cenonin jetën private përderisa ato nuk ndërhyjnë në shpërbërjen e trungut familjar. Nga ana tjetër largimi i një funksionari publik në shërbim, Nikolaj Slivenkos pra, dhe i familjes së tij mund të konsiderohej i ngjashëm me një transferim gjatë një shërbimi normal të një funksionari publik. Në vijim, prania e vazhdueshme e një funksionari të një ushtrie të huaj mund të konsiderohej gjithashtu si e papajtueshme me sovranitetin e një shteti të pavarur dhe kërcënim për sigurimin kombëtar. Normalisht pra, interesi publik për largimin e këtyre ushtarakëve dhe të familjeve të tyre ishte më i lartë se interesi i individëve për të mos u larguar.

12. Megjithatë, masat për largimin e këtyre individëve mund të mos arrijnë të justifikohen në çdo rast. Për shembull, ato nuk zbatoheshin në të njëjtën masë edhe ndaj ushtarakëve në pension dhe familjeve të tyre.

13. Fakti që Nikolaj Slivenko kishte dalë në pension në kohën kur kishin filluar procedurat në lidhje me ligjshmërinë e qëndrimit të kërkuesve në Letoni, nuk kishte çuar në ndonjë ndryshim përsa i përket statusit të tyre. Megjithatë vendimet ishin marrë rast pas rasti, autoritetet nuk duket se kishin vlerësuar nëse secili person përfaqësonte një rrezik specifik për sigurinë kombëtare ose rendin publik, duke

e perceptuar kështu interesin publik në terma abstraktë. Hartimi i një skeme për tërheqjen e trupave të huaja dhe të familjeve të tyre thjesht e bazuar në një vlerësim të përgjithshëm se largimi i tyre ishte i nevojshëm për sigurinë kombëtare nuk ishte në vetvete në kundërshtim me nenin 8, por në kundërshtim me këtë nen ishte zbatimi i kësaj skeme në mënyrë të tillë që nuk merrte parasysh rrethanat individuale.

14. Kërkuesit ishin integruar në shoqërinë Letoneze në atë kohë dhe nuk mund të thuhej më se ata përbënin rrezik për sigurinë kombëtare edhe për shkak se prindërit e Tatjanës, të cilët kishin dalë në pension më 1986, kishin qëndruar në Letoni dhe nuk ishin konsideruar se përbënin një rrezik të tillë. Duke mbajtur parasysh të gjitha këto rrethana, nuk mund të thuhet se largimi i kërkuesve kishte qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike dhe për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

#### **B. Në lidhje me nenin 14**

15. Gjykata nuk e pa të arsyeshme që ta shqyrtonte çështjen edhe në bazë të këtij neni.

#### **C. Në lidhje me nenin 5 § 1 dhe 4**

16. Gjykata vuri në dukje se asnjëri prej masave të ndalimit ndaj kërkuesve nuk i mungonte baza ligjore në të drejtën e brendshme dhe se nuk kishte prova se policia kishte vepruar në keqbesim ose arbitrarisht. Për pasojë ndalimi i kërkuesve ka qenë në përputhje me nenin 5 § 1 (f) të Konventës.

17. Gjykata vlerësoi gjithashtu se nuk ishte e nevojshme që të merrej në shqyrtim thelbi i ankesës përderisa kërkueset ishin lënë të lira menjëherë përpara se një gjykatë të shqyrtonte ligjshmërinë e ndalimit të tyre dhe neni 5 § 4 nuk gjen zbatim në lidhje me mjetet për rishikimin e ligjshmërisë së masave të heqjes së lirisë të cilat kanë marrë fund.

#### **D. Në lidhje me nenin 41**

18. Gjykata vendosi se secila prej kërkuesve duhet të merrte 10 000 euro si dëmshpërblim për dëmin jomaterial.

### **III. Koment**

19. Në këtë çështje të rëndësishme, Dhoma që në fazën e pranueshmërisë u tërhoq nga juridiksioni dhe ia kaloi shqyrtimin Dhomës së Madhe. Gjykata e ka marrë në shqyrtim edhe më parë qëndrimin e mbajtur nga Letonisë në lidhje me minoritetin rus dhe në çështjen *Podkolzina kundër Letonisë* konstatoi shkelje të Konventës nga masat e marra kundër një shtetaseje me origjinë ruse që dëshironte të kandidonte për zgjedhjet e përgjithshme.

20. Në fushën e imigrimit, Gjykata shpeshherë ka qenë e detyruar të marrë në shqyrtim raste kur individët që iu përkisnin minoriteteve etnike pretendonin se dëbimi ose largimi i tyre nga një shtet shkelte të drejtën e tyre për respektim të

jetës familjare dhe private. Jurisprudenca e Gjykatës është orientuar normalisht drejt qëndrimit që nuk ka ndërhyrje ndaj së drejtës për jetë familjare, dhe nuk ka prapash nevojë për justifikim në bazë të paragrafit 2 të nenit 8, në qoftë se individëve iu kërkohet që të shkojnë të jetojnë në një vend tjetër. Në këtë kuadër, vlen të theksohet një moment tepër i rëndësishëm, për kushtet e Shqipërisë sidomos. Pikërisht ai që nuk ka ndonjë të drejtë të përgjithshme të individit në bazë të Konventës për zgjedhjen e vendbanimit nga ana e tij.

21. Vendimi interesant që po komentojmë riorientohet drejt konceptit të jetës private të nenit 8. Shumica e Dhomës së Madhe vlerësoi se largimi i kërkuesve nga Letonia, vendi “ku ata kishin zhvilluar, në mënyrë të pandërprerë që nga lindja e tyre, një rrjet marrëdhëniesh personale, sociale dhe ekonomike të cilat përbëjnë në fakt jetën private të çdo personi” përbente një ndërhyrje ndaj së drejtës së tyre për respektim të jetës private. Sipas Gjykatës, autoritetet letoneze gabuan kryesisht në një moment në lidhje me këtë çështje. Gabimi i tyre kishte të bënte me faktin që ato nuk ndërmorën një analizë të tillë që të baraspeshonte interesat ndërmjet rreziqeve të mundshme për sigurinë kombëtare për shkak të lejimit të familjeve të ish ushtarakëve sovjetikë që të qëndronin në Letoni, nga njëra anë, dhe ndërhyrjet ndaj jetës së tyre private për shkak të dëbimit nga ana tjetër. Gjashtë gjyqtarë, përfshirë gjyqtarin letonez, dolën në pakicë. Ata vlerësuan se ndërhyrja ishte justifikuar nga rrethanat e jashtëzakonshme të tërheqjes së ish trupave sovjetike nga Letonia.

## PECK kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 44647/98)

28 janar 2003

*kjo çështje ka të bëjë me një ndërhyrje të pajustificuar në jetën private të kërkuesit me anë të një filmimi dhe regjistrimi të paautorizuar*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Geoffrey Dennis Peck, është shtetas britanik i lindur më 1955 dhe banon në Essex.
2. Në pasditen e 20 gushtit 1995, në një kohë që ai vuante nga depresioni, z. Peck, ecte i vetëm nëpër rrugët e qytetit me një thikë kuzhine në dorë dhe tentoi të vriste veten duke prerë damarët e dorës. Ai nuk e kishte vënë re se ishte filmuar nga kamera e një televizioni me rrjet të mbyllur (TVM) e instaluar nga Këshilli Bashkiak i Brentwood-it.
3. Filmimi nga TVM nuk e tregonte kërkuesin duke prerë damarët e tij; operatorit

vetëm i kishte tërhequr vëmendjen një individ që mbante një thikë. Pas njoftimit policia arriti në vendin e ngjarjes, ku ata morën thikën, i dhanë kërkuesit ndihmë mjekësore dhe e çuan në rajonin e policisë ku ai u mbajt, në bazë të Ligjit për Shëndetin Mendor të vitit 1983. Ai u vizitua dhe u kurua nga një mjek, dhe pas këtij mjekimi ai u lirua pa u akuzuar dhe u shoqërua në shtëpi nga disa policë.

4. Më 9 tetor 1995, Këshilli Bashkiak shpërnda dy fotografi të marra nga filmimi i TVM-së me anë të një artikulli të titulluar: “Të qetë – partneriteti ndërmjet TVM dhe policisë parandalon situata që mund të jenë të rrezikshme”. Në këto foto, fytyra e kërkuesit nuk ishte mbuluar. Artikulli sqaronte se një individ ishte parë me thikë në dorë, se ai ishte qartazi i mërzitur por nuk dukej se kërkonte të shkaktonte turbullira, se policia ishte njoftuar dhe se e kishte marrë këtë individ, e kishte çuar në rajonin e policisë ku ai ishte marrë në pyetje dhe i ishte ofruar ndihmë.

5. Më 12 tetor 1995, gazeta “Brentwood Weekly News” përdori një fotografi nga ngjarja në faqen e saj të parë me qëllim që të ilustronte një artikull mbi përdorimin dhe përfitimet e sistemit të TVM. Edhe në këtë rast fytyra e kërkuesit nuk ishte mbuluar.

6. Më 13 tetor 1995 në “Yellow Advertiser”, një gazetë lokale me një tirazh prej rreth 24 000 kopje, u botua një artikull i titulluar “Gotcha”. Artikulli, i shoqëruar me një fotografi të kërkuesit të marrë nga filmimi i TVM, përmendte se kërkuesi ishte bllokuar ndërkohë që kishte një thikë dhe se kështu ishte shmangur një situatë që mund të bëhej e rrezikshme. Bëhej gjithashtu e ditur se kërkuesi ishte lënë i lirë dhe pa u akuzuar për ndonjë akuzë. Më 16 shkurt 1996, një tjetër artikull u botua nga e njëjta gazetë duke përdorur të njëjtën fotografi. Duket pra se një numër njerëzish e njihnin tashmë kërkuesin.

7. Më 17 tetor 1995, pjesë nga filmimi i TVM u përfshinë në një program të Anglia Television, një rrjet lokal me audiencë prej rreth 350 000 teleshikuesish. Fytyra e kërkuesit këtë radhë, ishte fshehur me kërkesë me gojë nga ana e Këshillit Bashkiak.

8. Nga fundi i tetorit ose në nëntor 1995, kërkuesi u bë i ndërgjegjshëm se ai kishte qenë filmuar nga TVM dhe se ky filmim ishte shpërndarë, sepse një fqinj i tij tha se e kishte parë atë në televizion. Ai nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim sepse ende vuante nga një depresion i rëndë.

9. Filmimi i TVM iu dha gjithashtu producentëve të “Në ndjekje të krimin”, një serial i BBC në televizionin kombëtar me një audiencë prej rreth 9.2 milion shikuesish. Këshilli Bashkiak vuri një numër kushtesh, gjithmonë me gojë, duke përfshirë atë që askush nuk duhet të jetë i identifikueshëm nga filmimi dhe se të gjitha fytyrat duhet të fshiheshin.

10. Megjithatë, në reklamat për një episod të emisionit “Në ndjekje të krimin”, pamja e kërkuesit nuk ishte fshehur aspak. Pasi miqtë e tij i thanë se e kishin parë më 9

mars 1996 në këto reklama, kërkuesi u ankua në Këshillin Bashkiak në lidhje me programin që do të shfaqej. Këshilli kontaktoi producentët të cilët siguruan se kjo pamje ishte maskuar në programin kryesor. Më 11 mars, filmimi i TVM u shfaq në emisionin “Në ndjekje të krimin”. Por megjithëse pamja e kërkuesit ishte maskuar në këtë program, miqtë dhe familja e njohën atë.

11. Pas kësaj kërkuesi doli disa herë në media për të folur kundër bërjes publike të filmimit dhe të fotografive.

12. Më 25 prill 1996 kërkuesi, ndër të tjera, u ankua pranë Komisionit të Standardeve të Transmetimit (KST), në lidhje me programin “Në ndjekje të krimin”, duke pretenduar një shkelje të paparalajmëruar të jetës së tij private, dhe se ai kishte pësuar një trajtim të padrejtë dhe të parregullt. Më 13 qershor 1997, KST i hodhi poshtë të dyja ankesat. Më 1 maj 1996, kërkuesi u ankua përpara Komisionit të Pavarur të Televizioneve (KPT) në lidhje me transmetimin nga Anglia Television. KPT konstatoi se identiteti i kërkuesit nuk ishte fshehur siç duhej dhe se kodi i KPT ishte shkelur. Megjithatë, në vijim të një pranimi të këtij fakti dhe të paraqitjes së keqardhjes në lidhje me të nga ana e Anglia Television, nuk u ndërmor asnjë hap tjetër. Më 17 maj 1996, kërkuesi u ankua përpara Komisionit të Ankesave ndaj Shtypit në lidhje me artikujt në “Yellow Advertiser”, por pa sukses.

13. Më 23 maj 1996, ai iu drejtua Gjykatës së Lartë që t'i njihte të drejtën të ankohej në rrugë gjyqësore ndaj dhënies nga ana e Këshillit Bashkiak të materialeve të filmuara nga TVM. Kërkesa e tij si dhe një apelim përpara Gjykatës së Apelit u hodhën poshtë.

14. Kërkuesi ankohej në lidhje me dhënien e filmimeve të TVM mediave, gjë që çoi në botimin dhe transmetimin e pamjeve të tij në një masë të gjerë, duke pretenduar pra për shkelje të jetës së tij private të njohur nga neni 8 i Konventës. Ai ankohej gjithashtu për mungesë të mjeteve efektive ankimore duke u bazuar në nenin 13 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

15. Gjykata vuri në dukje se, pasi filmimet e TVM iu dhanë mediave, veprimet e kërkuesit nuk mund të shiheshin më si transmetimi i sjelljes së një kalimtarit të zakonshëm ose të një regjistrimi për arsye sigurie, dhe se këto regjistrime ishin të tilla që kërkuesi nuk do të kishte pasur mundësi t'i parashikonte. Për këto arsye, dhënia e këtyre filmimeve nga ana e Këshillit Bashkiak mediave përbënte një ndërhyrje serioze ndaj të drejtës së kërkuesit për respektimin e jetës së tij private. Kjo, aq më tepër që ato shfaqnin një sjellje të veçantë të kërkuesit; përpjekjen e tij për vetëvrasje.

16. Gjykata nuk gjeti ndonjë arsye të mjaftueshme apo të rëndësishme të tillë që të justifikonte transmetimin në “Lajmet e TVM” nga ana e Këshillit të pamjeve të kërkuesit, pa marrë prej këtij pëlqimin ose pa e fshehur identitetin e tij. Në mënyrë të veçantë, duhej pasur parasysh fakti që përmbajtja dhe qëllimi i transmetimit synonin parandalimin e krimin.



17. Gjykata nuk ishte e mendimit as që ndonjë nga shfaqjet e mëvonshme në media të kërkuarit e kishte zbutur natyrën serioze të ndërhyrjes, apo që këto shfaqje e kishin ulur nevojën për një kujdes në lidhje lejimin e transmetimit të tyre. Kërkuari ishte dëmtuar pra nga një ndërhyrje serioze në të drejtën e tij për jetë private nga transmetimet e mediave vendore dhe kombëtare; prandaj nuk mund të ngriheshin pretendime kundër tij në lidhje me përpjekjet për ta trajtuar dhe denoncuar këtë ndërhyrje nëpërmjet mediave.

18. Për këtë arsye, Gjykata vlerësoi se shfaqja nga ana e Këshillit të TVM e filmimeve në "TVM News" dhe në "Yellow Advertiser", Anglia Television dhe BBC nuk u shoqëruan me garanci të mjaftueshme, dhe për këtë arsye, përbënte një ndërhyrje jo proporcionale dhe të pajustificuar ndaj të drejtës së kërkuarit për jetë private, dhe pra edhe një shkelje të nenit 8.

#### *B. Në lidhje me nenin 13 në bashkëpunim me nenin 8*

19. Gjykata konstatoi se rishikimi gjyqësor nuk i ofronte kërkuarit një mjet efektiv ankimor në lidhje me shkeljen e së drejtës së tij për respektim të jetës së tij private. Në vijim, mungesa e kompetencave vendimore e KPT dhe KST për t'i akorduar kompensim për dëme kërkuarit, bëjnë të qartë se këto organe nuk mund të ofrojnë një mjet efektiv në dispozicion të tij.

20. Duke vlerësuar pra se kërkuari nuk kishte mundësi të përdorte një mjet efektiv ankimor ndaj shkeljes të së drejtës së tij për jetë private, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 13.

#### *C. Në lidhje me nenin 41*

21. Gjykata i akordoi kërkuarit 11 800 euro për dëmin jomaterial dhe 18 075 euro për shpenzime gjyqësore dhe ligjore.

### **III. Koment**

22. Gjykata ka pranuar shpesh se mbledhja e të dhënave private të individëve mund të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike. TVM përdoret shpesh tashmë në vendet publike për parandalimin ose ndjekjen e krimit. Edhe në çështjen Peck, u pranua plotësisht që përdorimi i TVM ishte i justifikuar, madje edhe kur synohej bërja e tyre publike. Por,, Gjykata konstatoi si të papranueshëm faktin që veprimet e një individit çfarëdo, që nuk kishte lidhje me konsumimin e ndonjë vepre penale, ishin bërë publike në media në mënyrë të tillë që ndërhyenin jo-proporcionalisht në të drejtën e tij për respektim të jetës private.

23. Në rastet kur kemi procese penale, një mediatizim i tillë do të ngrinte aspekte të zbatimit të nenit 6 në lidhje me respektimin e prezumimit të pafajësisë ose paragjykimin e së drejtës për një gjykim të drejtë. Por ky nuk ishte rasti në çështjen në fjalë. Gabimi nuk qëndronte në mediatizimin e filmimit por në tre shkelje të tjera specifike:

- i) mosmarrjen e masave për të pasur pëlqimin e kërkuesit që nga çasti kur identiteti i tij u bë i njohur për ata që e shihnin filmimin;
- ii) mosfsherja e identitetit të tij përpara mediatizimit të filmimit;
- iii) dështimi në garantimin e faktit që televizionet që do ta përdornin filmimin do ta maskonin identitetin.

Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se Gjykata nuk vlerësoi se kërkuesi e kishte sakrifikuar të drejtën e tij për jetë private meqenëse kishte ndërmarrë veprime publike për t'u ankuar ndaj ndërhyrjes në jetën e tij private.

## K.H. DHE TË TJERË kundër SLOVAKISË

(kërkesa nr. 32881/04)

28 prill 2009

*e drejta për akses efikas tek informacioni për shëndetin dhe statusin e riprodhimit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkueset janë tetë femra të kombësisë sllovake dhe me origjinë etnike rome. Ato u trajtuan në dy spitale të Sllovakisë lindore gjatë shtatëzhanive të tyre dhe gjatë lindjeve, pas të cilave asnjëra prej tyre nuk mund të bënte sërish fëmijë pavarësisht përpjekjeve të tyre të vazhdueshme. Kërkueset dyshuan se arsyeja për papjellorinë e tyre mund të ishte fakti se ndaj tyre ishte ndërmarrë një procedurë sterilizimi gjatë lindjes së tyre cezariene prej personelit mjekësor në spitalet përkatëse.

2. Për të patur mundësinë e kryerjes së analizave mjekësore lidhur me arsyet për jofertilitetin e tyre dhe për mundësinë e marrjes të trajtimit të mundshëm, kërkueset autorizuan avokatët e tyre për të riparë dhe fotokopjuar kartelat e tyre mjekësore si një evidencë potenciale në procedurat e ardhëshme civile për dëme si dhe për t'u siguruar se dokumente dhe evidencë e kësaj natyre të mos shkatërroheshin ose humbnin. Avokatët kryen dy përpjekje, respektivisht në gusht dhe shtator të vitit 2002 për marrjen e fotokopjeve të kartelave mjekësore por nuk u lejuan ta bënin këtë nga menaxhuesit e spitalit.

3. Kërkueset paditën spitalet përkatëse, duke u kërkuar gjykatave që të urdhëronin këta të fundit për lëshimin e kartelave mjekësore të tyre përfaqësuesve ligjorë të autorizuar dhe për t'i lejuar ata më vonë që të merrnin fotokopje të dokumentave të përfshira në kartelat në fjalë.

4. Në qershor të vitit 2003, gjykatat urdhëruan spitalet që të lejonin kërkueset dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë të autorizuar për të konsultuar kartelat mjekësore dhe për të bërë shënime me dorë prej tyre, por nuk pranuan kërkesën për fotokopjimin e dokumentave duke argumentuar se kështu parandaloheshin abuzimet me to. Ata

gjithashtu vendosën se kërkueset nuk ishin ndaluar për të patur ndonjë ankimum të mëtejshëm për dëmtime të cilën ato mund ta sillnin, të vendosur sipas kërkesave të Konventës. Në veçanti, nën ligjin relevant institucionet mjekësore ishin të detyruara të parashtronin informacionin e duhur për, veç të tjerash, gjykatat, për shembull në kontekstin e procedimeve civile përsa i përket pretendimit të një pacienti për dëme.

5. Rrjedhimisht, shtatë kërkueset ishin të afta për të aksesuar kartelat e tyre dhe për të bërë fotokopje të tyre në përputhje me Aktin e ri të Shëndetësisë të vitit 2004. Sa i përket kërkueses së tetë, spitali i ka dhënë asaj vetëm një kartelë të thjeshtë të procedurës kirurgjikale që tregon se mbi të është kryer një operacion dhe që ajo ishte sterilizuar gjatë procedurës.

6. Duke u bazuar në nenin 8, nenin 6 § 1 dhe nenin 13, kërkueset u ankuan se nuk kishin qenë të afta për t'u pajisur me fotokopje të kartelave të tyre mjekësore të cilat u nevojiteshin atyre për të gjetur shkakun për pafertilitetin e tyre. Ato u ankuan gjithashtu se iu ishte ndaluar aksesin në gjykatë duke qenë se ato ishin të paafta për të patur akses në mënyrë të kualifikuar pozicionin në çështjet e tyre për një padi të mëvonshme civile, për shanset për sukses të një padie të tillë, dhe për të patur mundësinë që të përdornin fotokopjet të kartelave mjekësore në fjalë si evidencë.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

7. Gjykata vërejtë se kërkueset janë ankuar se ato kanë qenë të paafta për të ushtruar të drejtën e tyre për një akses efektiv në informacionin që lidhet me shëndetin e tyre dhe me aftësitë e tyre riprodhuese në një moment të caktuar në kohë. Kjo pyetje lidhet me jetën e tyre private dhe familjare dhe mbrohet si e tillë prej nenit 8 të Konventës. Gjykata konsideron se personat të cilët, si kërkueset, duan të pajisen me fotokopje të dokumentave që përmbajnë të dhënat e tyre personale, nuk duhen detyruar të arësyetojnë se përse u duhen këto kopje. Në të kundërt, duhet të ishin autoritetet që posedonin të dhënat në fjalë, që të tregonin se kishte patur një arsye të pranueshme për të mos u dhënë atyre këtë lehtësi.

8. Duke patur parasysh se kërkueset kanë marrë urdhëra gjyqësorë që u lejojnë atyre të konsultojnë të dhënat e tyre mjekësore në tërësi, për ndalimin e mundësisë për të bërë fotokopje të këtyre dokumentave nuk është dhënë një arsye mjaftueshëm e justifikuar prej autoriteteve. Për të shmangur rrezikun e abuzimit me të dhënat mjekësore do të ishte e mjaftueshme vendosja e mbrojtjes legislative në mënyrë që përdorimi i tyre të limitohej vetëm për rrethanat në të cilat të dhëna të tilla mund të shpërndareshin, si dhe për qëllimin e personave të titulluar për të patur akses në këto kartela. Gjykata vërejtë se Akti i Shëndetësisë i adoptuar në vitin 2004 ka qenë në përputhje me atë kërkesë, megjithatë, ai ka hyrë në fuqi shumë vonë për të prekur situatën e kërkueseve të kësaj çështjeje. Prandaj, ka patur një shkelje të nenit 8.

**B. Në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1**

9. Gjykata pranoi argumentin e kërkueseve se ato kanë qenë në një gjendje pasigurie lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore dhe me aftësinë e tyre riprodhuese pas trajtimit në spitalet në fjalë. Ajo gjithashtu ra dakord se marrja e fotokopjeve ka qenë esenciale për vlerësimin prespektivave për të kërkuar rivendosjen prej gjykatave të mungesave të trajtimit të tyre mjekësor. Duke qenë se ligji i brendshëm që aplikohej gjatë periudhës në fjalë limitonte shumë për kërkueset dhe avokatët e tyre mundësinë për të paraqitur çështjen e tyre përpara gjykatës në mënyrë efektive, dhe se qeveria nuk kishte paraqitur arësye të mjaftueshme për të justifikuar këtë limitim, Gjykata vendosi se ka patur shkelje të nenit 6 § 1.

**C. Në lidhje me nenin 13**

10. Gjykata nuk gjeti shkelje të këtij neni duke theksuar se ai nuk garantonte një kompensim për të sfiduar një ligj sit ë tillë përpara një autoriteti të brendshëm. Ajo gjithashtu konsideroi si të panevojshme për të shqyrtuar veçanërisht ankimet e kërkueseve sipas nenit 13 në kombinim me nenin 6 § 1, duke qenë se ajo vendosi se detyrimet e nenit 13 ishin më pak strikte dhe të përfshira në ato të nenit 6 § 1.

**D. Në lidhje me nenin 41**

11. Gjykata i dha secilit aplikant 3 500 euro për dëme jo pasurore dhe të gjithë aplikantëve sëbashku 8 000 euro për kostot dhe shpenzimet.

**III. Koment**

12. K.H. dhe të tjerë kundër Sllovakisë ngre çështje që i përkasin kryesisht viktimizimit të komunitetit rom, por edhe çështje të rëndësishme të cilat kanë aplikim të përgjithshëm lidhur me të drejtën për informimin për qëllimin e përfitimit të një procesi të drejtë dhe investigimi efikas, sidomos në rastet që lidhen me shëndetin. Ishte veçanërisht e rëndësishme gjatë këtij rasti, që secila prej kërkueseve kishte marrë një urdhër gjykate që autorizonte avokatët e saj të kishin akses në raportet mjekësore për qëllime hetimi dhe se në këtë pikë atyre iu mohua akses në raportet në fjalë me anë të një apeli nga Ministria e Shëndetësisë.

13. Kjo çështje adreson çështje të rëndësishme që lidhen me të drejtën për akses efektiv në informacionin dhe në statusin riprodhues. Gjykata konsideroi se kjo ishte e lidhur me të drejtën e tyre për jetë private dhe familjare sipas nenit 8 duke ndjekur edhe çështjen Roche kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>125</sup>. E drejta për akses të informacionit shëndetësor u njoh si një obligacion pozitiv edhe sipas nenit 8 në çështjen Guerra kundër Italisë<sup>126</sup> ashtu si edhe tek Roche, siç Gjykata përsëriti dhe në këtë çështje niveli i obligimeve positive ishte se ajo duhet të pajiste kërkuesit me një procedurë efikase dhe aksesibël që u mundësonte atyre që të kishin akses në të gjithë informacionin relevant dhe të duhur. Ajo konsideroi këtë në lidhje me bërjen

<sup>125</sup> Vendimi Dhomes së Madhe 19 nëntor 2005.

<sup>126</sup> Vendim i 19 shkurtit 1998.

të disponueshme të informacionit të kartelës mjekësore të një individi. Më tej, është sinjifikative që Gjykata vendosi se nuk i takon individit që të justifikojë kërkesa të tilla, por që shteti duhet të justifikojë çdo refuzim për të pajisur individin me këto të dhëna.

14. Edhe pse faktet e kësaj çështjeje ngrenë çështje substantive të cilat nuk mund të konsiderohen se janë kompetencë e nenit 3 dhe nenit 8 të marra në lidhje me nenin 14, aplikimi i përkiste të drejtës për akses në informacion lidhur me shëndetin sipas nenit 8 dhe pasojave për dështimin në dhënien e informacionit mbi padi civile të cilat janë të varura prej këtij informacioni, çka çoi në gjetjen e një dhunimi të nenit 6 § 1. Ky vendim do të shërbejë si shembull për çështje të tjera që i përkasin hetimeve të aktiviteteve që janë deklaruar se kanë një impakt mbi shëndetin dhe janë gjithashtu kryesore për të vendosur se nuk i takon një individi që të justifikojë kërkesat e tyre për marrjen e kartelës ose të dhënave, por që shteti duhet të justifikojë mosdhënien e këtij informacioni.

## VON HANNOVER kundër GJERMANISË

(kërkesa nr. 59320/00)

24 qershor 2004

*liria e shprehjes së medias mund të kufizohet kur ajo cenon jetën private të personave të tretë, qofshin këta edhe figura publike*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Princesha Caroline von Hannover, shtetase është vajza e madhe e Princit Ranier III i Monakos. Ajo ka lindur më 1957, është shtetase e Principatës së Monakos dhe banon po në Monako.

2. Në fillim të viteve 90, Princesha Caroline von Hannover kishte ndërmarrë një fushatë në disa shtete evropiane, shpesh në rrugë ligjore, me qëllim që të ndalojë botimin e fotografive mbi jetën e saj private në shtypin sensacional.

3. Në rastin konkret, kërkuesja disa herë me radhë i ishte drejtuar gjykatave gjermane me qëllim që të ndalohej çdo botim i ri i një serie fotografish që kishin dalë në shtyp në vitet 90 në revistat gjermane Bunte, Freizeit Revue dhe Neue Post, me argumentimin se ato cenonin të drejtën e saj për mbrojtje të jetës së saj private dhe të imazhit të saj. Megjithatë ajo nuk kishte pasur ndonjë sukses të madh në përpjekjet e saj.

4. Në një vendim të 15 dhjetorit 1999, Gjykata Kushtetuese gjermane i dha të drejtë pretendimit të kërkueses përse i përket fotografive ku ajo shfaqej e shoqëruar me fëmijët e saj, me argumentimin se nevoja e këtyre të fundit për mbrojtje të sferës së jetës së tyre private ishte më e gjerë se ajo e të rriturve.

5. Nga ana tjetër, Gjykata kushtetuese çmoi se kërkuesja, si “figurë *par excellence* e epokës sonë”, duhet të toleronte botimin e fotografive ku ajo shfaqej në një vend publik, edhe pse bëhej fjalë për fotografi të skenave të jetës së saj të përditshme dhe jo për fotografi që tregonin ushtrimin e funksioneve të saj zyrtare. Gjykata Kushtetuese iu referua me këtë rast lirisë së shtypit dhe interesit legjitim të publikut për të ditur se si një person i tillë sillej përgjithësisht në publik.

6. Më 6 qershor 2000 kërkuesja paraqiti kërkesën e saj në Strasburg. Ajo pretendonte se vendimet e gjykatave gjermane kanë cenuar të drejtën e saj për respektim të jetës private, të garantuar nga neni 8 i Konventës, sepse ato nuk i kanë ofruar një mbrojtje të mjaftueshme ndaj botimit të fotografive të bëra pa dijeninë e saj nga paparacë, me argumentimin se për arsye të origjinës së saj ajo ishte një ‘figurë’ e pakontestueshme e epokës sonë. Ajo ankohej gjithashtu për shkelje të së drejtës së saj për respektim të jetës familjare të garantuar nga i njëjti nen.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

#### a. A kishte ndërhyrje

7. Gjykata u shpreh se botimi i fotografive të kërkueses në jetën e saj të përditshme, qoftë vetëm qoftë me persona të tjerë, bënte që neni 8 të gjente zbatim. Megjithëse ky nen ka të bëjë në radhë të parë me mbrojtjen e individëve nga ndërhyrjet arbitrare të shtetit, ai krijon gjithashtu detyrime pozitive për shtetet me qëllim që këto të marrin masa që synojnë respektimin e jetës private edhe në sferën e marrëdhënieve të individëve me njëri tjetrin<sup>127</sup>. Në këtë rast mbrojtja e jetës private duhet vënë në balancë me lirinë e shprehjes të garantuar nga ana e nenit 10.

8. Fotografitë e botuara nëpër revista e gazeta mund të përmbajnë të dhëna tepër personale dhe madje edhe intime në lidhje me një person. Për më tepër ato shpesh merren në një klimë ngacmimesh të vazhdueshme e cila e shtynte personin e interesuar drejt një gjendje ku ndien ndërhyrje ndaj jetës së vet private e madje deri në një gjendje persekutimi. Faktori vendimtar në baraspeshimin e mbrojtjes së jetës private me lirinë e shprehjes qëndron në kontributin që ofrojnë fotografitë dhe artikujt e botuar në një debat me interes të përgjithshëm. Në çështjen në fjalë ato nuk dukej se ofronin një kontribut të tillë përderisa kërkuesja nuk ushtronte ndonjë funksion zyrtar dhe fotografitë e artikujt kishin të bënin ekskluzivisht me detaje të jetës së saj private.

9. Publiku nuk kishte ndonjë interes legjitim për të ditur se ku gjendje zakonisht kërkuesja dhe se si sillej ajo normalisht në jetën e saj private. Kjo pavarësisht nga fakti se kërkuesja shfaqej edhe në vende që nuk mund të konsideroheshin gjithmonë si të izoluar dhe se ajo njihej fare mirë nga publiku. Edhe në qoftë se kishte ndonjë

<sup>127</sup> Në lidhje me konceptin e efektit horizontal të Konventës shih “Të drejtat e njeriut në Evropë – jurisprudencë dhe komente” fq. 32 si dhe vendimin e Gjykatës të 26 marsit 1986 në lidhje me çështjen X dhe Y kundër Holandës.



interes të tillë në rastin në fjalë ai duhet ta gjente cakun e vet në mbrojtjen efektive të jetës së saj private.

10. Gjykata e Strasburgut ishte e mendimit se kriteret e vendosura nga gjykatat gjermane nuk ishin të mjaftueshme për të siguruar mbrojtjen efektive të jetës private të kërkueses dhe ajo duhet të kishte pasur një “interes legjitim” për mbrojtjen e jetës së saj private. Kriteri i izolimit hapësinor i përdorur nga gjykatat gjermane ishte tepër i vagët dhe thjesht klasifikimi i një personi si “figurë *par excellence* e epokës sonë” nuk mjaftonte për të justifikuar ndërhyrjet e shtypit.

11. Për këto arsye, pavarësisht nga hapësira e vlerësimit që iu njihet shteteve në lidhje me mbrojtjen e jetës private dhe lirisë së shtypit dhe medias në përgjithësi, Gjykata e Strasburgut u shpreh se gjykatat gjermane nuk kishin mbajtur një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesave që konkurronin me njëri-tjetrin në këtë rast.

12. Të dy palët, pra Caroline von Hannover dhe Republika Federale e Gjermanisë, më 7 korrik 2005 arritën një marrëveshje për zgjidhje me pajtim. Gjykata e gjeti këtë marrëveshje në respektim të të drejtave të njeriut siç kërkohet nga nenet 37 § 1 të Konventës dhe 62 § 3 dhe 75 § 4 të Rregullores së Gjykatës dhe më 28 korrik 2005 vendosi që ta çregjistrojë këtë çështje nga regjistri i saj.<sup>128</sup>

### III. Koment

12. Vendimi trajton një nga balancat më interesante brenda vetë gjirit të Konventës – atë midis jetës private dhe familjare të garantuar nga neni 8 dhe lirisë së shprehjes të garantuar nga neni 10. Është një balancë jo e lehtë për t'u trajtuar përderisa të dy të drejtat e lartpërmendura kanë rëndësi në barabartë brenda Konventës dhe asnjëra nuk ka një përparësi në parim në raport me tjetrën.

13. Gjithsesi, duket se në këtë çështje Gjykata e ka orientuar qëndrimin e vet drejt një mbrojtje më të zgjeruar të së drejtës për jetë private në raport me lirinë e shprehjes dhe të shtypit. Nga kjo pikëpamje çështja është interesante sepse thërret në lojë veprimin e nenit 8 të Konventës në një mënyrë shumë më të hapur se sa në raste të tjera. Sipas Gjykatës në këtë çështje neni 8 gjente zbatim thjesht për shkak të botimit të fotografive. Kurse në çështjen Peck kundër Mbretërisë së Bashkuar, që paraprin në këtë botim duket se Gjykata ka qenë më “dorështrënguar” përsa i përket thirrjes në lojë të nenit 8, duke mbajtur parasysh për këtë qëllim sjelljen e veçantë të z. Peck që ishte transmetuar nga sistemi TVM por edhe faktin që në pozitën e tij si person jo me interes publik ai nuk priste që pamjet e tij të shfaqeshin në televizion pa pëlqimin e tij<sup>129</sup>.

<sup>128</sup> Në bazë të nenit 41 të Konventës kërkuesja kishte kërkuar 50 000 euro shpërblim për dëm jo-material dhe 142 851.31 euro për shpenzime dhe pagesa procedurale dhe avokatie. Sipas marrëveshjes së lartpërmendur të 7 korrikut 2005 palët ranë dakord që kërkuesja të merrte nga ana e Republikës Federale Gjermane 10 000 euro shpërblim për dëmin jo-material të pësuar dhe 105 000 euro për shpenzime dhe pagesa.

<sup>129</sup> Shih sidomos paragrafin 15 të përmbledhjes dhe komentin tonë të këtij vendimi të përfshirë në këtë botim.

14. Ky vendim është interesant të krahasohet gjithashtu me një vendim që e parapriu me një muaj në House of Lords në Londër në lidhje me çështjen Naomi Campbell kundër MGN Limited<sup>130</sup>. Në këtë vendim House of Lords u shpreh se botimi i fotografive nuk fut domosdoshmërisht në lojë nenin 8 të Konventës. Sipas pikëpamjes së tyre neni 8 mund të gjejë zbatim vetëm nëse personi i interesuar ka një pritshmëri legjitime për respektim të jetës së tij ose të saj private<sup>131</sup>. Kurse Gjykata e Strasburgut në rastin e Princeshës Caroline duket se zbaton një nivel minimal më të ulët për zbatimin e nenit 8 në një rast konkret. Sipas saj duhet që personi përkatës të përmbushë funksione publike me qëllim që interesi publik rreth këtij personi të mund të vlerësohet më shumë se e drejta e personit për jetë private. Megjithatë duhet pasur kujdes se ky raport duhet vlerësuar rast pas rasti në përputhje me pozitën specifike të personit të interesuar. Interesante janë qëndrimet e dy gjyqtarëve që dhanë mendime paralele me këtë vendim, Cabral Barreto dhe Zupancic. I pari pretendon se “kur një figurë publike ka një ‘pritshmëri legjitime’ që të jetë i mbrojtur nga media e drejta e tij/e saj për jetë private ka përparësi në raport me të drejtën për lirinë e shprehjes ose të drejtën për t'u informuar”. Kurse gjyqtari Zupancic përdor në të njëjtën logjikë termin “pritshmëri e arsyeshme”.

15. Është për të ardhur keq që një analizë e thelluar në një frymë pse jo edhe më të detajuar se analiza e bërë në Strasburg dhe në Londër nuk gjeti vend në vendimin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kushtetutshmërinë e ligjit mbi deklarin e pasurive. Momentet më të kritikueshme për mendimin tim të këtij vendimi kanë të bëjnë me lejimin e zbatimit të ligjit ndaj familjarëve apo personave të lidhur me subjektin deklarues. Një situatë e tillë kam përshtypjen se mund të rrezikonte të kapërcente edhe testin ‘ligj’ në analizën që i bëhet ndërhyrjeve ndaj jetës private pasi nocionet ‘familjarë’ dhe sidomos ‘persona të lidhur’ janë aq të përgjithshëm sa fare kollaj mund të krijojnë mundësinë e një diskrecionariteti abuziv nga ana e organeve administrative ose gjyqësore. Nga ana tjetër, për mendimin tim, problemi i këtij vendimi konsiston në faktin se nuk i konsideron të dhënat pasurore si të dhëna me karakter të ndjeshëm personal apo që të përbëjnë thelbin e jetës private aq sa të preferojë mosdeklarimin e këtyre të dhënave në raport me të drejtën e informimit<sup>132</sup>. Ky moment së bashku me aspektin tjetër të ekuilibrit të së drejtës për informim me atë për të dhënat personave duket se vjen në kundërshtim me interpretimin që Gjykata e Luksemburgut i bën nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke e konsideruar atë si parim të përgjithshëm të së drejtës komunitare<sup>133</sup>. Nuk do na ngelej gjë tjetër veçse të citojmë një pjesë të paragrafit 21 të vendimit ku thuhet: “Një ndërhyrje ndaj të drejtave themelore nuk mund të justifikohet thjesht nga ekzistenca

<sup>130</sup> Vendim i 6 majit 2004.

<sup>131</sup> Mund të përmendet se vendimi i House of Lords (në [2004] UKHL 22) për shkelje të jetës private të Naomi Campbell për shkak të botimit nga gazeta 'Mirror' të një artikulli të titulluar “Naomi: Unë jam përdoruese droge” dhe të shoqëruar me fotografi të saj.

<sup>132</sup> Shih gjithashtu Leksionin e Dr. Kuner “Privacy, Security and Transparency: Challenges for Data Protection Law in New Europe” Second Annual Stuart Chalfen Memorial Lecture, The British Institute of International and Comparative Law, Londër, 5 korrik 2004.

<sup>133</sup> Vendim i Gjykatës së Luksemburgut i datës 20 maj 2003 në lidhje me çështjet e përbashkëta C-465/00, C-138/01 dhe C-139/01.

e një interesi për informim. Gjykata dyshon nëse bërja publike, me anë të Raportit, e të dhënave mbi të ardhurat personale nxit mirëqenien ekonomike të vendit. Në çdo rast, ajo përbën një ndërhyrje joproporcionale ndaj së drejtës private. Kontrollat e ushtruara nga ana e Rechnungshof<sup>134</sup> janë padyshim të mjaftueshme për të siguruar mirëpërdorimin e fondeve publike.”

## REKLOS DHE DAVOURLIS kundër GREQISË

(kërkesa nr. 1234/05)

15 janar 2009

*intepretimi i rregullave procedurale të ankimit me qëllim respektimin e të drejtës së ankimit të kërkuësve*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuësit, Dimitrios Reklos dhe Vassiliki Davourli, janë shtetas grekë lindur në 1964 dhe 1967 dhe jetojnë në Athinë. Ata janë prindërit e Anastasios Reklos, i cili lindi më 31 mars 1997, në një klinikë private. Menjëherë pas lindjes, fëmija u vendos në një vend steril ku vetëm stafi mjekësor mund të kishte akses.

2. Si pjesë e shërbimit të klinikës, fëmijës iu bënë dy fotografi ku dallohej qartë fytyra e tij, ndërkohë që prindërit nuk kishin dhënë miratimin e tyre.

3. Më 25 gusht 1997, në vijim të refuzimit të klinikës për dorëzimin e fotove, kërkuësit hapën një proces gjyqësor para Gjykatës së Shkallës së Parë të Athinës për dëmin e shkaktuar.

4. Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e tyre. Në shtator 1998, prindërit e fëmijës apeluan kundër këtij vendimi por pa sukses. Në gusht 2002, ata apeluan për çështje ligjore, duke kërkuar se Gjykata kishte shkelur të drejtën e “dinjitetit” dhe “mbrojtjen e jetës private” dhe duke nënvizuar rreziqet e mundshme për fëmijët invalidë.

5. Më 8 korrik 2004, Gjykata e Kasacionit hodhi poshtë kërkesën, bazuar në argumentin se ajo ishte e paqartë.

6. Duke u mbështetur në nenin 6 § 1, kërkuësit u ankuan për hedhjen poshtë të ankesës së tyre nga gjykatat lidhur me fotografitë e fëmijës së tyre të bëra në klinikë pa lejen e tyre. Ata u ankuan për shkeljen e jetës private të fëmijës së tyre bazuar në nenin 8.

<sup>134</sup> Gjykata e Llogarive në Austri.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1

7. Sipas Gjykatës greke të Kasacionit, kërkuetit kishin dështuar në përmbushjen e kritereve të pranueshmërisë së kërkesës së tyre që kishin të bënin me specifikimin e fakteve të duhura, mbi të cilat Gjykata e Apelit kishte vendosur. Gjykata Evropiane konstatoi se Gjykata e Kasacionit kishte vlerësuar faktet siç i kishte vlerësuar Gjykata e Apelit.

8. Gjykata Evropiane konsideroi se duke deklaruar apelin e prindërve të papranueshëm vetëm mbi bazën se kish qenë tepër i paqartë, Gjykata e Kasacionit kishte aplikuar një formalizëm të tepërt.

9. Kjo kishte privuar prindërit nga shqyrtimi i Gjykatës së Kasacionit të pretendimeve të tyre të bazuara duke shkelur të drejtën e aksesit në Gjykatë sipas nenit 6 § 1.

### B. Në lidhje me nenin 8

10. Gjykata ripërsëriti se koncepti i jetës private është i gjerë dhe përfshinte të drejtën për identitet. Ajo theksoi se imazhi i një personi paraqiste karakteristikat e tij ose të saj unike dhe përbënte një nga cilësitë kryesore të personalitetit të tij. Gjykata shtoi se mbrojtja efektive e të drejtës për të kontrolluar imazhin presupozonte, në rrethanat e çështjes, marrjen e miratimit të personit në fjalë kur fotografia ishte shkrepur dhe jo vetëm kur ajo do të publikohej.

11. Gjykata observoi se që kur kish qenë minoren, e drejta e Anastasios për të mbrojtur imazhin e tij kish qenë në duart e prindërve. Miratimi i tyre nuk ish kërkuar kurrë, as për mbajtjen e negativeve, të kundërshtuara prej tyre. Gjykata vërejti se negativat mund të përdoreshin më vonë kundër dëshirës së personave të prekur.

12. Gjykata konkludoi se gjykatat greke nuk kishin marrë masat e duhura për të garantuar mbrojtjen e jetës private, në shkelje të nenit 8.

### C. Në lidhje me nenin 41

13. Gjykata i akordoi kërkuetesve shumën prej 8,000 eurosh si dëmshpërblim moral.

## III. Koment

14. Shkelja e nenit 6, e drejta për një proces të rregullt, në këtë rast është një mësim i mirë për Gjykatat e Larta në gjithë Evropën për të siguruar, që të jepen arsyet e duhura për hedhjen poshtë të apelimëve dhe se kriteret shumë formaliste nuk duhet të mbahen parasysh. Kërkuetit duhet të përmbushin rregullat procedurale vendase por këto rregulla duhen interpretuar në mënyrë të tillë që ato nuk mohojnë të drejtën e apelimëve. Në rastin në fjalë Gjykata e Kasacionit vendosi se kërkuetit nuk kishin paraqitur fakte mbi të cilat Gjykatat e Ulëta kishin bazuar vendimin e tyre. Sidoqoftë, vendimi i Gjykatave më të Ulëta të cilat përcaktonin faktet i ishin bashkëngjitur kërkesës së apellesit.

15. Gjykata, në lidhje me shkeljen e nenit 8, e drejta për të respektuar jetën private dhe familjare, theksoi se nuk dëshironte të ngrinte pyetjen nëse një individ duhet të jetë në dijeni të një shkelje të jetës private për të përbërë një shkelje. Ajo konstatoi se e drejta e një personi për të respektuar jetën private mbrohet që nga momenti i lindjes së tij. Ajo shprehu shqetësim të veçantë jo vetëm për bërjen e fotove për arsye tregtare për t'ia shitur prindërve, por dhe nga ruajtja e negativëve nga fotografi (një parim i ngjashëm i aplikohet dosjeve dixhitale). Ajo konsideroi se Gjykata greke nuk ekzaminuan këto aspekte dhe si rrjedhim neni 8 u shkel.

## DUDGEON kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 7525/76)

**22 tetor 1981**

*jeta seksuale e një personi përfshihet në konceptin e jetës së tij private dhe prandaj përfiton mbrojtje nga ana e nenit 8 të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Në Irlandën e Veriut, bazuar mbi shkeljet e Aktit mbi Personin të vitit 1861 dhe të Aktit Amendues të Ligjit Penal të vitit 1885, sjelljet homoseksuale dhe të turpshme ndërmjet burrave, të bëra privatisht ose në publik, përbënin vepra penale të dënueshme respektivisht me dy vjet burg ose me burgim të përjetshëm. Sjelljet homoseksuale midis grave që bien dakord nuk përbënin shkelje.

2. Përveç përjashtimeve që kishin të bënin me të sëmuret mendore, anëtarët e forcave të armatosura dhe personelin e marinës tregtare, aktet homoseksuale të bëra në privat midis dy burrave që bien dakord nga 21 vjet dhe lart nuk përbënin më shkelje në Angli dhe në Uells që prej hyrjes në fuqi të Aktit mbi Krimet Seksuale i vitit 1967 dhe në Skoci që prej Aktit mbi të Drejtën Penale të vitit 1980. Në korrik 1978, qeveria e Mbretërisë së Bashkuar botoi një projekt-urdhëresë që kishte qëllim të vendoste ligjin në Irlandën e Veriut në përputhje me atë të Anglisë dhe të Uellsit. Por pas konsultimit të popullsisë, qeveria lajmëroi në korrik 1979 që nuk kishte qëllimin që ta vazhdonte projektin.

3. Z. Dudgeon, shtetas britanik, lindur në 1946 dhe rezident në Belfast (Irlandën e Veriut) ishte homoseksual. Për disa kohë ai dhe të tjerë ishin përpjekur për të reformuar ligjin mbi homoseksualët në Irlandën e Veriut. Ai ishte pyetur nga policia, në janar 1976, për aktivitetet homoseksuale. Çështja iu transferua Drejtorit të Hetimeve Publike, por z. Dudgeon u informua në shkurt 1977 se nuk do të hetohej mbi të.

4. Çështja lindi nga një kërkesë e paraqitur Komisionit nga z. Dudgeon në maj 1976. Z. Dudgeon pretendonte se ligji penal në Irlandën e Veriut që ndalonte aktivitetet homoseksuale në mjedise private midis dy të rriturve meshkuj që kishin rënë dakord përbën një ndërhyrje të pajustificueshme në të drejtën e tij të mbrojtur nga neni 8 i Konventës, për respektimin e jetës private. Ai pretendoi edhe se kishte rënë viktimë e një diskriminimi në kundërshtim me nenin 14 të Konventës sepse si homoseksual mashkull, ai ka qenë objekt i kufizimeve më të mëdha se sa homoseksualët e tjerë në pjesët e tjera të Mbretërisë së Bashkuar, heteroseksualët dhe homoseksualët femra brenda Irlandës së Veriut.

5. Në raportin e tij të 13 marsit 1980, Komisioni u shpreh se ndalimi me ligj i akteve homoseksuale të dëshirueshme private nga individë meshkuj nën 21 vjeç nuk shkelte të drejtat e kërkuarit as mbi bazën e nenit 8 as të nenit 14 të marrë së bashku me nenin 8. Ai shpreh gjithashtu se ndalimi me ligj i këtyre marrëdhënieve midis meshkujve mbi 21 vjeç dhunonte të drejtën e kërkuarit për respektimin e jetës private bazuar mbi nenin 8 dhe se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohej fakti nëse ky ndalim i fundit shkelte gjithashtu nenin 14 të marrë së bashku me nenin 8. Komisioni ia kaloi çështjen Gjykatës më 18 korrik 1980.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

#### *i. A ka ndërhyrje?*

6. Gjykata vendosi se ekzistenca e një legjislacioni të dyshimtë përbën një ndërhyrje të vazhdueshme në të drejtën e respektimit të jetës private të kërkuarit (që përfshin jetën e tij seksuale) sipas kuptimit të paragrafit 1 të nenit 8. Për më tepër, hetimi policor i janarit 1976 nxori në pah se kërcënimi që përbënte ky legjislacion ishte real.

#### *ii. A justifikohet ndërhyrja?*

7. Qeveria pretendonte se ndërhyrja në jetën private të z. Dudgeon justifikohej, përderisa ligji në fjalë në Irlandën e Veriut, që ka të bëjë me marrëdhëniet homoseksuale, është i nevojshëm në një shoqëri demokratike, ndërmjet të tjerash, për mbrojtjen e moralit sipas kuptimit të paragrafit 2 të nenit 8.

8. Gjykata njohu domosdoshmërinë legjitime në një shoqëri demokratike për të rregulluar deri në një farë mase sjelljen e meshkujve homoseksualë ashtu si edhe forma të tjera të sjelljes seksuale me mjetet e ligjit penal. Zbatimi i ndëshkimeve penale justifikohej vetëm kur nevojitej mbrojtja e publikut të gjerë nga shkelje dhe fyerje, mbrojtja e të rinjve nga shfrytëzimi dhe korrupsioni, edhe kur ata vepronin me dëshirën e tyre.

9. Vendimi, pasi specifikoi se Gjykata nuk bën ndonjë gjykim vlerësimi mbi lidhjet homoseksuale të të rriturve meshkuj, vazhdon më tej për të vlerësuar nëse arsyet e ndërhyrjes në jetën private të z. Dudgeon janë të rëndësishme dhe të mjaftueshme sipas nenit 8 § 1. Kjo ka të bëjë, së pari, me argumente të ndryshme të bëra nga



qeveria duke kundërshtuar opinionin e Komisionit, sipas të cilit ndalimi penal i akteve homoseksuale të dëshiruara që implikojnë persona meshkuj mbi 21 vjet nuk është i justifikuar.

10. Midis të tjerash, Gjykata pranoi se ndryshime të sjelljes dhe të opinionit publik ekzistojnë midis Irlandës së Veriut dhe Britanisë së Madhe në lidhje me çështjet e moralit dhe përbëjnë një faktor të rëndësishëm. Si rrjedhim, klima e moralit në çështjet seksuale në Irlandën e Veriut, ashtu si e tregon edhe shembulli i kundërshtimit të reformës legislative të parashikuar, zë vend midis atyre të dhënave që autoritetet e brendshme mund t'i marrin parasysh duke verifikuar nëse ekziston një nevojë sociale imperative e cila e justifikon mos ndryshimin e legjislacionit në fuqi.

11. Në vazhdim, Gjykata iu kthye problemit për të përcaktuar nëse arsyet e quajtura të rëndësishme ishin edhe të mjaftueshme. Në ditët e sotme, marrëdhëniet homoseksuale kuptohen më mirë sesa në kohën e miratimit të ligjeve të viteve 1861 dhe 1885. Në shumicën e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, njerëzit nuk besuan më se praktikat homoseksuale meritonin në vetvete sanksione penale. Vendimi dëshmon se në Irlandën e Veriut, autoritetet kanë shmangur këto vitet e fundit përndjekjen penale të sjelljeve homoseksuale të kryera nga burra që janë 21 vjeç e lart. Pra, nuk mund të flitet për një nevojë sociale imperative duke i cilësuar këto akte si shkelje, në mungesë të një justifikimi të mjaftueshëm të garantuar nga rreziku që i kanoset individëve të ndjeshëm ndaj këtyre sjelljeve, të rinjtë për shembull, ose nga pasoja mbi shoqërinë. Pasojat e dëmshme që ekzistenca e vetë legjislacionit të Irlandës së Veriut mund të shkaktojë në jetën private të një individi me prirje homoseksuale, si z. Dudgeon, mbizotërojnë mbi argumentet që kundërshtojnë çdo amendament të ligjit në fuqi. Sipas arsyeve të dhëna nga qeveria, edhe pse të rëndësishme, ato nuk ishin të mjaftueshme për të justifikuar mbajtjen në fuqi të legjislacionit të kundërshtuar, i cili dënon marrëdhëniet homoseksuale në mjedise private ndërmjet meshkujve të rritur të aftë për të rënë dakord.

12. Ndryshe nga opinioni i Komisionit, Gjykata nuk e shqyrtoi çështjen, sipas së cilës, ndërhyrja e denoncuar nga kërkuesi (ndalimi i tij për të pasur marrëdhënie seksuale me të rinj nën 21 vjeç) mund të justifikohet nga nevoja e mbrojtjes së moralit të të rinjve. Ajo shpjegon se autoritetet vendase e kanë për detyrë të vendosin garancitë e duhura që kanë të bëjnë me këtë problem dhe në veçanti për të fiksuar moshën përpara së cilës të rinjtë duhet të mbrohen nga ligji penal.

13. Gjykata vendosi se kishte shkelje të nenit 8, si z. Dudgeon kishte vuajtur dhe po vuante një ndërhyrje të pajustificueshme në të drejtën e respektimit të jetës së tij private.

#### ***B. Në lidhje me nenin 14***

14. Në vijim, Gjykata vendosi se në rrethanat e rastit, nuk ishte e nevojshme të analizohej çështja mbi bazën e nenit 14.

**C. Në lidhje me ish nenin 50 (aktualisht neni 41)**

15. Kërkuesi kërkonte një shpërblim të drejtë për shqetësimin dhe vuajtjen që ai pësoi si dhe për shpenzimet e bëra. Ky problem u dërgua përpara Dhomës së ngritur në fillim për analizën e çështjes, e cila ia kishte kaluar atë Gjykatës Plenare në janar 1981. Në vendimin e veçantë të 24 shkurtit 1983, Gjykata vendosi që Mbretëria e Bashkuar duhet t'i jepte Z. Dudgeon për pagesat dhe shpenzimet e bëra për procedurat e Strasburgut 3 315 sterlina. Ajo hodhi poshtë kërkesat, sidomos kompensimin financiar të dëmit të pretenduar.

**III. Koment**

16. Kjo çështje është e para e një serie jurisprudenciale tepër të rëndësishme të Gjykatës, megjithëse jo pa kundërshtime nga opiniononi publik i një sërë vendesh anëtare të Konventës dhe ndoshta edhe ai shqiptar, në lidhje me faktin se “jeta seksuale e personit është pjesë përbërëse e jetës së tij private”. Gjykata e ka përforcuar më tej këtë qëndrim në një sërë rastesh ndër të cilat mund të përmenden X dhe Y kundër Holandës<sup>135</sup>, Norris kundër Irlandës, Modinos kundër Qipros apo Sutherland kundër Mbretërisë së Bashkuar.

17. Ndoshta aspekti më interesant i vendimit konsiston në faktin se Z. Dudgeon kundërshtonte a priori ekzistencën e akteve ligjore që penalizonin marrëdhëniet homoseksuale në Irlandë dhe ndaj tij nuk kishte filluar hetimi në kuptimin formal e aq më pak të ishte dënuar. Nga kjo pikëpamje duket sikur ai ishte vetëm viktimë potenciale dhe jo reale e shkeljes së Konventës, për qëllimet e nenit aktual 34 të Konventës, gjë që mund ta bënte kërkesën e tij të papranueshme. Kjo për arsye se organet e Strasburgut (Komisioni dhe Gjykata) kanë pranuar se nuk marrin në shqyrtim a priori pajtueshmërinë formale të legjislacionit të vendeve anëtare me kërkesat e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>136</sup>. Sidoqoftë Komisioni në fillim dhe pastaj Gjykata pranuan se vetë mbajtja në fuqi e një legjislacioni të tillë (penalizues të akteve homoseksuale), përbënte një shkelje konkrete të atij aspekti që u konsiderua si përbërës i jetës private të personit; të jetës seksuale të tij.

18. Nga një pikëpamje tjetër, vendimi paraqet rëndësi në lidhje me përpjekjet për ta justifikuar mbajtjen e këtij legjislacioni penalizues të marrëdhënieve homoseksuale në kuadrin e paragrafit 2 të nenit 8. Shumica e Gjykatës u shpreh se nuk ishte më e mundur të lejohej një justifikim i tillë. Ky interpretim përbën një rishikimin të vetë jurisprudencës së organeve të Strasburgut në lidhje me marrëdhëniet homoseksuale dhe sidomos me moshën e lejuar për kryerjen e tyre<sup>137</sup>.

<sup>135</sup> Përfshirë në këtë botim.

<sup>136</sup> Shih vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen Gjuhësore Belge të përfshirë në këtë botim ose të 18 shkurtit 1999 në lidhje me çështjen Waite dhe Kennedy kundër Gjermanisë (sidomos paragrafi 54).

<sup>137</sup> Ndërsa më 1975 me vendimin në lidhje me çështjen X kundër Mbretërisë së Bashkuar Komisioni Evropian justifikonte dallimin në moshë për dhënien e pëlqimit për kryerjen e marrëdhënieve homoseksuale dhe heteroseksuale, me vendimin e vitit 1997 në lidhje me çështjen Sutherland kundër Mbretërisë së Bashkuar ai, e pastaj edhe Gjykata e ndryshojnë këtë qëndrim.

## HATTON DHE TË TJERË kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 36022/97)

2 tetor 2001 dhe 8 korrik 2003

*ndërsa njëra nga Dhomat e Gjykatës mendon se fluturimet e natës mbi aeroportin Heathrow të Londrës cenojnë të drejtën për jetë private Dhoma e Madhe shprehet se ky cenim justifikohet për arsye të interesit ekonomik të përgjithshëm të këtyre fluturimeve*

### I. Faktet kryesore

1. Tetë kërkuesit, të gjithë shtetas britanikë, jetonin ose kishin jetuar më parë në zonën përreth Aeroportit të Heathrow, pranë Londrës.

2. Përpara tetorit 1993 zhurmat e shkaktuara nga fluturimet gjatë natës në Heathrow kishin qenë të kontrolluara në bazë të një sistemi kufizimesh mbi një numër të përgjithshëm ngritjesh dhe uljesh të avionëve nga ky aeroport. Por pas kësaj date, çështja e zhurmave ishte rregulluar me anë të një sistemi kuotash të zhurmave, në bazë të së cilit çdo lloj avioni i regjistrohej dhe i vihej një sigël "QC" - (Quota Count<sup>138</sup>) - ku sa më i lartë të ishte niveli i zhurmës së shkaktuar nga avioni aq më i lartë ishte niveli i QC. Kjo gjë u lejonte shoqërive përdoruese për të zgjedhur një numër më të madh avionësh më pak të zhurmshëm dhe më pak avionë të zhurmshëm, duke bërë kujdes që kuotat e përcaktuara të zhurmës të mos tejkaloheshin. Skema e re vuri kritere shumë strikte ndaj këtyre kontrolleve sidomos ndërmjet orëve 23:30 dhe 06:00 dhe më pak strikte në periudhën 06:00 deri 07:00. Më parë periudha e kontrollit strikt kishte qenë më e gjatë.

3. Në vijim të një kërkesë për rishikim gjyqësor të këtij vendimi të paraqitur nga një numër autoritetesh vendore të interesuara, kjo skemë u vlerësua si në kundërshtim me Seksionin 78 (3) të Ligjit për Aviacionin Civil të vitit 1982, i cili kërkonte që një numër i saktë avionësh të saktësohej në kuadrin e kuotave të zhurmës. Për këtë arsye pranoi që vetëm një numër i kufizuar avionësh të lejoheshin të fluturonin gjatë natës. Një tjetër vendim gjyqësor konstatoi që procesi i vlerësimit të skemës nga ana e Qeverisë ishte bërë në mënyrë të paligjshme dhe për pasojë, në mars dhe qershor 1995, Qeveria britanike ndërmori procese të reja. Më 16 gusht 1995 Sekretari i Shtetit për Transportin bëri të ditur se detajet e një skeme të re do të ishin të njëjta me ato të skemave të mëparshme. Vendimi u kundërshtua përsëri nga ana e autoriteteve vendore por pa sukses.

<sup>138</sup> Niveli ose matja e kuotës.

4. Kërkuesit, ndër të tjera, ankoheshin që, në vijim të fillimit të zbatimit të skemës së vitit 1993, zhurmat gjatë natës ishin shtuar, veçanërisht në periudhat herët në mëngjes, gjë që ndërhynte në të drejtën e tyre për jetë private dhe familjare në shtëpitë e tyre, e garantuar nga ana e nenit 8. Ata pretenduan gjithashtu se rishikimi gjyqësor nuk kishte qenë një mjet efektiv në kuptimin e nenit 13, përderisa ai nuk arriti të shqyrtonte themelin e vendimeve të autoriteteve publike dhe se ai kishte qenë tepër i shtrenjtë për t'u përdorur nga ana e kërkuesve.

## II. Vendimet e Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

5. Dhoma e Gjykata vuri në dukje se qeveria kishte pranuar që, parë në tërësi, niveli i zhurmës gjatë periudhës së kuotave (23:30 deri më 06:00) kishte qenë rritur në bazë të skemës së vitit 1993. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se, përderisa Aeroporti i Heathrow dhe avionët që fluturonin mbi të nuk ishin në pronë, në kontroll ose në përdorim të Qeverisë ose të ndonjë strukture të saj, nuk mund të thuhet se Mbretëria e Bashkuar kishte ndërmarrë veprime që përbënin ndërhyrje në jetën private apo familjare të kërkuesve.

6. Sidoqoftë çdo shtet ka një detyrim pozitiv<sup>139</sup> për të ndërmarrë masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të siguruar të drejtat e kërkuesve në bazë të nenit 8 dhe për të mbajtur një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesave konkurrentë të individit dhe të komunitetit në tërësi. Në fushën veçanërisht të ndjeshme të mbrojtjes së mjedisit, thjesht bazueshmëria në mirëqenien ekonomike të vendit nuk ishte e mjaftueshme për të zhvleftësuar të drejtat e të tjerëve. Shteteve u kërkohet që të minimizojnë, sa më tepër që të jetë e mundur, ndërhyrjen ndaj këtyre të drejtave, duke u përpjekur të gjejnë zgjidhje alternative dhe duke kërkuar përgjithësisht arritjen e qëllimeve të tyre në mënyrën që prek sa më pak që të jetë e mundur të drejtat e njeriut. Me qëllim që të arrihet kjo, duhet ndërmarrë përpara projektit konkret për kuotat, një shqyrtim dhe studim i plotë dhe i përshtatshëm me synimin që të gjejë zgjidhjen më të mirë të mundshme dhe që synon që të arrihet një baraspeshë e drejtë në këtë drejtim.

7. Dhoma vuri në dukje se ndërsa dukej se, të paktën fluturimet e natës kontribuuan në një masë të madhe në ekonominë kombëtare në tërësi, rëndësia e këtij kontributi nuk ishte vlerësuar asnjëherë në mënyrë kritike, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ana e Qeverisë qoftë nga ana e kërkuesve të pavarur për llogari të saj. Përsa i përket impaktit të rritjes së numrit të fluturimeve gjatë natës, ajo theksoi se kërkimi i vetëm që ishte bërë kishte konsistuar në natyrën e shqetësimeve që i jepte gjumit dhe në pagjumësinë në tërësi, kur skema e vitit 1993 kishte filluar të zbatohet.

8. Si përfundim Dhoma vlerësoi se, duke zbatuar skemën e vitit 1993, Shteti nuk arriti të bënte një balancë të drejtë ndërmjet mirëqenies ekonomike të Mbretërisë së Bashkuar nga njëra anë, dhe gëzimit efektiv të së drejtës për respektimin e banesave dhe jetës private dhe familjare të kërkuesve nga ana tjetër. Pra, ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

<sup>139</sup> Shih në përgjithësi në lidhje me këtë interpretim të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut botimin "Të Drejtat e Njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komentë", Tiranë 2001 në fq. 31-32.

9. Në vijim të këtij vendimi të dhënë më 2 tetor 2001, Britania e Madhe kërkoi, më 19 dhjetor 2001 që çështja t'i kalonte për shqyrtim Dhomës së Madhe<sup>140</sup>. Një panel i kësaj të fundit vendosi që ta kalonte çështjen për shqyrtim në Dhomën e Madhe më 27 mars 2002 dhe më 13 nëntor 2002 ajo mbajti një seancë për shqyrtimin e kësaj çështje.

10. Pasi vlerësoi se nuk kishte probleme nën këndvështrimin e Konventës në lidhje me ligjshmërinë, legjitimitetin apo të karakterin jo diskriminues të masës së vitit 1993 në lidhje me skemën e vitit 1993, edhe Dhoma e Madhe e përqendroi analizën e saj në karakterin e balancuar të skemës së vitit 1993 midis interesit ekonomik dhe proporcionalitetit të ndërhyrjes ndaj të drejtës së kërkuesve për jetë private.

11. Për një vlerësim të tillë, mjaft i vështirë edhe në sytë e Dhomës së Madhe, kjo e fundit mbajti parasysh disa elementë, përfshirë mënyrën e mbikëqyrjes dhe të rishikimit të skemës së vitit 1993, faktin që sipas studimeve përkatëse vetëm 2 deri në 3 % e banorëve të zonës kishin pasur probleme me gjumin si pasojë e fluturimeve të natës, faktin që çmimi i shtëpive në atë zonë nuk kishte pasur ulje si dhe faktin që banorët mund të merrnin pjesë në hartimin e skemave të tilla si dhe ankoheshin ndaj tyre. Në këto kushte Dhoma e Madhe vlerësoi se Britania e Madhe, duke ofruar gjithë këto garanci dhe duke bërë të gjitha përpjekjet për të ruajtur një barazhesh të drejtë nuk e kishte shkelur hapësirën e vet të vlerësimit. Pra, vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 8.

### ***B. Në lidhje me nenin 13***

12. Dhoma kishte vënë në dukje se procedurat gjyqësore ishin në gjendje të përcaktonin se skema e vitit 1993 ishte e paligjshme për shkak se hendeku ndërmjet politikës së Qeverisë dhe praktikës së ndjekur ishte tepër i madh. Megjithatë, ishte e qartë se qëllimi i kontrollit nga ana e gjykatave të brendshme ishte i kufizuar në kuadrin e koncepteve klasike të së drejtës publike angleze të tilla si, iracionaliteti, paligjshmëria dhe këmbëngulja e titullarit të së drejtës, dhe nuk lejuan të vlerësohej pra nëse rritja e numrit të fluturimeve të natës në bazë të kësaj skeme përfaqësonte një kufizim të justifikueshëm ndaj së drejtës së respektimit të jetës private dhe familjare ose të banesave të personave që jetonin në afërsi të Aeroportit të Heathrow. Gjykata vlerësoi se qëllimi i kontrollit gjyqësor nga ana e gjykatave të brendshme në këtë rast ishte i pamjaftueshëm dhe se ka pasur për këtë arsye shkelje të nenit 13 të Konventës.

<sup>140</sup> Në bazë të nenit 43 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, brenda tre muajve nga data e vendimit të një Dhome, secila nga palët në çështje, në raste përjashtimore, mund të kërkojnë që çështja t'i kalohet Dhomës së Madhe të përbërë nga 17 gjyqtarë. Në këtë rast, një panel prej pesë gjyqtarësh vlerëson nëse çështja ngre probleme të rëndësishme që prekin interpretimin ose zbatimin e Konventës ose të Protokolleve të saj ose një çështje të rëndësishme të një rëndësie të përgjithshme. Në rast se po atëherë Dhoma e Madhe është ajo që do të japë vendimin përfundimtar. Në rast se nuk ngrihet ndonjë çështje e tillë paneli do të hedhë poshtë kërkesën dhe kështu vendimi merr formë përfundimtare. Ndryshe vendimi mund të marrë formë përfundimtare me mbarimin e periudhës prej tre muajsh ose më parë në qoftë se palët deklarojnë se nuk synojnë të kërkojnë që çështja t'i kalohet Dhomës së Madhe.

13. Në lidhje me këtë pikë Dhoma e Madhe mbajti të njëjtin qëndrim dhe la në fuqi vendimin e Dhomës, duke vendosur për shkelje të nenit 13 të Konventës.

### C. Në lidhje me nenin 41

14. Dhoma kishte vendosur t'u akordonte secilit prej kërkuesve 4 000 sterlina për dëm jo-material dhe një total prej 70 000 sterlina për shpenzime dhe pagesa ligjore. Dhoma e Madhe nga ana e saj, megjithëse konstatoi vetëm shkelje të nenit 13, dhe normalisht shpërblimi përfshirë shpenzimet dhe pagesat akordohet vetëm për shkeljet, argumentoi se neni 13 nuk do të mund të kishte qëndruar i vetëm – pasur parasysh që është dispozitë e varur në sistemin e Konventës. Për këtë arsye ajo preferoi të mbante parasysh deri në njëfarë mase edhe punën e avokatëve të kërkuesve në lidhje me nenin 8 të Konventës dhe iu akordoi kërkuesve 50 000 euro për shpenzime dhe pagesa, por nuk i akordoi shpërblim për shkelje të nenit 13 duke e konsideruar këtë vendim të saj si shpërblim të mjaftueshëm për këtë qëllim.

### III. Koment

15. Është me vend të thuhet se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk parashikon një mbrojtje të shëndetit ose të mjedisit. Nuk ka pra në gjirin e Konventës një dispozitë të posaçme që synon mbrojtjen e të drejtave 'të mjedisit'. Kjo nuk është e çuditshme po të kujtohet se Konventa është një instrument tradicional i të drejtave të njeriut, që synon mbrojtjen e individëve dhe jo mbrojtjen e të drejtave kolektive. Sidoqoftë rëndësia në rritje e çështjeve të së drejtës së mjedisit dhe rritja e ndërgjegjes së publikut në lidhje me mbrojtjen e mjedisit por edhe rreziqet që i kanosen këtij kanë çuar në rritjen e numrit të rasteve që kanë të bëjnë me ankime pikërisht në lidhje me mjedisin. Ata bëjnë pjesë kryesisht në dy kategori kryesore.

#### *i. mbrojtja e mjedisit kundrejt të drejtës së shfrytëzimit të trojeve*

16. Në rastet kur ka pronësi individuale mbi trojet, një nga momentet e para të konfliktit që përfshin mjedisin është rasti kur e drejta e pronarit të truallit për ta shfrytëzuar atë kufizohet nga masa që justifikohen nga mbrojtja e mjedisit. Deri së fundi ky ishte drejtimi kryesor në të cilin haseshin kërkesa që përfshinin çështje të mjedisit. Gjykata dhe Komisioni, pavarësisht se shumë në favor të mbrojtjes të së drejtës së pronës, njohën të drejtën e shtetit për të ruajtur zonat me bukuri natyrore dhe për të vënë në zbatim programe të mbrojtjes së mjedisit<sup>141</sup>.

#### *ii. cenimi i mjedisit*

17. Kërkesat e vetme në lidhje me cenimin e mjedisit dhe që mund të argumentohen në bazë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë ato ku cenimi shkel në mënyrë të drejtpërdrejtë një të drejtë individuale të mbrojtur nga ana e Konventës. Në pjesën më të madhe të rasteve kjo përfshin qoftë një ndërhyrje në të jetën private ose banesën e individëve, të mbrojtur nga ana e nenit 8 të Konventës, ose në të drejtën e individëve për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e vet, të mbrojtur

<sup>141</sup> Shih në këtë kuadër kërkesën nr. 11185/84 dhe kërkesën nr. 12570/86.



nga ana e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës. Organet e Strasburgut kanë marrë në shqyrtim, për shembull, raste të ndërhyrjes edhe ndaj të drejtës së personit për jetë private dhe banesë edhe ndaj gëzimit paqësor të pronës për shkak të zhurmave të shkaktuara nga rritja e numrit të fluturimeve dhe e itinerarit të tyre në Aeroportin e Heathrow<sup>142</sup>, si edhe në rastin që po shqyrtojmë.

18. Përgjegjësia e shtetit angazhohet edhe në qoftë se ai krijon vetë ndërhyrje si në rastin e rritjes së një shfrytëzimi ose ndërtimi me karakter publik. Por, përgjegjësia e tij mund të angazhohet edhe kur, megjithëse shteti nuk po krijon një ndërhyrje nga ana e tij, dështon në kontrollin e ndërhyrjeve të bëra nga të tjerët ose në rregullimin siç duhet të këtij kontrolli. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konfirmuar sërish në këtë vendim të rëndësishëm që po shqyrtojmë se shtetet kanë përgjegjësi për veprimtaritë e shoqërive private kur është detyra e vetë shteteve që t'i rregullojnë këto veprimtari dhe se është detyrimi pozitiv i shtetit për të marrë masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të siguruar të drejtat e kërkuarve në bazë të paragrafit 1 të nenit 8<sup>143</sup>.

19. Është e rëndësishme të vihet në dukje nga ky vendim se niveli i ndërhyrjes në jetën e një individi nuk ka përse të jetë aq i rëndë sa të verë seriozisht në rrezik shëndetin e tij që të arrihet në konstatimin e shkeljes. Gjykata e Strasburgut do të mund të pranojë, në disa rrethana, se ka pasur ndërhyrje në banesën ose në jetën private të personit kur individi është penguar të gëzojë banesën e tij ose mirëqenia e tij e përgjithshme ka qenë prekur<sup>144</sup>.

20. Së fundi është e rëndësishme të vihet në dukje se edhe Gjykata në vetvete nuk e ka të thjeshtë të bëjë një balancë ndërmjet mirëqenies ekonomike e vendit dhe ndërhyrjeve ndaj të drejtave të së tjerëve, veçanërisht në “fushën e ndjeshme të mbrojtjes së mjedisit”. Në një kohë kur zhvillimi ekonomik shihet si qëllimi thelbësor i qeverisjes, ky vendim do të shërbejë si një kujtesë për zhvillime të mundshme jurisprudenciale në Strasburg, në lidhje me pasojat që ky zhvillim ka ndaj njerëzve dhe mjedisit. Nuk do ishte e papritur që në të ardhmen vendimi i Dhomës në këtë çështje të përbëjë qëndrimin e shumicës së gjyqtarëve të Strasburgut<sup>145</sup>.

<sup>142</sup> Shih në këtë kuadër vendimin e 15 korrikut 1980 në lidhje me pranimin në çështjen Arrondelle kundër Mbretërisë së Bashkuar si dhe vendimin e 16 tetorit 1985 në lidhje me pranimin në çështjen Baggs kundër Mbretërisë së Bashkuar.

<sup>143</sup> Shih për shembull vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 9 dhjetorit 1994 në lidhje me çështjen Lopez Ostra kundër Spanjës.

<sup>144</sup> Id.

<sup>145</sup> Kujtojmë se në Dhomën e Madhe pesë gjyqtarë (Costa, Ress, Türmen, Zupančič dhe Steiner) votuar në pakicë në raport me vendimin e shumicës.

## FADEYEVA kundër RUSISË

(kërkesa nr. 55723/00)

9 qershor 2005

*ky vendim thekson detyrimin e shteteve në fushën e mbrojtjes së mjedisit*

### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje kishte të bënte me një kërkesë të paraqitur nga një shtetase ruse, Nadezhda Mikhai Fadeyeva, e cila ka lindur më 1949 dhe jeton në Cherepovets, një qendër e rëndësishme e prodhimit të çelikut që ndodhet rreth 300 km në verilindje të Moskës.

2. Kombinati i prodhimit të çelikut në Severstal ishte ndërtuar në periudhën e regjimit sovjetik. Ai kishte qenë dhe ngelej ende qendra më e madhe e shkrirjes së çelikut në Rusi. Me qëllim që të kufizoheshin zonat në të cilat ndotja e shkaktuar nga prodhimi i çelikut ishte e tepërt, autoritetet krijuan një zonë sigurie përreth mjedisëve kombinatit në Severstal. Kjo zonë u quajt “zona e sigurisë sanitare”. Kërkesja kishte banuar në një apartament në këtë zonë bashkë me familjen e saj që më 1982.

3. Megjithëse teorikisht kjo zonë supozohej të ndante mjediset e kombinatit nga zonat e banuara, në praktikë mijëra persona banonin në këtë zonë. Një Dekret i shtatorit 1974 e detyronte Ministrinë e Metalurgjisë që brenda vitit 1977 t'i sistemonte banorët e zonës së sigurisë sanitare në një zonë tjetër banimi. Megjithatë, asnjë veprim nuk u ndërmor. Në vitet në vijim qeveria adoptoi disa programe të reja që synonin përmirësimin e situatës mjedisore në Cherepovets. Sipas programit që është aktualisht në fuqi, mbetjet industriale në kombinatin e Severstalit duhet t'i arrijnë nivelet e pranueshme të sigurisë rreth viteve 2010-2015. Në vitin 1993 kombinati u privatizua dhe apartamentet që kishin qenë në pronësi të kombinatit dhe të vendosura në zonën e sigurisë sanitare iu transferuan këshillit vendor.

4. Më 1995 kërkesja së bashku me banorë të tjerë të zonës bënë një padi në gjykatë kundër kombinatit të çelikut, duke kërkuar sistemimin e tyre jashtë zonës së sigurisë sanitare në një zonë të sigurt nga pikëpamja mjedisore. Më 17 prill 1996 gjykata e rrethit të Cherepovets konstatoi se, sipas së drejtës ruse, kërkesja kishte në parim të drejtë për t'u sistemuar me shpenzimet e autoriteteve vendore. Megjithatë, gjykata nuk urdhëroi asgjë specifike por vetëm iu kërkoi autoriteteve që ta konsideronin rastin e kërkuësës “me përparësi në listën e pritjes” për një sistemim të ri, “në varësi të fondeve përkatëse”. Vendimi u la në fuqi edhe në apel por nga vendimi u hoq referenca “në varësi të fondeve përkatëse” si kusht për zgjidhjen e situatës. Pas këtij

vendimi doli edhe një urdhër ekzekutimi por më 10 shkurt 1997 procedura u ndërpre me arsyetimin se nuk kishte ndonjë “përparësi në listën e pritjes” për banorët e zonës së sigurisë sanitare që prisnin të sistemoheshin diku tjetër. Kërkesja u përfshi në listën e përgjithshme në pritje të banesës së re – ajo kishte numrin 6820 në këtë listë.

5. Më 1999 kërkesi bëri një padi të re kundër këshillit vendor, duke kërkuar sistemimin e saj të menjëhershëm në respektim të vendimit të 17 prillit 1996. Megjithatë, gjykata e rrethit të Cherepovets nuk e pranoi padinë e saj me arsyetimin se nuk kishte “përparësi në listën e pritjes” dhe këshilli vendor nuk kishte banesa në dispozicion. Gjykata e rrethit arriti në përfundimin se, përderisa kërkesja ishte përfshirë në një listë të përgjithshme pritje, vendimi i 17 prillit 1996 ishte ekzekutuar. Ky vendim u la në fuqi nga gjykata rajonale më 17 nëntor 1999.

7. Kërkesja ankohej sidomos në lidhje me faktin se funksionimi i një kombinati çeliku në afërsi të vendbanimit të saj cenonte shëndetin dhe mirëqenien e saj. Ajo bazohej në nenin 8 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

#### i. mbi zbatueshmërinë e nenit 8 në rrethanat konkrete

8. Gjykata theksoi se, përgjatë një periudhe të caktuar kohe, përqendrimi i elementëve të ndryshëm toksikë në ajër përreth zonës së vendbanimit të kërkeses e tejkalonte në një masë të konsiderueshme nivelin e pranueshëm të përqendrimeve të elementëve toksikë, siç parashikohej nga legjislacioni rus. Për pasojë, ndotja mund të ishte e dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e personave që binin në kontakt me të.

9. Në rastin e kërkeses, kombinimi mjaft i qartë i provave dhe deduksioneve të çonte fare kollaj në përfundimin se shëndeti i kërkeses ishte përkeqësuar si rezultat i ekspozimit të saj të tejkëqatur ndaj nxjerrjeve industriale nga kombinati i çelikut në Severstal. Edhe në qoftë se pranohej se ndotja nuk kishte shkaktuar asnjë dëm të matshëm ndaj shëndetit të saj, pa dyshim që ajo e kishte bërë kërkesen më të prekshme nga sëmundjet e ndryshme. Për më tepër, nuk kishte asnjë dyshim që ndotja e kishte përkeqësuar cilësinë e jetës në vendbanimin e saj. Për këtë arsye, Gjykata pranoi se përkeqësimi aktual i shëndetit dhe mirëqenies së kërkeses e kishte arritur nivelin e mjaftueshëm për të pranuar që neni 8 i Konventës gjente zbatim në këtë situatë.

#### ii. në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 8

10. Në rastin e kërkeses, megjithëse situata rreth kombinatit kërkonte një trajtim të posaçëm të personave që jetonin në atë zonë, shteti nuk i ofroi asnjë zgjidhje efektive që ta ndihmonte të lëvizte nga kjo zonë e rrezikshme. Për më tepër, megjithëse kombinati që shkaktonte ndotjen shkelte standardet kombëtare të mjedisit, nuk

rezultonte asnjë e dhënë që shteti kishte parashikuar ose po zbatonte ndonjë masë efektive që nga njëra anë të mbante parasysh interesat e popullsisë vendore që prekej nga kjo ndotje ndërsa nga ana tjetër të mund të ulte nivelin e ndotjes brenda kritereve të pranueshme.

11. Gjykata arriti në përfundimin që, pavarësisht nga hapësira e gjerë e vlerësimit që i ishte lënë shteteve në raste të tilla, shteti rus nuk kishte arritur të mbante një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesave të komunitetit dhe gëzimit efektiv nga kërkuesja të së drejtës së saj për respektim të vendbanimit dhe jetës së saj private. Për këtë arsye Gjykata vendosi se në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

### *B. Në lidhje me nenin 41*

12. Gjykata i akordoi kërkueses 6 000 euro për dëmet jomateriale të pësuarra dhe 6 500 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore si dhe 5 540 sterlina në lidhje me pagesat dhe shpenzimet e përballuara nga avokatët britanikë të kërkueses.

## **III. Koment**

13. Me vendimin e Dhomës së Madhe të 8 korrikut 2003 në lidhje me çështjen Hatton dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>146</sup>, Gjykata deklaroi se megjithëse “nuk ka një të drejtë të shprehur në Konventë për një mjedis të pastër dhe të qetë, ...kur një individ preket në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe serioze nga zhurmat apo ndonjë formë tjetër ndotjeje, mund të kemi një problem në kuadrin e nenit 8 të Konventës”. Më duket e tepërt që të theksohet rëndësia e këtij obiter dicta në kuadrin legjislativ, jurisprudencial apo praktik shqiptar. Qoftë rasti Fadeyeva që po komentojmë, qoftë Hatton që sapo përmendëm, qoftë Lopez Ostra apo Moreno Gomes të referuara pak më poshtë, janë situata fare kollaj të dallueshme në realitetin shqiptar. Pavarësisht se, të paktën për mendimin tim, zgjidhjet, dhe ç’është më keq kriteret e analizave juridike mund të mos jenë të njëjta me ato të Strasburgut<sup>147</sup>.

14. Siç edhe Gjykata e deklaroi në çështjen që po komentojmë, “në dekadat e fundit ndotja mjedisore është bërë një çështje e shqetësimit publik”. Kjo tendencë pasqyrohet në jurisprudencën në rritje të Gjykatës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin në të cilin individët jetojnë. Në një prej çështjeve të para në lidhje me problemet mjedisore, LopezOstrakundër Spanjës<sup>148</sup>, kërkuesja jetonte pranë një zone të trajtimit të mbetjeve urbane, kurse në një çështje më të vonë, Moreno Gomes

<sup>146</sup> Shih më lart në këtë botim përmbledhjen e këtij vendimi mjaft të debatueshëm dhe komentin përkatës.

<sup>147</sup> Pohuar këtë, referoj përsëri tek komenti i çështjes Hatton dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, pararendëse, ku për pakënaqësinë e një pjese të konsiderueshme të doktrinës dhe timen personale analiza e Dhomës së Madhe të Gjykatës nuk i jep karakter prioritar mbrojtjes së mjedisit në raport me interesat e zhvillimit ekonomik të shtetit britanik. Sidoqoftë vlen të theksohet se, pavarësisht nga Verdicti përfundimtar, analiza e Dhomës kalon nëpër një fill tepër të hollë proporcionaliteti dhe ekuilibrash dhe kriter themelor për justifikimin e Britanisë së Madhe ishin masat tërësore dhe sistematike që ajo kishte marrë për të analizuar dhe shmangur ndotjet nga zhurmat.

<sup>148</sup> Vendim i Gjykatës i 9 dhjetorit 1994

kundër Spanjës<sup>149</sup>, kërkuesja ankohej për shkak të zhurmave në mjedis nga klubet dhe baret e natës në afërsi të vendbanimit të saj. Në çështjen që po komentojmë Gjykata vlerësoi se qeveria ruse kishte dështuar në detyrimet e saj pozitive për mbrojtjen e së drejtës së kërkueses për respekt të vendbanimit dhe të jetës së saj private.

## PIBERNIK kundër KROACISË

(kërkesa nr. 75139/01)

4 mars 2004

*në këtë vendim Gjykata u shpreh se vonesat e tejzgjatura në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore përbëjnë shkelje të së drejtës për proces të rregullt dhe të drejtën për banesë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Zdenka Pibernik, është shtetase kroate, që ka lindur më 1965 dhe që jeton në Zagreb.
2. Më 25 shtator 1995, S.Ž. u fut me dhunë në apartamentin e saj në Split dhe nuk dilte më jashtë. Më 3 shkurt 2000, Gjykata e rrethit të Zagrebit dha ndaj tij një urdher largimi. Megjithatë kërkuesja nuk u rikthye në apartamentin e saj deri në 21 mars 2003.
3. Znj. Pibernik u ankua në lidhje me pamundësinë e saj të tejzgjatuar për të rifituar posedimin e apartamentit të saj si dhe në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave për dhënien e urdhrin të largimit, të cilat zgjatën shtatë vjet, pesë muaj dhe 17 ditë. Nga këto Gjykata mund të merrte në shqyrtim vetëm pesë vjet, katër muaj dhe 15 ditë, duke filluar nga 6 nëntori 1997, datë kur Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka hyrë në fuqi në Kroaci. Kërkuesja u bazua në nenin 6 § 1 dhe nenin 8, me argumentimin se ajo nuk kishte qenë në gjendje të jetonte në apartamentin e saj për më se shtatë vjet.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

4. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e procedurave dhe paaftësinë për të zbatuar për rreth katër vjet urdhrin e gjykatës për largim të zaptuesit të apartamentit.

<sup>149</sup> Vendim i Gjykatës i 16 dhjetorit 2004

**B. Në lidhje me nenin 8**

5. Përsa i përket nenit 8 Gjykata vuri në dukje se apartamenti në fjalë ishte banesa e kërkueses, ku ajo zakonisht jetonte dhe se S.Ž. u fut me dhunë në të dhe banonte në të në mënyrë të paligjshme. Megjithëse Gjykata e rrethit të Zagrebit e kishte njohur të drejtën e kërkueses për të banuar në apartamentin e saj dhe kishte urdhëruar nxjerrjen jashtë të S.Ž., vendimi i saj nuk u vu në zbatim për një periudhë të gjatë kohe, për shkaqe që i ngarkoheshin të gjitha autoriteteve kroate. Mënyra e vetme me anë të së cilës kërkuesja mund të kishte rifituar posedimin e apartamentit të saj ishte procesi gjyqësor në një gjykatë civile, por S.Ž. refuzoi të respektonte vendimin gjyqësor.

6. Vonesa në ekzekutimin e urdhrin të largimit do të thoshte që kërkuesja nuk kishte pasur mundësi të banonte në shtëpinë e saj për një periudhë më të gjatë se tre vjet pas hyrjes në fuqi të Konventës në Kroaci.

7. Ishte e qartë se Kroacia nuk kishte treguar se organizimi i sistemit të saj ligjor ishte bërë në mënyrë të tillë që të mund të parandalonte pengesat ndaj ekzekutimit të vendimeve përfundimtare të gjykatave vendase. Një mangësi e tillë krijonte, ose të paktën lejonte, një situatë ku kërkuesja nuk ishte në gjendje të përdorte banesën e saj për një periudhë të gjatë kohe. Duke konstatuar se Kroacia nuk kishte respektuar detyrimet e saj me karakter pozitiv për mbrojtjen e së drejtës së kërkueses për respektim e së drejtës së banesës së saj, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës. Ajo i akordoi kërkueses një shpërblim prej 11 250 euro për dëm material dhe 5 000 euro për dëm jomaterial.

**III. Koment**

8. Në këtë çështje Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 për shkak se autoritetet kroate nuk kishin arritur të ekzekutonin një urdhër largimi për një periudhë të paarsyeshme kohe. Gjykata disa herë me radhë ka vendosur se ekzekutimi i një vendimi gjyqësor është pjesë përbërëse e procesit gjyqësor për qëllimet e nenit 6. Në çështjen *Hornsby kundër Greqisë*, Gjykata shpalli se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, ashtu siç garantohet nga neni 6 i Konventës, do të ishte iluzive në qoftë se sistemi ligjor i një shteti do të lejonte që një vendim gjyqësor i karakterit përfundimtar dhe i detyrueshëm të ngelej pa efekt në dëm të palëve në proces.

9. Duke iu referuar çështjes nëse kishte pasur apo shkelje të nenit 8, ishte e qartë që apartamenti përbënte vendin e banimit të kërkueses, përderisa ajo kishte banuar në të derisa S.Ž. u fut me dhunë në të. Megjithatë është interesante të vihet në dukje se kuptimi i termit “banesë” sipas Konventës është mjaft i gjerë. Ai përfshin çdo mjedis ose strehë të përdorur nga individët si banesë e tyre dhe në lidhje me të cilën ata kanë një titull legjitim. Ky kuptim mund të shtrihet edhe në mjedise që janë zënë në mënyrë të paligjshme për aq sa ka një interes legjitim qoftë në lidhje me mjediset qoftë në lidhje me truallin në të cilin ato janë ngritur. Gjykata ka pranuar gjithashtu se nocioni i “banesës” në disa rrethana mund të kuptohet sikur përfshin edhe zyrat



qëndrore të një shoqërie tregtare, zyrat e filialeve ose mjedise të tjera të veprimtarisë profesionale<sup>150</sup>.

10. Argumentimi i Gjykatës në konstatimin e shkeljes së nenit 8 vijon konstatimin e shkeljes së nenit 6 të Konventës. Ishte e qartë që shteti nuk kishte ndërhyrë vetë në të drejtën e kërkuases për respektim të banesës së saj. Pra, çështja ishte nëse Kroacia kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj me karakter pozitiv për të siguruar që të drejtat e kërkuases të mbroheshin në mënyrë efektive. Ishte pikërisht paaftësia e shtetit në ekzekutimin e urdhrat të largimit ajo që e pengoi kërkuesen që të gëzonte banesën e saj për një periudhë të gjatë kohe. Kjo mangësi përbënte një shkelje të nenit 8 të Konventës.

## CONNORS kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 66746/01)

27 maj 2004

*në këtë çështje Gjykata vendosi se mungesa e garancive procedurale shkelte të drejtën e kërkuetit për banesë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkueti, James Connors, është shtetas britanik që ka lindur më 1955 dhe jeton në Britaninë e Madhe. Kërkueti dhe familja e tij janë ciganë dhe jetojnë sipas një mënyre tradicionale - duke udhëtuar vazhdimisht. Por ata pretendonin se shpesh ftoheshin dhe detyroheshin të largoheshin gjithnjë e më shpesh nga vendbanimet e tyre, sa pastaj ishin detyruar të vendoseshin në lagjen cigane të Cottingley Springs në Leeds, në Angli, ku ata banonin prej 13 vjetësh. Në shkurt 1997 ata u ankuan, ndërmjet të tjerash për shqetësime dhe akte të dhunshme të kryera ndaj tyre. Ata u larguan dhe morën me qira një shtëpi, por nuk ishin në gjendje që të jetonin në të sipas mënyrave të tyre të jetesës.

2. Në tetor 1998, kërkueti dhe e shoqja u kthyen në Cottingley Springs dhe u lejuan të banonin në një parcelë me kusht që ata, familjet e tyre apo edhe të ftuarit e tyre të mos i "shqetësonin" personat që banonin në atë zonë ose në afërsi të saj. Më 29 mars 1999, vajzës më të rritur të kërkuetit, Margaret Connors, iu dha e drejta që të banonte në një parcelë bashkangjitur, ku ajo jetonte me Michael Maloney. Djemtë e rritur të kërkuetit e vizitonin mjaft shpesh motrën e tyre.

3. Më 31 janar 2000, familja u njoftua që të largohet nga të dy parcelat, me arsyetimin se Michael Maloney dhe fëmijët e kërkuetit, përfshirë edhe djemtë e tij të rritur,

<sup>150</sup> Shih vendimin e 16 prillit 2002 në lidhje me çështjen Stés Colas Est kundër Francës.

nuk ishin sjellë siç duhej dhe kishin shkaktuar shqetësime në atë zonë. Kërkuesi i kundërshtoi këto pretendime. Më 20 mars, 2000 Këshilli Vendor filloi procedurat për të rimarrë në posedim të dy parcelat.

4. Në atë kohë kërkuesi jetonte me të shoqen dhe katër nga fëmijët e tyre – Charles, Michael, Daniel – respektivisht 14, 13, 10 vjeç dhe Thomas, 4 muajsh. Thomas kishte probleme me veshkat ndërsa gruaja e kërkuesit, e cila ishte astmatike, kishte vuajtur nga disa kriza si pasojë e të cilave kishte shkuar në spital. Kërkuesi, i cili kishte pasur disa shqetësime në gjoks, po priste për caktimin e një date vizite në spital. Danieli shkonte shumë mirë në shkollë ndërsa të tjerët merrnin asistencë, përfshirë këtu edhe mësimdhënien në shtëpi.

5. Në orët e para të datës 1 gusht 2000, Këshilli Vendor e largoi familjen nga parcelat, me anë të një operacioni që zgjati pesë orë. Karvani që ishte pronë e familjes nuk iu kthye asaj, sipas kërkuesit, deri pas dreke vonë. Më 3 gusht këshilli ia ktheu të gjitha orenditë e tyre të cilat ishin braktisur përgjatë rrugës, mjaft larg nga karvani i kërkuesit.

6. Kërkuesi pretendoi se familja e tij nuk kishte pasur asnjë ndihmë ose këshillë se ku mund të shkonin, përveç një oferte për t'u sistemuar në bregun lindor të Anglisë e cila nuk mbante parasysh lidhjet sociale të familjes, pasi ata kishin jetuar në zonën e Leedsit për rreth 20 apo 30 vjet.

7. Kërkuesi deklaronte se që nga largimi, familjes së tij i ishte kërkuar që të ishte vazhdimisht në lëvizje dhe se stresi e pasiguria kishin ndikuar në vendimin e gruas së tij për të banuar në një apartament dhe për t'u ndarë me të në maj 2001. Pas këtij urdhri largimi as Danieli nuk ishte kthyer më në shkollë.

8. Kërkuesi ankohej sidomos për faktin se atij nuk i ishte dhënë mundësia për të kundërshtuar përpara gjykatave pretendimet e ngritura kundër tij të cilat kishin qenë edhe argumentet për largimin e familjes së tij, dhe se në ndryshim nga pronarët e trojeve private, shoqatat e strehimit dhe organet lokale të strehimit, autoritetet lokale që administrojnë zona banimi për ciganët, nuk ishin të detyruara t'i provonin pretendimet që ata ngrinin ndaj banorëve të tyre. Kjo sipas kërkuesit parashikohej nga Ligji i vitit 1983 “Mbi Banesat e Lëvizshme”. Ai bazohej në nenet 8, 14, 6 dhe 13 të Konventës si dhe në nenin 1 të Protokollit 1.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

9. Gjykata vuri re se pozita e brishtë e ciganëve si minoritet nënkupton se nevojave dhe mënyrës së tyre të veçantë të jetesës iu duhet kushtuar një vëmendje e veçantë qoftë në nivel legjislativ qoftë në marrjen e vendimeve në raste të veçanta. Në këtë kuadër, kishte një detyrim pozitiv për Mbretërinë e Bashkuar që të lehtësonte mënyrën e jetesës së ciganëve.

10. Situata ishte shumë serioze për kërkuesin. Ai dhe familja e tij ishin larguar nga zona ku ata kishin jetuar për rreth 14 ose 15 vjet (përveç një shkëputjeje të shkurtër). Pas kësaj shpërnguljeje ata kishin pasur vështirësi në gjetjen e një vendosjeje të ligjshme për karvanët e tyre, shoqëruar me probleme shëndetësore për fëmijët e vegjël si dhe me ndërprerjen e arsimimit të tyre. Në fakt familja u la pa banesë, duke e vënë përballë vështirësive të mëdha për mirëqenie dhe siguri.

11. Problemi themelor në këtë çështje ishte nëse, në rrethanat përkatëse, legjislacioni i zbatueshëm për zënien e parcelave në zonat e dedikuara për ciganët, i ofronte kërkuesit garanci procedurale të mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të tij.

12. Sipas mendimit të Gjykatës, kjo ndërhyrje serioze ndaj të drejtave që kërkuesit i garantohen nga neni 8, kërkonte arsye veçanërisht të rëndësishme të interesit publik që të mund të justifikohesh. Thjesht fakti që sjellja joshoqërore në zonat e banuara nga ciganët nuk mundej që, në vetvete, të justifikonte një urdhër largimi. Kjo sidomos duke pasur parasysh që probleme të tilla ishin hasur edhe në rastin e autoriteteve të tjera vendore që administronin banesa të lëvizshme dhe në këto raste autoritetet e kishin ushtruar gamën e kompetencave të tyre në mënyrë të ndryshme, duke arritur në largim vetëm pas shqyrtimit të pavarur gjyqësor të arsyeve që justifikojnë largimin. Pavarësisht nga pretendimi se qëndrimet e ciganëve ndaj autoriteteve e bënë zbatimin e procedurave gjyqësore të pamundura, Gjykata theksoi se edhe ndaj parcelave të dedikuara për t'u banuar nga ciganët, gjenin zbatim të njëjtat garanci. Ajo nuk u bind se kishte ndonjë arsye kaq themelore që bënte që këto parcela të mos mund të administroheshin nëse autoriteteve përkatëse iu kërkohesh të paraqisnin arsyet përpara se t'i detyronin banorët e tyre tradicionalë të largoheshin.

13. Gjykata nuk i nënvlerësoi vështirësitë me të cilat përballeshin autoritetet në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për ciganët dhe popullsitë migratore dhe pranoi që në këtë fushë autoritetet shtetërore gëzonin një hapësirë të gjerë vlerësimi në adoptimin dhe zbatimin e politikave të tyre sociale dhe të strehimit. Megjithatë, Gjykata nuk u bind se nga ana e qeverisë britanike u argumentua sa duhej nevoja e një skeme që lejonte largimin e paargumentuar të kërkuesit dhe familjes së tij nga zona ku banonin. Kompetenca për të dëbuar, por pa ia nënshtruar arsyet shqyrtimit të një gjykate të pavarur, nuk është treguar se i përgjigjet bindshëm ndonjë qëllimi specifik ose se i ofron ndonjë përfitim konkret bashkësisë cigane.

14. Si përfundim, Gjykata vlerësoi se largimi i kërkuesit dhe i familjes së tij nga parcela ku kishin vendosur karvanin nuk i ishte nënshtruar garancive të kërkuara procedurale, konkretisht kërkesës për të parashtruar justifikimet e duhura për largimin e tij. Për pasojë, ky largim nuk mund të konsiderohej si i justifikuar nga një "nevojë e ngutshme sociale" ose se ishte në proporcion me qëllimin legjitim që masa ndiqte. Pra, Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

## **B. Në lidhje me nenin 14**

15. Pasi gjeti shkelje të nenit 8, Gjykata u shpreh se nuk dilte në pah ndonjë aspekt i veçantë në bazë të nenit 14.

**C. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1**

16. Edhe në lidhje me këtë nen, Gjykata u shpreh se nuk dilte në pah ndonjë aspekt i veçantë.

**D. Në lidhje me nenin 6**

17. Përsëri Gjykata u shpreh se nuk dilte në pah ndonjë aspekt i veçantë në bazë të nenit 6.

**E. Në lidhje me nenin 13**

18. Gjykata kujtoi se neni 13 nuk shkon aq larg sa të garantojë një mjet ankimor që të lejojë kundërshtimin e legjislacionit të një shteti anëtar përpara autoriteteve shtetërore me argumentimin se vjen në kundërshtim me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Duke parë se ankimi i kërkuesit kishte të bënte në thelb me një përjashtim që iu ishte akorduar autoriteteve lokale që administronin zona banimi për ciganët nga Ligji i Banesave të Lëvizshme të vitit 1983, Gjykata nuk konstatoi shkelje të nenit 13.

**F. Në lidhje me nenin 41**

19. Gjykata i akordoi kërkuesit 14 000 euro për dëm jomaterial dhe 21 643 euro për shpenzimet gjyqësore.

**III. Koment**

20. Problemi kryesor në këtë çështje ishte nëse ekzistonte një kuadër i përshtatshëm ligjor që i mbronte në mënyrë të mjaftueshme të drejtat e kërkuesit në bazë të nenit 8 të Konventës. Qeveria britanike argumentoi se shteteve duhet t'iu njihet një hapësirë e konsiderueshme vlerësimi në këtë çështje apo të tjera të ngjashme.

21. Doktrina e “hapësirës së vlerësimit” është krijesë e së drejtës ndërkombëtare. Ajo përcakton marrëdhëniet ndërmjet një gjykate mbishtetërore – Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – dhe gjykatave të brendshme shtetërore. Në bazë të Konventës, shtetet janë të lira që të marrin masat që ato i gjykojnë më të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat e njohura nga Konventa, por kjo liri i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Strasburgut. Konventa nuk kërkon që të njëjtat standarde të zbatohen në mënyrë uniforme në të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës përderisa këto vende kanë sisteme ligjore, sociale, kulturore dhe ekonomike krejt të ndryshme. Por për aq kohë sa shtetet arrijnë të “sigurojnë” të drejtat që duhet të sigurojnë në bazë të nenit 1 të Konventës, ato gëzojnë një hapësirë vlerësimi në lidhje me mënyrën për ta përmbushur këtë detyrim. Nëse një hapësirë vlerësimi është e gjerë ose e ngushtë do të varet nga të drejtat e Konventës që janë në lojë dhe nga rrethanat e çështjes.

22. Në kundërshtim me pretendimet e qeverisë, Gjykata vendosi se përderisa në këtë çështje ndërhyrja ndaj të drejtave të kërkuesit ishte serioze (familja e tij ishte lënë praktikisht pa strehë) hapësira e vlerësimit që mund t'iu njihet autoriteteve shtetërore duhet të ishte më e ngushtë. Kriteri themelor ishte që kërkuesi nuk

kishte mundësi të kundërshtonte faktet mbi bazën e të cilave ishte marrë vendimi i largimit të tij dhe familjes së tij. Kjo mangësi në lidhje me garancitë procedurale nuk justifikohet nga një nevojë e ngutshme sociale dhe për këtë arsye, përbënte shkelje të të drejtave të kërkuarit.

## NIEMIETZ kundër GJERMANISË

(kërkesa nr. 13710/88)

16 dhjetor 1992

*koncepti i banesës shtrihet edhe në mjediset e ushtrimit të aktivitetit profesional dhe përfiton nga mbrojtja që akordon neni 8 § 1 i Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Më 9 dhjetor 1985, gjyqtarit Miosga, në Gjykatën Rajonale të Freising iu dërgua me faks një letër nga zyra e postës kryesore të Friburgut. Ajo kishte të bënte me një kallëzim penal ndaj një punëdhënësi që refuzonte t'iu mbante nga rroga punonjësve të tij dhe më pas t'ia derdhte administratës tatimore taksën e kishës që ata duhet të paguanin. Letra e akuzonte gjyqtarin për abuzime në detyrën në lidhje me shqyrtimin e çështjes në fjalë. Ajo mbante firmën e Klaus Wegner, ndoshta një person fiktiv, dhe shoqërohej me fjalët "në emër të grupit Bunte Liste<sup>151</sup> të Friburgut". Prokuroria e Munihut që drejtonte hetimet nuk arriti të gjente ndonjë të dhënë në lidhje me Klaus Wegner dhe për të vazhduar hetimet mori një urdhër për kontroll në zyrën e z. Gotfried Niemiets i cili kishte drejtuar për disa vite Bunte Liste dhe kolegu me të cilin ai ndante zyrën e tij avokatore kishte qenë militant i kësaj partie.

2. Më 8 gusht 1986 urdhëroi një kontroll në zyrën e kërkuarit me qëllim bllokimin e çdo dokumenti që përmbante të dhëna mbi Klaus Wegner. Mandati i kontrollit arsyetohej si vijon: "letrat që i drejtoheshin Bunte Liste dërgoheshin në një kuti postare, përmbajtja e së cilës deri në 1985, i përcillej zyrës të z. Niemiets". Kontrolli u bë më 13 nëntor 1986 dhe zgjati mbi një orë. U kontrolluan dhe u shqyrtuan me imtësi katër blloqe që përmbanin të dhëna mbi klientët dhe gjashtë dosje individuale, por nuk u gjet asnjë dokument i dobishëm për qëllimet e hetimit konkret.

3. Më 27 mars 1987, Gjykata Rajonale e Munihut e shpalli të papranueshëm ankimin e z. Niemiets kundër mandatit të kontrollit për shkakun se ai ishte ekzekutuar njëherë. Më 18 gusht 1987, gjykata kushtetuese federale, e deklaroi të papranueshëm ankimin e të interesuarit kundër mandatit të kontrollit dhe vendimit të gjykatës rajonale.

<sup>151</sup> Bundes Liste ishte një parti politike me shtrirje lokale në Bavari.

4. Z. Niemiets iu drejtua Komisionit më 15 shkurt 1988. Ai pretendonte se kontrolli ka shkelur nenin 8 të Konventës, duke shkelur të drejtën e tij për respektimin e banesës dhe të korrespondencës, dhe nenin 1 të Protokollit 1, duke cenuar klientelën e tij dhe reputacionin si avokat. Ai pretendonte gjithashtu se edhe neni 13 ishte shkelur, pasi ai nuk kishte mundur të bënte një ankim efektiv përpara autoriteteve gjermane për këto pretendime.

5. Me një vendim të datës 5 prill 1990 Komisioni e pranoi kërkesën vetëm në lidhje me nenin 8 të Konventës dhe me nenin 1 të Protokollit 1 dhe e deklaroi të papranueshme përsa i përket pjesës tjetër të pretendimeve. Në raportin e tij të 29 majit 1991 ai arriti njëzëri në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 8 dhe se nuk kishte nevojë për këtë arsye për një shqyrtim më vete në bazë të nenit 1 Protokollit 1.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

*i. A gjente zbatim neni 8 § 1 – a kishin ndërhyrje?*

6. Qeveria kundërshtonte ekzistencën e një ndërhyrje, duke mbështetur idenë se neni 8 dallon qartë jetën private dhe banesën nga njëra anë dhe mjedisin profesional nga ana tjetër.

7. Gjykata nuk e vlerësoi as të mundshëm e as të nevojshëm përkufizimin në një kuptim të gjerë të nocionit “jetë private”. Megjithatë do të ishte kufizuese ta ngushtoje atë në një “rreth intim” ku secili mund të bëjë një jetë personale sipas dëshirës, duke veçuar plotësisht botën e jashtme. Respekti i jetës private duhet të përfshijë gjithashtu, deri në një farë mase, të drejtën e individit për të lidhur dhe zhvilluar marrëdhëniet me individët e tjerë. Për më tepër duket se nuk kishte asnjë arsye parimore për të marrë në konsideratë një mënyrë përcaktimi të “jetës private” që të përjashtojë veprimtarinë profesionale ose tregtare. Në të vërtetë, Gjykata u shpreh se shumica e njerëzve kanë më shumë mundësi të vendosin lidhje me botën e jashtme në vendin e punës.

8. Një fakt e pohonte këtë qëndrim të Gjykatës: në punët e një njeriu nuk është gjithmonë e mundur të ndash atë që i përket fushës profesionale dhe atë që nuk i përket asaj. Veçanërisht, detyrat e një profesionisti të lirë, mund të përbëjnë një element të jetës së tij në një shkallë kaq të lartë sa që nuk mund të përcaktojmë se në çfarë cilësie ai vepron në atë moment. Për më tepër, mund arrihej në një pabarazi trajtimi në qoftë se do të refuzohej zbatimi i nenit 8 për shkak se masa e denoncuar kishte lidhje vetëm me veprimtarinë profesionale. Sipas Gjykatës ky nen gjente zbatim në favor të një individit, veprimtaritë profesionale dhe private do të ndërthureshin kaq shumë sa që nuk do të ekzistonte asnjë mjet për t’i ndarë. Deri këtu Gjykata nuk bëri ndonjë dallim të tillë dhe e pranoi zbatimin e konceptit të jetës private edhe në lidhje me mjediset ku ushtrohet aktiviteti profesional<sup>152</sup>.

<sup>152</sup> Shih gjithashtu vendimet e saj të 30 marsit 1989 në lidhje me çështjen Chapell kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe të 24 prillit 1990 në lidhje me çështjen Huvig kundër Francës (ky i fundit i përfshirë në këtë përmbledhje).



9. Përsa i përket fjalës “home” që figuron në tekstin anglez në nenin 8, në disa shtete palë si Gjermania pranohej, që ajo përfshinte edhe mjediset profesionale. Një interpretim i tillë i përshtatet plotësisht versionit francez “domicile”. Termi “banesë” ka një kuptim më të gjerë se “home” dhe mund të përfshijë si në rastin konkret, zyrën e një anëtari të një profesioni të lirë. Ai mund të shfaqet si i vështirë për të bërë përcaktime të sakta. Gjykata u shpreh se në shtëpi mund të zhvillohen veprimtari të lidhura me një profesion ose tregti dhe në zyrë ose në një mjedis tregtar mund të ushtrohen veprimtari private. Në qoftë se do t'i jepej një kuptim i ngushtë fjalëve “home” dhe “banesë”, mund të krijohet një rrezik pabarazie në trajtim si për nocionin e “jetës private”.

10. Në mënyrë më të përgjithshme, u shpreh Gjykata, sikur interpretimi i fjalëve “jetë private” dhe “banesë” të përfshinte disa mjedise ose veprimtari profesionale ose tregtare do t'i përgjigjej më mirë objektit dhe qëllimit thelbësor të nenit 8. Shtetet palë nuk do të trajtoheshin padrejtësisht sepse ata do të ruanin në atë masë që e parashikon paragrafi 2 i nenit 8, të drejtën e tyre të “ndërhyrjes”, dhe në lidhje me mjediset dhe veprimtaritë profesionale ky i fundit mund të ishte më i gjerë se në rastet e tjera.

11. Këtyre konsideratave të përgjithshme iu shtoj edhe një faktor që kishte të bënte me rrethanat e çështjes. Mandati i dhënë nga Gjykata Rajonale e Munihut urdhëronte kërkimin dhe marrjen e “dokumenteve” mbi identitetin e Klaus Wegner, pa saktësi dhe kufizim. Për më tepër personat që bënë kontrollin shqyrtuan katër blloqe me të dhëna mbi klientët si dhe gjashtë dosje individuale. Kontrolli duhet të jetë bërë kryesisht në lidhje me “korrespondencën” dhe me objekte që përfshihen në këtë kategori sipas Konventës. Mjafton të nënvizohet në lidhje me këtë, se në nenin 8 fjala “korrespondencë”, në kundërshtim me termin “jetë”, nuk shoqërohet nga asnjë mbiemër. Këto arsye të marra së bashku çojnë në vlerësimin se kontrolli përbënte ndërhyrje.

*ii. Në lidhje me ligjshmërinë e ndërhyrjes*

12. Kjo ndërhyrje ishte “parashikuar nga ligji”, sepse Gjykata Rajonale e Munihut dhe Gjykata Kushtetuese Federale vlerësuan se kontrolli ishte i rregullt në përputhje me nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale.

*iii. A udhëhiqej ndërhyrja nga qëllime legjitime?*

13. Ndërhyrja mund të thuhet se ndiqte qëllime legjitime, si parandalimin e veprave penale dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve, si rrjedhim nderin e gjyqtarit Miosga.

*iv. A ishte ndërhyrja proporcionale në një shoqëri demokratike?*

14. Përsa i përket domosdoshmërisë së ndërhyrjes, Gjykata konstatoi një mungesë proporcionaliteti. Sigurisht nuk mund të konsiderohej e vogël shkelja që i dha shkas kontrollit. Ajo përbënte jo vetëm një fyerje të gjyqtarit por edhe një tentativë për të ushtruar presion mbi të. Megjithatë, mandati ishte përpiluar me një kuptim të

gjerë: ai urdhëronte kërkimin dhe marrjen e “dokumenteve” lidhur me identitetin e autorit të letrës fyese pa asnjë kufizim. Kjo gjë merr një rëndësi të madhe, kur, si në Gjermani, kontrolli i bërë në zyrën e një avokati nuk shoqërohet me garanti të veçanta procedurale, siç mund të ishte prania e një vëzhguesi të pavarur. Por mund të shkojmë edhe më tej. Duke pasur parasysh natyrën e objekteve të analizuara efektivisht, kërkimi shkeli sekretin profesional në një nivel që duket joproporcionale. Në rastin e një avokati, një ndërhyrje e tillë mund të ketë pasoja mbi administrimin e mirë të drejtësisë dhe mbi të drejtat e garantuara nga neni 6. Për më tepër, publiciteti lidhur me çështjen duhet të ketë rënduar mbi reputacionin e kërkuesit, si për klientët ashtu edhe për publikun në përgjithësi. Si përfundim, ajo arriti njëzëri në përfundimin se neni 8 ishte shkelur.

### **B. Në lidhje me nenin 1 i Protokollit 1**

15. Gjykata, duke marrë parasysh sipas nenit 8 pasojat e mundshme të kontrollit mbi reputacionin e z. Niemietz, njëzëri çmoi se asnjë problem tjetër nuk lind lidhur me nenin 1 të Protokollit 1.

### **C. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)**

16. Gjykata hodhi poshtë njëzëri kërkesën për dëmshpërblim të bërë nga kërkuesi mbi bazën e nenit 50. Kjo për shkak se ai nuk solli asnjë provë për dëm material të pësuar prej tij. Kërkuesi nuk kishte paraqitur nga ana tjetër asnjë provë as në lidhje me dëmin eventual moral dhe as në lidhje me shpenzimet dhe pagesat ligjore. Për këto arsye nuk iu akordua asnjë shumë nga ana e Gjykatës.

## **III. Koment**

17. Vendimi i Gjykatës në lidhje me çështjen Niemietz kundër Gjermanisë përbën një hap me rëndësi në drejtim të zgjerimit të konceptit “banesë” për qëllimet e nenit 8 të Konventës. Një interpretim i zgjeruar i këtij koncepti, sipas Gjykatës, përbën një instrument të nevojshëm për të arritur qëllimin e mbrojtjes efikase të të drejtës për jetë private të garantuar nga neni 8 i Konventës. Për këtë qëllim Gjykata në vendimin e saj përdor edhe teknikën e referimit në të dy versionet zyrtare të Konventës, anglisht dhe frëngjisht, për të gjetur kuptimin më të gjerë të termit.

18. Interesi specifik në lidhje me këtë vendim konsiston në faktin se ai e shtrin konceptin e banesës edhe në mjediset e ushtrimit të profesionit, duke përbërë një gur themelor për jurisprudencën e mëtejshme të Gjykatës në këtë fushë<sup>153</sup>. Megjithatë duhet theksuar se Gjykata pranon se në rastin e mjediseve të punës ose mjediseve të ushtrimit të profesionit hapësira e vlerësimit të shteteve në lidhje me ndërhyrjen ndaj së drejtës për jetë private është më e gjerë se në rastin e mjediseve të banimit privat ose familjar. Mjafton që shtetet të arrijnë ta justifikojnë këtë hapësirë më të gjerë në kuadrin e paragrafit 2 të nenit 8 të Konventës, siç bëri Spanja në çështjen

<sup>153</sup> Shih në vijim vendimin e Gjykatës të 16 prillit 2002 në lidhje me çështjen Colas Est dhe Të Tjerë kundër Francës.

Banco de Finanzas E Inversiones, SL<sup>154</sup>, duke argumentuar se kontrolli i ushtruar në zyrat e shoqërisë ishte bërë duke pasur si qëllim parandalimin e krimit dhe se gjyqtari hetues i kishte bërë të gjitha përpjekjet e tjera për të marrë prova në lidhje me sjelljen e personit të dyshuar. Duket pra, se parimi i proporcionalitetit peshon më tepër nga ana e shtetit në rastet e mjediseve të punës.

## COLAS EST DHE TË TJERË kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 37971/97)

16 prill 2002

*koncepti i banesës shtrihet edhe në mjediset e ushtrimit të aktivitetit tregtar dhe përfiton nga mbrojtja që akordon neni 8 § 1 i Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit janë Colas Est, Colas Ouest dhe Sacer, të cilët janë shoqëri për ndërtimin e rrugëve në Francë. Ato ishin hetuar më 1985 në kuadrin e një kontrolli administrativ gjatë të cilit oficerë hetimorë nga Drejtoria e Përgjithshme për Konkurrencën, çështjet e Konsumatorit dhe Ndjekjen e Mashtrimeve hetuan 56 shoqëri në të njëjtën kohë dhe sekuestruan disa mijëra dokumente nga të cilat rezultonte se në lidhje me disa kontrata ishin bërë marrëveshje të pandershme. Oficerët hetimorë ishin futur edhe në mjediset e shoqërive kërkuese në bazë të dispozitave të Urdhrit nr. 45-14-84. Mbi bazën e dokumenteve të sekuestruara, Ministri i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit ia kaloi çështjen Këshillit të Konkurrencës, i cili i gjobiti kërkuesit për shkak se këta kishin qenë pjesëmarrës në praktika të paligjshme. Kërkuesit i ishin drejtuar Gjykatës së Apelit të Parisit duke kundërshtuar ligjshmërinë e kontrollit dhe të sekuestrimit të kryera pa asnjë paralajmërim. Gjykata e Apelit i gjobiti kërkuesit përkatësisht me pesë milion, tre milion dhe gjashtë milion franga franceze. Gjykata e Kasacionit nga ana e saj i hodhi poshtë kërkesat e tyre.

2. Duke u bazuar në nenin 8 të Konventës, kërkuesit pretendonin që kontrolli dhe sekuestrimi që ishin kryer nga oficerët hetimorë pa asnjë mbikëqyrje apo kufizim, arrinte deri në një shkelje të “vendbanimit” të tyre.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 8

3. Gjykata vendosi se kishte ardhur koha për të njohur që në disa rrethana, të drejtat e garantuara nga ana e nenit 8 të Konventës mund të konceptohen sikur përfshijnë edhe të drejtën për respektimin e zyrave qendrore të një shoqërie tregtare, të zyrave të degëve të saj ose të vendit të zhvillimit të aktivitetit.

<sup>154</sup> Vendimi për mospranim i 27 prillit 1999.

4. Gjykata konstatoi se oficerët hetimorë kishin hyrë në zyrat e kërkuesve pa asnjë paralajmërim, gjë që përbënte një cenim të “vendbanimit” të tyre. Legjislacioni i zbatueshëm si dhe praktika përkatëse nuk parashikonin garanci të përshtatshme apo të mjaftueshme kundër ndonjë abuzimi të mundshëm në raste të tilla. Për këtë arsye Gjykata vlerësoi se në kohën e ngjarjes autoriteti përkatës kishte kompetenca mjaft të gjera dhe se ai kishte ndërhyrë pa asnjë paralajmërim nga ana e magjistratëve apo pa qenë prezent ndonjë oficer policie. Për këtë arsye Gjykata vlerësoi se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës

### **B. Në lidhje me nenin 41**

5. Gjykata i akordoi secilit prej kërkuesve 5 000 euro për dëmin jomaterial dhe 6 700 euro Colas Est, 10 200 Colas Ouest dhe 4 400 Sacer për shpenzime dhe pagesa ligjore.

### **III. Koment**

6. Kjo çështje konsistonte fillimisht në dy kërkesa që kishin të bënin me procedurat e filluara ndaj shoqërive kërkuese për shkelje të së drejtës së konkurrencës.

7. E para, e bërë në bazë të nenit 6 të Konventës dhe kishte të bënte me kontrollin dhe sekuestrimin e dokumenteve që edhe u përdorën në vijim si bazë për bërjen dhe argumentimin e akuzës. Kjo kërkesë nuk u pranua në fazën e pranueshmërisë. Kërkesa e dytë në lidhje me shkeljen e respektimit të “vendbanimit” u deklarua e pranueshme.

8. Dy aspekte të këtij meritajnë vëmendje të veçantë. Së pari, është zgjerimi i konceptit “vendbanim” deri në përfshirjen e zyrave të një shoqërie tregtare të regjistruar dhe të çdo mjedisi të aktivitetit tregtar. Mbrojtja e ofruar nga Konventa, pavarësisht nga titulli i kësaj, nuk kufizohet vetëm tek qeniet njerëzore. Edhe personat juridikë si shoqëritë tregtare, partitë politike, kishat ose organizatat jo-qeveritare gëzojnë mbrojtjen e Konventës në lidhje me të drejtat e tyre në mënyrë thuajse të pavarur, pra si subjekte më vete, nga të drejtat që anëtarët apo aksionarët e tyre mund të kenë individualisht apo bashkërisht si qenie njerëzore. Në vendimin që dha më 6 prill 2000 në lidhje me çështjen *Comigersoll S.A. kundër Portugalisë*, Gjykata u shpreh se edhe një person juridik ashtu si një person fizik ka të drejtën për një shpërblim të dëmeve me karakter jomaterial.

9. Gjykata e shtriu zbatimin e termit vendbanim deri në përfshirjen e ambienteve të aktiviteteve tregtare si një rrjedhojë logjike, por nuk ofroi asnjë shpjegim në lidhje me këtë shtrirje interpretuese. Termi kishte qenë shtrirë më parë deri në përdorimin e rezidencave personale të ushtrimit të aktivitetit dhe u zbatua në rastin e zyrës së një avokati për shkak të karakterit personal dhe privat të praktikës ligjore të ushtruar prej tij<sup>155</sup>. Por interpretimi i dhënë në vendimin që po komentojmë, arrin një zbatim

<sup>155</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 16 dhjetorit 1992 në lidhje me çështjen *Niemietz kundër Gjermanisë*, që paraprin të këtë përmbledhje.

shumë më të gjerë i cili duket se ka qenë bazuar ekskluzivisht, të paktën në pjesën kryesore të tij, në kuptimin e zgjeruar të termit francez “domicile” sesa të termit anglisht “home”. Megjithëse të dy këta terma në gjuhët përkatëse të barasvlershmin e tyre të drejtpërdrejtë në shqip e gjejnë në termin “vendbanim”<sup>156</sup>, në terminologjinë juridike franceze termi “domicile” në raste specifike dhe me prapashtesa të veçanta përdoret edhe për të treguar vendin e ushtrimit të aktivitetit<sup>157</sup>.

10. Elementi i dytë me interes ka të bëjë me mbivendosjen ndërmjet jurisprudencës së Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe asaj të së drejtës së Bashkimit Evropian, të cilin edhe vetë vendimi e ve në dukje. Gjykata Evropiane e Drejtësisë në Luksemburg vendos në lidhje me mosmarrëveshje që lindin në kuadrin e së drejtës komunitare duke zbatuar standardet e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastet ku mendon se kjo gjë është e përshtatshme. Për një kohë të gjatë jurisprudenca e Gjykatës së Luksemburgut ka mbajtur qëndrimin se mjediset e ushtrimit të aktivitetit tregtar nuk përfshihen në termin “vendbanim” sipas nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky vendim i Gjykatës së Strasburgut shtron çështje tepër interesante në lidhje me zbatimin nga ana e Gjykatës së BE-së në Luksemburg si dhe nga gjykatat e brendshme kur ato zbatojnë drejtpërdrejt të drejtën komunitare në këtë fushë.

## KLASS DHE TË TJERË kundër GJERMANISË

(kërkesa 5029/71)

6 shtator 1978

*vendimi i parë i Gjykatës në lidhje me përgjimet telefonike dhe me justifikueshmërinë e tyre në bazë të paragrafit 2 të nenit 8*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Gerhard Klass, prokuror, Peter Lubberger, Hans Jurgehn Pohl dhe Dieter Selb, avokatë, dhe Jurgen Nussbruch, gjyqtar, janë shtetas gjermanë.

2. Legjislacioni i vitit 1968, sidomos një amendament i nenit 10 § 2 i Ligjit Themeltar dhe një Akt i 13 gushtit 1968, që kufizonte sekretin e postës dhe telekomunikacionit, autorizonte në disa rrethana mbikëqyrjen sekrete pa nevojën e informimit të personit në fjalë. Për më tepër, legjislacioni përjashtonte ankimin përpara gjykatave lidhur me urdhrin dhe zbatimin e masave të mbikëqyrjes. Në vend të kësaj ai krijonte dy agjenci, një Bord me pesë anëtarë të Parlamentit, të emëruar nga Bundestagu dhe një Komision me tre anëtarë, të emëruar nga ky Bord.

<sup>156</sup> Shih për përkthimin në frëngjisht Fjalor Frëngjisht-Shqip (Vedat Kokona), fq. 314, dhe për përkthimin në anglisht Fjalor Anglisht-Shqip (Ramazan Hysa), fq. 326.

<sup>157</sup> Shih për shembull Dalloz – Termes Juridiques, 10e édition, fq. 213.

3. Pas një apelimi të paraqitur nga kërkuesit, Gjykata Kushtetuese Federale vendosi më 15 dhjetor 1970 se Akti i 13 gushtit 1968 ishte i pavlefshëm përderisa ndalonte njoftimin e individit për mbikëqyrjen edhe kur ky njoftim mund të bëhej pa rrezikuar qëllimin e mbikëqyrjes.

4. Në qershor 1971, kërkuesit i paraqitën një kërkesë Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut. Ata pretendonin se legjislacioni i vitit 1968 shkelte Konventën në tre nene: nenin 6 § 1, nenin 8 dhe nenin 13.

5. Në raportin e tij të 9 marsit 1977, Komisioni shprehu mendimin se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përderisa kërkuesit ishin mbështetur në nocionin e "të drejtave civile" ose përderisa ata ishin mbështetur në nocionin "akuza penale". Ai gjithashtu u shpreh se nuk ishin shkelur as nenet 8 dhe 13.

6. Në seancën verbale të marsit 1978, agjenti i qeverisë Gjermane informoi Gjykatën se asnjëherë nuk janë urdhëruar ose zbatuar masa mbikëqyrjeje bazuar në legjislacionin e ankimuar.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 25 § 1 (aktualisht neni 34)

7. Qeveria Gjermane pretendonte se përderisa në ankimin e kërkuesve të qenit subjekt mbikëqyrjeje sipas legjislacionit të përmendur vetëm supozohej, ata nuk mund të konsideroheshin si viktimë sipas kuptimit të nenit 25 të Konventës. Ky nen vë disa kushte për paraqitjen e kërkesave nga çdo person që "pretendon të jetë viktimë e një shkeljeje" e Konventës.

8. Duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të rastit në fjalë, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit mund të pretendonin se ishin të dëmtuar nga një shkelje e Konventës edhe pse - për shkak të sekretit të çdo mase mbikëqyrjeje - ata nuk ishin në gjendje të provonin, për të mbështetur kërkesat e tyre, se ata kishin qenë në fakt, nën mbikëqyrjeje.

9. Më pas, Gjykata rishqyrtoi çështjen nëse kërkuesit kishin qenë viktimë të ndonjë shkeljeje të Konventës dhe analizoi nëse legjislacioni në fjalë përputhej apo jo me Konventën.

### B. Në lidhje me nenin 8

10. Duke mos pasur ndonjë debat lidhur me faktin se legjislacioni i diskutuar përbënte një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesve për respektimin e jetës private, familjare dhe korrespondencës, problemi kryesor ishte nëse kjo ndërhyrje justifikohej nga paragrafi 2 i nenit 8. Përderisa ky paragraf parashikon një përjashtim të së drejtës së garantuar nga Konventa, duhet të interpretohet në mënyrë të kufizuar. Pra, ushtrimi i mbikëqyrjes sekrete të qytetarëve, që karakterizon një shtet policor tolerohet nga Konventa vetëm në rast nevojë, për të mbrojtur institucionet demokratike.



11. Gjykata konstatoi se legjislacioni në fjalë, kishte një qëllim legjitim sipas paragrafit 2 të nenit 8, konkretisht mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe parandalimin e prishjes së rregullit dhe të krimit. Më pas ajo analizoi problemin nëse mjetet e përdorura qëndronin apo jo brenda kufijve të asaj që është e domosdoshme në një shoqëri demokratike për të arritur atë qëllim. Gjykata nënvizoi faktin se shoqëritë demokratike në ditët e sotme ndihen të kërcënuara nga forma tepër të sofistikuarat spiunazhi dhe terrorizmi. Si rrjedhim shteti duhet të jetë i aftë t'iu kundërvihet kërcënimeve edhe të ushtrisë një mbikëqyrje sekrete mbi elementët armiqësorë të cilët ndodhen nën juridiksionin e tij. Duhet pranuar se ekzistenca e disa ligjeve që mundësojnë mbikëqyrjen sekrete mbi postën dhe telekomunikacionin është në disa rrethana, e domosdoshme në një shoqëri demokratike për interesat e sigurimit kombëtar dhe/ose për parandalimin e prishjes së rregullit dhe të krimit.

12. Megjithatë duke ditur se Konventa u lejon shteteve palë një diskrecionaritet përse i përket përcaktimit të kushteve sipas të cilave duhet të funksionojë sistemi i mbikëqyrjes, vendimi vazhdon: "kjo nuk do të thotë se shtetet palë gëzojnë një diskrecionaritet pa kufi në mbikëqyrjen sekrete të personave që ndodhen në juridiksionin e tyre. Gjykata duke njohur, rrezikun që paraqiste një ligj i tillë që fshihej nën idenë e mbrojtjes së demokracisë, por që në të vërtetë e shkatërronte atë, pohoi se shtetet palë nuk duhet që në emër të luftës kundër spiunazhit dhe terrorizmit të marrin masa që ata i quajnë të duhura. Gjykata duhet të kënaqet me faktin se, në cilindo sistem ekzistojnë garanci të përshtatshme dhe efikase kundër abuzimit".

13. Nën dritën e këtyre konsideratave, Gjykata analizoi më pas, funksionimin e sistemit të mbikëqyrjes sekrete parashikuar nga ligji i kundërshtuar. Në vendim nënvizohet në veçanti se:

- sipas këtij ligji, duhet të plotësohen një sërë kushtesh kufizuese përpara se një masë mbikëqyrje të urdhërohet
- kushte të rrepta janë parashtruar për zbatimin e masave mbikëqyrëse dhe procesit të njoftimit të marrë;
- ndërsa në një fushë ku abuzimi është lehtësisht i mundshëm në rastet individuale dhe se mund të ketë pasoja tepër të rrezikshme për një shoqëri demokratike e marrë tërësisht, në parim është e preferueshme që kontrolli mbikëqyrës t'i besohet një gjyqtari", dy grupet kontrolluese të krijuara nga legjislacioni" në disa rrethana mund të konsiderohen sikur gëzojnë një pavarësi të mjaftueshme për të dhënë një vendim objektiv;
- mos informimi i individit kur mbikëqyrja ka përfunduar nuk mund të përputhet me nenin 8 përderisa ky fakt siguron efikasitetin e masës.

14. Si rrjedhim Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 8.

### *C. Në lidhje me nenin 13*

15. Më pas, Gjykata analizoi rastin nën dritën e nenit 13, i cili garanton se çdo njeri, kur të drejtat dhe liritë e tij ashtu si i parashikon Konventa janë shkelur, duhet të

gëzojë të drejtën e një ankimi efikas përpara një autoriteti vendas. Gjykata vendosi midis të tjerave se:

- mungesa e njoftimit të mbikëqyrjes nuk është në rrethanat e çështjes e kundërt me konceptin e një "ankimi efektiv" dhe si rrjedhim nuk përbën shkelje të nenit 13;
- për qëllimet e këtyre procedurave, një "ankim efikas" bazuar mbi nenin 13 do të thotë një ankim aq efikas sa që, duke pasur parasysh vlerën e tij të kufizuar, mund të jetë pjesë përbërëse e çdo sistemi mbikëqyrjeje;
- në këtë rast të veçantë, grumbullimi i ankimeve të disponueshme për kërkuesit sipas ligjit Gjerman i kënaq kërkesat e nenit 13.

#### *D. Në lidhje me nenin 6 § 1*

16. Qeveria Gjermane dhe Komisioni vlerësuan se neni 6 ishte i pazbatueshëm në këtë çështje. Gjykata vlerësoi se neni 6 edhe po të gjente zbatim, nuk ishte shkelur.

### **III. Koment**

17. Në këtë çështje, Gjykata u mor për herë të parë me problemin e përgjimit të komunikimeve postare dhe telefonike. Gjykata pranoi se legjislacioni gjerman i cili lejonte përgjimin dhe kontrollin e komunikimeve postare dhe telefonike për qëllime të sigurisë publike ishte i pajtueshëm me nenin 8 të Konventës. Ajo arriti ta justifikonte këtë legjislacion me argumentimin se ai ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike, për interesat e sigurisë kombëtare dhe të parandalimit të prishjes së rendit ose të krimit. Për këtë qëllim Gjykata mbajti parasysh edhe parimin e hapësirës së vlerësimit që i takonte Gjermanisë në këtë rast, për të arritur në justifikimin e masës. Vlen të përmendet që një faktor përcaktues në këtë drejtim ishte fakti se sistemi i kontrollit në Gjermaninë perëndimore ndaj ligjshmërisë dhe karakterit të nevojshëm të këtyre ndërhyrjeve me qëllim që të parandaloheshin abuzimet, ishte i mjaftueshëm për qëllimet e Konventës.

18. Vlen të përmendet se Gjykata analizoi me kujdes organet që ndërhyjnë në çdo fazë të procedurës për të legjitimuar përgjimin, karakterin e këtyre organeve<sup>158</sup>, arsyet mbi bazën e të cilave këto organe vendosnin për miratimin e përgjimit, si dhe mundësinë e personit të interesuar për t'u ankuar ndaj masës së përgjimit. Ishte pikërisht kjo tërësi garancish procedurale për qëllimet e nenit 8 të Konventës që e bënë Gjykatën të vendosë se nuk ka pasur shkelje të së drejtës për jetë private në këtë rast. Madje ajo shkoi deri aty sa të pohonte se megjithëse se ankimi pranë një gjykate të brendshme ishte i preferueshëm, ekzistenca e gjithë këtyre garancive procedurale përmbushte qëllimet e mbrojtjes së ofruara nga ana e nenit 8.

19. Ndërkohë që situata Gjermane, sidomos në rastin në fjalë dukej se ishte e pajtueshme me kërkesat e nenit 8 të Konventës, nuk ishte e njëjta gjë për Britaninë e

<sup>158</sup> Mjaft interesant në këtë rast ishte kontrolli që i bëhej legjitimitit të urdhrimit të përgjimit nga ana e një komisioni parlamentar të përbërë nga anëtarë të pozitës dhe të opozitës.

Madhe<sup>159</sup>, Francën<sup>160</sup> apo Zvicrën. Në një sërë çështjesh Gjykata vendosi se praktika britanike e përgjimit të telefonave në bazë të një leje të dhënë policisë nga ministri i brendshëm binte në kundërshtim me kërkesat e nenit 8<sup>161</sup> aq sa Britania e Madhe u detyrua të ndryshonte legjislacionin e saj në këtë drejtim<sup>162</sup>.

## KRUSLIN kundër FRANCËS, DHE HUVIG kundër FRANCËS

(kërkesat 11801/85 dhe 11105/84)

24 prill 1990

*legjislacioni që parashikon ndërhyrje ndaj të drejtës private duhet të jetë i saktë, i qartë dhe i parashikueshëm në mënyrë të mjaftueshme*

### I. Faktet kryesore

1. Në prill 1985, prokuroria e Gjykatës së Apelit të Tuluzës e dërgon z. Jean Kruslin përpara Gjykatës Penale të Garonës së Sipërme, për tu përgjigjur si bashkëpunëtor i një vrasjeje, i një vjedhje në rrethana rënduese dhe i një tentative për vjedhje në rrethana rënduese. Një nga elementet e dosjes ishte regjistrimi i një bisede telefonike të bërë nga kërkuesi më 17 qershor 1982, me një linjë që i përkiste një personi tjetër. Ky regjistrim ishte bërë me kërkesën e një gjyqtari të hetimeve paraprake të Saint-Gaudens në kuadrin e një procedure tjetër. Gjykata e Kasacionit i kishte hedhur poshtë ankesat e kërkuesit në lidhje me këto përgjime që figuronin në dosjen e tij penale.

2. Ndaj z. Jacques Huvig, i cili drejtonte një shoqëri tregtare me ndihmën e gruas së tij, Janine, u bë një akuzë për një mashtrim fiskal, mosmbyllje të llogarive tregtare dhe mbyllje të pasakta të llogarive. Në kuadrin e një hetimi të hapur nga gjykatësi i hetimeve paraprake të Shomon, ky i fundit ngarkon policinë e Langres për të përgjuar dhe transkriptuar të gjitha bisedat telefonike tregtare dhe private të të interesuarve. Përgjimet u bënë për rreth 28 orë me radhë gjatë muajit prill 1974.

3. Të akuzuarit, zoti dhe zonja Huvig u dënuan në mars 1982 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Shomon për pothuajse të gjitha shkeljet për të cilat ata u akuzuan. Në mars të vitit 1983, Gjykata e Apelit të Dizhonit e la në fuqi këtë vendim por i rriti dënimet. Në prill 1984, Gjykata e Kasacionit e hodhi poshtë kërkesën e ankuesve për prishje të vendimeve.

<sup>159</sup> Shih Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe në vijim Halford kundër Mbretërisë së Bashkuar, Christie kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe P.G. dhe J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar, ky i fundit i përfshirë në këtë botim.

<sup>160</sup> Shih Kruslin kundër Francës dhe Huvig kundër Francës, të përfshira në këtë botim si dhe Lambert kundër Francës.

<sup>161</sup> Shih Kopp kundër Zvicrës dhe Amann kundër Zvicrës.

<sup>162</sup> Interception of Communications Act, i vitit 1985.

4. Përpara Komisionit, i cili u mbledh më 16 tetor 1985 dhe 9 gusht 1984, z. Kruslin dhe bashkëshortët Huvig, denoncuan vënien nën përgjim të telefonave dhe dëgjimin e bisedave të tyre, në shkelje të nenit 8 të Konventës. Në mendimet e tij të 14 dhjetorit 1988, Komisioni formulon mendimin sipas të cilit ka pasur shkelje të nenit 8.

## II. Vendimet e Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

#### i. A ka ndërhyrje?

5. Duke konstatuar që përgjimet e ankmuara në çështjen në fjalë përbënin ndërhyrje të autoritetit publik në ushtrimin e të drejtës të të interesuarve për respektimin e paprekshmërisë së korrespondencës dhe të jetës së tyre private, Gjykata kërkoi, nga ana tjetër, nëse ndërhyrje të tilla mund të justifikoheshin në bazë të paragrafit të 2 të nenit 8.

#### ii. A është ndërhyrja e parashikuar në ligj?

6. Në radhë të parë, a ishin përgjimet «të parashikuara nga ligji»? Këto terma të fundit kërkojnë para së gjithash që masa ndaj së cilës ngrihet akuza të ketë një bazë ligjore në të drejtën e brendshme. Por nga ana tjetër ato kanë të bëjnë gjithashtu me cilësinë e ligjit në fjalë. Ato kërkojnë mundësinë e personit përkatës që t'i njohë ato, i cili për më tepër duhet të ketë mundësi të parashikojë pasojat për atë vetë, dhe se sa pajtohen ato masa me parimin e shtetit të së drejtës.

7. Pyetja për të kuptuar nëse kushti i parë ishte përmbushur, i la vend një debati. Ankuesit iu përgjigjën asaj në mënyrë negative. Sipas mendimit të qeverisë franceze, me “ligj” duhet kuptuar “e drejta në fuqi në një sistem juridik të dhënë”, dhe si rrjedhim në këtë rast konkret tërësia e përbërë nga e drejta e shkruar - kryesisht nenet 81, 151 dhe 152 të Kodit të Procedurës Penale - dhe nga jurisprudenca që i interpreton ato. Kurse relatori i caktuar nga Komisioni deklaronte që në rastin e vendeve kontinentale, ndër të cilët bën pjesë edhe Franca, veçse një akt normativ me efekt të përgjithshëm - i votuar ose jo nga Parlamenti - mund të konsiderohet si një “ligj” në kuptimin e nenit 8 § 2 të Konventës.

8. Gjykata kujtoi se u takon së pari autoriteteve shtetërore, dhe në mënyrë të veçantë gjykatave, që të interpretojnë dhe të zbatojnë të drejtën e brendshme. Nuk i përket pra asaj që të shprehë një opinion të kundërt me atë të tyre, në lidhje me pajtueshmërinë e përgjimeve të miratuara me vendim gjykate me nenin 368 të Kodit Penal. Qysh prej disa vjetësh, një sërë vendimesh, dhe në veçanti të Gjykatës së Kasacionit, ka vlerësuar se nenet 81, 151 dhe 152 të Kodit të Procedurës Penale përbënin bazën ligjore të përgjimeve të bëra nga oficerë të policisë gjyqësore, të ngarkuar me këtë detyrë posaçërisht nga një gjyqtar i hetimeve paraprake. Ajo çmoi se nuk mund të bënte abstraksion të një jurisprudencë të tillë, të qartësuar tashmë. Në fushën e paragrafit 2 të nenit 8 të Konventës dhe të klauzolave të tjera analoge me të, ajo e ka shtrirë gjithmonë kuptimin e termit “ligj”, në një konceptim të tijin material dhe jo formal, duke përfshirë në të edhe tekste të rangut nënligor, si dhe të drejtën e pashkruar. Si përfundim, ndërhyrjet që ishin bazë e gjykimit kishin një bazë ligjore në të drejtën franceze.

9. Kërkesa e dytë që del në pah nga kuptimi i shprehjes “i parashikuar nga ligji”, mundësinë për tu njohur me këtë të fundit pra, nuk nxirrte asnjë problem sipas Gjykatës.

10. Ajo u shpreh se nuk mund të thuhet e njëjta gjë në lidhje kërkesën e tretë - “mundësia e parashikimit” të ligjit përsa i përket kuptimit dhe natyrës së masave të zbatueshme. Gjykata bëri të qartë se përgjimet si dhe format e tjera të ndërhyrjes në bisedat telefonike përfaqësojnë një çenim të rëndë ndaj respektimit të jetës private dhe të korrespondencës. Për këtë arsye, ato do të duhej të bazoheshin në një “ligj” të një saktësie të veçantë. Ekzistenca e rregullave të qarta dhe të detajuara në këtë fushë duket e domosdoshme, duke pasur parasysh që edhe procedurat teknike që përdoren nuk rreshtin së perfeksionuari nga ana e tyre.

11. Qeveria pohoi se Gjykata nuk duhet të gjykonte në parim në lidhje me pajtueshmërisë e legjislacionit francez me Konventën, ashtu sikur të vendoste de lege ferenda<sup>163</sup>. Ajo parashtroi një listë prej shtatëmbëdhjetë garancish që do të gjenin zbatim në këtë rast sipas së drejtës së brendshme. Këto garanci kishin të bënin si me realizimin e përgjimeve, si me përdorimin e rezultatit të nxjerrë prej tyre, ashtu edhe me mjetet për të arritur vënien në vend të parregullsive të mundshme - dhe ankuesit nuk ishin privuar nga asnjëra prej tyre. Gjykata nuk minimizoi aspak vlerën e shumë prej këtyre garancive. Nga ana tjetër, ajo konstatoi që vetëm disa prej tyre dalin në pah nga kuptimi i vetë termave të neneve 81, 151 dhe 152 të Kodit të Procedurës Penale. Të tjerat zbuloheshin nga vendimet e dhëna gjatë viteve, në mënyrë të pjesshme, dhe në shumicën e tyre dërrmuese, pas kryerjes së përgjimeve konkrete për të cilat kërkuesit ankoheshin. Në këtë kuptim madje nuk e kishte sanksionuar qartë as jurisprudenca e deritanishme. Mbi të gjitha, sistemi nuk ofronte ende për momentin një mbikëqyrje të përshtatshme kundër abuzimeve të ndryshme për të cilat mund të dyshohet. Për shembull, asgjë nuk i përcaktonte kategoritë e personave të cilët mund të vireshin nën përgjim, as natyrën e shkeljeve që mund të gjenin vend aty; asgjë nuk e kufizonte gjyqtarin në lidhje me caktimin e një kufiri të kohëzgjatjes për vënien në zbatim të këtyre masave. Për më tepër, asgjë nuk saktësonte kushtet e krijimit të proces-verbaleve të përmbledhura të bisedave që ishin përgjuar, as masat parandaluese që duheshin marrë me qëllim që të përcilleshin të paprekura dhe të plota regjistrimet e realizuara për qëllimet e një kontrolli eventual nga ana e gjyqtarit - i cili nuk do të kishte aspak mundësi që të shkonte në vend për të verifikuar vetë numrin si dhe gjatësinë e shiritave magnetikë origjinalë - dhe nga ana e mbrojtjes gjithashtu. Së fundi, asgjë nuk përcaktonte as rrethanat në të cilat do të mundej ose do të duhej të procedohej me fshirjen ose me eliminimin e shiritave të përmendur më sipër, e nevojshme sidomos në rast pabazueshmërie ose pafajësie. Udhëzimet e dhëna nga ana e qeverisë në lidhje me këto pika nxirrnin më mirë në pah ekzistencën e një praktike të zhveshur nga një forcë detyruese në mungesë të një teksti normativ ose të jurisprudencës.

<sup>163</sup> De lege ferenda - nga latinishtja që do të thotë "bëj ligj", "ligjëroj".

12. Si përfundim, e drejta franceze, e shkruar ose jo e shkruar, nuk parashikonte me një qartësi të mjaftueshme shtrirjen dhe mënyrat e ushtrimit të vlerësimit nga ana e autoriteteve në fushën e marrë në konsideratë. Kjo gjë mund të thuhej edhe më me forcë në lidhje me kohën kur kishin ndodhur faktet e të dy çështjeve, për shkak se ankuesit nuk kishin gëzuar asnjë shkallë minimale të mbrojtjes të kërkuar nga parimi i shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike. Në këto kushte Gjykata arriti njëzëri në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

13. Ky përfundim e shkarkoi Gjykatën nga detyrimi për shqyrtim në lidhje me respektimin e kërkesave të tjera të parashikuara nga paragrafi 2 i nenit 8, domethënë qëllimi dhe nevoja e vënies në jetë të ndërhyrjes së lartpërmendur.

### ***B. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)***

14. Duke u mbështetur në nenin 50, z. Kruslin pretendonte një shpërblim prej 1 000 000 frangash franceze për shkak të dënimit të tij me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie, si dhe rimbursimin e 70 000 Franga Franceze të shpenzuara për pagesa dhe honorar avokatie gjatë procedurave të brendshme. Gjykata hodhi poshtë kërkesën e tij të parë sepse konstatimi i shkeljes i ofron kërkuar një shpërblim mjaftueshmërisht të barasvlershëm me dëmin e shkaktuar. Ajo, nga ana tjetër, pranoi pjesërisht kërkesën e dytë, duke e detyruar Francën që të paguajë shumën prej 20 000 FF të nevojshme për një procedurë në Gjykatën e Kasacionit.

15. Bashkëshortët Huvig nuk pretenduan as reparacion dhe as rimbursim të pagesave dhe të shpenzimeve. Duke qenë se kjo çështje nuk shtronte nevojën e një shqyrtimi kryesisht, Gjykata vendosi që nuk ka vend për zbatimin e nenit 50.

### **III. Koment**

16. Dy vendimet në lidhje me dy çështjet e lartpërmendura, të dhëna të dyja në të njëjtën ditë për shkak të ngjashmërisë së fakteve dhe të problemeve që shtrinin, marrin në shqyrtim garancitë që ofron legjislacioni francez në lidhje me përgjimet telefonike. Duke shkuar më tej se vendimi i mëparshëm i Gjykatës në lidhje me çështjen *Klass kundër Gjermanisë*, Gjykata bën një analizë të kujdesshme të elementëve përbërës të paragrafit 2 të nenit 8. Pasi fillon të përdorë me radhë elementët e listës së kërkesave të paragrafit 2 të nenit 8 për justifikimin e një ndërhyrjeje ndaj së drejtës për jetë private, Gjykata ndalet në elementin ligj duke ofruar një analizë tepër interesante të këtij termi sipas kuptimit të Konventës. Ajo e pranoi faktin se, edhe në Francë si një vend tradicional i sistemit të civil law, jurisprudenca e gjykatave dhe sidomos e Gjykatës së Kasacionit mund të konsiderohet si pjesë përbërëse e termit “ligj” për qëllimet e Konventës, i marrë ky në kuptimin material dhe jo vetëm formal. Por pavarësisht nga vlera e këtij pohimi, me rëndësi edhe për situatën shqiptare, Gjykata analizon elementët që duhet të përmbushë termi ligj që të arrijë të plotësojë kërkesat e Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut. Duke vlerësuar se përgjimi i telefonatave të një personi përbën një ndërhyrje serioze në të drejtën e tij për jetë private Gjykata thekson se ligji që e parashikon këtë ndërhyrje duhet të jetë veçanërisht i saktë dhe



i qartë<sup>164</sup>. Pikërisht duke analizuar këta elementë përcaktues të termit ligj, në rastin konkret Gjykata arriti në përfundimin se jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit nuk përmbushte kërkesat e Konventës në lidhje me saktësinë dhe qartësinë e ligjit.

17. Këto vendime të Gjykatës ofrojnë një guidë të vlefshme të momenteve që legjislacioni i vendeve anëtare të Konventës në lidhje me përgjimet telefonike duhet të plotësojë që të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 8 § 2 të Konventës. Franca u detyrua në këtë kuadër të miratojë Ligjin nr. 91-646 i 10 korrikut 1991 në lidhje me karakterin sekret të korrespondencave të dërguara në rrugë telekomunikacioni i cili është botuar në Gazetën Zyrtare të 13 korrikut 1991. Ai shtoi një nen 100 në Kodin e Procedurës Penale, që ka të bëjë me ndërhyrjet e urdhëruara nga autoriteti gjyqësor. Në fakt Franca u dënua në vijim nga Gjykata edhe në çështje të tjera në lidhje me përgjimin e telefonave pikërisht se nuk kishte arritur të parashikonte ndërhyrjet me saktësinë e duhur ligjore<sup>165</sup>. Parashikimi sa më i saktë dhe i hollësishëm që të ishte i mundur mund të përbënte një bazë të mirë për të besuar se nuk kemi shkelje të nenit 8 të Konventës, por pa harruar gjithsesi elementët vijues të testit të paragrafit 2 të këtij neni që kanë të bëjnë me konceptet e "shoqërisë demokratike", "karakterit të nevojshëm" dhe "proporcionalitetit".

## P.G. DHE J.H. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 44787/98)

25 shtator 2001

*përgjimet e paligjshme në kuadrin e një hetimi përveçse mund të përbëjnë shkelje të së drejtës për jetë private mund edhe të shkelin të drejtën për një proces të drejtë*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit janë të dy shtetas britanikë. Më 28 shkurt 1998, oficeri i policisë D.I. Mann ka marrë një informacion sipas të cilit më ose rreth 2 marsit 1995, nga ana e kërkuesit të parë dhe e B. do të kryhej një pengmarrje me armë, e një polici të bankës që transferonte valutë. Kjo pengmarrje sipas informatës mund të ndodhte në disa vende të mundshme. Në të njëjtën ditë filloi mbikëqyrja e shtëpisë së B. Sidoqoftë nuk ndodhi asnjë pengmarrje.

2. Më 3 mars 1995 policia u informua se pengmarrja do të ndodhte rreth 9 marsit 1995. Me qëllim që të merrte detaje më të plota, D.I. Mann përgatiti një raport duke kërkuar një autorizim për instalimin e një aparature përgjimi në apartamentin e B. Më 4 mars 1995 Shefi i Rajonit të Policisë dha një autorizim me gojë dhe përgjuesi

<sup>164</sup> Shih sidomos paragrafët 33 deri 35 të vendimit.

<sup>165</sup> Shih vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet A. kundër Francës dhe Lambert kundër Francës.

u instalua në divanin që ndodhej në apartamentin e B. Më 8 mars 1995 zv. Shefi i Rajonit të Policisë dha një autorizim me shkrim me efekt prapaveprues. Më 14 mars 1995 policia kërkoi referencat nga faturat për të gjitha thirrjet telefonike nga telefoni i apartamentit të B. Më 15 mars 1995, B dhe të tjerë që ishin me të në shtëpinë e tij zbuluan përgjuesin dhe i shkëputën lidhjet e tij. Pengmarrja nuk u krye. Kërkuesit u arrestuan më 16 mars 1995 në një makinë të vjedhur ku kishte dy kapuçë të zinj, pesë kablllo lidhëse të zeza plastike, dy palë dorashka lëkure, dhe dy këllëfë armësh.

3. Përderisa preferuan të kishin regjistrime zanore për qëllime krahasimi të kasetave të regjistruara nga përgjuesi që ishte vënë në shtëpi, policia kërkoi një autorizim për të përdorur përgjues në qelitë e kërkuesve si dhe nga oficerët e policisë që do të ishin të pranishëm në momentet kur kërkuesve do t'u paraqitej akuza. Një autorizimi me shkrim u dha për këtë qëllim nga Shefi i Rajonit të Policisë dhe në vijim, u regjistruan biseda të kërkuesve pa dijeninë apo lejen e tyre. Një ekspert arriti në përfundimin se në kasetat e regjistruara "kishte të ngjarë" që të ishte zëri i kërkuesit të parë dhe "kishte shumë të ngjarë" që të ishte zëri i kërkuesit të dytë.

4. B dhe kërkuesit u akuzuan për marrëveshje me qëllim kryerje pengmarrjeje. Gjatë procesit në ngarkim të tyre, provat e marra nga përdorimi i përgjuesve u konsideruan të pranueshme dhe disa dokumente, përfshirë edhe pjesë të raportit të D.I. Mann nuk iu dhanë kërkuesve dhe as avokatëve të tyre. Më 9 gusht 1995, kërkuesit u gjetën fajtorë për marrëveshje me qëllim kryerje pengmarrjeje dhe u dënuan me 15 vjet burg. Kërkesa e tyre për lirim në Gjykatën e Apelit u hodh poshtë.

5. Kërkuesit u ankuan, duke u bazuar në nenin 8 të Konventës, në lidhje me përdorimin e përgjuesve për të mbikëqyrur dhe regjistruar bisedat e tyre në apartamentin e B-së, në lidhje me përgjimin e telefonatave që bëheshin nga telefoni i B-së dhe për përdorimin e përgjuesve për të marrë prova të zërave kur ata ishin në stacionin e policisë. Duke u bazuar në nenin 6 § 1, ata u ankuan që një pjesë e provave që ishin përdorur ndaj tyre dhe që kishte të bënte me autorizimin e vënies së përgjuesve nuk i ishte bërë e njohur mbrojtjes gjatë procesit, që një pjesë e dëshmive gojore ishte dëgjuar vetëm përpara gjyqtarit dhe se informacionet e marra nga përgjuesit në apartamentin e B-së dhe provat e zërave ishin përdorur si prova në proces. Ata bazoheshin gjithashtu në nenin 13 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

6. Duke pasur parasysh që edhe qeveria britanike kishte pranuar që mbikëqyrja nga ana e policisë të apartamentit të B-së nuk ishte në përputhje me ligjin ekzistues në kohën e zhvillimit të ngjarjeve, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8 në lidhje me këtë moment.

7. Informacioni në lidhje me përdorimin e telefonit të B-së ishte marrë dhe ishte përdorur në kontekstin e një hetimi dhe gjykimi në lidhje me një marrëveshje të dyshuar

për kryerjen e një pengmarrje me armë. Gjykata konstatoi se kjo masë ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Pra, nuk ka pasur shkelje të nenit 8 në këtë drejtim.

8. Në kohën e zhvillimit të ngjarjeve nuk kishte ndonjë sistem ligjor që të rregullonte përdorimin e përgjuesve nga ana e policisë me nismën e vetë asaj dhe për këtë arsye Gjykata konstatoi se ndërhyrja në të drejtën e kërkuesit për një jetë private nuk ka qenë në përputhje me ligjin. Pra ka pasur në këtë drejtim shkelje të nenit 8.

**B. Në lidhje me nenin 6 § 1**

9. Gjykata u kënaq me faktin që mbrojtja ishin vënë në dijeni dhe ishte lejuar të ngrinte pretendimet e veta si dhe të merrte pjesë në procesin e vendimmarrjes sa më tepër që ishte e mundur, pa i bërë asaj të njohur vetëm materiale të cilat akuza preferoi t'i mbante sekret për arsye të interesit publik. Pyetjet që mbrojtja kishte pretenduar t'ia bënte D.I. Mann iu bënë këtij nga gjyqtari me dyer të mbyllura. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se materiali që nuk ishte bërë publik në këtë rast nuk bënte pjesë në dosjen e akuzës dhe se nuk iu paraqit fare jurisë. Fakti që nevoja për bërjen publike të të dhënave iu nënshtrua gjithmonë vlerësimit të gjyqtarit të çështjes ofronte një garanci tjetër të rëndësishme në kuadrin e detyrës së tij për të mbikëqyruar gjatë të gjithë procesit karakterin e barabartë të këtij, pra edhe provat që nuk bëhen publike. Si përfundim, Gjykata konstatoi se, brenda mundësive, procedura gjyqësore kishte qenë në përputhje me kërkesat e parimit të një procesi me palë kundërshtare dhe se barazia e mjeteve dhe me garanci të tjera që bëjnë pjesë në të për mbrojtjen e interesave të të akuzuarit. Si rrjedhojë pra nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në këtë drejtim.

10. Gjykata vuri në dukje se provat e regjistruara nuk ishin të vetmet që ishin paraqitur në proces kundër kërkuesve. Për më tepër, ata kishin pasur një mundësi të gjerë për të kundërshtuar autenticitetin dhe përdorimin e këtyre regjistrimeve. Ishte e qartë që, nga ana tjetër, nëse gjykatat e brendshme do të kishin qenë të mendimit që pranimi i këtyre provave do t'i kishte lënë vend një pabarazie thelbësore të procesit, ato do kishin vendosur për të mos i pranuar ato. Gjykata në vijim vlerësoi se nuk kishte pabarazi në lënien e vlerësimit të peshës së këtyre provave jurisë, mbi bazën e një parashtrimi të bërë nga gjyqtari. Në lidhje me ankimin e kërkuesve përse i përket mënyrës në të cilën provat e zërit ishin marrë duke shkelur të drejtën e tyre për të mos u vetëakuzuar, Gjykata vlerësoi se këto prova të zërit, të cilat nuk përfshinin asnjë deklaratë në lidhje me fajësimin, mund të vlerësohen edhe si analizat e gjakut, të flokëve ose të elementëve të tjerë fizikë dhe objektivë të përdorur në analizat ligjore, ndaj të cilave kjo e drejtë nuk gjente zbatim. Ajo arriti pra në përfundimin se nuk kishte shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

**C. Në lidhje me nenin 13**

11. Gjykata vuri në dukje se gjykatat e brendshme nuk kishin qenë në gjendje të ofronin mjet efektiv në vetvete për shkak se nuk e kishin vlerësuar ankimin e ndërhyrjes ndaj të drejtës së kërkuesve për respektim të së drejtës private të kërkuesve e cila ishte jo në përputhje me ligjin dhe as nuk i kishin kushtuar vëmendjen e nevojshme këtij ankimi në kuadrin e procesit. Gjykata konstatoi në vijim se sistemi i hetimit të

ankimit nuk përmbushte standardet e pavarësisë të nevojshme për të përbërë një mbrojtje të mjaftueshme ndaj abuzimeve të autoriteteve duke përbërë kështu një mjet efektiv në kuptimin e nenit 13 të Konventës. Ajo arriti pra në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

#### *D. Në lidhje me nenin 41*

12. Gjykata i akordoi secilit prej kërkuesve 1 000 sterlina për dëm jomaterial dhe një shumë të përgjithshme prej 12 000 për shpenzime dhe pagesa.

### **III. Koment**

13. Siç është thënë në shumë herë më parë, shtetet në bazë të Konventës kanë detyrime me karakter pozitiv për të parandaluar, hetuar dhe ndjekur të gjitha veprat penale në mënyrë efektive. Të drejtat e personave që akuzohen për vepra të tilla duhet të jenë gjithmonë në balancë me detyrimet pozitive të lartpërmendura. Masat që merren në kuadrin e hetimit të një krimi dhe që përbëjnë ndërhyrje në jetën private të një personi janë përgjithësisht të pranueshme, për aq kohë sa ato janë të parashikuara nga një ligj i cili është “i saktë dhe i kuptueshëm” dhe janë në proporcion me qëllimin që duan të ndjekin.

14. Në këtë çështje kishte shkelje të nenit 8 për shkak se policia kishte përdorur përgjues, gjë e cila nuk ishte autorizuar nga një kuadër i posaçëm ligjor. Në qoftë se një masë përbën ndërhyrje ndaj të drejtave të parashikuara në nenin 8 dhe nuk ka një autorizim të qartë për këtë masë në bazë të së drejtës së brendshme, në një rast të tillë ka në mënyrë automatike shkelje të Konventës. Në këtë rast do të ishte e parëndësishme ndjekja e qëllimit legjitim, si për shembull hetimi ose parandalimi i krimit.

15. Pasi konstatoi se provat ishin marrë në kundërshtim me Konventën, Gjykata shkoi më tej për të vlerësuar se çfarë pasojash këto prova kishin pasur duke qenë përdorur në proces. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut arriti në përfundimin se ajo nuk kishte një juridiksion të përgjithshëm për të vendosur se çfarë provash duhet të jenë të pranueshme nga ana e gjykatave të brendshme edhe kur këto prova janë marrë në kundërshtim me Konventën<sup>166</sup>. Rrethanat e vetme në të cilat Gjykata do të marrë në shqyrtim pranueshmërinë e provave në kuadrin e nenit 6 janë ato në rastet e kurtheve nga agjentë sekretë provokues përderisa këto raste ngrenë çështje të mbrojtjes ndaj vetëakuzimit. Me këtë çështje Gjykata ka shtuar edhe regjistrimin e fshehtë të zërit në listën e elementëve objektivë të përdorur në analizat juridike, siç janë dhe gjaku dhe flokët. Përdorimi i këtyre elementëve nuk është konsideruar të përbëjë shkelje të së drejtës për të mos u vetë-akuzuar. Natyrisht që duhet theksuar në këtë kuadër që provat e marra me anë të përdorimit të torturës janë tërësisht të papranueshme, siç parashikohet shprehimisht edhe nga Konventa e O.K.B.-së kundër Torturës<sup>167</sup>.

<sup>166</sup> Shih gjithashtu në lidhje me këtë qëndrim vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i 12 majit 2000.

<sup>167</sup> Republika e Shqipërisë është palë në këtë Konventë.

## MARCKX kundër BELGJIKËS

(kërkesa nr. 6833/74)

13 qershor 1979

*ky vendim përpunon nocionin e familjes për qëllimet e Konventës që pranon një status të barabartë të fëmijëve të lindur jashtë martese me fëmijët e lindur brenda martese*

### I. Faktet kryesore

1. Aleksandra Marckx lindi më 16 tetor 1973 në Wilrijk pranë Antverp. Ajo është vajza e Paula Marckx, shtetase belge, beqare dhe me profesion gazetare. Më 29 tetor 1973, në përputhje me nenin 334 Kodit Civil Belg, e ëma e Aleksandrës e njohu atë ligjërisht. Një ditë më pas, më 30 tetor 1974, nëna adoptoi vajzën e saj sipas nenit 349 të Kodit Civil. Procedura u mbyll më 18 prill 1975, por pasojat e veprimit lindën që në datën e depozitimit të kërkesës për adoptim.

2. Sipas ligjit Belg, një nënë e pamartuar mund ta vendoste birësimin vetëm me njohje, ndërsa birësimi i një fëmijë "të ligjshëm" përcaktohej thjesht nga lindja. Fëmija i paligjshëm që ishte njohur ose adoptuar nga nëna e tij në parim konsiderohej se ishte jashtë familjes të së ëmës. Për më tepër, përta i përket trashëgimisë ligjore, në mungesë testamenti, Kodi Civil Belg kufizonte në shkallë të ndryshme të drejtën e fëmijës së "paligjshëm" dhe të nënës beqare në krahasim me të drejtat që gëzojnë fëmija "legjitim" dhe nëna e tij. Më 15 shkurt 1978, Qeveria Belge paraqiti përpara Senatit një Deklaratë e cila kërkonte të vendoste me ligj barazinë midis fëmijëve.

3. Përpara Komisionit, kërkueset pretenduan se dispozitat në fjalë shkelnin të drejtën e respektimit të jetës familjare, se këto dispozita përbënin një diskriminim të ndaluar nga neni 14 midis fëmijëve "të ligjshëm" dhe "të paligjshëm" ashtu si midis nënave të martuara dhe të pamartuara, dhe se kërkueset ishin viktime të një trajtimi degradues në shkelje të nenit 3. Ata pretenduan gjithashtu se neni 1 i Protokollit nr. 1 ishte shkelur për shkak se një nënë e pamartuar nuk mund të vendoste lirisht për pasurinë e saj në favor të fëmijës së saj. Për më tepër, Komisioni vendosi me propozimin e tij vlerësimin e çështjes në bazë të nenit 12 i cili parashikon të drejtën për t'u martuar dhe krijuar familje. Në raportin e tij të 10 dhjetorit 1977, Komisioni shprehu mendimin se legjislacioni i kundërshtuar nga kërkueset shkelte nenin 8 të Konventës të marrë në vetvete dhe në lidhje me nenin 14, si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të marrë së bashku me nenin 14, në bazë të kërkesës së Paula Marckx. Nga ana tjetër, Komisioni njëzëri nuk e konsideroi të nevojshëm shqyrtimin e çështjes në lidhje me nenin 3 të Konventës dhe arriti në përfundimin se neni 12 nuk lidhet me çështjen.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 8

4. Së pari, Gjykata vuri re se procedurat kishin lidhje kryesisht me nenin 8 dhe 14 të Konventës. Përpara se të vlerësonte aspektet e ndryshme të rastit duke u bazuar mbi këto nene, Gjykata nënvizoi se neni 8 gjen zbatim në “jetën familjare të familjes së paligjshme”. Për më tepër sipas Gjykatës, e drejta për respektimin e jetës familjare do të thotë midis të tjerave se një shtet, kur përcakton regjimin e zbatueshëm për disa familje, duhet të veprojë në mënyrë që t'i lejojë ato të bëjnë një jetë familjare normale. Duke vepruar kështu kundrejt nënës së pamartuar dhe fëmijës së saj, shteti duhet të shmangë çdo diskriminim bazuar në lindjen.

### B. Në lidhje me themelin e nenit 8 - mënyra e përcaktimit të lidhjes amësore

5. Në lidhje me Paula Marckx Gjykata vlerësoi se domosdoshmëria për të njohur vajzën e saj Aleksandra me qëllim për të vendosur birësimin vjen nga refuzimi për të pranuar mëmësinë që nga momenti i lindjes. Gjykata tërhoqi vëmendjen për disa pasoja problematike që rrjedhin nga kjo njohje për disponimin e pasurisë. Nëse nëna e pamartuar njihje fëmijën e saj, ajo në të njëjtën kohë do ta dëmtonte atë përderisa sipas Kodit Civil Belg, mundësia e saj për t'i dhuruar ose trashëguar pasurinë e saj fëmijës të paligjshëm ishte e kufizuar. Në qoftë se ajo dëshironte ta ruante mundësinë për të zgjedhur në favor të fëmijës së saj, ajo do të detyrohej të hiqte dorë nga birësimi. Sipas Gjykatës kjo dilemë në të cilën ndodhet nëna nuk përputhet me respektimin e jetës familjare. Gjykata arriti në të njëjtin përfundim lidhur me çështjen e Aleksandra Marckx, përderisa ajo konsiderohej nga ligji pa nënë, që nga lindja deri në njohjen e amësisë. Si rrjedhim Gjykata vendosi se neni 8 ishte shkelur në rastet e të dy kërkueseve.

### C. Në lidhje me nenin 14 të marrë së bashku me nenin 8

6. Më pas, Gjykata vlerësoi nëse Paula dhe/ose Aleksandra kishin qenë ose jo viktimat të një diskriminimi në shkellje të nenit 14 të marrë së bashku me nenin 8. Në vendimin e Gjykatës, fakti se disa nëna të pamartuara nuk dëshirojnë të kujdesen për fëmijët e tyre nuk mund të justifikojë ligjin Belg me anë të cilit vendosja e mëmësisë është e kushtëzuar përveç të tjerave, nga njohja vullnetare. Për më tepër, interesi i një fëmije “të paligjshëm” për të pasur një lidhje të tillë nuk është më i pakët se ai i një fëmije të “ligjshëm”.

7. Duke njohur si legjitim ose të lavdërueshëm qëllimin e ndjekur nga legjislacioni belg - sidomos mbrojtjen e fëmijës dhe familjes tradicionale -, Gjykata thekson se nuk duhet të merren masa të tilla që do të dëmtonin familjen e “paligjshme”. Së fundi, në përgjigje të një argumenti të paraqitur nga Qeveria, Gjykata pranoi se në kohën e hartimit të Konventës, u konsiderua i lejueshëm dhe i pranueshëm dallimi midis familjes së “paligjshme” dhe të “ligjshme”. Sidoqoftë, Gjykata rikujtoi se Konventa duhet të interpretohet nën dritën e kushteve aktuale; ajo nuk mund të përjashtohet nga evolucioni i legjislacionit të shumicës së shteteve palë të Këshillit të Evropës që shkon drejt barazisë midis fëmijëve “të ligjshëm” dhe “jo të ligjshëm” në



lidhje me çështjen në fjalë. Ajo nënvizon gjithashtu, që sipas motiveve të ekspozuara në projekt-ligj të paraqitur më 15 shkurt 1978 përpara Senatit, juristët dhe opinionioni publik janë gjithnjë e më shumë të bindur që duhet t'i jepet fund diskriminimit mbi fëmijët e "paligjshëm". Gjykata arriti në përfundimin se dallimi në fjalë nuk justifikohet objektivisht dhe shkelte në të dy rastet nenin 14 të konsideruar së bashku me nenin 8.

#### *D. Pasojat juridike të "familjes" për Aleksandra Marckx*

8. Gjykata konsideroi se "jeta familjare" sipas kuptimit të nenit 8 përfshin të paktën lidhjet midis kushërinjve të afërt dhe ky "respektim" për jetën familjare përbën një detyrim për shtetin i cili duhet të marrë masat me qëllim që këto marrëdhënie të zhvillohen normalisht. Por zhvillimi i jetës familjare të një nëne beqare dhe të fëmijës së saj të cilin ajo e ka njohur mund të pengohet në qoftë se fëmija nuk bëhet një anëtar i familjes së saj dhe nëse vendosja e lidhjes nuk ka pasoja përveçse midis tyre. Gjykata nuk gjeti asnjë justifikim për dallimin midis shtrirjes së marrëdhënieve të familjes së Aleksandrës dhe atyre të një fëmije "të ligjshëm". Si rrjedhim, ajo vendosi se neni 8 i konsideruar në vete dhe së bashku me nenin 14 ishin shkelur.

#### *E. Pretendimi për të drejtat pasurore*

9. Gjykata pranoi se neni 1 i Protokollit 1 që mishëron të drejtën e secilit për respektimin e pasurisë së tij, nuk e garanton të drejtën për të marrë pasuri me anë të trashëgimisë apo shprehjes së një vullneti me pasoja juridike pasurore. Përsa i përket Aleksandra Marckx kjo e drejtë sipas Gjykatës gjen vend vetëm në terrenin e nenit 8 të Konventës: fusha e trashëgimisë dhe e dhurimit midis të afërmeve i bashkëngjitet jetës familjare. Pra jeta familjare nuk përfshin vetëm marrëdhëniet me karakter shoqëror, moral ose kulturor por edhe interesa materiale. Sipas Gjykatës, neni 8 nuk kërkon që një fëmijë të ketë të drejtë për të marrë një pjesë të trashëgimisë të prindërve ose të të afërmeve të tij. Kufizimet e bëra nga Kodi Civil për trashëgiminë e Aleksandra Marckx nuk e shkelnin këtë nen në vetvete pavarësisht nga motivet e frymëzimit të tyre. Dhurimet duheshin analizuar sipas të njëjtës mënyrë. Por nga ana tjetër, Gjykata vlerësoi se dallimi i bërë në këtë fushë midis fëmijëve "të ligjshëm" dhe atyre "të paligjshëm" nuk justifikohet në mënyrë objektive dhe të arsyeshme. Pra, Aleksandra Marckx i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga neni 14 i kombinuar me nenin 8, për shkak të kufizimeve të aftësisë së saj për të marrë të mira nga nëna e saj dhe të pamundësisë për të trashëguar nga të afërmit e saj nga ana e nënës.

10. Përsa i përket Paula Marckx, Gjykata nënvizoi se neni 8 nuk i garanton një nëne lirinë absolute për t'i dhuruar ose trashëguar pasurinë e saj fëmijës. Përkundrazi ajo vlerësoi që dallimi i bërë midis nënave beqare dhe të martuara nuk justifikohet objektivisht dhe në mënyrë të arsyeshme dhe shkelte, në lidhje me Paula Marckx, nenin 14 të marrë së bashku me nenin 8.

11. Gjithashtu, Gjykata analizoi problemin nën dritën e nenit 1 të Protokollit 1, i cili garanton të drejtën e pronës, "një aspekt tradicional dhe themelor të saj" që është e drejta e secilit të disponojë pasurinë e tij. Megjithatë, Gjykata vuri re se interesi

i përgjithshëm në disa raste mund ta bëjë legjislatorin të rregullojë përdorimin e pasurisë në fushën e dhurimeve, Gjykata konsideroi se kufizimi i kundërshtuar nga Paula Marckx nuk shkelte nenin 1 të Protokollit 1. Në të kundërt, meqenëse ai vlente vetëm për nënat beqare dhe jo për gratë e martuara, dhe që ky dallim nuk justifikohet në mënyrë objektive dhe të arsyeshme, nenin 14 i kombinuar me nenin 1 Protokollit 1 janë shkelur në rastin e Paula Marckx.

#### **F. Në lidhje me nenet 3 dhe 12**

12. Gjykata nuk gjeti shkelje të neneve 3 dhe 12 të Konventës.

#### **G. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)**

13. Avokati që përfaqësoi kërkueset përpara Komisionit në bazë të nenit 50 i kishte kërkuar Gjykatës që kjo t'i akordonte secilës prej kërkueseve një frangë belge si kompensim simbolik për dëmin moral. Gjykata konsideroi se në rrethanat e rastit, nuk ishte e nevojshme t'u jepej kërkuesve tjetër gjë, përveç atyre që rezultinin nga shkeljet e të drejtave të tyre.

### **III. Koment**

14. Vendimi në fjalë përpiket të shmangë një boshllëk të dispozitës së nenit 8 të Konventës e cila ndoshta jo pa qëllim është formuluar në këtë mënyrë për të reflektuar ndryshimet në konceptimin evropian të nocionit “familje”. Për një kohë të gjatë Komisioni dhe Gjykata janë bazuar në konceptimin tradicional të familjes – pra të asaj biologjike dhe për këtë qëllim merrnin për bazë kryesisht të drejtën e brendshme dhe konceptimin e saj në lidhje me këtë nocion. Ishte Komisioni i pari ai që u shpreh se nocioni i familjes sipas Konventës ishte një nocion autonom dhe nuk mund t'i nënshtrohej përcaktimeve juridike nacionale. Në këtë kuadër ai u shpreh se ky nocion nuk mund të bazohej më vetëm në lidhje martesore dhe mund të vazhdonte edhe pas prishjes së kësaj lidhjeje, duke u përpjekur të fshijë dallimin ndërmjet familjes së ligjshme dhe asaj të paligjshme<sup>168</sup>. Ishte ky mendim që u formalizua në mënyrë më të plotë dhe më të përpunuar me vendimin e Gjykatës që po komentojmë.

15. Gjykata pranon se neni 8 nuk bën dallim ndërmjet familjes së ligjshme dhe asaj të paligjshme pasi një dallim i tillë nuk do të përputhej me termin “çdokush” dhe se mund të lindnin probleme edhe në kuadrin e veprimit të nenit 14 të Konventës. Nga ana tjetër Gjykata i referohet qëndrimit të Komitetit të Ministrave i cili me Rezolutën 70 (15) e konsideron një grua dhe fëmijën e saj si përbërës të një familje aspak të ndryshme nga të tjerat. Madje ajo shkon deri aty sa pranon se brenda konceptit të familjes përfshihen edhe marrëdhëniet me të afërmit e një rrethi të ngushtë, si gjyshërit me nipërit, pasi këta persona mund të kenë një rol të veçantë në jetën familjare të njëri tjetrit.

<sup>168</sup> Mendim i Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut i 15 dhjetorit 1985 në lidhje me kërkesën nr. 9639/82.

16. Vendimi nxjerr në pah gjithashtu faktin se shtetet anëtare duhet të adoptojnë një legjislacion i cili duhet t'i mundësojë fëmijës që nga momenti i lindjes një jetesë brenda familjes. Në rast të kundërt, sipas Gjykatës, do të kishim shkelje të paragrafit 1 të nenit 8 pa pasur nevojë për një analizë të paragrafit 2 të këtij neni. Kodi Civil belg i vitit 1804 dukej se në këtë rast nuk i përgjigjej këtyre kërkesave në lidhje me fëmijët e lindur jashtë martesë. Ky detyrim madje sipas Gjykatës shtrihej edhe deri në marrëdhëniet pasurore të cilat nuk duhet të lejonin që të kishte një diskriminim të fëmijës së paligjshëm në raport me fëmijën e ligjshëm. Është tepër interesant të shihet, në vijim të këtij vendimi dhe në kuadër të efektit të tij apo të jurisprudencës së Gjykatës në përgjithësi, vendimi i saj i 29 nëntorit 1991 në lidhje me çështjen *Vermeire kundër Belgjikës*. Në këtë çështje Gjykata shprehet në thelb se autoritetet belge duhet të kishin interpretuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në sistemin e brendshëm nenet 8 dhe 14 të Konventës, ashtu siç interpretohen prej saj në çështjen *Marckx*.

## SAHIN kundër GJERMANISË, SOMMERFELD kundër GJERMANISË DHE HOFFMAN kundër GJERMANISË

(kërkesat nr. 30943/96, nr. 31871/96 dhe nr. 34045/96)

11 tetor 2001

*e drejta e një babai me fëmijë të lindur jashtë martesës për të kontaktuar me fëmijën e tij është e drejtë që garantohet nga neni 8 i Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Asim Sahin, Menfred Sommerfeld dhe Friedhelm Hoffman janë të gjithë shtetas gjermanë. Z. Sahin ishte shtetas turk në kohën e zhvillimit të ngjarjeve për të cilat ai po ankohet por në vijim ai mori shtetësinë gjermane. Të tre këta persona kanë fëmijë të lindur jashtë martesës dhe në lidhje me këta fëmijë atyre iu mohua e drejta për t'iu drejtuar gjykatave gjermane.

2. Kërkuesit ankoheshin se vendimet e gjykatave gjermane për të mos pranuar kërkesat që ata kishin bërë për të takuar fëmijët e tyre shkelnin nenin 8 të Konventës. Ata ankoheshin gjithashtu për diskriminim, duke u bazuar në nenin 14 të marrë së bashku me nenin 8. Z. Sommerfeld dhe z. Hoffman ankoheshin gjithashtu për mohim të së drejtës për të pasur një gjykim të drejtë duke u bazuar në nenin 6 të Konventës.

### II. Vendimet e Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 8

i. Përsa i përket çështjes Sahin kundër Gjermanisë

3. Gjykatat kompetente gjermane, duke i refuzuar z. Sahin kërkesën për të pasur mundësi të takohet me fëmijën e vet, u bazuan në deklaratat e bëra nga kërkuesi, nëna e

fëmijës dhe nga dëshmitarë si dhe në komentet e Zyrës së Fëmijëve të Wiesbaden dhe të këshillave të një eksperti. Këta kishin mbajtur parasysh marrëdhëniet jonormale ndërmjet prindërve dhe kishin konstatuar që kontaktet nuk do të ishin në interes të fëmijës.

4. Gjykata nuk vuri në dyshim që arsyet ishin të rëndësishme. Megjithatë, sipas mendimit të saj, mosdëgjimi nga ana e gjykatave gjermane të fëmijës nxori në pah se kërkuesi nuk ishte përfshirë aq sa duhej në procedurat gjyqësore. Ishte themelore që gjykatat kompetente të jepnin një vlerësim të kujdesshëm të asaj që ishte në interesin më të mirë të fëmijës pasi të kishin pasur kontakt të drejtpërdrejtë me të. Gjykata e Apelit nuk duhet të kishte qenë mjaftuar me deklaratat e vagëta të ekspertit në lidhje me rrezikun që ekzistonte në qoftë se pyetjet fëmija, pa marrë parasysh as mundësinë e vlerësimit të procedurave të veçanta të pyetjes së tij duke pasur parasysh moshën e tij të vogël. Një informacion i saktë dhe i plotë në lidhje me marrëdhënien e fëmijës me kërkuesin, si prindi që kërkonte të kishte kontakte me të, ishte një kusht i domosdoshëm paraprak për vlerësimin e dëshirave reale të fëmijës. Vetëm në këtë mënyrë mund të vihejshin në një balancë të drejtë interesat që ishin në lojë në këtë rast. Për këto arsye Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës.

*ii. Përsa i përket çështjes Sommerfeld kundër Gjermanisë*

5. Gjykata vuri në dukje se Gjykata e Rrethit, duke refuzuar kërkesën e z. Sommerfeld për mundësi vizitash fëmijës së tij, u bazua në deklaratat e bëra nga fëmija, i pyetur nga ana e Gjykatës së Rrethit më 1994 në moshën 13 vjeçare si dhe, në një proces të mëparshëm për të njëjtin qëllim, në moshën 10 vjeçare. Ajo kishte pyetur gjithashtu kërkuesin si dhe nënën e fëmijës. Duke vlerësuar gjithashtu komentet e bëra nga ana e Zyrës për Fëmijët dhe materialet e marra gjatë fazës së parë të procedurave në lidhje me mundësitë e takimit, Gjykata e Rrethit konstatoi se kontaktet nuk ishin në interes të fëmijës. Gjykata e Apelit veçse la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit duke u bazuar në të njëjtat argumente.

6. Gjykata vuri në dukje se Gjykata e Rrethit e kishte dëgjuar fëmijën dhe prindërit dhe e kishte mbajtur parasysh dosjen e krijuar në një çështje të mëparshme me të njëjtin objekt, duke përfshirë edhe komentet e bëra nga një psikolog dhe shërbimet shëndetësore në prill 1992. Gjykata vlerësoi se, pasur parasysh deklaratat paksa sipërfaqësore të psikologut në çështjen e parë, duke pasur parasysh kalimin e kohës si dhe objektin e çështjes, sidomos marrëdhënien ndërmjet një babai dhe fëmijës së tij, Gjykata e Rrethit nuk duhet të kishte qenë kënaqur vetëm me dëgjimin e dëshirave të fëmijës në lidhje me këtë çështje pa pasur në dispozicion prova nga ana e një eksperti psikolog, me qëllim që të vlerësonte dëshirat e vërteta të fëmijës. Një informacion i saktë dhe i plotë në lidhje me marrëdhënien e fëmijës me kërkuesin, si prindi që kërkonte të kishte kontakte me të, ishte një kusht i domosdoshëm paraprak për vlerësimin e dëshirave reale të fëmijës. Vetëm në këtë mënyrë mund të vihejshin në një balancë të drejtë interesat që ishin në lojë në këtë rast. Gjykata kujtoi në vijim që Gjykata e Apelit, e cila kishte kompetenca të plota për të rishikuar të gjitha çështjet që kishin të bënin me kërkesën për takime, veçse la në fuqi konstatimet e Gjykatës së Rrethit duke u bazuar në dosjen e çështjes. Sipas mendimit të Gjykatës, moskërkimi

i një raporti psikologjik nga ana e gjykatave gjermane në lidhje me mundësitë e vendosjes së kontakteve ndërmjet fëmijës dhe kërkuesit nxori në pah që kërkuesi nuk kishte qenë përfshirë sa duhet në procesin e vendim-marrjes. Për këtë arsye Gjykata mendoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

*iii. Përsa i përket çështjes Hoffman kundër Gjermanisë*

7. Gjykata vuri në dukje se gjykatat kompetente të brendshme, duke mos njohur të drejtën e z. Hoffman për t'u takuar me fëmijën e vet, u bazuan në deklaratat e bëra nga ana e kërkuesit dhe e nënës së fëmijës, në komentet e Zyrës të Mülheim për Fëmijët, në këshillat e një eksperti dhe në veçanti në deklaratat e bëra nga fëmija që ishte pyetur nga Gjykata e Rrethit kur ai kishte qenë shtatë vjeç. Gjykatat mbajtën parasysh marrëdhëniet jonormale ndërmjet prindërve dhe konstatuan se çdo kontakt i mëtejshëm do të dëmtonte fëmijën.

8. Gjykata kujtoi se Gjykata e Rrethit kishte mbajtur parasysh disa raporte në lidhje me çështjen e kontakteve ndërmjet kërkuesit dhe fëmijës së tij J., një prej tyre i bazuar në eksperiencën e takimeve ndërmjet kërkuesit dhe J. në një qendër të kujdesit për fëmijët. Kërkuesi, i përfaqësuar nga avokati i tij, pati mundësinë të bënte komente mbi këto raporte dhe gjykatat gjermane arritën në marrjen e vendimit të kundërshtuar pasi kishin peshuar të gjitha interesat e kundërta që ballafaqoheshin. Duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat, Gjykata konstatoi se gjykatat gjermane kishin të drejtë ta vlerësonin refuzimin e kontakteve si të nevojshëm dhe se argumentet e tyre për të arritur në këtë përfundim ishin 'të mjaftueshme'. Për këtë arsye Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të nenit 8 të Konventës në këtë rast.

**B. Në lidhje me nenin 14**

9. Në të tre rastet, Gjykata vuri në dukje se ligjet gjermane në lidhje me kujdestarinë dhe kontaktet e prindërve me fëmijët e tyre ishin amenduar nga Ligji mbi Çështjet Familjare të 16 dhjetorit 1997, që ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1998, i cili i jep të drejtë edhe babait edhe nënës të një fëmije të mitur të lindur jashtë martesë që të takohen me fëmijën e tyre. Këto amendamente tregojnë se qëllimet e ligjeve gjermane të zbatueshme në kohën e ngjarjeve në të tre rastet në fjalë (të cilat kishin ndodhur përpara vitit 1998 - pra hyrjes në fuqi që ligjit të lartpërmendur) - veçanërisht mbrojtja e interesave të fëmijëve dhe prindërve të tyre - mund të ishte arritur pa bërë një dallim mbi bazën e faktit nëse fëmijët përkatës kishin lindur brenda apo jashtë martesës. Për këtë arsye Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të marrë së bashku me nenin 14 në të tre rastet e lartpërmendura.

**C. Në lidhje me nenin 6**

10. Në çështjet Sommerfeld kundër Gjermanisë dhe Hoffman kundër Gjermanisë, Gjykata vuri në dukje se në procedurat në lidhje me takimet e një babai natyror me fëmijën e tij të lindur jashtë martesës, nuk parashikohej një e drejtë e përgjithshme për një ankim të mëtejshëm kundër një vendimi të një gjykate apeli. Gjykata arriti në përfundimin se ky kufizim ndaj së drejtës së kërkuesit për t'iu drejtuar Gjykatës nuk ishte në përputhje me nenin 6 të Konventës.

**D. Në lidhje me nenin 41**

11. Në bazë të nenit 41 të Konventës, kërkuesve iu akorduan shumë vijuese: në Sahin kundër Gjermanisë 50 000 DM për dëm jo-material dhe 8 000 DM për pagesa dhe shpenzime ligjore; në Sommerfeld kundër Gjermanisë 55 000 DM për dëm jomaterial dhe 2 500 DM për pagesa dhe shpenzime ligjore dhe në Hoffman kundër Gjermanisë 25 000 DM për dëm jo-material dhe 2 500 DM për pagesa dhe shpenzime ligjore.

**III. Koment**

12. Këto tre raste kanë të bëjnë me ligjin gjerman, tashmë të amenduar, që rregullon kontaktet ndërmjet fëmijëve dhe baballarëve natyrorë, të cilët nuk kanë qenë martuar me nënat e këtyre fëmijëve. Në këtë kuadër kishte një prezumim të vagët në lidhje me të drejtën për kontakt për prindërit e divorcuar ose të ndarë, por jo për baballarët e pamartuar të cilëve, iu duhej të hapnin një proces gjyqësor për të siguruar kontakte të tilla. Në të tre rastet Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të marrë së bashku me nenin 14 ndërsa në çështjet Sahin dhe Sommerfeld ajo konstatoi edhe shkelje të nenit 8 të interpretuar më vete. Në çështjet Hoffman dhe Sommerfeld Gjykata konstatoi edhe shkelje të nenit 6 ndërkohë që z. Sahin nuk kishte ngritur ndonjë pretendim në bazë të këtij neni.

13. Në çështjen Sahin, fëmija kishte qenë 18 muajsh kur prindërit e tij ishin ndarë, kishte qenë 2 vjeç kur e ëma i ndaloi kontaktet me të atin, 10 vjeç kur kishin përfunduar procedimet e brendshme dhe 13 kur mbaruan ato përpara Gjykatës së Strasburgut. Në Sommerfeld fëmija ishte 5 vjeç kur prindërit u ndanë dhe nëna ndaloi kontaktet, 15 vjeç kur përfunduan procedurat e brendshme dhe 20 kur u mor vendimi në Strasburg. Në rastin e Hoffman fëmija ishte pothuajse dy vjeç kur prindërit u ndanë. Pas disa vizitave të para i ati nuk kishte arritur më të ushtronte të drejtën e tij për takime për tre vjet me radhë. Kur atij iu njoh e drejta për takime, përsëri kontaktet ishin të pakënaqshme dhe gjykatat e brendshme ia ndaluan vazhdimin e tyre kur fëmija ishte 8 vjeç. Proceset e brendshme përfunduan kur fëmija ishte 11 vjeç ndërsa çështja në Strasburg, kur ai ishte 16 vjeç.

14. Të tre këto raste kanë të bëjnë me atë që shumë ekspertë e quajnë “sindroma e përkatësisë prindërore” dhe që është rasti kur një prind që është armiqësuar pandryshueshmërisht me prindin tjetër, e kthen edhe fëmijën kundër këtij prindi<sup>169</sup>. Shkelja në themel në rastin Sommerfeld u konstatua në lidhje me dështimin e autoriteteve gjermane në kërkimin e një raporti psikologjik i cili do të mund të kishte vendosur nëse mendimet e shprehura nga ana e fëmijës ishin të sinqerta dhe nuk kishin qenë manipuluar. Në rastin Sahin shkelja u bazua në mosdëgjimin e fëmijës. Ndërsa në Hoffman Gjykata nuk konstatoi shkelje në thelb të nenit 8 për shkak se, sipas saj, kërkuesi kishte marrë pjesë në mënyrë të mjaftueshme në procesin e vendimmarrjes. Sidoqoftë ajo konstatoi shkelje të këtij neni të marrë së bashku me

<sup>169</sup> Shih në këtë kuadër për shembull vendimin e Gjykatës të 25 janarit 2000 në lidhje me çështjen Ignaccolo Zenide kundër Rumanisë.



nenin 14 për shkak se, si edhe në rastet e tjera, ai ishte trajtuar në mënyrë më pak të favorshme sesa një baba i divorcuar. Gjykata ka qenë gjithmonë e mendimit se neni 14 mund të shkelet në qoftë se mbrojtja e ofruar me ligj ka karakter diskriminues edhe kur ajo nuk konstaton shkelje thelbësore të nenit të zbatueshëm<sup>170</sup>.

## HANSEN kundër TURQISË

(kërkesa nr. 36141/97)

23 shtator 2003

*kjo çështje ka të bëjë me të drejtën e prindërve për tu takuar me fëmijët pas divorcit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Sophia Guðrún Hansen, është shtetase islandeze që ka lindur më 1959 dhe jeton në Islandë. Më 1981 dhe 1982 ajo pati dy vajza nga martesja e saj me Halil Al, një shtetas turk, me të cilin ajo bashkëjetonte në Reikjavik. Ata u martuan në Islandë më 13 prill 1984 dhe u ndanë në nëntor 1989. Z. Al u largua nga shtëpia në të cilën ata jetonin së bashku, në shkurt 1990.

2. Në qershor 1990, me pëlqimin e nënës, z. Al shkoi në Turqi për pushime së bashku me dy vajzat. Në gusht 1990 znj. Hansen u njoftua nga z. Al se vajzat e saj nuk do të ktheheshin më në Islandë. Duke filluar që nga kjo periudhë z. Al refuzoi të komunikonte me të dhe gjatë muajve vijues kërkuesja nuk mori asnjë të dhënë në lidhje me vajzat e saj.

3. Gjykatat Islandeze i vendosën për divorcin e znj. Hansen si dhe i njohën asaj kujdestarinë e fëmijëve me argumentin se vajzat kishin jetuar me të që në momentin e ndarjes së saj me z. Al dhe se Islanda kishte qenë gjithmonë vendi i tyre.

4. Më 25 tetor 1991 znj. Hansen e bëri një padi për divorc dhe kujdestari në Turqi. Gjatë procesit përkatës - i cili tërhoqi edhe vëmendjen e publikut dhe të medias - vajzat deklaruan se nuk donin të qëndronin me të. Megjithatë avokati i znj. Hansen pretendoi se vajzat ishin nën ndikimin e babait të tyre dhe se nuk po dëshmonin me vullnetin e tyre të lirë. Gjykatat turke i lanë vajzat në kujdestarinë e babait me argumentin se ishte në interesin e tyre më të mirë përderisa vetë ato kishin kërkuar të rrinin me të dhe se ato po jetonin tashmë në Stamboll.

5. Znj. Hansen iu njoh e drejta për t'u takuar me vajzat e saj. Sidoqoftë në praktikë, ndërmjet marsit 1992 dhe gushtit 1998 ajo u takua me vajzat vetëm katër herë, megjithëse ajo dhe përfaqësuesit e zyrës së përmbartimit, e kishin vizituar shtëpinë ku banonin fëmijët rreth 50 herë.

<sup>170</sup> Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 28 majit 1985 në lidhje me çështjen Abdulaziz, Cabaes dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar të përfshirë në këtë përmbledhje.

6. Gjykatat turke e gjobitën z. Al për mosrespektim të urdhrave të gjykatave për takimet e vajzave me të ëmën me 500 000 lira turke më 19 janar 1994, 1 200 000 lira më 7 mars 1997 dhe 350 000 lira më 15 korrik 1998.

7. Znj. Hansen ankohej në bazë të nenit 8 të Konventës dhe se autoritetet turke kishin dështuar në zbatimin e së drejtës së saj për t'u takuar me vajzat e saj dhe pretendoi, në bazë të nenit 14, që ajo ishte diskriminuar për shkak se ishte katolike dhe islandeze.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

8. Gjykata kujtoi se procedurat që kishin të bënin me njohjen e kujdestarisë prindërore, përfshirë këtu edhe ekzekutimin e vendimit të dhënë për këtë qëllim, kërkonte zgjidhje urgjente, për shkak se vonesat mund të kishin pasoja të pashmangshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijëve dhe prindërve që nuk jetonin me ta.

9. Gjatë procesit në lidhje me këtë çështje, i cili kishte zgjatur gjashtë vjet e pesë muaj, fëmijët kishin qenë nën një presion të jashtëzakonshëm dhe kishin qenë objekt i vëmendjes së medias dhe publikut. Megjithatë, edhe në rrethana të tilla të vështira, autoritetet nuk kishin marrë asnjë masë për t'i mundësuar znj. Hansen që të takonte fëmijët e saj ndërkohë që procesi vazhdonte. Në mënyrë të veçantë ato nuk kërkuan këshillat e shërbimeve sociale ose ndihmën e psikologëve ose psikiatërve për fëmijët të cilët të lehtësonin takimet e kërkuases me fëmijët e saj ose që të krijonin një atmosferë më mirëkuptuese ndërmjet saj dhe ish bashkëshortit të saj.

10. Megjithëse vajzat kishin shprehur njëfarë ngurrimi për të takuar nënën e tyre disa herë me radhë, Gjykata ishte e mendimit se atyre nuk u ishte dhënë asnjë mundësi reale për të zhvilluar një marrëdhënie me të ose një mjedis të qetë që të mund të shprehnin lirisht ndjenjat e tyre, pa pasur ndonjë presion të jashtëm.

11. Gjykata vuri re se në momentin e secilit prej takimeve të programuara, ish bashkëshorti i kërkuases merrte masat që të largohej bashkë me fëmijët kur autoritetet e përmbarimit arrinin në vendbanimin e fëmijëve. Megjithatë, autoritetet nuk morën asnjë hap për të lokalizuar vendndodhjen e fëmijëve dhe për të lehtësuar kontaktet me kërkuosen. Në prani të refuzimit të vazhdueshëm të z. Al për të respektuar detyrimet për takimin e nënës me vajzat e saj, autoritetet duhet të kishin marrë masa që ta lejonin kërkuosen të takonte vajzat, përfshirë këtu masa konkrete detyruese ndaj ish bashkëshortit të saj të një natyre që të mund të çonin në respektimin prej tij të vendimit që parashikonte kriteret për takime.

12. Gjykata nuk e pranoi pretendimin e qeverisë sipas së cilës autoritetet turke bënë gjithçka kishin pasur mundësi të bënin objektivisht, për respektimin e së drejtës së kërkuases për të takuar fëmijët e saj. Ajo vlerësoi se gjobat që i ishin vënë ish bashkëshortit të kërkuases nuk ishin as efektive as adekuate. Për këto arsye Gjykata mendoi se autoritetet turke kishin dështuar në marrjen e masave adekuate dhe

efektive për respektimin e të drejtave të kërkuases për të takuar fëmijët e saj dhe pra kishin shkelur të drejtën e saj për respektim të drejtës familjare të garantuar nga neni 8.

### **B. Në lidhje me nenin 14**

13. Duke i gjetur të pathemelta pretendimet e kërkuases për diskriminim ndaj saj për shkak të fesë ose të kombësisë së saj, Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 14.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

14. Gjykata i akordoi kërkuases si dëmshpërblim 50 000 euro për dëm material, 15 000 euro për dëm jomaterial dhe 10 000 euro për shpenzime dhe pagesa procedurale.

## **III. Koment**

15. Përpara vendimit në lidhje me çështjen Hansen kundër Turqisë këtë vit ka pasur edhe tre vendime të tjera në lidhje me situata ku prindërit e largojnë një fëmijë nga juridiksioni i një shteti pa lejen e prindit tjetër<sup>171</sup>. Të gjitha këto vendime ndjekin vendimin e mëparshëm të Gjykatës të 25 janarit 2000 në lidhje me çështjen Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë. Në ndryshim nga çështja Hansen, këto vendime kishin të bënin me Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Kjo Konventë rregullon kthimin e fëmijëve të rrëmbyer ose të mbajtur në mënyrë të paligjshme në juridiksionin e tyre me qëllim që çdo mosmarrëveshje në lidhje me kujdestarinë ose takimet, të gjejë zgjidhje nga ky juridiksion. Vlen të theksohet se kjo Konventë nuk vendos se cili prind duhet të ketë kujdestarinë e fëmijës.

16. Në lidhje me çështjen që po komentojmë, Konventa e Hagës nuk ishte në fuqi as në Islandë dhe as në Turqi në kohën e ngjarjeve dhe për këtë arsye, kërkuësja nuk mund t'i referohej dispozitave të saj. Megjithatë, Gjykata e Strasburgut kishte marrë në shqyrtim një problem të ngjashëm edhe vendimet e mëparshme që përmendëm, pikërisht atë të detyrimit pozitiv të shtetit për të marrë masa me qëllim që prindërit e interesuar të takohen me fëmijët e tyre. Gjykata në çështjen konkrete, ashtu si edhe në të mëparshmet, konstatoi se shteti kishte dështuar pikërisht në këtë drejtim dhe pra, ka pasur shkelje të nenit 8.

17. Shpeshherë Gjykata e ka theksuar rëndësinë e marrjes së shpejtë të masave në çështje që kanë të bëjnë me fëmijët, për shkak se kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pariparueshme për marrëdhëniet e një fëmije me një prind me të cilin nuk jeton. Në këtë çështje vajzat e kërkuases ishin tetë dhe nëntë vjeç kur i ati i tyre refuzoi që t'i kthente në Islandë pas pushimeve. E ëma filloi menjëherë procedurat ligjore në Islandë dhe pas një viti edhe në Turqi dhe pas njëfarë kohe iu njoh e drejta për

<sup>171</sup> Këto janë vendimet e 29 prillit 2003 në lidhje me çështjen Iglesias Gil dhe A.U.I. kundër Spanjës, të 24 majit 2003 në lidhje me çështjen Sylvester kundër Austrisë dhe të 26 qershorit 2003 në lidhje me çështjen Maire kundër Portugalisë.

t'i takuar vajzat. Megjithatë derisa vajzat u bënë tetëmbëdhjetë vjeç, kjo e drejtë e kërkueses për t'u takuar me to, nuk gjeti zbatim. Gjatë gjithë kësaj kohe kërkuesja pati mundësi t'i shihte vajzat vetëm katër herë.

18. Është e rëndësishme të vihet në dukje se edhe pse Gjykata thekson rëndësinë e masave të shpejta në këto raste, vetë procedurat përpara institucioneve të Strasburgut zgjatën gjashtë vjet e gjysmë deri në momentin e seancës. Numri i çështjeve me të cilat po përballet Gjykata është rritur me përmasa dramatike gjatë pesëmbëdhjetë muajve të fundit dhe nuk është e pazakontë që çështjet të presin për periudha të tilla përpara se të ketë një vendim përfundimtar në lidhje me to. Aktualisht po paraqiten propozime për reforma të Gjykatës së Strasburgut dhe që metodat e saj të punës të bëhen më efikase. Disa prej këtyre propozimeve konsistojnë në vështirësimin e kriterëve të pranueshmërisë. Pritet që, në lidhje me këto propozime, Komiteti i Ministrave të marrë një vendim në maj 2004.

## T.P. DHE K.M. kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 28945/95)

10 maj 2001

*pjesëmarrja e prindërve në procesin e vendimmarrjes në lidhje me kujdestarinë e fëmijëve të tyre përfshihet në konceptin e së drejtës familjare dhe shtetet duhet të krijojnë mjete efektive ankimi, të cilat duhet të parashikojnë edhe kompensimin e mundshëm ndaj shkeljeve*

### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje ka të bëjë me një kërkesë të paraqitur përpara Gjykatës nga një nënë, T.P. lindur më 1965, dhe e bija, K.M. lindur më 1983, të dyja shtetase britanike.

2. Ndërmjet viteve 1984 dhe 1987, autoritetet vendore kishin pasur dyshime se ndaj K.M. abuzohej seksualisht. Pas një interviste më 2 korrik 1987, K.M. u klasifikua në Regjistrin e Mbrojtjes së Fëmijëve në kategorinë e fëmijëve të abuzuar emocionalisht. Më 13 nëntor 1987, K.M., në atë kohë katër vjeç, u intervistua nga Dr. V, një psikiatër fëmijësh. Një punonjës social, z. P. ishte i pranishëm gjatë intervistës e cila u regjistrua gjithashtu në sistem video. Gjatë kësaj interviste K.M. zbuloi se i ishte nënshtruar abuzimeve nga dikush i quajtur "X". I dashuri i T.P., i cili quhej "X.Y." dhe që jetonte me kërkueset, kishte të njëjtin emër, "X", si edhe personi që kishte abuzuar me K.M. Megjithatë, kjo e fundit kishte treguar se nuk ishte "X.Y." abuzuesi dhe deklaroi se "X" ishte nxjerrë jashtë nga shtëpia. T.P. u informua se K.M. kishte bërë të ditur se "X.Y." kishte abuzuar seksualisht me të. T.P. u shqetësua dhe u nervozua për këtë arsye dhe si rrjedhim, Dr. V dhe z. P. arritën në përfundimin se ajo nuk ishte në gjendje ta mbronte kërkuesen e dytë nga abuzimet që i bëheshin dhe se ajo po

kërkonte ta bindte K.M. që të tërhiqte thëniet e saj të mëparshme. Si përfundim ata e hoqën menjëherë K.M. nga kujdestaria e së ëmës.

3. Më 13 nëntor 1987, autoriteti vendor iu drejtua, me sukses, gjykatës së Newham për një dhënien e një urdhri të vënies në kujdestari për 28 ditë. Më 24 nëntor 1987, T.P., pasi i kishte nxjerrë jashtë të gjithë të tjerët nga shtëpia e saj, kërkoi që kërkuesja e dytë të vendosej nën kujdestarinë e gjykatës. Autoriteti vendor kishte marrë ndërkaq kujdestarinë për K.M. dhe T.P. i ish-in lejuar vetëm të drejta të kufizuara për të takuar të bijën.

4. Rreth tetorit 1988, avokatët e T.P.-së kërkuan që të shihnin videon e intervistës së deklaratave të K.M.-së. Autoriteti mjekësor dhe Dr. V. paraqitën kundërshtimet e veta për dhënien e videos kërkueses së parë. Në një datë të panjohur saktësisht rreth asaj periudhe, avokatët e T.P. patën mundësi që të kishin akses në transkriptimin e videos. Ky tregonte se K.M. kishte thënë se nuk ishte "X.Y." personi që kishte abuzuar me të dhe se ajo kishte thënë se abuzuesi ishte nxjerrë jashtë nga shtëpia nga ana e T.P.-së. E njëjta gjë ishte pretenduar nga avokatët e parë të T.P.-së edhe përpara autoriteteve vendore. Më 21 nëntor 1988, pas një seance në Gjykatën e Lartë në të cilën autoriteti vendor rekomandoi që kërkuesja e dytë të rikthehej në kujdestarinë e kërkueses së parë, u urdhërua që K.M. të vihej nën kujdestarinë e gjykatës dhe se një kujdes dhe kontroll i përkohshëm duhej kryer nga ana e autoritetit vendor, i cili duhet t'ia kalonte fëmijën T.P. K.M. duhej të qëndronte pas këtij momenti me T.P.

5. Në 8 nëntor 1990, kërkueset filluan procedurat gjyqësore duke ngritur një sërë pretendimesh për neglizhencë ndaj detyrimit ligjor të autoritetit vendor, ku më kryesori ishte ai sipas të cilit punonjësi social, z. P, dhe psikiatri Dr. V nuk kishin analizuar me kujdesin dhe vëmendjen e duhur faktet e çështjes. Kërkuesit pretenduan se si rezultat i ndarjes së tyre të detyruar, secila kishte vuajtur çrregullime psikike të konsiderueshme. Në përfundim të procedurave në *House of Lords*, pretendimet e kërkuesve nuk u pranuan. Në vendimin e dhënë më 29 qershor 1995, dhe që kishte të bënte me tre çështje, Lordi Browne-Wilkinson u shpreh, ndër të tjera, se interesat e politikës publike ishin të tilla që autoritetet vendore nuk duhet të konsideroheshin përgjegjëse për neglizhencë në lidhje me ushtrimin e detyrave të tyre ligjore në mbrojtje të kujdesit për fëmijët.

7. Znj. Hansen ankohej në bazë të nenit 8 të Konventës, dhe se autoritetet turke kishin dështuar në zbatimin e së drejtës së saj për t'u takuar me vajzat e saj dhe pretendoi, në bazë të nenit 14, që ajo ishte diskriminuar për shkak se ishte katolike dhe islandeze.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

7. Gjykata arriti në përfundimin se, nëse dhënia e videos të intervistës dhe e transkriptimit të saj do të ishte vendosur në mënyrë të menjëhershme, do t'i

kishte lejuar T.P. të kishte një mundësi efektive për të vlerësuar dhe kundërshtuar pretendimet që K.M. nuk mund të kthehej të jetonte e qetë nën kujdesin e saj. Duke pasur parasysh pastaj që, mosparashtrimi i çështjes nga ana e autoritetit lokal Gjykatës për të vendosur, nënkuptonte që T.P. nuk kishte marrë pjesë siç duhej në procesin e vendimmarrjes në lidhje me kujdestarinë e së bijës. Në lidhje me këto momente, Gjykata konstatoi një mosrespektim të jetës familjare të kërkueseve që përbënte një shkelje të nenit 8 të Konventës.

### **B. Në lidhje me nenin 6**

8. Gjykata shprehu mendimin se në përfundim të procedurave kishte përsëri një mosmarrëveshje serioze dhe themelore në lidhje me ekzistencën e së drejtës të pretenduar nga kërkuesit në bazë të së drejtës së brendshme mbi neglizhencën dhe se mbi këtë bazë ata kishin të drejtë për një ankim në bazë të kësaj të drejte. Për këtë arsye, pra neni 6 ishte i zbatueshëm në lidhje me procedurat e paraqitura nga kërkuesit me anë të të cilave ata pretendonin neglizhencë nga ana e autoriteteve vendore.

9. Në lidhje me pajtueshmërinë me nenin 6, Gjykata vuri në dukje, së pari, se kërkuesit nuk ishin penguar në asnjë mënyrë praktike për paraqitjen e pretendimeve të tyre përpara gjykatave të brendshme. Nuk mund të thuhet as që ishte ngritur zbatimi i ndonjë rregulli procedural ose kufizimeve kohore në këtë drejtim.

10. Gjykata nuk u bind as në lidhje me faktin që pretendimet e kërkuesve ishin hedhur poshtë për shkak të zbatimit të një norme me karakter përjashtimor. Vendimi i *House of Lords* vendosi, duke zbatuar parimet normale ligjore mbi neglizhencën, se autoriteti vendor nuk mund të konsiderohej përgjegjës për neglizhencën e pretenduar të mjekut dhe të punonjësit social.

11. Për këtë arsye kërkueset nuk mund të pretendojnë se u ishte mohuar e drejta për të pasur një vendim në lidhje me themelin e pretendimeve të tyre për neglizhencë. Pretendimet e tyre ishin shqyrtuar siç duhej dhe mbi baza barazie nën dritën e parimeve ligjore të brendshme të zbatueshme ndaj neglizhencës. Pasi *House of Lords* kishte vendosur në lidhje me çështjet ligjore të pretenduara që nxirrnin në pah zbatimin e nenit 6 § 1, kërkueset nuk mund të ngrinin asnjë pretendim tjetër në bazë të nenit 6 § 1 për të pasur ndonjë seancë tjetër në lidhje me vlerësimin e fakteve. Pra nuk kishte pasur mohim të mundësisë për t'iu drejtuar gjykatës dhe për pasojë, shkelje të nenit 6.

### **C. Në lidhje me nenin 13**

12. Gjykata vlerësoi se kërkueset duhet të kishin pasur mundësi të shfrytëzonin një mjet me anë të të cilit të pretendonin se trajtimi i procedurave nga ana e autoriteteve vendore shtronte përgjegjësinë e tyre për dëmin që ato kishin pësuar. Ato duhet të kishin pasur gjithashtu mundësinë që, në qoftë se pretendimi i tyre pranohej të vlerësohej edhe çështja e dëmshpërblimit të tyre. Gjykata, në këtë drejtim të fundit, nuk ishte dakord me mendimin e qeverisë, sipas së cilit një kompensim me karakter



pasuror nuk do të ofronte një ndreqje konkrete të situatës. Në qoftë se, sipas Gjykatës, kishte pasur një dëm psikik siç u pretendua, mund të ketë pasur elementë të shpenzimeve mjekësore si dhe vuajtje dhe dhimbje të mjaftueshme që duheshin riparuar.

13. Gjykata konstatoi se kërkuesit nuk kishin pasur mundësi të shfrytëzonin mjete të përshtatshme për të pasur një shqyrtim dhe vendim në lidhje me pretendimet e tyre për shkelje të së drejtës së tyre për respektim të jetës familjare nga ana e autoritetit vendor e as mundësinë për të pasur një shumë të ekzekutueshme kompensuese për dëmin që ato kishin vuajtur si pasojë e kësaj shkeljeje. Si rrjedhim, Gjykata vendosi se nuk ka pasur mundësi për një mjet efektiv dhe pra, konstatoi shkelje të nenit 13.

#### *D. Në lidhje me nenin 41*

14. Gjykata i akordoi 10 000 sterlina secilës prej kërkueseve për dëm jomaterial dhe 25 000 sterlina për shpenzime dhe pagesa.

### **III. Koment**

15. Konventa ka krijuar dy mekanizma për mbrojtjen në nivel shtetëror të të drejtave të parashikuara prej saj. I pari prej tyre gjendet në të ashtuquajturat 'dispozita sandwich' - nenet 1 dhe 13 të Konventës. Sipas nenit 1 shtetet marrin përsipër t'u 'sigurojnë' individëve të drejtat e parashikuara nga Konventa ndërsa në nenin 13 ata marrin përsipër t'u ofrojnë atyre një mjet efektiv në nivel shtetëror për çdo shkelje që mund të ndodhë. Normalisht Gjykata e Strasburgut duhet të konstatojë shkelje të nenit 13 kurdo që ajo konstaton shkelje të të drejtave materiale, përderisa mbrojtja e ofruar nga ana e nenit 13 ka dështuar, përderisa kërkuesit detyrohen të vijnë deri në Strasburg për të pasur vënien në vend të të drejtave të tyre. Megjithatë qëndrimi i Gjykatës ka qenë ai që neni 13 nuk ishte shkelur në rastet kur kishte një mekanizëm në të drejtën e brendshme i cili është në gjendje, në parim, të ofrojë një mjet efektiv, por që ka dështuar të jetë i tillë thjesht në rrethanat konkrete të çështjes që merret në shqyrtim.

16. Mekanizmi i dytë, i cili ka ndihmuar dhe do të ndihmojë shumë të dëmtuar nga shkeljet e Konventës, është ai që gjendet në nenin 6 dhe që garanton jo vetëm një gjykim të drejtë, por përfshin gjithashtu të drejtën për "t'u drejtuar gjykatës" në përcaktimin e të drejtave me karakter juridiko-civil. Jo të gjitha shkeljet e Konventës mund të klasifikohet sikur angazhojnë të drejta me karakter juridiko-civil, të cilat përkufizohen para së gjithash në bazë të së drejtës së brendshme. Ka në fakt dy përjashtime nga ky rregull. I pari është kur gjykatat e brendshme i konsiderojnë procedurat thjesht si me karakter 'administrativ'. Gjykata Evropiane vlerëson se, në rastet kur procedurat me karakter administrativ janë në mënyrë të drejtpërdrejtë përcaktuese të një të drejte me karakter civil që ekziston si e tillë në bazë të së drejtës së brendshme, këto procedura duhet të konsiderohen si 'civile'. Përjashtimi i dytë është kur ekziston një pamundësi procedurale për t'u paditur në bazë të së drejtës së brendshme, në rrethana kur një padi civile duhet të kishte ekzistuar normalisht.

Gjykata ka konstatuar, si në këtë rast, se në qoftë se një pamundësi e tillë procedurale është kaq e lidhur me të drejtat materiale që nuk janë e drejtë me karakter civil sipas së drejtës së brendshme, atëherë, *a fortiori*, nuk ka një të drejtë të përgjithshme për t'iu drejtuar gjykatës.

17. Gjykata ka qenë shpesh në pozitat e vlerësimit të marrëdhënieve ndërmjet neneve 6 dhe 13. Në rastet kur neni 6 gjen zbatim ajo preferon që t'i shqyrtojë Nenet në bazë të këtij neni për shkak se kërkesat e këtij janë më strikte se ato të nenit 13. Vendimet në lidhje me çështjet Z dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe T.P. dhe K.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar shkojnë mjaft afër kërkesës për një mjet efektiv, në raste të ngjashme, me karakter gjyqësor të aftë që të çojë në akordimin e një kompensimi.

## BAJRAMI kundër SHQIPËRISË

(*kërkesa nr. 35853/04*)

12 dhjetor 2006

*cenimi i së drejtës së kërkuarit për një jetë të qetë familjare si pasojë e mos përmbushjes nga ana e shtetit e detyrimeve të tij pozitive*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Agim Bajrami, lindur dhe rritur në Kosovë, u martua në vitin 1993 me shtetasen shqiptare F.M. Në janar të vitit 1997 ata lindën një fëmijë, I.B. Në vitin 1998 çifti u nda dhe F.M së bashku me vajzën e saj u shpërngul në shtëpinë e prindërve të saj në Vlorë. F.M u martua për herë të dytë dhe pas ndarjes, u martua për herë të tretë, periudhë gjatë së cilës ajo udhëtonte shpesh për Greqi. Shumicën e kohës, ajo e linte vajzën në kujdesin e prindërve të saj në Vlorë. F.M dhe prindërit e saj nuk e lejonin kërkuesin të kishte kontakt me vajzën, ai u lejua ta shihte vajzën vetëm 2 herë.

2. Në 24 qershor 2003 kërkuesi solli procedurat e divorcit pranë Gjykatës së Rrethit Vlorë dhe 2 ditë më vonë i kërkoi Policisë së Rrethit Vlorë të bllokoni pasaportën e të bijës, pasi kishte mundësi që F.M ta merrte atë me vete në Greqi. Në janar 2004 F.M e mori vajzën në Greqi. Në 4 shkurt 2003 Gjykata e Rrethit shpalli divorcin dhe i dha kërkuesit kujdestarinë e fëmijës. Të gjitha përpjekjet e kërkuesit pranë autoriteteve shqiptare për të gjetur dhe kthyer vajzën e tij në Shqipëri, së bashku me vendimin final të Gjykatës së Rrethit, ishin të pasuksesshme.

3. Kërkuesi u ankua përpara Gjykatës për shkelje të nenit 6 § 1 dhe 8 të KEDNJ.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Fillimisht, Gjykata thekson natyrën pozitive që i përket shteteve kontraktuese sipas nenit 8 të Konventës. Sipas saj, shtetet duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë dhe të marrin masat e duhura kur bëhet fjalë për bashkimin e familjes si dhe duhet kushtuar një kujdes specifik në procedurat lidhur me rastet e rrëmbimit dhe kujdestarinë e fëmijëve, si rasti në fjalë. Në këtë raport, Gjykata është frymëzuar drejtpërdrejt nga neni 11 i Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit ndërkombëtar të Fëmijëve të 25 tetorit 1980.

### A. Në lidhje me nenin 8

5. Duke u kthyer në rrethanat specifike të rastit, Gjykata shprehet se marrëdhënia e kërkuesit me të bijën ishte dëmtuar nga dështimi i autoriteteve shqiptare për të zbatuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Vlorë që i jepte kërkuesit kujdestarinë e vajzës. Gjykata vlerëson se autoritetet nuk kanë bërë atë që duhet për të zbatuar vendimin e Gjykatës, sidomos duke pasur parasysh interesat në fjalë dhe frymën e Konventës së lartpërmendur të Hagës.

6. Gjykata vlerëson së, në kuadër të mosratifikimit të Konventës së Hagës, sistemi ligjor shqiptar nuk i ofroi kërkuesit ndonjë mbrojtje alternative efektive dhe praktike, e cila kërkohet nga detyrimi pozitiv i shtetit i parashikuar në nenin 8 të Konventës. Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 8, ndërkohë që nuk e ka gjetur të nevojshme shqyrtimin e çështjes sipas nenit 6 § 1.

## III. Koment

7. Ky gjykim, për fat të keq, nuk pati asnjë impakt individual sepse kërkuesi kishte vdekur një muaj para dhënies së vendimit. Megjithatë, ky vendim pati një impakt të rëndësishëm në sistemin ligjor shqiptar, duke pohuar në të njëjtën kohë një vendim të rëndësishëm të Gjykatës, në lidhje me standardet ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e fëmijëve.

8. Rëndësia e tij për kontekstin shqiptar bazohet në faktin se ky vendim përbën nxitjen e drejtpërdrejtë për autoritetet shqiptare për të përfunduar procedurat e pranimit të Shqipërisë në Konventën e Hagës të 25 tetorit 1980. Edhe pse Parlamenti Shqiptar kishte votuar për Ligjin nr. 9446 për ratifikimin e Konventës së Hagës më 24 nëntor 2005, vetëm pesë muaj pas këtij vendimi është depozituar instrumenti i ratifikimit dhe Shqipëria u bë palë në Konventë më 1 gusht 2007.

9. Aspekti tjetër i rëndësishëm i këtij gjykimi konsiston në referimin në Konventën e Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Gjykata këtu jo vetëm që konfirmon jurisprudencën e saj në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve, por siç ka bërë tashmë në lidhje me të drejtën e vizitës, konfirmon detyrimin pozitiv të një shteti jo-palë në Konventën e Hagës për masat në rastet për rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve. Kjo jo vetëm që tregon se neni 8 i Konventës Evropiane në çështjet e

mbrojtjes së fëmijës interpretohet në dritën e Konventës së Hagës. Aktgjykimi përbën, në të vërtetë, një mbështetje të qartë për shqyrtimin e Konventës së Hagës si një standard i përgjithshëm ndërkombëtar, që duhet respektuar në rastet e rrëmbimit të fëmijëve. Me kujdes, Gjykata nuk e konsideron Shqipërinë përgjegjëse vetëm për mos hyrjen në Konventën e Hagës, por për shkak se sistemi ligjor shqiptar nuk ofron mbrojtje alternative praktike dhe efektive për aplikantin, siç kërkohet me nenin 8 të Konventës Evropiane, që interpretohet në dritën e nenit 11 të Konventës së Hagës.

## ZORICA JOVANOVIĆ kundër SERBISË

(kërkesa nr. 21794/08)

26 mars 2013

*foshnjat të humbura në spitale: Serbia duhet të japë shpjegime të besueshme në lidhje me fatin e secilit prej fëmijëve dhe të vërë në vend të drejtat e shkelura të prindërve*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Zorica Jovanović, është shtetase serbe, e cila ka lindur në vitin 1953 dhe jeton në Batočina (Serbi).
2. Më 28 tetor 1983 Znj. Jovanović lindi një djalë të shëndetshëm në Qendrën Mjekësore Čuprija, një spital shtetëror. Tre ditë më vonë, kur ajo dhe foshnja ishin gati për tu larguar, ajo u informua se, foshnja e saj kishte vdekur. Ajo u përpoq të hynte në dhomën e spitalit ku djali i saj kishte kaluar natën, por u ndalua nga dy sanitare të spitalit. Një infermiere u përpoq t'i injektonte një qetësues, të cilën ajo arriti ta shmangë. Në një gjendje shoku dhe duke mos pasur asnjë mundësi tjetër, ajo u largua nga spitali
3. Trupi i foshnjës nuk iu dorëzua kurrë znj. Jovanović apo familjes së saj. Asaj kurrë nuk iu dha ndonjë raport autopsie apo ndonjë informacion se, kur dhe ku ishte varrosur foshnja. Spitali thjesht e informoi atë se, djali i saj kishte vdekur më 31 tetor 1983 dhe se, nuk kishte asnjë informacion për sa i përket shkakut të vdekjes.
4. Në nëntor të vitit 2002 komuna lokale e informoi znj. Jovanović se, lindja e të birit, por jo vdekja, ishte regjistruar në regjistrat komunal. Kjo u konfirmua përsëri në shtator të vitit 2007.
5. Një padi penale e ngritur nga bashkëshorti i znj. Jovanović kundër stafit të spitalit - pas raportimeve në media për rastet e tjera të ngjashme - u hodh poshtë në tetor 2003 si e pabazuar. Nuk u dhanë shpjegime të mëtejshme dhe nuk ishte e qartë nëse ishte kryer apo jo një hetimi paraprak.

6. Midis vitit 2003 dhe 2010 u ndërmorën disa hapa për përmirësimin e procedurave në spitale në rastet e vdekjes së të porsalindurve dhe për të hetuar pretendimet në vitin 2005 nga prindërit e qindra foshnjave të porsalindura të cilat, ishin zhdukur pasi ishin deklaruar se kishin vdekur në repartet spitalore, kryesisht që nga vitet 1970 deri në vitet 1990. Raportet zyrtare konstatuan mangësi serioze në legjislacionin në fuqi në vitet 1980, si dhe në procedurat dhe rregullimet normative për trajtimin e rasteve kur një i porsalindur vdes në spital dhe se dyshimet e prindërve për çfarë u kishte ndodhur në të vërtetë fëmijëve të tyre, ishin të justifikuar. Gjithashtu raportet kishin konstatuar se, përgjigja e organeve shtetërore për situatën kishte qenë e pamjaftueshme në vetvete. Në dhjetor 2010, një grup pune i ngritur nga Parlamenti serb arriti në përfundimin se, nuk kishte nevojë për ndryshime të legjislacionit, i cili ndërkohë ishte amenduar, me përjashtim përse i përkiste mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave mjekësore. Grupi gjithashtu vuri në dukje se, Kushtetuta nuk e lejonte zgjatjen e periudhës së parashkrimit të ndjekjes penale të veprave të kryera në të kaluarën, ose për të parashikuar veprat penale të reja, më të rënda, dhe/ose dënime më të ashpra.

7. Znj. Jovanović ishte trajtuar në mënyrë të përsëritur për depresion ndërmjet viteve 2009-2011.

8. Duke u mbështetur në veçanti në nenin 8 dhe nenit 13, znj. Jovanović pretendoi se, autoritet serbe kishin dështuar në mënyrë të vazhdueshme për t'i dhënë asaj informacion në lidhje me fatin e djalit të saj të porsalindur dhe për t'i dhënë asaj mundësinë për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

9. Gjykata vërejti se, Znj. Jovanović kishte mbetur ende sot e kësaj dite pa një përgjigje të besueshme mbi çfarë kishte ndodhur me djalin e saj në vitin 1983. Ajo kurrë nuk e kishte parë trupin e pajetë të djalit të saj, shkak i vdekjes së tij kurrë nuk ishte përcaktuar dhe vdekja e tij kurrë nuk ishte regjistruar zyrtarisht. As padia penale e ngritur nga bashkëshorti i saj në lidhje me këtë nuk ishte vlerësuar siç duhej. Në të vërtetë, vetë autoritetet serbe kishin pohuar në një sërë raportesh, se kishte probleme dhe mangësi në legjislacionin në fuqi në atë kohë, në procedurat dhe rregullimet normative në rastet e vdekjeve në spital të të sapolindurve si dhe në reagimin e shtetit ndaj akuzave për zhdukjen e foshnjave në spitale.

10. Pavarësisht nga disa nisma zyrtare, në dukje premtuese, ndërmjet viteve 2003 dhe 2010, raporti i grupit të punës i dhjetorit 2010 arriti në përfundimin se, nuk ishin të nevojshme ndryshime të mëtejshme në legjislacionin tashmë të ndryshuar. Megjithatë, kjo në mënyrë të qartë vetëm përmirësonte situatat në të ardhmen por, në fakt, nuk bëri asgjë për prindërit, përfshirë këtu edhe kërkuesen, të cilët kishin kaluar një eksperiencë të tillë në të kaluarën.

11. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se, kishte pasur shkelje të vazhdueshme të së drejtës së Znj. Jovanović për respektimin e jetës familjare për shkak të dështimit të vazhdueshëm të autoriteteve serbe për t'i siguruar asaj informacion të besueshëm në lidhje me atë që kishte ndodhur me djalin e saj. Kështu, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 8.

#### ***B. Në lidhje me nenin 13***

12. Gjykata u shpreh se, nuk kishte nevojë për të shqyrtuar më vete kërkesën sipas nenit 13.

#### ***C. Në lidhje me nenin 46***

13. Duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të kërkuessve potencialë, Gjykata u shpreh më tej se Serbia duhej që - brenda një viti nga momenti që vendimi merrte formë të prerë - të merrte masat e duhura për të siguruar vendosjen në vend të të drejtave të të gjithë prindërve në situatë të ngjashme me kërkuessin. Ky proces duhet të mbikëqyret nga një organ i pavarur, me kompetencat e duhura, në mënyrë që tu jepej një përgjigje e besueshme prindërve në lidhje me çfarë u kishte ndodhur fëmijëve të zhdukur dhe të merrnin dëmshpërblimin e duhur.

14. Ndërkohë, Gjykata vendosi ta shtyjë për një datë të mëvonshme shqyrtimin e të gjitha kërkesave të ngjashme, tashmë pezull para saj.

#### ***D. Në lidhje me nenin 41***

15. Gjykata i akordoi kërkuesses 10 000 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe 1 800 euro për kostot dhe shpenzimet.

### **III. Koment**

16. Nga çdo pikëpamje, ky është një rast i dhimbshëm, por ngre një numër çështjesh interesante në lidhje me pranueshmërinë e kërkesave para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky vendim unanim i Gjykatës mori në konsideratë një sërë ngjarjesh që kishin ndodhur ndërmjet vitit 1983, kur kërkuessa lindi një fëmijë të shëndetshëm për të cilin iu tha më pas se kishte vdekur, dhe datës së paraqitjes së kërkesës. Qeveria serbe pretendonte që, duke qenë se ngjarjet e ankmuara kishin ndodhur para se Serbia të ratifikonte Konventën, rasti ishte i papranueshëm *ratione temporis*. Dhoma nuk e pranoi këtë argument dhe konsideroi se, kjo ishte një "situatë e vazhdueshme" (shih Kuric kundër Sllovenisë, vendimi i Dhomës së Madhe i datës 26 qershor 2012, një nga rastet e botuara në Buletinin 3-2012). Gjykata vlerësoi gjithashtu se, kërkuessa kishte respektuar afatin kohor gjashtë mujor (afat që do të bëhet katër muaj kur të hyjë në fuqi Protokollit 15). Gjykata vuri në dukje se, megjithëse afati kohor gjashtë mujor në përgjithësi nuk zbatohet në situata të vazhdueshme që kanë të bëjnë me zhdukjet, vjen një moment kur të afërmit duhet të kuptojnë se nuk është kryer apo do të kryhej ndonjë hetim efektiv. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstatoi se nuk ishte e paarsyeshme për kërkuessen që të priste rezultatin e zhvillimeve të cilat mund të kishin zgjidhur çështje të rëndësishme



faktike ose ligjore dhe se kërkesa e saj në këtë mënyrë ishte në kohë. Qeveria serbe kërkoj që rasti t'i referohej Dhomës së Madhe, por kjo nuk u pranua nga Paneli i Dhomës së Madhe.

## K DHE T kundër FINLANDËS

(kërkesa nr. 25702/94)

12 korrik 2001

### Dhomë e Madhe

*kjo çështje kishte të bënte me balancën interesante mes së drejtës për jetë private dhe asaj për jetë familjare e cila kërkon garanci procedurale të qarta nga ana e autoriteteve në mënyrë që të mos kemi shkelje të nenit 8*

#### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, K. dhe T. janë shtetas finlandezë. Ata bashkëjetojnë dhe K., është nënë e katër fëmijëve ndërsa T., babai i dy prej tyre.

2. Përpara fakteve që merren në shqyrtim, K. kishte qenë shtruar në spital disa herë me radhë dhe ishte diagnostikuar sikur vuante nga skizofrenia. Në maj 1993, kur ajo po priste fëmijën e saj të tretë J., Bordi i Shëndetit Publik, duke konsideruar se K. nuk ishte në gjendje të kujdesej për fëmijën e saj të dytë M., e vendosi atë në një shtëpi fëmijësh si një masë e përkohshme e marrë edhe me pëlqimin e kërkuesve. Sapo u lind, në qershor 1993, J. u vendos, në bazë të një urdhri urgjent, në kujdes publik në pavijonin e spitalit për fëmijët, duke pasur parasysh kushtet e paqëndrueshme mendore të K. si dhe vështirësitë e tejzgjatura të familjes së saj. K.-së iu ndalua që të shkonte të takonte fëmijët në mënyrë të pakontrolluar dhe ajo u shtrua përsëri në spital për shkak të psikozave të saj. Urdhrrat kujdesit të menjëhershëm për fëmijët u zëvendësuan me urdhra normalë kujdesi në korrik 1993. Këto urdhra u konfirmuan nga Gjykata Administrative e rrethit dhe Gjykata e Lartë Administrative i hodhi poshtë kërkesat e kërkuesve.

3. Në shtator 1993 kufizimi i K. për të takuar fëmijët u shty dhe më 1994 fëmijët u vendosën në kujdesin e një familje tjetër që banonte rreth 120 km larg nga shtëpia e kërkuesve. Zyrtarët e kujdesit social pretenduan se u kishin thënë kërkuesve dhe kujdestarëve se ky kujdes për fëmijët do të vazhdonte për vite. Kërkuesit propozuan, më kot, që kjo kujdestari të transferohej në shtëpinë e të afërmeve të tyre dhe se ky duhej që, në çdo rast, të synonte ribashkimin e familjes. Në maj 1994 vajtjet e të dy prindërve tek fëmijët u kufizuan në një herë në muaj dhe bëheshin gjithmonë nën kontroll. Në dhjetor 1994 Drejtori Social vuri në dijeni kërkuesit se nuk kishte më asnjë bazë për kufizimin e takimeve. Megjithatë, vazhduan të lejoheshin vetëm

takime një herë në muaj nën mbikëqyrjen e Bordit të Shëndetit Social. Bordi e konfirmoi këtë vendim në janar 1995 dhe kërkesa e kërkuësve nuk u pranua.

4. Ndërkohë, në maj 1994, kërkuësit kërkuan gjithashtu që urdhrat e kujdestarisë të revokoheshin. Kjo kërkesë nuk u pranua nga Bordi i Shëndetit Social në mars 1995. Në prill 1995 K. lindi një fëmijë të katërt i cili nuk u vendos në kujdes publik. Menjëherë pas kësaj K. u mor me forcë në kujdes të detyrueshëm psikiatrik për gjashtë javë, përsëri për shkak të skizofrenisë së saj.

5. Ky sistem kujdesi u rishikua përsëri në maj 1996 dhe në prill 1997 por kufizimi i takimeve u la përsëri në fuqi. Në dhjetor 1998 autoritetet shoqërore vlerësuan se ribashkimi i familjes nuk ishte i parashikueshëm për momentin. Gjithsesi, në nëntor 2000, kërkuësit dhe fëmijët u lejuan të takoheshin një herë në muaj pa mbikëqyrje. Ky nivel kufizimi për takimet ndërmjet tyre ngelet në fuqi deri në fund të vitit 2001.

6. Kërkuësit ankoreshin se e drejta e tyre për respektim të jetës së tyre familjare, e garantuar në bazë të nenit 8, ishte shkelur për shkak të vendosjes së fëmijëve të tyre J. dhe M. në kujdes publik, si dhe për shkak të masave vijuese të kujdestarisë. Ata u ankuan gjithashtu se nuk u ishte akorduar një mjet efektiv, i garantuar në bazë të nenit 13.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

#### i. urdhrat emergjente për kujdestarinë

7. Gjykata pranoi se, kur nxirret një urdher urgjent për kujdestari nuk ishte gjithmonë e mundur që, për shkak të karakterit urgjent të situatës, të merrnin pjesë në procesin vendimmarrës edhe personat që kishin kujdestarinë e fëmijës. Kjo nuk ishte as e dëshirueshme, nga ana tjetër, në qoftë se këta persona shiheshin si burim kërcënimi të menjëhershëm ndaj fëmijës. Gjykata u bind gjithsesi me faktin që autoritetet finlandeze kishin të drejtë të vlerësonin që në lidhje me J. dhe me M. ekzistonin rrethana që justifikonin marrjen e tyre nga kujdestaria e kërkuësve pa një këshillim paraprak. Në mënyrë të veçantë, i takonte autoriteteve finlandeze të vendosnin që, përpara fillimit të zbatimit të çdo mase kujdestarie, ishte ndërmarrë një vlerësim i kujdesshëm i impaktit të masës së kujdestarisë së propozuar kërkuësve dhe fëmijëve si dhe i të gjitha mundësive të tjera për vendosjen e fëmijëve në kujdes publik.

8. Gjykata e gjeti të arsyeshëm besimin e autoriteteve që, në qoftë se K, kishte qenë paralajmëruar për synimin e autoriteteve për t'ia marrë qoftë M., qoftë fëmijën që pritej të lindte J., mund të kishte pasur pasoja të dëmshme për të dhe për fëmijën. Dukej gjithashtu i arsyeshëm vlerësimi i autoriteteve sipas të cilit T. nuk do të kishte qenë në gjendje të vetëm që të merrej me të sëmurën mendore K., fëmijën që pritej J. dhe me M.. Pjesëmarrja vetëm e T. në procesin e vendimmarrjes nuk ishte një zgjidhje realiste për autoritetet pasur parasysh marrëdhënien e ngushtë ndërmjet kërkuësve si dhe mundësinë reale të shkëmbimit të informacioneve ndërmjet tyre.

9. Megjithatë, marrja e një fëmije të sapolindur në kujdes publik në momentin e lindjes së tij ishte një masë tejet e rëndë. Duhej të ekzistonin arsye tepër të forta që një foshnjë të mund të merret fizikisht nga kujdesi i nënës së tij në kundërshtim me dëshirën e kësaj, menjëherë pas lindjes dhe si pasojë e një procedure në të cilën as ajo dhe as personi që bashkëjetonte me të, nuk kishin marrë pjesë. Nuk doli që arsye të tilla ekzistonin. Autoritetet ishin në dijeni për lindjen e pritshme të J. muaj më përpara si dhe për problemet mendore të K.-së, kështu që situata nuk ishte urgjente nga pikëpamja e paparashikueshmërisë së saj. Qeveria Finlandeze nuk kishte vlerësuar dhe as propozuar mundësi të tjera të mbrojtjes së J. nga rreziku i vuajtjeve fizike nga ana e K.-së.

10. Kur merret një masë e tillë drastike e cila menjëherë e privon një nënë nga fëmija i saj i sapo-lindur, u del për detyrë autoriteteve shtetërore që të shqyrtojnë nëse janë të mundshme ndërhyrje të një shkalle më të lehtë në jetën familjare në një moment kaq kritik të jetës së prindërve me fëmijët e tyre. Arsyet në të cilat u bazuan autoritetet ishin të rëndësishme por jo të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen serioze në jetën familjare të kërkuesve. Edhe duke mbajtur parasysh hapësirën e vlerësimit të autoriteteve shtetërore, Gjykata arriti në përfundimin se urdhrat emergjentë të kujdestarisë në lidhje me J. dhe metodat e përdorura në vënien në zbatim të këtij kujdesi nuk ishin në përpjesëtim me qëllimin e ndjekur. Pra, megjithëse kishte pasur një “nevojë” për të marrë disa masa paraprake për të mbrojtur J., ndërhyrja në jetën familjare të kërkuesve nuk mund të shihej sikur kishte qenë “e nevojshme” në një shoqëri demokratike.

11. Vlerësime të ndryshme u bënë në lidhje me M.. Autoritetet kishin të drejtë të ishin të shqetësuara në lidhje me aftësinë e K., edhe e ndihmuar nga T., që të vazhdonte të kujdesej për familjen e saj në një mënyrë normale edhe pas lindjes së fëmijës së saj të tretë. M. po tregonte shenja shqetësimi, kështu që kishte nevojë për një kujdes të veçantë. Urdhrat emergjentë të kujdesit në lidhje me të nuk mund të kishin të njëjtat pasoja ndaj jetës familjare të kërkuesve si ato të marra në lidhje me J. M. kishte qenë veçuar fizikisht nga familja e tij si rezultat e vendosjes së tij vullnetare në një shtëpi fëmijësh. Mosmarrja pjesë e T. dhe K. në procesin e vendimmarrjes ishte e kuptueshme në kuadrin e mosprovokimit të një krize në familje përpara ngjarjes stresuese të lindjes së J. Autoritetet shtetërore kishin të drejtë pra, ta konsideronin të nevojshme marrjen e masave të jashtëzakonshme, për një periudhë të kufizuar kohe, në interes të M.

*ii. urdhrat normale mbi kujdestarinë*

12. Duke pasur parasysh që detyra parësore e autoriteteve ishte mbrojtja e interesave të fëmijës, Gjykata nuk kishte arsye që të dyshonte që autoritetet ishin në gjendje që të vlerësonin se vendosja e fëmijëve në kujdes publik. duke filluar nga 15 korriku 1993 dhe në një shtëpi fëmijësh, duke që nga fillimi i vitit 1994, ishte më e preferueshme se sa vazhdimi i masave të kujdestarisë normale ose të masave të tjera të ngjashme. Nuk mund as të thuhet, nga ana tjetër, se urdhrat normalë mbi kujdestarinë ishin vënë në zbatim me ndonjë nxitim të veçantë ose në një mënyrë jo të zakonshme. Për

më tepër, kërkuesit kishin marrë pjesë në mënyrë të plotë në procesin e vendim-marrjes të urdhrave normalë të kujdestarisë dhe në këtë mënyrë interesat e tyre ishin mbrojtur në mënyrë të përshtatshme.

*iii. Pretendimi për mosmarrjen e masave të duhura për bashkimin e familjes*

13. Gjykata kujtoi parimin themelor se kujdesi publik i fëmijës duhet që në parim të shihet si një masë e përkohshme, që duhet të marrë fund sa më shpejt që këtë ta lejojnë rrethanat. Çdo masë që synon të vërë në zbatim një kujdes të tillë të përkohshëm duhet të jetë në përputhje me qëllimin final të ribashkimit të prindërve natyrorë dhe fëmijës. Detyrimi pozitiv për të marrë masa për të lejuar ribashkimin familjar sa më shpejt që ky të jetë logjikisht i mundur bëhet gjithnjë e më i ndjeshëm me kohëzgjatjen e periudhës së kujdestarisë, me kusht që ky detyrim duhet të jetë në balancë me detyrimin për të vlerësuar interesin më të mirë të fëmijës.

14. Gjykata vuri në dukje se nuk ishin bërë disa vlerësime me qëllim që të vlerësohej nëse kërkuesit do të ishin në gjendje të merreshin me J. dhe M.. Gjithsesi, mund të thuhet se ato nuk arrinin të përbënin një përpjekje serioze dhe të fortë për të lehtësuar ribashkimin familjar. Minimumi i pritshëm nga ana e autoriteteve ishte ai që ato të analizonin situatën herë pas here, për të parë nëse ka pasur ndonjë përmirësim në situatën familjare. Mundësitë e ribashkimit do të zvogëloheshin dhe eventualisht do të zhdukeshin në qoftë se prindërit biologjikë dhe fëmijët e tyre nuk do të lejoheshin fare të takonin njëri tjetrin, ose ta takonin aq rrallë sa të mund të krijohej ndërmjet tyre një lidhje e natyrshme. Kufizimet dhe ndalimet e vendosura ndaj kërkuesve në lidhje me mundësinë e tyre për të takuar fëmijët më tepër e penguan sesa e ndihmuan ribashkimin e mundshëm të familjes. Në këtë çështje, ishte vërtet i çuditshëm qëndrimi negativ i vendosur nga ana e autoriteteve. Për këto arsye kishte një shkelje të nenit 8 në këtë kuadër.

*iv. Kufizimet dhe ndalimet e takimeve*

15. Për aq sa kërkesa në lidhje me kufizimet e takimeve mbulohej nga konstatimi i një shkeljeje të nenit 8 si rezultat i mosmarrjes së hapave të mjaftueshëm për ribashkimin e familjes së kërkuesve, nuk ishte e nevojshme për Gjykatën që të shqyrtonte masat e kundërshtuara si një burim i një shkeljeje më vete. Duke pasur parasysh situatën konkrete, përfshirë edhe periudhën pas dhënies së vendimit fillestar të Gjykatës (nga Dhoma), Dhoma e Madhe arriti në të njëjtin përfundim si edhe Dhoma. Duke vlerësuar gjendjen e fëmijëve gjatë periudhës së fundit vlerësimi i autoriteteve në lidhje me nevojën e kufizimit të takimeve nuk përbënte shkelje të nenit 8 § 2.

*B. Në lidhje me nenin 13*

16. Dhoma e Madhe nuk pa ndonjë arsye që të mbështetej në konstatimet e lartpërmendura të Dhomës në lidhje me këtë nen.

*C. Në lidhje me nenin 41*

17. Dhoma e Madhe la në fuqi vendimin e Dhomës në lidhje me akordimin secilit prej kërkuesve 40 000 marka finlandeze si shpërblim i drejtë për dëm jo-material.

Ajo la gjithashtu në fuqi akordimin që bëri Dhoma në lidhje me shpenzimet dhe pagesat gjyqësore prej 5 190 markash finlandeze, por akordoi edhe një shumë tjetër prej 60 000 markash finlandeze për procedurat përpara Dhomës së Madhe.

### III. Koment

18. Më 1 nëntor 1998, Protokolli 11 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut futi procedurën e re për vlerësimin e kërkesave përpara Gjykatës. Çështjet që deklarohen si të pranueshme tani merren në shqyrtim nga një Dhomë e Gjykatës e përbërë nga shtatë gjyqtarë. Një Dhomë mund të vendosë të tërhiqet nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe ose të vendosë vetë në lidhje me çështjen. Një vendim i një Dhome të Gjykatës bëhet përfundimtar veçse tre muaj pas dhënies së tij. Gjatë këtij afati palët kanë të drejtë të kërkojnë që çështja t'i kalohet për shqyrtim Dhomës së Madhe, në bazë të nenit 43 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Pjesa më e madhe e kërkesave të tilla janë bërë nga ana e kërkuësve që kishin humbur përpara Dhomave. Dhe pjesa më e madhe e tyre kanë qenë refuzuar. Ankimi i K dhe T. kishte qenë gjykuar ndërkaq nga një Dhomë e cila kishte konstatuar shkelje të nenit 8 të Konventës nga ana e qeverisë (e drejta për respektim të jetës familjare). Pas kësaj qeveria i kërkoi Dhomës së Madhe që ta rishqyrtonte çështjen dhe kjo kërkesë iu pranua. Ky është rasti i parë kur Dhoma e Madhe jep një vendim në vijim të kërkesës për të rishqyrtuar vendimin e ndonjërit nga Dhomat. Gjykata ka shfrytëzuar rastin në vendimin e saj për të theksuar dy parime në lidhje me rishqyrtimet në bazë të nenit 43. Së pari, ajo do ta vlerësojë një çështje deri në masën që ajo është konsideruar si e pranueshme nga ana e një Dhome. Megjithëse Gjykata mund të vlerësojë edhe çështjet e pranueshmërisë që janë ngritur më parë, qeveria nuk mund të ngrejë pretendime të reja që nuk i kishte ngritur në fazën e pranueshmërisë përpara Dhomës. Së dyti, Gjykata mund të vlerësojë në këtë fazë çdo material të ri, dhe çdo argument ligjor që palët ngrenë në lidhje me të, por që ajo e vlerëson si të rëndësishëm për kërkesën e deklaruar ndërkaq të pranueshme.

19. Vendimi në lidhje me themelin në këtë çështje përbën një ndryshim rrënjësor në jurisprudencën e Strasburgut në lidhje me vendosjen e fëmijëve në kujdestari. Është çështja e parë në të cilën Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 8 të Konventës në rastin e marrjes së një fëmije nga prindërit e tij kur autoritetet shtetërore kishin vlerësuar se një ndërhyrje urgjente ishte e nevojshme. Vendimi i 10 majit 2001 në lidhje me çështjen T.P dhe K.M kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>172</sup> kishte konstatuar se edhe një marrje e bazuar në një gabim fakti nuk ishte një shkelje në rrethana të tilla emergjente.

20. Vënia në lëvizje e procedurave emergjente që nuk lejojnë qoftë një kontroll efektiv gjyqësor të propozimeve të një organi administrativ, qoftë një pjesëmarrje të prindërve në procesin e vendim-marrjes cenon garancitë procedurale që përbëjnë, siç e ka theksuar Gjykata, pjesë thelbësore të nenit 8<sup>173</sup>. Këto garanci gjejnë zbatim edhe në fazën gjyqësore edhe në atë administrative të procedurave të kujdestarisë së fëmijës. Nuk ka rëndësi nëse procedurat emergjente janë përdorur për të përjashtuar

<sup>172</sup> Vendim i përfshirë në këtë botim.

<sup>173</sup> Shih vendimet e saj në lidhje me çështjet McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar, të 24 shkurtit 1995, dhe B kundër Mbretërisë së Bashkuar, të 24 prillit 2001.

autorizimin e mëparshëm gjyqësor, apo për të kërkuar miratimin e gjykatës për një plan emergjent me një paralajmërim në një afat të tillë që gjyqtari të mund të ketë pasur mundësi të kufizuara në dhënien e urdhrit të kërkuar për shkak të rrezikut të menjëhershëm që i kanosej fëmijës në qoftë se urdhri refuzohej. Gjykata i trajton këto çështje në mënyrë të tërthortë në këtë çështje. Kjo edhe për faktin se neni 6, i cili mund të kishte pasur një vlerë të madhe në lidhje me çdo diskutim mbi karakterin e drejtë të procedurave, nuk u shfrytëzua nga kërkuesit K. dhe T.

## **PINI DHE BERTANI & MANERA DHE ATRIPALDI kundër RUMANISË**

*(kërkesat nr. 78028/01 dhe 78030/01)*  
**22 qershor 2004**

*ky vendim ritheksoi parimin se në procedurat e adoptimit të fëmijëve rëndësi e veçantë i duhej kushtuar interesave më të mira të fëmijës.*

### **I. Faktet kryesore**

1. Kërkuesit janë katër shtetas italianë. Carlo Pini dhe Annalisa Bertani kanë lindur përkatësisht më 1957 dhe 1952 dhe jetojnë në Itali. Salvatore Manera dhe Rosalba Atripaldi kanë lindur respektivisht më 1951 dhe 1953 dhe gjithashtu jetojnë në Itali.
2. Në kohën e bërjes së kërkesave në Strasburg, kërkuesit kishin fituar të drejtën për të adoptuar dy vajza rumune, Florentina dhe Mariana. Vajzat kishin lindur më 1991 dhe ishin nëntë vjeç kur u miratua adoptimi i tyre nga Qendra e Edukimit “Poiana Soarelui” në Braşov (tani e tutje “CEPSB”). CEPSB është një institucion privat funksioni, i të cilit është t'u ofrojë strehë jetimëve dhe fëmijëve të braktisur, që të kujdeset për ta dhe t'u ofrojë edukim dhe arsimim.
3. Me ndërmjetësimin e një shoqate, kërkuesit filluan procedurat për adoptimin e Florentinës dhe Marianës, të cilat ishin deklaruar të braktisura me vendim gjykate kur kishin qenë përkatësisht tre dhe shtatë vjeç. Gjykata e rrethit të Braşovit, më 28 shtator 2000, vendosi adoptimin e vajzave si dhe ndryshimin e certifikatave të lindjes. Një apel që bëri Bordi Rumun i Adoptimeve ndaj këtij vendimi nuk u pranua dhe vendimi mori formë të prerë.
4. Kërkuesit u përpoqën që vendimi për adoptimin e vajzave të gjente zbatim, por CEPSB refuzonte që të jepte certifikatat e tyre dhe që t'ia kalonte kujdestarinë kërkuesve. Disa herë me radhë, përmbauesit e shoqëruar nga policë dhe në një pjesë të rasteve edhe nga vetë kërkuesit shkoi në selinë e CEPSB me qëllim që të ekzekutonte vendimin, por pa sukses.



5. Në shtator dhe nëntor 2002 Florentina dhe Mariana filluan procedurat për prishjen e vendimit të adoptimit me argumentimin se ato nuk i njihnin prindërit e tyre adoptues dhe nuk dëshironin të largoheshin nga Rumania dhe nga CEPSB. Padia e bërë nga Florentina nuk u pranua, *inter alia*, me argumentimin se nuk ishte në interes të saj që të prishej vendimi i adoptimit. Megjithatë, gjykata e rrethit të Braşovit pranoi padinë e Marianës dhe e prishi vendimin për adoptimin e saj pasi konstatoi se ajo po merrte një edukim të mirë dhe po jetonte në kushte të mira në CEPSB dhe se nuk kishte krijuar asnjë lidhje emocionale me prindërit e saj adoptues.

6. Baronesha Nicholson e Winterbourne, një relatores në Parlamentin Evropian, deklaroi se fëmijët nën kujdesin e CEPSB nuk duhet të largoheshin nga Rumania për t'iu bashkuar prindërve të tyre adoptues. Themeluesi i CEPSB ishte shprehur gjithashtu se asnjë prej fëmijëve të kësaj qendre nuk do të largohej pasi të gjithë ata ishin bërë pjesë e familjes së tij dhe kishte ardhur koha t'i jepej fund eksportit të fëmijëve nga Rumania.

7. Kërkuesit ankoheshin se e drejta e tyre për respektim të jetës së tyre familjare, e garantuar në bazë të nenit 8, ishte shkelur për shkak të vendosjes së fëmijëve të tyre J. dhe M në kujdes publik si dhe për shkak të masave vijuese të kujdestarisë. Ata u ankuan gjithashtu se nuk u ishte akorduar një mjet efektiv, i garantuar në bazë të nenit 13.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

8. Gjykata konstatoi se marrëdhënia ndërmjet prindërve adoptues dhe vajzave të tyre të adoptuara, e bërë në bazë të procedurave të rregullta të adoptimit, mund të konsiderohej e mjaftueshme për të kërkuar respektimin e ofruar nga ana e nenit 8 të Konventës. Ky nen pra gjente zbatim në këtë rast.

9. Për Gjykatën ishte mjaft e qartë se Florentina dhe Mariana tanimë preferonin që të rrinin në mjedisin social dhe familjar të CEPSB ku edhe ishin rritur dhe ku ato vlerësonin se ishin integruar plotësisht. Nga ana tjetër, ky institucion iu ofronte atyre një zhvillim fizik, emocional, arsimor dhe social më të mirë sesa perspektiva e transferimit të tyre gjetkë, në një mjedis tjetër.

10. Interesi i kërkuesve qëndronte në dëshirën e tyre për të krijuar një marrëdhënie të re familjare me vajzat e tyre të adoptuara. Sado legjitime që të ishte, dëshira e kërkuesve nuk mund të gëzonte një mbrojtje absolute. Për të arritur në përfundimin nëse autoritetet shtetërore kanë marrë të gjitha masat që mund të kërkohen normalisht prej tyre për të siguruar që një fëmijë të bashkohet me prindërit e tij, vëmendje kryesore i duhet kushtuar interesave më të larta të fëmijës.

11. Gjykata u shpreh se me të drejtë autoritetet rumune kanë vlerësuar se e drejta e kërkuesve për të krijuar lidhje familjare me vajzat e adoptuara nuk mund të kishte

përparësi ndaj interesave të këtyre të fundit, pavarësisht nga dëshirat legjitime të kërkuesve për të krijuar një familje. Për këtë arsye, ajo arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 8.

### **B. Në lidhje me neni 6 § 1**

12. Gjykata konstatoi se shkak i vetëm i dështimit të ekzekutimit të vendimit të adoptimit kishin qenë veprimet e personelit të CEPSB dhe anëtarëve të tij themelues.

13. Duke dështuar, për më se tre vjet, në marrjen e masave efektive për të respektuar vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe përfundimtare, autoritetet rumune mund të konsideroheshin përgjegjëse për veprimet e një institucioni privat që i kishte bërë pa vlerë dispozitat e nenit 6 § 1. Një përfundim i tillë ishte i pashmangshëm për shkak të pasojave të pakthyeshme që kishte sjellë kalimi i kohës që nga marrja e vendimit të adoptimit, në marrëdhëniet e mundshme midis kërkuesve dhe vajzave respektive të adoptuara. Gjykata me keqardhje vuri re se, megjithëse këto marrëdhënie nuk kishin marrë fund, perspektiva e lulëzimit të tyre tanimë dukej tepër e vakët, duke pasur parasysh se vajzat, tashmë 13 vjeç, kishin bërë të qartë së fundi se ato kundërshtonin hapur që të adoptoheshin dhe të shkonin për të jetuar në Itali.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

14. Gjykata i akordoi z. Pini dhe znj. Bertani 12 000 euro dhe z. Manera dhe znj. Atripaldi 10 000 euro shpërblim për dëm material dhe jomaterial. Ajo iu akordoi respektivisht atyre 7 000 euro dhe 6 000 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

## **III. Koment**

15. Gjatë leximit të këtij vendimi është e rëndësishme të kujtohet se konstatimi i një shkeljeje të nenit 6 apo edhe i nenit 8, nuk do të thotë që qeveria rumune është e detyruar që të marrë ndonjë veprim për të vënë në jetë dy adoptimet për të cilat bëhej fjalë në këtë çështje. Juridiksioni i Gjykatës lejon vetëm konstatimin e shkeljes dhe akordimin e shpërblimit të drejtë. Edhe në qoftë se do të kishte konstatuar shkelje të dy neneve të referuara në këtë çështje, Gjykata nuk do të kishte mundur të urdhëronte që vajzat të shkonin pranë prindërve të tyre adoptues në Itali. Megjithatë, logjika e efektit të këtij vendimi është interesante të krahasohet, nga pikëpamja e rolit të Gjykatës, qoftë me vendimin Broniowski kundër Polonisë<sup>174</sup>, qoftë me të gjitha rastet e ekstradimit apo të dëbimit, ku dispozitivi që vjen nga Strasburgu është shumë më orientues dhe i qartë. Çdo masë që autoritetet rumune morën dhe mund të marrin pas këtij vendimi mundet fare mirë t'i nënshtrohet përsëri shqyrtimit të Gjykatës për të kontrolluar respektimin e të drejtave të njeriut dhe sidomos të të drejtave themelore të fëmijëve.

16. Ky vendim ka të bëjë me një çështje tepër të rëndësishme – gjykatat që merren me të drejtën familjare janë të detyruara që në marrjen e vendimeve të tyre të

<sup>174</sup> Vendim i të njëjtës datë - 22 qershor 2004.

mbajnë parasysh në radhë të parë interesat e fëmijëve. Gjykatat rumune dhanë një vendim përfundimtar në një kohë që vajzat nuk kishin mbushur ende dhjetë vjeç dhe adoptimi ishte në interes të tyre, kështu që ishte më se i pranueshëm. Konflikti lindi pikërisht nga koha e tejzgatur e moszbatimit të një vendimi gjyqësor të marrë në interes të fëmijëve. Problemi konsistonte gjithashtu në mangësinë e autoriteteve rumune për të marrë çdo masë të përshtatshme për t'u mundësuar prindërve adoptues që të njiheshin me vajzat ose t'i përgatisnin psikologjikisht këto të fundit për transferimin e tyre social dhe familjar.

17. Për fat të keq, ky vendim tepër i gjatë (më se 200 paragrafë) ka një vlerë të kufizuar jurisprudenciale për shkak të kundërshtive brenda trupit gjykues që e dha atë. Pesë nga shtatë gjyqtarët e Dhomës që dhanë vendimin e panë të arsyeshme t'i bashkëngjisnin vendimit të shumicës, mendime të veçanta. Gjyqtarët Thomassen (Holandë) dhe Jungwiert (Republika Çeke) shprehën mendim të kundërt me pjesën themelore të vendimit duke u shprehur se testi për zbatueshmërinë e nenit 8 ishte së pari një test de facto. Sipas tyre, thjesht adoptimi ligjor i vajzave ishte element i pamjaftueshëm për të krijuar atë lloj familjeje që mbrohet nga Konventa dhe për këtë arsye neni 8 nuk gjen zbatim. Ata vlerësuan gjithashtu se neni 6 nuk mund të kërkonte ekzekutimin e një vendimi në qoftë se kjo do të çonte në shkelje të të drejtave të fëmijëve. Gjyqtari Birsan (Rumania), në mendimin e tij pjesërisht të kundërt, vlerësoi se ishte shumë e vështirë të pajtohej konstatimi i një mosshkeljeje të nenit 8 (për shkak se vendimet nuk ishin ekzekutuar) me konstatimin e shkeljes së nenit 6 në këtë çështje. Gjyqtari Loucaides (Qipro) u shpreh se ka pasur shkelje të nenit 8 përderisa autoritetet rumune, pasi kishin miratuar adoptimin e vajzave, kishin dështuar në respektimin e detyrimeve të tyre pozitive për zbatimin efektiv të adoptimit duke përgatitur psikologjikisht dhe mbështetur vajzat për këtë ndryshim në jetën e tyre. Ai vlerësoi se të gjitha pengesat e krijuara ndaj zbatimit efektiv të adoptimit ishin për faj të shtetit, dhe për këtë arsye Rumania kishte shkelur Konventën. Gjyqtari Costa (Francë) dha një mendim paralel.

## BELDJOUDI kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 12083/86)

26 mars 1992

*një masë jo proporcionale dëbimi, sado e ligjshme dhe për arsye legjitime çon në shkelje të nenit 8*

### I. Faktet kryesore

1. Z. Mohand Beldjoudi kishte lindur në Francë më 1950, nga prindër me origjinë algeriane të cilët, ashtu si ai vetë, e humbën shtetësinë e tyre franceze më 1963, pas fitimit të pavarësisë nga ana e Algjerisë. Ai ishte rritur në Francë dhe kishte jetuar

gjithmonë aty, në fillim me prindërit e tij dhe pastaj me Znj. Martine Teychene, qytetare franceze me të cilën ishte martuar më 1970 e cila mori edhe mbiemrin e tij. Prindërit dhe pesë vëllezërit dhe motrat e tij ishin të gjithë rezidentë francezë. Më 1969, 1974, 1977 dhe 1978, ai u dënua për shkelje të ndryshme, ndërmjet të cilave një vjedhje në rrethana rënduese për të cilën u dënua me tetë vjet heqje lirie.

2. Në nëntor 1979, Ministri i Brendshëm francez nxori ndaj tij një urdhër dëbimi me arsyetimin se prezenca e tij në territorin francez ishte e një natyre të tillë që vinte në rrezik rendin publik francez. Në prill 1988, Gjykata Administrative e Versajës hodhi poshtë padinë për anulimin e këtij urdhri, të paraqitur nga Z. Beldjoudi. Ndërkohë, në vitin 1986, ky i fundit ishte dënuar për shkelje të tjera të shumta dhe kishte kërkuar, më kot, më 1983 dhe më 1984, një vërtetim të shtetësisë franceze. Më 18 janar 1991, Këshilli i Shtetit e dëgjoi të interesuarin, në ankimin e vendimit të gjykatës administrative duke e lënë në fuqi vendimin e dënimit të tij me dëbim. Ndërkohë që ky vendim i fundit nuk ishte ekzekutuar ende Z. Beldjoudi mori një leje qëndrimi në rajonin e Senës së Sipërme. Nga ana tjetër akuza ndaj tij për fshehje të sendeve të vjedhura ishte ende në shqyrtim e sipër nga gjykatat franceze

3. Në kërkesën e tyre të datës 28 mars 1986 paraqitur Komisionit, zoti dhe zonja Beldjoudi pretendonin se masa e dëbimit ndaj të parit vinte në kundërshtim me disa nene të Konventës: nenin 8, për cenim të së drejtës së tyre për respektim të jetës private dhe familjare; nenin 3, sepse refuzimi i mundshëm i autoriteteve algjeriane për t'i dhënë z. Beldjoudi një pasaportë që ta lejonte të largohej nga Algjeria do të përbënte një trajtim çnjerëzor dhe degradues, nenin 14 të kombinuar me nenin 8, për diskriminim të bazuar në besimin fetar dhe në origjinën etnike të z. Beldjoudin nenin 9, për kufizim të lirisë së tyre të mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë, nenin 12, për mosnjohje të së drejtës së tyre për tu martuar dhe për të krijuar familje.

4. Në Raportin e tij të 6 shtatorit 1990, Komisioni hartoi një mendim sipas të cilit dëbimi i z. Beldjoudi shkelte të drejtën e tij dhe të bashkëshortes së tij për respektimin e së drejtës familjare sipas nenit 8, por njëzëri u shpreh se nuk shkelte nenin 3, dhe që nuk ka pasur as shkelje të nenit 14 të kombinuar me nenin 8 as të neneve 9 dhe 12.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8 të Konventës

#### *i. mbi jetën familjare të çiftit Beldjoudi*

5. Sipas Gjykatës, ekzekutimi i masës së dëbimit përbënte një ndërhyrje të një autoriteti publik në ushtrimin e së drejtës së kërkuësve për respektim të jetës së tyre familjare, e drejtë e garantuar nga ana e paragrafit 1 të nenit 8.

6. Në vijim Gjykata shqyrtoi nëse dëbimi objekt i mosmarrëveshjes i përmbushte apo jo kushtet e paragrafit 2 të të njëjtit nen në mënyrë që të mund të justifikohet. Baza ligjore e ndërhyrjes qëndronte, pa asnjë kundërshtim, në nenin 23 të urdhëresës të 2 nëntorit 1945 në lidhje me kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të të huajve në

Francë. Ndërhyrja në fjalë kishte synuar të arrinte qëllime plotësisht të pajtueshme me Konventën dhe pikërisht respektimin e urdhëresës dhe parandalimin e veprave penale. Përsa i përket nevojës në një shoqëri demokratike, e kaluara penale e z. Beldjoudi paraqitej shumë më e rënduar se ajo e z. Moustaquim<sup>175</sup>. Duke bërë krahasimin me këtë jurisprudencë të sajën të mëparshme, Gjykata kërkoi nëse rrethanat e çështjes - të përbashkëta për të dy kërkuesit ose të veçanta për ndonjërin prej tyre - mjaftonin që të kompensojnë këtë të dhënë të një rëndësie të konsiderueshme.

7. Duke pasur parasysh moshën e kërkuesve si dhe mungesën e fëmijëve në ngarkesë të tyre, ndërhyrja objekt i gjykimit prekte në radhë të parë jetën e tyre familjare si bashkëshortë. Ata ishin martuar në Francë që prej njëzet vjetësh, dhe kanë pasur gjithmonë po aty banesën e tyre bashkëshortore. Periudhat e heqjes së lirisë së z. Beldjoudi nuk e kishin ndërprerë jetën e tyre familjare, e cila gjithashtu mbrohet nga ana e nenit 8.

8. Z. Beldjoudi ka lindur në Francë nga prindër që në kohën e lindjes së tij kanë pasur shtetësi franceze, po ashtu si vetë ai, deri më 1 janar 1963. Një vit pas dënimit të tij të parë dhe nëntë vjet përpara marrjes së vendimit të dëbimit, ai nisi përpjekjet për të rimarrë shtetësinë franceze. Së dyti, ai ishte martuar me një shtetase franceze, dhe të gjithë familjarët e tij kishin pasur gjatë një kohe të caktuar shtetësinë franceze dhe kishin banuar në Francë që prej disa dhjetëra vjetësh. Së fundi, ai kishte kaluar në Francë të gjithë jetën e tij, që do të thotë më shumë se dyzet vjet, kishte ndjekur arsimimin në frëngjisht dhe nuk dukej se e njihnte gjuhën arabe. Ai nuk dukej se kishte me Algjerinë lidhje të tjera, përveç asaj të shtetësisë.

9. Përsa i përket znj. Beldjoudi, e lindur në Francë nga prindër francezë, ajo kishte banuar gjithmonë aty dhe kishte shtetësinë franceze. Në qoftë se do të ndiqte bashkëshortin e saj ajo do të duhej të vendosej në një vend të huaj, në Algjeri, shtet, gjuhën e të cilit ajo mund të mos e dinte. Një zhvendosje e tillë do të mund t'i shkaktonte vështirësi të mëdha përshtatjeje dhe vënien përballë pengesave reale praktike dhe deri juridike. Duke u nisur nga këto analiza Gjykata arriti në përfundimin se vendimi për të dëbuar z. Beldjoudi, në qoftë se do të gjente ekzekutim, nuk do të ishte në proporcion me qëllimin legjitim që ai ndjek dhe do të shkelte nenin 8.

*ii. mbi jetën private të zoti dhe zonja Beldjoudi*

10. Një përfundim i tillë e çliroi Gjykatën nga detyrimi për të vlerësuar nëse dëbimi shkelte gjithashtu të drejtën e të interesuarve për respektim të së drejtës së tyre për jetë private.

### **B. Në lidhje me nenin 14**

11. Parë konstatimin e shkeljes të nenit 8, Gjykata nuk e çmoi të nevojshme të

<sup>175</sup> Moustaquim kundër Belgjikës, vendim i Gjykatës i 18 shkurtit 1991 në lidhje me një çështje që kishte të bënte me rrethana të ngjashme me vendimin që po komentojmë dhe në të cilën vendosi se kishte shkelje të nenit 8 të Konventës.

studionte në vazhdim edhe pretendimin e diskriminimit, të bazuar në nenin 14, në lidhje me gëzimin e së drejtës së kërkuesve për respektim të jetës së tyre familjare.

### C. Në lidhje me nenet e tjera

12. Pretendimet në lidhje me nenet 3, 9 dhe 12, duke qenë se nuk u ngritën përsëri përpara saj, nuk u çmuan se duhet të merreshin në shqyrtim *ex officio* nga Gjykata.

### D. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht nenit 41)

13. Kërkuesit pretenduan 10 000 000 franga franceze për shkakim dëmi moral. Gjykata pranoi se ata duhet të kishin pësuar një dëm moral, por ajo njëzëri gjykoi se ky është kompensuar në mënyrë të mjaftueshme nga vendimi i saj. Në lidhje me shpenzimet dhe detyrimet financiare të përballuara gjatë procedurës para organeve të Konventës, ajo e gjeti me vend të akordonte 60 000 FF.

## III. Koment

14. Ky është një vendim tepër interesant sidomos për të kuptuar teknikën e analizës nga ana e Gjykatës për një shkelje të neneve që parashikojnë të drejta të ashtuquajtura të cilësuar të njeriut, siç është edhe e drejta për jetë familjare. Vendimi i Gjykatës merr me radhë në vlerësim elementët e grilës vlerësuese të shkeljes apo jo të një të drejte të cilësuar duke filluar me elementin e ekzistencës së ndërhyrjes, më tej parashikueshmërisë ligjore, legjitimitetit të arsyeve për të cilat bëhet ndërhyrja, karakterit të nevojshëm të ndërhyrjes konkrete në një shoqëri demokratike dhe duke përfunduar me parimin e proporcionalitetit. Është pikërisht në bazë të këtij parimi të fundit që Gjykata arrin në përfundimin se në rastin në fjalë ka pasur shkelje të jetës familjare të kërkuesit në marrëdhëniet me bashkëshorten e tij pasi masa e marrë, në qoftë se do të kishte prodhuar pasojat e veta, do ta kishte vënë z. Beldjoudi në një situatë tepër të rëndë e që nuk përlligjej nga qëllimi dhe nevojat për të cilat masa ishte marrë.

15. Komenti që bëj në vendimin paraardhës në këtë botim, Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, thekson se e drejta për jetë familjare nuk arrin deri aty sa t'u japë të drejtë çifteve që jetojnë së bashku në një familje, që të zgjedhin vendbanimin e tyre. Megjithatë, po aty i lë vend konkluzionit që vjen nga vendimi Beldjoudi dhe nga të tjera vendime të Gjykatës në lidhje me largimin e një pjese të familjes jashtë territorit të një shteti anëtar – largime të tilla, në varësi të arsyeve dhe të rrethanave, mund të çojnë në shkelje të së drejtës për jetë familjare, eventualisht edhe private, të mbrojtura nga ana e nenit 8 të Konventës<sup>176</sup>.

<sup>176</sup> Vendimet Berrehab kundër Holandës, Moustaquim kundër Belgjikës, Boulouf kundër Zvicrës (ky i fundit i përfshirë në këtë përmbledhje) ku Gjykata vendos për shkelje por edhe El Boujaidi kundër Francës ku Gjykata vendos se nuk ka pasur shkelje sepse ndërhyrja nuk ka qenë jo proporcionale në raport me qëllimin e ndjekur.



## BOULTIF kundër ZVICRËS

(kërkesa nr. 54273/00)

2 gusht 2001

*dëbimi i një personi mund të cenojë të drejtën e tij për jetë familjare në qoftë se nuk mbahen parasysh me kujdes rrethanat në të cilin jepet vendimi i dëbimit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Abdelouahab Boulfif, është një shtetas algjerian. Ai kishte hyrë në Zvicër me një vizë turistike në dhjetor 1992. Në 19 mars 1993 ai u martua me M.B., shtetase zvicerane.

2. Më 1994 kërkuesi u akuzua për veprat penale të pengmarrjes dhe dëmtimit të pronës të kryera në Zyrih. Në janar 1997 gjykata e shkallës së parë e dënoi kërkuesin me dy vjet burg për shkak se e gjeti fajtor për këto dy vepra penale. Më 11 maj 1998 ai filloi vuajtjen e dënimit. Më 19 maj të të njëjtit vit autoritetet zvicerane refuzuan t'i rinovojnë lejen e tij të qëndrimit. Kundër këtij vendimi kërkuesi u ankua në gjykatën administrative por kërkesa e tij nuk u pranua. Gjykata administrative vlerësoi se mosrinovimi i lejes së qëndrimit ishte bërë për arsye të interesit të rendit dhe të sigurisë publike; megjithëse ai mund të çonte në ndarje të kërkuesit nga e shoqja, ata mund të jetonin së bashku në një vend tjetër ose ta vizitonin njëri-tjetrin herë pas here. As ankimi në Gjykatën Federale nuk u pranua.

3. Në 3 dhjetor 1999 Zyra Federale për të Huajt e urdhëroi z. Boulfif që të largohej nga Zvicra brenda 15 janarit 2000. Në një datë të pasaktësuar të vitit 2000 ai u largua nga Zvicra dhe aktualisht jeton në Itali.

4. Kërkuesi ankohej se autoritetet zvicerane nuk e kishin rinovuar lejen e tij të qëndrimit. Për pasojë ai ishte ndarë nga e shoqja, e cila është shtetase zvicerane dhe nuk mund të pritej që të shkonte pas tij në Algjeri. Ai bazohej, për pretendimin e tij në nenin 8 të Konventës.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 8

5. Gjykata kujtoi se nuk garantohet si e tillë nga Konventa, e drejta e një të huaji për të hyrë ose qëndruar në një vend të caktuar. Megjithatë, largimi i një personi nga vendi në të cilin jetojnë të afërm të familjes së tij mund të përbëjë një shkelje të së drejtës së respektimit për jetë familjare të garantuar në nenin 8 § 1 të Konventës. Një ndërhyrje e tillë do të shkelë Konventën në qoftë se ajo nuk përmbush kërkesat e paragrafit 2 të nenit 8.

6. Gjykata e vlerësoi faktin që ndërhyrja ishte “në përputhje me të drejtën e brendshme”, dhe motivohej nga një qëllim legjitim – “parandalimi i krimit dhe i prishjes së rregullit”. Në vijim të këtyre konstatimeve ajo vazhdoi me vlerësimin e elementit nëse ndërhyrja në fjalë ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

7. Detyra e Gjykatës në këtë drejtim konsistonte në vlerësimin e faktit nëse, refuzimi për të rinovuar lejen e qëndrimit të kërkuesit në rrethanat e lartpërmendura, ruante një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesave që ishin në lojë, pra së drejtës së kërkuesit për të respektuar jetën e tij familjare, nga njëra anë, dhe parandalimin e krimit dhe të prishjes së rregullit, nga ana tjetër.

8. Gjykata ka pasur rast të vendosë veçse në një masë të kufizuar që pengesa kryesore për dëbimin është vështirësia për të martuarit që të jetojnë së bashku dhe në veçanti për bashkëshorten dhe fëmijët që të largohen në vendin e origjinës së burrit. Ishte pra e nevojshme që të vendoseshin parimet themelore për të vlerësuar nëse një masë e tillë ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike.

9. Në vlerësimin e kriterëve të zbatueshme në një rast të tillë, Gjykata do të duhet të vlerësojë natyrën dhe seriozitetin e shkeljes të kryer nga kërkuesi, kohëzgjatjen e qëndrimit të kërkuesit në vendin nga i cili ai synohet të dëbohet, periudhën që ka kaluar që kur është kryer shkelja si dhe sjelljen e kërkuesit gjatë kësaj periudhe, shtetësitë e personave të ndryshëm që mund të preken nga një vendim i tillë dëbimi, situata familjare e kërkuesit, si për shembull kohëzgjatja e martesës dhe faktorët e tjerë që shprehin efektivitetin e jetës familjare në çift, faktin nëse bashkëshorti/bashkëshortja ishte në dijeni për kryerjen e veprës penale në kohën kur hyri në një marrëdhënie familjare me personin, nëse ka fëmijë nga martesja e tyre dhe nëse po, mosha e këtyre fëmijëve. Natyrisht që Gjykata do të marrë gjithashtu parasysh edhe seriozitetin e vështirësive që bashkëshorti/bashkëshortja do të përballojnë në vendin e origjinës së bashkëshortes/bashkëshortit, megjithëse thjesht fakti që një person mund të haset me disa vështirësi për shkak se ndjek bashkëshortin e vet, nuk mund ta përjashtojë në vetvete një dëbim.

10. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vlerësoi se kërkuesi i ishte nënshtruar një pengese serioze për krijimin e një jete familjare, përderisa ishte praktikisht e pamundur për të që të jetonte me familjen e vet jashtë Zvicrës. Kjo në mënyrë të veçantë për mënyrën krejt të ndryshme të jetesës në vendin e tij të origjinës. Për më tepër, kur autoritetet zvicerane kishin vendosur që të refuzonin rinovimin e lejes së tij të qëndrimit, kërkuesi përbënte një rrezik shumë më të kufizuar ndaj rendit publik. Për këtë arsye, pra, ndërhyrja nuk ishte në proporcion me qëllimin e ndjekur dhe kishte shkelje të nenit 8 të Konventës.

### ***B. Në lidhje me nenin 41***

11. Gjykata i akordoi kërkuesit 534 670 franga zvicerane për shpenzime dhe pagesa gjyqësore.

### III. Koment

12. Ky vendim përbën një zhvillim shumë të rëndësishëm në jurisprudencën e Gjykatës në kuadrin e nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ai është i rëndësishëm së pari për shkak se ai parashtron kriteret e zbatueshme që duhen marrë parasysh në raste kur një person ka një familje në një shtet por ka kryer atje një vepër penale dhe nuk ka një leje për të qëndruar më gjatë.

13. Por vendimi është i rëndësishëm edhe për shkak se ai nxjerr në pah rolin e shtetësisë së personave që preken nga ky vendim si dhe situatat e tyre personale. Vendimi i Gjykatës mban parasysh faktin që marrëdhëniet ndërmjet çifteve dhe martesat natyrisht që bëhen ndërmjet personave me shtetësi dhe origjina kombëtare të ndryshme dhe pavarësisht nga mospërputhjet e mundshme ndërmjet vendeve përkatëse apo ndryshimeve të tjera ndërmjet tyre. Këto mospërputhje dhe ndryshime mund të kenë një ndikim në lidhje me mundësinë e tyre për ta vazhduar jetën familjare të çiftit edhe në këtë vend tjetër. Në lidhje me vazhdimin e kësaj jete familjare mund të ndikojnë gjithashtu, ndryshimet në kulturë apo në gjuhë.

14. Gjykata, në vlerësimin e faktit nëse dëbimi i një personi në drejtim të vendit të tij të origjinës përbën apo jo shkelje të nenit 8, do të shqyrtojë edhe mundësitë e familjes për të jetuar bashkë në këtë vend tjetër. Në raste kur ka pengesa reale si për shembull mungesa e lidhjeve për disa nga anëtarët e familjes apo vështirësi në gjuhë, ka mundësi që Gjykata të arrijë në përfundimin se familja nuk mund të pritët që ta ndjekë personin që dëbohet dhe se ndërhyrja ndaj jetës familjare nuk është në përputhje me qëllimin duke pasur parasysh se faktorë të tjerë, si një e kaluar kriminale, nuk arrijnë ta justifikojnë atë.

15. Një zbatim dhe interpretim i tillë i nenit 8 kërkon gjithmonë një vlerësim të kujdesshëm nga ana e vendimmarrësve përderisa duhen peshuar të gjithë faktorët që kanë rol në këtë kuadër. Por është gjithsesi e qartë nga ky vendim se e drejta e shteteve për të vendosur se kush jeton në territorin e tyre nuk është absolute dhe kjo veçanërisht në rastet kur individi i interesuar ka krijuar një marrëdhënie me një shtetas/shtetase të këtij shteti.

## RADOVANOVIC kundër AUSTRISË

(kërkesa nr. 42703/98)

22 prill 2004

*në këtë çështje u vendos se ishte shkelur e drejta për jetë familjare për shkak të ndalimit të pakufizuar në kohë për të banuar në një vend të caktuar*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Jovo Radovanovic, është shtetas i Serbisë dhe Malit të Zi, i cili ka lindur në Vjenë më 1979 dhe aktualisht jeton në Serbi.

2. Në Vjenë ai kishte kaluar shtatë muajt e parë të jetës së tij bashkë me prindërit, të cilët ishin shtetas Serbo-Malazezë dhe me leje qëndrimi të rregullta në Vjenë. Më pas ai u largua për të jetuar me gjyshërit e tij në ish Jugosllavi, tani Serbi e Mali i Zi, ku edhe përfundoi shkollën fillore. Ai i kalonte pushimet e tij me prindërit në Austri dhe kur ishte 10 vjeç, u kthye për të jetuar me ta dhe motrën e tij në Austri. Këtu ai përfundoi shkollën tetëvjeçare dhe një trajnim profesional për kasap. Më 5 maj 1993 ai mori një leje qëndrimi për një periudhë të pakufizuar.

3. Më 30 korrik 1997, Gjykata e të Miturve e Vjenës e dënoi kërkuesin për vjedhje dhe grabitje në rrethana rënduese dhe e dënoi me 30 muaj burg, 24 nga të cilët me kusht. Më 30 shtator 1997, në bazë të Ligjit për të Huajt të vitit 1992, ndaj tij u mor edhe një urdhër për heqjen e lejes së qëndrimit për një periudhë të pakufizuar.

4. Z. Radovanovic e vuajti dënimin e tij në burg deri në 14 tetor 1997. Pas kësaj date ai u transferua në një qendër izolimi në pritje të dëbimit. Ankesat e tij të shumta ishin të pasuksesshme dhe, më 4 shkurt 1998, ai u dëbua drejt ish Republikës Federale të Jugosllavisë.

5. Kërkuesi ankohej se ndalimi i qëndrimit të tij për një periudhë të pakufizuar përbënte shkelje të nenit 8.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 8

6. Pa kundërshtuar natyrën serioze të veprave për të cilat ishte akuzuar kërkuesi, Gjykata vuri në dukje se ai i kishte kryer ato kur kishte qenë i mitur, se ai kishte një të kaluar të pastër penale dhe se pjesa më e madhe e dënimit të tij të rëndë ishte dhënë me kusht. Për këto arsye Gjykata nuk ishte e bindur se kërkuesi përbënte një rrezik serioz ndaj publikut, të tillë që të kërkonte marrjen e masës së ankimuar.

7. Duke pasur parasysh faktin që kërkuesi kishte lindur në Austri, ku më vonë, ndërsa jetonte me familjen e tij përfundoi gjithashtu edhe shkollën tetëvjeçare dhe një trajnim profesional, faktin që familja e tij ishte prej një kohe të gjatë banore e ligjshme në Austri dhe se vetë kërkuesi kishte pasur një leje qëndrimi të pakufizuar në kohën që kreu veprën penale, si dhe duke konsideruar që, pas vdekjes së gjyshërve të tij në Serbi dhe Mal të Zi, ai nuk kishte më asnjë të afërm tjetër atje, Gjykata vendosi se lidhjet e tij familjare dhe sociale me Austrinë ishin më të forta se me Serbinë dhe Malin e Zi.

8. Për këto arsye Gjykata vlerësoi se heqja e lejes së qëndrimit për një periudhë të pakufizuar ishte një masë tejet e ashpër. Sipas saj një masë më e butë, si heqja e lejes së qëndrimit për një periudhë të kufizuar kohe, mund të kishte mjaftuar. Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet austriake, duke hequr lejen e qëndrimit për një periudhë të pakufizuar, nuk kishin ruajtur një baraspeshë të drejtë ndërmjet interesave që ishin në lojë në këtë çështje dhe se mjetet e përdorura nuk ishin në

proporcion me qëllimin e ndjekur. Për këtë arsye Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8. Gjykata vendosi gjithashtu se aspekti i shpërblimit të drejtë nuk ishte gati për zgjidhje.

### III. Koment

9. Në këtë çështje Gjykata konstatoi se Austria ishte përgjegjëse për shkeljen e të drejtave të një shtetasi të Serbisë dhe Malit të Zi. Fakti që një individ nuk ka përse të ketë shtetësinë e shtetit ndaj të cilit ai po ankohet përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, rrjedh nga detyrimi i parashikuar në nenin 1 të Konventës që t'i sigurojnë *çdokujt që ndodhet në juridiksionin e tyre* të drejtat dhe liritë e përcaktuara në titullin e I të kësaj Konvente. Individët që pretendojnë se një shtet ka shkelur të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara nga Konventa nuk kanë përse të jenë shtetas të një shteti anëtar të Këshillit të Evropës apo të Konventës. Madje ata as nuk ka përse të jenë detyrimisht fizikisht të pranishëm në territorin e shtetit ndaj të cilit ankohen, dhe në qoftë se janë, nuk ka përse të jenë në mënyrë të ligjshme.

10. Tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar e cila pranon se e drejta për respektimin e së drejtës private dhe familjare mund të shkelet kur një shtet dëbon një të huaj ose apatrid nga territori i tij, në qoftë se me këtë akt ai ndan një familje ekzistuese. Ashtu siç e vë në dukje edhe Gjykata në këtë çështje në lidhje me emigrantët e gjeneratës së dytë që nuk kanë krijuar një familje të tyre në vendin pritës ajo zbaton disa kritere të veçanta. Këto kritere përfshijnë natyrën dhe ashpërsinë e veprës penale që kërkuesi ka kryer, kohëzgjatjen e qëndrimit në vendin përkatës si dhe lidhjet familjare dhe sociale që kërkuesi ka krijuar në vendin pritës me anë të shkollimit ose kalimit të një pjese të konsiderueshme të rinisë së tij atje.





# NENI 9

**LIRIA E MENDIMIT,  
NDËRGJEGJES DHE FESË**

## KOKKINAKIS kundër GREQISË

(kërkesa nr. 14307/88)

25 maj 1993

*liria e mendimit, besimit dhe e fesë përfshin gjithashtu përpjekjet për të bindur persona të tjerë në lidhje me përfaqimin e tyre*

### I. Faktet kryesore

1. Z. Minos Kokkinakis, me shtetësi greke, biznesmen i dalë në pension, ka lindur më 1919 në një familje të besimit ortodoks. I shndërruar në dëshmitar të Jehovahit më 1936, ai ka qenë arrestuar më se gjashtëdhjetë herë për proselitizëm. Përveç kësaj ai ka qenë internuar dhe burgosur disa herë.

2. Më 2 mars 1986, ai dhe gruaja e tij shkuan në shtëpinë e znj. Kyriakaki, e krishterë ortodokse, në Sitia (Kretë), ku hapën me të një bisedë gjatë së cilës z. Kokkinakis u përpoq që ta konvertojë atë, sidomos duke i lexuar disa pasazhe të disa librave si dhe duke i ofruar asaj shumë libra të tjerë. Bashkëshorti i znj. Kyriakaki lajmëroi policinë, e cila i arrestoi dhe i vendosi në gjendje arresti bashkëshortët Kokkinakis. Të dy u akuzuan për akte proselitizmi, të ndaluara nga neni 4 i Ligjit 1363 të vitit 1938, i cili ishte miratuar gjatë diktaturës së Metaxas (1936-1940). Më 20 mars 1986, Gjykata Penale e Lassithit i dënoi me nga katër muaj heqje lirie secilin, të konvertueshëm në 400 dhrahmi për ditë heqje lirie, dhe një gjobë prej 10 000 dhrahmish. Më 17 mars 1987, Gjykata e Apelit të Kretës, e mbledhur me kërkesë të të dënuarve, e konsideroi të pafajshme znj. Kokkinakis por konfirmoi fajësinë e bashkëshortit të saj, të cilit ajo ia reduktoi dënimin me heqje lirie në tre muaj dhe e konvertoi në një sanksion pasuror prej 400 dhrahmish për ditë heqje lirie. I interesuari iu drejtua Kasacionit, por kërkesa iu hodh poshtë në prill 1988.

3. Simbol i ruajtjes së gjuhës dhe të kulturës greke gjatë afro katër shekujsh të pushtimit osman, Kisha ortodokse lindore e Krishterimit ka marrë pjesë aktivisht në luftërat e popullit grek për emancipimin e tij, deri në një shkallë të tillë sa ekziston një farë identifikimi i helenizmit në ortodoksinë. Kushtetutat e njëpasnjëshme greke i atribuuan Kishës në fjalë një karakter "dominues". Duke përfaqësuar shumicën dërrmuese të popullsisë, ajo mishëron sipas saj, sipas ligjit dhe sipas faktit, besimin e vetë shtetit duke marrë përsipër nga ana tjetër edhe një numër të mirë funksionesh të karakterit administrativ apo edukativ. Kushtetutat e viteve 1844, 1864, 1911 dhe 1952 e ndalonin "proselitizmin dhe çdo lloj ndërhyrjeje tjetër kundër fesë dominuese". Ndërsa Kushtetuta e vitit 1975 e ndalon proselitizmin, këtë herë në mënyrë të përgjithshme: ai ka të bëjë me "çdo fe të njohur", do të thotë dogmat e të cilës nuk janë të pranuar nga kishat e krishtera dhe që nuk u imponon atyre që nuk besojnë asnjë besim sekret.

4. Në kërkesën e tyre të 22 gushtit 1988 drejtuar Komisionit, z. Kokinakis pretendoi se dënimi i tij për proslitizëm mohonte të drejtat e garantuara nga nenet 7, 9 dhe 10 të Konventës. Ai u referua gjithashtu neneve 5 § 1 dhe 6 §§ 1 dhe 2 të Konventës.

5. Më 7 dhjetor 1990, Komisioni e pranoi kërkesën me përjashtim të pretendimeve që kishin të bënin me nenet 5 dhe 6. Në raportin e tij të 3 dhjetorit 1991, ai hartoi mendimin sipas të cilit nuk ka pasur shkelje të nenit 7, që ka pasur shkelje të nenit 9, dhe se nuk shtrohej asnjë çështje e veçantë nën këndvështrimin e nenit 10.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 9

6. E mbrojtur nga neni 9, liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë përfaqëson një prej themeleve të një “shoqërie demokratike” sipas kuptimit të Konventës. Ajo renditet ndërmjet elementëve më thelbësorë të identitetit të besimtarëve dhe të konceptit të tyre për jetën, por është gjithashtu edhe një gjë e çmuar për ateistët, agnostikët, skeptikët apo indiferentët. Në veçanti liria e fesë nënkupton atë të “manifestimit të fesë” jo vetëm në mënyrë kolektive por edhe “individualisht” dhe “në mënyrë private”; ajo nënkupton në vetvete kryesisht të drejtën për të provuar të bindësh fqinj, për shembull me anë të një “mësimi”. Karakteri themelor i të drejtave të garantuara nga ana e nenit 9 del në pah gjithashtu nga mënyra e formulimit të klauzolës që lidhet me kufizimin e tyre: në ndryshim nga paragrafi i dytë i neneve 8, 10 dhe 11, që përfshin tërësinë e të drejtave të përmendura në paragrafët e tyre të para, paragrafi i dytë i nenit 9 ka të bëjë veçse me “lirinë për të shfaqur fenë ose bindjet e tij”.

#### a) A kishte ndërhyrje?

7. Pasi parashtrroi në fillim parimet e saj të përgjithshme, Gjykata shqyrtoi zbatueshmërinë e tyre në rastin në fjalë. Dënimi i shpallur nga ana e Gjykatës Penale të Lassithit, i ulur më pas nga ana e Gjykatës së Apelit të Kretës, u analizua si një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së z. Kokkinakis të “lirisë së shfaqjes së besimit ose bindjeve të tij”.

#### b) A ishte ndërhyrja e ligjshme?

8. A ishte kjo ndërhyrje e parashikuar nga ligji? Gjykata konstatoi ndërkaq se gjuha e ligjeve nuk paraqet një saktësi absolute. Për shkak të nevojës për të shmangur një ngurtësi të tepruar dhe për t'iu përshtatur ndryshimeve të rrethanave, shumë prej tyre përdorin formula pak a shumë të përgjithshme interpretimi, dhe zbatimi i të cilave varet nga ana e praktikës. Në rastin në fjalë, neni 4 i Ligjit nr. 1363 të vitit 1938 ishte plotësuar nga një jurisprudencë e qëndrueshme e juridiksioneve greke, jurisprudencë që ishte botuar dhe që mund të gjendej.

#### c) A ishte ndërhyrja legjitime?

9. Në vazhdim duhej parë nëse masa e ankimuar ndiqte apo jo qëllime legjitime nën këndvështrimin e nenit 9 § 2 - mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

*d) A ishte ndërhyrja e nevojshme?*

10. Përsa i përket nevojës në një shoqëri demokratike, është e domosdoshme që të bëhet dallimi ndërmjet dëshmisë të krishterë dhe proselitizmit abuziv. I pari i korrespondon evangjelizimit të vërtetë; i dyti përfaqëson shtrembërimin ose deformimin e tij dhe nuk përputhet me respektimin e duhur ndaj lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë të tjetrit. Kriteret e pranuar në fushën e proselitizmit nga ana e legjislatorit grek do të mund të konsideroheshin si të pranueshme deri në masën që ato do të kishin për synim që të ndalonin vetëm proselitizmin abuziv, përkufizimi i të cilit në parim nuk shtrohej si çështje në rastin në fjalë.

11. Gjykata vuri në dukje, nga ana tjetër, se juridiksionet greke kanë vendosur për përgjegjësinë e kërkuesit për arsye që kufizoheshin vetëm në ripërsëritjen e termave të nenit 4, të ligjit nr. 1363 të vitit 1938 pa saktësuar në mënyrë të mjaftueshme se në lidhje me çfarë i dënuari kishte bërë përpjekje për të bindur fqinjën e tij me mjete abuzive. Asnjë prej fakteve që ato kanë relatuar nuk lejon që të konstatohet një gjë e tillë. Prej këtui, nuk ka qenë vërtetuar se dënimi i z. Kokkinakis justifikohet me një nevojë sociale imperative. Pra si përfundim, ka pasur në këtë rast shkelje të nenit 9.

**B. Në lidhje me nenin 7**

12. Neni 7 § 1 nuk kufizohet në ndalimin e zbatimit prapaveprues të së drejtës penale në dëm të të akuzuarit. Ai shpall gjithashtu, në mënyrë më të përgjithshme, parimin e ligjshmërisë të veprave penale dhe të dënimeve, si dhe parimin që kërkon që të mos zbatohet ligji penal në kuptim të gjerë në dëm të të akuzuarit, sidomos kjo për analogji. Rezulton prej tij pra që një shkelje duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë të qartë nga ligji.

13. Në rastin në fjalë, kërkuesi mund të dinte, duke u nisur nga gjuha e nenit 4 të ligjit 1363 të vitit 1938 dhe, sepse i nevojitej për ta referuar për interpretim përpara gjykatave, se çfarë aktesh angazhonin përgjegjësinë e tij. Nuk ka pasur pra shkelje të nenit 7.

**C. Në lidhje me nenin 10 dhe me nenin 9 ndërthurur me nenin 14**

14. Duke pasur parasysh vendimin e saj në lidhje me nenin 9, Gjykata nuk vlerësoi se ishte e nevojshme që të shqyrtonte ankesat e formuluar për shkelje të nenit 10 dhe të nenit 14 të kombinuar me nenin 9.

**D. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)**

15. Në bazë të nenit 50, Gjykata i akordoi z. Kokkinakis 400 000 dhrahmi për dëm moral. Në lidhje me shpenzimet dhe me detyrimet financiare të paguara në Greqi dhe më pas përpara organeve të Konventës, Gjykata i akordoi atij 2 789 500 dhrahmi.

### III. Koment

16. Vlen të përmendet në komentimin e kësaj çështje mendimi pjesërisht i kundërt i gjyqtarit Pettiti i cili e konsideron këtë si “*të parin rast real në lidhje me lirinë e besimit*”

që është paraqitur përpara Gjykatës Evropiane". Për këtë arsye, sipas tij, shumica e Gjykatës "mund të kishte qartësuar më mirë se neni 9 i Konventës gjen zbatim edhe në lidhje me besime filozofike jofetare dhe se zbatimi i tij duhet t'i mbrojtë njerëzit nga abuzimet që bëhen nga disa sekte". Ndërsa shumica e Gjykatës vendosi se kishte shkelje të nenit 9 në lidhje me faktin se masa e marrë nga gjykatat greke nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe pra nuk ishte proporcionale, gjyqtari Pettiti u shpreh se në fakt ligji grek që ndalonte proselitizmin nuk ishte aq i qartë sa duhej, dhe kishte pasur kështu shkelje të nenit 9 të Konventës në këtë pikë – masa nuk ishte parashikuar me ligj – i cili duhet të jetë mjaft i qartë dhe i saktë nga pikëpamja e formulimit normativ sa të orientojë sjelljen dhe qëndrimin e subjekteve të së drejtës. Sipas gjyqtarit Pettiti një formulim ligjor si "proselitizmi që nuk është i respektuar", i zbatuar pa ndonjë përpunim dhe sqarim të mëtijshëm nga gjykatat greke nuk i përgjigjet kërkesave të Konventës për ligjshmëri.

17. Gjyqtari De Meyer arriti deri aty sa të përdorte përkufizimin e fjalorit të gjuhës frënge Le Petit Robert në lidhje me proselitizmin. Ndërsa gjyqtari Martens pasi bën një analizë të kujdesshme të fakteve mban një qëndrim, në parim, sipas të cilit ishte në kundërshtim me nenin 9 të Konventës parashikimi si vepër penale i përpjekjeve të bëra nga disa persona për të bindur persona të tjerë për ndryshimin e besimit të tyre. Ai arrinte në konkluzionin se Greqia ishte i vetmi vend anëtar i Konventës që e parashikonte si vepër penale një akt të tillë<sup>177</sup>. Ndërsa nga ana tjetër gjyqtari grek Valtikos dhe gjyqtarët Foighel dhe Loizou nuk ishin dakord me këtë qëndrim duke u shprehur se ligji grek mbi përcaktimin e proselitizmit ishte në përputhje me nenin 9 të Konventës.

18. Sidoqoftë, përtej rastit specifik vendimi ka rëndësi për një element thelbësor në interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe të konceptit të shtetit të së drejtës në përgjithësi – konceptin e ligjit. Ky vendim na bën të qartë se për qëllimet e Konventës dhe të nocionit të shtetit ligjor në kuptimin evropian nuk mjafton një akt i veshur me një formë të caktuar normative dhe i konsideruar si akt normativ nga autoritetet vendore. Që ligji të plotësojë kërkesat e këtij nocioni sipas këndvështrimit evropian duhet që të përmbushë disa kritere në lidhje me mënyrën e formulimit përse i përket saktësisë dhe qartësisë. Kjo ishte edhe një arsye e fortë – në lidhje me nocionin e proselitizmit - që e bëri një pjesë të Gjykatës së Strasburgut të votonte për shkelje të Konventës në këtë rast.

<sup>177</sup> Në fakt nuk është e rastit që pjesa më e madhe që Gjykata e Strasburgut ka marrë në shqyrtim në lidhje me lirinë e fesë kanë qenë kundër Greqisë. Mjafton të shihen vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet Manoussakis, Serif (të përfshira në këtë botim), Larissis, Valsamis, Efstratiou, Tsirlis dhe Kouloumpas, Kalaç dhe Pentidis, të gjitha kundër Greqisë, disa nga të cilat përbëjnë edhe pjesën themelore në jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me nenin 9.

## ŞAHIN kundër TURQISË

(kërkesa nr. 44774/98)

29 qershor 2004

Dhomë e Madhe

*ndalimi i mbajtjes së shamisë myslimane në institucionet akademike publike mund të justifikohet si masë e nevojshme në një shoqëri demokratike*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkesja, Leyla Şahin, është shtetase turke që ka lindur më 1973 dhe që aktualisht jeton në Vjenë. Ajo u largua nga Turqia më 1999 me qëllim që të ndiqte studimet në fakultetin e mjekësisë të Universitetit të Vjenës. Duke qenë se rrjedh nga një familje që tradicionalisht ka praktikuar fenë myslimane, ajo mban vazhdimisht shaminë islamike me qëllim që të respektojë një zakon fetar.

2. Në kohën e ngjarjeve për të cilat ankohet, ajo ishte studente në vitin e pestë të fakultetit të mjekësisë të Universitetit të Stambollit. Më 23 shkurt 1998, Zëvendës Kancelari i Universitetit nxori një urdhëresë e cila, *inter alia*, parashikonte që: “në bazë të Kushtetutës, të ligjeve dhe rregulloreve, dhe në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës së Lartë Administrative dhe të Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut dhe me rezolutat e miratuara nga bordet administrative të universitetit, studentët që i mbulojnë ‘kokat’ e tyre (që venë shami islamike)...nuk duhen pranuar në leksione, kurse ose seminare”.

3. Për pasojë, në mars 1998 kërkesja u refuzua që të merrte pjesë në një provim me shkrim pikërisht sepse mbante një shami islamike. Për të njëjtën arsye, asaj iu refuzuan në vijim regjistrimi ose pranimi në disa lëndë, si dhe pjesëmarrja në një provim me shkrim në një lëndë.

4. Nga ana tjetër, në maj 1998 zëvendëskancelari i fakultetit e paralajmëroi për shkak se ajo kishte shkelur uniformën e universitetit dhe e përjashtoi nga procesi mësimor për shkak të pjesëmarrjes së saj në një tubim të paautorizuar të organizuar në protestë ndaj rregullave të veshjes në universitet. Pas hyrjes në fuqi të një ligji amnistues, sanksionet disiplinore ndaj kërkueses u anuluan.

5. Znj. Şahin iu drejtua Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut më 2 mars 1998 dhe çështja iu kalua Gjykatës së re datën kur kjo hyri në funksion – më 1 nëntor 1998. Ajo ankohej për ndalimin e mbajtjes së shamisë islamike që sipas saj përbënte shkelje të së drejtës për lirinë mendimit, besimit dhe fesë, të garantuar nga neni 9 i Konventës, për shkelje të së drejtës për edukim, sipas kuptimit të nenit 2 të Protokollit



1, për shkelje të nenit 14 të interpretuar së bashku me nenin 9 për shkak se sipas saj në lidhje me uniformat universitare kishte diskriminim midis besimtarëve dhe jobesimtarëve. Ajo ankohej gjithashtu për shkelje të neneve 8 dhe 10 të Konventës. Kërkesa u deklarua e pranueshme më 2 korrik 2002.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 9

#### a. A kishte ndërhyrje?

6. Gjykata nuk preferon t'i hyjë debatit nëse mbajtja e përherëshme e shamisë përbën apo jo përmbushje të një detyrimi fetar. Gjithsesi ajo shprehet se për znj. Şahin ky akt frymëzohet nga një fe ose një bindje. Në këto kushte Gjykata pranon se qëndrimet e autoriteteve universitare që nuk e lejonin kërkuuesen ta mbante shaminë në mjediset akademike përbënin një ndërhyrje ndaj ushtrimit prej të saj të së drejtës për të shfaqur fenë e saj.

#### b. A ishte ndërhyrja e ligjshme?

7. Gjykata konstatoi se kjo ndërhyrje kishte një bazë ligjore në të drejtën turke. Në fakt jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese bënte të qartë se lejimi i studenteve për të "mbuluar qafën dhe flokët me një shami ose shall për shkak të bindjeve fetare" në universitete ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Nga ana tjetër, prej vitesh, Këshilli i Shtetit konsideronte se mbajtja e shamisë islamike nuk ishte e pajtueshme me parimet themelore të Republikës Turke. Nga ana tjetër, është jashtë çdo dyshimi që ndalimi i mbajtjes së shamisë islamike ishte parashikuar nga universiteti shumë më parë se të regjistrohej kërkesja. Studentët, sidomos ata të mjekësisë ndër të cilët bënte pjesë edhe kërkuuesja, duhet të respektonin disa rregulla në lidhje me veshjen duke mos mbajtur sidomos gjatë zhvillimit të disa lëndëve veshjen fetare përfshirë këtu edhe shaminë. Në këto kushte znj. Şahin mund ta kishte parashikuar që nga momenti i regjistrimit të saj në Universitetin e Stambollit që mbajtja e shamisë ishte e ndaluar sipas normave universitare, sidomos në bazë të urdhëresës së vitit 1998, dhe se për këtë arsye ajo rrezikonte të mos lejohej të merrte pjesë në mësim nëse insistonte për ta mbajtur shaminë.

#### c. A ishte ndërhyrja legjitime?

8. Gjykata vlerëson se ndalimi i mbajtjes së shamisë në mjediset universitare ndiqte në thelb qëllime legjitime që ishin pikërisht mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe ruajtja e rendit.

#### d. A ishte ndërhyrja e nevojshme në një shoqëri demokratike?

9. Përsa i përket karakterit të nevojshëm të kësaj ndërhyrjeje, Gjykata vuri në dukje se ajo mbështetej në dy parime që plotësonin dhe përforconin njëri-tjetrin: laiciteti dhe barazia. Sipas jurisprudencës kushtetuese turke, në këtë vend laiciteti është një prej parimeve garantuese të vlerave demokratike, i pacenueshmërisë së lirisë së besimit dhe fesë dhe i barazisë së shtetasve para ligjit. Nga ana tjetër laiciteti mbron individët nga presionet e jashtme<sup>178</sup>. Sipas Gjykatës Kushtetuese turke liria

<sup>178</sup> Shih në lidhje me këtë moment vendimin e Gjykatës të 25 majit 1993 në lidhje me çështjen Kokkinakis kundër Greqisë.

për të shfaqur fenë mund të kufizohet me qëllim që të ruhen disa vlera dhe disa parime të shoqërisë demokratike. Një konceptim i tillë i laicitetit sipas mendimit të Gjykatës së Strasburgut respekton vlerat themelore të Konventës dhe për këtë arsye ajo konstaton se respektimi i këtij parimi mund të konsiderohet i nevojshëm për mbrojtjen e sistemit demokratik në Turqi. Sipas Gjykatës së Strasburgut një parim tjetër themelor i Konventës duket se gjendet mishëruar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese turke si një parim kushtetues – pikërisht mbrojtja e të drejtave të grave.

10. Ashtu si edhe Gjykata Kushtetuese turke, Gjykata e Strasburgut vlerëson se kur merret në analizë çështja e shamisë islamike në kontekstin turk, nuk mund të mos mbahet parasysh impakti që mund të ketë mbajtja e këtij simboli, i pretenduar ose i perceptuar si detyrim fetar, ndaj atyre që nuk e mbajnë. Hyjnë pra në lojë sidomos interesat e “të drejtave dhe lirive të të tjerëve” dhe “ruajtja e rendit publik” në një vend ku shumica e popullsisë, duke shfaqur një lidhje të thellë me të drejtat e gruas dhe një jetë laike, pranon fenë myslimane. Në këto kushte kufizimi i mbajtjes së shamisë mund të jetë bërë për t’iu përgjigjur një “nevoje të ngutshme sociale” me qëllim që të përmbushë këto dy qëllime legjitime. Gjykata mban gjithashtu parasysh faktin që ky simbol fetar gjatë viteve të fundit kishte fituar një peshë politike ku disa lëvizje politike ekstremiste përpqeshin t’i impononin të gjithë shoqërisë simbolet e tyre fetare dhe konceptimin e tyre mbi shoqërinë, të bazuar mbi rregulla fetare. Duke pasur parasysh këtë moment të fundit Gjykata çmon se rregullimi universitar për të cilin ankohej kërkuesja, ka synuar që të mbrojë edhe pluralizmin në një institucion universitar.

11. Duket pra se parimi i laicitetit dhe interesat legjitime të pluralizmit, respektimit të drejtave të të tjerëve dhe sidomos barazia ndërmjet burrit dhe gruas përpara ligjit kanë bërë që autoritetet turke të vlerësojnë se mbajtja e shamisë islamike në mjediset universitare është në kundërshtim me këtë parim dhe me këto vlera.

*e. A ishte ndërhyrja diskriminuese?*

12. Gjykata vuri në dukje se aktet dhe qëndrimet e autoriteteve të Universitetit të Stambollit i trajtonin njësoj të gjitha llojet e veshjeve që simbolizonin ose shfaqnin cilindo prej besimeve fetare dhe po njësoj i ndalonte ato në mjediset universitare.

13. Në këto kushte, duke pasur parasysh sidomos hapësirën e vlerësimit të shteteve palë në kuadrin e nenit 9 Gjykata arrin në përfundimin se rregullimi i kësaj çështje nga ana e Universitetit të Stambollit, duke kufizuar mbajtjen e shamisë islamike, justifikohet në parim dhe ishte në proporcion me qëllimet e ndjekura duke e konsideruar si të “nevojshëm në një shoqëri demokratike”. Ajo vendosi pra se nuk ka pasur shkelje të nenit 9 të Konventës.

**B. Në lidhje me nenin 8 dhe 10, nenin 14 të marrë së bashku me nenin 9 dhe nenin 2 të Protokollit 1**

14. Gjykata çmoi se asnjë problem më vete nuk dilte në pah në kuadrin e këtyre neneve, duke qenë se rrethanat konkrete ishin të njëjta si ato për të cilat në kuadrin e nenit 9 ajo vendosi se nuk kishte pasur shkelje të Konventës.

### III . Koment<sup>179</sup>

15. Vendimi ka një rëndësi themelore për situatën aktuale sociale por edhe politike në Evropë. Në thelbin e vet ai trajton marrëdhëniet ndërmjet demokracisë dhe fesë islame si dhe shpreh pikëpamjen e Gjykatës së Strasburgut në lidhje me këtë marrëdhënie. Ky vendim mund të jetë një referencë interesante për disa vende evropiane, përfshirë edhe Shqipërinë, të cilat aktualisht janë duke u përballur me çështjen e shamive dhe të veshjeve apo simboleve të tjera me frymëzim fetar.

16. Tepër interesante është të vlerësohet se praktika evropiane është gjithësi variabël. Kështu për shembull ka disa shtete si Belgjika, Spanja<sup>180</sup> që në mungesë të një rregullimi konkret nacional ia lënë kompetencën e rregullimit të këtij problemi institucioneve arsimore. Nga ana tjetër ka disa shtete si Britania e Madhe<sup>181</sup>, Danimarka, Italia<sup>182</sup>, Suedia, Holanda<sup>183</sup>, apo Gjermania të cilat janë tepër liberale në këtë drejtim, madje kjo e fundit edhe në ndryshim të qartë me këtë vendim të Gjykatës së Strasburgut që po komentojmë<sup>184</sup>. Nga ana tjetër qëndron Franca si shteti më kufizues në Evropë për momentin në këtë drejtim. Ligji nr. 2004-228 i 15 marsit 2004 dhe që hyri në fuqi pas vendimit Şahin kundër Turqisë - më 1 shtator 2004, titullohet pikërisht "Mbi zbatimin e parimit të laiciteti, mbajtjen e shenjave ose veshjeve që shfaqin një përkatësi fetare në shkolla, kolegje dhe lice publike"<sup>185</sup>. Ky ligj që shkaktoi debate dhe protesta të shumta të Francë edhe mund të gjejë një bazë për justifikimin e tij juridik në bazë të Konventës pikërisht në vendimin Şahin kundër Turqisë. Nga ana tjetër në kuadrin e së drejtës komunitare ekzistojnë dy direktiva të cilat duket se lejojnë një qëndrim më liberal sesa ai i mbajtur në Strasburg<sup>186</sup>. Do të jetë interesant një zhvillim i mundshëm jurisprudencial në bazë të tyre në Luksemburg<sup>187</sup>, pasur parasysht nga njëra anë afatit e tyre maksimal të

<sup>179</sup> Në të njëjtën ditë Gjykata vendosi të çregjistrojë nga lista e çështjeve të saj një kërkesë tjetër të deklaruar të pranueshme, Tekin kundër Turqisë e cila kishte të bënte me fakte identike me çështjen që po komentojmë. Ky vendim ishte pasojë e letrës që më 19 shkurt 2003 Znj. Tekin i kishte dërguar Gjykatës duke i bërë të ditur dëshirën e saj për tu tërhequr nga ankesa e saj pa ofruar asnjë arsye për këtë vendim. Duke vlerësuar se nuk kishte më asnjë arsye për të vazhduar gjykimin e kësaj çështjeje në bazë të nenit 37 të Konventës, Gjykata njëzëri vendosi ta çregjistrojë atë nga regjistri i saj.

<sup>180</sup> Në bazë të ligjit organik të 23 dhjetorit 2002 dhe dy dekreteve mbretërore të 26 janarit 1996.

<sup>181</sup> Komisioni që mbikëqyr zbatimin e Non-Discrimination Act të vitit 1976 ka vlerësuar se ndalimi i mbajtjes së simboleve fetare në mjedise publike përbën një kufizim të pajustificueshëm. Është gjithashtu interesant vendimi i House of Lords në lidhje me çështjen Mandla kundër Dowell Lee ([1983] AC 548), në të cilën ajo shprehet se mbrojtja e ofruar nga Race Relations Act po i vitit 1976 mund të shtrihet edhe ndaj grupeve fetare apo edhe vendimi i Courts of Appeal i 2 marsit 2005 në lidhje me çështjen SB, R kundër Denbigh High School në [2005] EWCA Civ 199.

<sup>182</sup> Brenda kushteve të parashikuara nga neni 19 i Kushtetutës italiane.

<sup>183</sup> Kështu për shembull në bazë të ligjit të vitit 1994 për mos-diskriminimin Komisioni për trajtimin e barabartë më 20 mars 2003 dha një mendim sipas së cilit ndalimi i përgjithshëm të mbajtjes së takijes, çallmës ose shamisë është i palejueshëm, qoftë kur ka të bëjë me nxënësit apo me mësuesit dhe profesorët.

<sup>184</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Gjermane i 24 shtatorit 2003 (BverG, 2BvR, 1436/02), në të cilin ajo vendos lejimin e mbajtjes së shamive nga një mësuese shkolle, duke u shprehur se lejimi nuk bën që shteti ta pranojë simbolin ose fenë përkatëse si të tijën.

<sup>185</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës Franceze e 17 marsit 2004.

<sup>186</sup> Direktiva e Këshillit të BE 2000/78 e cila ofron një kuadër të përgjithshëm për trajtimin e barabartë të punësim dhe vetëpunësim dhe Direktiva e Këshillit 2000/43 në lidhje me trajtimin e barabartë për arsye të racës dhe origjinës etnike.

<sup>187</sup> Ndërkaq Gjykata e Luksemburgut në çështjen 170/75 Prais kundër Këshillit [1976] Rec. 1589, vendos që përjashtimi i një gruaje hebre nga mundësia për t'u punësuar për shkak se ajo nuk

implementimit, dhjetorin 2003 dhe me pak përjashtime dhjetorin 2006, ndërsa nga ana tjetër hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re të BE-së, neni II-10 i së cilës duket se ofron një mbrojtje më të gjerë sesa neni 9 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

17. Vendimi në fjalë vijon praktikën e organeve të Strasburgut që deri tani i kanë justifikuar ndalime të tilla<sup>188</sup>. Gjithsesi kësaj jurisprudence dhe vendimit Şahin kundër Turqisë mund t'i bëhen edhe kritika të qenësishme, qoftë nga pikëpamje a teknikës juridike qoftë në lidhje me impaktin që mund të ketë në shoqëritë evropiane. Nga pikëpamje juridike duket se shqetësimi i Gjykatës për situatën turke e prezumoi gati të mirëqenë hapësirën e vlerësimit të qeverisë turke në këtë çështje dhe nuk ia nënshtroi një shqyrtimi të kujdesshëm siç edhe duhej pritur. Ndërkohë që do të ishte e preferueshme që më në fund Gjykata të përpunonte më tej kriteret e paragrafit të dytë të nenit 9, ose të ashtuquajturën 'clawback clause', duket se interpretimi i saj nuk detajon sa duhet elementë thelbësorë juridikë të parashikuara në këtë paragraf. Kështu ajo lë të kuptohet se pavarësisht se ndalimi i shamive nuk zbatohet në të gjitha shkollat dhe universitetet publike turke, mbajtja e saj vë në rrezik laicitetin dhe demokracinë në Turqi. Nga pikëpamja e impaktit ndaj shoqërive evropiane në përgjithësi, vendimi paraqet interes për faktin se si Gjykata, për të arritur në një përfundim sa më të drejtë, i referohet edhe historisë jo vetëm kushtetuese republikane<sup>189</sup> por edhe sociale perandorake turke duke kujtuar edhe sistemin e miletit si dhe hapësirat që një konceptim i tillë i organizimit shtetëror dhe social kishte lënë vend historikisht për diskriminim. Në këtë kuadër, vlera e tij për situatën franceze, që përmendëm në fund të paragrafit të mësipërm të këtij komenti, apo të shoqërive të tjera evropiane mund edhe të jetë tepër e kufizuar për shkak të kushteve historike, sociale dhe politike të ndryshme.

## MANOUSSAKIS DHE TË TJERË kundër GREQISË

(kërkesa nr. 18748/91)

26 shtator 1996

*procedurat dhe sanksionet e vendosura për ngritjen e vendeve të kultit mund të shkelin parimin e proporcionalitetit dhe të bien në kundërshtim me nenin 9*

### I. Faktet kryesore

1. Z. Titos Manoussakis, z. Constantinos Makridakis, z. Kyriakos Baxevanis dhe z. Vassilios Hadjakis banonin në Kretë dhe ishin dëshmitarë të Jehovait. Më 30 mars

---

merrte dot pjesë në një intervistë që mbahej një të shtunë, përbënte shkelje të parimeve të përgjithshme të së drejtës komunitare.

<sup>188</sup> Vendimi i Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjen Karaduman kundër Turqisë i vitit 1993 (kërkesa nr. 16278/90) dhe vendimi i Gjykatës i vitit 2001 në lidhje me çështjen Dahlab kundër Zvicrës.

<sup>189</sup> Shih gjithashtu në këtë drejtim përmbledhjen në këtë botim të vendimit të Dhomës së Madhe të Gjykatës të 13 shkurtit 2003 në lidhje me çështjen Refah Partisi dhe të tjerë kundër Turqisë.

1983, Z. Manoussakis mori me qira një sallë në Heraklion, me anë të një kontrate të panoterizuar e të nënshkruar nga palët, në bazë të së cilës salla do të përdorej për të gjitha llojet e mbledhjeve, martesave, etj., të të krishterëve dëshmitarë të Jehovahit. Më 28 qershor 1983, kërkuesit i kërkuan Ministrin të Edukimit Kombëtar dhe të Kulteve autorizimin për të përdorur këtë sallë si shtëpi lutjesh. Më 10 dhjetor 1984, Ministria i informoi se administrata po analizonte kërkesën e tyre. Deri në datën e dhënies së vendimit nga ana e Gjykatës procedura nuk ishte mbyllur ende.

2. Më 3 mars 1986, prokurori i Heraklionit filloi ndjekjen penale kundër kërkuesve mbi bazën e nenit 1 të Ligjit nr. 1363 të vitit 1939, i ndryshuar nga Ligji nr. 1672 të vitit 1939, për shkak të hapjes të një shtëpie lutjesh me qëllim për t'u mbledhur dhe për të zhvilluar ceremoni fetare të besimtarëve të rrëfimit të dëshmitarëve Jehovahit, pa autorizimin e autoriteteve fetare të njohura dhe të Ministrin të Edukimit Kombëtar dhe të Kulteve. Më 6 tetor 1987, gjykata penale e shkallës së parë i liroi kërkuesit duke vlerësuar se «mbledhja e besimtarëve të çfarëdo lloj doktrine, në mungesë të akteve të përhapjes së besimit (proselitizmit), është e lirë edhe në qoftë se ajo nuk është e autorizuar». Më 8 tetor 1987, prokurori i Heraklionit e kundërshtoi këtë vendim në apel dhe më 15 shkurt 1990 secili prej fajtorëve u dënua me tre muaj burgim të konvertuar me 400 dhrahmi për ditë burgu dhe 20 000 dhrahmi gjobë. Të dënuarit e çuan çështjen përpara Gjykatës së Kasacionit dhe pretenduan se neni 1 i ligjit në fjalë (dekreti mbretëror i 20 majit dhe 2 qershorit 1939) dhe detyrimi për të kërkuar një autorizim për të hapur një shtëpi lutjesh binin në kundërshtim me nenin 13 të Kushtetutës dhe nenin 9 të Konventës, të cilët garantojnë të drejtën për lirinë e fesë dhe të kultit. Gjykata e Kasacionit e hodhi poshtë kërkesën e tyre më 19 mars 1991.

3. Në kërkesën e tyre të 7 gushtit 1991 drejtuar Komisionit, të interesuarit u mbështetën në nenet 3, 5, 6, të ndërthurur me nenin 8, 9, 10, 11 dhe 14 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1.

4. Më 10 tetor 1994, Komisioni e mbështeti kërkesën përse i përket ankesës së bazuar mbi nenin 9. Në raportin e 25 majit 1995, ai vendosi njëzëri se neni 9 ishte shkelur.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake

5. Qeveria pretendoi në radhë të parë se kërkuesit nuk i kishin shfrytëzuar të gjitha mjetet e brendshme efektive, për shkak se dy herë kishin pasur mundësi t'i drejtoheshin Këshillit të Shtetit për refuzimin e heshtur nga ana e Ministrin të Edukimit Kombëtar dhe të Kulteve për autorizimin e kërkuar. Kjo sepse sipas qeverisë heshtja e ministrit në krye të tre muajve ishte e barabartë me një refuzim të heshtur, i cili mund të kundërshtohej përpara Këshillit të Shtetit për tejkalim kompetencash.

6. Në rekursin e tyre në Kasacion, kërkuesit ishin mbështetur vetëm mbi papajtueshmërinë e nenit 1 të Ligjit nr. 1363 të vitit 1938, i cili kishte shërbyer si bazë

për dënimin e tyre, me nenet 9 të Konventës dhe 13 të Kushtetutës. Gjykata e Kasacionit e kishte hedhur poshtë këtë ankesë duke vlerësuar se Gjykata e Apelit e Heraklionit i kishte interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte dispozitat e lartpërmendura. Kërkuesit kanë shfrytëzuar rrugët e brendshme të ankimit lidhur me dënimin e tyre.

7. Përsa i përket kërkesave të autorizimit, Ministri i Edukimit Kombëtar dhe i Kulteve iu ishte përgjigjur pesë herë me shkrim se ai po hetonte çështjen. Asnjëherë nuk ka pasur as vendim të heshtur që vendoste një afat rekursi, as vendim të qartë nga ana e administratës dhe kërkuesit kanë qenë në pritje që prej 18 tetorit 1983. Por një dyshim në lidhje me datën e fillimit të afateve të parashikuara mund të ekzistonte në mendjen e kërkuesve: pas kërkesës së dytë të autorizimit të interesuarve, më 18 tetor 1983, Ministri i Edukimit Kombëtar dhe i Kulteve iu përgjigj të interesuarve më 25 nëntor 1983, pra përpara skadimit të tre muajve që vijuan bërjen e kërkesës. Rezulton se nuk ka pasur heshtje të administratës të barabartë me një refuzim të heshtur të autorizimit të kërkuar. Në këto kushte Gjykata e hodhi poshtë këtë pretendim të qeverisë greke.

### **B. Në lidhje me themelin**

#### *a) A ka ndërhyrje?*

8. Në lidhje me themelin e çështjes, Gjykata konstatoi se dënimi i të interesuarve i vendosur prej Gjykatës Penale të Heraklionit e thirrur në apel, për faktin se të interesuarit kanë përdorur sallën e marrë me qira pa autorizimin e parashikuar nga Ligji nr. 1363 të vitit 1938, përbënte një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtës së tyre për «lirinë e ushtrimit të fesë së tyre me anë të kultit dhe riteve».

#### *b) A ishte ndërhyrja e ligjshme?*

9. Në lidhje me justifikimin e ndërhyrjes, Gjykata vërejti se kërkuesit ankohen më pak për trajtimin, pengimin që iu bëhet kur ata dëshirojnë të hapin një kishë apo një vend kulti; pra ata sulmojnë në thelb dispozitat e legjislacionit të brendshëm. Megjithatë, Gjykata nuk e gjykoi të nevojshme të kërkojë nëse ndërhyrja ishte “e parashikuar nga ligji” apo jo, sepse sido që të ndodhte, ndërhyrja në fjalë ishte në kundërshtim me nenin 9 përsa i përket pikëpamjeve të tjera.

#### *c) A ishte ndërhyrja legjitime?*

10. Shtetet kanë pushtetin e kontrollit nëse një shoqatë, duke pasur qëllime fetare, kryen aktivitete që dëmtojnë qytetarët. Megjithatë rrëfimi i dëshmitarëve të Jehovahit, i përmbush sipas ligjit grek kushtet e një kishë “të njohur”. Por duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, Gjykata konsideroi se dënimi i tyre ndiqte një qëllim legjitim në përputhje me nenin 9 § 2 të Konventës – pikërisht mbrojtjen e rregullit.

#### *d) A ishte ndërhyrja proporcionale?*

11. A ishte kjo masë e nevojshme në një shoqëri demokratike? Legjislacioni grek lejonte një ndërhyrje të konsiderueshme të autoriteteve politike, administrative dhe fetare në ushtrimin e lirisë fetare. Kushteve të shumta të parashikuara nga ligji, që disa prej tyre i japin policisë, kryetarit të bashkisë, dhe të komunës një pushtet të madh vlerësimi, i shtohet mundësia e dhënë Ministrit të Edukimit Kombëtar



dhe të Kulteve për të shtyrë deri në pafundësi përgjigjen e tij ose për të refuzuar autorizimin pa shpjegime apo arsye të vlefshme.

12. E drejta për lirinë e fesë, ashtu sikurse e koncepton Konventa, përjashton çdo vlerësim nga ana e shtetit të legjitimitetit të besimeve fetare ose të mënyrave të shprehjes së tyre? Duke u bazuar mbi këtë, Gjykata vlerësoi se sistemi i autorizimit shkon me nenin 9 vetëm kur ai ka për qëllim të sigurojë një kontroll të Ministrisë mbi respektimin e kushteve formale.

13. Por, si dhe nga shumë raste të raportuara nga kërkuesit dhe të pakundërshtuara nga qeveria, nga dosja del se shteti tenton të përfitojë nga fuqia e legjislacionit në mënyrë që të imponojë kushte të rrepta dhe që ndalojnë ushtrimin e disa kulteve jo ortodokse, sidomos atë të dëshmitarëve të Jehovait.

14. Në rastin tonë, Ministri i Edukimit Kombëtar dhe i Kulteve, i pyetur pesë herë nga kërkuesit, nga 25 tetori 1983 deri më 10 dhjetor 1984, ishte përgjigjur se ai po analizonte dosjen e tyre. Kërkuesit nuk morën një përgjigje të shprehur qartë. Në këto kushte qeveria nuk mund të mbështetej mbi moszbatimin e një formaliteti ligjor nga kërkuesit për të justifikuar dënimin e tyre. Në këtë kuadër masa e dënimit nuk ka asnjë rëndësi.

15. Gjykata vendosi se dënimi i kundërshtuar prek kaq direkt lirinë fetare të kërkuesve, aq sa ai nuk mund të vihet në baraspeshim me qëllimin legjitim të ndjekur, dhe të nevojshëm në një shoqëri demokratike. Pra ka pasur shkelje të nenit 9.

### **C. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)**

16. Në fushën e nenit 50, Gjykata vlerësoi se të interesuarit kanë pësuar një dëm moral, por konstatimi i shkeljes së nenit 9 mjafton për t'i shpërblyer. Për shpenzimet përpara autoriteteve greke dhe të Strasburgut, të interesuarit kërkuan një shumë prej 4 030 100 dhrahmish, të paraqitura hollësisht në kërkesë. Gjykata e vlerësoi këtë kërkesë të arsyeshme dhe e mbështeti në tërësi.

### **III. Koment**

17. Vlera më e spikatur e këtij vendimi në lidhje me nenin 9 është analiza tërësore e kriterëve të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 9 në lidhje me justifikimin apo jo të ndërhyrjeve ndaj të drejtës për lirinë e besimit dhe të shprehjes së tij. Në parim, Gjykata pranon se shtetet mund të vendosin një sistem që parashikon bërjen e kërkesës, shqyrtimin e saj dhe miratimin ose hedhjen poshtë të saj në lidhje me ushtrimin dhe shfaqjen e besimeve fetare dhe sidomos ngritjen e vendeve të kultit. Ky moment është absolutisht në përputhje me nenin 9 të Konventës. Por duhet pasur parasysh që ky sistem t'i nënshtrohet me një saktësi të kujdesshme të gjitha kriterëve të përfshira në atë që e kemi quajtur grilë të pajtueshmërisë të ndërhyrjes ndaj të drejtave të cilësuar. Kujtoj pastaj që kjo saktësi dhe pajtueshmëri i nënshtrohet në analizë të fundit shqyrtimit të Gjykatës.

18. Një nga gjyqtarët në këtë çështje u shpreh se përsëri kishte probleme në lidhje me nocionin e ligjshmërisë përderisa Ligji 1363/1938 ishte formuluar në terma shumë të vagët dhe diskrecionarë<sup>190</sup>. Megjithatë shumica e Gjykatës në këtë rast e kapërceu kriterin themelor të përdorur prej saj për të konstatuar shkeljen në çështjen Kokkinakis - atë të ligjshmërisë - duke u ndalur tashmë në parimin e proporcionalitetit të masës konkrete. Pasi merr me radhë elementët e grilës, që nga konstatimi i ndërhyrjes, parashikimi i kësaj me ligj, karakteri i saj legjitim dhe nevoja në një shoqëri demokratike, Gjykata e analizon në mënyrë të detajuar këtë të fundit duke përdorur një parim themelor të së drejtës publike evropiane - parimin e proporcionalitetit<sup>191</sup>. Në kushtet kur ligji lejonte një diskrecion tepër të madh në duart e Ministrisë të Edukimit dhe Kulturës për të vendosur mbi hapjen e vendeve të kultit, mosdhënia e autorizimit nga ana e këtij të fundit në rastin konkret dhe pastaj dënimi i kërkuesve nga ana e autoriteteve greke e çuan Gjykatën në përfundimin se masat e marra ndaj kërkuesve nuk ishin në proporcion me qëllimin e ndjekur dhe për këtë arsye përbënin shkelje të nenit 9 të Konventës. Konstatimi i shkeljes nga ana e Gjykatës u bazua ndër të tjera në pikëpamjen e saj se jurisprudenca greke në këtë fushë nxirrte në pah “një tendencë të qartë...që synonte kufizimin e veprimtarive fetare që nuk ishin të Kishës Ortodokse”.

## KISHA MITROPOLITE E BESARABISË DHE TË TJERË kundër MOLDAVISË

(kërkesa nr. 45701/99)

13 dhjetor 2001

*kjo çështje kishte të bënte me refuzimin nga ana e shtetit moldav për të njohur një kishë më vete, gjë që përbën, sipas vendimit të Gjykatës shkelje të lirisë së fesë*

### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje filloi pra me kërkesën e paraqitur përpara Gjykatës nga ana e Kishës Mitropolitike të Besarabisë dhe e njëmbëdhjetë shtetasve moldavë. Këta të fundit mbanin pozita zyrtare në këtë kishë.
2. Çështja filloi për shkak se autoritetet moldave refuzuan t'i njihnin kërkueses statusin e një kishë më vete - të krishterë ortodokse. Refuzimi u la në fuqi edhe me një vendim të Gjykatës së Lartë moldave më 9 dhjetor 1997. Kjo Gjykatë mbajti qëndrim se çështja e njohjes së kësaj kishë mund të zgjidhej vetëm nga ana e Kishës Mitropolitike të

<sup>190</sup> Mendimi në pakicë i gjyqtarit Martens.

<sup>191</sup> I lejoj vetes ta quaj parimin e proporcionalitetit si parim themelor të së drejtës publike në Evropë duke pasur parasysh se ai është parim themelor i së drejtës së KEDNJ, i së drejtës së Bashkimit Evropian dhe i së drejtës administrative të pothuajse të gjitha shteteve anëtare të BE, si dhe i Republikës së Shqipërisë (neni 17 § 1 i Kushtetutës).

Moldavisë, e cila ishte njohur nga ana e shtetit moldav dhe nga e cila ishte shkëputur edhe kisha që bënte ankimin, dhe se çdo ndërhyrje në këtë mosmarrëveshje nga ana e autoriteteve moldave veçse mund t'i përkeqësonte më tej gjërat. Për më tepër, ajo vendosi se kërkuesit dhe besimtarët e tjerë të kishës që bënte ankimin mund ta praktikonin lirisht besimin e tyre në Kishën Mitropolitike të Moldavisë.

## II. Vendimi i Gjykatës

3. Duke u bazuar në nenin 9 të Konventës, kërkuesit ankoheshin në lidhje me refuzimin e shtetit moldav për të njohur Kishën Mitropolitike të Besarabisë si kishë më vete dhe pretenduan se në bazë të legjislacionin vendas të zbatueshëm në këtë fushë, një ent fetar më vete nuk mund të ishte aktiv brenda territorit Moldav pa u njohur më parë nga ana e autoriteteve shtetërore. Kërkuesit pretenduan në vazhdim shkëlje të nenit 6 § 1 dhe u ankuan se refuzimi i autoriteteve moldave për të njohur kishën në fjalë e ndalonte këtë të kishte personalitet juridik dhe si rrjedhojë i ishte refuzuar e drejta për t'iu drejtuar gjykatave me qëllim që të arrinte të merrej një vendim për çdo lloj ankimi që ajo mund të kishte në lidhje me të drejtat e saj dhe në veçanti në lidhje me të drejtat e pronësisë. Duke u bazuar në nenin 9 të marrë së bashku me nenin 14, ata u ankuan se, në ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga liria për të shfaqur fenë me anë të riteve, kisha kërkuese vlerësonte se ajo ishte viktimë diskriminimi bazuar mbi kritere fetare përderisa nuk kishte të drejtë për mbrojtje juridike. Kërkuesit u ankuan gjithashtu për shkëlje të nenit 11 për shkak të refuzimit nga ana e autoriteteve për të njohur kishën kërkuese, vijuar edhe vendosmërinë për t'i konsideruar kërkuesit si anëtarë të Kishës Mitropolitike të Moldavisë. Së fundmi, kërkuesit pretenduan për shkëlje të nenit 13, duke vlerësuar që në prani të pamundësisë për mbrojtje juridike përpara autoriteteve shtetërore nga ana e kishës kërkuese, ata nuk kishin pasur mundësi të ngrinin përpara këtyre autoriteteve pretendimet që kishin ngritur përpara Gjykatës.

### A. Në lidhje me nenin 9

#### a. Konstatimi i ndërhyrjes

4. Gjykata vuri në dukje se përderisa kisha kërkuese nuk ishte njohur si person juridik ajo nuk mund të vepronte si subjekt i së drejtës. Në veçanti, priftërinjtë e saj nuk mund të kryenin shërbesa fetare, pjesëtarët e saj nuk mund të praktikonin fenë e tyre dhe, duke mos pasur pra personalitet juridik, nuk mund të mbronin pasuritë e saj. Për këtë arsye Gjykata mbajti qëndrimin se refuzimi i autoriteteve moldave për të njohur kishën kërkuese përbënte ndërhyrje në të drejtën e kësaj kisha dhe të kërkuesve të tjerë për liri besimi dhe feje, siç garantohet nga neni 9 § 1 i Konventës.

#### b. Ligjshmëria dhe legjitimiteti i ndërhyrjes

5. Gjykata pranoi se ndërhyrja në fjalë ishte e parashikuar në ligj, duke u bazuar në të drejtën moldave të referuar edhe nga vendimet e gjykatave vendase. Në lidhje me çështjen e qëllimit legjitim ajo pranoi gjithashtu se ndërhyrja e ankimuar ndiqte një qëllim të tillë në kuptimin e paragrafit 2 të nenit 9, dhe konkretisht atë të ruajtjes së rendit publik dhe të qetësisë publike.

*c. Karakteri i nevojshëm i ndërhyrjes*

6. Nga ana tjetër Gjykata mbajti qëndrimin se, duke qenë që kisha kërkuese nuk ishte një person juridik i njohur dhe se njohja e saj varej nga vullneti i një autoriteti ndërkaq të njohur fetar, Kishës Mitropolitike të Moldavisë, qeveria kishte dështuar në përmbushjen e detyrës së saj për qëndrim neutral dhe të paanshëm. Përsa i përket pretendimit për tolerancë nga ana e qeverisë ndaj kishës kërkuese dhe anëtarëve të saj, Gjykata nuk pranoi se ky qëndrim mund të shihej zëvendësues i njohjes përderisa vetëm kjo e fundit mund t'u jepte kërkuesve të drejtat e pretenduara. Për më tepër, ajo vuri në dukje se në një numër rastesh kërkuesit kishin qenë të paafhtë që të mbronin vetveten ndaj akteve të frikësimit, përderisa me ligj ishte parashikuar që vetëm aktivitetet e ligjshme mund të gëzojnë mbrojtje ligjore. Së fundmi, ajo vuri në dukje se përpara se të njihnin entitete të reja fetare autoritetet nuk kishin mbajtur parasysh dhe as vënë në zbatim kriteret që ato përdornin për mohimin e njohjes ndaj kishës kërkuese dhe se asnjë justifikim nuk ishte formuluar nga ana e qeverisë moldave për këtë ndryshim në trajtim.

7. Si përfundim, Gjykata vlerësoi se refuzimi për të njohur kishën kërkuese kishte pasur pasoja të tilla për lirinë e kërkuesve për të besuar dhe pasur fenë e tyre sa që nuk mund të shihej si proporcionale me qëllimin e ligjshëm të ndjekur. Pra ajo nuk ka qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe ka pasur pra një shkelje të nenit 9.

**B. Në lidhje me nenin 13**

8. Gjykata vuri në dukje se, në vendimin e saj të 9 dhjetorit 1997, Gjykata e Lartë kishte vendosur se refuzimi i qeverisë për t'iu përgjigjur kërkesës për njohje të paraqitur nga ana e kishës kërkuese nuk ishte i kundraligjshëm dhe as nuk përbënte shkelje të nenit 9 të Konventës, përderisa kërkuesit mund ta shfaqnin dhe ushtronin fenë e tyre brenda Kishës Mitropolitike të Moldavisë. Megjithatë, duke dhënë këtë vendim, Gjykata e Lartë nuk i ishte përgjigjur pretendimit kryesor të kërkuesve, pikërisht atij që ata dëshironin ta praktikonin besimin e tyre së bashku brenda një kishe më vete nga Kisha Mitropolitike e Moldavisë, si dhe që të kishin të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe të pronave të tyre, pasur parasysh që vetëm entitetet e njohura nga ana e shtetit gëzonin mbrojtje ligjore. Për këtë arsye, duke mos qenë njohur nga ana e autoriteteve shtetërore, Kisha Mitropolitike e Besarabisë nuk gëzonte të drejta që të mund t'i ngrinte si pretendim përpara Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye mund të thuhet se ankimi përpara Gjykatës së Lartë nuk ishte efektiv.

9. Prandaj edhe Gjykata mbajti qëndrimin që kërkuesit nuk kanë qenë në gjendje të vënë në vend të drejtat e tyre përpara një autoriteti shtetëror në lidhje me ankimin e tyre mbi lirinë e fesë. Pra ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

**C. Në lidhje me nenin 41**

10. Gjykata u akordoi kërkuesve një shumë prej 27 025 euro për dëm material dhe jo-material si dhe për shpenzime dhe pagesa.

### III. Koment

11. Kjo çështje ka të bëjë me nenin 9 edhe me nenin 11 të Konventës. Gjykata ka pohuar që Konventa mbron jo vetëm fetë dhe besimet kryesore dhe përgjithësisht të njohura por edhe sektet e tjera. Ajo mbron gjithashtu besimet jo-fetare të tilla si pacifizmi dhe veganizmi. Megjithatë ajo nuk mbron besimet thjesht idealiste apo altruiste dhe, çka ka edhe më rëndësi të kujtohet, besimet politike. E drejta e lirisë së mendimit, besimit dhe fesë është një e drejtë absolute dhe nuk mund të kufizohet. Është vetëm e drejta për të shfaqur ose praktikuar fenë ose besimin që merr në këtë rast një karakter të kufizueshëm.

12. Mbajtja e një feje zyrtare dhe të pranuar shtetërore nuk përbën në vetvete një cenim të kësaj dispozite<sup>192</sup> dhe këtë nuk e bën as ndalimi, indoktrinimi apo nxitja e qëndrimeve politike që bazohen në besime të caktuara fetare. E drejta për të shfaqur fenë shpesh përfshin në vetvete edhe nenin 10 të Konventës apo, si edhe në këtë rast që po shqyrtojmë, mund të lidhet me nenin 11 të saj. Ajo mund të ndërthuret gjithashtu me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave në kuadrin e nenit 6 përderisa një kishë të cilës i është mohuar njohja ligjore si subjekt pra edhe personaliteti juridik nuk është në gjendje të nisë procedura ligjore në emër të saj dhe pra nuk është as në gjendje të pretendojë të drejtat e saj në juridiksionet e brendshme. Ky ishte në fakt edhe problemi në çështjen Kisha Katolike e Caneas kundër Greqisë, në lidhje me të cilën Gjykata e dha vendimin e saj më 16 dhjetor 1997.

13. Ndoshta mund të thuhet që momenti më i rëndësishëm në vendimin e Gjykatës në lidhje me këtë çështje ishte ai ku toleranca e shtetit në lidhje me aktivitetet aktuale të pjesëtarëve të kishës kërkuese nuk zëvendësonte akordimin e vetë kishës të gamës së plotë të të drejtave që mbrohen nga Konventa.

## SERIF kundër GREQISË

(kërkesa nr. 38178/97)

14 dhjetor 1999

*ndërhyrja e shtetit në vetërregullimin e komuniteteve fetare duhet të jetë ngushtësisht e justifikueshme për arsyet e parashtruara në paragrafin 2 të nenit 9*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Ibrahim Serif, shtetas grek, ka lindur më 1951 dhe jeton në Komotini në Greqi. Megjithëse e drejta greke parashikonte që myftinjtë, si drejtues fetarë myslimanë në zonën e minoritetit në Trakë duheshin zgjedhur nga vetë minoriteti,

<sup>192</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 23 tetorit 1990 në lidhje me çështjen Darby kundër Suedisë.

kur Myftiu i Rodopit vdiq, Presidenti i Republikës duke u bazuar në një praktikë të konsoliduar, procedoi me emërimin e një myftiu të ri pa u mbajtur zgjedhje. Kur dy anëtarë të pavarur myslimanë të Parlamentit kërkuan që të organizoheshin zgjedhje, siç parashikohej sipas tyre nga Traktati i Athinës i vitit 1913 ndërmjet Greqisë dhe shteteve të tjera dhe Perandorisë Osmane nga ana tjetër, Parlamenti ndryshoi ligjin duke parashikuar emërimin e myftinjve nga Presidenti i Republikës. Në dhjetor 1990 një numër besimtarësh myslimanë që morën pjesë në lutjet e së premtes e shpallën kërkuesin Myfti të Rodopit. Pas kësaj kërkuesi u dënua në bazë të neneve 175 dhe 176 të Kodit Penal për uzurpim funksionesh të një kleriku të një “feje të njohur” dhe sepse ishte veshur si një klerik pa pasur të drejtë. Dënimi i tij u la në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata e Lartë.

## II. Vendimi i Gjykatës

2. Kërkuesi ankohej se ishin shkelur të drejtat e tij për liri besimi dhe shprehjeje të garantuara nga neni 9 dhe 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

### A. Në lidhje me nenin 9

3. Gjykata vlerësoi se dënimi i kërkuesit në bazë të neneve 175 dhe 176 të Kodit Penal përbënte ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit të garantuar nga neni 9 § 1 i Konventës të cilën ai mund ta ushtrojë *“individualisht ose kolektivisht, publikisht ose privatisht, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave dhe kryerjes së riteve”*. Gjykata nuk e pa të nevojshme që të vendoste në lidhje me çështjen nëse ndërhyrja ishte parashikuar me ligj pasi kjo dukej e qartë në legjislacionin grek. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se kërkuesi nuk ishte i vetmi person që pretendonte të ishte udhëheqësi fetar i bashkësisë myslimane lokale, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja në fjalë ndiqte një qëllim legjitim në bazë të paragrafit 2 të nenit 9 të Konventës, konkretisht atë të *“mbrojtjes së rendit publik”*.

4. Përsa i përket çështjes nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike Gjykata vuri në dukje se, në bazë të së drejtës greke, martesat e celebruara nga klerikë të “feve të njohura” barazoheshin me martesat civile dhe myftinj të kishin kompetencë për të vendosur në lidhje me disa mosmarrëveshje familjare dhe trashëgimore ndërmjet besimtarëve myslimanë. Në këto rrethana, mund të pranohej se marrja e masave të posaçme ishte në interes publik të shtetit me qëllim që të mbroheshin nga zhgënjimi ose mashtrimi personat, marrëdhëniet juridike të të cilëve mund të cenoheshin nga aktet e klerikëve të feve të ndryshme.

5. Në këtë drejtim Gjykata vuri re se gjykatat greke që e kishin dënua kërkuesin nuk kishin përmendur në vendimet e tyre asnjë akt të veçantë të tij që të kishte krijuar pasoja ligjore (për shembull ceremoni martesë apo aktivitete administrative). Gjykatat greke e dënuan kërkuesin për shkak se ai kishte dhënë një mesazh në lidhje me domethënien fetare të një feste, sepse kishte mbajtur një fjalim në një tubim fetar, se kishte dhënë një mesazh me rastin e një feste fetare dhe se ishte veshur si një udhëheqës fetar. Për më tepër, nuk u kundërshtua fakti se kërkuesi kishte mbështetur e të paktën një pjesë të bashkësisë myslimane në Rodop.



6. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ndëshkimi i një personi thjesht për faktin se kishte vepruar si udhëheqësi fetar i një grupi që me vullnet të lirë e ndiqte atë, vështirë se mund të vlerësohej në përputhje me kërkesat e pluralizmit fetar në një shoqëri demokratike. Për më tepër, Gjykata nuk ishte e mendimit se, në shoqëritë demokratike, shteti duhej të merrte masa për të siguruar që bashkësitë fetare të drejtoheshin nga një udhëheqje e bashkuar. Është e vërtetë që Gjykata pranoi se ishte e mundur që tensioni të mund të lindte në raste kur bashkësitë fetare ose të tjera ishin të ndara. Megjithatë, ajo vlerësoi se kjo ishte një prej pasojave të pashmangshme të pluralizmit. Roli i autoriteteve në rrethana të tilla nuk ishte që të shuante shkakun e tensioneve duke eliminuar pluralizmin, por të siguronte që grupet e ndryshme të tolerojnë njëri-tjetrin.

7. Gjykata theksoi se qeveria nuk bëri asnjë aludim që ndonjë prej trazirave ndërmjet besimtarëve myslimanë në Rodop të ishte shkaktuar nga prania e dy udhëheqësve fetarë. Për më tepër, Gjykata vlerësoi se asgjë nuk të bënte të mendoje se mund të kishte tensione ndërmjet myslimanëve dhe të krishterëve ose ndërmjet Greqisë dhe Turqisë.

8. Në dritën e sa u tha më lart, Gjykata vlerësoi se nuk doli në pah se dënimi i kërkuesit në bazë të neneve 175 dhe 176 të Kodit Penal ishte justifikuar nga rrethanat e çështjes për shkak të një “nevoje urgjente shoqërore”. Si rezultat, ndërhyrja ndaj së drejtës së kërkuesit nuk ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e rendit publik” siç parashikohej nga paragrafi 2 i nenit 9 të Konventës. Pra ka pasur shkelje të këtij neni.

### **B. Në lidhje me nenin 10**

9. Pasi konstatoi shkelje të nenit 9, Gjykata nuk e pa të arsyeshme të vazhdonte edhe me analizën e nenit 10 në rrethanat specifike të çështjes.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

10. Gjykata i akordoi kërkuesit si kompensim për dëm material vlerën e gjobës që atij i ishte dashur të paguante si rezultat i dënimit të tij, konkretisht 700 000 dhrahmi. Ajo i akordoi gjithashtu atij 2 000 000 dhrahmi greke si dëm shpërblim për dëm jomaterial. Duke qenë se kishte përfituar nga ndihma ligjore në procedurat përpara Gjykatës së Strasburgut, kërkuesi nuk pretendoi asnjë shumë për shpenzime apo pagesa procedurale.

## **III. Koment**

11. Gjykata pasi e analizoi me kujdes e hodhi poshtë argumentin e qeverisë greke sipas së cilës ajo duhej të ndërhynte me qëllim që të parandalonte krijimin e tensioneve në gjirin e besimtarëve myslimanë, midis këtyre dhe të krishterëve në atë zonë si dhe midis Greqisë dhe Turqisë. Gjykata vlerësoi se tensione të tilla janë gjithmonë të mundshme në rastet kur një bashkësi është e ndarë, por roli që duhet të luajnë autoritetet konsiston jo në eliminimin e pluralizmit por në garantimin e

tolerancës të grupeve të ndryshme ndaj njëri-tjetrit. Për këtë arsye ndërhyrja ndaj së drejtës së garantuar nga ana e nenit 9 u vlerësua si e pajustificueshme.

12. Shumë prej ankesave në lidhje me lirinë e besimit kanë lindur në Greqi ku Kisha Ortodokse ka një pozitë të veçantë. Në rastin Manoussakis kundër Greqisë<sup>193</sup> Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 9 në një rast kur Dëshmitarët e Jehovahit u ndoqën penalisht në bazë të së drejtës greke e cila ndalonte krijimin e një selie fetare pa autorizim, për çdo besim tjetër përveç atij ortodoks. Gjykata ka konstatuar gjithashtu shkelje të neneve 6 dhe 14 në çështjen Kisha Katolike e Caneas kundër Greqisë<sup>194</sup> për shkak se Kisha Ortodokse dhe bashkësia hebre mund të nisinin procedurat ligjore për të mbrojtur pronën e tyre kurse Kisha Katolike nuk e bënte dot këtë gjë. Vendimi ka rëndësi për t'u kuptuar në kuadrin e situatës shqiptare dhe të debatit të prej disa vitesh sidomos mbi vetorganizimin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare. Pavarësisht nga ekzistenca e nenit 10 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>195</sup>, mungesa e një ligji apo e marrëveshjeve për të cilat bën fjalë paragrafi 5 i këtij neni e lënë ende situatën në një paqartësi shqetësuese.

<sup>193</sup> Vendim i Gjykatës i 26 shtatorit 1996 i përfshirë në këtë përmbledhje.

<sup>194</sup> Vendim i Gjykatës i 16 dhjetorit 1997.

<sup>195</sup> Paragrafët më interesantë të këtij neni për qëllimet e vendimit që po komentojmë janë: "2. Shteti është asnjëherë në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. ... 4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjelltë pavarësinë e njëri-tjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. 5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend."

# NENI 10

LIRIA E SHPREHJES

## AXEL SPRINGER kundër GJERMANISË DHE VON HANNOVER (2) kundër GJERMANISË

(kërkesat nr. 39954/08, 40660/08 dhe 60641/08)

7 shkurt 2012

### Dhomë e Madhe

*mbulimi mediatik i jetës private të personave të famshëm mbrohet nga neni 10, nëse ekziston interesi i përgjithshëm dhe vendoset një ekuilibër i arsyeshëm me të drejtën për respektimin e jetës private*

#### I. Faktet kryesore

*i) Axel Springer AG*

1. Shoqëria kërkuese, Axel Springer AG ("Springer"), e regjistruar në Gjermani, është botuesja e Bild, gazetës së përditshme me tirazhin më të madh në vend.

2. Në shtator 2004, Bild ka publikuar një artikull në faqen e parë të saj për X, një aktor i njohur televiziv, duke u arrestuar në festën e birrës në Mynih pasi i ishte gjetur kokainë. Artikulli gjithashtu përmendi se X, i cili kishte luajtur rolin e një inspektori policie në një serial televiziv popullor prej vitit 1998, ishte dënua edhe në korrik 2000 me dënim me kusht për posedim droge. Gazeta publikoi një artikull të dytë në korrik 2005, duke raportuar se X ishte dënua dhe gjobitur për posedim të paligjshëm të drogës, pasi kishte rrëfyer plotësisht ngjarjen.

3. Kur artikulli u publikua për herë të parë, X nisi një proces gjyqësor kundër Springer në Gjykatën Rajonale të Hamburgut. Gjykata pranoi kërkesën e X-it dhe ndaloi çdo publikim të mëtejshëm të atij artikulli dhe fotove lidhur me të. Në një tjetër set procedurash në lidhje me artikullin e dytë botuar për dënimin e X-it, Gjykata Rajonale e Hamburgut dha gjithashtu një urdhër. Vendimet u lanë në fuqi nga Gjykata e Apelit në Hamburg dhe Gjykata Federale e Drejtësisë. Në të dy rastet, gjykatat vendosën se e drejta e X-it për mbrojtjen e jetës së tij private, mbizotëroi mbi interesin publik.

*ii) Von Hannover (nr. 2)*

4. Kërkuesit ishin Princesha Caroline von Hannover, e bija e të ndjerit Princit Rainier III i Monakos dhe bashkëshorti i saj Princi Ernst August von Hannover.

5. Prej fillimit të viteve 1990 Princesha Caroline është përpjekur për të parandaluar publikimin e fotografive të jetës së saj private në shtyp. Dy sete të fotografish, botuar në vitin 1993 dhe 1997 në revista gjermane kanë qenë subjekt i tre serie procedurash

përpara gjykatave gjermane. Këto procedura në fund u konkluduan me vendim nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih "*Caroline von Hannover k. Gjermanisë* (nr. 59320/00)"). Në këtë rast, Gjykata u shpreh se publikimi i fotografive kishte cenuar të drejtën e Princeshës Caroline për gezimin e jetës së saj private, sipas nenit 8 të Konventës.

6. Duke iu referuar çështjes "*Caroline von Hannover k. Gjermanisë*", Princesha Caroline dhe Princi Ernst August kanë hapur një sërë procesesh gjyqësore përpara gjykatave civile gjermane ku kërkojnë një urdhër kundër publikimit të fotografive të mëtejshme të tyre. Gjykata Federale e Drejtësisë pranoi kërkesën e Princeshës sa i përket publikimit të dy fotografive, duke deklaruar se ato nuk kontribuojnë në një debat me interes të përgjithshëm. Megjithatë, kjo gjykatë rrëzoi kërkesën e saj për një foto tjetër të çiftit duke ecur gjatë një pushimeve dimërore në Shën Moritz. Kjo fotografi u shoqërua me një artikull mbi shëndetin e dobët e princit Rainier të Monakos. Në marrjen e vendimit të saj, Gjykata Federale vendosi se shëndeti i dobët Princit ishte një çështje me interes publik dhe se shtypi ka pasur të drejtë për të raportuar për mënyrën në të cilën fëmijët e tij pajtojnë detyrimet e tyre të solidaritetit familjar me nevojat legjitime të jetës së tyre private.

7. Më pas, Gjykata Kushtetuese Federale hodhi poshtë një ankesë kushtetuese bërë nga Princesha Caroline, duke rrëzuar në mënyrë të veçantë pretendimin e saj se gjykatat gjermane kishin shpërfillur ose nuk kishin marrë parasysh mjaftueshëm çështjen "*Caroline von Hannover k. Gjermanisë*".

8. Axel Springer AG u ankua se urdhri për të ndaluar çdo publikimin e mëtejshëm të artikujve për aktorin X kishte cenuar të lirinë e tyre të shprehjes, sipas nenit 10 të Konventës.

9. Princesa Caroline von Hannover dhe Princi Ernst August von Hannover ankuan se refuzimi i gjykatave gjermane për të ndaluar çdo publikim të mëtejshëm të fotografive objekt gjykimi kishte shkelur të drejtat e tyre sipas nenit 8 të Konventës. Në veçanti, ishte theksuar se gjykatat gjermane nuk e kishin marrë në konsideratë vendimin *Caroline von Hannover k. Hannover k. Gjermanisë*.

## II. Vendimet e Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 10

#### i. Axel Springer AG

10. Dhoma pranë së të cilës kërkesat ishin paraqitur për gjykim si aplikime të ndara vendosi bashkimin e tyre dhe hoqi dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe.

11. Fakti se vendimet e gjykatave gjermane përbënin një ndërhyrje në të drejtat e Springer sipas nenit 10, nuk u kundërshtua nga palët. Në të njëjtën linjë qëndronte dhe fakti se ndërhyrja në fjalë ishte e parashikuar nga ligji gjerman dhe se kishte ndjekur një qëllim legjitim, për mbrojtjen e dinjitetit të të tjerëve.

12. Për sa i përket pyetjes nëse ndërhyrja kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike, Gjykata vërejtë se artikujt në fjalë, në lidhje me arrestimin dhe dënimin e aktorit, përbënin fakte gjyqësore publike, mbi të cilat publiku kishte një interes për t'u informuar. Gjykatave vendase i takonte të vlerësonin se sa i njohur ishte ky person, duke u ndalur në faktin se ky aktori ishte gjerësisht i njohur në nivel kombëtar. Gjykata vërejtë se, Gjykata gjermane e Apelit kishte theksuar se aktori kishte luajtur rolin e një inspektori të policisë gjatë një periudhe të gjatë kohe dhe ishte mirënjohur e shumë popullor. Prandaj, Gjykata vërejtë se X ishte një figurë e cila mund të kualifikohet si publike. Ky fakt përforconte interesin e publikut për t'u informuar për arrestimin e tij dhe procedurat e mëtejshme gjyqësore.

13. Gjykata mund të pajtohet me vlerësimin e gjykatave gjermane se interesi i gazetës për të publikuar artikujt vinte vetëm nga fakti se personi i arrestuar ishte aktor i mirënjohur, i cili kishte kryer një vepër penale – vepër që nuk do të kishte qenë raportuar nëse do të ishte kryer nga një individ i panjohur për publikun. Gjykata theksoi se aktori ishte arrestuar në publik në festën e birrës në Mynih. Pritshmëria e aktorit se jeta e tij private do të mbrohej në mënyrë efektive, duhet të ishte reduktuar edhe nga fakti se ai vetë kishte zbuluar detaje rreth jetës së tij private në një numër intervistash të dhëna më parë.

14. Në bazë të një deklaratë bërë nga një prej gazetarëve të përfshirë, fakt i cili nuk u kundërshtua nga qeveria gjermane, informacioni i publikuar në gazetën Bild në shtator të vitit 2004 ishte marrë nga zyra e prokurorit publik të Mynihut dhe policia. Për këtë arsye ekzistonte një bazë e mjaftueshme faktike, për të besuar vërtetësinë e informacionit. Nuk ekziston asnjë bazë për të argumentuar se Springer nuk kishte ndërmarrë në shqyrtim balancimin ndërmjet interesit të tij në publikimin e informacionit dhe të drejtës së aktorit për të respektuar jetën e tij private. Duke pasur parasysh se Springer kishte marrë konfirmimin e informacionit të përcjellë nga autoritetet e ndjekjes penale, nuk ka pasur arsye mjaftueshmërisht të forta për të besuar se ajo duhet të ruajë anonimitetin e aktorit. Nuk mund të thuhet pra, se kompania kërkuese ka vepruar me keqbesim.

15. Gjithashtu, Gjykata theksoi se artikujt nuk kanë zbuluar detaje në lidhje me jetën private të aktorit, por ishin ndalur kryesisht tek rrethanat e arrestimit dhe rezultatin e procesit penal kundër tij. Artikujt nuk përmbanin shprehje përçmuese apo pretendime të pabaza dhe autoritetet nuk kishin provuar se publikimi i artikujve kishte rezultuar në pasoja të rënda për aktorin, ndërsa sanksionet e vendosura mbi Springer, mund të prodhonin një efekt frenues mbi kompaninë. Gjykata arriti në përfundimin se kufizimet e vendosura ndaj kompanisë nuk kishin qenë proporcionale me qëllimin legjitim të mbrojtjes së jetës private e aktorit. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës.

ii. *Von Hannover* (nr. 2)

16. Gjykata vërejtë se, pas vendimit të saj në 2004 "*Caroline von Hannover k. Gjermanisë*", Gjykata Federale e Drejtësisë kishte bërë ndryshime në jurisprudencën



e saj të mëparshme. Në veçanti, Gjykata Federale e Drejtësisë kishte deklaruar se ishte e rëndësishme nëse një raport në media kontribonte në një debat faktik dhe nëse përmbajtja e tij shkonte përtej një dëshire të thjeshtë për të kënaqur kuriozitetin e publikut. Gjykata Federale e Drejtësisë ka theksuar se sa më e madhe vlera e informacionit për publikun, aq më shumë ekziston interesi i një personi të mbrojtë jetën e tij private dhe anasjelltas.

17. Fakti se, Gjykata Federale e Drejtësisë ka vlerësuar vlerën e informacionit dhe fotos në fjalë në dritën e artikullit që është botuar së bashku me të, nuk mund të kritikohet në bazë të Konventës. Gjykata mund të pranojë që fotoja, në kontekstin e shkrimit në një farë mase, kontribuonte për një debat me interes të përgjithshëm. Gjykatat gjermane u shprehën se karakterizimi i sëmundjes së Princit Rainier si një rast i një shoqërie bashkëkohore, nuk mund të konsiderohej i paarsyeshëm.

18. Gjykata më tej vuri në dukje se pavarësisht pyetjes se në çfarë mase Caroline von Hannover mori funksionet zyrtare në emër të Principatës së Monakos, ajo nuk mund të pretendojë se nuk ishte e njohur nga publiku, duke u trajtuar si një individ i zakonshëm privat. Kështu kërkuesit duhej të konsiderohen si figura publike. Gjykatat gjermane kishin konstatuar se kërkuesit nuk kishin provuar se fotot ishin kryer në një klimë të përgjithshme shqetësimi, apo ishin bërë në mënyrë të fshehtë, ashtu siç kishin pretenduar kërkuesit.

19. Në përfundim, Gjykata vendosi se gjykatat gjermane kishin balancuar me kujdes lirinë e shprehjes kundrejt të drejtës së kërkuesve për respektimin e jetës së tyre private. Duke vepruar kështu, gjykatat gjermane kishin zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ, duke përfshirë këtu dhe çështjen "*Caroline von Hannover k. Gjermanisë*". Për rrjedhojë, në këtë rast nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

20. Gjykata vendosi se Gjermania duhet t'i paguante kompanisë Axel Springer AG vlerën prej 17 734.28 euro në kuadër të dëmit material dhe 32 522.80 euro në lidhje me shpenzimet gjyqësore.

## **III. Koment**

### *Axel Springer AG*

21. Ky rast kishte të bënte me publikimin në revistën gjermane të një sërë fotografish të Caroline Von Hannover, vajza e madhe e princit Rainier III të Monakos. Pas procesit gjyqësor në gjykatat e brendshme gjermane lidhur me publikimet, ajo u ankua në Gjykatë për mungesën e mbrojtjes së duhur të jetës private dhe imazhit të saj nga ana e shtetit.

22. Gjykata iu qas çështjeve duke theksuar se mbrojtja e jetës së saj private duhej të balancohej kundrejt lirisë së shprehjes të garantuar në nenin 10. Nga njëra anë, ajo theksoi se e drejta për lirinë e shprehjes vlen për publikimin e fotografive. Nga

ana tjetër, ajo u shpreh se kjo është një fushë në të cilën mbrojtja e të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve merr një rëndësi të veçantë.

23. Në vlerësimin e ekuilibrit mes zbatimit të të drejtave të nenit 8 dhe nenit 10, Gjykata ka konstatuar disa pika të rëndësishme:

- Faktori vendimtar në vendosjen e ekuilibrit midis të drejtës së nenit 8 dhe nenit 10 është kontributi i dhënë nga fotot apo artikujt në shtyp për një debat me interes publik. Kërkuesja ka përfaqësuar familjen mbretërore të Monakos në ngjarje të caktuara kulturore apo bamirëse, por ajo nuk ka ushtruar funksione zyrtare. Fotot lidhen vetëm me jetën private të kërkueses dhe nuk kontribuojnë në një debat publik. Gjykata nënvizoi se duhej bërë një interpretim më i ngushtë i nenit 10.
- Në këtë rast, fotot përmban informacion shumë personal apo edhe intim rreth kërkuesit. Gjykata theksoi se fotot e publikuara në shtypin e shkruar shpesh janë marrë si ngacmime të vazhdueshme, të cilat personit në fjalë i shkaktajnë një ndjenjë shumë të fortë ndërhyrje apo edhe të persekutimi në jetën e tyre private.
- Ato janë marrë pa dijeninë apo pëlqimin e kërkuesit dhe u shpreh se ngacmimet e shkaktuara ndaj shumë figurave publike në jetën e përditshme nuk mund të shpërfillen plotësisht.
- Gjykata konsideroi se publiku nuk ka një interes legjitim për të ditur se ku ndodhet kërkuesja dhe se si ajo sillet në përgjithësi në jetën e saj private, edhe nëse ajo shfaqet në vende që jo gjithmonë mund të cilësohen si të veçuara dhe pavarësisht faktit se ajo është e njohur nga publiku.

24. Gjykata theksoi se neni 8, e drejta për respektimin e jetës private shtrihej përtej rrethit privat familjar dhe gjithashtu përfshinte një shtrirje shoqërore. Edhe personat e njohur për publikun e gjerë, duhet të kenë mundësinë për të gëzuar një "pritje legjitime" të mbrojtjes dhe respektimit të jetës së tyre private, veçanërisht duke pasur parasysh teknologjitë e reja të komunikimit. Gjykata vendosi unanimisht se e drejta e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private ishte shkelur nga mosveprimi i autoriteteve në mbrojtjen e saj nga ndërhyrjet e shtypit. Kjo mund të krahasohet me vendimin e Gjykatës në "*Von Hannover (nr. 2)*", në të cilin nuk u konstatua asnjë shkelje në lidhje me fakte të ngjashme pasi gjykatat e brendshme kishin parë me kujdes ekuilibërën mes interesave konkurruese, duke marrë parasysh jurisprudencën e Gjykatës.

## HANDYSIDE kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 5493/72)

7 dhjetor 1976

*botimi i një libri me përmbajtje pornografike mund të ndalohet nga shteti kur ai rrezikon të prekë moralin dhe rendin sidomos ndërmjet adoleshentëve*

### I. Faktet kryesore

1. Z. Richard Handyside, shtetas britanik i lindur në 1943, ishte pronar i Stage 1, një shtëpie botuese e themeluar prej tij në Londër, në 1968. Në shtator 1970, ai bleu të drejtën e botimit në Mbretërinë e Bashkuar të librit “Libri i vogël i kuq”, për përdorim nga ana e nxënësve britanikë. I hartuar nga dy danezë, Søren Hansen dhe Jesper Jansen, ai ishte bërë si një vepër reference dhe bënte fjalë për edukimin dhe mësimdhënien ndërkohë që rreth 1/10 e përmbajtjes kishte të bënte me çështjet seksuale. Ai doli në fillim në Danimarkë, në 1969, e në vijim, pas përkthimeve dhe përshtatjeve, në Republikën Federale Gjermane, në Belgjikë, në Finlandë, në Francë, në Greqi, në Islandë, në Itali, në Norvegji, në Holandë, në Suedi dhe në Zvicër si dhe në vende të tjera jo evropiane. Për më tepër, ai qarkulloi lirshëm në Austri dhe Luksemburg.

2. Pas përkthimit të librit në anglisht, z. Handyside përgatiti një botim për Mbretërinë e Bashkuar. Shitja për publikun duhet të fillonte më 1 prill 1970. Pas shtypit, botuesi i dërgoi për recension disa qindra ekzemplarë një serie botuesish të tjerë, që nga gazetat e përditshme kombëtare dhe lokale deri tek gazetat pedagogjike dhe mjekësore. Disa shpjegime dolën edhe në shtyp.

3. Më 30 mars 1971, pas disa ankimesh, autoritetet britanike morën masa në përputhje me ligjet e vitit 1959 dhe 1964 mbi botimet e turpshme. Më 31 mars dhe 1 prill, policia ndaloi të gjitha kopjet që ndodheshin tek botuesi dhe në shtypshkronjë. Sidoqoftë rreth 18 800 kopje nga afro 20 000 që ishin çuar për shtyp, iu shmangën kontrollit dhe iu shitën më pas, kryesisht shkollave që i kishin porositur. Më 1 korrik 1971 filloi hetimi ndaj z. Handyside. Gjykata e Lambeth e dënoi me gjobë dhe urdhëroi shkatërrimin e librave të bllokuar. Botuesi i bëri apel “Inner London Quarter Sessions<sup>196</sup>”, por pa sukses. Pasi dëgjoi dëshmitarët, kjo gjykatë, më 29 tetor 1971, arriti në përfundimin se, libri, i vlerësuar në tërësinë e tij, ishte i turpshëm për shkak të qëllimit që kishte për të shthurur dhe korruptuar një pjesë të rinisë që mund ta lexonin atë. Për më tepër, ajo çmoi se pavarësisht nga disa aspekte të vlefshme të librit, z. Handyside nuk arriti të provonte në bazë të përjashtimeve që parashikonte

<sup>196</sup> Gjykatë me juridiksion apeli në Angli.

ligji, se dobia publike do të justifikonte botimin. Një botim i rishikuar i librit “Libri i vogël i kuq” u shfaq më 15 nëntor 1971, pa i lënë vend hetimeve.

4. Në kërkesën e tij të paraqitur Komisionit më 13 prill 1972, z. Handyside pretendoi se autoritetet britanike kishin shkelur, midis të tjerash, lirinë e tij të shprehjes dhe të drejtën për respektimin e pasurisë së tij. Gjithashtu, ai pohoi se Mbretëria e Bashkuar nuk i kishte siguruar plotësisht gëzimin e të drejtave të tij, duke e diskriminuar në bazë të opinioneve të tij.

5. Komisioni, më 4 prill 1974, vendosi ta marrë në analizë çështjen *ex officio* nën dritën e neneve 17 dhe 18 të Konventës. Në raportin e tij të 30 shtatorit 1975, ai arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të neneve 10 dhe 18 të Konventës dhe as të nenit 1 të Protokollit 1. Ai e çmoi njëzëri të panevojshme që të thellohej më tej në analizën e çështjes, nën dritën e nenit 17 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 10

6. Pasi ishte e qartë se bllokimi i librit dhe hetimi ndaj z. Handyside përbënin ndërhyrje ndaj lirisë së tij të shprehjes së parashikuar në paragrafin e parë të nenit 10, Gjykata kaloi në analizën nëse këto masa përmbushnin kushtet e përmendura qartë në paragrafin 2 të nenit 10 dhe pra mund të justifikoheshin.

#### i. A ishin të ligjshme?

7. Mund të thuhej se masat e marra nga ana e qeverisë britanike ishin të ligjshme, sepse ato bazoheshin në ligjet e viteve 1959 dhe 1964 lidhur me botimet e turpshme. Z Handyside kritikonte zbatimin e tyre vetëm në raport me Konventën dhe jo me legjislacionin e brendshëm.

#### ii. A ishin masat legjitime?

8. Ndërmjet qëllimeve të numëruara në nenin 10, Gjykata vlerësoi se mbrojtja e moralit përbënte të vetmin objektiv të ligjeve të viteve 1959 dhe 1964. Masat individuale të marra në bazë të këtyre ligjeve i nënshtroheshin një kontrolli. Por, “Libri i vogël i kuq” i drejtohej mbi të gjitha fëmijëve dhe adoleshentëve nga dymbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç, të cilët mund të interpretonin disa pjesë si një nxitje për t’u marrë me veprimtari të dëmshme dhe jo të moshës së tyre, deri aty sa edhe për të kryer vepra penale. Si rrjedhim, gjyqtarët anglezë kishin të drejtë të besonin në atë kohë se libri do të kishte pasoja shkatërruese mbi moralin e të rinjve. Kërkuesi nënvizonte se gjykata angleze e apelit kishte cituar disa pjesë të tjera të librit, të konsideruara prej saj si prishje të rendit. Ai mbështeste idenë se pas hetimit fshihej një çështje politike. Gjykata hodhi poshtë këtë pretendim me argumentimin se *Inner London Quarter Sessions* e konsideroi pretendimin, prishje e rendit, si një element që synonte shthurjen dhe korrupsionin. Ajo pranoi se masat e kundërshtuara kishin si qëllim kryesor të mbronin moralin e të rinjve.

iii. *A ishin masat të nevojshme?*

9. Në vijim, Gjykata vërejtë se ishte e pamundur të nxirrje në pah nga legjislacionet e shteteve palë një nocion evropian uniform të moralit dhe se neni 10 § 2 parashikonte një hapësirë vlerësimi në dorë të shteteve palë për të vendosur se ç'është e nevojshme për mbrojtjen e moralit. Por ajo theksoi se kjo hapësirë nuk është e pakufizuar - ajo i nënshtrohet kontrollit të vetë asaj. Liria e shprehjes përbën një nga themelet e shoqërisë demokratike dhe vlen edhe për idetë që lëndojnë, tronditin ose shqetësojnë. Çdo kufizim në këtë fushë duhet të jetë në proporcion me qëllimin dhe Gjykata e ka për detyrë të përcaktojë nëse arsyet që mbështesin këtë kufizim janë të bindshme dhe të mjaftueshme.

10. Z. Handyside jepte një sërë argumentesh për të provuar se masat e kundërshtuara prej tij nuk ishin të nevojshme. Pasi shqyrtoi secilin prej tyre, Gjykata, duke u bazuar në elementet që ajo dispononte, u shpreh se neni 10 nuk ishte shkelur. **B. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 111.** Përsa i përket të drejtës së z. Handyside për respektimin e pasurisë, Gjykata njëzëri vlerësoi se pika 2 e nenit 1 të Protokollit 1 autorizonte si bllokimin e përkohshëm të librave, ashtu edhe konfiskimin dhe shkatërrimin e tyre. I pari ishte në përputhje me legjislacionin anglez dhe ishte bërë në dobi të interesit të përgjithshëm sepse kishte si qëllim mbrojtjen e moralit. Lidhur me të dytin dhe të tretin, bëhej fjalë për masa që zbatoheshin në bazë të parimeve të së drejtës së brendshme të shteteve palë, kur përdorimi i gjërave ishte gjykuar rregullisht i paligjshëm dhe i rrezikshëm për interesin e përgjithshëm.

**C. Në lidhje me nenin 14 12.** Së fundi, Gjykata njëzëri hodhi poshtë pretendimet e z. Handyside i cili ankohej për një trajtim diskriminues, në kundërshtim me nenin 14 të Konventës. Së pari, asgjë nuk të bënte të besojë se botuesi ishte hetuar për shkak të opinionëve politike. Së dyti, nuk provohej se botimet dhe shfaqjet pornografike të lejuara në Mbretërinë e Bashkuar i drejtoheshin po njësoj si "Libri i vogël i kuq", fëmijëve dhe adoleshentëve të cilët mund ta merrnin këtë fare lirshëm. Së treti, nuk dilte që masat e marra kundër kërkuesit dhe librit përkatës të ishin të ndryshme nga vendime të tjera të marra në raste të ngjashme, deri në atë pikë sa mund të përbënin mohim të drejtësisë ose një abuzim të dukshëm.

### III. Koment

13. Vendimi Handyside përbën gurin e parë në themelet e jurisprudencës së Gjykatës në lidhje me nenin 10 dhe me konceptin e lirisë së shprehjes. Ky vendim mund të thuhet se ofron edhe përjasjen e përgjithshme të Gjykatës në lidhje me këtë koncept si dhe me elementët përbërës të tij por edhe me parime të përgjithshme të interpretimit të Konventës.

14. Me këtë vendim që kishte të bënte me një tërësi interesash të ndryshme private dhe publike, individuale dhe shoqërore, Gjykata arrin të përpunojë konceptin "e nevojshme në një shoqëri demokratike" duke e perceptuar si një moment që nënkupton ekzistencën e "një nevoje të ngutshme shoqërore" që të mund të gjejë

zbatim si një nga kriteret e paragrafit 2 të nenit 10, për të justifikuar ndërhyrjet ndaj së drejtës së parashikuar nga paragrafi 1 i të njëjtit nen. Pikërisht duke i konsideruar masat e marra ndaj z. Handyside si të nevojshme në një shoqëri demokratike për qëllime legjitime të parashikuara nga neni 10 § 2 i Konventës, Gjykata arriti t'i justifikojë ato dhe të mos konsiderojë shkelje të Konventës në këtë rast.

15. Vlera tjetër e spikatur e këtij vendimi është përpunimi i parimit, tashmë themelor, në interpretimin e Konventës – i hapësirës së vlerësimit<sup>197</sup>. Duket se ky parim është huazuar nga jurisprudenca e përdorur nga Conseil d'Etat në Francë, në ushtrimin nga ana e tij të rishikimit gjyqësor të akteve me karakter administrativ. Thelbi i këtij parimi nënkupton që shteteve iu lihet njëfarë hapësire vlerësimi dhe veprimi në lidhje me masat dhe mjetet në kuadrin e detyrimeve të tyre në bazë të neneve 8-11 të Konventës. Por nga ana tjetër, nëse kjo hapësirë vlerësimi vjen apo jo në përputhje me standardet e Konventës – këtë e vendos gjithmonë në analizë të fundit Gjykata. Thënë me fjalë të tjera, shtetet anëtare të Konventës janë të lira operojnë në të gjitha fushat e mbuluara nga veprimi i Konventës, përfshirë këtu edhe lirinë në zgjedhjen e masave dhe të teknikave të veprimit, për aq kohë sa pasojat e veprimeve ose të mosveprimeve të tyre nuk rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa. Ky parim është përdorur edhe në interpretimin e neneve të tjera të Konventës por duhet pranuar se në interpretimin e nenit 10, ai ka gjetur kulmin e rëndësisë së vet në Strasburg. Në çështjen Handyside, në lidhje me këtë parim Gjykata lë të kuptohet se hapësira e vlerësimit të shteteve kur ndërhyjnë ndaj lirisë së shprehjes është e gjerë kur vihet në lojë mbrojtja e moralit publik.

## SHOQATA EKIN kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 30882/96)

17 korrik 2001

*përmbajtja e një botimi që sipas qeverisë nxiste pikëpamje separatiste, sipas Gjykatës nuk e justifikonte masën e ndalimit të botimit dhe shpërndarjes së tij në Francë*

### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje ka të bëjë me një shoqatë të quajtur Ekin dhe me seli në Bayonne, Francë, e cila ishte themeluar për të mbrojtur kulturën baske dhe mënyrën e jetesës baske.

<sup>197</sup> Në lidhje me konceptin e hapësirës së vlerësimit (në Ang.: 'Margin of Appreciation', ndërsa të Frëngj.: 'Marge d'Appréciation') shih në shqip "Të Drejtat e Njeriut në Evropë - Jurisprudencë dhe Komente" Tiranë 2001, fq. 38-39. Në gjuhë të huaj mund të shihen ndër të tjera J.G. Merrils "The Development of International Law by the European Court of Human Rights, 1993, Manchester University Press, fq. 174 e vijim", Timothy Jones "The devaluation of Human Rights Under European Convention", 1995 Public Law, fq. 449.



2. Më 1987 kërkuesit botuan një libër të titulluar “Euskadi në luftë” në disa gjuhë të ndryshme dhe në disa vende evropiane. Ky botim ishte një vlerësim i aspekteve historike, kulturore, gjuhësore dhe socio-politike të konfliktit bask.

3. Më 29 prill 1988 një dekret ministror i nxjerrë në bazë të nenit 14 të Ligjit të 29 korrikut 1881, të amenduar nga një dekret i 6 majit 1939, ndaloi qarkullimin, shpërndarjen dhe shitjen e këtij libri në Francë me arsyetimin se ai nxiste separatizmin, bënte thirrje për përdorimin e veprimeve të dhunshme dhe, për pasojë, përbënte një rrezik potencial për rendin publik. Kërkuesi bëri një ankim pranë Ministrisë të Brendshme, por u konsiderua sikur kërkesa e tij ishte hedhur poshtë. Pas kësaj ai bëri një kërkesë-padi në Gjykatën Administrative të Pau, e cila vendosi se nuk kishte juridiksion dhe ia kaloi çështjen Conseil d’État<sup>198</sup>. Ky i fundit ia ktheu çështjen Gjykatës Administrative të Pau, e cila si përfundim e hodhi poshtë kërkesën me arsyetimin se libri ishte me origjinë të huaj dhe përfaqësonte një rrezik potencial për rendin publik.

4. Kërkuesi u ankua në Conseil d’État, i cili e hodhi poshtë vendimin e kundërshtuar dhe dekretin ministror me arsyetimin se në mungesë të ndonjë dispozite ligjore që përcaktonte bazat për vendosjen e një ndalimi në bazë të nenit 14 të Ligjit të 29 korrikut 1881 dhe duke pasur parasysh interesat që ministri ishte ngarkuar të përfaqësonte, në veçanti shëndetin publik dhe rendin publik, përmbajtja e librit në vetvete nuk justifikonte sipas ligjit ndërhyrje në lirinë e shtypit, të tilla që të arrinin deri në një ndalim qarkullimi dhe shitjeje. Nga ana tjetër Conseil d’État vlerësoi se neni 14 i Ligjit të vitit 1881, siç ishte amenduar, nuk ishte në kundërshtim me nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të interpretuar së bashku me nenin 14 të kësaj.

5. Duke u bazuar në nenin 10 të Konventës, kërkuesi ankohej se neni 14 i Ligjit të vitit 1881, siç ishte amenduar, ishte tepër i paqartë për një rregull ligjor dhe se nuk përmbushte kërkesat e njohjes dhe të parashikueshmërisë në lidhje me pasojat që zbatimi i tij mund të krijonte. Nga ana tjetër ndërhyrja nuk ishte e lejueshme në bazë të kriterit të nevojës në një shoqëri demokratike. Për më tepër, dispozita i dha shtytje një debati në lidhje me dallimin në kuadrin e rasteve mbi lirinë e shprehjes të bazave ligjore të një gjuhe ose origjine kombëtare dhe për pasojë, sipas tij, ishte në kundërshtim me nenin 14 të marrë së bashku me nenin 10. Kërkuesi u bazua gjithashtu në nenin 6 § 1 (e drejta për të pasur një vendim në lidhje me të drejtat me karakter civil brenda një afati të arsyeshëm) dhe në nenin 13.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 10 të marrë më vete dhe bashkë me nenin 14

6. Neni 14 i Ligjit të vitit 1881, siç ishte amenduar, ishte formuluar në terma mjaft të gjerë dhe i jepte kompetenca të gjera Ministrisë të Brendshme për të nxjerrë urdhra administrativë që ndalonin përhapjen e botimeve me origjinë të huaj ose të shkruara

<sup>198</sup> Gjykata e Lartë Administrative në sistemin juridiksional francez.

në gjuhë të huaj. Kufizime të tilla paraprake nuk ishin, *a priori*, në kundërshtim me Konventën. Pavarësisht nga kjo, kërkohet një kuadër ligjor për të siguruar një kontroll të kujdesshëm në lidhje me qëllimin e ndalimeve dhe rishikimin efektiv gjyqësor për të parandaluar çdo abuzim kompetencash.

7. Duke pasur parasysh qëllimin e rregullave të zbatueshme ndaj botimeve të huaja, Gjykata vuri në dukje se neni 14 i Ligjit të vitit 1881, siç ishte amenduar më 1939, vendoste një përjashtim ndaj rregullit të përgjithshëm, duke i dhënë Ministrin të Brendshëm kompetencën për të vendosur një ndalim të përgjithshëm dhe absolut që mbulonte të gjithë territorin francez, në lidhje me qarkullimin, shpërndarjen ose shitjen e çdo dokumenti të hartuar në gjuhë të huaj ose të çdo dokumenti të konsideruar me origjinë të huaj edhe pse mund të ishte hartuar në frëngjisht. Gjykata vuri në dukje se dispozita nuk i qartësonte rrethanat në të cilat kjo kompetencë mund të përdorej. Në veçanti, nuk kishte përcaktim të konceptit “origjinë e huaj” dhe asnjë element mbi bazat për mundësinë e ndalimit të një botimi që mund të konsiderohej i huaj. U pranua natyrisht, që këto boshllëqe ishin mbushur pak nga pak nga jurisprudenca e gjykatave administrative. Megjithatë, siç e tha edhe kërkuesi, zbatimi i këtyre rregullave, në disa raste, kishte dhënë rezultate që kishin qenë, në më të paktën, të çuditshme dhe në raste të tjera ishin kthyer në arbitraritete duke u varur nga gjuha e botimit ose vendi i origjinës së tij.

8. Përsa i përket mënyrës në të cilën u dha urdhri administrativ i ndalimit dhe kuadrit të rishikimit gjyqësor të këtij ndalimi, Gjykata vuri në dukje se ky i fundit gjeti vend vetëm *ex post facto*. Për më tepër, rishikimi gjyqësor nuk ishte me efekt të menjëhershëm përderisa mund të fillonte vetëm me ankimin e botuesit pranë gjykatave. Në lidhje me shtrirjen dhe efektivitetin e rishikimit gjyqësor, Gjykata e vlerësoi që deri në dhënien e vendimit nga *Conseil d'État* përsa i përket kësaj çështjeje, gjykatat administrative kishin dhënë vetëm një numër të kufizuar vendimesh rishikuese të dekreteve ministrore të nxjerra në bazë të nenit 14 të Ligjit të vitit 1881, siç ishte amenduar. *Conseil d'État* nuk i kishte ushtruar kompetencat e tij rishikuese në lidhje me bazat për nxjerrjen e dekretit deri në vendimin e tij të 9 korrikut 1997 në lidhje me çështjen Ekin. Duke pasur parasysh këtë, kërkuesit i ishte dashur që të priste më shumë se nëntë vjet përpara se të kishte në dorë një vendim gjyqësor përfundimtar. Natyrisht që kohëzgjatja e procedurave kishte prekur thelbësisht efektivitetin e rishikimit gjyqësor, ndërkohë që çështja duhet të ishte trajtuar me zhdërvjelltësi, duke pasur parasysh objektin e saj. Një rrethanë rënduese, që as nuk u kundërshtua nga ana e qeverisë, ishte ajo që, sipas dispozitave ligjore të zbatueshme në çështjen në fjalë, pezullime të ekzekutimit akordoheshin vetëm në rast se pala e interesuar ishte në gjendje të tregonte se ndalimi i botimit do të shkaktonte dëme, që ishin të vështira për t'u ndrequr më vonë. Mjafton të thuhet se ky ishte një kusht i vështirë për t'u përmbushur. Së fundmi, neni 8 i Dekretit të 28 nëntorit 1983 parashikonte që, në qoftë se autoritetet konstatonin se ndalimi i botimit kërkohet me urgjencë, botuesi nuk kishte të drejtë të paraqiste pretendime me shkrim ose me gojë përpara se dekreti që parashikonte ndalimin të miratohej. Pikërisht kjo gjë kishte ndodhur edhe në rastin që po shqyrtohej përpara Gjykatës.

Si përfundim, Gjykata vendosi se procedurat e rishikimit gjyqësor, të zbatueshme në lidhje me ndalimet me karakter administrativ ndaj botimeve, parashikonin garanci të pamjaftueshme ndaj abuzimeve të mundshme.

9. Qeveria argumentoi se ekzistenca e legjislacionit që rregullonte në mënyrë specifike botimet me origjinë të huaj ishte justifikuar, ndërmjet të tjerash, nga fakti se ishte e pamundur që të ngriheshin padi ose të fillohej ndjekja penale ndaj autorëve ose botuesve përgjegjës për qëndrime të paligjshme, kur ata ishin jashtë juridiksionit francez. Gjykata nuk e gjeti këtë si argument bindës. Ajo, për më tepër, vuri në dukje se selia kryesore e shoqatës kërkuese, e cila ishte botuesja e veprës së ndaluar, ndodhej pikërisht në Francë.

10. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata ashtu si edhe *Conseil d'État*, vendosi se përmbajtja e librit nuk justifikonte, sidomos nën këndvështrimin e çështjeve të shëndetit dhe rendit publik, një ndërhyrje kaq serioze ndaj lirisë së shprehjes së kërkuarit, siç ishte pikërisht kjo që konsistonte në ndalimin e vendosur nga Ministri i Brendshëm. Së fundi, Gjykata vlerësoi se ndalimi nuk përmbushte kriteret e nevojave të ngutshme shoqërore për justifikueshmërinë e tij dhe se nuk respektonte parimin e proporcionalitetit me qëllimin e ligjshëm që ndiqte.

11. Nën dritën e këtyre vlerësimeve dhe të analizës së legjislacionit të shqyrtuar, Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja e parashikuar nga neni 14 i Ligjit 1881, siç ishte amenduar më 1939, mund të mos konsiderohej si “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Për këtë arsye, ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës. Duke pasur parasysh këtë përfundim, Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme që çështja të shqyrtohej edhe nën këndvështrimin e nenit 10 të marrë së bashku me nenin 14.

### **B. Në lidhje me nenin 6 § 1**

12. Gjykata vuri në dukje se procedurat kishin vazhduar për më tepër se nëntë vjet përpara dy niveleve gjyqësore dhe se kërkuari nuk kishte pasur përgjegjësi për sjellje që ta kishin ngadalësuar këtë proces.

13. Gjykata ritheksoi përsëri në këtë çështje qëndrimin e saj, sipas të cilit, i përkiste shteteve palë që të organizonin sistemet e tyre ligjore në një mënyrë të tillë që gjykatat të mund t'i garantonin çdokujt dhe brenda një afati të arsyeshëm të drejtën për një vendim të karakterit përfundimtar në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta me karakter civil. Ajo vlerësoi se kohëzgjatja totale e procedurave, prej më tepër se nëntë vjetësh, nuk mund të vlerësohej “e arsyeshme”, edhe pse objekti i mosmarrëveshjes në shqyrtim e sipër përpara gjykatave kishte një rëndësi të veçantë. Për pasojë ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

### **C. Në lidhje me nenin 13**

14. Duke pasur parasysh sidomos konstatimin e mësipërm në lidhje me nenin 6 § 1, Gjykata nuk e vlerësoi të nevojshme ta konsideronte çështjen më vete edhe mbi bazën e nenit 13.

**D. Në lidhje me nenin 41**

15. Gjykata i akordoi shoqatës kërkuese 250 000 franga franceze (FF) për dëm material, 50 000 FF për dëm jo-material dhe 58 500 FF për shpenzime dhe pagesa ligjore.

**III. Koment**

16. Ka qenë një jurisprudencë e qëndrueshme e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që tregon se çdo përjashtim nga liria duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë<sup>199</sup> dhe se nevoja për çdo kufizim duhet vërtetuar në mënyrë bindëse<sup>200</sup>. Megjithëse kufizimet paraprake ndaj botimeve mund të mos jenë në vetvete të papajtueshme me nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ato shtrojnë nevojën e një mbikëqyrjeje shumë strikte. Në rastin në fjalë, Gjykata vlerësoi se kompetencat e Ministrisë të Brendshme për të nxjerrë vendime që ndalonin qarkullimin e botimeve me “origjinë të huaj” ishin tepër të gjera, të formuluar në mënyrë të përgjithshme dhe me garanci apo kontroll të pamjaftueshëm përsa i përket zbatimit të tyre. Në fakt, përveç të qenit shumë të gjera dhe pa garanci të mjaftueshme, e drejta franceze shkelte vetë formulimin e nenit 10 § 1 i cili sugjeron se autoritetet duhet të pranojnë gjithashtu informacione që vijnë përtej kufijve të vendit dhe të lejojnë përhapjen e informacionit edhe jashtë këtyre kufijve, duke qenë e mundur t’ia nënshtrojnë këtë, sidoqoftë, kufizimeve të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 10.

17. Siç ka ndodhur edhe në çështje që kanë pasur të bëjnë me situatat e sigurisë në Juglindje të Turqisë, Gjykata e Strasburgut do të mbajë parasysh gjithmonë karakterin e ndjeshëm të situatës si dhe faktin që autoritetet shtetërore duhet të jenë në gatishmëri ndaj akteve që mund të gjenerojnë dhunë<sup>201</sup>. Gjithsesi duhet që Gjykata të bindet që kishte në fakt në botim një vullnet për të çuar te dhuna dhe se masat e marra nga autoritetet ishin në përpjesëtim me qëllimin e shmangies së kësaj dhune. Gjykata Evropiane duhet të bindet në këtë kuadër për një “nevojë të ngutshme shoqërore” si dhe që autoritetet vendase janë siguruar në vetvete se, arsyet për ndërmarrjen e ndërhyrjes janë “të rëndësishme dhe të mjaftueshme” përpara se vetë ajo të arrijë në përfundimin se masa e marrë është “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Në këtë kuadër Gjykata kujtoi se në të shkuarën ajo ka theksuar se publiku ka nevojë për “një pikëpamje të ndryshme në lidhje me situatën..., pavarësisht se sa i pranueshëm mund të jetë ky kuadër për autoritetet shtetërore”<sup>202</sup>.

<sup>199</sup> Shih në lidhje me këtë një jurisprudencë të tillë të Gjykatës së Strasburgut “Të drejtat e njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komente”, fq. 44. Botim i Qendrës Evropiane, Tiranë 2001, fq. 44-45.

<sup>200</sup> Shih gjithashtu vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 26 nëntorit 1991 në lidhje me çështjen The Observer and Guardian kundër Mbretërisë së Bashkuar.

<sup>201</sup> Shih për shembull vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 8 korrikut 1999 në lidhje me çështjen Surek kundër Turqisë.

<sup>202</sup> Shih paragrafin 58 të vendimit të përmendur në poshtëshënimin paraardhës.

## SUNDAY TIMES kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa 6538/74)

26 prill 1979

*me një shumicë të ngushtë, Gjykata arrin në përfundimin se, ndalimi i botimit të artikujve që cenojnë ose paragjykojnë rolin e gjykatave shkel lirinë e shprehjes*

### I. Faktet kryesore

1. Nga viti 1959 deri në 1962, qindra fëmijë lindën me deformime të rënda në Mbretërinë e Bashkuar, për shkak se nënat gjatë shtatëzansisë kishin marrë talidomid me anë të qetësuesve. Më pas, shumë prindër denoncuan në gjykatë fabrikuesin dhe shitësin e talidomidit në Mbretërinë e Bashkuar, Distillers Company Ltd.

2. Më 24 shtator 1972, e përjavshmja britanike "The Sunday Times" publikoi një artikull të titulluar "Fëmijët tanë viktime të talidomidit: turp për vendin" dhe tregoi qëllimin e saj për të bërë një historik mbi tragjedinë, fabrikimin dhe provat e talidomisë nga 1958 dhe 1961.

3. Distillers-i u ankua pranë Prokurorit të Përgjithshëm me pretendimin se artikujt në fjalë përbënin ose do të përbënin një "cenim të Gjykatës"<sup>203</sup>, meqenëse çështja ishte në gjykim e sipër. Prokurori i Përgjithshëm vendosi t'i kërkojë Gjykatës së Lartë të ndalonte publikimin e një artikulli të ri. Në nëntor 1972 ai mori përgjigje pozitive prej saj. Pas apelimit të Times Newspapers Ltd, Gjykata e Apelit ndryshoi urdhëresën e Gjykatës së Lartë, por pas ankimit të Prokurorit të Përgjithshëm, më 18 korrik 1973 Dhoma e Lordëve rivendosi njëzëri ndalimin. Ajo arriti në përfundimin se botimi i artikullit të ri do të përbënte një cenim për Gjykatën, për faktin se ai do të shtynte publikun të paragjykonte rezultatin e procedurës gjyqësore që zhvillohej midis kërkuesve dhe Distillers-it, përfshirë këtu edhe negociatat për një zgjidhje me pajtim midis palëve. Urdhri u shfuqizua përfundimisht në 1976.

4. Në kërkesën e tyre të paraqitur Komisionit më 19 janar 1974, kërkuesit pretendonin se urdhri i dhënë nga Gjykata e Lartë dhe i ridhënë nga Dhoma e Lordëve, dhe parimet në të cilat ky i fundit bazohej, ishin në kundërshtim me nenin 10 të Konventës. Më vonë gjatë procedurave, ata pretenduan edhe se kishte pasur diskriminim sipas nenit 14, për faktin se publikime të ngjashme nuk ishin kufizuar dhe se rregullat e zbatuara për Parlamentin mbi komentet e tij në lidhje me procesin gjyqësor ishin të ndryshme nga ato të rregullave të zbatueshme mbi shtypin në lidhje me parimin e cenimit të gjykatës. Në raportin e tij të 18 majit 1977, Komisioni shprehu mendimin

<sup>203</sup> Shih paragrafin 14 tek Komenti i këtij vendimi.

se kufizimi i lirisë së shprehjes të kërkuesve shkelte nenin 10 të Konventës dhe se nuk kishte shkelje të nenit 14 të marrë së bashku me nenin 10.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 10

5. Kërkuesit pretendonin se neni 10 ishte shkelur, në radhë të parë për shkak të urdhrorit dhe së dyti, nga vazhdimi i kufizimeve që ata duhet t'u nënshtroheshin si rezultat i karakterit të përgjithshëm dhe të pasaktë të legjislacionit mbi cenimin e gjykatës. Pasi i ishte referuar jurisprudencës së saj, Gjykata pohoi se duhej të analizonte vetëm pretendimin e parë. Ajo duhej të verifikonte për këtë qëllim, nëse ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes ishte e “parashikuar nga ligji”, kishte një qëllim legjitim sipas nenit 10 § 2 dhe nëse ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

#### i. A ishte ndërhyrja e ligjshme?

6. Kërkuesit pretendonin se ndërhyrja nuk ishte e parashikuar nga ligji për shkak të pasaktësisë së legjislacionit mbi cenimin e gjykatës dhe të karakterit të ri të parimeve të shprehura nga Dhoma e Lordëve. Sipas opinionit të Gjykatës, qytetari duhet të kishte informimin e duhur mbi rregullat juridike të zbatueshme në një rast të dhënë dhe të ishte në gjendje të parashikonte në një stad të arsyeshëm për rrethanat, pasoja të tilla që mund të shmangnin një veprim të dhënë. Gjykata konkludoi nga faktet e çështjes, se njohja dhe qartësia e ligjit ishin objektivist të mjaftueshme dhe si rrjedhim ndërhyrja ishte “e parashikuar me ligj”.

#### ii. A ishte ndërhyrja legjitime?

7. Gjykata vendosi se si legjislacioni i cenimit të gjykatës, si urdhri kundër Times Newspaper Ltd kishin një qëllim legjitim në bazë të nenit 10 § 2, “garantimin e autoritetit të pushtetit gjyqësor”.

#### iii. A ishte ndërhyrja e nevojshme?

8. Mbi problemin nëse urdhri ishte “i nevojshëm” sipas kuptimit të Konventës, për qëllimin e sipërpërmendur, së pari Gjykata rikujtoi disa parime të jurisprudencës së saj. Neni 10 § 2 iu njihte shteteve palë që kishin përgjegjësinë fillestare për të siguruar të drejtat dhe liritë e Konventës, një “hapësirë vlerësimi” por kjo nuk është pa kufi. Është Gjykata ajo që ka kompetencë të vendosë përfundimisht nëse një kufizim përputhet me lirinë e shprehjes që mbrohet nga neni 10. Kur ajo përballlet me vendimet e gjykatave të brendshme, ajo nuk zë vendin e tyre, por rishikon përputhjen e vendimeve të tyre me nenin 10. Gjykata tregoi se kontrolli i saj nuk ishte i kufizuar në verifikimin e sjelljes së arsyeshme, të kujdesshme dhe në mirëbesim të një shteti. Nga ana tjetër meqenëse ajo duhet të verifikonte domosdoshmërinë e urdhrorit në përputhje me Konventën, rregullat e së drejtës angleze nuk mund t'i shërbenin si kritere të interpretimit të saj.

9. Pasi sqaroi këto parime themelore, Gjykata vlerësoi faktet e çështjes nën dritën



e tyre. Ajo u shpreh se publikimi i projektit të artikujve nuk do të kishte shtuar presionin që ushtrohej mbi Distillers-in për ta shtyrë atë që të arrinin në një zgjidhje me pajtim më bujare ndaj prindërve dhe se në rast se ajo do t'i informonte lexuesit për neglizhencën e pretenduar të Distillers-it, kjo gjë nuk do ta dëmtonte autoritetin e pushtetit gjyqësor. Ky publikim mund të kishte provokuar replika, por Gjykata mendoi se studimi i të gjitha rrethanave ishte i domosdoshëm, për të vlerësuar nëse motivi i ndalimit ishte i mjaftueshëm sipas nenit 10 § 2. Fakti që disa veprime që tregonin neglizhencën ishin në shqyrtim gjatë heqjes së ndalimit në vitin 1976, nxiti analizën e nevojës fillestare të ndalimit.

10. Vendimi vazhdon më tej, duke nënvizuar rëndësinë, në një shoqëri demokratike, të parimit të lirisë së shprehjes që zbatohet në fushën e administrimit të drejtësisë si dhe në fusha të tjera. Jo vetëm që masmedia ka për detyrë të komunikojë informacione dhe ide mbi problemet që shqyrtojnë gjykatat, por edhe se publiku ka të drejtë t'i marrë ato. Për të përcaktuar nëse një ndërhyrje në lirinë e shprehjes justifikohet sipas Konventës, duhen pasur parasysh rrethanat e çështjes dhe në veçanti, çdo aspekt që lidhet me interesin publik. Tragjedia e talidomidës dhe çështja për të ditur se e kujt ishte përgjegjësia lidhej pa dyshim me interesin publik. Çështja ishte në shqyrtim prej shumë vitesh, dhe nuk dihej nëse ankimet e prindërve do të shkonin përpara gjykatës dhe se nuk kishte pasur ndonjë hetim publik. Edhe pse Sunday Times-it nuk i ishte ndaluar të diskutonte probleme më të gjëra, si parime të përgjithshme të së drejtës angleze, Gjykata e vlerësoi si artificiale përpjekjen e dallimit midis këtyre problemeve dhe atij të neglizhencës së pretenduar nga Distillers-i. Faktet nuk reshtnin së qeni një çështje me interes për publikun, sepse ata sqaronin rrethanat e mosmarrëveshjes në vazhdim e sipër.

11. Me njëmbëdhjetë vota kundër nëntë, Gjykata arriti në përfundimin se urdhri nuk i përgjigjej një nevoje urgjente sociale të tillë që t'i paraprante interesit publik për lirinë e shprehjes. Si rrjedhim nuk kishte arsye të mjaftueshme bazuar në nenin 10 § 2, ndalimi nuk ishte proporcional me qëllimin legjitim të ndjekur, pra nuk ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të mbrojtur autoritetin e gjyqësorit. Pra ka pasur shkelje të nenit 10<sup>204</sup>.

### **B. Në lidhje me nenin 14**

12. Gjykata vendosi njëzëri se nuk ka pasur diskriminim në shkelje të nenit 14 të marrë së bashku me nenin 10. Mosmarrja e masave të ngjashme kundër gazetave të tjera nuk përbënte një provë të mjaftueshme diskriminimi kundër The Sunday Times dhe detyrat respektive, përgjegjësitë e shtypit dhe të Parlamentit ishin të ndryshme në thelb.

### **C. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)**

13. Kërkuesit kishin kërkuar si shpërblim të drejtë, rimbursimin e shpenzimeve të tyre për procedurat e ndjekura në Angli, përpara Komisionit dhe Gjykatës. Gjykata

<sup>204</sup> Në vijim të këtij vendimi qeveria Britanike ndërmoi një rishikim të Contempt of Court Act të vitit 1981.

e rezervoi këtë çështje dhe ftoi qeverinë dhe Komisionin ta shqyrtonin atë brenda një periudhe prej tre muajsh. Në fakt shumë muaj më vonë, më 6 nëntor 1980, Gjykata e Strasburgut e dha vendimin e vet në lidhje me ish nenin 50 të Konventës. Në këtë vendim, ku përsëri kishte mendime të pakicës qoftë në parim, qoftë në lidhje me përllogaritjen e shumës<sup>205</sup> Gjykata i akordoi Sunday Time 22 626.78 paund.

### III. Koment

14. Është një nga çështjet më të rëndësishme të Gjykatës në lidhje me nenin 10 të Konventës. Kjo qoftë për natyrën tepër të ndjeshme që përmbanin faktet e saj, qoftë për kompleksitetin e marrëdhënieve që krijohen ndërmjet medias dhe autoriteteve publike, ashtu edhe për arsye të përpunimit nga ana e Gjykatës të disa parimeve tepër të rëndësishme në interpretimin e Konventës. Çështja është e famshme ndërmjet studiuesve të së drejtës së Konventës sepse ngre në nivel evropian një nocion interesant të së drejtës angleze - *“The contempt of court”* - që në shqip mund të përkthehej cenimi ose paragjykimi i rolit të gjykatës.

15. Vendimi nxjerr në pah edhe një moment tjetër tepër interesant të rolit të Gjykatës dhe të gjithë sistemit të Konventës. Ky moment ka të bëjë me interpretimin nga Gjykata të parimit të subsidiaritetit. Duke qenë i lidhur me parimin e hapësirës së vlerësimit për të cilin flitet gjithashtu në këtë vendim dhe që u shpjegua në vendimin paraprirës *“Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar”*, parimi i subsidiaritetit nga njëra anë nënkupton që mekanizmi zbatues i krijuar nga ana e Konventës hyn në lojë vetëm atëherë kur shteti ka pasur të gjitha mundësitë për të shmangur shkeljen. Por nga ana tjetër ky parim ka një kuptim kohor dhe jo juridiksional. Kjo do të thotë që në gjykimet dhe interpretimet e veta Gjykata e Strasburgut nuk zëvendëson juridiksionet e brendshme nacionale të çfarëdo shkalle. Kjo është e vërtetë qoftë nga pikëpamja e së drejtës materiale, qoftë procedurale. Gjykata e Strasburgut nuk interpreton të drejtën e asnjë vendi anëtar. Ajo kufizohet në vlerësimin e pajtueshmërisë të veprimeve shtetërore - të bazuara apo jo në të drejtën e brendshme dhe në parimet e saj - me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe me parimet e kësaj të fundit.

16. Vendimi përkatës u arrit me një shumicë tepër të ngushtë - 11 kundër 9. Gjyqtarët që dolën në pakicë, ndër të cilët ish kryetarët Ryssdal dhe Wiarda, Fitzmaurice dhe Marscher nuk ranë dakord me këndvështrimin e shumicës sipas së cilës, hapësira e vlerësimit që iu njëhej shteteve në raste të cenimit të rolit të autoritetit gjyqësor ishte më e vogël, sesa në rastet e cenimit të moralit publik. Ky krahasim bëhej duke pasur parasysh vendimin e 7 dhjetorit 1976 të Gjykatës, pararendës në këtë botim, në lidhje me çështjen *“Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar”*. Në këtë çështje kujtojmë që Gjykata me një shumicë gati unanime (13 vota kundër 1) kishte vendosur të justifikonte masat britanike për bllokimin e botimit dhe sanksionimin përkatës duke i justifikuar si të nevojshme në një shoqëri demokratike. Sipas pakicës

<sup>205</sup> Në pakicë votuan gjyqtarët Sir Gerald Fitzmaurice, Liesch dhe Pinheiro Farinha.

ishte e arsyeshme që t'i njihej e drejta *House of Lords* për të vendosur se çfarë ishte e nevojshme për të ruajtur autoritetin dhe mosparagjyqeshmërinë e sistemit gjyqësor dhe të administrimit të drejtësisë në kushtet konkrete.

17. Duke përshkruar rrugën normale të teknikës së vet interpretuese në lidhje me kufizimet ndaj të drejtave të parashikuara në nenet 8-11 të Konventës, Gjykata ndalet në disa koncepte bazë të kësaj grile justifikuese. Në këtë kuadër është tepër i rëndësishëm qëndrimi që Gjykata përqafton në paragrafët 47-53 të vendimit në lidhje me konceptin e ligjit. Ajo pranon se në sistemin e common law, edhe jurisprudenca mund të përfshihet në këtë koncept për qëllimet e nenit 10 § 2, me kusht që ajo të jetë e qartë dhe e saktë në masën e duhur<sup>206</sup>.

## COUDERC DHE HACHETTE FILIPACCHI ASSOCIÉS kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 40454/07)

10 nëntor 2015

Dhomë e Madhe

*e drejta e princit Albert të Monakos për respektimin e jetës së tij private sipas  
nenit 8 nuk mund të justifikonte ndërhyrjen në lirinë e shprehjes së shtypit sipas  
nenit 10*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit janë Anne-Marie Couderc, një shtetase franceze e lindur në vitin 1950, e cila është drejtoreshë publikimi i Paris Match dhe kompania Hachette Filipacchi Associés, e cila boton revistën javore Paris Match.

2. Më 3 maj 2005, gazeta britanike Daily Mail botoi një artikull në të cilin, një qytetare e quajtur Znj. Coste pretendonte se babai i djalit të saj ishte Albert Grimaldi, princi në fron i Monakos. Më 5 maj 2005, Paris Match publikoi artikullin, i cili përbëhej nga një intervistë me znj. Coste ku rrëfehej fakti i mësipërm. Artikulli u shoqërua me fotografi që tregojnë Princin Albert me fëmijë në krahët e tij.

3. Më 19 maj 2005, Princi Albert nisi procedim kundër kërkuesve me pretendimin se artikulli kishte shkelur të drejtat e tij për të gëzuar një jetë të qetë private dhe për të mbrojtur imazhin, duke kërkuar dëmshpërblim nga kompania botuese dhe një urdhër që të publikojë vendimin e gjykatës në kopertinën e revistës.

<sup>206</sup> Në lidhje me qëndrimin e Gjykatës mbi vlerën e jurisprudencës në vendet e civil law shih përmbledhjen dhe komentimin e vendimit të Gjykatës të 24 prillit 1990 në lidhje me çështjet Kruslin kundër Francës dhe Huvig kundër Francës.

4. Më 29 qershor 2005, Gjykata e Lartë e Nanterres urdhëroi kompaninë Hachette Filipacchi Associés t'i paguajnë Princit Albert dëmshpërblim për dëm jomaterial në shumën 50 000 euro, si dhe urdhëroi që detajet e gjykimit të botoheshin në tërë ballinën e Paris Match-it, me titull "*Gjykata vendosi kundër Paris Match, me kërkesën e princit Albert II i Monakos*". Gjykata vendase vlerësoi se i tërë artikulli përfshihej brenda sferës më intime të dashurisë dhe jetës familjare të princit Albert dhe se nuk shqetësohej më për ndonjë debat me interes të përgjithshëm. Kërkuesit apeluan vendimin.

5. Në një njoftim për shtyp të datës 6 korrik 2005 princi Albert pranoi publikisht se ai ishte babai i fëmijës. Më 24 nëntor 2005, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin kundër kërkuesve dhe ndryshoi kushtet për publikimin e vendimit të gjykatës në kopertinën e revistës.

6. Duke u bazuar në nenin 10, kërkuesit u ankuan se gjykimi kundër tyre kishte derivuar ndërhyrje të pajustificuar në ushtrimin e së drejtës së tyre për t'u shprehur lirisht. Më 12 qershor 2014, Dhoma e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka gjetur se ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës. Më 13 tetor 2014, një panel i Dhomës së Madhe pranoi kërkesën e qeverisë për referimin e rastit.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 10

7. Gjykata theksoi se, nuk është kundërshtuar nga palët se vendimi objekt gjykimi përbente një ndërhyrje në ushtrimin e lirisë së shprehjes të kërkuesve, as nuk u është kontestuar se ndërhyrja ishte e parashikuar me ligj. Për më tepër, Gjykata vërejtë se është pranuar se kjo ndërhyrje ndiqte qëllimin legjitim të mbrojtjes të së drejtave të të tjerëve, brenda kuptimit të nenit 10 § 2 të Konventës. Megjithatë, në mënyrë që një ndërhyrje të jetë në përputhje me Konventën, ajo duhet të jetë "e nevojshme në një shoqëri demokratike".

8. Gjykata vërejtë se për të shqyrtuar nëse ndërhyrja në këtë rast ishte "e nevojshme", kërkohet që ajo të shqyrtojë nëse, gjykatat e brendshme vlerësuan ekuilibrin e duhur mes dy të drejtave konkurruese, pra të drejtës për respektimin e jetës private të princit dhe të lirisë së shprehjes së kërkuesve. Gjykata vuri në dukje se mbrojtja e ofruar nga koncepti i "jetës private" në nenin 8 të Konventës është menduar kryesisht për të siguruar zhvillimin, pa ndërhyrje nga jashtë, të personalitetit të çdo individit. Në lidhje me nenin 10, Gjykata përsëriti se mbrojtja e tij përfshin informacion dhe ide që fyejnë, trondisin ose shqetësojnë dhe se kur informacioni ka të bëjë me çështje me interes publik, shtypi ka për detyrë për të dhënë këtë informacion dhe publiku ka të drejtë për ta marrë atë. Gjykata vuri në dukje se mbrojtja e ofruar nga neni 10 mund të cedojë për shkak të kërkesave të nenit 8 të Konventës, kur informacioni është i natyrës private e intime dhe nuk ka interes publik për shpërndarjen e tij.

9. Më tej, Gjykata iu referua kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e saj të mëparshme për të shqyrtuar ekuilibrin e të drejtave konkurruese. Kriteret relevante

janë: kontributi në një debat me interes publik, fama të personit në fjalë, objekti i raportimit në media, sjellja paraprake e personit në fjalë, përmbajtja, forma dhe pasojat e publikimit, si edhe në rastet kur është e përshtatshme, rrethanat në të cilat janë marrë fotografitë. Gjykata ka deklaruar edhe më parë se, kur shqyrton një kërkesë të parashtruar sipas nenit 10 të Konventës, do të analizohet mënyra në të cilën është marrë informacioni, vërtetësia e tij dhe pesha e sanksionit të marrë ndaj gazetarëve apo botuesve.

10. Gjykata pranoi se nuk kishte asnjë dyshim se, botimi i marrë si një i tërë dhe në kontekst, duke u analizuar në dritën e precedentëve të jurisprudencës së saj të mëparshme, përbënte një çështje të interesit publik. Në kohën e zhvillimit të ngjarjeve lindja e këtij fëmije nuk ishte pa pasoja të mundshme dinastike dhe financiare e për rrjedhojë, informacioni i kundërshtuar ishte me rëndësi politike, pasi ai mund të ngjallte interesin e publikut në lidhje me rregullat e trashëgimisë në fuqi të Principatës.

11. Gjykata theksoi se duke pasur parasysh se princi ishte një figurë publike, garantimi i së drejtës së tij sipas nenit 8, do të mund të ndikohet. Fakti i ushtrimit të një funksioni publik domosdoshmërisht ekspozon një individ ndaj kontrollit të publikut, duke përfshirë edhe median. Gjykata vërejtë se publikimi i kontestuar kishte të bënte me jetën private të princit. Megjithatë, elementi thelbësor i përmbajtjes së informacionit të publikuar - ekzistenca e fëmijës - shkonte përtej sferës private, duke pasur parasysh natyrën e trashëgueshme të funksioneve të princit, si kryetarit i shtetit. Për më tepër, vërtetësia e deklaratave të znj. Coste në lidhje me atësinë e fëmijës së saj nuk u kundërshtua as nga vetë princi, i cili e pranoi publikisht atë menjëherë pas botimit të artikullit të parë. Së fundi, Gjykata u shpreh se fotografitë ishin dorëzuar për Paris Match nga znj. Coste vullnetarisht dhe pa pagesë, ato nuk janë marrë pa lejen e princit dhe nuk paraqesin asnjë pamje të pafavorshme të tij.

12. Në dritën e këtyre konsideratave, Gjykata vlerësoi se argumentet e parashtruara nga qeveria në lidhje me mbrojtjen e jetës private të princit Albert dhe të drejtës së tij për ruajtjen e imazhit, nuk mund të konsiderohen si të mjaftueshme për të justifikuar ndërhyrjen në fjalë. Gjykatat e brendshme nuk i kishin dhënë vëmendjen e duhur parimeve dhe kritereve për ekuilibrimin e duhur mes të drejtës për respektimin e jetës private dhe lirisë së shprehjes. Në këtë drejtim, Gjykata vërejtë se gjykatat e brendshme kishin dështuar në vlerësimin e intervistës në mënyrë të tillë, që të përcaktonin peshën e duhur të aspekteve të jetës private të princit dhe çfarë mund të cilësohej në mënyrë legjitime çështje me interes publik. Gjykatat e brendshme kanë mohuar se ka pasur ndonjë "vlerë diskutimi" lajmi për ekzistencën e djalit të princit dhe kështu arritën në përfundimin se artikulli nuk ishte pjesë e "një debati mbi një çështje të interesit publik e cila do të justifikohet duke u raportuar mbi bazën e transmetimit të ligjshëm të informacionit për publikun". Pra, Gjykata arriti në përfundimin se gjykatat e brendshme dështuan të arrijnë një ekuilibër të arsyeshëm proporcional midis masave që kufizojnë të drejtën e kërkuarit për t'u shprehur lirisht dhe qëllimit legjitim të ndjekur.

13. Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur një shkelje të nenit 10 të Konventës.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

14. Gjykata rrëzoi pretendimet e kërkuësve për dëmshpërblim për shkak se ata nuk mund të pretendonin një vlerë konkrete dëmi. Megjithatë, Gjykata i akordoi kërkuësve së bashku shumën prej 15 000 euro për shpenzimet gjyqësore.

### **III. Koment**

15. Revista javore franceze, Paris-Match, botoi një artikull në lidhje me vrasjen e Prefektit Klaud Erignac në Ajacio, Korsikë, më 6 shkurt 1998. Artikulli ishte ilustruar me një fotografi të skenës së krimit, moment i marrë pas vrasjes, e cila tregonte trupin e prefektit të shtrirë në tokë.

16. Në gjykimin civil të brendshëm, gjykatat franceze urdhëruan Paris-March të botojë një deklaratë se fotografia është publikuar pa lejen e familjes Claude Erignac dhe se ajo e konsideroi botimin e saj si një ndërhyrje në privatsinë e jetës së tyre private.

17. Shoqëria botuese kërkuese u ankua para Gjykatës se, detyrimi për të publikuar deklaratën shkelte të drejtën e tij për tu shprehur lirisht. Gjykata u shpreh se rasti në fjalë përbënte ndërhyrje në lirinë e shprehjes së kërkuësit. Ajo vazhdoi të vlerësojë nëse ndërhyrja ishte e justifikuar:

- Së pari, ajo u shpreh se detyrimi i caktuar në bazë të jurisprudencës, përmbushte kushtet e aksesit dhe parashikueshmërisë së nevojshme për të përcaktuar se kjo formë e ndërhyrjes është "e parashikuar me ligj".
- Së dyti, ajo u shpreh se ndërhyrja kishte ndjekur një nga qëllimet legjitime të përcaktuara në nenin 10 § 2, dmth "mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve".
- Për rrjedhojë, çështja e tretë dhe kritike ishte nëse masa ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike".

18. Në vlerësimin e çështjes së tretë Gjykata konsideroi një sërë faktorësh, duke përfshirë:

- 'Detyrat dhe përgjegjësitë' që rrjedhin natyrshëm nga ushtrimi i lirisë së shprehjes dhe efektit potencialisht parandalues të dënimit të dhënë, mbi mënyrën që revista ushtron lirinë e saj të shprehjes.
- Shqetësimin e ndjerë nga familja e viktimës, kundërshtimin e tyre të shprehur në publikimin dhe rrethanave të dhunshme dhe traumatike të vdekjes.
- Formulimi i deklaratës se gjykatat franceze i kërkuan Paris-Match të publikojë dhe respektimi i gjykatave vendase mbi lirinë e editorialit të revistës.

19. Duke marrë parasysh këta faktorë, Gjykata konstatoi se gjykatat e brendshme i kishin caktuar dënimin më të lehtë të parashikuar sipas Kodit Civil Francez të drejtave të shoqërisë kërkuese. Prandaj, Gjykata u shpreh se ndërhyrja e gjykatave të brendshme mbi lirinë e shprehjes së kërkuësit ishte e justifikuar dhe se për rrjedhojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 10.



## LINGENS kundër AUSTRISË

(kërkesa nr. 9815/82)

8 korrik 1986

*gjakimet vlerësuese dhe të bëra në mirëbesim nuk kanë përse të provohen si faktet, përfitojnë mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe iu nënshtrohen kufizimeve më strikte sesa referimi i fakteve vërtetësia e të cilave duhet provuar*

### I. Faktet kryesore

1. Më 14 dhe 21 tetor 1975, z. Peter Michael Lingens botoi në gazetën vjeneze "Profil" dy artikuj të cilët përmbanin disa kritika të rrepta kundër z. Bruno Kreisky, në atë kohë kancelar federal. Në artikullin në fjalë, kancelari kritikohej për sjelljen e tij kundrejt një lideri politik, i cili gjatë luftës së dytë botërore kishte bërë pjesë në një brigadë SS, gjithashtu edhe për sulmet e tij kundër z. Simon Wiesenthal, i cili e kishte denoncuar publikisht të interesuarin. Z. Kreisky bëri një kallëzim ndaj kërkuesit për shpifje me anë të shtypit. Më 26 mars 1979, gjykata rajonale e Vjenës e deklaroi fajtor kërkuesin dhe e gjobiti me 20 000 shilinga austriake.

2. Pas apelimit nga të dy të interesuarit, Gjykata e Apelit të Vjenës anuloi vendimin dhe e dërgoi përsëri çështjen përpara gjykatës rajonale, e cila më 1 prill 1981, ripohoi vendimin e saj të parë. E vënë përsëri në lëvizje nga z. Kreisky dhe z. Lingens, më 29 tetor 1981 Gjykata e Apelit e uli gjobën në 15 000 shilinga austriake.

3. Më 19 prill 1982, z. Lingens paraqiti kërkesën e tij përpara Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut. Ai pretendonte për një shkelje të lirisë të tij të shprehjes, e cila garantohet nga neni 10 i Konventës. Në raportin e tij të 11 tetorit 1984, Komisioni njëzëri shprehu opinionin, sipas të cilit kishte patur shkelje të nenit 10.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 10

*i. A kishte ndërhyrje dhe a ishte ajo e ligjshme dhe legjitime?*

4. Gjykata konstatoi se, për shkak të dënimit për shpifje të deklaruar nga gjykata rajonale e Vjenës dhe e konfirmuar nga gjykata e apelit, ka patur "ndërhyrje nga autoritetet publike" në ushtrimin e lirisë së shprehjes. Ndërhyrja që e parashikuar me ligj - konkretisht nga neni 111 i Kodit Penal. Nga ana tjetër ajo kishte një qëllim të ligjshëm në përputhje me nenin 10 § 2 të Konventës që ishte mbrojtja e reputacionit dhe e të drejtave të tjetrit. Qeverisë, e cila bazohej mbi një konflikt ndërmjet nenit 10 dhe nenit 8, Gjykata iu përgjigj se kritikata e z. Lingens lidheshin me deklaratat publike të z. Kreisky dhe sjelljen e tij si person politik. Si rrjedhim, nuk kishte vend për një lexim të nenit 10 nën dritën e nenit 8.

*ii. A ishte ndërhyrja e nevojshme?*

5. Në lidhje me proporcionalitetin e dënimit, Gjykata rikujtoi karakterin thelbësor të lirisë së të shprehurit në një shoqëri demokratike, e cila vlen edhe për “informacionet” dhe “idetë” që godasin, shokojnë apo shqetësojnë. Ajo nënvizoi rëndësinë e veçantë të këtyre parimeve për shtypin. I përket atij që të komunikojë informacionet dhe idetë mbi çështjet politike si dhe çështje të tjera të interesit të përgjithshëm. Publiku ka të drejtë t’i marrë ato dhe liria e shtypit paraqet një mjet të mirë për të njohur dhe gjykuar sjelljet e liderëve politikë. Limitet e kritikave të pranueshme janë më të gjera për një person politik, sesa për një individ të thjeshtë. Megjithëse i pari përfiton nga mbrojtja e paragrafit 2 të nenit 10, kërkesat e mbrojtjes së reputacionit të tij duhet të vihen në ekuilibër me interesat e diskutimit të lirë të çështjeve politike.

6. Artikujt në fjalë, trajtonin disa çështje politike me interes publik për Austrinë, përmbajtja dhe toni i tyre ishin mjaft të ekuilibruar, por termat e kritikuar ishin të asaj natyre sa që dëmtonin reputacionin ez. Kreisky. Këtu bëhej fjalë për një person politik, por s’duhet harruar konteksti në të cilin ata ndodheshin - ishte një konflikt politik pas zgjedhjes. Në sytë e Gjykatës, dënimi i z. Lingens përbënte një lloj censure, e cila e shtynte atë të mos formulonte kritika të tilla në të ardhmen në fushën politike, dhe e pengonte detyrën e informimit dhe të kontrollit nga ana e shtypit.

7. Gjykata analizoi më pas vendimet gjyqësore të kundërshtuara. Pjesët e artikullit për të cilat gazetari akuzohej, përbënin disa gjykime vlerësuese të tij. Në këto kushte akuzat cenonin lirinë e opinionit të gazetarit dhe të drejtën për të komunikuar idetë e tij. Juridiksionet austriake kishin kërkuar nëse fjalët e kërkuarit kishin baza të vërteta sipas nenit 111 § 3 të Kodit Penal. Por Gjykata u shpreh se duhej bërë një dallim ndërmjet fakteve dhe gjykimeve vlerësuese. Ekzistenca e të parave mund të vërtetohet, por prova dhe vërtetësia e të dytave është e pamundur. Për më tepër saktësimi i fakteve që përbënin bazën e gjykimeve vlerësuese të z. Lingens dhe mirëbesimi i këtij të fundit nuk u kundërshtuan. Në këto kushte ndërhyrja nuk ishte e nevojshme për mbrojtjen e reputacionit të tjetrit dhe kështu ajo kishte shkelur nenin 10.

***B. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)***

8. Në bazë të nenit 50, Gjykata i njohu të drejtën z. Lingens që t’i rimbursojë gjoba prej 15000 shilingash austriake dhe shpenzimet që kishte bërë përpara juridiksioneve austriake. Përsa i përket shpenzimeve të bëra për publikimin e vendimit në revistën Profil, ajo nuk përjashtoi faktin se kërkuari kishte pësuar një humbje mundësish, si edhe shpenzime për ribotimin. Ajo konsideroi si të pranueshme shumën e kërkuar për shpenzimet dhe pagesat përpara gjykatave të brendshme. Përsa i përket atyre të bëra përpara organeve të Konventës, Gjykata nuk e vlerësoi veten të lidhur nga tarifa apo kritere shtetërore, por pranoi rezervat e arsyeshme të bëra nga qeveria. Së fundi, ajo pranoi t’i akordojë rimbursimin e pagesave të udhëtimit dhe të qëndrimit të të interesuarit në Strasburg, gjatë gjyqit. Në total kërkuarit iu akorduan 284 538,60 shilinga austriake.

### III. Koment

9. Duke arritur njëzëri në mbajtjen e një qëndrimi, që është guida themelore për gazetarët në përplasjet e tyre me politikanët, Gjykata në këtë vendim mbajti qëndrimin se dënimi penal i një gazetari, z. Lingens, për kritika ndaj kancelarit federal në rastin në fjalë përbën shkelje të lirisë së tij të shprehjes siç mbrohet nga neni 10 i Konventës. Thelbi i këtij qëndrimi konsiston në momentin se masa e marrë ishte joproporcionale dhe si e tillë e panevojshme në një shoqëri demokratike.

10. Pranohet se ky vendim përbën guidën themelore për interpretimin e nenit 10 në përplasjet gazetar – politikan, për faktin se bën një pohim tepër të rëndësishëm: autoritetet shtetërore nuk mund t'u kërkojnë gazetarëve që të provojnë vërtetësinë e deklaratave të tyre ndaj figurave politike, të cilat janë gjykime vlerësuese dhe janë bërë në mirëbesim. Ky moment përbën në fakt mbrojtjen më të madhe që mund t'i ofrojë Konventa personave që përfitojnë nga liria e shprehjes së tyre.

11. Ky parim i zbatuar nga Gjykata në një sërë vendimesh vijuese<sup>207</sup>. Është interesante se Gjykata në vendimin e dhënë në lidhje me çështjen “Oberschlick kundër Austrisë” (nr. 2), arriti deri aty sa ta konsideronte dënimin e z. Oberschlick në shkelje të Konventës, kur ky e kishte quajtur Jorg Haider – idiot. Në këtë rast Gjykata mbajti parasysh gjithsesi edhe natyrën e shprehjeve të z. Haider të cilat provokuan një reagim të tillë të z. Oberschlick dhe duke zbatuar parimin e proporcionalitetit, arriti në përfundimin se “të quash një politikan [idiot] në publik mund ta fyesh atë. Por megjithatë, në këtë çështje kjo fjalë nuk duket të jetë joproporcionale me indinjatën e qartë që krijoi z. Haider”<sup>208</sup>.

## JUPPALA kundër FINLANDËS

(kërkesa nr. 18620/03)

2 dhjetor 2008

*procedura pwr shpifje në vijim të një kërkesë për abuzim me fëmijën*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkesësja, Eine Juppala, është një shtetase finlandeze lindur në 1929 dhe jeton në Finlandë. Në 20 korrik 2000 kërkesësja çoi nipin 3 vjeç tek mjeku, për shkak të një dëmtimi në kurriz. Ajo ngriti shqetësimin se plaga ishte shkaktuar nga babai i fëmijës T. Ajo gjithashtu informoi doktorin se djali kishte thënë se ai ishte qëlluar me grusht.

<sup>207</sup> Shih vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen Oberschlick kundër Austrisë (nr. 1) ku Gjykata vlerësoi shkelje vetëm sepse gjykatat austriake i kishin kërkuar Z. Oberschlick të provonte vërtetësinë e thënies së tij që në fakt ishin gjykime vlerësuese.

<sup>208</sup> Paragrafi 34 i vendimit.

Mjeku shkroi në raportin e tij se dëmtimi ishte shkaktuar me një grusht dhe se pas intervistës, djali përsëriti se ishte qëlluar nga i ati. Më vonë atë ditë, mjeku lajmëroi shërbimin e mbrojtjes së fëmijës. Më 26 prill 2001 kërkuesja u akuzua për shpifje pasi ajo i kishte dhënë informacion mjekut, i cili kishte konkluduar se T. kishte rrahur të birin dhe se ajo nuk kishte dhënë asnjë arsye për të mbështetur këtë pretendim. T. iu bashkua procedurave në maj 2001 duke kërkuar kompensim për dëmin moral.

2. Pas një seance më 24 gusht 2001 gjykata e rrethit hodhi poshtë këtë akuzë: ajo konstatoi se nuk ishte e qartë nëse kërkuesja kishte nënkuptuar që djali ishte rrahur nga i ati, apo nëse raporti i mjekut përmbante përshtypjen e tij bazuar mbi diskutimin me kërkuesen dhe nipin e saj. Megjithatë ky vendim u hodh poshtë në apel dhe kërkuesja u shpall fajtores për shpifje. Ajo u urdhërua të paguante 3 365.67 euro kompensim për dëmin moral dhe shpenzimet ligjore. Gjykata e Apelit konstatoi në veçanti se fakti që kërkuesja kishte diskutuar dëmtimin me djalin, i cili ishte vetëm 3 vjeç, dhe se ai kishte thënë se babai i tij e kishte rrahur nuk përbënin arsye të mjaftueshme për pretendimin e abuzimit. As kërkuesja nuk kishte dhënë arsye të tjera për pretendimin e saj. Gjykata e lartë refuzoi apelin më 17 dhjetor 2002.

3. Mbështetur në nenin 10, kërkuesja u ankua për dënimin e saj për shpifje dhe pse ajo kishte dhënë vetëm ndershmërisht përshtypjen e saj për shkaqet e dëmtimit të nipit të saj.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 10

4. Palët ranë dakord se dënimi i kërkueses përbënte një ndërhyrje në lirinë e shprehjes dhe se ndiqte një qëllim legjitim, mbrojtjen e reputacionit ose të drejtat e të tjerëve. Gjykata pranoi se dënimi i kërkueses ishte parashikuar nga ligji. Ajo vërejti se çështja thelbësore ishte ekuilibri ndërmjet faktit kur një prind ishte potencialisht gabimisht i dyshuar për abuzim të fëmijës dhe duke parë vështirësitë, mbrojtja e fëmijëve në rrezik ndaj një abuzimi. Në veçanti, gjykata e pa si alarmues faktin që gjykata e apelit kishte marrë vendimin se, edhe pse nuk kishte asnjë dyshim që kërkuesja kishte parë shpinën e vrrarë të nipit, ajo nuk kishte pasur të drejtë të përsëriste se çfarë i nipi i kishte thënë, pra që ai ishte rrahur nga i ati, një pretendim që ai e kishte përsëritur gjatë intervistës me mjekun. Për më tepër, ngritja e shqetësimit për abuzimin me fëmijën, bërë me mirëbesim, në kontekstin e një procedure raportimi të përshtatshme duhet ti mundësohet çdo individ, i cili nuk duhet të ketë frikë nga një dënim penal ose detyrim për të paguar kompensim për ndonjë dëm ose shpenzime ligjore. Gjykata konkludoi se arsyet e mjaftueshme nuk ishin sjellë dhe se ndërhyrja kishte dështuar për t'iu përgjigjur ndonjë nevoje sociale urgjente. Si pasojë neni 10 ishte shkelur.

### B. Në lidhje me nenin 41

5. Gjykata i akordoi znj. Juppala 3 000 euro për dëmin moral dhe 3 616.41 euro për dëmin material si dhe 2 695.83 euro për shpenzimet e procesit.

### III. Koment

6. Ky është një rast jo i zakonshëm. Gjykata është thirrur për të shqyrtuar ankesa të bëra nga prindër mbi prezumime të gabuara të autoriteteve publike, përfshirë gjykatat, për abuzim me fëmijët. Shpesh ky është rezultati i prezumimeve të pajustificuara të bëra nga autoritete publike. Disa herë është rezultati i ankesave të bëra nga prindi tjetër, i divorcuar, mbështetur nga administrata, pa prova. Është e rrallë që personi që ngre pretendimet, me të drejtë apo pa të drejtë, si në këtë rast, i nënshtrohet një dënimi. Gjyqtarët e çështjeve familjare janë në dijeni se prindërit që janë kundra njëri-tjetrit bëjnë shpesh akuzime të pabazuara. Fëmija bëhet si top futbollit në ndeshjen mes dy prindërve.

7. Ky rast është ndryshe. Personi që akuzonte babanë ishte gjyshja e fëmijës dhe jo mamaja. Gjyshërit mund të kenë dhe më shumë paragjykime ndaj prindit tjetër. Ata mund dhe të tregohen indiferentë, gjë që është në të mirë të fëmijës. Vendimi nuk jep asnjë detaj mbi marrëdhënien midis prindërve ose gjyshes dhe babait, pra gjithë rrethanat e rëndësishme të rastit mungojnë në këtë vendim. Mungojnë gjithashtu referencat në jurisprudencën e gjykatës ku pretendimet e bëra ndaj prindërve kanë qenë të pabazuara dhe ku gjykata ka konstatuar shkeljen e nenit 8. Gjykata kishte para saj fakte materiale të mjaftueshme për të miratuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata ishte e prerë në konstatimin se ata persona që njoftojnë autoritetet për dyshime lidhur me abuzimin e fëmijës nuk duhet ti nënshtrohen pasojave të frikshme që mund të sjellin sanksionet. Ajo njohu gjithsesi se në rrethana të veçanta, ndaj të drejtës së shprehjes në këtë fushë mund të ngrihen kufizime të justifikueshme.

## GSELL kundër ZVICRËS

(kërkesa nr. 12675/05)

8 tetor 2009

*vendimi për të refuzuar aksesin e gazetarit në forumin e Davosit pa asnjë bazë ligjore*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Mario Gsell, është një shtetas zviceran i lindur në vitin 1958 dhe që jeton në Zvicër. Ai është një gazetar i *Gastro-News*, një revistë e specializuar për ushqimin e mirë. Në kohën kur do të zhvillohej Forumi Ekonomik Botëror (WEF) në Davos në vitin 2001, atij iu kërkua që të shkruante një shkrim për impaktin e demonstratave mbi restorantet dhe hotelet e zonës.

2. Më 27 janar 2001, kur zoti Gsell ndodhej rrugës për të shkuar në Forumin Ekonomik Botëror, dhe në mënyrë më specifike në aktivitetin *Syri Publik mbi Davosin*,

që organizohej nga organizatat anti-globaliste, policia i bëri një kontroll identitetit të gjithë pasagjerëve në autobusin ku po udhëtonte ai. Megjithëse tregoi kartën e tij si gazetar, zotit Gsell iu ndalua hyrja në Davos nga policia, e cila kishte marrë masa të shumta sigurie në prag të zhvillimit të një demonstrate të paautorizuar dhe të trazirave të mundshme.

3. Në shkurt 2001, kërkuesi depozitoi një ankesë, e cila u shpall e papranueshme nga qeveria e Kantonit Graubünden në prill 2002, mbi bazat se ishte depozituar jashtë afateve të paracaktuara kohore. Megjithatë, në lidhje me themelin e çështjes, qeveria kantonale vendosi që aplikimi i të ashtuquajturës klauzolë e përgjithshme e policisë në Kushtetutën Federale, e cila mund të përdorej nga autoritetet në menaxhimin e “situatave të emergjencës” në mungesë të mjeteve të tjera ligjore për të shmangur një “rrezik të qartë e të pranishëm”, nuk kishte qenë i tepruar, duke parë se bëhej fjalë për sigurinë publike dhe se kishte qenë e pamundur të bëhej dallimi midis individëve potencialisht të rrezikshëm dhe pjesëtarëve të tjerë të publikut.

4. Më 7 korrik 2004, Gjykata Federale hodhi poshtë dy apeli me civile të kërkuesit. Për sa i përket nenit 6 të Konventës, mbi të cilin u mbështet z. Gsell, kjo gjykatë vendosi që as ushtrimi i profesionit të tij dhe as reputacioni i tij profesional nuk ishin prekur në mënyrë të pakthyeshme si rezultat i ndalimit të pjesëmarrjes në WEF. Në lidhje me nenin 10, gjykata arriti në përfundimin se qeveria e Kantonit Graubünden kishte pasur të drejtë për t’u justifikuar me klauzolën e përgjithshme të policisë, meqenëse aktivitetet e kaluara anti-globaliste kishin dhënë arsye për ta konsideruar mbajtjen e *Syri Publik mbi Davosin* si një situatë emergjente, e cila përfaqësonte një kërcënim real dhe që nuk ishte qartësisht i identifikueshëm apo i parashikueshëm.

5. Mbështetur mbi nenin 10, z. Gsell u ankua se i qe ndaluar hyrja në Davos. Mbi bazën e nenit 6 § 1, ai u ankua, në radhë të parë, se çështja e tij nuk ishte shqyrtuar nga një “gjykatë” sipas kuptimit të nenit 6 § 1 dhe, në radhë të dytë, se procedimet përpara autoriteteve zvicerane kishin qenë tepër të gjata. Kërkesa u depozitua pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 5 prill 2005.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 10

6. Masa e marrë, që ishte në diskutim në këtë çështje, kishte arritur deri aty sa të ndërhynte në të drejtën e z. Gsell për liri të shprehjes, meqenëse ai kishte qenë duke udhëtuar për në Davos me synimin për të shkruar një shkrim.

7. Autoritetet kishin përdorur klauzolën e përgjithshme të policisë sipas Kushtetutës Federale, sepse nuk kishte asnjë bazë ligjore të shkruar për të penguar z. Gsell.

8. Megjithatë, sipas jurisprudencës së Gjykatës Federale, klauzola e përgjithshme e policisë nuk mund të përdorej nga autoritetet në situata të parashikueshme dhe të përsëritura, por vetëm në “situata emergjente”, në mënyrë që të parandalohet



një “rrezik i qartë dhe i pranishëm”. Në çështjen në fjalë, ndërsa Gjykata pranoi vështirësinë e autoriteteve për të bërë një vlerësim të saktë të rreziqeve reale në WEF, ajo nuk mori në konsideratë se përshkallëzimi i demonstratave kishte qenë i paparashikueshëm, duke parë përvojën e kaluar dhe gjetjet e raportit *Arbenz* mbi sigurinë në forum. Rrethanat e WEF 2001 kishin qenë pra, të parashikueshme dhe periodike. Për më tepër, sërish sipas jurisprudencës së Gjykatës Federale, masat për të kufizuar lirinë e mbledhjes duheshin marrë vetëm për ata persona që po krijonin shqetësim, gjë që nuk vlente për z. Gsell.

9. Për rrjedhojë, autoritetet nuk kishin pasur të drejtë që të përdornin klauzolën e përgjithshme të policisë për t'i ndaluar kërkuesit hyrjen në Davos. Ndërhyrja nga ana e autoriteteve në lirinë e tij të shprehjes nuk ishte e lejuar nga ligji, prandaj përbënte një shkelje të nenit 10.

### ***B. Në lidhje me nenin 6 § 1***

10. Sa për ankimin e kërkuesit në lidhje me të drejtën për akses në gjykatë, Gjykata nënvizoi arsyet tepër të detajuara që u dhanë veçanërisht nga Gjykata Federale në vendimin e saj të 7 korrikut 2004, pas disa procedimeve negative në të cilat ishte cenuar parimi i trajtimit të barabartë procedural të palëve. Duke vënë re, më tej, se faktet nuk kishin qenë subjekt i një konflikti të vërtetë midis palëve, ajo nuk arriti në përfundimin se kompetencat e kufizuara të Gjykatës Federale për të vlerësuar faktet që kishin lidhje me apelimin civil kishin shkelur të drejtën e zotit Gsell për të pasur akses në gjykatë. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se ankimi ishte dukshëm i pabazuar dhe se duhej hedhur poshtë.

11. Pjesa e kërkesës së z. Gsell, që kishte lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve, nuk arriti të përmbushte kërkesën për shterim të mjeteve të brendshme ankimore, meqë kërkuesi nuk ishte ankuar për këtë në kërkesat e tij të ndryshme ndaj autoriteteve. Për këtë arsye, ky ankim u hodh poshtë si dukshëm i pabazuar. Gjykata vuri re më tej, se duke parë rrethanat e çështjes, kohëzgjatja e përgjithshme e procedimeve – rreth tre vite e gjysmë për katër nivele juridiksioni – nuk kishte qenë e tepërt, për ato që parashikon neni 6 § 1.

### ***C. Në lidhje me nenin 41***

12. Gjykata i caktoi kërkuesit 1 026 euro për dëmin pasuror dhe 7 000 euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

## **III. Koment**

13. Kërkuesi në këtë çështje ishte i mendimit, se kishte pasur një shkelje të nenit 10, lirisë së shprehjes, meqë ai ishte një gazetar që synonte të shkruante mbi impaktin e pësuar prej restoranteve vendore nga demonstratat që do të shoqëronin zhvillimin e samitit ekonomik. Megjithatë, arsyetimi i gjykatës në lidhje me justifikimin dhe proporcionalitetin e masave të marra ka po aq lidhje edhe me nenin 11, sa liria e mbledhjes dhe organizimit.

14. Kohët e fundit, veprimet e policisë gjatë takimeve politike që janë shoqëruar nga demonstrata masive janë kritikuar shumë ashpër nëpër media. Rasti më i fundit ndodhi në Kopenhagë gjatë Samitit të Kombeve të Bashkuara për Klimën, ku rreth 1 000 protestues u ndaluan, por që shumica e tyre u lëshuan më vonë pa asnjë ndëshkim. Parlamenti danez kishte miratuar pak përpara zhvillimit të samitit ligje të reja, të cilat i jepnin të drejtë policisë që të bënte “arrestime parandaluese” – shumë prej aktivistëve të përfshirë në demonstrata pretenduan se në fakt, policia ishte duke abuzuar me kompetencat e saj dhe se arrestimet ishin bërë pa asnjë arsye.

15. Gjatë demonstratave që shoqëruan takimin e G20 në Londër në prill 2009, një burrë vdiq pas përballjes me policinë, kurse protestuesit e plagosur gjatë demonstratave për ditën e 1 Majit në Londër në vitin 2001 janë në proces e sipër të kundërshtimit të sjelljes së policisë përpara Gjykatës së Strasburgut.

16. Në çështjen në fjalë, Gjykata e bëri të qartë se autoritetet nuk mund të përdornin procedurat e emergjencës në situata ku shqetësimet e mundshme ishin të parashikueshme, gjë që ndodhi në çështjen e kërkesit. Ajo nënvizoi rëndësinë, që ka një polici me rregullore dhe rregulla të qarta e të sakta kur bëhet fjalë për menaxhimin e situatave me demonstrata masive dhe që këto rregullore të jenë në përputhje me kërkesat e neneve 10 e 11 për “cilësinë e ligjit” – të jetë i parashikueshëm dhe lehtësisht i përdorshëm, në mënyrë që të mos shkelë Konventën Evropiane.

## COLOMBANI DHE TË TJERË kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 51279/99)

25 qershor 2002

*kjo çështje ka të bëjë me një kufizim të pajustificuar të lirisë së shtypit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkesit janë dy shtetas francezë që jetojnë në Paris, Jean Marie Colombani dhe Eric Incyan, si dhe shoqëria Le Monde.

2. Në nëntor 1995 gazeta Le Monde, në të cilën Z. Colombani është drejtor i botimit, botoi një artikull nga Z. Incyan që kishte të bënte me një version konfidencial të një raporti nga Vëzhguesi Gjeopolitik i Drogave (OGD) mbi prodhimin dhe trafikimin e drogave në Marok. Raporti ishte hartuar me kërkesën e Komisionit të Komunitetit Evropian në vijim të aplikimit të Marokut për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe një version i tij u botua më 1994 por emrat e trafikantëve ishin mbajtur sekret. Ndërmjet të tjerash raporti shpallte se volumi dhe shtrirja e prodhimit të kanabisit “e bënin Marokun një mbajtës të denjë të titullit të eksportuesit kryesor botëror të hashashit”.

3. Një përmbledhje e artikullit të z. Incyan doli në faqen e parë të gazetës nën titullin “Maroku: eksportuesi i parë botëror i hashashit” dhe pjesa kryesore e artikullit nëntitullohej “një raport konfidencial hedh dyshime mbi oborrit e Mbretit Hasan II”. Ai hidhte pikëpyetje mbi angazhimin e deklaruar të autoriteteve marokene, dhe në veçanti të mbretit, për të luftuar përhapjen e trafikimit të drogës në territorin Maroken.

4. Më 23 nëntor 1995 Mbreti i Marokut paraqiti një kërkesë zyrtare pranë Ministrisë franceze të Punëve të Jashtme që ndaj gazetës *Le Monde* të fillonte ndjekja penale. Z. Colombani dhe z. Incyan u akuzuan në bazë të nenit 36 të Ligjit të 29 korrikut 1881, për fyerje ndaj kryetarit të një shteti të huaj. Sidoqoftë ata u gjetën jo fajtorë nga Gjykata Penale e Parisit më 5 korrik 1996 e cila vendosi që gazetarët kishin vepruar në mirëbesim, kishin ndjekur një qëllim të ligjshëm dhe kishin cituar një raport, besueshmëria e të cilit ishte e padiskutueshme.

5. Mbreti i Marokut dhe prokurori apeluan ndaj këtij vendimi. Gjykata e Apelit të Parisit mbajti qëndrimin se, dëshira për të tërhequr vëmendjen e publikut ndaj përgjegjësisë së oborrit të Mbretit dhe ndaj tolerancës së Mbretit për këtë situatë, ishte frymëzuar nga synime jo të mira. Ajo i kritikoi gjithashtu gazetarët sepse nuk kishin kontrolluar vërtetësinë dhe koherencën e fakteve që referonin si dhe gjetën se faktet e çështjes të marra në tërësi tregonin mungesë mirëbesimi. Për pasojë ajo i gjeti fajtorë kërkuesit për fyerje të kryetarit të një shteti të huaj, dhe i dënoi ata me një gjobë prej 5 000 Frangash franceze dhe i urdhëroi që t'i paguanin Mbretit Hasan II 1 Frangë franceze për efekt dëmi dhe 10 000 Franga franceze në bazë të Kodit të Procedurës Penale. Ajo gjithashtu urdhëroi gazetën *Le Monde* që të botonte pjesë nga vendimi i saj. Kërkesa e kërkuesve në Gjykatën e Kasacionit nuk u pranua.

6. Duke u bazuar në nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, kërkuesit u ankuan për një shkelje të lirisë së tyre të shprehjes.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 10

7. Gjykata vuri në dukje se opinioni publik në Francë kishte një interes legjitim që të informohej për vlerësimet e Komisionit të Komunitetit Evropian në lidhje me problemet e prodhimit dhe të trafikimit të drogës, në një vend që kërkon të aderojë në Bashkimin Evropian. Gjykata ritheksoi se, me qëllim që të përfitonin mbrojtje nga neni 10, gazetarët duhet të vepronin në mirëbesim mbi baza të kujdesshme faktike dhe të ofronin informacione të besueshme dhe të sakta në përputhje me etikën e gazetarit. Ajo vuri në dukje që në këtë drejtim, përmbajtja e raportit të *OGD-së* ishte e padiskutueshme dhe se pretendimet që ai përmbante mund të quheshin me plotë të drejtë si të besueshme. Ajo vlerësoi se, ndërsa kontribuonte në një debat publik mbi probleme që ngrinin shqetësime të ligjshme, shtypi në parim duhet të jetë në gjendje të bazohet në raportet zyrtare pa qenë e domosdoshme që të kryejë hetimet e veta të pavarura në këtë drejtim.

8. Në vijim Gjykata vuri në dukje se, në ndryshim nga të akuzuarit për shpifje, personat

e akuzuar për fyerje të kryetarëve të shteteve të huaja nuk janë të detyruar që ta mbrojnë veten e tyre duke ofruar prova se deklaratat e tyre ishin të vërteta. Gjykata vuri në dukje gjithashtu se zbatimi i nenit 36 të Ligjit të 29 korrikut 1881 u jepte kryetarëve të shteteve një status të veçantë, në ndryshim nga e drejta e përgjithshme dhe nuk mund të pajtohej me praktikën dhe konceptimet politike moderne, përderisa qëllimi i tij ishte vetëm që t'u akordonte atyre imunitet nga kritikizmi vetëm për shkak të funksionit ose statusit të tyre, pavarësisht nga fakti nëse kritikizmi ishte i arsyeshëm apo jo.

9. Për pasojë Gjykata konstatoi se, për shkak të natyrës së posaçme të mbrojtjes që akordonte dispozita përkatëse e Ligjit për Lirinë e Shtypit, fyerja ose sharja e kryetarëve të shteteve bënte të mundur shkeljen e lirisë së shprehjes pa pasur ndonjë “nevojë të ngutshme sociale” që të mund të justifikonte një kufizim të një lloji të tillë. Ajo vlerësoi se nuk kishte një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet kufizimeve të vendosura ndaj lirisë së shprehjes së kërkuesve dhe qëllimit legjitim të ndjekur. Për këtë arsye Gjykata vendosi, me unanimitet, se ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

10. Gjykata u akordoi kërkuesve 4 096.46 euro për dëm jomaterial dhe 21 852.20 euro për shpenzime dhe pagesa.

## **III. Koment**

11. Jurisprudenca e Gjykatës është përpjekur gjithmonë të gjejë një ekuilibër të drejtë ndërmjet të drejtës për lirinë e shprehjes, të mbrojtur nga neni 10 dhe së drejtës për një reputacion të mirë, të mbrojtur në kuadrin e jetës private të nenit 8 të Konventës.<sup>209</sup>

12. Artikujt e gazetave të cilat përmbajnë citime apo pjesë nga gazeta të tjera, kanë dhënë shpesh shkak për procese për shpifje, të cilat janë marrë për shqyrtim në vijim nga ana e Gjykatës së Strasburgut. Në çështjen “Bladet Tromso kundër Norvegjisë<sup>210</sup>”, Gjykata vendosi se shtypi duhet të ketë të drejtë të mbështetet në përmbajtjen e raporteve zyrtare, pa qenë nevoja të ndërmarrë kërkime të pavarura për të verifikuar vërtetësinë e informacionit që ato përmbajnë. Në çështjen “Bergens Tidende kundër Norvegjisë<sup>211</sup>” Gjykata kishte konstatuar se kur një gazetë përmban artikuj që citojnë apo përmbajnë pjesë që janë të besueshme dhe të kujdesshme, procedimet për shpifje mund të përbëjnë një ndërhyrje jo të justifikueshme ndaj të drejtave të parashikuara në nenin 10 të Konventës. Një shqyrtim më i kujdesshëm kërkohet në rastet kur e drejta e brendshme nuk e lejon mbrojtjen që të pretendojë se deklaratat objekt i mosmarrëveshjes janë të vërteta. Në çështjen “Castells kundër Spanjës<sup>212</sup>”, Gjykata kishte vendosur ndërkaq që e drejta spanjolle që penalizonte sharjen e qeverisë, shkelte nenin 10 të Konventës.

<sup>209</sup> Shih për shembull vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjen Tammer kundër Estonisë, të 6 shkurtit 2001, përfshirë në këtë botim.

<sup>210</sup> Vendim i 20 majit 1999.

<sup>211</sup> Vendim i 2 majit 2000.

<sup>212</sup> Vendim i 2 prillit 1992, i përfshirë në këtë botim.

## AMIHALACHIOAIE MIHALACHIOAIE kundër MOLDAVISË

(kërkesa nr. 60115/00)

20 prill 2004

*kur kritikant ndaj vendimeve ose pushtetit gjyqësor bëhen brenda kufijve të pranuar nga neni 10, ato nuk mund të pengohen me qëllimin e ruajtjes së autoritetit dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Gheorghe Amihalachioaie, është shtetas moldav i cili ka lindur më 1949 dhe jeton në Chişinău. Ai është avokat dhe në të njëjtën kohë, Kryetar i Bashkimit të Avokatëve të Moldavisë.

2. Në një çështje që iu paraqit nga një grup deputetësh dhe nga Ombudsmani i Moldavisë, Gjykata Kushtetuese, me anë të një vendimi të 15 shkurtit 2000, i deklaroi antikushtetuese dispozitat ligjore që iu kërkonin avokatëve të ishin anëtarë të Bashkimit të Avokatëve të Moldavisë.

3. Kërkuesi e kritikoi këtë vendim në një intervistë me një gazetar, intervistë që në vijim u botua në gazetën "Analiza Ekonomike". Me një vendim të formës së prerë të 6 marsit 2000, Gjykata Kushtetuese mori një sanksion administrativ prej 36 eurosh ndaj kërkuesit, për shkak se ky nuk kishte treguar respekt ndaj saj. Ajo e sanksionoi atë për shkak të deklaratës se, si pasojë e vendimit "do të mbretërojë një kaos i plotë në profesionin e avokatit" dhe se lindte çështja nëse vetë Gjykata Kushtetuese ishte kushtetuese apo jo. Gjykata Kushtetuese e sanksionoi gjithashtu për pohimin se gjyqtarët e saj "ndoshta nuk e konsideronin Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut si një autoritet".

4. Kërkuesi ankohej, në bazë të nenit 10, se sanksioni i parashikuar ndaj tij përbënte një ndërhyrje të pajustificuar ndaj së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 10

5. Gjykata vuri në dukje se ndëshkimi i kërkuesit përbënte një ndërhyrje ndaj lirisë së tij të shprehjes dhe se kjo ndërhyrje parashikohej nga neni 82 (e) i Kodit të Procedurave Kushtetuese. Në vijim, ndërhyrja në fjalë kishte ndjekur një qëllim legjitim që ishte pikërisht ruajtja e autoritetit dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

6. Në lidhje me faktin nëse ndërhyrja ishte apo jo “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykata vuri në dukje se deklaratat e kërkuetit kishin pasur të bënin me një çështje të interesit të përgjithshëm e cila kishte qenë objekt i një debati të ashpër ndërmjet juristëve. Ky debat e kishte zanafillën në një vendim të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me statusin e profesionit të avokatit dhe që i kishte dhënë fund organizimit të avokatëve në një strukturë të vetme, në Bashkimin e Avokatëve të Moldavisë, kryetar i të cilit ishte vetë kërkueti.

7. Në këtë kontekst, edhe në qoftë se deklaratat e z. Amihalachioaie dukej se përmbanin një mungesë vlerësimi ndaj Gjykatës Kushtetuese, ato nuk mund të konsideroheshin si serioze ose fyese ndaj gjyqtarëve të asaj gjykate. Për më tepër, përderisa kërkueti në vijim kishte mohuar një pjesë të deklaratave që shtypi ia atribuonte atij, Gjykata vlerësoi se ai nuk mund të konsiderohej përgjegjës për gjithçka ishte botuar në intervistë. Duke pasur parasysh gjobën e vënë ndaj tij, pavarësisht se shumica nuk kishte qenë e konsiderueshme, dukej se gjithsesi qëllimi kishte qenë ndëshkimi i kërkuetit në mënyrë të ashpër, përderisa Gjykata Kushtetuese kishte parashikuar një shumë afër maksimumit ligjor.

8. Në këto rrethana Gjykata vlerësoi se nuk ka pasur një “nevojë të ngutshme sociale” për të kufizuar të drejtën e kërkuetit për lirinë e shprehjes dhe se autoritetet vendase nuk kishin ofruar arsye “të mjaftueshme dhe bindëse” për të justifikuar ndërhyrjen. Përderisa kërkueti nuk kishte tejkaluar kufijtë e kritikës të lejuar në bazë të nenit 10 të Konventës, ndërhyrja për të cilën ai ankohej nuk mund të konsiderohej si “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

9. Gjykata vlerësoi se vetë konstatimi i shkeljes përbënte një shpërblim të drejtë për çdo dëm jomaterial të pësuar nga kërkueti.

### **III. Koment**

10. Neni 10 i autorizon shprehimisht ndërhyrjet ndaj lirisë së shprehjes, në qoftë se këto janë të nevojshme për të garantuar autoritetin dhe paanësinë e pushtetit gjyqësor. Shumica e gjyqtarëve të Gjykatës vlerësuan se ndërhyrja në këtë rast nuk e kishte respektuar këtë kusht.

11. Megjithatë, tre nga shtatë gjyqtarët që shqyrtuan këtë çështje e panë të nevojshme të shtonin mendime paralele në lidhje me këtë vendim. Gjyqtari moldav u shpreh se nuk kishte pasur shkelje, duke argumentuar, *inter alia*, se shumica e gjobës ishte tepër e papërfillshme. Në mendimin e tij paralel, gjyqtari qipriot Loucaides vlerësonte se gjoba me karakter administrativ e vënë ndaj kërkuetit, nuk i shërbente qëllimit legjitim që ndiqte masa për shkak se ajo justifikohej me “mungesën e vlerësimit ndaj gjykatës” nga ana e kërkuetit. Kjo sipas tij nuk ishte e nevojshme për qëllimet e ruajtjes së dinjitetit të gjykatës. Gjyqtarja holandeze Thomassen vlerësoi se kufizimet e vendosura ndaj kritikave në drejtim të gjykatave duhen lejuar vetëm në raste kur



ushtrimi i lirisë së shprehjes mund të paragjykojë zgjidhjen e duhur të një çështjeje përpara gjykatave përkatëse dhe jo në raste kur avokatët kërkonin të kritikonin vendimet e gjykatave pasi ato të ishin dhënë. Të dy këta gjyqtarë u shprehen se, liria për të kritikuar vendimet gjyqësore dhe mënyrën në të cilën ushtrohej pushteti gjyqësor, përbën një element të domosdoshëm të demokracisë.

## CASTELLS kundër SPANJËS

(kërkesa nr. 11798/85)

23 prill 1992

*ndjekja penale e një senatori që akuzon qeverinë e vet përbën shkelje të nenit 10 të Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Z. Miguel Castells, me profesion avokat, ishte zgjedhur senator i koalicionit bask "Herri Batasuna" në senatin spanjoll. Më 1979 ai botoi në gazetën e përjavshme "Punto y Hora de Heuskalherria" një artikull në të cilin ai tërhoqi vëmendjen e opinionit publik mbi vrasjet dhe sulmet e kryera nga grupe të armatosura kundër qytetarëve baskë. Sipas tij, këto grupe vepronin krejt lirshëm dhe qeveria ishte përgjegjëse për këtë

2. Prokuroria filloi ndjekjen penale ndaj tij. Pas heqjes së imunitetit parlamentar nga Senati, më 7 korrik 1981 Gjykata e Lartë e akuzoi për fyerje të qeverisë, vepër e parashikuar nga neni 161 i Kodit Penal. Z. Castells pretendoi se shkrimi i tij iu referohej fakteve të vërteta dhe të njohura dhe në këto kushte, artikulli nuk përbente shkelje të nenit të lartpërmendur. Megjithatë prokuroria i kundërshtoi këto prova të palës mbrojtëse.

3. Më 31 tetor 1983, dhoma penale e Gjykatës së Lartë e dënoi z. Castells me një vit heqje lirie të shoqëruar me një dënim plotësues - heqjen e së drejtës së ushtrimit të çdo profesioni ose funksioni publik gjatë kësaj periudhe. Ajo vlerësoi se si senator, kërkuesi ishte i detyruar t'i përshtatej mjeteve të parashikuara nga rregullorja e brendshme e Senatit lidhur me kritikën ndaj qeverisë, gjë që ai nuk e bëri. Artikulli i tij përbente një fyerje me qëllim. Më 10 prill 1985, Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë rekursin kushtetues të bërë më 22 nëntor 1983 nga Z. Castells. Megjithatë, i interesuari përfitoi pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

4. Në kërkesën e tij të paraqitur Komisionit, z. Castells citoi nenet 6, 7, 10, dhe 14 të Konventës. Më 9 maj 1989, Komisioni i deklaroi të papranueshme ankesat e ngritura në bazë të neneve 6 dhe 7. Por, nga ana tjetër, ai e pranoi pjesën tjetër të ankesës në 7 nëntorin pasues. Në raportin e tij të 8 janarit 1991, ai arriti në përfundimin se kishte shkelje të nenit 10 dhe konsideroi që asnjë çështje tjetër më vete nuk shtrohej mbi bazën e nenit 14 të marrë së bashku me nenin 10.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimet paraprahe

5. Sipas qeverisë, Z. Castells nuk kishte ngritur në një mënyrë të veçantë përpara Gjykatës Kushtetuese ankesën në lidhje me dhunimin e të drejtës së shprehjes. Në këto kushte sipas saj ai nuk kishte shteruar të gjitha mjetet efektive të mundshme për të përpara juridiksioneve spanjolle. Por duke vlerësuar faktin që i interesuari bazohej në nenin 10 në ankesat e tij, Gjykata hodhi poshtë njëzëri këtë prapësim. Ai ishte bazuar në nenin 10 të Konventës edhe përpara Gjykatës së Lartë, edhe përpara Gjykatës Kushtetuese. Së pari, z. Castells si senator kërkonte të drejtën që të kundërshtonte veprimin e qeverisë, e cila ishte haptazi një e drejtë e pandarë e të drejtës së shprehjes, veçanërisht për të zgjedhurit. Për më tepër, duke pretenduar të provonte pafajësinë e tij dhe duke përdorur provat me qëllim që të tregonte saktësinë e tyre, ai formuloi një ankesë në lidhje me dhunimin e nenit 10 të Konventës. Së fundi, ai citonte nenin 20 të Kushtetutës (e drejta e lirisë të shprehjes) në përmbledhjen e tij të ankesave dhe i referohej gjithashtu të drejtës së tij që të merrte dhe të komunikonte informacionet e vërteta.

### B. Në lidhje me nenin 10

*i. A kishte ndërhyrje dhe a ishte ajo e ligjshme dhe legjitime?*

6. Përsa i përket bazueshmërisë së ankesës, dënimet për të cilat z. Castells ankohej u analizuan si një ndërhyrje në lirinë e të shprehurit. Kjo ndërhyrje bazohej në nenet 161 dhe 162 të Kodit Penal. Për më tepër, hedhja poshtë e përjashtimit të së vërtetës nga Gjykata e Lartë, në përputhje me dispozitat e zbatueshme, ishte e parashikueshme, pavarësisht nga mungesa e precedentëve. Në rrethanat ekzistuese në Spanjë në 1979, ndjekjet penale kundër kërkuesit kishin si qëllim mbrojtjen e rregullit dhe jo vetëm mbrojtjen e reputacionit të tjetrit.

*ii. A ishte kjo ndërhyrje e nevojshme?*

7. Liria e të shprehurit është më e çmueshme për të zgjedhurin e popullit sepse ai përfaqëson zgjedhësit, vë në dijeni publikun në lidhje me shqetësimet e tyre dhe mbron interesat e tyre. Duke qënë se Z. Castells ishte shprehur në një revistë, Gjykata vuri në dukje rolin e rëndësishëm të shtypit në një qeveri demokratike. Liria e shtypit i jep qytetarëve një nga mjetet më të mira për të njohur dhe gjykuar idetë dhe sjelljet e drejtuesve, u jep mundësinë politikanëve për të marrë pjesë në lojën e lirë të debatit politik.

8. Megjithatë, sipas Gjykatës, liria e diskutimit politik nuk është absolute. Sidoqoftë kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjera përkundrejt qeverisë, sesa ndaj një individi apo një politikani. Pozita dominuese që ai zë, kërkon që të tregohet maturi në përdorimin e zgjidhjes penale. Megjithatë autoritet kompetente mund të marrin edhe masa të tilla për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme, por gjithsesi të përmbajtur, sulmeve pa bazë dhe në keqbesim.

9. Z. Castells nuk mundi të përdorte për shfaqësimin e tij, faktin që deklaratat e tij ishin të vërteta si dhe faktin që ai ishte në mirëbesim. Edhe pse ai kërkoi disa herë

vërtetimin e saktësisë së provave dhe njohjen e fakteve të përmbajtura në artikull, Gjykata e Lartë i deklaroi të papranueshme provat e propozuara, ndërsa Gjykata Kushtetuese tha se bëhej fjalë për një çështje ligjshmërie të zakonshme për të cilën ajo nuk ishte kompetente. Ndërsa Gjykata e Strasburgut, iu referua këtij momenti dhe vlerësoi se një tentativë prove konceptohej fare mirë nga numri i pohimeve që përmbante vetë artikulli, po ashtu si edhe nga përpjekjet e ankuesit për të provuar mirëbesimin e tij. Pra ndërhyrja nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike. Si përfundim mund të thuhet se ka patur shkelje të nenit 10.

### *C. Në lidhje me nenin 14*

10. Z. Castells pretendonte se ishte viktimë e një diskriminimi, sepse persona të tjerë po të ishin shprehur në të njëjtën mënyrë nuk do të kishin pësuar asnjë dënim. Duke qenë se ky problem nuk përbënte një element themelor të çështjes, Gjykata nuk vlerësoi se duhej ta gjykonte në mënyrë të veçantë.

### *D. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)*

11. Duke u mbështetur në nenin 50, Gjykata rikujtoi se ajo nuk kishte kompetencë t'u jepte direktiva qeverive, siç ishte publikimi i një vendimi në një gazetë ose eliminimi i çdo referimi tek një dënim në regjistrin qendror të dosjeve gjyqësore. Ajo hodhi poshtë njëzëri kërkesat për dëmshpërblim, sepse nuk ishte provuar ekzistenca e ndonjë dëmi material dhe konstatimi i shkeljes në vendimin e saj përbënte një shpërblim të drejtë e të mjaftueshëm për dëmin moral të shkaktuar. Në lidhje me shpenzimet dhe pagesat ligjore ajo i akordoi kërkuarit 1 000 000 peseta për procedurën në Spanjë dhe 2 000 000 peseta për procedurën në Strasburg.

## **III. Koment**

12. Me këtë vendim, Gjykata e Strasburgut bëri një hap përpara në lidhje me sqarimin e një momenti të rëndësishëm të interpretimit të nenit 10 të Konventës. Sipas Gjykatës, mbrojtja që ofron ky nen ndaj shprehjes që kritikon strukturat e një qeverie, është më e gjerë sesa kur shprehja kritikon politikanë konkretë. Kriteri i vendosur nga Gjykata në këtë çështje është zbatuar prej saj edhe në çështje vijuese me rrethana të ngjashme<sup>213</sup>, fakt që tregon se është bërë tashmë një bazë solide jurisprudenciale në interpretimin e nenit 10.

13. Një kriter me rëndësi që e bëri Gjykatën të vendoste për shkelje në këtë çështje ishte fakti se Z. Castells nuk u lejua nga ana e gjykatave spanjolle që të provonte vërtetësinë e deklaratave të tij. Ky moment nxjerr në pah nevojën e garancive procedurale, përfshirë ato gjyqësore, që gjejnë zbatim në respektimin e së drejtës së lirisë së shprehjes.

14. Ky vendim, së bashku me vendimin e Gjykatës në lidhje me çështjen "*Lingens kundër Austrisë*" që vijon në këtë botim, ofrojnë një guidë të pazëvendësueshme

<sup>213</sup> Shih për shembull vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet *Incal kundër Turqisë* dhe *Ceylan kundër Turqisë*.

për gazetarët dhe për shprehjen në përgjithësi, kur ajo drejtohet ndaj politikanëve dhe institucioneve shtetërore. Këto dy vendime bëjnë një sqarim themelor në këtë drejtim, duke dalluar mes deklaratave me karakter faktik dhe gjykimeve vlerësuese. Ndërsa në lidhje me të dytat nuk kërkohet ofrimi i vërtetësisë së tyre, në lidhje me të parat vërtetësia është një element thelbësor për të përfituar nga mbrojtja e nenit 10 § 1 të Konventës.

## RADIO FRANCE kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 53984/00)

30 mars 2004

*në këtë çështje u vlerësua se procedimi për shpifje ndaj një nëpunësi civil ishte në përputhje me standardet e Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkesa ishte paraqitur nga shoqëria kombëtare e transmetimit radiofonik Radio France dhe nga dy shtetas francezë, shefi i redaksisë së shoqërisë së transmetimit, Michel Boyon, dhe një gazetar i France Info (një kanal i kontrolluar nga shoqëria kërkuese), Bertrand Gallicher. Shoqëria kërkuese kishte selinë e vet të regjistrimit në Paris. Z. Boyon ka lindur më 1946, dhe jeton në Paris dhe z. Gallicher ka lindur më 1957 dhe jeton në Saint Cloud.

2. Më 31 janar dhe 1 shkurt 1997, rreth gjashtëdhjetë lajme dhe buletine të shkurtra u transmetuan në France Info, të cilat përmendnin një artikull të botuar në të përjavshmen "Le Point" dhe që bënte fjalë për Michel Junot, zëvendësprefekt i Pithiviersit, i cili më 1942 dhe 1943 kishte mbikëqyrur internimin e mijëra hebrenjve.

3. Në lidhje me këto transmetime, një vendim i Gjykatës Penale të Parisit i shpalli z. Boyon dhe z. Gallicher përgjegjës për veprën penale të shpifjes publike ndaj një nëpunësi publik dhe i gjobiti ata me 20 000 Franga Franceze (FF - të barazvlefshme me 3 048.98 euro) dhe i urdhëroi që të paguanin 50 000 FF (të barazvlefshme me 7 622.45 euro) si dëmshpërblim. Shoqëria kërkuese u urdhërua që të transmetonte një njoftim në lidhje me këtë vendim gjyqësor çdo dy orë gjatë një periudhe prej 24 orësh.

4. Me një vendim të 17 qershorit 1998, Gjykata e Apelit e Parisit e la në fuqi dënimin e kërkuesve. Ajo vlerësoi se duke pretenduar se Michel Junot kishte mbikëqyrur internimin e mijëra hebrenjve dhe organizuar transferimin e tyre në Dransi, duke e krahasuar situatën e tij me atë të Maurice Papon (rasti i të cilit ishte në gjykim e sipër përpara Gjykatës së Asizit<sup>214</sup>) dhe duke aluduar se ai nuk kishte qenë anëtar i

<sup>214</sup> Gjykatë penale e shkallës së parë në sistemin francez në të cilën ka juri.

Rezistencës franceze kundër nazistëve, transmetimet objekt i gjykimit kishin cenuar nderin dhe reputacionin e tij. Seksioni penal i Gjykatës së Kasacionit e hodhi poshtë apelimin e kërkuesve për interpretim të ligjit, më 8 qershor 1999.

5. Duke u bazuar në nenin 7 të Konventës, kërkuesit ankoheshin se qëllimi i së drejtës penale ishte zgjeruar së tepërmi. Ata pretenduan se, duke vlerësuar se faktet objekt i gjykimit ishin brenda qëllimit të Ligjit të Komunikimit Audiovizual, gjykatat franceze kishin krijuar një kategori të re vepre penale me “analogji”. Kërkuesit pretenduan gjithashtu se Ligji i 29 korrikut 1982 krijonte një prezumim të pakundërshtueshëm se shefi i redaksisë ishte përgjegjës, duke shkelur në këtë mënyrë parimin e prezumimit të pafajësisë të garantuar nga ana e nenit 6 § 2 të Konventës. Për më tepër, ata pretendonin se ky Ligj cenonte parimin e barazisë së mjeteve në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës (e drejta për një gjykim të rregullt). Së fundmi, duke u bazuar në nenin 10 të Konventës, kërkuesit ankoheshin për shkelje të së drejtës së tyre për “të dhënë informacion” si rezultat i sanksioneve dhe masave të marra ndaj tyre nga gjykatat e brendshme

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 7 § 1

8. Gjykata vuri në dukje se, prezumimi i përgjegjësisë së shefit të redaksisë nga ana e Ligjit të 29 korrikut 1982 ishte pasojë e detyrës së tij për të kontrolluar informacionin e transmetuar nga mjete informativ në të cilin ai punonte. Kjo përgjegjësi dilte në pah vetëm në ato raste kur kishte pasur një “regjistrim paraprak” të deklaratave të kundërshtuara përpara transmetimit të tyre.

9. France Info vepronte me anë të transmetimit të buletineve të rregullta direkt në mënyrë periodike. Në këtë pikë, gjykatat franceze nuk e konsideruan shefin e redaksisë përgjegjës për transmetimin e buletinit të parë informativ që përmbante deklaratat në fjalë, por vlerësuan se ky transmetim i parë përbënte “regjistrim paraprak” për qëllimet e transmetimeve vijuese. Për këtë arsye gjykatat vlerësuan se shefi i redaksisë ka qenë në gjendje të kontrollojë transmetimet vijuese dhe e konsideruan atë penalisht përgjegjës.

10. Sipas Gjykatës, duke pasur parasysh mënyrën e operimit të France Info, gjykatat penale e kishin interpretuar konceptin e “regjistrimit paraprak” në përputhje me shkeljen në fjalë dhe në një mënyrë që ishte “normalisht e parashikueshme”. Për këtë arsye, ajo vendosi se nuk kishte shkelje të nenit 7 të Konventës.

### B. Në lidhje me nenin 6 § 1 dhe 2

11. Gjykata vuri në dukje se, ankesa në bazë të nenit 6 § 1 ishte mbivendosur me ankesën në bazë të nenit 6 § 2 dhe për këtë arsye nuk kishte nevojë për një shqyrtim më vete të fakteve në bazë të nenit 6 § 1.

12. Ligjet e 29 korrikut 1982 dhe të 29 korrikut 1881 parashikonin që një shef redaksie është penalisht përgjegjës për transmetimin dhe përhapjen e deklaratave shpifëse

kur është bërë një “regjistrim paraprak” përpara transmetimit të tij. Ky prezumim i përgjegjësisë shoqërohej me një prezumim tjetër i cili nuk ishte absolut – ai që shpifjet janë bërë në keqbesim.

13. Shefi i redaksisë mund t'i ishte shmangur përgjegjësisë qoftë duke provuar mirëbesimin e personave që bënin deklaratat e kundërshtuara, qoftë duke provuar se nuk ka pasur “regjistrim paraprak” të tyre. Duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes, d.m.th. nevojën për të parandaluar transmetimin e deklaratave shpifëse ose cënues të dinjitetit në media, duke e detyruar shefin e redaksisë që të ushtronte një kontroll paraprak, Gjykata konstatoi se prezumimi i parashikuar nga Ligji i vitit 1982 qëndronte brenda “kufijve të arsyeshëm” të kërkuar. Për më tepër, duke pasur parasysh kujdesin me të cilin gjykatat franceze kishin shqyrtuar arsyet e apelimit të kërkuarit në lidhje me këtë pikë, Gjykata konstatoi se ato nuk e kishin zbatuar ligjin në mënyrë të tillë sa të shkelnin prezumimin e pafajësisë. Për këtë arsye, ajo vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 2 të Konventës.

### *C. Në lidhje me nenin 10*

14. Gjykata u shpreh se dënimi i kërkuarve përbënte ndërhyrje ndaj së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes. Si dënimi i z. Boyon dhe i z. Gallicher ashtu edhe urdhri drejtuar shoqërisë transmetuese kishin një bazë në të drejtën penale franceze sipas pikëpamjes së Gjykatës. Sipas kësaj, përgjegjësia civile e shoqërisë bazohej në dispozitat e Kodit Civil në lidhje me përgjegjësinë e çdo subjekti për aktet e kryera prej vetë atij, dhe në një jurisprudencë franceze të qëndrueshme e cila iu jepte gjykatave juridiksion ekskluziv për të përzgjedhur mjetet e përshtatshme për të vënë në vend dëmet e pësuarat. Nga kjo pikëpamje, dukej se botimi i njoftimeve në lidhje me vendimet gjyqësore ishte një mjet i zakonshëm për dëmet e shkaktuara nga media.

15. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se ndërhyrjet në fjalë kishin një qëllim legjitim, pikërisht atë të mbrojtjes së reputacionit ose të të drejtave të të tjerëve. Në lidhje me faktin nëse ndërhyrjet ishin proporcionale apo jo me qëllimin që kishin, Gjykata vuri re se debati fokusohej në një çështje me interes të përgjithshëm, atë të qëndrimit të funksionarëve publikë të një rangu të lartë gjatë pushtimit nazist. Për më tepër, botimet dhe transmetimet e kundërshtuara kishin ardhur ndërsa po bëhej një debat i madh publik në lidhje me procesin ndaj Maurice Papon, për pjesëmarrje në krime kundër njerëzimit.

16. Përsa i përket transmetimit të lajmit të botimit, Gjykata vlerësoi se ai kishte cituar, me një referencë konkrete në burimin e informacionit, që ishin një artikull i detajuar dhe i mirë dokumentuar dhe një intervistë të botuar në një të përjavshme me reputacion. Për këtë arsye gazetarët e France Info nuk mund të akuzoheshin se nuk kishin vepruar në mirëbesim vetëm sepse kishin bërë transmetimet në fjalë. Por megjithatë, transmetimet përmendnin se Michel Junot kishte pranuar se “kishte organizuar nisjen e një kolone me të internuar në Dransi”. Sipas Gjykatës, ky moment, që nuk ishte botuar në Le Point, nuk pasqyronte me kujdes artikullin



ose intervistën e botuar në këtë të përjavshme. Pjesa tjetër e transmetimeve citonte nga të dhënat e botuara, duke përmbledhur në disa fjali një hetim gazetaresk që ishte i gjatë disa faqe dhe duke nënvizuar aspektet më goditëse, duke i prezantuar pra faktet me një ton shumë më kategorik sesa artikulli i të përjavshmes. Megjithëse transmetimet u modifikuan paksa në vijim, dhe theksuan se Michel Junot i kishte mohuar këto akuza, gjithsesi buletini original ishte transmetuar disa herë.

17. Duke pasur parasysh karakterin tepër serioz të fakteve që në mënyrë të pakujdesshme i visheshin Michel Junot, qëllimit për të transmetuar deklaratat edhe disa here të tjera si dhe faktin që këto transmetime kishin një mbulim në mbarë Francën, gazetarët përkatës duhet të kishin ushtruar kujdesin më të madh dhe treguar një tolerancë të veçantë. Në këto kushte Gjykata vlerësoi se arsyet e parashtuara nga Gjykata e Apelit në vendimin ndaj kërkuesve ishin “të rëndësishme dhe të mjaftueshme”.

18. Përsa i përket dënimit të kërkuesve, Gjykata vuri në dukje se z. Boyon dhe z. Gallicher u konsideruan fajtorë për një vepër penale dhe u urdhëruan që të paguajnë shuma modeste si gjobë dhe dëmshpërblim. Për më tepër, urdhri ndaj shoqërisë kërkuese që të transmetonte rreth 12 herë në Francë Info një njoftim prej 118 fjalësh për vendimin gjyqësor, pasqyronte shqetësimin e gjykatave franceze për të vënë në vend, në masën e përshtatshme, dëmin e pësuar nga Michel Junot dhe përfshinte, sipas Gjykatës, vetëm një pjesë të kufizuar e programit të transmetuar nga kanali në fjalë.

19. Gjykata konstatoi se, masat e marra ndaj kërkuesve nuk ishin joproporcionale me qëllimin legjitim që ndiqnin dhe për këtë arsye mund të konsideroheshin “të nevojshme në një shoqëri demokratike”. Pra Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

### III. Koment

20. Kjo çështje ka të bëjë me transmetimet në mënyrë radiofonike të pretendimeve të ngritura në një të përjavshme, e cila ishte botuar ndërkaq. Sidoqoftë, duhet vënë në dukje se transmetuesit radiofonikë kishin shtuar se personi për të cilin bënte fjalë artikulli i së përjavshmes, kishte pranuar se kishte organizuar një kolonë me të internuar. Ky moment nuk rezultonte nga artikulli dhe kjo ishte pika kyçe e problemit. Gazetarët kishin qenë gjithashtu tepër përzgjedhës në citimet e tyre mbi artikullin dhe i kishin paraqitur faktet me një ton shumë më kategorik sesa ai i përdorur në artikull. Sidoqoftë, stacioni i radios kishte transmetuar edhe refuzimin e Z. Junot në lidhje me këto pretendime si dhe të nesërmen, hedhjen poshtë prej tij të faktit që gjoja ai i kishte pranuar ato.

21. Duhet theksuar se, normalisht Gjykata e Strasburgut përkrah lirinë e medias kur deklaratat e kundërshtuara bëhen në lidhje me figura publike dhe janë gjykime vlerësuese. Në rastet kur, si ky që po shqyrtojmë, problemi konsiston në

mosrespektimin eventual të normave të kodit të etikës së gazetarit për shkak të mos-verifikimit të fakteve, Gjykata do të jetë shumë më strikte në përkrahjen e vet ndaj medias. Megjithëse personi i interesuar ishte mbi 80 vjeç, ishte larguar nga jeta publike prej shumë vitesh dhe ngjarjet për të cilat bëhej fjalë kishin ndodhur në vitet 1940, Gjykata pranoi se ishte e pranueshme që Radio Francë të konsiderohej përgjegjëse në bazë të ligjit për shpifje ndaj funksionarëve publikë, përderisa i tillë kishte qenë Z. Junot në kohën e ngjarjeve të referuara në kronikë.

22. Nga vendimi nuk mund të kuptohet qartë nëse një subjekt mund të ishte konsideruar përgjegjës në Francë sikur z. Junot nuk do të kishte qenë funksionar publik as në kohën e ngjarjeve për të cilat akuzohej dhe as më vonë. Në vendimin e saj të 21 janarit 1999 në lidhje me çështjen “Janowski kundër Polonisë”, Gjykata u shpreh se funksionarët publikë duhet të gëzojnë besimin e publikut dhe të mbrohen nga sulmet abuzive dhe fyese ndërkohë që janë në detyrë e sipër<sup>215</sup>. Sidoqoftë duket se ky vendim sugjeron – por pa e thënë shprehimisht – që kjo mbrojtje duhet të zgjasë përjetë.

## NIKULA kundër FINLANDËS

(kërkesa nr. 31611/96)

21 mars 2002

*ndërhyrja në lirinë e shprehjes të një avokateje në seancë gjyqësore shkelte nenin  
10*

### I. Faktet kryesore

1. Anne Nikula, shtetase finlandeze e lindur më 1962, është avokate dhe jeton në Helsinki. Më 1992 dhe 1993 ajo punonte si avokate në dy dosje penale në gjykim e sipër në Gjykatën e Rrethit dhe që kishin të bënin me akuzat ndaj disa shoqërive tregtare, në të cilat klienti i saj ishte akuzuar se kishte mbështetur akte mashtrimi dhe abuzimi të pozicionit dominues. Një i bashkakuar tjetër ishte thirrur nga prokurori T. për të dëshmuar. Kërkuesja e kundërshtoi thirrjen e tij dhe përgatiti një mbrojtje me shkrim në të cilën ajo i denonconte taktikat e prokurorit T. si të tilla që përbënin “manipulim të rolit të prokurorit dhe paraqitje të paligjshme të provave” si dhe “shkelje të detyrave të tij zyrtare”. Kundërshtimi i saj u hodh poshtë nga ana e Gjykatës së Rrethit, e cila e shqyrtonte çështjen në shkallë të parë dhe klienti i saj u gjet fajtor dhe u dënua.

2. Prokurori T. në vijim ia paraqiti deklaratat e kërkuesit Zyrës së Prokurorit të Gjykatës së Apelit për t'i vlerësuar dhe në qoftë se shihej e arsyeshme, për ta ngarkuar kërkuesen me përgjegjësi penale për thënie të pavërteta. Zyra e Prokurorit të Apelit

<sup>215</sup> Shih gjithashtu vendimin e 21 marsit 2002 në lidhje me çështjen Nikula kundër Finlandës.

vlerësoi se kërkuesja kishte qënë fajtores për thënie të pavërteta, por vendosi të mos e ndiqte atë penalisht përderisa vepra penale kishte qënë e një rëndësie të ulët.

3. Pavarësisht nga kjo, duke përdorur të drejtën e tij private për ndjekje penale, prokurori T. bëri kallëzim kundër kërkueses në Gjykatën e Apelit. Më 22 gusht 1994 ajo u dënua për shpifje “duke mos patur të dhëna të sakta”, që konsiston pra në shprehjen e mendimit të dikujt në lidhje me qëndrimin e dikujt tjetër dhe pa bërë kallëzim penal duke e ditur që nuk ka qënë mbajtur qëndrimi në fjalë. Kërkuesja u dënua me gjobë si dhe me pagimin e dëmeve prokurorit si dhe të shpenzimeve gjyqësore shtetit. Si kërkuesja ashtu edhe prokurori apeluan në Gjykatën e Lartë, e cila la në fuqi argumentimin e Gjykatës së Apelit por e hoqi dënimin me gjobë, duke vlerësuar që vepra penale ishte e një karakteri të vogël, por ripohoi detyrimin për të paguar dëmet dhe shpenzimet.

4. Kërkuesja u ankua në bazë të nenit 10 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 10

5. Gjykata ritheksoi se statusi i posaçëm i avokatëve u jep atyre një pozicion qendror në administrimin e drejtësisë si ndërmjetës midis publikut dhe gjykatave. Një pozicion i tillë shpjegon edhe kufizimet e parashikuara zakonisht në sjelljen e anëtarëve të Dhomave të Avokatisë. Për më tepër, gjykatat – “qeverisësit e drejtësisë”, roli i të cilave është themelor në një shtet të bazuar të sundimit e ligjit – duhet të gëzojnë edhe besimin e publikut. Duke mbajtur parasysh rolin kyç të avokatëve në këtë fushë, është legjitime që prej tyre të pritet të kontribuojnë në miradministrimin e drejtësisë, duke mbështetur kështu ruajtjen e besimit të publikut në të.

6. Në vijim Gjykata kujtoi që neni 10 mbron jo vetëm thelbin e ideve dhe informacionin e shprehur, por gjithashtu edhe formën në të cilën ato shprehen. Por ndërsa avokatët kanë edhe ata natyrisht të drejtë të komentojnë publikisht në lidhje me administrimin e drejtësisë, nuk duhet të kalojnë disa kufij. Në këtë kuadër, duhet mbajtur parasysh nevoja për të hequr një balancë të drejtë ndërmjet interesave të ndryshëm që janë në lojë, të cilat përfshijnë interesin e publikut për të marrë informacion mbi çështje që kanë të bëjnë me vendimet gjyqësore, me kërkesat e miradministrimit të drejtësisë dhe me dinjitetin e profesionit të juristit. Autoritetet shtetërore kanë njëfarë hapësire vlerësimi në konceptimin e nevojës së një ndërhyrjeje, por kjo hapësirë vlerësimi është objekt i mbikëqyrjes evropiane në këndvështrimin si të normave të zbatueshme, ashtu edhe të vendimeve që jepen mbi bazën e tyre.

7. Gjykata vuri në dukje se kufijtë e kritikizmit të pranueshëm në disa rrethana mund të jenë më të gjera ndaj funksionarëve publikë që ushtrojnë detyrat e tyre, sesa ndaj individëve privatë. Sidoqoftë, nuk mund të thuhet se funksionarët publikë qëllimisht duhet t'ia nënshtrojnë çdo fjalë dhe akt një kontrolli të imët në të njëjtën masë sa edhe politikanët dhe se ata duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë më këta

të fundit kur vjen fjala për kritikën që u bëhen. Nga ana tjetër, mund të provohet si e nevojshme që të mbrohen funksionarët publikë në detyrë e sipër nga sulmet abuzive verbale.

8. Znj. Nikula u dënua sepse kishte kritikuar prokurorin për vendimet e marra në cilësinë e tij si palë, në procesin penal në të cilin kërkuesja mbronte një të akuzuar. Ishte e vërtetë që kërkuesja e akuzoi prokurorin T. për sjellje të paligjshme, por kjo kritikë ishte drejtuar ndaj strategjisë së ndjekjes penale të zgjedhur me qëllim nga T., pra përse i përket dy vendimeve që ai kishte marrë përpara procesit dhe të cilat, sipas pikëpamjes së kërkueses, përbënin "*manipulim të rolit...deri në shkëlqje të detyrave të tij zyrtare*". Megjithatë disa prej termave të përdorur ishin të papërshtatshëm, kritikizmi i kërkueses ishte i kufizuar në qëndrimin e T. si prokuror në çështjen kundër klientit të saj, dhe jo si kritikë ndaj cilësive të përgjithshme profesionale ose të tjera të T.. Në këtë kontekst procedural T. do t'i duhej të toleronte kritika të konsiderueshme nga ana e kërkueses në cilësinë e saj si avokate. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se deklaratat e kërkueses ishin kufizuar në sallën e gjyqit, dhe nuk ishin në formën e një kritike ndaj një gjyqtari apo një prokurori në shprehurë, për shembull, në media. Gjykata nuk arriti të konstatojë as se, kritikën e kërkueses ndaj prokurorit përbënin një shprehje personale, duke qënë se ato ishin të një karakteri procedural.

9. Gjykata theksoi në vijim se, edhe pse kërkuesja nuk ishte anëtare e Dhomës së Avokatisë dhe për këtë arsye nuk mund t'i nënshtrohej procedimeve disiplinore, ajo ishte gjithsesi subjekt i mbikëqyrjes dhe drejtimit nga ana e trupit gjykues në proces. Nga ana tjetër, nuk kishte ndonjë të dhënë që prokurori T. t'i kishte kërkuar kryetarit të seancës që të reagojë ndaj kritikave të kërkueses në ndonjë mënyrë tjetër, përveçse duke vendosur në lidhje me kundërshtimin procedural të mbrojtjes ndaj dëgjimit të dëshmitarit të thirrur nga akuza. Gjykata e Rrethit në fakt e kufizoi veprimin e vet në mospranimin e këtij kundërshtimi. Për më tepër, kryetari i seancës edhe mund të kishte ndërprerë parashtrësen e kërkueses dhe mund t'i kishte tërhequr vëmendjen edhe pa patur ndonjë kërkesë për këtë qëllim nga ana e prokurorit. Gjykata e Rrethit edhe mund të kishte revokuar pjesëmarrjet e saj si avokate sipas skemës së avokatëve të caktuar kryesisht, ose ta përjashtonte atë nga pjesëmarrja si avokate në gjykatë. Në këtë kontekst Gjykata theksoi që roli i gjykatave dhe i kryesuesve të seancave ishte që të drejtonin procedurat në një mënyrë të tillë, që të siguronin sjelljen e duhur palëve dhe mbi të gjitha barazimin dhe drejtësinë e procesit – dhe jo t'ia linte shqyrtimin e karakterit të përshtatshëm apo jo të deklaratave të palëve në seancë gjyqësore procedurave të mëtejshme.

10. Në vijim në ndjekjes penale të vënë në lëvizje nga prokurori T., kërkuesja u dënua në fakt për shpifje në neglizhencë. Gjykata e Lartë e shfuqizoi dënimin e saj, duke vlerësuar shkëlqjen si të një natyre të vogël. Por edhe pse gjopa që iu vu nga Gjykata e Apelit u hoq, ngeli detyrimi i saj për të paguar dëmet dhe shpenzimet. Për më tepër, kërcënimin për një rishikim *ex post facto* të kritikizmit të avokatit të palës tjetër me anë të procedurave penale, është shumë e vështirë të pajtohet me detyrimin e avokatit për të mbrojtur interesat e klientëve të tij me zellin e duhur. Për pasojë,

u takon në radhë të parë vetë avokatëve që, nën mbikëqyrjen e trupit gjykues, të vlerësojnë rëndësinë dhe dobinë e një argumenti mbrojtës pa u ndikuar nga “efekti armiqësor” apo edhe nga ndonjë sanksion i lehtë penal apo ndonjë detyrimi për të paguar kompensim për dëm apo edhe për shpenzimet e kryera.

11. Për këtë arsye, vetëm në rrethana përjashtimore – qoftë edhe me anë të sanksioneve fare të lehta penale – që kufizimi i lirisë së shprehjes së avokatit mund të konsiderohet si i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Edhe vendimi i prokurorit të çështjes kundër kërkueses për të mos nisur ndjekjen penale edhe vendimi i pakicës së Gjykatës së Lartë sugjeronin që autoritetet shtetërore nuk ishin të gjitha dakord në lidhje me ekzistencën e arsyeve të mjaftueshme për ndërmarrjen e ndërhyrjes në fjalë. Sipas mendimit të Gjykatës, arsye të tilla nuk dolën në pah se ekzistonin dhe se kufizimi ndaj lirisë së shprehjes së Znj. Nikula nuk arrinte t'i përgjigjej testit të “nevojës të ngutshme shoqërore”. Për këtë arsye, Gjykata arriti në përfundimin se neni 10 kishte qënë shkelur përderisa Gjykata e Lartë në vendimin e saj e kishte lënë në fuqi dënimin e kërkueses dhe e kishte urdhëruar atë të paguante dëmet dhe shpenzimet dhe kjo nuk ishte në përputhje me qëllimin legjitim të ndjekur.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

12. Gjykata i akordoi kërkueses 5 042 euro për dëm jomaterial dhe 1 900 euro për dëm material, si dhe 6 500 euro për pagesa dhe shpenzime procedurale.

## **III. Koment**

13. E drejta për respektimin e jetës private e parashikuara nga neni 8 i Konventës, përfshin të drejtën për respektimin e reputacionit të mirë të një personi. Paragrafi i dytë i nenit 10 lejon kufizime dhe dënime ndaj ushtrimit të së drejtës për lirinë e shprehjes, në qoftë se këto janë të nevojshme, ndër të tjera, për të mbrojtur reputacionin e të tjerëve ose për të ruajtur autoritetin e pushtetit gjyqësor (në lidhje me këtë duhet theksuar se në shumë juridiksione evropiane prokurorët janë konsideruar si pjesë e pushtetit gjyqësor). Mbajtja e një baraspeshe të drejtë ndërmjet neneve 8 dhe 10 është gjithmonë e vështirë. Pjesa më e madhe e rasteve të përmendura kanë patur të bëjnë me gazetarë që kanë qënë sanksionuar, për shkak se kanë përhapur të dhëna në lidhje me gjyqtarë ose policë<sup>216</sup>.

14. Në vendimin shumë të kritikuar të 21 janarit 1999 në lidhje me çështjen “*Janowski kundër Polonisë*”, Gjykata nuk gjeti shkelje të nenit 10 në një rast kur u sanksionuan kritikant publikë ndaj një zyrtari publik. Gjykata, nga ana tjetër, ka qënë shumë më e stepur që të pranojë dënime për kritika të bëra brenda një gjykate. Duke konstatuar shkelje të nenit 10 nga sanksioni i vënë ndaj Znj. Nikula, Gjykata mbajti parasysh jo vetëm nenet 8 dhe 10, por kujtoi gjithashtu se fjalët që kishin çuar pastaj tek sanksioni ishin formuluar gjatë një procesi gjyqësor dhe vuri në dukje se ishte përgjegjësia

<sup>216</sup> Shih për shembull vendimin e Gjykatës të 24 shkurtit 1997 në lidhje me çështjen De Haes dhe Gijssels kundër Belgjikës, dhe të 25 qershorit 1992 në lidhje me çështjen Thorgeirson kundër Islandës, ku policët u përshkruan si “shtazë në uniformë”.

e kryetarit të seancës gjyqësore që të siguronte sjelljen e duhur të palëve dhe se në qoftë se kryetari i seancës, ashtu si edhe në këtë çështje, mban një qëndrim të caktuar mbi këtë sjellje, avokati nuk ka pse të ketë frikë më pas për ndjekje penale. Në Marsin e kaluar Gjykata shqyrtoi një çështje, “A kundër Mbretërisë së Bashkuar”, e cila kishte të bënte me komente tepër shpifëse të bëra në Parlament, një forum i cili gëzon privilegje nga ndjekja penale. Vendimi përkatës pritet ende të jepet nga Gjykata.

## OTTO - PREMINGER - INSTITUT kundër AUSTRISË

(kërkesa nr. 13470/87)

20 shtator 1994

*liria e shprehjes me anë të veprave artistike mund të kufizohet nga autoritetet shtetërore kur këto vepra cenojnë të drejtat e të tjerëve*

### I. Faktet kryesore

1. Shoqata kërkuese Otto-Preminger-Institut für audiovisuelle Mediengestaltung - “OPI” është e vendosur në Insbruk, ku edhe administron një kinema të licencuar. Në këtë kinema ajo kishte për qëllim që të vinte në skenë më 13 maj 1985 filmin e Werner Schroeter, “Das Liebeskonzil”<sup>217</sup>. Sipas fakteve të pranuar përpara Gjykatës, filmi “...portretizonte perënditë e feve hebre, të krishterë dhe myslimane si një plak që i gjunjëzohej djallit dhe shkëmbente me të një të puthur të thellë duke e quajtur mikun e tij... Skena të tjera tregonin Shën Mërinë e cila dëgjonte një histori të turpshme dhe shfaqte një marrëdhënie erotike midis Shën Mërisë dhe djallit. Kurse Jezu Krishti përulej deri në një person me të meta të gradës së fundit”.

2. Pas një kërkesë të dioqezës së Kishës Katolike Romake të Insbrukut, prokurori publik hapi një dosje penale kundër administratorit të shoqatës kërkuese tre ditë përpara shfaqjes së filmit, me akuzën e tentativës së veprës penale “denigrim i mësimëve fetare” (seksioni 188 i Kodit Penal Austriak). Një ditë përpara vënies në skenë të parashikuar, Gjykata Rajonale e Insbrukut urdhëroi bllokimin e filmit, i cili pra nuk mundi të shfaqej në publik. Një apelim i drejtuar nga ana e administratorit të shoqatës kërkuese kundër këtij urdhri nuk u pranua nga Gjykata e apelit e Insbrukut në 30 korrik 1985.

3. Më 24 tetor 1985 procedimi penal ndaj administratorit të shoqatës kërkuese u ndërpre. Procedimi vijues nuk synonte gjetjen fajtor të përgjegjësit, por për sekuestrimin e filmit (*Seksioni 33 i Ligjit për Median*). Më 10 tetor 1986 Gjykata Rajonale e Insbrukut urdhëroi sekuestrimin e filmit, duke vlerësuar se ndërhyrja

<sup>217</sup> Gjermanisht - Këshilli në Parajsë.



e rëndë që ishte bërë ndaj ndjenjave fetare e shkaktuar nga qëndrimi provokues i mbajtur në film kapërcente lirinë artistike të garantuar nga Kushtetuta Austriake. Administratori i shoqatës kërkuese apeloj në Gjykatën e Apelit të Insbrukut e cila mendoi se ai nuk kishte *locus standi*, përderisa ai nuk ishte pronari i së drejtës së autorit të filmit dhe për këtë arsye e deklaroi apelimin e tij të papranueshëm më 25 mars 1987.

4. Në kërkesën e saj të 6 tetorit 1987 drejtuar Komisionit, shoqata kërkuese ankohej në kuadrin e nenit 10 në lidhje me bllokimin e filmit dhe konfiskimin e tij në vijim. Më 12 prill 1991 Komisioni deklaroi kërkesën të pranueshme. Në raportin e tij të 14 janarit 1993 ai shprehu mendimin se ka pasur shkelje të nenit 10 në lidhje me bllokimin (nëntë vota kundër pesë) dhe sekuestrimin (njëmbëdhjetë vota kundër një).

## II. Vendim i Gjykatës

### A. Pretendimet paraprahe të qeverisë

5. Qeveria pretendonte se kërkesa e bërë Komisionit më 6 tetor 1987, nuk ishte paraqitur brenda tetë muajve ashtu si e parashikonte neni 26 i Konventës. Gjykata rikujtoi se ajo i shqyrtonte këto çështje në qoftë se shteti përgjegjës i kishte ngritur në mënyrë të qartë përpara Komisionit. Kjo duhet bërë në shkallën fillestare të pranimit të kërkesës. Megjithatë qeveria kishte cituar rregullën e gjashtë muajve përpara Komisionit, duke iu referuar vetëm vendimit të gjykatës së apelit të Insbrukut të 30 korrikut 1985, por jo vendimit të gjykatës së rrethit të Insbrukut të 10 tetorit 1986 që urdhëronte konfiskimin. Pra ata nuk mund ta ngrinin këtë problem përpara Gjykatës.

6. Argumenti tjetër kryesor i qeverisë si prapësim paraparak ishte se OPI nuk ishte “viktimë” e konfiskimit të filmit, meqë ai kundërshtonte bllokimin e tij. Sipas jurisprudencës së Gjykatës një individ mund të kërkojë me të drejtë të jetë viktimë e një ndërhyrje në ushtrimin e të drejtave garantuara nga Konventa në qoftë se ai ose ajo janë cenuar në mënyrë direkte nga ajo. OPI ka qenë i cenuar në mënyrë direkte nga konfiskimi i filmit, gjë që e bënte të pamundur shfaqjen e filmit në kinemanë e tij të Insbrukut, por në fakt edhe në gjithë Austrinë. Për më tepër bllokimi ishte një masë e përkohshme, legjitimiteti i së cilës ishte konfirmuar nga vendimi i konfiskimit të filmit; të dyja masat nuk mund të ndaheshin. Së fundi, drejtori i OPI-t u shfaq në vendimin e gjykatës rajonale të 10 tetorit 1986 në procedurat e konfiskimit si një “palë përgjegjëse e interesuar e mundshme”. Sipas Gjykatës OPI mund të ankohej me të drejtë si “viktimë” e konfiskimit të filmit si dhe të bllokimit të tij. Ajo vazhdoi, se vendimi përfundimtar lidhur me nenin 26 ishte vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit të Insbrukut të 25 marsit 1987 i cili ishte njoftuar OPI-t më 7 prill. Prapësimet paraprahe të qeverisë u hodhën poshtë.

**B. Në lidhje me nenin 10***i. Nëse ka pasur ndërhyrje në lirinë e shprehjes së OPI-t*

7. Përpara Gjykatës nuk u kundërshtua nëse, objeksionet paraprake ishin hedhur poshtë, të dyja masat e ndalimit dhe të konfiskimit përbënin ndërhyrje me të drejtën e OPI-t për të ushtruar të drejtën e tij të lirisë së shprehjes.

*ii. Nëse ndërhyrja ishte parashikuar nga ligji*

8. OPI pretendonte se ndërhyrja nuk ishte parashikuar nga ligji, dhe ankohej se Seksioni 188 i Kodit Penal Austriak ishte zbatuar në mënyrë të gabuar. Gjykata përsëriti se i përkiste autoriteteve vendase, sidomos gjykatave, të interpretonin dhe zbatonin ligjin e brendshëm. Ajo tha se nuk i qe parashtruar asnjë argument që ta bënte të gjykonte se ligji austriak ishte zbatuar keq.

*iii. Nëse ndërhyrja kishte një “qëllim legjitim”*

9. Siç e ka vënë në dukje Gjykata në vendimin e saj “Kokkinakis kundër Greqisë<sup>218</sup>”, liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, që ndodhet e sanksionuar nga neni 9 i Konventës, përfaqëson një nga themelet e një “shoqërie demokratike” në kuptimin e shprehur nga Konventa. E shprehur në aspektin fetar, ajo përbën një nga elementet më jetësore që kontribuojnë në formimin e identitetit të besimtareve dhe të konceptimit të jetës së tyre. Ata që zgjedhin ushtrimin e lirisë së shfaqjes së fesë së tyre, qofshin pjesëtare të një shumice apo të një pakice fetare, logjikisht nuk presin që të përballen me lloj-lloj kritikash. Ata duhet të tolerojnë e të pranojnë refuzimin nga ana e të tjerëve, e besimeve të tyre fetare madje dhe përhapjen nga ana e të tjerëve, e doktrinave të kundërta me besimin e tyre. Gjithsesi, mënyra se si besimet dhe doktrinave fetare bëhen objekt i një opozite apo i një mospranimi është një çështje që mund të angazhojë përgjegjësinë e shtetit, pikërisht atë përgjegjësi që i siguron ata që i predikojnë këto besime dhe doktrina, të përfitojnë qetësisht nga e drejta e garantuar nga neni 9. Në fakt, në rastet ekstreme përdorimi i metodave të veçanta të kundërvënies dhe të mohimit të këtyre besimeve fetare mund të çojë në atë që njerëzit që i praktikojnë të heqin dore prej tyre dhe prej lirisë së pasjes dhe të shprehjes së besimeve.

*iv. A ishte ndërhyrja e nevojshme?*

10. Në vendimin Kokkinakis, Gjykata mendoi, duke pasur parasysh nenin 9, se një shtet në mënyrë legjitime mund të konsiderojë të nevojshme që të marrë disa masa të cilat synojnë shtypjen e disa formave të sjelljes, duke përfshirë këtu edhe komunikimin e informacioneve dhe ideve që gjykohen si të papajtueshme me respektimin e lirisë së mendimit, të ndërgjegjes dhe të fesë së tjetrit<sup>219</sup>. Në mënyrë legjitime, mund të thuhet se respektimi i ndjenjave fetare të besimtareve ashtu siç garantohet në nenin 9, është shkelur nga shfaqje provokuese ndaj simboleve fetare. Të tilla shfaqje mund të konsiderohen si një dhunim keqdashës i frymës së tolerancës, që duhet të karakterizojë normalisht një shoqëri demokratike. Konventa

<sup>218</sup> Vendim i 25 majit 1993, sidomos paragrafi 31.

<sup>219</sup> Ibid, paragrafi 48.

duhet të lexohet si një e tërë dhe për pasojë, interpretimi dhe zbatimi i nenit 10 në këtë rast duhet të harmonizohet me logjikën e Konventës.

11. Masat për mosmarrëveshje bazohen mbi nenin 188 të Kodit Penal austriak, i cili ka për tendencë t'i eliminojë sjelljet që sulmojnë objektet e kultit dhe që në këtë mënyrë mund të shkaktojnë një "indinjatë të justifikuar". Nga kjo del se synonin mbrojtjen e së drejtës për qytetarët që të mos fyhen në ndjenjat e tyre fetare, për shkak të shprehjes publike të pikëpamjeve të njerëzve të tjerë. Duke pasur parasysh gjithashtu mënyrën se si ishin formuluar vendimet e juridiksioneve austriake, Gjykata pranon se masat e marra dhe për të cilat ishte ngritur akuza, kishin një qëllim legjitim në raport me nenin 10 § 2, domethënë "mbrojtja e të drejtave të tjetrit".

12. Gjithsesi, ashtu siç e konfirmon edhe vete formulimi i paragrafit të nenit 10, cilido ushtron të drejtat dhe liritë e sanksionuara në paragrafin e parë të këtij neni merr përsipër "detyra si dhe përgjegjësi". Midis tyre - në kontekstin e opinioneve dhe besimeve fetare - në mënyrë legjitime mund të përfshihet një detyrim që të shmangen me aq sa të jete e mundur shprehjet fyese pa ndonjë motiv të veçante për tjetrin dhe që përbëjnë pra, një cenim të të drejtave dhe që në këtë mënyrë nuk kontribuojnë në asnjë formë të atij debati publik që mund të favorizojë progresin në çështjet e njerëzimit. Nga kjo del se në parim, mund ta gjykojmë të nevojshme që në disa shoqëri demokratike të sanksionohen, madje edhe të parandalohen sulmet fyese kundër simboleve fetare, por pa harruar që çdo "formalitet", "kusht", "kufizim" apo "sanksion" i detyruar, të përputhet me qëllimin e caktuar.

13. Ashtu sikurse edhe për "moralin" që është një nocion i lidhur me "të drejtat e tjetrit" është shumë e vështirë që të gjesh në të gjithë Evropën një konceptim uniform të domethënies së fesë në shoqëri. Konceptime të tilla mund të ndryshojnë madje edhe në gjirin e së njëjtës shoqëri në të njëjtin vend. Për këtë arsye nuk është e mundur që të arrihet në një përkufizim të kuptueshëm të asaj që përben një cenim të pranueshëm të së drejtës për lirinë e shprehjes kur kjo e fundit ushtrohet kundër ndjenjave fetare të tjetrit. Qysh atëherë, autoritetet kombëtare duhet të kenë një lloj hapësire vlerësimi për të përcaktuar ekzistencën dhe shtrirjen e nevojës së ndërhyrjeve të tilla. Kjo hapësirë vlerësimi, gjithsesi, nuk është e pakufizuar. Ajo shkon bashkë me kontrollin që bëhet në emër të Konventës, dhe rrezja e këtij kontrolli varet nga rrethanat. Në raste si ky në fjalë, ku ka ndërhyrje në ushtrimin e lirive të garantuara në paragrafin 1 të nenit 10, ky kontroll duhet të jete strikt, po të kemi këtu parasysh rëndësinë e lirive në fjalë. Domosdoshmëria e çdo lloj kufizimi duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse.

14. Filmi që u bllokua dhe u sekuestrua sipas vendimeve të gjykatave austriake, konsiston në një pjesë teatrale, por çështja në fjalë lidhet vetëm me prodhimin kinematografik për të cilin po diskutojmë. Në radhë të parë, Gjykata vuri në dukje se, megjithëse mundësia për të parë këtë film që krijoi mosmarrëveshje ishte vetëm me pagesë dhe e ndaluar për disa moshë, filmi u ndoq pavarësisht nga këto, nga një publik i gjerë. Publiku kishte një njohje të mjaftueshme për temën e filmit dhe

të linjave kryesore të tij sa të krijonte një mendim të qartë për natyrën e filmit. Për këto arsye, shfaqja e filmit duhet të konsiderohet si një fakt që përbën një shprehje gjerësisht “publike”.

15. Çështja themelore që po analizonte Gjykata, kërkonte një vënie në peshore të interesave kontradiktore që kane të bëjnë me shprehjen e dy lirive themelore të garantuara nga Konventa; nga një anë, e drejta e Otto - Preminger - Institut që t’i komunikojë publikut ide që ngjallin debate dhe nëpërmjet kësaj, të drejtën, për personat e interesuar, të njihen me këto ide si dhe nga ana tjetër, e drejta e personave të tjerë për respektimin e lirisë së mendimit të tyre, të ndërgjegjes së tyre si dhe të fesë. Kësisoj duhet pasur parasysh hapësira e vlerësimit që gëzojnë autoritetet nacionale të cilat kane gjithashtu për detyrë që brenda kompetencave të tyre të marrin në konsideratë, ashtu siç duhet vepruar në një shoqëri demokratike, interesat e shoqërisë në tërësinë e saj.

16. Duke urdhëruar ndalimin e shfaqjes dhe sekuestrimin e filmit, gjykata austriake, e mbështetur në mënyrën e të kuptuarit të publikut vendas, ka gjykuar që ky film përbënte një sulm fytes kundër fesë katolike romane. Nga vendimet e marra del se autoritetet austriake, sipas të gjitha rregullave kanë mbajtur parasysh lirinë e shprehjes artistike, që i gjen garancitë nenin 10 të Konventës<sup>220</sup> dhe për këtë liri, neni 17 a) i Ligjit themelor parashikonte një mbrojtje të veçantë. Sipas vendimeve të juridiksionit austriak vlera artistike e filmit ose kontributi i tij në zhvillimin e debatit publik në shoqërinë austriake nuk dalin mbi ato veçori që e bëjnë filmin të jetë fytes për publikun që ndjehet i prekur. Në analizë të fundit, pasi e rishikuan gjithë filmin nxorën në pah karakterin provokues të mënyrës sesi përfaqësohej Zoti, Shën Mëria dhe Jezu Krishti. Nuk mund të konsiderohet se përmbajtja e filmit nuk i mbështet konkluzionet në të cilat ka arritur juridiksioni austriak.

17. Gjykata nuk mund të neglizhonte faktin se, feja katolike romane është feja e shumicës dërrmuese të banoreve të Tirolit. Me sekuestrimin e filmit, autoritetet austriake kanë ndërmarrë një veprim që synon gjithashtu të mos lejojë që disa të ndjehen të prekur në ndjenjat e tyre fetare në mënyrë të pamërituar dhe fyese. Në radhe të parë, u përket autoriteteve kombëtare të cilat e dinë me mirë se sa gjyqtari ndërkombëtar, se si mund ta vlerësojnë domosdoshmërinë e masave të tilla. Duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat e këtij rasti. Gjykata nuk mendon se për autoritetet austriake duhet gjykuar se e kanë kapërcyer hapësirën e tyre të vlerësimit ndaj kësaj çështjeje. Për pasojë, as konfiskimi nuk e ka shkelur nenin 10.

### III. Koment

18. Kjo çështje vinte përballë njëra-tjetrës në mënyrë mjaft interesante dy të drejta të parashikuara në dy dispozita të Konventës, të dyja të konsideruara si të drejta të cilësuar. Kështu pra e drejta për lirinë e shprehjes, garantuar nga neni 10 i

<sup>220</sup> Shih vendimin Müller dhe të tjerë kundër Zvicrës, të 24 majit 1988, sidomos § 23.

Konventës, gjente cakun e realizimit të vet në të drejtën për lirinë e besimit dhe fesë, garantuar nga neni 9 i Konventës. Madje ky vendim mund të ishte klasifikuar fare mirë edhe në kuadrin e trajtimit jurisprudencial të nenit 9 në këtë botim, pikërisht për arsye të rëndësisë që ka në lidhje me të drejtën e lirisë së besimit dhe të fesë.

19. Pavarësisht se përmendet edhe në përmbledhjen e mësipërme është mjaft interesante të vihet në dukje se si Komisioni dhe Gjykata nuk ishin të një mendimi në lidhje me aspektin themelor të kësaj çështje – nëse masa e autoriteteve austriake për bllokimin dhe sekuestrimin e filmit ishte apo jo e justifikueshme në bazë të paragrafit 2 të nenit 10 të Konventës. Siç është e qartë tashmë për të gjithë lexuesit, ndërhyrjet ndaj të drejtave të ashtuquajtura të cilësuar, mund të justifikohen vetëm në qoftë se plotësojnë në mënyrë kumulative dhe të njëpasnjëshme kriteret e ligjshmërisë, legjitimitetit, nevojës në një shoqëri demokratike dhe proporcionalitetit. Ishte pikërisht kriteri i karakterit të nevojshëm në një shoqëri demokratike i masës së bllokimit dhe sekuestrimit të filmit që përbënte thelbin e vendimit. Duke përdorur doktrinën e hapësirës së vlerësimit<sup>221</sup>, Gjykata vendosi se të dy këto akte – bllokimi dhe sekuestrimi – mund të justifikoheshin si të nevojshme në një shoqëri demokratike duke qenë të ligjshme dhe duke pasur si qëllim legjitim mbrojtjen e interesave të të tjerëve – ndjenjat e tyre fetare. Në kushtet kur këto ndjenja mbrohen nga ana e nenit 9 § 1 të Konventës, duket se balanca anon akoma më shumë nga justifikimi i masës. Aq më tepër që në kushtet konkrete, Gjykata vlerësoi se rreth 87 % e banorëve të Tirolit ishin katolikë.

<sup>221</sup> Shih shkurtimisht në lidhje me këtë doktrinë në “Të Drejtat e Njeriut në Evropë – Jurisprudencë dhe Komente”, Qendra Evropiane, Tiranë 2001, fq 27.





# NENI 11

## LIRIA E TUBIMIT DHE E ORGANIZIMIT

## SINDIKATA KOMBËTARE E PUNËTORËVE TË HEKURUDHAVE, DETAR DHE TË TRANSPORTIT kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesë nr. 31045/10)

**8 prill 2014**

*ndalimi i grevës mbështetëse të sindikatës së transportit kundër një punëmarrësi,  
i cili nuk ishte palë e mosmarrëveshjes së punës nuk përbën shkelje të nenit 11 të  
Konventës*

### I. Faktet kryesore

1. Sindikata Kombëtare e Punëtorëve të Hekurudhave, Detar dhe të Transportit (RTM), është një sindikatë me bazë në Londër me një anëtarësi prej më shumë se 80 000 persona të punësuar në sektorë të ndryshëm të industrisë së transportit në Mbretërinë e Bashkuar.

2. RMT parashtrori dy ankesa në lidhje me kufizimet ligjore për sa i përket të drejtës së grevës.

3. Kështu së pari, kërkuesi pretendoi se parashikimi në të drejtën e brendshme, për sa i përket organizimit për votimin në lidhje me zhvillimin e grevës, ishte shumë i detajuar dhe e kufizonte këtë veprimtari. RMT solli para Gjykatës shembullin e kompanisë së energjisë EDF, me të cilën kishte pasur mosmarrëveshje në 2009 mbi pagën dhe kushtet e punës. Sindikata bëri thirrje për tu futur në një grevë, por punëdhënësi arriti të merrte një urdhër gjyqësor për mos zhvillimin e grevës, me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte përcaktuar mjaftueshmërisht qartë kategorinë e stafit që do të votonte. Pas dhënies së urdhrit gjyqësor, kërkuesi filloi mbledhjen e përshkrimeve të sakta të punës së punëtorëve në fjalë dhe i përfshiu në njoftimin e ri për votimin në lidhje me grevën, votim i cili përfundoi me një rezultat në favor të zhvillimit të grevës. Greva u zhvillua në dhjetor 2009 dhe në fillim të janarit 2010. EDF bëri një ofertë të përmirësuar më 7 janar 2010, e cila u pranua nga anëtarët e kërkuesit dhe marrëveshja kolektive hyri në fuqi më 1 prill.

4. Pretendimi i dytë i kërkuesit kishte të bënte me faktin se ai nuk kishte të drejtë të zhvillonte greva apo të ndërmernte veprime të tjera sindikaliste mbështetëse. Kjo formë e veprimit sindikalist ishte e kufizuar në Mbretërinë e Bashkuar që prej vitit 1980 dhe konsiderohej i paligjshëm që nga viti 1990. RMT parashtrori shembullin e një situate që përfshinte dy kompani në sektorin e mirëmbajtjes së hekurudhave, i quajtur Hydrex dhe Jarvis. Një grup prej 20 punëtorësh, anëtarët e RMT, u transferuan nga Jarvis tek HYDREX në vitin 2007. Këta punëtorë dolën në grevë,

kur kompania njoftoi dy vjet më vonë se do të ndryshonte, jo në favor të tyre termat dhe kushtet e punësimit, duke i barazuar me ato të punonjësve të saj. Edhe pse kompania e ndryshoi disi qëndrimin e saj, punonjësit votuan për refuzimin e ofertës së rishikuar. Megjithatë, duke qenë se ata ishin shumë të paktë në numër që greva e tyre të kishte ndonjë efekt të dukshëm në kompani, nuk kishin zgjedhje tjetër veçse të pranonin termat dhe kushtet e reja. Sindikata pretendoi se greva ishte joefektive pikërisht për shkak të numrit të vogël të punonjësve që morën pjesë. Ata duhet të kishin organizuar një grevë mbështetëse me punonjësit e firmës Jarvis - edhe pse nuk ishte palë në mosmarrëveshjen e punës - në mënyrë që të rriste presionin mbi HYDREX, por kjo ishte qartësisht e ndaluar me ligj.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesi në kërkesën drejtuar GJEDNJ-së më 1 qershor 2010, pretendoi se kërkesat ligjore të njoftimit të votimit për zhvillimin e grevës dhe mos lejimin e grevave mbështetëse, tregonin ekzistencën e kufizimeve të tepruara mbi lirinë e saj të organizimit në bazë të nenit 11 të Konventës, duke cenuar kështu aftësinë për të mbrojtur interesat e anëtarëve të saj.

### A. Në lidhje me njoftimin për votimin për zhvillimin e grevës

6. Gjykata e shpalli këtë pretendim të papranueshëm pasi nuk kishte asnjë bazë që Gjykata të konstatonte se ishte ndërhyrë në ushtrimin e të drejtave të kërkuesit sipas nenit 11 të Konventës, për më tepër që i ishte kërkuar të përmbushë kërkesa procedurale të përcaktuara në ligj, të cilat i përmbushi me sukses. Faktet e shembullit praktik të dhënë, siç paraqiten nga kërkuesi, tregojnë se edhe pse sindikata pati disa vonesa në marrjen e masave për të mbrojtur interesat e anëtarëve të saj, ajo arriti të zhvillonte një grevë dy muaj më vonë. Ky veprim, me pohimin e vetë kërkuesit, e detyroi EDF të përmirësonte ofertën e saj ndaj anëtarëve të sindikatave, të cilët e pranuan dhe hyri në fuqi menjëherë si marrëveshje kolektive. Ajo konsideroi se çfarë situata e EDF-së tregonte në të vërtetë është në fund të fundit aksion i suksesshëm kolektiv nga kërkuesi në emër të anëtarëve të tij.

### B. Në lidhje me veprimet sindikaliste mbështetëse

7. Për herë të parë, Gjykata duhet të vlerësonte nëse e drejta për zhvillimin e grevës mbështetëse binte në fushëveprimin e nenin 11, siç pretendonte kërkuesi.

8. Së pari, Gjykata vërejtë se veprimet sindikaliste mbështetëse ishin të njohura dhe të mbrojtura nga Konventa nr. 87 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe Karta Sociale Evropiane dhe do të ishte e papajtueshme që Gjykata të miratonte, në lidhje me nenin 11, një interpretim të fushëveprimit të lirisë së organizimit të sindikatave shumë më të ngushtë se ai që mbizotëron në të drejtën ndërkombëtare. Përveç kësaj, një kuptim i tillë i lirisë sindikale gjen mbështetje në praktikën e shumë shteteve evropiane që kanë pranuar prej kohësh grevat mbështetëse si një formë e ligjshme e veprimit sindikal.

9. Mundet që veprimet sindikaliste mbështetëse, për nga natyra e tyre, të jenë një aspekt dytësor më tepër se një aspekt thelbësor i lirisë sindikale, megjithatë, ndërmarrja e veprimeve mbështetëse nga një sindikatë, përfshirë grevat, kundër një punëdhënësi për të mbështetur një mosmarrëveshje ndërmjet anëtarëve të sindikatës së tyre dhe një tjetër punëdhënësi, duhet të konsiderohet si pjesë e aktivitetit sindikal të mbuluara nga neni 11. Kështu Gjykata konkludoi se ndalimi ligjor i veprimeve sindikaliste mbështetëse, siç demonstron nga shembujt e parashtruara nga kërkuesi, përbënin ndërhyrje në të drejtat e kërkuetit sipas kësaj dispozite. Që të ishte në përputhje me paragrafin 2 të nenit 11, një ndërhyrje e tillë duhet të ishte e parashikuar me ligj, të ndiqte një qëllim legjitim dhe të ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur këto qëllime. Gjykata vërejti se ndërhyrja ishte e parashikuar në nenin 224 të Ligjit të vitit 1992 për Marrëdhëniet e Punës dhe Sindikatat.

10. Për më tepër, ndalimi kishte ndjekur qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, i cili përfshinte jo vetëm të drejtat e punëdhënësit në një mosmarrëveshje të punës. Veprimi sindikalist mbështetës kishte potencialin për të cenuar të drejtat e personave që nuk ishin palë në mosmarrëveshjen e punës, për të krijuar çrregullime të mëdha në ekonominë e vendit dhe ndikonte në ofrimin e shërbimeve për publikun, duke sjellë kështu implikime shumë më të gjera se veprimi kryesor.

11. Më tej, Gjykata theksoi se në bazë të Konventës sindikatat duhet të jenë në gjendje, sipas së drejtës kombëtare, të mbrojnë interesat e anëtarëve të tyre. Pra, e rëndësishme ishte shkalla në të cilën kërkuesi kishte qenë në gjendje, në ato rrethana, të mbronte interesat e anëtarëve të saj, pavarësisht ndalimit të zhvillimit të grevës kundër Jarvis. Faktet e çështjes tregojnë se kërkuesi kishte qenë në gjendje për të përfaqësuar anëtarët e tij, të negocionte me HYDREX në emër të tyre dhe të organizonte një grevë në vendin e tyre të punës, megjithëse në një shkallë të kufizuar dhe me rezultate të kufizuara. Ishte dëshira e tij për ta përshkallëzuar grevën, përmes kërcënimit për përfshirjen apo përfshirjen reale të qindra anëtarëve të saj në Jarvis, një tjetër kompani, e cila nuk ishte aspak e përfshirë në mosmarrëveshjen tregtare në fjalë dhe që cenohet në këtë mënyrë. Gjykata vërejti se bindja e kërkuetit se veprimi sindikalist mbështetës do ta kishte kthyer rezultatin në favor të tij mbetj gjithsesi në nivelin e hamendësimeve.

12. Gjykata theksoi se, në këtë fushë të politikave legislative me një ndjeshmëri të njohur, Shteti gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi për rregullimin e lirisë sindikaliste, përfshirë edhe aspekte dytësor të kësaj lirie, si në rastin në fjalë. Kështu, parlamentet e zgjedhur në mënyrë demokratike, në parim janë në një pozicion më të mirë se gjyqtarët ndërkombëtar për të vlerësuar interesin publik dhe se cilat janë masat legislative më të përshtatshme për kushtet e vendit të tyre, me qëllim zbatimin e politikave të caktuara sociale, ekonomike apo sindikaliste.

13. Gjatë kohës së zhvillimit të ngjarjeve, Mbretëria e Bashkuar, bënte pjesë në të

paktat shtete anëtare të BE-së që e ndalojnë veprimin sindikalist mbështetës<sup>222</sup>. Gjithashtu, Gjykata i konsideron vlerësimet negative kundrejt Mbretërisë së Bashkuar, të bëra nga organet përkatëse të monitorimit të ILO-s dhe Kartës Sociale Evropiane jo të një rëndësie të madhe për përcaktimin nëse zbatimi i ndalimit ligjor për grevat mbështetëse në rrethana të tilla, si ato të kundërshtuara në rastin konkret, mbeten brenda gamës së mundësive të lejueshme për autoritetet kombëtare në bazë të nenit 11 të Konventës. Ndalimi i veprimeve sindikaliste mbështetëse ka mbetur i paprekur për më shumë se njëzet vjet, pavarësisht dy ndryshime të Qeverisë gjatë kësaj kohe, çka nënkupton një konsensus demokratik në mbështetje të saj dhe një pranim të arsyeve që qëndrojnë pas saj.

14. Edhe pse kërkuesi parashtrori argumente të fuqishme për solidaritetin sindikalist dhe efikasitetin, këto nuk e bindën Gjykatën se Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar nuk kishte arsyet e mjaftueshme politike dhe faktike për t'a konsideruar ndalimin e kundërshtuar të veprimit sindikalist mbështetës si "të nevojshëm në një shoqëri demokratike".

15. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se në dritën e fakteve specifike të çështjes në fjalë nuk kishte një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e sindikatës për lirinë e organizimit, sipas nenit 11 të Konventës. Për më tepër nuk mund të thuhej se ndalimi i veprimit sindikalist mbështetës, në lidhje me marrëdhëniet e sindikatës me HYDREX, ishte jo proporcional. Kështu, Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 11 të Konventës.

### III. Koment

16. Rasti është i rëndësishëm, pasi Gjykata pranoi se kufizimet e veprimit sindikalist përfshirë grevat mbështetëse ishin të mbrojtura nga neni 11 i Konventës, linte në mënyrë të hapur mundësinë që në rrethana të tjera, ndalimet apo kufizimet e tjera të lirisë sindikaliste, përfshirë gjithashtu dhe veprimet sindikaliste mbështetëse të mos ishin të justifikuar sipas nenin 11 § 2. Por ajo gjithashtu reflekton një prirje të Gjykatës, pasqyruar në vendimet e fundit të saj<sup>223</sup>, për ti lënë Shteteve një hapësirë të gjerë vlerësimi për çështje të politikës sociale që Gjykata i konsideron të ndjeshme.

<sup>222</sup> Sipas një studimi krahasues mbi rregullimin e veprimeve sindikaliste në Evropë (Rregullat e Grevës në BE dhe përtej, Një pasqyrë krahasuese, E. Earneck, Instituti Evropian i Sindikatave për Kërkimin, Edukimin, Shëndetin dhe Sigurinë, 2007), veprimet sindikaliste mbështetëse janë të mbrojtura dhe të lejuara dhe i nënshtrohen kufizimeve dhe kushteve të ndryshme, në shumicën e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Shtetet që, ashtu si Mbretëria e Bashkuar, nuk i lejojnë ato janë Austria, Luksemburgu dhe Holanda.

<sup>223</sup> Vendimi i Dhomës së Madhe në Sindicatul Pastorul cel Bun kundër Rumanisë.

## STANKOV DHE ORGANIZATA E BASHKUAR MAQEDONASE ILINDEN kundër BULLGARISË

(kërkesat nr. 29221/95 & 29225/95)

2 tetor 2001

*kriteret e demokracisë dhe shtetit ligjor janë themelore për të vlerësuar nëse ndalimi i organizimeve dhe tubimeve është i nevojshëm në një shoqëri demokratike*

### I. Faktet kryesore

1. Organizata e Bashkuar Maqedonase Ilinden është një shoqatë që vepron në jug-perëndim të Bullgarisë (në një zonë të njohur me emrin Pirin ose si rajoni gjeografik i Pirin Maqedonia). Kryetari i saj për një periudhë të pasaktësuar ka qenë Iordan Kostadinov Ivanov, shtetas bullgar që jeton në Sandanski, Bullgari. Kërkuesi tjetër quhet Boris Stankov, është shtetas bullgar i lindur më 1926 dhe jeton në Petrich, Bullgari. Në kohën e zhvillimit të ngjarjeve të çështjes ai ishte kryetari i një dege të shoqatës kërkuese.

2. Shoqata kërkuese është themeluar më 1990 me qëllimin për të bashkuar maqedonasit në Bullgari mbi baza rajonale dhe kulturore dhe për të arritur njohjen e minoritetit maqedonas në Bullgari. Më 1991 shoqatës iu refuzua regjistrimi përderisa gjykatat konstatuan se qëllimet e saj reale ishin të drejtuara kundër unitetit të kombit, se ajo nxiste urrejtjen etnike dhe përbënte rrezik për tërësinë territoriale të Bullgarisë.

3. Qëllimi i çështjes së paraqitur përpara Gjykatës ishte i kufizuar në ngjarje ndërmjet 1994 dhe 1997, kur autoritetet ndaluan mbajtjen e tubimeve përkujtimore të organizuara nga shoqata kërkuese dhe Z. Stankov në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend me zhvillimin e ceremonive zyrtare.

### II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesit ankoreshin se ishte shkelur e drejta e tyre për lirinë e tubimit e garantuar nga ana e nenit 11 të Konventës.

#### A. Në lidhje me nenin 11

5. Duke pasur parasysh që neni 11 i Konventës ishte i zbatueshëm në këtë rast, që kishte në mënyrë të qartë një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesve për tubim paqësor, ndërhyrje e cila ishte e parashikuar nga ligji dhe ndiqte një qëllim legjitim, Gjykata u përqendrua në faktin nëse ndërhyrja ishte apo jo e nevojshme në një shoqëri demokratike për arritjen e qëllimit legjitim.



6. Gjykata vuri në dukje se shoqatës kërkuese i ishte refuzuar regjistrimi më 1990 dhe 1991 me arsyetimin se ishte antikushtetuese. Sidoqoftë, ajo vlerësoi se, ndërsa vlerësimet e gjykatave ishin pa dyshim të rëndësishme, një referencë e menjëhershme vetëm në faktin se organizata ishte konsideruar antikushtetuese – dhe për këtë arsye i ishte refuzuar regjistrimi – nuk mund të mjaftonte për të justifikuar në bazë të nenit 11 § 2 të Konventës një praktikë të ndalimit të vazhdueshëm të mbajtjes së tubimeve paqësore. Për këtë arsye Gjykata shkoi më tej për të vlerësuar kriteret e veçanta të referuara nga autoritetet për të justifikuar ndalimet dhe kuptimin e ndërhyrjes ndaj lirisë së kërkuesve për tubim.

7. Gjykata vlerësoi se në qoftë se do të kishte pasur përgatitje për veprime të armatosura, siç u pretendua nga ana e Qeverisë, kjo e fundit duhet të kishte qenë në gjendje të sillte para saj prova shumë më bindëse se sa një artikull gazete dhe një kopje të një fletushke të shpërndarë nga ajri.

8. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se asnjë shqetësim serioz nuk kishte ndodhur gjatë takimeve të mëparshme në të cilat kishin marrë pjesë kërkuesit dhe se askush nuk ishte ndjekur penalisht në vijim të tyre. Rreziku i incidenteve të vogla nga ana tjetër nuk e justifikonte ndalimin e plotë të tubimit.

9. Gjykata konstatoi se autoritetet kishin pasur mundësi që të parandalonin parullat separatiste, që bënin thirrje për autonomi të rajonit të Pirin Maqedonisë, ose edhe për shkëputje nga Bullgaria, në qoftë se të tilla do të ishin menduar të hidheshin nga disa prej pjesëmarrësve. Megjithatë, fakti që një grup bëri thirrje për autonomi ose qofte edhe për shkëputje të një pjese të territorit të vendit – duke kërkuar pra ndryshime thelbësore kushtetuese dhe territoriale – nuk mund të justifikonte në vetvete ndalimin e tubimeve të këtij grupi. Kërkesa për ndryshime territoriale në fjalime dhe demonstrata nuk përbënte në vetvete një kërcënim për tërësinë territoriale dhe sigurimin kombëtar. Thelbi i demokracisë është aftësia e saj për t'i zgjidhur problemet me anë të një debati të hapur. Vendosja e ndalimeve ndaj lirisë së shprehjes dhe tubimit, përveç rasteve të nxitjes së dhunës ose mohimit të parimeve të demokracisë, përbënte një shkelje të demokracisë dhe madje shpesh e vinte atë në rrezik. Në një shoqëri demokratike të bazuar në parimin e shtetit të së drejtës, ideve politike që bëjnë të ndryshojë rendi ekzistues dhe realizimi i të cilave synohet të bëhet me mjete demokratike duhet t'u lejojehet një mundësi shprehjeje ndërmjet ushtrimit të së drejtës së tubimit si dhe me anë të mjeteve të tjera. Gjykata përfundoi me vlerësimin se mundësia e bërjes së deklaratave separatiste nuk justifikonte ndalimin e tubimeve të shoqatës Ilinden.

10. Duke analizuar të gjitha provat përpara saj, Gjykata nuk gjeti ndonjë motiv që të çonte në konkluzionin që takimet po bëheshin në një platformë për propagandimin e dhunës ose rrëzimin e demokracisë në një masë të tillë që të kërkohej ndalimi i tyre. Pjesa më e madhe e deklaratave të Ilinden vinin në dukje bazueshmërinë në debatin publik, presionin politik dhe hidhërinë poshtë shprehimisht dhunën. Deklaratat e shkëputura që dukej se bënin thirrje për dhunë, përmbanin një element ekzagjerimi përderisa kërkonin thjesht të tërhiqnin vëmendjen dhe në çdo rast ato mund të trajtoheshin me një ndjekje penale të personave përgjegjës.

11. Duke pasur parasysh që takimet e Ilinden lindën njëfarë tensioni për shkak se heronj kombëtarë bullgarë u konsideruan si martirë maqedonas, Gjykata konstatoi se fakti që ngjarjet preknin simbole dhe identitetin kombëtar nuk mund të shihej në vetvete si një faktor që justifikonte lënien e një hapësire më të madhe vlerësimi autoriteteve shtetërore. Këto të fundit duhet të bënin kujdes të veçantë që të siguronin që opinioni publik kombëtar të mos mbrohej në kurriz në pikëpamjeve të pakicave pavarësisht se sa jo-popullore ato mund të jenë (kërkuesit kishin vetëm afro 3000 mbështetës).

12. Në vijim Gjykata vuri në dukje se vendi i tubimeve kishte qenë me rëndësi themelore për kërkuesit si dhe për personat e tjerë që kishin marrë pjesë në ceremonitë zyrtare dhe se nuk arriti të tregohej para saj se takimet përkujtimore të kërkuesve nuk mund të ishin zhvilluar në mënyrë paqësore qoftë në të njëjtën kohë qoftë pak kohë më vonë.

13. Si përfundim, Gjykata konstatoi se, përderisa nuk kishte rrezik real dhe të parashikueshëm për veprime të dhunshme, për thirrje për dhunë ose për mosrespektim të parimeve të demokracisë, ndalimi i tubimeve të kërkuesve nuk ishte i justifikueshëm në bazë të paragrafit 2 të nenit 11.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

14. Gjykata u akordoi secilit prej kërkuesve 40 000 franga franceze për dëm jomaterial dhe 36 127 franga franceze për shpenzime dhe pagesa ligjore.

### **III. Koment**

15. Neni 11 i Konventës përfshin dy momente: (1) lirinë e organizimit, që është e drejta që u duhet njohur entiteteve ligjore kur një grup bashkohet në mënyrë vullnetare për çdo qëllim që është në përputhje me Konventën; dhe (2) lirinë e tubimit, që është e drejta e individëve për t'u bashkuar në publik ose në vende private dhe për demonstrime.

16. Gjykata ka njohur shprehimisht që të drejtat në bazë të nenit 11 janë të lidhura ngushtësisht me të drejtën për lirinë e shprehjes së parashikuar në nenin 10. Megjithëse tërësia territoriale nuk është përfshirë shprehimisht si një interes që mund të justifikojë ndërhyrjet ndaj të drejtave të parashikuara në nenin 11, ajo është përfshirë në nenin 10. Në çështjen *Sidiropoulos kundër Greqisë*, të 10 korrikut 1998, Gjykata vendosi se ky interes mund të vlerësohet si një aspekt specifik i sigurimit kombëtar i cili gjendet në nenin 11 § 2. Çështja *Sidiropoulos* u fillua gjithashtu nga një grup minoritar Maqedonas me qëllime të ngjashme me grupin në çështjen që po komentojmë, por kishte të bënte me refuzimin për të regjistruar shoqatën. Ankimi i kërkuesve në çështjen *Stankov* në lidhje me refuzimin e regjistrimit të shoqatës duhet kujtuar se ishte konsideruar nga Gjykata i papranueshëm *ratione temporis* në fazën e pranueshmërisë përderisa vendimi i mos-pranimi datonte përpara ratifikimit të Konventës nga ana e Bullgarisë. Që në atë kohë shoqata ka kërkuar përsëri

regjistrimin i cili i është refuzuar përsëri. Në këtë drejtim është bërë një kërkesë e re për shkelje të së drejtës së organizimit, e cila është në gjykim e sipër nga Gjykata.

17. Pra, kërkesa që është objekt i këtij vendimi ka të bëjë vetëm me të drejtën e tubimit. Ruajtja e rendit publik kërkon shpesh që demonstrimet dhe tubimet e planifikuara kërkojnë njoftim ose edhe autorizim paraprak. Institucionet e Strasburgut kanë vendosur që kjo është në përputhje me Konventën për aq kohë sa qëllimi i shtetit nuk është që të pengojë tubimet paqësore<sup>224</sup>. Çdo ndërhyrje duhet të jetë e parashikuar nga ligji i cili nga ana e tij duhet të jetë i saktë dhe i verifikueshëm. Ndërhyrja duhet që gjithashtu të jetë e nevojshme dhe në përputhje me qëllimin që ndjek. Kur organizatorët e një demonstrate kanë synime të dhunshme, tubimi i tyre është krejtësisht jashtë qëllimit të veprimit të nenit 11 dhe, në qoftë se këto synime mund të provohen, kufizimet ndaj këtyre demonstrimeve janë më se të justifikueshme. Por kur asnjë synim i dhunshëm nga ana e organizatorëve nuk mund të provohet, shteti ka një detyrim prima facie që jo vetëm të lejojë zhvillimin e këtyre tubimeve por gjithashtu edhe të mbrojë pjesëmarrësit në to nga kundër-demonstruesit<sup>225</sup>. Madje ky qëndrim duhet mbajtur edhe kur demonstruesit kanë dhe përkrahin pikëpamje që mund të godasin ose të 'shajnë'. Një mbrojtje e veçantë i jepet pikëpamjeve politike, përfshirë atyre që synojnë shpëputjen nga shteti. Sidoqoftë, Gjykata vuri në dukje në këtë çështje shprehimisht që "të kërkojë të dëbosh të tjerët nga një territor i caktuar mbi bazën e origjinës etnike është një mohim i plotë i demokracisë" dhe theksoi se nxitja e këtyre qëndrimeve është krejtësisht e papranueshme.

## APPLEBY DHE TË TJERËT kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

(kërkesa nr. 44306/98)

6 maj 2003

*në këtë çështje Gjykata vlerësoi si të justifikueshme disa kufizime ndaj lirisë së shprehjes dhe lirisë së tubimit*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit janë Mary Eileen Appleby, shtetase britanike e lindur më 1952, Pamela Beresford, shtetase britanike e lindur më 1966, Robert Alphonsus Guggan, shtetas irlandez i lindur më 1947 dhe një organizatë ambientaliste, Washington First Forum. Tre kërkuesit e parë të cilët jetojnë në Uashington, Tynë, dhe Wear (Angli), krijuan

<sup>224</sup> Shih kërkesën Nr. 8191/78 Rassemblement Jurassien et Unite Jurassienne kundër Zvicrës.

<sup>225</sup> Shih vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të 21 qershorit 1988 në lidhje me çështjen Plattform Artze fur das Leben kundër Austrisë. Natyrisht që në një moment të tillë të shkon mendja në efektin horizontal të zbatimit të Konventës në lidhje me të cilin shih në fq. 32 të botimit "Të Drejtat e Njeriut në Evropë - Jurisprudencë dhe Komente", Tiranë 2001.

Washington First Forum për të bërë fushatë kundër një plani për të ndërtuar në të vetmin park publik natyror pranë qendrës së qytetit të Uashingtonit.

2. Më mars dhe prill 1998 kërkuesit filluan të mbledhnin firma për një peticion që të bindnin Këshillin Bashkiak që ta hidhte poshtë këtë plan. Ata u përpoqën që të ngrinin një stendë për të mbledhur firma në “The Galleries”, një qendër tregtare në Uashington që ishte bërë në fakt qendra e qytetit. Megjithatë ata u ndaluan ta bënin një gjë të tillë nga Postel, një shoqëri private që e kishte blerë pjesën më të madhe të zonës së dyqaneve dhe për këtë arsye, sipas së drejtës së brendshme kishte të drejtë që të mos lejonte askënd të kryente veprimtari të paautorizuara në pronat e veta. Drejtori i njërit prej dyqaneve në qendrën tregtare iu dha kërkuesve të drejtë që ta ngrinin stendën në dyqanin e tij. Megjithatë leja nuk u dha më në prill 1998 kur kërkuesit synuan të mbledhnin firma për një peticion tjetër. Drejtori i qendrës tregtare i vuri në dijeni kërkuesit se leja ishte mohuar për shkak se pronarët e zonës kishin marrë një qëndrim plotësisht neutral në lidhje me të gjitha çështjet politike dhe fetare. Por kërkuesit pretenduan se organizata të tjera ishin lejuar që të mbledhnin firma dhe të ngrinin stenda apo të shpalosnin parulla në mjediset e qendrës tregtare.

## II. Vendimi i Gjykatës

3. Duke u mbështetur në nenin 10 dhe 11, kërkuesit ankoheshin se ata nuk ishin lejuar të mbledheshin në qendrën e qytetit të tyre për të shkëmbyer informacione dhe ide në lidhje me planet e propozuara për ndërtim. Ata ankoheshin gjithashtu, në bazë të nenit 13, se ata nuk kishin pasur një mjet efektiv në bazë të së drejtës së brendshme që të vlerësohej nëse ndërhyrja ndaj së drejtës së tyre ishte apo jo e ligjshme.

### A. Në lidhje me nenet 10 dhe 11

4. Gjykata konstatoi se ndërsa liria e shprehjes ishte një e drejtë e rëndësishme, ajo nuk ishte e pakufizuar. Gjykata u shpreh se duheshin marrë parasysh edhe të drejtat e pronësisë të pronarit të qendrës tregtare. Ajo nuk u bind se duhet të njihen të drejta të drejtpërdrejta për të hyrë në një pronë private ose qoftë edhe pronë publike, por në qoftë se e drejta e pronësisë nënkupton mungesën e ushtrimit efektiv të lirisë së shprehjes, Gjykata nuk do ta përjashtonte mundësinë e lindjes së një detyrimi pozitiv nga ana e shtetit për të mbrojtur gëzimin e të drejtave të njohura nga Konventa duke parashikuar rregullime të posaçme të së drejtës së pronësisë.

5. Megjithatë, në këtë çështje kërkuesit kanë pasur mjete të tjera për t'i përcjellë publikut pikëpamjet e tyre dhe për të bërë këtë gjë nuk ishin penguar në fakt nga kufizimi i ngushtë që u ishte bërë nga ana e pronarit të qendrës tregtare. Pretendimi se ata do të kishin marrë më shumë firma në mbështetje të peticionit të tyre në qoftë se do t'i kishin ngritur stendat në qendrën tregtare, sipas Gjykatës ishte vetëm një spekulim. Sipas Gjykatës qeveria nuk kishte dështuar në respektimin e detyrimeve të saj me karakter pozitiv për mbrojtjen e lirisë së shprehjes së kërkuesve. Vlerësime thuhet të ngjashme u bënë edhe në lidhje me të drejtën e tyre për lirinë e tubimit. Për këtë arsye Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të neneve 10 dhe 11.

**B. Në lidhje me nenin 13**

6. Neni 13 nuk mund të interpretohet sikur kërkon që të ketë një mjet ankimor kundër shtetit në të drejtën e brendshme, përndryshe Gjykata do të kishte kërkuar shteteve palë që ta përfshinin Konventën në sistemin e tyre të brendshëm normativ. Pas 2 tetorit 2000, kur hyri në fuqi Ligji mbi të Drejtat e Njeriut në Mbretërinë e Bashkuar, kërkuarit mund t'i kishin ngritur pretendimet e tyre përpara gjykatave të brendshme. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.

**III. Koment**

7. Gjykata ka deklaruar shpesh se liria e shprehjes gëzon një status të posaçëm në bazë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ajo iu referua asaj si një prej themeleve kryesore të një shoqërie demokratike, ashtu siç edhe është një parakusht për gëzimin e shumë prej të drejtave dhe lirive të tjera të mbrojtura nga ana e Konventës. Megjithatë ajo nuk është një e drejtë absolute – ndaj saj mund të bëhen kufizime që të jenë në përputhje me nenin 10.

8. Kjo çështje u fokusua në detyrimet pozitive të shteteve për të mbrojtur ushtrimin e të drejtave të kërkuarve në bazë të nenit 10 të Konventës nga ndërhyrjet e të tjerëve – në këtë rast nga pronarët e qendrës tregtare. Shumica e gjyqtarëve konstatoi se qeveria nuk kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive të saj në bazë të nenit 10 pasi vuri në baraspeshë të drejtat e kërkuarve nga njëra anë me të drejtat e pronarëve nga ana tjetër. Kujtojmë që “të drejtat e të tjerëve” është një prej qëllimeve legjitime që sipas paragrafit të dytë të nenit 10 mund të justifikojnë kufizimet ndaj lirisë së shprehjes.

9. Gjykata pranoi se zhvillimet demografike sociale, ekonomike dhe teknologjike po ndryshojnë mënyrat me të cilat njerëzit lëvizin dhe hyjnë në marrëdhënie me njëri-tjetrin. Gjyqtari Maruste e zhvilloi edhe më tej këtë mendim në lidhje me privatizimin e pronës publike. Ai dha një mendim të pakicës ku shprehu mendimin se më kot i ishte dhënë përparësi të drejtës së pronës së pronarëve të qendrës tregtare në këtë rast ndaj lirisë së shprehjes dhe të tubimit të kërkuarve. Ai iu referua faktit se qendra e qytetit ishte planifikuar dhe ndërtuar nga një organ i krijuar nga qeveria dhe vetëm në vijim ishte privatizuar. Zona në fjalë ishte tepër e gjerë dhe përfshinte disa shërbime publike me rëndësi të veçantë. Për këto arsye, sipas mendimit të gjyqtarit Maruste, autoritetet publike mbanin disa përgjegjësi për vendimet që merrnin në lidhje me natyrën e zonës dhe me hyrjen në të apo shfrytëzimin e saj. Në vijim ai nënvizonte se nuk mund të pranohej se me anë të privatizimit autoritetet publike mund ta zhvishnin veten e tyre nga çdo përgjegjësi që kishin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjera përveç atyre të pronësisë. Ato duhet të mbanin ende përgjegjësi për të vendosur se si zonat e krijuara prej tyre duheshin përdorur dhe për të siguruar që interesat publikë dhe të drejtat e individëve të respektoheshin në mënyrë të drejtë.

## SIGURDUR A. SIGURJÓNSSON kundër ISLANDËS

(kërkesa nr. 16130/90)

30 qershor 1993

*e drejta e organizimit dhe e krijimit e pjesëmarrjes në sindikata e parashikuar nga neni 11 përfshin gjithashtu lirinë për të mos marrë pjesë në to*

### I. Faktet kryesore

1. Më 24 tetor 1984 kërkuesi i ishte dhënë një licencë për përdorimin e një taksie. Ai pranoi të respektojë Rregulloren përkatëse të Ministrisë e cila parashikonte, *inter alia*, që ai duhej të bëhej anëtar i Shoqatës së Shoferëve të Automjeteve "Frami" (këtë e tutje referuar thjesht "Frami"). Me kërkesën e kësaj të fundit, Sigurdur A. Sigurjónsson iu hoq licenca, në korrik 1986, nga ana e Komitetit të Mbikëqyrjes së Taksive, kryesisht për arsyen se ai nuk kishte paguar më kuotat e anëtarësisë. Ai ndërkaq e kishte vënë paraprakisht në dijeni Frami-n që nuk dëshironte të vazhdonte të ishte anëtar i saj. Kërkuesi u ankua për heqjen e licencës në Ministrinë e Transporteve, e cila gjithsesi konfirmoi vendimin. Në 1 gusht 1986, policia e ndaloi atë në rrugë ndërsa ai qarkullonte në rrugë me automjetin e tij, duke i hequr targat dhe duke e identifikuar automjetin e tij si taksi.

2. Më 17 korrik 1987 Gjykata Civile e Reikjavikut e hodhi poshtë padinë e Sigurdur A. Sigurjónsson për pavlefshmëri të vendimit të heqjes së licencës. Apelit të tij Gjykata e Lartë e Islandës iu përgjigj me vendimin e 15 dhjetorit 1988, se detyrimi për të qenë anëtar i Frami-t nuk ishte në kundërshtim me Kushtetutën Islandeze. Megjithatë ajo e ndryshoi vendimin e Gjykatës Civile të Reikjavikut me arsyetimin se detyrimi i lartpërmendur për anëtarësim në Frami nuk kishte bazë ligjore. Pas kësaj Parlamenti Islandez miratoi një Ligj të ri "Mbi automjetet për përdorim si taksi" i cili hyri në fuqi më 1 korrik 1989, dhe që parashikonte shprehimisht që anëtarësia në sindikatën në fjalë përbën një kusht për dhënien e licencës së shoferit të taksisë. Që nga ky moment, kërkuesi u rianëtarësua në Frami, pavarësisht se në kundërshtim me vullnetin e tij.

3. Sigurdur A. Sigurjónsson i'a paraqiti kërkesën Komisionit më 1990 dhe ky i fundit e konsideroi atë të pranueshme me një vendim të 10 korrikut 1991. Pasi u përpoq të arrinte një zgjidhje me pajtim, Komisioni përgatiti raportin e tij më 15 maj 1992 duke shprehur mendimin se ka pasur shkelje të nenit 11 të Konventës, që nuk kishte nevojë për këtë arsye që të procedohej më tej me shqyrtimin e çështjes edhe nën dritën e neneve 9 dhe 10, dhe që nuk ka pasur në këtë rast shkelje të nenit 13 të Konventës.



## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 11

#### a) Nëse kishte ndërhyrje?

4. Gjykata së pari vlerësoi nëse në rastin e Frami-t kishte të bënte apo jo me një shoqatë në kuptimin e nenit 11 të Konventës. Ajo ishte e mendimit se Frami është para së gjithash një organizim i së drejtës private dhe për këtë arsye duhet të konsiderohet si “shoqatë” në kuptimin e nenit 11. Në vazhdim ajo nuk e vlerësoi të nevojshme të vendoste nëse Frami mund apo jo të konsiderohet si “sindikata” në kuptimin e të njëjtit nen.

5. Qeveria mohonte faktin që e drejta për lirinë e krijimit të shoqatave, e tillë siç ishte interpretuar nga Gjykata në vendimin e saj të 31 gushtit 1981 në lidhje me çështjen *Young, James dhe Webster kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përfshinte edhe të drejtën e kërkuarit që të mos ishte anëtar i Frami-t. Sipas këndvështrimit të saj, një e drejtë e tillë me karakter negativ duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë, duke kujtuar në këtë rast një fjali të punimeve përgatitore të Konventës, të cituar në vendimin e lartpërmendur të Gjykatës, në të cilën thuhet se një rregull i përgjithshme sipas së cilit askush nuk mund të detyrohet të bëjë pjesë në një shoqatë nuk ka qenë përfshirë me qëllim në tekstin e Konventës. Nga ana tjetër kjo çështje që po trajtohej duhej të dallohej nga ajo e vitit 1981.

6. Përsa i përket karakterit të përgjithshëm të së drejtës që po merrte në shqyrtim, Gjykata vuri në dukje se, megjithëse vendimi i lartpërmendur i'u është referuar punimeve përgatitore, ai nuk iu dha një rëndësi vendimtare atyre. Aq më tepër, duke pasur parasysh një konsensus të përgjithshëm ndërmjet shteteve kontraktuese Gjykata kujtoi se Konventa është një instrument i gjallë, që duhet interpretuar “... nën dritën e kushteve të sotme...”.

7. Në rritje është edhe shkalla e konsensusit që del në këtë fushë edhe në planin ndërkombëtar. Siç e vë në dukje Komisioni, në përputhje me nenin 20, pika 2 të Deklaratës Universale, neni 11, pika 2 e Kartës Komunitare të të Drejtave Sociale Themelore të Punonjësve, e adoptuar në dhjetor 1989 nga Kryetarët e Shteteve ose të Qeverive të njëmbëdhjetë vendeve anëtare të Komunitetit Evropian, thotë se “çdo punëdhënës dhe çdo punonjës ka lirinë të anëtarësohet ose të mos anëtarësohet” në organizata profesionale apo sindikale, “pa rrjedhur nga kjo ndonjë dëmtim personal apo profesional për të”. Për më tepër, më 24 shtator 1991 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës votoi në unanimitet një rekomandim i cili kërkonte që të futej një fjali në këtë kuptim në nenin 5 të Kartës Sociale Evropiane të 1961. Megjithë mungesën e klauzolës së thënë shprehimisht, Komiteti i ekspertëve të pavarur i ngarkuar me mbikëqyrjen e realizimit të Kartës vlerëson se ky instrument përfshin një të drejtë negative; ai i ka dizaprovuar shumë herë praktikën e *closed shop* të konstatuara në disa shtete anëtare, ndërmjet të cilëve edhe Islanda. Nga ana tjetër, sipas doktrinës së Komitetit të Lirisë së Shoqatave të Këshillit të Administrimit të Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ZNP), masat e sigurisë sindikale, të parashkruara

nga ligji, pikërisht duke kërkuar me domosdo përkatësinë në një sindikatë, nuk do të përputheshin me Konventën nr. 87 mbi lirinë sindikale dhe mbrojtjen e së drejtës sindikale dhe as me Konventën nr. 98 mbi të drejtën e organizimit dhe të negociatave kolektive.

8. Pra është e nevojshme të konsiderohet që neni 11 sanksionon një të drejtë në sensin negativ të krijimit dhe anëtarësimit në shoqata. Gjykata nuk mendon se duhet vlerësuar për rastin konkret nëse kjo e drejtë ekziston në mënyrë të barabartë me të drejtën pozitive.

9. Nga ana tjetër, në qoftë se detyrimi për t'u anëtarësuar bazohej për zotërinjtë Young, James dhe Webster, mbi një marrëveshje midis punëdhënësit të tyre dhe sindikatave, ajo e Z. Sigurdur A. Sigurjónsson rridhte nga ligji. Sipas formulimit të nenit 5 dhe të nenit 8 të rregullores së 1989, ai nuk mund të fitonte një liçence pune pa u anëtarësuar në një shoqatë të caktuar që quhej Frami; ai nuk e kishte lirinë të zgjidhte një shoqatë tjetër apo të themelonte një të re për këtë qëllim. Për veç kësaj, mos respektimi i këtij kushti mund t'i sillte tërheqjen e liçencës si dhe pagesën e një gjobe. Një anëtarësim i tillë i detyruar që, mund të kujtojmë, ka të bëjë me një shoqatë subjekt të së drejtës private, nuk ndeshet në të drejtën e shumicës dërrmuese të shteteve kontraktuese. Përkundrazi, shumë sisteme të brendshme japin garanci që, në një mënyrë apo në një tjetër, mbrojnë lirinë e shoqatës në aspektin e saj negativ, domethënë, lirinë për të mos u anëtarësuar ose për t'u tërhequr.

10. Duke vazhduar t'i referohet rrethanave konkrete të rastit në shqyrtim, Gjykata nuk u bind nga argumenti i qeverisë sipas së cilit kërkuesi kishte pranuar vetë t'i bashkohej Frami-t. Sipas fakteve, nevoja për t'u anëtarësuar nuk doli qartë veçse me hyrjen në fuqi, më 1 korrik 1989 të Ligjit të ri "Mbi automjetet për përdorim si taksí" kur anëtarësimi u bë kusht për marrjen e liçencës. Qysh atëherë, kërkuesi ka qenë i detyruar të mbetet anëtar i Frami-t, sepse pa këtë anëtarësim ai mund të rrezikonte humbjen e liçencës sikurse e tregon në mënyrë krejt të dukshme heqja e saj më 1986. Në këtë rast, një tip i tillë shtrëngimi prek vetë thelbin e së drejtës që mbron nenin 11 dhe përbën në vetvete një ndërhyrje ndaj kësaj lirie.

11. Për më tepër pretendimet z. Sigurdur A. Sigurjónsson bazohen pjesërisht mbi mosaprovimin nga ana e tij të politikës së ndjekur nga shoqata e lartpërmendur, e cila është për shkurtimin e numrit të taksive duke kufizuar kësisoj mundësinë për të zbatuar këtë profesion; sipas tij, liritë personale, duke përfshirë aty edhe lirinë e ushtrimit të profesionit. Gjykata vlerëson se mund të shqyrtojë këtu nenin 11 nën dritën e nenit 9 dhe të nenit 10: mbrojtja e opinioneve personale bën pjesë në objektivat e lirisë së shoqatave që ai garanton dhe në lidhje me këtë pikë ajo i referohet vendimit *Young, James dhe Webster* të përmendur më lart. Presionet e ushtruara mbi kërkuesin për ta shtrënguar që të rrijë në shoqatën Frami përfaqësojnë një element shtesë që ka të bëjë me vetë thelbin e një të drejte të shprehur në nenin 11; kësisoj, edhe aty ka pasur ndërhyrje. Argumenti që nxjerr qeveria dhe që ka të bëjë me karakterin politik të Framit nuk është me vend në këtë drejtim.

b) Nëse ndërhyrja është e justifikuar në bazë të paragrafit 2 të nenit 11

12. Nuk pati kundërshtime në lidhje me faktin se, në lidhje me kohën e fakteve që merren në shqyrtim, pra pas 1 korrikut 1989, anëtarësimi i kundërshtuar ishte “në përputhje me ligjin” dhe respektonte një qëllim të ligjshëm që ishte “mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të tjerëve”. Por nga ana tjetër u kundërshtua fakti i “nevojës në një shoqëri demokratike” që paraqiste kjo masë.

13. Sipas mendimit të Gjykatës, detyrimi për anëtarësim, i kërkuar nga ligji, ishte një formë detyrimi që, në pamje të parë, duhej të konsiderohej e papajtueshme me nenin 11. Gjykata nuk vuri në dyshim se Frami luante një rol që i shërbente interesit publik dhe anëtarësimi i çdo të licencuari në të synonte pikërisht përmbushjen me sukses të këtij roli. Megjithëse argumentet e ofruara nga ana e Qeverisë mund të konsideroheshin si të rëndësishme, ato nuk ishin të mjaftueshme që të tregonin se ishte e “nevojshme” që të detyrohej kërkuesi të anëtarësohej në Frami në kundërshtim me opinionet e tij personale sepse përndryshe do të humbiste licencën e shoferit të taksisë. Në mënyrë të veçantë, pavarësisht nga hapësira e vlerësimit të Islandës, masat e kundërshtuara ishin jo në proporcion me qëllimin e ligjshëm që ato ndiqnin. Për këto arsye Gjykata gjeti në lidhje me këtë çështje, me tetë vota kundër një, shkelje të nenit 11 të Konventës.

#### **B. Në lidhje me nenet 9 dhe 10**

14. Duke qenë se nenet 9 dhe 10 janë marrë në shqyrtim në kuadrin e nenit 11, Gjykata me unanimitet arriti në përfundimin se nuk ishte e nevojshme që ato të merreshin në shqyrtim veçmas për të parë nëse kishte apo jo shkelje të tyre.

#### **C. Në lidhje me nenin 13**

15. Me unanimitet, Gjykata mendon se nuk ka vend që ajo të shqyrtojë *ex officio* nëse ka apo jo shkelje të nenit 13 të Konventës, përderisa kërkuesi kishte pranuar përfundimin e Komisionit në këtë pikë për mospasje të ndonjë shkeljeje.

#### **D. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)**

16. Gjykata i akordoi me unanimitet kërkuesit 2 134 401 korona islandeze për shkak pagesave pranë instancave gjyqësore dhe shpenzimeve gjatë procedurave në Strasburg, duke hequr shumat e paguara ndërkaq për ndihmë juridike. Megjithatë ajo hodhi poshtë pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesit në lidhje me nenin 50, për një shpërblim të drejtë.

### **III. Koment**

17. Vendimi paraqet një rëndësi të madhe për faktin se sqaron kuadrin e një konceptimi negativ të lirisë së pjesëmarrjes në shoqata dhe organizata – pra të lirisë për të zgjedhur pjesëmarrjen ose jo në një organizim të caktuar<sup>226</sup>. Megjithëse qeveria

<sup>226</sup> Siç del edhe nga përmbledhja jonë (paragrafi 5) ky konceptim negativ i lirisë së parashikuar nga neni 11 § 1 i Konventës është diskutuar për herë të parë nga Gjykata në vendimin e 31 gushtit 1981 në lidhje me çështjen Young, James dhe Webster kundër Mbretërisë së Bashkuar.

islandeze ashtu si edhe gjyqtari islandez Thor Vilhjalmsson i cili votoi kundër vendimit të shumicës, duke iu referuar edhe travaux préparatoires të Konventës, u shprehën se aspekti negativ i të drejtës së parashikuar në nenin 11 § 1 duhet interpretuar tepër ngushtë, shumica e Gjykatës pranoi detyrimi për të bërë pjesë një shoqatë kundër dëshirës së personit përbën ndërhyrje të nenit 11 § 1 dhe për aq sa nuk justifikohet në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, përbën edhe shkelje të tij. Megjithëse Gjykata ishte e përmbytur në lidhje me përcaktim e një marrëdhënieje mes elementit pozitiv dhe atij negativ të kësaj të drejte, në mënyrë të qartë ajo pranon se e drejta për lirinë e tubimit dhe organizimit vesh një aspekt negativ.

18. Vendimi ka vlerë edhe për faktin se Gjykata, në konkluzionin që sapo përmendëm, arriti me anë të një interpretimi evolues të dispozitave të Konventës. Në paragrafin 6 të përmbledhjes së mësipërme theksohet se Gjykata e interpreton Konventën nën dritën e kushteve aktuale duke e konsideruar atë si një instrument që duhet t'iu përshtatet këtyre kushteve gjatë ndryshimit të tyre. Një element tjetër që bie në sy në këtë vendim të Gjykatës për qëllimin e arritjes së përfundimit të saj të lartpërmendur. Gjykata përdor referenca të gjera tek e drejta e shteteve të tjera anëtare të Konventës, por edhe në instrumente të tjerë ndërkombëtarë në lidhje me të drejtat ekonomike dhe sociale.

19. Një aspekt tjetër interesant i këtij vendimi është dallimi që bën Gjykata midis organizimeve me karakter privat dhe atyre me karakter publik duke futur si kriterë themelore të përcaktimit:

- (i) Formën e ligjit ose së drejtës mbi bazë të së cilës janë krijuar organizmat përkatës;
- (ii) Shkallën e kontrollit ose të ndikimit shtetëror mbi këta organizma;
- (iii) Masën në të cilën organizmat ofrojnë shërbime publike.

20. Në këtë mënyrë Gjykata i jep organizimeve të tilla një konceptim autonom duke kufizuar mundësinë e shteteve në klasifikimin dhe eventualisht në regjistrimin ose lejimin e aktivitetit të tyre<sup>227</sup>.

<sup>227</sup> Shih në këtë botim në lidhje me këtë problem sidomos vendimet e Gjykatës të 2 tetorit 2001 në lidhje me çështjen Stankov dhe Organizata e Bashkuar Maqedonase Ilinden kundër Bullgarisë dhe në vijim vendimin e 8 dhjetorit 1999 në lidhje me çështjen Partia e Lirisë dhe e Demokracisë (ÖZDEP) kundër Turqisë dhe vendimin e Dhomës së Madhe të 13 shkurtit 2003 në lidhje me çështjen Refah Partisi dhe të tjerë kundër Turqisë.

## MAESTRI kundër ITALISË

(kërkesa nr. 39748/98)

17 shkurt 2004

Dhomë e Madhe

*ky vendim i Dhomës së Madhe kishte të bënte me lirinë e organizimit të gjyqtarëve*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Angelo Massimo Maestri, është shtetas italian i cili ka lindur më 1944 dhe jeton në Itali. Ai është gjyqtar dhe kur bëri këtë kërkesë ai ishte kryetar i Gjykatës së Rrethit të La Speccias.

2. Në nëntor 1993, në bazë të Dekretit Mbretëror të 31 majit 1946, ndaj tij filloi procedimi disiplinor për shkak se kishte qenë anëtar i një grupimi Masonik<sup>228</sup> nga viti 1981 deri në mars 1993.

3. Në një vendim të 10 tetorit 1995 seksioni disiplinor i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) konstatoi se kërkuesi e kishte kryer shkeljen për të cilën akuzohej dhe i dha një vërejtje. Seksioni disiplinor deklaroi se qenia e një gjyqtari Freemason binte në kundërshtim me rregullat disiplinore për shkak të papajtueshmërisë ndërmjet betimit gjyqësor dhe atij masonik, marrëdhënien hierarkike ndërmjet Freemasonëve, mospranimin e shtetit të së drejtës në favor të drejtësisë Masonike dhe natyrën e pazgjdhshme të lidhjes ndërmjet Freemasonëve. Ai iu referua gjithashtu direktivave të dhëna nga KLD-ja në mars 1990 dhe korrik 1993, të cilat theksonin papajtueshmërinë ndërmjet anëtarësimit në grupimet Freemason dhe në pushtetin gjyqësor. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Kasacionit por kërkesa e tij u hodh poshtë me një vendim të 20 dhjetorit 1996.

4. Sipas Z. Maestri, karriera e tij kishte ngelur në vend që kur ndaj tij ishin marrë masat disiplinore.

### II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesi pretendoi se marrja e një mase ndaj tij për faktin se ishte Freemason përbënte shkelje të neneve 9, 10 dhe 11 të Konventës. Gjykata Evropiane e të Drejtave

<sup>228</sup> Freemasonët ose Masonikët janë grupime mes personash normalisht me një pozitë shoqërore të caktuar të cilët ndajnë me njëri-tjetrin parime të miqësisë, të ndihmës reciproke dhe që organizohen dhe funksionojnë në mënyrë të fshehtë mbi bazën e riteve të caktuara.

të Njeriut vlerësoi se ankesat e kërkuetit ishin kryesisht në kuadrin e nenit 11 të Konventës. Për pasojë ajo i mori në shqyrtim ato vetëm në kuadër të këtij neni.

#### *A. Në lidhje me nenin 11*

6. Gjykata vlerësoi se ka pasur një ndërhyrje ndaj së drejtës së kërkuetit për lirinë e organizimit, të mbrojtur nga ana e nenit 11. Duke vlerësuar nëse ndërhyrja ka qenë parashikuar me ligj Gjykata ritheksoi se masa që përbën ndërhyrje duhet të ketë një bazë në të drejtën e brendshme dhe të mund të parashikohet dhe të gjendet nga individët e interesuar.

7. Në këtë drejtim Gjykata theksoi se neni 18 i Dekretit të vitit 1946, i interpretuar në dritën e Ligjit nr. 17 të vitit 1982 mbi të drejtën e organizimit dhe të Direktivës të KLD-së së vitit 1990 në lidhje me këtë qëllim, ka qenë dispozita ligjore e përdorur si bazë për masën që ishte marrë ndaj kërkuetit.

8. Duke pasur parasysh cilësinë e ligjit, në vështrim të parë Gjykata vlerësoi se neni 18 i dekretit të vitit 1946 ishte i hapur për personat e interesuar përderisa ishte publik dhe kërkueti, duke pasur parasysh profesionin e tij, mund ta kishte marrë vesh fare kollaj ekzistencën e tij. Së dyti, në lidhje me parashikueshmërinë e ligjit, pra nëse dispozitat normative italiane ishin formuluar me saktësi të mjaftueshme saqë një gjyqtar ta kishte të qartë se nuk mund të bënte pjesë në grupime Freemasonë, Gjykata vlerësoi se duhej bërë një dallim ndërmjet dy periudhave: ajo përpara miratimit nga KLD-ja të direktivës së parë të 22 marsit 1990 dhe periudha pas këtij miratimi.

9. Në lidhje me periudhën nga viti 1981 deri në mars 1990 Gjykata vlerësoi se neni 18 nuk i përmbushte kushtet e parashikueshmërisë dhe se, edhe pse Italia kishte miratuar një ligj më 1982 në lidhje me të drejtën e tubimit, kërkueti nuk mund ta parashikonte se anëtarësimi i një gjyqtari në një grup Masonik përbënte shkak për marrjen e masave disiplinore ndaj tij.

10. I njëjti qëndrim ishte i vërtet për periudhën nga miratimi i direktivës në mars 1990 deri në mars 1993. Megjithëse direktiva në fjalë ishte miratuar në kuadrin e shqyrtimit të çështjes së anëtarësimit të gjyqtarëve në grupime Masonike, debati në gjirin e KLD-së më tepër synonte të konstatonte sesa të zgjidhte një problem. Gjykata vendosi se perifrazimi i direktivës nuk ishte i qartë sa duhej që, pavarësisht se kërkueti ishte gjyqtar, t'i mundësonte atij të kuptonte se anëtarësimi në një grup Masonik mund të çonte në marrjen e masave dhe sanksioneve disiplinore ndaj tij. Vlerësimi i Gjykatës u konfirmua nga fakti se vetë KLD-ja e kishte parë të arsyeshme t'i rikthehej këtij problemi në korrik 1993 dhe të deklaronte në terma të qartë që ushtrimi i funksioneve gjyqësore ishte i papajtueshëm me anëtarësimin në grupime Masonike.

11. Për këtë arsye Gjykata vendosi se ndërhyrja nuk ishte parashikuar me ligj, duke pasur parasysh këtu kriteret e formulimit që duhet të plotësojë një akt për t'u quajtur i tillë. Pra ka pasur shkelje të nenit 11 të Konventës.



**B. Në lidhje me nenin 41**

12. Gjykata i akordoi kërkuetit, me njëmbëdhjetë vota kundër gjashtë, 10 000 euro për dëm jomaterial dhe 14 000 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

**III. Koment**

13. Ishte e qartë se në këtë rast kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkuetit për liri të organizimit. Shumica e gjyqtarëve në Dhomën e Madhe vlerësuan se kjo ndërhyrje kishte një bazë në të drejtën e brendshme dhe se ligji përkatës ishte i hapur për të gjithë. Pas këtij shqyrtimi u fokusua në aspektin e parashikueshmërisë së ligjit, pra të kushtëzimit që një subjekt i së drejtës duhet t'u bëjë akteve të veta duke pasur parasysh rregullimin përkatës dhe sanksionet në qoftë se ai nuk e bën një gjë të tillë.

14. Shumica e gjyqtarëve vlerësuan se nuk kishte qenë e mundur që kërkueti gjatë periudhës në fjalë të parashikonte se anëtarësimi në grupet Masonike të përbënte një shkelje me karakter disiplinor, qoftë përpara qoftë pasi KLD-ja të kishte miratuar direktivën e parë pas shqyrtimit të këtij problemi.

15. Verdikti i shumicës u kritikua ashpër nga dy mendime të pakicës me të cilat u bashkuan në total gjashtë gjyqtarë. Mendimi i parë në pakicë kritikonte përjasjen e Gjykatës në lidhje me interpretimin e së drejtës së brendshme, duke argumentuar se kjo ishte hera e parë që Gjykata kishte vendosur të mos mbante fare parasysh interpretimin unanimit të së drejtës italiane të bërë nga autoritetet më të larta italiane, në vend që të analizonte nëse e drejta italiane, ashtu siç ishte parashikuar dhe interpretuar nga autoritetet shtetërore, ishte apo jo në përputhje me Konventën. Sipas këndvështrimit të tyre, ky vendim e përjashton plotësisht parimin e subsidiaritetit i cili është themelor në zbatimin siç duhet të Konventës.

16. Mendimi i dytë në pakicë fokusohet në faktin se një qartësi dhe parashikueshmëri absolute mund të mos ishte e mundur në të gjitha fushat, dhe sidomos në atë të etikës dhe masave disiplinore.

## REFAH PARTISI DHE TË TJERË kundër TURQISË

(kërkesat nr. 41340/98, 41342/98, 41343/98, dhe 41344/98)

13 shkurt 2003

### Dhomë e Madhe

*ky vendim i Dhomës së Madhe ka të bëjë me shpërndarjen e një partie politike në Turqi*

#### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi i parë, Refah Partisi (Partia e Mirëqenies) ishte një parti politike ndërsa kërkuesit e tjerë ishin liderë të kësaj Partie dhe anëtarë të parlamentit në kohën e ngjarjeve për të cilat bëhet fjalë në këtë çështje.

2. Më 1997 Këshilltari i Parë Shtetëror pranë Gjykatës së Kasacionit filloi përpara Gjykatës Kushtetuese procedurat për shpërndarjen e Refah Partisi, të cilën ai e akuzonte se ishte bërë "një qendër aktivitetesh të drejtuara kundër parimit të laicitetit". Në mbështetje të kërkesës së tij, ai u bazua në akte dhe deklarata të ndryshme të udhëheqësve dhe anëtarëve të Refah-ut, të cilat sipas tij nxirrnin në pah se disa prej objektivave të partisë, të tilla si futja e shariatit dhe e një regjimi teokratik, ishin të papajtueshme me kërkesat e një shoqërie demokratike. Këto pretendime u kundërshtuan nga përfaqësuesit e Refah-ut.

3. Më 1998 Gjykata Kushtetuese vendosi që Refah Partisi të shpërndahej duke argumentuar që ajo ishte bërë një "qendër aktivitetesh kundër parimit të laicitetit". Ajo deklaroi gjithashtu që pasuritë e partisë t'i kaloheshin thesarit. Gjykata Kushtetuese vendosi në vijim se deklaratat publike të udhëheqësve të Refah-ut kishin angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjegjësinë e kësaj të fundit në lidhje me kushtetutshmërinë e aktiviteteve të saj. Për pasojë, ajo i ndaloi ata që të merrnin pjesë në punimet e Parlamentit ose të mbanin poste politike për një periudhë prej pesë vjetësh.

#### II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesit ankoheshin në bazë të nenit 11 të Konventës për shkelje të së drejtës së tyre për lirinë e organizimit.

##### A. Në lidhje me nenin 11

5. Gjykata vlerësoi se një parti politike mund të bëjë fushatë për një ndryshim ligjor ose në strukturat kushtetuese ose ligjore të një shteti duke respektuar dy kushte: së

pari, mjetet e përdorura për këtë qëllim duhet të jenë ligjore dhe demokratike në çdo aspekt; së dyti, ndryshimi i propozuar duhet që në vetvete të jetë i pajtueshëm me parimet themelore demokratike. Për pasojë duhet të jetë e qartë se një parti politike liderët e së cilës nxisin dhunën ose parashtrajnë një program politik i cili nuk respekton një ose disa rregulla të demokracisë ose që synon shkatërrimin e demokracisë dhe mosrespektimin e të drejtave dhe lirive të njohura në një demokraci, nuk mund të pretendojnë të kenë mbrojtjen e Konventës ndaj sanksioneve të vëna për arsyet e sapo përmendura.

6. Megjithatë, kur bëhet fjalë për parti politike, përjashtimet e parashikuara në nenin 11 duhen kuptuar në mënyrë të ngushtë – vetëm arsye tepër bindëse dhe të pamohueshme mund të justifikojnë kufizimet e lirisë së organizimit ndaj këtyre partive. Për këtë arsye, në përcaktimin e ekzistencës së domosdoshmërisë, në kuptimin e paragrafit 2 të nenit 11, Shtetet Palë kanë vetëm një hapësirë të kufizuar vlerësimi.

7. Në vijim Gjykata vlerësoi se kushtetuta dhe programi i një partie politike nuk mund të merren për bazë si kriteri i vetëm për të përcaktuar objektivat dhe synimet e partisë. Gjykata ka vënë gjithmonë në dukje se programi politik i një partie politike mund të fshehë objektiva dhe misione të ndryshme nga ato që ajo shpall. Për të verifikuar që nuk ka një ndryshim të tillë duhet që përmbajtja e programit të krahasohet me veprimet e udhëheqësve të partisë dhe me qëndrimet që ata mbajnë ose mbrojnë.

8. Gjykata konstatoi se aktet dhe fjalimet e anëtarëve të Refah Partisi të cituara nga Gjykata Kushtetuese i ngarkoheshin të gjithë partisë, që këto akte dhe fjalime bënë pjesë në politikën afatgjatë të Refah-ut për të ngritur një regjim të bazuar në sheriatin në kuadrin e një shumëllojshmërie sistemesh ligjore dhe se Refah-u nuk e përjashtonte mundësinë e përdorimit të forcës me qëllim që të vinte në jetë politikën e saj ashtu edhe për të mbajtur në këmbë sistemin e programuar. Duke pasur parasysh se këto plane vijnë në kundërshtim me konceptin e një “shoqërie demokratike” dhe se mundësitë konkrete që Refah kishte për t'i vënë ato në praktikë e rrezikonin demokracinë në mënyrë reale dhe madje imediate, sanksioni i vënë ndaj kërkuesve nga ana e Gjykatës Kushtetuese, edhe në kontekstin e një hapësire të kufizuar vlerësimi që shteti kishte, në mënyrë të arsyeshme mund të konsiderohej se përmbushte kriterin e një “nevoje të ngutshme shoqërore”. Për këto arsye, pra, nuk ka pasur shkelje të nenit 11 të Konventës.

### III. Koment

9. Çështja që po trajtohet vlen të krahasohet me atë të *Partisë së Lirisë dhe Demokracisë (Özdep) kundër Turqisë*, në lidhje me të cilën, më 8 dhjetor 1999, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 11 për shkak se Gjykata Kushtetuese Turke kishte urdhëruar shpërndarjen e Partisë Özdep. Gjykata nuk mundi të gjejë asgjë në programin e Partisë Özdep që mund të konsiderohej si një thirrje për përdorimin e dhunës, si një

kryengritje apo ndonjë formë tjetër të shmangies nga parimet demokratike. Programi përfaqësonte qëllimin e krijimit të një rendi shoqëror që përfshinte popullin turk dhe atë kurd. Në atë rast, Gjykata mbajti pikëpamjen se ndonëse një projekt politik i tillë ishte konsideruar i papajtueshëm me parimet dhe strukturat aktuale të shtetit turk, kjo nuk do të thoshte se ai shkelte rregullat e demokracisë. Në fakt, lejimi i propozimit dhe debatimit të projekteve të ndryshme politike, edhe i atyre që vinin në pikëpyetje mënyrën e caktuar të organizimit të një shteti, qëndron në vetë thelbin e demokracisë, me kusht që ata nuk kërkonin të dëmtonin vetë demokracinë. Kurse në çështjen e Refah Partisi Gjykata vlerësoi se politika e saj ishte e papajtueshme me konceptin e “shoqërisë demokratike” dhe konstatoi se kufizimi i lirisë së organizimit ishte, për këtë arsye, i justifikuar.

# NENI 13

**E DREJTA PËR ANKIM EFEKTIV**

## EGMEZ kundër QIPROS

(kërkesa nr. 30873/96)

21 dhjetor 2000

*kur autoritetet shtetërore nuk veprojnë pas një ankese të bërë tek ombudsmani shkelin nenin 13 të Konventës dhe nuk mund të pretendojnë mos-shërim të mjeteve të brendshme ankimore*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Erkan Egmez, lindur më 1966 dhe banues në veri të Qipros (territor që nuk kontrollohet nga qeveria qipriote) është shtetas britanik me origjinë turko-qipriote.

2. Një grup policësh të anti-drogës shkoi të arrestonte z. Egmez në një pikë hyrjeje pranë zonës së ndalimit që ndan Qipron e veriut nga ajo e jugut. Ai rezistoi dhe u përpoq të ikte por u kap nga dy policë me të cilët edhe u përlesh. Njëri prej tyre e qëllloi z. Egmez në kokë me armë zjarri, i dyti e përplasi përtokë ndërsa një i tretë i vuri prangat. Z. Egmez u çua në stacionin e policisë dhe më pas në spital, ku kontrollet mjekësore nxorën në pah djetje të shumta si dhe dëmtime të tjera.

3. Pas një seance që u zhvillua të nesërmen, kërkuesi u vendos në gjendje arresti. Një kontroll vijues mjekësor nga ana e mjekut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nxori në pah gjithashtu dëmtime të shumta. Megjithatë një hetim i kryer nga ana e policisë arriti në përfundimin se këto dëmtime ishin bërë gjatë arrestimit dhe që forca e përdorur kishte qenë e domosdoshme dhe në proporcion për arritjen e qëllimit. Kërkuesi u ankua tek Ombudsmani, duke pretenduar se ai i ishte nënshtruar një sulmi të paprovokuar dhe të dhunshëm nga ana e disa policëve gjatë arrestimit të tij dhe se në vijim ishte torturuar. Ombudsmani arriti në përfundimin se kërkuesi ishte keqtrajtuar gjatë arrestimit dhe gjatë çuarjes së tij në stacionin e policisë. Megjithatë, ndaj policisë nuk ishin filluar procedime penale apo të ndonjë lloji tjetër.

### II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesi u ankua se ai kishte qenë rrëmbyer me forcë dhe torturuar nga autoritetet e Republikës së Qipros dhe nuk ishte vënë në dijeni në lidhje me arsyet e arrestimit të tij, se nuk ishte çuar menjëherë përpara një gjyqtari, se nuk kishte pasur mundësi të kishte një rivlerësim të masës së marrë ndaj tij, që sipas tij ishte e paligjshme. Gjithashtu, ai pretendoi se nuk kishte pasur mundësitë e shfrytëzimit të një ankimi efektiv përpara gjykatave vendase. Ai bazohej në nenin 3, nenin 5 §§ 1, 2, 3 dhe 4, nenin 6 § 1 dhe nenin 13 të Konventës.



### A. Në lidhje me nenin 3

#### a. Mbi pretendimet paraprake

5. Qeveria pretendonte se ankimi i kërkuesit në bazë të nenit 3 nuk duhej pranuar sepse ai nuk kishte shteruar rrugët e brendshme. Megjithatë, Gjykata e hodhi poshtë pretendimin paraprak të qeverisë me arsyetimin se kërkuesi i kishte shteruar mjetet e brendshme duke u ankuar tek Ombudsmani. Por ndërsa një ankim tek Ombudsmani nuk ishte në parim një ankim që duhej shteruar, duke e bërë një të tillë kërkuesi ka bërë, që vëmendja e autoriteteve të drejtohej ndaj pretendimeve të tij. Nga ana tjetër nga momenti që Prokurori i Përgjithshëm ishte bërë gati t'i konsideronte ato si të besueshme, mund të thuhej se kërkuesi kishte ngritur një pretendim të arsyeshëm. Autoritetet gjendeshin nga ky moment nën detyrimin për të bërë një hetim të plotë dhe efektiv, të tillë që të ishte në gjendje të çonte në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës.

6. Megjithëse, hetimi i Ombudsmanit hapi rrugën e fillimit të një procedimi penal, Prokurori i Përgjithshëm nuk ndërmori asnjë veprim. Autoritetet pa u menduar gjatë, nxituan të prezumonin se kërkuesi nuk do të bashkëpunonte me to dhe nuk lejuan fillimin e një procedimi efektiv. Megjithëse nuk kishte vend për të dyshuar në lidhje me efektivitetin e hetimit të Ombudsmanit, duhet thënë se ai nuk kishte kompetenca për të urdhëruar marrjen e masave ose vendosjen e sanksioneve.

7. Për këto arsye Gjykata vlerësoi se për shkak të detyrimit të posaçëm që Konventa ka krijuar për autoritetet shtetërore në rastet e pretendimeve të bazuara mbi nenin 3, kërkuesi, duke u ankuar pranë Ombudsmanit është çliruar nga detyrimi i tij në bazë të nenit 35 § 1 i Konventës sipas së cilit shteti përkatës gëzon një mundësi që t'i zgjidhë çështjet brenda sistemit të tij gjyqësor përpara se të detyrohet që të përgjigjet përpara një instance ndërkombëtare për aktet e tij. Mënyra e vetme për të zgjidhur siç duhej çështjen në fjalë ishte fillimi i ndjekjes penale ndaj oficerëve të policisë të përzier në ngjarje. Në këtë zgjidhje duhet të kishte çuar normalisht ankimi tek Ombudsmani. Për këto arsye pretendimi paraprak i qeverisë nuk u pranua.

#### b. Mbi ekzistencën e shkeljes së nenit 3

8. Gjykata kujtoi se edhe në rrethanat më të vështira, të tilla si lufta kundër krimit të organizuar, Konventa e ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimet çnjerëzore ose degraduese. Me qëllim që të përcaktohet në se një formë e veçantë keqtrajtimi duhet cilësuar si torturë, Gjykata duhet të mbajë parasysh dallimin ndërmjet këtij nocioni dhe atij të trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Me anë të një dallimi të tillë Konventa i kushton një kujdes të veçantë konstatimit të trajtimeve çnjerëzore, që shkaktojnë vuajtje serioze.

9. Qeveria ka pranuar që, në momentin e arrestimit të kërkuesit dhe menjëherë pas tij, oficerët e policisë e kishin keqtrajtuar atë me qëllim, keqtrajtim, që nuk kishte qenë i nevojshëm në rrethanat e çështjes. Gjithsesi, Gjykata vlerësoi se nuk u vërtetua se synimi i policëve kishte qenë që ta bënë kërkuesin të tregonte ndonjë të dhënë apo të jepte ndonjë informacion. Dëmtimet ishin shkaktuar brenda një periudhe të

shkurtër të ngarkuar me tensione dhe emocione në rritje. Gjykata nuk mund të mos mbante parasysh, nga ana tjetër, mungesën e qartësisë në lidhje me karakterin e rëndë të dëmtimeve, që i ishin shkaktuar kërkuesit. Kjo paqartësi ishte shkaktuar pjesërisht nga “retushimi” i fotografive që ishin paraqitur bashkë me formularin e kërkesës dhe kërkuesi nuk kishte bërë asgjë për t’u kundërshtuar këtë gjë përpara Gjykatës. Gjykata vuri në dukje si përfundim se nuk ishin paraqitur përpara saj prova bindëse të cilat të tregonin se keqtrajtimi në fjalë ka pasur ndonjë pasojë afatgjatë për kërkuesin.

10. Si përfundim Gjykata mbajti qëndrimin se keqtrajtimi të cilit kërkuesi i ishte nënshtruar nuk mund të cilësohet torturë. Megjithatë keqtrajtimi ishte aq serioz sa të konsiderohej çnjerëzor dhe prandaj kemi të bëjmë me shkelje të nenit 3 të Konventës.

#### ***B. Në lidhje me nenin 5 § 1***

11. Gjykata konstatoi se kërkuesi ishte arrestuar mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm të kryerjes së veprës penale të trafikimit të drogës dhe prandaj kjo dispozitë nuk ishte shkelur.

#### ***C. Në lidhje me nenin 5 § 2***

12. Kërkuesi ishte vënë menjëherë në dijeni dhe në një gjuhë që ai e kuptonte në lidhje me arsyet e arrestimit të tij dhe mbi të gjitha veprat për të cilat akuzohej. Pra as kjo dispozitë nuk ishte është shkelur.

#### ***D. Në lidhje me nenin 5 § 3***

13. Seanca e mbajtur ditën vijuese të arrestimit të kërkuesit siguroi që ky ishte çuar në mënyrë të menjëhershme përpara një gjyqtari, pra në përputhje me dispozitën e këtij paragrafi.

#### ***E. Në lidhje me nenin 5 § 4***

14. Në vijim të seancës së zhvilluar një ditë pas arrestimit të kërkuesit, ligjshmëria e masës së sigurimit të marrë ndaj tij ishte rivlerësuar në dy raste të tjera, një herë automatikisht dhe një herë mbi bazën e një kërkesë për lirim. Pra, nuk kemi të bëjmë me shkelje të kësaj dispozite.

#### ***F. Në lidhje me nenin 13***

15. Gjykata iu referua përsëri konstatimit të saj në lidhje me shterimin nga ana e kërkuesit të mjeteve të brendshme mbi bazën e vlerësimeve vijuese, kërkuesi duke u ankuar tek Ombudsmeni u ka dhënë autoriteteve mundësinë për t’u zgjidhur çështjen siç duhej duke urdhëruar një hetim, që të mund të çonte në identifikimin dhe dënimin e policëve përgjegjës. Kjo ishte në fakt mënyra e vetme e përshtatshme si përgjigje ndaj shkeljes për të cilën ishte bërë ankimi. Megjithatë, Prokurori i Përgjithshëm, që ishte zyrtari i ngarkuar me fillimin e ndjekjes penale, nuk kishte ndërmarrë asnjë hap në këtë drejtim. Gjykata arriti në përfundimin se në këtë rast ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës.

G. Në lidhje me nenin 6 § 1

16. Gjatë jurisprudencës së saj Gjykata e ka konsideruar gjithmonë të arsyeshme që t'i shqyrtojë pretendimet mbi mungesën e mjeteve gjyqësore në lidhje me rastet e keqtrajttimeve nën dritën e nenit 13, prandaj nuk e sheh të arsyeshme që ta vlerësojë çështjen edhe në kuadrin e nenit 6 § 1.

H. Në lidhje me nenin 41

17. Gjykata i akordoi kërkuarit 10 000 sterlina për dëm jo-pasuror dhe 400 sterlina për shpenzimet dhe pagesat ligjore.

### III. Koment

18. Ky vendim i rëndësishëm ka të bëjë me një incident që ndodhi në një situatë të nderë etnike dhe politike të ishullit të ndarë të Qipros. Kjo situatë ka qenë objekt i disa çështjeve ndërshtetërore dhe i një çështjeje të nisur nga një individ, çështje shumë e njohur<sup>229</sup>. Pjesa më e madhe e këtyre çështjeve kanë qenë në lidhje me pretendimet e shkeljeve të kryera nga ana e autoriteteve turke në Qipron e Veriut. Ky rast ka të bëjë me keqtrajtimin e një turko-qiprioti (banues në të ashtuquajturën Republikë Turke të Qipros së Veriut) nga ana e policisë së Qipros Greke në një pikë kalimi pranë “zonës së ndaluar” që ndan ishullin.

19. Kjo çështje ngre disa probleme të rëndësishme në lidhje me ankimet e brendshme në pikëvështrimin e Konventës. Neni 13 kërkon ankime “efektive” në nivel shtetëror për shkeljet e pretendueshme në bazë të Konventës. Neni 35 u kërkon individëve të shterojnë të gjitha ankimet e brendshme përpara se të dërgojnë një kërkesë në Strasburg. Çështja se çfarë përbën një ankim efektiv ka qenë objekt i një jurisprudencë të bollshme në GJEDNJ. Avokatët duhet të jenë të kujdesshëm në vlerësimin e faktit se ky vendim nënkupton që një ankim tek Ombudsmeni kënaq kërkesën e nenit 35 të Konventës.

20. Ombudsmeni është një institucion jashtë-gjyqësor, që i ka fillesat në Suedi dhe që është bërë gjithnjë e më popullor vitet e fundit në përpjekjet që bën për një administratë publike të efektive dhe të përgjegjshme. Sidoqoftë, meqenëse ai si institucion nuk mund të parashtrojë në mënyrë të detyrueshme prova ose vendime, ankimi pranë Ombudsmanit nuk është konsideruar përgjithësisht një ankim efektiv që kënaq detyrimet e shtetit në kuadrin e nenit 13 (megjithëse mund të bëjë pjesë në një “mekanizëm ankimor” i cili i vlerësuar në tërësi mund të konsiderohet sikur e përmbush kërkesën e një ankimi efektiv). Gjykata vlerëson *a fortiori*, që ai nuk është një ankim që duhet shteruar përpara se një rast të çohet në Strasburg. Në çështje të tjetra si *Tumelovich kundër Federatës Ruse*, Gjykata ka vënë në dukje se një ankim i ngjashëm – rishikimi mbikëqyrës nga ana e prokurorit – i cili ishte më tepër diskrecionar sesa një detyrim ligjor, nuk përbën një ankim efektiv. Kur një ankim është konsideruar si joefektiv nga ana e Gjykatës së Strasburgut, përdorimi i tij

<sup>229</sup> Bëhet fjalë për çështjen Loizidou kundër Turqisë.

mund të jetë fatal për çuarjen e kërkesës më pas në Strasburg sepse mund ta vendosë kërkuesin jashtë afatit përfundimtar të kërkuar prej gjashtë muajsh (në rastin Egmez ankimi pranë Komisionit ishte paraqitur brenda gjashtë muajve nga ngjarja dhe një muaj përpara se Ombudsmani të bënte raportin e tij, kështu që kjo çështje nuk u ngrit). Normalisht, përderisa janë konsideruar një mjet jo-efektiv, hetimet dhe përfundimet e Ombudsmanit nuk përbëjnë një “vendim përfundimtar” për qëllimet e fillimit të afatit prej gjashtë muajve të zbatueshëm në bazë të nenit 35 të Konventës ndaj të gjitha kërkesave.

21. Vlerësimi i ankimit tek Ombudsmani si një ankim efektiv në përputhje me qëllimet e nenit 35 në rastin në fjalë përbën një precedent të guximshëm. Gjykata donte të bënte të qartë që kërkuesi kishte bërë gjithçka ishte e mundur për të dhe që i kërkohej nga ana e nenit 3 të Konventës dhe të kundërshtonte kështu pretendimet e qeverisë për një refuzim për bashkëpunim për arsye politike. Në qoftë se vëmendja e autoriteteve shtetërore është thirrur në lidhje me pretendime serioze në kuadrin e nenit 3 – në këtë rast vlerësimet e Ombudsmanit për keqtrajtim shkojnë përtej pretendimeve të thjeshta – ato nuk duhet të ngelen në pasivitet sepse barra a ndjekjes së personave përgjegjës atëherë ju bie atyre dhe jo personit të dëmtuar (shih gjithashtu nenet 11-13 të Konventës kundër Torturës së OKB-së).

22. Kështu mund të arrihet në përfundimin se në qoftë se një ankim tek Ombudsmani në këto rrethana është vlerësuar si mënyrë për të përmbushur kërkesën e shterimit të ankimeve të brendshme, atëherë ai konsiderohet si një ankim që duhet shteruar përpara se çështja të dërgohet në Strasburg. Një përfundim i preferueshëm, në këtë rast, do të ishte ai i vlerësimit të Ombudsmanit si mekanizmi i përshtatshëm për paraqitjen e një ankimi zyrtar në lidhje me trajtimin në trajtim e sipër, një mekanizëm që mund dhe duhet të kishte vënë në lëvizje ndjekjen penale kundër policëve përgjegjës. Autoritetet Qipriote nuk mund të lejoheshin për këtë arsye pra që të pretendonin mos-shterimin e ankimeve të brendshme në bazë të nenit 35 të Konventës. Nuk është e mundur as që ato, ashtu si autoritetet e qeverive të tjera, të jenë në gjendje të përdorin mos-ankimin tek Ombudsmani si mburojë për të kundërshtuar një kërkesë pranë Strasburgut në qoftë se organe të tjera shtetërore po vepronin në lidhje me keqtrajtimin e pretenduar. Kjo pikëpamje mbështetet nga konstatimet e Gjykatës për shkelje nga ana e Qipros edhe të nenit 13 të Konventës, përderisa hetimi dhe konstatimet e Ombudsmanit nuk mund të përbënin veprime të afta për identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës. Në vijim të jurisprudencës paraardhëse, Gjykata mori vendimin që do ta vlerësonte çështjen në bazë të nenit 13 dhe jo të nenit 6 të Konventës. Për rrjedhojë, ne nuk mund ta dimë se cili mund të kishte qenë mendimi i saj në lidhje me ankimin e kërkuesit për pamundësi të shfrytëzimit të sistemit gjyqësor në Qipro, përderisa çka kërkon normalisht neni 13 është pikërisht një mjet gjyqësor.

# NENI 14

## NDALIMI I DISKRIMINIMIT

## SALGUEIRO DA SILVA MOUTA kundër PORTUGALISË

(kërkesa nr. 33290/96)

21 dhjetor 1999

*një prind nuk mund të ndalohet të takohet me vajzën e tij pas ndarjes nga bashkëshortja për shkak të orientimit të tij seksual*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, João Manuel Salgueiro Da Silva Mouta, shtetas portugez, ka lindur më 1961 dhe jeton në Portugali.
2. Ai ndalohej nga ish-gruaja e tij që të vizitonte vajzën e tij M., e cila shkelte kështu një marrëveshje që ishte lidhur ndërmjet tyre në kohën e divorcit. Kërkuesi pretendoi nxjerrjen e një urdhri që t'i jepte atij kujdestarinë prindërore të fëmijës. Më 1994 Gjykata e Çështjeve Familjare e Lisbonës ia plotësoi kërkesën duke nxjerrë një urdhër të tillë. M. jetoi me kërkuesin, pra me të atin, deri më 1995 kur, sipas pretendimit të këtij të fundit, vajza u rrëmbye nga e ëma. Në Gjykatën e Apelit kujdestaria e vajzës iu dha nënës, ndërsa kërkuesit iu dha e drejta për takime me vajzën, por që ky pretendonte se nuk kishte mundësi ta ushtronte këtë të drejtë në mënyrën që ajo përcaktohej në urdhrin e kësaj gjykate. Gjykata e Apelit e Lisbonës parashtrroi dy argumente për këtë qëndrim të sajën që i jepte kujdestarinë e fëmijës nënës: së pari ajo përmendi interesin e fëmijës dhe së dyti faktin që kërkuesi ishte homoseksual dhe se jetonte me një burrë tjetër.

### II. Vendimi i Gjykatës

3. Kërkuesi ankohej për një ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën e tij për respektim të jetës së tij private dhe familjare, të garantuara nga neni 8 dhe për diskriminim, në kundërshtim me nenin 14 të Konventës. Ai pretendonte gjithashtu se, në kundërshtim me nenin 8, ai ishte detyruar nga Gjykata e Apelit e Lisbonës që të fshihte homoseksualitetin e tij kur shkante të takonte vajzën e tij.

#### *A. Në lidhje me nenin 8 të marrë së bashku me nenin 14*

4. Gjykata theksoi që në fillim se në bazë të jurisprudencës të organeve të Konventës Neni 8 gjente zbatim në lidhje me vendimet që njihnin kujdestarinë prindërore të një fëmije njërit prej prindërve në rast divorci apo ndarje mes këtyre. Vendimi i Gjykatës së Apelit të Lisbonës përbënte një ndërhyrje ndaj së drejtës së kërkuesit për respektim të jetës së tij familjare përderisa kishte prishur vendimin e Gjykatës së Çështjeve Familjare të Lisbonës që i njëjtte përgjegjësinë prindërore kërkuesit.



5. Gjykata vijoi duke nënvizuar se megjithëse Gjykata e Apelit kishte marrë parasysh interesat e fëmijës duke vendosur të prishte vendimin e Gjykatës së Çështjeve Familjare të Lisbonës, ajo kishte mbajtur parasysh gjithashtu një faktor të ri, pikërisht atë që kërkuesi ishte homoseksual dhe jetonte me një burrë tjetër. Për këtë arsye mund të thuhet se ka pasur një ndryshim në trajtim ndërmjet kërkuesit dhe nënës së M., nocion që binte në fushën e zbatimit të nenit 14 të Konventës. Në bazë të këtij neni një ndryshim i tillë trajtimi ishte diskriminues në qoftë se ai nuk kishte justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, pra në qoftë se ai nuk ndiqte një qëllim të ligjshëm ose në qoftë se nuk kishte një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohej të realizohej.

6. Në marrjen e këtij vendimi Gjykata e Apelit kishte ndjekur një qëllim legjitim, pikërisht atë të mbrojtjes së shëndetit dhe të të drejtave të fëmijës. Me qëllim që të vendoste nëse mungonin bazat e arsyeshme për marrjen e vendimit në fjalë, Gjykata shqyrtoi nëse faktori i ri që ishte marrë si kriter nga Gjykata e Apelit e Lisbonës – homoseksualiteti i kërkuesit – ishte thjesht një *obiter dictum* pa ndonjë peshë të drejtpërdrejtë mbi vendimin përfundimtar, apo në të kundërt, ishte një faktor përcaktues. Për këtë qëllim Gjykata iu referua vendimit të Gjykatës së Apelit të Lisbonës dhe vuri re se pasi kjo kishte vlerësuar se nuk kishte arsye të mjaftueshme për të privuar nënën nga ushtrimi i kujdestarisë prindërore – pasi vetë prindërit kishin rënë dakord për këtë – ajo ishte shprehur se: “...edhe në qoftë se do të kishte pasur arsye për ta privuar nënën, ne mendojmë se asaj i duhet dhënë kujdestaria e fëmijës”. Duke u shprehur kështu Gjykata e Apelit kishte vënë re se kërkuesi ishte homoseksual dhe jetonte me një burrë tjetër dhe kishte deklaruar: “fëmija duhet të jetojë në ... një familje tradicionale portugeze” dhe “nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse homoseksualiteti është një sëmundje apo një orientim seksual drejt njerëzve të njëjtit seks. Sidoqoftë, ai është një anomalitet dhe fëmijët nuk duhet të rriten në hijen e situatave anormale”.

7. Gjykata ishte e mendimit se këto pasazhe nga vendimi i Gjykatës së Apelit të Lisbonës të bënin të mendoje se homoseksualiteti i kërkuesit kishte qenë përcaktues në marrjen e vendimit përfundimtar duke përbërë një dallim në bazë të faktorëve që kishin të bënin me orientimin seksual të kërkuesit. Një dallim i tillë nuk ishte i lejueshëm të bëhej në bazë të Konventës. Ky përfundim mbështetej nga fakti se, në marrjen e vendimit për të drejtën e takimeve, Gjykata e Apelit e kishte këshilluar kërkuesin që gjatë takimeve të mos sillej në mënyrë të tillë që vajza të kuptonte se ai jetonte me një burrë tjetër “njësoj sikur të ishin burrë e grua”.

8. Për këto arsye Gjykata arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 8 të marrë së bashku me nenin 14.

#### ***B. Në lidhje me nenin 8 të Konventës të marrë më vete***

9. Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme të merrte një vendim në lidhje me pretendimin e shkeljes së Nenit 8 të marrë më vete përderisa çështja në lidhje me këtë pikë ishte, në thelb, i njëjtë me atë të vlerësuar në bazë të Neneve 8 dhe 14 të marrë së bashku.

**C. Në lidhje me nenin 41**

10. Kërkuesi kërkoi “shpërblim të drejtë” por dështoi në përcaktimin sasior të pretendimit të tij. Në këto rrethana, Gjykata vendosi se konstatimi i shkeljes ishte në vetvete shpërblim i drejtë për dëmin e pretenduar. Nga ana tjetër ajo i akordoi kërkuesit 2 150 000 peseta për shpenzime dhe pagesa procedurale ligjore.

**III. Koment**

11. Në kohën kur është hartuar Konventa aktet homoseksuale përbënin vepra penale kudo në Evropë. Për këtë qëllim Gjykata ka theksuar në mënyrë të përsëritur se Konventa është një instrument i gjallë dhe se jurisprudenca e saj nuk është statike por “dinamike dhe evoluese” dhe duhet t’u përgjigjet ndryshimeve të qëndrimeve shoqërore. Së pari Gjykata bëri të qartë se ishte në kundërshtim me konceptin e jetës private të mbrojtur nga Konventa që të penalizoheshin qëndrimet private të homoseksualëve të rritur dhe të ndërgjegjshëm<sup>230</sup>. Marrëdhëniet homoseksuale janë konsideruar gjithmonë si aspekt i jetës private dhe jo i saj familjare. Por në rastin që po marrim në shqyrtim, në mënyrë tepër interesante, situata është në kufirin ndërmjet marrëdhënies së jetës familjare ndërmjet babait (kërkuesit) dhe së bijës dhe marrëdhënies së jetës private ndërmjet po atij dhe partnerit të tij.

**KUOA POIRREZ kundër FRANCËS**

(kërkesa nr. 40892/98)

**30 shtator 2003**

*diskriminimi mbi baza shtetësie në lidhje me trajtimin financiar të invalidëve përbën shkelje të Konventës*

**I. Faktet kryesore**

1. Ettien Laurent Koua Poirrew është shtetas i Bregut të Fildishtë, i lindur më 1966 dhe që jeton në rajonin e Parisit. Ai u adoptua nga një shtetas francez më 1987.

2. Z. Koua Poirrez ka vuajtur nga një sëmundje e rëndë fizike që kur ishte shtatë vjeç. Autoritetet franceze i dhanë një dokument që vërtetonte se ai ishte 80% invalid. Më 1990 Zyra e Mbështetjes së Familjeve refuzoi t’i akordonte atij trajtimin financiar të një invalidi madhor me arsytimin se ai nuk ishte shtetas francez dhe se nuk kishte ndonjë marrëveshje dypalëshe ndërmjet Francës dhe Bregut të Fildishtë në lidhje me një trajtim të tillë. Kërkuesi e kundërshtoi këtë qëndrim përpara gjykatave franceze por pa sukses.

<sup>230</sup> Shih vendimet e Gjykatës në lidhje me çështjet Dudgeon kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Norris kundër Irlandës.

3. Pas miratimit të ligjit të 11 majit 1998 i cili e hiqte kushtin e shtetësisë për përfitimin e trajtimeve jo-kontributive, kërkuesi bërë një kërkesë të re për të pasur një trajtim të një invalidi madhor (T.I.M.) i cili iu akordua në qershor 1998.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkuesi ankohej për shkelje të Nenit 14 (ndalimi i diskriminimit) të Konventës të marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës) për shkak të refuzimit të autoriteteve franceze për t'i akorduar atij një trajtim të një invalidi madhor (T.I.M.). Ai ankohej gjithashtu në bazë të nenit 6 § 1 (e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm) për kohëzgjatje të procesit vijues gjyqësor.

### A. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

5. Gjykata vendosi se një përfitim jo-kontributiv i një lloji si T.I.M. hyn në fushën e zbatimit të një të drejte me karakter pasuror për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1. Fakti që vendi i origjinës së kërkuesit nuk kishte nënshkruar një marrëveshje reciproke – ndërkohë që vetë kërkuesit i ishte dhënë një dokument që vërtetonte invaliditetin e tij, jetonte në Francë, ishte djali i adoptuar i një shtetasi francez i cili kishte jetuar dhe punuar në Francë dhe, së fundi, kishte përfituar paraprakisht një trajtim minimal social – nuk mund të justifikonte refuzimin që atij t'i paguhej trajtimi i pretenduar TIM. Në vijim, kriteri i shtetësisë si kusht për akordimin e këtij përfitimi ishte shfuqizuar me ligjon e 11 majit 1998 dhe kërkuesit i ishte akorduar T.I.M. menjëherë pas miratimit të këtij ligji. Për këtë arsye Gjykata vlerësoi se kërkuesi kishte pasur një të drejtë me karakter pasuror për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1 dhe se neni 14 i Konventës gjente gjithashtu zbatim duke pasur parasysh kriterin që përdorej si justifikim për mosakordimin e TIM.

6. Gjykata vuri re se nuk kishte ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për dallimin në trajtim ndërmjet shtetasve francezë ose shtetasve të vendeve të kishin nënshkruar marrëveshje dypalëshe dhe të huajve të tjerë. Edhe pse në kohën e ngjarjeve Franca nuk kishte ndonjë marrëveshje dypalëshe me Bregun e Fildishtë, duke ratifikuar Konventën ajo kishte marrë përsipër t'i siguronte çdokujt brenda juridiksionit të saj – dhe këtu hynte padyshim edhe kërkuesi – të drejtat dhe liritë e parashikuara në Seksionin I të Konventës. Për këtë arsye Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës të marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit 1.

### B. Në lidhje me nenin 6

7. Përsa i përket ankimit për kohëzgjatje të tepërt të procedurave përpara gjykatave të brendshme, Gjykata vuri re se ato kishin zgjatur shtatë vjet, shtatë muaj dhe nëntë ditë për të tre nivelet e juridiksionit. Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes ajo vendosi se këto procedura nuk i kishin kaluar kërkesat e konceptit të afatit të arsyeshëm të parashikuar në nenin 6 § 1 dhe arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të këtij neni.

**C. Në lidhje me nenin 41**

8. Gjykata i akordoi Z. Koua Poirrez 20 000 euro për dëmin e pësuar dhe 3 000 euro pagesa dhe shpenzime ligjore.

**III. Koment**

9. Duke u mbështetur edhe në Rekomandimin R (92) 6 të Komitetit të Ministrave, ky vendim i rëndësishëm në lidhje me të drejtat ekonomiko shoqërore përforcon këndvështrimin e mbajtur nga ana e Gjykatës në vendimin e 16 shtatorit 1996 në lidhje me çështjen Gaygusuz kundër Austrisë sipas të cilit edhe një përfitim me karakter jokontribues, si për shembull TIM mund të përbënte një të drejtë me karakter pasuror për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1.

10. Një ligj i cili i ndalonte personat që në mënyrë të ligjshme jetonin në Francë dhe të adoptuar nga shtetas franceze që të përfitonin nga trajtimi në fjalë me argumentimin se ata nuk kishin shtetësinë franceze shkelte nenin 1 të Protokollit 1 të marrë së bashku me nenin 14 të Konventës. Ndërkohë që Gjykata është shprehur gjithmonë se Konventa nuk përfshin edhe të drejtën për të gëzuar një shtetësi të caktuar<sup>231</sup> jurisprudenca po përparon ngadalë në një drejtim që ngushton pasojat e dëmshme të statusit të të huajit që për një kohë të gjatë banon në një vend pa marrë shtetësinë e këtij vendi<sup>232</sup>. Gjykata duket se iu kushton vëmendje të veçantë pretendimeve të qeverive se një diskriminim justifikohet nëse ai, pas ndryshimeve legislative, shfuqizohet.

11. Me një mendim tepër interesant në pakicë, Gjyqtari Mularoni (San Marino) vlerësoi se kërkesa duhet të ishte shqyrtuar edhe në bazë të nenit 8 të Konventës si çështje e dinjitetit personal të mbrojtur nga aspekti i jetës private të atij neni.

**FABRIS kundër FRANCËS**

*(kërkesa nr. 16574/08)*

**21 korrik 2011**

**Dhomë e Madhe**

*të drejtat e trashëgimit midis vëllezërve dhe motrave brenda dhe jashtë martesë*

**I. Faktet kryesore**

1. Kërkuesi, Henry Fabris, u lind në vitin 1943. Në kohën e ngjizjes së tij nëna e tij ishte martuar me Z. M., me të cilin ajo kishte dy fëmijë. Në vitin 1970 Z. dhe Znj

<sup>231</sup> Shih vendimin e saj të 9 tetorit 2003 në lidhje me çështjen Slivenko kundër Letonisë.

<sup>232</sup> Shih në këtë drejtim vendimin e 26 shtatorit 1997 në lidhje me çështjen Mehemi kundër Francës.

M. nënshkruar një akt të ndarjes së pasurisë *inter vivos* duke e ndarë pronën e tyre ndërmjet dy fëmijëve të tyre të lindur prej martesës.

2. Në vitin 1983 - kur ai ishte 40 vjeç z. Fabris u shpall ligjërisht fëmija "jolegjitim" i zj. M. Pas vdekjes së nënës së tij në vitin 1994, ai kërkoi shfuqizimin e aktit të ndarjes të pasurisë *inter vivos*, duke pretenduar se i takonte një pjesë e barabartë pasurie me atë që u takonte fëmijëve të tjerë të nënës së tij. Gjykata vendase vendosi në vitin 2004 në favor të tij në bazë të neneve 8 dhe 14 të KEDNJ-së.

3. Fëmijët e lindur nga martesë e zj. M, apeluan dhe Gjykata e Apelit vendosi më 14 shkurt 2006 prishjen e vendimit të gjykatës më të ulët me arsyetimin se, sipas ligjit të vitit francez të 1972, pasuritë *inter vivos* të ndara para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk mund të kundërshtoheshin dhe në rastin konkret akti i ndarjes *inter vivos* ishte nënshkruar në vitin 1970. Sipas Gjykatës së Apelit, kishte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm për këtë rregull në dritën e qëllimit legjitim të ndjekur, domethënë, garantimin e marrëdhënieve paqësore familjare duke siguruar të drejtat të përfituara në atë kontekst - ndonjëherë të përfituara prej shumë kohësh.

4. Një akim nga kërkuesi për shkak të ligjit u rrëzua në vitin 2007 nga Gjykata e Kasacionit, e cila vërejtë se, në bazë të dispozitave kalimtare të ligjit të datës 3 dhjetor 2001, të drejtat e reja trashëgimore të fëmijëve "të lindur nga shkelja e kurorës" ishin të zbatueshme vetëm në lidhje me trashëgimin e çelur dhe ende të pa ndarë para 4 dhjetorit 2001. Gjykata gjeti se në rast konkret ndarja e pasurisë ishte bërë pas vdekjes së nënës së kërkuesit në vitin 1994. Pra, përpara datës 4 dhjetor 2001.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Në vendimin e Dhomës të datës 21 korrik 2011, Gjykata u shpreh se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 i shqyrtuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës. Kërkuesi pretendoi para Dhomës së Madhe që dallimi në të drejta, bazuar mbi lindjen brenda ose jashtë kornizës martesore ishte një shkelje e të drejtës së tij për barazi, në kundërshtim me nenin 14 dhe të drejtës së tij për gëzimin e pronës së tij, në kundërshtim me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 14 marrë sëbashku me nenin 1 të Protokollit 1

6. Gjykata përsëriti se kërkohen arsye shumë të mëdha, që një dallim i bazuar në lindjen jashtë ose brenda martesë për fëmijët mund të konsiderohet si i pajtueshëm me Konventën. Ligji mbi të cilën trajtimi i kërkuesit u bazua, e kufizonte të drejtën e trashëgimisë të fëmijëve "të lindur nga shkelja e kurorës". Kështu, arsyeja e vetme për dallim në trajtim ishte se kërkuesi ishte fëmijë i lindur jashtë martesë.

7. Ndërkohë, që do të shqyrtojë se deri në çfarë masë diferenca në fjalë në trajtimin e kërkuesit ndiqte një qëllim legjitim, Gjykata vërejtë se Franca kishte rishikuar legjislacionin e saj në përputhje me parimin e Konventës për mosdiskriminimin e fëmijëve bazuar në lindje. Gjykata e përshëndeti këtë ndryshim. Ajo gjithashtu vërejtë

se, mbrojtja e të drejtave të fituara mund t'i shërbejë interesit të sigurisë juridike. Në fakt, qeveria kishte argumentuar se, shqetësimi për të mos cenuar të drejtat e fituara nga trashëgimtarët justifikonte kufizimin e efektin prapaveprues të ligjit të vitit 2001 për trashëgimin që nuk shtrihej edhe mbi ndarjet e pasurisë deri në atë datë . Sipas mendimit të Gjykatës, ky ishte një qëllimi legjitim i aftë për të justifikuar dallimin në trajtim në rastin konkret.

8. Gjykata më pas shqyrtoi proporcionalitetin e masave. Ajo konsideroi se, gjysmë-vëllai dhe gjysmë-motra e kërkuesit ishin në dijeni - ose duhet të kishin qenë - se të drejtat e tyre mund të kundërshtoheshin. Ata duhet të kenë ditur se, gjysmë-vëllai i tyre kishte deri në vitin 1999 të drejtë për të kërkuar pjesën e tij në pasuri. Kërkuesi nuk ishte një pasardhës ekzistenca e të cilit ishte e panjohur për ta, pasi ai kishte qenë i njohur si fëmijë i lindur jashtë martese nga nëna e tyre në vitin 1983. Prandaj, Gjykata çmoi se, qëllimi legjitim për mbrojtjen e drejtave të trashëgimisë të gjysmë-vëllait dhe gjysmë-motrës së kërkuesit nuk ishte aq serioz sa të justifikonin refuzimin e dhënies së një pjese të pasurisë së nënës së tij kërkuesit.

9. Gjykata më tej vuri në dukje se, edhe në sytë e autoriteteve kombëtare, pretendimet e trashëgimtarëve të cilët ishin përfituesit e një ndarjeje *inter vivos* të pasurisë nuk duheshin mbrojtur në të gjitha rrethanat, pasi në bazë të së drejtës franceze kërkesa e një fëmije të lindur nga martesë pas ndarjes së pasurisë *inter vivos* apo të përjashtuar nga një ndarje e tillë nuk do t'i deklarohej e papranueshme.

10. Gjykata nuk i konsideroi këto masa në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur nga kufizimi i së drejtës vendosur me ligj. Prandaj, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 14 i shqyrtuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës në favor të kërkuesit. Gjykata nuk e konsideroi të nevojshme shqyrtimin veçmas të pretendimit të kërkuesit sipas nenit 8.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

11. Gjykata konstatoi se, çështja e shpërblimit të drejtë nuk ishte gati për vendim dhe e rezervoi atë për vendimin në një fazë të mëvonshme.

## **III. Koment**

12. Ky rast, në të cilin Dhoma e Madhe në vendimin e saj të vitit 2011 rrëzon vendimin e Dhomës është interesant pasi ai përfshin detyrimin e shteteve për të zbatuar vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Dhoma e Madhe konstatoi shkelje të nenit 14 i shqyrtuar në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës edhe pse qeveria franceze kishte bërë një ndryshim në ligj në lidhje me të drejtat e trashëgimisë të fëmijëve "të paligjshëm", pas vendimit të GJEDNJ në rastin *Mazurek kundër Francës*, të datës 1 shkurt 2001.

13. Dhoma e Madhe deklaroi se, konstatimet e saj nuk vinin në pikëpyetje vet të drejtën e shteteve për të nxjerrë dispozita kalimtare. Megjithatë, shtetet duhet të



parandalojnë, me kujdesin maksimal, shkeljet e mëtejshme të ngjashme me ato që ishin konstatuar në vendimet e Gjykatës. Sipas Dhomës së Madhe ky qëndrim vendos një detyrim mbi gjykatat e brendshme për të siguruar efektivitetin e plotë të standardeve të Konventës, në përputhje me rendin e tyre kushtetues dhe duke pasur parasysh parimin e sigurisë juridike.

14. Në mendimin e tij paral, Gjyqtari Pinto De Albuquerque, shkoi edhe më tej dhe diskutoi gjerësisht çështjen e forcës detyruese të vendimeve të Gjykatës, duke kritikuar pjesërisht qëndrimin e shumicës. Së pari, ai përcaktoi se vendimet e Gjykatës kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe *erga omnes* dhe shërbejnë për të shpjeguar, ruajtur dhe zhvilluar rregullat e krijuara nga Konventa. Siç thuhet në Deklaratën Brighton, e shkruar gjatë procesit të reformimit të funksionimit të Gjykatës për të siguruar, që ajo të mund të trajtojë një numër gjithnjë në rritje të kërkesave, shtetet palë të Konventës të përfshira në procedurën në fjalë nuk duhet të bëjnë një sy të verbër ndaj interpretimit zyrtar të Konventës të bërë nga Gjykata, e cila është instanca e fundit e veshur me atë fuqi. Zbatimi i plotë i Konventës në nivel kombëtar kërkon që shtetet palë jo vetëm të rivendosin të drejtat e shkelura, por edhe të parandalojnë shkeljet. Gjithashtu, me rëndësi është respektimi i standardeve të vendosura në çështjet në të cilat ata nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt është një mënyrë për ta arritur këtë.

15. Gjyqtari De Pinto Albuquerque vazhdoi më tej, duke shprehur se, qartësisht vendimet e Gjykatës nuk ishin më vetëm deklarative, por edhe normative, duke pasur parasysh aftësinë e Gjykatës dhe përdorimin praktik të përcaktimit të masave individuale dhe të përgjithshme sipas nenit 46. Gjykata jo vetëm që e ndihmon procesin e zbatimit të vendimeve të veta në një numër mënyrash, për shembull ofron udhëzime për masat e duhura për zbatimin, por ajo gjithashtu mban përgjegjësinë përfundimtare për efektivitetin afatgjatë të të gjithë sistemit e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Evropë duke mbikëqyrur pajtueshmërinë me këtë proces zbatimit. Kjo kompetencë e Gjykatës mbizotëron mbi një vendim të kundërt nga ana e Komitetit të Ministrave. Prandaj në rastin konkret, Gjykata duhet të kishte distancuar veten nga Rezolutat e Komitetit të Ministrave të cilat deklaronin se, Franca e kishte zbatuar siç duhen vendim e rastiit Mazurek. Megjithatë, gjykatësi Pinto De Albuquerque argumenton se, çështja Fabris ri-afirmon forcën kushtetuese të vendimeve të Gjykatës dhe juridiksionin e saj për të verifikuar nëse një shtet palë ka përmbushur detyrimet e vendosura mbi të nga një vendim i mëparshëm.

## X DHE TË TJERË kundër AUSTRISË

(kërkesa nr. 19010/07)

19 shkurt 2013

Dhomë e Madhe

*pamundësia e birësimit nga bashkëjetuesi në një marrëdhënie të seksit të njëjtë në Austri është diskriminues në krahasim me situatën e çifteve të pamartuara të seksit të ndryshëm*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit janë dy gra austriake ("kërkuesja e parë dhe e tretë"), të dyja të lindura në vitin 1967, të cilat jetojnë në një marrëdhënie të qëndrueshme homoseksuale dhe i biri i njëres prej tyre ("kërkuesi i dytë"). Ky i fundit, fëmijë i lindur jashtë martese në vitin 1995 dhe e ëma e tij, e cila ka kujdestarinë e plotë të tij. Kërkuesit jetojnë sëbashku dhe dy gratë bashkërisht kujdesen për fëmijën.

2. Duke dashur të krijonin një marrëdhënie juridike ndërmjet kërkuesit e parë dhe fëmijës, pa ndërprerë marrëdhënien që ai kishte me nënën e tij, ata arritën një marrëveshje birësimi në shkurt 2005 dhe e dorëzuan atë në gjykatën kompetente të rrethit për miratim. Duke qenë të vetëdijshëm se dispozitat përkatëse të Kodit Civil mund të kuptoheshin sikur përjashtonin birësimin e fëmijës së partnerit nga partneri tjetër në një çift homoseksual, pa ndërprerë marrëdhënien me prindin biologjik, kërkuesit i kërkuan Gjykatës Kushtetuese t'i shpallte ato dispozita antikushtetuese, me argumentin se ishin diskriminuese ndaj tyre për shkak të orientimit seksual. Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë kërkesën si të papranueshme në qershor 2005, duke argumentuar se ishte në pritje të vendimit të gjykatës së rrethit.

3. Në tetor 2005, gjykata e rrethit refuzoi të miratonte marrëveshjen e birësimit, duke arsyetuar se sipas Kodit Civil në rast të birësimit nga një person, prindi birësues zëvendëson prindin natyror të seksit të njëjtë, duke ndërprerë marrëdhëniet e fëmijës me të. Në rastin në fjalë, birësimi i fëmijës nga kërkuesja e parë do të ndërpriste marrëdhënien e fëmijës me nënën, jo me babain e tij.

4. Kërkuesit apeluan ndaj këtij vendimi por ai u hodh poshtë nga gjykata rajonale në shkurt 2006. Përveç konsideratave të gjykatës së rrethit, ajo shtoi më tej se e drejta austriake, duke mos i dhënë një përkufizim të saktë termit "prindër", haptazi i referohet dy njerëzve të sekseve të ndryshme. Ndërkohë, në rastin në fjalë, fëmija i kishte të dy prindërit dhe nuk ishte nevoja për të zëvendësuar njërin prej tyre nga një birësues. Në lidhje me këtë, gjykata vuri re, bazuar në dosjen e çështjes se fëmija

kishte kontakte të rregullta me babain e tij. Ajo nuk analizoi çështjen nëse kishte baza thelbësore për mos marrjen parasysh të refuzimit të babait për dhënien e pëlqimit për birësimin, siç pretendohet nga kërkuesit. Në shtator 2006, Gjykata e Lartë hodhi poshtë ankesën e kërkuesve për çështje të ligjit, duke vendosur se birësimi i fëmijës nga partneri femër i nënës së tij ose të saj ishte ligjërishit i pamundur. Ajo konkludoi se dispozitat përkatëse të Kodit Civil nuk ishin jo kushtetuese.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Kërkuesit u ankuan bazuar në nenin 14 marrë sëbashku me nenin 8 të Konventës me argumentin se diskriminoheshin për shkak të orientimit seksual. Ata parashtruan se nuk kishte asnjë përligjje të arsyeshme dhe objektive për të lejuar birësimin e fëmijës së partnerit nga partneri tjetër tek çiftet heteroseksuale, qofshin ata të martuar ose jo dhe të ndalohej e njëjta praktikë në rastin e çifteve homoseksual.

### A. Në lidhje me nenin 14 marrë sëbashku me nenin 8

6. Gjykata konfirmoi se marrëdhëniet midis tre kërkuesve përbënin "jetë familjare" brenda kuptimit të nenit 8 të Konventës. Prandaj, në këtë rast neni 14 mund të shqyrtohej në lidhje me nenin 8 të Konventës.

*i) Krahasimi me një çift të martuar kur bashkëshorti dëshironte të birësonte fëmijën e bashkëshortit tjetër*

7. Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesja e parë dhe e tretë nuk ishin në një situatë të ngjashme me atë të një çifti të martuar. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 14 i shqyrtuar në lidhje me nenin 8 të Konventës në këtë drejtim.

*ii) Krahasimi me një çift të pamartuar me partner të sekseve të ndryshme, kur një partner dëshiron të birësojë fëmijën e partnerit tjetër*

8. Gjykata pranoi se kërkuesit ishin në një situatë të ngjashme me atë të një çifti të pamartuar me partnerë të sekseve të ndryshme, ku njëri prej tyre dëshironte të birësonte fëmijën e partnerit tjetër. E drejta austriake e lejonte birësimin e fëmijës së partnerit në rastet e një çifti të pamartuar me partnerë të sekseve të ndryshme. Ndërkohë, që birësimi i fëmijës së partnerit në rastin e çifteve homoseksuale ishte ligjërishit i pamundur. Kjo pamundësi ligjore e birësimit kishte qenë vazhdimisht në qendër të konsideratave të gjykatave austriake, ato nuk kishin analizuar në një mënyrë të plotë nëse birësimi do të ishte në interesin e fëmijës. Në rastin e një çifti të pamartuar me partnerë të sekseve të ndryshme, atyre do tu duhej të shqyrtonin nëse birësimi i shërbente interesave të fëmijës. Rrjedhimisht, kërkuesit ishin të prekur drejtpërdrejt nga situata ligjore të cilën ata e kundërshtuan. Për më tepër, duke qenë se ata, pa diskutim gëzonin "jetën familjare" sëbashku për qëllime të nenit 8, të tre kërkuesit mund të pretendoni të ishin viktimë të shkeljes së në fjalë.

9. Nuk kishte asnjë detyrim sipas nenit 8 të Konventës për të shtrirë të drejtën për birësimin e fëmijës së partnerit për çiftet e pamartuara. Duke qenë se e drejta austriake lejonte birësimin e fëmijës së partnerit në rastin e çifteve heteroseksuale të

pamartuara, Gjykata duhej të shqyrtonte nëse kjo e drejtë për të çiftet e të njëjtit seks i shërbente një qëllimi legjitim dhe ishte në proporcion me të.

10. Gjykatat austriake dhe qeveria kishin argumentuar se e drejta austriake për birësimin synonte të rikrijonte rrethanat e një familje biologjike. Gjykata pranoi se mbrojtja e familjes në kuptimin tradicional ishte në parim një arsye legjitime, që mund të justifikonte një dallim në trajtim, siç ishte edhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës. Megjithatë, sipas jurisprudencës së Gjykatës, në rastet kur kishim të bënim me një dallim në trajtim në bazë të seksit apo orientimit seksual, qeveria duhej të tregonte se ky dallim ishte i nevojshëm për të arritur qëllimin.

11. Gjykata konstatoi se qeveria nuk kishte parashtruar arsye bindëse për të treguar se përjashtimi nga e drejta për të birësuar fëmijën e partnerit për çiftet e të njëjtit seks dhe lejimi i të njëjtës situatë për çiftet e pamartuara me partnerë heteroseksualë ishte e nevojshme për mbrojtjen e familjes në kuptimin tradicional apo për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës. Prandaj, dallimi përbënte diskriminim. Gjykata vendosi me shumicë se ka pasur shkelje të nenit 14 i shqyrtuar në lidhje me nenin 8 të Konventës.

### **B. Në lidhje me nenin 41**

12. Gjykata u akordoi kërkesve 10 000 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 28 420.88 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

### **III. Koment**

13. Ky vendim duhet të lexohet së bashku me vendimin e Gjykatës në *Gas dhe Dubois kundër Francës* vendim i 15 marsit 2012, i cili ka të bëjë me përpjekjet e një gruaje për të birësuar fëmijën biologjik të partnerit të saj femër. Në *Gas dhe Dubois*, Gjykata nuk gjeti asnjë shkelje, në ndryshim nga rasti konkret. Arsyetja për këtë ndryshim është delikate, por vendimtare për të kuptuar qasjen e Gjykatës në lidhje me orientimin seksual. Sipas ligjit francez, 'birësimi i fëmijës së partnerit' mund të ndodhë vetëm kur personi që kërkon të birësojë është i martuar me prindin biologjik të fëmijës. Sipas Konventës, shtetet munden ta kufizojnë të drejtën për martesë vetëm për çiftet heteroseksuale dhe pozita e shtetasve të martuar është krejtësisht e ndryshme me atë të shtetasve të pamartuar, çka do të thotë se Franca nuk kishte shkelur të drejtat e një çifti homoseksual duke e diskriminuar atë. Në ndryshim nga kjo, sipas së drejtës austriake, një person në një marrëdhënie heteroseksuale, i pa martuar, mund të kërkojë që të birësojë e fëmijën biologjik të partnerit të tij/saj. Duke qenë se një person në një marrëdhënie homoseksuale nuk mund të bëjë të njëjtën gjë, u konstatua shkelje e nenit 14 i shqyrtuar në lidhje me nenin 8 të Konventës. Mbrojtja e Austrisë se po përpiqej të ruante familjen tradicionale nuk e bindi Gjykatën. Sipas Gjykatës është e pranueshme të privilegjosh martesën si institucion, por tjetër gjë të privilegjosh marrëdhëniet e heteroseksualëve jashtë martesë, krahasuar me ato të homoseksualëve.

14. Gjykata ka vendosur një ekuilibër, që i lë ligjvënësve një zgjedhje të qartë. Ata janë të lirë t'u refuzojnë personave homoseksualë avantazhet, që lidhen me jetën e familjare, të tilla si e drejta për birësim, për aq kohë sa ua refuzojnë edhe personave heteroseksualë të pamartuar. Kjo mund të shihet si një qëndrim shoqëror tradicional, duke u lejuar shteteve të ruajnë martesën si një institucion i privilegjuar ku mund të zhvillohet jeta familjare dhe t'ua mohojnë atë çifteve të seksit të njëjtë. Nëse shtetet vendosin, që disa aspekte të caktuara të jetës familjare t'i "nxjerrin" jashtë martesës, të tilla si birësimi, nuk ka më një justifikim për të përjashtuar komunitetin LGBTI. Ky qëndrim në fakt ishte shumë e qartë edhe nga jurisprudenca e mëparshme e Gjykatës (p.sh. Karner kundër Austrisë, vendim i datës 24 korrik 2003, në lidhje me trashëgimin e të drejtës së qiramarrjes nga një partner i pamartuar). Fakti që Dhoma e Madhe ishte e ndarë 10-7 në këtë rast, me një opinion të fortë të pakicës, tregon se kjo qasje është ende e diskutueshme, megjithëse tashmë e themeluar mirë në jurisprudencën e Gjykatës.

15. Megjithatë, kjo qasje të jep ndjesinë e një zgjidhje të përkohshme. Disa nga arsyet, që Gjykata parashtrroi për konstatimin e një shkelje në këtë rast, në mënyrë të barabartë mbështesin idenë se në përgjithësi çiftet e të njëjtit seks duhet të lejohen të birësojnë: "ekzistenca de facto e jetës familjare ndërmjet kërkuesve, rëndësia e të pasurit mundësi për njohjen ligjore të saj, mungesa e provave të paraqitura nga qeveria për të treguar se do të ishte e dëmshme për fëmijën që të rritej nga një çift i të njëjtit seks ose të ketë dy nëna dhe dy baballarë për qëllime ligjore, si edhe veçanërisht pranimin nga ana e tyre se partnerët e çifteve homoseksuale janë po aq të përshtatshëm për të birësuar fëmijët e partnerit tjetër sa edhe partnerët e çifteve heteroseksuale" (§ 146). Gjykata në Schalk dhe Kopf kundër Austrisë<sup>233</sup> vërejt se një konsensus evropian ndryshe mund të detyrojë të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës për tu ofruar të drejtën partneritet të regjistruar edhe çifteve të të njëjtit seks. Një konsensus evropian eventualisht mund të lindë edhe për birësimin dhe martesën e çifteve të të njëjtit seks. Pyetja për ligjvënësit është nëse ata do të kontribuojnë në këtë konsensus apo ky konsensus do t'i vëri ata në lëvizje.

233

Vendimi i datës 24 qershor 2010.





# NENI 18

## KUFIRI I ZBATUESHMËRISË SË KUFIZIMEVE TË TË DREJTAVE

## TYMOSHENKO kundër UKRAINËS

(kërkesa nr. 49872/11)

30 prill 2013

*ndalimi në mënyrë arbitrare e ish-kryeministres së Ukrainës përbën shkelje të të drejtave të garantuara nga Konventa*

### I. Faktet kryesore

1. Julia Tymoshenko, e lindur në vitin 1960, është ish kryeministrja e Ukrainës dhe liderja e një prej partive më të forta opozitare në Ukrainë. Në prill të vitit 2011, kundër saj filloi procedimi penal, pasi akuzohej për urdhërimin e paligjshëm të nënshkrimit të një kontrate lidhur me importin e gazit. Më 11 tetor 2011, në bazë të këtyre akuzave, ajo u dënua me shtatë vjet burg dhe u ndalua të mbajë poste publike për tre vjet. Dënimi u la në fuqi me një vendim përfundimtar.

2. Gjatë procesit penal, më 5 gusht 2011, trupi gjykues urdhëroi mbajtjen e znj. Tymoshenko në paraburgim. Gjyqtari vërejti në veçanti se, ajo kishte injoruar urdhrat e kryetarit të trupit gjykues kishte treguar përbuzje ndaj pjesëmarrësve në seancë dhe kishte refuzuar të jepte informacione në lidhje me adresën e saj. Në të njëjtën ditë, ajo u vendos në paraburgim, ku qëndroi deri më 30 dhjetor 2011. Gjykata hodhi poshtë të gjitha kërkesat e saj për lirim duke iu referuar arsyetimit të dhënë në vendimin e datës 5 gusht 2011. Më 30 dhjetor 2011, znj. Tymoshenko u transferua në një burg për të kryer dënimin e saj.

3. Duke qenë se vuante nga probleme të shumta shëndetësore znj. Tymoshenko pretendonte se kushtet në të dyja objektet ku ajo ishte mbajtur e burgosur ishin të pa përshtatshme në shumë aspekte dhe se nuk kishte marrë trajtimin e duhur mjekësor.

4. Në disa raste ajo refuzoi të ekzaminohej nga mjekët të tjerë përveç atyre të zgjedhur prej saj, duke deklaruar se nuk kishte besim në stafin mjekësor të paraburgimit. Ndërmjet shkurtit dhe prillit 2012, ajo u vizitua disa herë nga një ekip mjekësh gjermanë, të cilët rekomanduan trajtimin e saj në një spital të specializuar.

5. Pas kërkesës nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut më 15 mars 2012 për marrjen e një mase të ndërmjetme për garantimin e një trajtimi mjekësor në një institucion të përshtatshëm të znj. Tymoshenko, ajo u transferua në një spital më 20 prill 2012. Ajo pretendoi se kishte kundërshtuar transferimin dhe për këtë arsye ishte ushtruar forcë mbi të duke i shkaktuar mavijosje në bark dhe krahë. Ajo refuzoi trajtim mjekësor pasi pretendonte se ai spital ishte jo i duhuri për nevojat e saj dhe hyri në një grevë urie në shenjë proteste kundër dhunës nga rojet e burgut dhe transferimit të saj me forcë.

6. Më 22 prill 2012, znj. Tymoshenko u kthye në burg dhe të nesërmen ajo paraqiti një ankesë në lidhje me transferimin e saj me forcë në spital. Më 24 prill 2012, ajo u vizitua nga mjekët e burgut. Sipas raportit të mjekëve, ajo kishte disa të nxira, por qartësisht koha kur ato ishin bërë nuk korrespondonte me kohën e incidentit, siç pretendohet prej saj. Sipas qeverisë, një ekspert mjeko-ligjor ishte thirrur për të ekzaminuar znj. Tymoshenko, por ajo kishte refuzuar të lejonte një ekzaminim të tillë.

7. Më 25 prill 2012, pas njoftimeve të medias në lidhje me incidentin u urdhërua një hetim i mëtejshëm. Sipas qeverisë, u morën në pyetje një numër dëshmitarësh potencialë. Ata deklaruan se ajo nuk kishte ankuar dhe se ata nuk kishin parë shenja lëndimi tek znj. Tymoshenko. Në ditën në vijim, znj. Tymoshenko iu kërkua sërish që t'i nënshtrohej një ekzamini mjeko-ligjor, të cilin ajo e refuzoi. Një ekspert mjeko-ligjor bëri vlerësimin e dëmtimeve të saj mbi bazën e raportit të mjekëve të datës 24 prill 2012 dhe arriti në përfundimin se ato nuk mund të ishin shkaktuar më 20 prill, siç ajo pretendonte. Ai vuri në dukje se hematomat e përsëritura mund të kishin ardhur si rezultat i gjendjes së sistemit të enëve të saj të gjakut në vend që të ishin shkaktuar nga goditje të jashtme. Më 3 maj 2012, prokurori vendosi të mos niste procedim penal.

8. Më 9 maj 2012, znj. Tymoshenko u transferua sërish në spital, ku filloi trajtim mjekësor dhe i dha fund grevës së urisë. Ajo më pas bëri një padi penale në lidhje me mbikëqyrjen e saj të përhershme me kamera në spital, me pretendimin e publikimit të informacionit konfidencial mjekësor. Prokurori vendosi të mos niste një procedim penal. Një ankim administrativ, i ngritur nga znj. Tymoshenko më 8 qershor 2012, me të njëjtat pretendime dhe, në veçanti, mohimi i pretenduar i të drejtës së saj për të bërë telefonata, nuk u pranua më 30 tetor 2012.

## II. Vendimi i Gjykatës

9. Znj. Tymoshenko u ankua në veçanti për: kushtet e papërshtatshme të paraburgimit dhe mos ofrimin e kujdesit të duhur mjekësor; transferimin në spital kundër vullnetit të saj më 20 prill 2012 dhe faktin që kishte pësuar lëndime gjatë transferimit, si edhe se incidenti nuk ishte hetuar siç duhej; këqyrjen me kamera gjatë gjithë kohës së qëndrimit në spital; paraburgimin e saj arbitrar dhe pa bazë ligjore; pamundësinë e saj për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit dhe mos pasjen e një të drejte për dëmshpërblim; di edhe pretendimin se ndalimi i saj ishte për motive të tjera të fshehta. Ajo mbështetej kryesisht në nenet 3, 5, 8 dhe 18 të Konventës.

### A. Në lidhje me pretendimet e deklaruara të papranueshme

10. Gjykata i deklaroi të papranueshme pretendimet e ngritura nga znj. Tymoshenko sipas nenit 3 në lidhje me kushtet e paraburgimit të saj dhe për mungesën e trajtimit të duhur mjekësor gjatë ndalimit të saj. Gjykata vendosi se situata lidhur me kushtet materiale të ndalimit nuk ishte aq e rëndë për të rënë në fushëveprimin e nenit 3. Përveç kësaj, nga materialet voluminoze të paraqitura para Gjykatës, ishte e qartë se shëndeti i znj. Tymoshenko kishte marrë vëmendje të konsiderueshme nga

autoritetet ukrainase. Gjithashtu, Gjykata deklaroi të papranueshme pretendimet e Znj. Tymoshenko sipas nenit 8 lidhur me këqyrjen e saj gjatë gjithë kohës së qëndrimit në spital për mosshkrim të mjeteve të brendshme ligjore -.

### **B. Në lidhje me nenin 3**

11. Përsa i përket ankesës së znj. Tymoshenko për keqtrajtimin e pretenduar gjatë transferimit të saj në spital më 20 prill 2012, Gjykata vërejtë se tashmë dihej se disa të nxira ishin shfaqur në trupin e saj gjatë qëndrimit në burg. Kjo kërkon një shpjegim nga autoritetet shtetërore në lidhje me origjinën e tyre. Megjithatë, duke pasur parasysh mungesën e provave mjeko-ligjore, që vjen si rezultat i refuzimit nga znj. Tymoshenko për një ekzaminim të plotë mjeko-ligjor, Gjykata nuk gjen të vërtetuar sipas standardit të nevojshëm të provës, që të nxirat në trup ishin rezultat i trajtimit në shkelje të nenit 3 gjatë transferimit të saj në spital më 20 prill 2012.

12. Duke qenë se znj. Tymoshenko kishte bërë një ankesë të arsyeshme për keqtrajtim përpara autoriteteve ukrainase, ata kishin qenë nën detyrimin për të kryer një hetim efektiv të pretendimeve të saj. Megjithatë, gjetja se efektiviteti i hetimeve ishte penguar nga refuzimet e Znj. Tymoshenko për t'iu nënshtruar një ekzaminimi mjeko-ligjor, ishte e mjaftueshme për të çuar Gjykatën në përfundimin se hetimi i ankesës së saj kishte qenë "efektiv" për qëllime të kërkesave të nenit 3. Rrjedhimisht, sipas Gjykatës në këtë rast nuk ka pasur shkelje të nenit 3.

### **C. Në lidhje me nenin 5 § 1**

13. Përsa i përket pretendimit të znj. Tymoshenko se paraburgimi i saj kishte qenë i paligjshëm dhe arbitrar, Gjykata vërejtë se ndalimi në pritje të gjyqimit të saj ishte urdhëruar për një periudhë të pacaktuar kohe, çka në vetvete ishte në kundërshtim me kërkesat e nenit 5 të Konventës.

14. Për më tepër, urdhri i ndalimit i datës 5 gusht 2011, nuk kishte treguar se znj. Tymoshenko kishte shkelur detyrimin për të mos u larguar nga qyteti, masë e cila ishte vendosur ndaj saj si një masë parandaluese. As nuk ishte pohuar nga gjyqtari, që gjykonte çështjen se ajo kishte munguar në ndonjë nga seancat gjyqësore. Kështu, nuk rezultonte ndonjë rrezik për arratisje nga akuzat të cilat kishin qenë shkak për ndalimin e saj. Justifikimi kryesor për ndalimin e znj. Tymoshenko kishte qenë se e dyshuara kishte penguar procesin dhe kishte sjellje përbuzëse. Kjo arsye nuk është përfshirë në mesin e argumentave që do të justifikonin heqjen e lirisë sipas nenit 5 § 1. Gjithashtu, mbetej e paqartë se si paraburgimi ishte një masë më e përshtatshme në rrethanat e sjelljes të pretenduar përbuzëse nga znj. Tymoshenko për të zëvendësuar detyrimin që të mos e larguar nga qyteti. Duke pasur parasysh se arsyet e paraburgimit të saj mbetën të njëjta deri në dënimin e saj, Gjykata çmoi se ndalimi kishte qenë arbitrar dhe i paligjshëm. Për rrjedhojë kishte pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

### **D. Në lidhje me nenin 5 § 4**

15. Ligjshmëria e ndalimit të znj. Tymoshenko ishte shqyrtuar nga gjykatat e Ukrainës në disa raste. Megjithatë, vendimet përkatëse gjyqësore nuk plotësonin

kërkesat e nenit 5 § 4 të Konventës, pasi ato ishin mjaftuar thjeshtë me deklarin se nuk mund të apelohej urdhri për ndryshimin e një masë parandaluese të urdhëruar gjatë shqyrtimit të një çështjeje penale dhe kishin përsëritur arsyetimin fillestar, të cilin Gjykata Evropiane e kishte çmuar si të mangët. Ndërkohë, znj. Tymoshenko kishte parashtruar argumente të shumta në kërkesat e saj të shumta për lirim, gjykata i kishte hedhur poshtë ato pa dhënë asnjë vlerësim në lidhje me këto argumente. Rrjedhimisht ka pasur shkelje të së drejtës së garantuar nga neni 5 § 4 të Konventës.

#### *E. Në lidhje me nenin 5 § 5*

16. Gjykata vërejtë se nuk kishte asnjë procedurë sipas së drejtës ukrainase për të kërkuar dëmshpërblim për heqjen e lirisë, fakt i cili ishte konstatuar edhe më parë të ishte në shkelje të nenit 5 nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Pra, kishte pasur shkelje të nenit 5 § 5 të Konventës.

#### *F. Në lidhje me nenin 18 marrë sëbashku me nenin 5*

17. Znj. Tymoshenko pretendoi se ndalimi i saj ishte përdorur nga autoritetet për t'ua parandaluar atë nga pjesëmarrja pjesë në jetën politike dhe të kandidonte në zgjedhjet e tetorit 2012. Gjykata kishte vlerësuar tashmë se ndalimi i znj. Tymoshenko kishte shërbyer kryesisht për ta ndëshkuar atë për një mungesë respekti për gjykatën. Prandaj, Gjykata arriti në përfundimin se kufizimi i lirisë së kërkueses nuk ishte bërë me qëllimin e sjelljes së saj para autoritetit kompetent ligjor për dyshimin e arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, por për arsye të tjera. Gjykata e konsideroi këtë një bazë të mjaftueshme për të konstatuar shkelje të nenit 18 të shqyrtuar në lidhje me nenin 5 të Konventës.

#### *G. Në lidhje me nenin 41*

18. Znj. Tymoshenko nuk paraqiti asnjë pretendim në lidhje me dëmin apo kostot dhe shpenzimet.

### **III. Koment**

19. Ky është i pari nga të paktën dy vendime të Gjykatës në lidhje me kërkuesen, Julia Tymoshenko. Gjykata në rastin aktual u përqendrua në çështjet që lidheshin me paraburgimin e saj. Ndërkohë, një tjetër kërkesë që ka të bëjë pretendimet e kërkueses në lidhje me gjykimin e saj dhe paraburgimin e mëtejshëm për procedura të tjera penale është në pritje për t'u gjykuar nga Gjykata.

20. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 5 të Konventës, pasi paraburgimi ishte urdhëruar për një periudhë të pacaktuar kohe, çka ishte një problem që ndodhte shpesh në Ukrainë, por edhe për shkak se arsyeja e vërtetë për ndalimin e saj ishte pengimi i supozuar nga ana e kërkueses mbi procesin dhe sjellja përbuzëse, të cilat nuk ishin arsye të pranuar për heqjen e lirisë sipas nenit 5 § 1 të Konventës dhe rrjedhimisht të paligjshme. Ky konstatim na çon në arsyetimin e Gjykatës kur shqyrton nenin 18 në lidhje me nenin 5 të Konventës – duke qenë se kufizimi i lirisë së kërkueses nuk kishte për qëllim ta çonte atë para autoritetit kompetent ligjor, por kishte arsye të

tjera, rrjedhimisht kishim shkelje. Ka shumë pak raste kur Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 18, kështu që është e qartë se Gjykata këtu dërgon një mesazh të rëndësishëm për autoritetet ukrainase. Në të vërtetë, në një mendim paralel të përbashkët, tre prej gjyqtarëve kërkuan të zhvillonin edhe më tej këtë argument duke arsyetuar se konstatimi i shumicës nuk kishin shqyrtuar pretendimet kryesore të kërkueses, që kishin të bënin me lidhjen midis shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe demokracisë: domethënë ndalimi i saj ishte përdorur nga autoritetet për ta përjashtuar nga jeta politike. Të tre gjyqtarët e gjetën të vërtetuar se kishte pasur motive të fshehta në themel të veprimeve të autoriteteve përkatëse të cilat nuk ishin të lidhura me sjelljen e duhur në një proces penal, por më tepër lidheshin me identitetin e kërkuesit dhe ndikimit të saj si lidere e një partie politike kryesore opozitare.

21. Në mënyrë të qartë, një rast i profilit të lartë si ky, ka gjithashtu pasoja politike dhe ka pasur implikime për marrëdhëniet e Ukrainës me anëtarët e tjerë të Këshillit të Evropës dhe me Bashkimin Evropian në veçanti. Pasi ky vendim ishte marrë në Strasburg, BE-ja u bëri thirrje autoriteteve ukrainase për të "rishikuar tërësisht" burgosjen e kërkueses. Më tej BE-ja i bëri thirrje Ukrainës për të korrigjuar të metat procedurale sistematike të identifikuara në këtë vendim, si pjesë e një reforme gjithëpërfshirëse të gjyqësorit, e cila është një nga kushtet për nënshkrimin e marrëveshjes së asociimit ndërmjet BE dhe Ukrainës, si dhe marrëveshjen e tregtisë së lirë, të cilat u vonuan për shkak të konstatimeve të Gjykatës Evropiane në këtë rast.



# PROTOKOLLI 1

## NENI 1

**MBROJTJA E PRONËS**

## SPORRONG DHE LÖNNROTH kundër SUEDISË

(kërkesat nr. 7151/75 & 7152/75)

23 shtator 1982

*ndalimi i dikujt për të ndërtuar në pronën e tij pa u shoqëruar me kompensim ose dëmshpërblim përkatës përbën shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 dhe shkelje të nenit 6 § 1 në rast se gjykatat nuk kanë mundësi t'ia garantojnë këtë aspekt të së drejtës së pronësisë*

### I. Faktet kryesore

1. Trashëgimtarët e Znj. Sporrong, M.C. - O Sporrong dhe Znj. B. Atmer kishin në bashkëpronësi të detyrueshme një pronë në Stokholm, në lagjen qendrore të Neddre Norrmalm, një truall në të cilin ishte ngritur një ndërtesë e viteve 1860.
2. Në korrik 1956, Qeveria autorizoi Bashkinë e Stokholmit të shpronësojë një zonë, ku ndodheshin 164 ndërtesa, ndër të cilat edhe ajo e trashëgimtarëve të Z. Sporrong. Ky shpronësim bëhej për të ndërtuar një ujësjellës dhe një parking. Në sajë të ligjit të vitit 1917 mbi shpronësimin, Qeveria vendosi një afat prej pesë vjetësh, gjatë të cilit Bashkia duhet të thërriste pronarët përpara gjykatës për dëmshpërblim, në rast të kundërt dëmshpërblimi do të ishte i pavlefshëm. Afati u zgjat në vitin 1961 dhe më 1964, e më pas në 1969 ai u zgjat për dhjetë vjet. Ky i fundit u anulua në vitin 1979 me kërkesë të Bashkisë, politika e së cilës kishte për synim uljen e numrit të automjeteve në qytet dhe ruajtjen e infrastrukturës ekzistuese. Nga viti 1954 deri më 1979, pronarëve iu ishte ndaluar ndërtimi në truallin e tyre.
3. Prona e Znj. I. M. Lönnroth, e cila gjendej edhe ajo në qendrën e qytetit u bë objekt i një leje për shpronësim nga viti 1971 deri më 1979 dhe njëkohësisht i një ndalimi për të ndërtuar prej vitit 1968 deri në vitin 1981. Paditësja e kishte nxjerrë në shitje shtatë herë, por të interesuarit tërhiqeshin pasi informoheshin në Bashki.
4. Në atë kohë legjislacioni suedez nuk parashikonte as mundësinë për të kërkuar shkurtimin e afatit të autorizimit për shpronësim, as atë për të kërkuar dëmshpërblim si rrjedhim i afatit apo i mospërdorimit të këtij të fundit. Ndërsa ndryshimi i bërë në vitin 1972 e përjashtonte kërkesën për dëmshpërblim.
5. Më 15 gusht 1975 trashëgimtarët e Z. Sporrong dhe Znj. Lönnroth u ankuan përpara Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut duke pretenduar se ishte shkelur e drejta e respektimit të pronës së tyre, e parashikuar nga neni 1 i Protokollit 1. Ata pretendonin gjithashtu shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, sepse çështjet e

shpronësimit dhe të dëmshpërblimit nuk ishin gjykuar në një afat të arsyeshëm nga gjykatat suedeze. Po ashtu ata pretendonin edhe shkëlje të nenit 13, për arsye të mungesës së një mjeti efektiv përpara një gjykate kombëtare për të denoncuar shkëljet e të drejtave të tyre ndaj autorizimeve të shpronësimit dhe ndalimeve të ndërtimit. Së fundi, ata pretendonin shkëlje të nenit 14 dhe mbështeteshin edhe tek nenet 17 dhe 18 § 1. Në raportin e 8 tetorit 1980, Komisioni vlerësoi se ka pasur shkëlje të nenit 13 të Konventës. Por ai vendosi se neni 1 i Protokollit 1, neni 6 § 1 dhe nenet 14, 17, 18, nuk ishin shkelur.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

*i. A kishte ndërhyrje ndaj së drejtës së pronës?*

6. Trashëgimtarët e Z. Sporrong dhe ata të Znj. Lönnroth mendonin se autorizimi i shpronësimit dhe ndalimi i ndërtimit me afat të gjatë, përbënin një shkëlje të së drejtës që prona e tyre të respektohej, e garantuar nga neni 1 i Protokollit 1. Ata kritikonin kohën e gjatë që kishte në dispozicion qyteti i Stokholmit për të filluar procedurat gjyqësore, të cilat mund të vendosnin dëmshpërblimin e shpronësimit. Ky afat ishte në fillim pesë vjet, pastaj edhe tre, më pas edhe pesë dhe në rastin tonë afati u zgjat deri 10 vjet. Kërkuesit denonconin mbajtjen në fuqi të autorizimeve dhe ndalimeve për ndërtim për një kohë të gjatë: njëzetetë vjet për të parët; njëzetepesë dhe dymbëdhjetë për të dytët. Ata nënvizonin efektin shkatërrues që do të kishin pasur këto vendime mbi të drejtën e pronës së tyre, si humbjen e mundësisë për të shitur pronën në kushtet normale të tregut, rrezikun që ata do të pësonin në qoftë se ata do të investonin në ndërtesat e tyre, vështirësinë për t'i vënë në hipotekë si dhe ndalimin për të ndërtuar në tokën e tyre. Qeveria nga ana e saj, pohonte se lejet dhe ndalimet ishin pjesë përbërëse e administrimit të infrastrukturës së qytetit dhe se si të tilla nuk shkelin të drejtat e pronarëve. Gjykata pranonte se autorizimet e shpronësimit nuk e shkelin të drejtën e të interesuarve për të përdorur dhe përfituar nga pronat e tyre. Megjithatë Gjykata vlerësonte se masat e marra zvogëlonin mundësinë praktike për të ushtruar të drejtën e pronës dhe preknin thelbin e pronës duke njohur fillimisht legjitimitetin e shpronësimit dhe duke autorizuar qytetin e Stokholmit të vepronte në çdo kohë, kur ai e shihte të arsyeshme. E drejta e pronës e paditësve dobësohej në këtë mënyrë. Përsa i përket ndalimeve për të ndërtuar, ata kufizonin pa diskutim të drejtën e kërkuesve për të gëzuar pronën.

*ii. A ishte ndërhyrja në të drejtën e pronës, e justifikuar?*

7. Fillimisht, duke kërkuar nëse ka pasur shkëlje të pronës (paragrafi 1, fjalia e dytë e nenit 1 të Protokollit 1), Gjykata rikujtoi se autoritetet suedeze nuk kishin bërë shpronësimin e ndërtesave të kërkuesve. Këta mund t'i përdornin pasuritë e tyre, mund t'i shisnin, t'i trashëgonin, t'i falnin apo t'i hipotekonin. Ajo vlerësoi se situata nuk mund të konsiderohej një shpronësim në praktikë, sepse megjithëse e drejta e pronës ishte e cenuar në substancë, ajo nuk ishte zhdukur.

8. Së dyti, Gjykata analizoi nëse masat e marra përbënin apo jo një kontroll të

përdorimit të pronës dhe të pasurive (paragrafi 2 i nenit 1 të Protokollit nr. 1). Ky ishte rasti i ndalimit të ndërtimeve, por jo i autorizimeve të shpronësimit. Këto të fundit përfaqësonin një etapë fillestare në procesin e marrjes së pronës.

9. Së treti, Gjykata krahasoi autorizimet me parimin e respektimit të pronës (paragrafi 1, fjalia e parë e nenit 1). Pa u shprehur mbi përputhjen e tyre me të drejtën suedeze, Gjykata nënvizoi nevojën e një ekuilibri midis kërkesave të interesit publik të popullit dhe ruajtjes të të drejtave themelore të individit. Por ajo konstatoi se legjislacioni në fuqi në atë kohë cilësohej si i ngurtë. Përveç anulimit të lejeve, gjë që kërkonte edhe pëlqimin e bashkisë, ai nuk ofronte asgjë për ndryshimin e mëtejshëm të gjendjes së pronarëve. Gjatë një periudhe të gjatë, kërkuesit kishin qenë në gjendje pasigurie përse i përkiste pronës së tyre, ndërsa qeveria nuk merrte përsipër vështirësitë që ata mund të hasnin. Duke pasur parasysh interesin që kishte qyteti i Stokholmit për të shpronësuar ndërtesat për realizimin e projektit, Gjykata nuk shpjegonte përse legjislacioni suedez duhet të përjashtonte mundësinë për të rivlerësuar gjatë intervaleve të arsyeshëm, interesat e qytetit dhe të pronarëve. Për më tepër, ajo tregonte se ekzistenca e ndalimit të ndërtimeve, kishte shtuar pasojat e dëmshme të kohës së vlefshme të autorizimeve.

10. Së fundi, trashëgimtarët e Z. Sporrng dhe Znj. Lönnroth mbajtën mbi supë një barrë të veçantë dhe të posaçme, e cila mund të ishte legjitime vetëm nëse do të kishte qenë e mundur kërkesa për shkurtimin e afatit të autorizimeve ose kërkesa për dëmshpërblim. Por siç e thamë më lart legjislacioni suedez e përjashtonte këtë mundësi në atë kohë. Me një shumicë tepër të ngushtë prej dhjetë gjyqtarësh kundër nëntë, Gjykata vendosi se ishte shkelur neni 1 i Protokollit 1 të Konventës.

### ***B. Në lidhje me nenet 17, 18, dhe 14***

11. Duke qenë se Gjykata konstatoi një shkelje të nenit 1 të Protokollit 1, ajo nuk e analizoi çështjen në terrenin e nenit 17 dhe të nenit 18 të Konventës.

12. Kërkuesit i ishin referuar gjithashtu nenit 14 të Konventës. Ata pretendonin se ishin viktimat të një diskriminimi në krahasim me pronarët e ndërtesave të pashpronësuar dhe atyre të ndërtesave të shpronësuar sipas rregullave, në përputhje me të drejtën suedeze dhe Konventën. Gjykata e hodhi poshtë këtë tezë sepse asnjë dokument i dosjes nuk e mbështeste atë.

### ***C. Në lidhje me nenin 6 § 1***

13. E drejta e pronës e trashëgimtarëve të Z. Sporrng dhe të Znj. Lönnroth kishte një karakter civil. Lindte pyetja nëse të interesuarit kundërshtonin apo jo autoritetet suedeze lidhur me çështjen e pronës. Kërkuesit pretendonin se afatet e gjata nuk ishin në përputhje me ligjin suedez, gjë që qeveria Suedeze e kundërshtonte. Gjykata nuk e mohonte debatin, përkundrazi ajo njihte ekzistencën dhe seriozitetin e tij. Sapo kërkuesit gjykonin si të paligjshme marrjen e masave të cilat shkelnin të drejtën e pronës dhe ishin në fuqi për afate si ato në çështjen tonë, ata kishin të drejtë që gjykata të jepte një vendim mbi këtë çështje, që i përkiste të drejtës së brendshme.

Gjithashtu kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 sepse çështja e paraqitur prej kërkuesve nuk ishte gjykuar nga një gjykatë që kishte juridiksion të plotë.

14. Duke pasur parasysh këtë vendim, Gjykata mendoi se nuk ishte e nevojshme që çështja të analizohej mbi bazën e nenit 13. Pretendimet e ngritura në bazë të këtij neni përfshiheshin brenda atyre të nenit 6 § 1.

D. Në lidhje me nenin 50 (neni 41 aktual) - vendimi i 18 dhjetorit 1984

15. Në momentin e dhënies së vendimit mbi themelin Gjykata nuk ishte gati për të vendosur edhe në lidhje me çështjen e shpërblimit të drejtë të kërkuesve. Trashëgimtarët e Z. Sporrong kërkonin si shpërblim për dëm material 13 284 500 korona suedeze dhe Znj. Lönnroth 10 912 303, ku secila nga këto shuma përbëhej nga një humbje parash më 31 dhjetor 1980 (8 400 000 dhe 6 900 000 korona suedeze) dhe nga interesa (4 884 540 dhe 4 012 303 korona suedeze). Kërkuesit ankoheshin edhe për një dëm moral por ata i linin Gjykatës të vendoste dëmshpërblimin.

16. Gjykata e dha vendimin e saj në lidhje me këto pretendime më 18 dhjetor 1984. Për të treguar ekzistencën e dëmit, ajo filloi të përcaktonte periudhën kur kishte ndodhur dëmi . Ajo pranoi që bashkia kishte nevojë për kohë - katër vjet - për të bërë studimet e nevojshme për përgatitjen e vendimit përfundimtar lidhur me shpronësimin e planifikuar. Gjykata përcaktoi nëntëmbëdhjetë vjet për trashëgimtarët e Z. Sporrong dhe katër për Znj. Lönnroth. Ajo përcaktoi pastaj përbërësit e dëmit. Megjithatë ata kishin pësuar një dëm gjatë kësaj periudhe - ishin penguar për të përdorur lirshëm pasurinë, për të marrë borxhe hipotekore, kishin pësuar zhvleftësim të ndërtesave, nuk kishin mundësi për të bërë një projekt rinovimi dhe mbi të gjitha kishin qenë në një gjendje të gjatë pasigurie. Pra nga shkelja e nenit 6 § 1 ishte i shkaktuar dëm moral.

17. Përsa i përket vlerësimit të dëmit çështja paraqitej tepër komplekse, për shkak të vështirësisë që përbënte llogaritja e humbjes së mundësive të ardhshme. Megjithëse Gjykata vlerësoi si të papërshtatshme metodat e llogaritjes të sugjeruara nga ana e kërkuesve dhe e qeverisë Suedeze, ajo nuk mendoi se mund të sugjeronte të tjera. Gjykata kufizoi të ndalej në gjykimin mbi faktorët e vlerësuar si të pranueshëm. Duke qenë se elementet e dëmit ishin të pandarë dhe se asnjëri prej tyre nuk llogaritej saktësisht, ajo i vlerësoi së bashku dhe në mënyrë të drejtë. Ajo u akordoi 800 000 korona suedeze trashëgimtarëve të Z. Sporrong dhe 200 000 korona suedeze Znj. Lönnroth.

18. Për shpenzimet e bëra përpara organeve të Konventës, kërkuesit pretendonin 963 175,89 korona suedeze, duke hequr 24 103 franga franceze të marra nga Znj. Lönnroth për ndihmë juridike. Gjykata vendosi që Suedia duhej t'u jepte trashëgimtarëve të Z. Sporrong dhe Znj. Lönnroth së bashku 723 865,75 korona suedeze, minus 24 103 franga franceze.

### III. Koment

19. Vlera më e spikatur e këtij vendimi qëndron në faktin se ai bëri një strukturim të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës duke nxjerrë në pah tre rregulla themelore, që tashmë gjejnë zbatim në të gjithë jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me të drejtën e pronës<sup>234</sup>. Këto tre rregulla të mishëruara në dispozitën e nenit 1 të Protokollit 1 janë: (i) parimi i gëzimit në mënyrë paqësore të pasurive i cili shprehet në fjalinë e parë të paragrafit të parë; (ii) privimi nga prona i shprehur në fjalinë e dytë të paragrafit të parë dhe (iii) kontrolli i përdorimit të pronës dhe pasurisë i shprehur në paragrafin e dytë të dispozitës. Në këtë vendim Gjykata ofroi edhe formulën e marrjes në analizë dhe të interpretimit të këtyre tre rregullave duke orientuar se fillimisht merren në shqyrtim rregulli i dytë dhe i tretë dhe pastaj i pari<sup>235</sup>.

20. Megjithatë duhet thënë se nuk është e thjeshtë që të përcaktosh se cili nga rregullat e mësipërm gjen zbatim në një situatë faktike. Në fakt tetë nga gjyqtarët e Gjykatës në këtë çështje, u shprehën se qëndrimi i autoriteteve suedeze në këtë rast duhej vlerësuar në kuadrin e rregullit të tretë<sup>236</sup>, ndërkohë që shumica e Gjykatës gjeti shkëlqe të nenit 1 të Protokollit 1 në bazë të rregullit të parë. Nga ana tjetër Gjykata në këtë çështje përpunoi konceptin e shpronësimit de facto. Ajo u shpreh se në një situatë konkrete duhet bërë një analizë që kapërcen marrëdhënien dhe aktet formale dhe analizon realitetin e marrëdhënies së pronësisë, për të vlerësuar nëse kemi të bëjmë me një shpronësim de facto apo jo, gjë që do të çonte pastaj në vlerësimin e zbatimit të rregullit të parë apo atij të dytë të nenit 1 të Protokollit 1<sup>237</sup>.

21. Sidoqoftë në jurisprudencën e saj të mëvonshme në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 ajo është përpjekur ta qartësojë këtë çështje. Vlen të shihen në këtë drejtim sidomos vendimet e saj në lidhje me çështjet “James kundër Mbretërisë së Bashkuar”, ku Gjykata shprehet se tre rregullat nuk janë të veçuar nga njëri tjetri por duhen interpretuar duke u mbajtur parasysh reciprokisht dhe sidomos nën dritën e rregullit të parë që shpall parimin e përgjithshëm. Kurse në çështje më të reja<sup>238</sup>, duket se Gjykata përqendrohet më shumë në testin e proporcionalitetit të ndërhyrjes së shtetit ndaj të drejtës të shpallur në rregullin e parë sesa në një zbatim kronologjik të tre rregullave të lartpërmendur.

<sup>234</sup> Paragrafi 61 i vendimit të Gjykatës

<sup>235</sup> Paragrafët 7-9 të përmbledhjes së vendimit që ju ofrohet dhe paragrafët 62-75 të vendimit të Gjykatës.

<sup>236</sup> Mendim i përbashkët i pakicës, sidomos paragrafi 3

<sup>237</sup> Paragrafi 63 i vendimit.

<sup>238</sup> Shih për shembull vendimin e 28 korrikut 1999 në lidhje me çështjen Imobiliare Saffi kundër Italisë, të vitit 1994 në lidhje me çështjen Manastiret e Shenjta kundër Greqisë apo edhe Ish Mbreti i Greqisë kundër Greqisë, ku në këtë të fundit testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes duket se gjen zbatim edhe në lidhje me masën e dëmshpërblimit.



## BOSPHORUS AIRWAYS kundër IRLANDËS<sup>239</sup>

(kërkesa nr. 45036/98)

30 qershor 2005

Dhomë e Madhe

*në një vendim tepër interesant që trajton konkurrencën mes sistemeve europiane, Gjykata vendosi se kontrolli i pronës të huajve mund të justifikohet kur bëhet në zbatim të një të drejte ndërkombëtare që mbron njësoj me Konventën të drejtat e njeriut*

### I. Faktet kryesore

1. Kjo çështje e ka zanafillën në një padi të ngritur nga ana e Bosphorus Airways, një shoqëri private fluturimesh e regjistruar në Turqi, kundër Irlandës. Në maj të vitit 1993 një avion që Bosphorus Airways mori me qira nga Yugoslav Airlines ('JAT') gjendej në Irlandë për një riparim të përgjithshëm nga TEAM Aer Lingus, një shoqëri shtetërore irlandeze për riparime avionësh. Ky avion u bllokua nga autoritetet irlandeze në bazë të Rregullores 990/93 të Komunitetit Europian e cila nga ana e saj vinte në zbatim regjimin e sanksioneve të OKB-së ndaj Republikës Federale Jugosllave (Serbisë dhe Malit të Zi).

2. Bosphorus Airways e kundërshtoi këtë masë fillimisht me sukses përpara gjykatës së lartë<sup>240</sup> e cila, në qershor 1994, vendosi se Rregullorja 990/93 nuk gjente zbatim ndaj këtij avioni. Megjithatë në apel, Gjykata Supreme<sup>241</sup> irlandeze në bazë të nenit 177<sup>242</sup> të Traktatit të Komunitetit Europian ia përcolli çështjen Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Europiane (GJ.D.K.E.) në Luksemburg, duke i drejtuar pyetjen nëse Rregullorja 990/93 gjente zbatim edhe për avionin në fjalë. GJ.D.K.E. iu përgjigj në mënyrë pohuese kësaj pyetje, pra që Rregullorja gjente zbatim edhe mbi këtë avion dhe, në vendimin e saj të nëntorit 1996, Gjykata Supreme irlandeze zbatoi këtë interpretim të Luksemburgut duke i dhënë të drejtë shtetit për bllokimin e avionit.

3. Në kohën e dhënies së këtij vendimi, afati i kontratës së qirasë së avionit nga Bosphorus Airways kishte skaduar. Përderisa edhe regjimi i sanksioneve ndaj

<sup>239</sup> Titulli i plotë i çështjes është "Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi kundër Irlandës"

<sup>240</sup> Gjykatë me juridiksion të përgjithshëm në sistemin gjyqësor irlandez.

<sup>241</sup> Gjykata më e lartë në sistemin gjyqësor irlandez me kompetencë edhe kontrollin e kushtetutshmërisë të ligjeve.

<sup>242</sup> Aktualisht neni 234 pas rinumërimit që Traktati i Amsterdimit i ka bërë Traktateve BE dhe KE. Shih "Bashkimi Europian - Përmbledhje Traktatesh", Qendra Europiane - Tiranë, 2001.

Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mali i Zi) ishte zbutur, autoritetet irlandeze iu kthyen avionin drejtpërdrejt JAT-it. Për pasojë Bosphorus Airways humbi tre nga katër vjet qira për përdorimin e avionit, i cili ka qenë i vetmi që është bllokuar në kuadrin e sanksioneve ndaj Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mali i Zi).

4. Shoqëria Bosphorus Airways ankohej se mënyra në të cilën autoritetet irlandeze kishin vënë në zbatim regjimin e sanksioneve duke bllokuar avionin e saj ishte një përdorim i kritikueshëm i diskrecionaritetit të tyre në bazë të nenit 1 të Konventës dhe përbënte shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të saj.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

#### i. Baza ligjore për bllokimin e avionit

5. Gjykata vuri në dukje se, pas adoptimit, Rregullorja KE 990/93 ishte “e zbatueshme ndaj të gjithëve” dhe “e detyrueshme në të gjithë elementët e saj” në bazë të së drejtës komunitare<sup>243</sup>. Në këto kushte kjo rregullore zbatohet ndaj të gjitha shteteve anëtare të BE dhe asnjëri prej tyre nuk mund t'i shkelte dispozitat e saj. Për më tepër, karakteri “drejtpërdrejt i zbatueshëm”<sup>244</sup> i Rregullores, sipas mendimit të Gjykatës as nuk vihej fare në dyshim. Rregullorja ishte bërë pjesë e së drejtës së brendshme irlandeze dhe kishte fituar vlerë normative pa pasur nevojë për legjislacion implementues, që nga 28 prilli 1993, kur ajo ishte botuar në Fletoren Zyrtare të KE - pra përpara datës së bllokimit të avionit. Gjykata e vlerësoi plotësisht të parashikueshme që një Ministër Transporti do t'i vinte në jetë kompetencat për bllokim të parashikuara në nenin 8 të Rregullores KE 990/93. Autoritetet irlandeze me plot të drejtë e konsideruan veten të detyruara që të bllokoni çdo avion që ata mendonin se mbulohej nga veprimi i nenit 8 të Rregullores 990/93. Vendimi i tyre për zbatimin e kësaj Rregulloreje ndaj avionit në fjalë u konfirmua më tej edhe nga GJ.D.K.E.

6. Gjykata ra dakord me qeverinë irlandeze dhe me Komisionin Europian edhe në lidhje me faktin që Gjykata Supreme nuk kishte mundësi të ushtronte ndonjë diskrecion të madh, qoftë përpara, qoftë mbas referimit të çështjes tek GJ.D.K.E. Gjykata arriti në përfundimin se bllokimi që Bosphorus Airways nuk ishte rezultat i ushtrimit të një pushteti diskrecionar nga ana e autoriteteve irlandeze, qoftë në bazë të drejtës komunitare qoftë asaj irlandeze, por kishte të bënte me përmbushjen e detyrimeve ligjore komunitare nga ana e shtetit irlandez.

#### ii. A ishte bllokimi i justifikuar?

7. Gjykata konstatoi se mbrojtja e të drejtave themelore nga e drejta komunitare mund të konsiderohej se ishte, edhe në kohën e bllokimit, “e njëjtë” me atë të sistemit

<sup>243</sup> Shih po aty, nenin 249 të Traktatit KE (në kohën e ngjarjeve neni 189).

<sup>244</sup> Ibid.

të Konventës. Për pasojë, lindte prezumimi se Irlanda nuk çlirohej nga kërkesat e Konventës kur ajo vinte në zbatim detyrime që i lindnin nga anëtarësia e saj në Komunitetin Europian. Një prezumim i tillë mund të vihej në dyshim vetëm në qoftë se, në ndonjë rast të veçantë, vlerësohej se mbrojtja e të drejtave nga Konventa ishte haptazi e mangët. Në raste të tilla, interesi i bashkëpunimit ndërkombëtar do të merrte përparësi ndaj rolit të Konventës si një “instrument kushtetues i rendit publik europian” në fushën e të drejtave të njeriut.

8. Gjykata mbajti parasysht natyrën e ndërhyrjes, interesin e përgjithshëm që ndiqte bllokimi në fjalë dhe regjimi i sanksioneve në tërësi, si dhe vendimin e Gj.D.K.E. të cilin Gjykata Supreme duhet ta zbatonte ashtu siç edhe bëri në fakt. Ajo vlerësoi se ishte e qartë që nuk kishte ndonjë mangësi funksionimi në mekanizmin e kontrollit të respektimit të të drejtave të Konventës. Për këto arsye, sipas pikëpamjes së saj nuk mund të thuhej se mbrojtja e të drejtave që i takonin Bosphorus Airways ishte haptazi e mangët. Ajo vijoi duke pohuar se prezumimi i respektimit të Konventës nuk ishte vënë në dyshim dhe se bllokimi i avionit nuk jepte shkak për shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

### III. Koment

9. Gjykata në këtë çështje përballet me problemin jashtëzakonisht kompleks dhe aktual të konkurrencës mes sistemeve juridike në Europës, përsa i përket mbrojtjes të të drejtave të njeriut<sup>245</sup>. Për më tepër, përveç dy sistemeve europiane, hyn në lojë edhe e drejta ndërkombëtare me rezolutat e miratuara nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Thelbi i kësaj konkurrence që ka arritur shpesh edhe në përplasje jurisprudenciale, është nëse një shtet mund të konsiderohet përgjegjës për shkelje të Konventës nëse vepron në përmbushje të detyrimeve të tij të tjera ndërkombëtare, qoftë në kuadrin e BE-së apo të OKB-së si në këtë rast, qoftë në kuadrin e NATO-s<sup>246</sup>. Pra sfida është tepër interesante - në Europë sidomos mund të bëhet fjalë tashmë për atë që do ta quaja shtet të së drejtës ndërkombëtare në kuptimin sa formal aq edhe material.

10. Irlanda e ka ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut përpara se të bëhej anëtare e Komunitetit Ekonomik Europian në vitin 1972. Gjykata e Strasburgut disa herë ka marrë në shqyrtim përgjegjësinë e shteteve që janë palë në Konventë për veprime ose mosveprime të tyre në kuadrin e detyrimeve që u rrjedhin nga traktate të tjera. Neni 53 i Konventës e bën të qartë se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk duhet interpretuar “sikur kufizon ose cenon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, që mund të sigurohen nga legjislativi i çdo pale kontraktuese ose nga çdo konventë tjetër në të cilën kjo palë kontraktuese është palë”. Megjithatë, nuk ka asnjë dispozitë paralele që të parashikojë se asnjë marrëveshje tjetër në të

<sup>245</sup> Për një trajtesë më të gjerë në lidhje me këtë problem shih në shqip artikullin tim (L.B.) “Mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut në Bashkimin Europian” - në “Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe rruga për në Gjykatën e Strasburgut” fq. 118-133, Qendra Evropiane, Tiranë 2003, ose për një trajtesë të plotë, ndër të tjerë shih Philip Alston “The EU and Human Rights”, OUP, 1999

<sup>246</sup> Si në rastin e vendimit të Gjykatës i 19 dhjetorit 2001 në lidhje me çështjen “Banković dhe të tjerë kundër Belgjikës dhe 16 Shteteve të Tjera Anëtare”.

cilën ndonjë nga shtetet anëtare të Konventës është palë duhet interpretuar - nga Gjykata e Strasburgut në këtë rast - sikur kufizon ose cenon ndonjë prej të drejtave të garantuara në bazë të Konventës. Në këtë mënyrë, kanë qenë organet e Konventës dhe kryesisht Gjykata ajo që ka marrë përgjegjësinë për zbatimin e parimeve të përfshira në Konventën e Vjenës të vitit 1969 “Mbi të Drejtën e Traktateve”, fakt që është tepër interesant për zhvillimet e së drejtës në Europë

11. Gjykata i përdor këto parime për të përcaktuar se në çfarë mase zbatimi i detyrimeve të tjera ndërkombëtare të një shteti anëtar në Konventë, është në përputhje me detyrimet e tij në bazë të Konventës. Rregulloret e Komunitetit European të nxjerra në bazë të Traktatit të Romës kanë një status të veçantë, të ndryshëm nga detyrimet e tjera ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe një pjesë të legjislacionit BE - ato bëhen automatikisht pjesë e së drejtës së brendshme e të gjitha shteteve anëtare të BE pa pasur nevojë për asnjë transpozim nga ana e autoriteteve shtetërore. Këto të fundit madje nuk kanë asnjë hapësirë veprimi të njëanshëm në zbatimin e tyre dhe janë të detyruara të ndjekin edhe interpretimet përkatëse nga ana e GJ.D.K.E. në Luksemburg.

12. Çështja që shtrohej përpara Gjykatës së Strasburgut në këtë rast ishte se deri në çfarë mase mund t'i lejonte ky karakter i së drejtës komunitare qeverisë irlandeze që të shmangej nga përgjegjësia në bazë të Konventës për akte që i rridhnin në bazë të së drejtës komunitare. Në parim, nën këndvështrimin e së drejtës së Konventës, thjesht fakti që një shtet nuk mund të vepronte ndryshe për shkak të një dispozite të së drejtës së tij të brendshme, përfshirë këtu edhe kushtetutën, nuk e përjashton një shtet nga përgjegjësia e tij në bazë të Konventës. Shtetet janë përgjegjëse dhe japin llogari edhe përpara Gjykatës së Strasburgut edhe për ligjet dhe kushtetutat e tyre. Ky vendim ripohon në fakt që një shtet vazhdon të ketë përgjegjësi në bazë të Konventës edhe në lidhje me anëtarësimin e mëvonshëm në angazhime të tjera ndërkombëtare. Në qoftë se regjimi ligjor në të cilin ai merr pjesë në këtë rast ofron një “mbrojtje të njëjtë” shteti nuk i ka shkelur angazhimet e tij në bazë të Konventës në qoftë se thjesht ka zbatuar detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky angazhim tjetër ndërkombëtar. Megjithatë, prezumimi i “mbrojtjes së njëjtë” mund të bjerë poshtë në qoftë se në rrethanat specifike të një rasti konkret, vlerësohet se mbrojtja e të drejtave të Konventës është haptazi e mangët. Në rrethana të tilla një shtet do të jetë plotësisht përgjegjës për të gjitha aktet që nuk janë në përputhje me detyrimet e tij ndërkombëtare.

13. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 vlen të theksohet se Gjykata konstatoi se “prona” për të cilën bëhej fjalë në këtë çështje nuk ishte avioni në vetvete, por përfitimi nga qiramarrja e avionit. Pas këtij konstatimi ajo shkoi më tej duke analizuar se bllokimi i avionit nuk përbënte privim nga prona - pra nga përfitimet nga qiramarrja - por ishte në fakt një element përbërës i kontrollit të përdorimit të pronës në fjalë - avionit. Në këtë mënyrë nuk gjente zbatim rregulli i dytë i nenit 1 të Protokollit 1 por rregulli i tretë i këtij neni. Duke arritur në këtë përfundim, Gjykata arrinte të përjashtonte zbatimin në këtë rast të nocionit “parimet e përgjithshme të

së drejtës ndërkombëtare” të përmendura në nenin 1 të Protokollit 1. Këto parime kërkojnë një kompensim të detyrueshëm kur një shtet privon një të huaj nga prona e tij. Rregullorja komunitare nuk parashikonte asnjë kompensim. Konstatimi që në këtë rast kishte një kontroll të përdorimit dhe jo privim, nënkuptonte se Irlanda nuk ishte e detyruar që ta kompensonte Bosphorus Airways – një i dëmtuar plotësisht i pafajshëm – në lidhje me humbjet që ai kishte pësuar.

## HUTTEN-CZAPSKA kundër POLONISË

(kërkesa nr. 35014/97)

22 shkurt 2005

*shtetet duhet të marrin masa edhe deri legjislative në qoftë se, sipas Gjykatës së Strasburgut, rregullimet ekzistuese i shkelin në mënyrë sistematike të drejtat e njeriut*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Maria Hutten-Czapska është shtetase franceze me origjinë polake, që ka lindur më 1931 dhe jeton në Andresy në Francë. Ajo ka në pronësinë e saj një shtëpi dhe një copë truall në Gdynia në Poloni. Kërkuesja është një prej rreth 100 000 pronarëve të tokave në Poloni që ishin prekur nga një sistem kufizues i kontrollit të qirasë. Nga ana tjetër, nga ky sistem përfitojnë rreth 600 000 deri 900 000 qiramarrës. Sistemi bazohet në ligje të miratuara në periudhën e regjimit të kaluar komunist dhe parashikonte një sërë kufizimesh ndaj të drejtave të pronarëve dhe në veçanti përcaktonte një tavan për çmimin e qirasë, i cili ishte kaq i ulët sa pronarët nuk mund të mbulonin shpenzimet e mirëmbajtjes, e jo më të kishin ndonjë fitim.

2. Gjatë Luftës II Botërore prona e kërkueses u përdor nga ushtria gjermane dhe në maj 1945 nga Ushtria e Kuqe. Në maj 1945 një pjesë e shtëpisë iu dha A.Z. ndërsa në qershor 1945 gjykata e rrethit të Gdinas vendosi që shtëpia t'i kthehej prindërve të kërkueses. Ata filluan ta rikonstruktin shtëpinë, por pas pak kohe u urdhëruan të largoheshin prej saj. Për vite me radhë prindërit e kërkueses u orvatën e rimerrnin shtëpinë, por pa sukses.

3. Më 18 shtator 1990 gjykata e rrethit njohu faktin se kërkuesja kishte trashëguar pronën e prindërve dhe në korrik 1991 ajo e mori shtëpinë nën administrim. Pas kësaj kërkuesja nisi një sërë procesesh – civile dhe administrative – për të rifituar posedimin e shtëpisë dhe për të larguar qiramarrësit por pa sukses. Në vitin 1994 u miratua në Poloni një skemë e re e kontrollit të qirave të pronave private, në bazë të së cilës pronarët ishin të detyruar që të përballonin shpenzimet e mirëmbajtjes të pronave, por nuk kishin të drejtë që këto shpenzime t'i përfshinin në çmimet e qirasë. Sipas një llogarie, qiratë mbulonin vetëm rreth 60 % të shpenzimeve të mirëmbajtjes.

Sistemi në fjalë parashikonte gjithashtu kufizime strikte në lidhje me përfundimin e marrëdhënieve të qirasë.

4. Ligji i vitit 1994 u zëvendësua me një ligj të ri më 2001 i cili kishte për synim të përmirësonte situatën. Ky ligj nuk bëri asgjë tjetër veçse la në fuqi të gjitha kufizimet në lidhje me përfundimin e marrëdhënieve të qirasë dhe detyrimet për përballimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes të pronave, si dhe miratoi një procedurë të re për kontrollin e rritjes së vlerës së qirasë. Në vitin 2000 Gjykata Kushtetuese Polake konstatoi që kjo skemë e kontrollit të qirasë në bazë të ligjeve të viteve 1994 dhe 2001 ishte jokushtetuese dhe se ajo kishte krijuar një barrë joproporcionale dhe të tepërt për pronarët. Pas këtij vendimi dispozitat përkatëse u shfuqizuan. Më 1 janar 2005 hynë në fuqi disa dispozita të reja, të ashtuquajtura “amendamentet e dhjetorit 2004” të cilat lejonin për herë të parë që qiratë që e kapërcenin me 3 % vlerën e rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së pronës të dhënë me qira, të rriteshin me jo më shumë se 10 % në vit.

5. Kërkuesja ankohej se nuk kishte qenë asnjëherë në gjendje të rifitonte posedimin ose përdorimin e pronës së saj ose edhe të merrte një qira të përshtatshme prej saj. Ajo bazohej në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

6. Gjykata kujtoi se ajo vetëm mund të merrte parasysh efektin e mundshëm ndaj pronës së kërkuesve, të vendimeve të marra apo të ligjeve të miratuara, duke filluar që nga 10 tetori 1994, data kur Polonia ka ratifikuar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

7. Skema e kontrollit të qirave në Poloni vinte si pasojë e mungesës së banesave për popullsinë, numrin e vogël të apartamenteve për t'u dhënë me qira dhe kostove të larta të tyre në shitje. Kjo skemë ishte vënë në zbatim edhe për të siguruar mbrojtjen sociale të qiramarrësve – veçanërisht të atyre në një situatë financiare të vështirë – dhe të siguronte tranzicionin gradual nga një qira e kontrolluar nga shteti, në një qira plotësisht të negociueshme nga pikëpamja kontraktuale, në kuadrin e shndërrimit të vendit pas rënies së sistemit komunist. Gjykata pranoi që në rrethanat ekonomiko-sociale të kësaj çështjeje, legjislacioni në fjalë kishte pasur një qëllim legjitim në interesin e përgjithshëm.

8. Vlerësimi i impaktit që kjo skemë e kontrollit të qirave kishte ndaj të drejtës së pronës së kërkueses duke filluar nga 10 tetori 1994 deri në ditën e gjykimit para Gjykatës përfshinte tre ligje të ndryshme: Ligjin e vitit 1994, Ligjin e vitit 2001 dhe Amendamentet e vitit 2004.

9. Në lidhje me Ligjin e vitit 1994, Gjykata vuri në dukje se në të drejtën polake nuk ekzistonte asnjë procedurë që t'u mundësonte pronarëve të rimerrnin shpenzimet për mirëmbajtjen e pronave dhe nuk parashikohej nga sistemi polak asnjë mekanizëm



për të balancuar shpenzimet për mirëmbajtjen e pronave, me të ardhurat nga qiraja e këtyre pronave. Gjykata konstatoi se kombinimi i kufizimeve në bazë të ligjit të vitit 1994 prekte vetë thelbin e së drejtës së pronës së kërkueses.

10. Në vijim, dispozitat e Ligjit të vitit 2001 i kufizonin së tepërmi të drejtat e kërkueses për pronën dhe e ngarkonin atë me një barrë të tepërt e cila nuk mund të justifikohet në kuadrin e qëllimit legjitim të ndjekur nga autoritetet me anë të miratimit të këtij ligji në lidhje me qiratë e banesave.

11. As Amendamentet e dhjetorit 2004 nuk i ofronin kërkueses ndonjë zgjidhje që mund ta kompensonte për shkeljen që kishte pësuar, për shkak se mundësia për të rritur 10% qiratë aktuale nuk përbënte ndonjë rritje të konsiderueshme.

12. Duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana dhe në veçanti pasojat që skema e kontrollit të qirave sillte për ushtrimin e të drejtave të kërkueses për të gëzuar pronën e saj, Gjykata vendosi se autoritetet e kishin ngarkuar atë me një barrë joproporcionale dhe të tepërt dhe se për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.

### **B. Në lidhje me nenin 46**

13. Çështja e kërkueses nxirrte në pah një problem të rëndësishëm dhe të vazhdueshëm, përderisa legjislacioni polak në fjalë kishte parashikuar dhe vazhdonte të parashikonte ndaj pronarëve të trojeve dhe shtëpive, kufizime ndaj rritjes së qirave për shtëpitë e tyre, duke e bërë të pamundur për ta që të merrnin qira, normalisht të krahasueshme me shpenzimet e përgjithshme për mirëmbajtjen e pronës.

14. Gjykata vlerësoi se Polonia, përpara së gjithash, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të ndonjë natyre tjetër duhet të siguronte një nivel të arsyeshëm qiraje për kërkuesen dhe personat e tjerë të dëmtuar njësoj si ajo, ose t'u ofronte atyre një mekanizëm kompensues që zbuste pasojat e kontrollit shtetëror mbi rritjen e qirasë së pronave të tyre.

15. Nuk i takonte Gjykatës të tregonte se çfarë do të ishte një nivel “i arsyeshëm” qiraje në këtë çështje, ose në përgjithësi në Poloni, ose në çfarë mënyre duheshin parashikuar dhe ngritur mekanizmat kompensues. Në bazë të nenit 46 të Konventës, Polonia ngelej e lirë të zgjidhte mjetet me anë të të cilave ajo do të respektonte detyrimet që i rridhnin nga dhënia e një vendimi kundër saj nga ana e Gjykatës së Strasburgut.

### **C. Në lidhje me nenin 41**

16. Gjykata vendosi se çështja e zbatimit të nenit 41, në lidhje me dëmin material ose jomaterial nuk ishte gati për vendim dhe e shtyu për më vonë<sup>247</sup>. Ajo i akordoi gjithsesi kërkuese 13 000 euro për shpenzime dhe pagesa ligjore.

<sup>247</sup> Deri në momentet që është përgatitur kjo përmbledhje nuk është dhënë asnjë vendim në lidhje me nenin 41 të Konventës.

### III. Koment

17. Vendimi në fjalë përballet me një situatë që nuk është aspak e panjohur për realitetin shqiptar – rimarrjen nën posedim të plotë të pronave nga ish pronarët. Me vlerë është për t'u vënë re mënyra se si Gjykata arrin në përfundimin për shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës duke vlerësuar masën e kufizimit ndaj së drejtës së pronës së këtyre pronarëve dhe mënyrat që ofronte legjislacioni polak për një ndreqje të situatës ose një zbutje deri në maksimum të këtij kufizimi që ajo e konsideroi të tepërt dhe joproporcional.

18. Vlera e këtij vendimi mund të shihet edhe nën një këndvështrim tjetër. Është në fakt i dyti vendim, në të cilin Gjykata në mënyrë të shprehur orienton qeverinë e paditur për të marrë masat e përshtatshme, me qëllim zgjidhjen e një problemi të përgjithshëm dhe të vazhdueshëm që paraqitet para saj, në një rast individual që përbën vetëm një shembull të fenomenit. Në çështjen e trajtuar më sipër, Broniowski kundër Polonisë, Gjykata konstatoi se legjislacioni në fuqi që cenonte një numër të konsiderueshëm individësh ishte në kundërshtim me Konventën dhe vendosi se qeveria duhet të ndreqte situatën duke adoptuar masat e përshtatshme. Me këto dy vendime, Gjykata bën të qartë se në raste kur shkeljet e konstatuara në një rast individual janë të tilla që cenojnë një numër të gjerë individësh dhe se situata mund të zgjidhet vetëm duke miratuar masa me karakter legjislativ, ajo do t'i kërkojë qeverisë së paditur që të veprojë në këtë drejtim.

19. Të dy këto çështje janë zgjedhur nga Gjykata si çështje “tip” që shprehin orientimin e saj në trajtimin e këtyre çështjeve në mënyrën më efektive të mundshme. Kjo tendencë është pasqyruar qartë në procedurën e përshpejtuar dhe të thjeshtëzuar të adoptuar nga ana e Protokollit 14 të Konventës. Ky Protokoll parashikon masa të ndryshme në kuadrin e një reforme që synon të zgjidhë çështjen e ngarkesës së madhe të punës përpara Gjykatës. Protokollin 14 do të amendojë nenin 28 § 1 (b) të Konventës në mënyrë që tre gjyqtarë mund të vendosin në lidhje me themelin si dhe pranueshmërinë e çështjeve “të përsëritura”, aspekti themelor i të cilave është bërë ndërkaq “objekt i një jurisprudence të qëndrueshme të Gjykatës”. Protokollin 14 do të hyjë në fuqi vetëm kur të 14 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës do ta ratifikojnë atë. Megjithatë, Gjykata në mënyrë të pavarur po demonstroi dëshirën e saj për të trajtuar në mënyrë efektive çështjet “e përsëritura” ose “të ngjashme” duke ushtruar një presion më të madh ndaj qeverive të paditura, për të respektuar në mënyrë efektive dhe “të përgjithshme” vendimet e dhëna kundër tyre.

20. Për më tepër, nevoja për një ekzekutim efektiv të vendimeve pasqyrohet nga neni 46, ashtu si amendohet nga Protokollin 14, i cili e mundëson Komitetin e Ministrave që të nisin procedura shkeljeje përpara Gjykatës kur një shtet anëtar refuzon të respektojë një vendim të dhënë nga Gjykata kundër tij. Ekzekutimi i shpejtë dhe adekuat i vendimeve të Gjykatës ka një rëndësi themelore në çështjet që kanë të bëjnë me problemet strukturore, në mënyrë të tillë që çështjet e përsëritura të shmangen nga ngarkesa e punës së Gjykatës dhe të drejtat e individëve të mbrohen në mënyrë më efektive.

## PIALOPOULOS DHE TË TJERË kundër GREQISË

(kërkesa nr. 37095/97)

15 shkurt 2001

*garancitë e parashikuara nga ana e nenit 6 § 1 të Konventës veprojnë qoftë në respektim të këtij neni në vetvete qoftë në respektim të të drejtave të tjera si ajo e pronës*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, të gjithë shtetas grekë, janë: Michael Pialopoulos, lindur më 1951 dhe banues në Pefki, Atikë; Aristophanes Alexiou, lindur në 1930 dhe banues në Filothei në Atikë; Nikolaos Georgakopoulos, vëllai nga nëna i kërkuesit të parë, lindur më 1964 dhe banues në Athinë dhe Aristeia Pialopoulos, motra e kërkuesit të parë, lindur më 1949 dhe banuese në Gjenevë.
2. Kërkuesit ankoheshin se, që nga 1987, ata kishin nuk kishin qenë në gjendje të përdornin pronën e tyre, një copë truall në të cilën dy kërkuesit e parë kishin kërkuar fillimisht të ndërtonin një godinë shumëkatëshe me dyqane, por që kjo kërkesë dhe të tjera vijuese u ishin refuzuar dhe disa përpjekje për të shpronësuar truallin e tyre, me pretendimin e ruajtjes së mjedisit.
3. Ata ankoheshin gjithashtu se, nuk ishte pretenduar që shpronësimet e truallit të tyre ishin në interes publik; autoritetet nuk kishin respektuar një vendim gjykatë që shfuqizonte një prej shpronësimeve; e drejta e brendshme ishte shkelur përderisa autoritetet kishin refuzuar të respektonin vendimet gjyqësore dhe t'u paguanin kërkuesve paraprakisht kompensim siç kërkohej nga Kushtetuta Greke dhe se ata nuk arrinin të vinin në zbatim vendimet e gjykatave që ishin në favor të tyre.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

4. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut pranoi që masat që po merreshin në shqyrtim synonin të mbronin mjedisin në një zonë ndërtimesh. Megjithatë, duke konstatuar që nuk kishte pasur një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit publik dhe mbrojtjes së të drejtave të kërkuesve, Gjykata vendosi me unanimitet se kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

#### B. Në lidhje me nenin 6 § 1

5. Gjykata në vijim konstatoi se autoritetet nuk kishin respektuar një vendim të Gjykatës së Apelit në favor të kërkuesve dhe, për këtë arsye, ajo vendosi me unanimitet

që ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës (e drejta për gjykim të drejtë). Gjykata vendosi gjithashtu që nuk ishte e nevojshme të vlerësohej nëse ka pasur shkelje të nenit 13 dhe se çështja e shpërblimit të drejtë nuk ishte gati për t'u vendosur.

### III. Koment

6. Është me vlerë të përmendet kjo çështje, sepse duhet kujtuar që garancitë parashikuara nga ana e nenit 6 nuk fillojnë dhe as mbarojnë në sallën e gjyqit. Në çështjet penale ato fillojnë sapo personi është “akuzuar” formalisht – një koncept që ka një përkufizim autonom sipas Konventës dhe i cili shpesh e ka fillimin më tepër në një fazë shumë të hershme të procesit të hetimit sesa në momentin kur hartohet dhe dorëzohet akuza. Në çështjet civile dhe në çështjet administrative me pasoja civile, garancitë e nenit 6 mund të gjejnë zbatim nga fillimi i fazës së procedurave administrative. Megjithatë, Gjykata si gjithmonë, ashtu edhe në këtë rast, e ka vënë në dukje në mënyrë të veçantë kërkesën që vendimi i gjykatave duhet zbatuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur pala kundër së cilës është dhënë vendimi është vetë shteti. Çdo moszbatim ose vonesë nga ana e shtetit në zbatimin e këtyre vendimeve do të përbëjë një shkelje të nenit 6. Nuk i takon palës që ka fituar çështjen që të rifillojë edhe një herë procedurat për të vënë në zbatim vendimet gjyqësore<sup>248</sup>. Në procedura ndërmjet privatëve, Gjykata ka vendosur se mund t'i takojë individëve që të ndërmarrin disa hapa bazë, për të njoftuar autoritetet që pala tjetër nuk ka respektuar vendimin e gjykatës<sup>249</sup>.

## VASILIU kundër RUMANISË, HODOŞ kundër RUMANISË DHE SURPACEANU kundër RUMANISË

(kërkesat nr. 29407/95, 29968/96 & 32260/96)

21 maj 2002

*vendim i Gjykatës së Lartë që hedh poshtë një vendim në kundërshtim me të drejtën e një procesi të rregullt*

### I. Faktet kryesore

#### *Vasilii kundër Rumanisë*

1. Maria Vasiliu është shtetase rumune e lindur më 1919 dhe që jeton në Bukuresht. Në shtator 1993, si trashëgimtare e të atit, ajo iu drejtua Gjykatës së Rrethit të Bukureshtit me qëllim që të vendoste në lidhje me një pronë që i kishte takuar atij. Ajo parashitri përpara Gjykatës se, për shkak se babai i saj kishte punuar në shërbimin civil, në bazë të Dekretit nr.92/1950 prona e tij nuk duhet të kishte qenë shtetëzuar. Me një vendim

<sup>248</sup> Shih vendimin e 19 marsit 1997 në lidhje me çështjen Hornsby kundër Greqisë

<sup>249</sup> Shih vendimin e 19 shtatorit 2000 në lidhje me çështjen Glaser kundër Mbretërisë së Bashkuar.

që në vijim u bë përfundimtar, Gjykata e Rrethit vendosi në favor të kërkueses dhe urdhëroi që prona t'i kthehej asaj. Me apelimin e Avokatit të Shtetit, Gjykata e Lartë e prishi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ia hoqi kërkueses titullin e pronësisë, me argumentimin se gjykatat nuk kishin kompetencë të rishikonin ligjshmërinë e Dekretit nr. 92/1950. Për këtë arsye, shteti shiti një pjesë të pronës së saj personave të tretë.

### *Hodoq dhe të tjerë kundër Rumanisë*

2. Kërkuesit janë shtetas rumunë dhe jetojnë në Bukuresht. Në maj 1990, si trashëgimtarë të babait të tyre, ata bënë një padi në Gjykatën e Rrethit të Bukureshtit me qëllim që tu njihej pronësia e tyre mbi një pronë që i kishte takuar babait të tyre. Kërkuesja parashitri përpara Gjykatës se, për shkak se babai i saj kishte punuar në shërbimin civil, në bazë të Dekretit nr. 92/1950 prona e tij nuk duhet të kishte qenë shtetëzuar. Me një vendim që në vijim u bë përfundimtar, Gjykata e Rrethit vendosi në favor të kërkueses dhe urdhëroi që prona t'i kthehej asaj. Me apelimin e Avokatit të Shtetit, Gjykata e Lartë e prishi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ia hoqi kërkuesve titullin e pronësisë me argumentimin se gjykatat nuk kishin kompetencë të rishikonin ligjshmërinë e Dekretit nr. 92/1950, duke hedhur poshtë edhe një pretendim për antikushtetutshmëri nga ana e kërkuesve. Në vijim shteti e shiti pronën e pretenduar nga kërkuesit.

### *Surpaceanu kundër Rumanisë*

3. Kërkuesit, Constantin Surpaceanu dhe Train-Victor Surpaceanu (ky i fundit duke vijuar një kërkesë të bërë fillimisht nga e motra, e cila kishte vdekur) janë dy shtetas Suedezë që jetojnë në Malmö. Një pasuri e paluajtshme që ndodhej në Rumani dhe që u përkiste atyre, u ishte konfiskuar pasi ata emigruan në Suedi. Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës së Rrethit të Bukureshtit me qëllim që kjo të vendoste në lidhje me të drejtën e tyre të pronësisë. Gjykata e Rrethit e deklaroi konfiskimin e pasurive të pavlefshme dhe pa pasoja juridike. Me një vendim që në vijim u bë përfundimtar, Gjykata e Rajonit e la në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe kërkuesit e morën në zotërim shtëpinë objekt gjykimi në shkurt 1994. Pas një apelimi nga ana e Avokatit të Shtetit, Gjykata e Lartë në shkurt 1996 e prishi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe ia hoqi kërkuesve titullin e pronësisë. Si përfundim, Këshilli Bashkiak i Bukureshtit ia ktheu pronësinë kërkuesve në mars 2001 me një vendim administrativ.

4. Në këto tre raste kërkuesit u ankuan, në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (e drejta për t'iu drejtuar gjykatave), për refuzimin e Gjykatës së Lartë për të njohur juridiksionet e gjykatave më të ulëta mbi mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtën e pronës. Ato u bazuan edhe në nenin 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e së drejtës së pronësisë) duke u ankuar se, përderisa vendimet e Gjykatës së Lartë kishin prishur vendime gjyqësore që kishin marrë formë përfundimtare, ato kishin shkelur të drejtën që ata kishin në bazë të Konventës për të gëzuar pasuritë e tyre. Në çështjen Hodoq dhe të tjerë kërkuesit pretendonin gjithashtu shkelje të nenit 6 § 1 dhe 13 (të drejtën për një mjet efektiv) për shkak të refuzimit të Gjykatës së Lartë për të pezulluar procedurat me qëllim që t'i dërgonte Gjykatës Kushtetuese kërkesën për antikushtetutshmëri që ata kishin bërë.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 6

5. Duke vënë në dukje se bërja e pavlefshëm e një vendimi gjyqësor me karakter përfundimtar është në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike në marrëdhëniet ligjore, Gjykata mbajti qëndrimin se Gjykata e Lartë në këtë mënyrë kishte shkelur të drejtën e kërkuësve për një gjykim të drejtë. Ajo në vijim vendosi se qëndrimi i Gjykatës së Lartë, sipas të cilit gjykatat nuk kishin kompetencë për të pranuar ankesa që vendosnin në lidhje me një titull pronësie, ishin në vetvete në kundërshtim me të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate. Për pasojë, Gjykata vendosi se në këto tre raste ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 për shkak të mungesës së një gjykimi të drejtë dhe mohim të së drejtës për t'iu drejtuar një gjykate.

### B. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

6. Në lidhje me kërkesat që kishin të bënin me ndërhyrjen në të drejtën e gëzimit të pronave, Gjykata vuri re se në secilin prej rasteve, titujt përkatës të pronësisë ishin njohur me vendim gjyqësor përfundimtar, duke e bërë këtë titull të parevokueshëm. Për këtë arsye ajo mbajti qëndrimin se kërkuësit kishin pasuri të tyre në kuptimin e nenit 1 të Protokollit 1.

7. Pasoja e vendimeve me anë të të cilave Gjykata e Lartë kishte bërë të pavlefshme vendimet përfundimtare të Gjykatës së Rrethit të Bukureshtit dhe shpallur shtetin si pronar me të drejta të plota në lidhje me pronat në fjalë, kishte qenë ajo e privimit të kërkuësve nga pronat e tyre. Gjykata vuri në dukje se kërkuësit ishin privuar nga pronat e tyre mëse pesëdhjetë vjet më parë në rastet e Vasiliu dhe Hodoş dhe më se pesë vjet më parë në rastin e Surpaceanu. Në këto rrethana, edhe duke supozuar se privimi nga pronat mund t'i kishte shërbyer ndonjë interesi publik, Gjykata vlerësoi se baraspesha e drejtë që duhet mbajtur ndërmjet kërkesave të interesit përgjithshëm të bashkësisë dhe atyre të mbrojtjes të të drejtave themelore të individit ishte cenuar, dhe se kërkuësit kishin mbajtur dhe vazhdonin të mbanin mbi vete një barrë të tepruar. Për këtë arsye ajo vendosi me unanimitet se në këto tre raste ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1. Ajo në vijim vendosi se nuk ishte e nevojshme të merreshin në shqyrtim ankesat e tjera të bëra nga kërkuësit në kuadrin e çështjes Hodoş.

### C. Në lidhje me nenin 41

8. Gjykata vendosi se, duke qenë se nuk ia kishte kthyer Znj. Vasiliu apartamentin që i takonte dhe pjesën tjetër të ndërtesës që ajo kishte paguar më 1974 brenda tre muajve nga data kur vendimi ishte bërë përfundimtar, Rumania duhet t'i paguante asaj 186 000 euro për dëm material dhe 19 000 euro për dëm jomaterial.

9. Në rastin Hodoş Gjykata vendosi se, duke qenë se prona nuk u ishte kthyer kërkuësve brenda tre muajve nga data kur vendimi u bë përfundimtar, Rumania duhet tu paguante atyre së bashku shumën prej 195 000 euro për dëm material dhe 19 500 euro për dëm jomaterial.



10. Së fundmi, në çështjen Surpaceanu, Gjykata u akordoi kërkuesve shumën prej 8 000 euro për dëm material.

### III. Koment

11. Këto tre vendime kanë të bëjnë me një aspekt të nenit 6 i cili u trajtua edhe në kuadrin e çështjes Burdov.

12. Në çështjet rumune Gjykata zbatoi dy parimet që ajo kishte formuluar në vendimin e saj të 28 tetorit 1999 në lidhje me çështjen Brumarescu kundër Rumanisë<sup>250</sup>. Pasi një vendim të ketë marrë karakter përfundimtar në të drejtën e brendshme, ai nuk mund të bëhet i pavlefshëm, duke dëmtuar një nga palët, me një vendim tjetër gjyqësor që e rishikon atë. Po ashtu nuk është e pranueshme në bazë të nenit 6, që gjykatat të mos e njohin juridiksionin e tyre në lidhje me zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që ka të bëjë qartazi me çështje të të drejtave me karakter civil, të njohura në të drejtën e brendshme. Në vendimin e saj të 10 majit 2001 në lidhje me çështjen “Z kundër Mbretërisë së Bashkuar”, Gjykata mbajti qëndrimin se, një individ që ngre një pretendim për një të drejtë me karakter civil duhet të ketë mundësi t’i drejtohet një gjykate, e cila ka kompetencë për të vendosur nëse një mosmarrëveshje ka të bëjë apo jo me një të drejtë me karakter civil, të njohur nga e drejta e brendshme.

## WITTEK kundër GJERMANISË

(kërkesa nr. 37290/97)

12 dhjetor 2002

*kjo çështje ka të bëjë me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mbi pronën të lindura pas bashkimit të dy Gjermanive*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Sabine dhe Harro Wittek, janë të dy shtetas gjermanë të lindur respektivisht më 1958 dhe 1948 dhe jetojnë në Gjermani. Në maj 1986 ata blenë një shtëpi në Lajpcig, në Republikën e atëhershme Demokratike Gjermane (R.D.GJ.) për një shumë prej 56 000 markash gjermano-lindore. Shtëpia ishte ndërtuar në një truall që i përkiste shtetit, por në lidhje me të cilin ata fitonin të drejtën e uzufuktit në bazë të nenit 287 e vijim të Kodit Civil të R.D.GJ.-së

2. Kërkuesit pranuan se, Departamenti i Punëve të Brendshme të Këshillit Bashkiak të Lajpcigut u kishte bërë të ditur se në qoftë se ata dëshironin të largoheshin nga R.D.GJ., ata duhet të hiqnin dorë nga pronësia e tyre mbi shtëpinë, qoftë duke e

<sup>250</sup> Vendim i përfshirë në këtë përmbledhje.

shitur ose falur atë. Më 8 dhjetor 1989 ata, me akt noterial, ia bënë dhuratë zyrtarisht shtëpinë një çifti, megjithëse në fakt këta u paguan kërkuesve 55 000 marka gjermano – perëndimore (DEM) në një llogari në një bankë zvicerane. Kërkuesit pretendojnë se shtëpia dhe trualli tani vlejnë rreth 600 000 DEM, gjë të cilën qeveria gjermane e mohonte, duke argumentuar se kërkuesit kishin vetëm të drejtën e uzufuktit mbi truallin.

3. Pas bashkimit të Gjermanive, kërkuesit pretenduan që t'i rifitonin të drejtat e tyre mbi shtëpinë si dhe të drejtën e uzufuktit drejtpërdrejt nga blerësit. Në vijim ata bënë një padi në një gjykatë civile. Gjykata Federale e Drejtësisë vendosi se mosmarrëveshja ishte nën juridiksionin e gjykatave administrative, përderisa gjente zbatim ligji i 23 shtatorit 1990, “Mbi Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Veçanta në lidhje me Çështjet e Pronësisë”, – që tani e tutje do ta quajmë Ligji për Pronësinë. Ky ligj parashikonte që ish shtetasit e R.D.GJ.-së kishin të drejtë t'u kthehej prona e tyre, në rast se ata kishin qenë të detyruar ta tjetërsonin atë, me qëllim që të lejoheshin të largoheshin në mënyrë të ligjshme nga vendi.

4. Kërkuesit filluan procedurat edhe përpara gjykatave administrative. Gjykata Administrative Federale konstatoi se, kushtet e parashikuara në seksionin 1 (3) të Ligjit për Pronësinë nuk ishin përmbushur, përderisa kërkuesit nuk kishin qenë të detyruar ta dhuronin shtëpinë me qëllim që të largoheshin nga R.D.GJ.-ja pas rihapjes së kufirit më 9 nëntor 1989 dhe nuk treguan se ishin shtyrë që ta tjetërsonin atë, duke rënë viktimë të praktikave mashtruese ose të padrejta. Në dy vendime të 22 janarit 1997, Gjykata Kushtetuese Gjermane i hodhi poshtë kërkesat e kërkuesve të bëra kundër vendimeve të gjykatave civile dhe administrative.

5. Kërkuesit ankoheshin në bazë të nenit 1 të Protokollit 1 (mbrojtja e pronës) me argumentin se refuzimi nga gjykatat gjermane i dhënies së vendimit të kthimit të pronës së tyre në ish- R.D.GJ., përbënte një ndërhyrje ndaj të drejtës së tyre për gëzimin e lirë të pronës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

6. Gjykata vuri re se Gjykata Federale e Drejtësisë kishte vendosur që tjetërsimi i pronës së kërkuesve në kohën e R.D.GJ.-së ishte nul dhe pa pasoja juridike. Përderisa kërkuesit nuk kishin mundur të mbështeteshin në të drejtën e tyre të kthimit të pronës përpara gjykatave gjermane, Gjykata vlerësoi se ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e tyre të gëzimit të plotë të pronave të tyre dhe se kjo ndërhyrje ishte bazuar në dispozitat e Ligjit për Pronësinë.

7. Përderisa ky ligj ishte miratuar me qëllim që të zgjidhte mosmarrëveshjet mbi pronësinë, të lindura si pasojë e ribashkimit gjerman duke baraspeshuar interesat e ndryshme, të pranueshme nga pikëpamja sociale, Gjykata ishte e mendimit se ndërhyrja kishte ndjekur një qëllim që ishte në interes të përgjithshëm. Përsa i

përket çështjes nëse kjo ndërhyrje ishte proporcionale apo jo, Gjykata vuri në dukje se Gjykata Administrative e Lajpcigut kishte arritur në përfundimin se nuk kishte pasur ndonjë praktikë të padrejtë në këtë çështje, sipas kuptimit të seksionit 1 (3) të Ligjit mbi Pronësinë. Në fakt kërkuesit e kishin tjetërsuar pronën e tyre thujse një muaj pasi kufiri ishte rihapur, pra kishin pasur mundësi që të largoheshin nga vendi në liri të plotë pa qenë të detyruar ta tjetërsonin atë. Gjykata vuri gjithashtu në dukje se, ata e kishin blerë shtëpinë për një shumë prej 56 000 markash gjermano-lindore në maj 1986, dhe në dhjetor 1989 e kishin shitur 55 000 DEM, shumë që ishte e barazvlefshme me 220 000 marka gjermano lindore. Për këtë arsye, edhe pse vlera e pronës ishte rritur që nga blerja, nuk mund të thuhet se kërkuesit kishin përballuar një “barrë jo proporcionale”.

8. Duke pasur parasysh faktorët e mësipërm si dhe rrethanat përjashtimore të ribashkimit gjerman, Gjykata konstatoi se Gjermania nuk e kishte kapërcyer hapësirën e saj të vlerësimit, dhe se duke vlerësuar objektivin legjitim, nuk kishte dështuar në mbajtjen e “një baraspeshe të drejtë” ndërmjet interesave të kërkuesve dhe interesit të përgjithshëm të shoqërisë gjermane. Për pasojë Gjykata mbajti qëndrimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.

### III. Koment

9. Gjykata ka theksuar vazhdimisht se shtetet kanë të drejtë t'i zgjidhin problemet që lindin si pasojë e privatizimit, kthimit të pronës dhe skemave të kompensimit të saj, në një mënyrë që ato e vlerësojnë si më të përshtatshme në rrethanat e tyre specifike. Në rastet kur legjislativi e ka bërë zgjidhjen e tij, me nxjerrjen e ligjeve të caktuara që ai i konsideron se janë në interesin e përgjithshëm, ekzistenca e mundshme e zgjidhjeve të tjera, në vetvete, nuk i humbet legjitimitetin legjislativ të ankimuar. Në qoftë se ky ngelet brenda kufijve të hapësirës së vlerësimit, atëherë nuk i takon Gjykatës që të thotë nëse ky legjislacion përfaqëson zgjidhjen më të mirë<sup>251</sup>.

10. Në një çështje tjetër<sup>252</sup> që kishte të bënte me probleme të ngjashme, kërkuesit kishin fituar një pronësi kur pronarët e mëparshëm ishin larguar nga R.D.GJ., por Gjykata, në kundërshtim me çështjen Wittek, konstatoi se kërkesa nuk ishte e bazuar sepse ligji mbi kthimin e pronës ishte zbatuar siç duhej nga gjykatat e brendshme.

<sup>251</sup> Shih vendimin e 23 marsit 1999 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjen Ceskomoravska myslivecka jednota kundër Republikës Çeke, ku Gjykata vendos papranueshmërinë e kërkesës.

<sup>252</sup> Vendimi i 4 tetorit 2001 i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjen Teuschler kundër Gjermanisë ku Gjykata vendos papranueshmërinë e kërkesës.

## JASIÛNIENË kundër LITUANISË

(kërkesa nr. 41510/98)

6 mars 2003

*kjo çështje kishte të bënte me rikthimin e pronës private në Lituani, në situata të ngjashme me ato që hasen si në Shqipëri ashtu edhe në vende të tjera ish-komuniste*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Znj. Jasiūnienė, ka lindur më 1923 dhe jeton në Lituani. E ëma e saj, e vdekur tashmë, kishte pasur në pronësi një shtëpi në një zonë turistike në detin Baltik. Pas pushtimit Sovjetik të Lituanisë më 1940, trualli u shtetëzua dhe shtëpia u prish në vitet 1960. Këshilli Bashkiak i qytetit Palanga dha një vendim më 25 shtator 1992, duke i kthyer të drejtën e pronësisë mbi tokën e nënës së tyre, kërkueses dhe së motrës. Sidoqoftë, vendimi nuk u vu në zbatim dhe për më tepër, nuk u ofrua asnjë kompensim.
2. Në janar 1995 kërkuesja nisi procedurat kundër autoritetit lokal për kthimin e truallit. Gjykata e Rrethit e hodhi poshtë kërkesën e saj për kthimin e truallit, por vendosi se kërkueses duhet t'i ofrohej një parcelë tjetër trualli për kompensim. Kërkuesja apeloj kundër këtij vendimi duke refuzuar kompensimin dhe Gjykata e Rajonit, (instancë apeli) më 3 prill 1996, e prishi vendimin e Gjykatës së Rrethit, duke ia kthyer çështjen autoritetit lokal. Ajo i kërkoi zyrës së përmbartimit që të vinte në ekzekutim vendimin e Gjykatës së Rajonit, por ata nuk qenë në gjendje ta bënin një gjë të tillë. Kryetari i Komunës e paralajmëroi se në qoftë se ajo nuk zgjidhte një parcelë tjetër trualli, do t'i jepej një e tillë pa pëlqimin e saj. Më 31 dhjetor 1997 kërkuesja u ankua pranë zyrës së Kryeministrit për shkak se parcelat që i ishin ofruar gjendeshin në rrethinat e qytetit dhe kishin pra një vlerë më të vogël se trualli i së ëmës që ajo pretendonte. Më 30 gusht 1999, kërkuesja u vu në dijeni se ajo nuk kishte arritur të provonte pronësinë e së ëmës mbi truallin origjinal dhe për pasojë nuk mund të merrej asnjë vendim për kompensim derisa të ofrohej një provë e tillë.
3. Kërkuesja pretendonte se shtetëzimi dhe shkatërrimi i pronësisë së të ëmës nga autoritetet sovjetike dhe paaftësia e autoriteteve lituaneze për t'ia kthyer ose kompensuar atë truall shkelte nenin 1 të Protokollit 1, të marrë qoftë vetëm qoftë së bashku me nenin 14. Ajo ankohej gjithashtu, se mosekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Rajonit më 3 prill 1996 shkelte nenet 6 dhe 13 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

4. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi edhe një herë që e drejta për t'iu drejtuar një gjykate, e mishëruar në nenin 6 të Konventës, do të ishte krejt iluzive dhe e kotë nëse një vendim gjyqësor me karakter përfundimtar dhe të detyrueshëm lihej i pazbatuar, në dëm të ndonjërës nga palët. Gjykata e Rajonit nuk e kishte mohuar thelbin e pretendimit të kërkueses mbi pronën, por thjesht u kishte kërkuar autoriteteve që të zgjidhnin formën e kompensimit që i duhej dhënë asaj. Duke dështuar në ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor, autoritetet lituaneze e kishin privuar në fakt nenin 6 § 1 të Konventës nga çdo efekt i dobishëm. Për këtë arsye ka pasur shkelje të këtij neni. Nga ana tjetër, nuk ishte e nevojshme që të merrej në shqyrtim kërkesa edhe nën këndvështrimin e nenit 13, përderisa kërkesat e dispozitës së këtij neni thithen nga ato dispozitës së nenit 6 § 1.

### B. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1

5. Gjykata vuri në dukje se ajo nuk kishte kompetencë për ta shqyrtuar ankimin e kërkueses në lidhje me shtetëzimin e truallit në pronësi të së ëmës dhe me shkatërrimin e shtëpisë së saj, sepse ato lidheshin me ngjarje që kishin ndodhur përpara hyrjes në fuqi të Konventës dhe të Protokollit 1, në raport me Lituanië. Pra, nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1, të marrë veçmas ose së bashku me nenin 14 të Konventës, në këtë këndvështrim.

6. Në lidhje me ankesën e kërkueses se ajo nuk kishte pasur mundësi të rimerrte një truall të tillë pas rikrijimit të shtetit Lituanëz, Gjykata theksoi se Konventa, në vetvete, nuk e garanton të drejtën e kthimit të pronës. Shpresa se një pronë e harruar prej vitesh mund të rimerrret nuk mund të shihet si një "pasuri" për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës. Ishte e qartë se kërkesja nuk kishte asnjë shpresë të bazuar në ligj për kthimin e truallit sipas zgjidhjes normative lituaneze të zbatueshme dhe se autoriteteve iu kërkohej vetëm që t'i akordonin asaj kompensim në natyrë ose në të holla. Neni 1 i Protokollit 1 nuk ishte pra i zbatueshëm në lidhje me këtë ankesë. Përderisa neni 14 nuk mund të merret në shqyrtim i vetëm, atëherë as ai nuk mund të gjente zbatim këtu. Pra, nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të marrë veçmas ose së bashku me nenin 14.

7. Përsa i përket paaftësisë së autoriteteve për të vënë në zbatim vendimin e Gjykatës së Rajonit, Gjykata e Strasburgut theksoi se një pretendim mund të arrinte të përbente një pasuri për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1, në qoftë se ka mundësi konkrete që të realizohet në praktikë. Vendimi i Gjykatës Rajonale e ka pajisur kërkuësin me një pretendim konkret që arrin të përbëjë një "pasuri" për qëllimet e Konventës. Për këtë arsye, pamundësia për të vënë në zbatim këtë vendim përbën një ndërhyrje ndaj së drejtës së saj për të gëzuar e qetë pasuritë e saj. Autoritetet lituaneze e kishin penguar kërkuësen që të merrte kompensimin që ajo priste të merrte në mënyrë të natyrshme dhe se Qeveria nuk kishte ofruar asnjë justifikim të kënaqshëm për këtë ndërhyrje. Për këtë arsye Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje

të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me moszbatimin e vendimit Gjykatës së Rajonit.

### C. Në lidhje me Nenin 41

8. Gjykata i akordoi kërkueses 9 000 euro për dëm material.

### III. Koment

9. Ky vendim i rëndësishëm përmbledh në mënyrë fare të shkurtër mjaft prej problemeve të debatueshme që ngrihen në lidhje me kthimin e pronës private në Shqipëri, ashtu si edhe në shtete të tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe në ish Bashkimin Sovjetik.

10. Duhet theksuar se në bazë të Konventës nuk ekziston një e drejtë për të rifituar një titull pronësie që ishte shuar për shumë vjet me radhë nën regjimin komunist. Gjithashtu nuk mund të thuhet se ka ndonjë të drejtë për kompensim për një pronë që ishte konfiskuar ose shtetëzuar gjatë regjimit të vjetër. Në rastet kur shtetet kanë ngritur në këmbë një sistem për kthimin e pronës së konfiskuar ose për kompensimin e pronës që ose është prishur, ose është konfiskuar dhe kur kjo e drejtë është konfirmuar rregullisht nga një autoritet kompetent kombëtar, e drejta 'e konfirmuar' për kthimin ose kompensimin e pronës përbën një "pasuri" për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1 dhe për pasojë ky i fundit gjen zbatim.

11. Mosekzekutimi nga ana e autoriteteve shtetërore të një vendimi gjyqësor, i cili ka urdhëruar qoftë kthimin e pronës qoftë kompensimin në qoftë se kthimi nuk është i mundur, përveç nenit 1 të Protokollit 1, do të çonte në shkelje edhe të nenit 6 § 1 të Konventës. E drejta për një gjykim të drejtë, siç garantohet nga ana e nenit 6 § 1, përfshin edhe të drejtën për një ekzekutim të shpejtë të vendimit gjyqësor. Vonesat e pajustificueshme në pagimin e kompensimit mund të shkelin nenin 6, në të njëjtën mënyrë si edhe vonesat në marrjen e vendimit në lidhje me çdo mosmarrëveshje mbi të drejtën e pronësisë ose mbi shumën e kompensimit që duhet akorduar. Pra vetëm në rastin kur e drejta e pronësisë është njohur dhe realizuar qoftë nëpërmjet kthimit ose kompensimit kërkesat e neneve 6 dhe 1 të Protokollit 1 plotësohen dhe këto nene gjejnë zbatim.



## VASILESCU kundër RUMANISË

(kërkesa nr. 27053/95)

22 maj 1998

*ky vendim ka të bëjë me një rast të mbajtjes e sendeve me vlerë të marra në mënyrë të paligjshme nga milicia më 1966 por që konsiderohet si shkelje e Konventës e cila në atë kohë nuk kishte veprim ligjor në Rumani*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja, Elisabeta Vasilescu ishte shtetase rumune e lindur më 1897. Më 23 qershor 1966, oficerë të policisë lokale ushtruan një kontroll në shtëpinë e saj pa asnjë lloj paralajmërimi. Ky kontroll kishte të bënte me një hetim që policia kishte filluar ndaj bashkëshortit të kërkueses për mbajtje të sendeve me vlerë, akt që përbënte shkelje penale sipas legjislacionit në fuqi në atë kohë. Policia gjeti dhe konfiskoi 327 monedha ari, të cilat ishin të një prerje të tillë që e kushtëzonte shfrytëzimin e tyre vetëm për qëllime bizhuterie. Në qershor 1966 policia vendosi që të mos e vazhdonte ndjekjen penale ndaj bashkëshortit të kërkueses dhe e mbylli dosjen. Megjithatë ata vendosën që ti mbanin monedhat.
2. Në maj 1990 kërkuesja paraqiti një kërkesë për kthim sendi pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Rumanisë. Në tetor 1990 Prokurori i Përgjithshëm iu përgjigj që nuk kishte pasur ndonjë urdhër për konfiskim ose paralajmërim për kontroll, qoftë më 1966, qoftë edhe më pas. Më 1991 kërkuesja bëri një padi për rifitimin e pronësisë të 40 monedhave të arta. U zhvillua një numër mjaft i madh seancash gjyqësore dhe më së fundi, në tetor 1994, Gjykata e Lartë arriti në përfundimin se gjykatat civile nuk kishin juridiksion për të urdhëruar kthimin e monedhave sepse ishte Këshilli i Shtetit i rajonit përkatës, organi i vetëm që mund ta pranonte kërkesën e kërkueses për kthimin e sendeve në fjalë.
3. Kërkuesja iu drejtua Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut më 1995 duke pretenduar shkelje të neneve 8 dhe 6 § 1 dhe të nenit 1 Protokollit 1 të Konventës. Ky i fundit shprehu mendimin e tij, sipas të cilit, në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 dhe të nenit 1 të Protokollit 1, por nuk ka pasur shkelje të neneve 8 dhe 13 të Konventës.

### II. Vendimi i Gjykatës

#### A. Në lidhje me nenin 6 § 1 i Konventës

*i. Mbi prapësimet paraprake të ngritura nga ana e qeverisë për mosshtrim të të gjitha mjeteve të brendshme ligjore)*

4. Një prapësim i tillë nuk ishte ngritur përpara Komisionit - veprimi i parimit të *estoppelit*. Për këtë arsye, Gjykata vendosi me unanimitet se prapësimi paraprak i ngritur nga ana e qeverisë rumune nuk pranohej.

*ii. Mbi faktet që kanë lidhje me kërkesën*

5. Në lidhje me pretendimin e ngritur për shkelje të paragrafit 1 të nenit 6, nuk u kundërshtua se kërkesja kishte qenë pronare e monedhave për të cilat diskutohej. Gjykata e Lartë kishte prishur vendime të mëparshme të gjykatave civile, të cilat urdhëronin kthimin e pronësisë dhe arriti në përfundimin se këto gjykata kishin shkelur në kompetencat ekskluzive të Këshillit të Shtetit. Gjykata e Lartë kishte qenë e mendimit që, për shkak të faktit se kërkesa e kërkeses për kthimin e pronësisë kishte të njëjtin rol me një ankim kundër një mase me karakter hetimor penal, ishte vetëm Këshilli i Shtetit të rajonit të Arges i vetmi që kishte juridiksion që të vendoste në lidhje me të.

6. Në këtë kuadër mbahej parasysh se, edhe atje ku Këshilli i Shtetit për një rajon ushtronte pushtete të një karakteri gjyqësor, ai vepronte si anëtar i drejtorisë së Prokurorit të Përgjithshëm, i cili varej pikësisht nga Prokurori i Përgjithshëm i Rumanisë si dhe nga Ministri i Drejtësisë, pra ishte e qartë që kishte varësi nga ekzekutivi dhe nuk ofronte garancitë e një instance me karakter gjyqësor. Pra sipas mendimit unanimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut kishte pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 6.

### **B. Në lidhje me nenin 13**

7. Neni 6 § 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka karakterin e një *lex specialis* në raport me nenin 13 po të Konventës. Për këtë shkak, mund të thuhet se kërkesat e nenit 13 ishin shtruar nga ato të nenit 6 § 1. Për këtë arsye Gjykata arriti njëzëri në përfundimin se nuk kishte nevojë pra, që të vlerësohej zbatueshmëria e nenit 13 në lidhje me kërkesën në fjalë.

### **C. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1**

8. Duke qenë se konsiderohej e pranueshme se mbajtja e pronësisë në rastin në fjalë nga ana e milicisë kishte qenë e paligjshme dhe që kërkesja kishte qenë pronare e ligjshme e kësaj pronësie, për pasojë mund të thuhet se kërkesja kishte vazhduar të ishte pronare e saj. Ishte e vërtetë që Rumania nuk e kishte njohur juridiksionin e Gjykatës deri më 20 qershor 1994, por vendimi i Gjykatës së Lartë së Rumanisë datonte më vonë se 20 qershori 1994 dhe ankesa e kërkeses kishte të bënte me një situatë që vazhdonte të ekzistonte ende.

9. Duke pasur parasysh se nuk kishte asnjë bazë ligjore, mbajtja, e cila vazhdonte ende, e të mirave materiale të trajtuara në rastin në fjalë, nuk do të mund të interpretohej si një privim posedimi ose kontroll i përdorimit të pronësisë, të lejueshme nga ana e nenit 1 të Protokollit 1.

10. Kërkesja kishte fituar një vendim gjyqësor i cili urdhëronte autoritetet përkatëse që t'i kthenin asaj të mirat materiale të pretenduara. Ky vendim nga njëra anë - siç u

tha edhe më lart - ishte hedhur poshtë nga ana e Gjykatës së Lartë të Rumanisë dhe nga ana tjetër përpjekjet e mëparshme pranë Këshillit të Shtetit të rajonit, i cili ishte konsideruar se kishte kompetencë ekskluzive, nuk kishin pasur ndonjë sukses më të madh.

11. Pra humbja nga ana e kërkueses për të disponuar sendet në pronësi të saj, e marrë në konsideratë bashkë me përpjekjet e kota të deriatëhershme për ta ndrequr gjendjen përpara autoriteteve dhe gjykatave të brendshme, sillte pasoja aq të rënda saqë kërkuesja të konsiderohej si e dëmtuar *de facto* nga një konfiskim që ishte në kundërshtim me të drejtën e saj për gëzimin paqësor të pronës së saj. Pra Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të këtij neni.

#### D. Në lidhje me nenin 8

12. Duke pasur parasysh përfundimet në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1, Gjykata nuk e pa të nevojshme që ta shqyrtonte rastin në fjalë edhe në lidhje me nenin 8. Gjykata me unanimitet vendosi se nuk kishte nevojë të shprehej në lidhje me pretendimin në fjalë.

#### E. Në lidhje me nenin 50 (aktualisht neni 41)

13. Në lidhje me dëmin material, qeveria nuk kishte qenë në gjendje që të kthente pronësinë në lidhje me të mirat materiale në fjalë. Për këtë arsye, u pa e nevojshme të akordohej një kompensim *ex æquo et bono*. Në lidhje me dëmin jo-material gjithashtu u akordua një kompensim mbi bazën e kriterit *ex æquo et bono*. Pra Gjykata vendosi që shteti i paditur duhet t'i paguante kërkueses shumat e specifikuar në lidhje me dëmin material dhe me atë jomaterial. Kjo shumë u llogarit të ishte 90 000 FF.

14. Në lidhje me shpenzimet dhe pagesat ligjore pretendimi nuk u arrit të matej në terma sasiore. Për këtë shkak rimbursim u bë mbi baza barazie. Si përfundim Gjykata vendosi se shteti i paditur duhet t'i paguante kërkueses shumat e specifikuar në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

### III. Koment

15. Vendimi në lidhje me këtë çështje ka një rëndësi tepër të madhe për situata si ato që kanë ndodhur dhe ndodhin ende edhe në realitetin shqiptar. Interesi qëndron konkretisht në zbatimin *ratione temporis* të dispozitave të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të juridiksionit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

16. Në këtë çështje, pavarësisht se konfiskimi i pasurive të Znj. Vasilescu ishte bërë përpara hyrjes në fuqi Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për Rumaninë, pra më 1966, fakti që ky konfiskim kishte qenë dhe vazhdonte të ishte i paligjshëm, fakti që ajo vazhdonte të ishte pronare e këtyre pasurive edhe pas hyrjes në fuqi të Konventës në Rumani dhe se Gjykata e Lartë rumune e kishte njohur, qoftë edhe në mënyrë indirekte, këtë fakt me një vendim pas hyrjes në fuqi të Konventës në Rumani, Konventa u konsiderua e zbatueshme *ratione temporis*.

17. Formula e shprehur në këtë vendim, pra që Konventa mund të gjejë zbatim edhe në lidhje me situata që kanë ndodhur përpara hyrjes së saj në fuqi në vendin përkatës, por që vazhdojnë t'i shprehin pasojat e tyre në dëm të të drejtave të garantuara prej saj pas hyrjes në fuqi, është e rëndësishme të kuptohet, vlerësohet dhe eventualisht të interpretohet në lidhje me situatat shqiptare të shpronësimeve, konfiskimeve apo sekuestrimeve të periudhës së komunizmit. Kjo formulë, për mendimin tim (L.B), mund të jetë me vlerë edhe për rastin e pasurive të shqiptarëve të dëbuar nga Greqia dhe që nuk kanë pasur mundësi efektive për të shtënë në dorë përsëri pasuritë e tyre.

# PROTOKOLLI 1

## NENI 2

**E DREJTA PËR ARSIMIM**

## ÇËSHTJA GJUHËSORE BELGE<sup>253</sup>

(kërkesat nr. 1474/62, 1677/62, 1691/62, 1769/63, 1994/63 & 2126/64)

23 korrik 1968

*shteti duhet të garantojë gjithësesi të drejtën efektive për arsim për të gjithë pa asnjë diskriminim pavarësisht se nuk ka për detyrë të ngrejë një sistem të arsimor të ndonjë lloji të veçantë*

### I. Faktet kryesore

1. Çështja e ka zanafillën në pretendimet e 324 banuesve të Alsebergut, Beerselit, të Kraainemit, Anversës, Gandit, Lëvenit dhe Vilvordës mbi pamundësinë e tyre dhe në veçanti të fëmijëve të tyre për të mësuar në gjuhë e tyre të origjinës, franceze, në rajonin ku ata banonin në shtetin Belg. Me përjashtim të Kraainem, që i përkiste që nga 1963 një njësie administrative të veçantë me një statut të tij, këto rrethe i përkisnin një rajoni të përcaktuar nga ligji "me gjuhë holandeze". Popullsia e tyre përfshinte një pjesë të konsiderueshme frankofonësh.

2. Kërkesit, nëna dhe baballarë me shtetësi belge bënë të qartë se bëhej fjalë si për ta, ashtu edhe për fëmijët e tyre, numri i të cilëve i kalonte 800. Duke nënvizuar faktin se ata ishin frankfonë ose se ata shpreheshin më shpesh në frëngjisht, dëshironin që fëmijët e tyre të mësonin në këtë gjuhë. Ankimet e tyre i kundërviheshin një sërë dispozitash të legjislacionit belge, dhe kryesisht ligjit të 30 korrikut 1963 në lidhje me regjimin gjuhësor të mësimdhënies, i cili kishte abroguar dy ligje të vitit 1932, që ishin në fuqi gjatë hetimit lidhur me kërkesat e para. Ata e akuzonin shtetin belge se nuk organizonte asnjë lloj mësimdhënie në gjuhën frënge në komunat ku ata banonin, ose se në rastin e Kraainem, organizimi i mësimdhënies ishte i pamjaftueshëm. Ata ankoheshin gjithashtu se shkollat, të cilat në të njëjtat komuna nuk i përgjigjeshin klauzolave gjuhësore të legjislacionit arsimor, privoheshin nga subvencionet dhe se refuzonte njohjen e disa certifikatave shkollore të lëshuara nga këto shkolla. Në vijim pretendonin disa klasa në gjuhën frënge që ekzistonin në disa vende u mbyllën dhe se prindërit detyroheshin ose t'i dërgonin fëmijët në një shkollë lokale, zgjidhje të cilën ata e vlerësonin në kundërshtim me aspiratat e tyre, ose t'i dërgonin ata të studionin në lagjen Bruksel-qendër, ku gjuha e mësuar qe holandishtja ose frëngjishtja, sipas gjuhës amtare ose të zakonshme të fëmijës, ose në Valloni. Por një "emigrim shkollor" do të shkaktonte rreziqe të mëdha dhe të padëshirueshme.

3. Gjashtë kërkesa të paraqitura Komisionit, nga qershori 1962 deri në janar

<sup>253</sup> Titulli i plotë i është "çështja në lidhje me disa aspekte të legjislacionit mbi përdorimin e gjuhëve në sistemin arsimor në Belgjikë kundër Belgjikës", në Recueil A 5 (vendimi mbi pretendimet paraprake i 9 shkurtit 1967) dhe A 6 (vendimi mbi themelin i 23 korrikut 1968)



1964, kishin si objekt kryesor mungesën ose pamjaftueshmërinë e strukturave të mësimdhënies në frëngjisht në rajonin Flamand të Belgjikës. Kërkuetit, pra prindërit, denoncuan shkëljen e neneve 8, 9, 10 dhe 14 të Konventës si dhe të nenit 2 të Protokollit 1. Komisioni i deklaroi të gjashtë kërkesat vetëm pjesërisht të pranueshme (ai i deklaroi të papranueshme pretendimet në lidhje me nenet 9 dhe 10) dhe u shpreh për të gjitha kërkesat bashkërisht. Në raportin e 24 qershorit 1965, Komisioni shprehu mendimin se nëse legjislacioni belg respektonte në mënyrë të kënaqshme nenet e pretenduara nga kërkuetit, ai nuk i përgjigjej, në tre pika, kërkesave të fjalisë së parë të nenit 2 të Protokollit 1, të ndërthurur me nenin 14 të Konventës. Para së gjithash, ai provokonte heqjen e plotë të subvencioneve për shkollat rajonale, komunale ose private që zbatonin, një mësimdhënie të plotë ose të pjesshme në një gjuhë tjetër. Në vazhdim, legjislacioni belg pengonte disa fëmijë, vetëm për shkak të vendbanimit të prindërve të tyre, që të kishin mundësi të shkonin në shkollat e gjuhës franceze që ekzistonin në Lëven dhe në gjashtë bashkësitë dygjuhësore të periferisë së Brukselit. Së fundi, ky legjislacion që pas vitit 1932, përmbante refuzimin për barasvlefshmërinë e certifikatave që përcaktonin studimet tetëvjeçare që nuk ishin në përputhje me parashikimet gjuhësore.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me pretendimet paraprake

4. Paraprakisht, qeveria belge kundërshtonte kompetencën e Gjykatës. Ajo pretendonte se Konventa dhe Protokollit 1 nuk zbatohet në fushat që kishin lidhje me çështjen dhe se këto fusha i përkisnin "kompetencave të rezervuara" të Shteteve. Ajo i kërkonte Gjykatës të pranonte këtë pretendim paraprak ose ta përfshinte në gjykimin në themel të çështjes. Në vendimin e saj të 9 shkurtit 1967 mbi pranueshmërinë, Gjykata e refuzoi njëzëri këtë pretendim. Ajo theksoi në fakt se të gjitha ankesat e prindërve të interesuar ngrinin çështje për interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe se këto çështje janë të pandashme me themelin. I njëjti arsyetim u ndoq edhe për nocionin e kompetencave të rezervuara shtetërore.

### B. Mbi themelin

5. Gjykata e dha vendimin e saj në lidhje me themelin e çështjes më 23 korrik 1968. Përpara se të shqyrtonte gjashtë problemet specifike të ngritura si nga Komisioni ashtu edhe nga qeveria belge, Gjykata mori në shqyrtim problemet me karakter më të përgjithshëm, lidhur me kuptimin dhe vlerat e nenit 2 të Protokollit nr 1 dhe të neneve 8 dhe 14 të Konventës. Ajo vlerësoi se përgjigjja që i duhej dhënë problemeve të veçanta varej, deri në njëfarë mase, nga zgjidhja e problemeve të karakterit të përgjithshëm.

### C. Në lidhje me nenin 2 të Protokollit 1

6. Në interpretimin e përgjithshëm që bëri, Gjykata theksoi së pari se fjalia e parë e nenit 2 të Protokollit 1 shpall të drejtën për arsimim. Ajo konstatoi se të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që në kohën e nënshkrimit të Protokollit dhe ende në ditën e shqyrtimit të çështjes prej saj, kishin një sistem arsimimi të përgjithshëm dhe

zyrtar. Ajo arriti në përfundimin se nuk qe e mundur dhe se nuk është e mundur të detyrohej çdo shtet të krijonte një sistem specifik, por vetëm se ai duhet t'i garantonte personave që ndodhen nën juridiksionin e shteteve palë të drejtën e arsimit me mjete të disponueshme në një çast të dhënë. Kjo sjell të drejtën e hyrjes në shkollat ekzistuese si dhe të drejtën për të përfituar, në përputhje me rregullat në fuqi të çdo shteti, në një formë ose në një tjetër, njohjen zyrtare të studimeve të bëra. Gjykata theksoi se Konventa nuk parashikon detyrime të përcaktuara dhe në veçanti, nuk përcakton gjuhën në të cilën mësimi duhet dhënë. Së fundi, ajo pranoi se e drejta për arsimim kërkon nga natyra e saj një rregullim shtetëror, i cili nuk duhet të shkelë thelbin e kësaj të drejte dhe as të dëmtojë të drejta të tjera të parashikuar nga Konventa.

7. Më pas, Gjykata mori në shqyrtim fjalinë e dytë të nenit 2 të Protokollit 1. Kjo dispozitë që e detyron shtetin të respektojë të drejtën e prindërve për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e veta fetare dhe filozofike, nuk garanton një të drejtë për arsimim dhe nuk i detyron shtetet që të respektojnë në fushën e edukimit dhe arsimimit, preferencat gjuhësore të prindërve. Interpretimi i termave “fetare” dhe “filozofike” deri në atë masë sa të përfshijnë preferencat gjuhësore, nuk do t'i përshtatej kuptimit të zakonshëm të këtyre termave që figurojnë në këtë paragraf.

8. Bazuar në interpretimin e përgjithshëm që bëri, Gjykata shqyrtoi me radhë, nëse në lidhje me gjashtë problemet e ngritura kishte pasur ose vazhdonte të kishte shkelje të Konventës ose të Protokollit 1:

- i. për aq sa ligjet e vitit 1932 ishin në kundërshtim dhe se ligjet e vitit 1963 i kundërviheshin krijimit dhe subvencionimit nga shteti të shkollave që nuk përputheshin me dispozitat e përgjithshme gjuhësore;
- ii. për aq sa ligjet e vitit 1963 kishin si pasojë heqjen e plotë të subvencioneve të shkollave provinciale, bashkiake ose private që do të merrnin përsipër, si klasa të pasubvencionuara dhe krahas mësimi të dhënë në gjuhën e parashikuar me ligj, një mësim të plotë ose të pjesshëm në një gjuhë tjetër;
- iii. për aq sa përket statutit të gjashtë komunave të periferisë së Brukselit, përfshirë Kraainem, të parashikuar nga neni 7 paragrafi 3, i ligjit të 2 gushtit 1963;
- iv. lidhur me kushtet e regjistrimit në shkollat e lagjes Bruksel-qendër, të fëmijëve, prindërit e të cilëve nuk banonin në këtë lagje;
- v. për aq sa neni 7, pika e fundit, e ligjit të 30 korrikut 1963 dhe neni 7 paragrafi 3 i ligjit të 2 gushtit 1963 ndalonin disa fëmijë, bazuar mbi rezidencën e prindërve të tyre, të hynin në shkollat me gjuhë frënge që ndodhen në (a) Lëven dhe (b) në gjashtë komunat e periferisë së Brukselit që kishin secila statutin e tyre, përfshirë Kraainem;
- vi. për aq sa ligjet e vitit 1932 kishin sjellë dhe ligjet e vitit 1963 sillnin refuzimin absolut të njohjes të çertifikatave të shkollimit tetëvjeçar në mospërputhje me dispozitat gjuhësore në fushën e arsimimit

9. Gjykata arriti njëzëri në përfundimin se, nuk ka pasur shkelje në lidhje me pikat i, ii, iii, iv, v (a) dhe vi. Në lidhje me këtë të fundit, ajo nuk e vlerësoi të pamundur

që zbatimi i dispozitave të kundërshtuara të arrinte, në çështje specifike, në rezultate që do të rrezikonin ruajtjen e proporcionalitetit midis mjeteve dhe qëllimit, deri në masën sa të krijoheshin diskriminime. Por ajo theksoi se në çështjen në fjalë, as nuk u provua dhe as nuk u pretendua që fëmija i ndonjërit prej kërkuesve të ishte cenuar nga një rezultat i tillë.

#### *D. Në lidhje me nenin 8*

10. Përsa i përket nenit 8 paragrafi 1 të Konventës, Gjykata theksoi se ai nuk garanton në vetvete të drejtën për arsimim, as të drejtën e prindërve në lidhje me arsimimin e fëmijëve të tyre. Megjithatë, nuk përjashtohet që masa të marra në fushën e arsimimit mund të prekin të drejtën e respektit të jetës private ose familjare, ose edhe ta cenojnë atë. Mund të ndodhë kështu për shembull, në qoftë se masat e marra do të kishin për qëllim ose si pasojë të prishnin këtë jetë në mënyrë të pajustificueshme, sidomos duke larguar në mënyrë arbitrare fëmijët nga prindërit e tyre. Sidoqoftë ajo arriti në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 në rrethanat e kësaj çështjeje.

#### *E. Në lidhje me nenin 14*

11. Përsa i përket nenit 14 të Konventës, sipas së cilit gëzimi i të drejtave dhe lirive i njohur prej saj duhet të sigurohet pa asnjë dallim, sidomos të bazuar mbi gjuhën, Gjykata konstatoi së pari, se kjo garanci nuk ka ekzistencë të pavarur. Çdo gjë ndodh sikur neni 14 i Konventës të ishte pjesë e çdo neni që mishëron të drejtat dhe liritë. Në lidhje me këtë nuk duhet dalluar sipas natyrës të këtyre të drejtave dhe lirive dhe detyrimeve përkatëse dhe për shembull, nëse respektimi i së drejtës në fjalë kërkon një veprim ose një abstenim. Gjykata vlerësoi se neni 14 nuk ndalon çdo trajtim të ndryshëm në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të garantuara, por që barazia e trajtimit shkelet në qoftë se dallimi nuk justifikohet në mënyrë objektive dhe të arsyeshme. Ekzistenca e një justifikimi të tillë duhet të vlerësohet kundrejt qëllimit dhe pasojave të masës së marrë, duke pasur parasysh parimet që mbizotërojnë në shoqëritë demokratike. Një dallim trajtimi nuk duhet të ketë vetëm një qëllim legjitim - neni 14 shkelet kur vërtetohet qartë se mungon një raport i arsyeshëm proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit.

12. Në vijim të këtij *obiter-i*, Gjykata vendosi se neni 7 paragrafi 3 i ligjit të 2 gushtit 1963 (pika b), nuk përputhej me nenin 14 të Konventës të marrë së bashku me fjalinë e parë të nenit 2 të Protokollit 1, për aq sa ai i ndalonte disa fëmijë të shkonin në shkolla me gjuhë frënge që ekzistojnë në gjashtë komuna të periferisë së Brukselit, që kishin një status të vetin, përfshirë Kraainem. Një masë e tillë e pajustificuar, e dëmshme për disa individë, përmban elementët e një trajtimi diskriminues bazuar më shumë në gjuhë, sesa në banesë. Së pari, ajo nuk zbatohet në mënyrë uniforme për familjet që flisnin një të gjuhë ose tjetrën. Fëmijët holandofonë që banonin në rajonin që përdorte gjuhën frënge mund të shkonin në shkollat me gjuhë holandeze që ekziston në gjashtë komunat, ndërsa fëmijëve frankofonë që jetonin në rajonin që përdorte vetëm gjuhën holandeze iu refuzohej hyrja në shkollat franceze në të njëjtat komuna. Gjithashtu, klasat holandeze të të gjashta komunave ishin të hapura për fëmijët holandofonë të rajonit me gjuhë holandeze, ndërsa klasat franceze ishin të

mbyllura për fëmijët frankofonë të këtij rajoni. Një situatë e tillë ishte në kontrast me mundësinë e hyrjes në shkollat me gjuhë frënge të lagjes Bruksel-qendër për fëmijët frankofonë, pavarësisht nga banesa e prindërve të tyre. Pra duket se kushti i banesës nuk ishte vendosur në interes të shkollave për arsye të karakterit administrativ ose financiar por kishte pasur si referencë vetëm në karakterin gjuhësor. Për më tepër masa në fjalë nuk respektonte tërësisht, kundrejt pjesës më të madhe të kërkuesve dhe të fëmijëve të tyre, raportin e proporcionalitetit midis mjeteve dhe qëllimit. Në veçanti, pamundësia për të hyrë në shkollat franceze, zyrtare ose të subvencionuara, të gjashtë komunave “me lehtësira” e cenonte aq ushtrimin e të drejtës për arsimimin e fëmijëve të kërkuesve, sa sikur të tilla shkolla nuk do të ekzistonin aspak në komunat ku ata banojnë.

13. Me arritjen e këtij përfundimi Gjykata njohu të drejtën e kërkuesve për një shpërblim të drejtë. Megjithatë asnjëri prej tyre nuk bëri asnjë kërkesë në bazë të ish nenit 50 të Konventës. Belgjika nga ana e saj mori disa masa për të respektuar këtë vendim të Gjykatës së Strasburgut, përfshirë këtu edhe një reformë kushtetuese me anë të ligjit të 23 dhjetorit 1970 i cili pasi i përfshinte gjashtë komunat e lartpërmendura në zonën holandeze por duku iu njohur të drejta dhe lehtësi specifike.

### III. Koment

14. Në këtë vendim, që është i pari dhe mund të thuhet ngelet referenca më e rëndësishme interpretuese e nenit 2 të Protokollit 1 të Konventës, Gjykata, e përbërë nga disa prej figurave më të shquara të së drejtës ndërkombëtare gjatë shekullit të kaluar<sup>254</sup>, pati përpara vetes një detyrë tepër të vështirë, e cila justifikon ndoshta edhe ndarjen e saj në një shumicë të ngushtë – tetë me shtatë. Vështirësia qëndrore konsistonte në vetë e formulimin këtij neni. Duke qenë fryt i negociatave shumë të tendosura dhe të arritura me vështirësi në kuadrin e adoptimit të Protokollit 1 të Konventës<sup>255</sup>, fjalia e parë e këtij neni është formuluar në terma negativë, gjë që i kufizonte mundësinë Gjykatës për të përdorur një interpretim të zgjeruar të kësaj të drejte. Nga ana tjetër, Gjykata, duke preferuar që t'i qëndrojë strikt interpretimit tekstual të nenit i cili i referohet vetëm bindjeve “fetare dhe filozofike” të prindërve si kriter për arsimimin e tyre dhe jo edhe atyre gjuhësore, ia vështirësonte mundësinë asaj për të konstatuar shkelje vetëm të këtij neni të marrë më vete.

15. Sidoqoftë në këtë çështje Gjykata ofroi disa nga piketat më të rëndësishme në interpretimin e nenit 2 të Protokollit 1 të Konventës. Duke pranuar diskrecionaritetin tepër të gjerë që ky nen iu njeh shteteve në rregullimin e sistemit kombëtar arsimor dhe as nuk iu kërkon shteteve që të ngrejë në këmbë ndonjë sistem specifik arsimor apo edukativ. Madje Gjykata theksoi se fjalia e parë e nenit 2 le në zgjedhjen e shteteve edhe çështjen e krijimit ose të financimit të ndonjë lloji të veçantë institucioni arsimor

<sup>254</sup> Ndër të cilët kryetari Cassin, e pastaj Verdross, Balladore Pallieri, Sir Waldock apo Wiarda.

<sup>255</sup> Për më tepër në lidhje me vështirësitë e formulimit dhe të adoptimit të nenit 2 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, A. W. Brian Simpson, “Human Rights and the End of Empire”, Oxford Publishing, 2003, sidomos fq. 754-807 por dhe në vijim Kreu 15.

ose edukativ. Sidoqoftë është e rëndësishme të theksohet se Gjykata në këtë çështje pohon qartë se çdokush duhet të ketë të drejtën që të ketë akses në institucionet arsimore ekzistuese dhe shtetet duhet të sigurojnë njohjen zyrtare të edukimit që secili person ka kryer efektivisht. Ky pohim, sidoqoftë, duhet të shoqërohet me një sqarim që duket të ketë vlera aktuale për situatën dhe debatin politik dhe akademik në Shqipëri, sidomos në lidhje me liberalizimin e universiteteve - e drejta për të pasur akses në institucionet arsimore konsiston kryesisht në edukimin elementar<sup>256</sup>.

16. Vendimi që po komentojmë është interesant të lexohet duke iu referuar gjithashtu mendimit këshillimor të Gjykatës së Përhershme të së Drejtës Ndërkombëtare të 6 prillit 1936, në lidhje me Shkollat Minoritare në Shqipëri<sup>257</sup> në të cilin u Gjykata e atëhershme e Hagës u shpreh se, një masë shtetërore për mbylljen e të gjitha shkollave private në Shqipëri, pavarësisht se kishte zbatim të përgjithshëm ndaj të gjithë shtetasve shqiptarë, mund të cenonte të drejtat e minoriteteve për t'u arsimuar në gjuhën e tyre amtare si dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë<sup>258</sup>. Ndërkohë që në "çështjen Gjuhësore Belge" Gjykata shprehet se termat "fetare" dhe "filozofike" nuk shkojnë deri aty sa të përfshijnë edhe termin "gjuhësore"<sup>259</sup>. Pavarësisht se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk mbron në mënyrë specifike të drejtat e minoriteteve, përfshirë këtu edhe ato gjuhësore, do të ishte tepër e vështirë të pranohej se minoritetet dhe të drejtat e tyre mbroheshin më mirë nga e drejta ndërkombëtare në vitet 30, se në vitet 60 e në vijim.

17. Në këto kushte, mundësia e vetme mbetej vlerësimi i së drejtës për arsimim duke e kombinuar me dispozitën e nenit 14, që ndalon diskriminimin në lidhje me të drejtat e parashikuara nga Konventa dhe Protokollin e saj. Është pikërisht në këtë këndvështrim që Gjykata arriti të konstatojë shkelje duke vlerësuar se situata e fëmijëve frëngjishtfolës që banonin në zona me shumicë flamande, nuk ishte e njëjtë me situatën e fëmijëve flamandfolës që banonin në zonat valone e madje as me atë të fëmijëve frëngjishtfolës që banonin në zonën e Brukselit. Ndërkohë, gjyqtarët e ngelur në pakicë u shprehën se në kushtet konkrete, trajtimi i fëmijëve frëngjishtfolës nuk përbënte një barrë të tepërt në raport me trajtimin e fëmijëve të tjerë, aq sa të mund të konsiderohej diskriminim në lidhje me të drejtën e tyre për arsimim.

18. Ky vendim mund të ishte klasifikuar fare mirë edhe në kuadrin e nenit 14 të Konventës. Jo për faktin se Gjykata konstatoi shkelje të nenit 2 të Protokollit 1 duke e

<sup>256</sup> Në lidhje me qëndrimet e Gjykatës në këtë drejtim përveç çështjes që po komentojmë me vlerë është gjithashtu vendimi i saj i 25 shkurtit 1982 në lidhje me çështjen Campbell dhe Cosans kundër Mbretërisë së Bashkuar (sidomos paragrafi 41) kurse për qëndrimet e ish Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut me vlerë janë sidomos atë të 06 janarit 1993 në lidhje me kërkesën e Yanasik kundër Turqisë, të 17 janarit 1996 në lidhje me çështjen Sulak kundër Turqisë, dhe sidomos vendimin e 22.09.1980 në lidhje me çështjen X kundër Mbretërisë së Bashkuar në të cilin Komisioni shprehet se janë shtetet ato që kanë të drejtë të rregullojnë mundësitë e aksesit të studentëve në institucionet e larta akademike duke përcaktuar madje edhe kritere të tilla si rezultatet e tyre mësimore.

<sup>257</sup> Cour Permanente de Justice Internationale, Série A/B, " Arrêts, ordonnances et avis consultatifs", Fascicule n°64.

<sup>258</sup> Bëhet fjalë për Deklaratën e 2 tetorit 1921 të nënshkruar nga Fan Noli në Lidhjen e Kombeve mbi njohjen dhe respektimin e të drejtave të minoriteteve nga ana e Shqipërisë (sidomos nenet 6 dhe 7).

<sup>259</sup> Shih më lart paragrafin 7 të përmbledhjes së vendimit.

interpretuar së bashku me nenin 14 të Konventës, por për arsyen se me këtë vendim, Gjykata përpunoi ndoshta formulimin më të qëndrueshëm të jurisprudencës së saj në lidhje me këtë nen të fundit. Në faqen 34 të vendimit Gjykata hedh poshtë pretendimin e kërkuesve, sipas të cilëve neni 14 i Konventës ndalon çdo dallim në trajtim. Në këtë kuadër, Gjykata adopton konceptin e justifikimit të arsyeshëm dhe objektiv të një trajtimi të ndryshëm. Sipas Gjykatës, që të pranohet një justifikim i tillë dhe që trajtimi i ndryshëm të mos përbëjë diskriminim të ndaluar nga neni 14 ai duhet që të plotësojë këto dy kritere:

- i) trajtimi i ndryshëm duhet të ketë një qëllim legjitim;
- ii) ai duhet të respektojë një raport proporcionaliteti mes qëllimit të ndjekur dhe mjeteve të përdorura.

19. Një pohim tjetër i Gjykatës në këtë vendim, tepër i rëndësishëm edhe për situatën shqiptare<sup>260</sup>, është ai në lidhje me diskriminimin pozitiv. Pasi pranon se diskriminimi pozitiv nuk është në vetvete i papajtueshëm me nenin 14 të Konventës, ajo ofron në paragrafin 20 të vendimit të saj një obiter dictum tepër interesant kur shprehet se “disa pabarazi ligjore synojnë vetëm që të ndreqin pabarazi që ekzistojnë në fakt”<sup>261</sup>.

<sup>260</sup> E kam fjalën këtu për debatin, shpeshherë shterpë dhe aspak juridik, që mori vrull më 1998 gjatë hartimit të Projektit të Kushtetutës së Shqipërisë në lidhje me Nenin 18 të saj (sidomos paragrafi 3) i cili deri në një farë mase dhe në disa mjedise mund të thuhet se vazhdon ende.

<sup>261</sup> Considerandumi 3 i Preambulës së Protokollit 12 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut shprehet gjithashtu: “parimi i mos-diskriminimit nuk i ndalon Shtetet Palë që të marrin masa me qëllim që të nxisin një barazi të plotë dhe efektive, me kusht që këto masa të kenë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv”



# PROTOKOLLI 1

## NENI 3

E DREJTA PËR ZGJEDHJE  
TË LIRA

## PODKOLZINA kundër LETONISË

(kërkesa nr. 46726/99)

9 prill 2002

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesja është një shtetase letoneze, e lindur në vitin 1964 dhe banuese në Daugavpils. Ajo i përkiste minoritetit rusfolës.
2. Më 3 tetor 1998 ajo kandidoi në zgjedhjet parlamentare letoneze, duke përfaqësuar Partinë Harmoni Kombëtare (PHK) në zonën elektorale të Latgale.
3. Kërkuesja u regjistrua nga partia e saj në listën e kandidatëve zgjedhor dhe sipas ligjit në fuqi, ajo duhet të vërtetonte që njihje dhe fliste gjuhën zyrtare letoneze.
4. Komisioni i Certifikimit të Gjuhëve (KCGJ) në zonën e Latgale, një insitucion në varësi të Qendrës Shtetërore të Gjuhës (QSHGJ), kishte lëshuar një certifikatë që vërtetonte se kërkuesja e zotëronte gjuhën letoneze.
5. Më vonë, në zyrën e kërkueses u paraqit një punonjës i QSHGJ-së me detyrën për të kontrolluar dhe verifikuar aftësitë e saj në gjuhën letoneze. Kontrolluesi e pyeti kërkuesen në gjuhën letoneze për shumë çështje, ku ndër to edhe arsyet që e kishin shtyrë atë që të zgjidhte të përfaqësonte Partinë Harmoni Kombëtare dhe jo një tjetër.
6. Të nesërmen, kontrolluesi i shoqëruar me një dëshmitar, i kërkoi kërkueses që të shkruante një ese në gjuhën letoneze. Duke qenë se ajo nuk e priste një takim të dytë kaq shpejt dhe për arsye se po nervozohet edhe nga prania e dëshmitarit, ajo ndali së shkruari dhe e grisi punën e lënë përgjysëm.
7. Pas këtyre episodeve, kontrolluesi i QSHGJ-së përpiloi një raport ku shprehte paaftësinë e Znj. Podkolzina për të zotëruar gjuhën letoneze siç e kërkon ligji për të gjithë kandidatët që marrin pjesë në zgjedhje dhe për pasojë i kërkoi Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), heqjen e kërkueses nga lista e kandidatëve për zgjedhjet parlamenatare të 1988.
8. PHK-ja, në emër të kërkueses iu drejtua Gjykatës Rajonale të Rigas, duke kërkuar anulimin e vendimit të QSHGJ-së. Gjykata e rrëzoi kërkesën e tyre me argumentin se vërtetimi për zotërimin e gjuhës letoneze me anë të një certifikate shtetërore ishte një kusht i domosdoshëm për kandidatët që nuk kanë mbaruar studimet e tyre në Letoni dhe kërkojnë të jenë pjesë e listave zgjedhore.

9. Kërkesat e tyre drejtuar Kryetarit të Dhomës Civile në Gjykatën Supreme dhe Prokurorit të Përgjithshëm gjithashtu u rrëzuan.

10. Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me pretendimin se heqja e emrit të saj nga lista e kandidatëve për zgjedhjet e vitit 1998, për shkak se ajo nuk zotëronte në mënyrën e duhur gjuhën letoneze, ishte një shkelje e nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës. Gjithashtu, ajo pretendoi se kishte qenë subjekt i shkeljes së të drejtave garantuar nga nenet 13 dhe 14 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3 të Protokollit 1

11. Gjykata vlerësoi se qëllimi i masës për certifikimin e njohurive të gjuhës zyrtare letoneze ishte vendosur nga autoritetet në mënyrë, që të siguronte mirëfunksionimin e sistemit institucional të Letonisë. Gjykata nënvizoi se nuk është detyrë e saj që të përcaktojë gjuhën zyrtare të një shteti, duke pasur parasysh se ajo krijohet nga konteksti historik dhe politik i vendit. Kjo e drejtë i takon ekskluzivisht shtetit në fjalë.

12. Gjykata vlerësoi se ky qëllim i autoriteteve letoneze ishte objektivisht i drejtë dhe detyra e saj ishte, që të përcaktonte raportin e proporcionalitetit të kufizimit të kërkueses për të qenë pjesë e listave të kandidatëve në zgjedhjet parlamentare, në përmbushje të qëllimit të ligjit.

13. Sipas Gjykatës, kërkuesja ishte certifikuar nga një komision shtetëror për zotërimin e gjuhës letoneze dhe GJEDNJ nuk mund të gjykonte mënyrën sesi ishte vlerësuar ajo nga ky Komision. Madje as qeveria letoneze nuk gjykoi faktin që ajo ishte certifikuar nga KCGJ-ja dhe as mënyrën sesi ishte kryer ky certifikim.

14. Gjykata vërejtë se, fakti që vlerësimi i zotërimit të gjuhës letoneze për kërkuesen ishte lënë në gjykimin e një personi të vetëm, ishte një masë e tepruar duke konsideruar që më parë, aftësitë e saj ishin kontrolluar nga një grup ekspertësh. Për më tepër, Gjykata nuk mund ta kuptonte arsyen se përse ky zyrtar shtetëror e kishte pyetur kërkuesen mbi arsyet, që e shtynë atë të bashkohej me PHK-në.

15. Për pasojë, në mungesë të garancive objektive ligjore dhe nga mënyra e padrejtë e trajtimit të kërkueses nga ana e autoriteteve të sistemit gjyqësor, Gjykata arriti në përfundimin se në rastin konkret ka pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.

### B. Në lidhje me nenet 13 dhe 14

16. Për Gjykatën, fakti që ishte konstatuar një shkelje e nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës bënte të panevojshme shqyrtimin veçmas të pretendimeve për shkelje të neneve 13 dhe 14 të Konventës.

**C. Në lidhje me nenin 41**

17. Gjykata vendosi që në kuadër të nenit 41 të Konventës, kërkueses t'i akordohet shuma prej 7 500 euro në kuadër të dëmit jomaterial dhe 1 500 euro për shpenzimet e procesit gjyqësor.

**III. Koment**

18. Ky vendim me rëndësi të veçantë, u jep një paralajmërim në kohë atyre vendeve anëtare, të cilat si pasojë e zhvillimeve politike kanë një minoritet të konsiderueshëm të elektoratit të tyre, i cili nuk flet gjuhën e shumicës si gjuhën e nënës, apo në nivelin e kërkuar.

19. Gjykata vuri në dukje se, shtetet kanë një hapësirë të gjerë vlerësimi në miratimin e rregullave që zbatohen ndaj atyre që synojnë të dalin si kandidatë në zgjedhje. Përcaktimi i nevojës për të njohur gjuhën zyrtare si kriter për lejimin e daljes si kandidat në zgjedhje, nuk vjen në kundërshtim me Konventën.

20. Në këtë vendim Gjykata sugjeroi që neni 3 i Protokollit 1 ka disa “garanci procedurale të mishëruara” dhe në qoftë se këto garanci kundër arbitraritetit, ose nuk janë parashikuar, ose nuk respektohen, atëherë kemi të bëjmë me shkelje të Konventës. Gjykata mbajti parasysh jo vetëm që kërkuesja ishte pyetur në lidhje me përkatësitë e saj politike gjatë provës dhe vizitës së zyrtarëve, por gjithashtu edhe faktin që kjo vizitë ishte bërë gjatë orarit të punës dhe pa asnjë paralajmërim, duke ndërprerë kështu marrëdhëniet e saj të punës me kolegët e tjerë. Megjithëse çështja kishte të bënte kryesisht me diskriminimin që minoriteti rusfolës ndjen se vuan në Letoni, Gjykata nuk preferoi ta shqyrtojë kërkesën në bazë të nenit 3 të Protokollit 1 të marrë së bashku me nenin 14. Ajo nuk mbajti parasysh më vete as kërkesën në bazë të nenit 13. Një vendim në lidhje me këto ankesa mund të kishte shërbyer si një guidë e dobishme për shtete të tjera, ku situata të ngjashme mund të dalin në pah.

**ZDANOKA kundër LETONISË**

*(kërkesa nr. 58278/00)*

**16 mars 2003**

**I. Faktet kryesore**

1. Kërkuesja është një shtetase letoneze që jeton në Riga dhe aktualisht është deputete në Parlamentin Europian. Në vitin 1971 kërkuesja kishte qenë pjesë e Partisë Komuniste Letoneze (P.K.L.), një degë e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik (P.K.B.S.).

2. Në vitin 1990 ajo u zgjodh anëtare e Këshillit Suprem të Republikës Sovjetike Socialiste Letoneze. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1990, Partia Komuniste

Letoneze u shpall antikushtetuese, pas dy tentativave të dështuara për grusht shteti. Këshilli Suprem letonez urdhëroi mbylljen e aktivitetit të kësaj partie në 10 shtator 1991.

3. Në vitin 1993, kërkuesja u bë kryetare e “Lëvizjes për Drejtësi Sociale dhe të Drejta të Barabarta në Letoni”, parti e cila më vonë ndryshoi emrin në “Partia e të Drejtave të Barabarta”. Në vitin 1998 ajo vendosi të kandidojë për zgjedhjet parlamentare, por KQZ-ja refuzoi kandidaturën e saj, duke e përjashtuar atë për shkak të aktivizimit të saj të drejtëpërdrejtë në Partinë Komuniste Letoneze.

4. Në vitin 1997 ajo u zgjodh anëtare e Këshillit të Bashkisë së Rigës, por me iniciativën e Prokurorit të Përgjithshëm, duke qenë se ajo kishte pasur lidhje të drejtëpërdrejtë me aktivitetin politik të P.K.L.-së, u kërkua që të shkarkohej nga posti i saj në Këshillin Bashkiak. Gjykata e Rrethit të Rigës mori vendimin për shkarkimin e saj. Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Supreme për ligjshmërinë e vendimit ndaj saj, por ankimi i saj u rrëzua nga kjo e fundit si i pabazuar.

5. Kërkuesja tentoi të merrte pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2002, duke marrë pjesë në zgjedhje në koalicion me dy parti të tjera, por duke qenë se vendimi i Gjykatës Supreme ishte akoma në fuqi, KQZ-ja e hoqi emrin e saj nga lista e kandidatëve për t’u votuar. Po me të njëjtin koalicion, ajo kandidoi në zgjedhjet e Parlamentit Europian në vitin 2004, ku fitoi mandatin e deputetes.

6. Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me pretendimin se Ligji Elektoral Letonez që pengonte atë të ishte pjesë e zgjedhjeve, cenonte të drejtën e saj për t’u zgjedhur, garantuar nga neni 3 i Protokollit 1 të Konventës. Gjithashtu, ajo shtoi se përjashtimi i saj nga këto zgjedhje shkelte edhe nenet 10 dhe 11 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3 të Protokollit 1

7. Gjykata theksoi se ligji i ri elektoral nuk kishte si qëllim dënimin apo përjashtimin e personave që kishin qenë pjesëtarë të Partisë Komuniste Letoneze në veçanti, por shërbente si një masë mbrojtëse për demokracinë dhe regjimin e ri politik në Letoni, nga ata persona që kishin qenë aktiv në lëvizje të ndryshme për rrëzimin e kësaj fryme të re politike.

8. Ishte e kuptueshme që parlamenti i ri demokratik letonez do të besonte se figura të spikatura të P.K.L.-së apo P.K.B.S.-së do të ishin të papërshtatshme për pjesëmarrjen në aktivitetin politik në vend, duke qenë se në të shkuarën kishin vepruar kundër ndryshimeve të reja politike në Letoni.

9. Gjykata vërejti se në këto raste, për të treguar një përjasje pozitive për ndryshimet e reja politike, minimumi që mund të bëhej nga këto persona do të ishte distancimi i

tyre nga aktiviteti i P.K.L.-së apo P.K.B.S.-së. Kjo nuk kishte ndodhur as në fillim të ndryshimeve politike në vend dhe as më pas, nga kërkuesja.

10. Gjykata vlerësoi se masa e marrë nga autoritetet letoneze ishte proporcionalisht e drejtë dhe në përputhje me kufizimet që lejon neni 3 i Protokollit 1 të Konventës. Përfundimi i kërkueses vinte si pasojë e veprimtarisë së saj në vitin 1991 në veçanti, vit kur partia e saj tentoi dy herë të kryente një grusht shteti për të rrëzuar regjimin e ri demokratik në vend.

11. Gjykata pranoi se një rast tjetër, ku një shtet do të kishte një regjim politik demokratik prej kohësh dhe vendi do të gëzonte një demokraci të qëndrueshme, kjo masë do të ishte e papranueshme. Duke u nisur nga konteksti historiko-politik i Letonisë, kjo masë shërbente për ruajtjen dhe vazhdimësinë e demokracisë dhe pengimin e kthimit të regjimit totalitar në vend.

12. Vendet Baltike e kishin humbur pavarësinë e tyre për shkak të marrëveshjes së arritur mes Hitlerit dhe Stalinit dhe pas rifitimit të pavarësisë, këto shtete duhet të gëzonin një hapësirë të gjerë vlerësimi për ngritjen dhe ruajtjen e një regjimi të ri demokratik. Duke patur parasysh këtë fakt, Gjykatës i duhej të shqyrtonte arbitraritetin e vendimeve të marra dhe anën ligjore të tyre.

13. Sipas Gjykatës, fakti që ligji elektoral ishte rishikuar disa herë nga Parlamenti deri në momentin që çështja ishte duke u gjykuar në Strasburg dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese letoneze detyronte parlamentin për të vendosur një afat kohor për dispozitën penguese objekt gjykimi, shpreh mjaft qartë gadishmërinë e qeverisë letoneze për respektimin e Konventës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se në rastin konkret nuk ishin shkelur garancitë e neni 3 të Protokollit 1 të Konventës.

### ***B. Në lidhje me nenin 10 dhe 11***

14. Gjykata u shpreh se nuk ka asnjë rrethanë apo fakt të ri që ajo të shqyrtonte pamundësinë e kërkueses për të marrë pjesë në zgjedhje, në vështrim të neneve 10 dhe 11 të Konventës. Gjykata vlerësoi se një shqyrtim veçmas i pretendimeve të kërkueses në lidhje me këto nene, ishte i panevojshëm.

## **III. Koment**

15. Në këtë çështje Gjykata ritheksoi parimin e shprehur në çështjen Partia Refah kundër Turqisë<sup>262</sup>, sipas të cilit shtetet kanë të drejtë të ndalojnë aktivitete politike të cilat, në mënyrë të arsyeshme, mendohet se përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare dhe demokracinë, pa qenë të detyruara të presin që subjektet ose individët e interesuar të kryejnë vepra me pasoja të dëmshme. Pesë nga shtatë gjyqtarët e Dhomës që shqyrtoi këtë çështje u shprehën se ndalimi i Znj. Zdanoka për të kandiduar në zgjedhjet parlamentare shkelte Konventën, për shkak se

<sup>262</sup> Vendim i 31 korrikut 2001.



Gjykata kishte konstatuar ndërkaq se idetë e mbrojtura prej saj dhe partia në të cilën bënte pjesë nuk e cenonin më as demokracinë dhe as vlerat themelore të rrënjësura në Konventë. Pavarësisht kësaj, u pranua se ideologjia komuniste që ajo kishte mbështetur fuqimisht më parë i hidhte poshtë këto vlera. Për më tepër, ndalimi për të kandiduar ishte i përhershëm, dhe për këtë arsye jo proporcional. Nga ana tjetër mjafton të përmendet se kërkuesja u lejua të merrte pjesë në zgjedhjet për Parlamentin Evropian në qershor 2004.

16. Kjo çështje në mënyrë tepër interesante na bën të mendojmë për një situatë të ngjashme në Republikën e Shqipërisë, sidomos në lidhje me zgjedhjet e viteve 1996-1997. Veprimi i ligjeve të ashtuquajtura mbi kontrollin e figurës, konkretisht ligji Nr. 8001, i 22 shtatorit 1995 “Mbi gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit të kryera në Shqipëri gjatë regjimit komunist për arsye politike, ideologjike dhe fetare”, si dhe Ligji 8043 i 30 nëntorit 1995 “Mbi verifikimin e figurave të zyrtarëve publikë dhe të individëve të tjerë në lidhje me mbrojtjen e shtetit demokratik”, penguan në fakt pjesëmarrjen e disa kandidatëve në këto zgjedhje. Për një analizë të shembullit shqiptar, që besojmë se shkon në një linjë me këtë vendim të Gjykatës së Strasburgut, që më në fund e sqaron këtë situatë, mjafton të shihet komenti im në fq.71-73 të “Raportit të Përqasjes së Legjislacionit Shqiptar me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut”. Vlen të kujtohet gjithashtu që në lidhje me zbatimin e nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës, Republika e Shqipërisë kishte bërë një rezervë me karakter interpretues ndaj këtij neni pikërisht për shkak të miratimit të këtyre dy neneve. Sidoqoftë, kjo rezervë kishte një efekt kohor pesë vjeçar dhe tani nuk ka më fuqi interpretuese.

17. Dy mendime të kundërta nga gjyqtarët Bonello (Maltë) dhe Levits (Letoni) e kundërshtuan këtë pikëvështrimi, megjithëse për arsye të ndryshme. Gjyqtari Bonello u shpreh se i takonte autoriteteve letoneze dhe jo Gjykatës së Strasburgut, që të vendosnin nëse deri më 1998 kishte kaluar apo jo për Letoninë periudha e tranzicionit nga një satelit Sovjetik, në një demokraci në pavarur.

## **AZIZ kundër QIPROS**

*(kërkesa nr. 69949/01)*

**22 qershor 2004**

### **I. Faktet kryesore**

1. Kërkuesi është një shtetas qipriot i lindur në vitin 1938, me origjinë turke dhe banues në Nicosia. Më 30 janar 2001, ai i dërgoi një kërkesë Ministrisë së Brendshme për të qenë pjesë e listës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të atij viti.

2. Më 8 shkurt 2001, kërkesa e tij u refuzua me argumentin se në bazë të Kushtetutës, shtetasit qipriot që i përkasin komunitetit turk nuk mund të përfshihen në listat

zgjedhore të qipriotëve me origjinë greke. Ai gjithashtu u informua se çështja tij po shqyrtohej nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës dhe se do të informohej për çdo ndodhi të mundshme.

3. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Supreme me kërkesën për anulimin e vendimit të Ministrisë së Brendshme, duke u mbështetur tek neni 3 i Protokollit 1 të Konventës. Ai pretendoi se, qeveria qipriote kishte dështuar në detyrën e saj për të siguruar zgjedhje demokratike në vend për sa kohë që nuk kishte krijuar 2 lista zgjedhore sipas komuniteteve, ku qytetarët e Qipros të votonin sipas komunitetit që i përkasin.

4. Gjykata Supreme rrëzoi kërkesën e Z. Aziz me argumentin se në bazë të nenit 63 të Kushtetutës së Qipros dhe nenit 5 Ligjit nr. 72/79 “Për zgjedhjet parlamentare”, shtetasit qipriot që i përkisnin komunitetit turk në Qipro dhe jetonin në territorin e kontrolluar nga qeveria, nuk mund të përfshiheshin në listat zgjedhore të shtetasve qipriot, të cilët i përkisnin komunitetit grek dhe për pasojë nuk mund të votojnë në zgjedhjet parlamentare.

5. Gjithashtu, Gjykata Supreme u shpreh se nuk kishte kompetenca që të ndryshonte Kushtetutën e vendit për të mundësuar zgjedhje me lista të veçanta zgjedhore sipas komuniteteve, sepse kjo do të cenonte parimin e ndarjes së pushteteve.

6. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke pretenduar se e drejta e tij për të votuar ishte kufizuar vetëm për shkak se ai i përkiste komunitetit turk qipriot dhe kështu, atij i mohohej një e drejtë themelore e garantuar nga Konventa, konkretisht nga neni 3 i Protokollit 1 të saj. Ai gjithashtu pretendoi se i ishte shkelur e drejta e garantuar nga neni 14 i Konventës duke qenë se kufizimi ishte diskriminues për shkak të origjinës tij.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3 të Protokollit 1

7. Gjykata u shpreh se, neni 63 i Kushtetutës së Qipros, e cila kishte hyrë në fuqi në gusht 1960, mundësonte listat zgjedhore të veçanta për shtetasit grek të Qipros dhe ata të komunitetit turk. Pavarësisht këtij fakti, që prej vitit 1963, pjesëmarrja e shtetasve qipriot nga komuniteti turk ishte ndërprerë dhe ishte bërë i pamundur përfaqësimi i komunitetit turk në parlamentin e Qipros.

8. Gjykata vërejti se, është e vërtetë që shtetet palë në Konventë gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi për të vendosur rregullat e zgjedhjeve parlamentare, duke pasur parasysh faktin se shtete të ndryshme janë formuar në bazë të konteksteve të ndryshme historike dhe politike. Gjithsesi, këto rregulla nuk mund të jenë kurrë të një karakteri kufizues deri në atë pikë, sa të mos lejojnë shtetasit e vendit tyre të votojnë apo të marrin pjesë në jetën politike. Kjo e drejtë garantohet si nga Konventa ashtu edhe nga të gjithë kushtetutat e shteteve palë që kanë ratifikuar Konventën.

9. Gjykata çmoi se situata politike në vend kishte degraduar me pushtimin e veriut të Qipros nga trupat turke, një situatë e cila po zgjaste për më shumë se 30 vite. Ajo gjithashtu vuri theksin tek fakti se ky nen i kushtetutës ishte bërë i pazbatueshëm dhe nuk ishte bërë ansjë përpjekje ligjore për ta zgjidhur këtë ngërç politik. Për pasojë, një shtetas qipriot që i përkiste komunitetit turk, që kishte jetuar gjithë jetën e tij në këtë territor, nuk mund të shprehte vullnetin e tij për përfaqësuesit e parlamentit që do ta përfaqësojë, vetëm për shkak se i përkiste komunitetit turk.

10. Gjykata vlerësoi se kufizimi i të drejtës së kërkuesit për të votuar, duke shprehur kështu vullnetin e tij të lirë politik, derivon shkelle të thelbit dhe qëllimit të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.

#### ***B. Në lidhje me nenin 14***

11. Gjykata theksoi se, pavarësisht faktit se në Kushtetutën qipriote ishte garantuar e drejta për të votuar në lista të veçanta zgjedhore sipas komuniteteve të ndryshme, në praktikë kjo e drejtë nuk zbatohet.

12. Gjykata vërejti se, pavarësisht se kërkuesi ishte shtetas qipriot që jetonte në pjesën që kontrollohej nga qeveria qirpiote, nuk mund të votonte vetëm sepse i përkiste komunitetit turk në Qipro.

13. Gjykata vlerësoi se, fakti që personat që i përkisnin komunitetit turk nuk mund të votonin në asnjë prej zgjedhjeve parlamentare, ishte objektivisht i pajustificuar. Sipas Gjykatës, ekzistonte një trajtim dukshëm i ndryshëm i shtetasve të dy komuniteteve në Qipro, trajtim ky i cili derivonte haptazi trajtim diskriminues për komunitetin turk. Për rrjedhojë në këtë rast autoritetet qipriote kanë shkëlur nenin 14 të Konventës në lidhje me nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës.

#### ***C. Në lidhje me nenin 41***

14. Gjykata vendosi t'i akordonte kërkuesit 3 500 euro vetëm për shpenzimet e procesit gjyqësor.

### **III. Koment**

15. Ky vendim përbën një kontribut themelor të jurisprudencës së Gjykatës, në trajtimin e problemit të konflikteve të ngrira ose jo plotësisht të zgjidhura, në një numër vendesh evropiane. Natyrisht që problemet e zgjedhjeve dhe të së drejtës për të votuar dhe për tu zgjedhur janë të parat që dalin në pah. Vendimi konkret duhet kuptuar në kuadrin e rrethanave specifike qipriote. Pjesa dërmuese e turko-qiprioteve nuk kanë marrë pjesë në jetën politike dhe në zgjedhjet e organizuara në Republikën e Qipros që më 1963. Grushti i shtetit më 1974, i cili u pasua me një pushtim të pjesës veriore të ishullit nga ushtria turke, veçse sa e vështirësoi situatën, dhe praktikisht ishulli është i ndarë në Republikën e Qipros dhe në Republikën Turke të Qipros së Veriut<sup>263</sup>. Pavarësisht se nenet 62 dhe 63 të Kushtetutës Qipriote

<sup>263</sup> Për më shumë informacion shih vendimin e GJEDNJ në çështjen Qipro kundër Turqisë, 10 maj 2001. Shih në Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, Ledi Bianku, fq. 51.

të vitit 1960 parashikonin krijimin e dy listave të veçanta, një për qipriotët grekë, të cilët votonin për 70 % të deputetëve, dhe një për qipriotët turkë, të cilët votonin për 30 % të deputetëve, ligji 72/79, duke pasur parasysh situatën faktike të pas vitit 1974, nuk parashikonte dy lista të ndara. Kjo bënte shtetasit qipriote me origjinë turke që jetonin në Republikën e Qipros, pra në pjesën jugore të ishullit, të mos mund të merrnin pjesë efektivisht në votime. Megjithëse pranon faktin se shtetet gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi në zbatimin e së drejtës për të votuar, në kuptimin e nenit 3 të Protokollit 1, Gjykata vlerësoi se autoritetet qipriote e kishin privuar tërësisht kërkuesin nga çdo mundësi për të shprehur mendimin e tij dhe për këtë arsye konstatoi shkelje të kësaj dispozite.

16. Vendimi i Gjykatës përçon një mesazh me shumë interes për situatën shqiptare. Ajo që kuptohet nga vendimi i Gjykatës është se, fakti që Kushtetuta qipriote e parashikonte të drejtën e shtetasve qipriote me origjinë turke të merrnin pjesë në zgjedhje nuk kishte asnjë vlerë për atë kohë nuk ishin marrë masa konkrete legjislative dhe administrative për të realizuar këtë të drejtë. Për më tepër, ligji 72/79 reflektonte realitetin politik dhe jo detyrimin kushtetues. Kjo situatë, ku ligji i brendshëm nuk respekton detyrimin kushtetues, duke shfaqur një problem të qartë të ligjshmërisë së kufizimit të së drejtës për të votuar, e bën të pashmangshme konstatimin e shkeljes të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës. Siç është thënë në mënyrë të përsëritur nga Gjykata, parimi i ligjshmërisë është guri themelor i funksionimit të çdo sistemi ligjor që pretendon të respektojë të drejtat e njeriut. Nga ana tjetër, vendimi që po shqyrtojmë mund të na shtyjë deri në përfundimin se, mangësitë procedurale në lidhje me regjistrimin në listat zgjedhore ose ankimin gjyqësor vijues për shkak të problemeve të lidhura me deklarimin dhe regjistrimin e vendbanimit, mund të përbënin objekt ankesash eventuale në Strasburg nga Shqipëria.

17. Gjykata konstatoi gjithashtu shkelje të nenit 14 të Konventës, të lexuar së bashku me nenin 3 të Protokollit 1. Ky konstatim, gjithashtu krejt logjik, bëhej për shkak se kufizimi i së drejtës për të votuar që i bëhej kërkuesit, e gjente haptazi shkakun në origjinën e tij etnike. Përderisa ai kishte shtetësinë qipriote, një diskriminim i tillë nuk mund të justifikohet dhe ai duhet të kishte mundësinë efektive të ushtronte të drejtën e tij për të votuar, si të gjithë shtetasit e tjerë qipriote.

## SITAROPOULOS DHE GIAKOPOULOS kundër GREQISË

(kërkesa nr.42202/07)

15 mars 2012

### Dhomë e Madhe

#### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit ishin dy shtetas grek të lindur respektivisht në vitin 1967 dhe 1958, banues në Strasburg, Francë. Kërkuesit mbanin postin e zyrtarit në Këshillin e Evropës.
2. Me dekretin Presidencial nr. 154/2007, parlamenti grek u shpërnda dhe u shpall data e zgjedhjeve të parakohshme më 16 shtator 2007. Kërkuesit i dërguan një faks ambasadorit të Greqisë në Francë, ku i kërkonin të shprehnin vullnetin e tyre me votë për zgjedhjet e ardhshme, prej vendit ku ata jetonin.
3. Ambasadori, duke u mbështetur edhe në direktivat e dhëna nga Minsitria e Punëve të Brendshme të Greqisë i ktheu përgjigje kërkesës tyre, duke u shpjeguar kërkuesve se mungonte baza ligjore për mënyrën e votimit të qytetarëve grek rezident në një vend tjetër, pa qenë nevoja e vajtjes së tyre në Greqi ditën e votimit.
4. Zgjedhjet u zhvilluan në datën e përcaktuar dhe kërkuesit, duke mos patur mundësi që të udhëtonin për në Greqi, nuk e ushtruan të drejtën e tyre për të votuar.
5. Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke pretenduar se me pamundësinë që kishin emigrantët grek për të votuar jashtë Greqisë ishte shkelur e drejta e tyre për të shprehur lirshëm vullnetin e tyre me votë, një e drejtë kjo që garantohej nga neni 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës.

#### II. Vendimi i Gjykatës

##### A. Në lidhje me nenin 3 të Protokollit 1

6. Gjykata vlerësoi se, pavarësisht se Kushtetuta greke i kishte dhënë të drejtën emigrantëve për të votuar në vendin ku ata banonin, qeveria nuk kishte ndërmarrë asnjë masë nënligjore për procedurën dhe mënyrën sesi do të mbaheshin këto zgjedhje për emigrantët. Kjo sjellje e qeverisë greke kishte derivuar në një trajtim jo të drejtë të qytetarëve grek, që jetonin jashtë Greqisë.
7. Neni 3 i Protokollit 1 të Konventës është një detyrim për shtetet palë për të mundësuar zgjedhje demokratike si dhe garantimin e të drejtës individuale të votës për të gjithë.

8. Gjykata vërejtë se kërkuesit e gëzonin të drejtën për të votuar jashtë vendit të tyre dhe këtë të drejtë ua garantonte Kushtetuta, por ata u ankuan për faktin se nuk janë marrë masat e duhura nënligjore për vënien në praktikë të kësaj të drejte.

9. Për të shqyrtuar këtë pretendim, Gjykata mori në konsideratë praktikatat e shteteve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës, që lejonin votimet e emigrantëve në vendin ku ato jetonin, instrumenta të ndryshëm ndërkombëtarë në lidhje me këtë problem dhe dispozitat e legjislacionit të brendshëm grek.

10. Sipas Gjykatës, nga shqyrtimi i materialeve të mësipërme, nuk ekzistonte asnjë parashikim apo praktikë e ushtruar, që të detyrojë shtetet për të krijuar kushte të veçanta për votimin e emigrantëve prej vendit ku ata jetojnë.

11. Pavarësisht se Këshilli i Evropës i kishte rekomanduar të gjithë shteteve anëtare të merrnin masat e duhura për ushtrimin e të drejtës së votës nga ana e emigrantëve, Komisioni i Venecias kishte dalë në përfundimin se kjo ishte një këshillë dhe i takonte secilit shtet ta merrte ose jo në konsideratë, duke mos e cilësuar kështu një detyrim.

12. Gjithashtu, Gjykata theksoi se në Kushtetutën Greke këshillohej që të krijoheshin mekanizma për votimin e emigrantëve prej vendit ku ata jetonin, por kjo nuk ishte një detyrim për qeverinë greke.

13. Duke pasur parasysh se ky diskutim ishte ngritur në shtetin grek, dhe partitë politike greke ndanin mendime të ndryshme për mënyrën sesi do të lejohej votimi i emigrantëve jashtë Greqisë, atëherë Gjykata vlerësoi se nuk është detyrë e saj të vendosë për këtë çështje krejtësisht të brendshme.

14. Në përfundim, Gjykata çmoi se shpenzimet që do të kishin kërkuesit dhe familjet e tyre në rast se do të udhëtonin për në Greqi ditën e votimit, nuk përbëjnë shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.

### III. Koment

15. Në këtë vendim, Gjykata shqyrtoi pamundësinë e emigrantëve të votojnë në shtetin e tyre të banimit në zgjedhjet parlamentare. Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 në një vendim të Dhomës, duke u shprehur se mungesa e parashikimit ligjor të së drejtës së emigrantëve për të votuar, e garantuar sipas Kushtetutës, përbënte një "trajtim të padrejtë ndaj grekëve të mërguar (...) në krahasim me ata që banojnë në territorin grek". Këshilli i Evropës kërkon që shtetet anëtare të lejojnë qytetarët e tyre që jetojnë jashtë vendit, të marrin pjesë sa më shumë të jetë e mundur në procesin zgjedhor. Gjykata mbajti parasysh tekstet relevante të miratuara nga organet përkatëse të Këshillit të Evropës, në veçanti Kodin, në lidhje me votimin me postë dhe votimin elektronik.

16. Dhoma e Madhe mbajti një pozicion të kundërt me Dhomën. Ashtu si Komisioni i Venecias, ajo e konsideroi të dëshirueshëm lehtësimin e ushtrimit të së drejtës së



votës nga emigrantët. Por sipas Dhomës së Madhe, kjo nuk do të thotë që është e detyrueshme, por më tepër është një mundësi për t'u marrë parasysh në çdo vend. Ajo vëren më tej se në të drejtën krahasuese, disa shtete të Këshillit të Europës nuk ofrojnë mundësinë e votimit për emigrantët dhe vetëm në shtetet ku sigurohet kjo e drejtë, që gjithsesi janë shumica, kushtet për ushtrimin e saj ndryshojnë shumë, duke përfshirë një hapësirë të gjerë vlerësimi. Kushtetuta greke nuk imponon një detyrim, por një mundësi për votim jashtë vendit, dhe autoritetet janë përpjekur në mënyrë të përsëritur, por pa sukses, të nxjerrin ligje mbi këtë çështje. Kodi Zgjedhor parashikon votimin me postë ose në mënyrë elektronike vetëm duke iu referuar kritereve strikte që rregullojnë përdorimin e tyre, duke pasur parasysh rrezikun e manipulimeve që këto sjellin dhe jo detyrimin për t'i zbatuar këto forma të votimit.

## SEJDIC DHE FINCI kundër BOSNJE-HERCEGOVINËS

(kërkesa nr. 27996/06 dhe 34836/06)

22 dhjetor 2009

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit janë të dy shtetas nga Bosnje-Hercegovina dhe jetojnë në Sarajevë. Z. Sejdic është me origjinë rome, ndërsa Z. Finci i përket komunitetit hebre. Të dy janë figura të spikatura publike në Bosnje-Hercegovinë.
2. Kushtetuta e Bosnje-Hercegovinës bën një ndarje të popullsisë në dy kategori në preambulën e saj: kategoria e shtetasve kushtetues (boshnjakët, kroatët dhe serbët) dhe kategoria e shtetasve të tjerë, ku bëjnë pjesë minoriteti rom, hebre dhe disa shtetas të tjerë që nuk janë pjesë e asnjë minoriteti etnik.
3. Kjo ndarje shërben për të bërë një dallim mes qytetarëve që mund të kandidojnë për Dhomën e Dytë të Parlamentit dhe në postin e Presidentit. Sipas Kushtetutës, vetëm ata shtetas që i përkasin kategorisë së popullsisë kushtetuese mund të kandidojnë për këto poste.
4. Z. Finci i kishte shprehur KQZ-së qëllimet e tij për të marrë pjesë në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. KQZ-ja i kishte refuzuar kërkesën me argumentin se ai, duke qenë me origjinë hebreje, nuk mund të kandidonte në këto poste për shkak se nuk e lejonte Kushtetuta.
5. Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke pretenduar se ishin shkelur një sërë nenesh të Konventës, duke i penguar ata për të marrë pjesë në zgjedhjet presidenciale apo parlamentare, vetëm për faktin se i përkisnin një grupi të caktuar etnik. Sipas tyre, ishin shkelur nenet 3, 13, 14 të Konventës, neni 3 i Protokollit 1 dhe neni 1 i Protokollit. 12 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 14 marrë sëbashku me nenin 3 të Protokollit 1

6. Gjykata u shpreh se, duke pasur parasysh impaktin që kishin dy kërkuesit në jetën publike të Bosnje-Hercegovinës, ishte thjesht logjike dhe çështje kohe që ata të kërkonin të kandidonin në zgjedhjet presidenciale apo parlamentare. Pra, ishte e qartë që në këtë rast kemi të bëjmë me një shkelje të të drejtave të tyre.

7. Duke u ndalur në Dhomën e Dytë të Parlamentit, pjesëtarët e saj edhe pse zgjidheshin në mënyrë indirekte, gëzonin fuqi të konsiderueshme legislative. Rasti i kërkuesve nuk ishte i vetmi dhe vendime përjashtimore për shkak të origjinës etnike kishte pasur edhe më parë. Gjykata vërejtë se ishte shprehur edhe më parë për diskriminimin që i bëhej një individit për origjinën e tij etnike. Ajo u shpreh se Konventa nuk lejon asnjë lloj forme diskriminimi të kësaj natyre, qoftë direkte apo indirekte, si një arsye justifikuese për të shkelur të drejtat e individit.

8. Në rastin konkret, që të ishte i legjitimuar për të marrë pjesë në zgjedhjet presidenciale apo parlamentare, duhej të deklaronte se i përkisje grupit të personave kushtetues, diçka që kërkuesit nuk kishin pranuar ta bënin për shkak të origjinës tyre etnike. Ky mekanizëm kishte të bënte me ndarjen e pushteteve në vend, dhe sipas kësaj pengese ishte e pamundur që të kundërshtohesh vullneti i kategorisë së popullsisë kushtetuese, duke pasur parasysh se ata ishin të vetmit që mund të mbanin postet e rëndësishme në vend.

9. Gjykata pranoi faktin që ky sistem pushtetesh përdorej për të qetësuar tensionet politike në vend dhe kjo si pasojë e pushimit të luftrave etnike në rajon. Palët kishin rënë dakord dhe ishte arritur një marrëveshje paqeje dhe vendi ndodhej në një situatë të brishtë, por në vitin 2009 kur kushtetuta ishte amenduar, situata ishte përmirësuar dukshëm falë administrimit dhe vëmendjes së lartë ndërkombëtare.

10. Pavarësisht këtij fakti, ndoshta qeveria e Bosnje-Hercegovinës akoma nuk ishte gati që të dilte nga ky sistem i ndarjes së pushteteve. Me ratifikimin e Konventës dhe Protokolleve të saj në 2002, Bosnja kishte rënë dakord që ta rishikonte të gjithë sitemin dhe ligjin elektoral të vendit duke e përshatur atë me frymën e Konventës.

11. Gjithashtu edhe në vitin 2008, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit për t'u bërë pjesë e B.E.-së, shteti i paditur kishte rënë dakord që do ta rishikonte të gjithë mekanizmin e zgjedhjeve në vend, qofshin parlamentare apo presidenciale, brenda një ose dy viteve. Duke u ndodhur para këtyre fakteve, Gjykata vlerësoi se Bosnje-Hecegovina nuk ka pasur arsye për të vazhduar të zbatonte të njëjtin sistem zgjedhor dhe për pasojë ka shkelur nenin 14 të Konventës marrë sëbashku me nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës.

### B. Në lidhje me nenin 1 të Protokollit 12

12. Sipas Gjykatës, neni 1 i Protokollit 12 të Konventës shërben për të përforcuar

dhe zgjeruar më shumë konceptin e diskriminimit, një dukuri e konsideruar shkelje edhe në kuptim të nenit 14 i Konventës.

13. Pavarësisht se kishin qëllime të ndryshme, si neni 14 ashtu edhe neni 1 i Protokollit 12 të Konventës, shërbejnë për ndalimin e çdo lloj forme diskriminimi. Duke patur parasysh argumentet që Gjykata kishte parashtruar për zgjedhjet parlamentare më sipër, ajo vlerësoi se këto argumenta vlejné edhe për rastin e zgjedhjes së presidentit dhe për këtë arsye ishte cenuar e drejta e garantuar nga neni 1 i Protokollit 12 të Konventës.

14. Sipas Gjykatës, nuk ishte e nevojshme të shqyrtohet vetë pretendimi për nenin 1 të Protokollit 3 të Konventës, marrë së bashku apo pa nenin 1 të Protokollit 12 të Konventës.

### *C. Në lidhje me nenin 41*

15. Gjykata vlerësoi se thjesht fakti që ajo evidentoi shkelje të të drejtave të kërkuesve përbënte në vetvete një shpërblim të drejtë dhe të mjaftueshëm në kuadër të dëmit jomaterial. Gjykata, në kuadër të shpenzimeve gjyqësore, i akordoi kërkuesit të parë 1 000 euro dhe të dytit shumën prej 20 000 euro.

### **III. Koment**

16. Ky vendim përbën një risi përpara Gjykatës Evropiane për disa arsye tepër të rëndësishme.

17. Ky është vendimi i parë në bazë të Protokollit 12, që ndalon diskriminimin, por jo vetëm në lidhje me të drejtat e parashikuara nga Konventa, siç bën neni 14, por në përgjithësi. Në shqyrtimin e saj, Gjykata i referohet fillimisht nenit 14. Kujtojmë se neni 14 është më kompleks në interpretim pasi varet nga zbatueshmëria e një neni tjetër të Konventës, kurse Protokollit 12 thjesht kërkon “të drejte të përcaktuar me ligj”, pra qoftë edhe ligj të brendshëm. Megjithatë duket se Gjykata e preferoi këtë përqasje për dy arsye. Së pari, duke shqyrtuar nenin 14 vetëm para nenit 3 të Protokollit 1, Gjykata tregoi një ndryshim të mirëpritur për të vendosur mbi një çështje që është në thelb në lidhje me diskriminimin sipas nenit 14 dhe jo qasjen e saj tradicionale për të vendosur mbi nenin që parashikon një të drejtë materiale, dhe eventualisht, në rast shkelje të tij, nuk e shihte të nevojshme të vendoste edhe mbi nenin 14. Së dyti, zgjidhja e saj mbi këtë çështje sugjeron gjithashtu që neni 14 mbi ndalimin e diskriminimit do të zbatohet për zgjedhjet e tërthorta, si dhe drejtpërdrejtë, të çdo dhome të një asambleje.

18. Vendimi i Gjykatës bën gjithashtu të qartë se, Konventa duhet të zbatohet në mënyrë të plotë edhe në situatat më delikate të tilla si në Bosnjën pas konfliktit dhe në veçanti dallimi në trajtim i bazuar në përkatësinë etnike do të jetë shumë i vështirë për t’u justifikuar, edhe në rrethana të tilla. Ky është një mesazh themelor për situatën në Bosnjë e cila ende nuk ka arritur ta ekzekutojë këtë vendim. Madje ka

edhe interpretime që në situatën e Bosnjës, Gjykata nuk duhet të shkonte deri aty sa të gjente shkelje, duke sugjeruar indirekt që Gjykata të legjitimonte një diskriminim të hapur mbi bazën e origjinës etnike. Gjykata, duke e mbajtur parasysh specifikën e situatës Boshnjake, theksoi se Bosnja kishte fuqinë për të ndryshuar Kushtetutën e saj dhe se në fund të fundit ishte ajo që kishte zgjedhur të ratifikonte Konventën dhe për këtë arsye kishte marrë përsipër të sillte standardet e saj në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës. Ky mesazh ka rëndësi të veçantë në lidhje me situatën në Qipro<sup>264</sup>. Pra thelbi i mesazhit është që, për shtetet që kanë ratifikuar Protokollin 12, ashtu si edhe Shqipëria, në procesin elektorale në lidhje me të drejtat e parashikuara me ligj, nuk mund të bëhet asnjë diskriminim për arsye etnike apo për çfarëdo arsye tjetër.

19. Ky vendim i Gjykatës duket të jetë i pari ku një pjesë e Kushtetutës që ka të bëjë me organizimin e institucioneve të një Shteti gjendet në shkelje të Konventës.

20. Vendimet për të gjetur shkeljet e nenit 14 dhe Protokollit 12 janë marrë me shumicë votash. Gjyqtarët e pakicës kritikuan konstatimet e shumicës për një numër arsyes. Frika ishte ngritur që gjykimi mund të rezultojë në trazira serioze kushtetuese dhe prandaj Dhoma e Madhe duhet të kishte analizuar si sfondin historik ashtu edhe rrethanat në të cilat u vendos Kushtetuta e Bosnjës dhe Hercegovinës. Dy nga gjyqtarët e pakicës shprehën gjithashtu zhgënjimin e tyre se Dhoma e Madhe nuk e ka përdorur këtë rast, i pari që e konsideron diskriminimin sipas Protokollit 12, për të përcaktuar parime, standarde apo teste specifike që mund të konsiderohen si universale dhe të zbatueshme për rastet e ardhshme në lidhje me diskriminimin e përgjithshëm. Në vend të kësaj, sipas atyre, Gjykata përsëriti arsyetimin e saj në lidhje me gjetjet sipas nenit 14. Megjithëse mund të diskutohet nëse kjo gjë do të ishte e dobishme apo jo, vlen të theksohet se sipas shumicës, duket se parimet e përgjithshme në lidhje me diskriminimin sipas Protokollit 12 janë të njëjta me ato të nenit 14 të Konventës. Duket se, sipas mendimit të Gjykatës, është thjesht fusha e veprimit që ndryshon.

## HIRST kundër MBRETËRISË SË BASHKUAR

*(kërkesa nr.74025/01)*

**6 tetor 2005**

**Dhomë e Madhe**

### **I. Faktet kryesore**

1. Kërkuesi është një shtetas britanik i lindur në vitin 1950, i cili ka vuajtur dënimin me burgim të përjetshëm në një burg të Mbretërisë së Bashkuar deri në vitin 2004, kur dhe u lirua me kusht.

<sup>264</sup> . Shih edhe vendimin Aziz k. Qipros të përfshirë në këtë botim.

2. Kërkuesi vuan dënimin në burg për shkak se në vitin 1980 ai u dënua për vrasje për shkak të aftësive të kufizuara mendore. Një raport mjekësor i cilësonte veprimet e tij si veprime anormale. Ai u dënua me burgim të përjetshëm me të drejtë rishikimi.

3. Në 25 qershor të vitit 1994 u mbledh Bordi për Shqyrtimin e Akordimit të Lirimit me Kusht me qëllim vlerësimin e situatës së kërkuesit. Ky bord nuk e aprovoi lirimin e tij me kusht me argumentin se ai vazhonte të përbënte rrezik të lartë për shoqërinë dhe për këtë arsye, kërkuesi u rikthye për të vazhduar dënimin e tij në burg.

4. Ligji elektorale britanik i vitit 1983 ndalonte për të votuar kërkuesin apo edhe persona të tjerë të cilët vuanin dënim të ngjashëm me të.

5. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Lartë me pretendimin se duke i mohuar të drejtën e tij për të votuar ishte shkelur Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kërkesa e tij u refuzua nga gjykata, po ashtu edhe apelimi ndaj vendimit të gjykatës.

6. I gjendur në këtë situatë, kërkuesi iu drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke pretenduar se përjashtimi i tij nga mundësia dhe drejta për të votuar në Mbretërinë e Bashkuar përbënte shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës. Ai mbështeti pretendimet e tij gjithashtu edhe në nenin 10 dhe 14 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3 të Protokollit 1

7. Gjykata theksoi faktin se neni 3 i Protokollit 1 të Konventës është një e drejtë dhe jo një privilegj që mund t'i jepet personave të caktuar. Kjo e drejtë duhet të qëndrojë në bazë të çdo demokracie të zhvilluar në botë.

8. Por ashtu siç është shprehur edhe në raste të tjera, Gjykata vërejtë se kjo e drejtë nuk është absolute dhe se palët e larta kontraktuese gëzojnë një hapësirë të gjerë vlerësimi mbi këtë drejtë. Zgjedhjet në vende të ndryshme vijnë dhe organizohen në forma të ndryshme për shkak të kontekstit të tyre historik dhe zhvillimeve të ndryshme ekonomike, sociale dhe kulturore.

9. Gjykata theksoi se çdo kufizim i kësaj të drejte duhet të ndjekë një qëllim objektiv legjitim dhe të respektojë parimin e proporcionalitetit. Përjashtimi i grupeve të ndryshme të popullsië nga votimi duhet t'i shërbejë ruajtjes dhe garantimit të zgjedhjeve në vend dhe nuk duhet të cenojë thelbin e nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.

10. Për rastin e të dënuarve, Gjykata është shprehur edhe në çështje të tjera që ata janë të përjashtuar vetëm nga e drejta për të qenë të lirë dhe gëzojnë çdo të drejtë tjetër të garantuar nga Konventa, duke theksuar këtu se privimi i lirisë vjen si pasojë e veprimeve të tyre në kundërshtim me ligjin. Nuk është e drejtë që të burgosurit të privohen nga e drejta e tyre për të votuar, vetëm për faktin se ato janë në atë gjendje.

11. Përsa i përket qëllimit legjitim, Gjykata u shpreh se neni 3 i Protokollit<sup>1</sup> nuk përcakton në mënyrë shteruese arsyet apo nevojën përse shteti mund t'i privojë këtë të drejtë një individi, duke qenë se rastet mund të jenë nga më të ndryshmet. Në rastin konkret qeveria u shpreh se në këtë mënyrë, ligji shërben në uljen e kriminalitetit në vend dhe nxit respektimin e ligjit. Gjykata e pranon se kjo mund të konsiderohet si qëllim legjitim.

12. Duke u ndalur në parimin e propocionalitetit, Gjykata u shpreh se numri prej 48 000 të dënuarish që ishin privuar nga kjo e drejtë, përbënte një numër të paneqlizhueshëm personash. Sipas saj, ligji përfshinte një gamë të gjerë dënimesh dhe krimesh, që varionin nga dënimi me një ditë burg, në atë me burgim të përjetshëm, nga krime të lehta në ato me rrezikshmëri shumë të lartë.

13. Gjithashtu, Gjykata vuri theksin tek mungesa e një debati parlamentar apo dhe mes ekspertëve të sistemit gjyqësor në Mbretërinë e Bashkuar, mbi ndryshimet e fundit mbi dënimet penale dhe të drejtat e njeriut, për të diskutuar propocionalitetin e ligjit aktual. Në vend, përjashtimi i këtij grupi personash për të votuar shikohej më shumë si një çështje me rëndësi për Parlamentin sesa për sistemin e drejtësisë, ku asnjë gjykatë lokale nuk kishte marrë iniciativën për të shqyrtuar proporcionalitetin e këtij ligji.

14. Përsa i përket qëllimit të këtij ligji, Mbretëria e Bashkuar nuk ishte e vetmja palë e lartë kontraktuese që kishte marrë këto masa, madje ajo kishte ligjin me efektet më të lehta ndër ato shtete, që e privonin këtë të drejtë. Kishte pasur shumë raste që personat ishin lejuar të votonin dhe çdo person e fitonte të drejtën për të votuar në momentin që ai rifitonte lirinë.

15. Pavarësisht situatës së lartpërmendur, faktit që kishte pasur disa përmirsime me Aktin e vitit 2000, apo se Mbretëria e Bashkuar gëzonte një hapësirë të gjerë vlerësimi, Gjykata arsyetoi se kjo masë ishte diskriminuese dhe i hiqte të drejtën për të votuar një numri të konsiderueshëm njerëzish.

16. Gjykata u ndal në veçanti te fakti se çdo i dënuar, pavarësisht krimit apo dënimit, gjatë kohës që vuante dënimin e humbiste këtë të drejtë. Sipas Gjykatës, pavarësisht se Konventa i njuh një hapësirë të gjerë vlerësimi shteteve anëtare, kjo masë e përgjithshme nuk mund të pranohet se është në përputhje me frymën e Konventës. Në fund ajo u shpreh se në rastin objekt gjykimi ishte shkelur neni 3 i Protokollit 1 të Konventës.

17. Përsa i përket masës dëmshpërblyese, duke pasur parasysh qasjet e ndryshme ligjore që Mbretëria e Bashkuar po ndiqte për zgjidhjen e kësaj çështje, Gjykata ia la në dorë shtetit të paditur marrjen e vendimit për rastin konkret.

#### ***B. Në lidhje me nenin 10 dhe 14***

18. Gjykata vlerësoi se asnjë nga faktet e çështjes nuk lidhet me shqyrtimin e këtyre neneve.



### III. Koment

19. Dhoma e Madhe konkludoi se ndalimi absolut i të drejtës së të burgosurve për të votuar në Mbretërinë e Bashkuar përbënte shkelje të nenit 3 Protokollit 1 i Konventës. Qeveria i kërkoi Gjykatës, në qoftë se do të gjente një shkelje, në interes të sigurisë juridike duhet t'u jepte shteteve udhëzime të hollësishme se çfarë hapash duhet të merrnin për të implementuar një regjim në përputhje me kërkesat e nenit 3 të Protokollit 1. Megjithatë, Gjykata nuk pranoi ta bënte këtë. Siç kuptohet nga vendimi, disa kufizime për të drejtën e të burgosurve për të votuar lejohen, por do të kishte qënë e dobishme nëse Gjykata do të kishte specifikuar nëse të burgosurit që shërbenin periudhën pas tarifës<sup>265</sup>, duhet të privoheshin gjithashtu apo jo. Për më tepër, duhet të specifikohet nëse një gjyqtar duhet të urdhëronte specifikisht heqjen e të drejtës për të votuar në secilin rast individual, ose nëse disa aspekte të tjera duheshin rregulluar rast pas rasti. Është e qartë se duhen bërë disa ndryshime në ligj.

20. Vendimi u pasua nga një reagim i ashpër nga disa media britanike, disa prej të cilave shkruanin në tituj se "Vrasësit kanë të drejtën e votës". Tituj të tillë tregojnë se mesazhi i vendimit nuk është kuptuar drejtë. Ky vendim godet ndalimin absolut, për çdo të burgosur, për të votuar, dhe jo ndalimin për të gjitha kategoritë e të burgosurve.

21. Dhoma e Madhe e ka shprehur pozicionin e saj në vendimin Scoppola k. Italisë, ku ajo thekson se ndalesat e përgjithshme dhe absolute që prekin automatikisht një grup të padallueshëm të dënuarish vetëm për shkak të burgosjes së tyre dhe pavarësisht nga masa e dënimit, natyra ose ashpërsia e veprës dhe rrethanat e tyre të veçanta, nuk është në përputhje me nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

22. Gjykata citon përsëri Kodin e Praktikave të mira elektorale<sup>266</sup>, por ende heziton të zbatojë kushtin e fundit të përcaktuar nga ky Kod në lidhje me parashikimin e sanksioneve nga një gjykatë, në një vendim. Ajo largohet nga llogjika Frodl k. Austrisë, duke çmuar se qëllimi i individualizimit minimal të dënimit mund të arrihet në mënyrë të mjaftueshme me akte ligjore, edhe në mungesë të një vendimi gjyqësor. Nëse, sipas Gjykatës, ndërhyrja e një gjyqtari siguron proporcionalitetin e kufizimeve ndaj të drejtave të të burgosurve, kufizime të tilla nuk janë domosdoshmërisht automatike, të përgjithshme dhe pa dallim, thjesht sepse ata nuk janë vendosur nga një gjyqtar. Në të vërtetë, rrethanat në të cilat mund të humbasi e drejta e votës mund të detajohen në mënyrë të mjaftueshme nga ligji, i cili mund t'ia nënshtrojë privimin e të drejtave të votimit kushteve të ndryshme të tilla si, natyra ose ashpërsia e veprës. Gjykata gjithashtu vëren se nevoja për një vendim gjyqësor specifik nuk gjen konsensus në të drejtën krahasuese evropiane (§ 99).

<sup>265</sup> Dmth jo elementin ndëshkimor të dënimit.

<sup>266</sup> Shih § 44 të vendimit Scoppola (3).

## YUMAK DHE SADAK kundër TURQISË

(kërkesa nr.10226/03)

8 korrik 2008

### I. Faktet kryesore

1. Të dy kërkuesit janë shtetas turk, banues në Sirnak të Turqisë. Ata pretendojnë se nuk kanë arritur që të marrin mandatin e deputetit në zgjedhjet parlamentare të vitit 2002, për shkak të ligjit elektoral në fuqi.

2. Kërkuesit kandiduan për Partinë e Popullit Demokrat në zonën elektorale të Sirnakut, duke fituar 45.59% të votave, por nuk arritën të fitonin një vend në parlamentin turk për shkak të ligjit elektoral në fuqi. Sipas këtij ligji, asnjë kandidat nuk mund të përfitonte mandatin e deputetit nëse partia e tij nuk fitonte minimalisht 10% të votave në rang kombëtar.

3. Nga tre mandate që do të dilnin nga ajo zonë elektorale, dy vende i fitoi Partia për Drejtësi dhe Zhvillim me 11% të votave në atë zonë, ndërsa mandati tjetër u fitua nga një kandidat i pavarur.

4. Nga tetëmbëdhjetë parti pjesëmarrëse, vetëm dy prej tyre arritën që të kalonin pragun elektoral dhe të merrnin mandate në parlament. Partia mazhoritare fitoi 63% të vendeve në parlament ndërsa tjetra 33% prej tyre. Gjithashtu, tetë vende u fituan nga kandidatë të pavarur.

5. Parlamenti turk shënoi rekordin më të ulët të përfaqësimit popullor, që nga koha e miratimit të sistemit multi-partiak. Gati 45% e popullsisë nuk kishte përfaqësues në parlament. Opinionistë të ndryshëm rënditën një sërë faktorësh që lidheshin me problemet ekonomike dhe politike në vend, si arsye të këtij rezultati, pa lënë mënjanë ndikimin e ligjit elektoral.

6. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 partitë politike në Turqi përdorën 2 strategji të ndryshme për të shmangur efektin e ligjit elektoral. Ata vendosën që kandidatët e tyre të kandidonin si të pavarur, në mënyrë që ndaj tyre ndaj të mos aplikohet kushti, që partia e tyre të kishte minimalisht 10% të votës popullore në rang kombëtar për të përfaqësuar në parlament, ose duke ndryshuar partinë që kandidonin në zgjedhje apo dhe hyrjen në koalicione të ndryshme.

7. Kërkuesit iu drejtuan GJEDNJ-së pasi sipas tyre, kushti që partitë politike duhet të kishin minimalisht 10% të votave popullore në rang kombëtar me qëllim që kandidatët e tyre të merrnin mandatin e deputetit, cenonte lirinë e tyre për t'u

zgjedhur dhe lirinë e njerëzve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në parlament. Ata u mbështetën në nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3 të Protokollit 1

8. Gjykata vuri theksin tek fakti që pragu elektoral në Turqi ishte më i larti mes të gjithë vendeve anëtare të Këshillit të Evropës. Madje pragu elektoral zbatohet vetëm nga tre shtete të tjera anëtare.

9. Gjithashtu, Gjykata u shpreh se pragu elektoral është një mënyrë ligjore, me anë të së cilës vende të ndryshme zgjidhin problemet që mund të vijnë nga sistemi zgjedhor. Kushte të tilla vendoseshin me qëllimin që të shmangnin sa më shumë copëzimin dhe përçarjen parlamentare për krijimin e një mazhorance të fortë dhe të qëndrueshme. Vende të ndryshme kanë qasje të ndryshme dhe kjo varet nga sistemet zgjedhore që ato zbatojnë.

10. Gjykata u shpreh se pavarësisht se shtetet anëtare në Këshillin e Evropës zbatonin një prag elektoral prej 5% të votës popullore në rang kombëtar, disa shtete mund ta rrisin ose zvogëlojnë këtë normë duke u bazuar në kontekstin dhe evolucionin politik të tyre. Pra, Gjykata duhet ta shqyrtojë çështjen, duke u bazuar në historinë politike të Turqisë si dhe në garancitë ligjore që ofronte ky shtet për të shmangur arbitraretin.

11. Sipas Gjykatës, zgjedhjet parlamentare të vitit 2002 ishin zhvilluar nën ndikimin e një gjendje të vështirë ekonomike e politike, dhe nuk mund të thuhet që ligji elektoral në fuqi kishte ndikuar plotësisht në rezultatin zgjedhor në atë kohë. Gjithashtu, Gjykata vuri theksin tek fakti se partitë politike në vend kishin gjetur disa mënyra për të shmangur zbatimin e pragut elektoral, por duke bërë këtë ata kishin cenuar qëllimin e ligjit, që kërkonte të shmangte copëzimin parlamentar.

12. Duke vlerësuar punën e Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht se Gjykata mendon se Turqia duhet ta ulë pragun elektoral poshtë normës prej 10%, ajo u shpreh se në rastin konkret objekt gjykimi nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës. Sipas saj, zbatimi i kësaj norme nuk cenon lirinë e individit për të zgjedhur apo për t'u zgjedhur, deri në atë pikë sa të cenojë qëllimin e nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.

## III. Koment

13. Ky vendim i Dhomës së Madhe, që ka të bëjë me një problem tepër të debatuar në një sërë vendesh evropiane, u arrit me një shumicë prej 13 me 4, duke vendosur se nuk kishte shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 ose të drejtën për zgjedhje të lira në rastin e një pragu elektoral prej 10%. Gjyqtarët Tulkens, Vajic, Jaeger dhe Sikuta, në mendimin e tyre në pakicë argumentuan se një prag kaq i lartë elektoral privonte një numër të madh votuesish nga e drejta për të zgjedhur. Rezultati i këtij vendimi është

kurioz po të mbahet parasysh që vetë shumica e Dhomës së Madhe vë në dukje se "... pragu zgjedhor prej 10% duket i tepruar. Në lidhje me këtë, ajo pajtohet me organet e Këshillit të Evropës, të cilat kanë theksuar nivelin jashtëzakonisht të lartë të pragut dhe kanë rekomanduar që të ulet."<sup>267</sup>

14. Vendimi ka rëndësi edhe sepse ai i referohet Kodit të Komisionit të Venecias për Praktikën e Mira Elektorale. Sipas udhëzimeve të këtij Kodi, "trashëgimia evropiane në fushën elektorale udhëhiqet nga pesë parime: ato duhet të jenë universale, të barabarta, të lira, të fshehta dhe të drejtpërdrejta".<sup>268</sup> Gjykata e ndan këtë vizion dhe thekson të njëjtat parime të përgjithshme, edhe pse përmbajtja e tyre mund të jetë shumë e ndryshme.

15. Duhet kujtuar që parimi i votimit të përgjithshëm ishte hequr gjatë hartimit të nenit 3 të Protokollit 1, nën presion nga përfaqësuesi britanik. Megjithatë ky boshllëk është plotësuar tashmë nga jurisprudenca e Gjykatës. Neni 3 është konsideruar se përfshin nocionin e votës universale. Ky parim është pranuar nga Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut që në vitin 1967 dhe është konfirmuar në mënyrë të përsëritur nga Komisioni<sup>269</sup> dhe Gjykata<sup>270</sup>, në çështjen Mathieu-Mohin dhe Clerfayt kundër Belgjikës<sup>271</sup>. Në vendime të tjera të rëndësishme Gjykata thekson se çdo shmangie nga ky parim përbën "një rrezik për vlefshmërinë demokratike të trupës legjislative të zgjedhur nga ky proces dhe të ligjeve që ajo nxjerr."<sup>272</sup>

16. Jurisprudenca e Strasburgut konsideron se e drejta për zgjedhje të lira përfshin në vetvete edhe barazinë përpara ligjit zgjedhor. Sipas Komisionit, në fakt, "kriteri i vetëm (sipas nenit 3) është se zgjedhjet duhet të sigurojnë një trajtim të barabartë të qytetarëve", ose, siç e thekson Gjykata, një "trajtim të barabartë të të gjithë qytetarëve në ushtrimin e së drejtës së tyre për të votuar dhe të drejtën e tyre për t'u përfaqësuar në zgjedhje." Zbatimi i ligjit zgjedhor nuk duhet të jetë diskriminues dhe Gjykata shpesh kombinon një shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 me shkelje të nenit 14, si në rastin Aziz kundër Qipros, të përfshirë në këtë botim, ku ajo dënon dallimin në trajtim midis dy komuniteteve në ishullin e Qipros. Megjithatë, sipas Gjykatës, titulli i Kodit "mundësi të barabarta", "nuk do të thotë (...) se të gjitha votat duhet të kenë peshë të barabartë në rezultat, apo se të gjithë kandidatët kanë gjasa të barabarta për të fituar"<sup>273</sup>. Ajo në këtë mënyrë pranon disa teknika zgjedhore. Specifikat territoriale për shkak të kufijve elektorale janë të mundshme siç është sqaruar në vendimin Bompard v. Francës<sup>274</sup>.

<sup>267</sup> . Shih paragrafin 147 të vendimit.

<sup>268</sup> Paragrafi 54 i vendimit.

<sup>269</sup> Vendimi i Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut, X k. R.F.GJ., n°2728/66, 6 tetor 1967.

<sup>270</sup> Vendimi i Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut, X, Y et Z, X k. Mbretërisë së Bashkuar, n° 7566/76, 11 dhjetor 1976.

<sup>271</sup> Vendim i vitit 1987. Shih paragrafin 51 të atij vendimi.

<sup>272</sup> Shih Hirst (n° 2) k. Mbretërisë së Bashkuar, § 62 ; Melnychenko k. Ukrainës, no 17707/02, 19 tetor 2004, § 56.

<sup>273</sup> Mathieu-Mohin dhe Clerfayt k. Belgjikës, paragrafi, § 54

<sup>274</sup> Bompard k. France, n° 44081/02, 4 prill 2006

## **PARTIA DEMOKRATIKE E BASHKUAR RUSE YABLOKO kundër RUSISË**

*(kërkesa nr. 18860/07)*

**8 nëntor 2016**

### **I. Faktet kryesore**

1. Kërkuesi, Partia Demokratike e Bashkuar Ruse Yabloko është një parti politike ruse e regjistruar, e cila e ka selinë e saj edhe në rajonin e Karelias. Në 26 prill të 2006, Këshilli Rajonal i Partisë lajmëroi organizimin e dy konferencave partiake që do të mbaheshin në 26 maj dhe 12 gusht në Karelia.

2. Partia kishte 3800 anëtarë, prej të cilëve 474 ishin “të regjistruar”. “Anëtarë të regjistruar” ishin të gjithë anëtarët e partisë që kishin kërkuar shprehimisht të regjistroheshin si anëtarë të organeve rajonale të partisë. Nga 474 antarë, 36 shprehën dëshirën për të marrë pjesë në zgjedhet e ardhshme që do të zhvilloheshin në rajonin e Karelias.

3. Në 10 dhe 11 qershor, partia Yabloko mbajti Kongresin e 13-të, gjatë të cilit u bënë disa ndryshime të Statutit të Qeverisë. Në bazë të ndryshimeve, u vendos se të drejtën për të zgjedhur dhe për të qenë të zgjedhur në organet qeverisëse dhe kontrolluese të partisë, e kanë vetëm anëtarët e regjistruar.

4. Në 4 qershor të 2006 u vendos se zgjedhjet e Karelias do të mbaheshin më 8 tetor 2006.

5. Në 12 gusht 2006 u mbajt sërish Konferenca e Partisë. Gjatë konferencës u caktuan emrat e kandidatëve në listat zgjedhore. Në konferencë ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (tani e tutje KQZ) të Karelias. Këta të fundit nuk raportuan asnjë parregullësi gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidaturave.

6. Në 31 gusht 2006, Shërbimi Federal i Regjistrimit (tani e tutje SH.F.R.) të Karelias i shkruajti KQZ-së, se Konferenca e datës 12 gusht 2006 është bazuar në pjesëmarrjen e anëtarëve të regjistruar në parti, dhe jo tek të gjithë antëtarët në përgjithësi, duke mos u garantuar të drejta të barabarta të gjithë pjesëmarrësve dhe duke shkelur ligjin kombëtar.

7. Në 8 shtator 2006, KQZ-ja kërkoi pranë Gjykatës së Lartë të Karelias të anulohet vendimi i regjistrimit të listës së kandidatëve të partisë Yabloko. KQZ-ja e bazoi kërkesën e saj tek Akti i Garantimit të Barazisë ku thuhet shprehimisht se mund të anulohet regjistrimi i listave të kandidaturave zgjedhore të regjistruara në rast se zbulohen “fakte të reja”, të cilat nuk ishin zbuluar më përpara.

8. Gjykata e Lartë pranoi kërkesën e KQZ-së, duke u shprehur se procedura e hartimit të listave të kandidaturave ka patur shkelje dhe se nuk ishin respektuar standardet demokratike pasi në lista ishte përfshirë vetëm kategoria e anëtarëve të regjistruar dhe jo të gjithë anëtarët.

9. Kërkuesi pretendoi se vendimi i KQZ-së përbënte shkelje të së drejtës për zgjedhje të lira. Sipas kërkuesit, KQZ-ja ishte në dijeni të të gjitha procedurave të hartimit të listave zgjedhore të partisë, dhe asnjëherë nuk i kishte kontestuar ato. Kërkesa për anulimin e listave pranë Gjykatës së Lartë nuk vinte si pasojë e zbulimit të “fakteve ose rrethanave të reja” nga ana e KQZ-së, por ishte një tentativë për të ndërhyrë në rregullat dhe organizimin e brendshëm të partisë.

10. Së dyti, kërkuesi sqaroi se statuti i partisë dhe procedurat e emërimit të listave zgjedhore nuk shkelnin ligjin, pasi e drejta për t'u regjistruar në parti iu ishte dhënë të gjithë anëtarëve pavarësisht gjinisë, fesë, përkatësisë etnike etj. Së fundmi, kërkuesi theksoi se asnjë nga antëtarët e partisë nuk ishte ankuar për procedurën e hartimit të listave pasi procedura ishte transparente, e pranuar nga të gjithë dhe në respektim të statutit të partisë dhe ligjit kombëtar.

11. Shteti theksoi se partia Yabloko nuk ishte bazuar tek ligji relevant kombëtar i Partive Politike gjatë hartimit të listave zgjedhore. Gjithashtu, gjatë hetimeve të kryera ishin zbuluar fakte dhe rrethana të reja, të cilat çonin në konkluzion se procedura e hartimit të listave nuk ishte e bazuar në ligj. Bazuar tek rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare, masa e marrë nga Gjykata e Lartë për anulimin e listave është proporcionale, pasi nuk ka si pasojë prishjen e partisë por thjesht ribërjen e listave.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 3 të Protokollit 1

12. Gjykata u shpreh se të drejtat e garantuara nga neni 3 i Protokollit 1 të KEDNJ-së janë parime bazë për demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës. Për të përcaktuar përputhshmërinë e një mase të marrë nga shteti anëtar me nenin 3 të Protokollit 1 kriteret e përdordura nga Gjykata janë: së pari, nëse ka patur mungesë të proporcionalitetit ose ka patur arbitraritet, së dyti nëse masa ka ndikuar në shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve.<sup>275</sup> Gjithashtu, duhet patur parasysh që të gjitha masat e marra nuk duhet të jenë në kundërshtim me shprehjen e lirë të elektoratit, duke respektuar integritetin dhe efektivitetin e procesit të rregullt ligjor.

13. Gjykata theksoi rëndësinë që luajnë autoritetet kombëtare kompetente në garantimin e standardeve të të gjithë procesit zgjedhor. Këto të fundit nuk duhet të marrin masa arbitrare dhe joproporcionale.

<sup>275</sup> Shiko Yumak dhe Sadak, § 109 (iii), dhe Sitaropoulos dhe Giakoumopoulos k. Greqisë



14. Gjatë analizës së saj, Gjykata u ndal tek arsyet kryesore në bazë të të cilave u dha vendimi i Gjykatës së Lartë që janë: procedura e zgjedhjes së kandidatëve për Asamblenë Rajonale të Partisë Yabloko cenonte parimin e përfaqësimit demokratik dhe statuti i partisë nuk është në përputhje me ligjet kombëtare.

15. Në lidhje me arsyen e parë, Gjykata si fillim theksoi se KQZ-ja ka të drejtë të shqyrtojë respektimin e ligjit nga ana e partive, por ajo nuk duhet të tejkalojë tagrat e saj duke marrë vendime arbitrare dhe joproporcionale.<sup>276</sup>Në rastin konkret, KQZ-ja ka ndërhyrë në çështje të brendshme të organizimit të partisë, duke tejkaluar kompetencat dhe limitet që i janë dhënë nga ligji.

16. Duke u bazuar tek Komisioni i Venecias, partitë janë të lejuara të bëjnë ndërhyrje direkte dhe jodirekte për çështje që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm të partisë dhe në caktimin e kandidaturave.<sup>277</sup>Në lidhje me argumentin e dytë të Gjykatës së Lartë, Gjykata theksoi se procedura e përzgjedhjes së kandidatëve i ishte bërë e ditur KQZ-së dhe Ministrisë së Drejtësisë që në vitin 2004 dhe nuk ishte kontestuar asnjëherë prej tyre. Kërkesa për anulimin e listave nuk ishte bërë në kushtet e paraqitjes së fakteve ose rrethanave të reja. Për këtë arsye vendimi i dhënë nga gjykata ndikon në autonominë e partive politike dhe parashikueshmërinë e interpretimit të ligjit.

17. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.

### III. Koment

18. Ky vendim është tepër interesant për situatën aktuale shqiptare dhe mbi debatin për hartimin dhe përbërjen e listave elektorale nga partitë e ndryshme politike. Në këtë rast, u analizua vendimi i Gjykatës Supreme të Karelisë për të anuluar regjistrimin e kandidatëve të Yabloko në zgjedhjet e tetorit të vitit 2006, për Kuvendin Legjislativ të Karelisë.

19. Kërkuesit u ankuan se ishin larguar në mënyrë arbitre nga pjesëmarrja në zgjedhje. Kërkuesi i parë, Zyra Rajonale e Partisë Yabloko, pretendonte se nuk ishte lejuar të regjistroheshin kandidatët e saj për zgjedhje. Kërkuesit e dytë dhe të tretë, Znj. Petelyayeva dhe Z. Klimçuk, pretendonin se u ishte lejuar të kandidonin në zgjedhje. Kërkuesja e katërt, Znj. Fillipenkova, pretendonte se nuk kishte qenë në gjendje të votonte për kandidatët e saj të preferuar të partisë në zgjedhje.

20. Gjykata gjeti në mënyrë të veçantë se, vendimi për të anuluar regjistrimin e kandidatëve të Yabloko nuk ishte i parashikueshëm sipas ligjit kombëtar dhe as propocional. Prandaj, kishte pasur shkelje të së drejtës për zgjedhje të lira si për partinë rajonale Yabloko, ashtu dhe për kërkuesen e tretë, Z. Klimçuk. Ndërsa

<sup>276</sup> Shiko Mathieu-Mohin dhe Clerfay

<sup>277</sup> Shiko dokumentin e Komisionit të Venecias CDL-AD (2004) 007 rev dhe CDL-AD(2006) 025

kërkesa e Znj. Petelyayev u hodh poshtë për arsye procedurale. Ajo çka mund të hapë debat dhe të jetë e diskutueshme është zgjidhja e Gjykatës përsa i përket Znj. Fillipenkova dhe të drejtës së saj për të votuar. Gjykata vlerësoi se Fillipenkova, pavarësisht se nuk mund të votonte për kandidatët e Partisë Yabloko, kishte pasur një zgjedhje të gjerë pasi mund të kishte votuar për kandidatë të një sërë partish të tjera, ose sipas Gjykatës edhe mund të kishte votuar nul.

21. Çështja është gjithsesi nëse vlerësimi që autoritetet kishin ndërhyrë në sferën e brendshme të një partie dhe nuk e kishin lejuar të paraqiste listën që do të ndikonte në fund të fundit në zgjedhjen konkrete të një zgjedhësi, për të votuar pikërisht atë parti. Gjykata nuk e sheh këtë lidhje, por që për mendimin tim (L.B) mund të jetë e arsyeshme për tu pranuar, sidomos në bazë të jurisprudencës “Partia për një Shqipëri Demokratike dhe të Tjerë kundër Turqisë” dhe “RPD kundër Bullgarisë”.

# PROTOKOLLI 4 NENI 2

LIRIA E LËVIZJES

## BAUMANN kundër FRANCËS

(kërkesa nr. 33592/96)

22 maj 2001

*mbajtja e pasaportës së një personi në kuadrin e një procesi gjyqësor mund të përbëjë shkelje të lirisë së tij për të lëvizur lirshëm*

### I. Faktet kryesore

1. Bernd Baumann, shtetas gjerman, ankohej në lidhje me konfiskimin e disa sendeve në posedim të tij, si pasaporta e tij, në kuadrin e një procesi penal në Strasburg, Francë, në të cilin për më tepër ai nuk kishte qenë i akuzuar. Ai ankohej për mungesë të mundësive për t'iu drejtuar një gjykate, për mungesë të mundësisë për t'u ankuar në lidhje me konfiskimin e sendeve në posedim të tij si dhe pretendoi se konfiskimi i pasaportës së tij arrinte deri në një shkelje të së drejtës së tij për lirinë e lëvizjes.

### II. Vendimi i Gjykatës

2. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi në këtë çështje se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 (mundësia për t'iu drejtuar një gjykate) por që nuk ishte e nevojshme që pretendimi i kërkuarit të vlerësohej në kuadrin e nenit 1 të Protokollit 1. Gjykata, në vijim vendosi, me katër vota kundër tre, që ka pasur shkelje të nenit 2 të Protokollit 4, duke filluar nga data kur avokati i kërkuarit kishte paraqitur kërkesën për kthimin e pasaportës së këtij të fundit. Gjykata i akordoi kërkuarit 20 000 franga franceze për dëm jo-material dhe 30 000 franga franceze për shpenzime dhe pagesa të kryera për efekt të paraqitjes dhe mbrojtjes së çështjes së tij.

### III. Koment

3. Vlera më e madhe e këtij vendimi qëndron në ripohimin nga ana e Gjykatës të standardeve që duhen zbatuar në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve të brendshme ankimore përpara se një kërkesë të mund të paraqitet në Strasburg. Kriteri i nenit 13 deri tani ka parashikuar që një mjet i brendshëm duhet të jetë në gjendje t'i japë zgjidhje pretendimeve të ankuesit, por jo që ai ta realizojë këtë domosdoshmërisht në praktikë. Gjykata vuri në dukje se qeveritë nuk mund të pretendojnë mos-shterimin e mjeteve të brendshme duke u bazuar në pretendimin se mund të bëhet një ankim i ri për rishikimin në çdo fazë të vendimit gjyqësor përkatës. Pranimi i këtij argumenti do të çonte në rrezikun e krijimit të një pengese të vazhdueshme për çuarjen e kërkesave përpara Gjykatës së Strasburgut.

4. Deri më sot Gjykata ka ofruar një jurisprudencë të pakët në lidhje me Protokollin 4 i cili garanton të drejtën e lirisë së lëvizjes brenda një vendi të caktuar<sup>278</sup> si dhe të drejtën për t'u larguar nga çdo vend. Në këtë kuadër nuk ka një të drejtë të përgjithshme për lirinë e lëvizjes, pra asnjë të drejtë për të hyrë në një vend, përveç vendit shtetësinë e të cilit e ka ai person. Në vendimin Peltonen kundër Finlandës<sup>279</sup>, Komisioni konstatoi se refuzimi për të lëshuar pasaportë ndaj një personi për shkak se ky nuk kishte kryer shërbimin ushtarak ishte i justifikueshëm në bazë të Konventës. Nga ana tjetër, për shkak të rëndësisë që e drejta e Bashkimit Evropian i kushton lëvizjes së lirë për qytetarët e Bashkimit, Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Evropiane në Luksemburg, ka konstatuar se, në rastet kur është refuzuar lëshimi i një pasaporte, personi i cenuar nga ky refuzim duhet të jetë në gjendje të udhëtojë dhe qëndrojë në territorin e Bashkimit Evropian duke treguar thjesht letërnjoftimin e tij – edhe pse ky letërnjoftim nuk është lëshuar për qëllimet e udhëtimit apo qëndrimit në vende të tjera. Për këtë arsye Z. Baumann kishte të drejtë të udhëtonte në vendet anëtare të Bashkimit Evropian vetëm duke treguar letërnjoftimin e tij, i cili nuk i ishte marrë nga autoritetet franceze. Megjithatë, shumica e Gjykatës në këtë rast, mendoi se, ashtu si edhe në çështjen Peltonen, e drejta për t'u larguar përfshinte të drejtën për të shkuar drejt një vendi që vetë personi e zgjedh dhe në të cilin ai mund të pranohet të hyjë.

## NAPIJALO kundër KROACISË

(kërkesa nr. 66485/01)

13 nëntor 2003

*sekuestrimi i pasaportës së kërkuesit për një periudhë të gjatë kohe shkelte të drejtën e tij për lirinë e lëvizjes*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Dragan Napijalo, është shtetas kroat i datëlindjes 1947 dhe jeton në Karlovac në Kroaci. Më 6 shkurt 1999 ai u gjobit nga autoritetet doganore në një pikë kontrolli sepse nuk kishte deklaruar disa sende kur hynte në Kroaci. Ai pretendonte se një oficer i doganës kishte konfiskuar pasaportën e tij sepse nuk kishte qenë në gjendje të paguante menjëherë gjobën. Kurse sipas qeverisë kroate, kërkuesi kishte refuzuar të paguante gjobën dhe u largua me makinë në mënyrë demonstrative, duke e lënë pasaportën e tij në pikën e kontrollit. Pak kohë më vonë, kërkuesi iu drejtua me shkrim autoriteteve doganore duke iu kërkuar kthimin e pasaportës së tij. Ai mori një përgjigje në të cilën autoritetet deklarorin se pasaporta e tij ishte konfiskuar në përputhje me ligjin.

<sup>278</sup> Shih gjithashtu vendimin e 23 majit 2001 në lidhje me çështjen Denizci dhe të tjerë kundër Qipros të trajtuar në këtë përmbledhje në kuadrin e nenit 2 të Konventës.

<sup>279</sup> Vendim i 20 shkurtit 1995.

2. Në 2 mars 1999 kërkuesi bëri një padi civile në Gjykatën e Rrethit të Zagrebit kundër Ministrisë së Financave, duke kërkuar kthimin e pasaportës së tij si dhe dëmshpërblim për shkak të pasojës që sekuestrimi kishte sjellë – pamundësinë e tij për tu larguar nga Kroacia. Ai kërkoi gjithashtu një masë të ndërmjetme në mënyrë që t'i kthehej menjëherë pasaporta. Gjykata e Zagrebit nuk e pranoi padinë e tij më 10 shtator 2002. Ndaj këtij vendimi kërkuesi u ankua edhe në Gjykatën e Apelit por përsëri nuk pati sukses. Ndërkohë pasaporta iu kthye më 4 prill 2001.

## II. Vendimi i Gjykatës

3. Kërkuesi ankohej në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të kohëzgjatjes së procedurave civile për kthimin e pasaportës së tij. Ai pretendonte gjithashtu se konfiskimi i pasaportës së tij kishte çuar në shkelje të lirisë së tij të lëvizjes të garantuar nga neni 2 i Protokollit 4 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 6 § 1

4. Gjykata vuri në dukje se procesi i hapur nga kërkuesi kishte zgjatur tre vjet, gjashtë muaj e tetë ditë dhe vlerësoi se kjo kohëzgjatje nuk përputhej me kërkesën e “afatit të arsyeshëm” të parashikuar nga ana e nenit 6 § 1 të Konventës. Për këtë arsye ajo vendosi se ka pasur shkelje të këtij neni.

### B. Në lidhje me nenin 2 të Protokollit 4

5. Gjykata vuri re se autoritetet doganore në letrën e tyre i kishin deklaruar kërkuesit se bllokimi i pasaportës së tij ishte bërë në përputhje me ligjin. Në këtë mënyrë ato kishin pranuar se e kishin bllokuar pasaportën kështu që pretendimi i Qeverisë Kroate përpara Gjykatës se një gjë e tillë nuk kishte ndodhur duhej hedhur poshtë.

6. Autoritetet doganore të cilat kishin marrë pasaportën e kërkuesit, nuk ia kishin kthyer atij por e kishin dërguar në Rajonin e Policisë të Slunj, i cili pastaj e kishte përcjellë në Rajonin e Policisë të Zagrebit, ku e kishin mbajtur për dy vjet përpara se ta dërgonin në Rajonin e Policisë të Karlovacit. Arsyet për të cilat pasaporta nuk i ishte kthyer kërkuesit ishin të paqarta përderisa ndaj tij nuk kishte filluar asnjë procedim për ndonjë vepër penale në lidhje me doganat.

7. Përderisa kërkuesit i ishte mohuar përdorimi i dokumentit të tij të identifikimit për udhëtime jashtë shtetit, ai nuk kishte qenë në gjendje të largohej nga Kroacia. Një kufizim i tillë ndaj lirisë së tij të lëvizjes përbënte një ndërhyrje ndaj së drejtës që atij i njihnte neni 2 i Protokollit 4. Gjykata nuk arriti të gjejë asnjë justifikim për refuzimin e autoriteteve doganore që t'i kthenin kërkuesit pasaportën e tij dhe as për refuzimin e Gjykatës së Rrethit të Zagrebit në lidhje me kërkesën e tij për një vendim të ndërmjetëm. Kjo aq më tepër kur dy vendime të kësaj të fundit kishin zgjatur periudhën e mbajtjes nën sekuestro të pasaportës së kërkuesit, pra edhe të vetë ndërhyrjes ndaj së drejtës së tij për lirinë e lëvizjes. Kjo ndërhyrje nuk kishte qenë në proporcion me qëllimet e ndjekura pra nuk kishte qenë një masë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Për këtë arsye Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 2 të Protokollit 4.



**C. Në lidhje me nenin 41**

8. Gjykata i akordoi kërkuarit 2 000 € shpërblim për dëm jomaterial.

**III. Koment**

9. Protokollit 4 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që përmban të drejtën për lirinë e lëvizjes është ratifikuar nga 37 prej 45 vendeve anëtare të Këshillit të Evropës. Megjithatë ka një jurisprudencë të kufizuar në lidhje me këtë dispozitë. Vendimet e dhëna deri tani kanë pasur të bëjnë më tepër me marrëdhënien ndërmjet të drejtës për lirinë e lëvizjes dhe të drejtës për liri dhe siguri të parashikuar në nenin 5 të Konventës. Për të vlerësuar nëse një situatë bie nën veprimin e njërës apo të tjetrës dispozitë, Gjykata mban parasysh një tërësi kriteresh: tipin, kohëzgjatjen, pasojat dhe mënyrat e zbatimit të masave që kufizojnë lirinë e individit. Në çështjen *Guzzardi kundër Italisë* kërkuari ishte izoluar në një ishull. Edhe përse zona në të cilën ai ishte izoluar ishte shumë më e madhe se një qeli burgu, ajo konsistonte gjithsesi në një pjesë të vogël të ishullit. Atij i duhej të qëndronte në banesën e tij gjatë gjithë natës dhe duhet të raportonte dy herë në ditë përpara autoriteteve. Në vendimin e saj të 6 nëntorit 1980 në lidhje me këtë çështje Gjykata vendosi se Guzzardi ishte privuar nga liria e tij dhe nuk i ishte kufizuar liria për të lëvizur duke argumentuar zbatueshmëri të nenit 5 të Konventës. Kurse në çështjen që po komentojmë ishte e qartë që situata në të cilën gjendej Z. Napijalo's përfshihej në zbatimin e nenit 2 të Protokollit 4.

10. E drejta për lirinë e lëvizjes është një e drejtë e cilësuar, pra jo absolute. Kjo do të thotë se pasi Gjykata konstaton se ka pasur ndërhyrje ndaj të drejtave të një personi në bazë të Nenit 2 të Protokollit 4, ajo vazhdon me shqyrtimin e faktit nëse ndërhyrja ishte e justifikuar apo jo. Në çështjen në fjalë Gjykata nuk gjeti ndonjë justifikim për refuzimin e autoriteteve për kthimin e pasaportës së kërkuarit për një periudhë të gjatë kohe dhe arriti në përfundimin se kjo masë nuk ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike dhe as në proporcion me qëllimet legjitime që ajo ndiqte.

11. Gjykata vendosi se kishte gjithashtu shkelje të nenit 6 për shkak se procesi që kërkuari kishte filluar kishte zgjatur së tepërmi. Një numër i madh ankesash përpara Gjykatës kundër Kroacisë kanë të bëjnë me këtë çështje. Kur vendos nëse kohëzgjatja e një procesi pajtohet me kërkesat e nenit 6 Gjykata do të mbajë parasysh disa elementë përfshirë këtu qëndrimin e kërkuarit, qëndrimin e autoriteteve, karakterin kompleks të çështjes dhe rëndësinë e saj për kërkuarin.

## HIRSI JAMAA DHE TË TJERË kundër ITALISË

(kërkesa nr. 27765/09)

23 shkurt 2012

Dhomë e Madhe

*kthimi i emigrantëve në Libi pa shqyrtuar çështjen e tyre, i ekspozonte ata ndaj rrezikut të keqtrajtimit dhe përbënte dëbim kolektiv*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit ishin 11 somalez dhe 13 shtetas nga Eritrea.

2. Ata ishin pjesë e një grupi me rreth 200 persona, të cilët ishin larguar nga Libia në vitin 2009 për në Itali, me tre anije. Më 6 maj 2009, kur anijet ishin 35 milje në jug të Lampedusa (Agrigento), brenda juridiksionit të kontrollit detar dhe të shpëtimit të Maltës, ata ishin kapur nga autoritetet doganore italiane dhe rojet bregdetare. Pasagjerët u transferuan në anijet ushtarake italiane dhe u dërguan në Tripoli. Kërkuesit deklaruan se gjatë udhëtimit autoritetet italiane nuk i kishin bërë me dije se për ku ishin nisur dhe as nuk kishin kontrolluar identitetet e tyre. Pas një udhëtimi 10 orësh arritën në Tripoli, ku u dorëzuan tek autoritetet libiane.

3. Në një konferencë shtypi, në 7 maj 2009, Ministri italian i Punëve të Brendshme deklaroi se lokalizimi i anijeve në det të hapur dhe kthimi i emigrantëve në Libi ka qenë në përputhje me marrëveshjet bilaterale me Libinë që kishin hyrë në fuqi më 4 shkurt 2009, duke shënuar një pikë të rëndësishme kthese në luftën kundër emigracionit të paligjshëm. Kjo politikë dekurajonte bandat kriminale, të përfshira në kontrabandimin dhe trafikimin e njerëzve, ndihmonte në shpëtimin e jetëve në det dhe reduktonte ndjeshëm ardhjen e emigrantëve klandestinë në bregdetin italian. Gjatë vitit 2009 Italia kreu nëntë operacione në det të hapur për të kapur emigrantë klandestinë, në përputhje me marrëveshjet dypalëshe të lidhura me Libinë. Më 26 shkurt 2011 Ministri i Mbrojtjes italian deklaroi se marrëveshjet dypalëshe me Libinë u pezulluan pas ngjarjeve në Libi.

4. Sipas informacione të dorëzuara në Gjykatë nga përfaqësuesit e kërkuesve, në kohën e gjykimit, dy prej kërkuesve kishin vdekur në rrethana të panjohura. Ndërmjet qershorit dhe tetorit 2009, katërmbëdhjetë prej kërkuesve u ishte dhënë statusi i refugjatit nga zyra e Komisionerit të Lartë të OKB për Refugjatët (ZKLBK) në Tripoli. Pas revolucionit në Libi, në shkurt të vitit 2011, kontakti ndërmjet kërkuesve dhe përfaqësuesve të tyre u vështirësua. Në atë kohë, avokatët ishin në kontakt me gjashtë nga kërkuesit, katër prej të cilëve jetonin në Benin, Maltë dhe

Zvicër dhe disa prej të cilëve ishin ende në pritje të përgjigjes së kërkesës së tyre për mbrojtje ndërkombëtare. Njëri prej kërkuesve ishte në një kamp refugjatësh në Tunizi dhe planifikonte të kthehej në Itali. Në qershor të vitit 2011 njëri nga kërkuesit mori statusin e refugjatit në Itali, pasi ishte kthyer atje në mënyrë klandestine.

## II. Vendimi i Gjykatës

5. Duke u bazuar në nenin 3, kërkuesit pretenduan se vendimi i autoriteteve italiane për t'i kthyer në Libi i kishte ekspozuar ndaj rrezikut të keqtrajtimit atje, si dhe rrezikut të keqtrajtimit në vendet e origjinës (Somali dhe Eritrea), nëse vendosej kthimi i tyre në këto vende. Gjithashtu, ata pretenduan se ndaj tyre ishte zbatuar dëbimi kolektiv, i ndaluar nga neni 4 i Protokollit nr. 4. Së fundmi, bazuar në nenin 13, ata u ankuan se nuk kishin pasur asnjë mjet ligjor efektiv në dispozicion në Itali, kundër shkeljeve të pretenduara të nenit 3 dhe nenit 4 të Protokollit 4.

### A. Në lidhje me nenin 1

6. Gjykata përsëriti parimin e të drejtës ndërkombëtare, sanksionuar në Kodin Detar italian, se një anije që lundron në det të hapur ishte subjekt i juridiksionit ekskluziv të shtetit, flamurin e të cilit ajo mbante. Gjykata nuk mund ta pranonte përshkrimin që i bëri qeveria italiane operacionit si një "operacion shpëtimi në det të hapur" apo pretendimin se kishte ushtruar kontroll gjoja minimal mbi kërkuesit. Ngjarjet kishin ndodhur tërësisht në bordin e anijeve të forcave të armatosura italiane, ekipet e së cilës përbëheshin vetëm nga personeli ushtarak italian. Në periudhën midis hipjes në anijet italiane dhe dorëzimit tek autoritetet libiane, kërkuesin kishin qenë, në mënyrë të vazhdueshme dhe ekskluzivisht, nën kontrollin e autoriteteve italiane, *de jure* dhe *de facto*. Rrjedhimisht, në përputhje me rrethanat në fjalë, ngjarjet që kishin çuar në shkeljet e pretenduara, binin brenda juridiksionit të Italisë në kuptimin e nenit 1.

### B. Në lidhje me nenin 3

#### i. Rreziku i keqtrajtimit në Libi

7. Gjykata ishte në dijeni të presionit me të cilin Shtetet po përballeshin si pasojë e rritjes së fluksit të emigrantëve, i cili ishte një fenomen veçanërisht kompleks kur ardhjet e emigrantëve ishin nga deti, por megjithatë kjo nuk i përjashtonte Shtetet nga detyrimi i tyre për të mos kthyer personat të cilët rrezikojnë t'i nënshtrohen trajtimit të ndaluar sipas nenit 3 në vendin pritës. Duke vënë në dukje se situata në Libi ishte përkeqësuar pas prillit të 2010, Gjykata vendosi të kufizojë shqyrtimin e çështjes në gjendjen që mbizotëronte në Libi në atë kohë. Ajo vuri në dukje se konkluzionet shqetësuese të organizatave të shumta, në lidhje me trajtimin e emigrantëve klandestine, ishin konfirmuar nga një raport i Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) i vitit 2010. Emigrantët e parregullt dhe azilkërkuesit, ndërmjet të cilëve nuk bëhej asnjë dallim, arrestoheshin në mënyrë sistematike dhe mbaheshin të ndaluar në kushte të përshkruara si jonjerëzore nga vëzhguesit, të cilët kishin raportuar, ndër të tjera, raste të torturës. Emigrantët klandestinë rrezikonin në mënyrë të vazhdueshme të ktheheshin në vendet e tyre të origjinës dhe, nëse arrinin të rifitonin

lirinë e tyre, jetonin në kushte veçanërisht të pasigurta dhe të ekspozuar ndaj akteve raciste. Italia nuk mund t'i shmangej përgjegjësisë së saj sipas Konventës, duke iu referuar detyrimeve të saj të mëvonshme që rridhnin nga marrëveshjet dypalëshe me Libinë. Më tej, Gjykata vuri në dukje, se zyra e ZKLKBR-së në Tripoli nuk njihej nga qeveria libiane. Kjo situatë, në atë kohë, ishte e njohur dhe lehtësisht e verifikueshme. Prandaj, Gjykata konkludoi se kur kërkuesit ishin transferuar, autoritetet italiane kishin dijeni ose duhej të kishin dijeni se kërkuesin rrezikonin të trajtoheshin në shkelje të Konventës.

8. Për më tepër, fakti se kërkuesit nuk kishin kërkuar azil shprehimisht, nuk e përjashtonte Italinë nga përgjegjësia e saj. Gjykata përsëriti detyrimet e Shteteve, që rridhnin nga e drejta ndërkombëtare, duke përfshirë edhe "parimin e *moskthimit*" sanksionuar edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

9. Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet italiane, pavarësisht se kishin dijeni të plotë të fakteve, duke transferuar kërkuesit në Libi, i kishin ekspozuar ata ndaj trajtimit, në shkelje të Konventës. Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 3.

*ii. Rreziku i keqtrajtimit në vendin e origjinës të kërkuesve*

10. Largimi i indirekt i një të huaji nuk bënte përgjegjës Shtetin që e largonte mjafton që ky Shtet të sigurohej se vendi ndërmjetës ofronte garanci të mjaftueshme kundër kthimit arbitrar, veçanërisht kur ky Shtet nuk ishte palë në Konventë. Në rastin në fjalë, Gjykata duhet të përcaktonte nëse këto garanci ishin dhënë.

11. Të gjitha informacionet që posedonte Gjykata, tregonin, *prima facie*, se gjendja e pasigurisë ishte e përhapur në Somali dhe në Eritrea; individët i nënshtroheshin akteve të dhunës dhe mbaheshin të ndaluar në kushte çnjerëzore, thjesht sepse ishin larguar nga vendi në mënyrë të pa ligjshme. Për këtë arsye, kërkuesit pretenduan se riadhesimi i tyre do të shkelte nenin 3 të Konventës. Gjykata vërejtë se Libia nuk e kishte ratifikuar Konventën e Gjenevës dhe vuri në dukje mungesën e çdo forme të procedurës së azilit dhe mbrojtjes së refugjatëve në vend. Kështu, Gjykata nuk mund të pranonte argumentin e Qeverisë se aktivitetet e ZKLKBR-së në Tripoli përfaqësonin një garanci kundër riadhesimit arbitrar të kërkuesve. Për më tepër, Human Rights Watch dhe ZKLKBR-ja kishin denoncuar disa raste të kthimit të detyruar të azilkërkuesve dhe refugjatëve në vende me rrezik të lartë. Fakti që disa nga kërkuesit kishin marrë statusin e refugjatit në Libi, jo vetëm që nuk garantonte sigurinë e tyre por, përkundrazi, rriste vulnerabilitetin e tyre.

12. Gjykata arriti në përfundimin se, kur kishin bërë transferimin e kërkuesve në Libi, autoritetet italiane kishin pasur dijeni ose duhet të kishin dijeni se nuk kishte garanci të mjaftueshme që i mbronin ata nga rreziku i dëbimit në mënyrë arbitrare në vendet e tyre të origjinës. Kështu, transferimi shkelte nenin 3.

**C. Në lidhje me nenin 4 të Protokollit 4**

13. Gjykata vuri re se, deri në momentin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, ajo kishte

konstatuar vetëm një herë shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4, dhe konkretisht në rastin Čonka k. Belgjikës<sup>280</sup>. Në rastin konkret transferimi i kërkuesve në Libi ishte kryer pa shqyrtuar secilin rast individualisht. Autoritetet italiane, nuk kishin kryer asnjë procedurë për identifikimin e kërkuesve, por thjesht i kishin marrë kërkuesit në bordin e anijes së tyre për t'i zbarkuar në Libi. Gjykata arriti në përfundimin se dëbimi i kërkuesve ka qenë i një natyre kolektive, në shkelje të nenit 4 të Protokollit 4.

***D. Në lidhje me nenin 13 i marrë në lidhje me nenin 3 dhe nenin 4 të Protokollit 4***

14. Qeveria italiane pranoi se nuk kishte qenë e mundur vlerësimi i rrethanat personale të kërkuesve në bordin e anijeve ushtarake. Kërkuesit pretenduan se, personeli ushtarak i anijes nuk i kishte dhënë asnjë informacion se për ku ishin nisur, duke i bërë të besonin se ishin nisur për në Itali dhe as i kishin informuar në lidhje me procedurën që duhet të ndiqnin për të mos u kthyer në Libi. Ky version i ngjarjeve, edhe pse kundërshtohet nga Qeveria, ishte vërtetuar nga një sërë dëshmish të mbledhura nga ZKLLKBR, KPT-së dhe Human Rights Watch. Kështu, kërkuesit e kishin pasur të pamundur për të paraqitur ankesat e tyre, në bazë të nenit 3 të Konventës dhe të nenit 4 të Protokollit nr. 4, tek një autoritet kompetent, i cili të shqyrtonte plotësisht dhe rigorozisht këto ankesa, para se të dëboheshin. Edhe në qoftë se ekzistonte një mjet ankimor në bazë të ligjit penal që kërkuesit të mund ta përdornin në praktikë kundër personelit ushtarak në bordin e anijeve, ky nuk përmbushte kriterin e efektit pezullues. Gjykata përsëriti detyrimin e Shteteve, sipas nenit 13, për vënien në dispozicion të një mjeti ankimor me efekt pezullues të një mase të marrë, kur kjo masë ishte në kundërshtim me Konventën dhe kishte efekte potencialisht të pariparueshme. Gjykata arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 13, i marrë në lidhje me nenin 3 dhe nenit 4 të Protokollit 4.

***E. Në lidhje me nenin 41***

15. Gjykata vendosi që Italia t'i paguante secilit kërkues 15 000 euro në lidhje me dëmin jo material dhe 1 575.74 euro të gjithë kërkuesve së bashku, në lidhje me kostot dhe shpenzimet.

**III. Koment**

16. Gjykata kishte vendosur tashmë, dy vjet më parë, në çështjen Medvedyev dhe të Tjerë k. Francës<sup>281</sup> se personat e ndaluar në bordin e një anije që lundronte në det të hapur, e lokalizuar nga autoritet franceze gjatë një operacioni policor dhe që më pas ishte vënë nën drejtimin e autoritetet franceze, konsideroheshin në "juridiksionin" e Francës. Një konstatim i ngjashëm u bë edhe në këtë rast ku emigrantët, të cilët lundronin në det të hapur, u morën në bordin e një anije italiane dhe u kthyen në Libi. Kishte prova të mjaftueshme për keqtrajtimin e azilkërkuesve në Libi, edhe para revolucionit dhe të një rreziku të vërtetë dëbimi nga Libia në vendet e tyre të origjinës. Kjo çoi Gjykatën të vendoste se kishte shkelje të nenit 3.

<sup>280</sup> Čonka k. Belgjikës, vendim i 5 shkurtit 2002, nr. 51564/99.

<sup>281</sup> Medvedyev dhe të Tjerë k. Francës, [Dhoma e Madhe] vendim i 29 marsit 2010, nr. 3394/03.

17. Kjo ishte hera e parë që neni 4 i Protokollit nr. 4, u aplikua për "kthime pas" të kryera jashtë territorit të një Shteti. Pasi Gjykata përcaktoi se kërkuesit ishin brenda juridiksionit të Italisë, ishte e lehtë arritja e përfundimit se neni 4 i Protokollit nr. 4 gjente zbatim. Shkelja e kësaj dispozite varet nga natyra kolektive e dëbimit ose refuzimit dhe mungesa e vlerësimit në mënyrë individuale të gjendjes së tyre, e jo (si në rastin e nenit 3) të rreziqeve ndaj të cilave ekspozohen kërkuesit. Kishte qenë jashtëzakonisht e vështirë për avokatët për të kontaktuar klientët e tyre dhe Gjykata ishte e shqetësuar pasi ata nuk mund të pretendonin se vepronin sipas udhëzimeve të klientëve.

18. Ky vendim ka rëndësi të veçantë për ata Shtete të cilat ndodhen në kufijtë jugore dhe juglindorë të Bashkimit Evropian. Në rastet kur rreziqet në rast kthimi janë gjerësisht njohura, kthimi në atë Shtet është i ndaluar. Kthimi i një personi tek një shtet ndërmjetës, i cili më pas mund ta kthejë personin në fjalë në vendin i tij të origjinës, përbën shkelje të nenit 3. Tashmë, Konventa zbatohet në mënyrë të qartë edhe në operacionet shtetërore të kontrollit të emigracionit kudo që ndodhin, madje edhe në det të hapur.

19. Mendimi paralel i Gjyqtarit Pinto de Albuquerque tërhoqi një interes të konsiderueshëm pasi në të pohohej se "*nëse një person është në rrezik për t'iu nënshtruar torturës në vendin e tij dhe kërkon azil në ambasadën e një shteti palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ai duhet të pajiset me vizë për të hyrë në territorin e atij shteti, në mënyrë që të mundësohet fillimi i procedurës së azilit*"

## KHLAIFIA DHE TË TJERË kundër ITALISË

(kërkesë nr. 16483/12)

15 dhjetor 2016

Dhomë e Madhe

*dëbimi dhe riatdhesimi në Tunizi i emigrantëve të parregullt, të cilët kishin arritur në brigjet italiane në shtator të vitit 2011*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesit, Saber Ben Mohamed Ben Ali Khlaifia, Fakhreddine Ben Brahim Ben Mustapha Tabal dhe Mohamed Ben Habib Ben Jaber Sfar, janë shtetas tunizianë, të lindur respektivisht në vitin 1983, 1987 dhe 1988. Të gjithë jetojnë në Tunizi.

2. Më 16 dhe 17 shtator 2011 ata u larguan nga Tunizia me anijet e improvizuara, drejt bregdetit italian. Anijet e tyre u ndaluan nga autoritetet italiane, dhe u shoqëruan për në ishullin Lampedusa. Më pas u transferuan në Qendrën e Pritjes dhe të



Ndihmës së Parë ("QPNP") në ishullin Lampedusa, ku autoritetet proceduan me identifikimin e tyre. Kërkuesit pohuan se Qendra ishte e mbipopulluar, me higjenë të papranueshme, hapësirë joadekuate për të fjetur dhe se nuk kishin kontakt me personat jashtë për shkak të mbikëqyrjes së vazhdueshme policore.

3. Pas një revolte të personave të ndaluar në këtë qendër, më 20 shtator, QPNP-ja pësoi dëmtime nga zjarri dhe u shkatërrua pjesërisht. Kërkuesit u transferuan në një park sportiv për natën, ku mundën të shmangnin forcat e zbatimit të ligjit që i mbikëqyrnin dhe arritën në fshatin Lampedusa. Më pas u bashkuan në një demonstratë me pothuajse 1 800 emigrantë të tjerë. Pasi u ndaluan nga policia, kërkuesit fillimisht u shoqëruan në qendren e pritjes e më pas në aeroportin e Lampedusës, nga ku u dërguan për në Palermo më 22 shtator 2011. Në Palermo kërkuesit qëndruan për disa ditë në dy anije të ankoruara në portin e qytetit. Kërkuesi i parë qëndroi në bordin e anijes *Vincent*, së bashku me rreth 190 persona të tjerë, ndërsa kërkuesi i dytë dhe i tretë qëndruan në bordin e anijes *Audace*, me rreth 150 të tjerë. Më 27 dhe 29 shtator 2011 kërkuesit u dëbuan për në Tunizi. Para se të largoheshin ata u intervistuan nga konsulli tunizian, i cili sipas kërkuesve thjesht regjistroi të dhënat e tyre të gjendjes civile.

4. Gjithashtu, kërkuesit pohuan se gjatë qëndrimit të tyre në Itali, ata nuk ishin pajisur në asnjë moment me ndonjë dokument. Në përgjigje të pretendimeve të kërkuesve, Qeveria paraqiti tre urdhra për refuzimin e hyrjes të datës 27 dhe 29 shtator 2011, që ishin lëshuar në lidhje me kërkuesit. Këto urdhra, të cilat ishin pothuajse identikë, shoqëroheshin secili me nga një shënim njoftimi me të njëjtin shkrim dore, ku thuhej "personi refuzoi të nënshkruante ose të merrte një kopje". Me arritjen e tyre në aeroportin e Tunizisë, kërkuesit u liruan.

5. Më 1 shtator 2015, një Dhomë e Gjykatës konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 5 paragrafi 1, 2 dhe 4 të Konventës dhe shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me kushtet e ndalimit në QPNP, por nuk konstatoi shkelje të nenit 3 në lidhje me kushtet e ndalimit në bordin e anijeve. Gjithashtu ajo vërejtë se kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit 4, të nenit 13 të marrë në lidhje me nenin 3 të Konventës dhe nenit 4 të Protokollit 4. Me kërkesë të Qeverisë, çështja iu referua Dhomës së Madhe sipas nenit 43.

6. Kërkuesit pretendonin se mbyllja e tyre, fillimisht në një qendër pritjeje për emigrantët e paligjshëm dhe më pas në dy anije cenonte nenet 3 dhe 5 të Konventës. Gjithashtu, ata argumentuan se kishin qenë subjekt i dëbimit kolektiv dhe se kuadri ligjor italian nuk parashikonte asnjë mjet efektiv për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave të tyre themelore.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 5

7. Në kundërshtim me argumentin e qeverisë, Gjykata u shpreh se marrëveshja dypalëshe e prillit 2011 midis Italisë dhe Tunizisë, nuk mund të konsiderohej se përbënte një bazë ligjore për ndalimin e kërkuesve në QPNP, duke pasur parasysh

se marrëveshja nuk ishte bërë publike e për rrjedhojë ishte e paaksesueshme për kërkuesit, të cilët nuk mund të kishin parashikuar pasojat e zbatimit të saj. Përveç kësaj, kërkuesit nuk kishin gëzuar as garancitë themelore të *habeas corpus* siç është kërkesa që çdo kufizim i lirisë personale duhet të bazohet në një vendim të arsyetuar të një autoriteti gjyqësor dhe se çdo masë e përkohshme e ndërmarrë nga një autoritet policor, duhet më pas të aprovohet nga një vendim i autoritetit gjyqësor. Në rastin në fjalë, nuk kishte asnjë autoritet gjyqësor apo administrativ që të aprovonte me një vendim ndalimin e kërkuesve.

8. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata konstatoi se heqja e lirisë së kërkuesve nuk mund të konsiderohej "e ligjshme" në kuptim të nenit 5 § 1, pasi nuk respektonte parimin e përgjithshëm të sigurisë juridike dhe nuk ishte në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individit kundër arbitraritetit. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

#### ***B. Në lidhje me nenin 5 § 2***

9. Gjykata vuri në dukje, duke u nisur nga konstatimi i saj sipas nenit 5 § 1, se ndalimi i kërkuesve nuk kishte bazë ligjore të qartë dhe të aksesueshme në të drejtën italiane, autoritetet nuk mund t'i kishin njoftuar kërkuesit për arsyet ligjore të ndalimit të tyre apo t'i informonin lidhur me mundësinë për të kundërshtuar arsyet e ndalimit përpara një gjykate. Rrjedhimisht, konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 5 § 2.

#### ***C. Në lidhje me nenin 5 § 4***

10. Duke pasur parasysh konstatimin e saj sipas nenit 5 § 2 se, arsyet ligjore për ndalimin e kërkuesve në QPNP dhe në anije nuk u ishin njoftuar atyre, Gjykata arriti në përfundimin se e drejta e kërkuesve për të kundërshtuar ndalimin e tyre ishte zhveshur nga efektiviteti i saj. Kështu, kishte pasur shkelje të nenit 5 § 4.

#### ***D. Në lidhje me nenin 3***

11. Për sa i përket kushteve të ndalimit të kërkuesve në QPNP të Lampedusas, Gjykata konstatoi se liria e lëvizjes që ata gëzonin në atë qendër, duhet ta kishte lehtësuar pjesërisht apo në një masë të konsiderueshme kufizimin e shkaktuar nga fakti se kapaciteti maksimal i qendrës ishte tejkaluar. Ajo pranoi se kjo qendër nuk ishte e përshtatshme për qëndrime disa ditore dhe autoritetet italiane kishin detyrimin për t'i transferuar të ndaluarit në vende të përshtatshme. Megjithatë, duke marrë parasysh se QPNP-ja ishte djegur vetëm dy apo tre ditë pas mbërritjes së kërkuesve, nuk mund të supozohej se autoritetet italiane kishin qenë joaktive ose neglizhente apo që emigrantët duhej të ishin transferuar në më pak se dy deri në tre ditë. Për më tepër, Gjykata vuri në dukje se kërkuesit nuk pretendonin të ishin keqtrajtuar qëllimisht nga autoritetet gjatë qëndrimit në QPNP, apo se ushqimi dhe uji ishte i pamjaftueshëm, apo klima në atë kohë kishte ndikuar negativisht kur atyre u ishte dashur të flinin jashtë. Për më tepër kërkuesit nuk përfshiheshin në asnjë nga kategoritë e personave vulnerabël. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata konstatoi se trajtimi për të cilin kërkuesit ankoreshin nuk e kalonte nivelin e ashpërsisë që kërkohet nga neni 3 i Konventës.

12. Sa i përket kushteve të qëndrimit në të dyja anijet, Gjykata hodhi poshtë pretendimet e kërkuesve për keqtrajtim pasi ato ishin të pa mbështetura në raporte që vërtetonin ekzistencën e shenjave apo pasojave të tjera të keqtrajtimit të pretenduar, apo në dëshmi të personave të tjerë që të vërtetonin faktet e pretenduara prej tyre. Përkundrazi, qeveria i paraqiti Gjykatës një vendim gjyqësor të datës 1 qershor 2012, që kundërshtonte pretendimet e kërkuesve në lidhje me gjykatësin e hetimeve paraprake të Palermos. Lidhur me këtë, kërkuesit nuk kishin ofruar dëshmi që të bindnin Gjykatën për të vënë në pikëpyetje paanësinë e gjyqtarit të lart përmendur. Rrjedhimisht Gjykata vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 3.

#### ***E. Në lidhje me nenin 4 të Protokollit 4***

13. Gjykata theksoi se neni 4 i Protokollit 4 nuk garantonte të drejtën për një intervistë individuale në të gjitha rrethanat. Kërkesat e kësaj dispozite mund të plotësohen kur çdo i huaj ka një mundësi objektive dhe efektive për të paraqitur argumente kundër dëbimit të tij ose të saj. Në rastin në fjalë, Gjykata konstatoi se kërkuesit kishin patur mundësinë të njoftonin autoritetet për arsyet se pse duhet të qëndronin në Itali apo pse nuk duhet të ktheheshin në Tunizi, gjatë dy procedurave të identifikimit që u ishin nënshtruar, ose në çdo kohë tjetër gjatë kohës që qëndruan në Itali. Për më tepër, natyra relativisht e thjeshtë dhe e standartizuar e urdhrave të refuzimit të hyrjes, mund të shpjegohet me faktin se kërkuesit nuk kishin dokumente të vlefshme udhëtimi dhe nuk kishin pretenduar se i frikësoheshin keqtrajtimit në rast të kthimit të tyre apo nëse kishte pengesa të tjera ligjore për dëbimin e tyre. Kështu, dëbimi i njëkohshëm i tre kërkuesve nuk përbënte dëbim "kolektiv" por ishte rezultat i një serie urdhërash individual të refuzimit të hyrjes. Rrjedhimisht, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit 4.

#### ***F. Neni 13 i marrë së bashku me nenin 3***

14. Gjykata vërejtë se nuk ishte paraqitur para saj asnjë dëshmi për ekzistencën e mjeteve ligjore në dispozicion të kërkuesve, për tu ankuar në lidhje me kushtet në të cilat ishin mbajtur të ndaluar. Kundërshtimi i urdhrave të refuzimit të hyrjes tek Drejtësia e Paqes së Agrixhendos shërbente vetëm për të kundërshtuar ligjshmërinë e dëbimit të tyre. Për më tepër, këto urdhra u lëshuan vetëm në fund të periudhës së ndalimit. Rrjedhimisht, Gjykata u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 13 i marrë së bashku me nenin 3 të Konventës.

#### ***G. Neni 13 i marrë së bashku me nenin 4 të Protokollit 4***

15. Gjykata vuri në dukje se, në urdhrat për refuzimin e hyrjes citohej shprehimisht mundësia e personave për të apeluar kundër tyre tek Drejtësia e Paqes të Agrixhentos. Në këtë kontekst, gjyqtari mund të shqyrtojë çfarëdo ankese lidhur me mosmarrjen parasysh të situatës personale të emigrantit e për rrjedhojë, për natyrën "kolektive" të dëbimit. Për sa i përket mungesës së efektit pezullues të mjetit ankimor të sipërpërmendur, Gjykata vlerësoi se kjo nuk përbënte në vetvete shkelje të nenit 13 të Konventës, kur, si në rastin konkret, kërkuesit nuk pretendonin se ekzistonte një rrezik real i shkeljes së të drejtave të garantuara me nenet 2 ose 3 në vendin e destinacionit. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të nenit 13 të Konventës, i marrë së bashku me nenin 4 të Protokollit 4.

### H. Në lidhje me nenin 41

16. Gjykata vendosi që secilit prej kërkuesve ti akordohej një shumë prej 2 500 euro për dëmin jomaterial dhe 15 000 euro të treve sëbashku për kostot dhe shpenzimet.

### III. Koment

17. Ky vendim ka të bëjë me kthimin në Tunizi të emigrantëve tunizianë që vijnë masivisht nga deti. Rëndësia e tij është e qartë, pasi vendet përgjatë kufijve të Bashkimit Evropian janë përballur me një fluks masiv të emigrantëve që vijnë nga deti dhe Italia është një ndër këto vende. Prandaj, ndikimi më i rëndësishëm i këtij vendimi ka të bëjë me nenin 4 të Protokollit 4 të Konventës, ndalimin e dëbimit kolektiv të të huajve. Dhoma e Madhe bëri dallimin ndërmjet situatës së kërkuesve në këtë rast me atë të kërkuesve në rastet “Çonka kundër Belgjikës<sup>282</sup>”, “Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë<sup>283</sup>” dhe “Sharifi dhe të tjerët kundër Italisë dhe Greqisë<sup>284</sup>”. Për tri arsye kryesore, Dhoma e Madhe, në ndryshim nga vendimi i mëparshëm i Dhomës, nuk gjeti shkelje të nenit 4 të Protokollit 4.

18. Së pari, kërkuesit ishin identifikuar personalisht dy herë nga autoritetet italiane. Së dyti, urdhrat e largimit, përkundër faktit se të gjithë kishin një format standard, ishin individuale. Dhe së treti, fakti që kërkuesit u dëbuan në të njëjtën kohë me persona të tjerë nuk do të thoshte se vendimet për deportimet e tyre nuk ishin individuale. Në vendimin e saj, Dhoma e Madhe pohoi se neni 4 i Protokollit 4 nuk garantonte të drejtën për një intervistë individuale në të gjitha rrethanat. Kërkesat e këtij nenin konsideroheshin të përmbushura kur çdo i huaj kishte një mundësi reale dhe efektive për t’u ankuar ndaj dëbimit të tij dhe kur ky ankim të shqyrtohej në mënyrë adekuate nga autoritetet e shtetit të paditur.

19. Reagimet ndaj këtij vendimi ishin të menjëhershme. Në përgjithësi, kritikët e kanë konsideruar këtë vendim si një hap prapa krahasuar me jurisprudencën e mëparshme.<sup>285</sup> Në një koment të botuar në revisten franceze të të drejtave të njeriut *La Revue des droits de l’homme*, vendimi u konsiderua si “përmirësim i gënjeshtërt në lidhje me të drejtat e emigrantëve në dyert e Europës”.<sup>286</sup> Në pritje të komenteve dhe kritikave të mëtejshme, mund të thuhet se vendimi ka njëfarë merite pasi kërkon të qartësojë të drejtat procedurale të azilkërkuesve sipas nenit 4 të Protokollit 4, edhe pse i kufizon ato në mënyrë të konsiderueshme.

<sup>282</sup> Çonka k. Belgjikës, vendim i 5 shkurtit 2002, nr. 51564/99.

<sup>283</sup> Hirsi Jamaa dhe të tjerë k. Italisë, vendim [DHM] i 23 shkurtit 2012, nr. 27765/09, i përfshirë gjithashtu në këtë seksion.

<sup>284</sup> Sharifi dhe të tjerë k. Italisë dhe Greqisë, vendim i 21 tetorit 2013, nr. 16643/09, i përfshirë gjithashtu në këtë seksion.

<sup>285</sup> . Shih Vëzhguesit e Strasb të Konventës urgut, Denise Venturi “Vendimi i Dhomës së Madhe në çështjen *Khlaifia* dhe të tjerë k. Italisë: një hap para, një hap mbrrapa?” ose *Marion Tissier* : « Dëbimi kolektiv i emigrantëve: Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së kufizon rreptësisht garancitë procedurale të të huajve » 7 mars 2017, *Journal d'actualité des droits européens*.

<sup>286</sup> . Foegle (Jean-Philippe), “Un renforcement en trompe-l’œil des droits des migrants retenus aux portes de l’Europe”, *La Revue des droits de l’homme, Actualités Droits-Libertés*, 2017, <http://revdh.revues.org/2904>

20 .Vendimi është gjithashtu i rëndësishëm për sa i përket interpretimit të nenit 5 të Konventës. Gjykata konstatoi se, në rastin e kërkesve ishin shkelur disa paragrafë të këtij neni. Veçanërisht ajo vërejtë që, marrëveshja dypalëshe e vitit 2011 ndërmjet Italisë dhe Tunizisë, nuk mund të konsiderohet bazë ligjore për ndalimin e kërkesve, në kuptimin që i jep neni 5 § 1 i Konventës, pasi marrëveshja nuk ishte e aksesueshme për ta. Përveç kësaj, Gjykata konstatoi se ndalimide *facto* i kërkesve pa ndonjë vendim zyrtar i kishte privuar ata nga mbrojtja kushtetuese e *habeas corpus* e për rrjedhojë nuk mund të konsiderohej në përputhje me qëllimin e nenit 5, edhe në kushtet e një situatë alarmante migrimi.

21. Mesazhi i Gjykatës në këtë vendim të sajën, në lidhje me të dyja këto nene, por edhe në lidhje me nenin 3 dhe 13 të Konventës, është vërtet shumë i rëndësishëm, veçanërisht në lidhje me marrëveshjetdypalëshe të lidhura me vendet e jugut dhe lindjes të Mesdheut për sa i përketndalimit ose reduktimit të flukseve migratore. Marrëveshja BE-Turqi është njëra prej tyre dhe do të ishte interesantetë shikonim një çështje që do të paraqitej para Gjykatës në lidhje me atë marrëveshje.<sup>287</sup>

<sup>287</sup> . Shih gjithashtu Urdhërat e Gjykatës së Përgjithshme (të Bashkimit Evropian) në rastet T-192/16, T-193/16 dhe T-257/16 NF, NG dhe NM kundër Këshillit Evropian, në të cilin Gjykata e Përgjithshme e BE-së deklaroi se i mungon juridiksioni për të dëgjuar dhe vendosur në lidhje me pretendimet e ngritura nga tre azilkërkes kundër marrëveshjes BE-Turqi, e cila kërkon të zgjidhë krizën e migracionit.





**NENI 34**

**KËRKESA INDIVIDUALE**

## DYBEKU kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 41153/06)

18 dhjetor 2007

*në këtë çështje Gjykata vendosi se në rastin e një të burgosuri me probleme shëndetësore specifike, masa të përshtatshme duhet të merren nga autoritetet shqiptare që të mos ketë shkelje të nenit 3 të Konventës, dhe masa të tilla duhet të parashikohen për të gjithë të burgosurit në situata të ngjashme*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Ilir Dybeku, është një shtetas shqiptar i lindur në vitin 1971 dhe që në kohën e vendimit të Gjykatës vuante dënimin në burgun e sigurisë së lartë të Peqinit. Prej vitit 1996 e në vazhdim kërkuesi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë paranojake dhe për shumë vite ai ka qenë i shtruar për kurim në disa spitale psikiatrike në Shqipëri.

2. Më 23 gusht 2002 si pasojë e një shpërthimi që ndodhi në apartamentin e motrës së kërkuesit, mbetën të vdekur tre persona, dy nga të cilët fëmijë të moshës 10 dhe 13 vjeç, dhe disa persona të tjerë u plagosën. Më 24 gusht 2002, një ditë pas ngjarjes, ndaj kërkuesit u bë një kallëzim penal dhe po atë ditë ai u arrestua dhe u akuzua për veprën penale të vrasjes dhe posedimit të paligjshëm të lëndëve eksplozive. Ai u ndalua në dhomat e paraburgimit në Komisariatin e Policisë së Durrësit, në një qeli me disa të paraburgosur të tjerë.

3. Në 27 maj 2003 duke u bazuar në ekspertimin mjekësor, i cili konkludonte se në kohën e kryerjes së veprës çrregullimi mendor i Z. Dybeku ishte në periudhë qetësie, Gjykata e Rrethit Durrës vendosi, që kërkuesi ishte i aftë t'i nënshtrohej procesit gjyqësor. Për rrjedhojë kjo gjykatë e shpalli atë fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm. Në shtator 2003 dhe mars 2004, respektivisht, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. As Apeli as Gjykata e Lartë nuk e pranuan kërkesën e kërkuesit për një ekzaminim të ri mjekësor, duke konkluduar se ekspertimi i parë mjekësor ishte kryer nga ekspertë të paanshëm në përputhje me garancitë procedurale.

4. Që nga dhjetori 2003 kërkuesi u transferua në tre burgje të ndryshme për të ekzekutuar dënimin e tij. Gjatë qëndrimit në këto burgje Z. Dybeku ndau qelinë me të burgosur të tjerë, të cilët gëzonin shëndet të plotë dhe u trajtua njësoj si ata. Në bazë të deklaratave të autoriteteve shqiptare, në pamundësi për t'i garantuar kërkuesit trajtimin mjekësor, që i nevojitej, atij i ishin dhënë barna të ngjashme me ato të parashikuara nga mjeku i tij. Z. Dybeku u shtrua në Spitalin e Burgut të Tiranës vetëm në dy raste kur shëndeti i tij ishte përkeqësuar ndjeshëm, nga 26 maji 2004 deri më 2 qershor 2004 dhe nga

1 dhjetori 2004 deri më 26 janar 2005. Ankesat e babait dhe avokatit të Z. Dybeku kundër administratës dhe stafit mjekësor të spitalit të burgut për pakujdesi dhe trajtim mjekësor jo të përshtatshëm, nuk u morën parasysh nga autoritetet.

5. Duke pasur parasysh gjendjen gjithnjë e më të shqetësuar të kërkuesit, më 7 janar 2005, avokati i tij nisi një procedurë në Gjykatën e Rrethit Tiranë për të kërkuar lirin ose transferimin në një institucion mjekësor, me arsyetimin se kushtet e vuajtjes së dënimit ishin të papërshtatshme për gjendjen e tij shëndetësore dhe përbënin rrezik për jetën e tij. Bazuar në raportet e fundit mjekësore, avokati i kërkuesit kërkoi gjithashtu që të kryhen ekzaminime psikiatrike. Kjo kërkesë ashtë si dhe apeli dhe rekursi në Gjykatë të Lartë u refuzuan. Në qershor 2007, Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e kërkuesit, me arsyetimin se pretendimet e tij në lidhje me vlerësimin e provave nuk ishin në juridiksionin e saj.

## II. Vendimi i Gjykatës

6. Kërkuesi pretendonte, në veçanti, se kushtet e tij të paraburgimit dhe trajtimi mjekësor që ai kishte marrë në burg nuk ishin të përshtatshme duke pasur parasysh gjendjen e tij shëndetësore. Ai gjithashtu u ankua për padrejtësinë e procedurave ligjore lidhur me ankesat e tij.

### A) Në lidhje me nenin 3

7. Gjykata vlerësoi se pavarësisht se kërkuesi nuk u bazua shprehimisht në nenin 3 të Konventës pretendimet e tij mbi kushtet e paraburgimit dhe trajtimi mjekësor në burg duheshin shqyrtuar sipas këtij neni.

8. Gjykata kujtoi se neni 3 i Konventës e ndalon absolutisht torturën dhe trajtimin e dënimit çnjerëzor pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës. Duke iu referuar jurisprudencës së saj Gjykata u shpreh se keqtrajtimi i pësuar gjatë mbajtjes në burg duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie për t'u cilësuar se shkel të drejtën e garantuar nga neni 3 i Konventës. Vlerësimi i nivelit të ashpërsisë së keqtrajtimit varet nga rrethanat specifike të një çështjeje dhe vlerësohet rast pas rasti duke marrë në shqyrtim një sërë faktorësh si kohëzgjatja e keqtrajtimit, efektet fizike dhe mendore të tij, si edhe moshja, gjinia dhe gjendja mendore të viktimës.

9. Gjykata vërejti se asnjë nga palët në proces nuk kundërshtoi faktin se kërkuesi vuante nga çrregullime të rënda mendore të një natyre kronike. Vlerësimi i fundit mbi shëndetin e kërkuesit ishte bërë në vitin 2002 dhe prej asaj kohe kërkuesi kishte marrë të njëjtin trajtim, duke mos iu nënshtruar asnjë ekzaminimi për përkeqësimin e gjendjes së tij. Gjykata pranoi se gjendja psikologjike e kërkuesit e bënte atë më vulnerabël se të paraburgosurit e tjerë, duke i shkaktuar atij ndjenja stresi, ankthi dhe pasigurie. Fakti që autoritetet shqiptare pranuan se kërkuesi ishte trajtuar në mënyrë të njëjtë me të burgosurit e tjerë pavarësisht gjendjes së tij të veçantë, tregoi se autoritetet shqiptare kanë dështuar në zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Evropës për trajtimin e të burgosurve me nevoja të veçanta.

10. Sipas Gjykatës autoritetet shqiptare nuk ofruan informacionit të detajuar mbi kushtet e burgimit të kërkuesit, dhe as provuan që gjendja e tij mendore ishte e përshtatshme për të qëndruar në të njëjtin ambient me gjithë të burgosurit e tjerë. Gjithashtu, Gjykata vuri në dukje se vizitat periodike të kërkuesit në spitalin e burgut nuk mund të konsiderohen si zgjidhje efektive përderisa Z. Dybeku ishte duke kryer një dënim të përjetshëm. Gjykata vërejtë se shumë nga mangësitë e vëna re mund të ishin rregulluar edhe në mungesë të mjeteve financiare të konsiderueshme. Sipas Gjykatës, mungesa e një trajtimi të tillë, duke marrë në konsideratë gjendjen shëndetësore të Z. Dybeku nuk mund të justifikohet.

11. Gjykata, duke marrë në konsideratë efektet kumulative të kushteve krejtësisht të papërshtatshme të burgimit të cilave kërkuesi iu ishte nënshtruar, sidomos natyrën, kohëzgjatjen dhe ashpërsinë e keqtrajtitimit, të cilat në mënyrë të qartë kishin pasoja të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e tij, duke iu referuar raportit të Komitetit të Parandalimit të Torturës në Këshillin e Evropës, si dhe jurisprudencës së saj të mëparshme, arriti në përfundimin se trajtimi i kërkuesit kishte qenë çnjerëzor dhe degradues, në shkelje të nenit 3 të Konventës.

### *B) Në lidhje me nenin 6*

12. Në lidhje me kërkesën e z. Dybeku për parregullsinë e proceseve gjyqësore dhe mos pranimit të kërkesës së tij për lirim nga burgu ose mbylljen në një institucion të specializuar, Gjykata, u shpreh se vendimi i marrë nga gjykatat e brendshme, dhe pretendimet e kërkuesit nuk përfshihen në përcaktimin e “një akuze penale” ose “të drejtave dhe detyrimeve civile” në kuptim të nenit 6 të Konventës. GJEDNJ vërejtë se Konventa nuk garanton të drejtën për lirim me kusht, ose vuajtjen e një dënimi në përputhje me regjimin burgimi të veçantë 4, për rrjedhojë kjo pjesë e kërkesës u deklarua haptazi e papabazuar dhe papranueshme me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

### *C) Në lidhje me nenin 41*

13. Gjykata i akordoi kërkuesit 5,000 euro si shpërblim për dëmin jopasuror për shkak të shkeljes së nenit 3.

## **III. Koment**

14. Vlera kryesore e këtij vendimi konsiston kryesisht në lidhje me nenin 3 të Konventës dhe ai referohet vazhdimisht në jurisprudencën e Gjykatës në çështje që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë së personave të sëmure<sup>288</sup>.

15. Në vendim Gjykata gjen rast të ritheksojë karakterin absolut të të drejtave të mbrojtura nga neni 3 i Konventës. Ajo saktësoi që neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet se përmban një detyrim të përgjithshëm për të liruuar për arsye shëndetësore një person që i është hequr liria. Por, vazhdon sqarimi i Gjykatës, ky

<sup>288</sup> Shih edhe L. Bianku "The Impact of the ECHR on Democratic Change in Central and Eastern Europe" Cambridge University Press, 2016, ed. Motoc, Ziemele, fq. 20.

nen përmban një detyrim për Shtetin që të mbrojë mirëqënien fizike të personave të privuar nga liria, për shembull duke i siguruar atyre ndihmën e kërkuar mjekësore dhe mungesa e kujdesit të përshtatshëm mjekësor mund të sjellë një shkelje të nenit 3. Në rastin e personave me sëmundje mendore, vlerësimi i kushteve të heqjes së lirisë mban parasysh vulnerabilitetin dhe paaftësinë e tyre, në disa raste edhe për të paraqitur ankesa apo për të kuptuar se si ata preken nga një trajtim i caktuar. Gjykata nënvizoi se fakti që kërkuesi ishte deklaruar i përgjegjshëm penalisht për kryerjen e veprës penale të vrasjes dhe ishte dënuar me burgim të përjetshëm nuk ndikon në çështjen e zbatimit të detyrimeve të nenit 3. Kjo do të thotë që karakteri absolut i nenit 3 kërkon që natyra e veprës penale ndaj personit të ndikuar nuk mund të ketë asnjë ndikim në justifikimin e trajtimit të tij problematik.

16. Gjykata në analizën e regjimit të privimit të lirisë ndaj një kërkuesi me probleme shëndetësore vlerëson së bashku tre elementë:

- i) gjendjen shëndetësore të të burgosurit;
- ii) përshtatshmërinë e ndihmës mjekësore dhe të kujdesit mjekësor në burg; dhe
- iii) përshtatshmërinë e vazhdimin të masës së privimit të lirisë me gjendjen shëndetësore të një kërkuesi.

Në rastin Dybeku, Gjykata i vlerësoi të tre këta elementë njëri pas tjetrit përgjatë gjithë periudhës kur kërkuesi kishte qenë në kushtet e burgut dhe se si autoritetet shqiptare kishin vepruar në prizmin e këtyre tre kriterëve. Historia e ndalimit të tij në ambientet e paraburgimit në rajonin e policisë në Durrës dhe më pas në burgun e sigurisë së lartë në Peqin nga viti 2002 e më tej, tregonte se gjendja e tij ishte përkeqësuar. Gjykata vërejti gjithashtu se vlerësimi i fundit mbi gjendjen shëndetësore të kërkuesit daton përpara vitit 2002. Të dhënat mjekësore mbi ankuesin tregonin se atij i ishte rekomanduar i njëjti trajtim si të burgosurit e tjerë dhe se nuk ishte bërë asnjë përshkrim i detajuar mbi zhvillimin e sëmundjes së tij. Ndërkohë që, sipas jurisprudencës së Gjykatës, është detyrë e autoriteteve të vendosin mbi bazën e rregullave të njohura të shkencës së mjekësisë në lidhje me metodat terapeutike që duhet të përdoren për të trajtuar gjendjen fizike dhe mendore të personave të paaftë për të vendosur për veten e tyre, në analizë të fundit i takon autoriteteve gjyqësore kombëtare dhe pastaj vetë Gjykatës së Strasburgut për të vlerësuar nëse këto trajtime kanë respektuar të drejtat e të burgosurve sipas nenit 3.

17. Gjykata pranoi se natyra e kushteve psikologjike të kërkuesit e bëri atë më shumë të cenueshëm sesa mesatarja e të dënuarve të tjerë dhe se burgimi i tij mund të ketë acaruar në një nivel të caktuar ndjenjat e tij të ankthit, vuajtjes dhe frikës. Në këtë drejtim, Gjykata pret që të burgosur si kërkuesi me probleme të tilla të shëndetit mendor, për shkak të gjendjes shëndetësore të veçantë, të mos trajtohen nga Shtetet si të burgosurit e tjerë. Një trajtim i përshtatshëm i këtyre të burgosurve kërkohet edhe nga Rregullat Europiane të Burgut. Në shumë vendime, Gjykata ka tërhequr vëmendjen e Shteteve për rëndësinë e këtyre Rregullave, pavarësisht natyrës së tyre jo të detyrueshme për Shtetet Anëtare. Ato përfshijnë dispozita në lidhje me nevojën për të pasur në dispozicion burgjet e specializuara, ose seksionet nën kontrollin mjekësor, për vëzhgimin dhe trajtimin e të burgosurve që vuajnë nga çrregullime

mendore, gjë që në atë kohë nuk ekzistonte në Shqipëri. Për këtë arsye Gjykata konsideroi, në bazë të nenit 46 të Konventës, se Shqipëria duhet të marrë masa të domosdoshme për të siguruar kushte të përshtatshme të paraburgimit dhe trajtim adekuat mjekësor për të burgosurit që kanë nevojë për kujdes të veçantë për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

18. Gjykata theksoi gjithashtu se kur gjykon çështje të tilla, ajo pret që autoritetet shtetërore t'i japin informacion të detajuar rreth kushteve materiale të vuajtjes së dënimit të një personi dhe të tregojnë se, pavarësisht qëndrimit të tij në një burg të sigurisë së lartë, këto kushte ishin të përshtatshme për një person me çrregullime të tilla mendore. Gjithashtu, Gjykata konsideroi se vizitat e rregullta të kërkuesit në spitalin e burgut nuk mund të shihen si një zgjidhje për sa kohë, që kërkuesi ishte duke vuajtur një dënim me burgim të përjetshëm.

19. Vendimi i jep një përgjigje të qartë pretendimit të përsëritur të Qeverisë shqiptare në Strasburg se "nuk kemi para". Megjithëse ajo është e ndjeshme ndaj faktit se ndërtimi i burgjeve të reja sipas standardeve dhe trajtimi i duhur mjekësor mund të jetë i kushtueshëm, Qeveria vëren se shumë prej mangësive të identifikuar mund të ishin ndrequr edhe në mungesën e mjeteve financiare të konsiderueshme. Në çdo rast ajo rithekson se mungesa e burimeve financiare nuk mundet të justifikojë kushte të tilla vuajtje dënimi, të cilat janë aq të varfra sa prekin nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të parashikuar nga neni 3 të Konventës. Në qoftë se ky pretendim do të pranohej *a priori* në Strasburg ashtu siç pretendon vazhdimisht qeveria shqiptare, efekti i Konventës dhe i çdo pretendimi për mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut, sidomos të atyre me karakter civil dhe politik, do të merrte një goditje tepër të rëndë.

20. Duke pasur parasysh efektet kumulative të të gjitha kushteve të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit të kërkuesit dhe pasojat e dëmshme që këto kushte kanë shkaktuar në shëndetin e tij, konstatimet e Komitetit për Parandalimin Torturës të Këshillit të Evropës (KPT) në raportet më të fundit në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare, në veçanti për sa i përket të burgosurve të sëmurë mendërisht, Gjykata vlerësoi se natyra, kohëzgjatja dhe keqtrajtimi ndaj të cilit është nënshtruar kërkuesi, si dhe efektet që ka pasur në tërësi mbi gjendjen e tij shëndetësore, janë të mjaftueshme për t'u kualifikuar keqtrajtimin si çnjerëzor dhe degradues. Prandaj ajo vendosi shkelje të nenit 3 të Konventës.

21. Kërkuesi u ankua edhe një herë tjetër në Strasburg më 2011 dhe pretendimet e tij u shqyrtuan nga Gjykata në mars 2014<sup>289</sup>. Kjo tregon që Gjykata pranon ta mbajë nën vëzhgim të vazhdueshëm ecurinë e të burgosurve të tillë, për shkak të gravitetit të shkeljeve të pretenduara, por edhe për të kontrolluar nëse autoritetet kanë marrë masat që rrjedhin nga vendimi i parë i Gjykatës. Në këtë vendim të dytë, Gjykata pasi konstatoi se kërkuesi ishte transferuar në burgun e specializuar të Krujës, pasi

<sup>289</sup> Shih Ilir Dybeku k. Shqipërisë, nr. 557/12, 11.3.2014.



Avokati i Popullit konfirmonte se ai merrte trajtimin e kërkuar mjekësor, dhe pasi Komiteti i Ministrave kishte arritur në përfundimin se asnjë masë tjetër individuale nuk dukej e nevojshme për rastin e tij<sup>290</sup>, vendosi që nuk kishte më shkelje të nenit 3 në lidhje me kërkuesin.

22. Kërkuesi pretendoi edhe shkelje të nenit 6 me argumentimin se gjykatat e brendshme nuk i kishin dhënë atij mundësinë për t'u ekzaminuar nga një psikolog i pavarur dhe i paanshëm për të përcaktuar natyrën e çrregullimit të tij mendor, duke e vendosur atë në një dizavantazh ndaj prokurorisë dhe duke shkelur parimin e barazisë së armëve. Por Gjykata rikujtoi neni 6 i Konventës nuk gjen zbatim mbi procesin që lidhet me ekzekutimin e një vendimi të dhënë nga një gjykatë kompetente dhe as mbi procesin për lirim me kusht. Po ashtu Konventa nuk garanton në vetvete, një të drejtë për lirim me kusht apo vuajtje të një vendimi për burgim në përputhje me një regjim burgimi të veçantë.

---

<sup>290</sup> Përfundimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në takimin 1092 (14-15.09.2010) dhe në takimin 1164 (5-7.03.2013). Megjithatë zbatimi i këtij vendimi nuk u mbyll përse i përket masave të përgjithshme që Gjykata iu kërkoi autoriteteve të marrin në lidhje me të gjithë të burgosurit e tjerë në situata të ngjashme të atë të kërkuesit Dybeku.



# NENI 35

## KUSHTET E PRANUESHMËRISË

## XHAVARA DHE PESËMBËDHJETË TË TJERË kundër ITALISË DHE SHQIPËRISË

(kërkesa nr . 39473/98)

11 janar 2001

*ndërkohë që procesi penal ndaj komandantit të Sibilës për shkaktimin e tragjedisë së Otrantos është ende në vazhdim e sipër, kërkesa e të shpëtuarve dhe e të afërmeve të viktimave në Strasburg konsiderohet e papranueshme*

### I . Faktet kryesore

1. Kërkuesit, me shtetësi shqiptare, janë të mbijetuar dhe të afërm të personave të mbytur më 28 mars 1997 në Kanalin e Otrantos. Natën e kësaj date Kateri i Radës, një anije shqiptare me anë të së cilës disa shtetas shqiptarë synonin të hynin ilegalisht në Itali, u fundos në Kanalin e Otrantos, rreth 35 milje detare nga brigjet italiane. Nga kjo tragjedi gjetën vdekjen 58 persona. Fundosja erdhi si shkak i përplasjes së anijes shqiptare me anijen italiane Sibila, e cila pasi e kishte diktuar Katerin e Radës i ishte afruar së tepërmi me qëllim që ta pengonte zbarkimin e klandestinëve në brigjet italiane. Sipas versionit të ngjarjeve të ofruar nga kërkuesit, bashi i Sibilës kishte goditur nga anash Katerin e Radës në lartësinë e urës, pa provokuar ndonjë dëm të ndjeshëm. Por pas kësaj goditje kishte pasur një përplasje të dytë e cila e kishte dëmtuar rëndë skafin e anijes shqiptare.

2. Kundër X, komandant i Sibilës, dhe Y, komandant i Katër i Radës u ngritën akuzat penale për vrasje nga pakujdesia dhe për provokim të mbytjes së një anije. Komandanti i Sibilës akuzohej, sidomos, për ndjekje të anijes shqiptare duke iu afruar asaj deri në 10 metra dhe pa mbajtur parasysh gjendjen e saj të vështirë, pamjen e kufizuar dhe as detin e trazuar. Sipas organit të akuzës një sjellje e tillë i kishte ekspozuar personat që udhëtonin me Katerin e Radës ndaj një rreziku joproporcional në raport me qëllimin legjitim që Sibila ndiqte, pra me mbrojtjen e sigurisë kombëtare<sup>291</sup>.

3. Ndërkohë që procedurat gjyqësore ishin në vijim e sipër, në 20 nëntor 2000 kërkuesit i drejtuan një letër të hapur Kryeministrit italian dhe Ministrit të Mbrojtjes. Me anë të saj ata parashtronin situatën e tyre dhe shpreheshin në favor të një zgjidhje me pajtim të çështjes, me anë të një dëmshpërblimi të menjëhershëm për të gjitha

<sup>291</sup> Disa prej kërkuesve pretenduan përpara Gjykatës së Brindisit që akuza të ndryshohej nga vrasje pa paramendim në vrasje me paramendim pasi Komandanti i Sibilës kishte vepruar duke zbatuar urdhrat e eprorëve të tij sipas të cilave çdo person që largohej nga Shqipëria në atë periudhë konsiderohej klandestin. Sipas kërkuesve situata politike në Shqipëri kërkonte që situata e çdo personi që kërkonte të largohej drejt Italisë të shqyrtohej nën këndvështrimin e azilit politik. Disa prej kërkuesve dolën gjithashtu palë civile në procesin penal kundër X dhe Y.

dëmet e pësuar prej tyre, pavarësisht nga rezultati i procedimit penal kundër X dhe Y. Më 23 dhjetor 2000, Parlamenti Italian miratoi ligjin financiar (ligji nr. 388 i vitit 2000). Neni 82 § 3 i këtij ligji autorizon Ministrin e Mbrojtjes që të përdorë një shumë prej 10 miliard liretash për të zgjidhur me pajtim, pavarësisht nga dispozitat ligjore në fuqi, çdo mosmarrëveshje me personat që ishin dëmtuar si pasojë e mbytjes së anijes Kater i Radës.

4. Situata e fillimit të vitit 1997 në Shqipëri për shkak të krizës së firmave piramidale kishte prodhuar një fluks të fuqishëm emigracioni klandestin drejt Italisë. Për të përballuar këtë situatë, shteti italian kishte marrë disa masa urgjente, ndër të cilat një dekret-ligj me nr. 60 të 19 majit 1997 që iu njihte prefektëve kompetencën për të dëbuar me efekt të menjëhershëm çdo të huaj që nuk paraqiste lejen e qëndrimit ose vizën. Kundër këtij vendimi mund të bëhej ankim në gjykata administrative por ky ankim nuk kishte karakter pezullues. U miratua gjithashtu një urdhër i 24 marsit 1997 drejtuar të gjitha autoriteteve të ngarkuara me ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike që të pengonin hyrjen e klandestinëve shqiptarë në Itali. Më 25 mars 1997 u nënshkrua mes ministrave të jashtëm shqiptarë dhe italianë një marrëveshje, në bazë të së cilës anijet ushtarake italiane mund të kapnin në ujërat ndërkombëtare ose në ujërat territoriale shqiptare çdo anije që transportonte shtetas shqiptarë dhe që nuk i ishte nënshtruar kontrollit të rregullt në territorin shqiptar nga ana e autoriteteve kompetente, duke krijuar në këtë mënyrë një 'bllokadë detare'.

5. Në emrin e tyre, por edhe të të afërmeve që kishin gjetur vdekjen gjatë fundosjes, kërkuesit pretendonin shkëlqej të nenit 2 të Konventës, me pretendimin se drejtimi i anijes Sibila kishte shkaktuar vdekjen e të afërmeve dhe kërcënuar jetën e vetë atyre. Ata pretendonin gjithashtu se 'bllokada detare' kundër anijeve shqiptare vinte në rrezik jetën dhe integritetin fizik të klandestinëve shqiptarë, në kundërshtim me nenet 3 dhe 5 § 1 të Konventës. Duke i referuar nenin 2 § 2 të Protokollit 4, kërkuesit pretendonin se nuk kishin të drejtë të largoheshin nga vendi i tyre. Duke i referuar neneve 13 dhe 14 të Konventës dhe nenin 4 të Protokollit 4, kërkuesit ankoreshin se ankimi në gjykata administrative ndaj një urdhri dëbimi të një të huaji nuk kishte efekt pezullues.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 2

6. Sipas kërkuesve, mbytja e Katerit të Radës kishte ardhur si pasojë e zbatimit të masave të parashikuara nga dekret-ligji nr. 60 i 19 majit 1997 dhe nga marrëveshja shqiptaro-italiane, akte të cilat parashikonin pengimin me çdo kusht të hyrjes klandestine të shqiptarëve në Itali, pa mbajtur parasysh pasojat që mund të sillnin aktet e marra për këtë qëllim.

7. Gjykata nga ana e saj konstatoi menjëherë se fundosja e Katerit të Radës ishte shkaktuar nga Sibila. Për pasojë çdo dëm i pësuar nga kjo ngjarje duhej t'i ngarkohej vetëm Italisë për shkak se anija luftarake Sibila ishte juridiksion i saj. Sipas Gjykatës,

fakti që Shqipëria ishte palë e marrëveshjes shqiptaro-italiane, në vetvete, nuk mund të angazhonte përgjegjësinë e saj në kuadrin e Konventës për çdo masë të marrë nga autoritetet italiane në zbatim të marrëveshjes në fjalë.

8. Nga ana tjetër Gjykata vlerësoi se kërkuesit nuk kishin ofruar asnjë provë që të bënte të besohej se fundosja e Katerit të Radës ishte provokuar “me qëllim”. Sidoqoftë ajo kujtoi se fjalia e parë e nenit 2 § 1 i detyron shtetet jo vetëm që të abstenojnë nga provokimi i vdekjes në mënyrë vullnetare dhe të paligjshme por edhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e jetës së personave nën juridiksionin e tyre<sup>292</sup>. Nga ana tjetër kjo dispozitë e kombinuar me dispozitën me karakter të përgjithshëm të nenit 1 të Konventës që parashikon garantimin “...e çdo personi nën juridiksionin e tyre të të drejtave dhe lirive...” të parashikuara në Konventë, kërkon ndërmarrjen e një hetimi zyrtar, efikas, të pavarur dhe publik në çdo rast që persona nën autoritetin shtetëror marrin jetë njerëzish<sup>293</sup>. Nga ana tjetër Gjykata kujtoi se shtetet anëtare, në bazë të parimeve të së drejtës ndërkombëtare kanë për detyrë që, pa cenuar detyrimet përkatese konvencionale, të kontrollojnë hyrjen e shtetasve të huaj në territoret e tyre<sup>294</sup>.

9. Gjykata konstatoi se ndaj X, komandantit të Sibilës, kishte filluar ndjekja penale, dhe se akuzat ndaj tij për vrasje pa paramendim dhe për provokim të fundosjes së një anijeje ishin në gjykim e sipër nga gjykata kompetente. Në sytë e saj asgjë nuk të bënte të mendoje se hetimi i autoriteteve italiane nuk ishte efektiv apo i pavarur. Nga ana tjetër, duke qenë se procesi në Gjykatën e Brindisit zhvillohej me dyer të hapura, kërkuesit kishin mundësi që gjatë procesit të dilnin si palë civile në procesin penal duke pretenduar dëmshpërblim.

10. Ky proces ishte ende në vijim e sipër deri më 21 dhjetor 2000, më shumë se tre vjet dhe tetë muaj pas incidentit. Megjithatë, duke pasur parasysh karakterin kompleks të çështjes, në veçanti nevojën për raporte të shumta ekspertize, Gjykata vlerësoi se kohëzgjatja e përgjithshme e procesit ndaj X, deri në atë datë, nuk ishte aq e madhe sa të pranohej që kërkuesit nuk ishin më të detyruar t'i shteronin të gjitha rrugët e brendshme gjyqësore. Në lidhje me këtë pikë pretendimet e tyre ishin të parakohshme. Në këto kushte ky pretendim i tyre duhej konsideruar i papranueshëm për mos-shërim të mjeteve të brendshme ankimore siç parashikon neni 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

### **B. Në lidhje me nenet 3 dhe 5**

11. Në lidhje me pretendimin se ‘bllokada detare’ kundër anijeve italiane vinte në rrezik jetën dhe integritetin fizik të klandestinëve shqiptarë, në kundërshtim me nenet

<sup>292</sup> Për këtë qëllim Gjykata në vendimin e saj i referohet sidomos vendimit të 28 tetorit 1998 në lidhje me çështjen Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar. Shih sidomos § 115 të këtij vendimi.

<sup>293</sup> Shih sidomos vendimin e Gjykatës të 27 shtatorit 1995 në lidhje me çështjen McCann dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, përfshirë në këtë botim, të 19 shkurtit 1998 në lidhje me çështjen Kaya kundër Turqisë, etj.

<sup>294</sup> Pranuar ndërkaq nga Gjykata në vendimin e saj të 19 shkurtit 1996 në lidhje me çështjen Gül kundër Zvicrës, sidomos paragrafi 38.



3 dhe 5 § 1 të Konventës, Gjykata kujtoi se procesi gjyqësor ishte ende në vazhdim e sipër në Gjykatën e Brindisit. Për atë kohë sa kërkuesit nuk kishin ofruar argumente për të menduar se fundosja ishte e qëllimshme analiza nën këndvështrimin e nenit 3 bëhej me të njëjtën logjikë si ajo e mësipërme në lidhje me nenin 2.

12. Përsa i përket nenit 5 § 1 Gjykata u shpreh se ky nen gjen zbatim në rastet e arrestimit ose të privimit të lirisë, gjë që në rastin e kërkuesve dhe të të afërmeve të tyre nuk kishte ndodhur. Pra edhe në lidhje me këto dy nene kërkesa u konsiderua e papranueshme për mos-shterim të mjeteve të brendshme.

#### C. Në lidhje me nenin 2 § 2 të Protokollit 4

13. Gjykata thekson se masat e marra nga shteti italian nuk synonin që t'i pengonin kërkuesit të largoheshin nga Shqipëria por që t'i pengonin ata të hynin në mënyrë të paligjshme në territorin italian. Për këtë arsye paragrafi i dytë i nenit 2 të Protokollit 4 nuk gjen zbatim në rastin në fjalë. Në këto kushte kërkesa nën këtë këndvështrim duhej hedhur poshtë si e papajtueshme *ratione materiae* me dispozitat e Konventës, në kuptimin e neneve 35 § 3 dhe 35 § 4.

#### D. Në lidhje me nenet 13 dhe 14 të marrë sëbashku me nenin 4 të Protokollit 4

14. Në këtë kuadër Gjykata vlerësoi se ankesa e kërkuesve konsistonte në një pretendim për papajtueshmëri *in abstracto* me Konventën të disa dispozitave të dekret ligjit nr. 60 të 19 majit 1997. Gjykata vë në dukje se ky është një akt me karakter normativ i autoriteteve italiane dhe kërkuesit duhet të tregojnë se ata janë cenuar individualisht nga një akt i tillë normativ. Nga ana tjetër ajo kujton se Konventa nuk autorizon një *actio popularis*. Në kushtet kur kërkuesit nuk pretenduan se ndaj tyre ishte ndërmarrë ndonjë procedurë dëbimi ose se kishin filluar ndonjë ankim pa efekt pezullues pranë ndonjë gjykate administrative, ata nuk mund të pretendonin, në bazë të nenit 34 të Konventës, se ishin viktimat të shkeljes së dispozitave materiale të Konventës të cilave iu referoheshin.

15. Për këtë qëllim ankimi i tyre në këtë këndvështrim është i papajtueshëm *ratione personae* me dispozitat e nenit 35 § 3 të Konventës dhe duhet hedhur poshtë në përputhje me nenin 35 § 4 të Konventës.

16. Në këto kushte Gjykata njëzëri e deklaroi kërkesën të papranueshme.

### III. Koment

17. Ky vendim është zgjedhur për t'u përfshirë në këtë botim jo vetëm për shkak të faktit se ka të bëjë me një ngjarje tronditëse për mbarë opinionin publik shqiptar por edhe për shkak të një fenomeni me të cilin përplasen të gjitha kërkesat për shkelje të Konventës që në momentin e parë të trokitjes në dyert e Gjykatës së Strasburgut – pranueshmërinë. Ky fenomen nga i cili vuajnë përgjithësisht kërkesat e drejtuara nga Shqipëria, madje edhe në faza më të hershme sesa kjo në të cilën arriti çështja që po komentojmë.

18. Duke pasur parasysh disa elemente karakteristike të juridiksioneve gjyqësore ndërkombëtare të tilla si subsidiariteti, kompetenca specifike dhe e kufizuar, duhet që ankimet në këto Gjykata të jenë të formuluar sipas disa kërkesave formale tepër strikte. Juridiksioni i gjykatave ndërkombëtare kuadratohet në fakt nga kombinimi i katër elementëve teknikë juridikë të cilët përcaktojnë edhe veprimin e çdo akti juridik si dhe ndërhyrjen e çdo juridiksioni administrativ dhe gjyqësor. Këto katër elementë janë *ratione personae* (lidhja personale), *ratione materiae* (lidhja materiale), *ratione temporis* (lidhja kohore) dhe *ratione loci* (lidhja territoriale ose juridiksionale).

19. Në mënyrë jashtëzakonisht interesante veprimi i alternuar i këtyre katër elementeve bën që kërkesa e Z. Xhavora dhe të tjerëve kundër Italisë dhe Shqipërisë të konsiderohet e papranueshme. Kështu për shembull kërkesa konsiderohet e papranueshme *ratione loci* në lidhje me Shqipërinë sepse fakti që kjo ishte palë në marrëveshjen me Italinë nuk e bënte a priori përgjegjëse për shkeljen në fjalë<sup>295</sup>. Nga ana tjetër kjo lidhje gjen zbatim në raport me Italinë për faktin se anija Sibila ishte nën juridiksionin e saj, pavarësisht se përplasja ndodhi rreth 35 milje nga bregu, pra përtej ujërave territoriale italiane. Kërkesa u konsiderua e papranueshme *ratione materiae* në lidhje me zbatimin e nenit 2 të Protokollit 4 të Konventës në këtë rast, pasi ankimi i kërkuësve nuk i referohej në mënyrë të saktë qëllimit të dispozitës përkatëse të Konventës<sup>296</sup>. Nga ana tjetër ankesa u konsiderua e papranueshme *ratione personae* në lidhje me pretendimin e papajtueshmërisë a priori të dekret-ligjit italian me Konventën, gjë mund të bëhet vetëm në një rast konkret të zbatimit efektiv të aktit ndaj situatës individuale të kërkuësve<sup>297</sup>. Përsa i përket *ratione temporis*, për t'u theksuar në këtë çështje është fakti që kërkesa ishte e parakohshme përderisa procesi ishte ende në vazhdim e sipër dhe po zhvillohej brenda termave të një kohëzgjatje normale për një proces të tillë kompleks. Ky moment në rastin e gjykatave ndërkombëtare kombinohet me parimin e shterimit të mjeteve të brendshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes përpara konstatimit ndërkombëtar të përgjegjësisë së shtetit<sup>298</sup>. Praktika e kërkesa shqiptare në Strasburg nxjerr në pah edhe dy aspekte të tjera të këtij kriteri. I pari është me karakter thelbësor - ankimin në lidhje me shkelje që kanë ndodhur përpara hyrjes në fuqi të Konventës në Shqipëri<sup>299</sup>. Ndërsa i dyti

<sup>295</sup> Shih paragrafin 7 të përmbledhjes më lart. Shih gjithashtu vendimet e 23 marsit 1995 në lidhje me çështjen Loizidou kundër Turqisë, atë të 4 korrikut 2001 në lidhje me pranueshmërinë në çështjen Ilaşcu dhe të tjerë kundër Moldavisë dhe Federatës Ruse, dhe të 19 dhjetorit 2001 në lidhje me pranueshmërinë në çështjen Banković dhe të tjerë kundër Belgjikës dhe 16 Shteteve të Tjera Anëtare.

<sup>296</sup> Shih paragrafin 15 të përmbledhjes më lart. Shih gjithashtu vendimin e Komisionit Evropian të të Drejtave të Njeriut të 15 korrikut 1980 në lidhje me çështjen Arrondelle kundër Mbretërisë së Bashkuar.

<sup>297</sup> Shih sidomos paragrafët 14 dhe 15 të përmbledhjes. Gjithashtu vendimin e 6 shkurtit 1976 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjen Schmidt dhe Dahlstrom kundër Suedisë, si dhe atë të 26 qershorit 1992 në lidhje me çështjen Drozd dhe Janousek kundër Francës dhe Spanjës.

<sup>298</sup> Ka një jurisprudencë e qëndrueshme e së drejtës ndërkombëtare në këtë drejtim. Ndër të tjera vendimi arbitral i 29 marsit 1933 në lidhje me çështjen Pyjet e Rodopit Qendror, e në vijim vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i 22 korrikut 1952 në lidhje me çështjen Anglo-Iranian Oil Company, i 19 majit 1953 në lidhje me çështjen Ambatielos, i 21 nëntorit 1959 në lidhje me çështjen Interhandel, etj.

<sup>299</sup> Në lidhje me këtë moment shih vendimin e Gjykatës të 22 majit 1998 Vassilescu kundër Rumanisë.

me karakter formal - shkelja e afatit gjashtë mujor për dërgimin e kërkesës duke filluar nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm efektiv. Këtë aspekt të fundit duket se e sqaron në një masë të konsiderueshme vendimi i Gjykatës i 28 shtatorit 2004 në lidhje me pranimin e kërkesës në çështjen Balliu kundër Shqipërisë<sup>300</sup>.

20. Sidoqoftë këto katër elementë do të ngelen një sfidë e vazhdueshme për të gjithë personat apo profesionistët që do të duan t'i drejtohen Gjykatës së Strasburgut.

## NAUMOV kundër SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 10513/03)

4 janar 2005

*kërkesa e ish ambasadorit bullgar në Shqipëri konsiderohet e papranueshme sepse kërkesa e tij është paraqitur me vonesë dhe një pjesë e pretendimeve të tij kanë qenë të pabazuara*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi Z. Stefan Naumov është shtetas shqiptar dhe bullgar, i cili ka lindur më 1945 dhe jeton në Tiranë. Ai ka qenë Ambasadori i Republikës së Bullgarisë në Republikën e Shqipërisë nga viti 1990 deri me 1997. Më 1996 Ministria e Punëve të Jashtme e Bullgarisë filloi procedurat gjyqësore kundër kërkuesit në përfundim të të cilave, me urdhër të Ministrit të Jashtëm Bullgar, ai u pushua nga puna. Me 10 Shkurt 1997 Gjykata e Lartë Bullgare anuloi urdhrin e Ministrit që e pushonte kërkuesin nga puna.

2. Me 1997 kërkuesi dhe familja e tij kërkuan pranë Presidentit të Republikës së Shqipërisë shtetësinë shqiptare i cili jua akordoi me 17 prill 1997. Me 20 shtator 2001 Presidenti pasues i Republikës së Shqipërisë, *ex officio* deklaroi të pavlefshëm dekretin e Presidentit të datës 17 prill 1997 duke revokuar në këtë mënyrë shtetësinë shqiptare të kërkuesit me arsyen se ishte siguruar me anë të dokumenteve të falsifikuara.

3. Me 2 tetor 2001, rreth orës 9.00 punonjës policie, disa prej të cilëve të armatosur, shoqëruan kërkuesin së bashku me gruan e tij në rajonin e policisë të Tiranës për njoftimin zyrtar të dekretit. Pas disa orësh pritje, kërkuesit i është dhënë një kopje e dekretit të Presidentit të datës 20 shtator 2001, me anë të se cilës i hiqej shtetësia shqiptare. Zëvendës-Shefi i Drejtorisë së Policisë Tiranë urdhëroi me gojë kërkuesin që të largohej nga territori i Shqipërisë brenda datës 5 Tetor 2001, në zbatim të një urdhri dëbimi date 29 Shtator 2001, përndryshe do të dëbohej me forcë. Më 2 tetor

<sup>300</sup> Me vlerë është të shihet gjithashtu vendimi i Gjykatës i 4 janarit 2005 në lidhje me pranueshmërinë në çështjen Naumov kundër Shqipërisë.

2001 Ministria e Rendit dha një njoftim për shtyp duke sqaruar se kërkuesi ishte urdhëruar të linte territorin e Shqipërisë me 5 tetor 2001, meqenëse i ishte hequr shtetësia shqiptare për shkak se e kishte fituar me ane të dokumenteve të falsifikuara.

4. Më 2 Tetor 2001 kërkuesi bëri një kërkesë-padi në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë duke pretenduar anulimin si antikushtetues të Dekretit të Presidentit të Republikës të datës 20 shtator 2001. Ai pretendoi gjithashtu marrjen e një mase të përkohshme për pezullimin e ekzekutimit të urdhrit të dëbimit. Me 4 tetor 2001 Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë refuzoi ta shqyrtonte kërkesë padinë me pretendimin se Gjykata Kushtetuese ishte autoriteti kompetent për të vendosur në lidhje me antikushtetueshmërinë.

5. Ndërkohë, po më 4 tetor 2001, policia pa asnjë arsye të qartë e ndaloi kërkuesin dhe familjen e tij të dilnin nga apartamenti i tyre. Më 5 tetor 2001 kërkuesi mori një letër nga Drejtoria e Policisë që i kujtonte atij largimin nga territori i Shqipërisë deri në mesnatën e asaj dite.

6. Me 31 Dhjetor 2001 Gjykata e Lartë (Kolegji Civil) prishi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të datës 4 tetor 2001 dhe e ia dërgoi po asaj çështjen për rigjykim si autoriteti kompetent për shqyrtimin e ankimit të kërkuesit. Me 23 dhjetor 2002, pas një viti mosveprimi, Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës, në rigjykimin e çështjes, vendosi të shfuqizojë dekretin e Presidentit të datës 20 shtator 2001 si të pabazuar duke konfirmuar në këtë mënyrë shtetësinë shqiptare të kërkuesit.

7. Me 5 tetor 2001 kërkuesi bëri një kërkesë-padi tjetër në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës duke pretenduar këtë radhë që urdhri i dëbimit i datës 29 shtator 2001 dhe urdhri i policisë i datës 5 tetor 2001 të anuloheshin dhe të hidheshin poshtë. Në bazë të fakteve të paraqitura nga kërkuesi, gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë ka zgjatur 2 vjet dhe 6 muaj dhe janë zhvilluar 14 seanca dëgjimore. Seancat gjyqësore janë shtyre në disa raste si rezultat i mungesës së pajustificuar të këshilltarëve ligjorë të Drejtorisë së Policisë dhe të Ministrisë së Rendit. Këta të fundit kane munguar në 13 seanca gjyqësore pa paraqitur asnjë arsye.

8. Me 25 mars 2002 Gjykata e Shkallës së Parë në Tiranë pezulloi shqyrtimin e kërkesë-padisë së kërkuesit deri në momentin që të vendosej në lidhje me vlefshmërinë e dekretit të Presidentit. Më 7 shkurt 2003 gjykata e mbylli gjykimin. Brenda një viti ajo kishte zhvilluar vetëm 4 seanca dëgjimore dhe, në mungesë të përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore, ka vazhduar procedurat vetëm në prani të kërkuesit. Më 20 mars 2003, në mungesë të përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore, Gjykata e Rrethit ka anuluar urdhrin e dëbimit të 2 tetorit dhe urdhrin e policisë të datës 5 tetor 2001 si të pabazuar në ligj.

9. Në kërkesën e 3 dhjetorit 2002, kërkuesi ankohej për shkelje të nenit 5 § 1 (f) për paligjshmërinë e ndalimit të tij në rajonin e policisë, të nenit 6 § 1 për kohëzgjatjen e tepërt të procesit në të cilin ishte palë dhe për mungesë të paanësisë dhe pavarësisë

së gjyqtarëve, në bazë të nenit 8 për shkelje të jetës private dhe familjare, për shkelje të nenit 10 me pretendimin se persekutohej për shkak të bindjeve politike dhe për shkelje të nenit 3 të Protokollit 4 dhe/ose të nenit 1 të Protokollit 7 të Konventës.

## II. Vendimi i Gjykatës

### A. Në lidhje me nenin 5 § 1

10. Kërkuesi pretendonte se mbajtja e tij në rajonin e policisë për një afat të papërcaktuar me 2 tetor 2001, përben "heqje të lirisë" sipas kuptimit të nenit 5 § 1 të Konventës dhe duke qenë e pabazuar në ligj vinte në kundërshtim me këtë nen të Konventës.

11. Gjykata theksoi se në bazë të nenit 35 § 1 të Konventës ajo mund të pranojë vetëm kërkesat që kanë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ankimore efektive dhe janë paraqitur brenda gjashtë muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm. Por në qoftë se brenda shtetit nuk ekziston mundësia efektive për një mjet të tillë ankimor, data e aktit konsiderohet si 'starti' i periudhës 6 mujore<sup>301</sup>. Duke pasur parasysh se e tillë është edhe situata në rastin në fjalë, se ngjarja e pretenduar si shkelje nga kërkuesi ka ndodhur më 2 tetor 2001 dhe kërkesa në Strasburg është paraqitur më 2 dhjetor 2002, pra përtej afatit taksativ 6 mujor, në bazë të nenit 35 §§ 1 dhe 4, kërkesa në lidhje me këtë pretendim nuk duhet pranuar për shkak se është paraqitur jashtë afatit 6 mujor të parashikuar nga ky nen.

### B. Në lidhje me nenin 6 § 1

12. Në kuadrin e nenit 6 § 1 kërkuesi pretendonte se në lidhje me procedurat e heqjes së shtetësisë, nuk i janë nënshtruar një shqyrtimi në kuadrin e një procesi të rregullt, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Për më tepër kohëzgjatja e këtyre procedurave sipas tij ka qenë e paarsyeshme.

13. Duke pasur parasysh dispozitën e nenit 6 § 1 të Konventës sipas së cilës ky nen gjen zbatim në "përcaktimin e të drejtave të tij civile apo detyrimet ose ndonjë akuze penale kundër tij", Gjykata thekson se ky nen nuk gjen zbatim në lidhje me procedurat që rregullojnë shtetësinë e personave apo hyrjen, qëndrimin, dhe dëbimin e të huajve, pasi këto procedura sipas Gjykatës nuk hyjnë as në konceptin e një të drejte civile dhe as penale në kuptimin e nenit 6 § 1<sup>302</sup>. Për këtë arsye ajo vendosi se, sipas nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës, në lidhje me këtë aspekt kërkesa ishte e papranueshme racione materiae.

### C. Në lidhje me nenin 8

14. Kërkuesi ankohej gjithashtu se veprimet e autoriteteve shqiptare përbënin shkelje të së drejtës së tij për jetë private dhe familjare të garantuar nga neni 8 i Konventës. Ky pretendim i kërkuesit kishte të bënte sidomos me bërjen publike të vendimit për dëbimin e tij.

<sup>301</sup> Vendimi i Gjykatës i 14 marsit 2000 në lidhje me çështjen Valasinas kundër Lituaniës.

<sup>302</sup> Gjykata iu referua ndër të tjera vendimeve të saj të 15 dhjetorit 1988 në lidhje me çështjen S. kundër Zvicrës dhe të 29 qershorit 2000 në lidhje me çështjen S. kundër Kroacisë.

15. Gjykata, ashtu si edhe për nenin 5, theksoi se kërkuesi nuk kishte ndërmarrë ndonjë ankim të brendshëm në lidhje me këto shkelje të nenit 8 të Konventës. Edhe në rastin që, për të shmangur kriterin e mos-shterimit të mjeteve efektive, mund të pretendohet se kërkuesi nuk kishte pasur asnjë mjet të tillë në dispozicion, data e fillimit të periudhës 6 mujore është momenti i bërjes së një publikimi të tillë, pra 2 tetor 2001. Për këtë arsye kërkesa e paraqitur më 3 dhjetor 2002 është e papranueshme në lidhje me këtë aspekt *ratione temporis*, në bazë të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

#### **D. Në lidhje me nenin 10**

16. Kërkuesi pretendon se persekutimi i tij është bërë për arsye të bindjeve të tij politike dhe të kaluarës se tij demokratike.

17. Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij. Për rrjedhojë ajo është e mendimit se kërkuesi nuk ka mundur të provojë thëniet e tij dhe të paraqesë një pretendim të argumentuar për shkelje të këtij neni. Në këto kushte, ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në zbatim të nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

#### **E. Në lidhje me nenin 3 të Protokollit 4 ose nenin 1 të Protokollit 7**

18. Kërkuesi ankohet se urdhri i dëbimit përbën shkelje ose të nenit 3 të Protokollit 4 ose të nenit 1 të Protokollit 7 të Konventës. Në mbështetje të këtij ankimi ai argumentonte se nuk ishte përcaktuar se kur merrte fuqi ligjore dekreti i presidentit i datës 20 shtator 2001 që revokonte shtetësinë shqiptare të tij, kështu që urdhri i dëbimit përbënte shkelje të dy neneve të sipërcituara.

19. Në lidhje me ankimin e kërkuesit për shkelje të nenit 3 të Protokollit 4, gjykata vëren se në bazë të dekretit të Presidentit të Republikës të 20 shtatorit 2001, kërkuesi nuk kishte shtetësi shqiptare në kohën e lëshimit të urdhrin të dëbimit të tij me 29 shtator 2001. Edhe pse në disa raste revokimi i shtetësisë i vijuar nga një masë dëbimi mund të sjellë probleme në kuptimin e nenit 3 të Protokollit 4, nisur nga fakti që urdhri i dëbimit nuk është ekzekutuar ende, gjykata vëren se në rastin konkret nuk ka elemente të shkeljes se këtij neni. Për rrjedhojë kjo pjesë e aplikimit është haptazi e pabazuar dhe duhet të refuzohet në zbatim të nenit 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

20. Për sa i përket ankimit të kërkuesit për shkelje të nenit 1 të Protokollit 7, Gjykata vërejt se kërkuesi asnjëherë nuk u dëbua nga Shqipëria dhe ndaj tij nuk u ndërmorën masa për zbatimin forcërisht të urdhrave të policisë të datave 29 shtator dhe 5 tetor 2001. Për më tepër kërkuesi ka qenë në gjendje të paraqesë arsyet kundër dëbimit të tij dhe çështja e tij u rishikua nga gjykatat vendase, të cilat me 20 Mars 2003 kanë deklaruar urdhrat të pavlefshëm duke vendosur anulimin të dekretit të Presidentit që i hiqte shtetësinë shqiptare kërkuesit. Prandaj edhe ankimi i kërkuesit për shkelje të nenit 1 të Protokollit 7 është i papranueshëm dhe haptazi i pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

21. Për këto arsye Gjykata njëzëri e deklaroi kërkesën të papranueshme.



### III. Koment

22. Për mendimin tim kjo çështje përbën shembullin e qartë të paraqitjes jo si duhet të një kërkesë në Gjykatën e Strasburgut dhe të mosrespektimit të kritereve procedurale të kërkuara për këtë qëllim. Pavarësisht se disa prej arsyeve për mospranimin e kërkesave në Strasburg i parashtruam dhe i komentuar edhe në çështjen e mëparshme Xhavana dhe të tjerë kundër Italisë dhe Shqipërisë, mendoj se vlen të theksohen edhe disa arsye të spikatura që çuan në mospranimin e kërkesës në këtë çështje, dhe që mundoj se janë me vlerë për terrenin juridik shqiptar.

23. Tre janë elementët e mospranimit që kërkesës që të bien në sy në këtë çështje. Së pari – lidhja kohore ose *ratione temporis*. Sipas paragrafit 1 të nenit 35 të Konventës, kërkesat me pretendime për shkelje duhet t'i paraqiten Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut brenda një periudhe prej 6 muajsh nga dhënia e vendimit përfundimtar të brendshëm. Për respektimin e këtij rregulli dhe për të shmangur çdo mospranim si në rastin në fjalë në lidhje me nenet 5 § 1 dhe 8 të Konventës, rëndësi themelore ka data e fillimit të këtij afati. Është me shumë vlerë të kihet parasysh se në rastet kur në dispozicion të kërkuesit nuk ekzistojnë mjete të brendshme ankimore, kur është e qartë se mundësia e përdorimit të tyre është tepër e vështirë ose kur ato janë jo efektive, ky afat fillon të ecë që nga data kur ka ndodhur shkelja. Në një situatë të tillë në qoftë se kërkesa nuk paraqitet brenda 6 muajve nga shkelja, ajo do të konsiderohet e papranueshme<sup>303</sup>.

24. Së dyti – lidhja lëndore ose *ratione materiae*. Në Gjykatën e Strasburgut mund të bëhen ankesa vetëm në lidhje me dispozitat e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, brenda kuadrit të tyre interpretues dhe zbatues dhe jo duke iu referuar situatave ose konceptimeve ligjore, administrative, jurisprudenciale ose doktrinale shtetërore. Kjo parashikohet nga nenet 34 dhe 35 § 3 të Konventës të cilët saktësojnë se ankimet mund të bëhen vetëm në lidhje me shkelje të neneve të saj apo të Protokolleve që i bashkëngjiten. Është përmendur disa herë në kuptimin e zgjerimit të impaktit të dispozitave të Konventës karakteri autonom i konceptimit të termave të Konventës. Megjithatë ky karakter vepron edhe në sensin negativ. Kjo do të thotë se pavarësisht se mbrojtja shtetërore mund të jetë më e gjerë në lidhje me një të drejtë të caktuar kjo nuk nënkupton se edhe mbrojtja ndërkombëtare duhet të ndjekë të njëjtin konceptim për nga gama e veprimit të dispozitave të caktuara. Për këtë arsye edhe kërkesa e Z. Naumov në bazë të nenit 6 § 1 të Konventës, nuk u pranua nga ana e Gjykatës. Pavarësisht se në raste të caktuara një parim i tillë nuk e ka penguar këtë të fundit të zgjerojë juridiksionin e vet, ajo e ka bërë gjithmonë për të arritur të ofrojë një mbrojtje efektive të të drejtave të garantuara nga Konventa<sup>304</sup>.

25. Së treti - karakteri subsidiar i mekanizmave ndërkombëtare për garantimin e të drejtave të njeriut. Ky karakter ka të bëjë me faktin që krijimi dhe vënia në lëvizje e

<sup>303</sup> Për më tepër organet e Strasburgut e kanë bërë të qartë që një rregull i tillë i nënshtrohet një interpretimi të ngushtë (Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut në vendimin 214/56 në lidhje me çështjen De Becker kundër Belgjikës)

<sup>304</sup> Shih për shembull vendimin e saj në lidhje me çështjen Hornsby kundër Mbretërisë së Bashkuar.

mekanismave ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut lidhen me rastet kur autoritetet shtetërore nuk kanë vënë në vend në mënyrën dhe masën e duhur të drejtat e shkelura brenda juridiksionit të tyre. Në këto kushte mekanizmat ndërkombëtarë veprojnë vetëm pasi autoriteteve shtetërore t'iu jetë dhënë mundësia për të ndrequr situatën brenda juridiksionit të tyre dhe nuk e kanë ndrequr, ose të paktën jo si duhet duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare<sup>305</sup>. Në çështjen në fjalë, për aq kohë sa kërkuesi nuk ishte dëbuar nga Shqipëria dhe se gjykatat shqiptare i kishin deklaruar të pavlefshme urdhrat e dëbimit dhe kishin shfuqizuar Dekretin e Presidentit për heqjen e shtetësisë, nuk kishte më asnjë arsye që të hynte në veprim mekani zmi i Strasburgut sepse shkelje e pretenduara të nenit 3 të protokollit 4 ose të nenit 1 të Protokollit 7 ishin ndrequr në nivel shtetëror.

## AZINAS kundër QIPROS

(kërkesa nr. 56679/00)

28 prill 2004

Dhoma e Madhe

*ky vendim sqaron kuadrin e juridiksionit të Dhomës së Madhe sidomos në lidhje me shqyrtimin edhe të pranueshmërisë të kërkesave edhe në këtë gradë të juridiksionit në Strasburg*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Andeas Azinas, është shtetas qipriot i cili ka lindur më 1927 dhe jeton në Nikosia.
2. Z. Azinas ka punuar për shërbimin publik në Nikosia si Guvernator i Departamentit të Zhvillimit të Përbashkët, që nga themelimi i Republikës së Qipros më 1960 e deri në largimin e tij.
3. Më 28 korrik 1982 Komisioni i Shërbimit Publik filloi procedimin disiplinor ndaj tij dhe vendosi që ta largojë nga detyra me efekt prapaveprues me argumentimin se më 8 prill 1981 ai ishte shpallur fajtor nga gjykata e rrethit të Nikosias për vjedhje, shkelje të mirëbesimit dhe abuzim në detyrë dhe ishte dënuar me 18 muaj burg. Apelimi i kërkuesit ndaj këtij vendimi ishte hedhur poshtë nga Gjykata e Lartë më 16 tetor 1981. Komisioni i Shërbimit Publik pretendoi se kërkuesi e kishte administruar Departamentin sikur burimet e tij të kishin qenë pronë e vet private. Dënimi me karakter disiplinor konsistonte në mosnjohjen e të gjitha përfitimeve sociale të kërkuesit, përfshirë këtu edhe pensionin e tij.

<sup>305</sup> Gjykata e ka theksuar këtë parim të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare në vendimet e saj në lidhje me çështjet De Wilde, Ooms dhe Versyp kundër Belgjikës, (përfshirë në këtë botim), Aksoy kundër Turqisë, Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë, etj.

## II. Vendimi i Gjykatës

4. Kërkesa u dorëzua më 18 janar 2000 dhe u deklarua pjesërisht e pranueshme më 19 qershor 2001. Në vendimin e saj në Dhomë, më 20 qershor 2002, Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1. Ajo vendosi gjithashtu se nuk ishte gati për të vendosur në lidhje me zbatimin e nenit 41 (shpërblimi i drejtë).

5. Qeveria qipriote kërkoi që çështja t'i përcillej Dhomës së Madhe<sup>306</sup>, dhe paneli i kësaj të fundit e pranoi këtë kërkesë.

6. Kërkuesi ankohej në veçanti në lidhje me largimin e tij nga puna dhe për shfuqizimin pasues të të drejtave të tij për pension. Ai bazohej në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës.

### A. Në lidhje me pranueshmërinë

7. Në mënyrë shumë interesante për këtë fazë të gjykimit në Strasburg, Dhoma e Madhe theksoi se ajo nuk përjashtoj nga mundësia për të marrë në shqyrtim pretendimin e qeverisë qipriote për mosshkrim të mjeteve të brendshme ligjore nga kërkuesi, përderisa, në përputhje me nenin 55 të Rregullores së Gjykatës, ky pretendim ishte ngritur në fazën e pranueshmërisë përpara Dhomës.

8. Rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme ankimore kërkon që normalisht individi t'i ngrejë në nivel shtetëror kërkesat që më pas i ngre në nivel ndërkombëtar, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat formale të afateve kohore të parashikuara në të drejtën e brendshme. Qëllimi i këtij rregulli të shterimit të mjeteve të brendshme ankimore është që t'ju lejojë në radhë të parë autoriteteve shtetërore që të shqyrtojnë dhe marrin masa në lidhje me ankesat e bëra në lidhje me shkeljen e një të drejte të mbrojtur nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe, kur është me vend, të sigurojë vënien në vend të shkeljes dhe të pasojave të saj përpara se ankesa të çohet në Strasburg.

9. Nuk mjafton në vetvete që kërkuesi të ketë shfrytëzuar në mënyrë të pasuksesshme një mjet tjetër ankimor i cili mund ta ketë devijuar masën në fjalë në terma që nuk kanë të bëjnë me një ankesë për shkelje të një të drejte të Konventës. Duhet që në procedimet e brendshme të ketë pasur ankim në lidhje me një të drejtë të parashikuar nga Konventa me qëllim që të mund të pranojmë se ka pasur shterim të mjeteve të brendshme. Kjo nuk do të thotë gjithsesi që ankimi përpara autoriteteve të brendshme t'i referohet shprehimisht neneve të Konventës apo jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut.

10. Gjykata vuri në dukje se Konventa ishte pjesë përbërëse e sistemit ligjor qipriot dhe se kishte përparësi ndaj çdo dispozite të së drejtës së brendshme që vinte në kundërshtim me të. Ajo vuri re gjithashtu se neni 1 i Protokollit 1 ishte drejtpërdrejt

<sup>306</sup> Shih nenin 43 të Konventës.

i zbatueshëm në sistemin ligjor qipriot. Kështu që kërkuesi mund t'i ishte referuar drejtpërdrejt kësaj dispozite në Gjykatën e Lartë ose efekteve juridike të kësaj dispozite në të drejtën e brendshme.

11. Megjithatë kërkuesi nuk e citoi nenin 1 të Protokollit 1 përpara Gjykatës së Lartë e cila në këtë rast kishte vepruar si Gjykatë Apeli. Nga dosja gjyqësore rezultonte se në të dy seancat përpara Gjykatës së Lartë avokati i kërkuesit i ishte referuar mosnjohjes së përfitimeve sociale për të provuar se vendimi i largimit ishte tepër i ashpër në kushtet kur mund të ishte marrë një dënim tjetër. Për këtë arsye Gjykata e Lartë nuk vendosi nëse largimi i kërkuesit nga detyra shkelte të drejtën e tij për të përfituar pension.

12. Çështjet mund t'i referohen Dhomës së Madhe në dy rrugë. Një Dhomë mund të tërhiqet nga juridiksioni, në bazë të nenit 30, në qoftë se çështja ngre probleme serioze në lidhje me interpretimin e Konventës ose kur zgjidhja e këtyre problemeve në Dhomë mund të çojë në papajtueshmëri me jurisprudencën e mëparshme të Gjykatës. Nga ana tjetër, ashtu si edhe në Azinas kundër Qipros, çështjet mund t'i referohen Dhomës së Madhe brenda tre muajve nga data e vendimit të Dhomës. Si kërkuesi ashtu edhe shteti mund ta kërkojnë këtë gjë. Një panel prej pesë gjyqtarësh do ta pranojë kërkesën në qoftë se çështja ngre probleme serioze në lidhje me interpretimin e Konventës ose një problem serioz me rëndësi të përgjithshme.

13. Kjo tregon pra se kërkuesi nuk iu ka ofruar gjykatave qipriote mundësinë për të shqyrtuar, duke parandaluar ose ndrequr në vijim, shkeljen konkrete të Konventës që ai pretendoi në Strasburg. Duke e vlerësuar pretendimin paraprak të qeverisë qipriote në lidhje me mosshkrimin e mjeteve efektive si të bazuar, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën si të papranueshme.

### III. Koment

14. Në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut vendimet në lidhje me çështjet konkrete jepen nga një komitet prej tre gjyqtarësh, një dhomë prej shtatë gjyqtarësh ose një dhomë e madhe prej 17 gjyqtarësh. Komitetet merren vetëm me çështje që janë haptazi të papranueshme.

Kjo çështje tregon se si kjo procedurë e kalimit të çështjes Dhomës së Madhe mund të ketë pasoja tepër interesante. Pasi Dhoma kishte deklaruar shkelje të nenit 1 të Protokollit 1, qeveria kërkoi që çështja t'i përcillej Dhomës së Madhe. Problemi i parë me të cilin ajo duhet të merrej ishte objekti i juridiksionit të saj. Sipas një jurisprudence të qartë tashmë, në juridiksionin e Dhomës së Madhe pranohet se përfshihet e gjithë çështja që i është përcjellë asaj për shqyrtim dhe jo vetëm aspektet e veçanta që sipas ndonjëres prej palëve justifikonin këtë përcjellje. Në çështjen *Odievre kundër Francës*<sup>307</sup>, Gjykata vendosi se ky juridiksion mund të përfshinte gjithashtu rishqyrtimin e vendimit në lidhje me pranueshmërinë.

<sup>307</sup> Vendim i 13 shkurtit 2003.

15. Në këto kushte, Dhoma e Madhe procedoi me shqyrtimin e argumentit të qeverisë qipriote se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme efektive dhe arriti në përfundimin se ky pretendim ishte i bazuar duke e deklaruar kërkesën të papranueshme. Ky vendim ishte tepër i papëlqyeshëm për kërkuesin duke pasur parasysh se Dhoma paraprakisht kishte vendosur se atij i ishin shkelur të drejta që i njihje Konventa.





# NENI 37

## ÇREGJISTRIMI

## STOJANOVIĆ kundër SERBIË

(kërkesa nr. 34425/04)

19 maj 2009

*çregjistrimi nga lista e një kërkesë sipas nenit 37 të Konventës, pasi Gjykata e konsideroi një çështje të zgjidhur*

### I. Faktet kryesore

1. Kërkuesi, Ljubiša Stojanović, është një nënshtetas serb i lindur në vitin 1956.
2. Çështja lidhet me ankesën e zotit Stojanović, sipas të cilit, teksa vuante dënimin në burg, autoritetet nuk kishin pranuar t'i siguronin atij një protezë dhëmbësh falas. Ai ankohej gjithashtu se autoritetet e burgut kishin hapur korrespondencën e tij me organet e brendshme dhe me Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.
3. Në shkurt të vitit 2004, kërkuesi u kontrollua fillimisht nga dentisti i burgut, i cili konfirmoi mungesën totale të dhëmbëve dhe propozoi që kërkuesit t'i sigurohej një protezë dhëmbësh. Më vonë, kërkuesit iu kërkua nga autoritetet që, sipas dispozitave të brendshme për kujdesin shëndetësor, të paguante 60 përqind të shpenzimeve për protezën e dhëmbëve. Kërkuesi propozoi që ta paguante kontributin e tij me këste mujore, por kjo rezultoi pa sukses.
4. Gjatë periudhës prej qershorit 2004 deri në janar 2007, kërkuesi bëri disa përpjekje të tjera për të marrë protezën e dhëmbëve, teksa vazhdonte të kishte probleme serioze gjatë të ngrënit. Atij i ranë të fikët në dy raste, ndërsa herën e dytë ai mori dëmtime të tilla, që u detyrua t'i nënshtrohej ndërhyrjes kirurgjikale në nofulla.
5. Më 30 janar 2007, drejtuesi i burgut e informoi kërkuesin se burgu do të mbulonte të gjitha shpenzimet për protezën e tij. Arsyeja për këtë veprim, sipas tij, ishte humanitare dhe se legjislacioni i brendshëm përkatës nuk përmbante asnjë detyrim të këtij lloji për autoritetet. Më 25 qershor 2007, kërkuesi mori protezën e kërkuar.

### II. Vendimi i Gjykatës

6. Kërkuesi u ankua për refuzimin e autoriteteve serbe për t'i siguruar atij një protezë dhëmbësh falas, në mungesë të së cilës ai pretendonte se kishte pasur probleme serioze me shëndetin. Ai u ankua gjithashtu për ndërhyrjen e autoriteteve të burgut në korrespondencën e tij me Gjykatën, si edhe me organet e ndryshme kombëtare. Ai u mbështet në nenin 3, 8 dhe nenin 1 të Protokollit të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

**A. Në lidhje me nenin 37**

7. Gjykata përsëriti se, sipas nenit 37 § 1 (b), ajo mund "... të vendosë në cilëndo fazë të procedimeve që ta heqë një aplikim nga lista e saj e çështjeve për shqyrtim, kur rrethanat të çojnë në përfundimin se... problemi është zgjidhur...". Me qëllim që të vlerësonte nëse kjo dispozitë i përgjigjej çështjes në fjalë, Gjykatës iu desh t'i përgjigjej dy pyetjeve: së pari, nëse ishin ende në fuqi kushtet për të cilat ishte ankuar drejtpërdrejt kërkuesi; dhe, së dyti, nëse ishin korrigjuar shkeljet e mundshme të Konventës dhe/ose të Protokollit 12.

8. Gjykata vërejti se kërkuesi e kishte marrë protezën e tij falas më 25 qershor 2007. Për më tepër nuk ka asnjë provë, se ai ka vuajtur probleme shëndetësore që atëherë. Nuk ka as dëshmi mjekësore, që ai është lënë të vuajë urinë ose që nuk ka marrë mjaftueshëm ushqim përpara datës në fjalë. Rrjedhimisht Gjykata konsideroi se çështja që kishte sjellë ankesën e kërkuesit ishte "zgjidhur" sipas nenit 37 § 1 (b), prandaj vendosi që ta mbyllte çështjen.

**B. Në lidhje me nenin 8**

9. Nuk ka asnjë provë, se kërkuesi kishte qenë ndonjëherë dakord me praktikën, nëpërmjet së cilës të burgosurit ishin të detyruar t'ia jepnin letrat e tyre të hapura autoriteteve të burgut dhe në kuadër të faktit se korrespondenca e tij në ardhje hapej dhe vulosej gjithashtu nga ata, Gjykata konsideron se këtu kishte qartësisht një "ndërhyrje nga një autoritet publik" në ushtrimin, që i bënte kërkuesi të drejtës për të respektuar korrespondencën e tij, e garantuar kjo nga neni 8 paragrafi 1 i Konventës.

10. Gjykata vuri re që si Kushtetuta e Serbisë e vitit 1990, ashtu edhe Karta e të Drejtave të Njeriut e Minoriteteve dhe Lirive Civile, të cilat ishin në fuqi në kohën e zhvillimit të çështjes, siguronin se nuk mund të ndërhyhej në korrespondencën e askujt në mungesë të një vendimi specifik nga ana e gjykatës për një gjë të tillë. Meqenëse nuk ishte marrë ndonjëherë një vendim i tillë në lidhje me kërkuesin, e meqë rregullat dhe rregulloret e aplikueshme të burgut ishin për vete mjaft të paqarta në këtë drejtim, ndërhyrja e përmendur nuk ishte "në përputhje me ligjin" në kohën materiale.

11. Për pasojë, Gjykata përfundoi se kishte pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës.

**C. Në lidhje me nenin 41**

12. Gjykata gjeti se gjetja e një shkeljeje përbënte në vetvete mjaftueshëm shpërblim të drejtë për çdo dëm jopasuror të pësuar nga kërkuesi.

**III. Koment**

13. Vendimi i Dhomës tregon mungesën aktuale të qartësisë dhe sigurisë ligjore përreth praktikës së tanishme gjyqësore në tre çështje - statusi i viktimës në vazhdimësi për një kërkues sipas Nenit 34; pika në të cilën çështjet mund të

vlerësohen “të zgjidhura” e për pasojë të hiqen nga lista e shqyrtimit nga ana e Gjykatës sipas Nenit 37; si edhe ndërlidhja midis këtyre dy çështjeve.

14. Qeveria Serbe kishte pretenduar se për shkak se kërkuesit i qe siguruar tashmë proteza e dhëmbëve, ai nuk mund të konsiderohej më një viktimë e një shkeljeje të Konventës. Gjykata nuk pranoi të vendoste mbi statusin e tij të viktimës dhe në vend të kësaj vendosi ta heqë çështjen jashtë liste – jo mbi bazën se ai kishte humbur statusin e viktimës, por mbi bazën se çështja mund të konsiderohej tashmë e zgjidhur.

15. Dhoma i dha rëndësi të konsiderueshme gjatë çështjes Stojanović vendimit të Dhomës së Madhe të Gjykatës në Sisojeva k. Letonisë<sup>308</sup> - një çështje e cila shqyrtonte situatën e njerëzve, të cilëve u refuzohej qëndrimi i ligjshëm në Letoni. Prapëseprapë Dhoma nuk i dha përgjigje faktit, se Dhoma e Madhe ishte shprehur hapur në çështjen Sisojeva se rastet e emigracionit kanë rëndësi primare. Ao kanë të bëjnë me shkeljen, që do të ndodhte nëse dëbimi i propozuar do të çohet deri në fund dhe Gjykata ka vendosur normalisht që sapo të hiqet rreziku i dëbimit, kërkuesit nuk mund të konsiderohen më viktimë. Çështjet e emigracionit si Sisojeva nuk kanë të bëjnë kryesisht me shkeljet në të kaluarën të së drejtës për dinjitet njerëzor, e cila ishte një pjesë domethënëse e problemit të hasur në çështjen Stojanović, edhe pse në Moustaquim k. Belgjikës (18 shkurt 1991), kërkuesit i ishte dhënë një leje qëndrimi, por ai nuk ishte kompensuar për pasigurinë në të cilën kishte jetuar për pesë vite, kështu që Gjykata konsideroi se ai ishte ende një viktimë.

16. Ndryshe nga situata e kërkuesit në çështjen Stojanovic, Dhoma e Madhe kishte vërejtur edhe tek Sisojeva se mungesa e statusit në Letoni nuk e kishte dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme aplikuesen, e cila kishte qenë në gjendje të vazhdonte edukimin e saj dhe të fillonte punë në një kohë kur statusi i saj prej emigranteje nuk ishte zgjidhur ende.

17. Kërkuesi po përpiqet që t’ia çojë për shqyrtim çështjen e tij Dhomës së Madhe. Prapëseprapë, tek Stojanović Dhoma nuk bëri zbulime të tjera në lidhje me pranueshmërinë e kësaj pjese të ankesit të kërkuesit dhe jurisprudenca e Gjykatës pohon se Dhoma e Madhe mund ta shqyrtojë një ankesë vetëm kur ky është deklaruar i pranueshëm, prandaj çështja duhet që më parë të rikthehet në listën për shqyrtim, në mënyrë që të merret një vendim për pranueshmërinë e saj.

<sup>308</sup> Vendim i 15.01.2007.

# NENI 46

**FORCA DETYRUESE DHE  
EKZEKUTIMI I VENDIMEVE**

## VEREIN GEGEN TIERFABRIKEN SCHWEIZ (VGT) kundër ZVICRËS (NR. 2)

(kërkesa nr. 32772/02)

30 qershor 2009

**Dhomë e Madhe**

*detyrimi i shteteve për të ekzekutuar vendimet e GJEDNJ*

### I. Faktet kryesore

1. Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) është një shoqatë për mbrojtjen e kafshëve e regjistruar në Zvicër, që bën veçanërisht fushatë kundër eksperimentimit mbi kafshët dhe pularive me prodhimtari të lartë.
2. Në kundërpërgjigje të reklamave të ndryshme të prodhuara nga industria e përpunimit të mishit, VgT realizoi një reklamë televizive ku përfshihej një skenë që shfaqte një sallë të zhurmshme ku derrat mbaheshin në kafaze shumë të vogla.
3. Leja për ta transmetuar reklamën u refuzua në janar 1994 nga Kompania e Reklamave Televizive dhe në shkallë të fundit nga Gjykata Federale. Shoqata kërkuese paraqiti një kërkesë fillestare në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në vendimin e 28 qershorit 2001 theksoi se refuzimi i autoriteteve zvicerane për ta transmetuar reklamën në fjalë përbënte një shkelje të lirisë së shprehjes. Gjykata gjeti një shkelje të nenit 10 të Konventës dhe caktoi si dëmshpërblim për shoqatën 20 mijë franga zvicerane (rreth 12 mijë euro) për koston dhe shpenzimet gjyqësore.
4. Më 1 dhjetor 2001, mbi bazën e vendimit të Gjykatës, shoqata kërkuese paraqiti një kërkesë pranë Gjykatës Federale për rishikimin e vendimit të formës së prerë që ndalonte transmetimin e reklamës. Në një vendim të 29 prillit 2002, Gjykata Federale e hodhi poshtë kërkesën, duke argumentuar ndër të tjera se shoqata kërkuese nuk kishte vërtetuar që transmetimi i reklamës kishte ende vlerë.
5. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, që është përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës, nuk ishte informuar fare që Gjykata Federale e kishte hedhur poshtë kërkesën për rishikim dhe për pasojë e mbylli shqyrtimin e kërkesës fillestare të shoqatës kërkuese, duke aprovuar një rezolutë përfundimtare në korrik 2003. Prapëseprapë, rezoluta sugjeronte mundësinë për të kërkuar rihapjen e procedimeve në Gjykatën Federale.



## 2. Vendimi i Gjykatës

6. Në korrik 2002, shoqata kërkuese paraqiti kërkesën e saj në Gjykatë, për sa i përket hedhjes poshtë që i bëri Gjykata Federale kërkesës për të rihapur procedimet dhe ndalimit të vazhdueshëm të transmetimit të reklamës së saj televizive. Në një vendim dhome të datës 4 tetor 2007, Gjykata Europiane tha se kishte pasur një shkelje të nenit 10. Dhoma e Madhe e pranoi kërkesën e qeverisë zvicerane, që çështja t'i kalohej Dhomës së Madhe sipas nenit 43 të Konventës (referimi për Dhomën e Madhe). Komentet e palëve të treta u morën nga Qeveria Çeke, e cila kishte marrë leje nga Presidenti për të ndërhyrë me procedurë me shkrim.

7. Shoqata kërkuese pretendoi se ndalimi i vazhdueshëm i transmetimit të reklamës televizive, pasi Gjykata Europiane kishte gjetur shkelje të lirisë së shprehjes më 28 qershor 2001, përbënte një shkelje të re të nenit 10 të Konventës.

### A. Në lidhje me nenin 35

8. Qeveria zvicerane pretendoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse kishte lidhje me një subjekt – ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ-së – që, sipas nenit 46, përfshihej në juridiksionin ekskluziv të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës.

9. Gjykata përsëriti, se konstatimet e një shkeljeje nga ana e saj ishin në thelb shpjeguese dhe se mbikëqyrja e ekzekutimit ishte e Komitetit të Ministrave. Roli i këtij komiteti në këtë drejtim, prapëseprapë, nuk donte të thoshte se masat e marra nga një shtet përgjegjës për korrigjimin e një shkeljeje të gjetur nga Gjykata nuk përbënin një problem të ri, kështu që formohej subjekti i një kërkesë të re. Në çështjen në fjalë, vendimi i Gjykatës Federale i 29 prillit 2002, që refuzonte kërkesën e shoqatës kërkuese për të rihapur procedimet, ishte mbështetur mbi baza të reja dhe për pasojë përbënte informacion të ri, për të cilin nuk ishte informuar fare Komiteti i Ministrave dhe që do t'i shpëtonte gjithë shqyrtimit sipas Konventës, nëse Gjykata Europiane nuk do të kishte mundësi ta merrte në shqyrtim. Për rrjedhojë, kundërshtimi paraprak i Qeverisë në këtë drejtim u hodh poshtë.

### B. Në lidhje me nenin 10

10. Gjykata përsëriti se liria e shprehjes ishte një nga parakushtet për një demokraci funksionale dhe se ushtrimi efektiv dhe i vërtetë i kësaj lirie nuk varej thjesht nga detyrimi i Shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të kërkonte gjithashtu marrjen e masave pozitive. Në çështjen në fjalë, duke parë rëndësinë e ekzekutimit efektiv të vendimeve të Gjykatës në sistemin e Konventës, Zvicra kishte pasur detyrimin për të ekzekutuar në mirëbesim vendimin e vitit 2001, duke u pajtuar edhe me përfundimet e vendimit, edhe me frymën e tij. Në këtë drejtim, rihapja e procedimeve të brendshme kishte qenë një masë domethënëse për të siguruar ekzekutimin e vendimit, por me siguri që nuk mund të konsiderohej si masë përfundimtare në vetvete. Në mungesë të çdo baze të re, që mund të justifikonte vazhdimin e ndalimit sipas nenit 10, autoritetet zvicerane kishin pasur detyrimin për të autorizuar transmetimin e reklamës, pa u vendosur në pozicionin e shoqatës kërkuese për të gjykuar nëse debati në fjalë ishte ende një çështje e interesit publik.

11. Për rrjedhojë Gjykata gjeti një shkelje të re të nenit 10.

### *C. Në lidhje me nenin 41*

12. Gjykata caktoi për shoqatën kërkuese 4 mijë euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

### **III. Koment**

13. Çështja, e cila nisi si një protestë kundër industrisë së mishit në Zvicër, u përshkallëzua në një pikëpyetje teknike përpara Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me përgjegjësinë e Shteteve Palë për të ekzekutuar vendimet e kësaj gjykate ndërkombëtare dhe dëmshpërblimet për kërkuesit, nëse ekzekutimi nuk kryhet.

14. Dhoma e Madhe e mbështeti vendimin e Dhomës, që lidhej me një vendim të vitit 2001. Shumica e Dhomës së Madhe arriti në përfundimin, se vendimi i Gjykatës Federale Zvicerane për të refuzuar rihapjen e procedimeve ishte mbështetur mbi baza të reja dhe për rrjedhojë përbënte informacion të ri, për të cilin Komiteti i Ministrave nuk ishte në dijeni dhe që do t'i kishte shpëtuar të gjithë kontrollit sipas Konventës, nëse Gjykata nuk do të ishte në gjendje për ta shqyrtuar. Kështu që çështja ishte e pranueshme – sepse përbënte një çështje të re dhe jo një rishqyrtim të vendimit të mëparshëm dhe vënies së tij në zbatim. Gjykata shpalli se kishte gjetur një shkelje të re të nenit 10.

15. Gjyqtarët e pakicës argumentuan se pretendimi nuk ishte “i ri” dhe se në çdo rast Konventa nuk i jepte juridiksion Gjykatës në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të dhëna prej saj, sepse kjo ishte një kompetencë e Komitetit të Ministrave. Në fakt, Protokollu 14 (që nuk ka hyrë ende në fuqi) do t'i japë Komitetit të Ministrave mundësinë për t'ia paraqitur Gjykatës procedimet për shkelje, në rast se një Shtet dështon në pajtimin me një vendim. Deri atëherë, nëse ngrihet një problem i ngjashëm përsëri, Gjykata do të duhet të bëjë një vlerësim nëse është apo jo e rastit që çështja e sjellë para saj të kualifikohet si e re.

# Bibliografia e përgjithshme

- ABRAHAM R. - *"The effects of the ECHR on the constitutional and administrative law in Contracting Parties"*, A.E.H.R.Y.B. 1992, fq.127- 146.
- AGI M. - *"Encyclopédie des droits de l'homme"* - Fondation Internationale des Droits de l'Homme, 1997.
- ALKEMA E. - *"Implementing the decisions of the supervisory bodies of the ECHR - exploring present possibilities"*, në Barkhuysen T., Van Emmerik L. et Van Kempen C. (ed.), *The execution of Strasbourg and Geneva human rights decisions in the national legal order*; La Haye, Kluwer, 1999, fq.89- 99.
- ALKEMA E.A. - *"Civil servants and their "civil rights" under the European Convention on Human Rights (Art.6, Para.1 of the Convention)"*, në Salvia M.de dhe Villiger M.E. (ed.), *The birth of European human rights law. L'éclosion du droit européen des droits de l'homme. Liber amicorum Carl Aage Nørgaard*, Baden- Baden, Nomos, 1998, fq.15- 23.
- ALKEMA E.A. - *"The European Convention as a constitution and its Court as a constitutional Court"* in *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.41- 63.
- ALKEMA E.A. - *"The third- party applicability or "Drittwirkung" of the European Convention on Human Rights"*, në *Protecting human rights: the European dimension. Protection des droits de l'homme: la dimension européenne*, Cologne, Carl Heymanns, 1988, fq.33- 45.
- ALSTON P. - *"The EU and Human Rights"* - OUP, 1999, fq. 970
- AMERASINGHE C.F. - *"Local remedies in international law"*, Cambridge, Grotius, 1990, fq.410.
- ANDRIANTSIMBAZOVINA J. - *"L'enrichissement naturel de la protection des droits fondamentaux au niveau européen et au niveau national. Vers un contrôle de 'fondamentalité' "*, R.F.D.A. 2002, fq.124- 138.
- ANDRIANTSIMBAZOVINA J. - *"La subsidiarité devant la Cour de justice des Communautés européennes et la Cour européenne des droits de l'homme"*, *Revue des affaires européennes/Law & European Affairs* 1998, fq.28- 47.
- *Annuaire Français du Droit International Public - "Jurisprudence de la Commission Européenne des Droits de l'Homme (deri më 1999 nga Cohen-Jonathan, G.) et de la Court Européenne des Droits de l'Homme (nga Coussirat- Coustère, V.)"*
- BARNES J. et GUICHOT E. - *"La jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme en matière de protection de la propriété privée"*, në Barnes J. (ed.), *Propiedad, expropiación y responsabilidad. La garantía indemnizatoria en el derecho europeo y comparado*, Madrid, Editorial Tecnos, 1995.
- BARSOTTI R. - *"Tendenze evolutive nell'interpretazione della Convenzione europea dei diritti dell'uomo"*, *Riv.D.I.* 1976, fq.286- 290.
- BARTOLE S., CONFORTI B. et RAIMONDI G. (ed.). - *"Commentario alla Convenzione europea per la tutela dei diritti dell'uomo e delle libertà fondamentali"*, Padova, CEDAM, 2001, XXXVI- fq.1011
- BARTSCH H.J. - *"The effects of decisions of the European Court of Human Rights"*, në *Les effets des décisions de la Cour de justice des Communautés européennes dans les États membres*, Bruxelles, U.G.A., 1983, fq.217- 245.
- BATTAGLINI G. - *"Convenzione europea, misure di emergenza e controllo del giudice"*, *Giurisprudenza costituzionale* 1982, fq.404 et s.
- BENGONTXEA J. et JUNG H. - *"Towards a European jurisprudence? The justification of criminal law by the Strasbourg Court"*, *Legal Studies* 1991, fq.239 et s.
- BENOÎT- ROHMER F. - *"La Cour européenne des droits de l'homme et la défense des droits des minorités nationales"*, *R.T.D.H.* 2002, fq.563- 586.
- BERGER V. - *"La jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme relative à l'article 1 du Protocole n°1"* në *Il diritto di proprietà nel quadro della Convenzione europea dei diritti dell'uomo*, Padova, CEDAM, 1989, fq.39- 52.
- BERGER V., LABAYLE H. et SUDRE F. - *"Droit administratif et Convention européenne des droits de l'homme"*, *R.F.D.A.* 1991, fq.101- 122 e 843- 854.
- BERGER, V., *Jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme*- Editeur: Sirey- 13e édition- 2014
- BERNHARDT R. - *"Human rights and judicial review: the European Court of Human Rights"* në Beaty D.M. (ed.), *Human rights and judicial review. A comparative perspective*, Dordrecht, Nijhoff, 1994, fq.297- 319.
- BIANCHI L.- *"Il processo penale italiano davanti alla Corte di Strasburgo"*, *Quaderni della giustizia*, novembre 1986, fq.16- 19.
- BINDSCHEDLER- ROBERT D. - *"La Cour européenne des droits de l'homme devant le droit interne"*, në *Festschrift für Rudolf Bindschedler*, Berne, Stämpfli, 1980, fq.597- 609.
- BIOY, X. et.al. *Les grands arrêts du droit des libertés fondamentales*- Dalloz- 1e édition - 2017

- BLACKBURN R. et POLAKIEWICZ J. (ed.). – *Fundamental rights in Europe. The ECHR and its Member States, 1950- 2000*, Oxford, Oxford University Press, 2001, fq.1090.
- BLOIS M. de – “The fundamental freedom of the European Court of Human Rights”, në *The dynamics of the protection of human rights in Europe. Essays in honour of Henry G. Schermers. Vol. III*, Dordrecht, Nijhoff, 1994, fq.35- 59.
- BORÉ L. – “La motivation des décisions de justice et la Convention européenne des droits de l’homme”, J.C.P 2002, édition générale, n°3, I 104.
- BOYLE A. – “Administrative law and the European Convention on Human Rights”, *Public Law* 1982, fq.218- 226.
- BREMSE E. – “The margin of appreciation in the case law of the European Court of Human Rights”, *Z.ä.ö.R.V.* 1996, fq.240- 314.
- British Yearbook of International Law – nën drejtimin e CRAFT J. (Sidomos vëllimet 52- 74)
- BROWNIE I. – “Basic documents on human rights”, third edition, Clarendon Press, Oxford University Press 1994.
- BUERGENTHAL T. – “Confrontation de la jurisprudence des tribunaux nationaux avec la jurisprudence des organes de la Convention en ce qui concerne les droits judiciaires (articles 5, 6 et 13)”, në *Les droits de l’homme en droit international*, Bruxelles, Presses universitaires de Bruxelles, 1968, fq.263- 325 (anglisht, fq.151- 200).
- BURGOGUE- LARSEN L.- “L’autonomie constitutionnelle aux prises avec la Convention européenne des droits de l’homme”, *R.B.D.I* 2001, fq.31- 64.
- CALLEWAERT J. – “Is there a margin of appreciation in the application of Articles 2, 3 and 4 of the Convention?”, *H.R.L.J.* 1998, fq.6- 9.
- CALLEWAERT J. – “La Convention européenne des droits de l’homme et la matière pénale”, në Tulkens F. et Bosly H.- D. (ed.), *La justice pénale et l’Europe*, Bruxelles, Bruylant, 1996, fq.135- 175.
- CALLEWAERT J. – “Quel avenir pour la marge d’appréciation?”, në *Protection des droits de l’homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de / Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.147- 166.
- CALLEWAERT J. – “The judgments of the Court: background and content”, në *The European system for the protection of human rights*. Dordrecht, Nijhoff, 1993, fq.713- 731.
- CAMERON I. – “National Security and the European Convention on Human Rights”, Uppsala, Iustus, 2000, XXXII- fq.479.
- CAMERON I. et ERIKSSON M.K. – “An introduction to the European Convention on Human Rights”, Uppsala, Iustus, Förlag, 1995, fq.179.
- CANCADO TRINDADE A.A. – “The application of the rule of exhaustion of local remedies in international law. Its rationale in the international protection of individual rights”, Cambridge, Cambridge University Press, 1983, XIII, fq.443.
- CARSS- FRISK M. – “The right to property. A guide to the implementation of Article 1 of Protocol No.1 to the European Convention on Human Rights”, Strasbourg, Council of Europe, 2001, fq.46.
- CATALDI G. – “La clausola di deroga della Convenzione europea dei diritti dell’uomo”, *Riv.D.E.*, 1983, fq.3- 22.
- CHARTIER, A. & SAURON, J. *Les droits protégés par la CEDH- Editeur : Gualino- 1re edition- 2014*
- CHARRIER J.-L. – “Code de la Convention européenne des droits de l’homme”, Paris, Litec, 2000, fq.438.
- CHIAVARIO M. – “Cour européenne des droits de l’homme et Cour constitutionnelle italienne: quelques notes pour une comparaison”, në Capri F. et Orlandi C.G. (ed.), *Judicial protection of human rights at the national and international level*, vol.II, Milan, Giuffrè, 1991, fq.555- 563.
- CHURCHILL R.R. et YOUNG J.R. – “Compliance with judgements of the European Court of Human Rights and decisions of the Committee of Ministers: the experience of the United Kingdom, 1975- 1987”, *B.Y.B.L.* 1991, fq.283- 346.
- CLAPAM A. – “Human rights in the private sphere”, Oxford, Clarendon Press, 1993, fq.385.
- CLAPHAM A. – “The “Drittwirkung” of the Convention ”, në *The European system for the protection of human rights*, Dordrecht, Nijhoff, 1993, fq.163- 206.
- CLAUDE V. – “L’interprétation consensuelle de la Convention européenne des droits de l’homme”, Montpellier, Institut de droit européen des droits de l’homme, 1998, fq.178.
- CLAYTON R. TOMLINSON H. – “The Law of Human Rights”, OUP, fq. 530
- CLEMENTS L., MOLEN., SIMMONS A. – *European human rights. Taking a case under the Convention*, Londres Sweet & Maxwell, 1994, fq.338.
- CLIQUENNOISM. (ed.). – *La Convention européenne des droits de l’homme et le juge français. Vademecum de pratique professionnelle*, Paris, L’Harmattan, 1997, fq.320.
- COHEN- JONATHAN G. – “La Convention européenne des droits de l’homme”, në *Perspectives canadiennes et européennes des droits de la personne*, Cowansville, Blais, 1986, fq.33- 60.
- COHEN- JONATHAN G. – “La Convention européenne des droits de l’homme. Caractères généraux”, J.C.P. 1990, Europe, fascicule 6500, fq.23.
- COHEN- JONATHAN G. – “La protection des droits fondamentaux dans l’Union européenne et la Convention européenne des droits de l’homme”, në *Les mutations contemporaines du droit public. Mélanges en l’honneur de Benoît Jeanneau*, Paris, Dalloz, 2002, fq.3- 31.

- COHEN- JONATHAN G. - "Convention européenne des droits de l'homme. Système international de contrôle", J.C.P. 1991, Europe, fascicule 6510, fq.27.
- COHEN- JONATHAN G. - "Le droit au juge", në *Gouverner, administrer, juger. Liber amicorum Jean Waline*, Paris, Dalloz, 2001, fq.471- 504.
- COHEN- JONATHAN G. - "Le rôle des principes généraux dans l'interprétation et l'application de la Convention européenne des droits de l'homme", në *Mélanges en hommage à Louis Edmond Pettiti*, Bruxelles, Bruylant, 1998, fq.165- 196.
- COHEN- JONATHAN G. - "Les réserves dans les traités institutionnels relatifs aux droits de l'homme. Nouveaux aspects européens et internationaux", R.G.D.I.P. 1996, fq.915- 949.
- COHEN- JONATHAN G. - "Responsabilité pour atteinte aux droits de l'homme", në *La responsabilité dans le système international*, Paris, Pedone, 1991, fq.101- 135.
- COHEN- JONATHAN G. - "Transparence, démocratie et effectivité des droits fondamentaux dans la Convention européenne des droits de l'homme", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq. 245- 263.
- COHEN- JONATHAN G. - "Quelques considérations sur l'autorité des arrêts de la Cour européenne des droits de l'homme", në *Liber amicorum Marc- André Eissen*, Bruxelles, Bruylant, et Paris, L.G.D.J., 1995, fq.39- 64.
- COHEN-JONATHAN G. - "Aspects européens des droits fondamentaux", Paris, Montchrestien, 1999, fq.229. 2ed.
- COHEN-JONATHAN G. - "La Convention européenne des droits de l'homme", Paris, Economica, et Aix-en- Provence, Presses universitaires d' Aix-Marseille, 1988, fq.616.
- COHEN-JONATHAN G. - "Liberté d'expression et message publicitaire", R.T.D.H. 1993, fq.69- 93.
- COHEN-JONATHAN G. - "Convention européenne des droits de l'homme et procédure civile", J.C.P. avril 1993, procédure civile, fq.18.
- COHEN-JONATHAN G. - "Convention européenne des droits de l'homme. Droits garantis", J.C.P. 1992, Europe, fascicule 6520, 6521 e 6522, 25, 32 e 32.
- COHEN-JONATHAN G. - "Cour européenne des droits de l'homme et droit international général" (1998- 1999)", A.F.D.I. 1999, fq.767- 789.
- COHEN-JONATHAN G. - "La Convention européenne des droits de l'homme et les systèmes nationaux des États contractants", në *Droit et justice. Mélanges en l'honneur de Nicolas Valticos*, Paris, Pedone, 1999, fq.385- 404.
- COMMISSION DE VENISE. - "Bulletin de jurisprudence constitutionnelle", édition spéciale, Grands arrêts, CEDH, 1998, fq.188.
- CONSEIL DE L'EUROPE. - "Répertoire de la jurisprudence relative a la Convention européenne des droits de l'homme", vol.1 (articles 1- 5), Cologne, Carl Heymanns, 1992.
- CORTEN O. - "L'utilisation du 'raisonnable' par le juge international. Discours juridique, raison et contradiction", Bruxelles, Bruylant et Éditions de l'Université libre de Bruxelles, 1997, fq.696.
- COSTA J.- P. - "La Convention européenne des droits de l'homme et la liberté religieuse", Cahiers du CREDHO n°4, 1998, fq.13- 18.
- COSTA J.- P. - "La Cour européenne des droits de l'homme: vers un ordre juridique européen?", në *Mélanges en hommage à Louis Edmond Pettiti*, Bruxelles, Bruylant, 1998, fq.197- 206.
- COSTA J.-P. - "La liberté d'expression selon la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", *Actualité et droit international* juin 2001, fq.1- 4.
- COSTA J.-P. - "La liberté d'expression selon la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", *Actualité et droit international* juin 2001, fq.1- 4.
- COSTA J.-P. - "La protection des droits de l'homme par la juge européen", *Revue européenne de droit public* printemps 2001, fq.69- 84.
- COSTA J.-P. - "Le principe du contradictoire dans l'article 6 § 1 de la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", R.F.D.A. 2001, fq.30- 32.
- COSTA, J. P. - *La Cour européenne des droits de l'homme- Des juges pour la liberté-* Dalloz, collection « les sens du droit » 2eme édition, 2016.
- COUNCIL OF EUROPE - "Digest of Strasbourg case- law relating to the European Convention on Human Rights", vol.1 (Articles 1- 5), fq.669, vol.2 (Article 6), fq.922, vol.3 (Articles 7- 12), fq.601, vol.4 (Articles 13- 25), fq.455, vol.5 (Articles 26- 66, Protocols to the Convention), fq.899, vol.6 (General Index to Vol. 1- 5), fq.662, Cologne, Carl Heymanns, 1984 et 1985.
- COUSSIRAT-COUSTÈRE V. - "Convention européenne des droits de l'homme et droit interne: primauté et effet direct", në *La Convention européenne des droits de l'homme*, Bruxelles, Némésis, 1992, fq.11- 23.
- COUSSIRAT-COUSTÈRE V. - "Famille et Convention européenne des droits de l'homme ", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.281- 307.
- COUSSIRAT-COUSTÈRE V. - "La notion de famille dans les jurisprudences de la Commission et de la Cour européenne des droits de l'homme ", në *Internationalisation des droits de l'homme et évolution du droit de la famille*, Paris, L.G.D.J., 1996, fq.45- 74.
- CREMONA J.J.- "The interpretation of the word "law "in the jurisprudence of the European Court of Human Rights ", në *Cremona J.J. , Selected papers. 1946- 1989*, Marsa, PEG, 1990, fq.187- 194.



- CREMONA J.J. - "The proportionality principle in the jurisprudence of the European Court of Human Rights", në *Recht zwischen Umbruch and Bewahrung. Festschrift für Rudolf Bernhardt*, Berlin, Springer, 1995, fq.323- 330.
- CREMONA J.J. - "The right to free elections in the European Convention on Human Rights ", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.309- 323.
- CULLEN H. - "Articles 9- 11 ECHR in 1995: a "new Europe" approach to fundamental freedoms ", *E.L.R. Human Rights Survey* 1996, fq.29- 39.
- DE MEYER J. - "Le droit de propriété dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", në Marcus-Helmons S. (ed.), *Le droit de propriété en Europe occidentale. Mutations et limites d'un droit fondamental*, Bxl, Academia et Bruylant, 1995, fq.55- 85.
- DE SCHUTTER O. - "L'interprétation de la Convention européenne des droits de l'homme: un essai en démolition", *Revue de droit international, de sciences diplomatiques et politiques* 1992, fq.83- 127.
- DE SCHUTTER O. - "La Convention européenne des droits de l'homme et l'asile ", *Revue du droit des étrangers* 1994, fq.471- 270.
- DE SCHUTTER O. - "La Convention européenne des droits de l'homme à l'épreuve de la lutte contre le terrorisme ", *R.U.D.H.* 2001, fq.185- 206.
- DE SCHUTTER O. - "La coopération entre la Cour européenne des droits de l'homme et la juge national ", *R.B.D.I.* 1997, fq.21- 68.
- DE SCHUTTER O. - "La protection juridictionnelle provisoire devant la Cour européenne des droits de l'homme", në Ruiz Fabri H. et Sorel J.- M. (ed.), *Le contentieux de l'urgence et l'urgence dans le contentieux devant les juridictions internationales: regards croisés*, Paris, Pedone, 2001, fq.105- 148.
- DE SCHUTTER O. - "Sur l'émergence de la société civile en droit international: le rôle des associations devant la Cour européenne des droits de l'homme ", *E.J.I.L.* 1996, fq.372- 410.
- DECAUX E. - "Le territoire des droits de l'homme", në *Liber amicorum Marc - André Eissen*, Bruxelles, Bruylant, et Paris, L.G.D.J., 1995, fq.65- 78.
- DELMAS-MARTY M. - "La jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme et la "logique du flou", *R.D.P.C.* 1992, fq.1031- 1046.
- DELMAS-MARTY M. - "Pluralisme et traditions nationales (revendication des droits individuels)", në Tavernier P. (ed.), *Quelle Europe pour les droits de l'homme?*, Bruxelles, Bruylant, 1996, fq.81- 92.
- DELMAS-MARTY M., DIISE W., LENOIR R. et PERCHERON A. - "La perception des droits de l'homme dans la société contemporaine. Projet d'enquête à partir de la jurisprudence de la Cour EDH", *Archives de politique criminelle* 1989, fq.35- 58.
- DIJK P.van . - "Access to court", në *The European system for the protection of human rights*, Dordrecht, Nijhoff, 1993, fq.345- 379.
- DIJK P.van . - "The interpretation of "civil rights and obligations" by the European Court of Human Rights - one more step ", në *Protecting human rights: the European dimension. Protection des droits de l'homme: la dimension européenne*, Cologne, Carl Heymanns, 1988, fq.131- 143.
- DIJK P.van et HOOFF G.J.H. van . - *Theory and practice of the European Convention on Human Rights*, Deventer, Kluwer Law and Taxation Publishers, 1998, fq.850.
- DIPLA H. - *La responsabilité de l'État pour violation des droits de l'homme - Problèmes d'imputation*, Paris, Pedone, 1994, fq.116.
- DOSWALD-BECK L. - "The meaning of the "right to respect for private life" under the European Convention on Human Rights ", *H.R.L.J.* 1983, fq.283- 309.
- DRZEMCZEWSKI A. - "European Human Rights Convention in Domestic Law, A Comparative Study" - Clanderon Press, 1985, fq. 372
- DRZEMCZEWSKI A. - "The authority of the findings of the organs of the European Human Rights Convention in domestic courts", *Legal Issues of European Integration* 1979, fq.50 et s.
- DRZEMCZEWSKI A. - "The right to respect for private and family life, home and correspondence as guaranteed by Article 8 of the European Convention on Human Rights", Strasbourg, Council of Europe, 1984, fq.30.
- DRZEMCZEWSKI A. - "Un État en violation de la Convention européenne des droits de l'homme: l'exécution interne des décisions des institutions de Strasbourg", në *Protecting human rights: the European dimension. Protection des droits de l'homme: la dimension européenne*, Cologne, Carl Heymanns, 1988, fq.149- 158.
- DUBROCARD M., PAPOUZADE J. et MARCHI- UHEL C. - "Evolution du champ d'application de l'article 6 § 1 de la Convention européenne des droits de l'homme", *Le Courtier juridique des finances* novembre 1997, fq.8- 10.
- DUFFAR J. - "La protection des droits économiques par la Convention de sauvegarde des droits de l'homme et des libertés fondamentales", *G.P.* 27- 28 septembre 1995, fq.7- 13.
- DUFFAR J. - "La protection internationale des droits des minorités religieuses", *R.D.P.* 1995, fq.1495- 1530.
- DUFFY P. - "Note sur l'article 15 de la Convention européenne des droits de l'homme", në *Droits intangibles et états d'exception. Non- derogable rights and states of emergency*, Bruxelles, Bruylant, 1996, fq/193- 201.
- DUMAS R. - "La liberté d'information dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme et du Conseil constitutionnel", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.447- 457.



- DUPEUX J.Y. - "Le droit du citoyen à l'information dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", G.P. 9- 10 février 1996, fq.7- 14.
- DURAND D. - "Les garanties apportées par la Convention européenne des droits de l'homme dans de procès pénal", në *La Convention européenne des droits de l'homme*, Bruxelles, Némésis, 1992, fq.53- 76.
- DUTERTRE G. - "Cour européenne des Droits de l'Homme", *Extraits clés de jurisprudence*, Council of Europe Publishing, Editions du Conseil de l'Europe, juillet 2003.
- DUTERTRE G. et VELDE J.van der . - "Key extracts from a selection of judgments of the European Court of Human Rights and decisions and reports of the European Commission of Human Rights. Extraits clés d'une sélection des arrêts de la Cour européenne des droits de l'homme et des décisions et rapports de la Commission européenne des droits de l'homme", *Yearbook of the European Convention on Human Rights*, vol.41A, La Haye, Nijhoff, 1999, fq.223.
- EINARSEN T. - "The European Convention on Human Rights and the notion of an implied right to de facto asylum", *International Journal of Refugee Law* 1990, fq.361- 389.
- EISSEN M. A. - "La durée des procédures civiles et pénales dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", Strasbourg, Éditions du Conseil de l'Europe, 1996, fq.78.
- EISSEN M.A. - "Cours constitutionnelles nationales et Cour européennes des droits de l'homme: leur influence mutuelle ", R.T.D.H. 1991, fq.167- 175.
- EISSEN M.A. - "Jurisprudence relative à l'article 5 de la Convention de sauvegarde des droits de l'homme et des libertés fondamentales", Strasbourg, Conseil de l'Europe, 1985, fq.46.
- EISSEN M.A. - "L'interaction des jurisprudences constitutionnelles nationales et de la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", në Rousseau D. et Sudre F. (ed.), *Conseil constitutionnel et Cour européenne des droits de l'homme. Droits et libertés et Europe*, Paris, Éditions S.T.H., 1990, fq.137- 215.
- EISSEN M.A. - "La durée des procédures civiles et pénales dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme ", *Bulletin d'information de la Cour de cassation*, 1<sup>er</sup> octobre 1995, communications, fq.3- 33.
- EISSEN M.A. - "La liberté d'expression dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", në Cassese A. et Clapham A. (ed.), *Transfrontier television in Europe: the human rights dimension. La télévision transfrontière en Europe dans la perspective des droits de l'homme*, Baden- Baden, Nomos, 1990, fq.113- 136.
- EISSEN M.A. - "The length of civil and criminal proceedings in the case- law of the European Court of Human Rights", Strasbourg, Council of Europe Publishing, 1996, fq.81.
- ELENS F. - "La notion de démocratie dans le cadre des limitations aux droits de l'homme ", *Documentação e direito comparado* 1982, fq.163- 248.
- ERCMAN S. - "European Convention on Human Rights. Guide to case- law - Convention européenne des droits de l'homme. Guide de jurisprudence - Europäis - che Menschenrechtskonvention. Wegweiser der Rechtsprechung", Vienne, Braumüller, 1981, fq.528.
- ERGEC R. - "L'incidence du droit du Conseil de l'Europe sur le développement du droit administratif", *Administration publique* 1992, fq.1- 11.
- ERMACORA F. - "Problems about the application of the European Convention on Human Rights in asylum cases", në *The dynamics of the protection of human rights in Europe. Essays in honour of Henry G. Schermers*. Vol. III, Dordrecht, Nijhoff, 1994, fq.155- 163.
- EVANS C. - *Freedom of religion under the European Convention on Human Rights*, Oxford, Oxford University Press, 2001, fq.222.
- EVRIGENIS D. - "L'interaction entre la dimension internationale et la dimension nationale de la CEDH. Notions autonomes et effet direct", në *Völkerrecht als Rechtsordnung, Internationale Gerichtsbarkeit. Menschenrechte. Festschrift für Hermann Mosler*: Berlin, Springer, 1983, fq.193- 202.
- FACCHIN R. (ed.). - "L'interpretazione giudiziaria della Convenzione europea dei diritti dell'uomo. Guida alla giurisprudenza della Corte (1988- 1989)", Padova, CEDAM, 1990, fq.482.
- FAVOREU L. - "Les Cours de Luxembourg et de Strasbourg ne sont pas des Cours constitutionnelles", në *Mélanges en l'honneur de Louis Dubouis. Au carrefour des droits*, Paris, Dalloz, 2002, fq.35- 45.
- FAWCET J.E.S. - "The application of the European Convention on Human Rights", Oxford, Clarendon Press, 1987, fq.436.
- FLAUSS J.F. - "Actualité de la Convention européenne des droits de l'homme. Droit administratif et Convention européenne des droits de l'homme: l'année 1991 ", A.J.D.A. 1992, fq.15- 34.
- FLAUSS J.F. - "Actualité de la Convention européenne des droits de l'homme (mai 2002- octobre 2002) ", A.J.D.A. 2002, fq.1277- 1286.
- FLAUSS J.F. - "Discrimination positive et Convention européenne des droits de l'homme ", në *Pouvoir et liberté. Etudes offertes a Jacques Mourgeon*, Bruxelles, Bruylant, 1998, fq.415- 437.
- FLAUSS J.F. - "Droit constitutionnel et Convention européenne des droits de l'homme. Le droit constitutionnel national devant la Cour européenne des droits de l'homme ", R.F.D.C. 2000, fq.843 et s.
- FLAUSS J.F. - "La contribution de la jurisprudence des organes de la Convention européenne des droits de l'homme a la formation d'un droit constitutionnel européen ", R.U.D.H. 1995, fq.373- 383.
- FLAUSS J.F. - "La Cour de Strasbourg face aux violations systématiques des droits de l'homme ", në *Les droits de l'homme au seuil du troisième millénaire. Mélanges en hommage a Pierre Lambert*, Bruxelles, Bruylant, 2000, fq.343- 361.

- FLAUSS J.F. - "La Cour européenne des droits de l'homme est-elle une cour constitutionnelle?", në Flauss J.- F. et Salvia M.de (ed.), *La Convention européenne des droits de l'homme: développements récents et nouveaux défis*, Bruxelles, Bruylant, 1997, fq.69- 92.
- FLAUSS J.F. - "Le droit constitutionnel devant les instances de contrôle de la Convention européenne des droits de l'homme. Actualité jurisprudentielle 1994, 1995 et 1996 ", R.F.D.C. 1997, fq.377- 399.
- FLAUSS J.F. - "Les droit à un recours effectif: l'article 13 de la Convention européenne des droits de l'homme dans la jurisprudence de la Commission et de la Cour", në *Vues canadiennes et européennes des droits et libertés*. Cowansville, Blais, 1989, fq.255- 292.
- FLAUSS J.F. - "Les droits de l'homme comme élément d'une constitution et de l'ordre européen ", *Vorträge, Reden und Berichte aus dem Europa- Institut der Universität des Saarlandes n° 264*, Sarrebruck, 1992, fq.21.
- FOCARELLI C. - "Equo processo e Convenzione europea dei diritti dell'uomo", Padoue, CEDAM, 2001, XII- fq.438.
- FROWEIN J.A. - "Art.13 as a growing pillar of Convention law", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/ Studies in memory of Rolo Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.545- 550.
- FROWEIN J.A. - "Male captus, male detentus: a human right", në *The dynamics of the protection of human rights in Europe. Essays in honour of Henry G. Schermers. Vol. III. Dordrecht, Nijhoff*, 1994, fq.175- 185.
- FRUMER P. - "La renonciation aux droits et libertés. La Convention européenne des droits de l'homme à l'épreuve de la volonté individuelle", Bruxelles, Bruylant et Université de Bruxelles, 2001, fq.752.
- GANSHOF VAN DER MEERSCH W. - "Le caractère "autonome" des termes et la "marge d'appréciation" des gouvernements dans l'interprétation de la Convention européenne des droits de l'homme ", në *Protecting human rights: the European dimension. Protection des droits de l'homme: la dimension européenne*, Cologne, Carl Heymanns, 1988, fq.201- 220.
- GANSHOF VAN DER MEERSCH W. - "Quelques aperçus de la méthode d'interprétation de la Convention de Rome du 4 novembre 1950 par la Cour européenne des droits de l'homme", në *Mélanges offerts à Robert Legros*, Bruxelles, Éditions de l'Université de Bruxelles, 1985, fq.207- 243.
- GEARTY C.A. (ed.). - "European civil liberties and the European Convention on Human rights. A comparative study", La Haye, Nijhoff, 1997, fq.420.
- GÖLCÜKLÜ F. - "Exécution des décisions des organes de contrôle de la Convention européenne des droits de l'homme", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: the European perspective. Mélanges à la mémoire de/ Studies in memory of Rolo Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.557- 576.
- GOLSONG H. - "L'effets direct ainsi que en droit interne des normes de la Convention européenne des droits de l'homme et des décisions prises par les organes institues par celles- ci", në *Les recours des individus devant les instances nationales en cas de violation du droit européen*, Bruxelles, Larcier, 1978, fq.59- 83.
- GOMIEN D. - "Judgments of the European Court of Human Rights, Reference charts", Strasbourg, Council of Europe, 1995, fq.302.
- GOMIEN D. - "La Cour de Strasbourg, dénominateur commun de la protection des droits de l'homme en Europe", në *Les enjeux de la grande Europe. Le Conseil de l'Europe et la sécurité démocratique*, Strasbourg, La Nuée bleue et Editions du Conseil de l'Europe, 1996, fq.75- 84.
- GOMIEN D. - "Udhëzues i shkurtër për Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut", Këshilli i Europës, Strasbourg, 1998, fq.154.
- GOMIEN D. - "Vademecum de la Convention européenne des droits de l'homme", Strasbourg, Éditions du Conseil de l'Europe, 1999, fq.168.
- GOMIEN D., HARRIS D. et ZWAAK L. - "Convention européenne des droits de l'homme et Charte sociale européenne. Droit et pratique", Strasbourg, Éditions du Conseil de l'Europe, 1996, f.479.
- GOMIEN D., HARRIS D. et ZWAAK L. - "Law and practice of the European Convention on Human Rights and the European Social Charter", Strasbourg, Council of Europe Publishing, 1996, fq.479.
- GOUTTES R. de . - "Le juge judiciaire et la Convention européenne des droits de l'homme: avancées et réticences", në Tavernier P. (ed.), *Quelle Europe pour des droits de l'homme?*, Bruxelles, Bruylant, 1996, fq.217- 234.
- GOUTTES R. de . - "Vers un droit pénal européen?", R.S.C.D.P.C. 1993, fq.643- 661.
- GRAY C.D. - "Judicial remedies in international law", Oxford, Clarendon Press, 1987, fq.250.
- GREER S. - "Les exceptions aux articles 8- 11 de la Convention européenne des droits de l'homme", Strasbourg, Éditions du Conseil de l'Europe, 1997, fq.66.
- GREER S. - "The exceptions to Articles 8 to 11 of the European Convention on Human Rights", Strasbourg, Council of Europe Publishing, 1997, fq.63.
- GREGORI G. - "La tutela europea dei diritti dell'uomo", Milan, Sugar, 1979, fq.323.
- GRIEF N. et BETTEN L. - "EU law and human rights", Amsterdam, Addison Wesley Longman, 1998, fq.176.
- GROTRIAN A. - "L'article 6 de la Convention européenne des droits de l'homme. Droit a un procès équitable", Strasbourg, Éditions du Conseil de l'Europe, 1994, fq.90.
- GRUDA Z. - "Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut", vol. I & II, Universiteti i Prishtinës, 2001.

- HARRIS D.J. , O'BOYLE M. et WARBRICK C. - "Law of the European Convention on Human Rights", Londres, Butterworths, 1995, fq.753.
- HARRIS, D. & O'BOYLE, M. & BATES, E. & BUCKLEY, C., *Law of the European Convention on Human Rights*- 3rd edition, Oxford University Press, 2014
- HENNEBEL, L. & TIGROUDJA, H., *Traité de droit international des droits de l'homme* - Editions A. Pedone- 2016
- HIGGINS R. - "The European Convention on Human Rights", në Meron T. (ed.), *Human rights in international law: legal and policy issues*, vol.II, Oxford, Clarendon Press, 1984, fq.495- 549.
- HUTCHINSON M.R. - "The margin of appreciation doctrine in the European Court of Human Rights", *I.C.L.Q.* 1999, fq.638- 650.
- ISTITUTO INTERNAZIONALE DI STUDI SUI DIRITTI DELL'UOMO - "L'interpretazione giudiziaria della Convenzione europea dei diritti dell'uomo. Guida alla giurisprudenza della Corte (1960- 1987)", Padova, CEDAM, 1988, XXXIV-fq.560.
- JACOBS F.G. - "The "limitation clauses" of the European Convention on Human Rights ", në *La limitation des droits de l'homme en droit constitutionnel comparé*, Cowansville, Blais, 1986, fq.21- 40.
- JACOBS F.G. - "The European Convention on Human Rights ", në Bernhardt R. et Jolowicz J.A. (ed.), *International enforcement of human rights*, Berlin, Springer, 1987, fq.31- 55.
- JACOBS F.G. et WHITE R.C.A. - "The European Convention on Human Rights", Oxford, Clarendon, Press, 1996, XIV- fq.469.
- JACOBS, WHITE & OVEY. *The European Convention on Human Rights*- 7th edition, Oxford University Press, 2017
- JACOT-GUILLARMO. - "Le juge national face au droit européen: perspective suisse et communautaire", Bâle, Halding & Hahn, et Bruxelles, Bruylant, 1993, fq.379.
- JACQUÉ J.P. - "La Convention européenne des droits de l'homme et les limitations aux droits garantis - Rôle respectif des corps législatifs et des tribunaux", në *La limitation des droits de l'homme en droit constitutionnel comparé*, Cowansville, Blais, 1986, fq.157- 219.
- JACQUÉ J.P. - "La liberté d'association dans la Convention européenne des droits de l'homme", në *Perspectives canadiennes et européennes des droits de la personne*, Cowansville, Blais, 1886, fq.307- 319.
- JACQUÉ J.P. - "Le principe d'égalité" në *Vues canadiennes et européennes des droits et libertés*, Cowansville, Blais, 1989, fq.77- 89.
- JACQUÉ J.P. - "Le respect de la vie privée et familiale dans la jurisprudence des organes de la Convention européenne des droits de l'homme et des libertés fondamentales", në *La Convention européenne des droits de l'homme et des libertés fondamentales*, Toulouse, Annales de l'Université des sciences sociales de Toulouse, 1980, fq.125- 146.
- JANIS M., KAY R., BRADLEY A. - "European Human Rights Law- Text and Materials", OUP textbook. 2 ed. 2000, fq. 600
- KARAGIANNIS S. - "Expulsion des étrangers et mauvais traitement imputables à l'État de destination ou à des particuliers. Vers une évolution de la jurisprudence européenne?", *R.T.D.H.* 1999, fq.33-88.
- KASTANAS E. - "Unité et diversité: notions autonomes et marge d'appréciation des États dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", Bruxelles, Bruylant, 1996, fq.480.
- KAYSER P. - "Le regroupement familial dans le droit communautaire, la Convention européenne des droits de l'homme et de droit interne français", *La semaine juridique, édition générale*, n° 21- 22, 2 juin 1993, I (doctrine), fq.235- 244.
- KEMPEES P. - "A systematic guide to the case-law of the European Court of Human Rights", 1960- 1994, Dordrecht, Nijhoff, 1996, vol.I, fq.731, et vol. II, fq.1420, 1995- 1996, 1998, vol.III, fq.572, 1997- 1998, 2000, vol.IV, fq.966.
- KEMPEES P. - "Legitimate aims' in the case-law of the European Court of Human Rights", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.659- 675.
- Këshilli i Europës, Komisioni Europian, Ministria e Drejtësisë, Qendra Europiane- "Raport i Përqasjes së Legjislacionit Shqiptar me Kërkesat e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut", Tiranë, qershor 2003.
- KILKELLY U. - "The child and the European Convention on Human Rights", Aldershot, Ashgate/Dartmouth, 1999, XIV- fq.353.
- KILKELLY U. - "The right to respect for private and family life. A guide to the implementation of Article 8 of the European Convention on Human Rights", Strasbourg, Council of Europe, 2001, fq.66.
- KINLEY D. - "The European Convention on Human Rights: compliance without incorporation", Aldershot, Dartmouth, 1993, fq.202.
- KISS A. - "La Convention européenne des droits de l'home a-t-elle créé un ordre juridique?", në *Mélanges en hommage à Louis Edmond Pettiti*, Bruxelles, Bruylant, 1998, fq.493- 505.
- KLEIN E. - "Should the binding effect of the judgments of the European Court of Human Rights be extended?", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.705- 713.
- KOERING- JOULIN R. - "La notion européenne de tribunal indépendant et impartial au sens de l'article 6 § 1 de la Convention européenne des droits de l'homme", *R.S.C.D.P.C.* 1990, fq.765- 774.

- KRÜGER H.C. - "Reflections on some aspects of just satisfaction under the European Convention on Human Rights", në *Liber amicorum Marc- André Eissen*, Bruxelles, Bruylant, et Paris, L.G.D.J., 1995, fq.255- 269.
- LAMBERT - ABDELGAWAD E. - "L'exécution des arrêts de la Cour européenne des droits de l'homme", Strasbourg, Éditions du Conseil de l'Europe, 2002, fq.55.
- LAMBERT E. - "Les effets des arrêts de Cour européenne des droits de l'homme - Contribution a une approche pluraliste du droit européen des droits de l'homme", Bruxelles, Bruylant, 1999, fq.624.
- LAMBERT H. - "The European Court of Human Rights and the right of refugees and other persons in need of protection to family reunion", *I.J.R.L.* 1999, fq.427- 450.
- LAMBERT P. - "Extradition et expulsion d'étrangers dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", në *Les nouveaux droits de l'homme en Europe*, Bruxelles, Bruylant, 1999, fq.63- 78.
- LAMBERT P. - "La Grèce devant la Cour européenne des droits de l'homme", Bruxelles, Bruylant et Nemesis, 2003, fq.131.
- LAMBERT P. - "La liberté d'expression et la sécurité nationale, l'intégrité territoriale ou la sûreté publique, la défense de l'ordre et la prévention du crime", *R.T.D.H.* 1993, fq.119- 128.
- LAMBERT P. - "Marge nationale d'appréciation et contrôle de proportionnalité", në *Sudre F. (ed.), L'interprétation de la Convention européenne des droits de l'homme*, Bruxelles, Bruylant et Nemesis, 1998, fq.63- 89.
- LAMBERT P. - "Racisme et liberté d'expression dans la Convention européenne des droits de l'homme", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.735- 742.
- LAMBERT P. - "Vers une évolution de l'interprétation de l'article 14 de la Convention européenne des droits de l'homme?", *R.T.D.H.* 1998, fq.497- 505.
- LAVENDER N. - "The problem of the margin of appreciation", *E.H.R.L.R.* 1997, fq.380- 390.
- LAWSON R. - "Confusion and conflict? Diverging interpretations on human rights in Strasbourg and Luxembourg", në *The dynamics of the protection of human rights in Europe. Essays in honour of Henry G. Schermers. Vol. III*, Dordrecht, Nijhoff, 1994, fq.219- 252.
- LAWSON R.A. et SHERMERS H.G. (ed.) - "Leading cases of the European Court of Human Rights", Nimègue, Ars Aequi Libri, 1997, XXXIX- fq.788.
- LEACH P. - "Taking a case to the European Court of Human Rights", Londres, Blackstone, 2001, XXXIX- fq.392.
- LEACH, PH. *Taking a Case to the European Court of Human Rights* - 4th edition, OUP Oxford, 2017
- LENAERTS K. et ARTS D. - "La personne et le principe d'égalité en droit communautaire et dans la Convention européenne de sauvegarde des droits de l'homme et des libertés fondamentales", në *La personne humaine, sujet de droit*, Paris, P.U.F., 1994, fq.101- 134.
- LEWIS- ANTHONY S. - "Case law of Article 11 of the European Convention on Human Rights", në *Freedom of association/Liberté d'association*, Dordrecht, Nijhoff, 1994, fq.27- 43.
- LIDDY J. - "The concept of family life under the ECHR", *E.H.R.L.R.* 1998, fq.15- 25.
- LIVINGSTONE S. - "Article 14 and the prevention of discrimination in the European Convention on Human Rights", *E.H.R.L.R.* 1997, fq.25- 34.
- Lord LESTER dhe PANNICK D. (ed.) - "Human rights law and practice", Londres, Butterworths, 1999, fq.524.
- LOUCAÏDES L.G. - "Freedom of expression and the right to reputation ", në *Avancées et confins actuels des droits de l'homme aux niveaux international, européen et national. Mélanges offerts à Silvio Marcus Helmons*, Bruxelles, Bruylant, 2003, fq.197- 217.
- LOUCAÏDES L.G. - "Personality and privacy under the European Convention on Human Rights", *B.Y.B.I.L.* 1990, fq.175- 197.
- LOUCAÏDES L.G. - "Questions of fair trial under the European Convention on Human Rights ", *H.R.L.R.* 2003, fq.27- 51.
- LUZZATTO R. - "La Corte europea dei diritti dell'uomo a la riparazione delle violazioni della Convenzione", në *Studi in onore di Manlio Udina*, Milan, Giuffrè, 1975, fq. 423- 445.
- MACDONALD R.St.J. - "The margin of appreciation in the jurisprudence of the European Court of Human Rights", në *Collected courses of the Academy of European Law*, Dordrecht, Nijhoff, vol. I- 2, 1992, fq.95- 161.
- MACOVEI M. - "Freedom of expression. A guide to the implementation of Article 10 of the European Convention on Human Rights", Strasbourg, Council of Europe, 2001, fq.60.
- MAHONEY P. - "Judicial activism and judicial self-restraint in the European Court of Human Rights: two sides of the same coin", *H.R.L.J.* 1990, fq.57- 88.
- MAHONEY P. - "The comparative method in judgments of the European Court of Human Rights: reference back to national law", në *Le rôle du droit compare dans l'avènement du droit européen. The role of comparative law in the emergence of European law*, Zurich, Schulthess, 2002, fq.143- 157.
- MAHONEY P. - "Universality versus subsidiarity in the Strasbourg case law on free speech: explaining some recent judgments", *E.H.R.L.R.* 1997, fq.364- 379.
- MAHONEY P. et SUNDBERG F. - "The European Convention on Human Rights: a case study of the international law response to violence", në *Mahoney K.E. et P. (ed.), Human rights in the twenty- first century: a global challenge*, Dordrecht, Nijhoff, 1993, fq.361- 376.



- MALINVERNI G. - "La réserve de la loi dans les conventions internationales de sauvegarde des droits de l'homme", R.U.D.H. 1990, fq.401- 409.
- MALINVERNI G. - "Le droit communautaire devant la Cour de Strasbourg ", në *Aux confins du droit. Essais en l'honneur du professeur Charles- Albert Morand*, Bâle, Faculté de droit de Genève/ Helbing et Lichtenhahn, 2001.
- MANGAN B. - "Protecting human rights in national emergencies: shortcomings in the European system and a proposal for reform", H.R.Q. 1988, fq.372- 394.
- MARCUS - HELMONS S. - "Commentaires sur l'évolution de la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", në *Mélanges en hommage à Louis Edmond Pettiti*, Bruxelles, Bruylant, 1998, fq.567- 578.
- MARCUS- HELMONS S. - "De certains principes d'interprétation appliqués par les juridictions internationales", në *Liber Amicorum Professor Omer de Raeymaecker*, Louvain, Presses de l'Université de Louvain, 1978, fq.141- 162.
- MARGUÉNAUD J.P. - "Inventaire raisonné des arrêts de la Cour européenne des droits de l'homme relatifs à l'environnement", R.E.D.E. 1998, fq.5- 19.
- MARGUÉNAUD J.P. - "La Cour européenne des droits de l'homme", Paris, Dalloz, 1997, fq.147.
- MARGUÉNAUD J.P. (ed.). - "CEDH et droit privé. L'influence de la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme sur le droit privé français", Paris, La Documentation française, 2001, fq.253.
- MARTINEZ- TORRÓN J. et NAVARRO- VALLS R. - "The protection of religious freedom in the system of the European Convention on Human Rights", *Helsinki Monitor*, 1998, n° 3, fq. 25- 37.
- MATSCHER F. - "Idéalisme et réalisme dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme ", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/ Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.881- 904.
- MATSCHER F. - "La notion de 'décision d'une contestation sur un droit ou une obligation (de caractère civil)' au sens de l'article 6, § 1, de la Convention européenne des droits de l'homme", në *Protecting human rights: the European dimension. Protection des droits de l'homme " la dimension européenne*, Cologne, Carl Heymanns, 1988, fq.395- 410.
- MATSCHER F. - "La notion de 'tribunal' au sens de la Convention européenne des droits de l'homme", në *Les nouveaux développements du procès équitable au sens de la Convention européenne des droits de l'homme*, Bruxelles, Bruylant et Nemesis, 1996, fq.29- 47.
- MATSCHER F. - "Les contraintes de l'interprétation juridictionnelle. Les méthodes d'interprétation de la Convention européenne des droits de l'homme ", në *Sudre F. (ed.), L'interprétation de la Convention européenne des droits de l'homme*, Bruxelles, Bruylant et Nemesis, 1998, fq.15- 40.
- MATSCHER F. - "Quarante ans d'activités de la Cour européenne des droits de l'homme ", *Recueil des cours de l'Académie de droit international*, t.270, 1997, fq.237- 398.
- MAURER B. - "Le principe du respect de la dignité humaine et la Convention européenne des droits de l'homme", Paris, La Documentation française, 1999, fq.556.
- MELCHIOR M. - "Notions 'vagues' ou 'indéterminées' et 'lacunes' dans la Convention européenne des droits de l'homme", në *Protecting human rights: the European dimension. Protection des droits de l'homme: la dimension européenne*, Cologne, Carl Heymanns, 1988, fq.411- 419.
- MERRILLS J.G. - "The development of international law by the European Court of Human Rights". Manchester. Manchester University Press, 1993, fq.265.
- MOLE N. - "Problèmes soulevés par certains aspects de la situation actuelle des réfugiés sous l'angle de la Convention européenne des droits de l'homme", B.D.H. 1996, fq.23- 52.
- MOLE N. - "Problèmes soulevés par certains aspects de la situation actuelle des réfugiés sous l'angle de la Convention européenne des droits de l'homme", Strasbourg, Éditions du Conseil de l'Europe, 1997, fq.68.
- MOLE N. et HARBY C. - "The right to a fair trial. A guide to the implementation of Article 6 of the European Convention on Human Rights", Strasbourg, Council of Europe, 2001, fq.65.
- MOSLER H. - "Problems of interpretation in the case law of the European Court of Human Rights", në *Essays on the development of the international legal order, in memory of Haro F. van Panhuys*, Leyde, Sijthoff & Noordhoff, 1980, fq.149- 167.
- MOWBRAY A. - "The role of the European Court of Human Rights in the promotion of democracy", *Public Law* 1999, fq.703- 725.
- MUBIALA M. - "L'interdiction de la torture et des peines ou traitements cruels, inhumains ou dégradants en droit international", *Revue roumaine d'études internationales* 1990, fq.79- 98.
- NOWICKI M.A. "Article 10 of the European Convention on Human Rights", B.D.H. juillet 1997, fq.63- 79.
- NOWICKI M.A. "NGOs before the European Commission and the Court of Human Rights", N.Q.H.R. 1996, fq.289- 302.
- NOWICKI M.A. "Rreth Konventës Europiane – Komentari i shkurtër i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut", *Botim i QSHDNJ*, Tiranë 2003.
- NOWICKI M.A. "Strasbourg and the position of the defence counsel", E.J.C. 1996, fq.335- 347.
- O'BOYLE M. - "Freedom from self- incrimination and the right to silence: a Pandora's box?", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/ Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Carl Heymanns, 2000, fq.1021- 1038.

- O'BOYLE M. - "Right to speak and the associate under Strasbourg case- law with reference to Eastern and Central Europe", *Connecticut Journal of International Law* 1993, fq.263- 287.
- O'BOYLE M. - "The margin of appreciation and derogations under Article 15: ritual incantation or principle?", *H.R.L.J.* 1998, fq.23- 29.
- O'BOYLE M. - "The reconstruction of the Strasbourg human rights system", *Dublin University Law Journal* 1992, fq.41 et s. *ne des droits de l'homme et de son application en Autriche et au Royaume - Uni*", Paris, Pedone, 2001, fq.384.
- OETHEIMER M. - "L'harmonisation de la liberté d'expression en Europe. Contribution à l'étude de l'article 10 de la Convention européen", Naples, Editoriale Scientifica, 1998.
- ORAA J. - "Human rights in states of emergency in international law", Oxford, Clarendon Press, 1992, fq.288.
- PALMIERI G.M. - "L'autorità di cosa giudicata delle sentenze della Corte europea dei diritti dell'uomo", në *Scritti in onore di Guido Gerin*, Padova, CEDAM, 1996, fq.327- 358.
- PASTORINO P. - "L'interpretazione della Convenzione europea dei Diritti dell'Uomo nella prassi della Commissione e della Corte di Strasburgo"
- PEKKANEN R. - "Criticism of the judiciary by the media", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/ Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq.1079- 1085.
- PELLONPÄÄ M. - "Reflections on the notion of 'deprivation of possessions' in Article 1 of the First Protocol to the European Convention on Human Rights", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/ Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq. 1087- 1105.
- PETITI L.E. - "Le rôle de l'équité dans le système juridique de la Convention européenne des droits de l'homme", në *Justice, médiation et équité*, Paris, La Documentation française, 1992, fq.35- 45.
- PETITI L.E. - "L'évolution de la jurisprudence européenne en matière pénale ", *Revue pénitentiaire* 1993, fq.147- 149.
- PETITI L.E. dhe DE SCHUTTER O. - "Le rôle des associations dans le cadre de la Convention européenne des droits de l'homme ", *J.T.D.E.* 1996, fq.145- 150.
- PETITI L.E., DECAUX E. dhe IMBERT P.- H. (ed.). - "La Convention européenne des droits de l'homme. Commentaire article par article", Paris, Economica, 1995, fq.1230.
- PHILLIPS B. - "The long road to the European Court of Human Rights", *New Law Journal* 1994, fq.1126- 1129.
- PINHEIROFARINHA J. et PETZOLDH. - "La justice constitutionnelle dans le cadre des pouvoirs (fonctions) de l'État à la lumière des modalités, du contenu et des effets des décisions sur la constitutionnalité des normes juridiques: la Cour européenne des droits de l'homme", në *Justiça constitucional e espécies, conteúdo e efeitos das decisões sobre a constitucionalidade de normas*, Lisbonne, Tribunal constitucional, 1987, 4<sup>e</sup> partie, fq.296- 336.
- POLAKIEWICZ J.G. - "The implementation of the ECHR and of the decisions of the Strasbourg Court in Western Europe", *A.E.H.R.Y.B.* 1992, fq.147- 171.
- PREBENSEN S.C. - "Evolutive interpretation of the European Convention on Human Rights", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/ Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq. 1123- 1137.
- PUECHAVY M. - "Les fonctionnaires et l'article 6, 1<sup>o</sup> de la Convention européenne des droits de l'homme", në *Les droits de l'homme au seuil du troisième millénaire. Mélanges en hommage à Pierre Lambert*, Bruxelles, Bruylant, 2000, fq.673- 692.
- PUSTORINO P. - "L'interpretazione della Convenzione Europea dei diritti dell'uomo nella prassi della Commissione e della Corte di Strasburgo", Editoriale Scientifica, Napoli, 1998,
- RAYMOND J. - "A contribution to the interpretation of Art.13 of the European Convention on Human Rights", *H.R.R.* 1980, fq.161- 175.
- REID K. - "A practitioner's guide to the European Convention on Human Rights", Londres, Sweet & Maxwell, 1998, li- fq.503.
- REID, K. *A Practitioner's Guide to the European Convention on Human Rights*- Sweet & Maxwell, 2015- 5th Edition
- RENUCCI J.- F. - "Le droit au juge dans la Convention européenne des droits de l'homme", në Rideau J. (ed.), *Le droit au juge dans l'Union européenne*, Paris, L.G.D.J., 1998, fq.131- 140.
- RENUCCI J.- F. - "Les témoins anonymes et la Convention européenne des droits de l'homme ", *R.P.D.P.* 1998, fq.3 et s.
- RESS G. - "Effets des arrêts de la Cour européenne des droits de l'homme en droit interne et pour les tribunaux nationaux", në *Actes du cinquième colloque international sur la Convention européenne des droits de l'homme (Francfort, 9- 12 avril 1980)*, Paris, Pedone, 1982, fq.235- 313.
- RIDEAU J. - "L'influence réciproque des jurisprudences de la Cour de justice des Communautés européennes, de la Cour européenne des droits de l'homme et des cours constitutionnels en matière de droits fondamentaux", në *Cours constitutionnelles européennes et droits fondamentaux (nouveau bilan 1981- 1991)*, Aix- en- Provence, 1991.
- RIGAUX F. - "Interprétation consensuelle et interprétation évolutive", në Sudre F. (ed.), *L'interprétation de la Convention européenne des droits de l'homme*, Bruxelles, Bruylant et Nemesis, 1998, fq.41- 62.



- RIGAUX F. - "La protection de la vie privée et des autres biens de la personnalité", Bruxelles, Bruylant, et Paris, L.G.D.J., 1990, fq.849.
- ROBERT J. - "Droits de l'homme et libertés fondamentales", Paris, Montchrestien, 1996, fq.855.
- ROBERTSON A.H. et MERRILLS J.G. - "Human Rights in Europe. A study of the European Convention on Human Rights", Manchester et New-York, Manchester University Press, 1993, fq.422.
- ROUGET D. - "Le respect du droit extraditionnel et les 'extraditions déguisées", R.T.D.H. 1999, fq. 169- 197.
- RUDLOFF S. - "Droits et libertés de l'avocat dans la Convention européenne des droits de l'homme", Bruxelles, Bruylant, 1995, fq.198.
- RYSSDAL R. - "Aperçu de la jurisprudence récente de la CEDH", *Courrier juridique des finances*, novembre 1997, fq.1- 4.
- RYSSDAL R., BERNHARDT R. et WIARDA G. - "European Court of Human Rights", në *Judging the world. Law and politics in the world's leading courts*, Sidney, Butterworths, 1988, fq.509- 520.
- SACCUCCI A. - "Profili di tutela dei diritti umani", *Tra Nazioni Unite e Consiglio d'Europa*, con prefazione di Gionavvi Conso, Ristampa riveduta e aggiornata, CEDAM, 2005.
- SALVIA M. de . - "Esaurimento delle vie di ricorso interne e ricorsi individuali: la giurisprudenza della Commissione e della Corte dei diritti dell'uomo", *Riv.I.D.U.* 1988, fq.33- 42.
- SALVIA M. de . - "Il terrorismo e la Convenzione europea dei diritti dell'uomo", *Riv.I.D.U.* 1989, fq.21- 30.
- SALVIA M. de . - "L'élaboration d'un 'ius commune' des droits de l'homme et des libertés fondamentales dans la perspective de l'unité européenne: l'œuvre accomplie par la Commission et la Cour européennes des droits de l'homme", në *Protecting human rights: the European dimension. Protection des droits de l'homme: la dimension européenne*, Cologne, Carl Heymanns, 1988, fq.555- 563.
- SALVIA M. de . - "La Convention européenne des droits de l'homme et le crime organisé", *B.D.H.* 1996, fq.155- 170.
- SALVIA M. de . - "La notion de proportionnalité dans la jurisprudence de la Commission et de la Cour européennes des droits de l'homme", *Diritto comunitario e degli scambi internazionali* 1978, fq.463- 493.
- SALVIA M. de . - "Minoranze storiche e 'nuove' minoranze: diritti, doveri e spirito di tolleranza nella giurisprudenza della Commissione e della Corte europea dei diritti dell'uomo", *Riv.I.D.U.* 1992, fq.148- 158.
- SALVIA M. de . - "Sistema europeo e sistemi nazionali di protezione dei diritti dell'uomo: subordinazione, sussidiarietà?", *Riv.I.D.U.* 1994, fq.24- 37.
- SALVIA M. de . - "Compendium de la CEDH", *Les principes directeurs de la jurisprudence relative a la Convention européenne des droits de l'homme*, Vol.1, Jurisprudence 1960 a 2002, Editions N.P.Engel, Kehl, Strasbourg, Arlington, Va. 2003.
- SALVIA M.de . - "Compendium de la CEDH". Vol.1.Jurisprudence 1960 à 2002, Kehl, Engel, 2003, XIII- fq.865.
- SALVIA M.de . - "La Convenzione europea dei Diritti dell'Uomo", Naples, Editoriale Scientifica, 2001, fq.267.
- SALVIA M.de . - "Lineamenti di diritto europeo dell'uomo", Padova, CEDAM, 1991, fq.476.
- SCHABAS, X. *The European Convention on Human Rights: A Commentary- Oxford Commentaries on International Law- Oxford University Press*, 2015
- SCHERMERS H.G. - "Human rights and free movement of persons: the role of the European Commission and Court of Human Rights", në *Free movement of persons in Europe, Legal problems and experiences*, Dordrecht, Nijhoff, 1993, fq.235- 247.
- SCHLETTE V. - "Les interactions entre les jurisprudences de la Cour européenne des droits de l'homme et de la Cour constitutionnelle fédérale allemande", *R.F.D.C.* 1996, fq.747- 768.
- SCHOKKENBROECK J. - "The prohibition of discrimination in Article 14 of the Convention and the margin of appreciation", *H.R.L.J.* 1998, fq.20- 23.
- SIMOR, J. *Human Rights Practice- General Editor.* Sweet and Maxweel- October 2017
- SIMPSON B.A.W. - "Human Rights and End of Empire- Britain and the Genesis of the European Convention" - Oxford, 2004, fq. 1177.
- SOYER J.C. - "L'article 7 de la Convention existe-t- il?", në *Protection des droits de l'homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/ Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq. 1337- 1346.
- SOYER J.C. et SALVIA M.de . - "Convention européenne des droits de l'homme. Le recours individuel supranational. Mode d'emploi", Paris, L.G.D.J., 1992, fq.287.
- SPERDUTI G. - "De la notion de 'délai raisonnable' qualifiant la durée de la détention provisoire selon l'article 5, § 3, de la Convention européenne des droits de l'homme", *R.D.H.* 1976, fq.865- 868.
- SPIELMANN D. - "Human rights case law in the Strasbourg and Luxembourg Courts: conflicts, inconsistencies, and complementarities", në Alston P. (ed.), *The EU and human rights*, Oxford, Oxford University Press, 1999, fq.757- 780.
- SPIELMANN D. - "L'effet potentiel de la Convention européenne des droits de l'homme entre personnes privées", Bruxelles, Bruylant, 1995, fq.160.
- SPIELMANN D. - "The right of the accused to the counsel of his choice. Myth or reality?", *B.D.H.* septembre 2002, fq.106- 118.
- STARACE V. - "La Convenzione europea dei diritti dell'uomo e l'ordinamento italiano", Bari, Levante, 1992, fq.299.
- STARMER K. - "European Human Rights Law", *The Human Rights Act 1998 and ther European Convention on Human Rights*, With a foreword by Lord Justice Sedley, Legal Action group 1999.

- STARMER K. with Iain Byrne with a foreword by Lord Irving of Lairg, Lord Chancellor – “Blackstone’s Human Rights Digest”, King’s College, University of London, Blackstone Press Limited, 2001.
- SUDRE F. – “A propos du dynamisme interprétatif de la Cour européenne des droits de l’homme”, J.C.P. 11 juillet 2001, I 335, fq.1365- 1368.
- SUDRE F. et autres – “Chronique de jurisprudence de la Cour européenne des droits de l’homme: affaires françaises (2000)”, R.D.P. 2001, fq.657- 692.
- SUDRE F. – “Droit international et européen des droits de l’homme”, Paris, P.U.F., 2001, fq.536.
- SUDRE F. – “La Convention européenne des droits de l’homme”, Paris, P.U.F., 1997, fq.128.
- SUDRE F. – “Les grands arrêts de la Cour européenne des droits de l’homme”, Paris, P.U.F., 1997, fq.128.
- SUDRE F. et autres – “Les grands arrêts de la Cour européenne des droits de l’homme”, Paris, P.U.F., 2003, XIV- fq.617.
- SUDRE F. et autres. – “Les concepts autonomes de la Convention européenne des droits de l’homme”, Montpellier, Institut de droit européen des droits de l’homme, 1997, fq.136.
- SUDRE F. – “Droit de la Convention européenne des droits de l’homme – Chronique d’actualité”, J.C.P. 2 février 2000, I. 203.
- SUDRE F. – “Existe- t- il un ordre public européen?”, nê Tavernier P. (ed.), *Quelle Europe pour les droits de l’homme?*, Bruxelles, Bruylant, 1996, fq.39- 80.
- SUDRE F. – “La protection des droits sociaux par la Convention européenne des droits de l’homme”, nê *Les nouveaux droits de l’homme en Europe*, Bruxelles, Bruylant, 1999, fq.103- 126.
- SUDRE F. – “Le renouveau jurisprudentiel de la protection des étrangers par l’article 3 de la Convention européenne des droits de l’homme”, nê Fulchiron H. (ed.), *Les étrangers et la Convention européenne de sauvegarde des droits de l’homme et des libertés fondamentales*, Paris, L.G.D.J. 1999, fq.61 et s.
- SUDRE F. – “Les ‘obligations positives’ dans la jurisprudence européenne des droits de l’homme”, nê *Protection des droits de l’homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq. 1359- 1376.
- SUDRE, F. *Droit européen et international des droits de l’homme*- Presses Universitaires de France- P.U.F.- 13e édition- 2016
- SULLIGER D. – “L’épuisement des voies de recours internes en droit international général et dans la Convention européenne des droits de l’homme”, Lausanne, Imprimerie des Arts et Métiers, 1970, fq.201.
- SUNTINGER W. – “The principle of non- refoulement: looking rather to Geneva than to Strasbourg?”, A.J.P.I.L. 1995, fq.203- 225.
- SHELTON D. – “Remedies in international human rights law”, Oxford, Oxford University Press, 1999, fq.550.
- TAVERNIER P. – “La Convention européenne des droits de l’homme et la distinction droit public – droit privé”, nê *Liber amicorum Marc- André Eissen*, Bruxelles, Bruylant, et Paris, L.G.D.J., 1995, fq.399- 413.
- TAVERNIER P. – “La Cour européenne des droits de l’homme et la mise en œuvre du droit international de l’environnement”, *Actualité et droit international*, juin 2003, fq.8.
- TAVERNIER P. – “La notion de propriété en droit européen”, nê *La propriété en mutation*, Rouen, Presses universitaires de Rouen, 1997, fq.23- 30.
- TITIUN P. – “La Cour européenne des droits de l’homme et les pays d’Europe centrale et orientale: premières affaires”, nê *Les droits de l’homme au seuil du troisième millénaire. Mélanges en hommage à Pierre Lambert*, Bruxelles, Bruylant, 2000, fq.871- 895.
- TOMA R. – “La réalité judiciaire de la Cour européenne des droits de l’homme. Activisme et retenue judiciaires”, Baden- Baden, Nomos, 2003, fq.271.
- TOMUSCHAT C. – “Just satisfaction under Article 50 of the European Convention on Human Rights”, nê *Protection des droits de l’homme: la perspective européenne. Protecting human rights: The European perspective. Mélanges à la mémoire de/Studies in memory of Rolv Ryssdal*, Cologne, Carl Heymanns, 2000, fq. 1409- 1430.
- TOMUSCHAT C. – “What is a ‘breach’ of the European Convention on Human Rights?”, nê *The dynamics of the protection of human rights in Europe. Essays in honour of Henry Schermers*, Vol. III, Nijhoff, 1994, fq 119- 152
- TULKENS F. et CALLEWAERT J. – “La Cour de justice, la Cour européenne des droits de l’homme et la protection des droits fondamentaux”, nê Dony M. et Bribosia E. (ed.), *L’avenir du système juridictionnel de l’Union européenne*, Bruxelles, Éditions de l’Université de Bruxelles, 2002, fq.177- 203.
- VALTICONS N. – “La Cour européenne des droits de l’homme et sa spécificité judiciaire dans le cadre des différents systèmes de protection des droits de l’homme”, in *Les hommes et l’environnement. En hommage à Alexandre Kiss*, Paris, Frison- Roche, 1998, fq.207- 219.
- VALTICONS N. – “La jurisprudence de la Cour européenne des droits de l’homme sur l’art.3 de la Convention européenne des droits de l’homme”, nê Cassese A. (ed.), *The international fight against torture. La lutte internationale contre la torture*, Baden- Baden, Nomos, 1991, fq.121- 134.
- VAN DIJK, P. *Theory and Practice of the European Convention on Human Rights*- Intersentia- 4th Edition
- VAN DROOGHENBROECK S. – “L’article 17 de la Convention européenne des droits de l’homme est- il indispensable?”, R.T.D.H. 2001, fq.541- 566.
- VAN DROOGHENBROECK S. – “La Convention européenne des droits de l’homme (trois années de jurisprudence de la Cour européenne (1999- 2001)”, Bruxelles, Larcier, 2003, fq.288.

- VANDROOGHENBROECKS. - "La proportionnalité dans le droit de la Convention européenne des droits de l'homme", Bruxelles, Bruylant et Publications des Facultés universitaires Saint- Louis, 2001, V-fq.786.
- VASAK K. - "La Convention européenne des droits de l'homme", Paris, L.G.D.J., 1964, fq.327.
- VELU J. - "A propos de l'autorité jurisprudentielle des arrêts de la Cour européenne des droits de l'homme: vues de droit comparé sur des évolutions en cours" in *Nouveaux itinéraires en droit. Hommage à François Rigaux*, Bruxelles, Bruylant, 1993, fq.527- 562.
- VENICE COMMISSION - "Bulletin on constitutional case - law", special edition, Leading cases ECHR, 1998, fq.186.
- WACHSMANN P. - "La prééminence du droit dans la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme", në *Le droit des organisations internationales. Recueil d'études à la mémoire de Jacques Schwob*, Bruxelles, Bruylant, 1997, fq.241-286.
- WACHSMANN P. - "Une certain marge d'appréciation. Considérations sur les variations du contrôle européen en matière de liberté d'expression ", në *Les droits de l'homme au seuil du troisième millénaire. Mélanges en hommage à Pierre Lambert*, Bruxelles, Bruylant, 2000, fq.1016- 1042.
- WELLER M. - "The right of minorities", *Oxford Commentaty on International Law, A Commentaty on the European Framework Convention for the Protection of National Minorities*, European Centre for Minority Issues, University of Cambridge, Oxford University Press, 2005.
- WIEDERKEHR M.O. - "L'œuvre du Conseil de l'Europe dans le domaine du droit de l'asile et des réfugiés", në *Droit d'asile et des réfugiés*, Paris, Pedone, 1997, fq.197- 215.
- WILDHABER L. - "Les droits culturels et la jurisprudence des organes de la Convention européenne des droits de l'homme ", në *Colloque international sur la Convention européenne des droits de l'homme*, Strasbourg, Éditions du Conseil de l'Europe, 1996, fq.67- 73.
- WILDHABER L. - "Nouvelle jurisprudence concernant l'art. 8 CEDH", në *Mélanges en l'honneur de Jacques- Michel Grossen.*, Bâle, Helbing & Lichtenhan, 1992, fq.97- 106.
- WILDHABER L. - "Right to education and parental rights ", në *The European system for the protection of human rights*, Dordrecht, Nijhoff, 1993, fq.531-551.
- WYLER E. - "Victime 'actuelle' et victime 'virtuelle' d'une violation des droits de l'homme dans la jurisprudence relative à l'art.25 de la Convention européenne des droits de l'homme", *Revue suisse de droit international et de droit européen* 1993, fq.3- 38.
- YOROW H.C. - "The margin of appreciation doctrine in the dynamics of European human rights jurisprudence", La Haye, Nijhoff, 1996, fq.232.



**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Bianku, Ledi; Kumbaro, Odeta  
Jurispudenca e Gjykatës së Strasburgut / Ledi Bianku.  
Tiranë: Dollonja, 2017  
904 f. 17.6x25.0 cm.  
ISBN 978-9928-4432-4-3

1.E drejta ndërkombëtare 2.Gjykata e Strasburgut  
3.Të drejtat e njeriut 4. Vendime gjyqësore

341.64  
341.231.14

